AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare/ International scholarly conference / Conferenza scientifica internazionale

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI

ALBANISTIC STUDIES IN ITALY

GLI STUDI ALBANISTICI IN ITALIA

PRISHTINË

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare/ International scholarly conference / Conferenza scientifica internazionale

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI

ALBANISTIC STUDIES IN ITALY

GLI STUDI ALBANISTICI IN ITALIA

Prishtina 2019, 22-23 Tetor, October, Ottobre

Përgatiti për botim/ Prepared for edition/ A cura di: akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës/ Organisation board/ Consiglio della Conferenza:
Rexhep Ismajli, Seit Mansaku, Francesco Altimari, Eqrem Basha, Bardh Rugova

PRISHTINË
2020

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

Konferencë shkencore ndërkombëtare/ International scholarly conference / Conferenza scientifica internazionale

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI

ALBANISTIC STUDIES IN ITALY

GLI STUDI ALBANISTICI IN ITALIA

Prishtina 2019, 22-23 Tetor, October, Ottobre

Përgatiti për botim/ Prepared for edition/ A cura di: akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës/ Organisation board/ Consiglio della Conferenza: Rexhep Ismajli, Seit Mansaku, Francesco Altimari, Eqrem Basha, Bardh Rugova

Editor: Academician Eqrem Basha, Secretary of the Section of Linguistics and Literature.

PRISHTINA
2020

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare/ International scholarly conference / Conferenza scientifica internazionale

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI

ALBANISTIC STUDIES IN ITALY

GLI STUDI ALBANISTICI IN ITALIA

Prishtina 2019, 22-23 Tetor, October, Ottobre

Përgatiti për botim/ Prepared for edition/ A cura di: akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës/ Organisation board/ Consiglio della Conferenza:
Rexhep Ismajli, Seit Mansaku, Francesco Altimari, Eqrem Basha, Bardh Rugova

Redaktor: Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

PRISHTINË
2020

Copyright © ASHAK

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI
ALBANISTIC STUDIES IN ITALY
GLI STUDI ALBANISTICI IN ITALIA

PËRMBAJTJA – INDICE - CONTENTS

MEHMET KRAJA: FJALË PËRSHËNDETËSE 11

REXHEP ISMAJLI - FRANCESCO ALTIMARI: STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI 13

EMANUELE BANFI: VITTORE PISANI E LA POSIZIONE DELLA LINGUA ALBANESE TRA LE LINGUE INDEUROPEE 21

SEIT MANSAKU: PROBLEMI I ORIGJINËS SË GJUHËS SHQIPE NË VEPRËN E VITTORE PISANI-T.....31

REXHEP ISMAJLI: STUDIUES ITALIANË PËR PREJARDHJEN E GJUHËS SHQIPE 39

FLORESHA DADO: MBI STUDIMIN E MAURO GERACIT: *PROMETEO IN ALBANIA, PASSAGGI LETERARIA E POLITICI DI UN PAESE BALCANICO*.....63

FRANCESCO ALTIMARI: BALLKANIZMA DHE ITALO-ROMANIZMA NË DISA NDËRTIME FOLJORE ASPEKTORE TË ARBËRISHTES SË ITALISË.....69

LEONARDO M. SAVOIA AND BENEDETTA BALDI: IMPERATIVE IN GHEG, TOSK AND ARBËRESH: A COMPARISON.....83

JOHN TRUMPER: THE ROLE OF ALBANOID GROUPS (ALBANIAN AND ITALOALBANIAN) IN LANGUAGE TRANSMISSION (ITALY AND CALABRIA AS EXEMPLUM) 101

SABRI HAMITI: ERNEST KOLIQI: "SHÊJZAT" E LETËRSISË SHQIPE 109

MATTEO MANDALÀ: MBI MËRGIMIN ARBËRESH NË ITALI (SHEK. XIV-XVIII) 129

SHABAN SINANI: KADARE NË STUDIMET ITALIANE 165

KUJTIM M. SHALA: LATINITETI *YNË*..... 175

DHURATA SHEHRI: "STORIA DELLA LETTERATURA ALBANESE" APO "HISTORI E LETËRSISË SHQIPTARE"..... 187

PERSIDA ASLLANI - BRUNILDA DASHI: STUDIMET KRITIKE PËR LETËRSINË SHQIPE TË GIUSEPPE GRADILONES..... 199

BASHKIM KUÇUKU: IMPAKTI I NJË VEPRE HISTORIOGRAFIKE NË HISTORITË E LETËRSISË SHQIPE DHE NË TEKSTE TË TJERË..... 209

OSMAN GASHI: LETËRSIA SHQIPE NË FOKUSIN E KRITIKËS SË ANTONINO GUXETËS 215

GËZIM GURGA: FRANCESCO SOLANO DHE STUDIMET ARBËRESHE GJATË GJYSMËS SË DYTË TË SHEK. XX 223

BLERINA SUTA: BOTIMI ITALISHT I KANUNIT, PËRGATITUR NGA DODAJ-FISHTA-SCHIRÒ (1941): DISA KONSIDERATA PËR BOTIMIN ITALISHT TË *PRILLIT TË THYER* TË I. KADARESË 231

MIMOZA PRIKU: ATENEU PADOVAN DHE ALBANOLOGJIA 251

NICOLA SCALDAFERRI: ARKIVAT TINGULLORË NË ITALI DHE MATERIALET MBI FSHATRAT ARBËRESHE: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM 263

MERITA HYSA: KONTAKTET GJUHËSORE DHE SHFAQJET IDENTITARE NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE NË ITALI 271

EVALDA PACI: RRETH DISA KONTRIBUTEVE TË VEÇANTA SHKENCORE MBI FIGURËN E GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT NË TREVAT ITALOFONE 281

VICTOR A. FRIEDMAN: ARBËRISHTJA E ITALISË, ERIK HAMPI DHE HISTORIA E GJUHËS SHQIPE, E ALBANISTIKËS DHE E LINGUISTIKËS 291

IMRI BADALLAJ: MARTIN CAMAJ NË KËNDVËSHTRIMIN E STUDIMEVE ITALO-ARBËRESHE 295

REMZI PËRNASKA, **TOMORR PLANGARICA**: LUIGJ-LYSJEN BONAPARTI – GJUHËTARI QË VËZHGOI, PËRQASI E DËSHMOI EDHE PËR GJUHËN SHQIPE DHE TË FOLMET E SAJ 303

ALJULA JUBANI: STUDIME TË FONETIKËS EKSPERIMENTALE MBI SHQIPEN NË UNICAL DHE KONTRIBUTI I PROF. JOHN TRUMPER 315

BARDH RUGOVA: VENDI I THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE – KONTRIBUTI I STEFANO CANALISIT 323

VALBONA SINANAJ: KONTRIBUTI I PAOLO DI GIOVINES PËR ALBANOLOGJINË 331

ANILA OMARI: LE IDEE DI DEMETRIO CAMARDA SULLA LINGUA LETTERARIA ALBANESE - UN APPROCCIO RISORGIMENTALE 339

GIUSEPPINA TURANO: KONTRIBUTI I STUDIUESVE ITALIANË PËR MORFOSINTAKSËN E GJUHËS SHQIPE 349

SHKUMBIN MUNISHI: STUDIMET E EDA DERHEMIT PËR ARBËRISHTEN E PIANA DEGLI ALBANESI TË SICILISË 365

RREZARTA DRAÇINI: GEGËRISHTJA PËRMES STUDIMEVE TË LEONARDO M. SAVOIA..... 375

GENC LAFE: MBI (RI)PËRCAKTIMIN E ITALIANIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE 383

TEUTA ABRASHI: RRETH DISA ÇËSHTJEVE TË DISKUTUESHME TË SINTAGMËS EMËRORE TË SHQIPES 407

ARDIAN NDRECA: REVISTA "SHÊJZAT" VOTËR E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË ITALI (1957-1978) 437

RUSANA BEJLERI: VENDI I ANTOLOGJISË NË STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI 443

MAJLINDA BREGASI: NJË VEND PËR ANGELA CIRRINICONE-N NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE..... 449

BERTON SULEJMANI: FRANCESCO ALTIMARI PËR HABITOREN 459

EMILIA CONFORTI: IL CONTRIBUTO DI SANTORI PER LA LINGUA ALBANESE..... 465

BEGZAD BALIU: VLERËSIME TË PROFESOR JUP KASTRATIT PËR ALBANOLOGJINË E MJEDISIT ARBËRESH TË ITALISË..... 471

MELIZA KRASNIQI: ROMA E MUSINE KOKALARIT 489

AGRON Y. GASHI: DE RADA SIPAS ARSHI PIPËS 503

ABDULLA REXHEPI: VEPRA E NAIM FRASHËRIT NË PERSPEKTIVËN ITALIANE 515

SHPËTIM ELEZI: STUDIUESIT ITALIANË PËR SHQIPEN DHE SHQIPTARËT NË *FJALORIN ENCIKLOPEDIK TË KOSOVËS*..... 523

ANTONINO GUZZETTA: CENNI SULLA STORIA DELLA CATTEDRA DI LINGUA E LETTERATURA ALBANESE PRESSO L'UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI PALERMO..... 537

LUMNIJE JUSUFI: GELEHRTE ZWISCHEN WISSENSCHAFT UND POLITIK. AM BEISIEL VON ERNEST(O) KOLIQI (1903-1975)..... 545

PROGRAMI I KONFERENCËS..... 559

PAMJE NGA KONFERENCA..... 563

Mehmet KRAJA,
Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

FJALË PËRSHËNDETËSE

Të nderuar albanologë, akademikë, të nderuar miq,

Pavarësisht nga rrethanat politike, herë më shumë e herë aspak të favorshme, studimet në fushën e albanologjisë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një shtyllë e rëndësishme e punës shkencore në Kosovë, një segment i kërkimeve shkencore që ka njohur vazhdimësi dhe ngritje pa ndërprerje.

Edhe më shumë se kaq, në shtatëdhjetë vjetët e fundit albanologjia në Kosovë u bë sinonim i identitetit dhe i përkatësisë, një fushë ku ndodhën përplasje të mëdha dhe ku albanologjisë ndonjëherë iu dha edhe roli i armikut të shtetit, madje edhe të një ideologjie të tërë.

Pavarësisht lëndimeve që mori në këto rrethana shtrëngese, albanologjia në Kosovë ia doli të mbajë rreth vetes studiues të pandikuar, të cilët i bënë ballë qoftë reperkusionit, qoftë përfshirjeve politike dhe ideologjike. Studimet albanologjike në Kosovë u bënë ballë edhe sfidave bashkëkohore: avancimit të metodave dhe modernizimit të ideve dhe pikëpamjeve.

Në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mendojmë se studimet albanologjike kanë njohur një fazë ngritjeje në këto njëzet vitet e fundit. Janë botuar një numër i konsiderueshëm veprash të kësaj fushe, të autorëve traditës dhe atyre bashkëkohorë, të cilat e kanë pasuruar fondin e përgjithshëm të veprave albanologjike. Përmes studimeve në këtë fushë tashmë është vendosur një komunikim shkencor i qëndrueshëm i Kosovës me botën, veçmas me disa me qendra të rëndësishme studimore: institute, universitete, katedra etj. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe dy konferencat e mëhershme shkencore, për studimet albanistike në Amerikë dhe në vendet ku flitet gjermanisht. Kjo është konferenca e tretë që mbahet me këtë tematikë dhe besoj se edhe kjo do të jetë një lloj kurore mbi komunikimin e gjatë miqësor midis kulturës shqiptare dhe asaj italiane.

E kam vënë në parantezë këtë paragraf, me një lloj dileme, nëse duhet thënë këtu ose jo. Por duke parë këtu një numër studiuesish të rinj, më duhet ta them nga kjo foltore, se albanologët e rinj të Prishtinës, aty ku gjendet një numër syresh, siç është Universiteti i Prishtinës me filialet e tij në qendrat e tjera të

Kosovës, përballen me një mosnjohje të pashembullt: detyrohen që referencat shkencore bibliografike për ngritje në tituj universitarë t'i krijojnë në botime shkencore jashtë Kosovës, në një kohë që Prishtina tashmë ka arritur të funksionojë si njëra nga qendrat e rëndësishme albanologjike, të cilës i referohen pothuajse të gjithë studiuesit e albanologjisë dhe të ballkanistikës.

Tani, në fund, nuk më mbete gjë tjetër, përveçse t'ju uroj ligjërime të mbara dhe diskutime të frytshme.

Rexhep ISMAJLI - Francesco ALTIMARI, Prishtinë-Cosenza

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI

Kolege dhe Kolegë të nderuar,

Jemi sot këtu në hapje të Konferencës shkencore ndërkombëtare "**Studimet albanistike në Itali**", që vjen në vijim të dy konferencave të mëparme të ngjashme të organizuara nga kjo Akademi: 1. *Studimet albanistike në Amerikë*, dhe në vitin 2017 AShAK dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë po në Prishtinë organizuan Konferencë me temën *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*, për të cilën pati interesim dhe pjesëmarrje të gjerë. Me këto konferenca synohej të arriheshin dy qëllime kryesore: të evidentoheshin, të theksoheshin rezultatet e arritura në studimet për gjuhën shqipe në Amerikë, pastaj në botën gjermanishtfolëse dhe njëherësh të aktualizohej nevoja për rritjen e këtij interesi në rrethanat e reja. Konferencat dolën rezultative dhe në vijim u pa se kishte nevojë të ndërmerreshin aktivitete të ngjashme për hapësira të tjera. U pa qartë se kishte shumë nevojë për paraqitje të përbashkëta të sa më shumë studiuesve të hapësirave përkatëse në mënyrë që të nxiteshin më tej dialogë e diskutime. Punimet e konferencave u vlerësuan nga pjesëmarrësit e nga vëzhguesit, ndërsa Aktet e tyre u përmblodhën në vëllime të gjera.

Në vijim të kësaj përvoje Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i AShAK-ut vendosi të organizojë një konferencë me tematikën *Studimet albanistike në Itali*, ku po ashtu kemi të bëjmë me një traditë të hershme dhe të dyfishtë: me traditën e hershme të shkrimit dhe të studimit të gjuhës shqipe nga arbëreshët dhe me traditën po kështu të hershme të studimeve albanistike në kuadër të dijeve përkatëse italiane, të dyja të ndërthurura.

Tradita studimore albanistike arbëreshe përbën një pjesë të rëndësishme të studimeve albanistike dhe të kulturës shqiptare, por njëherësh lidhet me shumë fije me traditat studimore italiane. Ndërkaq, në Itali studimet për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët kanë qenë të gjera dhe janë varur nga shumë aspekte të zhvillimeve shkencore në atë vend. Gjithsesi ato kanë qenë të ndërlidhura me interesimin që mund të kenë pasur italianët për fqinjët e tyre arbëreshë në Itali, por edhe për fqinjët pak më të largët përtej Adriatikut, kështu që ato kanë shprehur interes të gjallë dhe për faza më të hershme të studimeve të popullatave fqinje më të hershme në botën romane (ilirët, mesapët, trakasit, dardanët), apo

edhe të tërësisë së botës ballkanike më vonë. Raportet e shqipes me latinishten, me italishten dhe me romanitetin tjetër në Ballkan kanë qenë vazhdimisht në vëmendjen e studiuesve italianë. Nuk është e rastit që pikërisht në Itali kemi botime me peshë për traditën e studimit e të dokumentimit të shqipes, si Fjalori i Frang Bardhit më 1635 apo *Gramatika* e Francesco Maria Da Lecce-s 1716, për të vijuar pastaj me studime të përdegëzuara në shekujt e më vonë. Periudha e gjuhësisë historike solli interesime për shqipen e shqiptarët në nivele të dijes ndërkombëtare që vinte nga Italia: emra të mëdhenj të shkencës gjuhësore si Bernardino Biondelli, Graziadio Isaia Ascoli, Matteo Bartoli, Carlo Tagliavini, Vittore Pisani, Giuliano Bonfante, Francesco Ribezzo, Gerhard Rohlfs, Ettore Rossi, Giovan Battista Pellegerini, Giuseppe Valentini, Carlo de Simone e deri te Tullio De Mauro, Leonardo Savoia, Emanuele Banfi, etj. sot, janë marrë dhe me studime albanistike më vete dhe në raportet e shqipes me gjuhët përreth në lashtësi apo më vonë. Arbëreshë të shquar si Giorgio Guzzetta, Nicolo Chetta, Angelo Masci, Vincenzo Dorsa, G. Crispi, Demetrio Camarda, Jeronim de Rada, Mrco La Piana, Nilo Catalano, Gaetano Petrotta, Matteo Sciambra, Giuseppe Schirò Junior, Francesco Solano, Emanuele Giordano, Antonino Guzetta, Angela Cirrincione dhe, më lejoni të shtoj unë R. I.), brezi i sotëm i studiuesve në Cosenza, në Palermo, në Napoli, në Romë, në Leçe, në Venezia, etj. dhe shumë të tjerë kanë dhënë ndihmesa me vlerë për këto studime, ashtu si shumë studiues shqiptarë, të përmendim me këtë rast Ernest Koliqin, Karl Gurakuqin, Namik Ressulin, Luigj Marlekajn, Arshi Pipën, Martin Camajn, etj. janë shquar me ndihmesa me vlerë për studimet arbëreshe/ shqiptare. Studimet e shqipes në Itali kanë qenë të ndërlidhura prej kohësh me botën arbëreshe dhe me interesimet e saj për ta ruajtur gjuhën, por ato janë zhvilluar me një intensitet të shtuar dhe në qendra studimore italiane. Sot kemi një sërë universitetesh italiane ku zhvillohen studime për gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Akademia ka menduar se tash është koha për ta shtruar për diskutim tematikën e tillë në një konferencë shkencore, në të cilën mund të bëhen vrojtime për zhvillimet e deritashme, bilance kritike, ashtu si dhe të shihen mundësitë e zhvillimit të këtyre studimeve në të ardhmen, sidomos në kontekstin e ri të raporteve shoqërore e shtetërore të shqiptarëve nga shtete të ndryshme me vendet kaq qendrore europiane, si Italia. Synohet që konferenca të përqendrohet në tematikat albanistike, por duke lënë mundësinë edhe për zgjerime albanologjike, fare të natyrshme në raste të këtilla.

Dy botimet e rëndësishme që qysh tash duan përmendur për historikun e studimeve shqiptare në Itali, *Dictionnarium latino-epiroticvm* i Franciscus

Blanchum 1635 dhe *Osservazzioni grammaticali nella lingua albanese* e Francesco Maria da Lecce-s e vitit 1716 përçuan te të interesuarit në hapësirat italiane dhe më tej në hapësirat europiane informacione të ndryshme dhe të rëndësishme për gjuhën shqipe.

Në vazhdën e shqyrtimeve që janë bërë më herët, sidomos të atyre të profesor Altimarit, do të përmendim këtu disa pika nga zhvillimet e rëndësishme të këtyre studimeve gjuhësore mbi gjuhën shqipe dhe dialektet arbëreshe në botën arbëreshe dhe në mjedisin akademik italian. Meqenëse ato studime janë zhvilluar në një ndërlidhje të pashkëputshme, ne e shohim të nevojshme të merremi vetëm me atë që mund të quhet albanologjia italiane, duke përfshirë këtu si studiuesit dhe albanologët arbëreshë ashtu dhe studiuesit dhe albanologët vendës.

Këtë traditë të madhe të albanistikës, pra, mund ta shohim të përqëndruar rreth "shtyllave" studimore: nga njëra anë mbi "shtyllën" arbëreshe që lind me interesin ndaj gjuhës, kulturës dhe historisë së vet nga intelektualët arbëreshë, të cilët filluan të veprojnë paralelisht me krijimin nga ana e Vatikanit në pjesën e parë të shekullit XVIII të institucioneve fetare dhe arsimore për mbrojtjen e komuniteteve arbërishtfolëse të ritit lindor në Kalabri dhe në Sicili dhe, më tutje, që prej fillimit të shekullit XX edhe brenda vatrave universitare italiane; dhe, nga ana tjetër, e mbështet këtë degë të rëndësishme të albanologjisë europiane "shtylla" italiane e mirëfilltë, ku përfshijmë studiuesit italianë vendës që janë marrë me gjuhën e shqiptarëve, disa edhe me të arbëreshëve, duke u zhvilluar në Itali paralelisht me lindjen e linguistikës si degë shkencore dhe universitare më vete që prej gjysmës së parë të shekullit XIX deri më sot. Nga kjo skemë pune nuk përjashtohen kontribute të tjera të vlefshme.

Me themelimin e katedrave albanologjike në universitetet italiane, qysh prej vitit 1900 në Institutin Universitar Lindor të Napolit dhe me interesin e shtuar për shqipen dhe dialektet e saj arbëreshe të nxitur pranë katedrave të afërta gjuhësore albanologjia italiane mori një status dhe një profil të mirëfilltë shkencor, të ngjashëm me atë që kishte arritur albanologjia në botën gjermanishtfolëse, që kemi pasur rastin ta analizojmë në konferencën e mëparshme këtu në Prishtinë. Midis këtyre dy degëve kryesore të albanologjisë europiane u krijuan raporte të dendura dhe të frytshme lidhjeje dhe shkëmbimi mbi të cilat nuk mund të ndalemi posaçërisht, por që u sollën atyre avantazhe të ndërsjella jo të pakta në fushën gjuhësore.

Lidhur me shtyllën arbëreshe të albanologjisë italiane duhet të përmendim rolin shtytës që kanë ushtruar në të shkuarën, qysh nga shekulli XVIII,

intelektualët italo-arbëreshë, të cilët, në rrethanat e degraduara kulturore, shoqërore, politike dhe ekonomike në të cilat ndodhej mëmëdheu nën zgjedhën shekullore osmane, ishin në gjendje të merreshin me prejardhjen, me historinë e me qytetërimin e kombit të tyre, falë dhe formimit që kishin marrë në Kolegjet arbëreshe të Kalabrisë (1732) dhe të Sicilisë (1734). Pikërisht kjo prani intelektuale energjike e arbëreshëve të Italisë tërhoqi mbi këto bashkësi minoritare një vëmendje më të madhe nga albanologët e huaj, gjermanë dhe italianë, të cilët, sidomos pas shekullit XIX, treguan një interes më të madh për trashëgiminë gjuhësore e letrare arbëreshe sesa për gjuhën dhe letërsinë shqiptare të mëmëdheut.

Nga gjysma e dytë e shekullit XVIII, dhe sidomos në shekullin XIX, duke kontaktuar teoritë e reja të shkencës gjuhësore moderne, edhe në mjedisin arbëresh të Kalabrisë e të Sicilisë u rrit një vëmendje më e vetëdijshme për dukuritë gjuhësore të arbërishtes së Italisë, e cila, sidoqoftë, nuk mund të çonte ende në një analizë të mirëfilltë "shkencore" të dukurive të gjuhës së arbëreshëve dhe të shqiptarëve.

Intelektuali i parë arbëresh që u mor me gjuhën shqipe, me leksikun dhe me strukturën e saj gramatikore, që në analizën e fenomenave të gjuhës zbatoi një përqasje shkencore të tipit ndërdisiplinor, qe Nikollë Keta (1741-1803) nga Kuntisa (italisht Contessa Entellina), autor i shumë veprave leksikore dhe gramatikore për shqipen. Sot disponojmë një vjeljeje elektronike të këtij fjalori nga Vinçenco Belmonte në fjalorin e parë elektronik të shqipes dhe të arbërishtes *Thesaurus Albanicae Linguae*.

Çështjen e lashtësisë së gjuhës shqipe e rimori dhe e rilancoi me arsye origjinale e me hipoteza interesante në fillim të shekullit XIX studiuesi kalabro-arbëresh Ëngjëll Mashi (1758-1821) në *Discorso sull'origine, costumi e stato attuale della Nazione Albanese* (Napoli 1807) që pati një përhapje të gjerë në qarqet kulturore të Europës pas botimit frëngjisht në veprën e famshme të gjeografit danez Malte-Brun, *Annales des voyages, de la géographie et de l'histoire* (Paris 1809), ku ai rimori teorinë e vazhdimësisë gjuhësore midis ilirishtes dhe shqipes duke e mbështetur me praninë e latinizmave të shumtë arkaikë që gjenden në shqipen që prej kohës së lashtë.

Në rrjedhën e shekullit XIX dhe në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX në mjedisin arbëresh regjistrojmë përpjekje të ndryshme në fushën e kultivimit të gjuhës, sidomos në hartimin e fjalorëve dygjuhësh italisht-arbërisht (dhe anasjelltas). Për këtë dhanë ndihmesën e tyre përfaqësuesit e lëvizjes kulturore të Rilindjes si Andrea Dara (1796-1872), Françesko Antonio Santori (1819-

1894), Xhusepe Anxhelo Noçiti (1832-1899), Bernardo Bilota (1843-1918), Pietro Kamodeka de' Koronei, Kozimo Serembe (1879-1938), etj. Nuk mund të nënvlerësojmë ndihmesën që i dha edhe gjuhësisë shqiptare korifeu i Rilindjes Jeronim De Rada (1814-1903).

Po aq të rëndësishme për studimet dialektologjike mbi të folmet siciliano-arbëreshe janë "gramatikat" e Dhimitër Kamardës (1821-1882), ku arbërishtja shihet brenda sistemit të shqipes, gjuhë e cila në atë kohë kishte një njohje me të vërtetë ende të pamjaftueshme. Kamarda dha vlerësime të sakta dhe të thelluara për strukturën e shqipes dhe të arbërishtes. Një pjesë e mirë e letërsisë nga merreshin shembujt u botua nga ai në *Appendice al saggio di gramatologia comparata sulla lingua albanese* (1866), e cila mund të quhet antologjia e parë e botuar e teksteve popullore të mbledhura në rrethin italo-arbëresh. Studimet e Kamardës patën rëndësi dhe për aspektet historike e krahasuese.

Arbërishtja e folur në Itali në gjysmën e dytë të shekullit XIX tërhoqi vëmendjen e disa prej nismëtarëve të së ashtuquajturës "shkollë italiane" e gjuhësisë historike, si Graciadio Isaia Ascoli (1821-1907), Bernardino Biondelli (1804-1886) dhe Domeniko Comparetti (1835-1927). Ascoli shkroi për çështje të leksikut, ashtu si për çështje të substratit, por njëherësh bëri dhe një vlerësim të veçantë për veprën e Camarda-s. Kjo është koha po ashtu kur botoheshin tekste gramatikore e manuale të destinuara për mësimin e shqipes, fjalorë të ndryshëm, ndër të cilët veçohen *Rregullat gramatikore* dhe *Fjalori italisht-shqip e shqip-italisht* të Franco Rossi-t (1866), i cili kishte qenë misionar në Gjakovë, Prizren e Shkup, pastaj *Rregulla gramatikore* dhe *fjalori italisht-shqip e shqip-italisht* të viteve 1880 e 1895, të Giacomo Jung-ut, misionar në Shkodër. Bie në sy se po merrte hov një zhvillim me interes për mësimin e shqipes dhe për studimin e saj dhe në këtë kohë veçoheshin emrat e Vincenzo Librandi-t me *Gramatikën* e tij, Pal Skiroit me studimet për tekstet e vjetra, ashtu si të Nilo Borgia-s. Në këtë kohë bien dhe studimet e frytshme të Gaetano Petrotta-s deri nga mesi i sh. XX për letërsinë arbëreshe dhe shqiptare. Ai njihet, pos veprës së tij të rëndësishme *Popolo, lingua e letteratura albanese*, dhe për bashkëpunime te *Shkrimtarë shqiptarë*, etj. Në këtë fazë të studimeve vërehet një interes i shtuar dhe për shqipen ballkanike, po edhe për historinë e saj. Ndër arbëreshët e Sicilisë u shqua me studimet e tij në fushën e historisë së gjuhës me veprën e tij *Studi linguistici I, II* M. La Piana, i cili ka lënë dorëshkrime një fjalor historik e etimologjik, një gramatikë historike të shqipes. Pastaj vijnë aportet e Francesco Ribezzo-s për mesapët e lashtë, përhapja e interesimeve për shqipen te gjuhëtarët e mëdhenj italianë të gjuhësisë areale-neolinguistikës si ato të

Matteo Bartoli-t në veprat e tij dhe në *Studi albanesi*, të Giuliano Bonfante-s, dhe sidomos studimet e romanistit, rumanistit, ballkanologut dhe albanologut Carlo Tagliavini, i cili u mor me arbnishten e Zarës, me të folmet gege verilindore, me shtresëzimin e leksikut të shqipes, me interesime të theksuara për etimologjitë dhe për historinë e gjuhës. Ndihmesat e tij dialektologjike, ato për elementin latin të shqipes, për historinë e gjuhës dhe për aspektet ballkanologjike i kanë shënuar këto fusha. Ai shquhej dhe me ndihmesat që dha për formimin dhe bashkëpunimin me albanologë të ndryshëm, italianë dhe të tjerë, përfshirë dhe shqiptarë. Njihet dhe si një nga bashkëpunëtorët e afërt të Norbert Jokl-it.

Angelo Leotti u bë i njohur me gramatikën dhe tekstin e mësimit të shqipes së folur, e sidomos me *Fjalorin shqip-italisht* të vitit 1937, ashtu si Fulvio Cordignano me fjalorët e tij shqip-italisht dhe italisht-shqip (1934. 1938), me tekstin e gjuhës shqipe, etj.

Themelimi i katedrave dhe i qendrave studimore qe i rënëdishëm për fatin e studimeve shqiptare në Itali. Më 1934 në Palermo u themelua katedra e studimeve albanologjike në Universitetin e Palermos, me Gaetano Petrotën, pastaj Qendra Ndërkombëtare e Studimeve Shqiptare 1948, ku Zef Valentini botoi *Acta Albaniae Veneta*, pastaj Karl Gurakuqi, Matteo Sciambra, Ignazio Parrino, e shumë i rëndësishëm u bë më vonë Antonino Guzzetta me studimet e tij po edhe me organizimet. Në Romë te Akademia Mbretërore u themelua Qendra e studimeve për Shqipërinë, aty gravituan Carlo Tagliavini, Matteo Bartoli, Francesco Ribezzo, Angelo Leotti, Zef Valentini, Antonino Baldacci, Franco Ercole.

Katedra e krijuar më herët u ringjall dhe në Romë më 1957 nga Ernest Koliqi. Në Bari më 1952 u krijua qendër albanologjike me Luigj Marlekajn, Josif Ferrarin, ndërsa në Napoli u vendos Namik Ressuli. Me M. La Pianën nisin studimet moderne, ai qe zbulues i Matrangës, studioi të folmet arbëreshe, la dorëshkrim gramatikën e krahasuar dhe *thesaurus lingue albanicae*.

Carlo Tagliavini në Padova dhe Vittore Pisani në Milano ishin figura eminente të linguistikës italiane që merreshin dhe me shqipen. Giuliano Bonfante u shtrëngua të ikte në Zvicër e SHBA, por ndërkohë u shquan Giovan Battista Pellegrini, ashtu dhe Riccardo Ambrosini, Giancarlo Bolognesi e Giuseppe Restelli në vijën e Pisani-t, lidhjet e shqipes me armenishten, Emanuele Banfi në vijën e Pisani-t me studimet romane dhe ballkanike. Me rëndësi qenë punët e G. Gangale. Një shtysë këtyre studimeve u dha Eric P. Hamp, i cili me arbëreshët u mor më shumë se gjysmë shekulli. Ernest Koliqi me katedrën dhe

me *Shêjzat* luajti një rol me rëndësi për zhvillimin e këtyre studimeve, Emanuele Giordano qysh në vitet 60 botoi Fjalorin e arbëreshëve të Italisë. Me rëndësi në Palermo qe roli i Antonnino Guzzetta-s. U afruan dhe gjuhëtarët italianë Tullio de Mauro, Leonardo Savoia e të tjerë.

Seminari i Prishtinës qe një dritare për arbëreshët ndaj botës shqiptare dhe luajti një rol me rëndësi për zhvillimet e mëtejme. Në vitet '70 të sh. XX u shqua sidomos F. Solano, me studimet e tij për të folmet arbëreshe, por edhe me organizimin e Katedrës albanaologjike në Kalabri, me planet për atlasin e këtyre të folmeve, me monografi të ndryshme. Aty bashkëpunuan nga 1992 nga Francesco Altimari, John Trumper, Leonardo Savoia, Gianni Belushi, Anton Berisha, etj. Në Universitetin e Palermos, në vijën e Antonnino Guzzetta-s veprimtarinë e vijuan Matteo Mandalà, Gëzim Gurga etj., të cilët u shquan dhe për studimet moderne filologjike. Studimet albanologjike në Universitetin e Napolit i drejtoi Italo C. Fortino, i interesuar sidomos për tekstet arbëreshe, botoi Atlasin, etj.

Në dekadat e fundit të sh. XX u kalua nga brezi i studiuesve Koliqi, Ressuli, Valentini, Gurakuqi tek arbëreshët Guzetta, Solano, Gradilone, ndihmuan shumë M. Camaj me studimet e tij arbëreshe, po dhe me përvojën albanologjike në Mynih, L. Savoia drejtpërsëdrejti me studimet për arbërishten në studimet fonologjike e morfosintaksore, Ritta Manzini e Benedetta Baldi. Në Bari, Luigj Marlekaj e Josif Ferrari, pastaj M. Mandala, në Lecce – F. Altimari, pastaj Monica Genesin, në Venecie Giuseppina Turano, në Napoli Italo Fortino. Qendrat u themeluan si vijon: Napoli 1900, Palermo 1932, Padova 1936, Roma 1939, Bari 1952, Cosenza 1973, Lecce 1993, Venecie 2002. Sot studimet albanistike në Itali njihen me rezultate në shumë drejtime, të studimit të të fëlmeve arbëreshe, të tekstologjisë dhe të filologjisë, të përpunimit elektronik të të dhënave gjuhësore, të studimeve historike letrare, të studimeve sociolinguistike të realiteteve gjuhësore arbëreshe, etj.

Edhe pse Kosova ka pasur momente të rëndësishme me zhvillimet albanologjike në Itali, mund të shtrohet pyetja ku jemi sot? Në vitet '40 të sh. XX pati interesim të shtuar për studimet e hapësirave shqiptare të Kosovës dhe të Çamërisë nga qarqet studiuese italiane, sidomos rreth Tagliavini-t, ndërsa pas viteve '70 u vendosën kontakte të rëndësishme studimore e kulturore përmes Seminarit të Prishtinës. Duket e nevojshme të ngulet këmbë në selitjen e këtyre kontakteve me botën linguistike italiane. Një nga pengesat duket dhe tradita e hollë e studimeve italiane në Kosovë, por edhe interesi i paktë i qarqeve zyrtare italiane për zhvillime më të rëndësishme në këtë drejtim, ndryshe nga zhvillimet

në Shqipëri, ku ka një traditë të gjerë të lidhjeve me këto studime dhe një prani të dukshme të studimeve italiane. Të shpresojmë se edhe kjo konferencë do të ndikojë si nxitje për zgjerimin e këtij horizonti të bashkëpunimit midis Italisë dhe Kosovës.

Emanuele BANFI, Milano

VITTORE PISANI E LA POSIZIONE DELLA LINGUA ALBANESE TRA LE LINGUE INDEUROPEE

Abstract. La relazione intende presentare, in modo sintetico, il modo in cui Vittore Pisani, grande glottologo indeuropeista italiano e fondatore della 'Scuola di Milano', ha considerato il quadro linguistico albanese e la sua collocazione all'interno del più ampio spazio linguistico indeuropeo.
Vittore Pisani, pur riconoscendo all'albanese il tradizionale statuto di lingua 'isolata', ha cercato tuttavia di coglierne le relazioni, oltre che con le lingue formanti il cosiddetto tradizionale *Sprachbund* balcanico (inteso nelle sue fasi sia antica che recenziore), anche con alcune specifiche lingue indeuropee: l'armeno e le lingue anatoliche; il greco pre-classico classico, tardo e bizantino; l'ambiente (proto-)slavo balcanico; ma soprattutto il latino post-classico/tardo e il quadro linguistico italo-romanzo con particolare riferimento ai dialetti italo-romanzi diffusi nei margini estremi della penisola in età medievale: dialetti fortemente conservatori e caratterizzati dal cosiddetto 'vocalismo siciliano'.

1. Vittore Pisani (Roma 1899 – Como 1990) fu un grande aristocratico delle scienze glottologiche, 'aristocratico' nel senso primo e pregnante del termine. Pochissimi studiosi, come egli fu, sono stati in grado di dominare con assoluta sicurezza praticamente tutti gli ambiti del vasto spazio linguistico indeuropeo: dal tokario (nelle sue due varianti A e B) alle lingue celtiche, e quindi dall' estremo lembo orientale dell' Indo-Europa nel cuore dell'Asia a quello suo estremo occidentale lungo le rive dell' Atlantico.

Vittore Pisani (Roma 1899 – Como 1990)

Pisani, oltre che dei problemi del tokario A e B, aveva una conoscenza impressionante delle lingue indo-arie: a partire dal sanscrito, nelle sue diverse forme, e dal persiano antico (leggeva, ad apertura di testo, il *Mahabharata* come anche il *Meghaduta* di Kalidasa e altri testi poetici dell'India antica); e conosceva a memoria i testi delle iscrizioni achemenidi, che commentava con vivace sicurezza, e dominava con assoluta padronanza greco e latino, le lingue

classiche per eccellenza, considerate nella loro piena e totale diacronia; e poi, ugualmente, conosceva in modo mirabile anche le lingue germaniche (fu germanista di riconosciuta esperienza) e le lingue baltiche e slave (leggeva i grandi romanzieri russi per diletto suo); e diceva di dolersi del fatto che delle lingue celtiche fossero rimasti solo pochi brandelli e che, soprattutto, delle loro fasi antiche poco si potesse sapere per il tramite di monumenti diretti.

Poliglotta, non si accontentava tanto di conoscere le lingue e, all' occasione, di utilizzarle con sicura competenza; aveva bensì delle lingue con cui si confrontava un 'rispetto' che gli veniva dal vederle quali 'testimoni', potenti e veri, del grande processo storico – e storico-linguistico – sotteso alla formazione del quadro indeuropeo: le lingue, viste (quando possibile) nelle loro fasi antiche e poi nelle loro fasi recenziori e moderne, valevano per lui quasi come reperti 'istologici' da ricomporre in un *corpus*, sempre vivo e mutevole nel tempo e nello spazio; o come tessere di un tessuto musivo paradossalmente 'dinamico', mutevole nel tempo e nello spazio: un tessuto formato da strati temporalmente diversi ove, in ognuno di essi, era fissata l'eco di dinamiche storiche, testimoniate da precise evidenze o da fenomeni spesso fortunosamente ricostruibili/ricostruiti e resi quindi 'visibili'.

1.1.Per venire all'albanese, ricordo molto bene che Pisani nelle sue lezioni di Glottologia all'Università Statale di Milano – ove insegnò la disciplina dal 1938 al 1969 – dedicava sempre una attenzione speciale al quadro linguistico della penisola balcanica e, all'interno di tale contesto, proprio alla posizione dell'albanese e delle sue articolazioni entro il diasistema delle parlate shqipetare. Considerava l'area balcanica come il grande crocevia fondante il quadro linguistico delle lingue indeuropee occidentali: e cioè dei rami germanico, celtico, italico (osco-umbro e latino), balto-slavo e, ovviamente, dei dialetti greci e di quelli shqipetari: greco e albanese, due lingue sì 'isolate', nella fase 'recente' della loro storia, ma testimonianti, nel loro passato remoto, contatti con genti e culture diverse.

Diceva del carattere dell'albanese quale 'lingua isolata'; lingua che, a differenza di altre e però al pari del greco, non aveva generato lingue 'figlie': parlava dell'albanese e delle sue caratteristiche strutturali come di una lingua 'fiera' della sua pur recenziore attestazione storica quale lingua scritta; diceva dell'albanese come di una lingua 'arroccata' in un'isola territoriale all'interno dei Balcani e sottolineava tuttavia il fatto che, prima del suo 'isolamento' in una fase recenziore della sua storia, l'albanese aveva portato in sé significativi tratti

che permettevano di vederne le relazioni, antiche, con altri segmenti dello spazio linguistico indeuropeo. Proprio per questo l'albanese era per lui una sorta di scrigno prezioso, ricchissimo di informazioni intorno alle correnti linguistiche che, dall'Oriente centro-asiatico e/o micro-asiatico, erano venute via via a disporsi nei territori storici, e cioè nelle 'patrie' delle diverse, attuali lingue indeuropee.

1.2.Tali temi erano costantemente presentati da Pisani come un tassello della sua visione 'dinamica' dell'Indoeuropa e dell'indeuropeo: superati certi (ottimistici) schematismi della pur importante stagione dei Neogrammatici, eredi della *Stammbaumtheorie* schleicheriana, Pisani considerava fondamentale analizzare i dati linguistici facendo interagire e dialogare tra loro fonti diverse: fonti storiche (innanzi tutto, le testimonianze degli storici) con i risultati delle ricerche archeologiche e demologiche e quindi con un'attenzione particolare per il quadro dei dialetti.

Importanti per lui erano, senz'altro, le evidenze veicolate dallo strato 'sorvegliato' della lingua – sottoposto tuttavia, e comprensibilmente, alla pressione di lingue di cultura e massimamente del greco (in sue diverse fasi e soprattutto in quelle bizantina e medievale) e del latino (nella sua versione 'balcanica' e poi medievale, aperta all'Italia); e poi dell'italiano letterario –; ma per lui erano ancora più importanti i dati derivati da indagini dialettologiche condotte in diversi punti del macro-spazio linguistico albanese.

2.Nella vastissima produzione scientifica di Vittore Pisani – più di 700 titoli… amorevolmente repertoriati in un volume apparso per festeggiare gli ottant'anni dello studioso (cfr. Ciro Santoro/Maria Teresa Laporta, *Charisteria Victori Pisani oblata.* Vol. II: *Bibliografia degli scritti di Vittore Pisani*, Galatina, Congedo, 1981-1982) – i lavori che Pisani dedicò specificatamente all'albanese sono poco più di una decina (e li segnalo in *Appendice* a questo contributo) e vanno da un primo saggio degli anni '40 ("Albanica", *REIE* 4 (1947), pp. 266-270) a un ultimo della fine degli anni '70 ("Su albanese *shoh*", *Shêjzat* – Numër Perkujtimuer kushtue Prof. Ernst Koliqi, 1978, pp. 196-197).

I più importanti tuttavia, per vastità di prospettive e genialità di intuizioni sistematizzatrici, sono a mio vedere i seguenti:

"L'Albanais et les autres langues indo-européennes", *Annales de l'Institut de Philologie et d'Histoire Orientales et Slaves 10* (Mélanges Henry Grégoire, II), 1950, pp. 519-538.

"Lexikalische Beziehungen des Albanesischen zu den anderen indo-germanischen Sprachen", *Jahrbuch für kleinasische Forschung*, 3 (1955), pp. 147-167. Anche in Vittore Pisani, *Saggi di Linguistica storica. Scritti scelti*, Torino, Rosenberg & Sellier, 1959, pp. 115-136.

"Les origines de la langue albanaise", *Studia albanica* 1-1, 1964, pp. 61-68.
"L'articolo postposto in albanese e questioni connesse", *Studia albanica* 6-1 (1969), pp. 129-131.
"Sulla genesi dell'albanese", *Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Insbruck 1972,* Innsbruck 1977, pp. 345-366.

2.1.Nella visione teorica di Vittore Pisani l'area balcanica era da considerarsi il vero ponte tra Oriente 'asiatico' e Occidente 'europeo'; era il 'luogo' di 'smistamento' di correnti linguistiche indeuropee formanti senz' altro il quadro linguistico remoto della penisola balcanica (nelle sue componenti tracio-dacica e illirica) e il quadro dei dialetti greci; ma anche quelli delle lingue italiche (massimamente dell'osco-umbro e del latino), e poi quelli delle lingue germaniche, balto-slave e celtiche: i Balcani intesi come luogo dove si separarono le componenti osco-umbre da quelle eoliche, entrambe fondanti, le prime, gran parte del tessuto connettivo del quadro latino – come ben emerge dal latino volgare –; le seconde, gran parte del tessuto connettivo del greco volgare, da cui dipendono i tratti salienti sottesi alla formazione della *koiné* di matrice ionico-attica, continuante poi nel greco ellenistico, in quello ellenistico- romano e quindi, via via, in quello medievale, bizantino e moderno.

Con la conseguenza che molti dei tratti fonologicamente salienti ancora oggi caratterizzanti buona parte delle parlate italo-romanze meridionali e buona parte dei dialetti neogreci settentrionali riflettono, in modo suggestivo, il continuare 'carsico' di tradizioni 'indeuropee- balcaniche'; come ho cercato di mostrare nel mio *Riflessi di antichi contatti eolico-oscoumbri nel neogreco e nei dialetti italo-meridionali,* in "Atti dell'Accademia di Scienze e Lettere e Arti di Palermo", Serie IV, 35 - 1977, pp. 619-655.

2.2.Nel saggio "L'Albanais et les autres langues indo-européennes", Annales de l'Institut de Philologie et d'Histoire Orientales et Slaves 10 (Mélanges Henry Grégoire, II), 1950, pp. 519- 538, muovendo da critiche al rigido metodo comparativo dei Neogrammatici e alla relativa posizione teorica che vedeva le lingue come 'organismi naturali', Vittore Pisani sostiene la necessità di fare 'storia' di una lingua muovendo dallo stato presente per risalire al passato: più in particolare, per quanto riguarda la storia dell'albanese, Pisani ritiene fondamentale andare alla ricerca dei più antichi rapporti tra le parlate shqipetare, intese come continuatrici parziali del tracio-illirico e il restante quadro linguistico indeuropeo.

Secondo Pisani nel quadro linguistico albanese si possono individuare fenomeni che lo collegano, nella sua più antica fase, alle lingue dell' area centro-

settentrionale dell'Europa: innanzi tutto e più nello specifico, alle lingue germaniche e alle lingue balto-slave (nel vocalismo, il trattamento di i.e. /a/, /o/ > [a]; ma non di i.e. /ō/ > alb. [e] e /ā/ > alb. [ō]); ad una fase recenziore risalirebbero fenomeni che legano l'albanese al trace e, per tramite del trace, al frigio, all'armeno e all'iranico (nel vocalismo, il trattamento dei dittonghi i.e. /ei, ai, au/ > [a], /oi, ou, eu/ > [e]; nel consonantismo, l'esito di sonore aspirate i.e. /bh, dh, gh/ > occlusive sonore [b, d, g] o spiranti sonore [β, ɣ, ð]; nella morfologia la postposizione dell' articolo che, attestata anche in trace (e, per influsso trace, tale isoglossa è presente anche in rumeno e in bulgaro), essa ricorre anche in armeno ove l'articolo, sempre postposto, è reso mediante particelle pronominali *-s, -d, -n* indicanti prossimità in relazione a chi parla o ascolta: *mard-s* "l'uomo (qui)", *mard-d* "l'uomo (vicino a te)", *mard-n* "l'uomo (là)"; e, sempre nella morfologia, la riduzione dei casi rispetto al quadro i.e., con particolare riferimento alla fusione tra genitivo e dativo e ablativo, con esiti diversi in ghego e in tosco e con parallelismi importanti in balto-slavo, in armeno e, in misura minore, anche in iranico e in tokario.

Si sa, comunque e purtroppo, troppo poco dell'antico trace per potere determinare con sicurezza se la maggior parte delle isoglosse armeno-albanesi coinvolgessero anche il trace. Si potrebbe ipotizzare una vasta area geolinguistica comprendente il frigio, il trace e l'illirico; ma si potrebbe parimenti supporre una doppia origine dell'*ethnos* albanese, composto da antichi illiri, stanziali in area balcanica, e da elementi provenienti da Oriente e in contatto con gli armeni (un indizio prezioso sembrerebbe l'attestazione, in area caucasica, dell'etnonimo *Ἀλβανοί* e del coronimo *Ἀλβανία*); non trascurabili anche alcuni fenomeni che legano l'albanese ai dialetti eolici, che hanno contribuito a formare l'unità linguistica greca, e a quei dialetti indeuropei che, superato l'Adriatico, contribuirono alla formazione dei futuri dialetti osco-umbri e, per il loro tramite, anche del latino.

2.3.Tali considerazioni sono ampiamente riprese nel saggio "Lexikalische Beziehungen des Albanesischen zu den anderen indo-germanischen Sprachen", Jahrbuch für kleinasische Forschung, 3 (1955), pp. 147-167 (ripubblicato in Vittore Pisani, *Saggi di Linguistica storica. Scritti scelti*, Torino, Rosenberg & Sellier, 1959, pp. 115-136). In esso, e in modo sistematico, Vittore Pisani mostra le relazioni che legano albanese e greco con lingue dell' Europa settentrionale (germaniche e balto-slave); relazioni vistose e importanti "sei es durch ihre Zahl, sei es durch ihre Beschaffenheit" (p. 134): le provano termini propri della vita pastorale, dell'artigianato, delle credenze religiose. Importanti

anche le testimonianze relative ai rapporti tra armeno e albanese e greco: esse corroborerebbero "die Theorie der Herkunft einzelner albanesischen Stämme aus dem Kaukasus, wo die Alte *Ἀλβανοί* kannten" (p. 135); e ugualmente importanti le relazioni tra albanese e lingue germaniche e balto-slave, relazioni che prevederebbero anche il coinvolgimento del greco in forza di alcune parole portate in greco dalla componente dorica "das vor seinem Eintritt in die griechische Halbinsel dem Illyrischen seher nahe stand, wie wir das, auf Tatsachen der Überlieferung gestützt, schon für *δίζα, ἄρυα* und *Ἔνυμα*- annehmen durften" (p. 135).

2.4. In "Les origines de la langue albanaise", *Studia albanica* 1-1 (1964), pp. 61-68, Vittore Pisani riprende i temi generali trattati nei due saggi precedenti ponendo tuttavia particolare attenzione a due questioni d'ordine storico-linguistico: la presenza, in albanese e nel trattamento delle serie velari i.e., di elementi sia di tipo *satem* (di probabile origine illirica) che di tipo *kentum* (di probabile origine tracia) e la connessa difficoltà di riconoscerne con precisione ruolo e funzione alla luce delle scarsissime conoscenze che si hanno di tali lingue di sostrato 'indeuropeo-balcanico': l'illirico … "une langue qu' on peut malheureusement définir fantômatique" (p. 66); il trace, di ugualmente problematica attestazione.

2.5.Nel saggio "L'articolo postposto in albanese e questioni connesse", *Studia albanica* 6-1 (1969), pp. 129-131, Vittore Pisani discute le tesi di A. V. Desnickaja (*Reconstrukcija elementov drevnealbanskogo jazyka i obščealbanskije lingvističeskije problemy*, Moskva 1960, pp. 22 sgg.) relative all'articolo postposto albanese visto in relazione con il parallelo fenomeno intra-balcanico ben documentato in bulgaro e in macedone.

Per Pisani la questione va fatta rientrare "nel quadro degli stretti rapporti fra l'albanese e il rumeno, rapporti che in parte risalgono a epoca preistorica, ma che sono proseguiti fino ai nostri giorni e costituiscono il nòcciolo in un certo modo più solido della lega linguistica balcanica" (p. 130) e chiama in causa un "bilinguismo albano-rumeno" proprio in massima parte di "pastori transumanti"… senza dimenticare, tuttavia, che l'articolo postoposto ricorre anche in parte delle lingue germaniche settentrionali, in armeno, in avestico (cfr. avest. *mithrō yō vouru, gaoyaoitiš* 'Mitra possessore di ampi terreni'; alla lettera: Mitra che è il possessore di ampi terreni) e in persiano moderno in forme del tipo *mard-ī chūb* 'homo bonus' = N + PronRel + Agg,, esattamente come avviene parzialmente in albanese e in rumeno: *njeri-u i mirë*, *omul cel bun*, alla lettera 'homo ille qui bonus'.

2.6.Nell'ultimo saggio pisaniano dedicato all'albanese – "Sulla genesi dell'albanese", *Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972,* Innsbruck 1977, pp. 345-366 –, entro un quadro teorico avanzatissimo in cui sono discusse le nozioni di 'lingua' e 'dialetto' e in cui è data priorità al secondo elemento della diade, sono affrontate questioni generali sottese alla genesi di una qualsiasi lingua storico-naturale. Vittore Pisani scrive:

> "[…]Si usa parlare dell'albanese e dei suoi dialetti, come anche di lingua italiana e dialetti italiani, quasichè la 'lingua' sia il *prius* rispetto ai 'dialetti'. Anzitutto, che cosa intendiamo in questi casi parlando di 'lingua'? Evidentemente non già di una lingua letteraria, di cui sappiamo come essa sia sorta quando i dialetti già esistevano, o dalla sublimazione di uno di questi dialetti secondo l'esempio di lingue letterarie precedenti (p. es. la māhārāṣṭrī […] secondo il modello del sanscrito, il gotico di Ulfila secondo l'esempio del greco), o in qualche altro modo che qui sarebbe troppo lungo descrivere; ma una specie di 'diasistema' radunante fatti comuni a certi dialetti, i quali vengono *a posteriori* riuniti sotto il cappello di quel diasistema per motivi extralinguistici, quali l'uso di una lingua letteraria, l'appartenenza a uno stesso stato o a una stessa nazione – sempreché fra quei dialetti esista un certo numero di isoglosse importanti – ecc. Ora, quei dialetti, i quali cronologicamente sono il *prius*, non risultano dalla suddivisione di una lingua comune, ma è questa che si costituisce dalla convergenza dei dialetti […] sia sotto la preminenza di uno di essi, dovuta a motivi storici, politici, economici, culturali, sia per una sorta di adattamento reciproco il quale può essere, ed è di solito, accompagnato da un secondario adattamento alla lingua comune così sorta" (p. 348).

E continua sottolineando un punto essenziale:

> "[…] quando noi parliamo di 'lingua albanese' riferendoci ai vari dialetti albanesi, dobbiamo sempre ricordare che si tratta di un certo numero di isoglosse presenti in tutti quei dialetti, delle quali non possiamo dire che fossero diffuse nella totalità di essi in epoche più antiche; e che quindi non abbiamo da immaginarci un punto di partenza unico, una 'protolingua'" (p. 348).

Con la conseguenza che, nell'indagare la vicenda storico-linguistica dell'albanese, secondo Pisani, occorre piuttosto

> "identificare le diverse stratificazioni a cui risalgono i suoi fatti singoli, fra questi naturalmente e anzitutto la struttura, il sistema che li tiene insieme, e di essi la diffusione areale al di fuori e all' interno dell' albanese, la cronologia, e il modo, cioè i motivi extralinguistici, per cui ha avuto luogo la diffusione; la quale […] può essersi propagata tanto dall'esterno verso l'interno del territorio considerato, quanto da questo verso l'esterno" (p. 351).

Forte di tale *caveat* metodologico Pisani rivolge lo sguardo a specifici fenomeni (riduzione dell'infinito; formazione del futuro perifrastico; fusione tra genitivo e dativo, ecc.) che legano le parlate albanesi al mondo balcanico e al noto *Sprachbund* definito con suggestiva precisione da Kristian Sandfeld in un lavoro magistrale apparso nel 1930 (*Linguistique balkanique: Problèmes et résultats*, Paris, Champion) vedendo anche ciò che avviene, oltre che in aree 'contigue' del Sud-Est europeo, anche nel Mezzogiorno d'Italia alla luce del ruolo svolto, nelle due macro-aree, dal greco bizantino e medievale.

E, a proposito poi dell'articolo postposto, tratto 'tipicamente' balcanico, oltre alle coincidenze – di cui si è già detto – con quanto avviene in lingue germaniche settentrionali, in armeno, e in lingue indo-arie (avestico, iranico, persiano), Pisani collega tale tratto alla strategia sintattica per cui il determinante viene aggiunto al determinato; strategia ampiamente ricorrente anche in ambiente ugro-finnico (ungh. *maro-m* 'il mio braccio', finn. *koira-mme* 'il nostro cane', turco *ev-im* 'la mia casa') e penetrata "anche nei dialetti indeuropei sfociati nel baltico e nello slavo, dove troviamo l'aggettivo determinato costituito con l'aggiunta del pronome indeuropeo *jo-, p. es. a.sl. *dobrŭ-jĭ*, lit. *geràs-is* 'buono', propriamente 'bonus ille'" (p. 361).

E però, nel caso dell'articolo 'prepositivo', che sta tra il sostantivo e il suo aggettivo o un genitivo dipendente da esso (alb. *mal i lartë* 'monte alto', *bir i mbretit* 'figlio del re'; e con l'articolo postposto: alb. *mal-i i lartë* 'il monte alto', *bir-i i mbretit* 'il figlio del re'; del tutto parallelo al tipo rum. *Ştefan cel mare* 'Stefano il grande', *cal-ul cel frumos* 'il cavallo bello', *cal- ul al vecinului* 'il cavallo del vicino'), Pisani si chiede se sia di fronte a un fenomeno di sostrato o a un influsso greco. Certo, anche in greco ricorre una strategia simile (cfr. Xen. *Cyr*. III 3,8 *τάγαθὰ τὰ μεγάλα*; Xen. *Anab*. IV 3, 20 *ἐπὶ τὸν πόρον τὸν κατὰ τὴν ἔκβασιν τὴν εἰς τὰ Ἀρμενίων ὄρη*); ma osserva opportunamente che, se si tratta di una costruzione occasionale, e cioè solo di una sfumatura stilistica, "si può essere certi che il suo tornare in rumeno e in albanese n o n è da ascrivere al greco" (p. 362).

Ecco, anche nel caso delle vicende dell'albanese – così come di una qualsiasi altra lingua – la lezione che viene dal grande maestro fondatore della Scuola glottologica di Milano, erede della pur grande lezione di Graziadio Isaia Ascoli, il padre delle scienze linguistiche in Italia e 'mediatore' tra la ottocentesca cultura linguistico-comparativa germanica e quella filologico-linguistica tipicamente italiana, è da vedersi, a mio parere, in un atteggiamento euristico attento ai singoli dati, ricomponibili all'interno di un quadro complessivo

che non può, quest' ultimo, se non essere 'dinamico', intessuto come è del fluire di eventi della 'grande storia' e delle innumerevoli 'micro-storie' proprie di 'persone', segmenti diversi della comunità linguistica oggetto di studio.

E, va ricordato, Pisani scriveva le cose che scriveva in anni in cui già era 'dilagante' l'atteggiamento anti-storicista tipico di certa linguistica 'generale' – figlia di una lettura superficiale dello strutturalismo di matrice saussuriana – che, nello studio delle lingue, voleva programmaticamente cancellarne la componente storica per ridurne l'analisi entro freddi, rigidi schemi meccanicistici fondati su 'esecuzioni' di un (inesistente) parlante 'ideale'.

Appendice

Gli studi di Vittopre Pisani su questioni relative ai Balcani e all'albanese

La posizione linguistica del acedone, *RIEB* 3 (1937), pp. 8-32 Albanica, *REIE* 4 (1947), pp. 266-270

L'Albanais et les autres langues indo-européennes, in *Annales de l'Institut de Philologie et d'Histoire Orientales et Slaves 10* (Mélanges Henry Grégoire, II), 1950, pp. 519-538.

Zur albanischen Etymologie, in *KZ* 71 (1953), pp. 62.64.

Lexikalische Beziehungen des Albanesischen zu den anderen indo-germanischen Sprachen, in *Jahrbuch fuer kleinasische Forschung*, 3 (1955), pp. 147-167. Anche in VP, *Saggi di Linguistica storica. Scritti scelti*, Torino, Rosenberg & Sellier, 1959, pp. 115-136

Alb. zot 'Herr', zonjë 'Herrin' und einige Wörter für 'Herr' , in *Die Sprache*, 7 (1961), pp. 99-103. *Les origines de la langue albanaise*, in *Studia albanica* 1-1 (1964), pp. 61-68.

Incidenti sul lavoro: albanese murk murg-u, in *Paideia* 21 (1966), pp. 131-132.

L'articolo postposto in albanese e questioni connesse, in *Studia albanica* 6-1 (1969), pp. 129-131. *Albanese ha 'mangiare'*, in *Paideia* 28 (1973), p. 183.Παιδεια

Der Sonnenuntergang in Albanischen und im Neugriechischen, *IF* 79 (1974), pp. 152-153.

Sulla genesi dell'albanese, in *Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Insbruck 1972*, Innsbruck 1977, pp. 345-366.2.

Albanese mellë – Greco κοῦρος, italiano ragazzo, in *AGI* 62 (1977), pp. 140-146.

Su albanese shoh, in *Shêjzat* – Numër Perkujtimuer kushtue Prof. Ernst Koliqi, 1978, pp. 196-197.

Seit MANSAKU, Tiranë

PROBLEMI I ORIGJINËS SË GJUHËS SHQIPE NË VEPRËN E VITTORE PISANI-T

Abstrakt. Në këtë artikull bëhet fjalë për interesimet dhe depërtimet e veçanta të Vittore Pisani-t në studimet e historisë së lashtë të shqipes, konkretisht në aspektet e ndryshme të vështrimit të prejardhjes së kësaj gjuhe.

Lidhjet e hershme, historike, ekonomike e politike, kulturore, gjuhësore e fetare midis iliro-arbërorëve e shqiptarëve, nga një anë, dhe latino-italianëve nga ana tjetër, kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve nga të dyanët e Adriatikut. Të dy vendet dhe popujt kanë qenë pjesë e Perandorisë romake për shumë shekuj.

Një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në tërheqjen e vëmendjes së studiueve italianë ndaj botës shqiptare, ka qenë pa dyshim jo vetëm fqinjësia e lashtë këtu në pellgun e Mesdheut, por ekzistenca e një komuniteti të hershëm arbëresh në Gadishullin italik. Bashkëjetesa midis dy komuniteteve kërkonte domosdo njohjen reciproke të historisë, gjuhës dhe kulturës së dy popujve. Madje edhe para arbëreshve fise ilire, të të parëve të shqiptarëve, patën kapërcyer Adriatikun dhe qenë vendosur në Itali dhe kanë lënë atje një trashëgimi të vyer gjuhësore kulturore, siç janë mbishkrimet mesape që janë bërë objekt studimesh serioze edhe nga studiues italianë si F. Ribezzo, Carlo de Simone etj. Vëmendjen e studiuesve italianë e kanë tërhequr sidomos të folmet arbëreshe.

Mjedisi i ri italian ku u vendosën arbëreshët pas emigrimit në Itali, u dha mundësi atyre, më shumë se bashkëatdhetarëve të tyre në dheun mëmë, të binin në kontakt me zhvillimet shkencore e kulturore të botës së qytetëruar europiane. Nga ana tjetër, dashuria për atdheun dhe krenaria për historinë, gjuhën dhe kulturën e të parëve që ata e ruajtën të pashuar në zemrat dhe mendjet e tyre i nxiste që mundësitë që u krijoi medisi i ri italian, më pranë zvillimeve të reja shkencore e kulturore, t'i përdornin në dobi të kombit të tyre, për ta bërë të njohur atë në atdheun e ri e më gjerë dhe për ta futur atë në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit shoqëror e kulturor krahas kombeve të tjera të Europës.

Studimet shkencore të mirëfillta për historinë e gjuhës shqipe në mjedisin Italian kanë nisur që në mesin e shekullit XIX, kur ajo u përfshi si objekt studimi i gjuhësisë historike krahasuese. Themelimi i gjuhësisë historike krahasuese,

hartimi me metodat shkencore të saj i gramatikave krahasuese për gjuhë e grupe gjuhësh të familjes indoeuropiane e nxiti studiuesin e mirënjohur arbëresh Dhimitër Kamarda të hartonte edhe ai një gramatikë të krahasuar për gjuhën shqipe, *Saggio di grammatologjia comparata sulla lingua albanese,* Pratto 1864 dhe dy vjet më vonë, *Apendice al Saggio di grammatologjia comparata sulla lingua albanese,* Livorno 1866. Ky autor arbëresh ka meritën e veçantë që i dha shqipes një gramatikë të krahasuar që në mesin e shekullit XIX, kur sapo kishin filluar të hartoheshin gramatika të krahasuara me metoda shkencore edhe për gjuhë të tjera të Europës: *Gramatika e gjuhëve romane* (1836-1847) nga Diez, *Gramatika e gjuhëve sllave* (1852-1875) nga F. Miklosich, *Gramatika e keltishtes* (1853) nga Johan Kaspar Zois, etj. Me veprën e Dh. Kamardës, të botuar në vitin 1864, krahas këtyre gjuhëve të tjera radhitet edhe shqipja me një gramatikë të krahasuar, të hartuar nga një studiues i truallit të saj, duke dëshmuar para botës shkencore të kohës se edhe shqiptarët vetë ishin në gjendje t'i dilnin zot studimit të gjuhës së tyre edhe në planin historik krahasues. Ai dha kështu një provë serioze të vërtetësisë së atij mendimi që një vit më parë kishte shprehur gjuhëtari italian dhe studiuesi i historisë së gjuhës shqipe D. Comparetti se "*Studimet shqiptare mund të presin shumë nga vetë shqiptarët, nëse këta do të dëshirojnë ta shqyrtojnë shkencërisht gjuhën e tyre sipas metodave që kërkojnë sot këto lloj vëzhgimesh*".

Vepra e Kamardës tërhoqi që në atë kohë vëmendjen e gjuhëtarit të njohur italian G. I. Ascoli, që mbahet edhe si themelues i gjuhësisë historike krahasuese në Itali dhe një nga figurat e njohura të gjuhësisë historike krahasuese indoeuropiane. Ai, në veprën e tij *Studi Critici* nuk ngurroi ta vlerësonte veprën e Kamardës si "*veprën më të gjerë të gramatikës së krahasuar që ka parë dritën e botimit në Gadishullin Apenin*", "*stoli të vërtetë të literaturës filologjike të Italisë së sotme*" dhe një përmendore të qëndrueshme që Dh. Kamarda i kushtoi gjuhës së arbëreshëve, të cilët me të drejtë mund të mburren me të. Por Ascoli, krahas vlerësimit i bëri atij edhe disa vërejte të rëndësishme për metodologjinë e kërkimit shkencor dhe për pëfundimet që nxori ai për përfshirjen e shqipes në trungun e gjuhëve pellazgjike bashkë me greqishten e latinishten, duke e vendosur atë më afër greqishtes se sa latinishtes, tezë e mbrojtur para tij nga A. Schleicher-i dhe G. Stier-i.

Me këtë rast doja të vë në dukje se shumica e studiuesve italianë të shekullit të kaluar (Ascoli. M. Bartoli, Pisani, G. Bonfante, Pellegrini etj.), që janë marrë me problemet e etnogjenezës së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe dhe të vendit të saj në familjen e gjuhëve indoeuropiane, i kanë kushtuar vëmendje

më shumë aspektit metodologjik shkencor të kërkimeve në këtë fushë se sa analizës konkrete të lëndës gjuhësore të shqipes. Kërkesat metodologjike kanë sjellë sigurisht edhe rezultate konkrete në mbështetjen dhe argumentimin e tezave të ndryshme rreth problemeve të mësipërme, ose për rrëzimin e atyre që nuk pajtoheshin me metodologjinë shkencore.

Konkluzioni i përgjithshëm i autorit (Kamardës) do të mund të përmblidhej, sipas Ascoli-t, si më poshtë: gjuha shqipe është e lidhur mjaft ngushtë me greqishten, të dyja gjuhët qëndrojnë njera ndaj tjetrës si dy binjake, por e para, sidomos në leksik, merr pjesë më gjerësisht se sa e dyta në elementin që mund të quhet pellazgo-italik. Arsye gjuhësore dhe historike, traditat dhe zakonet provojnë se shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të Iliro-Maqedonasve dhe të Epirotëve të antikitetit, duke e bërë kështu më të pranueshëm mendimin sipas të cilit Shqiptarët janë vijues të Pellazgëve, janë neopellazgë, siç do të quheshin neogrekë grekët e sotëm (Studii critici, 63). Megjithatë, Ascoli e sheh të vështirë vërtetimin e tezës së Dhimitër Kamardës për lidhjet e afrisë së gjuhës shqipe me greqishten dhe me latinishten dhe përfshirjen e tyre në trungun e gjuhëve pellazgjike. Që gjuha shqipe ka shumë elemente të përbashkëta me greqishten dhe gjuhët italike, kjo është një gjë aq evidente sa askush nuk mund ta mohojë. Por me të drejtë Ascoli vëren se është e nevojshme që të dallojmë nëse këto elemente të përbashkëta e kanë burimin nga një gjuhë e lashtë, nga një substrat i përbashkët, apo janë rezultat i takimeve, kontakteve të mëvonshme të këtyre gjuhëve në mes tyre.

Jetës dhe veprës së Graziado Isaia Ascoli-t i ka kushtuar një shkrim të veçantë revista *Albania* e Faik Konicës me rastin e një vjetorit të vdekjes, shkruar nga Kolë Kamsi me pseudonimin Komneni. Autori, pasi vlerëson kontributin e Askolit në fusha të ndryshme të gjuhësisë, e pëfundon shkrimin e tij me këto fjalë: *Askoli ka njoftë mirë edhe gjuhën shqipe e me një livre të vet Studi critici (frammenti albanesi), flet e zhvillon mendimet e veta dhe mbi gjuhë t'onë. Prannei ky yll qi u zhduk, ky shkencëtar i vërtetë qi bori Italia, s'qe vetëm mjerim për bashkëkombtarët e vet, por për gjith botën e nji kujtim e ka në detyrë me pasë edhe kombi shqipëtarë* (*Albania*, viti 11, nr. 4, 1907, 95-96).

Një gjuhëtar tjetër i mirënjohur italian që është marrë mjaft gjerë me problemet e etnogjenezës së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, si indoeuropianist dhe si albanolog është Vittore Pisani. Ai i përket atij brezi indoeuropianishtësh që në studimet e tyre bashkojnë arrritjet e gjuhësisë historike krahasuese tradicionale me drejtimin gjuhësor të gjeografinsë gjuhësore e të dialektologjisë indoeuropiane. Pikërisht për këtë punimet e tij për shqipen janë me interes për

metodologjinë e kërkimit shkencor dhe për arritjet konkrete.

Një nga shkrimet e para të këtij autori që lidhet me historinë e lashtë të shqiptarëve, me atdheun e parë të tyre, është botuar në fillim të viteve '40 në gjuhën shqipe në revistën e mirënjohur *Hylli i Dritës*. Është një shkrim kritik me titull "Rreth një botimi të Prof. Dr. G. Stadtmüller mbi historinë e hershme shqyptare, i cili është shkruar si një recension për veprën *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*", botuar në vëllimin VII të Archivum Europae cento-orientalis. Në këtë shkrim V. Pisani, pasi bën një vlerësim të përgjithshëm të punës kërkimore të G. Stadmüller-it, mban qëndrim kritik ndaj tezës së këtij autori lidhur me atdheun e hershëm të shqiptarëve, për karakterin baritor të kësaj popullsie dhe për romanizimin e saj. V. Pisani nuk pajtohet me metodologjinë e ndjekur nga autori për të nxjerrë përfundime të tilla të karakterit etnik, duke u nisur nga analiza gjuhësore e disa huazimeve latine e sllave në gjuhën shqipe në disa fusha të leksikut të saj. Konkretisht ai nuk pajtohet me tezën e Stadtmüller-it se popullsia e hershme shqiptare ka qenë një popullsi nomade baritore që ka jetuar në vise malore ku ka mundur t'i shpëtojë romanizimit dhe se shqiptarët bujqësinë e kanë mësuar vonë pas kontakteve me sllavët. Ai i kujton autorit se shqiptarët një fjalë kryesore të leksikut bujqësor si *parmendë* e kanë të huazuar nga latinët dhe se fjala *det* është fjalë e trashëguar në gjuhën shqipe. "*Kurrkush,* shprehet autori*, nuk na ka autorizue me i mbajtë Shqyptarët e hershëm vetëm si bari nomadë si me pasë një popull vetëm një mënyrë jetese*" (HD, 22). I kujton gjithashtu autorit se përmendja e fisit ilir *Albanoi* dhe e qytetit *Albanopolis* në shekullin II të erës sonë nga Ptolemeu nuk mbështesin tezën e tij për karakterin nomad baritor të të parëve të shqiptarëve. Po kështu V. Pisani kundërshton argumentin e Stadtmüller-it sipas të cilit "*teoria qi i mban shqyptarët si mbasardhësat e Ilirëvet ka ra poshtë nji herë e mirë qëse asht gjetë venetishtja, e cila, simbas gjykimit të shumicës së dijetarëve, asht ilire*". Pisani i përgjigjet autorit se mund të shtrohet ndryshe problemi dhe mund të themi se venetishtja nuk është ilire, sepse venetishtja nuk shpjegohet me gjuhën shqipe (HD, 22) dhe pëfundon "*tana këto sende janë mjaft të pasigurta, tue kenë se tradicioni i venetishtes asht si a ma zi*". Kërkimet e mëvonshme i kanë dhënë të drejtë V. Pisanit. Venetishtja përfshihet sot në gjuhët italike.

Në një mënyrë më të drejtpërdrejtë problemet e etnogjenezës së shqiptarëve dhe origjinën e gjuhës shqipe Vitore Pizani i ka trajtuar si në veprat e tij përgjithësuese për gjuhësinë indoeropiane ku përfshihet edhe shqipja, siç janë: *Linguistca generale e indoeuropea* (Milano, 1947), *Saggi di linguitica storica*

(Torina 1959) *Glottologia indoeuropea* (Torino, 1971), ashtu edhe në disa kumtime të mbajtura në disa veprimtari shkencore të organizuara në Shqipëri, ku ai ka qenë i ftuar për të marrë pjesë. Përfundimi themelor i tij për origjinën e gjuhës shqipe i shprehur në veprat përgjithësuese është ky: "*Në bërthamën e saj themelore shqipja vijon gjuhën e Ilirëve të lashtë, e njohur prej nesh nga disa emra dhe glosa dhe nga mbishkrimet mesape, gjuhë e folur nga Mesapët dhe Japigët e Gadishullit salentin me burim nga ilirishtja ballkanike*", një përfundim që e gjejmë që në një shkrim hershëm të tij me titull *Problemi ilirik*, botuar së pari në revistën Panonia në vitin 1935, f. 276.

Më gjerësisht dhe me më shumë argumente autori e ka shtjelluar tezën e prejardhjes së gjuhës shqipe në Konferecën I të Studimeve Albanologjike, organizuar në Tiranë në vitin 1962, ku ai mbajti kumtesën: "*Origjina e gjuhës shqipe, çështje parimesh dhe metode*".

Pas disa konsieratave të përgjithshme mbi natyrën e gjuhëve, lidhjet e tyre me popullsitë dhe trojet ku fliten dhe evolucionin e tyre gjatë kohëve, autori ndalet në disa çështje të rëndësishme parimore të metodologjisë së trajtimit të origjinës së gjuhës shqipe. Pyetjes së shtruar prej kohësh nga dijetarët: A është shqipja, të paktën në pjesën e saj themelore, vazhdim i ilirishtes apo i trakishtes?, autori i përgjigjet si vijon: "*Në qoftë se në Shqipëri është folur në kohën antike një gjuhë ilire, nuk shoh ndonjë arsye (rrugë) që popullsia e Shqipërisë ta ketë zëvendësuar këtë gjuhë me trakishten. Do ta pranoja më lehtë që këta ilirë të ishin romanizuar, ose të kishin përqafuar një gjuhë të madhe kulture si greqishten, por, duke pranuar se deri në kohën e pushtimit romak flisnin ilirisht, nuk shoh asnjë arsye që ata ta kenë këmbyer gjuhën e vet me gjuhën e një populli që nuk e ka shkelur, as nuk e ka pushtuar kurrë Shqipërinë. Për sa i përket burimeve për njohjen e ilirishtes dhe të trakishtes, autori mendon se "për trakishten ne nuk dimë pothuajse asgjë, për ilirishten ne dimë shumë-shumë ato që na thonë mbishkrimet mesape*", duke pranuar kështu përkatësinë ilire të këtyre mbishkrimeve, një problem mjaft i diskutueshëm.

Tezën e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe V. Pisani e trajton në lidhje me vendin e shqipes në familjen e gjuhëve indoeuropiane. Autori ndalet në ndarjen *kentum* dhe *satem* të gjuhëve indoeuropiane dhe në pozitën e shqipes, të ilirishtes dhe të trakishtes në këtë ndarje. Dihet se që nga Carl Pauli e, sidomos, nga Herman Hirt-i e më pas nga Henrik Barić-i e të tjerë mbështetës të tyre, është pohuar se me që shqipja është gjuhë e grupit *satem*, ndërsa ilirishtja mendohet se i përket grupit *kentum*, shqipja nuk mund ta ketë burimin nga ilirishtja. Ajo e ka prejardhjen nga trakishtja, e cila është cilësuar si gjuhë *satem*

ashtu si shqipja.

V. Pizani citon dhe mbështet në një farë mënyre mendimin e dijetarit arbëresh Marco La Piana, i cili kishte arritur në përfundimin se në gjuhën shqipe janë përzjerë dy diaklete indoeuropiane, që lidhen përkatësisht me grupin *satem* dhe me grupin *kentum*. Ai, duke iu referuar një studimi të mëhershëm të tij, *Studi sulla preistoria delle lingue indoeuropee*, botuar në vitin 1933, mendonte se "asibilimi i qiellëzoreve në gjuhët e grupit *satem* është një fakt relativisht i ri, që është përhapur nga iranishtja, duke kaluar, nga njera anë dhe vetëm pjesërisht, tek indishtja, nga ana tjetër, tek armenishtja e prej kësaj te frigishtja, te trakishtja, te shqipja e ardhshme dhe te gjuhët balto-sllave, në një kohë kur njësia e kryehershme kishte shumë kohë që ishte zgjidhur" (f. 112). Pas këtyre shpjegimeve V. Pisani arrin në përfundimin se "*një gjuhë mund të jetë satem jo se ajo ka qenë gjithmonë e tillë që nga koha e njësisë indoeuropiane; ajo mund të jetë bërë e tillë e prekur nga vala e shtegtimeve që sillte me vehte asibilimin e qiellëzoreve. Mund të thuhet ndërkaq që kjo valë ka arritur mjaft vonë në Iliri, prandaj kuptohet pse ilirishtja na duket si gjuhë kentum, ndërsa shqipja si gjuhë satem*" (f.113).

Lidhur ngushtë me këtë tezë dhe me dialektologjinë indoeuropiane, V. Pizani ka bërë vërejtje me interes edhe për shtresat ndryshme kronologjike të leksikut të shqipes jo vetëm të leksikut të huazuar, por edhe për leksikun e trashëguar. Në elementet indoeuropiane të shqipes autori dallon ato që janë të përbashkëta për shumicën e gjuhëve indoeuropiane edhe një sasi elementesh të një epoke më të hershme që e lidhin shqipen me gjermanikishten, baltishten dhe sllavishten dhe me një shtesë më të re që e lidhin shqipen me trakishten, dhe me ndërmjetim të saj me frigishten, armenishten dhe iranishten. Për shqipen, përfundon autori, mund të themi se me gjithë ndikimet e çdo lloji, që kanë përcaktuar pamjen e saj, ajo në elementet e saj indoeuropiane, vazhdon një dialekt që ishte më i sanskritizuar se sa, p.sh. gjermanikishtja e baltishtja. (f. 115). Ai bën fjalë edhe për elemente të hershme mesdhetare në gjuhën shqipe.

Me këto shpjegime V. Pisani e rrëzon një nga argumentet e mbështetësve të tezës së origjinës trake të gjuhës shqipe. Edhe Eqrem Çabej në referatin *Disa problem themelore të historisë së gjuhës shqipe*, mbajtur në këtë Konferencë ishte shprehur për karakterin problemetik të ndarjes dialektore të gjuhëve indoeuropiane në gjuhë *satem* dhe gjuhë *kentum*. Madje ai kishte mbështetur tezën e Norbert Joklit sipas së cilës "spirantet, që janë karakteristike për shqipen si një gjuhë e ashtuquajtur *satem*, shfaqen relativisht vonë te kjo gjuhë, pjesërisht në kohë të mesme, prandaj duhet të pranojmë që karakteri *satem* shpesh herë

nuk është punë gjenealogjie, por punë kronologjie. Nga këto del si përfundim që mënyra e trajtimit të palataleve indoeuropiane nuk ka si përbën një arsye për ta lidhur shqipen me trakishten dhe për ta shkëputur nga ilirishtja. Ashtu sikurse nuk ka njeri që do të mendojë të ndajë spanishten ose frëngjishten nga latinishtja, vetëm sepse, bie fjala, lat. *kentum* në të parën gjuhë ka dhënë *ciento* (shqipto *thiento*) e në të dytën *cent*, pra sepse guturali latin në këto dy gjuhë ka përfunduar në spirante. Shih E. Çabej, *Studime gjuhësore* IV, Prishtinë 1977, f. 174.

Prof. Selman Riza në diskutimin e tij për kumtesën e Vitore Pisanit të mbajtur në këtë Konferencë do të shprehej: "*Mënjanimi i mungesës specioze të dallimit gjuhë indoeuropine satem dhe gjuhës indoeuropine kentum nga rruga e vërtetimit shkencor të tezës shkencore të origjinës ilire të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar, ky mënjanim mund të quhet gati një punë e kryer qysh në këtë Konferencë ku edhe indoeuropianisti ynë i shquar prof. Eqrem Çabej dallimin e sipërm e cilësoi jo vetëm si gjenealogjik, por edhe si kronologjik. E me ç'më duket mua, mënjanimi i kësaj pengese nga kjo rrugë do të përbëjë njërin nga rezultatet më të rëndësishme të kësaj Konference*" (Konf. f. 850). Pra duke pranuar karakterin jo vetëm gjenealogjik, por edhe kronologjik të ndarjes së gjuhëve indoeuropiane në *kentum* dhe në *satem*, kjo do të thotë se edhe sikur ilirishtja të ketë qenë gjuhë *kentum* dhe shqipja është *satem*, nuk përbën një argument kundër prejardhjes ilire të shqipes. Një gjuhë dikur *kentum* me kalimin e kohës mund të fitojë tipare të gjuhëve *satem*.

Përveç sa u thanë më lart, siç ka vërejtur kohët e fundit prof. Shaban Demiraj në *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988, f. 170, karaktetri kentum i ilirishtes së jugut është vënë në dyshim nga shumë gjuhëtarë që janë marrë me tipologjinë e saj. Madje ai ka theksuar se shembujt që janë sjellë për të vërtetuar karakterin *kentum* të ilirishtes, emra të përveçëm si *Ves-cleves*, *Acra-Bannus*, *Bal-acros* e ndonjë tjetër, nuk i përkasin ilirishtes së jugut dhe nuk mund të vërtetojnë karakterin *kentum t*ë saj.

Problemet e etnogjenezës së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe V. Pisani i ka trajtuar në një këndvështrim të veçantë dhe original edhe në një kumtim me titull *Ilirët në Itali*, mbajtur në Kuvendin I të Studimeve ilire, mbledhur në Tiranë në vitin 1972 dhe botuar në Aktet e këtij Kuvendi. Edhe në këtë kumtim autori së pari përpiqet të sqarojë teorikisht konceptin ilir në vështrimin politik, gjuhësor, kulturor dhe arkeologjik, i cili nga studiuesit e disiplinave përkatëse përdoret me kuptime të ndryshme. Kur arkeologu flet për lirët, ka parasysh disa aspekte të kulturës materiale të përhapur në një sipërfaqe të caktuar dhe jo

gjuhën apo gjuhët që flisnin popullsitë që zotëronin këtë kulturë dhe nuk mund të na thotë se deri në ç'pikë këto popullsi përbënin një ose më shumë njësi politike, ndërsa glotologu që flet për Ilirët, u referohet fenomeneve gjuhësore, por nuk mund të na thotë gjë të madhe për kohezionin etnik e kulturor të njerëzve pranë të cilëve janë përhapur këto fenomene (f. 66).

Pas këtyre sqarimeve me karakter teorik, autori ndalet në vështrimin gjuhësor, duke trajtuar rrugët e depërtimit të ilirëve në Itali të Jugut, sipas tij, nëpërmjet Adriatikut, dhe gjurmët gjuhësore që ata kanë lënë në këtë vend. Për temën tonë është me rëndësi të theksojmë se autori ka pranuar se nga gjuhët për të cilat mund të themi se i përkasin grupit ilirik, mund të përfshihet përveç shqipes, e dëshmuar me shkrim që nga shekulli XVI, edhe mesapishtja që njihet nga disa monumente të shkruara të shkurtëra dhe jo të bollshme. (f. 67). Më tej autori në këtë shkrim merret me marrëdhëniet gjuhësore të mesapishtes me shqipen, duke vënë në dukje disa elemente të mbishkrimeve mesape që ka të ngjarë të shpjegohen me shqipen si: mesap. *bilia*, shqip *bilë bijë*; mesap. *Brendon*, shqip *bri brinj*; mesap. *Iuppiter Menzana*, shqip *maz, mëz* etj. Autori hedh idenë e marrrëdhënieve të Dorasve me Ilirët dhe të grecitetit italik me mesapishten, duke supozuar edhe ndikime gjuhësore në mes tyre.

Problemin e etnogjenezës së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe Vittore Pisani e ka ritrajtuar edhe në një Kolokuium Albanologjik Ndërkombëtar, mbledhur në Innsbruck në vitin 1972, kushtuar Norbert Jokl-it. Në këtë Kolokuium autori mbajti kumtesën *Sulla genesi dell'Albanese*, botuar në aktet e këtij Kolokuiumi me titull *Akten des internationalen albanologischen kolloquiums*, Innsbruck 1972, p. 345-366. Autori e trajtoi problemin e etnogjenezës së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe më shumë në një plan teorik të përgjithshëm nga perspektiva e dialektologjisë indoeuropiane.

Si përfundim mund të pohojmë se gjuhëtari i mirënjohur Italian Vittore Pisani hyn në historinë e studimeve albanologjike si dijetari që u angazhua seriozisht në trajtimin e problemit të etnogjenezës së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe dhe solli kontribute me vlerë, sidomos në planin e metodologjisë shkencore të trajtimit të tyre. Ai mbështeti tezën e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve, njohu përkatësinë ilire të mesapishtes dhe të mbishkrimeve të saj, relativizoi rëndësinë e ndarjes *kentum* dhe *satem* të gjuhëve indoeuropiane në çeshtjen e origjinës ilire të gjuhës shqipe etj.

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

STUDIUES ITALIANË PËR PREJARDHJEN E GJUHËS SHQIPE

Abstrakt. Në studimet italiane për gjuhën shqipe, për historinë e saj, vendin e formimit dhe për raportet e saj me gjuhët e lashtësisë ka pasur diskutime. Ka pasur opinione të përhapura për lashtësinë e saj në fazat e hershme në hapësirat ku flitet në kohë të vona. Studiues seriozë në gjuhësinë e krahasuar si V. Pisani kanë anuar drejt tezës për lidhjet me ilirishten. Ka studiues të rëndësishëm për studimet romane, ballkanike e për shqipen në sh. 20 si C. Tagliavini, që e kanë parapëlqyer teorinë e 'kompromisit' të N. Jokl-it. Ka pasur diskutime me interes lidhur me raportet midis shqipes së lashtë e mesapishtes, por ka të tjerë që në kohë më të vona kanë anuar më parë drejt një vështrimi që e largon nga horizontet me emërtime të vjetra. Nuanca idesh ndeshen te F. Ribezzo, V. Pisani, G. Bonfante, E. Banfi, P. di Giovine, G. B. Pellegrini, etj. Këtu do të merren në vështrim aspekte të tilla, më parë te diskutimi për idetë e V. Pisani-t, të E. Banfi-t, të G. Bonfante-s, etj.

Diskutimet për vendin që zë gjuha shqipe në kuadër të gjuhëve indoeuropiane e për raportet e saj eventuale me gjuhët e lashtësisë në Ballkan në dijet që janë zhvilluar në truall të Italisë kanë një histori dhe ajo nuk mund të përmblidhet në pak minuta pa lënë në hije aspekte thelbësore. Në faza më të hershme, duke u nisur nga supozimi se shqipja duhet të jetë folur në këto hapësira qysh në kohë të mugëta ka pasur diskutime të ndryshme për ndërlidhjet me gjuhë e komplekset gjuhësore të hershme. Ka pasur dijetarë që shqipen e përfshinin në diskutimet lidhur me substratet paleoballkanike e mesdhetare.[1] Ndërlidhjet me kompleksin pellazgjik, emërtim brenda të cilit zakonisht përmblidhen gjëra të ndryshme, kanë qenë të parapëlqyera shpesh në mjediset ku gjallonte miti për prejardhjen prej kohës paragreke ndër të interesuar arbëreshë, ndër arvanitë, ndër intelektualë të Rilindjes, sërish në pjesën II të sh. XX ndër shqiptarë, dhe për këtë mund të gjenden motivime të ndryshme.[2]

---

[1] Shih H. Barić në kap. *Ndikimet e substratit paraindoevropjan*, të veprës së tij *Hŷmje në historín e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1955, 53-58 (botimi serbok.: *Istorija arbanaškog jezika*, Sarajevo, 1959, 33-36). Ndër studiuesit italianë ai referonte A. Trombetti 1925: *Le origini della lingua basca*, Bologna dhe *Saggio di antica toponomastica mediterranea*, në *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju III*, Beograd, 1926, 1-116. Qëndrimi i Çabejtë mund të shihet te *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, 41-44.

[2] Miti për prejardhjen pellazgjike të shqiptarëve e të gjuhës shqipe është i vjetër; ka shërbyer në funksione të ndryshme, ideologjike, kombëtariste, në frymëzimet për çlirim. Mund të ketë dhe motivime që duan zbërthime më fine në raportet komplekse kulturore-politike-

Ka pasur vështrime lidhur me shqipen e gjuhët paleoballkanike me rastin e hulumtimeve për mbishkrimet mesape, janë rritur hipoteza me mbështetje të arsyeshme për lidhjet midis mesapishtes e gjuhës së ilirëve në anën tjetër të Adriatikut, lidhur me mundësitë e shpjegimit eventual të fenomeneve të ndeshura atje përmes fazave të hershme të shqipes. Albanologu J. G. von Hahn,[3] mbështetur te njoftimi i Strabonit, pas të cilit epirotët, makedonasit e ilirët ishin jogrekë, barbarë, me supozimin se epirotët, makedonasit e ilirët ishin farefis, me hamendësimin se epirotët e makedonasit përbënin thelbin e fisit tireno-pellazgjik më tej në Itali e Traki, besonte se ilirishtja ishte gjuhë pellazgjike me kuptim të gjerë dhe se ilirët, epirotët e makedonasit ishin pellazgë. Por një gjë është raporti midis makedonasve, epirotëve e ilirëve, tjetër është raporti midis ilirishtes e pellazgjishtes. Këtë ide të von Hahn-it, thoshte Çabej[4], "*shkrimtarët shqiptarë të kohës së Rilindjes e rrokën me entusiazëm... dhe i dhanë përhapje në librat e tyre*". Komparatisti A. Schleicher shënonte se shqipja ishte gjuhë indoeuropiane, që mbahej pasardhëse e ilirishtes. Kishte përdorur termin "*çifti i familjes pellazgjike*" ku shihte grupin greqishte-latinishte, që do të vinte nga një bazë e stërlashtë. *Pelasgisch* tek ai do të thoshte arkaik.[5] Në drurin gjenalogjik

religjioze-shtetërore në Ballkan. Ndër arbëreshë përmenden diskutime tek A. Masci (1758-1821), i cili shqiptarët i shihte me një prejardhje të largët pellazge përmes lidhjeve më të drejtpërdrejta me makedonasit, ilirët e epirotët. Refutohej hamendësimi për lidhjet me albanët e Kaukazit. Sipas M. Mandalàsë, në pika të tilla kishte një varg diskitimesh nga N. Keta te Gj. Krispi, pastaj te E. Bidera, i cili kishte pasur kontakte me J. De Radën dhe duhet të ketë pasur ndikim tek ai, që mbronte me zjarr idenë. Mandalà, M. 2013: *Prejardhja e mitit pellazgjik: Jeronim de Rada dhe Giovanni Emanuele Bidera*, në *Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare*, Shkodër, ff. 47-71. Për aspekte të mitit në kohë të vona shih G. de Rapper 2009): *Pelasgic Encounters in the Greek-Albanian Borderland: Border dynamics and eversion to Ancient Past in Southern Albania*, në *Anthropological Journal of European Cultures* 18 (1): 60-61, cf. Ismajli 2019: *Bashkësi gjuhësore, njësi varietet*, 166-167.

[3] Johan Georg von Hahn, *Albanesische Studien I*, Jena, 1854*:215.*

[4] E. Çabej: *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, në *Studime gjuhësore III*, 1976:44.

[5] Lidhur me çështjen e substrateve paraindoeuropiane e mesdhetare në hapësirat e Ballkanit ka pasur diskutime, ndërsa lidhur me atë që është quajtur pellazgjishte janë ndërlidhur valët e ndryshme të lëvizjeve të paraIE, paragrekëve e të tjerëve. Janë të njohura diskutimet e dijetarëve P. Kretschmer, M. Budimir, etj. V. Georgiev ka mbështetur hipotezën për pellazgjishten si si gjuhë IE lindore (satem), me një vend midis shqipes e armenishtes. Në Bullgari janë zhvilluar diskutime për pellazgjishten, ose paragreqishten, si paratrakishte. A. van Vindekens e shihte më parë midis gjuhëve gjermanike dhe gjuhëve balto-sllave, të ardhur në zonat mesdhetare para grekëve, ilirëve e italikëve, në kohën kur hetitët vijuan drejt Anadollit (2000-1500 p. K.). Rikujtojmë vlerësimin e Çabejtë: "*Duke i shikuar teoritë e fundit rreth pellazgjishtes... shihet se ato ecin nëpër shtigje të pasigurta, aq sa... mund të thuhet se gjindemi ende në një fazë parashkencore*". Çabej, *Studime gjuhësore*, 1976:44.

indoeuropian, Schleicher-i veçonte degën e gjuhëve *ario-greko-italo-keltike* që më tej ndahej në degët *greko-italo-keltike* dhe *ariane*, ndërsa *greko-italokeltikja* në degët *italo-keltike* më tej në *keltike* e *italike*, ndërsa dega tjetër kishte dy skaje të funtme - *Albanesisch* e *Griechisch*, ku greqishtja ndahej më herët, ndërsa shqipja pak më vonë.[6] Vendin e shqipes e caktonte kryesisht mbi bazë të afërsisë gjeografike.[7]

Më 1864 te gjuhëtari arbëresh Dh. Kamarda[8] gjejmë rrezatime të ideve të një pjese të gjuhësisë së kohës. Sipas vrojtimit të W. Fiedler-it, ai përpiqej të dëshmonte "*një bashkëpërkim gjenetik të greqishtes e të shqipes*".[9] Edhe studiues të njohur si G. Ascoli, A. Trombetti, etj. kanë shprehur ide për këto aspekte të historisë së shqipes. Romanistë italianë të sh. 19 e 20 kanë nyjëtuar ide me interes sa i përket historisë së shqipes. Ka mbisunduar vështrimi që shqipen e sheh gjuhë indoeuropiane me të kaluar të lashtë në Ballkan.

Janë të njohura pikëpamjet e gjuhëtarit të shquar Carlo Tagliavini, i cili, sa i përket periudhës së hershme dhe vendosjes së shqipes në raport me gjuhët e lashta të Ballkanit, ndiqte vijën e N. Jokl-it (që është quajtur e 'kompromisit') për prejardhjen e shqipes midis ilirishtes e trakishtes, duke kërkuar vendin e hershëm të saj në Dardani,[10] pastaj idetë e studiuesve si F. Ribezzo,[11] M. Bartoli,[12] V. Pisani, e të tjerë. Në vitet '30 të sh. 20 ndër shqiptarë pati të interesuar për dijen dhe

---

Aty mund të shihen vlerësimet e tij për substratin mesdhetar. Të shihet Katičić, R.: *Ancient Languages of the Balkans, I-II*, Hague, 1976, e te Ismajli, R.: *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë, 2015, etj.

[6] Schleicher, A. 1861: *Compendium der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*, 4-. Porzig, W. 1974: *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebiets*, Heidelberg, f. 22-23.

[7] Franz Bopp-i më 1855 kishte shprehur mendimin se shqipja nuk kishte lidhje më të ngushta afrie me asnjërën prej '*motrave të tjera të sanskritishtes*'.

[8] Demetrio Camarda 1864: *Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese* Livorno dhe 1866: *Appendicce al Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno. Vepra ka një ribotim anastatik në Palermo, 1989.

[9] Fiedler, Wilfried 2006: *Einführung indie Albanologie*. Shih Ismajli 2015:28-29.

[10] Tagliavini, Carlo 1968: *La stratificazione del lessico Albanese*, Bologna; *Gli elementi latini nell'albanese*, në *Cultura neolatina I, II*, ff. 90-94; Ismajli, R. 2015:247-252. Shih Priku, M. 2011: *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*, Shkodër.

[11] Francesco Ribezzo (1875-1952): *La lingua degli antichi Messapi*, 1907; *Corpus Inscriptionum Messapicarum*, Palermo 1938. Të shihet: *Italia e Illiria preromena*, in *Italia e Croazia*, Roma, 1942, 21-83 e *Premesse storico-linguistiche sull'autoctonia illirica degli Albanesi*, në *Rivista d'Albania*, 1940, 1, 114 e vijim.

[12] Namik Ressuli më 1933 (te *LEKA V, III*, f. 54-56, 89-90 dhe 152-156), *Parime dhe metode të neo-linguistikës*, kishte kishte bërë një paraqitje me dashamirësi për idetë teorike e Matteo Bartoli-t. Shih veprat me interes për shqipen: Bartoli, M. 1932: *Accordi antichi fra l'albanese e le lingue sorelle*, në *Studi albanesi* 2, 5-73; Bartoli, M.: *Dalmatico e albano-*

teoritë e neolinguistikës italiane dhe idetë e Matteo Bartolit. Në horizontin shqiptar Ressuli-Çabej i kishin ndjekur nga afër zhvillimet e gjuhësisë areale të Bartoli-t. Çabej kishte vijuar në rrugën e Jokl-it, ndërsa Ressuli, me njohuri jo të pakta për idetë e Bartoli-t. Më vonë kanë pasur interpretime R. Ambrosini,[13] G. Restelli, G. B. Pellegrini, P. di Giovine, etj. Do vënë në pah vështrimi i E. Banfi-t për situatën ballkanike e në raport me shqipen.

Vittore Pisani

Vittore Pisani i ka shprehur idetë e tij lidhur me vendin e shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane dhe në raport me ilirishten e gjuhët e tjera të lashtësisë ballkanike në disa raste.[14] Më 1933, në një vështrim për parahistorinë e gjuhëve indoeuropiane, hapësirën e stërlashtë indoeuropiane ai e kishte vendosur afërsisht në linjat gjeografike: Deti i Veriut - Rajna - Danubi - Karpatet - Deti i Zi - Dnjepri - Gryka e Rigas - Deti Verior, duke mos ngurruar që këto relacione t'i shprehte në skicë si relacione jo njëdrejtimëshe, siç nënkuptonte teoria e *Stammbaum*-it, po më komplekse[15]:

<table>
<tr><td>irisht, britisht, galisht</td><td colspan="2">gjermanikisht</td><td colspan="2">baltosllavisht</td><td>arianisht</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2">latinisht, sikulisht</td><td>Ilirisht</td><td>trakofrigjisht</td><td>tokarisht</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2"></td><td>oskisht, umbrisht</td><td>greqisht</td><td></td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2"></td><td></td><td>hetitisht</td><td></td></tr>
</table>

Skica le të kuptohet se ilirishtja me trakofrigjishten afër, vendosej disi në qendër në raport me gjuhët veriore (lindore balto-sllave) dhe perëndimore (gjermanike), në njërën anë, dhe me gjuhët joveriore perëndimore (latinisht) dhe lindore (trako-frigjisht e më tej armenisht), pak më në jug greqisht (që afrohet

romanico, në *Italia e Croazia*, Roma, 1942, 109-185. Njihet për dalmatishten (*Das Dalmatische*, Vjenë, 1906), për atlasin e italishtes e veprat teorike *Introduzione alla neolinguistica*, 1925; *Saggi di linguistica spaziale*, 1945.

[13] Ambrosini, R. 1983: *Elementi conservativi ed innovativi nella struttura dell' albanese*, in Guzzetta, A. (ed.): *Etnia albanese*, Palermo, ff. 159-169.

[14] Ismajli, R. 2015:32 dhe 44: Pisani 1964: *Les origins de la langue albanaise*, në *Studia albanica* 1, 63; Ismajli, aty, 46, ku raportohet Pisani 1950: *L'albanais et les autres langues indoeurpéennes*, në *Annuaire de l'Institut de philologie et d'histoire orientales et slaves, t. X, Mélanges Grégoire II*, Bruxelles; për 'hipertorfinë' e ilirishtes, 115; 135-137 për raportet me ilirishten dhe për raportet me idetë e Stadtmüller-it, Ismajli: *Pisani për Stadtmüller-in dhe atdheu i parmë i shqiptarëve*, lib. i cit. 241-246.

[15] V. Pisani, *Preistoria delle lingue indeuropee*, Atti del Reale Academia dei Lincei. Memorie. Cl. dei scritti mor., storia e filologia, Ser. VI, vol. IV, fasc. VI, 545. W. Porzig, *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebietes*, Heidelberg, 1974, 48-49. Shih Ismajli, R. 2015: *Studime për historinë.*, 32-33. Pisani vinte me idetë e komparatistëve italianë e me dijet me burim të gjerë filologjik.

me grupin trako-frigo-armen) e osko-umbras.

Për këtë kishte folur W. Porzig,[16] ndërsa shtojmë se Pisani mendonte që shqipja është pasardhëse e ilirishtes, vendin e së cilës në atë kuadër përpiqej ta përcaktonte përmes risimeve fonetike që përhapeshin si valë përtej kufijve dialektorë. Ajo lëvizje do të ketë nisur nga Lindja rreth viteve 1000 para Krishtit dhe nëpër Frigji të kishte arritur në Traki rreth viteve 500 para Krishtit dhe të ketë prekur prej andej ilirishten, por jo më venetishten.[17] Lëvizje të kundërta nga perëndimi drejt lindjes ai shihte në zhvillimet e mediave të aspiruara nëpër spirantet e shurdhëta drejt mediave të pastra shumë herët qysh para ndarjes së keltëve nga gjermanikët. Pas tij nga gjermanikët kalohet te baltët, sllavët e trakasit për të arritur drejt Detit Egje rreth 1000 para Krishtit, ndërsa prej andej nëpër frigjishten e armenishten drejt Iranit, në një anë, e drejt ilirishtes, venetishtes e osko-umbrishtes në anën tjetër, ndërkohë që latinishtja ishte prekur tashmë nga kontakti i pandërmjetshëm me keltishten. Një valë tjetër sillte labializimin e labiovelareve, që përfshinte greqishten-makedonishten, osko-umbrishten, ligurishten, galishten e pak dhe irishten. Kjo mund të jetë e kohës kur keltët e ligurët nga veriperëndimi dhe oskët e umbrët nga verilindja përkiteshin në Italinë e Veriut. Lidhjet midis grekëve dhe oskëve e umbrasve, në këtë vështrim, u ndërprenë nga depërtimi i ilirëve. Më tej grekët erdhën më afër me frigasit e armenët, kohë nga e cila ka disa risi gjuhësore. Pas Pisani-t të interpretuar nga Porzig, lëvizja indoeuropiane drejt lindjes do të ketë nisur rreth mesit të mijëvjeçarit të tretë me ndarjen e arianëve dhe të tokarëve, ndërsa hetitët nën trysninë e trakofrigasve do të kenë lëvizur drejt Azisë së Vogël nga fundi i mijëvjeçarit të tretë. Në hapësirat e parme do të kenë mbetur germanët, baltët, sllavët e trakasit. Fjala është për një autoritet që në vazhdimësi ka përkitur çështje të nyjëtimit e të përhapjes së dialekteve indoeuropiane.[18]

Pisani ishte marrë me çështjen e vendit të shqipes në kuadër të gjuhëve IE, me çështjen e prejardhjes së saj dhe e kishte vënë në pah bindjen se kjo gjuhë është pasardhëse e ilirishtes (me hamendësime për një influks më nga lindja - trakishtja). Për idetë e tij folën profesorët Banfi e Mansaku.[19]

Në artikullin për pozitën e shqipes, V. Pisani përfundonte:

"*Në elementet I.E. të shqipes, përtej atyre që karakterizojnë shumicën apo tërësinë e gjuhëve I.E., mund të veçojmë një sasi të caktuar elementesh të kohëve më të hershme që e afrojnë me gjuhët e qendrës veriore të Europës, përkatësisht, sipas renditjes së*

[16] Porzig, W. 1974: *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebiets*, 48-49.

[17] Dhe në këtë vazhdë do vështruar dhe diskutimi i mëtejmë pastaj lidhur me karakterin *centum/ satem* të ilirishtes, përkatësisht *satem* të shqipes.

[18] Porzig, W.: *Die Gliederung.*, 1974, 40-52, këtu 48-49.

[19] Ismajli 1987: *Artikuj për gjuhën shqipe*, Prishtinë; *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, 2015, 32, 44-46, 89-90, 135-140 e 241-246.

rëndësisë në rritje, të gjermanikishtes, të baltishtes e të sllavishtes; një shtresë më e vonë që na e shfaq në lidhje për një kohë me trakishten dhe, përmes saj, me frigjishten e armenishten (dhe iranishten), veç tjerash me greqishten apo më mirë të themi me disa prej dialekteve që, në vijim, kanë ndihmuar për konstitutimin e njësisë greke, dhe me dialektet e ardhme osko-umbre; më në fund një shtresë e tretë edhe më e vonë, në një kohë kur frigo-armenishtja, e larguar përfundimisht drejt lindjes, pushon së komunikuari me gjuhët europiane dhe në veri të së cilës vijon skito-iranishtja, ndërsa në jug konstituohet njësia greke."[20]

Mendimet e tij janë shprehur në kohë të ndryshme dhe mund të kërkojnë interpretim në zhvillim, që këtu s'e bëjmë dot. Pisani fliste për vështirësitë që i shfaqeshin në rindërtimet e raporteve të shqipes së hershme me gjuhë që nuk i njohim mirë, në shkallën që në një rast ilirishten ta cilësonte atë "*gjuhë që fatkeqësisht mund ta përkufizojmë si fantomatike*", ndërsa trakishten nuk e njohim.[21] Sipas e tij në Ballkanin e lashtë shpërfaqej një zonë gjeolinguistike me frigjishten, trakishten e ilirishten, por mbase duhej parë mundësia e një prejardhjeje të dyfishtë të etnosit shqiptar brenda marrëdhënieve lindje-perëndim: krahas filiacionit ilir të Ballkanit duheshin marrë në vështrim elementet që mund të vinin nga Lindja nga kontaktet me armenët. Si indicie kujtonte emërtimet *Ἀλβανοί* e *Ἀλβανία,* që mund të lidhen me qarkullimin të ndonjë fisi prej andej. Raportet me armenishtren e me greqishten i dukeshin po ashtu me rëndësi. Në fushën e leksikut i theksonte lidhjet e shqipes me gjuhët e Europës veriore (gjermanike e balto-sllave, të hetuara dhe në fushën fonetike) e me greqishten, në fushat e jetës pastorale, të artizanateve, të besimeve.

Më duket me ineres të vë në pah dy ide të avancuara nga ai: në studimin e historisë së gjuhëve shpesh e vlen të nisemi nga gjendja e sotme për t'u ngjitur më tej në histori. Ideja tjetër ka të bëjë me trajtimin e raportit gjuhë/ dialekt, me ç'rast përparësi ka dialekti dhe menjëherë pastaj të kalonte te problematika e ekzistencës së një protogjuhe shqipe prej së cilës do të kenë buruar dialektet.

Në vështrimin *Për problemin ilirik,*[22] Pisani ishte marrë me çështje që i dalin gjuhëtarit lidhur me disa koncepte të G. Stadtmüller-it të shprehura në veprën e tij për historinë e hershme të shqiptarëve. I tillë i dilte pikërisht përdorimi i konceptit '*atdhe i parmë'* i shqiptarëve i ndërlidhur me idenë se këto apo ato fjalë janë huazuar nga një gjuhë tjetër, kështu që '*protoshqiptarët'* nuk i njihnin ato koncepte. Argumentimi që mton se derisa emri për *zgjoin* është latin, ndërsa termat për *bletë*, *mjaltë*, *dyllë* indigjenë, çka do të thoshte se

[20] Pisani, V. 1959: *L'albanais et les autres langues indoeuropéennes*, në *Saggi di linguistica storica*, Torino, 113, referuar edhe te Pellegrini, 1998, 156.

[21] Pisani, V. 1964: *Les origines*., në *Studia albanica* 1, 66.

[22] Pisani, V.: *Il Problema illirico, Appendice 2: Su Georg Stadtmüller, Forschungen zur albanischen Frühg.*, 1941, in *Linguistica generale e indeuropea, Saggi e discorsi*, I. Torino, 1959, 100-101, Archivio Glottologico, XXXIV, 1942, 128. Ismajli 2015:241-246.

protoshqiptarët do të kenë njohur bletët e egra, por apikulturën do ta kenë nxënë nga romanët dhe, në më gjerë, se fjalët që shënojnë 'lugina' e të ngjashme janë me prejardhje latine, sepse "*shqiptarët i njohën rrafshinat në rajone pyjore në kohën kur ato ishin tashmë të romanizuara*", për të shtruar pyetjen: athua malësorët '*protoshqiptarë'* vërtet do të kenë qenë kaq larg nga luginat? Mospajtimet e tij Pisani i shprehte dhe në mënyra të tjera. Ai diskutonte me distancim të qartë idetë e Stadtmüller-it lidhur me huazimet sllave të shqipes. Nga huazimet sllave Stadtmüller-i, si një traditë e gjerë sllavistësh, nxirrte përfundimin se shqiptarët e hershëm nomadë do të kenë nxënë përmes kontakteve me bujqit sllavë edhe mjeshtritë. Por ai njihte se protoshqiptarët do të kenë nxënë një numër të madh të këtyre të mirave më herët përmes kontakteve me romanët. Pushtimi sllav (600) e paskësh ndërprerë këtë bashkëjetesë të frytshme kulturash e i paskësh ndaluar barinjtë nomadë në zhvillimin e tyre; vetëm pas nisjes së një bashkëjetese kulturore me popullsinë bujqësore sllave të fushave do të paskësh nisur ndikimi i frytshëm i të mirave të reja kulturore, sipas rrjedhës së mendimit të Stadtmüller-it. Pisani pyeste, me të drejtë, në çfarë mënyre u ruajtën shprehjet e numërta latine për bujqësi, ndër to parmenda, nëse do të ishin zhdukur konceptet përkatëse? Këtu vinte me vërejtjen:

> *"Është evidente se Stadtmüller-i mbështetet* ë *n*j*ë postulat q*ë *ka harruar ta demonstroj*ë*: q*ë ë*shtë se shqiptar*ë*t e sot*ë*m qenkan, pos p*ë*r gjuh*ë*n, ekskluzivisht vazhdues t*ë *barinjve t*ë *tyre endacak*ë*, p*ë*r ç*ka *askush kurr*ë *nuk ka provuar se popullata e rrafshin*ë*s, gjith*ë *duke futur n*ë *gjuh*ë*n e vet shum*ë *fjal*ë *latine e duke p*ë*rdorur, pos n*ë *klasat m*ë *t*ë *kulturuara, latinishten, e ka harruar gjuh*ë*n komb*ë*tare,"* 101,

për ta shtrirë vërejtjen lidhur me idenë e Jireček-ut për ndarjen kulturore afërsisht te via Egnatia me mbishkrimet mbisunduese greke në jug, latine në veri. Kundërshtonte përdorimet me konotacion ekskluzivisht etnik të emërtimeve si "*bullgar*" në periudhën bizantine, ndërkohë që ai emërtim ishte thjesht politik, jo etnik e gjuhësor. E vlen ta përsërisim përfundimin e Pisani-t:

> *"I tërë i ash*tuquajturi *problem i 'atdheut parmë' është shtruar keq në hulumtimet historike apo parahistorike ballkanike, dhe përbën fare mirë çift me 'problemin' e vështirë të 'Urheimat' indoeuropian: kemi mbetur te konceptet e lindura në romantizmin e tetëqindshes, tashmë ka kohë të superuar. Kështu, po ashtu, askush nuk të autorizon t'u atribuosh shqiptarëve të lashtë si të vetmen cilësinë e barinjve nomadë, mu sikur një popull të duhej të kishte një formë të vetme të jetesës",* 101.

Pisani më tej rikujtonte se në territorin kombëtar shqiptar njihen *Albanopolis* dhe *Albanoi* qysh te Ptolomeu. Prandaj edhe dyshimet eventuale se teoria që tek shqiptarët gjen pasardhësit e ilirëve të lashtë paskësh marrë grushtin vendimtar nga zbulimi i venetishtes, i dukej thjesht e pakuptim po të përmbysej pohimi, të thuhej se venetishtja nuk është ilirishte, sepse nuk pajtohet me shqipen? Lidhur me diskutimet për nyjën e shqipes dhe historinë e saj, diskutim

që Pisani e zhvilloi në shqyrtimet e ideve të A. V. Desnickaja-s për ballkanistikën, mendonte se e tërë çështja donte kthyer te raportet me rumanishten e te një "*bilinguizëm albano-rumun*" i barinjve nomadë.

Në përgjithësi mund të thuhet se shqyrtimet albanistike të këtij linguisti nga më të shquarit në Italinë e sh. XX meritojnë vëmendjen tonë dhe në ditët e sotme, sa për rezultatet e arritura, po aq për frymën dhe gjerësinë që i përshkon tejpërtej. Gjerësia e dijeve dhe njohurive të traditave gjuhësore, zotërimi i materieve indoeuropiane dhe rreptësia në konceptimet për gjuhët dhe zhvillimin e tyre u japin vlerë edhe më të madhe sprovave të tij.

Emanuele Banfi dhe zonat e latinizimit

Emanuele Banfi (1946-) grecist, romanist, është marrë me çështje të historisë së lashtë të shqipes, sidomos në raport me romanizimin e me kontekstin ballkanik. Traktati i tij për gjuhët ballkanike vlen ndër të mirët e kohës. Po - sjellim në vëmendje momente me interes, e që, sa po shoh, nuk po diskutohen.[23] Sipas tij duhej të niseshim nga konstatimet se në kohën e invazioneve sllave, për shkak se latinishtja kishte kohë që kishte depërtuar në Siujdhesën Ballkanike, në sh. 5-6, "*nuk mundet gjithsesi të flitet për një latinizim njësoj homogjen në tërë Ballkanin*".[24] Në depërtimin e latinishtes në Ballkan nga sh. 3 p.K. (luftërat ilirike) mund të shënoheshin këto faza: në vitin 219 p.K. kemi pushtimin e Istrës; në vitin 186 p.K. pushtimin e Ilirikut; në vitin 146 p.K. nënshtrimin e Greqisë e të Makedonisë; në vitin 29 p.K. pushtimin e Mezisë; në vitin 9 m.K. pushtimin e Panonisë; në vitin 56 m.K. pushtimin e Trakisë, në fillim të sh. 2 nënshtrimin e Dakisë. Rrugët e përhapjes së latinizimit: 1. nga *via Aquileia e Singidunum* nëpër luginën e Savës me degëzimet për Naiss e Serdica



[23] Ismajli 2015: *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, 2015, 284-5, etj.

[24] Banfi, E. 1972: *Aree latinizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica*, në Academia di Scienze e lettere, *Estratto dai rendiconti. Classe di letere*, vol. 106, 1972, Milano, 185-233: "*non si può tuttavia parlare di una latinizzazione egualmente omogenea per tutti i Balcani*" 215. Banfi: *Linguistica balcanica*, Bologna, 1985; *Cristianizzazione nei Balcani e formazione della lega linguistica balcanica*, in *Zeitschrift für Balkanologie*, 23 (1986), 1-11; *Storia linguistica del Sud-Est europeo. Crisi della Romània balcanica tra alto e basso medioevo*, Milano, 1991; *Le futur dans les systèmes balkaniques entre types romans et greco-byzantin*, in *Balkan-Archiv NF*, 17/18, 1992-93, 81-91.

drejt Salonica e Constantinopol; 2. *lidhja midis Aquileia e Durrachium* gjatë bregut dalmat; 3. *via Durrachium – Thessalonica* drejt Constantinopolit via Egnatia. Lat., gjuhë e administratës, u përhap si *lingua franca* në hapësirën etnikisht heterogjene, e këmbimeve e tregtisë. Nga sh. 2-3 përhapja e krishtërimit i shtyu proceset. Invazioni sllav u ndje në lat. ballkanik, "*sllavët u vendosën në ato rajone të Ballkanit ku latiniteti ishte më pak i fuqishëm*". Përpiqeshin me vendorët e paromanizuar.

Kufiri midis gr. e lat. në mbishkrime pas Jireček,[25] *Philippide e Skok (Banfi 1983, rimarrë te Mihăescu 1993. Pas Mihăescu-t linja Jireček nuk paraqiste ndonjë ndarje me rëndësi), Ismajli 2015:182.*



Invazioni sllav nxiti veçimin brenda lat. ballkanik të tri zonave kryesisht të latinizuara: 1. *bregdeti i Adriatikut* Dalmaci - Epir; 2. *zona gjatë rrjedhës së poshtme të Danubit*, me rëndësi strategjike; 3. *zona gjatë via Egnatia*, me komunikim me bregun jugor të Italisë e hapësirën e latinizuar të Dalmacisë. Duke qenë në sh. 5-6 latiniteti ballkanik i fuqishëm në këto zona, pjesa me latinizim më të dobët u asimilua më lehtë nga vala sllave.[26] Ato zona kishin kontakte midis tyre deri sa erdhën sllavët, pastaj ranë ndjeshëm. Gjatë bregut Adriatik u zhvillua 1. *zona romane me dalmatishten e vjetër*; 2. Gjatë Danubit u formua nukleusi i *dialekteve rumune*, ndërsa 3. në rajonet epirote e makedone gjatë via Egnatia u zhvillua *zona latine* prej nga dolën *elemente të greqishtes së re e të shqipes*.[27] Në zonën e tretë dalin probleme me kufizimin e kufirit midis latinishtes e greqishtes. Pas Jireček-ut, në bazë të mbishkrimeve, ajo nisej nga Lissus. Skok e

[25] Jireček, K. 1901: *Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters I*, Wien, f. 13. Banfi, E.1972: *Aree latinizzate*., 219.

[26] Banfi, E. 1972: *Aree lattinizzate.*, 217-218.

[27] Banfi, E. 1972: *Aree lattinizzate nei Balcani ed una terza area latino-balcanica*., 218-219. Lidhur me vendin e formimit të rumanishtes, si I. F. Sulzer, *Geschichte des transalpinischen Daziens*, Wien, 1871, sidomos R. Roesler (*Rumänische Studien. Untersuchungen zur älteren Geschichte Rumäniens*, Leipzig, 1871) e vendosin në Mezi, ndërsa N. Tomaschek (*Zur Kunde der Haemus-Halbinsel*, Wien, 1881) në Dardani, O. Densuşianu (*Histoire de la langue roumaine I*, Bucureşti, 1929, f. 294) në Iliri. M. Friedwagner: *Über die Sprache und Heimat der Rumänen*. Studimet e vona rumune anojnë nga vendi i formimit të rumanishtes në rajonin dako-miz midis sh. 7-9.

rishikoi çështjen duke pohuar se zona e ndikimit latin dhe zona e ndikimit grek kufizoheshin më në jug.[28] Banfi mendonte se

> "*prania e elementeve të shumtë latinë në gjuhën shqipe dëshmon se ajo gjuhë është formuar në një zonë latinizimi të fuqishëm*"

dhe vijonte me idetë e Stadtmüller-it, për të theksuar se vendi i formimit të shqipes ndërlidhej me zonat 1. e 3. latino-ballkanike, pra të Dalmacisë e të Via Egnatia. Lidhjet me zonën dalmate u dendësuan gjetë përhapjes së krishterimit:

> *"Konceptet kishtare, që shqipja i ka huazuar nga latinishtja, shfaqin një përfytyrim tingullor që të çon pamohueshëm te gjuha e vjetër romane e Dalmacisë"*[29],

është përfundimi që ishte dëgjuar dhe që flet zëshëm për hapësirën në të cilën do të jetë folur shqipja në relacionet ballkanike.

Do kuptuar që në zonën 3. latino-ballkanike u përhap një latinishte e ngjashme me të Italisë jugore. Vendosja e sllavëve në fund të sh. 6-7 në tokat e Jonit e zvogëloi ndikimin politik të Bizantit atje, popullata me gjuhë greke iku drejt Egjeut e u përcaktua '*ndarja e kontingjentit grek nga latini, që mbeti më i qëndrueshëm në territoret e romanizuara'*, shënonte Banfi, 224, 225. Midis sh. 6 e 7 zona 3. latino-ballkanike u *"mblodh një kontingjent i shënueshëm të latinizuarish të ardhur nga vija danubiane"*. Nëpër luginën e Vardarit kjo popullatë zbriti në territoret malore të Greqisë Veriore dhe përcaktoi

> "*bërthamën themeluese të dialektit maqedorumun: dialekt që edhe sot mbijeton në disa qendra të Greqisë veriore (Epir, Tesali, Maqedoni), të Jugosllavisë jugore (rreth liqenit të Ohrit) dhe të Shqipërisë jugore*".

Depërtimet e Banfi-t në fushën e latinitetit ballkanik flasin për një hapësirë të qartë të vendosjes së shqipes në pjesët e Ballkanit jolindor, pra në pjesën e lidhur më parë me kompleksin Via Egnatia e hapësirat në ndërlidhje njëherësh me romanitetin dalmatin e me tjetrin më lindor që u bë rumun.

Tek Emanuele Banfi gjejmë një sërë vrojtimesh me vlerë për shqipen dhe raportet e saj me gjuhët e tjera në studimet për gjuhësinë ballkanike, ashtu si në vrojtimet për arvanitishten.

Të tjerë

Giovan Battista Pellegrini, që veten e konsideronte nxënës të Tagliavinit, në veprën *Hyrje në studimet albanistike* kishte sjellë një panorama të ideve për vendin e shqipes brenda gjuhëve IE dhe për raportet e saj me gjuhët e lashta të Ballkanit. Ai u jepte më shumë jehonë ideve të E. Çabejtë e zhvillimeve të mëtejme te Sh. Demiraj. Paolo di Giovine kishte ndërmarrë një shqyrtim më të

---

[28] Skok, P.: *Zum Balkanlatein IV,* in *Zeitschrift für romanische Philologie LIV,* 1934, 175-215; po ai *Bysance comme centre d'irradiation pour les mots latins des langues balkaniques*, in *Byzantion VI*, 1931, f. 371. Banfi, 1972:219.

[29] Stadtmüller, G. 1966: *Forschungen*, 83; Banfi 1972, Aree., 221.

hollësishëm lidhur me afritë e supozuara të shqipes me trakishten, dakishten.[30] Në vijim të paraqitjes me vrojtime kritike të ideve në këtë fushë, të historikut të idesë për prejardhjen trakase të shqipes, në favor të së cilës u vu në pah karakateri *centum* i ilirishtes,[31] më tej konkordancat që konsideroheshin të substratit trakas midis rumanishtes, bullgarishtes e shqipes dhe korrespondencat leksikore midis shqipes e armenishtes të ndërmjetuara përmes trakishtes, të cilat ishin diskutuar te H. Barić (di Giovine 1979: 397), të hipotezës së Jokl-it për prejardhjen e shqipes, derisa ai lejonte në formimin e kësaj gjuhe konvergjencën e elementeve ilirë dhe trakas (prejardhje iliro-trakase) ndër afinitetet e shumta midis atyre gjuhëve të lashta ballkanike[32]etj.; të ideve të mbështetësve të vendosur të prejardhjes trakase të shqipes e të shqiptarëve si G. Weigand-i, i cili merrte parasysh indicie të rendit etnografik e gjuhësor, ndër të cilat përkimet rumune-shqiptare të termave latinë e fjalëve paralatine të rumanishtes, analizueshmërinë e toponimeve e antroponimeve trakase përmes leksikut të shqipes dhe e kundërta.[33] Më tej me diskutimin e argumenteve të natyrës fonetike te Barić, Dechev, Georgiev, Poghirc, Russu, etj. Para se ta argumentonte paqëndrueshmërinë e tezës trakase-dakase, di Giovine e shihte të nevojshme ta pohonte argumentimin e pamjaftueshëm të tezës ilire, pa implikuar se mohimi i lidhjeve me trakishten, dakishten, nuk do të thotë gjë për prejardhjen ilire. Mendonte se kishte arritur të shihte se teza për prejardhjen ilire të shqipes mbështetej në argumente mjaft fragjile:

> *"Më duket se këto divergjenca jo vetëm që nuk e justifikojnë hipotezën që ilirishtja të ketë qenë paraardhësja e shqipes, por e vënë në dyshim dhe mundësinë që midis dy gjuhëve të kishte një 'afri' më të ngushtë se ajo midis shqipes e balto-sllavishtes, për të dhënë një shembull",* di Giovine 1979: sh. 15, 400.

Pas një shqyrtimi të gjerë kritik të argumenteve të natyrës së fonologjisë historike për lidhjen e mundshme të prejardhjes së shqipes nga trakishtja/ dakishtja, Di Giovine nxirrte përfundime që më duken me interes. Nga të dhënat e sipërme, mendonte ai përfundimisht, është e vështirë të nxirret përfundimi për një raport gjenetik midis trakishtes (a dakishtes) dhe shqipes. Mendonte se në

---

[30] di Giovine 1979, Paolo: *Tracio, dacio ed Albanese nella prospettiva genealogica*, në *Rendiconti della Classe di scienze morali, storiche e filologiche dell'Accademia nazionale dei Lincei*, serie VIII, vol. XXXIV, fasc. 7-12, Luglio-dicembre, 397-412.

[31] Hirt 1898, H.: *Die sprachliche Stellung des Illyrischen, në Beiträge zur alten Geschichte und Geographie*, në *Festschrift für H. Kiepert*, Berlin, f. 181 e vijim; Hirt 1905, H.: *Die Ingogermanen*, Strassburg, I, 140 e vijim.

[32] Jokl, N.: *Albaner*, B. *Sprache*, në Ebert: *Reallexikon der Vorgeschichte* I, f. 84 e vijim; S. Mladenov 1938, S.: *Albanisch und Thrako-Illyrisch*, në *Balkan-Archiv* 4, 181; Ribezzo 1940, F.: *Premesse storico-linguistiche sull'autoctonia illirica degli Albanesi, Rivista d' Albania* 1, 114. Thoshte: teza e një prejardhjeje ngusht ilire e trakase nuk gëzon përkrahje, Georgiev 1963, V.: *Thrace et Illyrien*, në *Balkansko ezikoznanie* 6, 1963 71 e vijim.

[33] Weigand 1927, G.: *Sind die Albaner Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?*, *Balkan-Archiv* 3, 1927, f. 227 e v., shën. 7, 398.

këto shqyrtime duan marrë në konsideratë edhe raportet midis kulturave të ndryshme. Një prej elementeve me rëndësi i dukej konfrontimi midis sistemeve fonologjike. Prandaj i dukej se hipoteza e Hirt-it, diskutimet e Weigand-i e të tjerëve, e shfaqnin dobësinë e tyre në fushën e fonologjisë së krahasuar, që nga momenti që konkordancat janë pak sinjifikative, ndërsa mospërkimet shfaqen në pika me rëndësi për sistemin fonologjik. Për reflekset më të detajuara të di Giovine-s në këtë vështrim të shihet më gjerësisht libri ynë *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, 2015, ff. 92-100, ndërsa për ndihmesat e tij po ashtu me interes lidhur me reflekset e grupeve latine *cs*, *ct* në gjuhën shqipe shih po atë vepër 391-399.

Të themi po ashtu se diskutimi i Paolo di Giovine-s për raportet e shqipes me trakishten dhe përfundimi që fliste kundër mundësisë së lidhjes së prejardhjes me të, ashtu si shënimi distancues për raportet me ilirishten, sikur flasin për nevojën që ndjehet për të marrë në konsideratë idetë për një vijimësi tjetër, të veçantë, të shqipes në raport me grupet mëdha ilire e trakase.

Giuliano Bonfante

Do të merremi pak më shumë me pikëpamjet e njërit prej të mëdhenjve të neolinguistikës italiane afërsisht të asaj kohe, të indoeuropeistit të shquar, Giuliano Bonfante (Milano 1904-Roma 2005), i cili është marrë me problematikën e prejardhjes së gjuhës shqipe në disa raste, qoftë si studiues i problematikës indoeuropiane në suaza të teorive spaciale të Matteo Bartoli-t e të tjerëve në vijim, ku ai vetë zinte një nga vendet qendrore, qoftë si studiues i rumanishtes dhe i romanitetit lindor. Për G. Bonfante-n, profesor i linguistikës në Itali deri më 1939, i ikur në Gjenevë e SHBA (Princeton) pas ardhjes së fashizmit, i rikthyer në Genova e Torino si profesor (1952-1969), specialist i njohur për hetitishten, latinishten, gjuhët baltike, rumanishten, historinë dialektore të italishtes, më herët kisha pasur rastin të lexoja shkrime të tij për këtë problematikë, sidomos pas *Kuvendit të Ilirëve* të vitit 1972, ku pata rastin ta takoja dhe personalisht, po dhe për parimet e gjeolinguistikës.[34]

Nëse ndjekim paraqitjen e Walter Porzig-ut për nyjëtimin e gjuhëve indoeuropiane, do të shohim se diskutimet e Bonfante-s lidhur me këto aspekte të gjuhësisë indoeuropiane fare herët ndërlidhen me idetë e Antoine Meillet-së, sidomos sa i përket vendosjes së armenishtes në suaza të gjuhëve skajore (Ran-

[34] Me interes për këtë vështrim: *I dialetti indoeuropei*, 1931; *La dottrina neolinguistica* , 1970; *Studi romeni*, 1973, etj.

dsprachen), ndërkohë që ky bashkë me Matteo Bartoli-n vërenin atje dhe elemente për grupin qendror. Vetë Bonfante jepej dhe pas idesë së Holger Pedersen-it lidhur me lidhjet e afërta të armenishtes me greqishten (Porzig 1974:44-45). Dhe kjo ishte koha kur Emile Benveniste-i po vinte me idenë që greqishtja, armenishtja e trako-frigjishtja formonin një grup më të ngushtë, që nuk mund të kishte status të gjuhëve të skajeve. Diskutimet e Bonfante-s shkojnë më tej te raportet me arishten, tokarishten e hetitishten ndaj gjuhëve që quheshin qendrore (Porzig 1974:45). Në aspektet më konkrete të studimit të mbetjeve dialektore të gjuhëve si ilirishtja e trakishtja po sillnin ndihmesa autorë si Norbert Jokl-i (i cili merrej me vështrimet mbi gjuhët si shqipja, ilirishtja, trakishtja dhe frigjishtja në rendin e përgjithshëm të gjuhëve indoeuropiane). Materiale të reja për ilirishten dhe përhapjen e saj sillte Hans Krahe, i cili e vendoste atë te gjuhët *centum*, afër gjermanikishtes, italikishtes e keltishtes, ndërsa venetishten e shihte gjuhë të veçantë midis latinishtes, ilirishtes e gjermanikishtes. Ndërkaq, Anton Mayer-i mendonte se ilirishtja kishte karakter *satem* (Porzig 1974:46-7).[35] Wacław Cimochowski e të tjerë mendojnë se ilirishtja ishte *satem*, ndërsa Eric P. Hamp-i e më vonë kishin shënuar zhvillimet e kushtëzuara velarizuese të qiellzoreve në fqinjësi me sonantet. Kishte pasur dhe një relativizim të izoglosës *satem /centum*.

Në vështrimet e hershme lidhur me dialektet indoeuropiane G. Bonfante mbështetej tek A. Meillet-ja, ndërsa si metodë ndiqte atë të gjeografisë gjuhësore. Leximet e tij Porzig-u i përmblidhte si vijon:[36]

1. Ka një grup të mbyllur perëndimor të dialekteve IE (italik, keltik dhe gjermanik);
2. Një grup po ashtu të mbyllur përbëjnë arishtja dhe sllavishtja në lindje;
3. Midis dy grupeve të tilla si nyje ndërlidhëse janë në veri baltishtja dhe në jug greqishtja me pozicione të veçanta; baltishtja anon nga lindja, ndërsa greqishtja nga perëndimi.

Giulio Bonfante shqipen e shihte diku në mes. Pas tij ekzistonte një grup i mbyllur perëndimor i dialekteve IE: italik, keltik, gjermanik dhe një grup i mbyllur lindor: armen e sllav. Në mes si lidhje vinin – në veri baltiku nga lindja, në jug greku nga perëndimi. Shqipja vinte në mes, as në veri as në jug, por nga lindja bashkë me trakishten, frigjishten, ilirishten.[37] Pasqyra e përgjithshme e konceptit të Bonfante-s siç është paraqitur te Prozig 47,[38] duket:

---

[35] Krahe, Hans 1925: *Die alten balkanillyrischen geographischen namen*, Heidelberg; Krahe 1929: *Lexikon altillyrischer Personnennamen*, Heidelberg; Mayer, Antun 1957, 59: *Die Sprache alten der Illyrier*, I-II, Wien.

[36] Porzig 1974: *Die Gliederung*., f. 47.

[37] Giulio Bonfante, *I dialetti indoeuropei*, *Annali del Reale Istituti Orientale di Napoli IV*, 1931, 69. Shih po ashtu W. Porzig 1974: *Die Gliederung*., 47.

[38] Të raportuar te Ismajli, R. 1987: *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 34.



Kompleksi *trakishte-frigjishte, ilirishte, shqipe* është në rendin e dytë midis keltishtes e venetishtes, në anën perëndimore e iranishtes-indishtes në anën lindore. Shigjetat tregojnë se grupi trako-frig-ilir-alban ka relacione me venetishten e më tej keltishten në perëndim, jo me irano-indishten në lindje; bien në sy indikacionet e relacioneve me pjesën lindore të gjuhëve të veriut – sllavishten e tokarishten e me greqishten ndër gjuhët e jugut. Relacioni me armenishten mbetet i nënkuptuar përsa është shënuar raporti greqisht armenisht, ashtu si dhe greqisht-baltisht. Për gjërat themelore kjo skemë të kujton atë të A. Meillet-së.

Në kumtesën që mbajti në Kuvendin e studimeve ilire në Tiranë më 1972 me temën *Shqipja dhe ilirishtja*[39] Giuliano Bonfante paraqiti idetë e tij për prejardhjen e gjuhës shqipe e që janë afërsisht këto:

Në lashtësi dalloheshin dy popuj të mëdhenj në Ballkan: trakasit në Bullgari, Turqi europiane, Rumani dhe ilirët në Shqipërinë e sotme, Jugosllavinë e atëhershme, por dhe në Maqedoninë greke, në Epir, Etoli e Akarnani me ilirë, pjesërisht të përzier me grekët – mixobarbari. Nga dy izoglosat e mëdha IE – *centum/ satem*, ai shihte në Ballkan trakishten – *satem* e ilirishten *centum*; duke qenë *satem* shqipja nuk mund të ishte pasardhëse e ilirishtes (*Studime ilire* II:93). Prandaj shqipja lidhet me trakishten, shqiptarët janë pasardhës të trakasve të lashtë. Deri këtu nuk ka gjë të re në rrjedhat e studimeve të trashëgimisë së pjesës së parë të sh. 20 pas C. Pauli-t e të tjerëve, sidomos pas ashpërsimit të tezës te G. Weigand-i.[40]

Për qartësi më të madhe në këto raporte, pas tij, ka nevojë të vështrohen raportet e shqipes me rumanishten. Rumunët janë trakas apo trako-dakas që e kanë nxënë latinishten, por kanë në gjuhën e tyre 160 fjalë që nuk janë latine, sllave, gjermanike, hungareze, as turke – i përkasin *'substratit të lashtë trako-dak'*,

[39] Giuliano Bonfante: *Shqipja dhe ilirishtja*, në *Kuvendi I i studimeve* (Tiranë 15-20 shtator 1972) II, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë 1974, sipas *Studime ilire* II, Rilindja, Redaksia e botimeve, Prishtinë 1978, 93-96.

[40] Rrjedhat janë pasqyruar mirë në veprat e E. Çabejtë (*Hyrje në historinë e gjuhës me fonetikë historike*, Prishtinë 1976), pastaj të Sh. Demirajt (*Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988, Tiranë 2013) dhe ne vetë kemi shprehur në mendim në *Artikuj për gjuhën shqipe* 1987 dhe *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik* 2015.

shprehej ai. Prej tyre jo më shumë se 70 gjenden në shqipen; veshja e tyre fonetike nuk lejon të mendohet se do të kenë hyrë nga shqipja në rumanishten ose anasjelltazi, pohonte ai. Duke iu referuar I. I. Russu-it,[41] sillte këta shembuj:

viezure - vjedullë, bască - bashkë, buză - buzë, copil - kopil, guşă - gushë, moş - moshë, mugur - mugull, gălbează - këlbazë, ghiuj - gjysh, gog - gogë, strungă - shtrungë, zară - dhallë[42]

Në analizat e tij dilte se kemi të bëjmë kryesisht me fjalë të një populli barinjsh, ndaj këto janë fjalë trakase në rumanishten. Ndër veçoritë shqiptimore shënonte se shqipes *dh* i përgjigjet rumanishtja *z* (*zara-dhallë, viezure-vjedullë*); shqipes *ll* i përgjigjet *r*, prandaj kemi fjalë të lashta, më të hershme se pushtimi romak (*Studime ilire II*:94). Izoglosa vetëm rumune-shqipe sipas tij janë: *a* atone bëhet *ă* në rum, *i* në shqipen; *án* e *ám* bëhen *ăn, în* ose *ăm, îm*, ndërsa *e* atone bëhet *ă; n* bëhet *r*, në toskërishten dhe në të folmet istrorumune në Banat, e kjo do të thotë se duhet ta zhvendosim atdheun e parmë të shqiptarëve në veri, në Daki, pra shqipja është me prejardhje trakase, sipas tij (*Studime Ilire II*:94). Diskutonte çështjet e elementit latin të shqipes dhe të rumanishtes: konstatonte se ka përkime fonetike:

1. *o* atone bëhet *u*
2. *u* e shkurtë latine ruhet
3. *li* para zanores fundore bëhet *l'* (it. *foglio, capei*)
4. *o* para grupeve bashkëtingëllore bëhet *u*;
5. *ce, ci* latine (*ke, ki*) dhe *ge, gi* (*ge, gi*) qiellzorizohen më pak në shqipen (*qind, centum, gjind gentem*, më shumë në rumanishten);
6. *kl* bëhet *kj, gl gj, chiema* nga *clamare*, it. *chiamare, f.* 95.

Në leksik i dalin lidhje të habitshme: fjalë latine që ruhen vetëm në rumanishten dhe në shqipen, fjalë që ndryshojnë kuptim vetëm në rumanishten e në shqipen: *conuentum* me vështrim të fjalës[43], *draco* me vështrimin dreq.

Në strukturën morfologjike asnjanësi në rumanishten, italishten e shqipen është i njëjtë. Ka origjinë latine, por i përtëritur: lat. fructus e murus mashk. it. il frutto: la frutta, il muro le mura. Kjo tregon se është evidente që shqiptarë e rumunë dikur kanë qenë një popull, flisnin një gjuhë dhe ky popull pastaj qe romanizuar, më shumë rumuni, më pak shqiptari. Dhe qe romanizuar vonë, në

---

[41] *Beziehungen der rumänischen Sprache zum albanischen und zum Substrat*, në *Revue de linguistique* 8, 1963, f. 262, këtu f. 93.

[42] Lidhur dhe me disa nga këto fjalë le të shënojmë shkurt: *bashkë* lidhet me shqipen *bashk*, ashtu si *moshë* me *mot*; *këlbazë* është shpjeguar nga Çabej si ndërtim nga kalb+azë: këlbazë; shtrungë nga shtroj, si shtëllungë nga shtëlloj, shtjell.

[43] Kemi të bëjmë me shënime pjesërisht të sakta: *conventum* në shqip ka dhënë kuptimin *kuvênd/kuvënd* (mbledhje, tubim), ndërsa vetëm pastaj mund të jetë shtrirë te kuptimi *fjalë, besë*. Në toskërishten verilindore mund të ndeshet si në arumanishten e rumanishten, por kjo më duket më shumë e lidhur me çështje kontakti.

sh. II të erës së re, çka i shpjegon konkordancat me italishten. Meqë rumanishtja ka vazhdimësi në Daki, shqiptarët dikur kanë banuar në Daki (perëndimore, rotacizmi) dhe prej andej migruan në jug.[44]

Këtu ai arrinte edhe për shkak të disa konsideratave, (*Studime ilire II*: 95), e që janë: Çabej përmend vetëm tri-katër fjalë nga greqishtja e vjetër; sipas Rosetti-t, në mbishkrimet në Shqipëri veriu shkruante latinisht, jugu greqisht, në gjuhën vendëse nuk shkruhej kurrë. Në një vend ku gjuhë zyrtare ishte greqishtja, duket e habitshme që ndikimi i saj të zhduket tërësisht. Kjo do të thotë se shqiptarët nuk janë autoktonë në Shqipëri, ndërsa kontaktet e tyre me grekët janë të vona; po të shiheshin të ardhur nga Dakia, del se ato tri-katër fjalë greke mund të ishin nga substrati ilir, prandaj:

> "*shqipja është substancialisht një gjuhë trako-dake me shumë ndikime latine, sllave, turke, venedikase*", aty, 96.[45]

Sipas tij, toponomastika e Shqipërisë është kryesisht sllave (për këtë referonte veprën e Puşcariu-t, *Die rumänische Sprache*, 206); ka emra nga ilirishtja si *Shkodër, Durrës*, por ato nuk i tregojnë ndryshimet në shqipen e sotme që duhej t'i kishin treguar sikur të ishin nga ilirishtja në shqipen; *sk*- nuk mund të jetë shqipe, sepse *sk* e lashtë dha *h: njoh – gnosco, gr. γνώσκω, gnōskō, σκιά hije*. Terminologjia detare dhe e peshkimit janë me origjinë latine ose venedikase e italiane a sllave, pra kemi të bëjmë me një popull barinjsh kontinentalë. Përkundrazi, ilirët ishin lundrues e piratë, trashëgimtarë të tyre mund të jenë uskokët e Narentës (Neretvës).[46] Trashëgimtarë të ilirëve qenë dalmatët, gjuha e të cilëve u zhduk. Dalmatishtja ruan të paprekura velaret latine – *kenuór* nga *cēnāre*, shqip janë prekur – *qind* nga *centum*, 96. Prandaj

> *'dalmatishtja është iliro-romane, kurse rumanishtja (dhe brenda kufijve të romanitetit të saj, shqipja) janë dakoromane, ose, po të duam, trako-romane"*.[47]

Deri këtu, sidomos lidhur me çështje të leksikut rumuno-shqiptar, ai ndiqte idetë e Ion Iosif Russu-it, për qëndrimet e të cilit ka pasur vërejtje. Sa u

---

[44] Lidhur me diskutimet e gjera në rumanistikë e më tej për ide si kjo lidhur me lëvizjen/ bartjen e një pjese të bashkësisë folëse të shqipes, apo të tërësisë së saj nga hapësirat në veri të Danubit në jug, ku ndodhet në perudhën historike, shih Ismajli, R. 2015: *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*.

[45] Siç do të shihet, Çabej nuk kishte përmendur vetëm tri-katër fjalë greke të lashta, po pak më shumë, dhe kjo histori lidhur me huazimet nga gr. e lashtë ka nisur shumë më herët. Përdorimi kështu i pjesërishëm i të dhënave mund të kishte motivim që shkon përtej.

[46] *uskoci*, skr. *uskočiti* (me kapërcye, kcye përtej). Të ikurit nga hapësirat sllavojugore të pushtuara nga osmanët, të cilët nga zonat e Habsburgëve e të Venedikut riktheheshin për të plaçkitur e luftuar kundër turqve bashkë me të tjerë brenda hapësirës osmane. Përmenden të parët në sh. 16 nga Hercegovina të vendosur në rajonet e Splitit. Njihet krahina e Senjit.

[47] Për aspekte të këtilla shih diskutimet e Banfi-t të referuara më sipër.

përket fjalëve, siç kishte ngulur këmbë qysh herët Çabej, duhet të thuhet se disa syresh në shqipen kanë ndërtim transparent: *këlbazë, shtrungë, hamës, drojë,* etj., prandaj nuk ka kuptim të flitet për to si për fjalë të substratit.[48]

Si shembull më tej Bonfante merrte rotacizmin: te rotacizmi i *-l-* ndërzanore të rumanishtes shihte mundësinë e ndonjë ndikimi iranian (tashmë tepër të hamendësuar), çka mund të bartej pastaj dhe te ndryshimi *n:r*. *n* bëhet *r* në toskërishten dhe në të folmet istrorumune në Banat, kjo do të thotë, sipas tij, se atdheun e parmë të shqiptarëve duhet ta zhvendosim në veri, në Daki, pra shqipja është me prejardhje trakase, 94.[49]

Aexandru Rosetti kishte reaguar me kohë ndaj këtyre pohimeve për rotacizmin në rumanishten. Sipas tij, rotacizmi i -l- në -r- bë rumanishte ishte më i hershëm se invazioni sllav dhe nuk ka baza materilae që do të indikonin ndikimin iranian. Rotacizmi *-n-: -r-* në rum. e shq. ka paralelizëm, por jo komunitet. Rotacizmi i tosk., sipas tij, është më i vonë.[50] Ne kemi shprehur po ashtu një mendim tjetër për këtë çështje qysh herët.[51]

Më tej, Bonfante theksonte se për lidhje të këtilla flet dhe fakti se elementi latin i shqipes e rumanishtes shfaq përkime fonetike të shënueshme. Shqiptarë e rumunë dikur kanë qenë një popull, flisnin një gjuhë dhe ky popull pastaj qe romanizuar, më shumë rumuni, më pak shqiptari. Dhe qe romanizuar vonë, në sh. II të erës së re, çka i shpjegon përkimet me italishten.[52] Meqë rumanishtja ka vazhdimësi në Daki, shqiptarët dikur kanë banuar në Daki (perëndimore, rotacizmi) dhe prej andej migruan në jug. Kështu afërsisht mund të përmblidhet ky fill i idesë.

Nga greqishtja e vjetër shqipja ka pak huazime (2-3, edhe po të jenë 10), thoshte ai. Në një vend ku gjuhë zyrtare ishte greqishtja, duket e habitshme që ndikimi i saj të zhduket tërësisht. Kjo do të thotë se shqiptarët nuk janë autoktonë në Shqipëri, ndërsa kontaktet e tyre me grekët janë të vona; po të shiheshin të ardhur nga Dakia, del se ato tri-katër fjalë gr. mund të ishin nga substrati ilir:

---

[48] Për historinë e ideve lidhur me raportet midis shqipes e rumanishtes, përfshirë idetë e I. I. Russu-it shih Ismajli, 2015:271-268.

[49] Nuk ka qëndrueshmëri në përcaktimet *trakase* a *dakase*, *trako-dakase*, sepse një gjë është të themi ka prejardhje dakase dhe kjo të çon patjetër në veri të Danubit, e tjetër të themi se ka prejardhje trakase, që të lidh me hapësirat në jug të Danubit e rreth maleve Ballkan; tashmë ka mjaft gjuhëtarë që shohin dallim të rëndësishëm midis dakishtes e trakishtes.

[50] A. Rosetti 1974: *"Rhotacisme" et "pseudo-rhotacisme" en roumain,* në *Revue Roumaine de linguistique XIX*, 399-400, dhe te: *Mélanges linguistique*, Bucureşti, 1977, 137-138.

[51] Për rot. shih R. Ismajli 1971: *Edhe diçka rreth rotacizmit në gjuhën shqipe*, në *Dituria*, Prishtinë, 2-3, dhe te Ismajli1987: *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 184-192.

[52] Por, ç'të themi për huazimet e shqipes nga latinishtja para sh. II?

"*shqipja është substancialisht një gjuhë trako-dake me shumë ndikime latine, sllave, turke, venedikase*", 96. Por, nga A. Thumb e tëhu[53] dihet se huazimet greke të lashta shkojnë në numra mbi 30 dhe ato nuk kanë mundur të hynin në shqipen në Daki.

Në traktatin *La dottrina neolinguistica*, Torino 1970, derisa diskutonte kalimin nga një grup gjuhësor në një tjetër, Bonfante kishte konstatuar se, për pasojë ndikimi të fuqishëm, një gjuhë mund të kalojë nga një grup në një tjetër:

> "*Rumanishtja, me gjasë, nuk është tjetër pos një shqipe e romanizuar, sepse, nëse ndikimi latin në shqipen do të kishte qenë pak më i fuqishëm (ishte tashmë i fuqishëm), shqipja sot do të ishte një gjuhë 'romane' (kështu ishte klasifikuar pos tjerash në Grundriss të Gröber-it). Vetë rumanishtja pastaj kishte marrë rrjedhën serioze të rrezikut për t'u bërë një gjuhë sllave…*", aty, 21-22.

Ky qëndrim që i bën jehonë idesë së Gustav Meyer-it të fundit të sh. 19 për shqipen si "*eine halbromanische Misssprache*", i rimarrë më 1970 pas diskutimeve nga Holger Pedersen-i në fillim të shekullit e më vonë, duket gjithsesi anakronik. Në këtë pohim ka dhe diçka tjetër që meriton diskutim: "*il romeno non è che un albanese romanizzato*" (rumanishtja nuk është tjetër pos një shqipe e romanizuar), të cilin në njëfarë forme e ndeshim edhe te E. P. Hamp-i, tani vonë te B. Joseph-i, lidhur me vendin e theksit në fjalë. Të themi se ekziston mendimi mjaft i hershëm që vë në pah dallimet jo të vogla strukturore midis dy gjuhëve, të cilat e bëjnë të paqëndrueshëm pohimin e cituar.[54]

Të kthehemi te *Kuvendi i ilirëve*. Idetë që paraqiti aty ngjanin mr të G. Weigand-it, pjesërisht të V. Georgiev-it të pranishëm në sallë në atë Kuvend. Aty ishin dhe W. Cimochowski, R. Katičić, V. Pisani, R. Crossland etj. me ide tashmë të manifestuara krejt ndryshe. Diskutime, porse, pati vetëm nga Katičić, Çabej, Kostallari dhe Beci.

Pikë tjetër mbështetëse e tij është kjo: toponomastika e Shqipërisë është

---

[53] Thumb, A. 1909: *Altgriechische Elemente des Albanischen*, në *Indogermanische Forschungen* 26, 10. Shih përmbledhjen e paraqitur te Çabej, E. 1960: *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, bot. Prishtinë në *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, 45-50; Mansaku, S. 1997: *Quelques caratctéristiques des éléments du grec ancien en albanais*, në *Zeitschrift für balkanologie* 33, 182-186; Ölberg, H. 1972: *Griechisch-albanische Sprachbeziehungen*, në Muth, R. (Hg.): *Serta philologca Aeniponanan II*, Innsbruck, 33-64.

[54] Lidhur me idetë e Hamp-it në këtë aspekt shih Hamp, E. P. 1989: *Yugoslavia – as crossroads of Sprachbünde*, në *Zeitschrift für Balkanologie* 25, 47: "*historically Romania nis Latin spoken with an Albanian stres system*"; Joseph, Brian 1999: *Romanian and the Balkans: some comparative perspectives*, në Embleton, S.& Joseph, J. & Niedereh, H. J. (eds.): *The Emergence of Modern Language Sciences. Studies on the Transition from Historical-Comparative to Structural Linguistics in Honour of E. F. K. Koerner*, V. 2, Amsterdam, 218-235. Për Hamp-in shih dhe Ismajli 1996: *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*, në *Studime* 3, Prishtinë 1997, 255-274.

kryesisht sllave (sipas Puşcariu-t); ka emra nga ilirishtja si *Shkodër, Durrës*, por ata nuk i shfaqin ndryshimet në shqipen e sotme, që duhej të kishin shfaqur sikur të ishin nga ilirishtja në shqipen; *sk*- nuk mund të jetë shqipe, sepse *sk* e lashtë dha *h: njoh – gnosco*, gr. *γνώσκω, gnōskō, σκιά hije.* Lidhur me këtë argument iu bë vërejtja qysh atje se nuk merrej parasysh kronologjia.

Giuliano Bonfante dhe Eqrem Çabej, fragment nga një foto e pjesëmarrësve në Kuvendin e studimeve ilire, Tiranë 1972.

Pikëpamjet e tij Bonfante i kishte shprehur dhe në librin *Studi romeni*, 1973, rumanisht 2000; pas diskutimeve që kishte dëgjuar nga Katičić Çabej, Kostallari e Beci në Kuvendin e ilirëve nuk kishte ndryshuar diçka në pikëpamje e tij.

Në atë Kuvend Çabej (vep. e cit. 310-312) kishte shënuar disa vërejtje. Lidhur me raportet e shqipes me rumanishten ai konstatonte se qysh nga Miklosich-i në sh. 19 e këtej operohet me konceptin e një substrati trakas/dakas të lashtë. Kemi ekuacion me dy të panjohura, nuk dimë gjë nga substrati; ndërkaq, në shqipen fjalët e tilla gjejnë shpjegim brenda zhvillimit të saj, pra janë nga mesjeta e hershme, nuk kemi elemente pararom. (*bashkë* 'bashkë leshi' si rum., por shqip del nga **barshkë*; *këlbazë*, *kalb*; *moş* rum. është 'plak', *moaşă* 'plakë', shqip lidhet me *mot, shtrungë* me *shtroj*, si *shtëllungë* me *shtëlloj*, etj. Çabej pajtohej se fjalët latine të shqipes kanë afri me të rum., por mbajnë një anë të ndërmjeme midis rum,. e dalm., shqipja ka fjalë rom. që s'i ka rum., pra u formua në hapësirë të ndryshme, jo në Ballkanin Lindor. *k* latine para *i, e* u palatalizua por nuk u bë *ç*: *qiqër*, pra më e hershme; *kuvend* shpreh dhe ndërmjetësim të gr.; tani shihet që shumë elemente që shiheshin si lat. nuk janë të tilla, janë ital., vendore a tjetër. Shtonte se nga gr. e vjetër në shqipen ka rreth 30 huazime, ndërsa ndikimi ndër shqiptarë dhe më vonë ka ardhur prej Italie, jo prej Greqie; në shq. ka dorizma (*drapen, qull, mokër),* që s'i ka marrë në Daki; greq. hynë ose nga deti përmes Lissos, Dyrrachion, Apollonia, ose nga dialektet gr. veriperëndimore, ose në të dyja. Këtu Çabej e mbaronte diskutimin e tij.

Radoslav Katičić-i, f. 316, kishte bërë një sugjerim po ashtu: në romanitetin ballkanik Bonfante dallonte në një anë iliro-romanishten (dalmatishten) dhe trako-romanishten (rumanishten), në anën tjetër. P. Skok, V. Vinja dhe Ž. Muljačić kanë treguar se kishte një romanitet dalmat dhe një tjetër romanitet

trak, dako-roman. Romaniteti kontinental ishte përhapur njësoj në territorin trak dhe ilir, vllehtë janë gjithandej. Ky nuk mund të jetë argument për prejardhje lindore të gjuhës shqipe (shih për këto aspekte te Banfi, më sipër).

Më i gjerë ishte diskutimi i A. Kostallarit, f. 318-. Merrej me hipotezën për prejardhjen trakase të shqipes. Diskutonte çështjen e toponimeve *Shkodër*, *Durrës* dhe derivimit të tyre nga *Scodra*, *Dyrrachion*. Në rastin e *sk*- te *Scodra* në raport me *sk>shk* apo *sk>h* sillte argumentimin se te *njoh/ gnosco* nuk kemi të bëjmë me *sk*- nistore. Thoshte se *sk: h* i përket një periudhe të lashtë, ndërsa te *Scodra: Shkodra* kemi të bëjmë me një kohë më të vonë, periudhën antike, si te elementet latine (*scamnum*: *shkam*, jo *shkamb*, si thotë ai). Por ka dhe emra të tjerë: *Astibus :Shtip, Drivastum:Drisht, Naissus:Nish, Scupi:Shkup, Scardus Mons:Sharr, Lissus:Lesh, Isamnus:Ishëm, Scampinus: Shkumbin, Ragusium: R(r)ush* (në fakt *Rushë*), *Pirustae*: *(Qafa e) Prushit, Aulon:Vlorë, Thyamis: Çam,* etj. Vërejtja ka të bëjë me kronologjinë, f. 319. Rikujtonte se huazimet nga greqishtja e vjetër janë mbi 30, deri në 40 jo 3-4, numër që në raport me kohën nuk është i vogël. Përmendte Jokl-in që në dorëshkrimin e botuar pas vdekjes kishte shprehur mendimin se shqipja kishte më shumë huazime nga gr. e vjetër, f. 319-20. Kostallari diskutonte dhe çështjen e toponomastikës sllave në Shqipëri. Shprehte mendimin se numri i atyre toponimeve do parë më i vogël se ç'është menduar. Pranonte se në Shqipërinë e jugut ka shumë toponime sllave. Dallonte makrotoponiminë dhe mikrotoponiminë, në të cilën mbizotëron shqipja, apo ajo me prejardhje apelativësh që mund të jenë dhe huazime. Një numër toponimesh që duken sllave janë pjesë e leksikut të shqipes dhe si të tilla kanë shërbyer për emërtime vendesh, si *Koritë, Goricë*, etj. Me një fjalë, Kostallari sillte argumentime që qarkullojnë në albanistikë dhe që e kundërshtojnë konceptin e përgjithshëm e konkret të Bonfante-s.

Ndërkaq Bahri Beci, f. 324-, po ashtu vinte me rimarrjen e argumentimeve të paraqitura dhe më herët. Merrej me diskutimin e tezës themelore të mbështetur nga Bonfante: shqiptarët janë pasardhës të trakasve. Sillte kërkesën që të merren parasysh rezultatet që flasin në favor të autoktonisë. Mendonte se teza e Weigand-it për prejardhjen trakase të shqipes është kritikuar mjaftueshëm nga Çabej e Çimohovski. Disputën *centum/ satem* lidhur me ilirishten nuk e shihte të mbyllur, ka që mendojnë njërën, të tjerë thonë ndryshe. I mbahej idesë së Çabejtë, ashtu si për Scodra-Shkodër, ashtu si për terminologjinë detare e të peshkimit. Edhe sa u përket raporteve shqipe-rumanishte i mbahej argumentimit të Çabejtë. Nuk e pranonte idenë që ndarja dialektore e shqipes të jetë prodhuar diku tjetër dhe të jetë bartur pastaj në këto hapësira.

Giuliano Bonfante në Kuvend ishte përgjigjur se në diskutimet e ngritura nuk shihte argumentimë të reja, ndaj i mbahej mendimit të tij, f. 329.

Për ta ndjekur më mirë idenë e indoeuropeistit neolinguist G. Bonfante lidhur me prejardhjen e gjuhës shqipe dhe vendin e saj të hershëm më ndihmoi studimi i tij i vonë *La posizione linguistica dell' Albanese fra le lingue Indoeuropee*, botuar në *Convegno internazionale di studi albanesi*, Palermo 1973, botuar nga A. Guzzetta në Palermo më 1978, që pati mirësinë të ma dërgonte këto ditë M. Mandalà. Në frymën e neolinguistikës, pra përmes atyre që M. Bartoli quante *figura*, pra përkime të veçanta, ai vendin e shqipes së hershme e shihte si të tipit satem, të vendosur disi në qendër, afër me greqishten e armenishten, por me afri edhe me gjuhët veriore balto-sllave e gjermanike. Kritikonte Jokl-in, i cili, sipas tij, paskësh favorizuar lidhjet e shqipes me gjuhët baltike, si të themi, e paskësh parë historinë e protoshqipes me syze baltike. Në përgjithësi, e tërë kjo ngrehinë të kujton fare mirë skemën e Antoine Meillet-së te *Les dialectes indoeuropéens* të vitit 1908. Në një pikë të rëndësishme, të raporteve me armenishten, e tërë ideja të çon prapa te Holger Pedersen-i (1900), i cili kishte veçuar disa izoglosa, të cilat u rimorën me shumë zhurmë nga Henrik Barić-i, ndërsa tash vonë u zhvilluan me një sistematicitet më të madh nga Gert Klingenschmitt[55]. Bonfante nuk sillte asnjë referim te të parët, sado që duhet të themi se i gjithë materiali i sjellë nga Barić-i duket jo shumë i besueshëm. Sido që të jetë, nuk duket se afritë e supozuara të protoshqipes me protoarmenishten (mbase frigjishten) do të kenë qenë të asaj natyre që të arsyetonin supozimin për prejardhjen e shqipes nga trakishtja, apo thjesht vazhdimin e saj nga trakishtja. Kjo tani mund të thuhet me më shumë gjasë, sepse ato pak mbishkrime trakase, që janë më shumë gjithsesi se mbetjet ilire, tregojnë qartë se gjuha e tyre nuk ka të bëjë me shqipen, për këtë mund të shihet Hamp, di Giovine, Ködderitsch[56], Brixhe-Panayotou[57], etj. Për njohësin e tërësisë që mund të quhet *gjuhë paleoballkanike*, Radoslav Katičić-in, e tërë kjo nuk duket më shumë se një konstruksion interesant.

Ideja e Bonfante-s ishte kjo, që, protoshqipja, duke qenë e një hapësire

---

[55] Klingenschmitt, G. 1994: *Das Albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie*, në Rasmunsen (Hrg.): *In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 221-233; Klingenschmitt, G. 1994a: *Die Verwandschaftsverhältnisse der indogermanischen Sprachen*, në Rasmunsen (Hrg.): *In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 235-251; Klingenschmitt, G.: *Albanisch und Urindogermanisch*, në *MSS 40*, 93-131.

[56] Ködderitzsch, R. 1985: *Brygisch, Päonisch, Makedonisch*, në *Linguistique balkanique* XXVIII, 18-41.

[57] Brixhe, C. & Panayotou, A. 1997: *Le thrace*, në F. Bader (ed.): *Langues indoeuropéennes*, Paris, CNRS, 181-205.

më lindore, sepse afër greqishtes e armenishtes, duhej të ishte identike me trakishten, pra në përgjithësi e një hapësire më lindore, ndërsa ilirishtja ishte centum dhe më perëndimore. Kuptohet që lidhur me vendin e shqipes në faza më të hershme ka pasur diskutime të ndryshme. Bie në sy se në rastet si ky i Bonfante-s, e mbase edhe i Georgiev-it, ka një vështrim historikisht relativisht statik, përkundër Hamp-it që ndjek një rrugë më dinamike, duke rindërtuar faza më të hershme të një grupi jo gjenetik po të *Sprachbundit* në Europën qendrore bashkë me gjermanikishten, tokarishten, afër dhe me baltishten e sllavishten.[58] Raportet me baltishten, që nuk duket se i pëlqente shumë Bonfante dhe për çka e kritikonte Jokl-in, janë privilegjuar në studimet historike të shqipes edhe nga Desnickaja e Hamp-i[59]. Pra në përgjithësi është theksuar një linjë filiacioni të hershëm me gjuhët më veriore, ndërsa në fazat ballkanike janë theksuar dhe lidhje me peshë edhe me greqishten e armenishten (frigjishten), por gjithnjë është theksuar se shqipja vendosej më në perëndim të hapësirës IE paleoballkanike. Raportet me greqishten e lashtë i kishte theksuar dhe Dhimitër Kamarda[60], ndërsa Selman Riza[61] ngulte këmbë, ndryshe nga Çabej, te nevoja për hulumtimin e lidhjeve me greqishten për lashtësinë (ta zëmë, të krijimit të nyjës shquese), ndërsa me rumanishten për mesjetën.[62]

Në përgjithësi, tezat e Bonfante-s për raportet e hershme të shqipes me gjuhët e tjera IE duken tashmë të një faze më të hershme të këtyre studimeve, ndërsa për ato me rumanishten në varësi të plotë nga idetë e tij për vendin e hershëm të rumanishtes dhe të romanitetit ballkanik, apo lindor. Në të vërtetë ai mendonte se romaniteti lindor ndiqte dy vija të mëdha: në pjesën perëndimore, te bregu dalmat, ku ishin ilirët, romanizimi krijoi dalmatishten, ndërsa në pjesët e tjera një romanitet që do të duhej parë si njësor midis rumanishtes dhe

---

[58] Ismajli 1996: *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*, në *Studime* 3, Prishtinë, 255-274.

[59] Për idetë e Desnickaja-s e të Hamp-it shih Ismajli 2015: *Studime për historinë*., 39-57; Liukkonen, K.: *Albano-balto-slavjanskie etimologji*, in *Scando-slavica, 35*, 197-202. Hamp 1982-3, E. P.: *Indo-European *laugh- in the Ponto-Baltic Region*, in *Ponto-baltica 2-3*, Academia Toscana di Scienze e Lettere "La Colombaria", 7-8; Desnickaja 1984: *Drevnie balkan-baltijskie sootvestvija i albanskij jazyk*, në *Sravniteljnoe jazykoznanije i istorija jazykov*, Moskva, 192-210, këtu 195.

[60] Camarda, D. 1864: *Saggio di gramatologia comparata sulla lingua Albanese*, Livorno, 188-189.

[61] Riza, S. 2004: *Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten*, studim i përfunduar më 1966, si raport për Kongresin e Ballkanologëve që do të mbahej në Bullgari, por që nuk u lejua nga autoritetet e Shqipërisë dhe mbeti i pabotuar deri më 2004, sipas versionit të nëntor 1977, kur mundëm ta përfshinim në S. Riza: *Vepra IV*, ASHAK, Prishtinë, ff. 91-114.

[62] Kjo nuk e kundërshton idenë për lidhjet më të hershme me kompleksin balto-sllav.

elementit roman të shqipes. Ai mendonte se romanizimi i plotë do të kishte ndodhur pas sh. II të epokës sonë dhe se parashqiptarët këtë romanizim e morën duke qenë dakas, ndërsa më vonë u shpërngulën në jug. Madje favorizonte hipotezën pas së cilës elemente si rotacizmi, specifike për toskërishten dhe dakorumanishten perëndimore e istrorumanishten, flasin për një shpërngulje të tillë të toskërishtes. Por më tej ai harronte se elementet e përbashkëta leksikore nuk janë specifike për ndonjërin dialekt të shqipes, pos në dy raste që kanë shpjegim tjetër. Kjo dhe elemente të tjera flasin kundër idesë së shpërnguljes së toskërishtes tashmë të diferencuar nga veriu i Ballkanit në hapësirat ku identifikohet më vonë.

Edhe sa i përket romanizimit ka pasur diskutime të frytshme. Do të përmend aportin e H. Mihăescu-t,[63] i cili në elementet latine të shqipes, gjithsesi më të hershme se sh. II pas Krishtit, shihte një shtresë që i veçonte ato nga latinizmat perëndimorë dhe i afronte me rumanishten, por shihte dhe një grup të rëndësishëm që shfaqej vetëm në shqipen dhe jo në rumanishten, ashtu siç kishte të tjera që shfaqen në shqipen e në gjuhët romane perëndimore e në shqipen dhe jo në rumanishten. E. Banfi qysh herët kishte hetuar një zonë të tretë të romanizimit rreth vijës Egnatia, ku përfshiheshin elementet latine të shqipes dhe për një pjesë dhe të greqishtes. *Summa summarum*, çështja e hapësirës romane në Ballkan duket të jetë më komplekse se kaq dhe nuk mund të merret si argument për të dëshmuar prejardhjen trakase-dakase të shqipes.

Studiues të tjerë italianë kanë shkuar kryesisht në rrugë të tjera. Tagliavini ndiqte rrugën e Jokl-it, pra anonte nga Dardania si hapësirë në të cilën do të jenë takuar pararumanishtja e parashqipja, ndërsa indoeuropeistë të mëvonë, si Ambrosini, Restelli, etj. ndjekin më shumë vijat që mund të flasin për prejardhjen ilire apo trakase dhe konstatojnë se për asnjërën prej tyre nuk ka dëshmi, kështu që mund të jetë më mirë të flasim për një *filiacion alban*. Të gjitha këto mbështeten me shumë detaje. Gjuhëtari i madh neolinguist Giuliano Bonfante, indoeuropeist i shquar, më duket se me këto çështje të parahistorisë së shqipes ishte marrë në faza më të vona të veprimtarisë së tij dhe në mënyrë më anësore dhe nga një horizont rumanist. Krejtësisht ndryshe kishte menduar kolegu tjetër i tij i linguistikës areale dhe i neolinguistikës V. Pisani.

---

[63] Mihăescu, H. 1966: *Les éléments latins de la langue albanaise*, në *Revue des études sud-est-européennes 1-2-3-4*, Bucureşti; Mihăescu, H. 1981: *Locul elementelor lexicale letine din albanză în cadrul romanităţii sud-est europene*, në Coteanu I. & Wald, L.: *Semantică şi semiotică*, Bucureşti, ff. 216-235; Mihăescu, H. 1993: *La romanité dans le sud-est de l'Europe*, Bucureşti.

Giuseppe Restelli-t, *Problemi di linguistica albanese*, f. 19 shprehej:

"*Disputat lidhur me atë nëse shqipja do të jetë një fazë moderne e ilirishtes apo e trakishtes janë antihistorike: nisen nga një apo nga më shumë faza të historisë së gjuhës, jo nga prejardhja e lashtë dhe nga rrënjët*".

Sipas tij shqipja do parë si një gjuhë indoeuropiane *tout court*, që e ka ruajtur identitetin e saj ancestral.[64]

Ndërkaq, autori i vetëm j kësaj kohe atje i një vepre të hyrjes në studime e gjuhës shqipe, Giovan Battista Pellegrini kësaj çështjeje i jep një peshë më të madhe, duke paraqitur hipotezat e ndryshme që janë shqiptuar në këtë hapësirë dhe duke e vendosur çështjen në një kontekst më të gjerë. Pellegrini, po ashtu, nuk anonte nga ideja e përfaqësuar nga Giuliano Bonfante.

[64] Në *Atti del 3⁰ Seminario internazionale di studi albanesi*, a cura di F. Altimari e F. De Rosa, Rende, 2004.

Floresha DADO, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë

MBI STUDIMIN E MAURO GERACIT: *PROMETEO IN ALBANIA, PASSAGGI LETERARIA E POLITICI DI UN PAESE BALCANICO*

Abstrakt. Dukuria e mesianizmit dhe e prometeizmit në letërsinë shqipe është e vërejtur në studime prej shumë dekadash. Më së shumti kjo dukuri është veçuar tek *metonimia e qiririt* dhe *tretja filozofike* e Naimit; te *flijimet e ndjenjave të fuqishme në emër të qëllimeve fisnike* në veprën e De Radës; tek *miti i Mbinjeriut* që përdallon poezinë e Migjenit dhe në autorë të tjerë të mëvonshëm. Në studimin e tij monografik *Prometeo in Albania: passaggi letterari e politici di un paese balcanico / Prometeu në Shqipëri: pamje letrare dhe politike në një vend ballkanik* studiuesi italian Mauro Geraci tenton një lexim tërësor të letërsisë bashkëkohore shqiptare përmes *sindromit të prometeizmit.* Me këtë term ai u referohet miteve themelore të botës shqiptare, miteve që përbëjnë themelet e asaj ideologjie që nga dijetarët italianë e arbëreshë është quajtur *l'albanesità*. *Letërsia dhe albanologjia, letërsia dhe ideologjia*, janë të pandara në vështrimin e këtij studiuesi. *Miti i librit dhe i dijes, vetëdija iluministe* e pranishme në letërsi, arte dhe në mendimin shqiptar, spikaten si forma të prometeizmit shqiptar. Ndryshe nga sa mund të pritej, motivet themelore të traditës gojore shqiptare për flijimin nuk e fitojnë vëmendjen e Mauro Geraci-t. Me shumë vëmendje interpretohet letërsia e realizmit socialist si krijuese e mitit të njeriut të rid he më tej edhe e kultit të individit. Brenda kësaj optike shihet edhe poema e I. Kadaresë *Në mesditë Byroja Politike u mblodh* dhe romani *Dimri i vetmisë së madhe*. Zymtësia e *burgologjisë* së Visar Zhitit nuk e pengon studiuesin të gjejë mesianizëm dhe prometeizëm edhe në letërsinë e ndaluar, duke filluar prej veprës së Musine Kokalarit deri tek ajo e Fatos Lubonjës. Në studimin e tij M. Geraci alternon lehtësisht koncepte të mitologjisë klasike greke me nocione themelore të Krishterimit (*Purgatori, Ferri*). Ky *vështrim alternativ* i dukurisë së mesianizmit në letërsinë shqipe, në një lexim të kushtëzuar fort me realitetin parësor, *ka karakter demitizues* dhe në shumë raste shkon deri në kufijtë e destruksionit, sido që jo të qëllimshëm nga autori.

Pyetja e parë që mund të dilte në këtë mjedis shkencor do të ishte : pse ky autor? Ç'interes paraqet vepra ***Prometeo in Albania***-*Passaggi leteraria e politici di una paese balcaniko,* prej 500 faqesh? Mauro Geraci m'u shfaq në mënyrë befasuese me monografinë e tij shkencore, duke më krijuar bindjen se kjo vepër duhet të njihet si për qasjen origjinale me konkluzione të rëndësishme dhe interesante, ashtu edhe për njohjen e interpretimeve të diskutueshme, që mund të ngjallin debat midis studiuesve të letërsisë apo dhe socio-kulturorë. Në një qasje të përgjithshëm individualitetin shkencor të M. Geracit mund ta karakterizoj në disa plane:

1. Nuk është studiues i letërsisë, ndonëse dëshmon se e njeh procesin e zhvillimit historik

të letërsisë, një pjesë të së cilës e ka lexuar vetë.
1. Nga metoda e interpretimit shfaqet më shumë si etnolog dhe antropolog kulturor. Një studiues që vjen nga një shkencë tjetër, çka ka lënë gjurmë në mënyrën se si e sheh letërsinë. Kështu kemi një qasje antropologjike ndaj letërsisë, që realisht nuk e hasim në historinë e letërsisë shqiptare. Duke qenë më shumë antropolog, qasja e tij është specifike, sidomos në disa vëzhgime interesante, ndonëse jo gjithnjë të reja.
2. Si përkthyes i pjesëve letrare nga krijimtaria e autorëve të ndryshëm (aq shumë ka në këtë vëllim sa mund të shihej edhe si një antologji e pjesshme e zgjedhjeve letrare).
3. Ka njohje të gjera për botime që lidhen me historitë e letërsisë, me studime, monografi të studiuesve shqiptarë (citon një numur të madh brenda e jashtë Shqipërisë, arbëreshë, nga Kosova dhe të huaj: Petrotta, S. E, Mann, Meyer, Rugova, S. Hamiti, etj. etj..)
4. Njohës i realitetit shqiptar dhe i një rrethi të gjerë personazhesh nga sferat kulturore, publicistike dhe shkencore bashkëkohore.
5. Rob i apasionuar i temës që ka zgjedhur për trajtim, duke prishur jo pak herë raportin midis reales dhe subjektivitetit.

Megjithatë, mendoj se interesimi themelor për këtë monografi lidhet në rradhë të parë me **objektin** e studimit. Prometeizmi në Shqipëri, i parë si rrugëtim letrar dhe politik, është një çeshtje që ngjall interes për qasjen specifike dhe provokimin e pikëpamjeve të studiuesve shqiptarë, në Shqipëri dhe Kosovë. Në të vërtetë dukuria e mesianizmit dhe prometeizmit në letërsinë shqipe në mënyrë të pjesshme është trajtuar nga disa autorë: A.Pipa e pa këtë dukuri në veprën e Migjenit (miti i mbinjeriut që dallon poezinë e Migjenit dhe autorë më pas); R.Qosja pothuajse gjithë romantikët i trajton si prometeistë, në mënyrë të posaçme metoniminë e qiririt dhe tretjen filozofike të Naimit Frashërit; J. Bulo e shpjegon metaforën e qiririt si dukuri të mesianizmit. Ishte shfaqur në Evropë, nga gjysma e dytë e shek. të shkuar, prirja e autorëve të huaj që traditat letrare të trajtoheshin edhe në rrafsh krahasimtar me Biblën. Vepra e Northrop Fray *Kodi i madh: Bibla dhe Letërsia* ishte një platformë shumë interesante e studimit të tekstit letrar në këto plane. Por, te studiuesit tanë bie në sy një sinonimi terminologjike: prometeizëm, mesianizëm, flijim për liridashje, etj. Gjithsesi baza teorike e kësaj qasjeje ishte pikërisht propozimi i Fray. Ajo çka e dallon studimin e M. Geraci-t është: *së pari*, për herë të parë fenomeni i prometeizmit trajtohet në rrokjen më të gjerë, në plan letrar, kulturor antropologjik. *Së dyti*, kjo larmi zgjerohet duke krijuar shpesh edhe konfuzion kuptimor të termit.

Çështja thelbësore e kësaj vepre do të ishte: cili është koncepti i M. Geracit për prometeizmin? Me këtë term ai u referohet miteve themelore të botës shqiptare, miteve që përbëjnë themelet e asaj ideologjie që është quajtur *l'albanesita. Letërsia dhe albanologjia, letërsia dhe ideologjia*, janë të pandara në vështrimin e këtij autori. Krahasuar me studiues të tjerë shqiptarë Geraci i jep termit *prometeizëm* një përmbajtje tjetër, të dallueshme nga ajo që ne kemi në përfytyrimin tonë. Dihet se në letërsi prometeizmi është kuptuar si flijim për liri,

është trajtuar edhe si rebelim… Por autori e shpreh hapur synimin e tij (f. 12) për një qasje antropologjike e historiko-letrare të figurës prometeike në disa konceptime, që, sipas tij, mbeten akoma në letërsinë shqipe. Madje e quan veprën mozaik prometeik. Është pikërisht koncepti i tij mbi prometeizmin që e drejton posaçërisht te letërsia e burgologjisë (carcerologia), madje duke e parë në plan evropian (284), në një sfond të gjerë të personazheve të njohur si viktima të forcave politike, raporteve të ndryshme politiko-shoqërore. Geraci e koncepton prometeizmin si përballje me goditjet fatale të jetës, prandaj u kushton shumë vemendje autorëve që provuan burgun, si V. Zhiti, F. Lubonja, M. Kokalari… Nisur nga njohja e veprave të autorëve tanë të burgosur ai e sheh konceptin e prometeizmit jo vetëm si një ferr, shenjues të burgut, pra shprehje jo vetëm e vuajtjeve të personit, por *vuajtje e letërsisë*. Gjithsesi nga persona të veçantë kalon në sprovë për tipologjinë e letërsisë.

Në veprën e M. Geracit ka një lloj eklektizmi terminologjik: koncepti i *prometeizmit* përziehet me *mesianizmin*, apo kur kalon (132) nga prometeizmi te koncepti i *zeusomanisë*, që është brenda idesë së prometeizmit, i afërt me konceptin e F. Lubonjës (142): herë përdor konceptin e '*titanizmit*' (89), (vjersha Byroja…), herë shkon deri në termin '*homerizim* (74), herë sjell termin e *piramidizimit* (Piramida 247); në raste të tilla shpjegon krijimin e një olimpi shqiptar, ku nga letërsia merret modeli i figurës së E. Hoxhës, pothuajse në të gjitha llojet letrare. M. Geraci e trajton prometeizmin edhe si sindromë të sëmundjeve të lashta e moderne. Autor bashkëkohor në veprën e të cilit e gjen këtë sindromë, cilëson I. Kadarenë (120) (Shih identitetin … e Kadaresë 163), si kompleks dhe psikozë etnike. Sipas tij kjo psikozë shpreh psikologjinë e të qenit nën!, për të pranuar pushtetin, figurën e të madhit.

Një aspekt tjetër i konceptit të prometeizmit të Geracit është dukuria e *gjigandizmit* tek personazhe historikë shqiptarë. Sipas tij (159) Evropa ka krijuar tre mite: Skënderbeun, Nënë Terezën dhe Kadarenë… Ndonjëherë shfaqet konfondimi midis konceptit të prometeizmit dhe miteve iluministe… Autori e sheh prometeizmin edhe te figura e njeriut socialist, te miti i partizanit, duke zvogëluar, në të vërtetë, përmasat e brendisë së këtij koncepti mbinjerëzor. Monografia e tejkalon vështrimin historiko-letrar dhe historik-kulturor, duke tentuar një interpretim antropologjik e etnologjik. Autori qëndron gjatë te mitet e krijuara nga letërsia, por qasja antropologjike jo gjithnjë favorizon interpretime të sakta edhe në letërsi.

Një qëndrim tjetër i diskutueshëm është mënyra se si synon të gjejë prometeizmin në fushën e **albanologjisë.** (63) Nga njera anë, është përpjekja për të

parë lidhje dhe kushtëzim nga ky koncept të shkencave albanologjike, të cilat i konsideron krijuese të miteve të origjinës, të mitit të lashtësisë, të autoktonisë, të identitetit, të vazhdimësisë historike, të krenarisë dhe qëndrueshmërisë historike të shqiptarëve dhe kulturës së tyre, etj. Nga ana tjetër është ideja që e sheh letërsinë si ilustruese të këtyre miteve. A është e saktë kjo pikëpamje? Ky interpretim subjektivist shpreh mosnjohje të çështjeve shkencore që albanologjia gjermane, amerikane, italiane, etj. nuk i ka. Për një njohës kaq të gjerë të teksteve, burimeve nga fusha të ndryshme është paksa i çuditshëm mosdallimi midis albanologëve të vërtetë dhe amatorëve të entuziazmuar, apo dhe refraktarë të çështjeve thellësisht shkencore. Për shembull, referimi te pikëpamjet e Lubonjës (57), apo dhe autorëve jo profesionistë të fushave gjuhësore, apo historike… mendoj se e largon autorin nga koncepti i prometeizmit.

Referencat ndaj tezave dhe interpretmeve të disa albanologëve evropianë: Durham (111), Meyer (113) apo edhe të poetit Bajron (109), po të shihen me vemendje fshehin edhe një frymë ironie të hollë ndaj pikëpamjeve mbi origjinën, vlerat…e shqiptarëve (115). Ironizon termin 'shkëmbi ilirik' (103), tezën mbi origjinën etruske…(115..); madje përdor dy terma 'albanesita' dhe 'albanocentrizëm'.

Vihet re se miti i librit dhe i dijes, vetëdija iluministe e pranishme në letërsi, arte dhe në mendimin shqiptar interpretohen si forma të prometeizmit. Por, mendoj se me prometeizmin libror, sikurse edhe me kuptime të tjera që i ndeshim gjatë veprës, M. Geraci i largohet konceptit themelor të asaj që mbart vetë termi.

Cili është raporti me letërsinë ?

Dy janë qasjet themelore të studiuesit; interpretimi i letërsisë së realizmit socialist si krijuese e mitit të njeriut të ri dhe e kultit të individit; dhe përqendrimi në letërsinë e burgut, e cila duket se e tërheq në mënyrë të veçantë. Brenda kësaj optike shihet poema e Kadaresë *Në mesditë Byroja politike u mblodh* dhe romani *Dimri i vetmisë së madhe*. Prometeizmin ai e gjen edhe në letërsinë e ndaluar…

Mendoj se letërsia e burgut dhe pjesërisht arti, letërsia e realizmit socialist, që janë në qendër të interpretimit të monografisë, nuk mund të vihen në të njëjtin plan, sepse kanë përmbajtje specifike: njëra i përket kohës së diktaturës, tjetra mbas rënies, këto kontekste e lëvizin kuptimin e termit *prometeizëm*. Flijimi, sakrifica nuk janë kurrsesi paralele në këto krijime të dy periudhave të ndryshme. Ky mosdallim, sipas mendimit tim, ka bërë që në këtë studim, në

mënyrë të vetëdijshme apo instinktive, të shfaqen, siç e thashë, disa terma si *mesianizëm, zeusomani, homerizim, gjigandizmi, piramidizim…* Veç kësaj mendoj se ky konfuzion rrjedh edhe nga një pasaktësi metodologjike, sepse nuk mund të trajtohet tema e prometeizmit me të njëjtën qasje ndaj dy fushave krejt të ndryshme të krijimtarisë: letërsisë e shkencës albanologjike. Për shembull: poezitë e Rrahman Dedaj, apo *Pallati i Ëndrrave.*

Libri *Prometeo in Albania* mund të shihet edhe si një përpjekje për të konceptuar një histori të letërsisë dhe kulturës shqiptare prej Rilindjes Kombëtare e deri në ditët e sotme, por sipas një kriteri krejt të veçantë: kushtëzimit historik dhe ideologjik.

Cila është marrëdhënia me **historinë e Shqipërisë**? Sipas Geracit historia kombëtare është ndërtuar si histori letrare, e treguar nga shkrimtarë-partizanë, shkrimtarë politikë. Por, nga ana tjetër është po ai që në interpretimin e kësaj letërsisë ka parimin ngushtësisht ideor.

Njohjet e gjera e kanë çuar në historikun e botimeve, gazetave, (sidomos ato që dolën mbas rënies së diktaturës (‘*E përshtatshme’*), pjesë ditari (M. Kokalari), elemente të historisë së letërsisë (bejtexhinjtë), futet në historinë e raporteve me Ballin, Legalitetin, ndikimin e teorisë së Zhdanovit, historia e pushtimeve... (këto aspekte dhe të tjera janë shmangie nga objekti i studimit). Ky fakt ngre pikëpyetjen: kemi trajtim kulturor apo politik? Ndonëse dukuria e prometeizmit, me variantet terminologjikë që përcillen, lidhet si me realitetin e Shqipërisë së diktaturës, ashtu dhe me letërsinë e burgologjisë pas viteve 90, raporti gjithsesi është i deformuar. Mendoj se autori nuk ka mundur të ruajë raport të qartë midis këtyre dy qasjeve: politike apo kulturore. Duke mos qenë studiues i mirefilltë i letërsisë apo i arteve, por kryesisht antropolog, studimi mbetet në rrafshin ideor. Në fund të fundit kjo diktohet edhe nga vetë objekti i trajtimit.

Monografia e M. Geracit padiskutim ka shumë vlera ndonëse:

- Ka kapituj apo pjesë të tëra që nuk sjellin gjë të re, sepse shumë aspekte janë trajtuar nga studiues të tjerë.

- Ka interpretime subjektive dhe të pasakta, që janë më shumë të karakterit agjitativ.

- Tërthorazi duket që M. Geraci nuk i ka shpëtuar pozicionit të metropolitanit ndaj kulturës së një vendi të vogël, apo kurthit të idesë jo të saktë se perëndimi na sheh mbi bazën e kanunit, mitit…

- Duke qenë kryesisht antropolog ai e lidh prometeizmin më shumë me kategori sociale-kulturore dhe autorësinë e sheh si çeshtje të statusit intelektual

(430), pra antropologjik. Ndonëse duket se mbizotëron dashamirësia, në monografi ka disa momente ironikë, përqeshje (bie fjala kap. I: 'Tre milion banorë, katër milion shkrimtarë" (21).

- Gjithashtu autori e gjykon letërsinë tonë si të prapambetur, monumentin e Pavarësisë si mit të librit.(40)

- Për teza të rëndësishme të shkencave albanologjike u referohet amatorëve (si rasti i shkrimit të F. Lubonjës: *Akademia midis "Ilirëve" dhe "Pellazgëve",* etj. çka menjëherë ve në dyshim karakterin shkencor të trajtimeve. Gjithashtu është selektiv në dukurinë e prometeizmit dhe se dukurinë e prometeizmit a e çon aty ku dëshiron..

Gjithsesi, duke iu përgjigjur pyetjes që shtrova në fillim: pse duhet njohur kjo monografi ? them se M.Geraci ka meritë që i kushton vëmendje, me një rrokje shumë më të gjerë, fenomenit të prometeizmit në letërsinë shqiptare, formave të shfaqjes së tij prej Rilindjes e deri në ditët e sotme. Është me interes për diskutim edhe teza e tij për prometeizmin që shfaqjet në larmi formash në letërsinë tonë.

Është për t'u vlerësuar, gjithashtu, fakti se autori mbështetet në disa aspekte dhe fusha njohjeje: në përkthimet e letërsisë sonë në italisht apo gjuhë të tjera, në leximet e veta, në studimet që janë kryer mbi letërsinë nga autorë shqiptarë dhe të huaj, në burime të shtypit, intervista me shkrimtarë dhe studiues, shumë burime që i ka gjetur në botime shkencore dhe letrare. …

Ndonëse vështrimi alternativ i dukurisë së *prometeizmit shqiptar,* duket që ka edhe karakter demitizues, objekti i monografisë jep modelin e një qasjeje specifike ndaj letërsisë sonë. Kjo monografi mund të shihet edhe si një studim ndërdisiplinar, pak i lëvruar në shkencat tona humane. Për këto arësye, me pajtimet apo mospajtimet në gjithë tezat e shtjelluara, vepra nxit shumë interesin e studiuesve të letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Francesco ALTIMARI, (Universiteti i Kalabrisë)

BALLKANIZMA DHE ITALO-ROMANIZMA NË DISA NDËRTIME FOLJORE ASPEKTORE TË ARBËRISHTES SË ITALISË

Abstrakt. *Autori perqëndrohet në këtë kumtesë mbi disa ndërtime perifrastike që përdoren për të shprehur aspektin e progresivit dhe te iminencës në sistemin foljor të arbërishtes së Italisë. Për të trajtuar këto trajta aspektore ashtu si edhe disa trajta të tjera modale të të folmeve arbëreshe, autori merr parasysh gramatikat e para të arbërishtes së shekullit XIX dhe shumë korpora tekstesh të regjistruara në kontekstin arbërishtfolës botuar që prej gjysmës së shekullit XX, si edhe të dhëna të mbledhura personalisht gjatë kërkimeve në terren që prej viteve '80 të shekullit të kaluar. Këto rezultate analizohen në këtë kumtesë duke i krahasuar me kontekstin gjuhësor ballkanik dhe me atë italian, duke marrë parasysh italishten si dhe dialektet e Italisë së jugut, gjuhë me të cilat arbërishtja është prej shekujsh në kontakt të pandërprerë.*

Në gramatikat e para të botuara të arbërishtes, të cilat i përkasin gjysmës së dytë të shekullit XIX, kapim përpos konceptit të kohës edhe kushtëzimet e modelet e tyre përshkruese të marra dhe të huazuara nga gjuhët klasike (greqishtja dhe latinishtja), por edhe nga italishtja si dhe nga gramatika e parë shqipe e Françesko Maria da Lecce-s, nuk gjen shumë hapësirë aspekti i foljes. Megjithëkëtë ato tregohen shumë të besueshme dhe nganjëherë edhe të sakta në përshkrimin e formave paradigmatike foljore të të folmeve arbëreshe, të cilat përkojnë me arealet arbërishtfolëse të anketave gjuhësore të autorëve të vet.

Rrallisht gjejmë aty referime mbi ndërtimet perifrastike foljore, që edhe karakterizojnë, duke e diferencuar nga shqipja e arealit ballkanik, arbërishten e Italisë, e cila, siç do të shohim, po përdor struktura të ndryshme për të shprehur Aktionsart-in. Pa e zgjeruar më tepër këtë fushë të gjerë kërkimesh gjuhësore, do të ndalemi këtu vetëm mbi perifrazat foljore të progresivit dhe të ingresivit, duke u nisur nga ato që gjejmë në monografitë e ndryshme dialektore ose të dëshmuara nga korpuset e vëllimshme tekstesh të letërsisë gojore arbëreshe, të botuara që prej viteve ’70 të shekullit të kaluar, ose personalisht të regjistruara gjatë këtyre dyzet viteve përmes kërkimeve të bëra në terren në arealet e ndryshme arbërishtfolëse të Italisë, në pjesën më të madhe në trevat kalabro-llukane ku i kemi fokusuar gjurmimet tona.

Nuk i gjetëm në gramatikat e De Radës, megjithëse ky autor nuk harron

të na shënojë në zgjedhimin e foljes krahas disa formave të "gramatikalizuara" edhe pse në mënyrë artificiale dhe të sforcuar, disa kohë të përbëra që nuk janë aspak të sajuara dhe që pasqyrojnë një farë funksioni aspektor pos një funksioni kohor. E kemi fjalën për të kryerën "dyshimore" [*kam lār* 'ndoshta/me gjasë kam larë', *kam pasur* 'ndoshta/ me gjasë kam pasur'][65] e riemërtuar edhe e "e gjasshme" (hamendase?) ["passato in reminiscenza"][66], por edhe për të kryerën e papërfunduar" që ai lidh me një kohë të tejshkuar të tipit *pata me pasur* "qeshë për të pasur", *pata me qenur* "qeshë për të qenë", "*pata me vjuar"* "qeshë për të ruajtur" në gramatikën e tij të dytë[67], më saktë me të kaluarën e tejshkuar ["trapassato remoto"][68] [*"pata lār"* 'qeshë për të larë", "*u pata lār"* 'qeshë për t'u larë'] në gramatikën e parë[69].

Por nuk mungon te sistemi i tij foljor i shqipes ajo kohë që ai e përcakton si "e ardhme qëllimore ["futuro intenzionale"][70] *kam të lanj* 'kam për të larë'; *kam të laghem* 'kam për t'u larë', tipike e arbërishtes dhe i ndonjë të folmeje periferike të toskërishtes, të formuar nga folja KAM + TË + të tashmen e lidhores. Kjo formë përkon me "të ardhmen e domosdoshmërisë" ["futuro necessitativo"], pa hije dyshimi me origjinë ballkanike më e përhapura siç është e ardhmja "ballkanike" e tipit volitiv dhe, me siguri, jo me origjinë italo-romane[71].

Ndërsa gjen atestim te Kamarda ndërtimi perifrastik me parataksë, i cili shënon veprimin durativ përmes foljes ndihmëse JAM + E + foljen në dëftore:

"Këtu do të përmend një fjali tipike të shqipes, të baravlefshme në një farë mënyre me përcjelloren, që ndërtohet duke vendosur foljen ndihmëse para

---

[65] *Grammatica della lingua albanese* di Giuseppe De Rada, Tipografia dell'Associazione, Firenze 1870, f.60.

[66] [Girolamo De Rada], *Caratteri e grammatica della lingua albanese*, Stabilimento Tipo-Litografico del *Popolano*, Corigliano Calabro 1894, f.81 e f.84.

[67] [Girolamo De Rada], *Caratteri e grammatica della lingua albanese*, op. cit., f.81 e f.84.

[68] Secondo Rohlfs, "In Calabria il trapassato remoto è affatto sconosciuto, e vien di norma sostituito dal passato remoto. Nella Calabria meridionale anche il trapassato prossimo è sostituito dalla popolare forma del passato remoto, per esempio *fici u lavuru* 'avevo fatto il lavoro'; *vinni di Napoli* 'ero venuto da Napoli'; *rrivau* 'ero arrivato" (ROHLFS 1969, III:51).

[69] *Grammatica della lingua albanese* di Giuseppe De Rada, Tipografia dell'Associazione, Firenze 1870, f.61.

[70] *Grammatica della lingua albanese* di Giuseppe De Rada, vepër e cit., f.82.

[71] Francesco Altimari, "Il cosiddetto 'futuro necessitativo' dell'albanese d'Italia: influenza italo-romanza o arcaismo balcanico?" (fq.55-71) in Idem, *Studia linguistica italo-balcanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri 51, Prishtinë 2014.

një foljeje tjetër të lidhur me këpujën [lidhëzën bashkërenditëse] ἔ: p.sh. *ἴοζτ ἐ φλη* [isht e flē] "egli dorme", *ἴος ἔ σζκρουαιje* [ish e shkruaj] *scriveva*, ose *sta dormendo, stava scrivendo* etj. dhe shërben për të treguar një veprim të pandërprerë, si fraza italiane që shpjegon shqipen"[72].

I njëjti linguist nga Hora e Arbëreshëve[73] përmend edhe të ardhmen e domosdoshmërisë të shprehur nga folja KAM që lidh arbërishten me gegërishten, me ndryshim se te arbërishtja ajo ndiqet jo nga paskajorja si në gegërisht (ME + pjesore), por nga lidhorja, duke përfaqësuar një variant të toskërishtes ku paskajorja sistematikisht zëvendësohet nga lidhorja. Megjithëse ne kemi gjetur edhe në arbërishten e Italisë disa forma infinitive në trajta të ngurosura" me pak funksionalitet, por që na duken me rëndësi për historinë e gjuhës shqipe, sepse na dëftojnë se dikur kjo mënyrë ishte e përhapur në krejt arealin shqipfolës (ose albanishtfolës siç propozova ta quajmë këtë fazë paradokumentale të shqipes së lashtë, para degëzimit të arbërishteve të Greqisë dhe të Italisë) dhe jo vetëm në arealin geg[74].

Në veprën gramatikore të Kamardës[75] përshkruhen në sistemin foljor si e kryera – e tashmja e foljes ndihmëse KAM + foljen në pjesore, por pa nuancë hamendëse, siç e gjejmë sot të pasqyruar gjerësisht tek arbërishtja e Italisë[76] dhe në të folmen e tij horjote – ashtu edhe më se e kryera (e kryera e dytë) – e pakryera e foljes ndihmëse KAM (keshe, keshja, kishja) + pjesore. Por nuk gjejmë gjurmë në gramatikën e Kamardës të së kryerës së tejshkuar, me ose pa aspektin ingresiv të dëshmuar te De Rada dhe i marrë nga arbërishtja e folur siç

---

[72] Demetrio Camarda, *Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese,* Successore di E. Vignozzi, Livorno 1864, fq. 329.

[73] Demetrio Camarda, *Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese,* vepër e cit., fq. 266-267.

[74] Francesco Altimari, "Tracce di antichi infinitivi dell'albanese nell'arbëresh d'Italia" (fq.87-111), në Idem, *Studia linguistica italo-balcanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri 51, Prishtinë 2014.

[75] cf. Demetrio Camarda, *Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese,* vepër e cit., fq. 267-268.

[76] Francesco Altimari, "Osservazioni sul passato 'presuntivo'dell'arbëresh d'Italia e sulla formazione dell'ammirativo in albanese" (pp.27-40) në Idem, *Studia linguistica italo-balcanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri 51, Prishtinë 2014. Il tema del 'presuntivo' arbëresh è stato sollevato per la prima volta da Walter Breu, "Das italoalbanische 'Perfekt' in sprachvergleichender Sicht" (fq.51-66), në F. Altimari et al. (a cura di), *Atti del I Congresso internazionale di Studi sulla Lingua, la Storia e la Cultura degli Albanesi d'Italia* (Mannheim, 25-26 giugno 1987), CELUC, Rende 1991.

pata rastin ta verifikoja duke gjurmuar në arealin arbërishtfolës kalabrez të Pulinit.

Duhet të presim fillimin e viteve ’70 të shekullit XX, kur përgatiten monografitë linguistike mbi të folmet arbëreshe të përshkruara dhe të botuara nga Martin Camaj,[77] për t’u ndeshur me format perifrastike që tregojnë aspektualitetin durativ që i ndjeri albanolog shkodran na vërteton për të folmen e Katundit (italisht Greci)[78] (Camaj 1971: 83-84) si për diatezën veprore, ashtu dhe për atë joveprore. E kemi fjalën këtu për ndërtimin parataktik që ka si element të parë foljen ndihmëse JAM (në të tashmen ose në të pakryerën) lidhur me foljen në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë, në formën veprore ose joveprore, përmes lidhëzës ʧə [çë] “që”: p.sh. *jam çë qepinj* “po qep”, *jam çë lanj* “po laj”, *jam çë laham “*po lahem*”, inja çë lanja “*po laja*”. inja çë lahsha “*po lahesha*”.*

Edhe në studimin e tij të mëvonshëm dialektologjik (Camaj 1977: 93), ku përqëndrohet mbi të folmen arbëreshe të Falkunarës[79], Martin Camaj na vë në dukje (na nxjerr në shesh) një ndërtim analog perifrastik me strukturë parataktike – por me lidhëzën E në vend të lidhëzës ÇË – për të treguar veprimin foljor progresiv, me një folje stative JAM ose JESH si përbërës i parë përkatësisht në të tashmen – p.sh. *jam e qell* “ich bin dabei zu bringen”, “ich bringe gerade”; *jam e qellem* “ich bin dabei gebracht zu werden” - dhe në të pakryerën –*jesh e qellnja* “ich war dabei zu bringen, ich war beim Bringen”, *jesh e qellesha* “ich war dabei gebracht zu werden”. Në një fusnotë (Camaj 1977:96, fusnota 3) albanologu ynë na lidh për analogji semantike, dhe jo morfologjike, veprimin progresiv të këtij ndërtimi të arbërishtes së Italisë me format perifrastike që gjenden në gramatikën e shqipes të botuar në Vjenë më 1908 nga Georg Pekmezi:[80]: “po shkon” për të tashmen dhe “po shkonte”për të pakryerën, duke pohuar se “Die umschriebenen Formen sind vergleichbar mit

[77] Po citojmë, sipas rendit kronologjik të botimit, këto botime monografike të Camajt: Martin Camaj, *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino*, Leo Olschki editore, Firenze 1971; Martin Camaj, *Die albanische Mundart von Falconara Albanese in der Provinz Cosenza*, Trofenik Verlag, München 1977; Martin Camaj, *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia di Potenza*, Centro Editoriale e Librario dell’Università della Calabria, Rende 1993.

[78] Shih Martin Camaj, *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino*, Leo Olschki editore, Firenze 1971.

[79] Shih Martin Camaj, *Die albanische Mundart von Falconara Albanese in der Provinz Cosenza*, Trofenik Verlag, München 1977.

[80] [Georg] Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache (Laut- und Formenlehre)*, Verlag des Albanesischen vereines “Dija”, Wien 1908, f.151.

den gegischen Formen (sic!) auf /po-/".

Duke lënë përkohësisht mënjanë – por me premtimin se do t'i kthehemi më vonë - dëshmitë e aspektualitetit në arbërishten regjistruar në veprën e Camajt, që me siguri më shumë se punimet e tjera gjuhësore të tij, tregon një prirje të veçantë të albanologut tonë të shquar shkodran për të na përshkruar aspektualitetin e foljes së arbërishtes. Bëhet fjalë për monografinë ë tij postume (botuar pas vdekjes së autorit) mbi sistemin linguistik të Shën Kostandinit, njëra ndër të folmet arbëreshe që ai analizoi gjerë e gjatë, e konsideruar ndër ato më konservative. Në të njëjtin vit kur Martin Camaj po shtypte gjermanisht gramatikën e Falkunarës (1977), Eqrem Çabej, linguisti ynë më i famshëm i shekullit të kaluar, po përfundonte një studim rezervuar arbërishtes ku për herë të parë dhe sistematikisht analizohen në krahasim me shqipen ballkanike veçoritë më të theksuara të arbërishtes, na kujton se:

"Në fushën e morfosintaksës […] përmendim, në fund, një ndërtim që është specifik i arbërishtes së Italisë: shprehjen e tipit aktual dhe durativ (stativ) *isht e flë* "po fle", *ish e shkruaj* "po shkruante" – shembuj të marrë nga Kamarda, sipas citimit - në Molize *isht e ha buk* "po hante bukë", *ishën e hajën* "po hanin bukë" – të cituara prej Lambercit – […]. Një ndikim sipas modelit të italishtes *sto scrivendo* këtu nuk është shumë i mundshëm. Struktura është e ndryshme në të dy shprehjet, nga njëra anë ndërtimi perifrastik italian, nga ana tjetër parataksa ballkanike"[81].

Me parataksën ballkanike, siç na përmend Çabej duke na sjellë opinionin e autoritetshëm të Gerhard Rohlfs-it[82], mund të shpjegohet ndërtimi dialektor italian që shërben për të shprehur durativitetin italo-roman të Salentos *sta scrivi* "po shkruan", *sta mmangia* "po ha", *la signura stia ddurmia* "zonja po flinte". Ky ndërtim rrjedh nga greqishtja e Italisë, griko siç njihet në terminologjinë gjuhësore, pas modelit *estèi ce grafi* "po shkruan", *estèi te troi* "po ha".

Varianti dialektor italo-roman dhe varianti grik ndajnë bashkë në Salento, për shkak të kontaktit gjuhësor aq të dendur dhe aq të ngjitur midis tyre, të njëjtin ndërtim bashkuar nga e njëjta folje stative – RRI/*STARE*/ *ἵστημι* dhe jo

---

[81] Eqrem Çabej, "Storia linguistica e struttura dialettale dell'albanese d'Italia" (fq.5-30) në *Problemi di morfosintassi dialettale*, IX, Pisa 1976. Riedito (pp.85-105) në: Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia (a cura di), *I dialetti italo-albanesi*. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbereshe, presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni editore, Roma 1994, fq.100-101.

[82] Gerhard Rohlfs, *Griechischer Sprachgeist in Süditalien* (Zur geschichte der inneren Spachform) [Sitzungsberichte der Bayerischen Akademie der Wissenschaften, Phil. hist. Abteil, 1944-46], Monaco 1947, f.25.

JAM/*ESSERE*/ *εἶναι* – për të shprehur aspektin progresiv dhe, me ndonjë modifikator si shtesa e lidhëzës <CU> në dialektin salentin dhe e lidhëzës <C'>[IPA ʧ] në variantin grik, për të shprehur edhe atë ingresiv të veprimit foljor. Kemi kështu në dialektin salentin të arealit grek *sta facìa* "po bëja", *sta venia* "por *stau cu fazzu* "jam për të bërë" dhe *stìa cu fazzu* "isha për të bërë" e *stìa cu vegnu* "isha për të ardhur"[83], ndërsa në variantin italo-grek të arealit salentin *ìstika fènonta* o *ìstika zèfena* "po endte" (ishte që endte), *ìstika* o *ìstinna tronta* "po hante" ('ishte që hante' në dialektin italian), *ìstika marèonta* "po gatuante", *ìstika c'epesinìsco* "ishte për të vdekur"[84].'

Një ndërtim analog i perifrazës foljore salentine për të shprehur progresivin durativ, në greqishten apo në italishten dialektore të Salentos - formuar nga folja RRI/*STARE* (dhe jo JAM/*ESSERE*!) + lidhëzën E + foljen në parataksë ose lidhëzën TË me foljen në hipotaksë - regjistrohet në arbërishten e San Marcanit (në të folmen e San Marcanos: *rrij e qepinj* "po qep/sto cucendo") dhe në arbërishten e zonës së Vullturit (të folmet e Barilit, Zhurës dhe Mashqitit: *rria bënj* o *rrij të shoh* "po bëj/sto facendo" ose"po shoh/sto vedendo").

I ngjashëm me ndërtimin e tipit salentin ose italo-grek që i përket sferës aspektuale të progresivitetit dhe të durativitetit, ndërtimi arbëresh JAM Ç'QEPINJ, të cilin e gjejmë në Greci/ Katundi të përhapur edhe në areale të tjera arbërishtfolëse, kryesisht në krahinën e Kutronit dhe të Katanxaros, nuk mund të varet nga kushte specifike të kontaktit dhe pra të shpjegueshëm me ndikimin e kontekstit italo-roman.

Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë këtu më se me një zhvillim të mëtejshëm, në rrethanat e kontekstit të ri gjuhësor në mëmëdheun e ri, me një tendencë të sjellë nga arbëreshët me vetë nga mëmëdheu i vjetër[85]. Pra mund të hipotizojmë me të drejtë për arbërishten vazhdimësinë përmes disa perifrazave të diversifikuara parataktike të një fazë proto-romane ose latino-ballkanike të lashtë, por nuk dimë nëse janë të asociueshme për shkak të kontaktit me gjuhët sllave, duke u nisur nga shekulli VI[86], apo të shkaktuara nga ndikimi i greqishtes

---

[83] Informatori ynë ka qenë Silvano Palamà, me origjinë mga Kalimera (it. Calimera), në rrethinën e Leçes. Data e regjistrimit: 21 janar 2019.

[84] Mauro Cassoni, *Hellàs Otrantina o disegno grammaticale*, Scuola Tipografica Italo-Ortientale "San Nilo", Grottaferrata 1937, f.79.

[85] Eqrem Çabej, "Storia linguistica e struttura dialettale dell'albanese d'Italia" (fq.5-30) in *Problemi di morfosintassi dialettale* (1976), i ribotuar (fq.85-105) në: Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia (a cura di), *I dialetti italo-albanesi*, vep. e cit., f.102.

[86] "Accanto alle forme del verbo che danno all'espressione una graduazione temporale (passato, presente, futuro ecc.), certe lingue dalla morfologia arcaica o primitiva (per

së Dhjatës së Re[87] në bazë të "koine-së" ellenistike.

Në këtë rast zhvillimi mund të ketë prekur, pas një procesi natyror desemantizimi me ndihmësimin gradual, jo vetëm foljet stative si JAM/*ESSERE*/ εἶναι dhe RRI/*STARE*/ ἵστημι, por edhe foljet lëvizëse si VETE/ *VADO*/ *ἥκω* dhe *ἔρχομαι*, ose foljet inkoative/ nistore si ZË˜, ZË˜FILL, ˜ZEKSËNJ/ *COMINCIO*/ *μελλω*, etj. Ky ndikim konvergjent dhe i mundshëm i greqishtes përmes latinishtes së mëvonshme në fazën proto-romanistike, në arealin ballkanik si edhe në atë roman italo-jugor, mund të shpjegojë afrinë strukturore, në dukje sinkronike por thelbësisht diakronike, që ndeshim në këto ndërtime arbëreshe, grike dhe italo-romane, të cilat shprehin një dimension aspektual durativ, por disa herë edhe iminentiv përmes formave perifrastike zakonisht në parataksë[88].

Spektri i gjerë i formave perifrastike në sistemin foljor të gjuhëve në

---

esempio le lingue slave e quelle semitiche) dispongono di altre possibilità per caratterizzare le circostanze in cui si svolge l'azione. Grazie a particolari elementi morfologici è così possibile esprimere se l'azione presenta caratteri d'una certa durata (verbi durativi), o invece d'istantaneità (momentanei), o di ripetizione (iterativi), o d'incominciamento (incoativi), o d'incompiutezza (imperfettivi) o viceversa di compiutezza (perfettivi)", in Gerhard Rohlfs, *Grammatica storica della lingua italiana e dei suoi dialetti*, op.cit., vol.III, f.132.

[87] Shih për këtë aspekt studimin e veçantë të studiueses Luisa Amenta, *Perifrasi aspettuali in greco e in latino. Origini e grammaticalizzazioni*, Franco Angeli, Milano 2003. Autorja, duke u nisur nga konstatimi se shumica e dëshmive të perifrazave me vlerë aspektore i përkasin fazës më të vonshme të antikitetit klasik, në gjuhën greke apo atë latine, u përqëndrua në analizën e saj të vëmendshme dhe të thelluar mbi perifrazën në perioudhën me më shumë kontakte midis të dy gjuhëve klasike. Ajo na sjell në shkallë evropiane në shkrimin e korpusit të gjerë me përkthimet e krishtera nga greqishtja në latinishten, duke pasur si bazë gjuhën greke të Ungjillit dhe mbi versionet latine të Ungjijve. (shih Amenta 2003:13). Edhe Kristian Sanfield për të shpjeguar ndikim e ushtruar nga greqishtja në gjuhët e tjera të rajonit ballkanik, përmend greqishten e Ungjijve (shih. K. Sanfield, *Linguistique balkanique, problèmes et résultats*, Collection linguistique publiée par la Société Linguistique de Paris, Paris 1930, f. 215-216).

[88] Vëren Rohlfs se "per il durativo ha notevole voga la perifrasi a mezzo del gerundio, cf.il toscano *sto leggendo, stava perdendo, io vo cercando, viene dicendo* […]. Anche stare coll'infinito ha aspetto durativo […]. Nel Salento il durativo viene espresso nella forma sto ac bibo, stamus ac cantamus. Della congiunzione ac non rimane per lo più altra traccia che l'allungamento della consonante seguente (Rohlfs 1969, III: 133). Fra gli aspetti del verbo c'è anche l'espressione dell'imminenza di un'azione, "espressa in italiano e nei vari dialetti da un verbo volere, mentre "L'aspetto incoativo viene volentieri espresso con verbi di moto come andare e venire. In luogo dell' infinito le parlate meridionali presentano vado ac (et) dico; cal. *vegnu e sta,i si jiu a curarii.* Un aspetto incoativo sta anche alla base dell'uso pleonastico di pigliare, che unito a un altro verbo esprime intensità o vivacità (Rohlfs 1969, III: 134).

trevat ballkanike, mund të shpjegohet ndoshta përmes kalkut sintaktik që ushtroi mbi to greqishtja, nëpërmjet katinishtes që kaloi pra në neolatinishten (ose në proto-romanizmin). Ky fakt mund të ketë përcaktuar gramatikalizimin progresiv të aspektit – me ngjyrime durative, iminente ose qëllimore – duke konverguar në gjuhët midis tyre të afërta më parë në Gadishullin Ballkanik dhe më pas në Gadishullin Italian, ku këto gjuhë me prejardhje greke, sllave dhe shqipe janë mërguar.

Në kontekstin ballkanik sistemi foljor i këtyre gjuhëve, edhe sa i përket aspektualitetit, do të ketë pësuar një proces gradual por të pashmangshëm riorganizimi dhe sidomos thjeshtëzimi[89]. I njëjti sistem në kontekstin italian mund të ketë ruajtur thelbësisht pasurinë por edhe varietetin origjinar formash, siç mund të vëzhgohet përmes tabelës përmbledhëse që vë në dukje një kuadër relativisht të azhurnuar të përhapjes së formave të ndryshme perifrastike foljore në kontekstin arbëresh sa i përket veprimit progresiv e veprimit ingresiv.

Fokusin mbi këtë trajtë të veçantë të aspektualitetit ose Aktionsart-it në studimin e morfosintaksës së arbërishtes, që vazhdon ta mbajë ky varietet formash perifrastike që sot nuk dëshmohet më në shqipen ballkanike, e ka përqëndruar që më 1982 kolegu Walter Breu, i cili për herë të parë e bëri aspektin në dimensionet e tij ingresive, progresive dhe egresive të arbërishtes së Italisë objekt qendror me studiminm e tij themelor "Forme verbali perifrastiche arbërisht". Gjithashtu ka nxitur më vonë studjues të tjerë– përmend këtu Martin Camaj, Leonardo M. Savoia, Rita Manzini, Gjilda Alimhillaj, Giuseppina Turano – të thellonin aspektualitetin (durativ, incoativ, iterativ etj.) të foljes, deri atëherë të lënë pas dore në analizën e morfosintaksës të arbërishtes së Italisë. Në sajë të angazhimit shkencor të Walter Breu-t ky argument është sot më sistematikisht dhe analitikisht e shqyrtuar, siç provojnë kongreset (dhe aktet e tyre) që janë organizuar në Konstancë mbi këtë argument[90] dhe referatet e prezantuara në kuvendin e sivjetshëm të Hegne, në Gjermani.

---

[89]Një proces të tillë semplifikimi e gjejmë edhe në shqipen e Ballkanit, duke përfshirë edhe variantet arvanite, megjithëse ndodhen brenda sistemit të saj foljor gjurmë të dukshme të kësaj pasurie të lashtë trajtash foljore perifrastike, siç na dëfton Eqrem Çabej: "Rivolgendoci ai dialetti della madrepatria, ci imbattiamo nel costrutto paratattico rri e..., alla lettera "sta e…" precipuamente del dialetto tosco, in casi come rrinte e dëgjonte "stava ascoltando", in un canto popolare dei Suliotti del principio del secolo scorso natë e ditë rrimë e qajmë "notte e giorno stiamo piangendo" […] ove il verbo rri si è allontanato dal significato proprio, esprimendo una Aktionsart, l'aspetto di un'azione durativa " cf. E. Çabej, studimi i cit., f. 101.

[90] Të dy konferencat u mbajtën në Konstancë, përkatësisht më 2003 dhe më 2005. Gjithashtu aktet e të dy konferencave janë botuar me kujdes të Walter Breu: *L'influsso dell' italiano*

Pa u ndalur, pasi koha në dispozicion nuk është e mjaftueshme, mbi Aktionsart-in në tërë shqipen duke përfshirë edhe degën ballkanike, për të cilin mund të shërbejnë si referime të vlefshme thellimet e studiuesve, shqiptarë e të huaj, të sipërcituar, megjithatë nuk mund të mos përmend të dhënat e mbledhura dhe të pasqyruara në Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe (Napoli 2007-2008). Këtu perifrazat aspektore, siç kanë vërejtur vetë autorët[91], janë vërtet të pakta: ato i përkasin, lidhur me objektin e kësaj kumtese, formimit në epokën parashkrimore të shqipes të një të ardhmeje të vullnetit ose të dëshirës me foljen DUA dhe formimit të një të ardhmeje të domosdosë me foljen KAM – në tabelën 126, formimit të kohës së kryer – me KAM ose me JAM – në tabelën 125.a dhe e foljes JAM në tabelën 125.b, formës dhe strukturës së paskajores – PËR TË + pjesore (PUNUAR), ME + pjesore (PUNUE), PËR ME + pjesore (PUNUE) ose mungesës së saj e zëvendësimit me lidhoren në tabelën 130 dhe, trajtës së vetme aspektore që lidhet me kumtesën time, domethënë togfjalëshat e ndryshëm që gjejmë për të treguar veprimin progresiv durativ në arealet e ndryshme arbërishtfolëse dhe shqipfolëse (duke përjashtuar ato arvanitishfolëse) paraqiten të përmbledhura në tabelën 131:

a) PO + foljen DAL në të tashmen e dëftores;
b) JAM + përcjellore (duke, tuke o kute, ture, tue + DALË)
c) JAM + parafjalën KA(H) + foljen DAL në të tashmen e dëftores;
d) JAM + lidhëzën E + foljen DAL në të tashmen e dëftores;
e) JAM + lidhëzën ÇË + foljen DAL në të tashmen e dëftores.

---

sulla grammatica delle lingue minoritarie, Problemi di morfologia e sintassi. Atti del Convegno Internazionale-Costanza, 8-11 ottobre 2003, Università della Calabria, Centro Editoriale e Librario, Rende 2005 dhe *L'influsso dell'italiano sul sistema del verbo delle lingue minoritarie. Resistenza e mutamento nella morfologia e nella sintassi*. Atti del 2° Convegno Internazionale Costanza, 10-13 dicembre 2008, Universitätsverlag Dr.N. Brockmeyer, Bochum 2011.

[91] Sipas studiuesit shqiptar Jorgji Gjinari, "*Quanto alle differenze nel campo lessicale e soprattutto sintattico, le difficoltà sono senz'altro maggiori, non solo perché vengono a mancare i paradigmi, ma anche per l'assenza di ricerche dialettologiche in merito. Nel campo della sintassi, il numero degli argomenti trattati dipende dal fatto che le differenze dialettali in riguardo sono relativamente poche*" (cf. *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe*, vëllimi I, Napoli 2007, f.45). Në parathënien Mahir Domi na jep një shpjegim tjetër, duke nënvizuar si "*l'esiguo numero delle domande sulla sintassi – solo 9 su 260 ndr! – è dovuto a una serie di motivi. Innanzitutto le differenze tra i dialetti e le parlate dell'albanese – come del resto per altre lingue – nel campo della sintassi, non sono numerose; va notato, poi, che le relative indagini richiedono più tempo, rispetto a indagini, su altri fenomeni, d'ordine fonetico, morfologico e lessicale*" (cf. *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe*, vëllimi I, Napoli 2007, f.35).

Duke qenë të pakta pikat arbëreshe të përfshira në Atlasin Dialektologjik Shqiptar, na duket e dobishme t'i krahasojmë këto të ADGJSH me "rrjetëzën" përmbledhëse që na paraqiti Leonardo Maria Savoia më 1991 në studimin e tij "Alcuni elementi per una classificazione dei dialetti arbëreshë"[92]. Pas klasifikimit për herë të parë të arbërishtes sipas arealeve isofone që përgatiti Francesco Solano (cf. "I dialetti albanesi dell'Italia meridionale. I, Appunti per una classificazione", Quaderni di Zjarri, Castrovillari 1979), në këtë punim kemi përpjekjen e parë, me rezultate të shkëlqyera, për të përcaktuar burimet e përbashkëta të dialekteve të ndryshme të italo-arbërishtes, në bazë të morfologjisë së foljes, por edhe mbi variantet që regjistrohen në lëmin leksikor.

Ne e kemi zgjeruar modelin klasifikues, "rrjetëzën" origjinare të Savoia-s, në dritën e gjurmimeve të mëtejshme që kemi bërë personalisht mbi të folme të tjera arbëreshe dhe jo të analizuara prej tij dhe që, pra, nuk rezultonin në skemën e botuar më 1991. Nga ana tjetër e kemi plotësuar atë duke marrë në shqyrtim "korporat" e shumta që ndërkohë janë botuar me tekste arbërisht sipas varieteteve dialektore në periudhën tridhjetëvjeçare të fundit dhe përmes integrimesh të pastajme që kryem nëpërmjet intervistash me folës të komuniteteve arbëreshe, më parë jo të anketuar, kur jemi ndeshur në variante të reja që, pra, janë pranuar dhe përfshirë në "gjedhen" klasifikuese të M. Savoia-s.

Të dhënat e mia të shtuara janë shënuar dhe vënë në dukje përmes tabelës që keni parasysh lidhur me aspektin durativ progresiv, duke përdorur karakterin e zi për të folmet dhe format foljore, të cilat nuk janë të pasqyruara në tabelën e Savoia-s. Gjithashtu kam përfituar nga ky rast për të futur në të njëjtën "rrjetëz" të dhëna të reja, ende në përpunim e në fazë verifikimi dhe ende të përkohshme, mbi shpërndarjen në arbërishten e aspektit progresiv, për herë të parë trajtuar gjerësisht në studimet e dialektologjisë arbëreshe me shumë hollësira në përshkrimin e gjerë dhe organik që na dha Martin Camaj në monografinë e tij mbi të folmen arbëreshe të Shën Kostandinit, që doli pas vdekjes së tij më 1993[93].

---

[92] Leonardo M. Savoia, "Alcuni elementi per una classificazione dei dialetti arbëreshë" (pp.13-52) in AA.VV., *La lingua albanese nell'Italia meridionale. Studi e prospettive*, Università degli studi di Salerno, Salerno 1991. Disa thellime dhe integrime të tjera të mëtejshme këtij kuadri përgjithësues me të cilen klasifikon varietetet gjuhësore arbëreshe të Italisë, autori na i sjell pastaj në studimin "Variazione e mescolanza linguistica nei sistemi arbëreshë: code-mixing, prestiti e convergenza in condizioni di bilinguismo" (f.1-62) në Leonardo M. Savoia, *Studi sulle varietà arbëreshe*, con la prefazione di F. Altimari e un contributo di Rita Manzini, Università della Calabria, Rende 2008.

[93] Martin Camaj, *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese*, vep. e cit., fq.83-92.

F. ALTIMARI, *Tabela përmbledhëse e togfjalëshave perifrastikë foljorë të progresivit dhe ingresivit në sistemin foljor të arbërishtes të italisë* – 2019

Kodi [94]	Të folmet arbëreshe të Italisë	Aspekti durativ-progresiv	Aspekti iminent-ingresiv	TOGFJALËSHA FOLJORË NË PROCES, DURATIVË DHE IMINENTIVË, NË ARBËRISHTEN E ITALISË
04	KËMARINI	1.a	1.a	1.a togfjalësh i bashkërënditur me foljen stative JAM (‘sono’) +lidhëzën E + foljen e zgjedhuar në dëftore: ‘*jam e vinj’*
46	RURI	1.a	3.a	
30	PORTKANUNI	1.a	1.a	
26	MUNXHIFUNI	1.a	1.a	
3 9	SAN MARCANI	2.a	2.a?	**1**.b togfjalësh i bashkërënditur me foljen stative JAM (‘sono’) + komplementatorin (plotësorin) ÇË + foljen e zgjedhuar në dëftore: ‘*jam çë vinj’*
07	KAZALLVEQI	1.b		
11	QEUTI	1.a + 5a	4.a+ 2.b ±	
20	GREÇI / KATUNDI	1.b	4.a	
03	BARILLI	2.b	4.a + 2.b ±	1.c togfjalësh i nënrënditur me foljen stative JAM (‘sono’) + pjesëzën TË + foljen e zgjedhuar në lidhore: *‘jam të vinj’*
19	ZHURA	2.b	4.a + 2.b ±	
25	MASHQITI	2.b	4.a + 2.b ±	
41	SHËN PALI	1.a	3.b	
34	SHËN KOSTANDINI	1.a	3.b	
08	KASTËRNEXHI	1.a		1.d togfjalësh i bashkërënditur me foljen stative JAM (‘sono’) + komplementatorin (plotësorin) QË + foljen e zgjedhuar në dëftore: *jam që vinj*
29	PLLATËNI	1.a	3.a	
31	SHËN VASILI	1.a		
18	FRASNITA	1.a	3.a+4.a ±	2.a togfjalësh i bashkërënditur me foljen stative RRI (‘sto’) + lidhëzën E + foljen e zgjedhuar në dëftore: *rria vinj*
14	EJANINA/ PURÇILLI	1.a	3.a +4.a ±	
45	SPIXANA	1.a	3.a	2.b togfjalësh i nënrënditur me foljen stative RRI (‘sto’) + pjesëzën TË + foljen e zgjedhuar në lidhore: *rrij të vinj*
35	SHËN MITRI	1.a	1.a	
44	SHËN SOFIA	1.a	1.a	
24	LLIMARRI	1.a	1.a	
32	SHËN BENEDHITI	1.a	1.a	3.a togfjalësh i nënrënditur me foljen stative JAM (‘sono’) + komplementatorin (plotësorin) PO + pjesëzën TË + foljen e zgjedhuar në
15	FALKUNARA	1.a	1.a?	
40	SHËN KOLLI	1.b	1-b	

Duke vëzhguar këtë të folme arbëreshe studiuesi shkodran arrin të identifikojë një trajtë më arkaike, deri sot jo e shqytuar në mënyrë veçantëtë, të aspektualitetit të foljes në shqipen/arbërishten, dikur i realizuar por jo kaq i dëshmuar në tekstet e vjetra, në formë zgjedhore dhe jo perifrastike, brenda së njëjtës foljeje. Ky aspektualitet i dyfishtë bazohet tek zgjedhimi (dhe jo tek perifraza) duke përdorur prapashtesa të diferencuara, për të arritur përmes desemantizimit të foljes stative dhe gramatikalizimit të ndërtimit të ri parataktik apo ipotaktik që lidhet me të¸ te faza e zëvendësimit të mëpastajshëm të sistemit të lashtë aspektual eptimor me sistemin e ri foljor perifrastik.

[94] Kodi i të folmeve arbëreshe

06	KARFICI	1.b	1.b	lidhore: *jam po të vinj* 3.b togfjalësh i nënrënditur me foljen stative JAM (‘sono’) + 2 komplementatorë (plotësorë) PO + SA + pjesëzën TË + foljen e zgjedhuar në lidhore: *jam po sa të vinj* 4.a togfjalësh i nënrënditur me foljen stative JAM (‘sono’) + 2 pjesëza PËR [edhe në variantet PË e PE] + TË + foljen e zgjedhuar në lidhore: *jam për të arrivonj* [± = bashkëprania e të dy konstrukteve]
27	PUHËRIU	1.b	1.b	
02	DANDALLI	1.c + 1.d ±		
23	MARÇIDHUZA	1.b		
05	GHARRAFA	1.c + 1.d ±	1.c	
50	XINGARONA	1.d		
48	VINA	1.b	1.b	
28	HORA E ARBËRE-SHËVET	1.a + 1.b ±	1.a + 1.b ±	

Nga kjo tabelë përvijohet një hartë e parë gjeolinguistike mbi shpërndarjen e togfjalëshave të ndryshëm perifrastikë që përfaqësojnë veprimin iminent në të folmet e ndryshme arbëreshe, që ka një shpërndarje më të kufizuar në krahasim me veprimin progresiv, i cili në shumë të folme arbëreshe arrin shpesh ta “inglobojë” dhe ta përfaqësojë edhe veprimin ingresiv.

Edhe togfjalëshi foljor, ashtu si ai progresiv, zgjedhohet qoftë në kohën e tashme, qoftë në kohën e pakryer – JAM + PO + TË BËNJ (e tashme) “jam për të bërë/sto per fare”, ISHNJA ~ISHA~INJA~JESH + PO + TË BËNJA (e pakryer) “isha për të bërë/ stavo per fare”, ku në disa kontekste mund të shprehë një domethënie më qëllimore se iminente.

Ndërtimi foljor – PËR + TË+ LIDHORE – që merr trajtat e një fjalie qëllimore, në ndonjë areal arbërishtfolës të Kalabrise së Veriut mund të zëvendësohet apo mund të ndërrohet në të njëjtin kontekst sintaktik nga togfjalëshi i lashtë me paskajoren PËR + ME + PJESORE, që dikur është trajtuar si një formë e ndikuar dhe e huazuar nga autorët e vjetër gegë në arbërishten e shkruar të shekulkllit XIX. Por ashtu siç jemi përpjekur të provojmë në një studim të mëparshëm, sot mund ta konsiderojmë si një mbeturinë të ngurosur infinitivi që rrjedh nga një paskajore e lashtë pan-shqipe ose, ta themi më mirë, të albanishtes dmth të fazës parashkrimore të shqipes/ arbërishtes.[95]:

Ajo këmishë ng’është e mirë ***për të dalësh****, Ajo këmish ng’është e mirë* ***për me dalë~dalur***

[95] Francesco Altimari, “Tracce di antichi infinitivi dell’albanese nell’arbëresh d’Italia” (pp.87-111), in idem, *Studia linguistica italo-balcanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri 51, Prishtinë 2014.

Këto konstrukte perifrastike, një- apo bi-aspektuale, na hapin skenare të reja të mundshme e lumenj interesantë gjurmimi mbi arbërishten, por edhe mbi varietete të tjera gjuhësore që kanë qenë me të në kontakt – romane- greke ose sllave – një herë në kontekstin ballkanik dhe pastaj në kontekstin italian. Kjo kërkon një nxitje të mëtejshme kërkimore për këto analiza aspektologjike që na sollën në këto rezultate, të cilat jemi përpjekur t'ju ilustrojmë sot këtu shkurtimisht në këtë kumtesë.

Bibliografia

Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, vëllimi I, Università degli Studi di Napoli L'Orientale-Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale, Napoli 2007.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, vëllimi I, Università degli Studi di Napoli L'Orientale-Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale, Napoli 2008.

Gjilda Alimhilli Prendushi, *L'Aktionsart nella lingua albanese*. Klasifikimi foljor sipas mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe, Falco Editore, Cosenza 2009.

Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia (a cura di), *I dialetti italo-albanesi*. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni editore, Roma 1994.

Francesco Altimari, *Studia linguistica italo-balcanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, libri 51, Prishtinë 2014.

Luisa Amenta, *Perifrasi aspettuali in greco e in latino. Origini e grammaticallizzazioni*, Franco Angeli, Milano 2003.

Walter Breu (a cura di), *L'influsso dell'italiano sulla grammatica delle lingue minoritarie, Problemi di morfologia e sintassi. Atti del Convegno Internazionale-Costanza, 8-11 ottobre 2003*, Università della Calabria, Centro Editoriale e Librario, Rende 2005.

Walter Breu (a cura di), *L'influsso dell'italiano sul sistema del verbo delle lingue minoritarie. Resistenza e mutamento nella morfologia e nella sintassi*. Atti del 2° Convegno Internazionale Costanza, 10-13 dicembre 2008, Universitätsverlag Dr.N. Brockmeyer, Bochum 2011.

Eqrem Çabej, "Storia linguistica e struttura dialettale dell'albanese d'Italia" (pp.5-30) in *Problemi di morfosintassi dialettale*, IX, Pisa 1976. Riedito (pp.85-105) in: Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia (a cura di), *I dialetti italo-albanesi*. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, presentazione di Tullio De Mauro, Bulzoni editore, Roma 1994.

Martin Camaj, *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino*, Leo Olschki editore, Firenze 1971.

Martin Camaj, *Die albanische Mundart von Falconara Albanese in der Provinz Cosenza*, Trofenik Verlag, München 1977.

Martin Camaj, *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia di Potenza*, Centro Editoriale e Librario dell'Università della Calabria, Rende 1993.

Demetrio Camarda, *Saggio di grammatologia comparata della lingua albanese*, Successore di E. Vignozzi, Livorno 1864.

Mauro Cassoni, *Hellàs Otrantina o disegno grammaticale*, Scuola Tipografica Italo-

Ortientale "San Nilo", Grottaferrata 1937.

Georg Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache (Laut- und Formenlehre),* Verlag des Albanesischen vereines "Dija", Wien 1908.

Gerhard Rohlfs, *Griechischer Sprachgeist in Süditalien* (Zur geschichte der inneren Spachform) [Sitzungsberichte der Bayerischen Akademie der Wissenschaften, Phil. hist. Abteil, 1944-46], Monaco 1947.

Gerhard Rohlfs, *Grammatica storica della lingua italiana e dei suoi dialetti*, voll. I-II-III, Einaudi, Torino 1969.

Kristian Sanfield, *Linguistique balkanique, problèmes et résultats,* Collection linguistique publiée par la Société Linguistique de Paris, Paris 1930.

Leonardo M. Savoia, "Alcuni elementi per una classificazione dei dialetti arbëreshë" (pp.13-52) in AA.VV., *La lingua albanese nell'Italia meridionale. Studi e prospettive*, Università degli studi di Salerno, Salerno 1991.

Leonardo M. Savoia, "Variazione e mescolanza linguistica nei sistemi arbëreshë: code-mixing, prestiti e convergenza in condizioni di bilinguismo" (pp.1-62) in Leonardo M. Savoia, *Studi sulle varietà arbëreshe,* con la prefazione di Francesco Altimari e un contributo di Rita Manzini, Università della Calabria, Rende 2008.

Leonardo M. SAVOIA and Benedetta BALDI, Università di Firenze

IMPERATIVE IN GHEG, TOSK AND ARBËRESH: A COMPARISON

Abstract. Clitic order raises interesting questions concerning the relation between morpho-syntactic structure and its externalization into interpretive levels of language. This in particular regards imperative string where in many languages, typically in Romance varieties, the interaction of clitics with modality, specifically imperative and infinitive, and negation gives rise to reordering phenomena. More precisely, imperative differentiates from declarative sentences in selecting enclisis except in negative contexts where clitics occur between the negative element and the verb. This distribution generally characterizes all Albanian varieties, although with some differences. Moreover, in Albanian even the mesoclisis appears in the case of the 2nd plural person of imperative, whereby either one clitic or the entire clitic string is inserted between the verbal base and the person inflection. Manzini and Savoia began to analyze this distribution in Arbëreshë and in Calabrian and Lucanian contact varieties in some works from several years ago.

This contribution focalizes on the comparison of Albanian data from the different varieties and aims at resuming the descriptive and theoretical approach within a revised conceptual framework. The microvariation among these languages primarily involves the position of object clitics in 2nd plural person separating varieties allowing for total mesoclisis, as Albanian Tosk in (1), partial mesoclisis, as generally Arbëreshë dialects of Italy in (2), or preventing mesoclisis, as Gheg of Shkodër in (3). In (a) and (a') positive imperative forms are exemplified, with, respectively, a 3rd person and a 1st person clitic. In Arbëreshë dialects, both follow the 2nd singular imperative form but in 2nd plural imperative form the 1st (and reflexive) clitic are inserted in mësoclisis. In Southern Albania varieties (Tosk) both 1st and 3rd clitics occur in mesoclisis; moreover, 1st person clitic can occur also before the verb. In Gheg dialect of Shkoder 1st person clitics occur in pre-verbal position whereas 3rd person clitic occur in post-verbal position. No mesoclisis is attested. In (b) clitic clusters are illustrated, that obey the same distributional constraints. Finally, (c) exemplify negative imperatives, where the occurrence of the specialized modal negation *mos/ mas* selects the pre-verbal position of the clitics.

(1)a. jɛp-j-a
give-him-it
'give him it'
ʃiko-je-ni
look at-OCl3-2nd PL
'look at him/her'
a'. na ʃiko-ni
OCl.1st PL look at-2nd PL
'look at us'
b. m-asil-ni
me-itbring-2nd PL

'bring me it'
sil-m-ani
bringme-it2nd PL
'nring me it'
ʃiko- na-ni
look at-us2nd PL
'look at us'
c.mɔs j-a jɛp
Neghim-itgive
do'nt give him it'
mɔs m-a sil-ni
Negme-itbring-2nd PL
'don't give me it'
Gjirokastër

Differently from Tosk varieties, in Arbëreshë dialects, in the case of clitic string *dative+accusative* deictic clitics (1st person) are incorporated inside the word, while the 3rd person clitics are put on the right of the inflection.

(2)a.zɟo-ni-ɛ
2nd PL2nd PL her/him
'wake her/him up!'
a'.zɟo-m-ni
wake.up me 2nd PL
'wake me up!'
b.z̃-m-ni-ɛ
give me 2nd PL it
'Give it to me!'
jip-ni-j-a
give 2nd PLto.him it
'give(pl) it to him!'
c.mɔs j-a jipni
Neg him-it give-2nd PL
'don't give him it'
mɔs na zɟo-ni
Negus wake.up-2nd PL
'do not wake us up
Firmo

Finally, in Shkodër variety, deictic clitic are positioned before the verb and 3rd person clitic in post-verbal position. In the clusters the presence of one 1st person clitic forces the 3rd person clitic to occur before the verb.

(3)a.ʃif-ɛ
look-2nd SG-her/him'
'look at her/him'
ʃif-ni-ɛ
look-2nd PL-her/him
'look at her/ him'

mas ɛ ʃif / ʃif-ni
Neg her/ himlook-2nd PL/ look-2nd PL
'don't look at her/ him'
(mas)m ʃif-ni
(Neg)melook-2nd PL
'(don't) look at me'
(mas)m a nɛp-ni
(Neg)me itgive-2nd PL
'(don't) give me it'
Shkodër

The data show the following asymmetries:

- ✓ In all of the Albanian varieties that we examine proclisis is required in negative contexts (Manzini and Savoia 2007, 2011, 2017; baldi and Savoia 2018), so that negation triggers the reordering of the clitic string with respect to the verb
- ✓ A positional DOM effect emerges that aligns deictic clitics (1st person ones) to the left of the 3rd person clitics. This distribution is highlighted both in the varieties that admit the mesoclisis in the 2nd plural person of imperative, and in Gheg varieties that exclude mesoclisis.
- ✓ Tosk varieties admit or require mesoclisis with the 2nd plural person form of imperative, In Arbëreshë dialects mesoclisis only involves the deictic clitics while 3rd person elements follow the verb.

These asymmetries put into play the interaction of crucial morpho-syntactic properties of the sentence: the Phase structure of the imperative, the referential properties of the pronominal elements and the interpretive nature of the negation. We will try to bring to light the different syntactic and interpretive aspect involved in this complex picture.

In many languages, as in Romance varieties, the interaction of clitics with imperative and negation brings about reordering phenomena. In Albanian varieties, imperative, differently from declarative sentences requires enclisis, except in negative contexts where clitics occur between the negation and the verb. Moreover, the 2nd plural person of imperative generally triggers mesoclisis between the verbal base and the person inflection. The distribution of object clitics in Albanian imperative gives rise to an interesting variation that this work aims at accounting for.

1. Clitics and imperatives

In Albanian pronominal object clitics (OCls) generally occur in preverbal position except in imperative sentences, where may be inserted both in enclisis and in mesoclisis between the verbal root and the 2nd plural inflection. As highlighted by the data presented in this section, the distribution of OCls in imperative is partially different from one variety to another, whereby Tosk of

Ghirokastër in (1), Arbëresh in (2) and Gheg of Shkodër in (3) display differences in the position of 1st person clitics (deictic clitics) and of 3rd person clitics.

The following examples concern positive imperatives in Tosk, Arbëresh and Gheg varieties. In (a)-(a') for 2nd singular and (b)-(b') 2nd plural imperative. (a)-(b) illustrate the insertion of the 3rd person clitic, (a')-(b') the one of the 1st person clitic, (c)-(c') exemplify the *1st person+3rd person accusative clusters*, and (d)-(d') the *3rd person dative +3rd person accusative*. It is of note that the 2nd singular person coincides with the root of the verb in vocalic bases, or, in the case of consonant roots, with a basis including the vocalic alternant occurring also in 2nd person of indicative and in middle-reflexive forms, such as *-i-* in *ʃix* in (1a, b) contrasting with -ɔ- in *ʃɔx* 'I see' (see the discussion surrounding (12)). The 2nd plural person has the morpheme of 2nd plural *-ni*, as in *ʃixni!* 'see', *silni!* 'bring!' (Gjirokastër). (f) exemplifies the occurrence of the dative clitic *i*, which in this variety occurs in mesoclisis like the other 3rd person clitics. Generally 3rd person OCls occur in final position or, however, follow 1st person OCls. A crucial morpho-syntactic trait of these languages is that in 2nd plural person of imperative generally admits or requires mesoclisis of OCLs.

Consider now Gjirokastër's variety in (1), where both simple OCls and clusters are generally realized in mesoclisis, while admitting also pre-verbal occurrence of 1st person clitics (cf. (1b", e')).

(1)a.ʃix- / viʃ-ɛ/ i
see- / dresshim/her/them
'see/ dress (sg) her/ him/ them'
a'.ʃix-məmua
seeme me.OBL
'see (sg) me'
a".mə ʃi'kɔ
melook (2sg) at
'Look at me'
b.ʃix- / viʃ-ɛ-ni
see-/ dresshim/her2ndPL
'see/ dress (pl) him/her'
b'. ʃix- / viʃ- mə- ni/ nə-m-niatə
see-/ dress me2PL/ give(pl)me2PLthat
'see/ dress (pl) me / give me that'
b".mə ʃiko-ni
me look at-2PL
'look at (pl) me'–
c.jep- i- a
givehim/her it
'give(sg) it to her/ him'
c'.nə- m-a/ jep-m-a
givemeit

'give(sg) me it'
d.jɛp-i- a-ni
give-him/her it2PL
'give (pl) it to him/her/them'
d'.sil-m-a/ini
bringme -him/her/them2PL
'bring (pl) it/them to me'
nə-/jɛp-m-a / i-ni
givemeit/ them2PL
'give (pl) it to me'
e.na /mɛ ʃiko-ni
us / melook at-2PL
'look at (pl) us/ me'–
prit- na-ni
wait for us-2PL
'wait for (pl) us'
f. jɛp-i-nikətə
give-him/her 2PLthis
'give (pl) this to him/her/them' Gjirokastër

In Arbëreshë dialects mesoclisis is restricted to deictic clitics (1st person), so that in the case of clitic string *dative+accusative* the 3rd person clitics are in fina post-verbal position. The following data come from the varieties of San Benedetto Ullano (Calabria) and Casalvecchio (Apulia). The simply occurrence of dative, in (f), is obscured by the coalescence of the dative *-i* and the final vowel of the ending *-ni*, suggesting that its position is the same as the other 3rd person elements.

(2)a. zɟɔ ata
wake upthem
'wake (sg) them up'
zɟɔj- ɛ/ i
wake uphim/her/them
'wake (sg) him/ her/ them up'
a'. zɟɔj- əm
wake up me
'wake (sg) me up'
a. zɟo-ni-ɛ
wake up2PLhim/her
'wake (pl) her/him up'
b'.zɟo-m-ni
wake up me2PL
'wake (pl) me up'
c.a-m-ni-ɛ
give-me2PLit
'give (pl) it to me'
f.jip-ni(i)kətə
give2ndplthis

'give this to him/ her'
San Benedetto Ullano
a. θrit-a / i
callhim/her/them
'call (sg) her/ him/ them'
a'.θrit-mə
call me
'call (sg) me'
b.zɟɔ- ni-a
wake up2PL him/ her
'wake (pl) her/ him up'
b'. θrit-mə-ni
call me2PL
'call (pl) me!'
c'.jə-m-a
givemeit
'give (sg) it to me'
d'.jə-m-ni-a
give-me-2PL-it
'give (pl) it to me' Casalvecchio

In Shkodranë Gheg, the 1st person clitics and clitic clusters *1st person+3rd person* occur in pre-verbal position, differently from the preceding varieties, which insert 1st person clitics in proclisis or in mesoclisis. 3rd person clitics and 3rd person clusters (accusative and dative) occur in post-verbal position, or, variably, in mesoclisis. We note that in 2nd plural forms including the 3rd person cluster *i-a* '3DAT+3ACC' the duplication of the 2nd plural inflection is attested, as in (3d).

(3)a.ʃif-ɛ
look at- him/her
'look at (sg) her/him'
a'.m ʃif
me look at
'look at (sg) me'
b. θir-ni- ɛ
call2PLhim/her
'call (pl) her/ him'
ʃif- / θir-ɛ- ni
look at/ callher/him 2PL
'look at/ call (pl) her/ him'
b'.m ʃif-ni/θir-ni
melook-PLcall-PL
'look at/ call (pl) me'
b.nɛp- i-a
give.2SG3DATit
'give (sg) it to him/ her'
c'.m-a /naɛnɛp

meit /usitgive
'give (sg) it to me / us'
d. nɛp-ni-i- a-(ni)/ nɛp-i- a-ni
give2ndPL him/her it2PL/ give-him/her it2PL
'give (pl) him it'
tʃɔ-ni-i-a- (ni)(ktə)
bring2PLhim/herit 2PL
'bring (pl) it to him'
d'.m a nɛp- / jɛp-ni
1SGit give- 2PL
'give (pl) it to me' Shkodër

The order between deictic and 3rd person clitics is substantially preserved in Shkodranë language as in other varieties, in the sense that 1st person clitic occupies a scope position to the left of the 3rd person clitics. However, this order is obtained by placing deictic clitics before the verb and 3rd person clitics inside or to the right of the verbal form, a possibility which, however, is not unknown also to Gjirokastrit variety, as indicated in (1b").

In negative imperatives the specialized negation *mos/ mas* occurring in other modal contexts is inserted; besides, the reordering of clitics in pre-verbal position is triggered, independently of the person of the verbal form and the nature of clitics, as illustrated in (4).

(4) mɔs i- a jɛp
Neghim/her itgive
'do'nt give (sg) it to him/her/them'
mɔs m-a sil-ni
Negme-itbring-2PL
'don't bring (pl) it to me' Gjirokastër
mɔs mə / ɛ zɟɔ / zɟɔ-ni
Negme / him/her wake up-2SG/PL
'do not wake up (sg/ pl) me/ her/ him' San Benedetto Ullano
mas mə θrit
Negme call
'do not call (sg) me!' Casalvecchio
mas ɛ /mʃif / ʃif-ni
Neg him/her/melook-2SG/ look-2PL
'don't look at (sg/ pl) her/ him/me'
mas i / manɛp-ni
Neghim/her/me itgive-2PL
'don't give (pl) it to him/ her/ me' Shkodër

As to non-active forms of imperative, the middle-reflexive/ passive interpretation is generally lexicalized by the non-active (NA) clitic *u* (*oneself*; Manzini and Savoia 2007). In the imperative the distribution of *u* coincides with that of the 3rd person clitics, since *u* is positioned in enclisis in the 2nd singular imperative, as illustrated in (5a). In the 2nd plural person in (5b), it occurs in mesoclisis

in Gjirokastër and in enclisis in Shkodër variety. The negative form in (5a',b') implies the reordering whereby the modal negation morpheme occurs first followed by the clitic *u* and the verb. The data of Gjirokastër highlights the fact that vocalic roots, such as *la-* 'wash', select the middle-reflexive morpheme *-h-*.

(5)aviʃ-u
dressNA
'dress (sg) yourself'
la-h-u
wash-NA *inflection*NA
'wash (sg) yourself'
a'.mɔsu viʃ/ula
NegNAdress /NAwash
'don't dress (sg)/ wash (sg) yourself'
b.viʃ-u-ni
dressNA2PL
'dress (pl) yourself'
la-h-u-ni
washNA *infl* NA2PL
'wash (pl) yourself'
b'.mɔsuviʃ-ni /la-ni
NegNAdress-2PL/wash2PL
'don't dress (pl)/ wash (pl) yourself' Gjirokastër
a.lɑj-u
wash-NA
'wash (sg) yourself'
a'.masulɑj
NegNAwash
'don't wash (sg) yourself'
b.lɑ-ni-u
wash-2PL-NA
'wash (pl) yourself'
b'.masulɑ-ni
NegNAwash-2PL
'don't wash (pl) yourself' Shkodër

In Arbëresh dialects the internal structure of 2nd person plural of the middle-reflexive imperative coincides with the 2nd person plural of the middle-reflexive indicative. More precisely, the vocalic root is followed by middle-reflexive infix, *-h-* in S. Benedetto Ullano, *-x-* in Casalvecchio, followed in turn by the person ending, as in (6). In the negative imperative the clitic *u* is reordered before the verb and preceded by the modal negation, as in (6a',b'), in the singular, while in the negative 2nd plural the middle-reflexive form of indicative is preserved, so that non-active interpretation is entirely devolved to the NA inflection *-h-*, *-x-*.

(6)a.zɟɔj-u

wake upNA
'wake up (sg)'
a'.mɔs u zɟɔ
NegNA wake up
'don't wake up (sg)'
b. zɟɔ-h- ij
wake up NA *Infl* 2PL
'wake up (pl)'
b'.mɔs zɟɔ- h-ij
Negwake up NA *Infl*2Pl
'don't wake up (pl)' San Benedetto Ullano
a.ʎa-x- u
washNA *Infl*NA
'wash (sg)'
a'.mas u ʎa- x
NegNA wash
'don't wash (sg)'
b. ʎa-x-ni
washNA *Infl* 2PL
'wash (pl)'
b'.mas ʎa- x- ni
Negwash NA *Infl* 2Pl
'don't wash (pl)' Casalvecchio

Summarizing we have: (i) Mesoclisis is attested in all varieties in 2nd person plural form of imperative. (ii) In Arbëresh varieties mesoclisis affects only the 1st person singular form; 3rd person and NA clitics follow the imperative. (iii) In Gjirokastër variety mesoclisis involves both 1st singular and 3rd person clitics. (iv) In Shkodër variety 1st person clitics precede the imperative and mesoclisis involves only 3rd person and NA clitics.

In Tosk and Gheg languages, the 1st plural forms of imperative are realized by subjunctive forms, as in (7), introduced by the modal particle *tə* (MPrt), where the negation is in turn realized by the modal form *mɔs/ mas*.

(7) (mɔs)t i- ajap-im
NegMPrthim/her itgive1stPL
'let us give him/ her it / don't give it to him/ her' Gjirokastër
(mas)tla-hɛ-na
NegMPrtwashNA *Infl*1stPL
'let us wash / don't wash' Shkodër

In what follows we will concentrate on the specialized imperatives of 2nd person.

2. The analysis

The table (8) schematize the distribution of object clitics in the 2nd person plural in (1)-(3). In (8) 'm' indicates mesoclisis; the *preverbal position* is

designed by ‘prv’ and the *postverbal position* by ‘psv’. We remind that non-active clitic *u* and the dative *i* have the same distribution as the 3rd person OCls.

(8)*Clitics in 2nd plural person of imperative*

	1st SG	3rd ACC/DAT/NA	1st SG+3rd ACC	3rd DAT+3rd ACC
Gjirokastër	m	m	m	m
Arbëresh	m	psv	m	psv
Shkodër	prv		m/ psv	prv m/ psv

The more immediate generalization evidenced by (8) concerns the reciprocal distribution of the clitics in imperatives, whereby we have the following abstract ordering, in (9):

(9)*Deictic clitics 3rd Person dative 3rd Person and NA*

These asymmetries put into play some of the crucial morpho-syntactic properties of the sentence:

- ✓ DOM emerges whereby deictic clitics (1st person) have a different distribution from 3rd person clitics at least in Shkodër and Arbëreshë varieties;
- ✓ In all contexts 1st person precedes 3rd person clitics (mesoclisis/ post-verbal/ pre-verbal).
- ✓ Negation requires clitics to occur in pre-verbal position (Manzini and Savoia 2007, 2011, 2017; Baldi and Savoia 2018)

In keeping with the proposes in Manzini and Savoia (2011, 2018), Savoia et al. (2017, 2018), inflectional structures are built in the syntax. Nouns and verbs are analysed as the result of a syntactic Merge operation that combines a lexical root with the categorical elements that specify the syntactic nature of the word, gender, number and person for nouns and pronouns, voice, modal-aspectual properties and agreement inflections for the verb. In the following representtations √ stands for the category-less root (Marantz 1997) and Infl for the morphemes that externalize properties of the verb or the noun. We assume that all lexical material, including inflectional material, is associated to interpretable contents. As a consequence, our model excludes uninterpretable features and probe-goal induced movement, as in the case of the traditional Agree rule, i.e. the fundamental mechanisms of cartographic explanations (Chomsky et al. 2019). Agreement is nothing but the lexicalization of phifeature bundles identifying the same argument, i.e. denoting a single referent (Manzini and Savoia 2005, 2018).

On this basis, we represent the internal structure of the OCls as in (10a) for the accusatives *ɛ / i* and (10b) for the 1st person element *mə*. The accusative is associated to the class of definiteness elements and is realized by the bare inflectional element *ɛ* (sg)/*i* (pl), while the 1st person element includes the specialized root. The availability of 1st person clitic for oblique contexts led us to associate it to the oblique interpretation that we treat as corresponding to the

part-whole/ inclusion property, [⊆] (Manzini and Savoia 2018). So, 1st person clitic is interpreted as including the event of which is a participant.

(10) a. Infl b. Infl

Class Infl √ Infl

[definite] ɛ / i m [1st person] ə [⊆]

In this framework, the 2nd plural of imperative *ʃixni* 'see (pl)' (Gjirokastër) has the structure in (11).

(11) Infl

Mod Infl

ni_x [2nd pl]

√ Mod

$ʃix_{x,y}$ Imperative

The verbal root *ʃix* 'see', selecting two arguments, EA *x* and IA *y*, combines with the counterfactual property of order (Imperative) and the person Inflection *ni*, on its own saturating the EA.

In the variety of Shkodër, the 2nd singular person of imperative of roots ending in consonant, has a short stressed nucleus, in (12a), contrasting with otherwise coincident form of the reduced participle (Manzini and Savoia 2007), characterized by a stressed long nucleus, in (12b).

(12) a. m vɛʃ

me dress

'dress me!'

b. jam ve:ʃ

I.am dressed/ I dressed myself'

'I am dressed'

Morpho-phonological differences are able to register mood or other aspectual/ modal categories, as suggested in (11) above. In this case, the vowel duration (and its aperture degree) is involved.

2.1. Imperative

The crucial imperative property is the fact that the verbal element is not associated to temporal properties and it tends to coincide with the lexicalization of the simple predicative content (Aikhenvald 2010, Alcazar and Saltarelli 2004). No accident, in many languages imperatives correspond to the mere verbal root, as we see in the varieties in (1)-(3) in the case of the 2nd singular forms, as *ʃif* 'look at' in (2a) and *zɟɔ* 'wake up' in (3a) corresponding to the

verbal root. Imperatives introduce a clause that escapes the truth conditions generally applicable to declaratives; so, Portner (2004) conceives imperatives as expressions introducing a property. A very usual analysis is that the imperative form assigns a property (its predicative content) to a prominent argument, identified with the addressee (Platzak and Rosengren 1998, Mauck and Zanuttini 2005). Zanuttini (2008) postulates that the imperative is the head of a JussiveP projection, which 'has an operator in its specifier that... takes as input a proposition, consisting of the predicate saturated by the subject, and yields as output a property. This property has a presupposition that its argument, corresponding to the subject, refers to the addressee(s)'. In other words, in the imperative a modal operator connects the situation denoted by the sentence in its scope to the denotation of the hearer.

Our model is based on a different conceptualization, whereby the agreement is understood as the identity relation between two or more referential feature sets, for instance, the EPP argument and the verbal inflection (Baldi, Savoia 2018, Manzini, Savoia 2018). We agree with the insight that the imperative denotes a property 'which can only be true of the addressee' (Portner 2004: 239), rather than an event, and as such non-submitted to veridicality requirements. Simplifying the formalism of Mauck and Zanuttini (2005), imperative is a predicate with a variable *x* bound by the imperative operator, as in (13)
(13)[Speech Act [Imperative force,x zɟɔx,y [C [T [v [V

The expressed (or covert) agreement of imperatives coincides with the features identifying the addressee: in many languages this is externalized by specialized inflectional exponents, as, in the case of Albanian varieties, by *-ni* inflection of 2nd plural. This raises an interesting question, because the 2nd person inflection and object clitics lexicalize referential properties, possibly undergoing truth conditions. This discrepancy between the counterfactual nature of the imperative and the referential nature of clitics, seems to be the basis of the specialized distribution of clitics in imperative clauses in comparison with declarative ones (Manzini and Savoia 2017).

Let us consider, firstly, the distributional variation we have illustrated in (1)-(3) contrasting 1st person objects, with deictic content, and 3rd person clitics, the DOM (Differential Object Marking) effect. DOM refers to the phenomena whereby certain types of objects are overtly marked (Aissen 2003) based on their referential properties (animacy, definiteness, specificity, topicality) regulating the distribution of grammatical functions in case systems (Comrie 1979, Kiparsky 2008). In our case, DOM is manifested by the special distribution of

the clitics referring to the participants in the discourse. The split between 1st and 3rd clitics seems to reflect their different interpretive status; more precisely, deictic pronouns are able to be interpreted independently of the event they are participants to, on the basis of the discourse universe. 3rd person elements (on a par with nouns) are interpreted in relation to the event introduced by the verb (Manzini and Savoia 2005, 2011).

In order to illustrate this point, we take on the example in (2d') for San Benedetto, *a-m-ni-ε* 'give (pl) me it' in (2c). In addition to the general issue concerning the DOM distribution, obviously we have to account for mesoclisis. The insertion of lexical material between root and inflection has been initially treated in the DM framework by Halle and Marantz (1994), Harris and Halle (2005), as resumed in Arregi and Nevins (2019). Our proposal that morphemes are endowed with interpretable content and that inflectional structures are built in the syntax, allow us to deal with mesoclisis between root and inflection, as in (14), in a natural way. In other words, we can expect that syntax (Merge rule) can force clitics and inflectional morphemes to re-distribute in order to externalize relevant interpretive properties[96].

(14) Imperative force



ε San Benedetto Ullano

In (14) all elements except the verbal root are able to be assigned a truth value. The 1st person clitic *m* 'me' occurs freely in the immediate context of the verbal root, deploying its capability to be interpreted, independently of the verb/ event, directly in relation to the universe of discourse. In the varieties in (1) and (2) it occurs in a position immediately to the right of the root, while in the Shkodër variety (variably also in Gjirokastër and other varieties, cf. (1b")) it precedes the root. In any case it seems to be associated to the Phase of the root, conventionally identifiable with the domain of C.

[96] In the cartographic literature imperative is related to the high positions concerning Speech Act (Speas and Tenny 2003), on a par with other types of pragmatic expressions such as vocatives or discourse devices.

The occurrence of the 3rd person element is, on the contrary, adjacent to v, i.e. the lexicalization of the event. In the Arbëreshë varieties the object clitic follows the inflection *–ni*, while in Shkodër it precedes *–ni*, in mesoclisis, on a par with the position shown by the Gjirokastër variety. We can take it that the distribution of the 3rd person clitic depends on the fact that it needs to be licensed by v, in connection with the eventive domain, as usually. In other words, in the presence of non-veridical operators, definiteness must be lexicalized licencing the pronoun's reference. The reduplicative structures of Shkodër in (3d), e.g. *nεp-ni-i-a-(ni)* 'give (pl) it to him/her', suggest that the two positions are not substantially different, in the sense that *-ni* can be seen both as the inflectional part of the verb, in T, but also as a sort of suppletive lexicalization of v, as in (15).

(15) Imperative force



Clusters *1st person + 3rd person*, as *sil-m-a-ni* 'send (pl) it to me' in (1d') for Gjirokastër, are placed between the root and the inflection. It is reasonable to conclude that the combination with the deictic clitic is sufficient to render the licensing of the 3rd person element possible in the domain of T, as suggested in (16) for Gjirokastër.

(16) Imperative force



In Shkodër clitic string is in preverbal position, as in *m a nεp-ni* 'give (pl) me it', in (17). The deictic clitic is sufficient to license the 3rd person one regardless of the fact that the verbal root has modal non verydical properties. The clitic order in modal contexts corresponds to a particular type of externalization on the basis of the interpretive content of clitics.

(17) Imperative force





Following Roberts (2010) as regards the object clitic in Romance languages, in OCl languages we may deal with OCls as the true head of agreement for v phase97. In this perspective, the OCl in mesoclisis is to be viewed, on a par with the verbal inflection, as an agreement head for vP phase, connected to the special organization of imperatives. If we are on the right track, this explains why both final position (Arbëresh) and internal position in mesoclisis end up externalizing the same type of licensing in the domain of *v*. An interesting point is that in Albanian varieties the clusters *1st/2nd/dative +accusative* select the *a* form of the accusative, as in *sil-m-a-ni* 'give (2nd pl) me it'. In isolation the accusative form for the 3rd singular is generally *ɛ98*. The occurrence of *-a* in internal clusters suggests that in imperatives the sequences *m+a* 'me-it' and *i-a* 'him/her+it', are real clusters, confirming that no Phase boundary is involved between *m/j* and *a*. In other words, clusters appear to be however licensed in the T domain outside of the scope position of the root.

Turning now to the negative contexts, we see that the proclitic occurrence is triggered, Following especially the proposals of Manzini and Savoia (2017: 92), negation can be treated as an operator 'introducing a quantification over the internal argument' of the elementary event VP. This conclusion is supported by numerous facts in which negation and internal argument sintactically interact (Manzini and Savoia 2017). So, the different position of clitics can be related to the fact that in pre-verbal position clitics occur inside the scope of negation. (4'b) example *mas m a nɛp-ni* 'don't tell it to me' from Shkodër.

(18)



[97] Chomsky (2013, 2019) assumes the existence of two phases, CP and vP. The CP phase implies inheritance of features from the phase head C to the lower head T. Furthermore "the inheritance mechanism is simplified if it is generalized to phase heads generally, not restricted to C but extended to v* as well […] Therefore V (or R) must receive φ-features from v*. It follows that just as a nominal phrase can raise to SPEC-T within CP, so it should be able to raise to SPEC-V within v*P" (Chomsky 2007: 20-21) (cf. Richards 2011).

[98] Some Arbëresh varieties, for example the one of Casalvecchio in (2), generalize the form *a* 'her, him, it'.



Shkodër

This analysis allows us to account of the similarities between modal and negative contexts (Manzini and Savoia 2017) in determining scope phenomena, whereby clitics tend to occur in the immediate domain of the operator. A crucial point is that negation and modal verb contexts (imperatives, questions) are core instances of what Giannakidou (1998, 2011) calls non-veridical contexts "veridicality is a property of sentence embedding functions: such a function *F* is veridical if *Fp* entails or presupposes the truth of *p*. If inference to the truth of *p* under *F* is not possible, *F* is nonveridical" (Giannakidou 2011: 1674). This unification of negation and V-in-C makes a predicttion, namely that all (and only) non veridical contexts (subject to appropriate restrictions) favor a possibly transparent order (o, in certain Romance varieties, types of allomorphy, cf. Manzini and Savoia 2017).

X. Conclusions

This contribution has addressed the distribution of OCls in connection to the externalization of the modal properties of imperative and negation. We have analyzed the imperative as associated to the expression of the pragmatic force and the speech act restrictions, whereby the imperative verb occurs in initial position taking into its scope the clitics and the event. The form of the verb, coinciding with the root in the singular and, at least in a subset of contexts, also in the plural (in mesoclisis contexts), externalizes the non-veridical nature of the imperative sentences, in the sense that the imperative corresponds to the only predicative content of the verb.

The distributional split between 1st person clitics and 3rd person ones suggests they implies different interpretive properties: 1st person clitics are interpretable on their own, on the basis of their deictic properties referring to the participants to linguistic act. This explains why they, while occurring in the direct domain of the imperative operator, keep being fully interpretable. On the contrary, 3rd person object clitics are positioned on the right of the verb and, specifically, of the 2nd plural morphology, so reflecting the necessity for 3rd person

elements to be licensed in relation to the event (v) that selects them.

References

Aikhenvald, Alexandra Y. 2010. *Imperatives and Commands*. Oxford University Press.

Aissen, Judith. 2003. Differential object marking: iconicity vs. economy. *Natural Language & Linguistic Theory* 21, 435–483.

Alcázar, Asier and Mario Saltarelli. 2004. *The syntax of imperatives*. Cambridge: Cambridge University Press.

Baldi, Benedetta, and Savoia, Leonardo M. 2018. Morphosyntactic Reorganization Phenomena in Arbëresh Dialects: The Neuter. *Quaderni di Linguistica e Studi Orientali QULSO*, 4, 109-130

Chomsky, Noam 2013. Problems of projection. *Lingua* 130, 33-49.

Chomsky, Noam, Gallego, Ángel, and Ott, Dennis. 2019. Generative Grammar and the Faculty of Language: Insights, Questions, and Challenges. *Catalan Journal of Linguistics. Special issue*, 229-261.

Comrie, Bernard. 1979. Definite and animate direct objects: A natural class. *Linguistica silesiana* 3. 13–21.

Giannakidou, Anastasia. 1998. *Polarity Sensitivity as (Non)Veridical Dependency*. Amsterdam: John Benjamins.

Giannakidou, Anastasia, 2011. Negative and positive polarity items. In Klaus von Heusinger, Claudia Maienborn and PaulPortner (Eds.), *Semantics: an international handbook of natural language meaning*, Volume 2 (pp. 1660–1712). Berlin: Mouton de Gruyter.

Halle, Morris, and Marantz, Alec. 1994. Some Key Features of Distributed Morphology. In: Andrew Carnie, Heidi Harley and Tony Bures (Eds.), *Papers on Phonology and Morphology*, 275-288. *MIT Working Papers in Linguistics 21*.

Harris, James and Morris, Halle. 2005. Unexpected plural inflections in Spanish: Reduplication and Metathesis. *Linguistic Inquiry* 36, 195-222.

Kiparsky, Paul. 2008. Universals Constrain Change; Change Results in Typological Generalizations. In Jeff Good (ed.), *Linguistic Universals and Language Change*, 23-53. Oxford: Oxford University Press.

Manzini, M. Rita and Savoia, Leonardo M. 2005. *I dialetti italiani e romanci. Morfosintassi generativa.* Alessandria: Edizioni dell'Orso.

Manzini, M. Rita and Savoia, Leonardo M. 2007. *A Unification of Morphology and Syntax. Investigations into Romance and Albanian dialects*. London: Routledge.

Manzini, M. Rita and Savoia, Leonardo M. 2011. Mesoclisis in the imperative: Phonology, morphology or syntax?. *Lingua*, 121, 1101-1120.

Manzini, M. Rita and Savoia, Leonardo M. 2017. Enclisis/Proclisis Alternations in Romance: Allomorphies and (Re)Ordering. *Transactions of the Philological Society*, 115, 98-136.

Manzini, M. Rita and Savoia, Leonardo M. 2018. *The Morphosyntax of Albanian and Aromanian Varieties*. Berlin/ Boston: De Gruyter Mouton

Marantz, Alec. 1997. No escape from syntax: Don't try morphological analysis in the privacy of your own lexicon. *University of Pennsylvania Working Papers in Linguistics* 4. 201–25.

Mauck, Simon and Zanuttini, Raffaella. 2005. The subjects of English imperatives. In Corinne Brandstetter and Dominik Rus (Eds.), *Georgetown University working papers in theoretical linguistics*. (Vol. IV, pp. 53–85). Washington, DC: Georgetown University Department of Linguistics.

Platzack, Christer and Rosengren, Inger. 1998. On the subject of imperatives: A minimalist

account of the imperative clause. *The Journal of Comparative Germanic Linguistics* 1: 177–224,

Portner, Paul. 2004. The Semantics of Imperatives within a Theory of Clause Types. In Robert Young (Ed.), *SALT*, XIV 235-252, Ithaca, NY: Cornell University.

Roberts, Ian. 2010. *Agreement and Head Movement*. Cambridge, The MIT Press.

Savoia, Leonardo M., Baldi, Benedetta and Manzini, M. Rita 2018. Sigmatic plurals in Romance varieties spoken in Italy and their interaction with -i plurals. *LINGBAW*, 4, 141-160.

Savoia, Leonardo M., Manzini, M. Rita, Franco, Ludovico and Baldi, Benedetta. 2017. Nominal Evaluative Suffixes in Italian. In D'Alessandro, Roberta, Innàccaro, Gabriele, Passino, Diana and Thornton Anna M. (Eds.), *Di tutti i colori. Studi linguistici per Maria Grossmann* (pp. 283-300). Utrecht: Utrecht University Press.

Speas, Peggy, and Tenny, Carol. 2003. Configurational Properties of Point of View Roles. In DiSciullo, Anna (Ed.), *Asymmetry in Grammar* (pp. 315-344). Amsterdam: John Benjamins.

Zanuttini, Raffaella. 2008. Encoding the addressee in the syntax: evidence from English imperative subjects. *Natural Languages and Linguist Theory*, 26:185–218.

John TRUMPER, Cosenza

THE ROLE OF ALBANOID GROUPS (ALBANIAN AND ITALOALBANIAN) IN LANGUAGE TRANSMISSION (ITALY AND CALABRIA AS EXEMPLUM)

Abstract. Lo Sprachbund balcanico, concetto elaborato per primo in Kopitar (1829), Schleicher (1850) e Miklosich (1861, 1870), è dato fino agli anni '90 del secolo scorso come un insieme di relazioni speciali determinato dai tratti: (1) sistemi vocalici con vocali centrali quali /ɨ/ o/e /ə/; (2) equivalenza morfologica tra il genitivo e il dativo; (3) la posposizione dell'aggettivo rispetto al sostantivo qualificato; (4) la creazione di comparative e superlative analitici; (5) l'organizzazione locative dei numeri da 11 a 19; (6) la perdita dell'infinitivo; (7) la creazione del futuro perifrastico; (8) oggetti 'doppi'; (9) pronomi enclitici diventano meri possessivi. Comunque, la maggior parte dei tratti individuati sono presenti in altri gruppi linguistici (anche indoeuropei) sia vicini sia lontani, tratto (1) in celtico e iranico, marginalmente in germanico, (2) in troppi gruppi da esser rimarcato, (3) in tutto il celtico ed altri gruppi (in genere 1 o 2 aggettivi solo possono precedere per creare una specie di composizione), (4) è presente in romanzo (panromanzo), marginalmente in germanico, (5) è un processo tipicamente celtico e non solo balcanico (uno-su-dieci ecc.), (6) è presente soltanto nello slavo più orientale e meridionale (i dialetti della Slavonia presentano problemi), le lingue celtiche non hanno mai esplorato le possibilità di una categoria morfologica e semantica da etichettare 'infinitivo' (ci sono verbi nominalizzati ma non con un unico marcatore morfologico), (7) il 'futuro' non è una categoria temporale bensì modale che troppe lingue costruiscono perifrasticamente. Caratteristiche 9 (e 10) andrebbero discusse in maniera più approfondita di quanto non sia lecito qui.
Key words: sprachbund. language indices. contact linguistics. albanian- byzantine greek- slav- s. italian romance.

One of the great debates in the Eighteen and Nineteen Hundreds concerns the question of the validity of the existence of a Balkan 'Sprachbund', replacing the earlier substratum theories of Kopitar (1829), Schleicher (1850) and Miklosich (1861). Without disturbing overmuch historical authors such as Meyer, Weigand, or Sandfeld, but taking into reasonable account the contributions of authors such as Çabej, Rosetti or Hamp, I try to broaden out the field into the problem of 'Sprachmischung' and the intricacies of Contact Linguistics.

Up to the Nineteen Nineties (see Banfi 1991, Wolf 1995) the 'special' relations between the various 'Balkan Languages' were considered assessable in terms of nine characteristics which seemed to have the properties of structuralism's distinctive features, namely (1) the creation of vowel

sub-systems involving central vowels such as /ɨ/ or /ə/ (even rounded congeners /ʉ/ or /ɵ/ for that matter); (2) total morphological equivalence between Genitive and Dative case markers; (3) the post-position of adjectives in the NP; (4) the creation of analytical comparatives and superlatives; (5) the locative organization of numbers from 11 to 19; (6) the loss (or even non-creation) of an infinitive category and the lack of infinitival strategies; (7) the creation of a periphrastic future; (8) double objects; (9) the reduction of enclitic pronouns to mere possessives. Many such features often miss the mark because they are present in spatially near IE language groups (sometimes in not so far-off non-IE groupings) and seem accordingly to represent something different from a 'Sprachbund', viz. trend similarities due to a common 'linguistic' trigger. Take as example the first 'feature'. Although present in S. Slav (Bulgarian), Balkan Romance (Rumanian) and Albanoid (Tosk Albanian, Italoalbanian), the historical and present-day presence of similar shifts is also witnessed in the most southerly group of N. Slav (Ukrainian develops a phoneme /ɨ/ after the loss of the palatal vs. non palatal consonant opposition), in Brythonic Celtic and the most western varieties of E. Iranic (Ossetic etc.). It seems to involve, in most cases, the gradual centralization shift of historical ĭ and ŭ, sometimes the graded fronting of ū which effectively kept in this way its 'high' position (i.e. ū > ʉ, which may either lose its lip rounding becoming /ɨ/, as in Welsh, or eventually be fronted to /y/, as in Breton and Old Cornish). It is observed in some Afro-asiatic languages (Amharic and Ge'ez in Ethiopia), while the creation of ū > ʉ is observed in N. Germanic (Scandinavian), ŭ > ɵ > ʌ > modern ʊ in Anglo-Frisian W. Germanic (English: with specific cases of length loss in ū this creates a new /ʊ ~ ʊ/ RP/ EE opposition in put, book, took, look, rook, regional roof vs. putt, buck, tuck, luck, ruck, rough etc.). On the other hand only extreme N. Greek dialects observe this sort of shift, while mainstream Greek and the most southern dialects certainly do not. On this score one might have added as more pertinent a feature (10) the opposition between stress-timed languages vs. syllable-timed languages. The destructive effects of stress-timing are known historically in Slav, well known in all Albanoid varieties in all periods, as well as in N. Greece and Cappodocian Greek. Unfortunately stress-timing effects with vowel and syllable reduction are also well known throughout Celtic, Germanic and Iranic, even in Galloromance and Galloitalic dialects (Piedmont's and Emilia's dialects), as well as in nearby Afro-asiatic languages and dialects.

Even a banal morphological feature involving composition such as (5), though common to all languages of the postulated Balkan 'Sprachbund', is also usual composition in other IE languages: it is common to all Celtic languages viâ the use of an *ON* preposition (cp. Welsh *un-ar-ddeg, tri-ar-ddeg, un-ar-bymtheg, dau-ar-bymtheg, tri-ar-bymtheg, pedwar-ar-bymtheg* with respect to true composition in 12, *deuddeg*, and 15, *pymtheg*).

Even if we take a pragmo-syntactic feature such as (6), we find Slavonia, Montenegro, Croatia and some extreme western varieties of Serb cut off from more eastern varieties of Serb as well as Macedonian and Bulgarian, as well as other problems. It is true that non-infinitival strategies characterize Tosk (but NOT Geg with its me + Gerund infinitive category), mainstream Serb and Bulgarian, Rumanian and all modern Greek varieties. On the other hand, it would be difficult on this score to exclude Salento Romance as well as Middle and Southern Calabrian Romance, from any possible Balkan Sprachbund (Calabrese, Trumper, Rizzi, Ledgeway). Even extreme southern N. Calabrian as well as extreme northern Mid Calabria (on the Ionian coast from Crucoli down to Crotone) avoid infinitival strategies, not using *[m]u/ [m]i/ ma* (< mŏdō ŭt) but *unni* (< ŭnde, hinted at in Rohlfs), already reduced to *un'* or *nu'* in dialect poetry from the Sixteen Hundreds on (Trumper, Prantera). Similar strategies exist in ancient Sabellic (Oscan, pre-Roman) with *púd, púz* (regular with respect to Latin ŭt, all from a relative *K^{w}U-D-), though this did not imply the abandonment of a nominalized infinitive in the Accusative (*múltaúm, deicúm/ ezúm, herníúm*). It might also be noted that similar problems (presence/ absence of infinitival strategies) exist in the Slav dialects of Slavonia and Montenegro, while no Celtic language has ever developed any recognizable morphological infinitive but only what historical Celtic Grammar labels 'Verb-Nouns', which have no unique morphological formation. However, a Nominal strategy is classically used where other languages use a non-infinitival strategy (English *I know [that] he is telling the truth, I knew [that] he was telling the truth*, compared with Welsh *Gwn ei fod yn dwêd y gwir/ y gwirionedd* [lit. his 'telling' of the truth], past tense *Gwybum iddo ddwêd y gwir/ y gwirionedd* [lit. to-him 'telling' of the truth]). Scholars might have added a further feature (12) relativization strategies, with restrictive/ non restrictive relatives, but they seem to have gone unnoticed.

Various scholars, including myself, have argued that the relative lack of a sea and nautical lexicon in Albanian indicates a Middle-European

landlocked Urheimat and a gradual flight towards the south to avoid Slav invasions southwards in the Middle Ages. Albanian place names seem also to indicate Slav origins, therefore invasion, ex. Berat (< Велград). On one hand we have shown (Trumper 2002, 2005) that plant-names studied in Albanian Tosk have more than 60% indigenous elements, more than 25% Byzantine sources but almost 12% Slav borrowings, while their Italo-Albanian equivalents have slightly less than 40% indigenous elements, slightly more than 30% Byzantine loans, with more than 30% Latin or Romance elements, almost zero Slav phytonymic elements (one or two elements). This would imply greater Slav pressure on Albanian Geg and Tosk than on the 14th century Tosk (Llabëria, Epiro, later Morea in Greece) that generated Italo-Albanian dialects. This does not imply that there are no old Slav elements in Italian Arbëreshë, as Guyon 1909, Desnickaja 1963, Çabej and Hamp 1970 had already underscored, for example *bosht* (spindle), *daltë* (chisel), *falem* (bow; pray), *fingjill* (for *thingjill*, coal), *gozhd* (nail), *gobaçe/ gobacë* (firewood), *gorricë* (wild pear), *kyç* (for *klyç*, key), *lopatë* (shovel), *mbrazënj* (to empty), *petkùa* (horseshoe), *police* (hearth), *porosì/ porosimë* (order, command), verb *porosìtënj*, *prak* (*praku*, threshold) and *pushkë* (shotgun), *vëzhgonj* (other Tosk *vëzhdonj*, to look for), we add *kozlić* (Guyon 1909, kid > Byzantine κατσίκιον > Salento Greek κατσίκι, Arb. *kaciq*, *kacaniq*), all present in Arbëreshë. Of all the cases mentioned in Jokl 1923, many are limited to Geg dialects, though cases such as *stan*, *stani* (sheepfold; hut, shepherd's refuge: already late Byzantine, Proto Modern Greek στάν[ν]ιον, as in Agapius of Crete and other Geoponica), *stullpë* (group; herd), and *vidë/ vidhez* (dove), present in Arbëreshë, will have to be discussed. Hamp 1970 adds other cases present in Arvanitika Tosk (Greece) such as *briskë* (razor), *gërdëlàn* (pharynx), *kos* (curdled milk), *vedrë* (milk pail), and so on, including *shklerisht* (in the Greek manner), semantically distinct from Arbëreshë *shklavun* (Slav, Serb, Bulgar). Similar derivatives from this last base seem, however, to be more common in Calabrian Greek via Byzantium (σκλαβήνα, mantle of rough cloth, originally military; *σκλαβωνίσκος referred to dark colours), Calabro-Romance *schjavina/ ščavina*, primitive coverlet, *schjavuniscu/ ščavunìscu* (dark-coloured). They are all formally interesting and significant. Some of these seem not to have passed through Byzantine Greek, even the γορότζια of various Glossaries, which, though similar to *gorricë*, seems to mean Vitis alba and cannot, thus, be the transmitting element. We might also add here

Arbëreshë *kulaç*, *karkaveç* (var. *kastravec*), *koritë* (trough), *kral* (tyrant), alongside *kurvë* (prostitute) already quoted, even *shklavun* (Slav, *ut sup*.), some of which pass into Calabrian dialect, like *cullacciu*, or in the 5th case reinforced by Italo-Greek κοῦρβα (now relegated in Calabria to the surname *Corvace*). In some cases Slav elements pass into both Middle Greek and Albanian and it is difficult to say whether their passage into Calabrian Romance is due to Byzantine contacts in the period 700-1060 or early Albanian. Such cases are вава/ вавас, ваган, влато (mud), грава (hole, depression), коравь (boat), кувель (bee swarm; bee hive), сёнь (hay), снть (sieve), which appear in Middle Greek and its Italo-Greek varieties (βαβάς, βάγανον = γάβανον with dim. γαβάνιον, βάλτα -ον, γράβα, καράβιον, κουβέλιον, σανός, σίτα), in Arbëreshë (*babat/ babazun, govatë* [obviously retransmitted by the Greek metathetic form, perhaps from an earlier *gova-në], *baltë, graverë, karavë, kuvele, sanua/ sanòt, sitë*), but also, more to the point, even in Calabrian Romance (*babbu/ babbanu, vàganu/ bb-/ bbà-ünu* alongside *gàvanu*, place name Vurtù < βαλτῶδης, *grava* > *gravinu/ garvinu*, mushroom type named from its habitat, *garavìellu*, place name Cuvèḍḍi, *sanènu -a/ z-/ zanèja* Trigonella sp., Melilotus sp., *sita/ sitèḍḍa*, sieve). These 7-8 elements are at odds with what Caracausi had claimed as extraneous Slav (1 item + -ica morph), even Rohlfs (2 items + morph). There are some rare cases where Slav elements pass into Italo-Greek, sometimes local Romance, but apparently not into Arbëreshë, e.g. кора > κουράδιον, куна > κούνα/ κουνέḍḍα/ κουνακούτσι[ον], логх > λόγχος (also Calabrian Romance place names, woods called Longhi near Castrovillari etc.), рухо > ροῦχον -α. There are also cases where Slavisms pass into Albanian/ Arbëreshë, transmitted perhaps by Middle Greek, but are absent from Italo-Greek & Calabro-Romance, e.g. the case of *zakon, zakoni/ zakonë*, derived verb *zakonem*, Byzantine ζάκανον, ζακόνιον (Constantine Porphyrogenitus, De Adm. Imp.) or Middle Greek βογάτος, Albanian *i bëgatë* (rich), Middle Greek βοϊλᾶς, βολιάδες, Alb. *bular, bujar*, and so on. What is interesting is that in the midst of all these contact loans we even find Slav *karan* (? > Byzantine καράνος > ?) > East Sicilian *caràn*u, Albanian *derk* (*derku*, pig) > *derco* as an in insult in the Stratioti speech of 15th/ 16th century Venetian comedy (Calmo etc.), and *rikëz* (piglet) >12th-13th century Italo-Greek ῥέκκος (Trinchera) > modern Salento Greek ρέκκο. In a similar vein is jargon Albanian *arbër, arbën*, shepherd (< older

arben-) that passes into Calabrian trade slang *erbàru* [trade master, pronounced ərb'əru, erb'əru], which is then promulgated in other regional slangs as *arvar[o]* (Marche), *ravâr* (Friuli) etc. DISCUSSION.

The absence of Turkish elements that pass into the Albanian, Rumanian and Calabro-/ Siculo-Romance (apart from eşek > Sicilian *scèccu,* considered a hapax, though present around RC and along the whole Tyrrhenian coast up to Pizzo, though in a marine sense, *scecch'i mari = ciucci'i mari*), once accepted as axiomatic, has now been gainsaid in Mandalà 2003, Trumper 2007, and in successive studies. I propose a study of Turkish čāba, jāba (useless, Räsänen 176) [ζάμβα/ ζάμπα, Calabrian *zàmparu, zàmbu*, Arb. *càmbar*]; jumak/ jumbulak (< jum- round object, knob, Räsänen 210) [τζόμπος, Cal. *źumbu, źumpu*]; jasy (fat & useless, Räsänen 191) [τζάσ[σ]ος –α, Cal. *źassu –a*]; čaruk, čaryk (type of shoe, Räsänen 101) [τζαρούκιον, τζαρύκιον, Cal. *zarìcchja -e*, Arb. *cariqe*]; čoha (wedding dress, Räsänen 114, who argues for a Persian origin?) [τσόχα, Crotonese Cal. *zòca*, Arb. *cohë*]; Arabic fatīl > Turkish fitil (with vowel harmony) [πιτέλα, Cal. *pitèla*, Arb. *fitil*]; hanjar (Räsänen 155, re-transmitting an Arabism) [Cal. *cangiarru*,]; kota, kotan etc. (Räsänen 284) [κατοῦνα, Cal. place name Catona/ Catuna, Arb. *katunt, katundi*]; maγara, maara (Räsänen 320, probably retransmitting Arabic mağāra) [μαγάρον, μαγαρίζω, Cal. *magàru*, brasier cover/ damper, Arb. *magàrem, magàrtur* rather than a μάγος, Cal. *magara* source]; satyr, satïr (butcher's knife, Räsänen 405) [σατήριον, σατύριον, Cal. *saturi*, Arb. *satur*]; şaban (negative epithet of animals that have become useless, Räsänen 439) [Cal. *sciabbànu –a*, Arb. *shaban*]; taγar (Räsänen 454) [ταγάριον, Salento Romance *tacàru/ taàru*]. These are only a dozen cases.

DISCUSSION, ADDING OTHER CASES.

What is surprising is the presence of at least 38 Iranian items, presumably transmitted by Byzantium as the result of commercial and military contacts, some of which [3-4] origin were Arabic but have been re-transmitted by Iranian sources into the Byzantine lexicon. Examples are:

(1) āzād (free; unmarried, Horn p. 6 n. 19, Italo-Greek άζάτης, Arb. *axat*). (2) bāzār (emporium, Hornm p. 38 n. 168, Italo-Greek παζάριον, παζαριότης, Cal. *bbaźźariùotu*, Arb. *bazar* [Venice *bazariòto*). (3) çapū-k- > çabūk, sabūk, greedy or stupid, Asbaghi 153, Italo-Greek τσαβούκκης,

Cypriot τσαπούκκης, Cal, *ciavùccu, ’ngiavuccari –atu,* Arb. *çavuk*). (4) čante-, čante-k (sack, > σάνδυξ, σανδύκιον > σεντούκιον, Italo-Greek σεντούκι, Arb. senduq). (5) gebr (wild goat, X Arab. kāfir, Horn pp. 209-210, n. 938, κιαούρ, κιαβούρ, γγιαούρος, Cal. *źagurru, źagurdu, źavurdu, ’nźavurdari,* Arb. *xavardarënj*). (6) kandan, kenden (dig; dig holes > hole; furrow, Horn p. 194 n. 861, χάνδαξ, χανδάκιον, Cal. *candàci,* Arb. *handak, handaku*: the presence of velar fricatives may imply the passage Iranian > Turkish > Greek). (7) kanduš, kunduš, short dress, shirt (< kūt-, kūnd-, short, Horn p. 194 n. 871, καντούσιον, κοντόσιον, Cal. *cantùsciu,* Arb. *kandush*). (8) karkas var. kerkes (bird of prey, > late Byzantine κάργα, Horn p. 189 n. 849, Cal. *carraggiàu*). (9) kūze (Horn p. 194, n. 872, < Avestan χawza-, κουζίον, Cal. *cuzzìu*). (10) χāō, χān[i] (spring, water source, fountain, Horn p. 102 n. 459, Italo-Greek χάνος, cloaca, drain, Apulo-Romance *fanə* id.). (11) ma- ’sara (Iranic nominalization of an Arabic verb, unknown morphological outcome in Arabic, μασούριον, Cal. *masùli, masùdi,* Arb. *masur*). (12) pā-puš[an] (Horn p. 63 n. 281 pā[ī] < Avestan pāδa-, foot, παπούτζιον –ια, Cal. *papuscia, papusci,* Arb. *papush,* cp. Ven. *papusse*). (13) siper-, cover, shield, Horn p. 155 n. 700, Ancient Gr. σίφαρος, Middle Gr. τσίππα, τσήππα, Cal. *zippa,* omentum, Arb. *cepë* id.). (14) šarp < šan[a]p-, čarp/ čerb (Horn p. 97 n. 436, σιανάπ[π]η, Cal. *scirubbètta* [helped by Arabic šarūb], Arb. *shrapë*). (15) kšīr[a] > šīr but Ossetic [a]χšīr whey (Horn p. 178 n. 681, τσῆρος, Arb. *hirr,* though the second may be congener), (16) šubān (< fšu-pāna, Horn p. 171 n. 776, τσοπάνος, Arb. *çoban, coban,* shepherd, goatherd). (17) zahr, zehr, poison, pāzehr (Horn p. 150 n. 578 < Avestan zaθraka-, Asbaghi 22, 91, 107, Byzantine and Italo-Greek ζαργάρα, poison, poisonous plant, Cal. *źargàra* -u, Arb. *xarë, zarë*). (18) Iranian zambīl mediates Arabic zambīl, into Turkish zimbil (with vowel harmony), Byzantine ζεμβίλιον, ζιμπίλιον, Italo-Greek ζεμπίλι, Cal. *źummĭlə/ źimbili,* Arb. *ximbìl –i*). (19) zānū- (knee) > Pahlavi zānūk (Horn p. 144 n. 648bis, knee-length boot, Byzantine and Italo-Greek τζάγγα, τζαγκίον > τζαγγάρης, cobbler, 2. uncouth, Cal. *źangàrru*, uncouth, bumpkin). (20) zīrek, jug, vase (Horn p. 151 n. 681, < Avestan jīra- id., Byzantine and Italo-Greek τζίρρος, Cal. *źirru,* 1. vase, 2. young tuna, Arb. *xirr, xirri,* sometimes said to be of Arab origin, but the Arab is an Iranian loan).

DISCUSSION OF THESE AND OTHER 18 LEXEMES (IRANIAN CONTACT LOANS ETC.) WITH IMPLICATIONS.

Conclusion: All the analyses proposed and the level of language-mixing seem to point to a model that Guillou 1989 and Burgarella 1989 discussing pre-Norman Calabria call a '*civilisation mixte*' situation. Obviously using only lexical or lexico-semantic findings – though we also introduce morphological and pragmo-syntactic indicators – it is perhaps methodologically incorrect to insist on a cause-and-effect model, which insists that more lexicon absorbed by the host language or languages implies a more in-depth contact between the codes involved. This is undoubtedly true (McDonald 2015, re-iterating perhaps Sayers 2001), but all more recent contributions, including those of Sayers himself on lexical borrowings and calques, demonstrate that a statistical relation between codes involving lexico-semantic, morphological, phonological and pragmo-syntactic markers constitutes a good index of contact types. In other words two objectives can be reached: (1) real statistical studies can now begin, (2) 19th -20th century substratum and 20th century Sprachbund can now be satisfactorily replaced by contact typologies involving the concept of a centuries long mixed civilization model.

Sabri HAMITI, Prishtinë

ERNEST KOLIQI: "SHÊJZAT" E LETËRSISË SHQIPE

Hommage Ernest Koliqit

Abstrakt. Ernest Koliqi (1903-1975), në vitet '20 e '30 të shekullit 20 u artikulua e u bë i njohur si shkrimtar; në vitet '40, '50 e '60 të atij shekulli, u shqua më tepër si profesor universiteti e si studiues i letërsisë shqipe. Studimet e tij letrare u botuan kryesisht në revistën e tij "Shêjzat", e vetëm pastaj në vëllime të veçanta gjatë jetës së tij e edhe pas vdekjes; duke synuar trajtimin e letërsisë shqipe në tërësinë e saj.
Theksimi i Koliqit "Na mungon njí historí e letërsís shqipe" dhe insistimi "Jemi gjithënji në pritje të njí historíje të letërsís shqipe" mban të gjallë dëshirën dhe insistimin që të shkruhet kjo "historí", qoftë edhe nga dora e tij. Koliqi mëtoi një histori të letërsisë shqipe, por nuk mbërriti ta shkruajë, porse artikuloi kriteret themelore të saj: pjesëtimet e saj në nivelin kronologjik (koha) e në vështrimin tipologjik (hapësira), duke u përqendruar në leximin estetik, edhe si lexim të mbrendshëm relacional. Pra, ai krijoi premisa teorike letrare për një vepër sistematike nëpërmjet koncepteve: Qarqe, Shkolla, Ujdhesa, rryma, degëzime, krahina, gjithmonë *letrare*. Dhe kjo, përfundimisht për të pasur një vepër gjithëpërfshirëse të letërsisë shqipe.
Teorinë e integralitetit të letërsisë shqipe ai e bën vepër duke e trajtuar *Letërsinë e Kosovës* si degë letrare përbërëse të letërsisë shqipe, jo më vetëm si pretendim teorik, por shumë më thellë, si interpretim të saj letrar e estetik në koordinatat e historisë së letërsisë shqipe. Leximi e interpretimi i tij ndalet në autorë, në vepra e në fenomene karakteristike të kësaj letërsie. Mtim që në trajtë jehone do të shfaqet te autoritete letrare të diasporës shqiptare si Namik Resuli, Zef Skiroi e Arshi Pipa, por jo edhe te autoritetet letrare në Shqipëri, si Dhimitër Shuteriqi e ndjekësit e tij. Teoria e integralitetit e Koliqit mbështetet në leximin e interpretimin e *tekstit* e të *kontekstit* letrar, përkundrejt ngushtimit ideologjik letrar, që prodhon "përjashtime" e "zëvendësime". Kjo trashëgimi kulturore e letrare e Koliqit, do të bëhet prodhimtare në vitet e mëvonshme, në replikat e mëdha të Rexhep Qosjes (te romantizmi) të Ibrahim Rugovës (te letërsia e vjetër) të autorit të këtyre rreshtave (te letërsia filobiblike e letërsia moderne) e të Nysret Krasniqit (te letërsia e Kosovës). Këto tema të hapura, në nivel të interpretimit letrar dhe të kanonizimit letrar do të mbeten trashëgimi e çmueshme përpara historianit të ardhshëm të letërsisë shqipe.
Fjalët çelës: Historia e letërsisë, Shkollat letrare, Qarqet letrare, Rrymat letrare, Ujdhesat letrare, Degët letrare, Poetët e mëdhenj, Poetët dytësorë, "Albania" e Konicës, Letërsia e Kosovës.

I. HISTORIA E LETËRSISË
1. Historia

"Na mungon njí historí e letërsís shqipe. Énde s'ka dalun nji vepër qi të përmbledhi në vete zhvillimin t'onë letrar e ditunuer në valle të shekujvet"[1], thekson Ernest Koliqi në fillim e në fund, duke kërkuar një "histori organike" të letërsisë shqipe. Mirëpo, vlerësimi i lartë i përpjekjeve të përparshme bëhet duke i diskutuar në themel të çështjes. Koliqi thekson që vepra e Papas Gaetano Petrotës (1931) *Popull, Gjuhë e Letërsi Shqipe*, "Âsht nji enciklopedi e prodhimit t'onë letrar dhe nji panoramë e çmueshme e studimeve albanologjike"[2]. Veprën *Letratyra shqype* (1925) të Justin Rrotës e sheh si përpjekje të lavdueshme, "por me plot gjymtime per sa i perket analyzës estetike të veprave".[3] Veprës së Eqrem Çabejt *Për Gjenezën e Literatyrës shqipe* (1938) "S'mund i mohohet ndjekja e nji kriteri të shtrëngueshëm logjik qi ndihmon shum me pjestue mbarë e mirë zhvillimin e letërsís s'onë"[4], duke pasur parasysh ndarjen në katër qarqe kulturore e letrare: Qarku katolik i Shqipnís së Veriut, Qarku italo-shqiptar, Qarku Ortodoks i Shqipnís Jugore dhe literatura kombëtare e shek. 19. "Nji paraqitje shum mâ e mirë e fazave të ndryshme letrare në rend kronologjik âsht antologjia *Shkrimtarët shqiptarë* (1941)"[5], thekson Koliqi për veprën dyvëllimshe, të punuar nën kujdesin e tij e të Namik Resulit. Koliqi lë në heshtje botimet në Shqipëri mbas vitit 1945, që kanë merita të pakontestueshme, por "frymëzohen me kritere qi s'kanë të bâjnë kurrsesi me letërsí".[6]

Autori shqyrton problemin e ndarjes apo të pjesëtimit të letërsisë shqipe në vështrimin kohor e hapësinor, duke përdorur termin (nocionin) *ujdhesa letrare*, të cilat komunikojnë pak ndërmjet vetes në letërsinë shqipe. Prandaj, kërkon variante të ndërthurjes së komponentës kronologjike me komponentën tipologjike. Tashmë jemi në dialogun teorik letrar e historik ndërmjet *Qarqeve* të Çabejt e *Shkollave* të vetë Koliqit. "Letërsia e qarqeve énde nuk i ka derdhun të gjitha hiret e veta në qandrrën e letërsís kombtare".[7] Prandaj, gjithë ai vlerësim i madh i revistës "Albania" të Konicës, që për herë të parë boton në të njëjtin vëllim letërsinë gege, toske e arbëreshe, duke bërë të mundshëm komunikimin

---

[1] Ernest Koliqi, Vepra 5, *Syzime letrare*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 17.
2 Po aty, f. 18.
3 Po aty, f. 18.
4 Po aty, f. 19.
5 Po aty, f. 18.
6 Po aty, f. 14.
7 Po aty, f. 20.

e mbrendshëm letrar. Pokështu vlerësimi për *Anologjinë e lirikës shqipe* (1965) të Koliqit, sikur dhe funksionin e dy vëllimeve *Shkrimtarët shqiptarë* (1941).

2. Qarqet letrare/Shkollat letrare

Ujdhesat letrare lidhen (komunikojnë) nëpërmjet *Rrymave letrare*. Është proces letrar historik e stilistik për krijimin e vlerave estetike kombëtare. Koliqi mendon që qarqet kulturore letrare të Çabejt, si "parakombëtare" janë të dukshme edhe në shekullin 19, madje në të 20-in**.** Dhe ato sublimohen me Jeronim de Radën, Naim Frashërin e Gjergj Fishtën, si zhvillime të kulturës letrare së mbrendshmi dhe me komunikimet kulturore e letrare të jashtme. Madje, me elipsat poetiko-filozofike simbas rendit: *Ëndërrim, Lutje, Kushtrim*. Po filli i zgjidhjes së enigmës letrare shqipe kërkohet në ballafaqimin, më mirë, ndërhyrjen e kuvendimit letrar ndërmjet qarqeve e shkollave.

"Dy shkollat letrare shkodrane", ndoshta sprova më e sistemuar letrare e Ernest Koliqit (vitet 1955 e pas) në fakt ngriten mbi *humusin* e *eterin* letrar të qarkut katolik të veriut. Autori pati shkruar që "ky mund të njehet skeleti i nji vepre mâ të vëllimshme historije të letërsís, po që mjerisht mbet pa u krye".[8] Pra, po hyjmë në vallen e diskutimit letrar të modernitetit që rimerr e zbulon brendësinë letrare dhe historinë e saj. "Fjalën a skâjin *shkollë* këtu e përdorim në vështrim si *rrymbë*".[9]

Shkolla letrare e Jezuitëve, e prirë nga Anton Xanoni, kulmoi në letërsinë shqipe me poetin klasik, Ndre Mjedja, që u pushtua nga "disiplina e artit" e "kulti i trajtës". Shkolla letrare e Françeskajvet, e prirë nga Leonard de Martini u kurorëzua me epikun më të madh shqiptar, Gjergj Fishtën, që në kryeveprën e vet ngjizi palcën e kombit e të shqipes, mbështetur në idiomën shqiptare. Këta patën dhe autorët dytësorë: të parët Kolë Thaçin e Luigj Gurakuqin, të dytët Vinçenz Prendushin e Anton Harapin.

Porse, kur shkolla cilësohet si rrymë, atëherë komunikimi shpie tutje në letërsinë shqipe. Duke përimtuar format e stilet bëhen përafrimet e letrarëve modernë shqiptarë, përtej qarqeve. Në këtë vështrim, Koliqi saktëson:

a) Mjedja është më afër Zef Skiroit se Fishtës;

b) Koliqi është më afër Lasgush Poradecit se Prendushit e Palajt;

c) Shantoja në prozë është më afër Konicës se Anton Harapit.[10]

---

[8] Po aty, f. 13.
[9] Po aty, f. 21.
[10] Po aty, f. 15.

3. Poetët e mëdhenj

Në eseun (sprovën) tashmë klasik, Koliqi skajon poetët e mëdhenj të letërsisë shqipe: Jeronim de Radën, Naim Frashërin e Gjergj Fishtën, duke i parë si poetë nacionalë, njëherësh dhe sublimues të kulturave letrare shqipe që vënë në funksion letrar fizikën e metafizikën e kombit me përbërjen letrare të kulturës, besimit e dialektit. Qanrrat e kanonit letrar klasik, po themi duke përdorur figurën e Koliqit. Mirëpo, vetë Koliqi këmbëngul e argumenton që kanonit letrar dhe historisë së letërsisë shqipe i duhen si domosdo dhe autorë të rendit të dytë: mos qenkan këta: Çajupi, Mjedja, Poradeci, Migjeni... Rendi është i hapur, dhe do të provojë të skicohet në *Antologjinë e lirikës shqipe* (1963), sidomos në parathënien e saj *Evolucioni i lirikës shqipe*. Një pamje të tillë e bën në paraqitjen e *Teatrit* (shqiptar), ndërsa planifikonte të bënte një shkrim të ngjashëm gjeneze e zhvillimi për prozën shqipe, që nuk e kreu, pos theksimit të ndonjë autori.

Ernest Koliqi e teorizoi gjenezën e strukturën e letërsisë shqipe, duke propozuar thurje të kriterit kronologjik e tipologjik, në radhë të parë duke interpretuar çdo vepër letrare, duke portretuar autorët, të mëdhenj, apo pas tyre, duke trajtuar veprat në nivel artistik e estetik, dhe, ç'është me rëndësi, duke vënë në komunikim trashëgimitë e stileve dhe të epokave. Vetë nuk e mbaroi një punë të tillë si strukturë interpretuese, karakterizuese, vlerësuese e sistematizuese.

Një provë sintetizuese të letërsisë së shkruar shqipe Koliqi e bën në kuadër të kapitullit *Albania* në *Enciklopedia e popujve të botës*, 1965. Këtu bëhet trajtimi i letërsisë shqipe integralisht, duke përfshirë letërsinë arbëreshe, letërsinë e Shqipërisë dhe letërsinë e Kosovës, simbas kriterit të formave e të gjinive letrare: *Epika e kultivuar*, *Poetët lirikë*, *Narratorët-Prozatorët*, *Dramaturgjia*. Ka dhe një vlerësim preciz dhe eliptik të autorëve e të veprave më të njohura.

Mirëpo, vëllimi i sprovave të tij teorike e kritike për letërsinë shqipe është enorm, dhe trashëgimia e kërkimeve të tij ka vlerën e *shijen e bukës së mbrume*, për brezat e mëvonshëm, që do t'i hyjnë (apo jo) kësaj ndërmarrjeje.

II. "SHÊJZAT" E LETËRSISË SË KOSOVËS

1. Shêjzat

Duke bërë paraqitjen e revistës "Shêjzat", që në numrin e parë, më 1957, Ernest Koliqi e nënvizon palcën programore të revistës së vet si "hyllsí virtytesh arbnore". Në vështrimin figurues emri i revistës përfshinte grupe krijuesish në fusha të ndryshme të arteve e të dijeve; po edhe grupe krijuesish të letërsisë

shqipe të Kosovës. Në esetë e tij, Koliqi zbulon rrënjët etnike të kësaj letërsie; interpreton vepra e portreton autorë të saj; evidenton vlerat e saj estetike; duke parë vendin e saj në strukturën historike të letërsisë shqipe.

Në ballë të tematizimeve të kësaj letërsie përsërit rrënjët kulturore të saj, që do të lidhen me veprimet kulturore të këtij vetë, kur në vitet 1941-1942 dërgoi në Kosovë rreth dyqind mësues për të ndihmuar hapjen e shkollave shqipe në nivelin fillor e në nivelin e mesëm. Ky proces kulturor u bë themel për kultivimin e letërsisë së shkruar përballë letërsisë gojore, tradicionale. Në këtë mënyrë tematizohet dramatika e kalimit të "pragut" estetik nga "letërsia gojore" në "letërsinë e shkruar". Trajtimi i rrethanave socio-kulturore të lindjes e zhvillimit të kësaj letërsie, sqaron kontekstin letrar, i cili vetvetiu tëfillon çështjen e autenticitetit dhe vështrimeve letrare në këtë letërsi. Sa u takon autorëve të Kosovës, Koliqi në karakterizimin e vet, saktëson e figuron: janë "bij të furtunës" dhe janë "autorë modernë". Sa i takon çështjes së vendit në historinë e letërsisë shqipe, Ernest Koliqi Letërsinë e Kosovës e cilëson me termat: "Krahinë letrare", "periudhë letrare" e "përdegëzim letrar". Më në fund, në valën e diskutimit të trashëgimisë kulturore, Koliqi njeh një letërsi të Shqipërisë së Vjetër (në vështrimin e Shqipërisë londineze) dhe letërsinë e Kosovës (në vështrimin e Shqipërisë së Re), një binom të cilin e sugjeron, por nuk e emërton kështu.

2. Kronologji

Esetë (sprovat) e Ernest Koliqit për letërsinë e Kosovës, përfshijnë një periudhë kohore rreth dy deceniesh të kësaj letërsie e, po ashtu, janë botuar në një shtrirje kohore rreth dy deceniesh. Këto Sprova kanë këtë rend të paraqitjeve:

1. Kroje të reja në Parnaz shqiptar, "Shêjzat" nr. 1 dhe 4-7, 1957;[11]
2. Dhetvjetori i revistës "Jeta e re", "Shêjzat", nr. 11-12, 1959;[12]
3. Teatri shqiptar, (1960), "Jeta e re", nr. 2, 2002;[13]
4. Evolucioni historik i lirikës shqiptare, "Shêjzat", nr. 1-2, 1962;[14]
5. Poetët e Kosovës, ligjëratë më 1963 në Holandë, botuar te Ernest Koliqi, *Sprovat e letërsisë shqiptare*, 1963[15]
6. Antologjia e lirikës shqipe, 1963

[11] Ernest Koliqi, Vepra 5, *Syzime letrare*, Faik Konica, Prishtinë, 2003.
[12] Po, aty.
[13] Po aty.
[14] Po aty.
[15] Ernest Koliqi, Vepra 4, Faik Konica, Prishtinë, 2003.

Lexuesi i vëmendshëm i këtyre sprovave, duke i parë të lidhura ndërvete e me variante të vogla të botuara herë në shqip e në italisht e herë vetëm në njërën gjuhë, sheh që themeli i ideve e argumenteve përqendrohet në tri sprova. Letërsia e Kosovës përimtohet te tekstet "Kroje të reja" (1957) dhe "Dhetvjetori i 'Jetës së re'" (1959), ndërsa vendosja e kësaj letërsie në sistemin e letërsisë shqipe shfaqet te sprovat "Teatri shqiptar" (1960), "Evolucioni historik i lirikës shqiptare" (1962) dhe "Antologjia e lirikës shqipe" (1963). Paraqitjen kronologjike të teksteve të Koliqit e kërkon puna ta mbyllim duke përmendur që referencat e teksteve e të autorëve janë: vëllimi "Shkëndijat e para", të shtëpisë botuese "Mustafa Bakija", Prishtinë, 1956 dhe Kompleti i revistës "Jeta e re", 1949-1959.

3. Krojet e reja...

Titulli i eseut "kroje të reja në Parnaz shqiptar" për tekstet e zgjedhura nga tjetërkush me titull "Shkëndijat e para", krijon një ballafaqim paradoksal, sado i mbuluar dyherash me figurim. Në fakt ka të bëhet me ndeshjen e entuziazmit dashunor e dashamirës me një elementaritet në fushën e letërsisë. Koliqi e zë veten në këtë ngushticë etike e estetike, prandaj mundohet të vizatojë pozicionin e vet të kritikut e të interpretuesit. Ai veneron që "Ky lloj prodhimi... nuk vazhdon por fillon një historí letrare"[16]. Shpall gjykimet e veta të dhëna "në selín estetike e jo në atë ideologjike shoqnore".[17] Pozicionohet si *Vllau i madh*, që me dashuri përpiqet "me nxjerrë të tanë ambëlsín qi kullon prej këtyne veprave".[18]

Në këtë mënyrë fiton të drejtën të flasë për ndikimet, për mangësitë, thekson pëlqimet dhe bën karakterizimet e poetëve të Kosovës.

Zë fill me Esad Mekulin "në vjershat e të cilit tingullojnë klithma mesianike dhe kushtrime shoqnore... vjershtari naltohet në symtheza vezulluese historike... shpesh në rrjedhje arrîn në nji madhní gjymtyrash biblike."[19]

"Mark Krasniqi nuk hidhet në spirale sajimesh ajrore. Themat abstrakte nuk e joshin".[20]

"Pëlqej në Mehmet Hoxhën prirjen me përlavdue në vargje neoklasikët e ndiesíve të reja qi ia dalldisin sot zêmrën."[21]

---

[16] Ernest Koliqi, Vepra 5, *Syzime letrare*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 328.
[17] Po aty, f. 329.
[18] Po aty, f. 329.
[19] Po aty, f. 330.
[20] Po aty, f. 331.
[21] Po aty, f. 332.

"Latif Berisha, shfaqë mjaft cilsína të shqueme trilli dhe njifarë prirjeje muzikore qi e shkrin vjershën e tij në tinguj të kandshëm..."[22]

"Enver Gjerqekut, zâna i ka dhurue nji lumtuní të njomë pérftimesh poetike."[23]

"Për Murat Isakun mâ rândësí ka fjala se fjalija."[24]

"Rexhep Hoxha ka mjaft të pasun dërrasën e ngjyrave edhe penden të zhdërvjellët."[25]

"Më pëlqen Azem Shkreli. Tingullon nji notë trishtimi në poezinë e tij por e shkrîme në melodí të thjeshtë e depërtuese."[26]

Kështu i cilëson Koliqi poetët e antologjisë "Shkëndijat e para", duke theksuar pëlqimet e duke qortuar mungesat estetike. Në vijim trajton dhe prozën e kësaj antologjie, copa që arrijnë artin apo i afrohen atij.

"I rrasët në shprehje përshkruese më duket Hivzi Sulejmani. Më pëlqen e më kënaqë Zekeria Rexha. Në prozën e tij dallohen menjiherë zêja e talenti."[27]

"I mirë Sitki Imami. E qëndis ambël kallzimin me vërejtje humoristike të lëshueme me shije aty-këtu."[28]

"I zhdërvjellët e plot larëmí ngjyrash Ramiz Kelmendi në përshkrime të jetës së Ulqinit."[29]

"Vetina të dallueshme për hulumtim psikologjik dalin në shesh nga proza e Rexhai Surroit, edhe ky veç nganjëherë jo fort i kulluet në gjuhën shqipe."[30]

"Vërté i talentuem, nonsè ende në nji fazë papjekunie, më duket Adem Demaçi. Na del me nji prozë plot trill e shije e kuptim, nervoze, moderne."[31]

"Edhe Kapllan Resulit, mbas mendjes seme, i vjen përdoret endja e tregimeve. Kam shijue erën e njelmë, erën e shëndetshme të Ulqinit në prozën e tij."[32]

"Zotsí të veçantë analyze shpirtnore dhe pasuní mendimesh tregon në novelën *Martesa* e *Nahires* Hilmi Agani. Shifet se âsht i pregatitun me studjime serioze "[33]

"Adem gajtani shifet çiltas se âsht përcaktue, me cilësí qi e pajisin të bâjë udhë të gjatë e të lavdishme në lamije të letërsís."[34]

Edhe në prozë Koliqi pëlqen, trimëron, porse më tepër se në poezi, qorton autorët fillestarë, më tepër për thurje e gjuhë, sepse pati thënë më parë vetë, nuk merret me tematikat e ideologjitë. Po Vëllai i madh i Shqipërisë së vjetër kërkon të përtërihet letërsia shqipe me shkrimtarë shqiptarë të Kosovës, si Zekeria Re-

[22] Po aty, f. 332.
[23] Po aty, f. 335.
[24] Po aty, f. 334.
[25] Po aty, f. 335.
[26] Po aty, f. 335.
[27] Po aty, f. 338.
[28] Po aty, f. 341.
[29] Po aty, f. 341.
[30] Po aty, f. 342.
[31] Po aty, f. 342.
[32] Po aty, f. 342.
[33] Po aty, f. 343.
[34] Po aty, f. 343.

xha, Sitki Imami, Adem Demaçi, Kapllan Resuli e Hilmi Agani. Këta duke trajtuar veçoritë e veta, por duke kaluar më parë udhën e letërsisë pararendëse shqipe.

4. Poezia e "Jetës së re"

Teksti "Dhetvjetori i së përkohshmes 'Jeta e ré'", i shkruar dy vjet më vonë (1959) për letërsinë e Kosovës, pretendon të kalojë nga niveli i sprovës në nivel të studimit. Tashmë autori emërton *Krahinën e re letrare,* që i shtohet shqipes me hapësirë e banorë sa Shqipëria e vjetër. Kjo krahinë letrare është e licencuar nga revista "Jeta e ré", e cila përfshin panoramën shpirtërore e letrare të Kosovës. Nëse herën e parë artikulonte përshtypje, Koliqi ngulmon që këtë herë ka kaluar mijëra faqe letrare të kësaj letërsie, i përgatitur për të bërë analiza e vlerësime, karakterizime e strukturime më të gjera të kësaj letërsie, pikërisht të poezisë. Studimi përqendrohet në zhvillimin e kësaj letërsie, duke nënvizuar stile, individualitete, zgjerime tematike, arritje estetike të larta. As tani nuk është liruar nga entuziazmi, edhe pse, pikëpamjet e veta në diskutimet e thella të fenomeneve universale, tutje të fenomeneve të letërsisë shqipe, të vëna në relacion me vallen e Poetëve të Kosovës i zhvillon më tepër në parantezat e mëdha teorike, ku lakon kësaj here çështje estetike, tematike e ideologjike. Studimi strukturohet në kapituj, ku grupohen si rryma poetët e Kosovës e shqyrtohen çështjet e përgjithshme letrare. Struktura e studimit:

1. Vallja e Poetëve;
2. Esad Mekuli, Latif Berisha, Enver Gjerqeku;
3. Murat Isaku, Azem Shkreli, Rexhep Hoxha;
4. Josip Rela nga Zara;
5. Drejtimi shpirtnuer e formal;
6. Ideologji e frymzim;
7. Muhamed Kërveshi, Din Mehmeti, Besim Bokshi dhe Fahredin Gunga;
8. Poetesha Ganimete Nura;
9. Letërsia e re në brumosje.

Ernest Koliqi tani sprovon pikëpamjet e veta letrare, duke trajtuar etnicitetin e universalitetin letrar; reflektimet e ndikimeve e të formacioneve stilistike, portretimet letrare duke vënë në lojë historinë, gjeografinë dhe identitetin individual të poetëve një herë të identifikueshëm me peizazhin e origjinën (pra për ta krijon një mini psikobiografi), herën tjetër duke i vënë në rend tufëzimesh brezash, apo në pikë të fundit edhe stilesh. Në fund të fundit duke rezymuar krahinën e re letrare në ngrehinën e përhershme të letërsisë shqipe, natyrisht të

vënë në relacion të drejtpërdrejtë me trashëgiminë e saj (duke e provuar Vetveten me Veten e Botën).

Në grupin e parë të poetëve rivendos kushtrimet lartushtuese e kangën kumbore të Esad Mekulit, tashmë me gjuhë më të latuar shqipe; tingëllimën e përmallimit të këngës së Enver Gjerqekut me betimin në zemrën e njeriut të ri (patjetër si utopi); lirikën e Latif Berishës të mbështetur në ndjesi të veçanta të përmallimit.

Në grupin tjetër të poetëve sheh te Murat Isaku rritjen e vetëdijes artistike për ta mundur turbullirën e pasurisë metaforike e alegorike; pikat e ndikimit të shkollës letrare shkodrane te Azem Shkreli, për të dëshmuar që me trajtat klasike të vargut mund të fluturojnë në qiej të modernitetit shqiptar; përmend këngën tradicionale të elegjisë të Rexhep Hoxhës.

Veçon si poet e autor Josip Relën, që nga njëshi i dramës shkëlqen dhe në gjirin e lirikës me variacionet për lirinë e me gjakimin për identitet gjuhësor në përpjekje të krijimit të autoportretit arbnesh.

Një grup i veçantë është ai i poetëve të rinj të shejuem e të shêjzuem nga Koliqi, duke i parë këta pasrendës të të parëve, për të bërë kërkime të reja poetike, identifikuese e përgjasuese, duke lartësuar më fort shprehjen poetike. Edhe në këtë nivel Koliqi zgjedh poezi të veçanta për karakterizim: poezinë "Bistrica" të Muhamed Kërveshit; poezinë "Malsores" të Din Mehmetit, poezinë "Porosija e gjyshit" të Besim Bokshit, "Fragmente nga kronika e vendit tim" të Adem Gajtanit, poezinë "Rënkimi" të Fahredin Gungës.

Koliqi le vend të veçantë për Ganimete Nurën, duke e trajtuar poeteshë të parë të qarkut arbnuer. Vjen artikulimi poetik i gruas që këlthet si hakmarrje për statusin e zërit të saj të kufizuar në këngë ninullash a vajtime të vdekurish. Grua "me zêmër ulkoje qi këndon me sqep bylbyli". Ligjërim poetik për portretim të gruas, por nga kush? A s'është këtu në hije një "ligjërim mashkullor", Këtë do ta zbulonte Koliqi i kthjellët e jo entuziast i përparimit. Po se po, ai Koliqi që shtronte çështjen e diglosisë të gjinisë. Vetëmse atje argumentet ishin të letërsisë popullore. Këtu janë argumente të letërsisë artistike. Një interpretues i poezisë moderne s'mund të përziejë vetën e gjininë e saj me vetën e ligjërimit poetik. Vjershën "Për ty shoqe" mund ta shkruajë barabar një poet e një poeteshë.

Me këtë vërejtje të fundit për letërsinë e interpretimit (të interpretuesit) mund të kalojmë në vërejtjet e diskutimet teorike letrare të Koliqit për poezinë e Kosovës, të cilën përfundimisht e përkufizon: "Âsht nji botë poetike n'agim:

nji letërsí e re në trajtim, në brumosje”[35].

5. Dy parantezat

Në dy parantezat për drejtimin shpirtnor e formal e për ideologjinë e frymëzimin, Ernest Koliqi diskuton *pëlhurën letrare* universalisht duke karakterizuar *farën letrare* të poetëve të Kosovës. Nga mësues të Shqipërisë së vjetër këta mësuan shkrimin shqip, pa pasur kohë ta marrin traditën letrare. Ishin më afër rrymës letrare shkodrane, po kjo fort diturore e klasike për t’u ndjekur. Porse poetët e Kosovës janë brez i tronditjeve historike; bartës të idealeve shpartalluese e rilindëse. Në fillesë të kësaj *periudhe letrare*, më parë duhet shenjuar drejtimin shpirtëror, pastaj drejtimin formal. Në këtë degë letrare rrah gjaku arbnor me fuqi përtëritëse për të krijuar jetën e re. Me shprehje të vobekta të mbështetura me idiomatikën gojore për të shprehur një ndërgjegje moderne. Pa traditë letrare, poetët e Kosovës kanë krijuar një letërsi të re në përmbajtje e në forma. Koliqi insiston që këta autorë ndiejnë jehonat letrare të kohës, mirëpo qenësia e veprës së tyre nuk është e prekur nga frymëzimet libreske, për të figuruar mendimin:

> “Këtu jemi para gufimit të nji poezije të fortë të shprehun me nji art fëmijnuer, me mënyra letrare primitive.”[36]

Këta nuk kanë përsosjen formale të Mjedjes e Poradecit, të Shantojës e të Palajt, por në përmbajtje kanë ecur më përpara. Nuk njohin metrikën klasike, por vargu i tyre i lirë ndjek “rythmin e gjakut”, bashkojnë fjalët simbas “halucinacionit të fjalëve”, precizon Koliqi.

“Komunizëm ky? *Ai posteri l’ardua sentenza*! (Brezave të ardhshëm një fjalë të rëndë)”[37] kthehet në nismë Koliqi për të problematizuar çështjen e ideologjisë e të frymëzimit. Po, në fillim tematika të detyrueshme, pengime nga parimet marksiste-leniniste, poezia në shërbim të kolektivitetit. Porse, frymëzimi, fjala e ndjesia e çiltër e lidhur për mendimin në poezi e bëjnë relative lëndën. Flaka krijuese nëpërmjet imagjinimit bën të mundshme fluturimet që largohen nga ideja-nânë (ideologjia). Poetët “idhnín e humusit rî me djersë e gjak” donë ta kthejnë në mjaltë Zanash. Ekziston një rend: pas bubullimave të kryengritjes, pas stuhisë vjen qielli i kaltër e qetësia shpirtërore.

Ernest Koliqi e trajton këtë poezi, herë konceptualisht e herë me një

[35] Po aty, f. 375.
[36] Po aty, f. 361.
[37] Po aty, f. 360.

fantazi të figuruar, pa u lodhur asnjëherë nga entuziazmi i "zbulimit" të vet. Këtë *rrymë letrare, degë letrare* a *krahinë letrare,* pas sprovimit, e vendos dhe e sistematizon në kuadrin e letërsisë shqipe.

6. Brenda letërsisë shqipe

Tek eseja "Evolucioni historik i lirikës shqipe" (1962), duke trajtuar gjithë lirikën shqipe, thekson emrat e poetëve të Kosovës: Sat Nokshiqi (Esad Mekuli), Adem Gajtani, Besim Bokshi, etj. Dhe poeteshën Ganimete Nura. Ky vlerësim trupëzohet në "Antologjinë e lirikës shqipe", ku në mesin e autorëve bashkëkohorë zotërojnë poetët e Kosovës: Martin Camaj, Esad Mekuli, Murat Isaku, Enver Gjerqeku, Rexhep Hoxha, Din Mehmeti, Besim Bokshi, Muhamed Kërveshi, Adem Gajtani, Ganimete Nura, Fahredin Gunga. Njëmbëdhjetë. Kurse ka pesë poetë bashkëkohorë të Shqipërisë.

Gjithashtu, në trajtesën "Teatri shqiptar" (1960), me pretendime sistematizuese, vlerëson dramatikën e Kosovës në kuadër të zhvillimit historik të dramës në shqip. Bën portretin e Josip Relës, të cilin e quan "nji dramaturg i vërtetë", pastaj analizon dramën *Nita*. Evidenton autorët e veprat e tyre dramatike: Xhemil Doda: *Halit Gashi*, Myrteza Peza: *Nuk martohem me pare*; Hasan Vokshi: *Çarçafi*; Abdurrahman Shala: *Vllaznit*; Kristë Berisha: *Kryet e hudrës*; të gjitha vepra që lidhen me shfaqje të vitit 1955, për të përfunduar me vlerësimin:

> "Më 1956 paraqitet ndër skena *Bashkëshortët* e Muharrem Qenës, që ndoshta âsht puna ma e mirë dramatike e shfaqun në pesëmbëdhetë vitet e fundit, pamvarsisht nga ndonji naivitet a pasiguri skenike në momentet thelbësore."[38]

7. Prijsat e ndjeksat

Kur u vendos në Romë përfundimisht, Ernest Koliqi ishte autoritet letrar e përtej letrar. Sidomos për qarkun e miqve të hershëm e të vonshëm që ishin atje, apo kapërcyen andej si Namik Resuli, Zef Skiroi, Arshi Pipa, Martin Camaj e të tjerë. Për tri decenie ai vetëm e forcoi këtë autoritet, si profesor letërsie dhe, më tepër, si botues e vlerësues i letërsisë shqipe te revista "Shêjzat". U bë dhe promovues e përkthyes i letërsisë shqipe më së forti në Itali.

Idetë e tij për letërsinë shqipe dhe historinë e saj do të shfaqen vetëm në nivel variantesh te sprovat e Resulit, Skiroit e Pipës, që bëhen ndjekës të tij në grupin e studiuesve shqiptarë në Itali e në botën e jashtme. Resuli u pa ndjekës

[38] Po aty, f. 325.

i tij në mënyrën e pjesëtimit e të periodizimit të letërsisë shqipe; Skiroi mori apo përvetësoi sprovat e tij për shkollat letrare shkodrane; Pipa e shpuri në konsekuenca të fundit perspektivën sociale të letërsisë shqipe, në një skicë të pjesëtimit të historisë së kësaj letërsie.

Këta të tre: Namik Resuli, Zef Skiroi e Arshi Pipa ishin në një zë me të për çështjen e ideologjizimit të letërsisë bashkëkohore në Shqipëri dhe për shpërthimin e letërsisë shqipe në Kosovë e vendosjen e saj në hartën strukturore të historisë së letërsisë shqipe.

Zef Skiroi veprën e vet *Historia e letërsisë shqipe*[39](1959) e përfundon me kapitullin "Letërsia pas luftës", në të cilin paraqet "rajonin albanofon të Jugosllavisë", me poetët Murat Isaku, Enver Gjerqeku, me dramaturgët Josip Rela e Muharrem Qena, me prozatorët Kapllan Kallushi e Adem Demaçi, duke e përmbyllur një karakterizim të poetit Martin Camaj në tre paragrafë. Skiroi e vendos letërsinë e Kosovës në letërsinë bashkëkohore shqipe, duke u mbështetur në konceptet, vlerësimet e gjuhën eseistike të Koliqit.

Namik Resuli te vepra e vet Histori e shkurtër e letërsisë shqipe40, e rimarrë në anglisht me titull Letërsia shqipe41 (1987), në kapitullin "Letërsia e pas luftës" e paraqet letërsinë që krijohet në rajonet shqiptare ne Jugosllavi duke radhitur autorët: Esad Mekuli, Ali Podrimja, Enver Gjerqeku, Abdylaziz Islami, Muhamed Kërveshi, Qerim Ujkani, Murat Isaku, Rrahman Dedaj, Behram Hoti, Beqir Musliu, Demir Behluli, Latif Berisha, Besim Bokshi, Adem Gajtani, Fahredin Gunga, Ganimete Nura, Sinan Hasani, Daut Demaku, Rexhai Surroi, Anton Pashku, Azem Shkreli, Tahir Jaha, Rexhep Zogaj, Hivzi Sulejmani.

Arshi Pipa në veprën *Letërsia shqipe: Perspektiva shoqërore*[42] (1978), te kapitulli "Periodizimi i letërsisë shqipe", te letërsia bashkëkohore: 1944-1974, përfshin letërsinë shqiptare në Jugosllavi me autorët: Josip Rela, dramaturg dhe poetët Enver Gjerqeku, Murat Isaku, Muhamed Kërveshi e Azem Shkreli. Zgjedhja është mbrenda autorëve të Koliqit, po me një përpjekje për interpretim të nuancuar.

Pranimi i autoritetit si pikëpamje e pa lexim kritik, është një lloj komoditeti, të mos thuhet përtacie, për lexim e vështrim konkret. Kjo vërehet veçmas në

[39] Giuseppe Schirò Junior, *Storia della letteratura albanese*, 1959.
[40] Namik Resuli, *Breve storia della letteratura albanese*, 1975.
[41] Namik Resuli, *Albanian literature*, 1987.
[42] Arshi Pipa, Trilogia albanica III: *Albanian literature: Social Perspectives*, München, 1978. [Arshi Pipa, Trilogia albanica III: *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Tiranë, 2013. Përktheu Myftar Gjana]

trajtimin e letërsisë së Kosovës. Koliqi e trajtoi këtë letërsi me kujdes e dashuri deri ne fund të jetës, por vetëm duke u mbështetur në botimet deri në fund të viteve pesëdhjetë, pa e konsideruar këtë letërsi të viteve gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë, kur lulëzojnë botimet, përthejnë stilet, shumëzohen tematikat, jo vetëm në poezi, por edhe në prozë (tregim e roman) në dramatikë e në kritikë letrare.

Të themi, Koliqi kishte dituritë e veta letrare dhe shijet e veta, që domosdo duken në interpretimet letrare. Një lexues i kultivuar i letërsisë së Kosovës të viteve ′60 e ′70, nuk do të pranonte "gabimin" ta artikulonte entuziazmin për poeten e parë arbnore, Ganimete Nura, që mbase, qe emër i huazuar për një poet që botonte pak apo nuk mund të botonte aspak në atë kohë.

8. Letërsia gege

Koliqi përfundon që Shkodra historikisht ka qenë qendër e letërsisë gege. Porse a do të jetë më? Përgjigjja është – jo. Ai më tej rezonon mundësinë që kjo letërsi gege ka mundësinë të zhvillohet në Kosovë. Duke trajtuar zhvillimin e kësaj letërsie, autenticitetin e saj e ndikimet, rebelimin e përshtatjet, kjo letërsi lidhjet me trashëgiminë letrare shqipe i ka me Shkodrën. Jo vetëm pse Pjetër Bogdani e Gjon Nikollë Kazazi janë nga Kosova, porse është i mendimit që kjo letërsi do të zërë fille të këputura me trashëgiminë. Vizionet e tij errësohen duke marrë trajtën e dyshimit, madje të dëshpërimit në një përfundim me hije të trishtimit. Ka këtu shenja të autorëve të paditur a të mashtruar, që nuk mund të jenë protagonistë e pranojnë status të përcjellësit. Koliqi sikur harron veten, duke u folur të tjerëve. E ardhmja në duar të zotit, nuk është më zgjidhje apo propozim kulturor, por propozim metafizik. Koliqi mendon e shkruan:

> "Për shumë kohë, Shkodra përfaqësoi letërsín gege. Sot jo mâ. Përfaqësija letrare e Gegnís, mbas ngjarjeve fatale të historís së fundit, i përkitte Kosovarve. Këta shpinuen két nderë. Koha e ardhshme do të thotë a bane mírë a keq. Sidoqoftë, tue ndërpré traditën e Buzukut, të Budit, të Bogdanit e të Kazazit (këta dy të fundit auktorë kosovarë) ata nga shkalla e prijsave e zbritën veten në atë të ndjeksave. Mbasi, mbas gjase, ndiehen të kënaqun, na s'dijmë shka me thânë. Ase mâ mírë dijmë, por fjala – për arsye të njoftuna, - nuk na ecë sot. E nesërmja âsht në prêhen të Perendís."[43]

Ku janë tri pikëpyetje bëhet një pikëçuditëse!

9. À propos: Anton Pashku

Kur i shkruan këto radhë Ernest Koliqi po përfundonte krijimtarinë e vet letrare, i kurorëzuar krijues i tregimit gegë. Po në këtë kohë Anton Pashku po

[43] Ernest Koliqi, Vepra 5, *Syzime letrare*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 15.

përmbyllte krijimtarinë letrare në gegënisht, duke u bërë ikona e letërsisë moderne në Kosovë. Atëherë shtrohet çështja e rëndë: çfarë ishte komunikimi letrar ndërmjet këtyre shkrimtarëve, që në shkallë të dy brezave janë përfaqësues të prozës moderne. Evidenca ka pak, së paku të njohura deri më sot. Një përgjigje mund të provohet, ndërmjetshëm, duke parë dialogun e pashpallur lidhur me letërsinë shqipe dhe trashëgiminë e brezave.

Duke bërë, hera-herës, teorizimin e veprës së vet letrare Koliqi thekson letërsinë, farën e letërsisë së vet autentike, duke u mbështetur në gjuhë e në tematikë. Po kur interpreton e vlerëson letërsinë e Kosovës ai përqendrohet në stil, në gjuhë, në vlera estetike e në transformime që sjellin sprovat e modernitetit. Këto shenja i sheh tek autorët që përmend duke i përsëritur. Nuk e përmend emrin e Anton Pashkut!

Anton Pashkut, i cili në tregime e sidomos në kryeveprën e vet romansore, idiomatikën letrare gege e kurorëzon ne figurë e simbol, i cili tematikat shqiptare i rrok duke i lakuar kohët nga antika deri në bashkëkohësí; i cili artikulon qëndresën identitare që kalon nëpër nivel të lavdit, të tragjicitetit deri në pikëpyetjet e shpërbërjeve e shpërthimeve të mbrendshme; dhe në fund që kurorëzon veprën letrare qytetare, urbane, që komunikon me botët.

Mundet që ka të bëhet këtu me një moskuptim të brezave letrarë, apo me thyerjen e madhe të modernitetit letrar shqiptar. Si duket Ernest Koliqi e kishte mbaruar *utopinë letrare* shqiptare, kurse Anton Pashku e kishte nisur *distopinë letrare* shqiptare.

Nuk mund të pohojmë nëse një alterego letrare e Koliqit flet nëpërmjet penës së arbëreshit Angelo de Genti, në shkrimin për romanin *Oh* të Anton Pashkut, botuar te "Shêjzat" më 1972, një vit pas botimit të parë të romanit. Titulli i sprovës është pak si neutral: "Anton Pashku, tregimtar i shquem",[44] por kërkimet në enigmat e veprës janë të një "kënaqësie të mundimshme".

Angelo de Genti duke shpaluar domethëniet e veprës *Oh* rimerr formën dhe strukturën e saj. Autori-narratori shuplakon bespaksínë, kërkon trimin, vepruesin, e vetë është trim i mirë pa shokë shumë. E vë në sprovë njeriun për të qenë njeri, në situata të skajshme. Evidencat jetësore, referencat historike, prodhojnë vërtetësinë artistike, ku shfaqet rebelimi autorial i vënë në zgripc të jetës për të provuar lirinë e Hegelit, apo pafajësinë e Dostojevskit. Prek rrënjë qytetërimesh që dikur e tash vetëprodhojnë shkatërrimin e barbarinë, duke qenë në

[44] Angelo de Genti, "Anton Pashku, tregimtar i shquem", Shêjzat, nr. 1-4, kallënduer-prill, 1972, ff. 137-142.

botën vendëse e në botën e huaj, në një roman tmerresh, po "kumbimi e fuqija e fjalës dishmojnë fitoren estetike të autorit mbi mizorín e shëmtimin" e botës. Duke qenë autentik e universal, autori bëhet i krahasueshëm me Kamynë, Foknerin, Heminguejin. Imitimi, ngjashmëria, merr vlerë në penën që krijon. Pashku është nga "ma të paktit qi nuk e kanë prishun gjuhën e nânës". Duke trajtuar kobin e tmerrin me buzëqeshje të ironisë e të parodisë sharton tragjedinë me optimizmin, duke lënë një rrugëdalje nga tragjedia universale, që do të lëkundet me flatra të qytetnisë.

"Oh", psherëtimë a pasthirrmë? Pyet Angelo de Genti e provon të përgjigjet: nji grimcë atomi në trunin e seicilit gati me shpërthye në mendësí e qytetní.

III. KANONET LETRARE

1. Gjithëpërfshirja

Ernest Koliqi, bashkë me Namik Resulin e Karl Gurakuqin me ndihmën e bashkëpunëtorëve, në vitin 1941 hartuan e botuan veprën *Shkrimtarët shqiptarë I, II,* duke tentuar një gjithëpërfshirje të letërsisë shqipe nga fillimet deri më 1940. Vepra, në dukje si panoramë e letërsisë shqipe e krestomaci, mëtonte të paraqiste një rrjedhë historike të zhvillimit të letërsisë shqipe, dhe në fund një histori të kësaj letërsie. Kishte këtu të dhëna, dokumente, interpretim e rendim të autorëve e të veprave, që nisin nga kontekstet shoqërore e historike, për të kaluar tek idetë e tematikat, me qëllim të arritjes në shqyrtimet formale letrare e estetike. Këto orientime patën mbetur themeloret, edhe pse të modifikuara në kohë, për autorët e kësaj vepre, edhe për tri decenie sa vepruan ata në botën italiane. Fjala është në radhë të parë për Ernest Koliqin, Namik Resulin, Zef Skiroin e bashkëpunëtorë të tyre. Libri, për do kohë legal në Shqipëri e në Kosovë, për sa decenie mbeti referencë e arsimtarëve në shkolla, qoftë dhe në mënyrë klandestine.

2. Likuidimi, zëvendësimi

Kur Shqipëria u pushtua nga ortodoksia komuniste, kur u kanonizua realizmi socialist, si metodë e vetme letrare dhe kur tharmi i letërsisë u konsiderua ideologjia e saj, dhe përdorimi i saj deri në nivel propagande (me qendër Moskën) ndodhi tërmeti në letërsinë shqipe. Nisi fenomeni i likuidimit dhe i zëvendësimit, jo vetëm për atë që do të shkruhej, por, edhe më keq, për atë që ishte

shkruar. Promotor e promovues i këtij fenomeni u bë Dhimitër Shuteriqi, poet e kritik i viteve tridhjetë, i njohur për ide të majta ekstreme në fushë të kulturës e të letërsisë. Shuteriqi botoi më 1955 veprën *Histori e letërsisë shqipe*, në të cilën zbatoi kriterin ideologjik të vlerësimit letrar për bashkëkohësit e shkrimtarët e kohës së përparme. Në këtë vepër, në faqen 231, me një të rënë kanunore apo kanoniste likuidoi nga letërsia Zef Skiroin, Faik Konicën, Gjergj Fishtën, Ernest Koliqin e Lasgush Poradecin, shkrimtarët si përkrahës të të huajve, e veprat e tyre si rrymë dekadente a formaliste. Dhe: vepra nacionaliste që prishin idilën fqinjësore me sllavët. Këtu po flasim për të mëdhenjtë, të tjerët nuk përmenden fare.

> Dy rryma u dalluan ahere në letërsinë shqipe: njëra që ndoq vazhdën e letërsisë patriotike e demokratike të rilindjes; tjetra që u bë shërbëtore e vegël e regjimit shtypës të Zogut e pastaj e pushtonjësve fashistë e nazistë. E para njohu në radhët e saj shkrimtarë si Noli e Migjeni; e dyta njerëz si Konica, Fishta e Koliqi.
> Kështu ndër Arbëreshët e Italisë, teksa De Rada vdiq në pleqërinë më të zezë e për bukë të gojës, vendin e tij e zuri Zef Sqiroji, vegël e synimeve imperialiste italiane kundrejt Shqipërisë, fashist i orës së parë.
> Në fund të shekullit XIX e nisi veprimtarinë e tij letrare Faik Konica, shkrimtar antipopullor, vegël e imperializmit austriak e pastaj imperializmit e fashizmit italian, si dhe e Zogut. Po n'atë kohë filloi të shkruajë edhe Gjergj Fishta, koka e shkollës letrare të klerit katolik, vegël e të njëjtve. Me shkrimet e tyre këta luftuan zakonisht idetë e përpjekjet përparimtare në Shqipëri, ushqyen shovinizmin, nxitën luftën kundër popujve fqinj, duke lënë në heshtje luftën kundër pushtonjësve turq, austriakë e italianë, kundër imperializmit në përgjithësi. Këtë punë bënë, kush më shum e kush më pak, edhe shkrimtarë fashistë e profashistë të ndryshëm. Idetë qëndrore të veprave të tyre qenë antisllavizmi, idealizimi i jetës patriarkale e të klasave sundonjëse etj.
> Gjatë regjimit të Zogut, u dukën e u zhvilluan në Shqipëri edhe tendenca dekadentiste të letërsisë borgjeze evropjane. Këto tendenca karakterizoheshin nga largimi prej luftës shoqërore, mbyllja në kullën e fildishtë t'artit për art, idealizimi pa princip ose i tepruar i të kaluarës, misticizmi, admirimi dhe imitimi formal i letërsisë popullore, admirimi dhe imitimi i letërsisë dekadente evropjane, posaçërisht i simbolizmit e i romantizmit dekadent. Këto tendenca herë njera e herë tjetra, ose shum bashkë, dallohen në veprat e disa shkrimtarëve të kohës, veçanërisht te Koliqi e në shum poezi te Lasgush Poradecit, si dhe në shkrimet e disa të rinjve që bënë hapat e para në vitet '30. Domosdo, Zogu dhe pushtonjësit nuk i sollën asnjë pengesë një letërsije të tillë. Përkundrazi, ata e inkurajuan.[45]

Shuteriqi, vendin e të mëdhenjve të mënjanuar ua ofroi Fan S. Nolit e Migjenit, duke i pagëzuar këta prijatarë të të majtës letrare, e për pasojë paraprijës të letërsisë së realizmit socialist, që do të mugullonte tani mbështetur në trinomin: Maksim Gorki – Nëna – Realizmi socialist sovjetik. Ideologji e utopi

[45] Dhimitër Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqiptare*, kapitulli "Letërsia shqipe gjatë kohës s'independencës dhe të pushtimit fashist", 1955, f. 231.

së bashku. Atëherë rendon rrymën e vetme letrare bashkëkohore me autorë e vepra. Në poezi: Shefqet Musraj: *Epopeja e Ballit Kombëtar*, Kolë Jakova: *Heronjt e Vigut*; Llazar Siliqi: *Prishtina*; në prozë: Dhimitër Shuteriqi: *Çlirimtarët*; Sterjo Spasse: *Ata nuk ishin vetëm*; Fatmir Gjata: *Përmbysja*; në dramë: Kolë Jakova: *Toka jonë*. Kjo është yllësia e letërsisë së re, që ndërtohet me përfolje ideologjike e tematike; duke përjashtuar çdo letërsi tjetërfare. Këtë lloj kanonizimi Shuteriqi, si shkrues e si redaktor i parë, do ta çojë deri në konsekuencat e fundit në dy veprat e tjera: *Histori e letërsisë shqipe* (1959-1960) dhe *Historia e letërsisë shqiptare* (1983).

3. Dialogu

Dialogu në mes të "të shurdhërve" merr një trajtë në veprën *Histori e letërsisë shqipe* (1959) të Zef Skiroit të Ri. Ky në veprën e vet gjithëpërfshirëse deshi të dëshmojë që në letërsi nuk mund të ketë likuidime as zëvendësime. I trajtoi autorët me radhë. Zef Skiroi e Gjergj Fishta, kanë paraqitje e shkoqitje të barasvlershme me Jeronim de Radën, kurse Ernest Koliqi vlerësohet autori më i madh i epokës së re të letërsisë shqipe. Skiroi, më tutje trajton letërsinë e realizmit socialist në Shqipëri; edhe më tepër përpiqet të bëjë portretin e letërsisë së Kosovës në kuadër të letërsisë bashkëkohore shqipe, dhe në rrjedhën e historisë së kësaj letërsie. Skiroi sjell në vëmendje librin e Shuteriqit (f. 303), aty ku theksohet dashuria e temave sovjetike në poezinë e Siliqit.

Një dialog më të shtjelluar e më të problematizuar e bën Namik Resuli me përmbledhjen e ligjëratave të veta në Universitetin e Napolit (1955) në tekstin me titull "Katërqind vjet Letratyrë Shqipe". Gjithëpërfshirjen (pa përjashtime e likuidime) të letërsisë shqipe në historinë e saj, si shfaqje letrare e estetike, Namik Resuli e vijon dhe në studimin "Histori e shkurtër e letërsisë shqipe" (1975), ku përfshin letërsinë bashkëkohore në Shqipëri dhe në Kosovë. Këtu në këtë vepër Namik Resuli precizon që autorët e Kosovës "arritën të krijojnë për më pak se një çerek shekulli një letërsi të veten, letërsinë kosovare, një nga më të gjallat e të përparuarat në Evropën Juglindore, ndoshta superiore ndaj letërsisë së atdheut të origjinës, ngaqë ishte më pak e lidhur me direktivat e reja estetike sociale".

Nuk po përsërisim integralistin e letërsisë shqipe, Ernest Koliqin, që promovoi letërsinë e Kosovës dhe futi në shqyrtim analizën stilistike e estetike në kuadrin e hartimit të historisë së letërsisë. Veçmas ngase shumë ide të tij duket të kenë qenë bërthama e diskutimeve të bashkëpunëtorëve të tij në Itali e

jashtë në botën kulturore shqiptare.

Por, duhet të përmendet në mënyrë të veçantë, paranteza e hapur e Arshi Pipës te vepra *Letërsia shqipe: Perspektivat shoqërore* (1978), një trajtesë që përnjëmend merr trajtën e dialogut të hapur lidhur me tekstet letrare shqipe dhe kontekstet e tyre letrare, me argumenta shterues e gjuhë precize. Një diskutim letrar i thelluar për sociologjinë e kësaj letërsie dhe ideologjinë e saj, që është prekur së largu, por s'ka mundur të shkruhet as në Tiranë e as në Prishtinë deri në fund të shekullit njëzet.

4. Replikat

Replikat letrare nga Prishtina, për projektet e historisë së letërsisë shqipe, për arsye të vetëdijes letrare, nuk kanë marrë karakter polemike, që në botën shqiptare jashtë e mbrenda, më fort shpërbëjnë se sa krijojnë. Këto replika, më mirë, kanë marrë karakter të kurorëzimit në vepra. Janë marrë parasysh veprat e Ibrahim Rugovës: *Vepra e Bogdanit* (1982) e *Kahe e premisa të kritikës* (1986); veprat e Rexhep Qosjes: *Romantizmi I, II, III* (1984-1986); veprat e autorit të këtyre rreshtave: *Letërsia filobiblike, Letërsia moderne, Letërsia bashkëkohore* (1998-2002); vepra e Nysret Krasniqit: *Letërsia e Kosovës* (2016). Këto vepra, që nuk janë replika të thjeshta, tashmë kanë krijuar bazën e horizontin e historisë së letërsisë shqipe: si kronologji, shqyrtim estetik, sistematizim letrar dhe identifikim kulturor.

IV. Bibliografia

1. Shkrimtarët shqiptarë, Pjesa I (1462-1878), Tiranë, 1941, f. 368, E Koliqi e N. Resuli
2. Shkrimtarët shqiptarë, Pjesa II (1878-1940), Tiranë, 1941, f. 554, E Koliqi e K. Gurakuqi
1. Dhimitër Shuteriqi, *Histori e letërsisë shqipe*, Botim i Ministrisë s'Arsimit dhe Kulturës, Tiranë, 1955, f. 334.
2. *Historia e letërsisë shqipe*, Vëllimi I, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, Tiranë, 1959, f. 376.
3. *Historia e letërsisë shqipe*, Vëllimi II, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, Tiranë, 1960, f. 560.
4. *Historia e letërsisë shqiptare*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë, 1983, f. 630 (Nën drejtimin e Prof. Dhimitër Shuteriqit).
1. Ernest Koliqi, *Vepra 4, Sprovë letërsie shqiptare*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 355; Përktheu Willy Kamsi.
2. Ernest Koliqi, *Vepra 5, Syzime letrare*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 590.
3. Ernest Koliqi, *Vepra 6, Palci etnik arbnuer*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, 652.
1. Giuseppe Schirò Junior, *Storia della letteratura albanese*, 1959.
2. Namik Resuli, *Breve storia della letteratura albanese*, 1975.
3. Namik Resuli, *Albanian literature*, 1987.

4. Arshi Pipa, Trilogia albanica III: *Albanian literature: Social Perspectives*, München, 1978.
5. Arshi Pipa, Trilogjia albanika III: *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, Tiranë, 2013.

Përktheu Myftar Gjana

1. Ibrahim Rugova, *Vepra e Bogdanit 1675-1685*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 314.
2. Ibrahim Rugova, *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare, 1504-1983,* Instituti Albanologjik i Kosovës, Prishtinë, 1986, f. 442.
3. Rexhep Qosja, *Histori e letërsisë shqipe, Romantizmi I*, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 442.
4. Rexhep Qosja, *Histori e letërsisë shqipe, Romantizmi II*, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 478.
5. Rexhep Qosja, *Histori e letërsisë shqipe, Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 574.
6. Sabri Hamiti, *Vepra letrare 7, Letërsia filobiblike, Letërsia romantike*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, f. 463.
7. Sabri Hamiti, *Vepra letrare 8, Letërsia moderne*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, f. 800.
8. Sabri Hamiti, *Vepra letrare 9, 10, Letërsia bashkëkohore*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, f. 572 & f. 526.
9. Nysret Krasniqi, *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99-AIKD, Prishtinë, 2016, 718.
1. Dhurata Shehri, *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë, 2006, f. 176.
2. Dhurata Shehri, *Studimi i kritikës,* Albas, Tiranë, 2013, f. 160.

Matteo MANDALÀ, Palermo

MBI MËRGIMIN ARBËRESH NË ITALI (SHEK. XIV-XVIII)

1.– Mërgimi arbëresh drejt Italisë u zhvillua në faza të ndryshme, që u karakterizuan nga ngjarje të ndryshme historike në Gadishullin Ballkanik para, gjatë dhe pas pushtimit osman. Me njohuritë që kemi deri më sot, njohuri të paplota qoftë për shkak të kufizimeve në hapësirë dhe në kohë, qoftë për shkak të pamjaftueshmërisë së të dhënave dokumentare, është shumë e vështirë të përcaktohen me saktësi historiografike kufijtë kronologjikë të kësaj dukurie migruese, si edhe përmasat e vërteta të tij apo modalitetet përmes të cilave u zhvillua[1]. Historianët e sotëm për një të dhënë janë të një mendjeje: proceset migruese nga Ballkani drejt Europës Perëndimore, dhe veçanërisht, duke filluar qysh nga gjysma e dytë e shek. XIV, ato drejt Italisë së Jugut, përfshinë popullsitë që u prekën nga afër prej pasojave të turbullirave që pasuan rënien e Perandorisë Bizantine[2], pra grekët, sllavët dhe natyrisht shqiptarët, por s'ka dyshim se krahas arsyeve objektive, që lidhen me zhvillimet konkrete historike (çrregullimet shoqërore të shkaktuara nga fushata e shpeshta ushtarake dhe abuzimet e feudalëve lokalë, nga epidemitë, nga zitë e bukës, nga katastrofat natyrore), kishte edhe arsye të tjera që po i quajmë "subjektive" (si shndërrimi gradual i shoqërisë nga sedentare në gjysmë-sedentare dhe nomade), të cilat ndikuan në përvijimin e një fizionomie të re të popullsive që zgjodhën të shpërnguleshin dhe të vendoseshin përtej Adriatikut[3].

Të shtyrë nga perspektivat ekonomike dhe tregtare që u hapën falë zbulimeve të reja gjeografike, por edhe nga mungesa e krahëve të punës qoftë në bujqësi (si në rastin e Sicilisë dhe përgjithësisht të Italisë së Jugut), qoftë në

---

[1] Shh Peter Bartl: shih Peter Bartl, "Fasi e modi dell'immigrazione albanese in Italia" në *Rivista di storia del Mezzogiorno*, 15, Lecce, 1979, f. 199-212

[2] Shih Pietro Dalena – Alessandro Di Muro, "Dalle origini al Medioevo" në *La Calabria albanese. Storia, cultura, economia*, a cura di Fulvio Mazza, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 2013, f. 25-61. Pëllumb Xhufi, "Emigracioni shqiptar në Mesjetë: një vështrim tipologjik", në *Edhe 100! Studime në nderim të prof. Francesco Altimarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes*, Albpaper, Tiranë, 2015, f. 687-714.

[3] Shih Alain Ducellier, "Le raisons d'un départ: un monde désorienté" në Alain Ducellier - Bernard Doumerc - Brünehilde Imhaus - Jean de Miceli, *Les chemins de l'exile. Bouleversements de l'Est européen et migrations vers l'Ouest à la fin du Moyen Âge*, Armand Colin Éditeur, Paris, 1992, f. 7-89.

flotën detare tregtare (si në rastin e Venedikut), këto shtete favorizuan mes popullsive "të kolonizuara" apo atyre me të cilat hynin në kontakt përhapjen e mitit të *felix Italia*, pra të asaj paradigme që karakterizon dukuritë migruese të të gjitha kohëve[4]. Tri ishin drejtimet e zhvendosjeve masive të shqiptarëve: njëra shkonte drejt Veriut me destinacion qytetet-porte të brigjeve dalmate dhe prej aty mund të vijonte drejt skajeve veriore të Ballkanit dhe në Venedik, përndryshe përmes anijeve tregtare italiane mund të zbarkohej në brigjet markixhane. Drejtimi tjetër shkonte në kah të kundërt drejt Jugut dhe Greqisë, me destinacion Peloponezin, pra Morènë, ose qytetet bregdetare dhe ishujt e Egjeut[5]. Udha e tretë mbetej ajo e detit, që ishte më e shkurtër dhe shpinte në bregun tjetër të Adriatikut, pra në trevat qendrore dhe jugore të Italisë. Këto tri udhë nuk u rrahën njëkohësisht dhe me të njëjtin intensitet në momente të ndryshme historike, madje as destinacionet nuk mbetën gjithmonë po ato, sikurse nuk ishin të njëjta as arsyet që i shtynin shqiptarët të mërgonin (sipas rastit, mund të bëhej fjalë për një zgjedhje të lirë individuale ose për një ikje masive të detyruar nga rrethanat).

Udha e parë e mërgimit u ndërmor në mënyrë të pandërprerë nga gjysma e dytë e shekullit XIV deri aty nga fillimi i shek. XVI. Suksesi i saj garantohej

---

[4] Mbi këtë paradigmë historiografike të rëndësishme përqendrohet vëllimi i përgatitur nga Sergio Anselmi *Italia felix. Migrazioni slave e albanesi in Occidente. Romagna, Marche, Abruzzi, secoli XIV-XVI*, Quaderni di "Proposte e Ricerche", 3, Ed. di Ostra Vetere, Ancona, 1988.

[5] Mbi zhvendosjet e shqiptarëve në Greqi shih Denis A. Zakythinos, *Le Despotat grec de Morée.* Tome premier: *Histoire politique*, Société d'Edition "Les Belles Lettres" 95, Boulevard Raspail, Paris, 1932. Antoine Bon, *La Morée franque. Recherches historiques, topographiques et archéologiques sur la principauté d'Achaïe (1205-1430)*, fascicule 213 de la *Bibliothèque des Écoles françaises d'Athènes et de Rome*, Éditions E. sur de Boccard, Paris, 1969. Titos F. Jochalas, "Über die einwanderung der Albaner in Griechenland (Eine zusammenfassende Betrachtung)" në Peter Bartl und andere (Redaktion): *Dissertationes Albanicae. In honorem Josephi Valentini et Ernesti Koliqi septuagenariorum* (= Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Orients). Band 13. Trofenik, 1971, f. 80-106. Pëllumb Xhufi, "Albania graeca in the XIV-XV centuries. A survey on the Albanian Colonisation in Greece in the Late Middle Age", Studia Albanica, Nr. 1-2(XXVIII), Tiranë, 1991, f. 72-109 ribotuar në shqip me titullin "Albania Graeca": Përmasat dhe pasojat e migrimeve shqiptare në Greqi në shek. XIV" në Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Pegi, Tiranë, 2006, f. 327-368. Shkëlzen Raça, *Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi (shek. XIII-XVI)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2004. Bernard Doumerc, "Un peuple en errance: les clans albanais dans l'empire colonial" në *Des sociétés en mouvement. Migrations et mobilité au Moyen Âge*, Société des historiens médiévistes de l'Enseignement supérieur public, Éditions de la Sorbonne, Paris, 2010, f. 147-158.

nga prestigji dhe epërsia ekonomike e Republikës së Venedikut[6]. Duke zgjedhur këtë udhë mërgimtarët ballkanas, sidomos shqiptarët, dëshmonin se parapëlqenin krahinat qendrore dhe veriore italiane. Mirëpo ky parapëlqim do të fashitej aty nga gjysma e dytë e shek. XV, kur ato zona u mbingopën me fshatra dhe banorë dhe ekonomia lokale nuk kishte më nevojë për krahë pune nga jashtë. Qysh nga fundi i shek. XIV Venediku nuk ishte destinacioni i vetëm i mërgimtarëve. Treva dhe qytete të tjera bregdetare më në jug, sidomos në brigjet markixhane, tërhiqnin vazhdimisht familje mërgimtarësh: Të dhënat dokumentare që disponojmë dëshmojnë për mbërritje mërgimtarësh shqiptarë në "Romagna malatestiana" (Cesena, Rimini, Forlì[7]) dhe përgjatë bregdetit markixhan (Pesaro, Fano, Senigallia, Jesi, Ancona, Porto Recanati, Loreto, Porto Civitanova, Porto San Giorgio[8]), por edhe më në jug, paçka se në numër më të vogël, si në Bari, Brindisi, Lecce. Sot për sot është e vështirë të flasim për numra të saktë, por studimi i kryer nga Brünehilde Imhaus mbi bazën e të dhënave arkivore dëshmon se mes shekujve XIV dhe XV më se njëqind fshatra markixhane u populluan pak a shumë përfundimisht nga shqiptarë që merreshin me punë bujqësore[9]. Disa degë të kësaj vale mërgimi u shtrinë në qytetet e brendshme, qoftë drejt veriut, si p.sh. Cesena, qoftë drejt jugut.

2.– Kjo dukuri përfshiu edhe krahinën "le Marche", «një krahinë dikur e begatë, por tashmë e varfëruar», që ndryshe nga trevat e tjera të Italisë së veriut,

---

[6] Shih Alain Ducellier, "Les Albanais à Venise aux XVIe et XVe siècles", në *Travaux et Mémoires du Centre de recherche d'histoire et civilisation byzantines 2*, Paris, 1967, f. 405-420 ribotuar në *L'Albanie entre Byzance et Venise*, Variorum Reprints, London, 1987, nr. VIII. Freddy Thiriet, "Sur les communautés grecques et albanaises à Venise", në Mans Georg Beck, Manoussos Manoussacas & Angelo Pertusi (a cura di), *Venezia centro di mediazione tra Oriente e Occidente (sec. XV-XVI). Aspetti e problemi*. Leo S. Olschki, Civiltà Veneziana Studi 32, Firenze, 1977, 217-231. Brünehilde Imhaus, "Aspetti della colonia albanese di Venezia alla fine del Medio-Evo" në *Miscellanea Agostino Pertusi*, Tomo III, Rivista di Studi Bizantini e Slavi, Pàtron Editore, Bologna, 1983, f. 180. Brünehilde Imhaus, *Le minoranze orientali a Venezia, 1300-1510*, il Veltro Editrice, Roma, 1997; Silvia Moretti, "Une communauté étrangère dans la Venise des XVe et XVIe siècles: le cas des Albanais" në Jacques Bottin, Donatella Calabi, (a cura di), *Les Étrangers dans la ville: Minorités et espace urbain du bas Moyen Âge à l'époque moderne*, Editions de la Maison des sciences de l'homme Paris, Paris, 1999, f. 183-194. Lucia Nadin *Migrazioni e integrazione: il caso degli albanesi a Venezia, 1479-1552*, Bulzoni, Roma, 2008; Lucia Nadin, *Albania ritrovata. Recuperi di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto*, Onufri, Tiranë, 2012.

[7] Shih Viviana Bonazzoli – Oreste Delucca, "Slavi e albanesi nella Romagna malatestiana: primi esiti di ricerche d'archivio a Cesena, Rimini, Forlì" në *Italia felix*, cit., f. 213-231.

[8] Sergio Anselmi, "Slavi e albanesi nell'Italia centro-orientale" në *Italia felix*, cit. f. 11-32.

[9] Shih Brünehilde Imhaus, "Vers l'Italie des communes et des princes", në *Les chemins de l'exile*, cit., f. 225-294.

kishte probleme të rënda demografike, si pasojë e shpopullimit masiv të fshatrave. Kërkimet dhe studimet që ka kryer Sergio Anselmi konfirmojnë këtë kuadër të përgjithshëm dhe të dhënat arkivore që zbuloi dhe botoi ky studiues na ndihmojnë të shpjegojmë arsyet e shtrirjes dhe depërtimit të thellë të mërgatës shqiptare në ekonominë rurale markixhane[10]. Edhe pse me përmasa më të kufizuara se ato të sllavëve, prania shqiptare në Marche dëshmohet qysh nga shek. XIV, si p.sh. në Fermo, në Ancona, në Jesi, në Recanati. Sipas Anselmit, rritja e papritur e numrit të shqiptarëve në dyvjeçarin 1436-1437 hasi në kundërshtimin e popullsisë lokale, madje nxiti qëndrime të hapura armiqësore ndaj tyre. Mërgimtarët e rinj shqiptarë që shpesh konsideroheshin si vatra infeksionesh dhe sëmundjesh ngjitëse ose gjykoheshin si njerëz të dhunshëm e të trashë, patën një trajtim të ndryshëm nga ai që iu rezervua sllavëve, të cilët mbaheshin si më të përshtatshëm për punët bujqësore.

Burime të shumta dokumentare flasin për vështirësinë e integrimit të familjeve shqiptare në një ekonomi që në fakt kishte nevojë për krahë pune. Megjithëse vetë Anselmi vuri re se «edhe ndër shqiptarët kishte ndonjë që ia dilte të fitonte një *ubi consistam* dhe të shkonte përtej minimumit jetësor»[11], jemi ende larg urbanizimit të plotë që do të vihet re ne krahinat e tjera jugore, sidomos në Abruzzo dhe në Puglia, të cilat krahina studiuesi në fjalë i gjykoi si më mikpritëse falë pozicionit të tyre «gjeografikisht më logjik»[12]. Gjithsesi brigjet markixhane përbënin një pikëmbërritje natyrore për ballkanasit dhe fakti që fluksi i mërgimit gjatë shekujve ka qenë konstant dëshmon nevojën e vazhdueshme që kishin ato treva për krahë pune. Nga kjo pikëpamje, edhe sipas Brünehilde Imhaus, nuk përjashtohet të kenë qenë tregtarët ankonas ata që i këshillonin shqiptarët të mërgonin për t'u vendosur në fshatrat e shpopulluara në Marche dhe për të punuar tokat e lëna djerrë, sepse vetëm ata tregtarë mund ta njihnin gjendjen e rrënuar të fshatrave përreth qyteteve bregdetare markixhane prej nga niseshin për udhëtimet e tyre tregtare drejt Shqipërisë dhe Greqisë. Nga dokumentet zyrtare të kohës del se gjatë gjysmës së parë të shek. XV kishte një prani episodike individësh dhe familjesh shqiptare në shumë qytete bregdetare

[10] Shih Sergio Anselmi, "Insediamenti, agricoltura, proprietà nel Ducato roveresco: la catastazione del 1489-1490" në *Quaderni storici* "Grani, Prezzi, Mercato", nr. 28, Ancona, gennaio-aprile, 1975, f. 37-86; Sergio Anselmi, "Schiavoni e albanesi nell'agricoltura marchigiana, në *Le Marche e l'Adriatico orientale: economia, società, cultura, dal XIII secolo al primo Ottocento*, Ancona, 1978, f. 3-26.

[11] *Po aty*, f. 14.

[12] Sergio Anselmi, "Schiavoni e albanesi", cit., f. 12-13.

të kësaj krahine si në Ancona, Sirolo, Pesaro, Fano – por edhe në trevat e brendshme të Qendrës dhe Veriut të Italisë si në Foligno, Parma, Cesena, Gubbio. Krahas artizanëve, fshatarëve, tregtarëve dhe ushtarëve shfaqen edhe prostitutat, vjedhësit dhe keqbërësit e rëndomtë[13]. Në shumë raste, sipas dokumenteve gjyqësore që zbuloi dhe analizoi Brünehilde Imhaus, rrëfehet për akte kriminale pak a shumë të rënda që duke nisur nga gjysma e shek. XV shkaktojnë një «peur de l'étranger» që përbënte bazën e përhapjes së paragjykimeve, aktuale edhe sot e gjithë ditën, të cilat më pas u shndërruan në një «peur sociale» që qysh asokohe u përkthye në qëndrime përjashtuese dhe emargjinuese.

Fluksi migrator nuk u ndal në këmbët e vargmalit Apenin, por vazhdoi duke i shtyrë përtej këtij kufiri natyror grupet e shumta të mërgimtarëve nga Ballkani (kryesisht sllavë dhe shqiptarë) drejt krahinave të Umbrias, të Toskanës dhe të Lacios, popullsitë e të cilave po u nënshtroheshin shndërrimeve të thella socio-demografike, pasi në to kishte nevojë të madhe për krahë pune. Pas një faze të parë të mikpritjes së mërgimtarëve, që për fat të keq nuk është dokumentuar sa duhet, vijoi një periudhë armiqësie të hapur nga ana e popullsisë vendase, që ra pre e paragjykimeve dhe ndjenjave të frikës nga i huaji. Në Umbria pati shumë vendime dëbimi të mërgimtarëve, kryesisht shqiptarë. Për ata që ishin vendosur në Foligno, këshilli i qytetit, me rastin e epidemisë së murtajës së vitit 1467, vendosi "che veruno albanese che fusse venuto da due mesi in la città aut contado di Foligno si debia levare e partire da dicta città et contado de Foligno hogie alla pena de dieci tracti de corda et ultra alla pena de dece tracti de fune; et che non sia persona alcuna… che ardisca né presuma allocare casa alcuna a dicti talli albanesi adventi"[14]. Gjithmonë në Foligno, në vitin 1497 u mor vendim të kryhej regjistrimi i shqiptarëve që banonin në qytet me qëllim që të paguanin një taksë për frymë "për arsye sigurie»: nëse shqiptarët donin të qëndronin në Foligno, çdo burrë nga 14 në 70 vjeç duhej të paguante 15 solde në muaj, çdo grua nga 12 në 60 vjeç duhej të paguante 5 solde në muaj, ndërsa «fëmijët femra nga 3 në 12 vjeç, dhe fëmijët meshkuj deri në 14 vjeç" duhej të paguanin 2 solde e gjysmë në muaj; përndryshe familjet e shqiptarëve duhej që "brenda katër ditësh të largoheshin nga territori"[15]. Në të njëjtin vendim

[13] Alain Ducellier, "Réflexions sur le monde Orthodoxe" në *Les frontières religieuses en Europe du XVe au XVIIe siècle*: actes du XXXIe colloque international d'études humanistes, études réunies par Robert Sauzet, Librairie Philosophique J. Vrin. Paris, 1992, f. 325.

[14] Mario Sensi, "Fraternite di Slavi nelle Marche, secolo XV" në *Italia felix*, cit., f. 204, nota 6.

[15] Anna Esposito, "Il contributo dell'emigrazione slava e albanese al popolamento dei territori umbro-laziali tra Quattrocento e Cinquecento" në *La popolazione italiana del*

parashikoheshin edhe masa të tjera shtrënguese: shqiptarët nuk mund të fusnin në Foligno "as dru, as vreshtë, as vegla pune», asnjë lloj frute pa provuar se «të mos dëshmonin se i kishin blerë nga njerëz të qytetit tonë a nga rrethinat tij, ose se ua kishte dhuruar i zoti"[16], masë kjo që përpiqej të parandalonte futjen e mallrave të vjedhura në qytet; shqiptarët nuk mund të mbanin armë "pra shpata ose armë të tjera kur shkojnë për të punuar", përveçse kur shkonin jashtë krahinës, masë kjo që lidhej me emrin e keq që kishin marrë shqiptarët dhe sllavët si njerëz të dhunshëm. Edhe në Assisi, ku prania e shqiptarëve dëshmohet qysh nga vitet '70 të shek. XV, shpallen vendime *contra Albanenses*, me masa që kufizonin lirinë e lëvizjes jashtë mureve të qytetit (*extramœnia*) për ata që banonin prej kohësh në qytet, si edhe parashikonin dëbimin për të gjithë ata që ishin vendosur aty gjatë muajve të fundit. Motivet që shoqërojnë këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me frikën se përhapja e murtajës shkaktohej nga të huajt, sidomos nga sllavët dhe shqiptarët. Edhe në Amelia nuk "mungonin paragjykimet për popullsitë që vinin nga ana tjetër e Adriatikut, si p.sh. me rastin e epidemisë së murtajës të korrikut 1473 kur autoritetet e qytetit marrin vendim të dëbojnë menjëherë (*infra trium horarum spatium*) të gjithë epirotasit dhe shqiptarët që ishin vendosur në Amelia aty me familjet e tyre gjatë tri ditëve që paraprinë shfaqjen e murtajës nga frika se mos e kishin sjellë ata sëmundjen, *sub pena ut decies eculei ictibus torqueretur*, dënim ky që zbatohej edhe për ata *qui eos alios reciperet*. Pra edhe në këtë rast dëbimi parashikohej vetëm për të sapoardhurit, jo për ata që ishin vendosur prej kohësh në qytet"[17]. Dokumentet arkivore të Peruxhias dëshmojnë për "zhvendosje jo vetëm individësh, por familjesh dhe grupesh të përbëra nga shumë familje"[18] sllavësh dhe shqiptarësh. Shumë syresh punonin si ushtarë në shërbim të komunës; të tjerë çmoheshin si rrobaqepës, ndërkohë qysh nga vitet e para të shek. XV shumë mërgimtarë punonin "si kuzhinierë, shërbëtorë, kambanarë dhe korrierë"[19]. Mirëpo janë të shumtë ata që përfshihen në "episode dhune (rebelime, vjedhje, grabitje, vrasje); shumë syresh banojnë rregullisht në qytet ose në rrethinat e tij ku shkaktojnë turbullira shoqërore"; pjesa tjetër e këtyre, në pamundësi për t'u ngritur në

Quattrocento e Cinquecento (a cura di) Guido Alfani, Angela Carbone, Beatrice del Bo, Riccardo Rao, Forum editrice, Udine 2016, f. 162.

[16] *Po aty*.

[17] *Po aty*, f. 164.

[18] Luigi Rambotti, "Gli archivi perugini e la presenza di slavi e albanesi a Perugia nel XV secolo" në *Fonti archivistiche e ricerca demografica: Atti del convegno internazionale*, Ministero per i Beni Culturali e Ambientali, Trieste, 23-26 aprile 1990, Pubblicazioni degli Archivi di Stato. 37, Roma, 1996, f. 802.

[19] *Po aty*, f. 804.

nivele më të larta shoqërore, janë të detyruar "në merren me punët më të përbuzura e më të rrezikshme"[20]. Dëshmitë arkivore pakësohen duke nisur nga vitet e para të shek. XVI, derisa zhduken krejt gjatë dhjetëvjeçarëve që pasojnë. Kjo do të thotë se asokohe procesi i asimilimit ishte kryer duke lënë në shoqërinë peruxhine vetëm disa gjurmë antroponimike që ekovojnë kujtesën historike të kësaj mërgate ballkanike.

3.– Disa dokumente të zbuluara dhe të komentuara kohët e fundit nga Anna Esposito[21] flasin për një gjendje shumë të ngjashme të shqiptarëve që u vendosën në Romë dhe në Lacio, vise këto ku deri më sot ishte menduar gabimisht se prania e mërgimtarëve ballkanikë, pra edhe e sllavëve dhe grekëve "kishte mbetur në plan të dytë, për të mos thënë se nuk njihej fare"[22]. Sipas të dhënave që solli Muzio Polidori (1609-1683)[23], të rimarra më pas nga Luigi Dasti, shumë familje shqiptare në vitin 1484 e shtuan numrin e banorëve të Corneto-s. Paçka se më të paktë, grupe shqiptarësh shfaqen në regjistrat fiskalë të qendrave Montalto di Castro, Civitavecchia dhe Viterbo. Në të vërtetë, për sa i përket territorit të Lacios veriore dhe të Tuscia-s, kërkimet arkivore të studiueses Esposito i parazhvendosin me një dhjetëvjeçar dëshmitë e para: vendimi i parë i dëbimit i marrë në Viterbo mban datën 24 dhjetor 1474 dhe godet "sjelljet dhe shkeljet e padrejta e të tepruara të gjindve të sapoardhur siç janë korsikanët, sllavët dhe shqiptarët"[24]. Copëzimi i dokumentacionit na pengon të zbulojmë shtresëzimin social të këtyre mërgimtarëve, mirëpo edhe pse të dhënat që kemi në dispozicion nuk na thonë shumë mbi profesionet dhe statusin social të këtyre

---

[20] *Po aty*, f. 803.

[21] Anna Esposito, *Un'altra Roma. Minoranze nazionali e comunità ebraiche tra medioevo e rinascimento*, Il Calamo, Roma, 1995; Anna Esposito, "Popolazione e immigrazione a Corneto alla fine del Medioevo" në Luca Gufi, Alfio Cortonesi, Anna Esposito, Letizia Pani Ermini (a cura di), *Corneto medievale: territorio, società, economia e istituzioni religiose*, Atti del convegno di studio, Tarquinia 24-25 novembre 2007, Tipografia Lamberti, Tarquinia, f. 85-97 (= "Bollettino della Società tarquinense d'arte e storia", supplemento al n. 36); Anna Esposito, "Gli Albanesi a Roma e nell'area Laziale tra '400 e '500: prime indagini" në *Uomini Paesaggi Storie. Studi di Storia Medievale per Giovanni Cherubini*, a cura di Duccio Balestracci, Andrea Barlucchi, Franco Franceschi, Paolo Nanni, Gabriella Piccinni, Andrea Zorzi, Salvietti&barabuffi Editori, Siena, 2012, f. 533. Anna Esposito, "Le *nationes* difficili. Albanesi e corsi a Roma nel primo XVI secolo e le loro chiese nazionali" në *Chiese e nationes a Roma. Dalla Scandinavia ai Balcani: secoli XV-XVIII*, a cura di Antal Molnár - Giovanni Pizzorusso - Matteo Sanfilipo, Istituto Balassi Accademia d'Ungheria in Roma, Viella, Roma, 2017, f. 161-174.

[22] *Po aty*, f. 533.

[23] Cit. nga Luigi Dasti, *Notizie storiche archeologiche di Tarquinia e Corneto*, Tipografia dell'Opinione Roma, 1878, f. 253.

[24] Anna Esposito, "Il contributo dell'emigrazione slava e albanese", cit., f. 165.

grupeve, nuk pajtohemi plotësisht me mendimin sipas të cilit kemi të bëjmë vetëm me "njerëz të pakualifikuar dhe në rastin më të mirë të lidhur njëfarësoj me mjediset ushtarake"[25], pasi kjo do t'u binte ndesh qoftë pohimeve të lart-përmendura të Polidorit, qoftë dinamikave që gjatë viteve në vijim përcaktuan rritjen graduale demografike t disa qendrave urbane të kësaj zone, mes të cilave ndodhej edhe Corneto-Tarquinia. Me siguri shqiptarët "dalloheshin nga një famë e keqe", dhe kjo konfirmohet nga "vendimet gjyqësore që i shohin protagonistë dhe që kanë të bëjnë kryesisht me pajtime pas sherresh ose me plagosje etj"[26]. Edhe shqiptarët e vendosur në Romë janë objekt vendimesh dëbimi, si ai që gjendet në Bulën e shpallur nga Papa Siksti IV më 5 shtator 1475[27], që i dha fund indiferencës relative me të cilën u pritën emigrantët në qytet gjatë gjysmës së dytë të shek. XV. Ndryshimi në trajtim – thotë Esposito – mund t'i detyrohet përbërjes së ndryshme sociale të grupeve të mërgimtarëve shqiptarë: të parët, pa një dobi të vërtetë sociale, u mblodhën në disa kategori profesionale margjinale; ndërsa të dytët, që mbërritën mes fundit të shekullit XIV dhe dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XV "arritën nivele me prestigj" çka u lejoi atyre një pozicionim të ndryshëm në shoqërinë qytetare. Në të dyja rastet nuk u arrit të shmangej asimilimi i plotë që në fund do të fshijë gjurmët e kujtesës së pranisë së tyre.

Sipas dokumenteve arkivore nuk ishte shume e ndryshme gjendja në Maremma seneze[28], që ishte bërë pikë mbërritjeje për flukset migratore nga përtej Adriatikut. Nga të dhënat e pakta që kemi në dispozicion na rezulton një prani shqiptarësh edhe në këto vise të Italisë qendrore. Përkundrazi, nuk dimë pothuajse asgjë mbi kohëzgjatjen e këtij fenomeni, mbi shtrirjen e tij në hapësirë dhe sidomos mbi ndikimi që pati në ekonominë dhe në shoqërinë seneze. Gjurmët antroponimike, edhe pse janë të dobishme për të përcaktuar kombësinë e popullsive që zhvendoseshin[29], nuk na thonë asgjë mbi statusin social të tyre, as mbi nivelin e integrimit e të tolerimit të grupeve shqiptare, që vijuan të zhvendoseshin paprerë brenda territorit italian.

E ngjashme me përvojën markixhane, edhe pse me përmasa më të kufi-

[25] *Po aty*, f. 166.
[26] Po aty.
[27] *Po aty*, f. 167.
[28] Shih Maria A. Ginatempo, "Le presenze straniere nel dominio senese del Quattrocento" në *Bullettino senese di storia patria*, XCIII, 1986, f. 392-415.
[29] Shih Maria A. Ginatempo, "Per la storia demografica del territorio senese nel Quattrocento: problemi di fonti e di metodo" në *Archivio storico italiano*, n. 522, CXLII, IV, 1984, f. 511-587.

zuara, ishte dukuria migratore që u zhvillua mes fundit të shek. XIII dhe gjysmës së parë të shek. XV drejt Sicilisë dhe krahinave të tjera jugore të Italisë, ku kishte nevojë të madhe për krahë pune dhe një pjesë e mirë e tokave pjellore kishte mbetur djerrë[30]. Mërgimi drejt pjesës jugore të Mesdheut, qoftë nga ana e Adriatikut, qoftë nga ajo e Tirrenit, u favorizua nga interesat anzhuine dhe sidomos nga përpjekja për t'i shndërruar portet ballkanike në nyje tregtare. Anijet siciliane që rrihnin gjatë e gjerë Mesdheun, gjatë rrugës së kthimit ngarkonin shpesh skllevër që pastaj shiteshin në tregun e Ishullit. Mes atyre që vinin nga Europa juglindore, Henri Bresc ka veçuar disa skllevër, të shitur në vitet 1310-1359, që vinin me siguri nga trevat shqiptare[31]. Nuk ishin ushtarë të zënë robër, por "familje të tëra të hedhura në treg, si rasti i tre shqiptarëve, babai 30 vjeçar, nëna 20 vjeç dhe i biri 55 vjeç, të shitur për gjithsej 10 onça në vitin 1328"[32]. Një grup tjetër prej tre shqiptarësh të shndërruar në skllevër u shit në Termini mes viteve 1400-1439[33]. Në krahasim me numrin e madh të skllevërve grekë, shqiptarët ishin të paktë, por prania e tyre dëshmon ekzistencën e një udhe detare që në kapërcyell të shekujve XIV-XV lidhte drejtpërdrejt Sicilinë me brigjet lindore të Adriatikut[34].

Fluksi migrator i fundit të shek. XIII, përveçse drejt Sicilisë, drejtohej njëkohësisht drejt brigjeve më të afërta të Puglia-s. Pa lënë gjurmë arkivore, disa shqiptarë morën rrugën e mërgimit për të shpëtuar nga zgjedha e feudalëve vendas. "Dès les années 1270, des Albanais fuient en Pouille après le séisme de Durazzo et, un siècle plus tard, c'est plutôt que d'être "*traités en esclaves*" par leur prince, Charles Thopia, que des émigrés de la région de Durazzo préfèrent "aller en Pouille en mendiants"[35]. Mungesa e burimeve arkivore nuk na lejon të rindërtojmë me saktësi karakterin social të këtij mërgimi, por të dhënat e pakta që kemi në dorë mjaftojnë për të dëshmuar ekzistencën e një udhe të tretë të

---

[30] Shih Henri Bresc, "Pour une histoire des Albanais en Sicile XIV-XV siècles", në *Archivio Storico Siciliano*, LXVIII, 1972, f. 527-538.

[31] Shih Henri Bresc, *Un monde Méditerranéen. Économie et société en Sicilie (1330-1450)*, Tome I, Accademia delle Scienze e Arti di Palermo, Palermo, 1986, f. 443.

[32] *Po aty*, f. 444-445.

[33] *Po aty*, f. 447 dhe f. 459.

[34] Shih Laura Balletto, "Schiavi albanesi a Genova nel XV secolo" në *The Medieval Albanians*, National Hellenic Research Foundation, Institute for Byzantine Studies, International Symposium 5, Athens, 1998, f. 325-348.

[35] Alain Ducellier, "Le raisons d'un départ: un monde désorienté" në *Les chemins de l'exile*, cit., f. 87. Alain Ducellier, *La Façade maritime de l'Albanie au moyen âge. Durazzo et Valona du XIe au XVe siècle*, Institute for Balkan Studies, 177, Thessaloniki, 1982, f. 292 e f. 525.

mërgimit drejt Jugut të Italisë para rënies së Skënderbeut.

4.– Shumë domethënëse janë të dhënat e tjera që nxori Henri Bresc nga aktet notarile që ruhen në Arkivin e Shtetit të Palermos dhe që vënë në pah fytyrën tjetër të mërgimit shqiptar, atë që përbëhej nga njerëz të lirë, të cilët zbarkuan në Sicili për të kërkuar fatin e tyre. Mes viteve 1396-1429 "një dyzinë familjesh", kryesisht nga Durrësi, ose sikurse thotë Henri Bresc, nga zonat përreth Durrësit, ishin vendosur në periferi të Palermos, sidomos në lagjen bujqësore "Albergheria", ku e vepronte noteri Antonino Bruno që regjistroi aktet përkatëse[36]. Të gjithë këta ishin katolikë të deklaruar: në fakt frekuentonin kishën e Shën Nikollës *de Novo* o *dei Latini*. Bëhej fjalë kryesisht për bërthama të vogla familjare që e kishin lënë atdheun për arsye ekonomike, por kishte edhe "skllevër të kapur nga kapitenë të paskrupullt"[37] dhe "ushtarë", që u kishin mbijetuar betejave të përgjakshme që kishin përfunduar me pushtimin osman të Durrësit dhe të Shkodrës në vitin 1386, të Krujës në vitin 1415 dhe të Vlorës në vitin 1417. Ndryshe nga bashkatdhetarët e tyre që mbërritën në ishull si skllevër, ata që shkuan atje si njerëz të lirë, sipas Bresc-it, u pritën mirë dhe u integruan shpejt në shoqërinë siciliane. Këtë e dëshmojnë martesat e përziera, ndërsa fakti se banonin në qytet dëshmon se u pritën si "qytetarë". Falë këtij statusi prej qytetari (a ndoshta prej *habitatores*), i ngjashëm me atë që fituan bashkatdhetarët e tyre në Venedik, ata mundën të ruanin "një ndjenjë të fortë të origjinës dhe të tipareve të veçanta", çka del qartë edhe nga burimet arkivore që nuk i ngatërronin ata "as me grekët" as me fqinjët sllavë".

Vijimësia e mërgimit shqiptar drejt Jugut të Italisë dokumentohet deri në gjysmën e parë të shek. XV. Nga ky çast e prapa nuk kemi më burime, jo sepse arkivat nuk e kanë regjistruar praninë e shqiptarëve, por thjesht sepse nuk janë kryer kërkime shteruese sikurse është bërë për krahinat qendrore dhe veriore. Për sa i përket kuadrit ekonomik dhe ushtarak në Ballkan, vështirë të mendohet se fluksi migrator i periudhës mes shekujve XIII-XIV të jetë ndërprerë papritur pikërisht në kohën kur në Shqipëri u ashpërsua kriza ekonomike dhe u bë më konkret rreziku i pushtimit osman. Nga kjo pikëpamje mungesa e burimeve mund të përligjet nga vetë natyra e të mërguarve që ndoshta nuk e patën më mundësinë të vendoseshin nëpër qytete apo në qendra rurale të zhvilluara. Ajo çka do të ndodhë me diasporën e mirëfilltë që do të zhvillohet mes gjysmës së dytë të shek. XV dhe shekullit XVIII, kur në gjashtë krahina të Italisë së Jugut u vendosën shumë komunitete arbëreshe, që për pesë shekuj me radhë i dhanë

[36] Henri Bresc, "Pour une histoire", cit., f. 529-532.
[37] "esclaves razziés par des capitaines peu scrupuleux", *po aty*, f. 532.

jetë një procesi të gjatë e të ndërlikuar të krijimit të identitetit që edhe sot ngjall habi dhe admirim.

Valët e para të mërgimit masiv drejt Italisë së Jugut, sikurse dihet, u kryen gjatë dhe pas periudhës së dominuar nga figura e Skënderbeut (1405-1468), prijësit shqiptar që për një çerek shekulli iu kundërvu me armë pushtimit osman. Me njohuritë që kemi deri më sot është tejet e vështirë të rindërtojmë me hollësi modalitetet e këtij mërgimi masiv që pati si protagonistë refugjatët shqiptarë të cilët prej fundit të shek. XV deri në gjysmën e parë të shek. XVI gjetën strehë në brigjet e afërta italiane. Dokumentacioni që disponojmë është tejet i mangët dhe fatkeqësisht studimet historike arbëreshe nuk kanë sjellë ndërkohë ndonjë kontribut të ndjeshëm.

S'ka dyshim se me depërtimin e hordhive osmane në Shqipëri dhe përgjithësisht në Ballkan, një pjesë e banorëve të kësaj ane të Adriatikut zgjodhën më mirë të mërgonin sesa t'u nënshtroheshin pushtuesve të rinj.

Me eksodin masiv të shqiptarëve të periudhës së Skënderbeut lidhet themelimi a më mirë të themi rithemelimi i një numri të ndjeshëm ngulimesh në disa krahina italiane, sidomos në Kalabri dhe ne Sicili, që i përkasin të gjitha çerekut të fundit të shek. XV. Kësaj vale të madhe që historiografia shqiptare e shekujve XVIII-XIX e ka interpretuar me teprime dhe shtrembërime të shumta me qëllim që ta vinte në funksion të një vizioni ideologjik dhe mitik, i është dhënë përkufizimi "diasporë" ose "mërgatë" vullnetare e ndërmarrë në emër të besimit fetar dhe të lirisë, të një ikjeje të përkohshme në pritje të kushteve më të mira për të rimarrë armët dhe për të çliruar atdheun e të parëve. Në të vërtetë, sikurse do të shohim më poshtë, protagonistët e këtij mërgimi epokal u përkisnin shtresave më të ulëta të popullsisë dhe nëse nga njëra anë është e vërtetë që u detyruan të ikin për shkak të luftës, nga ana tjetër ata gjithsesi nuk kishin shumë për të humbur pasi jetonin në një gjendje të mjeruar. Nuk përjashtohet të jenë tërhequr drejt mërgimit pikërisht nga miti i përhapur asokohe i *felix Italia* që, siç e thamë, qysh nga shekujt pararendës kishte ndikuar mbi bashkatdhetarët e tyre dhe që do të vazhdojë të tërheqë mërgimtarë të tjerë edhe në dhjetëvjeçarët që do të pasojnë. Këtë na e konfirmon fakti se edhe pas eksodit të madh fluksi migrator nuk u ndërpre kurrë plotësisht, por vijoi me ulje dhe ngritje. Kështu nga fillimi e shek. XVI e deri në gjysmën e dytë të shek. XVIII[38], shume grupe të reja mërgimtarësh do të braktisin brigjet ballkanike të Adriatikut për të gjetur strehë në Itali.

[38] Italo Sarro, *L'insediamento albanese di Pianiano* (Nuova edizione), Graficreo, Viterbo, 2013.

Krahinat ku u vendos diaspora shqiptare ishin po ato ku sot janë përqendruar komunitetet arbëreshe, por s'ka dyshim se mërgimtarët u shpërndanë edhe në zona që sot nuk përfshihen mes atyre që njihen tradicionalisht. Është e qartë se mbërritja në Jugun e Italisë më shumë sesa një zgjedhje e vetëdijshme e mërgimtarëve ishte një domosdoshmëri urgjente e shkaktuar nga lufta në Ballkan. Po të kemi parasysh disa kufij kohorë, si ai *pas* thyerjes që pësuan shqiptarët në Greqi nga trupat e Sulltan Mehmetit II (1466) ose viti i vdekjes së Skënderbeut (1468) dhe ai *para* rënies së Shkodrës në duart e turqve (1479), mund ta vendosim pikërisht në këtë dhjetëvjeçar fazën më intensive të fluksit migrator. Kësaj periudhe i përkasin aktet zyrtare më të vjetra të themelimit të disa ngulimeve arbëreshe (si p.sh. Shën Mitër Korona në Kalabri në vitin 1471 dhe Palazzo Adriano në Sicili në vitin 1482). Edhe pse është e vërtetë, sikurse kanë pohuar disa studiues arbëreshë të shek. XVIII, se datat e akteve zyrtare të themelimit nuk përkojnë me kohën e fillimit të eksodit, ato data janë të rëndësishme për të caktuar një kronologji të vlefshme relative.

5.– Udha që përshkuan arbëreshët ka qenë me siguri ajo detare, që kishin rrahur bashkatdhetarët e tyre edhe më parë dhe që shpinte në Ragusa, në Venedik dhe në Marche. Këta të fundit imbarkoheshin në anije tregtare që ngjiteshin përgjatë brigjeve shqiptare deri në portet e mëdha dhe që andej shpërndaheshin nëpër qytetet italiane. Ndërsa arbëreshët që përfunduan në Jug gjatë fundit të shek. XV përshkuan një udhë tjetër. Disa syresh do të kenë marrë anijet tregtare që përshkonin kanalin e Otrantos drejt e në brigjet salentine; të tjerë do ta kenë kaptuar atë kanal me lundrat e tyre duke zbarkuar ku t'i hidhte deti e duke u dhënë jetë skenave që ka përshkruar Papa Pali II në një letër që i dërgonte Dukës së Bolonjës, Filipit[39].

Zhvillimi kaotik i fluksit migrator drejt Jugut mund të shpjegojë mungesën e dokumentacionit – qoftë arkivor, qoftë narrativ –, që përkundrazi nuk mungon në rastin e mërgimit drejt krahinave veriore. Që protagonistët e këtij eksodi nuk kanë qenë individë ose familje të veçanta, këtë e dëshmojnë ngjarjet e mëvonshme, sidomos të dhënat mbi organizimin social të ngulimeve të reja arbëreshe. U shpërngulën komunitete të tëra, që, ndryshe nga mistifikimet e mëvonshme të historiografisë arbëreshe që flet për pasuri përrallore, nuk kishin mjete jetese dhe asnjë mbështetje ekonomike. Vetë përbërja e tyre sociale dëshmon se u përkisnin shtresave të ulëta. Më së shumti ishin bujq dhe barinj, njerëz

[39] Jacopo Ammannati Papiensis, *Epistolæ & Commendatarii*, apud Alexandrum Minutianum, Impressum Mediolani, 1506 die XXVIII Martii, Milano 1506, "Duci Pro Pontefice Paulo", f. 102v.

të cilët vinin nga një gjendje nomadizmi që rreth fundit të shek. XV ishte shndërruar në endemik, i ngjashëm me atë që shtynte shqiptarë të tjerë të zhvendoseshin vazhdimisht drejt Greqisë. Edhe për ta lufta, pushtimi osman dhe vdekja e Skënderbeut i kishin hapur rrugën një procesi migrator që ekzistonte edhe më parë në gjirin e shoqërisë feudale shqiptare dhe që kishte përgatitur terrenin në mënyrë që mërgimi të mbetej e vetmja zgjidhje e mundshme.

Ky përshkrim i shkurtër, i përligjur nga të dhënat që pasuan eksodin, nuk dështmohet nga dokumentet e kohës. Këtej rrjedh vështirësia e përcaktimit të saktë të trevave nga vinin mërgimtarët, të përbërjes së tyre shoqërore dhe të faktorëve që, sipas rastit, ndihmuan ose penguan integrimin e tyre në indin shoqëror dhe ekonomik italian dhe që më vonë mundësuan themelimin e vendbanimeve të reja, që i gjejmë edhe sot të shpërndara nëpër gjithë Jugun e Italisë. Të dhënat onomastike, toponomastike dhe dialektologjike, së bashku me ato antropologjike dhe fetare na flasin për një prejardhje të arbëreshëve nga krahinat më jugore të Shqipërisë sotme, por nuk duhet harruar, sikurse e vuri re me mprehtësi Zef Valentini[40], se mes arbëreshëve kishte edhe grupe mërgimtarësh të ardhur nga Veriu i Ballkanit, çka dështmohet nga disa mbiemra (si p.sh. Riolo dhe Clementi), si edhe nga disa tipare gjuhësore tipike gege të arbërishtes[41].

Sado kaotike të kenë qenë fazat e mërgimit dhe mënyrat e vendosjes së shqiptarëve në Itali gjatë gjysmës së dytë të shek. XV, integrimi i tyre në krahinat jugore mund të shpjegohet, së pari, me vështirësitë ekonomike dhe shoqërore që këto të fundit përjetonin gjatë asaj periudhe. Të mbërthyera nga një krizë e përgjithshme (tkurrje e fortë demografike, rënie e prodhimit bujqësor, braktisje e tokave bujqësore dhe e qendrave rurale mesjetare, taksa gjithmonë e më të rënda, mangësi të theksuara në planifikimin dhe menaxhimin bujqësor), shumë krahina jugore italiane ia hynë një procesi ristrukturimi të thellë të indit ekonomik dhe prodhues, duke hapur kështu një epokë të gjatë kolonizimesh të brendshme dhe ripopullimi të zonave rurale që gjatë shekujve XV-XVII ia ndërroi krejt faqen shoqërisë dhe ekonomisë së Italisë së Jugut. Fakti që në këtë proces kolonizimi kontribuuan ndjeshëm grupet e mërgimtarëve shqiptarë, konfirmon qoftë krizën e thellë që kishte mbërthyer shoqërinë dhe ekonominë e

[40] Shih Giuseppe Valentini, "Sviluppi Onomastici-Toponomastici Tribali delle Comunità Albanesi in Sicilia", Estratto del *Bollettino del Centro di Studi Filologici e linguistici Siciliani*, vol. 11, Palermo, 1955 ribotuar në *Albanesi in Sicilia*, a cura di Matteo Mandalà, Albanica 16, Mirror, Palermo, 2004, f. 39-56.

[41] Mbi çështjen e antroponimisë shih Eqrem Çabej, "Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre" në *Në botën e arbëreshëve të Italisë*, botimi i tretë i plotësuar nën kujdesin e Matteo Mandalà-së, Excipere 30, Botime Çabej, Tiranë, 2017, f. 39.

jugut të Italisë nga mesi i shek. XIV deri fund të shekullit XV, qoftë përpjekjet e për ripopulluar qendrat rurale të braktisura dhe për t'i shndërruar ato në prodhuese.

Në Sicili llogaritet që në rreth një duzinë ngulimesh të reja të themeluara para vitit 1550, gjashtë prej tyre ishin koloni shqiptare dhe në tridhjetë e gjashtë qendra të reja të regjistruara, "katër ishin komunitete që ekzistonin qysh nga fundi i shek. XV": këto ishin Palazzo Adriano, Piana degli Albanesi, Mezzoiuso, Biancavilla. E njëjtë ishte gjendja edhe në Kalabri e cila "e dobësuar nga luftërat mes Aragonezëve dhe Anzhuinëve, gjatë çerekut të fundit të shek. XV […] po jepte shenja të qarta të dekadencës civile dhe ekonomike"[42]. Vetëm pas integrimit në strukturën sociale dhe ekonomike kalabreze të një numri të madh krahësh pune nga Shqipëria, u shënua një kthesë pozitive[43]. Rëndësi të veçantë në këtë proces patën edhe ngulimet arbëreshe të Puglias që ishin përjashtuar nga "detyrimet fiskale për dhjetë vjet prej autoriteteve Napolitane"[44] dhe që në zonat rreth Tarantos formuan të ashtuquajturën *Albania Tarantina* (ose *Salentina*), një lloj entiteti territorial homogjen për nga gjuha, zakonet dhe kulti fetar, si ato që do të krijohen dhe do të lulëzojnë më pas gjetkë në Itali. Gjatë shek. XVI janë të shumta gjurmët që kanë lënë shqiptarët në regjistrat famullorë të Galatinas, që ka studiuar dhe botuar Vincenzo Liguori, dhe që sot na lejojnë të flasim për një *Albania Salentina*. Po ashtu merr peshë të madhe përqendrimi i qendrave të reja rurale në rrethinat e Basilicata-s, që aty nga mesi i shek. XV kishte pësuar tkurrje demografike. Në vitet 1509-1510 u krye regjistrimi i familjeve shqiptare në 17 qendra në Vulture, po aq në krahinën e Potenza-s, dhe 23 në territorin e Senise-s[45]. Pati vendosje shqiptarësh edhe në viset mes pjesës jugore të Molise-

---

[42] Pietro De Leo, "Condizioni economico-sociali degli albanesi in Calabria tra XV e XVI secolo", në *Miscellanea di studi storici*, Università degli Studi della Calabria, Brenner, Cosenza, 1981, f. 124.

[43] Shih studimin paradigmatik të Italo Sarro, "Migrazioni albanesi", në *Hylli i Dritës. E përkohshme kulturale-letrare*, vjeti 25, nr. 1-2, Shkodër, 2015, f. 7-42, veçanërisht f. 20-33.

[44] Emidio Tomai-Pitinca, "Note su una comunità greco albanese di Taranto del XV secolo" në *Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata*, Ser. NS. vol. 33 (1979), Roma, 1979 f. 57-74; Emidio Tomai-Pitinca, "Comunità albanesi nel Tarentino sec. XVI (Premessa per un discorso di natura ecclesiale)", në *Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata*, Ser. NS, vol. 39 (1985), Roma, 1985 f. 217-232. Emidio Tomai-Pitinca, *Istituzioni ecclesiastiche dell'Albania Tarantina*, Università degli Studi di Lecce, Galatina, 1984, f. 12-13.

[45] Shih Antonella Pellettieri, "Gli albanesi e la regione del Vulture (I rapporti tra Albania e Meridione d'Italia; Gli insediamenti albanesi in Basilicata. Il caso della regione del Vulture)" në Filena Patroni Griffi, Antonella Pellettieri, Valeria Verrastro, *Minoranze etniche nel Melfese: ebrei, greci, albanesi tra medioevo ed età moderna*, Franco Angeli, 2002. Francesco Luigi Pietrafesa, *Rionero: note storiche e documenti*, prefazione del

s e dhe Capitanata-s veriore, që ishin prekur nga braktisja masive e tokave bujqësore për shkak të tërmeteve të shpeshta dhe epidemive të murtajës: na e dëshmon Imzot Tria[46], që në veprën e tij monumentale përshkruan ripopullimin e dioqezës së Larino-s dhe pasi përmend fshatrat Campomarino, Portocannone, Chieuti, Santa Croce, Ururi, Sant'Elena, Colle di Lauro, nuk bën fjalë për fshatra të tjera, edhe ato dikur të braktisura që ndërkohë ishin ripopulluar me kolonët e rinj nga Shqipëria[47].

6.– Një e dhënë tashmë e pranuar nga historiografia e sotme ka të bëjë me prirjen e fortë për t'u zhvendosur shpesh të kolonëve shqiptarë të Kalabrisë, Sicilisë, të cilët sikurse bashkatdhetarët e tyre të vendosur në krahina të tjera të Jugut, shpërnguleshin nga një fshat në tjetrin duke u dhënë jetë në këtë mënyrë proceseve migratore të brendshme – qoftë të organizuara, qoftë sporadike – që sot nuk është e lehtë të ndiqen e të rindërtohen me saktësi. Ky tipar, që nga njëra anë ka qenë nënvlerësuar ose injoruar krejt, nga ana tjetër ka qenë shtrembëruar dhe mistifikuar nga historiografia "tradicionale" arbëreshe, jo vetëm karakterizoi historinë e ngulimeve të reja që u ngritën në fund të shek. XV në Itali, por dëshmon edhe një rrjedhë të ndryshme të ngjarjeve që u paraprinë ngulimeve urbane të mirëfillta.

Në këtë pikë Daniele Gambarara nuk ka dyshime: "La costituzione di comunità albanesi in senso proprio non è avvenuta d'un colpo, con uno spostamento netto e definitivo, alle date tradizionali delle immigrazioni quattro-cinquecentesche, ma è il risultato di un lungo e tormentato processo, che comprende passaggi senza stanziamento attraverso centri diversi, rapido insorgere e rapido deperire di agglomerati provvisori, l'assorbimento in comunità italiane di stanziamenti albanesi minori, fusione sul suolo italiano tra albanesi di diversa provenienza e tra albanesi e italiani, spostamenti ancora da un centro albanese a un altro. Solo tra la fine del '500 e gli inizi del '600 cominciamo ad avere un certo numero di centri che costituiscono veramente 'comunità' albanesi, col loro rito, le loro feste, i loro costumi, la loro lingua, e la situazione comunque resta

---

prof. Antonio Cestaro Laurenziana, Napoli, 1982. Francesco Luigi Pietrafesa, *Per la storia di Ripacandida e del suo Casale Ginestra nel secolo XVII: i feudatari, gli apprezzi*, Laurenziana, Napoli, 1988.

[46] Shih Giovanni Andrea Tria, *Memorie storiche civili ed ecclesiastiche della città e diocesi di Larino, metropoli degli antichi Frentani*, per Gio: Zempel presso Monte Giordano, in Roma, MDCCLXIV (citato secondo l'edizione Cosmo Iannone Editore, Isernia, 1989), f. 411 *et passim*.

[47] Shih Cesare Colafemmina, *Slavi e albanesi in Puglia nel XV e XVI secolo*, prefazione di Pasquale Cordasco, Cassano delle Murge, 2013.

fluida ancora a lungo"[48].

Kjo qasje, e mbështetur sot nga të dhëna arkivore homogjene në rrafshin territorial dhe të qëndrueshme në diakroni, na jep një këndvështrim tjetër për interpretimin historik të dukurisë së veçantë të mërgimit shqiptar e përgjithësisht ballkanik, por edhe një shpjegim të pikave të errëta të rindërtimit të propozuar nga historiografia arbëreshe, përgjegjësja kryesore e kërkimit obsesiv të "prejardhjes fisnike". Nuk është rasti këtu të rikthehemi te çështja e të ashtuquajturve "koronej" që është trajtuar gjetkë[49]. Këtu po mjaftohemi të përmendim rolin objektiv që zhvilluan mercenarët që vinin nga trojet shqiptare gjatë procesit të integrimit të emigrantëve arbëreshë në sistemin feudal, rol ky që nuk përkon me imazhin e krijuar nga historiografia arbëreshe e cila është përpjekur të "shpikë" një kastë aristokratike që sot në rastin më të mirë të bën të qeshësh, ndërsa në rastin më të keq fsheh synimin e vetëdijshëm për të manipuluar të vërtetën historike. Punimet e studiuesit spanjoll José M. Floristán[50] kanë hedhur dritë në këtë faqe të historisë së mërgimit shqiptar në Itali, duke na dhënë kyçin për ta kuptuar më mirë këtë dukuri. Mes fundit të shek. XV dhe gjysmës së parë të shek. XVI lëvizjet migruese ishin nxitur nga autoritetet lokale të cilat synonin t'i vinin fre shpopullimit të disa zonave rurale. Shtimi i krahëve të punës shihej pozitivisht nga autoritetet, paçka se shpesh ngjallte konflikte të ashpra me popullsinë lokale[51] dhe karakterizohej nga prirja endemike e popullsive ballkanike për të mos u ngulitur në një vendbanim të përhershëm. Në këtë kuadër bëjnë pjesë masat që mori Ferdinandi II kur në vitin 1507 i ratifikoi lejen Lazzaro Matthes, kapiten i një trupe mercenarësh stradiotë në shërbim të kurorës së Spanjës, "leje që ia kishte dhënë Berlingerio Carafa nga dera e San Chirico Nuovo". Matthes u shpërndau të bijve zotërimet e tij feudale, ndërkohë që për vete mori shpërblime të tjera nga mbreti për punën që kishte bërë në organizimin

[48] Daniele Gambarara, "Parlare albanese nell'Italia unita" në *I dialetti italo-albanesi. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe*, (a cura di Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia, *Presentazione di Tullio De Mauro*), Bulzoni editore, Roma, 1994, f. 35.

[49] Shih Matteo Mandalà, "Mundus vult decipi"*: mitet e historiografisë arbëreshe*, vep. cit., f. 189-283; Italo Sarro, *Le migrazioni albanesi in Italia (secc. XV-XVIII): fonti e analisi*, Besa editrice, Lecce, 2019 (në proces shtypi).

[50] José M. Floristán, "Sociedad, economía y religión en las comunidades griega y albanesa de Nápoles y Sicilia", në *Erytheia. Revista de Estudios Bizantinos y Neogriegos* 37, 2016, f. 132-133.

[51] Për më tej shih Matteo Di Lena, "Incontri e Scontri tra Arbreshe e Italiani nel Molise" në Antonino Guzzetta (a cura di), *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia*, Atti dei IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi - Palermo, 25-28 Novembre 1981, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese - Università dì Palermo, Palermo, 1982, f. 107-121.

e fluksit migrator në krahinat e Puljes dhe të Bazilikatës. Ai kishte pasur për detyrë të kontrollonte ushtarakisht mërgimtarët që duhej të qëndronin brenda mureve të qyteteve ku ishin caktuar e të mos zhvendoseshin vazhdimisht.

Shembulli i Matthes nuk qe i vetmi, pasi në fakt asokohe kishte shumë krerë mercenarësh të cilët nga fundi i karrierës së tyre ushtarake vendosnin të investonin fitimet duke blerë koncesione për ndërtimin e ngulimeve të reja që pastaj i përdornin për veprimtari bujqësore. Floristán në hullinë e dokumenteve të botuara nga Martínez Ferrando[52], përmend vëllezërit Alfonso dhe Ferrando Castriota-Vranai, Teodoro Bischietto, Girolamo de Francisco, Salvador Rotta, Marco Antonio de Sanseverino, Giorgio Basta, Demetrio Capuzzimati, Dionisio Critopulo, Constantine Musaquis, Giorgio Sofiano dhe Miguel Ralis. Këtyre mund t'u shtojmë një pararendës, kapitenin shqiptar Cesare Masi, për të cilin do të flasim më poshtë, që aty nga fundi i shek. XV pati meritën të ripopullonte fshatin Biancavilla në Sicili[53]. Mjaft domethënës është rasti i ripopullimit të dytë, në shtator të vitit 1521, të fshatit Contessa Entellina në Sicili me anë të "rekrutimit" të kolonëve shqiptarë nga ishulli Andros[54]. Nuk duhet harruar as "prijësi shqiptar Gjon Gazuoli që solli në Pulje rreth 60 familje sllave të cilat u vendosën në fshatin Castelluccio degli Schiavi, në krahinën e Kapitanatës"[55]. Po të mbajmë parasysh përmasat e gjera që mori kjo dukuri, mund të themi se kemi të bëjmë me një profesion të vërtetë që synonte të tërhiqte kolonë të rinj në viset e braktisura të Italisë jugore, çka shpjegon, sikurse e ka vënë në dukje Floristán, rritjen e shpejtë të numrit të të ardhurve nga Ballkani në Mbretërinë e Napolit dhe "el esfuerzo que las autoridades españolas hicieron para asentarla y

---

[52] Shih Martínez J. E. Ferrando, *Privilegios otorgados por el emperador Carlos V en el reino de Nápoles*, CSIC-Instituto Jerónimo de Zurita, Barcelona, 1943.

[53] Giovanni Sangiorgio Mazza, *Storia di Adernò*, dalla tipografia di La Magna, Catania, 1820, f. 21-22.

[54] "8 settembre, X ind. 1521 – Sagali Curbi senior, Antoninus Lopes, Dimitri Serveja, Petrus Lopis, Ioannes Curbi, Michael Musacchi, Nicolaus Gerginus, Teodorus Nicolosi, Ioannes Petta, Petrus Musacchi, Sagali Curbi junior, Georgius Lopis, Angelus Petta junior, Nicolaus Lala, Petrus Lopis minor, Georgius Lopis, Thomas Manali, Dimitri Curbi, Ioannes Custagliorsi, Greci (sic) venientes ab Insula Andriae, partimm orientis, presentes coram nobis ... Antoninus et consortes, Greci orientales fugientes a dicta Insula, a manibus e servitute Mororum, quibus erant subditi, non volentes sufferre eorum dominium, navigaverunt Siciliam versus…; quod etiam praetendebant accedere ad habitandum casale Comitisse…": Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Napoli, 1923 (r.a. Piana degli Albanesi – Palermo 1988), f. XIII.

[55] Momčilo Spremić, "Gli slavi tra le due sponde adriatiche" në *Annali dell'Istituto Italiano per gli studi storici*, n. 6, 1973, f. 100; shih Cesare Colafemmina, "Nuovi documenti", cit., f. 78.

un ascenso social rápido de algunas familias de emigrados, cuyos miembros recibieron nombramientos como capitanes de guerra, feudatarios, beneficiarios de rentas y exenciones, etc.”[56]

Një dukuri e ngjashme u verifikua edhe në Istria gjatë shekullit XVII. Grupe pas a shumë të shumta shqiptarësh u nxitën të braktisnin viset përreth qyteteve të mëdha bregdetare (Shkodra, Tivari, Ulqini, madje edhe Vlora) për t’u zhvendosur në Veri të Dalmacisë falë disa “ndërmjetësve” që ndërhynin pranë autoriteteve venedikase, të cilat kishin interes të kolonizonin viset e shpopulluara, pra ekonomikisht të dobëta. Figurat e këtyre ndërmjetësve rezultojnë mjaft komplekse. Në shumë raste, si për shembull në atë të “Luca Duimo”, bëhej fjalë për njerëz që e ushtronin atë profesion në mënyrë të rregullt dhe siguronin kështu një burim të qëndrueshëm fitimi. Në raste të tjera bëhej fjalë për vetë krerët e fiseve shqiptare, fizionomia e të cilave, siç do ta shohim më poshtë, po del në dritë falë rindërtimit historik të komuniteteve arbëreshe të Italisë së Jugut, karakterizonte për shekuj me radhë strukturën dhe organizimin social të tyre[57]. Nuk është e rastit që ndonjëherë këta krerë merrnin nën kontroll vendbanimin e ri duke kryer funksione publike që i vendosnin në nivele të larta shoqërore aq sa ndonjëherë në kronikat e mëvonshme historike përmenden si bujarë që kishin hyrë në radhët e aristokracisë ushtarake.

Dukuria e ngritjes shoqërore të këtyre personazheve të cilët mes epokës humaniste dhe asaj të rilindjes italiane tërhoqën vëmendjen e artistëve dhe intelektualëve italianë[58] nuk preku mercenarët e famshëm shqiptarë – të ashtuquajturit “stradiotë” – të cilët pak a shumë në të njëjtën periudhë mbushën radhët e ushtrive italiane, nga Veriu në Jug të gadishullit Apenin. Në një studim të vëllimshëm të kohëve të fundit Francesco Storti ka rindërtuar praninë e mercenarëve shqiptarë që u rekrutuan në këmbësorinë dhe kalorësinë e lehtë të Napolit gjatë shek. XV[59]. Shumë të kërkuar për trimërinë e tyre, qysh nga viti

[56] José M. Floristán, “Sociedad, economía y religión” cit., f. 134.

[57] Mbi praninë e shqiptarëve në Istria dhe implikimet sociale të saj shih Matteo Mandalà, “Gli Albanesi in Istria (sec. XV-XVIII)” në Ardian Ndreca, *Symbiosis on the shores of the Adriatic Sea*: *encounters and dialogues among cultures, Atti della Conferenza internazionale tenutasi a Zara il 3-5 ottobre 2019, Shêjzat-Le Pleiadi, nuova serie, (në shtyp e sipër).*

[58] Shih studimin e Giuseppe Vidossi, “La più antica testimonianza dell'albanese ‘mjekrë’ *barba*”, në *Saggi e scritti di folklore*, Prefazione a cura di Paolo Toschi, Torino, Bottega d’Erasmo, 1960, f. 270-281.

[59] Shih Francesco Storti, *Fanteria e cavalleria leggera nel Regno di Napoli (XV secolo)*, Archivio storico per le province napoletane, Società napoletana di Storia patria, Napoli, 2015; të shihet në veçanti paragrafi “Regnicoli, albanesi, tedeschi e turchi”, f. 12-20.

1461[60] kur Skënderbeu zbarkoi në Itali për të ndihmuar Ferdinandin I, "ushtarët shqiptarë mbushën radhët e reparteve mbretërore ku hynë si ushtarë me pagesë. Nga ai çast Italia e Jugut, falë afrisë gjeografike dhe lidhjeve të vjetra mes dy vendeve, u bë pikëmbërritje e privilegjuar e këtyre luftëtarëve ballkanikë"[61]. Gjatë dhjetëvjeçarëve që pasuan numri i tyre rritet dhe aty nga fundi i viteve '70 të shek. XV "numri i ushtarëve shqiptarëve me pagesë barazohet me numrin e rekrutëve lokalë të cilët thuajse të gjithë u përkisnin zotërimeve të mbretit"[62]. Në hullinë e përfundimeve të Storti-t, vlen të përmendet fakti se këta shqiptarë caktoheshin të banonin në zona të ndjeshme nga pikëpamja "ushtarake", pra në po ato vise ku ngriheshin qendrat urbane në të cilat ishin vendosur – me vendbanim pak a shumë të përkohshëm – emigrantët e mirëfilltë ekonomikë[63], d. m. th. masa e madhe e krahëve të punës, që ishin punësuar si bujq, barinj dhe artizanë. Meqenëse qoftë të parët, qoftë të dytët do të pësojnë të njëjtin fat, pra do të asimilohen plotësisht (Storti flet për "integrim"), duhen dalluar, jo vetëm në rrafshin metodologjik, nga pjesa tjetër e ngulimeve që u ngritën në Jug të Italisë, ku u krijuan komunitete të qëndrueshme, homogjene nga pikëpamja kulturore dhe historikisht më jetëgjata. Kjo vlen sidomos po të kihet parasysh se të njëjtin

[60] Shqiptarët kishin shkuar në ndihmë të Ferdinandit I qysh në nëntor të vitit 1460: shih Constantin Marinescu, "Alphonse V, roi d'Aragon et de Naples, et l'Albanie de Scanderbeg", në *Mélanges de l'Ecole Roumaine en France*, I, Paris, 1923; Gennaro Maria Monti, "La spedizione in Puglia di Giorgio Castriota Scanderbeg e i feudi pugliesi suoi della vedova e del figlio", në *Iapigia, organo della real deputazione di storia patria per le Puglie*, nuova serie, anno X, 1939, fash. 3, f. 130; Francisc Pall, "I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV. (Documenti inediti con introduzione e note storico-critiche)" në *Archivio Storico per le Province Napoletane*, III s., 4, vol. LXXXIII, 1965, fl. 148-150; Vlen të sjellim këtu nga Storti përshkrimin që u bën ambasadori A. da Trezzo dhe prijësi ushtarak Roberto Sanseverino stradiotëve, kalorësve shqiptarë që mbërritën në Napoli në vitin 1460 për të ndihmuar Ferdinandin I: "Essi hanno li loro cavalli che sono tutti grandi corratori, et tali che con quella facilità vano ad corere longe da casa XXX et XL miglia, che li soldati italiani andassero X o XII": Francesco Storti, *Fanteria e cavalleria leggera*, cit., f. 22-23. Skëndërbeu vetë, siç dihet, mbërriti në gusht të vitit 1461: shih Giovanni Gioviano Pontano, *De bello Neapolitano et De sermone*, a cura di Pietro Summonte, Neapoli ex officina Sigismundi Mayr artificis diligentissimi, mense Maio M.D.VIIII.

[61] *Po aty*, f. 15.

[62] *Po aty*, f. 16.

[63] Disa dokumente pagesash të vitit 1468 flasin për trupa të vendosura në "contado di Mareri" në Abruzzo, ku banonin emigrantë shqiptarë (shih Lorenzo Giustiniani, *Dizionario geografico-ragionato del Regno di Napoli*, Tomo V, Napoli, 1802, f. 362-363). Stradiotët, që shpesh për arsye ushtarake shpërndaheshin në vise të ndryshme (Barletta, Matera, Atella, Melfi, Spinazzola, Molfetta, Brindisi, Taranto, Lecce, dhe në qytete të tjera të Otrantos), ishin shkrirë me forcat lokale. Sipas Storti-t nuk bëhej fjalë për një asimilim vetëm taktiko-organik: Francesco Storti, *Fanteria e cavalleria leggera*, cit., f. 32.

asimilim pësuan stradiotët dhe të ashtuquajturit *cappelletti* që morën pjesë në luftërat e Venedikut kundër osmanëve[64] në Friuli, më saktë në rrethinat e Gorizia-s[65]. Në fakt nuk do të mbetet asnjë gjurmë onomastike nga ushtarët dhe emigrantët e tjerë shqiptarë as në dokumentet e pagesave të mercenarëve, as në kontratat e ndryshme noteriale, ndryshe nga pjesa më e madhe e më pak e bujshme e emigrantëve që arritën të krijonin komunitet.

Procesi i gjatë dhe i mundimshëm i urbanizimit që gjatë shekujve XV-XVIII do të përfshijë krahinat e ndryshme të Italisë jugore ku ishin vendosur arbëreshët, paraqet edhe këto tipare që duhen mbajtur parasysh. Gjithsesi do theksuar se në zhvillimin e këtij fenomeni ndikuan edhe faktorë të tjerë. Për të rindërtuar dinamikën e brendshme migratore dhe sidomos për të mos rënë në po ato gabime interpretimi të natyrës antropologjike ose historiko-sociale që mbushin faqet e historiografisë arbëreshe, duhet inkuadruar drejt prirja e theksuar për të lëvizur vazhdimisht që karakterizonte emigrantët ballkanikë, sidomos shqiptarët dhe sllavët, duke filluar nga pranimi i shkaqeve të vërteta që e gjeneruan dhe e ushqyen atë: nga njëra anë, kultura latente në thelb nomade dhe organizimi shoqëror arkaik i shqiptarëve që, siç do ta shohim më poshtë, do të shkaktojnë zhvendosje të vazhdueshme para se të arrihet në urbanizimin përfundimtar të emigrantëve; nga ana tjetër, kushtet e rënda financiare që mërgimtarët këmbëngulnin të mos pranonin, e së fundi, mosbesimi dhe armiqësia që popullata lokale shfaqte ndaj "të huajve". Në paragrafin që vijon do të përshkojmë,

---

[64] Michael E. Mallett, *L'organizzazione militare di Venezia nel '400*, Jouvence, Roma, 1989, f. 63-65 dhe f. 107, shën. 9; Eugenio Barbarich, "Gli stradiotti nell'arte militare veneziana", në *Rivista di Cavalleria*", vol. XII, 1904, f. 52 e vijim.

[65] Për luftimet në Friuli shih Elisabetta Scarton, "Sulle tracce dei Turchi in Friuli. Frammenti di un'*inquisitio* per sciacallaggio nell'estate del 1478", në *"Ingenita curiositas". Studi sull'Italia medievale per Giovanni Vitolo*, a cura di B. Figliuolo, R. Di Meglio, A. Ambrosio, Laveglia, Salerno 2018, tomo I, f. 179-191 (shih f. 188). Do pasur parasysh se përfshirja e trupave të shqiptarëve – të ashtuquajturit *cappelletti* – do të vijojë deri në gjysmën e parë të shek. XVII me pjesëmarrjen e tyre në betejat që u zhvilluan në vitin 1622 në brigjet e Izoncit mes qyteteve Gorizia, Lucinico, Gradisca, Bruma. Shih Faustino Moisesso, *Historia della ultima guerra nel Friuli di Faustino Moisesso con le figure del paese dove si ha guerreggiato et una tavola de nomi di alcune persone spetialmente in essa guerra intervenute et loro attioni, et avenimenti*, libri due, vol. II, appresso Barezzo Barezzi, In Venetia, 1623, f. 47-48. Shih Giuseppe Trebbi, *Il Friuli dal 1420 al 1797. La storia politica e sociale*, Udine, Casamassima, 1998, f. 56 dhe 266. Giuseppe Trebbi, "Venezia, Gorizia e i Turchi. Un discorso inedito sulla difesa della Patria del Friuli (1473-1474)", në *Da Ottone III a Massimiliano I. Gorizia e i conti di Gorizia nel Medioevo*, a cura di Silvano Cavazza, Mariano del Friuli (Gorizia), Edizioni della Laguna, 2004, f. 375-396. Shih Liliana Ferrari - Donata Degrassi - Paolo Iancis (a cura di) *Storia di Lucinico*, Poligrafiche San Marco, Cormons, 2011, f. 176-177.

me aq sa do të na lejojnë burimet arkivore, rrugën e mundimshme që ndoqën arbëreshët, të cilët pasi zbarkuan në brigjet e Adriatikut, u shpërndanë në krahina të ndryshme ku ende gjejmë gjurmë të kalimit të tyre ose, në rastet më fatlume, të ngulimit të tyre.

7.– Në fakt ndërtimi i komuniteteve arbëreshe ashtu siç i njohim sot nuk ndodhi menjëherë, me një shpërngulje të prerë dhe përfundimtare gjatë valëve të shekujve XV-XVI, por ishte rezultat i një procesi të gjatë e të mundimshëm, që përfshinte kalime të shpeshta nga një fshat në tjetrin, ngritjen dhe rënien e herëpashershme të aglomerateve të përkohshme, asimilimin nga komunitetet lokale italiane të ngulimeve të vogla arbëreshe, shkrirjen mes shqiptarëve të ardhur nga krahina të ndryshme, si edhe mes shqiptarëve dhe italianëve, zhvendosje familjesh të tëra nga një fshat arbëresh në tjetrin etj. Vetëm në kapërcyell të shek. XVI-XVII fillojmë të kemi disa ngulime që përbëjnë vërtet komunitete arbëreshe, me ritin, festat, zakonet, gjuhën, por gjithsesi gjendja mbetet e paqëndrueshme për një kohë të gjatë.

Në Kalabri kjo prirje për lëvizshmëri, që me gjasa i detyrohej përpjekjeve për t'iu shmangur kontrolleve fiskale, dëshmohet në disa dokumente të gjysmës së parë të shek. XIV të "Regia Camera Sommaria" ku përmenden *hambarë kashte të djegur dhe kasolle të braktisura* pak përpara se të mbërrinin funksionarët mbretërorë për të bërë regjistrimin[66]. Lëvizshmëria e brendshme do të vazhdojë për një kohë të gjatë, sikurse dëshmohet edhe në veprën e Girolamo Marafiotit, që u botua në Napoli në vitin 1595[67].

Evazioni fiskal nuk ishte shkaku i vetëm i zhvendosjeve nga një fshat në tjetrin, pasi ndikonte dhe kërkimi i një vendi më të përshtatshëm, kërkim që përpara se të përfundonte me zgjedhjen e një vendi përfundimtar, kalonte përmes një faze pak a shumë të gjatë sistemimesh të përkohshme.

Në Kalabri "joshja drejt zonave fushore që siguronin prodhim më të

---

[66] Shih Domenico Cassiano, *Strigàri. Genesi e sviluppo di una comunità calabro arbreshe*, Marco editore, Cosenza, 2004, f. 17.

[67] "Non tengono case fabbricate, ma tugurij, e capanne di tavole. Sogliono tenere dentro i loro tugurij alcune profonde fosse, dentro le quali ascondono bovi, porci, vitelli, e ogni altra cosa. Eglino mai abitano in paese piano, ma solo dentro le montagne, e boschi, e nò fabbricano case, acciò nò stiano soggetti a Baroni, Duchi, Principi, o altri Signori. E se per sorte nel territorio dove abitano il Signore volesse alquanto lor maltrattare, eglino donano fuoco alli tugurij, e vanno ad abitare nel territorio d'altro Signore": Girolamo Marafioti, *Croniche et antichità di Calabria*. Conforme all'ordine de' testi greco, & latino, raccolte da' più famosi scrittori antichi, & moderni, ove regolarmente sono poste le citta, castelli, ville, monti, fiumi, fonti, & altri luoghi degni di sapersi di quella provincia… in Padova: ad instanza de gl'Vniti, 1601, f. 273-274.

madh bujqësor dhe kushte më të mira jetese"[68], shtyu një grup familjesh shqiptare të shpërnguleshin nga Vaccarizzo drejt fshatit San Cosmo, ku gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shek. XVI filluan "të ndërtonin shtëpitë e para "me gëlqere dhe rërë" ose kasolle qerpiçi"[69]. Këto zhvendosje në të vërtetë ishin kryer disa dhjetëvjeçarë më parë dhe kishin të bënin me grupe mërgimtarësh që u vendosën në rrethinat e Badia di San Demetrio. Para se të sistemoheshin përfundimisht aty ku sot ngrihet Shën Mitër Korona, me sa duket arbëreshët që e themeluan ishin vendosur më parë në një ngulim të përkohshëm që quhej lagjja Magarotti ose Filla, për të lëvizur më pas drejt një qendre të re që quhej Sancto Dimitrio. Sipas Innocenzo Mazziotti-t "fillimisht vendbanimet e mërgimtarëve ishin të lëvizshme dhe përbëheshin nga fushime me shatorre që lëviznin sipas nevojave të komunitetit"[70]. Nisur nga natyra nomade e këtyre grupeve ka gjasa që fshatrat San Cosmo (në arbërisht *Strigari*), Vaccarizzo, dhe San Giorgio (në arbërisht *Mbuzati*), që ndodhen "në skaj të feudit Sant'Adriano"[71], të jenë ngritur pas vendosjes së arbëreshëve, kur disa grupe të vogla u shkëputën nga bërthama fillestare dhe i dhanë jetë një procesi të ri kolonizimi të brendshëm. Kështu u themelua Santa Sofia, që u ngrit në feudet e Peshkopëve të Bisignano-s: "Tokat e para arbëreshëve iu dhanë nga Peshkopi Francesco Piccolomini d' Aragona (1498-1530), sikurse del nga një përmbledhje noteriale e vitit 1586; mungon data e saktë e aktit, që duhet t'i përkasë periudhës mes viteve 1515-1520"[72].

Gjithmonë në Kalabri, por në viset e Catanzaro-s, kemi të dhëna për zhvendosje mërgimtarësh nga ngulimet ku ishin sistemuar fillimisht. Kështu, fshatrat Arenoso dhe Casalnuovo nga viti 1550 deri në gjysmën e shek. XVII pësuan rënie të ndjeshme të popullsisë për shkak të largimit të shumë familjeve që kërkonin vendbanime ekonomikisht më tërheqëse[73].

---

[68] Domenico Cassiano, *Strigàri*, cit., f. 13.

[69] *Po aty*, f. 14.

[70] Innocenzo Mazziotti, *Immigrazioni albanesi in Calabria nel XV secolo e la colonia di San Demetrio Corone (1471-1815)*, Amministrazione Comunale di San Demetrio Corone, Edizioni il Coscile, Castrovillari, 2004, f. 91. Shih dhe Vincenzo Giura, "La vita economica degli albanesi in Calabria nei secoli XV-XVIII" në *Gli albanesi in Calabria. Secoli XV-XVIII*, a cura di Claudio Rotelli, Edizioni Orizzonti Meridionali, Cosenza, 1990, f. 74 *et passim*.

[71] *Po aty*, f. 92.

[72] *Po aty*, f. 93.

[73] Shih Francesco Maiorana, Caraffa di Catanzaro. Lineamenti storici di un Paese Albanese, Lamezia Terme, 1992, f. 42-53

Prania e arbëreshëve në qytetet pulieze Manduria[74], Lecce[75], Brindisi[76], Galatina[77] dhe Taranto[78] dokumentohet nga shumë akte që u përkasin viteve të para të shek. XVI, mirëpo në fund të atij shekulli nuk mbeti asnjë gjurmë prej tyre[79]. Arsyet e kësaj "zhdukjeje" të papritur nga burimet lokale mund të kërkohen qoftë në asimilimin e këtyre grupeve të izoluara të mërgimtarëve, qoftë edhe në politikat e reja të kolonizimit të brendshëm që ndërmorën feudalët lokalë. Në fakt nuk përjashtohet që në këtë mes të kenë ndikuar koncesionet që u premtoheshin mërgimtarëve po të pranonin të zhvendoseshin jashtë mureve të qyteteve pra të shndërroheshin në kolonë potencialë. Nga kjo pikëpamje janë domethënëse kolonizimet e brendshme që përfshinë fshatrat e provincave pulieze sidomos në anët e Tarantos. Shumë arbëreshë "kishin ripërtërirë këtu disa fshatra të braktisura, ndërsa në fshatra të tjera bashkëjetonin me italianët dhe italo-grekët"[80]. Fshati Faggiano në provincën e Tarantos "në vitin 1470 ishte

---

[74] Shih Michele Greco, "Immigrazione di albanesi e levantini in Manduria desunta dal *Librone Magno*" në *Rinascenza salentina. Organo della Real Deputazione di Storia Patria per le Puglie*, R. Tipografia Editrice Salentina, anno VIII (n.s.), 1940, Lecce, f. 329-343. Shih Michele Greco, "Un nucleo di albanesi e levantini in Manduria nel secolo XV e XVI" në *Rivista d'Albania*. Centro studi per l'Albania, anno IV, Fasc. 2, Roma, 1943, f. 90-108. Shih Benedetto Fontana, *Le famiglie di Manduria dal XV secolo al 1930. Capostipiti - provenienza - Uomini illustri*, Saggio introduttivo di Gianni Jacovelli Prefazione e note bibliografiche di Elio Dimitri, Centro servizi educativi e culturali, Manduria, 2005.

[75] Shih Salvatore Panareo, "Albanesi nel Salento e Albanesi al servizio del Regno di Napoli" në *Rinascenza salentina. Organo della Real Deputazione di Storia Patria per le Puglie*, R. Tipografia Editrice Salentina, anno VII (n.s.), 1939, Lecce, f. 209-220. Shih Gino Giovanni Chirizzi, "Albanesi e corfioti immigrati a Lecce nei secoli (XV-XVII)" në *Annuario del liceo ginnasio statale Giuseppe Palmieri*, 1995-1996, Lecce, 1996, f. 171-189.

[76] Andrea della Monaca, *Memoria historica dell'antichissima, e fedelissima città di Brindisi*, Appresso Pietro Micheli, Lecce, 1674, f. 559. Sipas Della Monaca "Tururano fin'à giorni nostri fù abitato d'Albanesi, che vivevano con rito greco, ma al presente sono gl'habitatori tutti italiani, vivendo col rito Latino": *po aty*, f. 341.

[77] Shih Giancarlo Vallone, "Il laboratorio dell'accoglienza. Albanesi a Galatina (sec. XV-XVII)" në *Tra letteratura e storia*. Studi in onore di Rosario Jurlaro, a cura di Mario Spedicato, Edizioni Panico, Galatina, 2008, f. 65-76. Shih Umberto Congedo, "I Castriota Scanderbergh [sic!] Duchi di Galatina (1485-1561)" në *Rivista Storica Salentina* fondata e diretta da Pietro Palumbo, annata prima (1903-1904), Ristampa fotomeccanica, Mario Congedo Editore, Lecce, 1903, f. 152-183.

[78] Shih Pietro Dalena, "Insediamenti albanesi nel territorio di Taranto (Secc. XV-XVI): realtà storica e mito storiografico" në *Miscellanea di studi storici*, vol. VIII (1989), Dipartimento di Storia dell'Università della Calabria, Rubbettino Editore, Soveria Mannelli, 1989, f. 35-105.

[79] F. A. Primaldo Coco, *Casali albanesi nel Tarentino: studio storico critico. Con documenti inediti*, Scuola tipografica Italo-orientale "S. Nilo", Grottaferrata, 1921, f. 17-21.

[80] *Po aty*, f. 21.

ripopulluar nga vendasit dhe nga arbëreshët"[81]: këta të fundit, që dokumentet e kohës i quajnë "endacakë" (vagabondi), duke u urbanizuar në fakt ndërrojnë statusin social dhe shndërrohen përfundimisht në kolonë të rinj. Shembulli i kolonëve të fshatit Faggiano mund të jetë ndjekur më vonë nga shumë arbëreshë të tjerë të shpërndarë në provincën e Salentos. Gjatë shekullit XVI shumë gjurmë antroponomastike shqiptarësh hasen në aktet e regjistrave famullitare të studiuar nga Vincenzo Liguori[82]: janë po ato gjurmë arkivore që mundësojnë rindërtimin e profilit historiografik të ashtuquajturës *Albania Salentina*. Dëshmitë e para të shndërrimit të tyre të ngadaltë nga grupe nomadësh në popullsi sedentare u përkasin viteve 1507-1509, kur u dhanë privilegjet "për të populluar disa fshatra me gjinde shqiptare"[83]. Këto ngulime të para u ndoqën, me luhatje, nga procese të mëtejme stabilizimi të nxitura madje nga vetë feudalët. Domethënës është rasti i regjistruar në vitin 1514, kur Geronima De Montibus, që i zuri vendin të shoqit të vdekur në administrimin e feudit, i transferoi të gjithë shqiptarët që gjendeshin në Fragagnano në fshatin e afërt Monteparano. […] Pra nga viti 1509 deri aty nga viti 1530 u populluan të gjitha fshatrat arbëreshe të Tarentos"[84]. Po ashtu ngjau me fshatin "e quajtur San Marzano i mbushur me shpella të banuara, për të cilin kemi të dhëna qysh nga viti 1281. Në vitin 1463 ky fshat rezultonte i pabanuar mirëpo ndodhi diçka që shkaktoi ripopullimin e këtij ngulimi të vogël shkëmbor: mbërritën mërgimtarët shqiptarë", prania e të cilëve "në këtë situatë shpopullimi u pa me sy të mirë jo vetëm nga sovranët por edhe nga vetë feudalët, që me atë rast mundën të ripopullonin fshatrat e rrënuara dhe të kompensonin së paku pjesërisht humbjen e popullsisë"[85]. Ky proces shoqërohej shpesh me marrëveshje politike që tërhiqnin ballkanasit, sepse u ofronin atyre një strehë të sigurt dhe i shtynin të vendoseshin përfundimisht në një ngulim të qëndrueshëm.

Në të njëjtën mënyrë mund të rindërtohet edhe faza e parë e ngulimeve

---

[81] Fr. A. Primaldo Coco, *Faggiano: primo casale albanese del Tarentino*, Stabilimento Tipografico Pappacena, Taranto, 1928, f. 35.

[82] Vincenzo Liguori, "Famiglie e parentele nei registri parrocchiali galatinesi del Cinquecento" në *Bollettino storico di Terra d'Otranto*, n. 7, Congedo, Galatina, 1997, f. 63-118.

[83] *Po aty*, f. 23.

[84] Po aty.

[85] Antonella Pellettieri, "Borghi nuovi e centri scomparsi fra Terra d'Otranto e Terra di Bari" estratto da *Puglia tra grotte e borghi*. Atti del II Convegno internazionale sulla civiltà rupestre, a cura di Enrico Menestò, Centro italiano di Studi sull'Alto medioevo, Spoleto, 2005, f. 51.

në Sicili. Themeluesit e fshatit Piana degli Albanesi, sipas një gojëdhëne që botoi Zef Skiroi[86], pasi u endën për një kohë të gjatë, ngritën një fushim në shpatet e malit Pizzuta, me shpresën se mund të siguronin lejet e nevojshme nga autoriteti që kishte në pronësi ato toka, në mënyrë që të zgjidhnin pastaj një vend më të përshtatshëm për të ndërtuar fshatin. Në një "ngulim të përkohshëm, të quajtur fshati i grekëve, të formuar nga shatorre, kasolle dhe banesa kësodore"[87], u vendosën banorët e parë të një qendre të vjetër saraçene të braktisur me emrin Manzil Yûsuf, italianizuar më vonë në Mezzoiuso. Sipas burime të vjetra historike, ishin arbëreshë nga Piana ata që në vitin 1501, së bashku me "të tjerë të ardhur nga vende të ndryshme, populluan Mezzoiuso-n"[88], duke u vendosur në lagjen e quajtur Albergheria, që ekziston edhe sot në Mezzoiuso[89]. Arbëreshët që populluan Biancavilla-n, me të zbarkuar – sipas gojëdhënës – në Messina, do t'i jenë drejtuar Catania-s nën udhëheqjen e "bujarit" Cesare Masi, i cili "meqenëse nuk shihte dot më gjindjen e tij që endej lart e poshtë në mjerim të plotë, e vendosi nën disa mullarë kashte në territorin e Adernò-së dhe pranë shtegut të quajtur Callicari"[90]. "Kolonia e territorit të Callicari-t – shton Placido Bucolo – pasi ngriti fushimin me lejen gojore të Kontit Gian Tommaso Moncada dhe me detyrimin të kultivonin tokën dhe të paguanin një kontribut, zuri të ndërtojë disa shtëpi kolonësh"[91]. Gjatë shek. XVI disa familje nga Mezzoiuso, me të marrë vesh se Konti Gravina donte të ripopullonte qendrën e braktisur San Michele di Ganzaria, "u zotuan të sillnin në atë vend tridhjetë familje dhe të ndërtonin aty disa kasolle të përkohshme, duke mos mundur të ndërtonin menjëherë shtëpi, të cilat ata premtonin se do t'i ndërtonin brenda një viti". Pak a shumë në të njëjtën periudhë dhe për të njëjtat arsye themelohet fshati Sant'Angelo Muxaro, që sot është krejt i sicilianizuar sikurse edhe San Michele di Ganzaria, ndërsa në fund të shekullit XVII, saktësisht në vitin 1691, disa dhjetëra familje me prejardhje nga Piana degli Albanesi themelojnë fshatin Santa Cristina Gela[92].

I njëjti fenomen ngjau edhe Basilicata, me gjithë interpretimet kontradiktore dhe mitike të historiografisë arbëreshe mbi natyrën e privilegjeve dhe të

---

[86] Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Napoli, 1923 (r. a. Piana-Palermo, 1986), f. LXXIX.

[87] *Po aty*, f. XLVI.

[88] Shih Ignazio Gattuso, *Opere*, vol. I-III, a cura di Matteo Mandalà, Pietro Di Marco, Giuseppe Di Miceli, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2004.

[89] Ignazio Gattuso, "Manzil Yûsuf", në *Opere*, cit., vol. I, f. 221.

[90] Giovanni Sangiorgio Mazza, *Storia di Adernò*, dalla tipografia di La Magna, Catania, 1820, f. 21-22.

[91] Placido Bucolo, *Storia di Biancavilla*, Grafiche "Gutenberg", Adrano, 1953, f. 40.

[92] Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali*, cit., f. CXXXI-CXXXIII.

lehtësive që iu njohën kolonëve arbëreshë në kohën e të ashtuquajturve "koronej"[93]. Prania e mërgimtarëve shqiptarë në regjistrat më të vjetër të fondit "Tesorieri e Percettori" të Basilicata-s, është sporadike gjatë viteve 1475 dhe 1479, por më e shpeshtë në vitin 1498. Shtohen vatrat gjatë shekullit XVI, kur "disa mërgimtarë vendosen në dioqezën e Anglona-s, ndërsa të tjerë vendosen në feudet e Sanseverinos", duke themeluar ose ripopulluar shumë fshatra, "si Maschito, Barile, Ripacandida, prej së cilës pastaj shkëputet fshati i sotëm Ginestra"[94]. Sipas të dhënave arkivore të shqyrtuara nga Carlo Palestina, ishte administrata qendrore ajo që ndërpreu zakonin e shqiptarëve për të çuar një "jetë nomade" dhe i detyroi të vendoseshin "në banesa me mure. Të prirë ndaj nomadizmit, mërgimtarët zakonisht strehoheshin në kasolle ose në shpella", mirëpo kjo vështirësonte regjistrimin dhe numërimin e tyre, pra edhe llogaritjen e saktë të taksave. Në të vërtetë zhvendosjet e shpeshta që verifikohen në Vulture nuk ndryshojnë shumë nga ato që ndodhnin në krahina të tjera të Italisë, madje edhe arsyet janë pak a shumë të ngjashme[95]. Regjistrat fiskalë të analizuar nga Palestina dokumentojnë dy fakte të pakundërshtueshme: i pari, se gjurmët e kalimeve të familjeve të veçanta të sllavëve dhe të shqiptarëve në shumë qendra rurale të Vulture-s nuk ishin më pak të përkohshme sesa ato që i detyronin mërgimtarët të strehoheshin në kasolle dhe shpella në pritje të një sistemimi përfundimtar. Zhdukja e tyre nga fshatrat Accadia, Ariano[96], Atella, Bella, Bisazza, Castello Franco, Castello del Barone, Castelgrande, Cedogna, Forenza, Gesualdo, Lavello, Melfi, Mirabello, Montemilone, Muro Lucano, Palazzo San Gervaso, Pescopagano, Porcarino, Rapolla, Rapone, Ripacandida, Rochetta, Ruvo del Monte, San Fele, Spinazzola, Vallata, Venosa, që nuk mbahen si të themeluara a të ripopulluara nga shqiptarët, shpjegohet vetëm me zhvendosjet e shpeshta nga një lokalitet në tjetrin me synimin për të gjetur atë sistemim përfundimtar që është në themel të shkakut të dytë: si "krahë pune" për t'u përdorur në feudet

[93] Mbi çështjen e "koronejve" shih Shih Matteo Mandalà, *Mundus vult decipi: mitet e historiografisë arbëreshe*, "Naimi" Shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë, 2016, f. 189-296. Me vlerë janë edhe gjurmimet arkivore që ka kryer kohët e fundit Italo Sarro: shih Italo Sarro, "La questione dei Coronei" në Francesco Altimari, Gezim Gurga, Shaban Sinani (a cura di), *Matteo Mandalà dhe albanologjia sot - Në 60-vjetorin e lindjes*, Fast Print, Tiranë, 2018, f. 461-484.

[94] Carlo Palestina, *Fuochi albanesi nella provincia di Potenza nel secolo XVI*, Provincia di Potenza, Potenza, 2004, f. 8-9.

[95] Francesco Luigi Pietrafesa, *Le immigrazioni albanesi nella regione del Vulture*, Rionero, Radici, 1991.

[96] Tommaso Vitale, *Storia della regia città di Ariano e sua diocesi*, Nella Stamperia Salomoni, Roma 1794, f. 408.

e braktisura, për këta kolonë ishte më e volitshme të mblidheshin rreth qendrave rurale, që sot i mbajmë si të themeluara nga shqiptarët, por vetëm pasi siguronin të njëjtat privilegje "feudale" që u ishin dhënë bashkatdhetarëve të tyre në krahinat e tjera italiane.

Dinamika sociale që nga shthurja fillestare solli në krijimin e komuniteteve etnikisht dhe shoqërisht kompakte u përcaktua nga faktorë ekonomikë dhe jo nga arsye "pasigurie", që sado të rënda të kenë qenë, nuk do ta kishin shqetësuar shumë një shtet feudal që nuk ngurronte të përdorte dhunën për të siguruar rendin publik. Interesimi i administratës mbretërore për t'i mbledhur mërgimtarët e shpërndarë gjithandej nëpër qendra rurale të qëndrueshme, përveçse nga arsye fiskale, motivohej sidomos nga efektet pozitive që do të kishin sjellë politikat e kolonizimit të brendshëm përmes rifutjes në ciklin e prodhimit të feudeve të braktisura.

I njëjtë ka qenë edhe zhvillimi i gjendjes në provincën e Potenza-s dhe në territorin e Senises, që mes viteve 1509-1511 regjistrojnë praninë e shqiptarëve në rreth dyzet qendra rurale, të cilat sot nuk mbahen si të themeluara nga shqiptarët. Këto investime do të kenë tërhequr edhe mërgimtarë të tjerë, që fillimisht ishin vendosur në Melfi, pastaj për shkak të mosmarrëveshjeve me autoritetet e qytetit, vendosën të transferoheshin më në brendësi dhe t'i kushtoheshin tërësisht bujqësisë dhe blegtorisë. Një dëshmi tjetër domethënëse është transferimi në vitin 1774 në Brindisi di Montagna i shqiptarëve që fillimisht ishin vendosur përkohësisht në Abruzzo, ku kishte edhe fshatra të tjera me arbëreshë qysh nga gjysma e shek. XVI[97]. Ka plotësisht të drejtë Antonella Pellettieri kur pohon se vështirësia "për të llogaritur numrin e saktë të shqiptarëve që kishin zbarkuar në brigjet e Italisë jugore" i detyrohej kryesisht dy arsyeve: "shpesh refugjatët zhvendoseshin nga një qendër në tjetrën: këto mërgime të

[97] Shih Angiola De Matteis, *L'Aquila e il contado. Demografia e fiscalità (secoli XV-XVIII)*, Napoli, Giannini, 1973; Sandro Galantini, "Gli insediamenti di Albanesi e Schiavoni nell'Abruzzo Ulteriore: Cologna, Teramo e Silvi", në *Abruzzo oggi*, a. XI [1988], n. 8, f. 17-19; Adelmo Marino, "Le popolazioni alloglotte nella regione abruzzese e il caso di Villa Bozza, Schiavi d'Abruzzo e Villa Badessa", në *L'Abruzzo e la Repubblica di Ragusa tra il XIII e il XVII secolo*, Atti del convegno di studi storici dell' associazione archeologica frentana (Ortona, 25-26 luglio 1987), a cura di Nicola Iubatti e Nicola Serafini, Ortona, Associazione archeologica frentana, 1989, vol. I, f. 49-74. Sandro Galantini, "Gli Albanesi e Schiavoni che popolarono siti dell'Abruzzo", në *L' Abruzzo e la Repubblica di Ragusa tra il XIII e il XVII secolo*, cit, vol. II, f. 33-35. Sandro Galantini, "Gli insediamenti slavoalbanesi in Abruzzo. Alcune note ed indicazioni bibliografiche", në *Abruzzo. Rivista dell'Istituto di studi abruzzesi*, anno XLI (2003), f. 367-399. Francesco Mastroberti, "Le colonie albanesi nel Regno di Napoli tra storia e storiografia", në *Annali della Facoltà di Giurisprudenza di Taranto*, a I (2008), n. 2, f. 241-251.

brendshme […] ishin me peshë sepse bëhej fjalë për qindra vetë që zhvendoseshin. Arsyeja e dytë ka të bëjë me lehtësirat fiskale" dhe me dinamikat sociale që provokonin edhe mes popullsisë vendase[98].

Zhvendosjet e vazhdueshme, që ndonjëherë bartnin shpresën për të gjetur vende më të volitshme e herë të tjera shkaktoheshin nga mospranimi për t'iu nënshtruar autoriteteve feudale lokale, u dhanë jetë kontakteve mes grupeve të ndryshme të shqiptarëve, duke krijuar kështu një lloj përzierje që ndoshta është shkaku i vërtetë i përkimeve të shumta që dëshmohen nga kërkimet e sotme. Mbiemrat e njëjtë që hasen në shumë komunitete arbëreshe pak a shumë të largëta mes tyre, që shpesh kapërcejnë edhe kufijtë krahinorë, shkojnë në mbështetje të kësaj hipoteze dhe na shtyjnë të përfytyrojmë një skenar ku bërthamat familjare që vendosnin të transferoheshin gjetkë i njihnin shumë mirë rrugët e "diasporës së diasporës", por njihnin mirë edhe vendet ku banonin bashkatdhetarët e tyre. Nuk mund të shpjegohen ndryshe zhvendosjet nga një krahinë në tjetrën si ato që ndërmorën mërgimtarët e shumtë që gjatë shek. XV përbënin komunitetin arbëresh të Gizzeria-s, për të cilin Francesco Altimari, bazuar në të dhënat arkivore, ka nxjerrë në pah bashkëpërkime të shumta onomastike me fshatrat siciliane Piana, Palazzo, Mezzoiuso[99]. Të dhënat që disponojmë flasin për marrëdhënie të shumta solidariteti ekonomik dhe kulturor mes arbëreshëve të shpërndarë në zona gjeografikisht homogjene falë një rrjeti të vetëdijshëm dhe efikas mbështetjeje ekonomike dhe bashkëpunimi reciprok.

Për sa u përket arbëreshëve të vendosur në Sicili, me rëndësi të veçantë janë të dhënat arkivore që ka botuar Henri Bresc, mbi të cilat u bazua Francesco Giunta për të mbërritur në disa përfundime bindëse: qysh nga fundi i shek. XV (mes viteve 1489-1498) "Arbëreshët e Horës së Arkipeshkëvit, të Palazzo Adrianos dhe Mezzojuso-s kishin në dorë një pjesë të mirë të tregtisë së drithërave të provincës së Palermos, ishin futur mirë në tregtinë e kafshëve të punës, të bagëtive dhe të djathit. Së dyti, ata vepronin në grup, me një solidaritet

[98] Antonella Pellettieri, "…quod casale fiat ibidem vel villa: i borghi di nuova fondazione in Basilicata", cit., f. 169.

[99] Shih Altimari Francesco, "Tracce onomastiche albanesi nella comunità calabrese di Gizzeria", në *Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia. Giornate di studio offerte a Antonino Guzzetta*, Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi, a cura di Matteo Mandalà, Palermo, 2003, f. 49-56.

që u lejonte të parashikonin dhe të llogaritnin me kohë rendimentet bujqësore[100]". Mes dy komuniteteve arbëreshe të Pianës dhe të Mezzoiusos kishte shkëmbime të shpeshta tregtare, çka konfirmohet edhe nga kërkimet arkivore që kreu Ignazio Gattuso, madje shpesh shumë kryefamiljarë rezultonin me vendbanim të dyfishtë në të dyja komunitetet përpara se arbëreshët e Mezzoiuso-s të nënshkruanin aktet (kapitujt) e themelimit në vitin 1501[101]. Për më tepër, përveç faktit se bashkëpërkimet onomastike dëshmojnë "lidhjet që ekzistonin mes banorëve të dy fshatrave, që i detyroheshin prejardhjes së përbashkët"[102], nuk mund të lihen pas dore bashkëpërkimet onomastike të shek. XVI që përmbajnë regjistrat famullorë të fshatrave Palazzo Adriano, Piana degli Albanesi dhe Contessa Entellina, çka konfirmon hipotezën se mes arbëreshëve të këtyre komuniteteve kishte marrëdhënie që u paraprinin kronologjikisht zhvendosjes në Sicili.

Disa burime narrative flasin për marrëdhënie mes arbëreshëve të Pianës nga njëra anë dhe atyre të Brontes dhe të Biancavilla-s nga ana tjetër. Këto dy fshatra të fundit u themeluan në shpatet e vullkanit Etna në të njëjtën periudhë kur në krahun perëndimor të ishullit u themeluan dhe u ripopulluan Palazzo Adriano dhe Piana degli Albanesi. Kapitujt e themelimit të Biancavillas u nënshkruan më 25 janar 1488, pak kohë pas themelimit të Palazzo Adrianos (1482) dhe njëkohësisht me atë të Pianës (30 gusht 1488)[103]. Për më tepër, sipas dëshmisë së Placido Buccolo-s[104], marrëdhëniet mes tri grupeve të arbëreshëve ishin shumë të dendura gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të ngulimit të tyre. Do të kenë qenë priftërinjtë e Pianës dhe të Palazzo Adriano-s ata që e mbajtën gjallë për ca kohë ritin bizantin në Biancavilla, para latinizimit të plotë të këtij komuniteti[105]. Këtu do përmendur fakti se Michele Del Giudice, duke iu referuar popullsisë arbëreshe të Bronte-s (ngulim për të cilin sot nuk kemi as kapitujt e themelimit, as të dhëna kronologjike mbi krijimin e tij), vuri në dukje disa tipare të përbashkëta me arbëreshët e Pianës, duke lënë të kuptojë kështu se dy grupet do të kishin prejardhje të përbashkët a së paku do të kishin pasur kontakte të

[100] Francesco Giunta, "Albanesi in Sicilia", në *Albanesi in Sicilia* a cura di Matteo Mandalà, Albanica 16, Mirror, Palermo, 2004, f. 15.

[101] Shih Giuseppe La Mantia, *I capitoli delle colonie Greco-Albanesi di Sicilia dei secoli XV e XVI*, Stabilimento Tipografico Giannitrapani, Palermo, 1904, f. 43-50.

[102] Ignazio Gattuso, "Manzil Ysûf", në *Opere*, cit., vol. I, f. 221.

[103] Shih Giuseppe La Mantia, *I capitoli*, cit., f. 31-35.

[104] Shih Placido Bucolo, *Storia di Biancavilla*, cit., f. 40.

[105] *Po aty*, f. 48.

hershme[106]. Prej këtej Schirò nuk ngurroi të supozonte se "themelimi i Brontes do të jetë kryer pak a shumë njëkohësisht me atë të Callicari-t, pranë l'Etna-s, që sot quhet Biancavilla, në fund të shek. XVI, nga arbëreshë të tjerë që, të udhëhequr nga Cesare Masi, u shkëputën prej bashkatdhetarët e tyre", të cilët do të themelonin Pianën[107]. Bazuar në këto supozime, Francesco Giunta, duke bashkuar traditën gojore me dokumentacionin e shkruar hamendësoi se "para se të zgjidhnin Pianën, ata kishin provuar të vendoseshin, pa sukses, në zona të tjera të ishullit. Këtu mund të përfshijmë grupet arbëreshe që u vendosën në Bronte, në Maniaci, në Adrano, në Callicari (më vonë Biancavilla), përgjatë rrëzës perëndimore të malit Etna, në feudet e Giovanni Tommaso Moncada-s, kontit të Adernò-së, si dhe në Cansoria, në Caltagirone dhe në Piazza Armerina"[108].

9.– Këto bashkëpërkime na ndihmojnë të kuptojmë lëvizjet e mërgimtarëve mes shekujve XIII-XV, fillimisht brenda gadishullit ballkanik, pastaj në dy brigjet e Adriatikut. Shqiptarët zhvendoseshin duke ndjekur një organizim të tipit fisnor, me grupe familjesh që mbanin të njëjtin mbiemër, i cili shndërrohej në toponim kur zhvendosja ndërpritej dhe familjet stabilizoheshin në një vend. Jo të gjithë anëtarët e fisit vendoseshin përfundimisht në të njëjtin vend, sepse disa prej tyre shkëputeshin nga grupi dhe vazhdonin udhëtimin për të kolonizuar fshatra të tjera të shpopulluara e të braktisura. Në More (Peloponez), sikurse edhe në krahina të tjera të Greqisë që tashmë kishte rënë në duart e osmanëve, shqiptarët që i kushtoheshin kryesisht blegtorisë dhe mercenarizmit, gjenin vende të shumta për të ripopulluar që u përshtateshin nevojave të tyre. Falë zbatimit të kësaj skeme të thjeshtë në gjithë Gadishullin Ballkanik që përshkohej tej e ndanë nga shqiptarë, u ngritën vendbanime të shumta që ende sot mbajnë emra që përkojnë me mbiemrat më të përhapur mes komuniteteve arbëreshe[109]. Mjafton t'i hedhim një sy hartës së Greqisë për të gjetur me dhjetëra fshatra të tilla[110]. Pasi mërguan në Itali, këto popullsi ndoqën për ca kohë skemën që ki-

---

[106] Michele Del Giudice, *Descrizione, del real tempio, e monasterio di santa Maria Nuova, di Morreale* [...], nella regia stamperia d'Agostino Epiro, in Palermo, 1702, f. 27.

[107] Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali*, cit., f. LXXVI.

[108] Francesco Giunta, "Albanesi in Sicilia", cit., f. 24.

[109] Shih Eqrem Çabej, "Çështja e prejardhjes së ngulimevet arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetiakë" në *Në botën*, cit., f. 45-63.

[110] Shih Konstantinos Sathas, *Mnēmeia hellēnikēs historias. Documents inédits relatifs à l'histoire de la Grèce au moyen âge*, publies sous les auspices de la chambre des Députés de Grèce, Tome IV. Maisonneuve et Ce éditeurs, Paris, 1882, f. XLV-XLVI. Shih Titos F. Jochalas, "Considerazioni sull'onomastica e toponomastica albanese in Grecia", Comunicazione letta in occasione del 12° Congresso Internazionale di Onomastica tenutosi

shin zbatuar në Ballkan, duke u dhënë lagjeve emra që më parë i mbanin katundet e veçanta. Kështu mund të shpjegohen përkimet mes mbiemrave më të përhapur të arbëreshëve, toponimeve të shumta në Ballkan dhe toponimeve urbane që kanë ruajtur dokumentet arkivore dhe kujtesa historike e arbëreshëve. Dinamikat që fshihen pas këtij sistemi të organizimit social na konfirmohen edhe nga të dhënat që përmbajnë regjistrat fiskalë osmanë të viteve 1460-1461 mbi fshatrat e Moresë ku banonin barinj dhe blegtorë grekë dhe shqiptarë. Sipas studiuesve Nicoara Beldiceanu dhe Irène Beldiceanu-Steinherr, që kanë botuar materiale (*Tapu ve Tharir n. 10 = TT 10*) të ruajtura në Bibliotekën Kombëtare të Parisit dhe në arkivat e Kryeministrisë në Stamboll, "on constate que ... En Morée, les villes sont divisées portaient simplement des anthroponymes grecs – prénom et nom de famille – sans autre précision"[111]. Edhe në Korint të dhënat fiskale nxjerrin në pah një strukturë sociale të tipit fisnor[112]. Nëse interesi i këtij regjistri, sipas autorëve, përligjet nga fakti se ai "lejon të vihet në pah një fakt i rëndësishëm: shumica e komuniteteve shqiptare në vitin 1461 nuk e kishin kapërcyer stadin fisnor"[113], përkimi i jashtëzakonshëm i këtij organizimi fisnor me atë që regjistrohet mes fundit të shek. XVI dhe fillimit të shek. XVII ndër arbëreshët e Sicilisë dhe të Kalabrisë, dëshmon jo vetëm një lloj vijimësie të traditave të vjetra, por edhe ruajtjen e strukturave sociale të trashëguara: ky është një tipar që karakterizon përgjithësisht grupet njerëzore të shkëputura nga vendet e prejardhjes dhe të vendosura në vise të largëta.

Vijimësia e organizimit fisnor zgjati deri në gjysmën e parë të shek. XVII, pra deri kur integrimi i plotë social i mërgimtarëve shkaktoi fundin e pashmangshëm të tij. Disa dëshmi të pakta na thonë se ai lloj organizimi ishte ende i rrënjosur nga fundi i shek. XVI. Mes këtyre vlen të përmendim "Kongregatën e Matrangave" që dëshmohet në një dokument të gjetur në arkivin historik të

a Berna (25-30 agosto 1975) në *Balkan Studies*: *a biannual publication of the Institute for Balkan Studies*, Thessaloniki, 1977, f. 313-329. Shih edhe Thoma Kacori – Rusi Stojkov, "Një regjistër osmano-turk i shek. XV për shqiptarët e Peloponezit" në *Studime historike*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, viti XX, nr. 3, Tiranë, 1966, f. 149-164.

[111] Nicoara Beldiceanu – Irène Beldiceanu-Steinherr, "Recherches sur la Morée *(1461-1512)*", në *Süd-Ost Forschungen*, R. Oldenbourg, München, Band XXXIX, 1980, f. 42.

[112] Nicoara Beldiceanu – Irène Beldiceanu-Steinherr, "Corinthe et sa région en 1461 d'après le registre *TT10*", në *Süd-Ost Forschungen*, Oldenbourg, München, Band XLV, 1986, f. 42.

[113] "permet de mettre en évidence un fait important: la majorité des communautés albanises n'avaient guère dépassées le stade clanique en 1461": *po aty*.

dioqezës së Monreales[114] që përmban një lutje me anë të së cilës familja Matranga nga Piana degli Albanesi në vitin 1597 kërkonte leje për të themeluar një "kongregatë në mbrojtje të fisit të tyre". Konkretisht dokumenti parashikon një lloj "ndihme të ndërsjellë" që nuk e ka shoqen në traditën europiane mesjetare, por nga ana tjetër është një praktikë e njohur në kulturën fisnore që bartnin shqiptarët e asaj periudhe. Fakti që "Matrangat" kanë ndier nevojën për të kërkuar një leje të tillë nga autoritetet e larta gjyqësore që përfaqësoheshin prej Arkipeshkvit të Monreales, mbajtës i *mero e mixto imperio* në feudet ku përfshihej edhe Piana e ripopulluar prej një shekulli nga arbëreshët, nga njëra anë dëshmon se kolonët e rinj kishin pranuar tashmë traditat dhe praktikat ligjore të vendit ku ishin vendosur; nga ana tjetër, tregon se zbulimi i hapësirës urbane përbënte në fakt premisën e shndërrimit të thellë antropologjik dhe kulturor të kolonëve, që pasi ishin endur për një kohë të gjatë lart e poshtë nëpër gjithë Jugun e Italisë, më në fund kishin zënë rrënjë në një vend të caktuar.

Këtu qëndron dallimi thelbësor mes dy llojeve të mërgimit shqiptar në Itali. Faza e parë migratore, ajo përpara eksodit të fundshekullit XV, u krye përmes një procesi të gjatë integrimi të individëve mërgimtarë në kontekstin juridik dhe social të realiteteve urbane, banorët e të cilave ushqenin mosbesim të madh ndaj të huajve. Këta të fundit nuk ishin të tillë, pra të huaj, vetëm sepse i përkisnin një etnie tjetër, por sidomos sepse vinin nga një mjedis i ndryshëm nga ai qytetar. Nuk duhet të habitemi nëse qysh në Ballkan, para se të kaptonin Adriatikun, këta mërgimtarë e ndien peshën e përjashtimit social dhe të emargjinimit nga vetë bashkatdhetarët e tyre, të cilët i mbyllën portat masës së madhe të katundarëve, të barinjve dhe të endacakëve që u dyndën në muret e qyteteve, duke kërkuar të bënin pjesë në një sistem që as mundej as donte t'i pranonte. Një refleks i kësaj logjike vetëmbrojtëse të qytetarëve është gjetur nga Brünehilde Imhaus në statutet e nënshkruara në Zarë më 1 prill 1454, konkretisht në një paragraf që i kushtohej lagjes së Vranës (Aurana), në të cilin "on peut, par exemple, y lire que "tout habitant d'Aurana et de son comté peut saisir les biens de tout étranger pour récupérer son dû, à moins qu'il vienne pour moudre le grain… et on peut aussi indifférentement détenir tout paysan ou tout morlaque, qu'il appartienne à un seigneur ou à une communauté, réserve faite des saufconduits et créances de la commune, qui ont le pas sur les autres créanciers". Le

[114] Shih Matteo Mandalà, Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra. Mbi botimin kritik të varianteve dorëshkrim e të shtypur të veprës E mbsuame e krështerë (1592), Ombra GVG, Tiranë, 2012, f. 29..

pauvre est averti: il existe des hommes, dans les villes, qui ne sont pas plus nobles qu'eux-mêmes, mais qui vivent incomparablement mieux et leur interdisent tout partage"[115].

Statutet e Zarës nuk ishin të vetmet që përmbanin norma të cilat synonin të kufizonin, të përjashtonin a t'u mohonin të huajve të drejtat që u rezervoheshin vetëm banorëve të qytetit. Statutet e Shkodrës, që i përkasin gjysmës së parë të shek. XIV dhe që përmbajnë "shtesa deri në vitin 1469"[116], të vetmet që kemi në dorë nga qytetet që ngriheshin në rrethinat e zonave të banuara nga shqiptarët, parashikonin masa kufizuese, të ngjashme me ato të Statuteve të Budvës[117] në të cilat "banorët e qytetit të Shkodrës dallohen gjithmonë si "qytetarë" nga "sllavët" dhe "nga shqiptarët", si edhe nga "të huajt" dhe "bujtësit", terma këta të fundit që i përfshijnë dy termat e parë"[118]. Sipas Alain Ducellier, e njëjta situatë dëshmohet edhe nga fundi i shek. XIV në qytetin e Durrësit ku "il résulte que la distinction entre Durrazzains et Albanais n'est pas à bas ethnique"[119].

Ky ishte një qëndrim tipik urban që i detyrohet shtysave që edhe në Itali gjatë epokës komunale i kundërvinte identitetin qytetar, të lartë, të kulturuar dhe të begatë, masës së injorantëve dhe të vobektëve që karakterizonte zonat rurale. Me fjalë të tjera ishte po ai konceptim identitar që banorët e "qyteteve komunale" e interpretonin në kundërvënie me "katundin": për "qytetarët" "qyteti ishte një gjendje shpirtërore, një tërësi zakonesh e traditash, sjelljesh e ndjesish, të organizuara rreth atyre zakoneve dhe të përçuara përmes atyre traditave"[120].

10.– Këtë "gjendje shpirtërore" nuk e zotëronin të tjerët, të huajt dhe sidomos katundarët, të cilët jo vetëm që dënoheshin të mos përfitonin nga avantazhet e qytetit, por emargjinoheshin me dhunë dhe izoloheshin si elementë turbullues. Ky ishte një nga tiparet dalluese më të rëndësishme, ndoshta më shumë sesa gjuha a riti fetar a etnia, që do të shënojë suksesin ose mossuksesin e ngulimeve arbëreshe në Itali, qoftë atyre të shek. XIV dhe të gjysmës së parë të shek. pasues, qoftë edhe atyre të mëvonshme.

---

[115] Shih Brünehilde Imhaus, "Vers l'Italie des communes et des princes", në *Les chemins de l'exile*, cit., f. 234.

[116] Shih *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469*, a cura di Lucia Nadin, Viella, Perugina, 2002..

[117] Shih Gerlando Ortalli, "Gli statuti, tra Scutari e Venezia", në *Statuti di Scutari*, cit., f. 11 *et passim*.

[118] Lucia Nadin, "Il Testo statutario" në *Statuti di Scutari*, cit. f. 54

[119] Alain Ducellier, *La Façade maritime*, cit., f. 532.

[120] Robert Ezra Park, "La città: indicazioni per lo studio del comportamento umano nell' ambiente urbano", në *Città e analisi sociologica: i classici della sociologia urbana*, a cura di Guido Martinotti, Marsilio editore, Padova, 1968, f. 459.

Sipas studiueses Imhaus nga ky refuzim lind natyrshëm në vetëdijen e të vobektëve një zgjedhje e re që ajgëton "bregun tjetër si shpëtimtar: ata janë të vendosur të besojnë në mitin e *felix Italia*"[121]. Kjo bindje forcohej nga ecejaket e vazhdueshme të anijeve në porte, të ngarkuara me të gjitha të mirat, me grurë, me verë, me fruta, me erëza, me stofra të shtrenjta. Para refuzimit që qytetet e mëdha bregdetare të Ballkanit, qoftë dalmate, qoftë shqiptare, u bënë kërkesave të tyre, ëndrra për të mbërritur në Venedik dhe në Itali u bë më konkrete. S'ka dyshim se për shqiptarët mes fundit të shek. XIV dhe gjysmës së parë të shek. XV fitimi i së drejtës së qytetarisë përbënte një objektiv kyç dhe një etapë vendimtare për integrimin përfundimtar, dhe nëse është e vërtetë çka thotë Bernard Doumerc se "ata përpiqen të arrijnë një integrim më të madh duke shkëputur lidhjet me vendin e origjinës"[122], edhe kur kjo nënkuptonte tjetërsimin e atyre pak pasurive që zotëronin, aq më e vërtetë është kur thyerja u bë përfundimtare.

Zbarkimi në Itali nuk u garantoi të gjithë mërgimtarëve të njëjtën pritje. Po të lëmë mënjanë rastin e Venedikut, që siç e ka vënë në dukje Lucia Nadin, ndërmori një politikë integrimi ndaj vasalëve shqiptarë pas rënies së Shkodrës në duart e osmanëve, janë të rralla episodet që rrëfejnë për ngritje të nivelit social dhe nuk kanë të bëjnë me grupe mërgimtarësh por me individë. Në qytetin e Venecies u vendos një komunitet i madh shqiptarësh, që gjetën punë si marinarë, artizanë, tregtarë, punëtorë krahu, ushtarë, por edhe mjekë dhe piktorë. Megjithëse kemi mjaft raste integrimi konfliktual, që dokumentohet nga akte të shumta gjyqësore dhe dënime për krime të ndryshme, masa e mërgimtarëve shqiptarë u angazhua në kërkim të një hapësire jetësore brenda një konteksti kulturor, social dhe ekonomik të ndryshëm, kryesisht armiqësor. Masa e para që bëri të mundur integrimin ishte pranimi i sistemit venecian të jetës, me rregullat dhe ligjet e veta. Pastaj vijoi asimilimi dhe humbja e identitetit kulturor e gjuhësor të mërgimtarëve që synonin të fitonin të drejtën e qytetarisë, atë të drejtë që u ishte mohuar në atdhe nga dalmatët dhe "qytetarët" shqiptarë.

Në Venedik nuk ishte e lehtë të fitohej statusi i qytetarit. Ndryshe nga "shtetësia" që jepej përmes një *kontrate sociale*, qytetaria "i rezervohej vetëm një numri të kufizuar familjesh". Vetëm në raste krizash demografike a problemesh ekonomike, pra kur "buxheti i shtetit ishte në vështirësi, ose kur e kërkonin nevojat ushtarake, qeveria bëhej më liberale" dhe e lëshonte dorën në dhënien e statusit të qytetarit. Gjithsesi "marrja e qytetarisë mbetej për të huajt elementi

[121] Brünehilde Imhaus, "Vers l'Italie des communes et des princes", në *Les chemins de l'exile*, cit., f. 234.
[122] Bernard Doumerc, "Vers l'Ouest: la Dalmatie et Venise", *Les chemins de l'exile*, cit., f. 122.

kryesor që i jepte atij një pozitë juridike": "të bëheshe qytetar përfaqësonte në njëfarë mënyrë "kontratën sociale", që përcaktonte qartë të drejtat dhe detyrat"[123].

Ngritja sociale nga niveli më i ulët në atë më të lartë parashikonte një gradualitet vertikal që rregullohej nga një sërë koncesionesh juridike dhe shoqërore. I huaji që mbërrinte në Venedik që priste të sistemohej përfundimisht, vendosej në nivelin më të ulët social, në atë të "bujtësit" a të endacakut. Për të arritur nivelin më të lartë, atë të qytetarit, duhej të kalonte përmes një hallke të ndërmjetme që përfaqësohej nga kategoria e "banorit" (*habitator*), i cili "ishte gjithmonë një mërgimtar i vendosur përkohësisht ose përfundimisht në qytet. Statusi i tij juridik shprehej me një leje banimi që i jepte mbajtësit një pozitë të privilegjuar ndaj të huajit. Në fakt *banori* (*habitator*) ngjante thuajse i integruar në shoqërinë venedikase". Me të marrë këtë status të ndërmjetëm, *banori* duhej të bënte një kërkesë në zyrat e Komunës (*Provveditori di Comun*) dhe duhej të vërtetonte se banonte prej vitesh në qytet. Pasi të paguante taksat përkatëse ai fitonte të drejtën "të hynte në disa zyra të ulëta", çka "përbënte hapin e parë drejt marrjes së qytetarisë". "Statusin e *banorit* e fitonin shumë lindorë, por nuk është e mundur të përcaktohet se cili grup etnik, shqiptarët, dalmatët apo grekët, përbënin numrin më të madh të kësaj kategorie". Pavarësisht nga numrat, s'ka dyshim se marrja e statusit të ndërmjetëm për ata që kishin braktisur vendin e tyre me shpresën e një jete më të mirë, përbënte një arritje të madhe. Të paktë kanë qenë shqiptarët që arritën një nivel të tillë që t'u garantonte pranimin e plotë social dhe politik. Praktikisht nuk kemi të dhëna mbi ekzistencën e rasteve të veçanta aq të bujshme sa ai i ish-skllavit shqiptar "Giorgio da Durazzo", që në vitin 1389 u strehua në Gjenovë[124].

U ndalëm gjatë në këto aspekte për të theksuar dallimet mes kësaj faze të mërgatës shqiptare dhe fazës së mëvonshme. Dallimet kanë të bëjnë me politikën e mikpritjes, por që nuk mund të shihen veçmas nga fakti se integrimi i shqiptarëve në Jug u detyrohej kushteve dhe rrethanave të veçanta të vendosjes së tyre. Së pari do thënë se ky proces përfshiu grupe pak a shumë kompakte shqiptarësh të cilët kur nënshkruanin kapituj themelimi ose marrëveshje me feudalët lokalë përdornin formulën "në emër të tyre dhe të shokëve të tyre". Me fjalë të tjera ata edhe juridikisht paraqiteshin jo si individë, por si komunitet i qëndrueshëm që synonte të vetëqeverisej në përputhje me parimet e asaj

[123] Brünehilde Imhaus, *Le minoranze orientali a Venezia*, cit., f. 259-260.

[124] Angela Valenti Durazzo, *I Durazzo. Da schiavi a dogi della Repubblica di Genova*, La Compagnia della Stampa, Brescia, 2004, f. 32-39.

gjendjeje shpirtërore qytetare që i kishte deklasuar për shumë kohë në nivelin e fundërrinave sociale. Të ashtuquajturit "kapituj të themelimit" përbëjnë një nga aspektet që bashkojnë historinë e fshatrave arbëreshe të Italisë së Jugut dhe, përtej dallimeve të veçanta që u detyrohen zakoneve lokale, vënë në pah një të dhënë që duhet theksuar: gjendja sociale dhe ekonomike e barabartë e kolonëve të rinj në momentin e mbërritjes, si edhe njohja e statusit të "qytetarit" për të gjithë ata që vendosnin të stabilizoheshin përfundimisht në një vend.

Sikurse e thamë më lart, shndërrimi gradual u shfaq përmes pranimit të sistemeve juridike dhe sociale që ishin në fuqi në krahinat ku gjendeshin mërgimtarët. Procesi i integrimit qe i vështirë, sidomos kohët e para, por i pandalshëm. Historiografia e sotme që është marrë me rindërtimin e këtyre dinamikave, duke lënë mënjanë mitizimet e së shkuarës, ka nxjerrë në pah momentet kyçe që pëson një popullsi gjatë shndërrimit nga "nomade" në sedentare. Studiuesi Italo Sarro në një vepër dyvëllimëshe[125], të ilustruara me dokumente të shumta, ka rindërtuar *ubi consistam* që arritën të rrënjosnin arbëreshët e Valle del Crati në Kalabri, nga njëra anë duke ruajtur traditat e të parëve e nga ana tjetër duke iu përshtatur kushteve dhe rrethanave të reja. Dëshmi të ngjashme gjenden në ngulime të tjera arbëreshe në rrjedhë të shekujve. Komunitetet ngritën strukturat e veta administrative me nëpunës arbëreshë dhe shërbime publike, duke forcuar në këtë mënyrë ndjenjën e përkatësisë ndaj "qytetit". Arbëreshët e Italisë e gjetën në ngulimet e tyre kulturën tipike qytetare, pra atë "gjendje shpirtërore" që përbënte kushtin e domosdoshëm në mënyrë që edhe ata në një moment të veçantë të kulturës europiane, të viheshin në kërkim të rrënjëve të tyre.

Për t'iu përgjigjur pyetjes "nga vijmë e bij të kujt jemi?", e vërteta e hidhur historike nuk e kënaqte "gjendjen shpirtërore" që kishin fituar. Prandaj duhej rishkruar historia, duhej lartësuar prejardhja e duhej shpikur tradita[126]. Këtej rrjedh nevoja për t'ia hyrë kërkimeve mbi identitetin kulturor në sintoni me prirjet e Europës së popujve, kërkime që jo rastësisht lindën shumë kohë përpara se fryma e re të përshkonte popujt e Ballkanit[127].

---

[125] Shih Italo Sarro, *Insediamenti albanesi nella valle del Crati*, voll. I-II, Edizioni Nuova Santelli, Castrovillari, 2010-2012.

[126] Shih Eric J. Hobsbawn, "Come si inventa una tradizione" në *L'invenzione della tradizione*, a cura di Eric J. Hobsbawn e di Terence Ranger, Torino, 2002.

[127] Shih Matteo Mandalà, *Mundus vult decipi: mitet e historiografisë arbëreshe*, "Naimi" Shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë, 2016.

Shaban SINANI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë

KADARE NË STUDIMET ITALIANE

Abstrakt. Të nisura relativisht vonë, studimet për Kadarenë në Itali kanë njohur një intensifikim të jashtëzakonshëm në dekadat e fundme. Përveç ndihmesave të *dijetarëve italo-shqiptarë*, ku veçohet Matteo Mandalà me artikujt e monografitë e tij; përveç ndihmesave të një brezi të ri kërkuesish nga Shqipëria e Kosova; rezultati më i rëndësishëm i studimeve kadareane në Itali është *kthimi i tyre në dije akademike dhe universitare*. Një shkollë kërkimore është duke u krijuar në Itali përmes programeve të doktoratës, stabilizuar tashmë në Palermo, Kozencë, Napoli, Romë, Firence, Bolonja, Milano etj. Studimet për Kadarenë dhe veprën e tij e kanë kaluar përfundimisht fazën e polemikës dhe atë recensionale. Për shkak të vëllimit numerikisht cilësor të ndihmesave në këtë fushë ka dalë e nevojshme përgatitja dhe *botimi i një bibliografie të orientuar kadareane*, për t'i ardhur në ndihmë bashkësisë gjithnjë e më të qendrueshme të të interesuarve (Simonetta Pelusi, *Kadare in Italia – Saggio di bibliografia orientativa: 1968-2007*). Të paraprira prej artikujsh dhe studimesh me autorë kryesisht vullnetarë të dijes, të cilët, të lënduar prej mënyrës si u paraqitën *gjenerali*, *prifti* dhe *ushtari italian* në romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, u vunë në kërkim të fakteve e burimeve përgënjeshtruese (Paolo Muner, *Una domanda a Ismail Kadare: per chi morta larmata del Generale;* Tullio Mereu, *Da Tirana a Fushë-Gurra: la storia della colonna Gamucci*; Antonio Magagnino, *L' eccidio della Colonna Gamucci: storia dei carabinieri reali in Albania comandati dal colonnello Giulio Gamucci*), studimet për letërsinë e Ismail Kadaresë *hynë në disiplinën e dijes së thelluar* falë kujdesit të studiuesve të katedrave universitare dhe qendrave kërkimore. Në pikëpamje të kronologjisë, ishte Universiteti i Kalabrisë më i hershmi që nxiti kërkime të tilla. Së fundmi është Universiteti *Ca' Foscari* i Firences që *i ka institucionalizuar studimet kadareane me nisma shkencore* italiane dhe ndërkombëtare. Studiuesit Alessandro Scarsella dhe Giuseppina Turano të këtij universiteti janë autorë, organizatorë, përkujdesës të tri botimeve të rëndësisë së dorës së parë: *La scrittura obliqua di Ismail Kadare*; *Kadare europeo e la cultura albanese oggi* dhe *Leggere Kadare: critica, ricezione, bibliografia.* Problematika e këtyre studimeve gjithnjë e më shumë përqendrohet në *tekstologji kritike*, *gjenetikë teksti*, *çështje të variantistikës* dhe *motërzimeve*, të *tipologjisë së qytetërimit* dhe *identitetit shqiptar* vështruar përmes letërsisë së Kadaresë. Ajo *pjesë periferike debatuese* e studimeve italiane për shkrimtarin shqiptar ende bashkëshoqëruese **(**Gianroberto Scarcia, *Gli dei della steppa e l'implausibile alast di Ismail Kadare;* Davide Rossi, *Letteratura albanese: realismo socialista 1945-1990*) nuk cenon karakterin shkencor të shkollës italiane të kërkimeve kadareane.

I.

Ndryshe prej dijeve të tjera albanologjike, që u disiplinuan si shkenca me objekt të qartë prej studimeve të Perëndimit qysh në shekullin e romantizmit

europian, *në kuadër të një interesimi të përgjithshëm metropolitan-kolonialist*, vëmendja për letërsinë shqipe është shfaqur shumë më vonë. Përveç krijimtarisë së Jeronim de Radës, Fan S. Nolit, Migjenit dhe Àt Gjergj Fishtës, fare të paktë janë ata shkrimtarë e tjerë shqiptarë, të mëhershëm e të mëpasmë, që janë njohur *përtej kufirit të gjuhës shqipe* dhe kanë nxitur interesime studimore jashtë saj.

Shkrimtari Ismail Kadare është pa dyshim shkrimtari me më shumë vëmendje në studimet letrare shqiptare jashtë vendit. Nëse interesimet më të rëndësishme të albanologjisë tradicionale në botë kanë qenë *gjuha shqipe, eposi heroik legjendar, tradita etnojuridike* (kanunet), atyre iu shtua dhe *letërsia e shkrimtarit Ismail Kadare*.

Shënimi më i hershëm që kemi mundur të gjejmë për veprën e Kadaresë në studimet italiane është ai i Umberto Bosco-s (*Istituto della Enciclopedia italiana, 1968*), i cili, në Lessico universale italiano shkruan: *Il massimo interprete dei miti nazionali e della storia del suo popolo è I. Kadaré*: *Interpreti më i rëndësishëm i miteve kombëtare të historisë dhe popullit shqiptar është Ismail Kadare*. Një vit më vonë (1969), në antologjinë *Tre poeti dell'Albania di oggi* (*Tre poetë të Shqipërisë së sotme*) Joice Lussu (heteronim i Gioconda Beatrice Salvadori Paleotti) do ta zgjidhte poezinë e Kadaresë si një nga përbërëset e *trinisë* së preferuar të saj: Migjeni, Siliqi, Kadare.

Studimet për veprën e Kadaresë në Itali kanë nisur *me një vonesë relative* të kuptueshme në krahasim me traditën e tyre në Francë. Para së gjithash kjo gjen shpjegim me rolin e frëngjishtes si *gjuhë e përurimit europian e ndërkombëtar* të veprës së tij. Damiano Latella, në artikullin e tij *I nostri conti con la narrativa in lingue balcaniche* (botuar në Tradurre, nr. 13, 2017), duke i njohur frëngjishtes rolin e *gjuhës së promovimit*, e cilëson Kadarenë *un grande scrittore "francese"*. Dhe më tej: *Secondo alcuni studiosi, le traduzioni di Jusuf Vrioni, quasi un "alter ego" per Kadare, di cui ha curato tutte le versioni francesi di narrativa fino alla sua morte, avvenuta a Parigi nel 2001, sarebbero più aderenti allo spirito dell'originale perché più libere dalla censura e dall'autocensura imposta all'epoca dalla situazione politica dell'Albania*: Sipas disa studiuesve, *përkthimet e Jusuf Vrionit, thuajse një "alter ego" për Kadarenë, prej të cilit janë përkthyer e redaktuar të gjitha veprat e tij në prozë deri sa u nda nga jeta në vitin 2001, mund të kenë qenë më shprehëse të frymës së origjinalit, duke qenë më të çliruara prej censurës dhe autocensurës së imponuar nga situate politike e Shqipërisë së kohës*.

Studimet italiane për Kadarenë e shfaqin këtë *vonesë relative* jo vetëm ndaj atyre në Francë, ku u themeluan studimet kadareane jashtë vendit, por relativisht edhe ndaj atyre të aerosferës së anglishtes, madje dhe ndaj atyre në rusisht, gjuhë me të cilën Kadare ishte paraqitur më së hershmi në një gjuhë të huaj, me vëllimin *Lirika*, përkthyer e introduktuar prej David Samoilov dhe Roza Koçi në vitin 1961.



Ismail Kadare, *Lirika*, përkthyen dhe botuan David Samoilov dhe Roza Koçi, seria *Sovremjennaja zarubjezhnaja poezia*, Moskë 1961

II

Përveç *vonesës relative*, studimet kadareane në Itali patën edhe një dallim tjetër. Ato *nisën prej rrethesh parashkencore* dhe për një kohë të gjatë *u sunduan prej karakterit recensionues dhe polemik*. Këto dy përbërëse, *karakteri paraqitës dhe opinional*, nuk u janë ndarë atyre në asnjë periudhë, duke përfshirë dhe atë bashkëkohore. Vepra e Kadaresë edhe në Itali është gjithnjë një çështje e *communis opinio*. Shkaku për polemikë në rastin e kësaj vepre mund të gjendet shumë lehtë: *italianët brenda saj, e vërteta historike dhe e vërteta letrare, ideologjia dhe letërsia*, madje dhe *simpatitë e indiferencat e shkrimtarit*. Raffaele Nigro, në një prej artikujve të tij në librin *Il piantatore di lune e altri racconti* (ediz. *Rizzoli*, Milano 1991), duke e konsideruar autorin *scrittore francofono*, vëren: *Kadarè non conosce nemmeno una parola di italiano*: *Kadare nuk njeh qoftë dhe një fjalë të vetme nga gjuha italiane*.

Studiues të tjerë italianë, të një kohe të mëvonshme, nuk e kanë fshehur kënaqësinë për krijimin e një bashkësie përkthyesish të veprës së Kadaresë *drejtpërsëdrejti nga shqipja*, pa ndërmjetësinë e gjuhës frënge apo angleze. Duke vlerësuar rëndësinë shkencore dhe letrare të antologjisë së përgatitur nga Emma Bond e Daniele Comberiati, titulluar *Il confine liquido: rapporti letterari e interculturali tra Italia e Albania*: *Kufiri i ujshëm: marrëdhëniet letrare dhe ndërkulturore midis Italisë dhe Shqipërisë* (2013), Francesco Forlani nuk e fsheh entuziazmin që në libër gjendet edhe: *Un lavoro meticoloso di Francesca Spinelli, traduttrice italiana di Kadare, che finalmente fa chiarezza nel tormentato e misterioso percorso albanese-francese-italiano che ha accompagnato i lavori del grande scrittore*: *Një vepër e rigoroze e Francesca Spinelli-t, për-*

kthyese italiane e Kadaresë, e cila më në fund hedh dritë në rrugën e mundimshme dhe misterioze të rrugës së gjatë të kalimit shqipt-frëngjisht-italisht që shoqëroi veprat e shkrimtarit të madh.

Qendrimi i shkrimtarit Ismail Kadare ndaj Perëndimit, qytetërimit dhe vlerave të tij, konceptit perëndimor për tjetrin, raporteve shqiptare me Krishterimin dhe me kodet tradicionale; si dhe polemikat për tipologjinë e identitetit, vlerësimet e shkrimtarit për autorët e traditës dhe ata të krishterimit roman, lehtësisht janë bërë shkak për të nxitur debate me interes kryesisht për lexuesin popullor.

III.

Kalimi prej njohjes debatuese-polemike tek ajo shkencore në studimet italiane duhej të kapërcente edhe nëpër një pengesë tjetër. Për një kohë relativisht të gjatë kjo njohje ka marrë nxitje dhe vëmendje publike prej faktorësh jashtëletrarë. Një prej tyre është ndjeshmëria subjektive ndaj disa çështjeve që lexuesin italian nuk mund të mos e shqetësojnë. Imazhi i italianit në veprën e Kadaresë, sidomos i italianit ushtar e komandant në Luftën II Botërore, i pranishëm si karakter në këtë vepër (*Kronikë në gur*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*), nuk mund të përftohej në mënyrë asnjanëse. Botimi frëngjisht i romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur,* me *demonizimin e figurës së priftit dhe të gjeneralit*, ndoshta më shumë vetë ngjarja historike që nxiti shkrimtarin ta shkruajë këtë roman, ishte një shkas. Pritja e kësaj vepre do të kishte qenë më e butë nëse menjëherë pas mbarimit të Luftës në Itali nuk do të ishte zhvilluar një gjyq me përmasa të gjera publike për viktimizimin e asaj që njihet si *colonna Gamucci* në tetor të vitit 1943 në Çermenikë, ngjarje në të cilën tërthorazi implikohej si urdhërdhënës, krahas komandantëve të tjerë politikë e ushtarakë, edhe emri i Tahir Kadaresë. Çfarë e provokoi më shumë refuzimin e pritshëm të veprës, *trilli apo ngjarja historike*, figura e *kolonelit të zi* Zeta apo ajo e komandantit të pushkatuar *Giulio Gamucci* bashkë me karabinierët e tij robër?

Edhe para vetë lexuesit shqiptar, më shumë heshturazi se me zë, ka dalë pyetja ose më saktë paqartësia pse midis dy ushtrive pushtuese gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtrisë fashiste e asaj naziste, Kadare zgjodhi të parën, me gjeneralët e kolonelët e saj, për të formësuar tipologjikisht *figurën e armikut*, figurën e pushtuesit në letërsi.

Dy vepra memoaristike, me burime arkivistike të reja, që kanë rihapur diskutimin midis *së vërtetës historike* dhe *së vërtetës letrare* në romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*: *L'eccidio della colonna Gamucci: storia dei carabinieri reali in Albania comandati dal col. Giulio Gamucci*, shkruar nga Antonio Magagnino (2009) dhe *Da Tirana a Fushë-Gurrë: la storia della Colonna Gamucci* (2004) shkruar nga Tullio Mereu.

Shqetësimi për të quajturën *zgjedhje tendencioze* të *antagonistit historik* prej Kadaresë ka ardhur nga periferia e studimeve letrare italiane dhe vijon të jetë në të njëjtën vijimësi edhe sot. Këtë prirje mund ta identifikonim me artikullin e publicistit Paolo Muner *Una domanda ad Ismail Kadare: "Per chi è morta l'armata del Generale?"*: *Një pyetje për Ismail Kadarenë: për kë u flijua ushtria e Gjeneralit?*, përmbyllet me studimin monografik të njohur me titullin e përkohshëm *Un coro di fantasmi vien giù dai monti*: *Një kor fantazmash po zbret që nga mali*. Përveç shumë artikujsh me karakter memoaristik, dy monografi të tjera janë botuar nga ushtarakë italianë ose trashëgimtarë të tyre, për episodin e errët të pushkatimit të 121 karabinierëve-robër të *kolonës Gamucci*. Me një *lexim vetëm historicist*, duke e konsideruar romanin e tij si një *kronikë lufte*, Tullio Mereu shkroi e botoi italisht e anglisht librin *Da Tirana a Fushë-Gurra: la storia della "colonna Gamucci"*: *Nga Tirana në Fushë-Gurrë: historia e kolonës Gamuçi*; kurse Antonio Magagnino botoi monografinë *L'eccidio della "colonna Gamucci": storia dei carabinieri Reali in Albania comandati dal colonnello Giulio Gamucci*: *Masakrimi i kolonës Gamuçi: historia e karabinierisë mbretërore në Shqipëri të komanduar nga koloneli Xhulio Gamuçi*. Në të dyja këto vepra, kushtuar një episodi të diskutueshëm të protagonistëve të luftës antifashiste ndaj robërve në Shqipëri, pikënisja është ngjarja dhe mbërritja *gjenerali*.

IV.

Duke i lënë mënjanë interesimet që u shfaqën në periudhën e parë për shkak të subjektivitetit të lexuesit dhe opinioneve të ndjeshme italiane, që

sidoqoftë janë jo të papërfillshme, jo vetëm në shtrirjen dhe vijimësinë kronologjike, vlen të pohohet se studimet për veprën e Kadaresë kanë marrë karakter të mirëfilltë shkencor dhe vëmendje të jashtëzakonshme sidomos në dekadat e fundme.

Përveç ndihmesave të *dijetarëve italo-shqiptarë*, ku veçohet Matteo Mandalà me artikujt e monografitë e tij; përveç ndihmesave të një brezi të ri kërkuesish nga Shqipëria e Kosova që formohen në universitetet italiane; rezultati më i rëndësishëm i studimeve kadareane në Itali është *kthimi i tyre në dije akademike dhe universitare*. Përveç shumë artikujve e parathënieve shkencore, duke përfshirë atë të ribotimit të veprës së plotë të shkrimtarit, Matteo Mandalà është autor i dy studimeve të tjera monografike në fushë të tekstologjisë kritike dhe të gjenetikës së tekstit: *Ismail Kadare mes së vërtetës së artit dhe mashtrimit të realitetit* (bot. *Onufri*, Tiranë 2018) dhe *Në studion kadare* kushtuar tre varianteve të romanit *Dimri i vetmisë së madhe* të këtij autori (bot. *Onufri*, Tiranë 2017).

Një traditë e qendrueshme kërkimesh kadareane është krijuar tashmë përmes programeve të doktoratës, stabilizuar prej tri dekadash jo vetëm në Palermo e Kozencë, por edhe në Venecia, Napoli, Romë, Firence, Bolonja dhe Milano. Vetëm në Universitetin e Kalabrisë, gjatë dy dekadave të fundme, nën drejtimin e prof. Francesco Altimarit, janë zgjedhur e mbrojtur së paku 15 studime të shkallës së mikrotezës dhe tezës shkencore, prej *tesi di lauera* deri tek *studi di dottoratura*, duke filluar prej vitit 1982 deri në vitin 2015, pa studimet e mëvonshme:

Costantino Gradilone	*La poesia di Ismail Kadarè*	*Poezia e Ismail Kadaresë*
Brunella Liguori	*Il "Kanun" nell'opera "Prilli i thyer" di Ismail Kadaré*	*Kanuni dhe "Prilli i thyer" i Ismail Kadaresë*
Vittoria Siciliano	*Le ricerche sui canti tradizionali dei Balcani di A. Lord e M. Parry e nell'opera "Dossier H" di I. Kadarè*	*Kërkimet për këngët tradicionale në Ballkan nga A. Lord dhe M. Parry sipas veprës "Dossier H" të I. Kadaresë*
Simona Guarna	*Totalitarismo e letteratura in Albania: il caso Kadarè*	*Totalitarizmi dhe letërsia në Shqipëri: rasti Kadare*

Amelia Turano	*L'opera letteraria di Ismail Kadare e la sua traduzione in ambito europeo*	*Vepra letrare e I.Kadaresë dhe përkthimet e saj në mjedisin europian*
Jessica Muscò	*"Gjenerali i ushtrisë së vdekur" di Ismail Kadarè: analisi dell'opera e del contesto storico-letterario*	*"Gjenerali i ushtrisë së vdekur" i Ismail Kadaresë: analizë e veprës në kontekstin historik-letrar*
Erica Vito,	*Il romanzo "Pallati i ëndrrave" di Ismail Kadare*	*Romani "Pallati i ëndrrave" i Ismail Kadaresë*
Marzia Franco	*La "Piramide" di Ismail Kadare: analisi dell'opera e del contesto storico-letterario*	*"Piramida" e I. Kadaresë: analizë e veprës në kontekst historik-letrar*
Stefania Demasi	"*Muzgu i perëndive të stepës" di Ismail Kadare: analisi dell'opera e del contesto storico-letterario*	*"Muzgu i perëndive të stepës" i Kadaresë: analizë e veprës në kontekst historik-lettrar*
Luna Alessandra Micieli	*Il romanzo "Kronikë në gur" di Ismail Kadare*	*Romani "Kronikë në gur" i Ismail Kadaresë*
Francesca Pellicorio	*Il sacrificio di fondazione: un motivo balcanico nella letteratura contemporanea europea: Kadare, Yourcenar e Bonnefoy*	*Sakrifica e flijimit, një motiv balllanik në letërsinë e sotme europiane: Kadare, Yourcenar e Bonnefoy*
Giovanna Nanci	*Problematiche traduttologiche in contesto interlinguistico del romanzo "Kështjella" di Ismail Kadare: analisi contrastiva e nuovi approcci traduttivi.*	*Probleme përkthimore në kontekst ndërgjuhësor lidhur me romanin "Kështjella" të I. Kadaresë: analiza krahasuese dhe qendrime të reja hermeneutike*

Për shkak të vëllimit gjithnjë e më të shtuar të përkthimeve të veprës së Kadaresë italisht dhe të një ngritjeje cilësore të ndihmesave për veprën e tij, ka dalë e nevojshme përgatitja dhe *botimi i një bibliografie të orientuar kadareane*, për t'i ardhur në ndihmë bashkësisë gjithnjë e më të qendrueshme të të interesuarve. Në funksionin e ndërmjetësit në komunikim midis veprës dhe studiuesit, Simonetta Pelusi botoi bibliografinë *Kadare in Italia - saggio di bibliografia orientativa: 1968-2007*.

Nëse në pikëpamje të kronologjisë, ishin Universiteti i Kalabrisë dhe ai i Palermos më të hershmit që nxitën kërkimet kadareane, në periudhat më të vonshme është Universiteti *Ca' Foscari* i Venezia-s ai që *i ka institucionalizuar studimet kadareane me nisma shkencore* italiane dhe ndërkombëtare. Giuseppina Turano dhe Alessandro Scarsella të këtij universiteti janë autorë, organizatorë e përkujdesës të tri botimeve të rëndësisë së dorës së parë: *La scrittura obliqua di Ismail Kadare*; *Kadare europeo e la cultura albanese oggi* dhe

Leggere Kadare: critica, ricezione, bibliografia. Paradigma e këtyre studimeve gjithnjë e më shumë përqendrohet në *tekstologji kritike*, në *gjenetikë teksti*, në *çështje të variantistikës* dhe *motërzimeve*, duke e shpenguar leximin e veprës së Kadaresë prej *interpretimeve të ideologjizuara*, të cilat janë deri-diku të pashmangshme, sepse sa herë që dalin probleme të mprehta, si ai i *identitetit kombëtar e fetar të shqiptarëve*, i tipologjisë së qytetërimit shqiptar, i raporteve të shqiptarëve me fqinjët dhe me Europën, i ndërlikimit të fatit të tyre me Lindjen dhe Perëndimin, i statusit të shkrimtarit në totalitarizëm, kjo vepër përfillet edhe si burim njohjeje.

Bashkësia e studiuesve të Kadaresë në Itali tashmë mund të thuhet se *ka mbërritur në stadin e një shkolle*. Ka dallimet e veta të dukshme me shkollën e *studimeve franceze*, jo vetëm sepse studiuesit francezë shpesh janë shfaqur më tepër të interesuar për *zbulimin e shkrimtarit në gjuhën e tyre*, por edhe sepse në një shumicë rastesh vëmendjen e tyre e ka tërhequr etnografizmi, ekzotika, çudia e vendit që rron me të shkuarën, misteri i vendit të vetëveçuar, që së bashku mund të njehsoheshin me një sjellje neoromantike dhe ndoshta edhe më shumë. Në studimet italiane gjithnjë e më shumë po sundojnë interesimet për gjenetikë teksti, filologji e tekstologji kritike, ndërkohë që në studimet franceze vend parësor zënë trajtesat me karakter antropoletrar dhe leximet etnologjike, kurse në ato anglo-amerikane studimet mbi raportet mes letërsisë dhe shtetit, censurës dhe anticensurës, censurës dhe indoktrinimit, lirisë dhe disidencës.



Albanistika italiane e sotme, me vëmendjen ndaj veprës së Kadaresë, ka zgjeruar shumë problematikën e studimeve për letërsinë shqipe, duke përfshirë madje dhe çështje të *hermeneutikës krahasimtare* (*Problematiche traduttologiche in contesto interlinguistico del romanzo "Kështjella" di Ismail Kadare: analisi contrastiva e nuovi approcci traduttivi*, Giovanna Nanci; idem, *Romani*

"Kështjella" i Ismail Kadaresë në gjuhën italiane, në *Res Albanicae*, nr. 1, ediz. *Rubbettino*, 2013; *A due o a quattro mani: lo strano caso dei traduttori di Ismail Kadare*, Francesca Spinelli); të *pozicionit të shkrimtarit ndaj traditës* (Giovanna Nanci, *La leggenda del fratello morto nella tradizione orale albanese*, në *Catanzaro Arberia*, 2006); të *tipologjisë së qytetërimit* dhe *identitetit shqiptar* vështruar përmes letërsisë së Kadaresë; *të letërsive të krahasuara* (Alberto Giorgio Cassani, *Distruggere i ponti: note su due romanzi di Ismail Kadaré e Carlo Repetti*, në *Horizonte*, nr. 3, 2018); të raporteve të shkrimtarit me qytetërimin italian dhe perëndimor (Giovanni Maddalena, *Dante e Kadare: o della malinconia per quella grandezza di cui siamo tutti fatti*, në *Tempi*, 15 gennaio 2013).

Shkolla italiane e studimeve kadareane, e pare në pasqyrë të studimeve të dijetarëve arbëreshë për këtë personalitet e dukuri letrare njëherësh, priret të jetë gjithnjë e më e drejtpeshuar, e ndarë prej parashkencës dhe vullnetarizmit në dije, larg tendencave të mëhershme të nxitura prej motivesh joletrare dhe larg kriticizmit recensionues.



Ajo *pjesë periferike debatuese* dhe e ideologjizuar e studimeve italiane për shkrimtarin shqiptar, deri-diku ende bashkëshoqëruese e studimeve universitare akademike për veprën e tij, që nuk përjashton qendrimet kritike edhe për shkak të lëndimit vetjak për shkak të simpatisë për *tjetrin e qortuar*, për shembull për qendrimin ndaj ish-Bashkimit Sovjetik (Gianroberto Scarcia, *Gli dei della steppa e l'implausibile alast di Ismail Kadare;* Davide Rossi, *Letteratura albanese: realismo socialista 1945-1990*; Davide Rossi, *Ismail Kadaré e la lettera del governo albanese a Mao* - në revistën *Aurora*, 2011), nuk cenon karakterin shkencor të shkollës italiane të kërkimeve kadareane, me përfaqësues të tjerë shumë

të rëndësishëm, si Stefano Trovato, Monica Genesin, Stefano Mandelli, Caterina Carpianti, Francesca Spinelli dhe jo pak të tjerë.

Duke respektuar paradigmën e fushës së interesimeve të shpallura prej organizatorëve të kësaj konference, kemi lënë mënjanë, jo pa dhimbje, studimet cilësore të dijetarëve arbëreshë, të italo-shqiptarëve, të cilët kanë qenë dhe mbeten protagonistë të dijes kadareane jo vetëm në Itali, por edhe në gjithë dijen albanologjike në tërësinë e vet.

Kujtim M. SHALA, Prishtinë

LATINITETI *YNË*

Abstrakt. *Latiniteti ynë* shënon fenomenin e lidhjeve letrare shqiptare me gjuhën dhe me kulturën e latinitetit, si një nga shenjat identitare evropiane të kulturës sonë.
Kjo është lidhja jonë e vjetër me *tjetrin*, përmjet *gjuhës së tjetrit*, që konceptohej si *gjuhë e të gjithëve*, d.m.th. si gjuhë universale. Ndërsa, çështja ndërliqësohet kur pyesim se çfarë ka tonën në diskurset e gjuhës universale të kulturës evropiane.
Kërkimi ynë nis me Barletin e mbyllet me De Radën, ndërsa kështu skicohet kërkimi në tërë literaturën *tonë* të shkruar në gjuhë të tjera. Me këta autorë provohen edhe gjinitë themelore letrare e kulturore, nga biografia e tregimi historik, apologjia, fjalori, poezia e tragjedia.
Kërkimi i tillë, përfundimisht, çon te një *histori letrare alternative*, e shënjuar këtu me disa autorë e që pret të provohet me vepra e autorë të tjerë, deri në bashkëkohësi. Kështu, *Latiniteti ynë* e bën *skicën* e historisë letrare shqipe, të lidhur me fenomene, si: *gjuha tjetër* (latinishtja, italishtja), *temat autentike* (të gjuhëve të tjera), *gjinitë universale* në *variantin shqip* (gjuhë e poetikë), *vetja tjetër* letrare etj., të gjitha të lidhura si çështje të *identitetit të letërsisë*, kur pyesim nëse identitetin e determinon gjuha, tema, gjinia ose statusi i tekstit apo këto kryqëzohen e shënjohen anasjelltas.
Në origjinën e fenomeneve që shenjon *Historia tjetër* ndodhet *gjuha e tjetrit*, e provuar në *variante* letrare të temave universale, problem që duket herët tek *oraliteti* (bilingualiteti i tij) e që, në historinë e tij, e përsërit *literariteti*.
Historia tjetër e zgjeron *Historinë e parë* të shqipes, Historinë e letërsisë shqipe, të lidhur me gjuhën apo me etninë/ nacionin dhe vetë hapet në *universalitet*, si dije që *letërsinë tonë* e lexon në qerthullin e *letërsive të tjera*.
Kështu, *Historia tjetër*, së pari, e mendon letërsinë në trajtë variantesh, nën vetëdijen se ato, sa më autentike që të bëhen, më thellë e provojnë universalitetin. Përfundimisht, *Historia tjetër* shënjohet si Histori e raportit autentik të shqipes, në pikën në të cilën ajo e takon Historinë letrare universale.
Varianti i diskursit të *Historisë tjetër* shkon përtej pikëpamjes së *ndikimeve* dhe njeh universalitetin e temave letrare, të shënjuar së pari si bilingualitet, përthyer në tema ambientale apo nacionale (autentike).

I HISTORIA TJETËR

Në këtë *diskurs* shënohet çështja e ndërliqshme e *identitet*, marrë nga perspektiva e *gjuhës së tjetrit*, e *temës sonë*, e *gjinive niversale* dhe e *ideologjive*, si shenjuese identitare. Kurse, formulimi *Latiniteti ynë* e shënon fenomenin e lidhjeve letrare shqiptare me gjuhën dhe me kulturën e latinitetit, me latinishten e, më vonë, me italishten, si një nga shenjat identitare evropiane të kulturës *sonë*. Kjo është lidhja jonë e vjetër me *tjetrin*, përmjet *gjuhës së tjetrit*, që konceptohej

si *gjuhë e të gjithëve*, d.m.th. si gjuhë universale. Ndërsa, çështja ndërliqësohet kur pyesim se çfarë ka *tonën* në diskurset e gjuhës universale të kulturës evropiane të latinitetit, duke e rrjetuar *tonën* si çështje identitare thelbësore.

Kërkimi nis nga tregimi biografik/ historik i Marin Barletit, kap apologjinë *Skënderbeu* (1636) të Frang Bardhit, bashkë me fjalorin e tij latino-epiroticum, veprën e Pjetër Bogdanit dhe mbyllet me Jeronim de Radën, ndërsa kështu skicohet leximi i literaturës *sonë* në *gjuhë të tjera*. Me veprat e këtyre autorëve provohen edhe *gjinitë* themelore letrare e kulturore, nga biografia e tregimi historik, apologjia, fjalori, apologjia e krishterë, te tragjedia e poezia.

Kërkimi i tillë, përfundimisht, çon te një *histori letrare alternative* (Sabri Hamiti), këtu e shënuar me disa autorë, e që mund të provohet me autorë e vepra të tjera, deri në bashkëkohësi.

Në origjinën e fenomeneve që evidentuam e që shënon *Historia tjetër* gjendet *gjuha e tjetrit*, e provuar në *variante* letrare të temave partikulare apo universale, problem që shfaqet tek *oraliteti* (bilingualiteti i tij) e që, në histori, e përsërit *literariteti*.

Historia tjetër e zgjeron *Historinë e parë* të shqipes, Historinë e letërsisë shqipe, të lidhur me gjuhën apo me etninë/ nocionin dhe vetë hapet në *universalitet*, si dije që *letërsinë tonë* e lexon në qerthullin e *letërsive të tjera*. Kështu, *Historia tjetër* letërsinë e koncepton në trajtë variantesh, nën vetëdijen se sa më autentike që të jenë variantet, aq më thellë e provojnë universalitetin. Përfundimisht, *Historia tjetër* shënohet si Histori e raportit autentik të shqipes, në pikën në të cilën ajo e takon Historinë letrare universale.

I tillë, varianti i diskursit të *Historisë tjetër* shkon përtej pikëpamjes së *ndikimeve* dhe njeh universalitetin ontologjik të temave letrare, të shënuar dhe si bilingualitet, përthyer dhe manifestuar në tema ambientale apo nacionale (autentike).

II GJUHA E TJETRIT

Gjuha e tjetrit është një zbulim letrar që shtrihet si zbulim kulturor e bëhet evidencë identitare. *Gjuhë e tjetrit*, sipas konceptimit tonë, është gjuha e epokës, si latinishtja dikur apo anglishtja sot, që merr komunikimin e dijen universale, për të komunikuar e për t'u kuptuar ndërmjet vete. Por, autorët e letërsia *gjuhën e tjetrit* e zbulojnë dhe e provojnë përmjet dramës personale e kulturore, madje nacionale, si një dramë identitare të krijimit e dramë të *personës*.

Gjuha e tjetrit, si një fenomen që e provon *historinë tjetër* shqiptare, bashkë me historinë identitare, të *skajuar* e të matur me të *tjerët*, mund të shtrohet duke

kapur cepat e dy domeneve, të *oralitetit* e të *shkrimit*, në të cilët vihen paradigmat kulturore të *kujtesës* e të *librit*, si dy faqe të përhershme të letërsisë e të kulturës shqiptare. Problemi bëhet më i ndërliqshëm kur autenticiteti e identiteti kulturor kthehen në shenja themelore të identitetit etnik, d. m. th. historik, e nacional, d.m. th. politik.

Çfarë ngjan me temat personale, tipike, ambientale e etnike/ nacionale, kur ato thuhen apo kur shkruhen në gjuhën e tjetrit?

A kthehen ato në tema të tjetrit, në kulturë tjetër apo hyjnë në gjirin e saj për ta matur autenticitetin me universalitet?

Kështu hapen çështja e tjetrit dhe e drama identitare e vetes, madje e vetjes.

Shqipja u provua me gjuhët e tjera, qoftë duke u kthyer në gjuhë tjetër, qoftë duke marrë në shqipe vepra të gjuhëve të tjera, si zbulesë për të tjerët përmjet gjuhës tjetër apo zbulesë e tjetrit në gjuhën shqipe.

III AUTENTIKË E UNIVERSALITET

Përballë *gjuhës së tjetrit*, madje në *gjuhë të tjetrit*, vihen *temat autentike*, të cilat i hapin shënjimet autentike, si dhe dramën identitare, kur letërsinë e diskurset kulturore i kthejnë në shenja identitare, madje në një trezor të gjuhës, të kulturës, të jetës e të identitetit etnik e nacional/politik.

Kështu, çfarë ngjan me Skënderbeun e Barletit, princin e epirotëve, heroin e përhershëm të *shqiptarëve*, kur historia e jetës dhe e veprave të tij thuret në latinishte, në gjuhën universale evropiane të epokës?

Apo, çfarë ngjan me temat universale kur ato i merr gjuha shqipe?

Çfarë është universalja?

Autenticitetin e provojnë temat apo gjuha?

Historia letrare dëshmon se autenticiteti më i madh kthehet në universalitet total, sepse autentikja shkon drejt natyrës së njeriut dhe drejt formave ideale të situatave, d.m.th. drejt kategorive universale të tyre. Ndërsa, letërsia shqipe bëhet provë për universalitetin e autenticitetit dhe për universaliet e kryqëzuara me autenticitet, meqë ajo mëson e përsërit fenomene, tema e forma universale, pastaj kthehet dhe i shkruan ato si *të vetat*, qoftë duke i përsëritur, qoftë si zbulesë, gjithnjë nën shenjën e kulturës e të ambientit autentik.

Marin Barleti është autori ynë i parë i njohur që, në dukje, i shkroi temat *partikulare* në latinishte. Por, leximi tematik etnik i Barletit është një lloj projeksioni ideologjik, i bërë paradigmatik. Barleti rri në hyrje të një kulture që ne e lexojmë si *tjetër*, ndërsa vetë e mendonte si *të veten*. Kjo e provon ndërliqësinë

e *raportit vetja - tjetri*, ashtu siç e provon ndërliqësinë *gnoseologjike* e *epistemologjike* të *çështjes vetja - tjetri*. Gjuha është kurora identitare, kur si e tillë njihet, mësohet e provohet.

Frang Bardhi gjuhën si variant dhe *gjuhën e tjetrit* si shenjë kulture e identiteti i provoi në trajtë norme, te *Dictionarium latino-epiroticum* (1635). Vepra e tillë e provon vetëdijen se gjuhët ecnin në skaje, ndërsa kulturat donin të komunikonin e të kuptoheshin në të dy gjuhët, duke njohur autenticitetin e secilës prej tyre. Por, kur thuri apologjinë *Skënderbeu*, Bardhi e zgjodhi latinishten, për ta thënë e për ta provuar të vërtetën për të gjithë, në komunikim të drejtpërdrejtë. *Shqipja* nuk mjaftonte, sepse ajo nuk komunikonte në truallin e latinishtes, në truallin e gjuhës së epokës.

Ndërsa, Pjetër Bogdani gjuhën *epirotice* (shqipe) e ka masë autenticiteti, d.m.th. masë identiteti, përkrah gjuhës së provës së doktrinës katolike, italishtes së *ligjëratave* e latinishtes së *Kankëve të Sibilave*. Bogdani e provoi deri në fund dramën e kalimit të emocionit e të mendimit nga *gjuha e parë* në *gjuhën tjetër*, si dramë të shndërrimit të identitetit, kur identitetet kishin nisur historinë e diferencimit, në variantin e historisë së ekzistencës.

Autori i madh, Jeronim de Rada, gjithë jetën shkroi në arbërisht e në italisht, me arbërishten si gjuhë identiteti etnik e politik, ndërsa zgjidhte italishten për mallin e komunikimit më të gjerë, ndoshta më të gjatë, dhe kurrë nuk e kaloi dramën e gjuhës si kurorë identitare.

Por, çfarë ngjan kur humbet gjuha?

De Rada e dinte se përgjigje universale nuk ka dhe se përgjigjet i japin ambientet e sprovuara në situata konkrete, të dramave konkrete, prandaj, edhe kur tretën gjuhën, arbëreshët i mbrojti riti bizantin i tyre, në katundet e rrethuara nga katolicizmi i italianëve.

IV FORMAT

Është e provuar se format letrare kryesore autorët shqiptarë, së pari, i shkruan në gjuhë të tjera, në gjuhët e mësimit letrar të tyre, ndërsa letërsia shqipe i mësoi edhe me këtë ndërmjetësim, si metodë që përthyen *universaliet* në shfaqje *autentike*. Format letrare janë universale, një manifestim i *diskursit letrar* (teorik), ndërsa historitë letrare (si procese) i provojnë ato me vepra konkrete, të cilat kryqëzojnë format *universale* me temat e *veta*. Kështu, format letrare janë të *diskursit letrar*, abstrakt e universal, ndërsa veprat – të *letërsive* (konkrete). *Tjetra* kthehet në *tonën* mbi bazën e motivimit, të gjuhës, të temës etj. Prandaj, diskursit për veprën e Barletit i shtohet forma universale, e

mësuar në një kulturë konkrete, në latinisht, me temën e ndarë, apo dhe me ideologjinë e ndarë. Kjo e provon se autentikja kryqëzohet me universalen, për t'u derdhur e tretur në të apo për t'u diferencuar përfundimisht. Që të dy raportet janë kulturore e identitare dhe lidhin apo ndajnë etni e biografi, gjuhë e kulturë, në raportet e ndërliqshme të literaturës me kulturën e me identitetin.

Në të gjitha rrafshet e në të gjitha rastet, format janë nyja që lidhin letërsitë, ndërsa temat bëjnë ideologjitë e i përcaktojnë gjinitë, në kryqëzimet e temave me forma apo me moduse. Por, tema kthehet në kategori universale që e konstituon gjininë dhe këtu hapen paradoksi dhe drama e madhe e temës autentike që e determinon gjininë (universale). Kështu, mësimi i formave kthehet në përsëritje të tyre në gjuhë e në letërsi konkrete, ndërsa temat (në gjuhën e vendit) e forcojnë natyrën identitare të letërsisë.

Por, çfarë ngjan kur temat janë universale e gjuha "lokale"?

Këtu problemi hapet në drejtimin tjetër dhe përgjigjen e marrim vetëm përmjet leximeve të drejtpërdrejta që, kur abstragohen, kthehen në përgjigje kategoriale. Një vepër e tillë në shqipe mbetet shqipe, nga gjuha autentike, por matet edhe me motivimin e me perceptimin kulturor të epokës.

Një skicë me format e letërsisë shqipe e provon fenomenin universal si fenomen autentik të letërsisë shqipe, një çështje identitare, të cilën letërsia e kalon më lehtë e më thjeshtë se ideologjitë apo sesa sociologjia.

Kështu, Barleti e shkroi *biografinë* e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, si fisnik e si prijës, por edhe rrëfimin për rrethimin e Shkodrën, në të cilin provohet diskursi i *historisë* së humanizmit në format e saj të njohura. Të dy veprat e tij, idenë e thurin në diskursin universal të historive të epokës, me temat tona.

Po për Skënderbeun, Bardhi shkroi *apologjinë* e njohur, në trajta të forta retorike, me objekt *tonin* e në forma *universale* të argumentimit.

Ndërsa, Bogdani *ligjëratën* retorike e sprovoi në diskursin moralizues e apologjetik, në trajtën tipike të kulturës së epokës së tij. Bogdani e strukturoi veprën në pjesë e shkallë, por gjinia bazike e saj është *ligjërata*, e ndërtuar në parimin e retorikës së argumentimit dhe e nyjëtuar edhe me retorikën psikologjike, në fund e kurorëzuar me figurën e bukur, si kurorë për diskursin e bukur, d.m.th. edhe për diskursin retorik.

De Rada është një autor mediteran, në radhë të parë për nga forma e veprës së tij, për nga sensibiliteti dhe krejt arbëresh për nga tematika letrare, e shënuar si *tematikë identitare*. Autor i tragjedisë, ai vetëm sa përsërit kanonin e gjinisë në italisht e në arbërisht, në pikën në të cilën ëndërron të universalizojë shkrimin e tij.

Kështu, gjinitë e format letrare dhe kulturore në përgjithësi, që evidentuam këtu, e shënjojnë lidhjen e literaturës shqipe me format universale të literaturës perëndimore, në radhë të parë me kulturën e latinitetit që shënon kulturë të hershme evropiane (universale).

V VEPRAT IDENTITARE

Veprat identitare janë edhe vepra ideologjie, madje vepra ideologjike, meqë kthehen në shqiptim ideologjish në trajtë mësimi, veti që i çon ato drejt një shkalle normimi. Kjo çështje ndërliqësohet kur vepra është letrare, meqë fiksioni letrar e kap edhe idenititetin dhe e kthen në projeksion identitar ose, në trajtë më të ndërliqshme, në *subjektivitet letrar*, siç ngjan në modernitet. Pra, jemi në rrafsh idealitetesh totale dhe, nën këtë shenjë, nga autorët që kemi përpara, mund ta lexojmë vetëm veprën e De Radës.

Ideologjia e Barletit lidhet në rrëfimin për Princin e Krishterë, Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, prijësin e epirotëve, burrë fisnik e trim. Vetëdija etnike/ nacionale në rrëfimet e tilla nuk e kishte shenjën identitare politike, meqë shenja që identifikonte prijësin e epirotëve ishte ajo e një të krishteri evropian. Leximet ideologjike partikulare (etnike) janë projeksione të mëvonshme, ndërsa ideologjia e Barletit, në këtë rrafsh, është universale.

Barleti e konceptonte latinishten si gjuhë të veten, në kuptimin e një gjuhe të kulturës së mësuar të tij, që është kulturë e shkrimit, përballë oralitet, i cili përherë mbetet autentik e i *skajuar*, për t'u hapur në universalitet kur shkohet drejt parabazës antropologjike të tij. Kështu, çështja e *tjetrit* të Barletit, ashtu si ajo e gjuhës dhe e identitetit, nuk mund të shtrohet si çështje e sotme, meqë kategoritë ontologjike e identitare epokat nuk i shtrojnë e nuk i *skajojnë* njëjtë. Kjo e bën të pamundur një zgjidhje universale të problemeve identitare, meqë identiteti është *proces* i gjallë në kulturë e në jetë dhe do përshkrim (i kapur si *njësi*), më parë se kategorizime e klasematikë.

Në anën tjetër, Bardhi do të provojë që Skënderbeu nuk është sllav dhe, në apologjinë e tij, e tëhollon kritikën dhe e thur me durim të rrallë retorikën, për të dhënë një rrëfim të provuar. Teksti i tillë e dëshmon dijen e shijen e Bardhit retor të rrallë.

Po universal shfaqet Bogdani në veprën e tij, kur ideologjinë e doktrinën e krishterë e kthen në mësim të provuar për jetën e Krishtit dhe të vërtetën ungjillore të tij. Një vepër si *Cuneus Prophetarum* (1675-1685) e Bogdanit, ashtu si edhe vepra e Barletit, merr shenja të vendit për identifikim e për identitet, por ideologjia është krejt universale, *katolike* - e përgjithshme.

Nga shënjimet e vetë Bogdanit, kuptojmë se ai librin e shkroi me qëllim të mësimit fenë të krishterëve, për të larguar mjegullat e mëkatit e të paditurisë, për të shpjeguar misteret e fesë, tipike për një prelat që njeh grigjën e tij të përvuajtur nën sundimin turk e nën peshën e mëkatit e të padijes. Këto janë shenja të një libri (mësimi) religjioz.

Ndërsa, De Rada do të kërkojë rapsodinë e vjetër arbëreshe, si mall e si shenjë për vendin e të parëve, por, kur nuk e gjen, nis ta thurë vetë. Kjo është një ideologji etnike, e kthyer në vepër e në kulturë letrare. Vetë arbërishtja e tij është idenitifikim ideologjik e shenjë identitare e veprës së tij, madje më thellë: e qenies së tij.

Mësimi i De Radës provohet thellë te temat nacionale, qoftë kur hapen mjegullat e mitologjisë së etnisë apo kur kapet historia e nacionit. Kjo e dyta merr shenjë përfaqësimi si temë e heroit nacional, shoqërohet me diskursin moralizues, i cili kthehet në diskurs karakterizues.

Mësimi letrar deradian i lidhur me Skënderbeun buron nga vepra heroike e Prijësit, por Skëndebu heroi i shenjës nacionale shqiptare vetë është zbulim i shekullit XIX, një figurë kulturore e letrare. Ndërsa, i shënjuar si emblemë e epokës, Skënderbeu bëhet përfaqësues fatlum; të gjitha këto janë shenja të një *figure morale*. Kështu, Heroi nacional dhe Heroi moral bëhen një dhe prodhojnë një *mit letrar*, si shenjë të *ideologemës nacionale*. Diskursi bëhet "fytyrë" e mitit dhe ka të gjitha nuancat e himnizimit e të moralizimit. Diskursi i tillë, bashkë me ideologemën, autorin e bëjnë një soj *mësuesi*. Kjo nuk është kryekëput një estetikë, por edhe një tendencë e veprës për ndërhyrje në jetën nacionale.

VI HISTORIA

Historia e jetës dhe e veprave të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut (1508-1510) e Marin Barletit, prift shkodran, është *histori e jetës* dhe e *veprave*, d. m. th. vepër që kap biografinë, në kuptimin e parë, nga lindja në vdekje, dhe që atë e shtrin në rrëfimin për veprimet e Skënderbeut, epokën e tij, raportet e tij dhe luftën e tij. Ky është një model klasik i historisë, i shtruar si rrëfim dhe i shtuar si retorikë, ashtu që heroi të jetë i lavdëruar, përballë kundërshtarëve. Për një vepër të tillë, raporti me dokumentin nuk është thelbësor, meqë këtë raport e kërkon historia moderne që provën, në trajtë dikursi, e kërkon te faktet konkrete e të cilat do t'i provojë diskursi. Historia e Barletit hyn në qarkun e madh të diskurseve që pretendojnë të bindin, në kuptimin klasik, ndërsa kjo është një shenjë retorike thelbësore. Pra, tregimi klasik biografik ka shenja të forta të diskursit retorik, të përqendruara te diskursi i bukur (retorika estetike).

Këto janë *skajime* tipike të kulturës së tij, të humanizmit evropian, që provohen me rrëfimet për ngjarjet e vendit të tij. Kultura e Barletit e ka të veten gjuhën latine, gjuhën universale të epokës, ndërsa vepra e tij në latinisht e hap çështjen e *temave autentike* (të vendit) në *gjuhën e tjetrit*, të lidhur si dramë kulturore e identitare.

Në këtë raport specifik me *tjetrin*, çfarë ngjan me historinë e princit të krishterë të epirotëve, të rrëfyer në gjuhën e kulturës evropiane?

A e bën vepër identitare *tonën* tema apo vepër universale gjuha (universale)?

Barleti *ynë* shkroi si evropian i kulturës, në nyjën që lidh ngjarjet partikulare të popujve evropianë në një kulturë universale, që ka shenjën e njësisë, por që i ruan shenjat *skajuese* të ngjarjeve të veçanta. Kështu, kultura e përbashkët bëhet një trezor që lidh të ngjashmit e *skajuar* në një gjuhë të përbashkët. Kjo e kthen latinishten në gjuhë të temave të mëdha e fisnike, prandaj në një *gjuhë të klasuar* edhe në rrafshin social e politik.

VII GJUHË E DOKTRINË

Pjetër Bogdani shënon rastin e parë në kulturën tonë të kthimit të tekstit *shqip* në një *gjuhë tjetër*. Jemi para një fakti të kulturës dhe në rrënjë të dramës identitare të tekstit që ndryshon *gjuhë*. Ndërsa, *gjuha tjetër*, d.m.th. edhe *gjuha e tjetrit*, është një nga kategoritë më të forta të identifikimit apo të diferencimit. Prandaj, i shtruar si "mjet" për t'u njohur, përkthimi bëhet "mjet" për t'u tjetërsuar. Para na vihen idetë që duhet të lënë gjuhën origjinare, por që nuk është e njohur nëse do të ruajnë konceptualitetin e semantikën origjinare. Kështu që, përkthimi është festa e njohjes së kulturës që kalon nëpër dramën e ruajtjes apo të humbjes së origjinaritetit, çështje që te veprat letrare duket më fort e në trajta krejt të ndërliqshme.

Kështu, në rrafshin letrar, në diskurset letrare, drama e tillë thellohet, meqë përkthimi, përpos semantikës, kap edhe sensibilitetin, figurën e diskursin. Ndërsa, te vepra e Bogdanit drama e gjuhës, së pari, provohet përballë doktrinës së interpretuar: *gjuha jonë* përballë të *vërtetës hyjnore*. Vërtet, drama e parë e Bogdanit është ajo e *thënies* dhe e *interpretimit* të doktrinës katolike në arbënisht.

Në këtë pikë, çështja themelore që do shtruar lidhur me përkthimin dhe me statusin e tekstit është se sa ka arritur ta marrë e ta interpretojë gjuha shqipe doktrinën katolike, si duken në shqipe shenjat, kategoritë e normat universale të saj?

Kjo na çon te *Flavisse Prophetarum*... që, sipas korrespondencës së vetë Bogdanit,[1] është kryer në vitin 1674, dhe, edhe pse e strukturuar si pjesë e dytë e *Cunes Prophetarum* (1685), është pjesa që është shkruar së pari.[2] Selman Riza pretendon që pjesa e parë është shkruar si *addendum*, si dëshmi e re për veprën, derisa teksti po përkthehej në italisht, dhe se duket që pjesa e parë do të jetë shkruar drejtpërdrejt në italisht, e dhënë kjo thelbësore, meqë i bie që Bogdani, krahas përkthimit në italisht, të ketë përkthyer edhe nga italishtja në shqip. Kjo duket të ketë prekur fort strukturën e shqipes së tij, sepse Bogdani donte që shqipen ta përshtaste me italishten në të gjitha rrafshet. Në rastet e tilla, ajo që humbet është gjuha që përshtatet (shqipja), meqë duhet të shtrihet në shtratin e huaj. Duket që kjo dukuri e kap gjithë fushën e përkthimit dhe se përkthimi e vë tekstin në shtratin e *gjuhës tjetër* si në *shtratin e Prokrustit*.

***

Cuneus Prophetarum e Pjetër Boganit hapet me një gravurë, në të cilën Bogdani, i përgjunjur e me përulësi, i drejtohet Krishtit-Zot, në Qiell, që ka Librin e hapur në dorë, në të cilin shkruan: *Ego sum via, veritas et vita* (Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta) dhe është i rrethuar me engjëj. Bogdani i drejtohet Krishtit-Zot në latinisht: *Salva nos Domine perimus* (Shpëtona, o Zot, mbaruam!). Poshtë, në të majtë të gravurës, është vënë titulli i shkruar i veprës, shenjat ipeshkvnore të Bogdanit, bashkë me stemën argjipeshkvnore të tij.

Kjo gravurë bëhet një çelës për ta lexuar veprën e Bogdanit, autorin e përunjur para të vërtetës së Krishtit dhe Librin e Bogdanit si hije të Librit të Krishtit, me shënimin mbretëror: Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta. Këtë rrugë, të vërtetë dhe jetë do të japë Libri i Bogdanit; një mësim i të vërtetës ungjillore të Krishtit; një përcaktim ky tematik dhe doktrinar/ideologjik i veprës. Ndërsa, i përqendruar apo edhe i redukruar, Libri i Bogdanit do të na çojë te virtyti për të kërkuar shpëtimin nga Krishti-Zot: Shpëtona, o Zot, mbaruam!; Nga mëkati dhe nga mjegullat e paditurisë.

Në shenjat dhe në synimin themelor, *Cuneus Prophetarum* është një vepër mbi doktrinën katolike, një komentar, siç u provua, i strukturuar nga një numër diskursesh e gjinish, të lidhura tematikisht e strukturalisht. Një vepër *mbi doktrinën*, si gjini nuk është *doktrinë*, por vepër diskursive. Në rrënjë, veprat si kjo janë teologjike/filozofike krishtere dhe janë shkruar për lexuesit e ditur.

Tek *Eminentissimo e Reverendissimo Signore Signore Padrone Colendissimo* dhe në *Te primite perpara letterarit* Bogdani jep disa të dhëna të çmuara, që mund të kapen si shenjuese të leximit implicit të tekstit të tij, ndërsa leximi i tillë shënjon konceptimet kulturore që u bëheshin librave si ky i Bogdanit dhe

qëllimit të tyre, në epokën kur libri doli, bashkë me piketime të situatës së dheut të Arbënit e të Serbisë nën Perandorinë osmane.

Libër i hartuar në vendin ku vërshon pafeja orientale; të lajmërojë punët e të shenjës fe katolike, me të vërtetën hyjnore dhe virtytin qiellor; njerëzit që kanë lindur në "shkretëtirën muhamedane" kanë aq shumë nevojë për ushqimin shpirtëror të mësimit të krishterë; një kontribut për arsimimin e njerëzve; përhapin njohuritë e fshehtësive të fesë sonë të shenjtë. Një libër mësimi fetar që është struktuar në dy pjesë, pastaj në shkallë, sipas modelit bazik të *Biblës*. Kështu, *Cuneus Prophetarum* është një përftyrë e *Biblës* apo *Bibla* e rrëfyer, e interpretuar dhe e provuar. Lidhur me jetën e Krishtit, në një version të shkurtuar e të strukturuar ashtu që të jepet për mësim. Megjithatë, libri i Bogdanit, sado i shkruar në gjuhë popullore (epirotice/shqipe), nuk është një libër popullor, por i destinuar për klerikët, si lexues të ditur, me nxënësit e tyre të mundshëm, si lexues që kuptojnë, e që, pasi ta kenë të vërtetën ungjillore të Krishtit, në trajtën që atyre ua jep Bogdani, apo mësuesit tyre klerikë, ta çojnë më tej, te grigja e paditur e tyre. Lidhja e Librit me *rendin* e klerikëve dhe me mësimin e strukturar e shënjon *Cuneus Prophetarum* edhe si nji Libër mësimi, veti e shënjuar herët nga Selman Riza.

VIII MËSIMI LETRAR

Vepra e De Radës, e shkruar në arbërisht e në italisht, e provon dramën e vjetër të *autentikes* me *alteritetin*, në të cilën *gjuha* bëhet përcaktuese identitare e nacionale. Vepra në gjuhën shqipe është *mësim* për *origjinën*, *kalesën* e *trashëgiminë*, vepra në italisht e shënjon vetëdijen për përkatësinë e ambientit, kulturën e tjetrit e dramën e *personës* që *kujton*.

Mësimi i De Radës provohet thellë te temat nacionale, qoftë kur hapen mjegullat e mitologjisë së etnisë apo kur kapet historia e nacionit. Kjo e dyta merr shenjë përfaqësimi si temë e heroit nacional, që shoqërohet me diskursin moralizues, i cili bëhet edhe një diskurs karakterizues.

***

Me vepër e me veprim, De Rada jeton në skemën, e provuar historikisht, të mbrojtjes së qenies (etnisë) me kulturë, skemë që merr shenjat e mbrojtjes së identitetit. Provohet si nyjë e madhe e jetës së tij përpjekja për të ruajtur ritin bizantin të arbëreshëve, në mjedisin katolik italian. Ai e dinte se po mbronte etni, kulturë e përkatësi, meqë një *besë* e përbashkët me italianët, përballë një arbërishteje që po lihej, do të cenonte identitetin arbëresh në shumë rrafshe.

De Rada themeloi revistën arbëreshe, *Fjamuri arbërit*, drejtoi shkolla në arbërishte, edhe kur shkruante tekste në italisht. Ai mblodhi kujtesën arbëreshe, e lidhi në vepër letrare, apo e imagjinoi atë, për t'ua dhënë arbëreshëve si kulturë të vjetër, të rrënjëve, të Arbërisë.

De Rada që argumentoi për ritin bizantin në jetën e gjallë të arbëreshëve, u dha atyre Skënderbeun, por një hero nacional e jo një hero religjioz, edhe pse përftesat religjioze jetojnë ngado faqeve të veprës së madhe të tij.
Vepra e De Radës, e kthyer në trashëgimi, është edhe një vepër identitare.

IX IDENTITETI NË PRERJE

Veprat e tilla, siç e provon edhe ky *diskurs*, janë *çështje identitare* kulturore, me shënime edhe në historinë etnike të shqiptarëve, meqë ngrenë dilema të tipit se cili është *tjetri*, *gjuha e tij*, *temat tona* në *gjuhën e tjetrit* a janë *tonat*, a *universalizohet* e jona në *gjuhën e tjetrit*, sidomos në rastet kur *gjuha e tjetrit* konceptohet si *e jona*. Ndërsa, këto evidenca shënojnë vepra me natyrë të fortë ideologjie dhe me pretendime ideologjike, d.m.th. me pretendime identitare, qoftë të hapjes së identitetit në *universalitet*, qoftë të veçimit të tij në *autenticitet*. Kështu, çështja shtrohet e lidhur me ne, me ne lidhur me tjetrin. Kjo është një çështje universale, këtu e dhënë në preje kohe, por që shkon përtej kohëve, aq sa shtrohet çështja e identitetit. Identitetin diskursi dituror prerjeve e takon dhe e shpjegon, të lidhur me raste të përshkrueshme, si shënuese të *çështjes*, ndërsa, kur rastet në rrjet, lidhen bëhen prova për fenomenin, si edhe në rastin e kërkimit tonë. Ndoshta, ky është shënimi themelor metodologjik i këtij *diskursi*.

Bibliografia

1.
Marin Barleti: *Historia e Skënderbeut*
Rrethimi i Shkodrës
Frang Bardhi: *Dictionarivm latino-epiroticvm*
Skënderbeu
Petro Bogdano: *Cvnevs Prophetarvm de Christo Salvatore Mvndi, Et Eivs Evangelica Veritate*
De Vita Iesv Christi Salvatore Mvndis, Et Eivs Evangelica Veritate
Letërkëmbim (përgatitur nga Odette Marquet)
Jeronim de Rada: *Sofonizba*
Rapsodi të një poemi arbëresh
Skanderbeku i Pafãn
2.

Bibla - Shkrimi Shenjt: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re (përktheu e shtjelloi Dom Simon Filipaj), Ferizaj, 1994
Selman Riza: *Vepra 1*, Prishtinë, 1996
Sabri Hamiti: *Testamenti*, Prishtinë, 2018
Kujtim M. Shala: *Epistemologjia e dytë*, Prishtinë, 2016
Kujtim M. Shala: *Identiteti i pa/zbuluar*, Prishtinë, 2019
Kujtim M. Shala: *Ligjërata e Katedrales*, Prishtinë, 2019

Dhurata SHEHRI, Tiranë

"STORIA DELLA LETTERATURA ALBANESE" APO "HISTORI E LETËRSISË SHQIPTARE"

Abstrakt: Kjo kumtesë merr në shqyrtim një prej kontributeve komplekse të studimeve albanistike në Itali, veprën historiografike të Giuseppe Schirò Junior *Storia della letteratura albanese* (apo Histori e letërsisë shqiptare) duke e vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve historiografike të kohës, me të cilat dialogon e polemizon.

1.Autori dhe tezat e hershme

Ndër shumë autorë e autoritete të studimeve letrare shqipe në Itali, rreth mesit të viteve '50 është Giuseppe Schirò Junior, atë kohë mësimdhënës i shqipes në Universitetin e Padovës, ai që thirret për t'u bërë pjesë e projektit madhor të "Nuova Akademia" për të hartuar historinë e letërsisë shqiptare si pjesë e "Storia delle letterature di tutto il mondo" (Historia e letërsive të të gjithë botës). Gaetano Pettrota vetëm pak më herët, më 1950 kishte botuar *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese*, ndërsa referenti absolut i botës shqiptare në Itali ishte Koliqi[1].

Po e nisim shqyrtimin e autorit të kësaj historie, duke nisur nga premisa "negative". Pse jo Koliqi? Gjurmët e një refuzimi të mundshëm të tij i gjejmë në botimin e dorëshkrimit të rishikuar të tezës "Dy shkollat letrare shkodrane" të lënë në dorëshkrim e të botuar vetëm pas vdekjes. Në këtë dorëshkrim që ka parë dritën e botimit vetëm në vitin 2003, Koliqi shprehet: "...syzim (pra Dy shkollat letrare shkodrane) qi mund të njehet skeleti i nji vepre mâ të vëllimshme historije të letërsis, por që mjerisht mbet pa u krye."[2] Arsyet pse nuk e ka hartuar një histori letërsie, pra edhe pse nuk e mori përsipër hartimin e historisë së vitit 1959 të shkruar nga Schirò-i duhen kërkuar në kriteret që ai i analizon po në artikullin e lartpërmendur. Koliqi, pasi shprehet për historitë pararendëse të letërsisë (të Petrotta-s, të Rrotës, të Çabejt e të Schirò-it) si "përpjekje të lavdueshme"[3] si edhe për ato të botuara në Shqipëri pas '45 që i lë në heshtje sepse

[1] Në dy shtator 1957, katedra e shqipes në Universitetin e Romës ngrihet në rangun e Institutit të Studimeve Shqiptare dhe Koliqi emërohet drejtor i tij.

[2] Ernest Koliqi, Dy shkollat letrare shkodranë, në Vepra 5, Faik Konica, Prishtinë 2003.

[3] Po aty, f. 15

"frymëzohen nga kritere qi s' kanë të bajnë kurrsesi me letërsi"[4], pra, me fjalë të tjera për mungesën e një historie të letërsisë shqipe, saktëson arsyet e kësaj mungese: "Pa monografina mbi auktorë e mbi shfaqe të rrymbave letrare nuk mund të shkruhet historija qi na dishirojmë."

Pas këtij refuzimi për të shkruar në vetë të parë, duket më i natyrshëm plazmimi i një pjese të mirë të ideve dhe të interpretimeve të Koliqit në historinë e G. Schirò Junior mbi disa autorë të letërsisë shqipe, sidomos mbi autorët e dy shkollave letrare shkodrane, mbi Poradecin, Migjenin etj..

Por, tjetër pamje na shfaqet në këtë marrëdhënie idesh e interpretimesh mes Koliqit dhe Schirò-it si dhe në arsyet e pranimit a refuzimit për ta shkruar historinë e letërsisë shqipe, nëse i referohemi një letre të Camajt me Pipën, të vitit 1962 ku zbulojmë, përveç arsyeve pse Pipa nuk figuron kurrkund në këtë histori, edhe të dhënën se historia e Schirò-it kishte qenë gati që dhjetë vite më parë: "*Ky tekst historie asht gadi tash dhetë vjet dhe unë mâ parë s'kam pasë asnji poezi të Pipës; kështu kanë mbetë jashtë edhe shum tjerë*."

Gjithsesi, përtej rishkrimit apo mbishkrimit të disa tezave e disa interpretimeve të historianëve dhe kritikëve pararendës, Schirò-i, autori i veprës, ndonëse jo fort i njohur deri atëherë si historian i letërsisë shqipe, leximet dhe njohjen me letërsinë shqipe e ka të hershme e të thellë, shkrimet e tij të para datojnë që në fillim të viteve '40. Mjafton të citojmë këtë koment në recensionin mbi studimin e autorit italian Angelo Leotti për këngën V të *Lahutës së Malcis*: "E sfuggito al Leotti, l'interesante studio estetico di Gjergë Kuka... uscito in due putate nella rivista Leka"[5]. Shkrimet dhe recensionet e tij në vitet 1940-1943 lidhen ngushtë me Rivista d'Albania dhe me prodhimet librore të Qendrës së Studimeve Shqiptare. Emrin dhe kontributin e tij e gjejmë në çdo numër të "Rivista d'Albania", si kryeredaktor i saj dhe si përgjegjës i rubrikës *Rassegne bibliografiche – Letteratura*; në përkujdesjen për përkthimin e *Kanunit*, sidomos pas vdekjes së Fishtës; si sekretar i komitetit për hartimin e atlasit gjuhësor, dhe si koordinator për hartimin dhe shpërndrajen e pyetsorit të këtij atlasi, siç zbulohet edhe nga letërkëmbimet e hershme e të vona me Tagliavinin dhe Çabejn; si firmosës i një prej artikujve në përbledhjen *Le terre albanesi redente*,

[4] Po aty, f. 14.

[5] Giuseppe Schirò, Rassegne , Letteratura, Studi fishtiani, recensione sullo studio – "lahuta e malcís, Canto V ...", in Rivista d'Albania, Dicembre 1941, f. 395. Komente të ngjashme që dëshmojnë për njohjen solide të shqipes janë edhe ato në recensionin mbi studimin e Luigi Pompili: Naim Frashëri, i Pascoli, i campi (Bagëti e Bujqësija), traduzione col testo albanese a fronte, ediz. Dell'Academia Spoletina 1941, XIX, në f. 396

Kosovo, si kontribues në mbledhjen e materialeve arkivore nëpër arkiva ku përmendim sidomos artikullin: "*Tragedia inedita del seicento*"[6] etj.

Po të bëjmë një ekskursion të shkurtër mes disa hipotezave interpretuese të Schirò-it të propozuara nëpër shkrimet e "Rivista d'Albania" mes viteve 1940-1943, ndeshim njohjen e thellë të klasikëve modernë të letërsisë shqipe dhe këmbënguljen për të zbuluar ndikimet italiane në letërsinë shqipe përmes nënvijëzimit të dy poleve letrare: të *letërsisë arbëreshe* (ndërmjetëse kulturore mes letërsisë italiane dhe asaj shqipe) dhe të *letërsisë katolike* (ndërmjetëse për hir të besimit katolik mes letërsisë italiane dhe asaj shqipe).[7]

Polit të parë i përket një pjesë e madhe e artikujve të tij autorialë të cilët përqendrohen tek letërsia e arbëreshëve. Artikulli i parë është "*Poesia e musica tradizionali degli italo-albanesi*" – ku përmes një shqyrtimi të karakterit melodik e diatonik bëhet dallimi i motiveve dukshëm të ndikuara nga muzika kishtare bizantine, nga motivet thellësisht shqiptare. Pikërisht në këtë artikull do të gjejmë edhe fillesat e një prej interpretimeve më të komentuara të Schirò Juniorit, atë mbi autorësinë e veprës *Kënga e sprasme e Balës*, tezë që ai do ta rimarrë dhe do ta përpunojë edhe në *Storia della letteratura albanese*. Në artikullin e Rivista d'albania[8], Schirò i tërheq vëmendjen lexuesit për tonin "*eccessivamente romantico*" të Darës kur flet për Balën si autor të këngëve "*të sprasme*"[9]. Por qëllimi i Schirò Juniorit në këtë përcaktim, për t'i kujtuar lexuesit se dy brigjet e Adriatikut tashmë të lidhur nën kurorën e Italisë, nuk kanë qenë kurrë të ndara si kujtesë e ripërtërirë vijueshëm nga poezia popullore heroike të përfaqësuar nga Bala, qoftë ky autori i vërtetë, qoftë miti i poetit luftëtar, e çon vetë Schirò-in drejt ëndrrës romantike apo neoromantike[10]. Qëllimi politik e

---

[6] Në Rivista d'Albania, giugno 1942, XX, f. 91-109

[7] Giuseppe Schirò, recensioni për Francesco Ercole: Giogio Fishta, Rivista d'Albania, A II (1941), Fac I, pag.3-18, në Rivista d'Albania, AII (1941), Fac. II, f. 174-176; recensioni për Settimo centenario dell'ordine Francescano in Albania, Hylli i dritës, 12, 1940, po aty, f. 176-177; recensioni për P. Valentini S.I.: Elementi romano-catolici nella cultura albanese, po aty f. 177-179

[8] Giuseppe Schirò, Poesia e musica tradizionali degli italo-albanesi, në Rivista d'Albania, Fascicolo IV, 1940, f. 404-415

[9] Kritikë të mëpasëm e kanë kundërshtuar këtë interpretim të Schirò-it, ndër ta mund të përmendim: Rexhep Qosja, Gavril Dara i Riu, në Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi II, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 349 – 374; Agnia Desnitskaja, Poema romantike e Gavril Darës të riut, në Le minoranze etniche e linguistiche, Atti del 2° Congresso Internazionale, Piana Degli Albanesi, 7/11 shtator 1988, Palermo 1989, f. 513 – 549.

[10] Po aty: "Un esempio se non una meravigliosa personificazione del poeta guerriero che fa rivivere nei canti gli eroismi degli compagni l'abbiamo nel vechio Bala di Palazzo Adriano, come Gabriel Dara, con accenti romantici, anzi troppo romantici, ci riferisce, triste

ideologjik i tezës së Balës si autor i *Këngës së sprasme të Balës* në studimin "*Poesia e musica tradizionali degli italo-albanesi*" botuar në Rivista d'Albania nuk gjen argumente shkencore, aq më pak, në faqet e *Storia della letteratura albanese* rreth 20 vite më pas.

Artikulli "Te dheu i huaj" – il poema postumo di G. Schirò" është një nga ata artikuj ku Schirò Junior, ndërsa analizon autorin e letërsisë arbëreshe që përfaqëson sipas tij majën e kësaj letërsie, thekson që në fillim "*due elementi fondamentali che si fondono atraverso la sensibilita artistica del autore: la poesia popolare albanese e la poesia clasica e italiana*"[11]. Kjo tezë e tij interpretuese do të bëhet udhëheqëse edhe në Historinë e 1959, ku Schiròi referohet si autori më i madh i letërsisë shqipe, sidomos duke u nisur nga dy filtrat e sipërpërmendur: ndikimi nga letërsia popullore arbëreshe dhe nga ajo klasike italiane. Duke kaluar nëpër interpretimin autorial të Juniorit, gjithsesi, në epilogun retorik të ngushtuar disi prej ngjarjeve dhe përkatësisë politike pohohet njëanshëm se "*Ma c'e ancora un lato del poema da mettere in rilievo: l'amore all'Italia, sua patria, la fede che solo dall'Italia l'Albania avrebbe potuto essere redenta*"[12] – për të mbërritur tek pllakatat politike "*Sull Albania splende oggi la bianca stella della pace di Roma*"[13].

Gjithsesi, poezia popullore arbëreshe dhe Giuseppe Schirò si autori më i rëndësishëm i letërsisë së kultivuar arbëreshe janë piketa të rëndësishme në studimet e Juniorit që do t'i mbijetojnë politikës së ditës dhe do të bëhen "kuajt e betejës" në historinë e letërsisë së tij të vitit 1959 të dominuar nga kërkimi i albanizmës së letërsisë shqipe si poetikë e praktikë shkrimi.

Poli i dytë që shërben për të theksuar ndikimin e letërsisë italiane në atë shqiptare në shkrimet e Schirò-it në Rivista d'Albania janë autorët katolikë, dhe katolicizmi si thelb i përbashkët e i hershëm, që tek autorët e vejtër, te poezia epike arbëreshe që kujton bëmat e atletit të Krishtit/ alias heroit kombëtar, Skënderbeut, deri te poezia e Fishtës e tradita gojore gege e mbledhur nga françeskanët.

Ky thelb i përbashkët e i pandërprerë katolik mes letërsisë shqipe dhe asaj italiane vihet në dukje, për shembull, në recensionin e Junior-it për artikullin e

---

di vedere inerte la sua spada con la quale ha inutilmente combatuto per la patria... Ora Bala, a presciendere dalle fogge con cui è presentato da Gabriello Dara, deve essere considerato come il poeta rappresentativo di tutti gli altri poeti delle colonie, che già soldati, cantarono le passate gesta.", f. 409

[11] Giuseppe Schirò Junior, Te dheu i huaj, il poema postumo di G. Sciro, në Rivista d'Albania, Fascicolo I, 1940, f. 87-90

[12] Giuseppe Schirò Junior, Te dheu i huaj, il poema postumo di G. Sciro, në Rivista d'Albania, Fascicolo I, 1940, f. 87-90

[13] Po aty.

Francesco Ercole-s: "*Giogio Fishta: ...*"*sono messi in rilievo i raporti del romanticismo italiano col romanticismo fishtiano, che é in fondo il romanticismo originario e institivo della poesia popolare albanese" ose më poshtë, kur nënvijëzon gjetjen e Ercole-s për të "rilevare una certa corespondenza fra la Kulçedra e il Polifemo omerico, tra Vocerr Bala e Ulisse*"[14]

Po të njëjtën prirje e ndeshim edhe në recensionin mbi "*P. Kurti – Prralla kombtare mbledhë prej gojës së popullit*" – ku na intereson të vëmë në pah komentin: "*Pur avendo presente dei criteri scientifici, non ha potuto fare a meno di selezionare quelle favole che eticamente non possono essere accetate da un figlio di S. Francesco*".

Në recensionin e veprës së Valentinit *Elementi romano-cattolici nella cultura albanese,* Schirò-i e thekson fort deri në tendosje idenë e Valentinit duke nënvijëzuar mungesën e ngjyresave nacionale tek disa autorë të vjetër të letërsisë shqipe e duke theksuar ndjeshëm ndikimin e humanistëve latinë e bizantinë dhe të elementëve romano-katolikë: "*altro e essere greci e grecisti ed altro e essere albanesi e cultori delle letterature clasiche*." Për të mbërritur te "*dall' osservazione sommaria della letteratura che va dal 500 all 800 riesce naturale che quella moderna risenta gli influssi degli elementi romano-catolici della precedente*." Kjo tezë e Valentinit e mbështetur nga Schirò-i më 1941, do të përmbyset në *Storia della letteratura albanese* më 1959.

Tone të zjarrta, gati patetike merr nënvijëzimi i idesë së Tagliavini-t nga Schirò-i në recensionin mbi artikullin "*Alcune considerazioni sulle origini e lo sviluppo della letteratura albanese*" të të parit. Schirò-i pohon se Tagliavini ka të drejtë kur vë në pah se "*i piu antichi scrittori albanesi come Busuk, il Budi, il Bianchi e il Bogdani studiarono tutti in italia, e fa rilevare che la letteratura religiosa albanese fu catolica ed ebbe Roma come nutrice*."

Një tjetër kah i së njëtës ide të lidhjes së hershme e ndikimit të pandërprerë të kulturës katolike (lexo italiane) në letërsinë shqipe përfaqësohet në faqet e Rivista d'Albania nga recensionet e librave dhe artikujve mbi veprën e Fishtës.

Disa prej tezave të Schirò Juniorit mbi letërsinë shqipe në faqet e Rivista d'Albania, pavarësisht rrethnave politike, e sidomos kur këto rrëthana nuk ekzistojnë më do të përforëcohen në interpretimet e tij në veprën madhore *Storia della letteratura albanese*.

2. Kanoni

[14] Rivista d'Albania, A II (1941), Fac I, pag.3-18, në Rivista d'Albania, AII (1941), Fac. II, f. 174-176

Këndi i vështrimit mbi letërsinë shqiptare në historinë e Schirò-it do të jetë theksimi i albanizmës, piedestali i letërsisë gojore si tharm i saj, mëshimi te epikja, heroikja e historikja, vlerësimi i letërsisë së vatrës, i gjuhës, traditës, e besimit (kryesisht të krishterë)[15]. Të kujtojmë që autori më me peshë është anonimi popullor (zë gati një të pestën e tekstit[16]). Në këtë prizëm asnjë nuk do të përjashtohet, as vetë Shuteriqi, Fatmir Gjata, Llazar Siliqi etj. Për fat të keq, në po atë vit, 1959, një histori letërsie e shkruar shqip, jo italisht, e frymëzuar nga një ideologji e kundërt me atë që frymëzoi *Rivista d'Albania* e nga parime internacionaliste do të përjashtojë shumicën e autorëve madhorë të letërsisë shqipe

Schirò-i shkroi një histori letërsie të lidhur e në funksion të historisë së Shqipërisë dhe të historisë politike të Shqipërisë, por edhe një antologji personale autorësh e veprash, më të dashurat për të. Pra kanoni i tij është sa historik e etik, po aq dhe estetik e personal. Në qendër të kanonit të tij historik, estetik e personal është SKIROI, sepse krijoi metaforën e "*këthimit*", koinenë e "bashkimit", dialogun mistik të arbëreshit të krishterë me shqiptarin e mbijetuar bektashian, lirikën italiane e evropiane. Kanoni i tij është historik e etik pasi u përmbahet të njëjtave vlera letrare e jashtëletrare nacionale duke kombinuar tri besime, tre dialekte, tri areale gjeografike e tre autorë "*të mdhaj*": De Radën, Naimin e mirësisë dhe Fishtën poetin kombëtar, poezinë popullore dhe prozën e Kanunit (tezë që dialogon e ritrajton tezat e paraardhësve si Çabej e Koliqi e polemizon me Shuteriqin), por duke shtuar të katërtin dhe më të madhin Skiroin. Kanoni i tij është edhe estetik pasi brenda autorëve çmon jo veprat "më në zë", por veprat me vlera më të mëdha estetike (te De Rada - *Milosaon*[17] – duke po-

[15] Giuseppe Schirò Junior, Storia della letteratura albanese: "asnjë nga poetët më të mëdhenj nuk është shfaqur si i tillë prej një bote të ndryshme nga ajo shpirtërore e fantastike e traditës së pastër popullore"f. 44 (përkth) "Në mënyrë të tërthortë, mbrojtja e Krishtërimit merrte pra një kuptim politik, pasi përfundonte me mbrojtjen e pavarësisë shpirtërore të popullit kundër pushtuesit" f. 36 (përkth); E njëjta ide shfaqet kur analizon Matrëngën "është kumbari i letërsisë shqipe në Itali: letërsi në kuptimin e gjerë të fjalës, që mbështet jo te krijimi, por te sanksionimi i gjuhës ndërmjetëse mes doktrinës religjioze dhe popullit që e flet" f. 39 (përkth); e njëjta marrëdhënie e gjuhës me besimin edhe te Matrënga.

[16] Në këtë hetim sasior që mund të shndërrohet edhe në element interpretimi, është përfshirë edhe vepra e Darës *Kënga e sprasme e Balës*, brendashkruar letërsisë popullore prej Schirò-it.

[17] Giuseppe Schirò Junior, Storia della letteratura albanese, "Poema duhet shqyrtuar si një kompleks lirikash dashurie të cilave nuk u duhet kërkuar as marrëdhënie as lidhje mes tyre. Ato janë pasqyra e shpirtit të De Radës që ishte vërtetë poet i madh kur i këndoi dashurisë së vet. Përtej *Milosaos* nuk do të gjejmë veçse përpjekje të

lemizuar me përzgjedhjen e *Serafina Topias* në shkrimet e Koliqit, për shembull; te Fishta epikën robuste, *Lahuta e Malcís*, por brenda saj këngën më lirike, *Tringën*[18]; Seremben lirik në vend të Darës; te Asdreni poezinë *Mister*, te Skiroi nënvijëzon *Minon*, te Shantoja *Vorr i harruem*, etj. Por kanoni i tij është edhe personal, kur Koliqin pothuaj nuk e vlerëson për prozën e poezinë, po për veprimtarinë pranëletrare e jashtë letrare, kur Kutelin e Lumo Skëndon e përjashton krejt nga kanoni (me gjasa, prej ndikimit nga i njëjti përjashtim që i bën Koliqi)[19].

3.Dialog e polemikë

Më 1959, gjashtëdhjetë vite më parë, në të njëjtin vit botohen dy histori letërsie, njëra në Itali nga Giuseppe Schirò Junior e tjetra në Shqipëri nga një grup autorësh të kryesuar nga Dhimitër Shuteriqi. E para edhe simbolikisht është pjesë e historisë së letërsive të të gjithë botës[20], e dyta edhe simbolikisht e

kota krijimesh të ripërpunuara vazhdimisht, rreth të cilave poeti u soll për dekada pa arritur kurrë ta gjente vetveten", f. 72 (përkth).

[18] Giuseppe Schirò Junior, Storia della letteratura albanese: "*Janë të shumta episodet e Lahutës që do të meritonin të përmendeshin në veçanti, por mund të mjaftojë kënga e Tringës për të dhënë idenë e shkrirjes gjeniale harmonike të historisë dhe të mitit, të njerëzores me mbinjerëzoren, mbi të cilat ngrihet poema e Gjergj Fishtës*."

[19] Gjithsesi, duket se Martin Camaj ka mendim të ndryshëm për këtë ndikim të Koliqit mbi Schro-in. Camaj, në një letër të datës 16.08.1962, drejtuar Pipës kur diskutohet për këtë çeshtje shkruan: "*Ti ke të drejtë me pasë pak risentimento edhe ndaj meje. Mbi këtë pikë do të këthej prap, por desha të kapi çashtjen e Lumo Skëndos e të historisë së Skiroit. E njof mirë Skiroin mbasi âsht ordinar i univers. të Romës dhe e dij se ke ai nuk losin rrol mendimet e pasjonet tona të mbrendëshme politike. E merr vesh vetë: nji njeri me nji pozitë të tillë intelektuale e morale (ai âsht bizantist i madh i Italisë, mbasardhsi i Mercatit në kohën e vet mâ i miri në Europë i degës së fjalë) dhe ai jam i bindun se do të jetë mundue me qenë fare objektiv. Ai ka pasë kët princip: me bâ nji histori të letërsisë shqipe e jo të kulturës shqiptare. Nëqese Skëndo asht nji poet, novelist apo prozaist i mirë Skiroi nuk do ta ketë lanë jashtë për çashtje politike por pse nuk do të ketë pasë veprat e tija përdore. Mund të mendohet prej ndokujt që s'dijnë punët e mbrendëshme se aty asht edhe gishti i Koliqit. Ata janë miq tash 30 vjet e sigurisht janë këshillue në shum pika, por jam i sigurtë se ky nuk do t'i ketë thanë kurr "shtin Palin e len Pjetrin jashtë*"... "*Skiroit i thash aqim në lidhje me ty (Pipën, shën i imi). Ai më përgjegji kështu: ky tekst historie asht gadi tash dhetë vjet dhe unë mâ parë s'kam pasë asnji poezi të Pipës; kështu kanë mbetë jashtë edhe shum tjerë. Unë mendoj se Skiroi edicjonin e dytë do ta ndreqi në shum pika, por gramatikantat dhe njerzit e kulturës shqiptare nuk do të hyjnë në historinë e tij, si Kruja, Karl Gurakuqi, as Çabej që âsht albanologu mâ i madh sot gjallë, dhe mâ i madh se Jokli*!". Marrë nga vëllimi i letërkëmbimit të Pipës me Camajn që është në proces botimi.

[20] Vepra Storia della letteratura albanese është pjesë e kolanës "Storia delle letterature di tutto il mondo".

ndan letërsinë shqiptare nga bota e vetvetja. Prirja për ta pranëvënë letërsinë shqipe si të tërë, por kryesisht atë arbëreshe dhe atë katolike në marrëdhënie me letërsinë botërore e kryesisht atë italiane është e dukshme në veprën e Schirò-it, ndërsa e kundërta, izolimi nga letërsia botërore dhe amputimi i letërsisë shqipe është i shpallur e i dukshëm tek e dyta. Vepra e Schiròit duke hyrë në rradhën jo fort të gjatë të historive të letërsisë shqiptare dialogon e polemizon me to. Polemika e pashpallur nis që me kushtimet: "*Luka Skiroit e Giovana Clestit, prindërve dhe shpirtrave të mërgimtarëve të parë shqiptarë që ruajtën ritet e zakonet*" ua kushton Schiròi veprën e tij[21], "*Partisë së Punës së Shqipërisë, trashëgimtares dhe vlerësueses së madhe të traditave të popullit tonë, farkëtueses së kulturës sonë socialiste me rastin e XV vjetorit të çlirimit të atdheut me dashuri dhe respekt të thellë*" – ua kushtojnë autorët e historisë së Tiranës.

Polemika vazhdon e pashpallur edhe në mënyrën e periodizimit të letërsisë shqiptare. Historia e vitit 1959 është vetëm rishkrim më i zgjeruar i amputimit të gjysmës së letërsisë shqipe në Historinë e letërsisë të vitit 1955 nga Shuteriqi. Periodizimi që zanafillën e ka në këtë tekst të 1955, e karakterizon letërsinë shqipe në letërsi **të vjetër** e letërsi **të re**. "*E vjetra, feudalizëm dhe gjuhë arkaike/ e reja e frymëzuar nga përpjekjet çlirimtare dhe gjuha e re*".[22]

Periodizimit binar, ku ndahen kategorikisht e mira dhe e keqja, e vjetra dhe e reja, ku amputohet gjysma, ku dyshi bëhet njësh e njëshi përgjysmohet, në të gjitha historitë e letërsisë të botuara në Shqipëri në komunizëm pas historisë së 1955, në historinë e Schirò-it i përgjigjen tri alternativa si përkëmbime e si varietete në unitet (tre poetë, tri besime, tri dialekte, një letërsi nacionale). Historia e tij dialogon nga ana tjetër me vargun e historive që nis me Straticonë, Petrotën, Rrotën, *Shkrimtarët shqiptarë* dhe e vijon dialogun më pas me tekstet historike të Koliqit më 1963[23], 1965[24] dhe të Resulit më 1970[25]. Mund t'i shtonim natyrshëm këtij vargu edhe studimin e Giuseppe Gradilones *Studi di letteratura albanese contempornea* i cili, duke ndjekur të njëjtën linjë sjell një ndër analizat e para serioze të realitetit të hidhur të "realizmit-socialist" shqiptar.

Ajo çfarë ndërpritet në Shqipëri më 1945, por paradoksalisht edhe sot,

---

[21] "A Luca Schirò e a Giovanna Clesi miri genitori e agli spiriti dei primi esuli albanesi che nel 1448 giunti in Sicilia Contessa Entellina per rito lingua e costume rigenerarono questa testimonianza di culto e di memoria riverente dedico."

[22] Dhimitër Shuteriqi, Histori e letërsisë shqipe, Tiranë, 1955, f. 4: "edhe pse shkruhet në të folmet e dialektet e ndryshme, nis të shkojë drejt njësimit."

[23] Antologia della lirica albanese, Milano, All'Insegna del pesce d'oro, 1963

[24] Enciclopedia dei popoli d'Europa, I, Albania, Letteratura, Milano (1965)

[25] Storia delle letterature del sud-est europeo, Milano 1970

vijon dialogun në Itali e mërgim. Dialogu me veprën madhore *Shkrimtarët shqiptarë* i ndërprerë për gjashtëdhjetë e pesë vite është cunguar edhe sot, pasi pjesa e dytë e veprës është botuar duke i hequr arbitrarisht 200 faqe të saj, pikërisht aty ku "*kriteri ideologjik*" do të bëhej dominant në kategorizimin e letërsisë shqipe nga historitë e letërsisë së realizmit socialist. Polifonizmi i veprës së Schirò-it shfaqet në disa "*dialogje*" kryesisht në ato me Koliqin: - në dialogun me interpretimin e Mjedjes si autori klasik i letërsisë shqipe nga Koliqi, të botuar te Cirka më 1937; në dialogun për tre poetët ma të mëdhaj të letërsisë shqipe; në interpretimin dhe sidomos në lartësimin e Shantojës[26], të Floqit e Prenushit, deri diku edhe në interpretimin e Poradecit, Migjenit e Nolit si dhe në përjashtimin e Mithat Frashërit. Tek interpretimi apo përjashtimi i këtyre të fundit, "*dialogu*" me Koliqin është më shumë personal e politik.

Por ajo që është më e dukshme është polemika me historinë e Shuteriqit që kulmon sidomos në interpretimin e Fishtës, pjesë që për saktësi po i citoj:

Histori e letërsisë shqipe, 1955: *"Gjergj Fishta, koka e shkollës letrare të klerit katolik, vegël e të njëjtëve. Me shkrimet e tyre, këta luftuan zakonisht idetë dhe përpjekjet përparimtare në Shqipëri, ushqyen shovinizmin, nxitën luftën kundër popujve fqinj duke lënë në heshtje luftën kundër pushtuesve turq, austriakë e italianë, kundër imperializmit në përgjithësi... Idetë qëndrore të veprave të tyre qenë antisllavizmi, idealizimi i jetës patriarkale e të klasave sundonjëse etj..*"[27]

Storia della letteratura albanese, 1959: "*Është kurorëzuar në histori si "poeti kombëtar" i Shqipërisë, interpretuesi besnik e i lartë i shpirtit të bashkëkombasve të tij, këngëtari i lumtur i popullit që fitoi lirinë dhe pavarësinë pas pesë shekujsh të sundimit turk". "Shpirtin e Fishtës, që është edhe shpirti i vetë Shqipërisë do ta gjejmë në poemën Lahuta e Malcis:" "... në historinë e letërsisë kombëtare ai zë në poezi dhe në ndërgjegjësimin e të qenit shqiptar atë vend që zë Skënderbeu në historinë politike e ushtarake të Shqipërisë. Për hir të këtij bashkimi, që është privilegj i gjenive, nuk mund të mohohet Fishta pa mohuar Shqipërinë*".

4. Dyshime e zbulime

Pa u ndalur në komentimin e disa gjetjeve të Schirò-it si ajo për Balën autor të *Këngës së sprasme të Balës*, apo për kronologjinë e shkrimit më të vjetër

[26] Ndonëse nuk citohet në tekst, bëhet fjalë për poezinë "Për një puthje të vetme" botuar nga L. Shantoja në *Illyria*, 1934 me pseudonimin LILJAN. Më pas kjo poezi u ribotua nga Koliqi te Shêjzat, 1971, nr 4-6.

[27] Dhimitër Shuteriqi, Histori e letërsisë shqipe, Tiranë, 1955, f. 231

shqip ku *Perikopeja e Ungjillit të Mateut* shfaqet si teksti i parë, po ndalemi në dy çështje të tjera.

Dy shkollat letrare shkodrane, ky është titulli i një prej kapitujve më të rëndësishëm të historisë së letërsisë së Giuseppe Schirò Juniorit, por edhe një nga çështjet më të diskutuara të këtij libri në këndvështrim të autorësisë. Koliqi nisi ta botonte tekstin e esesë që do të shërbente si skicë për një histori të letërsisë shqipe që më 28 nëntor të vitit 1954 dhe e mbaroi së botuari më 1 shkurt 1961 në gazetën L'Albanie libre. Deri në daljen e veprës së Schiròit, më 1959, ishte botuar krejt parashtrimi teorik i konceptit të shkollave letrare shkodrane, krejt shkolla jezuite dhe nga shkolla françeskane, kishin dalë artikujt për At Leonardo De Martinon dhe Fishtën. Duhet pohuar se, habitshëm, artikujt e sipërpërmendur të Koliqit nuk citohen asnjëherë e askund nga Schiròi, ndonëse në raste të tjera Koliqi si kritik citohet, për shembull për dallimin e tipologjizimin e epikës popullore[28].

Emri i Ernest Koliqit lidhet edhe me zbulimin e një poezie të panjohur më parë të tij, në të vërtetë e vetmja që citohet në historinë e Schirò-it nga krijimtaria e Koliqit, i cili "*çuditshëm*" karakteriohet nga Schirò-i si: Bëjmë fjalë për poezinë "*Il Rapsodo e l'eroe*". Pas hulumtimeve të gjata zbulojmë që kjo poezi është botuar në gazetën L'albanie Libre më 1 nëntor 1952 dhe mban të njëjtin kushtim që shfaqet edhe në tekstin e historisë së Schirò-it: U kushtohet heronjve të lirisë së çdo fare e të çdo vendi. Por në botimin e vitit 1952, autori i poezisë është anonim, ai nuk tregohet nga redaksia, por tregohet vetëm vendi, rasti, personazhi që e ka lexuar për herë të parë këtë poezi dhe përkthyesi i saj: "*Më 27 mars të këtij viti, "Shoqata e Intelektualëve Refugjatë në Itali" (AIRI) organizoi një "Të enjte shqiptare*" me kore e këngë popullore dhe prezantime të tjera tipike të pasurisë folkloristike kombëtare që korrën suksesin më të madh dhe u duartrokitën ngrohtësisht nga publiku i shumtë e i zgjedhur që merrte pjesë në manifestim. Përkthimi italisht i një kënge epiko-lirike, *vepër e një poeti shqiptar që do të ruajë anonimitetin* dhe që u deklamua në mënyrë të admirueshme nga Prof. Gradilone, Lektor i Gjuhës Shqipe në Universitetin e Romës, ndezi aprovime entuziaste. Shumë lexues na e kërkuan dhe sot jemi të nderuar t'ua plotësojmë dëshirën duke botuar përkthimin italisht të kryer nga Ernest

[28] Giuseppe Schirò Junior, Storia della letteratura albanese, "*Në poezinë heroike, sipas ndarjes që bën Koliqi, (mund të dallohen "ciklet", një kompleks këngësh që kanë në qendër një a më shumë personazhe të së njëjtës epokë dhe "këngët e vdekjes së bukur" (terthorce) që ngrenë në qiell virtytet dhe vdekjen heroike të një a më shumë personave*". F.

Koliqi, duke mbetur në pritje që në një kohë të dytë t'ju ofrojmë në këto kolona tekstin origjinal shqip të saj." Giuseppe Schirò Junior duke e cituar një pjesë të poezisë në italisht, në të vërtetë na ka zbuluar një poezi të panjohur të Koliqit.

5. Nga letersia jo-ishullore tek historia ishullore e letersisë

Kur Çabej përvijonte më 1939 katër qarqet e letërsisë shqipe, qarkun katolik të Shqipërisë veriore, atë italo-shqiptar, ortodoksin e Shqipërisë Jugore dhe literaturën e nacionale, nuk besoj se do të mendonte se vetëm njëzet vite më pas, dukuria e ishullimit të letërsisë shqipe që kishte filluar të zbehej me lindjen e shenjave njesuese të letërsisë kombëtare do të rishfaqej sërish në letërsinë shqiptare të shkallës së dytë, në historitë e letërsisë shqiptare të shkruara brenda Shqipërisë komuniste. Në mërgimin e ri, tre poetëve, tri dialekteve dhe tri besimeve do t'u shtohen tre historianë të letërsisë që rreken të mbajnë gjallë në gjuhë të huaj njesinë e letërsisë nacionale, Koliqi, Schiròi dhe Resuli, një katolik, një ortodoks dhe një mysliman.

Pavarësisht nga vlerat e saj të pakundërshtueshme, paradoksalisht, "Storia della letteratura albanese" apo "Histori e letërsisë shqyptare" e Schirò Junior nuk ka qenë seriozisht e pranishme as në studimet e as në botimet e tridhjetë viteve të "lirisë së fjalës" mes shqiptarëve. Me bindjen se tashmë ajo është e paanashkalueshme, kam ndërmarrë përkthimin e saj, që do të shohë dritën e botimit së shpejti.

Persida ASLLANI, Brunilda DASHI, Tiranë

STUDIMET KRITIKE PËR LETËRSINË SHQIPE TË GIUSEPPE GRADILONES

Abstrakt. Studiuesi me origjinë arbëreshe, profesori emeritus Giuseppe Gradilone, student i latinistit të madh Paratore dhe nxënës shpirtëror i Ernest Koliqit, misionin e të cilit e vijoi edhe duke drejtuar Institutin e Studimeve Shqiptare në Universitetin "La Sapienza", spikat me kontributin e tij në studimet e letërsisë shqipe kryesisht përmes përmbledhjeve studimore me fokus të shtrirë nga ato të letërsisë arbëreshe, ku zotëron leximi i De Radës, i Serembes e i Schiroit, te ato të letërsisë shqipe në leximet e holla të Naimit, të Mjedës, të Fishtës e të Koliqit, për të mbërritur deri te autorët bashkëkohorë si Pjetër Arbnori, Visar Zhiti, Dritëro Agolli, Fatos Arapi dhe Kasëm Trebeshina, disa prej të cilëve duke i prezantuar cilësisht për herë të parë në hapësirën kulturore italiane.

Përmes një kombinini metodologjik që e karakterizon si studiues, ai privilegjon kërkimet komparativiste dhe variantistike, veçanërisht në kërkimin e "reflekseve klasike" të letërsisë shqipe në disa prej autorët më të rëndësishëm të saj si De Rada, Naimi, Schiro e Fishta. Ndërsa në autorët bashkëkohorë ai sprovon leximin e kontrastiv mes ideologjisë si skemë e imponim dhe filozofisë së lirisë si botëkuptim e kërkim i lirisë krijuese të shkrimtarit, duke hetuar shpesh raportin mes tekstit, autobiografisë dhe vetërrëfimit.

Ndër veprat e tij kryesore përmendim: *Studi di letteratura albanese* –1960 [Studime të letërsisë shqipe]; *Altri studi di letteratura albanese* –1974 [Studime të tjera të letërsisë shqipe]; *La letteratura albanese e il mondo classico* – 1983 [Letërsia shqipe dhe bota klasike]; *Studi di letteratura albanese contemporanea* –1997 [Studime të letërsisë bashkëkohore shqipe].

Ndonëse nuk do të jenë objekt i këtij studimi, vemë në dukje faktin se kontributi i profesor Gradilones shtrihet edhe në kritikën tekstore me botimin kritik *I Canti di Milosao*, 1965; editio princeps të veprave të Santorit *Panaini e Dellja* dhe *Fëmija Pushtjerote* – 1979; me restitutio textus të Serembes *Canto Zonjës Madhe Perëndeshës Elenë Gjika*, 1986 dhe *Contributo alla critica del testo dei Canti di G. Serembe*, 1989.

Pavarësisht kontributit të gjatë e të rëndësishëm në studimet letrare shqipe, vepra e studiuesit arbëresh Giuseppe Gradilone ka mbetur thuajse tërësisht e pa shqyrtuar në studimet mbi letërsinë shqipe të zhvilluara e të botuara në Tiranë e Prishtinë[1]. Punimet e kësaj konference, me fokus "Studimet albanistike

[1] Ndërsa në Romë, studiuesja dhe bashkëpunëtorja e tij, Dr. Brunilda Dashi, ka hartuar dhe botuar më 2012, monografinë *Ritratto di Giuseppe Gradilone – Filologo, Critico, Storico*, Sapienza Universita di Roma, Roma, 2012. Gjithashtu, po në Romë, në vitin 1999, është botuar përmbledhja *Presentazione di due volumi di albanistica*, Istituto di Studi Albanesi dell'Università degli Studi di Roma "La Sapienza", Roma, 1999, në të cilën

në Itali", krijuan premisën e duhur për të hedhur dritë edhe mbi korpusin studimor letrar të këtij studiuesi që ka kontribuuar cilësisht në studimet albanistike prej më shumë se gjysmë shekulli.

Po përmendim qysh në fillim tri momentet[2] më të rëndësishme të rrugëtimit të studiuesit dhe profesorit *emeritus* Giuseppe Gradilone, i lindur më 26 mars të vitit 1925, në Shën Mitër, qendrën kulturore të arbëreshëve të Kalabrisë:

a) formimi në Kolegjin e mirënjohur Corsini në San Demetrio Korone;
b) laureimi në Universitetin "La Sapienza" për "Lettere" duke u specializuar në Filologji Klasike me latinistin e mirënjohur Gino Funaioli;
c) njohja dhe nisja e një bashkëpunimit të ngushtë me Ernest Koliqin qysh prej vitit 1951, që thellohet edhe më tej në bashkëpunimin pranë Institutit të Studimeve Shqiptare dhe në të mirënjohurën revistën *Shêjzat*.

Mbas Koliqit, ai ka drejtuar Institutin e Studimeve Shqiptare, duke vijuar traditën e studimeve albanistike themeluar në të, dhe pensionohet si *Profesor Emeritus* më 1998.

Gjatë punës së tij e më pas në drejtimin e Institutit të Studimeve Shqiptare ai spikat me kontribute në studimet e letërsisë shqipe kryesisht përmes përmbledhjeve studimore me fokus të shtrirë nga ato të letërsisë arbëreshe, ku zotëron leximi i De Radës, Serembes e Schirò-it, te leximet e holla të Naimit, Mjedës, Fishtës, Gurakuqit e Koliqit, për të mbërritur deri te autorët bashkëkohorë si Pjetër Arbnori, Visar Zhiti, Dritëro Agolli, Fatos Arapi dhe Kasëm Trebeshina, disa prej të cilëve duke i prezantuar cilësisht për herë të parë në hapësirën kulturore italiane.

Përmes një kombinimi metodologjik që e karakterizon si studiues, Gradilone privilegjon kërkimet komparativiste dhe variantistike, si në raportin mes letërsisë gojore dhe veprave letrare të autorëve ashtu dhe në kërkimin e "reflekseve klasike" të letërsisë shqipe në disa prej autorët më të rëndësishëm të saj si De Rada, Naimi, Mjedja, Schirò e Fishta.

Ndërsa në autorët bashkëkohorë ai sprovon leximin kontrastiv mes ideologjisë si skemë e imponim dhe filozofisë së lirisë si botëkuptim e kërkim i lirisë krijuese të shkrimtarit, duke hetuar shpesh raportin mes tekstit, autobiografisë dhe vetërrëfimit.

Ndër veprat e tij kryesore përmendim: *Studi di letteratura albanese* –

---

merren në shqyrtim e çmohen kontributet e fundit të Giuseppe Gradilones nga kolegët e tij të Universitetit "La Sapienza" të Romës.

[2] Jo vetëm në rastin e të dhënave biografike e bibliografike, por edhe në të dhënat dhe analizat mbi tërësinë e veprave të Giuseppe Gradilones, sugjerojmë që, për më tepër informacion, të shihet monografia e Brunilda Dashit, *Ritratto di Giuseppe Gradilone – Filologo, Critico, Storico*, Sapienza Universita di Roma, Roma, 2012.

1960 [Studime të letërsisë shqipe][3]; *Altri studi di letteratura albanese* –1974 [Studime të tjera të letërsisë shqipe][4]; *La letteratura albanese e il mondo classico* – 1983 [Letërsia shqipe dhe bota klasike][5]; *Studi di letteratura albanese contemporanea* –1997 [Studime të letërsisë bashkëkohore shqipe][6].

Ndër titujt më të spikatur të monografive në brendësi të këtyre botimeve përmendim:

"I canti di Milosao di G. De Rada"; "Tecnica, motivi e poesia in Bagëti e Bujqësia di Naim Frashëri"; "Spiriti e forme della poesia di G. Serembe"; "La poesia di Mjeda: svolgimento e modelli letterari"; "Composizione e rielaborazione di Mili e Haidhia di G. Schirò"; "La lezione letteraria di L. Gurakuqi"; "Note sull'episodio di Tringa"; "L'opera culturale e letteratura di Ernesto Koliqi"; "Girolamo De Rada e il mondo clasico"; "Aspetti del classicismo nella poesia di Giuseppe Schirò"; "L'influenza del classicismo sull'opera di Gjergj Fishta"; "L'influenza del potere nella letteratura e nella critica"; "Il poema "Nënë Shqipëri" di Dritëro Agolli"; "La poesia eterodossa di Fatos Arapi"; "Pjetër Arbnori scrittore"; "Un profilo autobiografico inedito di Kasëm Trebeshina"; "La poesia di Visar Zhiti".[7]

Ndonëse nuk do të jenë objekt i këtij studimi, vemë në dukje faktin se kontributi i profesor Gradilones shtrihet edhe në kritikën tekstore me botimin kritik *I Canti di Milosao* (1965)[8]; *editio princeps* të veprave të Santorit *Panaini*

---

[3] Gradilone, Giuseppe, *Studi di letteratura albanese*, Roma, 1960

[4] Gradilone, Giuseppe, *Altri studi di letteratura albanese*, Roma, 1974

[5] Gradilone, Giuseppe, *La letteratura Albanese e il mondo classico*, Roma, 1983

[6] Gradilone, Giuseppe, *Studi di letteratura albanese contemporanea*, Roma, 1997

[7] Respektivisht: titujt *I canti di Milosao di G. De Rada, Tecnica, motivi e poesia in Bagëti e Bujqësia di Naim Frashëri, Spiriti e forme della poesia di G. Serembe* dhe *La poesia di Mjeda: svolgimento e modelli letterari* janë 4 nga 9 shkrimet e përmbledhjes *Studi di letteratura albanese*, 1960; titujt *Composizione e rielaborazione di Mili e Haidhia di G. Schirò, La lezione letteraria di L. Gurakuqi, Note sull'episodio di Tringa* dhe *L'opera letteraria e culturale di Ernesto Koliqi* janë 4 nga 8 shkrimet e përmbledhjes *Altri studi di letteratura albanese*, 1974; titujt *Girolamo DeRada e il mondo clasico, Aspetti del classicismo nella poesia di Giuseppe Schirò dhe L'influenza del classicismo sull' opera di Gjergj Fishta* janë 3 nga 4 shkrimet e përmbledhjes *La letteratura Albanese e il mondo classico*, 1983; titujt *L'influenza del potere nella letteratura e nella critica, Il poema "Nënë Shqipëri" di Dritëro Agolli, La poesia eterodossa di Fatos Arapi, Pjetër Arbnori scrittore, Un profilo autobiografico inedito di Kasëm Trebeshina* dhe *La poesia di Visar Zhiti* janë të gjitha shkrimet e përmbledhjes *Studi di letteratura albanese contemporanea*, 1997.

8 Gradilone, Giuseppe, *I Canti di Milosao*, translitterazione, varianti delle edizioni a stampa e traduzione a cura di G. Gradilone, Firenze, 1965.

e Dellja dhe *Fëmija Pushtjerote* (1979)[9]; me *restitutio textus* të Serembes *Canto Zonjës Madhe Perëndeshës Elenë Gjika* (1986)[10] dhe *Contributo alla critica del testo dei Canti di G. Serembe* (1989)[11]. Shtojmë këtu dhe një vështrim kushtuar Giuseppe Schirò Junior-it, botuar edhe si separat më 1992[12].

* * *

Theksojmë qysh në fillim se e gjithë kjo veprimtari studimore, në një *corpus* prej rreth 2000 faqesh, në të tëra pamjet e saj, përfshihet në kontekstin e fortë studimor, kërkimor e botues të Institutit të Studimeve Shqiptare - dhe si e tillë i përgjigjet frymës, misionit dhe frymëzimit që personaliteti i Koliqit gjeneroi mbi bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, ku krahas Gradilones, përmendim Schirò Junior, Namik Resuli, Zef Valentinin, Martin Camaj, Elio Miraco etj.

Në veprimtarinë e Institutit përvijohen 5 linja kryesore në të cilat u përkujdes për dekada të tëra jo vetëm mbijetesa kulturore e intelektuale e mbarë diasporave shqiptare por sidomos u farkëtua një alternativë "në liri" e mendimit dhe gjykimit mbi letërsinë shqipe si kundërvënie e gjymtimit ideologjik të historiografisë zyrtare në Shqipërinë diktatoriale. Në linja kryesore spikasin:

- Përmbledhja dhe shqyrtimi i traditës gojore;
- Zhvillimi i metodologjive në kërkimin albanistik;
- Përkthimi në gjuhën italiane dhe komentimi i teksteve letrare dhe të traditës popullore;
- Botimet kritike të teksteve;
- Botimi i studimeve dhe përmbledhjeve me karakter gjuhësor, letrar, kulturor, historiografik.

Pavarësisht kësaj rezonance të përgjithshme mes veprës së Gradilones në tërësi dhe kontekstit të gjerë të veprimtarisë së Institutit, besojmë se janë pikërisht studimet e tij kritike mbi letërsinë shqipe ato që shprehin më qartë lidhjen e ngushtë e pa asnjë mëdyshje "strategjike" që kjo pjesë e veprës së tij ka pasur jo thjeshtë me veprimtarinë e Institutit por me një nga synimet e tij thelbësore, gjeneruar ekskluzivisht prej Koliqit: përgatitjen e terrenit për hartimin i një historie magjistrale të letërsisë shqipe duke u mbështetur në dy shtylla kryesore:

- Sprova të një historie të letërsisë shqipe ndërmarrë prej vetë Koliqit si edhe prej Schirò Junior;

---

9 Santori, Francesco Antonio, *Panaini e Dellja, Fëmija Pushtjerote, editio princeps*, Prolegomeni, transcrizione e apparato critico a cura di G. Gradilone, Roma, 1979.

10 Serembe, Giuseppe, *Canto Zonjës Madhe Perëndeshës Elenë Gjika* (Canto a Dora d'Istria) - *restitutio textus*; edizione, introduzione, trascrizione e apparato critico a cura di Giuseppe Gradilone, Roma, 1986.

11 Gradilone, Giuseppe, *Contributo alla critica del testo dei canti di Giusepppe Serembe*, Roma, 1989.

12 Gradilone, Giuseppe, *Giuseppe Schirò Junior albanista*, Roma, 1992.

- Hartimi e botimi i studimeve monografike[13] dhe eseve kritike, ku spikat vepra e Gradilones.

Nëse studimet e tij mbi Mjedjen, Skiroin, Fishtën, Koliqin do të shiheshin të shkëputura nga kjo "strategji" e përbashkët, do të cenonim rrokjen e plotë të kontekstit sa kulturor aq edhe politik e ideologjik në të cilin ato ndërtohen, jo vetëm si shqyrtim i specifikave krijuese të autorëve, por edhe si polemikë kundër përjashtimit të tyre nga Historiografitë zyrtare (në Tiranë). Edhe analizat e tij mbi Naimin e Seremben, ndonëse më pak të theksuara në pamje të parë, shkojnë po në linjën e një polemike të brendashkruar interpretimit kritik të teksteve të autorëve. Ndërsa studimet e fundit, nuk janë më thjeshtë një polemikë por një demonstrim i mirëstrukturuar i instrumenteve të punës së historiografisë dhe kritikës zyrtare të realizmit-socialist, duke hetuar ndikimin e pushtetit në letërsi e kritikë.

-si përvojë personale e dëshmuar, nga autori dhe të tjerë për të;
-si përvojë shkrimore dhe si gjurmë e tekstit e intertekstualitet.

Te De Rada kjo vlen për epigrafet, referencat e hapura tekstore, rivizitimin e fabulave, figurat e mitologjisë antike, veprat dramatike etj. Një kërkim i imtësishëm ky që i lejon autorit të na japë mjaftueshëm idenë e "*kompleksitetit të aspekteve të klasicizmit në mendimin e në krijimtarinë poetike të De Radës: aspekte erudite e herë margjinale, të jetuara në mënyrë lirike më së shumti, por po aq thelbësorë për të rindërtuar profilin historik të personalitetit të De Radës, te i cili ushtruan magjepsjen e tyre shpirtrat e mëdhenj të së shkuarës, me të cilët e bënin bashkë jeta e brendshme intensive dhe e përvuajtur*"[14].

Më konkrete bëhet analiza në rastin e hetimit të episodeve të mirëfillta që kanë shërbyer si burim intertekstualiteti dhe rivizitimi nga ana e poetëve Schirò dhe Fishta. Këtu analiza e Gradilones bëhet mbresëlënëse.

Ajo zhvillohet "d*uke ekzaminuar qasjen [e tij]*- sqaron Gradilone në rastin e Schiro-it, - *ndaj modeleve të parapëlqyera, për të individualizuar risinë përmbajtësore, formale dhe të tonit poetik të rielaborimeve të tij, pra me një fjalë të origjinalitetit të tyre*"[15].

Shembulli që përzgjedh studiuesi është episodi i dyluftimit në pjesën e parë të "Rapsodive shqiptare", dyluftim mes Lek Dukagjinit, Turkut dhe Nik

---

[13] "Pa monografina mbi auktorë e mbi shfaqe të rrymbave letrare nuk mund të shkruhet historija qi na dishirojmë", shprehej Koliqi në skicën e lënë në dorëshkrim *Dy shkollat letrare shkodrane,* shih Koliqi, Ernest, Dy shkollat letrare shkodrane, *Vepra 5*, Faik Konica, Prishtinë 2003, f. 15.

[14] Girolamo De Rada e il mondo clasico, *La letteratura Albanese e il mondo classico*, Roma, 1983

[15] Aspetti del classicismo nella poesia di Giuseppe Schirò, ibid., f. 42.

Petës, episod i zhvilluar mbi modelin homerik të dyluftimit të Menelaut me trojanin Adrast dhe marrjes së jetës së tij përfundimisht prej Agamemnonit. Mbas krahasimit të dy momenteve strukturore në tekstet e shqyrtuara si "falja" dhe "marrja e jetës", Gradilone del në përfundimin e rëndësishëm se është: "*e re pra ndjenja e këngës: jo më urrejtja e episodit homerik, shprehje e një bote specifike historike e kulturore, por dënimi etik, dënimi ndaj tradhtisë si cilësi negative, lidhur edhe me traditën shpirtërore të këngëve tradicionale shqiptare, mbi të cilat punon Schiroi*"[16] – saktëson ai.

Ky nuk është episodi i vetëm i hetuar nga Gradilone te Schirò-i: "Te Dheu i Huaj" janë edhe episodet e ndarjes mes Tanush Topias dhe Mamicës nën frymëzimin e episodit homerik të dialogut mes Hektorit dhe Andromakës; si edhe njohjes së Aliut nga Mrika sipas skenës homerike të Uliksit nga Euriklea te *Odisea*. Gjenialja e Schirò-it saktëson Gradilone është përdorimi i "rigjetjes" jo thjeshtë si njohje e personit por si rigjetje dhe rinjohje e etnicitetit arbëror[17].

Në veprën e Gjergj Fishtës leximi i klasikes zhvillohet edhe më kompleks në disa nivele: frymë homerike në epikë, modele klasike në vargëzim, intertekstualitet që riinterpreton në shqip vargje të Virgjilit, Ovidit, Horacit etj., si dhe në tekstin dramatik, ku spikat veçanërisht tragjedia *Ifigjenia n'Aulli*, në të cilën poeti "*shfaq një njohje të plotë të tragjedisë euripidiane të cilën e ripropozon përmes një rizhvillimi personal e origjinal*"[18]. Gradilone ndërmerr një lexim krahasues të imtësishëm, duke hetuar përftimin e karakterit shqiptar të heroinës fishtjane, që kulmon në mbyllje të tragjedisë me sakrifikimin e Ifigjenisë shqiptare, ndryshe nga ajo euripidiane (që shpëtohet përmes një artifici skenik). Është pikërisht sakrifikimi i Ifigjenisë, motivacioni, ligjërimi, modalitetet dhe regjistri kulturor në të cilin komunikon, që e bëjnë heroinën antike një heroinë tipikisht shqiptare duke ia përshtatur në fund edhe modelit kulturor e letrar të Rozafës.

Në analizën e Gradilones shkëlqen edhe episodi i Tringës së *Lahutës* si një figurë që i rri përballë personazhit të Kamilës virgjiliane të *Eneidës*. Edhe këtu, autori heton jo thjeshtë intertekstualitetin episodik por origjinalitetin riinterpretues të poetit, i cili, mbi modelin e episodit klasik modelon një variant të ri e një poetikë të re. Ndaj në përfundim, kjo përvojë klasike e Fishtës përkufizohet si një përvojë themelore kulturore që i flet shpirtit dhe trajtave të tij

[16] Ibid., ff. 44-45.
[17] Ibid., f. 56.
[18] L'influenza del classicismo sull'opera di Gjergj Fishta, *La letteratura Albanese e il mondo classico*, vep. cit. f. 109

poetike[19].

Po përmendim këtu edhe leximin e thelluar që autori kishte ndërmarrë qysh në përmbledhjen e parë të vitit 1960 të klasikes dhe klasicizmit te poemat e fundit të Mjedjes[20], *Lissus* e *Skodra*, poezi të evokimit historik e mitologjik, në të cilat "*ndjenja e lirisë dhe e rivendikimit nacional, e qetuar, por e pranishme, përbën limfën që i jep jetë krijimeve, e shprehur në një formë klasike që shenjon përsosjen dhe përmbylljen e parabolë së tij stilistike*."[21]

Nga odet Horaciane te "Trophées-të" parnasiane të Héredia-s, duke kaluar nga plasticiteti i peizazhit idiliko-historik karduçian e dritëhijet foskoliane, ky lexim i hershëm e cilësor i poetikës mjedjane e kurorëzon atë si "*poetin më kompleks e të plotë të letërsisë shqipe*"[22].

Nga kjo perspektivë leximesh klasike e neoklasike, kontributi i Gradilones mbetet unik e i domosdoshëm për çdo studiues e historian të letërsisë shqipe që priret të hetojë poetikat dhe intertekstualitetet e shumëfishta të letërsisë shqipe.

Në përmbyllje të projektit të tij të jetës, në të cilin analizat dhe monografitë studimore letrare zënë peshën kryesore, nuk mund të mos vinte edhe analiza thuajse shterruese e asaj dukurie që gjeneroi aparteidin kulturor e letrar shqiptar: realizimit socialist. Këtë e sjell përmbledhja e fundit[23] e Gradilones, e titulluar **Studi di letteratura albanese contemporanea** –1997.

Por kjo analizë nuk merr përsipër të parashtrojë aspekte të teorisë dhe estetikës së realizmit-socialist, të cilat nuk janë zhvillim i brendshëm i mendimit teorik e estetik në hapësirën kulturore shqiptare. Prandaj analiza mbështetet saktësisht te pasoja e drejtpërdrejtë që ajo ushtroi në peizazhin letrar shqiptar, duke kapur thelbin konceptual: *Ndikimin e pushtetit në letërsi dhe kritikë*, një proces, thekson autori, që zhvillohet "duke kushtëzuar e poshtëruar ekzistencën e shkrimtarëve dhe kritikëve"[24].

Me një erudicion mbresëlënës, Gradilone sjell të dhëna për të gjitha fjalimet e pleniumeve dhe kongreseve të Partisë së Punës, të Lidhjes së Shkrimtarëve, të figurave qendrore të kritikës, na shpalos jo vetëm absurditetin por sidomos rrezikshmërinë e një bashkëjetese të pamundshme mes lirisë së krijimit

---

[19] Ibid., f. 140.
[20] La poesia del Mjedja: svolgimento e modelli letterari, *Studi di letteratura albanese*, vep. cit., ff. 162-206
[21] Ibid., f. 185.
[22] Ibid., f. 206.
[23] *Studi di letteratura albanese contemporanea*, vep cit.
[24] L'influenza del potere nella letteratura e nella critica, ibid., f. 5.

artistik, skematizmit ideologjik dhe dhunës kapilare mbi të cilën pushteti mbështetej për të prodhuar artin-propagandë të tij.

Mbas këtij inventari shterues të terrorit ideologjik që buron nga teoria e politizuar si pushtet absolut, autori ka zgjedhur tri pamje të ushtrimit të saj në letërsinë shqipe:

-njëra përmes veprës tipike të realizmit-socialist "Nënë Shqipëri" e Dritëro Agollit[25], në një vështrim variantistik (meqenëse vepra ka pasur disa botime me ndërhyrje të konsiderueshme), ku poeti tipik realizon veprën tipike, nën ritmin e udhëzimeve e raporteve të pleniumeve të kohës;

-tjetra heton raportin e vështirë të disa poetëve të brezit të ashtuquajtur "novator" me skemat e ngurta të realizmit-socialist shqiptar, duke marrë në shqyrtim rastin e Fatos Arapit në studimin "Poezia heterodokse e Fatos Arapit"[26];

-Si dhe pamja e tretë dhe më e gjerë, ajo e poetëve të persekutuar e të burgosur nga diktatura, në shkrimet: *Pjetër Arbnori shkrimtar*[27]; *Një profil autobiografik i pabotuar i Kasem Trebeshinës*[28]; *Poezia e Visar Zhitit*[29].

Të tre autorët e fundit, Gradilone jo vetëm i sjell për herë të parë në vëmendjen e studiuesve dhe kritikës italiane në përgjithësi, duke paraqitur pjesë të konsiderueshme të teksteve të tyre të përkthyera, por i shndërron në ***sine qua non*** të një Historie të Letërsisë Shqipe, pikërisht si një dëshmi e shumëfishtë:

-dëshmi absolute e thelbit të lirisë së artit e të letërsisë edhe në momentet e saj më të errëta;

-dëshmi e kriminalizimit të kritikës së realizmit-socialist;

-dëshmi e thelbit anti-njerëzor të diktaturës së proletariatit.

E megjithatë, pavarësisht prirjes së shpallur të Gradilones për të hartuar përmes erudicionit e dijes të thelluar një dëshmi analitike të dukurive që ngjizën e karakterizuan letërsinë bashkëkohore shqiptare, ai shqyrton besnikërisht në çdo rast shkrimtarin dhe shkrimin, tekstin letrar dhe interpretimin e dëshmuar kritik të tij. Kjo qasje i lejon atij të "ruajë" në leximet e veta dashurinë dhe sqimën për letërsinë e mirë artistikisht, edhe aty ku poetëve "koha (u) tregoi se e kishin gabim" apo ku përvoja e hidhur jetësore ua "maturoi" forcën krijuese por edhe u diktoi kufizimet e saj.

"*Historiani* - rrëfehet studiuesi në veprën e tij të fundit -, *ka për detyrë të kuptojë gjithçka që ka ndodhur përderisa, duam apo s'duam, ka ndodhur, e për rrjedhojë të mos bjerë as në ekzaltim irracional, as në dënim aprioristik. Ndaj kam ndjekur me shumë interes, për thuajse pesëdhjetë vjet, zhvillimin e kësaj periudhe të gjatë jete e*

[25] Il poema "Nënë Shqipëri" di Dritëro Agolli, ibid.
[26] La poesia eterodossa di Fatos Arapi, ibid.
[27] Pjetër Arbnori scrittore, ibid.
[28] Un profilo autobiografico inedito di Kasëm Trebeshina, ibid.
[29] La poesia di Visar Zhiti, ibid.

arti, i sëmbuar në zemër prej dërrmimit të vijueshëm të inteligjencies dhe të kreativitetit të një populli fisnik e bujar dhe kam heshtur. Për këtë arsye, këto ese të miat, të menduara gjatë në kohë, duan të jenë shprehja e një qëndrimi të përmbajtur e të qetë, i duhuri për kë heton të vërtetën: me fjalë të tjera, nëse më lejohet t'i qasem poezisë së madhe, një qëndrim vergin di servo encomio *dje dhe* di codardo oltraggio[30] *sot*."[31]

Ndonëse ky është botimi i fundit i autorit, po në vitin 1997 ai përkujdes edhe botimin e një përmbledhjeje studimore të titulluar *Miscellanea di albanistica*, me kontribute nga bashkëpunëtorë dhe ish-studentë të Institutit, të moshuar e të rinj së bashku, si një "*provë* – pohon ai – *e historisë së shkencës, ku gjeneratat pasojnë njëra-tjetrën jo me melankolinë e fundit të pashmangshëm, por me vetëdijen e plotë e të qenit pjesë e një rrjedhe të gjerë, që në përhershmërimë e saj, përtërin e rinon ujërat e veta.*"[32]

Por nuk mund të flasim për korpusin studimor të Gradilones pa marrë në shqyrtim edhe metodologjinë e tij të cilën, në shumë raste kolegë të tij, por edhe vetë autori, e kanë cilësuar si një "metodë specifike". Tipar thelbësor i saj është një ndërthurje me bazë rigorozitetin filologjik e komparativistikës, kritikës tekstuale dhe variantistikës, duke e shndërruar tekstin në qendrën absolute të analizës.

Duke marrë në shqyrtim tekstin letrar jo vetëm si dokument por edhe si realitet estetik specifik, kjo makrostrukturë pasurohet e merr qëndrueshmëri vetëm përmes hetimit dhe ndërtimit të pandërprerë të kontekstit historik e kulturor të veprave e autorëve të tyre, epokave letrare nga njëra anë dhe theksimit të individualitetit artistik të autorëve të studiuar, duke përftuar për çdo studim një paraqitje thuajse shteruese të poetikave letrare të krijimtarisë së tyre.

Në fakt, është shpesh poetika e veprës ose ajo autoriale që është me të drejtë pika fundore e studimeve. Saktësojmë këtu se me këtë tipar të studimeve letrare që i jep vendin qendror hetimit të poetikave si pamje të origjinalitetit dhe thelbit estetik të korpuseve letrare, ai ka thelluar modelin e nisur mjeshtërisht nga Koliqi.

Veç kësaj, te Gradilone spikat sistematike prirja për të "*theksuar vlerën dhe risinë e një mesazhi sa njerëzor aq artistik*" që ai e pretendon te veprat e

---

[30] "vergin di servo encomio *e* di codardo oltraggio" janë vargje të shkëputura nga poezia e mirënjohur e poetit italian Alessandro Manzoni, me titull "5 maj", e lidhur me datën e vdekjes së Napoleon Buonapartit (5 maj 1821) të cilit dhe i kushtohet kjo odë. Poeti shprehet se "gjenia e tij poetike dëshiron të flasë për të dhe ngrihet e mallëngjyer, *pa lavde servilizmi apo fyerje të ulta*...".

[31] Premessa, *Studi di letteratura albanese contemporanea,* vep cit., f. 6.

[32] Gradilone, Giuseppe, "Premessa", *Miscellanea di albanistica,* Roma 1997, f.5.

përzgjedhura, si një bashkëpërkim pa të cilin vështirë se do të mbërrihej tek "e trashëgueshmja" e një Historie të Letërsisë Shqipe, e konceptuar kjo e fundit si trashëgimi e vlerave më të mira shpirtërore e etike të kombit.

Puna e Gradilones ka gëzuar prej kohësh vlerësimin e kolegëve të tij, shumë prej të cilëve personalitete shkencore e pedagogjike të Universitetit "La Sapienza", si Emanuele Paratore, Walter Pedullà, Piergiorgio Parroni, Paolo di Giovine etj[33]. Ndërsa nga studiuesit shqiptarë, në dijeni tonë, rezulton vetëm përpjekja e Profesoreshës Akademike Floresha Dado me shkrimin "Individualiteti i një studiuesi: Giuseppe Gradilone dhe kontributi i tij në shkencën shqiptare" (1997) e cila, e përmbyll artikullin e saj vlerësues me fjalët:

> "*Paradoksi midis jetës së gjatë shkencore, vlerave të tij si studiues dhe faktit që në shkencën tonë ky studiues nuk është njohur e vlerësuar sa duhet, ndoshta sepse punoi në një katedër me Ernest Koliqin, duhet shprishur. Duke qenë gjithë jetën i lidhur shpirtërisht me gjuhën dhe letërsinë shqipe, G. Gradilone, me gjithë largësinë fizike nga Shqipëria, mbetet një ndër figurat më të shquara të Albanistikës*".[34]

Duke e mbyllur këtë kumtesë, do të shtonim se ndoshta një punë më e organizuar për përkthimin nga italishtja në shqip e disa prej studimeve të tij letrare do ta përfshinte këtë kontribut në mënyrë më organike në studimet bashkëkohore për letërsinë shqipe e sidomos do të na lejonte të hetonim më mirë atë pol të jashtëzakonshëm kulturor e shkencor që Ernest Koliqi themeloi e i kushtoi dekadat e fundit të jetës së tij në Itali, në funksion të ngritjes së një korpusi shkencor të mirëfilltë në mbështetje të mbijetesës dhe zhvillimit të kulturës kombëtare duke anashkaluar e amortizuar aparteidin kulturor të shtetit komunist shqiptar. Dhe për këtë, fjalët me të cilat Gradilone përmbyll monografinë e tij për Koliqin, janë homazhi më i mirë:

> "*Nga gjymtyrët e shpërndara të etnosit [Koliqi] mbidhte përherë të njëjtin zë, të variueshëm në sfumatura, të njëzëshëm në frymëzim.*
> *Një mision, pra, ky i tiji, e jo vetëm kërkim shkencor.*
> *Kjo është arsyeja e thellë që e mban fuqishëm Koliqin, i cili, pavarësisht betejave të vijueshme me të cilat u përball, zhgënjimeve të pamunguara dhe dhimbjeve të mëdha që i solli fati, qëndron i patundshëm, [...] i ndriçuar nga shpresa e nga besa e idealeve të veta*"[35].

---

[33] Për më shumë shih *Presentazione di due volumi di albanistica*, vep. cit.

[34] Dado, Floresha, Individualiteti i një studiuesi: Giuseppe Gradilone dhe kontributi i tij në shkencën shqiptare, *Miscellanea di albanistica*, vep. cit., f. 43.

[35] L'opera letteraria e culturale di Ernesto Koliqi, *Altri studi di letteratura albanese*, vep. cit. f. 272.

Bashkim KUÇUKU, Tiranë

IMPAKTI I NJË VEPRE HISTORIOGRAFIKE NË HISTORITË E LETËRSISË SHQIPE DHE NË TEKSTE TË TJERË

Abstrakt. Krahas letërsisë, edhe veprat e para historiografikë të letërsisë shqipe janë shkruar nga arbëreshët e Italisë. Pas *Manuale di letteratura albanese* (Milano, 1896) të Albert Stratikoit është *Popolo, lingua e letteratura albanese* (Palermo, 1931, 1932) i Gaetano Petrotës, e cila ka pasur një impakt më të madh në tekste, në Historitë e letërsisë shqipe dhe në studime letrare. Rëndësia dhe impakti i saj, mbi të gjitha, janë përftuar prej pasurisë së madhe bibliografike, që i tejkalon 800 zëra: libra, studime, revista, gazeta në italisht, shqip-arbërisht, gjermanisht, frëngjisht, anglisht, greqisht, shumë të panjohur më parë. Tekste të më vonshëm të letërsisë për shkollat, historitë e letërsisë, studime historiografike, edhe kur në to nuk citohet, kanë marrë të dhëna, ose, vërehen ndikime, së paku, kanë gjetur të hapur rrugën për te burimet dokumentare. Te *Historia e letërsisë shqipe I, II*, Universiteti Shtetëror i Tiranës (1959) vepra e Petrotës është në bibliografi, citohet disa herë dhe vlerësohet, se, në të *konkretizohen tiparet e gjithë historiografisë sonë letrare gjer në vitet '30*; *solli shërbim të madh e mbetet edhe sot si mbështetje e nevojshme për studiuesit e historisë sonë të letërsisë, një minë shumë e pasur, një repertor i gjerë*. Por, në prizmin e "kritikës klasore marksiste-leniniste" orientimi i përgjithshëm i saj *nuk është përparimtar… ka më se njëherë vështrime reaksionare*. Te *Historia e letërsisë shqiptare*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (1983) është përsëri në bibliografi, citohet nja dy herë, por më tepër kritikohet për *mungesa të ndjeshme të metodës shkencore*, për *vështrim të letërsisë nga pozita idealiste dhe klerikale reaksionare*. Pavarësisht kritikave rënduese, në të dy tekstet ka gjurmë të ndjeshme të librit të Petrotës, deri në koncepte metodologjike të njëjta.

Në vitet e mendimit të lirë (1991) jo rastësisht është ringjallur interesimi për *Populli. gjuha dhe letërsisa shqiptare* të Gaetano Petrotës. I përkthyer nga Qemal Velija, në shenjë vlerësimi, u botua në Tiranë (*Almera*, 2008), duke plotësuar zbraztësinë e madhe të atyre studimeve pararendëse, që kanë lënë gjurmë në historiografinë e letërsisë shqipe, por, në ditët e sotme, thuajse, nuk mund të gjenden.

Në këtë kumtesë do të ndalemi në disa çështje të rëndësishme të ndikimit të italishtes mbi shqipen, si rishqyrtimi i dallimit të huazimeve latine nga ato italiane (i vlerësuar nga Çabej si njëra nga çështjet themelore të historisë së gjuhës shqipe), vlerësimi i venecianizmave dhe italianizmave diturore në shqipen e lashtë e kryesisht tek Buzuku, vlerësimi i ndikimit të italishtes në trevën e gegërishtes veriperëndimore ndërmjet shekujve 19-20 dhe i italishtes mbi shqipen në periudhën ndërmjet dy luftërave e pas Luftës së Dytë Botërore, duke shqyrtuar fakte të reja gjuhësore e duke saktësuar përfundimet që rrjedhin prej tyre.

Kanë kaluar nëntëdhjetë vjet që nga botimi i veprave studimore, gjuhësore, letrare, folklorike dhe kulturore, herë me objekte të dalluara e të veçuara dhe herë me objekte e lloje studimesh të përziera, të Gaetano Petrotës prej nga

mund të shihen më qartë roli, ndikimi/impakti dhe vlerat e tyre në kohë të ndryshme. Vepra kryesore, e cilësuar e tillë prej studiuesve, është *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*[1] e cila ka pasur ndikim/impakt në tekste shkollore, në *Histori të letërsisë shqipe*, në studime historiografike letrare, kulturore e folklorike. Bibliografia e saj shoqëruese, që i tejkalon 800 tituj, (Janë libra, studime, revista, gazeta, etj.) në italisht, shqip dhe arbërisht, gjermanisht, frëngjisht, anglisht, greqisht, ka qenë më e pasura deri atëherë, shumë prej tyre të panjohur më parë. Në studime dhe tekste të mëvonshme, përveç vlerësimeve, kritikava ideologjike dhe metodologjike, vërehen fakte të huazuara prej saj, gjurmë të tyre, në forma e mënyra të ndryshme. Historiografët, si ata që e kanë cituar, dhe ata që nuk e kanë cituar, së paku, kanë gjetur të gatshme rrugën e hapur për te burimet dokumentare.

Në tekstin e parë *Historia e letërsisë shqipe* (1959), pohohet, se, *Vepra më e rëndësishme e historiografisë sonë letrare të asaj kohe, e dyta vepër e këtij lloji për letërsinë shqipe, mbetet libri i studiuesit arbëresh Gaetano Pettrota* Populli, gjuha dhe letërsia shqipe *(1930). Te kjo vepër mund të themi se konkretizohen tiparet e gjithë historiografisë sonë letrare gjer në vitet '30*... Ajo *solli*, vazhdon vlerësimi, *shërbim të madh e mbetet edhe sot* (në vitet 1950) *si mbështetje e nevojshme për studiuesit e historisë sonë të letërsisë, një minë/ minierë shumë e pasur, një repertor i gjerë*.[2]

Mendime e të dhëna të këtij teksti mbështeten në një varg citimesh e referenca prej saj. Ky është edhe vlerësimi më i plotë në periudhën e zotërimit ideologjik. Kritikohet se, në të, nuk ka përpjekje për periodizimin e letërsisë, as grupëzimin e autorëve, as vështrime sintetike, edhe pse Petrota e sqaron në parathënien - *Lexuesit*, se, libri nuk është nisur për *Histori e letërsisë*. Kritika më rënduese është ideologjike. *Orientimi i përgjithshëm i veprës nuk është përparimtar… Ai ka më se një herë vështrime reakcionare. Klerik, Petrotta i ep veprës së vet vulën e pikëpamjeve idealiste dhe fetare të tij*.[3]

Në tekstin e dytë, *Historia e letërsisë shqiptare* (1983), nën trysninë ideologjike më të madhe, vlerësimet, të zbritur në shkallare të dorës së dytë, janë rrudhur në dy-tre rreshta, për *interesin që paraqit me faktet e të dhënat mbi historinë e letërsisë sonë*. Janë theksuar dobësitë, sidomos "kufizimet", *mun-*

---

[1] Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1931/Gaetano Petrota *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, përkthyes Qemal Velija, *Almera*, Tiranë, 2008.

[2] *Historia e letërsisë shqipe* I, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959, faqe XV, XVI.

[3] Po aty, faqe XVI.

gesa e ndjeshme e metodës shkencore, pa i u ndarë klasifikimi ideologjik negativ, se *udhëhiqet nga pikëpamjet idealiste dhe klerikale*.[4]

Krahas impaktit të dukshëm, në studime të mëpasme dhe në *Histori të letërsisë*, ka pasur dhe një impakt tjetër "të padukshëm", që është më i rëndësishëm, sepse është i brendshëm, në koncepte botëkuptimore dhe metodologjike. Dy tekstet *Historia e letërsisë shqi*pe (1959) dhe *Historia e letërsisë shqiptare* (1983), kanë disa lidhje dhe afri vazhdimësie me *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare* e Gaetano Petrotës.

Lidhja, disa afri e përbashkësi vërehen, ndër të tjera, në ndonjë koncept botëkuptimor romantik, i kthyer në kriter metodologjik, sikurse është roli parësor i popullit në përftimin dhe qëllimin e letërsisë. Po ashtu, lidhje e përbashkësi ka në vazhdimësinë e të njëjtit objekt studimi- folklori dhe folkloristika, që janë jashtë konceptit të historisë së letërsisë, në qasjen shkencore, ngjashmërinë strukturore dhe lëndore, përkatësisht të kësaj pjese në *Histori e letërsisë shqipe* (1959), me pjesën përkatëse në tekstin e Petrotës.

Teksti i Petrotës, në krye të titullit ka fjalën *popull*. Pastaj vijnë *gjuhë* dhe *letërsi*, dy njësi në një unitet simbiozë. Letërsi pa gjuhë nuk ka. Gjuha e shndërruar në art bën letërsinë. Në konceptin romantik, populli luan rol parësor, duke qenë njëherësh *përligjja* dhe *destinateri/i adresuari/marrësi* i veprës. Ky koncept, që përshkon librin e Petrotës, përshkon edhe dy *Historitë e letërsisë shqipe*, i shprehur drejtpërdrejt, në mënyra të tjera, dhe i konkretizuar në analiza veprash e vlerësime autorësh.

Pjesa *Populli shqiptar*, me të cilën hapet libri i Petrotës, fillon me këtë frazë: "*Shqiptarët, së bashku me helenët dhe rumunët, janë përfaqësuesit e banorëve më të lashtë të Gadishullit ballkanik*."[5]

Paragrafi i parë te *Hyrja* e *Historisë së letërsisë shqipe* I (1959) është ky: "*Është e para herë, në jetën kulturale të popullit tonë, që bëhet një përpjekje kaq e gjerë për hartimin e një teksti të historisë së letërsisë shqipe*."[6]

Paragrafi i tretë: "*Vend i banuar nga një popull nga më të vjetrit e Evropës, në pellgun e Mesdheut dhe në brigjet e Adriatikut, ku janë kryqëzuar kulturat më të shkëlqyera të lashtësisë së këtij kontinenti, Shqipëria kapërceu nëpër kaq rrebeshe të historisë, sa me vështirësi të papershkrueshme, arriti të krijojë*

---

[4] *Historia e letërsisë shqiptare*, që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1983, faqe 243.

[5] Gaetano Petrotta *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*, përktheu nga origjinali: Qemal Velija, *Almera*, Tiranë, 2008, f.15.

[6] *Historia e letërsisë shqipe* I, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959, faqe VII

dhe të zhvillojë kulturën e saj kombëtare."[7]

Në *Historia e letërsisë shqiptare* (1983), I. *Letërsia e vjetër shqiptare*, kreu I, *Hyrje*, fillon me frazën: "*Populli shqiptar është një nga më të lashtët popuj të Evropës. Ai krijoi gjatë shekujve një kulturë të pasur materiale dhe shpirtërore, shprehje e vitalitetit historik të tij. Në këtë thesar, letërsia e shkruar, ndryshe nga disa fusha të tjera të kulturës, na dokumentohet relativisht vonë*."[8] Për një rast të tillë ngjashmërie, mund të thuhet, se, koncepte të njëjta përftojnë pikëvështrime, qasje, vlerësime të njëjta, deri ligjërata dhe formulime të ngjashme. Nga njëra anë, koncepti i rolit paresor të popullit në përftimin dhe qëllimin e letërsisë, i kthyer edhe në kriter metodologjik, është i romantizmit, pra, i një burimi të përbashkët. Nga ana tjetër, mund të ketë qenë edhe në vazhdën e një tradite historiografike në të cilën më vepruese, deri atëherë, ka qenë vepra e Petrotës.

Pjesa e parë, 130 f., në tekstin *Historia e letërsisë shqipe* I (1959) i është kushtuar folklorit dhe folkloristikës shqiptare. Argumentimi teorik dhe trajtimi historiografik janë kundërthënës. Për përfshirjen e folklorit në historinë e letërsisë sillen argumentet teorike, se folklori është, së pari, *krijimtari letrare*, dhe, së dyti, *baza dhe pikënisja* e letërsisë artistike. Ndërkaq, pranohen pa ngurrim *dallimet* mes krijimtarisë gojore popullore dhe letërsisë, shkencës folklorike dhe shkencës letrare. Përmbyllja e këtij arsyetimi me sqarimin, se, *studimin e folklorit të mos e bëjmë këtu përzjerazi me studimin e historisë së letërsisë artistike*[9] shpreh qartë kundërthënien mes argumentimit teorik dhe trajtimit historiografik. Tërthorazi sikur pranohet shkelja e kritereve të historisë së letërsisë, duke trajtuar në të folklorin dhe folkloristikën, të cilat nuk janë më në *Historia e letërsisë shqiptare* (1983).

Përse në tekstin e parë janë përfshirë dhe në tekstin e dytë janë lënë jashtë, kur autori dhe redaktori kryesor ishte po ai, shkrimtari dhe studiuesi Dhimitër S. Shuteriqi? Folklori dhe folkloristika, duket se, janë përfshirë për t'i dhënë më autoritet letërsisë, ende jo e pasur. Nuk përjashtohet as mundësia, që, trajtimi i tyre edhe në *Historia e letërsisë shqipe* të jetë vazhdë e traditës së historiografisë letrare, dhe veçanërisht e librit të Petrotës.

Pjesa e parë në *Historia e letërsisë shqipe* ka edhe afri e përbashkësi të

---

[7] Po aty, faqe VII.

[8] *Historia e letërsisë shqiptare*, që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1983, faqe 9.

[9] *Historia e letërsisë shqipe* I, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959, faqe 4.

tjera me tekstin e Petrotës. Duke pasur të njëjtin objekt studimi - folklorin, natyrisht, lënda është ajo, edhe pse autorët e *Historisë së letërsisë shqipe* kanë pasur në dorë lëndë shumë më të pasur. Ndërsa, trajtimi i lëndës, që, në të dy tekstet është nëpërmjet llojeve folklorike, fare mirë mund të ishte tjetër, i ndryshëm. Për pasojë, edhe struktura e përgjithshme e kësaj pjese të tekstit dhe një varg njësish studimore janë të përafërta.

Ndihmesat studimore të Gaetano Petrotës, në mënyrë më të plotë janë paraqitur në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*[10] më të fundit, dhe, krahas tyre, dhe ndihmesa universitare e tij në krijimin dhe drejtimin e katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në universitetin e Palermos prej 1932-it deri sa jetoi, më 1952.

[10] *Fjalor Enciklopedik shqiptar 3,* Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009, f. 1997.

Osman GASHI, Universiteti i Prishtinës

LETËRSIA SHQIPE NË FOKUSIN E KRITIKËS SË ANTONINO GUXETËS

Abstrakt. Në këtë kumtesë do të trajtohen veçanësitë e studimeve letrare të njërit prej studiuesve më të rëndësishëm të letërsisë shqipe që vjen nga trungu i arbëreshëve të Italisë.

Duke qenë i lindur në Horën e Arbëreshëve, duke qenë, po kështu, i shkolluar në Seminarin arbëresh të Palermos si dhe duke e vazhduar traditën e paraardhësve të tij të shquar Papas Gaetano Petrotta, Zef Valentini e të të tjerëve në themelimin dhe organizimin e institucioneve akademike e në studimet mbi gjuhën, kulturën e letërsinë shqipe Antonino Guzzeta shquhet si njëri ndër më të mëdhenjtë të një tradite të pasur. Vepra e tij "Shqyrtime letrare" e botuar në shqip më 2007 përfshin një numër të madh studimesh letrare siç janë: "Bajroni në Shqipëri", "Françesk Santori dhe Zef Serembe", "Novelat e Ernest Koliqit mes traditës dhe risisë", "Poezia e Martin Camajt", etj.

Leximi i kujdesshëm i këtyre trajtesave na e shpërfaqë një studiues të thellë, këndvështrimet teorike e historiko – letrare të të cilit janë nga më të ndryshmet: strukturaliste, semiologjike, filologjike, antropologjike.

Studimi i tij "Bajroni në Shqipëri", me informacionet që sjell, me analizën e teksteve të Bajronit si dhe me kontekstin kohor e hapësinor mund të konsiderohet nga shkrimet e para diskursive komparative në studimet letrare shqiptare

Historia e letërsisë shqipe është shumë komplekse, me zhvillime të befta, atipike për kontekstin e përgjithshëm evropian, me kundërthënie të skajshme, me shkëndija gjenialiteti dhe me mosnjohje gati të plotë të autorëve, veprave e dukurive letrare në kohë e në hapësira të ndryshme. Ajo e ka krahun e saj diasporik, i cili është nismëtar i letërsisë së mirëfilltë (letërsia e arbëreshëve të Italisë) dhe pa dyshim nismëtar i letërsisë së romantizmit shqiptar, ndonëse ka pasur periudha kur ka qenë e mundur të flitet edhe për letërsinë shqipe si letërsi ekskluzivisht e diasporave.

Përgjatë gjithë shekullit XIX shkrimtarët arbëreshë e shkruan letërsinë e të gjitha gjinive, zhanreve e llojeve letrare: poemën epiko-lirike (De Rada, Dara i ri, Santori, Skiroi), poezinë lirike, baladën, sonetin (Zef Serembe); dramën, kanconën, poezinë satirike, romanin (Santori). Ata po kështu ishin mbledhës dhe përpunues të trashëgimisë folklorike (*Rapsodi e një poemi arbëresh*, *Këngë tradicionale*), ishin filologë, historianë, estetë, gjuhëtarë.

Një regjistër jashtëzakonisht i pasur, për një komunitet, i cili kishte kaluar shumë vështirësi përgjatë shekujsh për të ruajtur gjuhën e traditën e të parëve

larg atdheut. Nëse tërë shekullin XIX tek arbëreshët e Italisë mund ta konsiderojmë shekull të letërsisë, shekulli XX përgjithësisht shquhet për kritikën letrare, historinë e letërsisë e për studimet filologjike e kulturologjike.

Antonino Guxeta nga Hora e Arbëreshëve, pa dyshim i takon kësaj plejade studiuesish dhe shquhet shumë për vokacionin e kritikut, për thellësinë e gjykimeve dhe për risitë që sjell në studimet për letërsinë arbëreshe e më gjerë. Emri i tij lidhet pashkëputshëm me Seminarin Arbëresh të Palermos, ku i mori mësimet e para dhe ku u njoh me papas Gaetano Petrotan, "themeluesin e Katedrës dhe të parin docent të gjuhës e të letërsisë shqipe në Universitetin e Palermos". Përgjatë jetës ai u bë dëshmitar dhe pjesëmarrës aktiv i asaj që quhet ***gjysmëshekulli i albanologjisë italiane***, duke rindërtuar njërën nga "stinët më të begata të kulturës arbëreshe" (M. Mandala).

Sipas Mateo Mandalasë Guxeta shquhet për "shkrimet dialektologjike e filologjike arbëreshe, si një specialist në fonetikë e fonologji. Ai solli modelin funksionalist të shkollës strukturaliste në sistemin fonologjik të arbërishtes siciliane", ndërkaq "në kritikën letrare shqipe futi metodologjinë strukturaliste e semiologjike".[1]

Shkrimet kritike të Guxetës në fushë të letërsisë, të cilat janë objekt i këtij studimi janë të llojllojshme midis të cilave mund të veçohen: ato filologjike, kulturologjike e krahasimtare (*Bajroni në Shqipëri*), shkrime kritike për romantikët arbëreshë (*Françesk Santori dhe Zef Serembe në letërsinë romantike arbëreshe*, *Mbi veprën e Zef Skiroit "Këngët tradicionale" dhe krijime të tjera*), paraqitje okazionale letrare të autorëve shqiptarë të botuar në italishte (*Magjepsja e së vërtetës - novelat e Ernest Koliqit mes traditës dhe risisë*, *Poezia e Martin Camajt*) dhe më në fund shkrime për folklorin (*Gruaja dhe gjarpri: lexim i dy përrallave arbëreshe*) si dhe gjuhësinë (*Zef Krispi, helenist dhe albanolog, Dhimitër Kamarda atdhetar dhe lëvrues i gjuhës shqipe*) etj.

***

Midis të gjitha studimeve të tij letrare një vend qendror zë "Bajroni në Shqipëri". Në të mpleksen dhe bashkëjetojnë të gjitha prirjet e interesimet e Guxetës: analiza letrare dhe analiza psikologjike, vështrimi historik e kulturor si dhe këndvështrimi antropologjik, fenomenologjik e komparativ. Objekt i trajtimit të thellë e gjithëpërfshirës në këtë studim të gjatë janë vepra poetike "Shtegtimet e Çajld Haroldit" (1812), një letër e gjatë e Bajronit dërguar të ëmës me 12 nëntor 1809 për mbresat nga udhëtimi në Shqipëri e Greqi si dhe shënimet e

[1]Antonino Guxeta, Shqyrtime letrare, Ombra GVG, Tiranë, 2007, parathënia e M. Mandalasë, faqe 5 – 12.

udhëtimit të bashkudhëtarit të Bajronit Xhon Kam Hobhauz "*A jurney through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia to Constantinople during the years 1809 -1810"*[2].

Autori rreket të analizojë e vlerësojë njëkohësisht "romanin lirik" të Bajronit, letrat e tij, një korpus shkrimesh shumë të komentuara ndër bashkëkohësit e tij e më pas madje deri në ditët e sotme si dhe një prozë udhëpërshkruese, siç ishin shënimet e Hobhauz.

Si një njohës i shkëlqyeshëm i teorisë e koncepteve bazike të romantizmit, Guxeta i vë në pah tiparet kryesore të kësaj vepre të Bajronit dhe lidhjet e veprës së tij me vetë jetën e tij, me preokupimet e tij personale, sociale e politike.

Arsyet pse do të merret me veprën e Bajronit ai i shprehë që në fillim të studimit, duke pohuar se: "tema Bajron - Shqipëri rimerret tani, jo vetëm për të hetuar fatin e qytetërimit shqiptar në kulturën evropiane, por para së gjithash, për të hedhur dritë mbi çastin romantik të këtij fati dhe mbi zëdhënësin e tij më të madh; për të përcaktuar pra prurjet filologjike e historiografike të poetit të famshëm anglez". [3]

Para së gjithash në veprën e Bajronit ai i shquan tiparet si: egzotizmin, ngarkesat ideologjike, përmasat e fantastikes, interesimin për folklorin, portretizimin e figurave komplekse e kundërthënëse siç ishte ajo e Ali Pashë Tepelenës. Në shënimet e Hobhauz Guxeta vëren se bie që në fillimmenjëherë në sy "një vrundull entuziazmi që është i aftë për t'i risjellë të paprekura nëpër faqe emocionet e shqisave e të mendjes në një prozë që dëshiron, madje edhe brenda karakteristikave të përkohshme të pikësimit, të shprehë dyndjen e çrregullt të kujtimeve e të përshtypjeve".[4] Ndërsa për letrën e Bajronit shprehet se "në të vërehet një lloj shqetësimi: nga njëra anë synimi për t'i paraqitur besnikërisht të dhënat e një përvoje të jashtëzakonshme, nga ana tjetër ankthi për t'i risjellë me gjithë ngarkesën afektive që ka karakterizuar atë përvojë; sepse, merret vesh, për Bajronin gjithçka ishte e re dhe kryekëput e ndryshme".[5]

Një lexim i kujdesshëm i tezave e i gjykimeve të Guxetës për kompleksitetin e jetës e të veprës së Bajronit na i përkujton gjykimet radikale që i kishin shprehur studiuesit Tomas Sterns Eliot dhe Eduard E. Bosteter. Bosteter kishte shkruar për karakterin aristokratik të Bajronit, për fodullëkun, vetëkënaqësinë e egoizmin e tij (*egoja e rebelimi romantik).* Më 1821, sipas Bosteter,

---

[2] Udhëtim nëpër Shqipëri dhe provinca të tjera të Turqisë në Evropë dhe Azi deri në Konstatntinopol përgjatë viteve 1809 - 1810.

[3] Antonino Guxeta, Shqyrtime letrare, Ombra GVG, Tiranë, 2007, faqe 18.

[4] Po aty, faqe 39.

[5] Po aty.

Bajroni e kishte shënuar në veprën e tij "Mendime të pavarura" një regjistër të rreth dyzet personaliteteve ose dukurive të nxjerra nga gazetat angleze apo evropiane me të cilat ai do të mund të krahasohej, siç kishte pohuar "personalisht apo poetikisht". Në listë gjendeshin Rusoi, Gëtja, Shekspiri, Miltoni e Poupi, Napoleoni dhe Henri VIII, Arlekini, Timoni nga Athina dhe Satanai. "Objekt i krahasimeve aq të shumta e kontradiktore", erdhi në përfundim Bosteter, "sipas gjasash duhet të jetë diçka tjetër nga çfarë ishin ata të gjithë; por ç'mund të ishte më shumë se sa që dinte ai vetë, apo kushdoqoftë tjetër."[6]

Edhe Guxeta e kishte kuptuar qartë këtë kompleksitet e karakter kundërthënës të Bajronit, gjithsesi të përputhshëm fillimisht me filozofinë romantike si dhe atë që shquhet tek veprat e tij, sidomos te "Çajld Haroldi". Ai e quan Bajronin "poeti aristokrat", i cili "nuk e kishte të gjithë ndjeshmërinë e nevojshme dhe as vetëdijen historike për të kuptuar dramën që përjetonin popullsitë shqiptare të nënshtruara nga Ali Pasha".[7]

Vetëkënaqësia dhe individualizmi i Bajronit shprehen saktësisht në bisedat e tij me Lady Blessington, në pranverën e vitit 1823, kur Bajroni po mendonte për vështirësitë e biografëve të tij të ardhshëm: "domethënë", shkruante ai, "nëse e njoh vetveten do të mund të thosha që nuk kam fare karakter, … ajo që e mendoj për veten është se jam aq inegzistent, pasi kam qenë gjithçka e asgjë për kohë të gjatë. Unë jam një *mélange* (përzierje)e tillë e çuditshme e të mirës dhe e të keqes prandaj do të ishte e vështirë të më përshkruajnë."[8]

Duke rezymuar idetë mbi paradoksalitetin e karakterit të tij, studiuesi Bosteter e definon kështu pozicionin e tij: "këtë shqetësim fascinant të Bajronit, të ballafaquar me personalitetin vetjak e ndajnë të gjithë ata që kanë qenë të hedhur në orbitën e tij. Që ai ishte *diç ndryshe* është mjaftueshëm e qartë nga fakti që fjala "bajroniste" u bë një farë lloji i heroit mitik siç ishin Edipi apo Prometeu".[9] Megjithatë në tekstin e tij mbi Bajronin Guxeta pohon se prapësepraprë portreti që na japin letrat lidhur me Ali Pashën është i ndryshëm nga ai që na sjell "Çajld Haroldi"[10]. Po kështu Bajroni shkonte në gjurmët e Uolltër Skotit, krijuesit të romanit historik në romantizëm, në kontekstin e shpërfaqjes së ekzotikes e të të madhërishmes përbrenda përmbajtjeve të veprave të tij, por shpesh edhe i paraprinte dhe e kapërcente atë si model.

---

[6] Edward E. Bosteter, Dž. G. Bajron, Izabrana dela, Prosveta, Beograd, 1976, (nga parathënia, faqe 5 – 12).
[7] Antonino Guxeta, Shqyrtime letrare, Ombra GVG, Tiranë, 2007, faqe 62.
[8] Edward E. Bosteter, vep. cit., parathënia, faqe 5 – 12.
[9] Po aty.
[10] A. Guxeta, vepër e cituar, faqe 42.

Një nga synimet a intencat themelore të këtij studimi të Antonino Guxetas është kërkimi i një modusi të përputhshëm midis letrave të Bajronit dhe asaj që del si paradigmë e simbolikë në "Çajld Haroldin" e tij. Për të arritur në këtë pikë ai e vendosë studimin e tij në tri shtylla të veçanta:

-Bajroni si personalitet dhe përvoja e tij vetjake;

-Uolltër Skoti, krijuesi i romanit historik të romantizmit dhe

-Shqipëria, zbulimi i tij fascinues.

Kjo e fundit shpesh nga romantiku anglez është parë si një ambient ekzotik, mistik, misterioz, i virgjër e i panjohur. Ai e mendonte veten si zbulues i saj (të Shqipërisë), deri në një përmasë të tillë fantastike sa do të mund të krahasohej me përrallat arabe të "Një mijë e një netëve". Krahasuar me "rindërtimet e vështira historike të Uolltër Skotit, të lidhura me kodet mesjetare, udhëtimet dhe eksplorimet e Bajronit zbulojnë jo vetëm te piktoreskja, por në të gjitha aspektet e tjera të rrëfimit, qoftë prozaik qoftë poetik (pavarësisht prej disa momenteve në të cilat ndihet retorika), ndeshjen me gjërat dhe me njerëzit përmes një mënyre të shkruari për të cilën është e huaj çdo përmasë librore". "Romani" i Bajronit", e thotë Guxeta, "është para së gjithash përvoja jolibrore, por konkrete e një personaliteti që endet nëpër botë".[11]

A ishte kjo përmasë jolibrore e Bajronit baza e *romanit*të tij "Shtegtimet e Çajld Haroldit"? A mund të flasim për vërtetësinë, sinqeritetin, për përmasën edhe dokumentare të asaj vepre? Pa dyshim po, në qoftë se e analizojmë tërë veprën e tij letrare si dhe biografinë e tij të bujshme.

Imazhi mbi "tjetrin"

Kur e trajtojmë veprën e Bajronit, filozofinë bajroniane, konceptet si *dhembja e shekullit, pikëllimi botëror (*Weltschmertz), madje edhe kur flasim për *satanizmin*, i cili përgjithësisht në romantizëm lidhet po me emrin e Bajronit mund ta vështrojmë atë në kontekstin e një koncepti që i takon fushës së komparatistikës. Frenand Baldensperger dhe Paul van Tieghem e kanë përdorur emërtimin **imagologji,** konceptin e imazhit për *tjetrin, të ndryshmin* apo për *të huajin* si e njohim e siç na duket, duke kuptuar me këtë pamjen, portretin, imazhin e ndonjë populli në letërsinë e një populli tjetër. Por nëse egziston një imazh, që përsëritet në kohë e hapësirë, egzistojnë edhe **stereotipat**, rrjedhoja negative të tij, moskuptimet apo keqkuptimet.

[11] Antonino Guxeta, Shqyrtime letrare, Ombra GVG, Tiranë, 2007, faqe 54.

Për Hugo Dyserink ka një *imagologji komparative* e cila është domosdoshmërisht interdisiplinare. Madame de Staël (1766 - 1816), letrarja dhe historianja frënge në veprën e saj "Mbi Gjermaninë" (De l'Allemagne), të botuar më 1813 dhe të përkthyer gjermanisht në të njëjtin vit, i shihte gjermanët si popull ëndërrimtarësh, poetësh e filozofësh dhe ky imazh do të përcaktonte pikëpamjet për Gjermaninë edhe disa decenie të ardhshme pas botimit të kësaj vepre, jo vetëm te francezët, por edhe te popujt tjerë.

Portretizimi i luftëtarit shqiptar, i gruas shqiptare si dhe i prijësit shqiptar siç ishte Ali Pashë Tepelena, mund të vihet në koherencë me konceptin e imagologjisë e me pikëpamjet e Zonjës dë Stal. Pak a shumë në të njëjtën linjë ishte edhe studiuesi kroat dhe përkthyesi i Bajronit në kroatishte Ivo Hergeshiq, i cili në studimin e tij "Bajroni dhe bajronistët" shprehet: "gjakimin për erotikën e plotëson interesi për botën e cila nuk e ka humbur koloritin e saj lokal, për botën e njerëzve primitivë, të cilën nuk e ka prishur civilizimi bashkëkohor (shih Rusonë dhe filozofinë e tij të natyrës), prandaj dinë të duan e të urrejnë, të robërojnë e të vrasin, të primitivëve, të cilët Haroldi - Bajroni vërtetë do t'i takojë (ndërsa thellësisht do t'i njohë) në Mesollongji, në stacionin e tij të fundit jetësor edhe më thellësisht se sa e kishte paramenduar."[12]

Heroin lirik të Bajronit Guxeta e quan "rrëfimtari spektator" dhe konstaton se Bajroni nuk doli jashtë kornizave të filozofisë romantike madje edhe kur shkruante për shqiptarët" (Guxeta, 62). "Dokumentet", siç i quan ai, bajroniane, e shfaqin plotësisht përmasën e tyre letrare, joshjen njohëse, por ato zbulojnë, sipas një optike historiografike ngushtësisht shqiptare, edhe kufizimet e tyre.

Vështruar në tërësinë e tij, mund të konkludojmë se Antonino Guxeta në studimin "Bajroni në Shqipëri" ka dëshmuar njohje të thellë të filozofisë, të parimeve krijuese e veçorive tjera tematike e stilistike të Romantizmit. Interesi për Bajronin, për njërin nga shkrimtarët më të lexuar, më të komentuar dhe shpeshherë më të keqkuptuar, poetin i cili shkeli në tokën shqiptare para rreth dyqind vitesh, përligjet, duke pasur parasysh konceptin e ***ëndrrës romantike,*** një nga konceptet bazë të Romantizmit që mund ta lidhim edhe me ëndrrën e madhe të arbëreshëve të Italisë për rikthim në atdheun e çliruar të të parëve të tyre (i kujtojmë vargjet e De Radës, Serembes, Skiroit).

***

[12] Byron, *Childe Harold,* Zagreb, 196,5 pasthënie e Ivo Hergešić, faqe 245-258.

Në shkrimet kritike për letërsinë të Antonino Guxetas mund të veçojmë edhe disa ide të rëndësishme, me interes për studimet letrare shqipe. Në studimin e tij për Françesk Santorin dhe Zef Seremben ai vë në qendër të vëmendjes çështjet e historisë së letërsisë si dhe të periodizimit të letërsisë shqipe, më saktë kufijtë kohorë të romantizmit shqiptar. Por sipas tij disa çështje ishin akoma të pazgjidhura:

a.Kur zë fill e kur mbaron Rilindja? A pajtohemi për vitet 1836 (si vit i fillimit) - dhe 1912 (si vit i mbarimit)?

b.A mund të flitet për ekzistencën e një periudhe tranzitore që mund ta emërtojmë si PREROMANTIZËM? Këtë tezë ai e argumenton me veprimtarinë letrare, historike e kulturore të autorëve arbëreshë të shekullit XVII e XVIII si At Gjergj Guxeta, Françesk Avati, Nikollë Brankati, Nikollë Filja, Nikollë Keta, Jul Variboba, Darenjtë, Engjëll Mashi e Krispi.

Më në fund kur trajton veprën e Ernest Koliqit autori i karakterizon novelat e tij si "një zgjidhje fatlume moderne e një forme narrative që prirjet tona letrare me gjasë e mbajnë si të kapërcyer. (Guxeta, 182)

Po kështu midis tipareve dalluese të poezisë së Martin Camajt veçon universalizimin e poezisë së tij "sipas një konceptimi më fort pankronik se sa historik të përvojave e ndjenjave" (Guxeta, 207)

Kontributi i Antonino Guxetas dhënë albanologjisë përgjithësisht dhe studimeve letrare shqiptare veçanërisht është i madh. Është vërtetë e pafalshme që vepra e tij diskurzive të njihet kaq pak ndër lexuesit e studiuesit tanë ndonëse siç e cilëson në parathënien e veprës së tij "Shqyrtime letrare", nxënësi i tij, studiuesi Mateo Mandala, Antonino Guxeta ishte: mësues, studiues i madh, intelektual i spikatur, misionar, thesar i paçmuar dijesh dhe në radhë të parë - **arbëresh i pashoq**.

Gëzim GURGA, Palermo

FRANCESCO SOLANO DHE STUDIMET ARBËRESHE GJATË GJYSMËS SË DYTË TË SHEK. XX

Abstrakt. Francesco Solano është një nga autorët dhe studiuesit kryesorë arbëreshë të gjysmës së dytë të shek. XX, vepra e të cilit ushtroi një ndikim vendimtar në zhvillimet e mëtejshme të albanologjisë në Itali.
Kjo kumtesë synon të vërë në pah dhe të sintetizojë karakteristikat kryesore të kontributit të shumëfishtë të Solanos në lëmenjtë e dialektologjisë arbëreshe, të filologjisë, të letërsisë arbëreshe dhe të mësimdhënies së shqipes në mjedisin arbëresh.

§1.– Francesco Solano (1914-1999)[1] është një nga autorët dhe studiuesit kryesorë arbëreshë të gjysmës së dytë të shek. XX, vepra e të cilit ushtroi një ndikim vendimtar në zhvillimet e mëtejshme të albanologjisë në Itali. Në këto radhë synojmë të vëmë në pah dhe të sintetizojmë karakteristikat kryesore të kontributit të shumëfishtë të Solanos në lëmenjtë e gjuhësisë, posaçërisht të dialektologjisë dhe sociolinguistikës, të filologjisë, si edhe të mësimdhënies së shqipes në mjedisin arbëresh, duke lënë mënjanë këtu qoftë studimet mbi letërsinë arbëreshe, qoftë edhe veprën e gjerë letrare në gjuhën shqipe të autorit tonë, të cilat meritojnë një studim më vete.

Kontributi shkencor i Francesco Solanos në gjuhësi përfshin studime dialektologjike të të folmeve arbëreshe të Italisë qoftë në rrafshin diakronik, qoftë në atë sinkronik; studime të natyrës sociolinguistike; punime didaktike e didaskalike në shërbim të mësimdhënies së gjuhës shqipe në Itali; si edhe një sërë botimesh kritike të veprave të traditës arbëreshe.

§2.– Studimit të të folmeve arbëreshe të Italisë Solano i kushtoi qysh në krye të herës kontributet e tij më të mira. Përveç punës për hartimin e pyetësorit për realizimin e projektit ambicioz të Atlasit dialektologjik të arbërishtes[2], Ai ndërmori një sërë studimesh dialektologjike në terren, mes të cilave spikatin përshkrimet e plota e të hollësishme të sistemeve fonologjike dhe morfologjike

---

[1] Për të dhëna mbi jetën e F. Solanos shih Gaetano Passarelli, *Alcune note sulla cronologia della vita di Francesco Paolo Solano*, në *Studi sull'Oriente Cristiano,* Accademia Angelica-Costantiniana di Lettere, Arti e Scienze, Vol. 17, n. 2, Roma 2013, f. 153-179.

[2] Mbi kriteret ku bazohet projekti i këtij atlasi dialektologjik, mbi strukturën e pyetësorit, shtrirjen dhe metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave shih Francesco Solano, *I dialetti albanesi d'Italia meridionale. Appunti per una classificazione*, Quaderni di Zjarri 1979, f. 2.

të të folmeve të Shën Vasilit (San Basile), Pllatënit (Plataci)[3], dhe Fermës (Firmo)[4], të pajisura dhe të ilustruara me tekste të regjistruara drejtpërdrejt nga goja e folësve dhe të transkriptuara përmes një sistemi rigorozisht shkencor. Bie në sy fakti se në këto përshkrime Autori ynë distancohet nga qasja empirike që karakterizonte studimet dialektologjike që ndërkohë po zhvilloheshin në Shqiperi, pasi ai vë në zbatim metodologjinë e shkollës funksionaliste, sidomos në qëmtimin dhe zbulimin e sistemit fonologjik të të folmeve arbëreshe, në përcaktimin e numrit dhe natyrës së fonemave të veçanta, në kushtëzimet e rrethimeve fonetike e morfologjike të përdorimit të tyre etj. Vetëm më pas Solano i ballafaqon këto sisteme të veçanta me atë që ai quan "shqipja e përbashkët", për të mbërritur kështu në përfundime përgjithësuese mbi vendin që zënë të folmet arbëreshe në panoramën e gjerë të dialektologjisë shqiptare.

Punën e kërkimeve sinkronike në terren Solano e kombinoi me analizën e zhvillimit historik të dukurive gjuhësore mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga tekstet e veprave të traditës letrare arbëreshe, si p.sh. nga vepra e Vinçenc Dorsës, posaçërisht nga përkthimi i tij i *Ungjillit në të folmen e arbëreshe të Frasnitës*,[5] por sidomos nga korpusi i veprave të Anton Santorit, një pjese të të cilave vetë Solano u përgatiti botimin kritik.

Në studimin *Të folmet arbëreshe të Italisë së Jugut*,[6] botuar në vitin 1979 në kolanën *Radhonjtë e Zjarrit* dhe më vonë ribotuar i zgjeruar dhe i plotësuar me titullin *Mbi përcaktimin e disa isofoneve në arbërishte*,[7] prof. Solano, pasi identifikon dhe veçon disa tipare fonetike e fonologjike të të folmeve arbëreshe, propozon për të parën herë një klasifikim të këtyre të folmeve, të bazuar mbi dy kritere kryesore: arkaicitetin e tipareve fonologjike dhe dukuritë e ndërrimeve fonetike, duke përcaktuar në këtë mënyrë pesë areale dialektore:

1) një areal të parë konservativ ku ruhen togjet e lashta bashkëtingëllore /kl/ e /gl/, si në *klanj* e *gluhë*;

2) një areal të dytë, inovativ, ku togjet bashkëtingëllore të cilat në krye të herës përbëheshin nga një mbylltore dhe një likuide, e kanë shndërruar këtë të fundit në një frikative palatale të zëshme ose në një gjysmëbashkëtingëllore /j/:

---

[3] Francesco Solano, *Le parlate albanesi di San Basile e Plataci*, Quaderni di Zjarri, 1979.

[4] Francesco Solano, *La parlata albanese di Firmo. Schema grammaticale e testi*, Quaderni di Zjarri, 1983.

[5] Francesco Solano, *Vincenzo Dorsa e la traduzione del Vangelo nella parlata albanese di Frascineto*, Bolletino della Badia greca di Grottaferrata, vol. XXIX, 1975.

[6] Francesco Solano, *I dialetti albanesi dell'Italia meridionale. Appunti per una classificazione*, Quaderni di Zjarri, 1979.

[7] Francesco Solano, *Per la definizione di alcune isofone nell'italo-albanese*, në *I dialetti italo-albanesi*, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Bulzoni Ed., 1994.

si në rastet *pjak*, *fjë*: nga *plak*, *flë*;

3) një areal të tretë ku togjet /kl/ e /gl/ janë palatalizuar krejt në /q/ e /gj/, ndërsa togjet e tjera ruhen të pandryshuara;

4) një areal të katërt ku grykorja e aspiruar e shurdhët /h/ kalon në velare të zëshme;

5) një areal të pestë ku lëngorja velare /ll/ *mulli*, *vëlla* etj. është shndërruar në guturale të zëshme.

Mbi këtë klasifikim të parë fonologjik të Solanos u bazua më pas Leonardo Savoia kur në vitin 1991 propozoi një klasifikim të tijin të të folmeve arbëreshe, që përveç aspekteve fonologjike merrte parasysh edhe veçoritë morfologjike, sidomos ato të sistemit foljor të arbërishtes.[8]

§3.– Mbijetesa e të folmeve arbëreshe të Italisë së Jugut përbënte një çështje tjetër ndaj së cilës Solano ishte veçanërisht i ndjeshëm. Gjatë gjithë veprimtarisë së tij shkencore ai iu kthye vazhdimisht këtij problemi, duke përdorur çdo herë një qasje risore. Mund të themi se Solano ishte i pari albanolog që shtiu në punë nocione, terma dhe metoda tipike të sociolinguistikës moderne. Përmes vëzhgimesh të mprehta mbi kushtet socio-kulturore në të cilat gjendeshin komunitetet arbëreshe, Solano mori në analizë gjendjen e vështirë gjuhësore të tyre që e quajti një lloj "bilinguizmi të çalë", pasi përballë kompetencës së plotë gjuhësore të italishtes që përdorej në të gjitha nivelet, arbërishtja si gjuhë komunikimi ishte e kufizuar vetëm në mjediset e ngushta familjare dhe shoqërore. Ende sot janë aktuale udhëzimet e tij mbi rrugët që duhen ndjekur për të shpëtuar arbërishten nga zhdukja e plotë. Për Solanon të vetmet mjete që kanë në dorë arbëreshët për të vendosur një bilinguizëm të plotë janë shkolla, edukimi gjuhësor dhe alfabetizimi i tyre në gjuhën amë. Sipas tij "krahas gjuhës dhe kulturës italiane, arbëreshët duhet të zotërojnë në të njëjtin nivel gjuhën dhe kulturën shqipe [...] Kjo është e vetmja rrugë e mundshme – thoshte Solano – nëse nuk duam të rrezikojmë të humbasim çdo gjurmë të identitetit tonë, përndryshe mund të katandisemi në rolin e mjerueshëm të rezervave folklorike si ato të indianëve të Amerikës për të joshur turistët. [...]. Nuk duam të shndërrohemi vetëm në kavje për shkencën, as na ngushëllon mundësia të bëhemi objekte muzeore".[9]

---

[8] Shih Leonardo M. Savoia, "Alcuni elementi per una classificazione dei dialetti arbëreshë" (f. 13-52) në *La lingua albanese nell'Italia meridionale. Studi e prospettive*, Università degli studi di Salerno, Salerno 1991.

[9] "Accanto alla lingua e alla cultura italiana, l'italo-albanese deve possedere in eguale misura e livello la lingua e la cultura albanese" [...] "...è questa l'unica via da battere, anzi l'unica possibile se non vogliamo correre il rischio di perdere ogni traccia della nostra identità"

Solano dallonte qartë regjistrat gjuhësorë në terma sociolinguistikë, bazuar në funksionin e tyre komunikues. Për të një gjë është ta flasësh arbërishten në jetën e përditshme, në shtëpi, në bar, në mjediset shoqërore të fshatit dhe tjetër gjë është ta zotërosh dhe ta përdorësh gjuhën për qëllime letrare dhe shkencore. Përgjatë kësaj perspektive lindnin disa pyetje kyçe: cilin model duhet të përshtatnin arbëreshët për t'i arritur këta objektiva? A ekziston një dialekt i përbashkët arbëresh – pyeste Solano – për t'u marrë si model? Në përpjekje për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, pasi analizoi thellë nga njëra anë të folmet arbëreshe të Italisë dhe nga ana tjetër gjithë traditën letrare të autorëve arbëreshë të vjetër e të rinj, ai erdhi në përfundimin se "[...] nuk ka një tip të përbashkët të arbërishtes", madje në të folmet e ndryshme arbëreshe vihet re "një ndërthurje aq e ndërlikuar dukurish fonetike dhe morfologjike sa po të provonim të vizatonim një hartë gjuhësore të të folmeve arbëreshe do të na dilte një mozaik aq i larmishëm që do t'i ngjante më shumë një enigme kineze sesa një harte gjuhësore".[10]

Nga ana tjetër, – theksonte Solano – "Ndryshimet mes të folmeve arbëreshe dhe të folmeve shqipe të toskërishtes janë aq të pakta e aq të lehta sa kush njeh mirë këto të fundit dhe jo aq mirë arbërishten mund t'i ngatërrojë ato. I vetmi tipar që i dallon të folmet arbëreshe nga toskërishtja është sasia e madhe e italianizmave që gjenden në arbërishte. Dallimet e tjera janë aq të lehta sa nuk do të ngrinin peshë në çështjen e përcaktimit të një gjuhe të përbashkët".[11] Për këtë arsye për Solanon "*arbëreshët që dëshirojnë ta përdorin gjuhën e tyre me*

"[altrimenti], ma questa sarebbe una peggiore sciagura, saremo ridotti a svolgere il ruolo non nobile di riserve folkloristiche alla maniera di quelle degli Indiani d' America, per richiamo dei turisti. [...]. Non vorremmo essere soltanto delle cavie per la scienza, né ci può consolare l'eventualità di diventare addirittura dei pezzi da museo". Francesco Solano, "La realtà storico-linguistica delle comunità albanesi d'Italia" në *I dialetti italo-albanesi*, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Bulzoni Editore, 1994, f. 80-81.

[10] "[...] non vi è un tipo comune di italo-albanese" [...] "Per il resto dei fenomeni, sia fonetici che morfologici, vi è un intreccio così ingarbugliato che chi si accingesse a disegnare una mappa linguistica della parlate italo-albanesi ne caverebbe un mosaico così variopinto da sembrare piuttosto un rompicapo cinese che una mappa linguistica". Francesco Solano, *Osservazioni sulle parlate italo-albanesi*, në *Shejzat (Le Pleiadi)*, Anno IV, n. 3-4 (marzo-aprile), 1960, f. 81, 86.

[11] "Sono così poche, così lievi e comuni ad altre parlate d'Albania le differenze tra italo-albanese e tosco, che chi conosca bene quest'ultimo e non troppo bene le parlate italo-albanesi, non difficilmente li scambierebbe. Se vi è una caratteristica che distingua subito l'italo-albanese dal tosco, questa è la grande quantità di italianismi che trovansi in quello. Le altre differenze sono così lievi da non essere rilevanti, sempre ai fini di una lingua comune". Francesco Solano, *Po aty*, f. 85.

synime letrare, nuk kanë rrugë tjetër veçse t'i përshtaten sa të jetë e mundur gjuhës letrare që përdorin shkrimtarët shqiptarë. Në këtë mënyrë autorët arbëreshë nuk do të konsiderohen më si një zgjatim interesant në botën e kulturës shqiptare, por si bartës kontributesh gjuhësore, artistike dhe kulturore, e pse jo edhe të një fryme shpirtërore të re e origjinale që u buron nga mjedisi i veçantë i zhvilluar në dritën e misticizmit bizantin dhe të konkretizmit latin".[12]

§4.– Një aspekt tjetër gjuhësor që nuk mund të mos ngjallte interesin e Francesco Solanos si studiues, por edhe si prift, i vëmendshëm ndaj problemeve të kishës, përbëhet nga përdorimi i shqipes si gjuhë liturgjike në kishat arbëreshe të ritit bizantin. Në studimin e tij me titull "Shënime mbi përkthimin e liturgjisë në arbërishte", botuar në vitin 1965, gjuhëtari ynë, duke përshkuar historinë e letërsisë kishtare shqiptare nga Meshari i Buzukut deri në ditët tona, në dritën e fakteve dhe të të dhënave gjuhësore të shqyrtuara i kundërvihet mendimit të gjithë atyre që e konsideronin shqipen një gjuhë të varfër, pra të papërshtatshme për qëllime liturgjike, pasi sipas tij, "nuk është pasuria leksikore e një gjuhe ajo që përcakton aftësitë e saj shprehëse, por vitaliteti dhe stabiliteti i saj morfologjik dhe sintaksor".[13]

§5.– Nuk mund të mos përmendim këtu kontributin e Solanos në lëmin e didaktikës së gjuhës shqipe. Në pajtim me bindjen e tij mbi nevojën e përshtatjes nga arbëreshët të një gjuhë letrare të përbashkët për të gjithë shqipfolësit, Solano në vitin 1972 botoi një tekst didaktik për mësimin e shqipes nga studentët arbëreshë dhe italianë me titullin *Manual i gjuhës shqipe*,[14] që u ndoq dy vjet më vonë nga një "Udhëzues për të biseduar shqip"[15]. Në të vërtetë nuk kemi të

---

[12] "Per gli italo-albanesi che intendono far uso della lingua materna con scopi letterari, non vi è altra scelta che conformarsi il più possibile a quanto è già ufficialmente in uso e accettato dai buoni scrittori albanesi. [...] Lo scrittore italo-albanese non sarà più considerato come un'interessante escrescenza nel mondo della cultura albanese, ma come apportatore di un notevole contributo linguistico, artistico e culturale alla sua giovane e rigogliosa letteratura [...] apportando, in fine, un soffio di spiritualità nuovo e originale che gli deriva dal suo particolare ambiente sviluppatosi al calore del misticismo bizantino e del concretismo latino." Francesco Solano, *Po aty*, f. 88.

[13] "Si dice che l'albanese delle nostre comunità è povero di vocaboli e non potrebbe tradurre adeguatamente i testi greci. Neghiamo anzitutto la pretesa povertà lessicale dell' italo-albanese. [...] Per altro non è l'attuale ricchezza lessicale di una lingua che determina la sua capacità di espressione, ma è la sua vitalità, la sua essenziale sanità morfologica e sintattica", Francesco Solano, "Nota per una traduzione della liturgia in lingua albanese. Excursus sulla letteratura ecclesiastica albanese", në *Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata*, N. S. Vol. XIX, 1965, f. 18.

[14] Francesco Solano, *Manuale di lingua albanese. Elementi di morfologia e sintassi. Esercizi. Cenni sui dialetti*, Corigliano Calabro, 1972.

[15] Francesco Solano, *Guida alla conversazione albanese*. Quaderni di Zjarri, 1974.

bëjmë këtu me një tekst të thjeshtë didaskalik, por me një kontribut të vërtetë shkencor në fushën e gramatikës dhe të mësimdhënies së shqipes, sepse profesori ynë nuk u mjaftua të përshtaste a të përkthente në italishte doracakët e zakonshëm gramatikorë të shqipes letrare. Përkundrazi, duke shfrytëzuar kulturën e tij të thellë klasike, si edhe përvojën vetjake prej poligloti, ai propozoi një metodë didaktike të veçantë me një interpretim të vetin të fakteve gjuhësore që sot, pas thuajse pesëdhjetë vjetësh përdorimi të pandërprerë në universitetet italiane, mund të themi se rezultoi më se fatlum.

§6.– Lëmi i albanologjisë ku Solano dha kontributet më të rëndësishme është pa dyshim filologjia shqipe.

Qysh në vitin 1966 në faqet e revistës "Shejzat" u botua studimi i tij me titull "Bellusci apo De Rada? Vëzhgime mbi një dorëshkrim me këngë arbëreshe",[16] që në vështrim të parë mund të duket se zë një vend periferik në panoramën e gjerë të botimeve të këtij autori, por në të vërtetë ka një rëndësi vendimtare jo vetëm për të kuptuar më mirë kontributet e tij të mëvonshme filologjike, por edhe për ta vendosur historinë e gjithë filologjisë moderne shqiptare në perspektivën e duhur.

Në këtë artikull të gjatë Solano mori në shqyrtim autorësinë e një dorëshkrimi me poezi arbëreshe të botuar në vitin 1963 nga Giuseppe Ferrari[17], i cili e kishte paraqitur atë si një përmbledhje këngësh popullore të mbledhura në vitet e para të shek. XVII (1628-1633) nga njëfarë Michele Bellusci nga Frasnita. Sipas këtij datimi do të kishim të bënim me përmbledhjen e më të vjetër të folklorit shqiptar, rreth 150 vjet para *Kodikut të Kieutit*, çka përligj interesin e menjëhershëm që ngjalli botimi i atij dorëshkrimi ndër albanologët e huaj dhe shqiptarë, të cilët thuajse të gjithë i morën përfundimet e Ferrarit në mënyrë akritike si të vërteta. Në atë dorëshkrim, veç të tjerash, gjendeshin edhe nja dhjetë këngë që përsëriteshin identike te *Këngët e Milosaut* të De Radës, çka e bëri Dhimitër Shuteriqin të arrinte deri atje sa ta akuzonte poetin e madh arbëresh për plagjiaturë.[18]

Solano në studimin e tij, përmes një analize shembullore filologjike, vërtetoi se autor i dorëshkrimit në fjalë nuk ishte Bellusci por vetë De Rada. Studimi i Solanos nuk është i rëndësishëm vetëm për faktin se hodhi dritë mbi një gabim trashanik që ndërkohë kishte futur në qorrsokak gjithë folkloristikën

[16] Francesco Solano, *Bellusci o De Rada?* Osservazioni su un manoscritto di canti albanesi, *Shejzat (Le Pleiadi)*, nr. 7-8 (luglio – agosto), 1966 – Anno X.

[17] Giuseppe Ferrari, *Canti albanesi. Raccolta di Michele Bellusci del '600*. Adriatica Editrice, Bari (pa datë botimi, por në fakt doli nga shtypi nga fundi i vitit 1963).

[18] Dh. S. Shuteriqi, Këngët e Milosaos dhe poezia popullore, *Nëndori*, viti X, nr. 2, 1963.

shqiptare, por mbi të gjitha për metodën shkencore që autori ynë ndoqi për ta arritur një rezultat të tillë. Duke filluar me përshkrimin fizik të dorëshkrimit, me analizën e imtë të llojit të letrës, të filigranave që gjendeshin në të dhe të teknikave të përdorura për fabrikimin e saj, përmes të cilave autori arriti të përcaktonte periudhën kur ishte prodhuar, pra shek. XIX, te analiza fiziko-kimike e llojeve të ndryshme të bojërave të shkrimit përmes rrezesh ultra të kuqe, te analiza paleografike dhe grafologjike e tekstit, te shqyrtimi i elementeve të kontekstit historiko-kulturor që dëshmoheshin nga teksti, te analizat e hollësishme gjuhësore që flisnin për një përkatësi dialektore të autorit jo nga Frasnita, por nga Shën Mitër Korona, pra nga areali dialektologjik i De Radës, deri te shqyrtimi i tipareve individuale poetike, stilistiko-metrike e leksikore që e identifikonin gjuhën e tekstit me idiolektin e veçantë të De Radës.

Me fjalë të tjera, përmes këtij punimi Solano tërthorazi u ofroi lexuesve për herë të parë në historinë e filologjisë shqiptare një manual të mirëfilltë teorik dhe praktik të ekdotikës moderne. Ishte viti 1966; "Meshari" i Buzukut, përgatitur nga Eqrem Çabej, do ta shihte dritën e botimit dy vjet më vonë.

Përgatitja e botimeve kritike të mëvonshme të disa veprave të traditës letrare arbëreshe, si *Il Canzoniere albanese*, *Emira* dhe *Lekë Dukagjini* të Santorit; apo *katekizmi shqip i Shën Vasilit*, do të përbëjnë dëshminë dhe shembullin më të mirë praktik të faktit se metodologjia filologjike e zbatuar nga Solano për tekste të shkruara në një gjuhë të gjallë si arbërishtja ndryshon thelbësisht nga metodat e filologjisë klasike, të zbatuara para tij nga autorë të tjerë të mjedisit arbëresh, pasi këto të fundit mund të funksionojnë vetëm për gjuhë të vdekura si latinishtja apo greqishtja e vjetër, por janë krejt të pafrytshme kur zbatohen në praktikën ekdotike për botimin dhe studimin filologjik të trashëgimisë letrare në një gjuhë të gjallë si shqipja.

Ishte pikërisht kjo punë prej pionieri përmes kriteresh, metodash dhe procedimesh ekdotike moderne, që u hapi udhën një aradhe të re studiuesish dhe filologësh, nxënës të tij, si Francesco Altimari, Matteo Mandalà, Fiorella De Rosa, Vincenzo Belmonte, Gianni Belluscio etj., të cilët sot mund të konsiderohen me plot të drejtë si vijuesit e shkollës filologjike të themeluar nga Francesco Solano.

Si përfundim mund të themi se kontributi shkencor i Francesco Solanos shquhet jo vetëm për origjinalitetin e padiskutueshëm, por sidomos për perspektivën largpamëse që ai u dha studimeve të mëvonshme dialektologjike, sociolinguistike, filologjike dhe didaktike në viset arbëreshe.

Bibliografia

Ferrari, Giuseppe: *Canti albanesi. Raccolta di Michele Bellusci del '600*. Adriatica Editrice,

Bari. (1963).

Passarelli, Gaetano: Alcune note sulla cronologia della vita di Francesco Paolo Solano, në *Studi sull'Oriente Cristiano,* Accademia Angelica-Costantiniana di Lettere, Arti e Scienze, Vol. 17, n. 2, Roma 2013.

Santori, Francesco A.: *Il canzoniere albanese*. Trascrizione, traduzione italiana e note a cura di Francesco Solano, Quaderni di Zjarri, 1975.

Santori, Francesco A.: *Alessio Ducagino*, Melodramma. Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura di Francesco Solano, Quaderni di Zjarri, 1983.

Santori, Francesco A.: *Emira*. Dramma. Edizione del testo albanese e traduzione italiana a cura di Francesco Solano, 1995.

Savoia, Leonardo M.: "Alcuni elementi per una classificazione dei dialetti arbëreshë" (f. 13-52) në *La lingua albanese nell'Italia meridionale. Studi e prospettive*, Università degli studi di Salerno, Salerno 1991.

Solano, Francesco: Osservazioni sulle parlate italo-albanesi, *Shejzat (Le Pleiadi)*, Anno IV, n. 3-4 (marzo-aprile), 1960.

Solano, F.: Nota per una traduzione della liturgia in lingua albanese. Excursus sulla Letteratura ecclesiastica albanese, në *Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata*, N. S. vol. XIX, 1965.

Solano, F.: Bellusci o De Rada? Osservazioni su un manoscritto di canti albanesi, *Shejzat (Le Pleiadi)*, Anno X, nr. 7-8 (luglio – agosto), 1966.

Solano, F.: *Alfabeto albanese*, Tip. Patitucci, Castrovillari 1968.

Solano, F.: *Manuale di lingua albanese. Elementi di morfologia e sintassi. Esercizi. Cenni sui dialetti*, Corigliano Calabro, 1972.

Solano, F.: *Guida alla conversazione albanese*, Quaderni di Zjarri, 1974.

Solano, F.: *Vincenzo Dorsa e la traduzione del Vangelo nella parlata albanese di Frascineto*, Bollettino della Badia Greca di Grottaferrata, vol. XXIX, 1975.

Solano, F.: *Le parlate albanesi di San Basile e Plataci*, Quaderni di Zjarri, 1979.

Solano, F.: *Francesco Antonio Santori tra lingua e dialetto*, Quanderni di Zjarri, 1979.

Solano, F.: *I dialetti albanesi dell'Italia meridionale. Appunti per una classificazione*, Quaderni di Zjarri, 1979.

Solano, F.: *La parlata albanese di Firmo. Schema grammaticale e testi*, Quaderni di Zjarri, 1983.

Solano, Francesco: *Il catechismo Albanese di San Basile*. Edizione del manoscritto con trascrizione e interpretazione linguistica, Rende 1983.

Solano, F.: La realtà storico-linguistica delle comunità albanesi d'Italia në *I dialetti italo-albanesi*, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Bulzoni Ed., 1994,

Solano, F.: Per la definizione di alcune isofone nell'italo-albanese, në *I dialetti italo-albanesi*, Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Bulzoni Ed., 1994.

Shuteriqi, Dh. S.: Këngët e Milosaos dhe poezia popullore, në *Nëndori*, viti X, nr. 2, 1963.

Blerina SUTA, Romë

BOTIMI ITALISHT I KANUNIT, PËRGATITUR NGA DODAJ-FISHTA-SCHIRÒ (1941): DISA KONSIDERATA PËR BOTIMIN ITALISHT TË *PRILLIT TË THYER* TË I. KADARESË

Abstrakt. Përkthimi dhe botimi në italisht i Kanunit, kryer në 1941 nga një kolektiv albanologësh të nivelit të lartë (Dodaj, Fishta, Schirò) është një nga arritjet më të rëndësishme të albanologjisë në Itali.
Versioni italisht i Kanunit paraqet rëndësi jo vetëm për lëndën etno-antropologjike dhe juridike të Kodit, që ka interesuar pjesën më të mirë të studiuesve, por edhe për lëndën e rrafshit të shprehjes, veçanërisht për teknikën e kalimit nga një gjuhë në tjetrën të konstrukteve të figurshme dhe thellësisht të ngulitura. Solidariteti leksikor i fjalëve në Kanun lidhet ngushtësisht me kontekstin narrativ gojor që i ka bartur dhe transmetuar prej shekujsh nga folësit e shqipes. Prandaj dhe zëvendësimi i mjeteve të gjuhës ne sistemin e mbërritjes, me të tjera që nuk bartin funksionin e përdorimit të bashkësisë gjuhësore të nisjes, rrezikon dështimin e procesit të përkthimit.
Shembull për rëndësinë e këtij procesi përkthimor është analiza e përkthimit në italisht të një vepre si "Prilli i thyer" e I. Kadaresë e cila shpesh përdor drejtpërdrejt lëndën e konstrukteve metaforike dhe alegorike të shtresës më të vjetër të Kanunit.
Vepra artistike romanore e karakterizuar nga kontekstualiteti organik mëton përdorimin specifik të materialit gjuhësor në përputhje dhe rreptësisht të lidhur me atë kontekst. Prandaj dhe realizimi në një gjuhë tjetër (atë italiane) i vlerës shtesë të strukturës artistike të veprës, nuk mund të synohet pa konsideruar si jetike, punën e hollë albanologjike në përgatitje të përkthimit të 1941.

Kanuni[1], përmbledhja e dokeve zakonore shqiptare, ka qenë objekt i vazhdueshëm interesi e burim kryesor për krijimin e imagjinarit kulturor të shqiptarit, si në sensin pozitiv, ku koncepti i besës është më i spikaturi, ashtu edhe të mirazhit kulturor, apo imazhit të gabuar, shpesh të krijuar në shtypin e huaj.[2]

---

[1] I referohemi tekstit të *Kanunit* të Lekë Dukagjinit kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi në botim të Gjergj Fishtës, 1933: *Kanuni i Lekë Dukagjinit (vepër postume), përmbledhë e kodifikue prej A. Shtjefën Konst. Gjeçov, O.F.M., me parathâne t'A. Gjergj Fishtës, O. F. M.*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër 1933. Nuk është synim i këtij punimi arsyetimi mbi "kanunet" e ndryshme të mbledhura më herët a më vonë se ky version.

[2] Cfr. Besnik Mustafaj, *Albania: Tra crimini e miraggi*, Castelvecchi, Roma 2019, pp. 20-21: "Io leggo tutto quello che riesco a procurarmi sull'attività del crimine organizzato albanese in Europa: analisi, report, cronache. Tra centinaia di pagine di questa natura che ho avuto modo di leggere, tra le quali una buona parte confidenziali, che mi giungevano sulla scrivania quando ero ministro degli Esteri, ho trovato varie spiegazioni sull'apparizione di questo fenomeno nuovo tra gli albanesi. […] A due cose si fa più spesso riferimento. La prima è il *Kanun*, l'antico diritto consuetudinario degli albanesi, che si basa sul codice dell'onore. Il *Kanun* ha dato la possibilità per molti secoli agli albanesi di

Shkalla e receptimit të kodit nga publiku i gjerë, jashtë kufijve shqipfolës, kalon shpesh nëpërmjet veprash të tjera, më të aksesueshme, ndër të cilat më e famshmja përmendet *Prilli i thyer* i Kadaresë, edhe për shkak të sasisë së gjuhëve në të cilat është përkthyer.

Receptimi i veprës *Prilli i thyer* është ngushtësisht i lidhur me procesin e saj përkthimor; në pjesën më të madhe të gjuhëve evropiane, prej frëngjishtes.

E njëjta rrugë u ndoq edhe për variantin italisht, i cili në ato fillime u përkthye nga varianti frëngjisht i versionit origjinal të '78-s[3].

Versioni në gjuhën italiane i veprës së Kadaresë (si e përkthyera nga frëngjishtja më 1993, ashtu dhe botimi i vitit 2017 nga shqipja[4]) nuk mund t'i shpëtojë krahasimit me versionin italisht të veprës burimore, *Kanunit*[5], botuar në 1941 nga *Akademia Mbretnore Shqiptare* (Accademia dei Lincei).

"Pretekst" i këtij reflektimi mbi rëndësinë e monitorimit të specializuar të shpërndarjes në shkallë të gjerë të veprave themelore për nga struktura imagotipike, u bë një punim i filologut të mirënjohur Lorenzo Renzi, specialist i letërsisë rumune, i cili nga leximi i veprës së Kadaresë, kishte marrë shkas të zgjidhte një nyje të rëndësishme të kërkimeve të tij mbi kulturën popullore rumune dhe konkretisht për origjinën e një episodi enigmatik të *Miorița*-s (Antiche versioni della Miorița).[6]

Bëhet fjalë, në fakt, për një ngjarje kanunore, të cilën Renzi (që duket se nuk e njeh tekstin e Kanunit) e konsideron si episod të amalgamuar prej Kadaresë dhe gjen të përbashkëta në rrafsh të invariantit (*al minimo comun denominatore*) me variantin antik të *Miorița-s* rumune.

---

organizzarsi e unirsi come comunità etnica e come popolo sotto l'occupazione ottomana, al di là delle leggi del potere centralizzato dell'Impero. Nel secolo XIX, il *Kanun* serviva ormai agli albanesi coinvolti nel mondo sotterraneo del crimine internazionale di cementare la fedeltà reciproca. Ma era un Kanun adattato ai bisogni del mondo sotterraneo del crimine, senza legami con il codice d'onore, che proveniva dal Kanun storico.".

[3] Ismail Kadare, Prilli i thyer (1978), në *Vepra letrare 10*, Naim Frashëri, Tiranë 1983, tr. it., *Aprile spezzato*. Traduzione italiana dal francese (ediz. '82) di Flavia Celotto, Ugo Guanda, Parma 1993.

[4] Ismail Kadare, *Aprile spezzato*. Traduzione italiana di Liliana Cuka Maksuti, La nave di Teseo, Milano 2019.

[5] S. C. Gjeçov, *Codice di Lek Dukagjini ossia Diritto consuetudinario delle montagne d'Albania*, tradotto da P. Paolo Dodaj, a cura di P. Giorgio Fishta e Giuseppe Schirò, introduzione di Federico Patetta, Reale Accademia d'Italia – Centro Studi per l'Albania 2, Roma 1941.

[6] Lorenzo Renzi, Antiche versioni della Miorița, *Le piccole strutture. Linguistica, poetica, letteratura*, pp. 481-487. Il Mulino, Pubblicazione online: 2009 (ISBN edizione digitale: 978-88-15-14278-8).

Kadare e ka marrë ngjarjen thuajse besnikërisht nga *Shtojca* e *Kanunit* dhe konkretisht nga ajo në ilustrim të "Krye-s dhetët", *Nye XXII*, "Artikulli n. 123", me titull "Besa e gjâs e e çobânit" ku rrëfehet ngjarja e gjakësit i cili për "mos me mbarue pa shêj e pa dukë" në rast se vritej *i ban zâ skjapit të kumbonës* në mungesë të bariut të tufës: "*O skjap i kumbonës, thuejmi t'and zot, se po më gjet gjâ pa e kalue qafen e asaj kodre, t'a dijë se i jam pré mik*." (Gjeçov, Kanuni 1933[7])/ "O cjap i këmborës, i thuaj tyt zoti se, po më gjeti gjë pa kaluar qafën e kodrës përtej, ta dijë se i jam prerë mik" (Kadare, Prilli… i '78-s[8]).

Besa e gjâs e e çobânit.

(Shif: L. X. k. XXII, n. CXXIII).

Ndorja e skjapit të kumbonës.

Nji gjakës ndolli tuj kalue brî njij malit kalli vetem. — Tuj bâ rrugë, xû me i a kputë giòjt friga, kah drote mos i ká dalë kush në pritë. — Per me trimnue e me sigurue vedin, nemosë mos të mbarote pá shêj e pá dukë, 'si pau nji tubë dhísh tuj kullotë malit, i thirri bariut nja dý-trí herësh e, 'si nuk i pergjegji kush, i ìshoi zâ skjapit të kumbonës, tuj i thânë: „O skjap i kumbonës, thuejmi t'and zot, se, po më gjet gjâ pá e kalue qafen e asaj kodre, t'a dijë se i jam pré mik". — Mbas këtyne fjalve gjaksi vijoi rrugen e vet. — Ndrroi dísá hapa e, pá e kalue kodren, krisen pushkët e miku rá per dhé i dekun në vend. — Mbas do ditësh, nji barí tjeter, qi kishte pasë ndodhë malit me tufë të vet, i cilli edhè e kishte pasë ndie porosín e gjaksit, i kallxoi bariut tjeter ndollín. — Tuj vezhgjue bariu tjeter pûnen, s' bâni as cing as ping me gojë. Suell veç tufen, shkoi në shpí, u armatis mirë e mirë, edhè u nis me pague mikun e vet. — Shi aj, qi i a pat pré mikun, i rá në pritë, edhè e vrau.

Hini pûna nder Pleq: bariu u ìshoi pengun edhè u lidh me lá trí gjaqe, mos i pasët thirrë trí heresh gjaksi e, mbasi nuk kishte pasë qillue tu tufa, i kishte pasë thirrë skjapit të kumbonës, se, me bâ me e gjetë gjâ pá e kalue kodren, do t' i jitte të zot't mik i prém. — Pleqt e arsyetuen pûnen imë e hollë edhè e folen fjalen e mbrame, se bariut i ishte pré mik gjaksi e se, tuj e vrá shi dorërasin, e kishte pague mikun e prém prej atij. Ashtû mbet mik i prém e mik i márrun.

Vëmendja e Renzit përqendrohet te motivi invariant i të riut të paracaktuar me vdekje, i cili nuk reagon aspak për t'u mbrojtur, por i nënshtrohet fatit duke iu drejtuar një kafshe, qingjit të mbinatyrshëm te *Miorița* dhe cjapit të këmborës në ngjarjen e Kadaresë.[9]

I bindur se versioni rumun është një fragment i ardhur pjesërisht i paplotë nga e shkuara, ai e plotëson *puzzle*-n e arsyetimit të tij me versionin e Kadaresë; sipas tij variant me lidhje afërsie, apo motërzimi me këngën rumune.

Renzi e gjen domethënien e pikës së errët të variantit rumun në konceptin kanunor të "besës" (shpjeguar nga Kadare, sipas studiuesit, si "lealtà, impegno

[7] *Kanuni i Lekë Dukagjinit…*, cit., 1933, p. 119.
[8] Ismail Kadare, *Prilli* ('78), cit. p.13.
[9] Lorenzo Renzi, cit., p. 63: […] "ridotta al minimo comun denominatore, è questa: un uomo, minacciato di morte, si rivolge a un animale del gregge mettendolo al corrente della sua futura morte".

a non attaccare, rispetto alla parola data" (p. 12), që shpjegon sipas tij "nënshtrimin e protagonistit që nuk mbrohet nga ai që e kërcënon me vdekje"/ "remissività del protagonista, che rinuncia a difendersi da chi lo minaccia di morte"[10]).

Kësisoj, Renzi i largohet interpretimit të këtij invarianti si formë e "mnerës" përballë "historisë" siç predikojnë teoritë e Mircea Eliade, dhe e përgjithëson pikëtakimin mes dy historive në rrafsh më të gjerë ballkanik, duke folur për një "bërthamë", sipas tij "në qarkullim prej shumë kohësh", dhe duke e konsideruar kështu veten në hulli të "ideve gjeniale të M. Perry-t mbi krijimet gojore ballkanike".[11]

Arsyetimi i thukët për një burim antik të ngjarjes[12], pëson një devijim, kur studiuesi provon të ngrejë hipotezën mbi llojin apo gjininë që mund të ketë pasur për bazë Kadareja, kur ka shkruar ngjarjen dhe del në përfundimin se bëhet fjalë për një këngë të vjetër epike, "un'antica versione popolare albanese corrispondente alla Miorița romena".

Përgjegjës për këtë devijim bëhet "epiteti tipik i stilit gojor" "O capro dal grosso campanaccio", që në shqip do të tingëllonte "O ti cjap me atë këmborë të madhe"[13] i përkthimit italisht të tekstit origjinal të Kadaresë "O cjap i

---

[10] *Ibidem*: "Se pensiamo per un momento che il pastorello sia assoggettato alla legge fatale del riscatto di sangue, allora sarà logico che non potrà difendersi e che nessuno potrà aiutarlo: l'attentatore lo inseguirà fin che lo uccide, e a lui non resterà altro che lasciarsi uccidere. È quello che succede nel romanzo di Kadaré a Gjorg, prima assassino per rispetto del codice, poi braccato e assassinato a sua volta".

[11] *Ibidem*: "A simpatizzare per le idee del geniale americano sulla composizione orale, per le sue sagaci osservazioni stilistiche (generalizzate, a volte indebitamente, e anche un po' banalizzate dall'allievo Albert B. Lord), non ero del tutto impreparato. Già mi ero schierato con le tesi neotradizionalistiche (cioè neoromantiche) di Menéndez Pidal contro la concezione monogenetica e colta della genesi delle chansons de geste, opponendomi a un orientamento concordemente – tranne nel mio caso – condiviso in Italia.".

[12] *Ibidem*: "Nonostante il breve racconto sia amalgamato nello stile narrativo 'moderno' di Kadaré, un indizio potrebbe essere un'eco di stile epico nella ripresa lessicale, simile a quelle che abbiamo segnalato sopra: ...Allora invocò il caprone dal grosso campanaccio: 'O caprone dal grosso campanaccio...' – l'espressione 'dal grosso campanaccio', d'altra parte, costituisce un epiteto tipico dello stile epico orale, come si trova in molti popoli e in molte età (e già, come si sa, in Omero).".

[13] *Ibidem*: "Ma vedremo subito che i riscontri non mancano. La mia impressione è che Kadaré riecheggi qui proprio un'antica versione popolare albanese corrispondente alla Miorița romena. Nonostante il breve racconto sia amalgamato nello stile narrativo 'moderno' di Kadaré, un indizio potrebbe essere un'eco di stile epico nella ripresa lessicale, simile a quelle che abbiamo segnalato sopra: ...Allora invocò il caprone dal grosso campanaccio: 'O caprone dal grosso campanaccio...' – l'espressione 'dal grosso campanaccio', d'altra parte, costituisce un epiteto tipico dello stile epico orale, come si trova in molti popoli e in molte età (e già, come si sa, in Omero).".

këmborës", prej frëngjishtes "O bouc à la grosse sonnaille".

Në parashtrim të funksionit që merr lënda e *Kanunit* në veprën e Kadaresë duhet të theksojmë se në teknikën e krijimit të veprës letrare, ndryshe nga vepra joletrare, çdo element apo detaj i rrafshit të substancës së shprehjes dhe asaj të përmbajtjes, është nevojë e patjetërsueshme, për të funksionuar si harmoni elementesh të lidhura në mënyrë koherente, të thukët e të ekuilibruar mes tyre.

Përdorimi i shprehjes "skjap i kumbonës" ashtu si dhe vetë rrëfimi kanunor në veprën e Kadaresë, duhet lexuar si domosdoshmëri me precizion të lartë në funksion të idesë-tension që sendërton formën artistike të romanit.

Pa u ndalur në gjeometrinë e "thyerjes" që strukturon veprën e Kadaresë (gjë që do t'i jepte një tjetër drejtim arsyetimit tonë), mund të thuhet se citimet eksplicite të *Kanunit* si "burim" tekstor i *Prillit...*, e bëjnë procesin përkthimor të veprës së Kadaresë një proces të dyfishtë përpunimi hermeneutik, ku bashkohen rrugë që përmbyllin domethënie të ndryshme: ajo "juridike" e tekstit gojor të kodifikuar dhe ajo "polisense" e veprës letrare.

Funksioni i *Kanunit* në roman, pretendon fillimisht një sqarim të kodit të tekstit burimor, *Kanunit*, ndërtuar si një tekst joletrar dhe mjaft kompleks.

Cardona, në *Hyrjen në etnolinguistike*[14] të drejtën kanunore e klasifikon në "gjininë e artit gojor" apo si "gjini gjuhësore", e cila ushtron kontroll social mbi përdoruesin, sepse bart "veç memories dhe njohjes", edhe "aftësinë për të përshtatur një normë të përgjithshme nga rasti i veçantë"[15]. Funksionimin e këtij mekanizmi ai e sheh të bartur te proverbi, si kod që parakupton "një sistem vlerash të pranuara", që jepet për të tjerët, por është pikë referimi edhe për të bindur veten: "një konflikt juridik mund të zgjidhet me një betejë mes proverbash"[16].

Kodi shqiptar nuk ka pasur shumë studime për kalimin nga rrafshi gojor

---

[14] Giorgio Raimondo Cardona, *Introduzione all'etnolinguistica*, Il mulino, Bologna 1976, p. 192: "Qui si userà l'accezione ampia, corrente nell'etnografia della comunicazione e nello studio dell'arte verbale, per cui è un genere ogni modello testuale che abbia sue proprie ed enunciabili caratteristiche formali e strutturali.".

[15] Ivi, p. 194. "Genere linguistico" […] "il proverbio per essere una formula consegnata alla tradizione può avere valore di testo di diritto consuetudinario [...] anche se la difficoltà da A. Taylor (1930) nega l'utilità della definizione utile per il proverbio, che possiede una sua "qualità incomunicabile.

[16] *Ibidem*: "Per quel che è la sua funzione, si deve innanzitutto dire che il proverbio, per essere una formula consegnata alla tradizione, può avere valore di testo di diritto consuetudinario; o meglio, il diritto consuetudinario può essere tramandato sotto forma di proverbio.[…] Una contesa giuridica può essere risolta quindi con un combattimento a base di proverbi, in cui vale naturalmente oltre che la memoria e la conoscenza, anche la capacità di adattare una norma generale al caso particolare. […] Un proverbio presuppone un sistema di valori accettati.".

i kodit, ku trashëgohet, siç thotë D. Luka, një vijë "logjike të thukët dhe të qartë" e ndërthurur me kodin "moral" dhe "estetik"[17], në rrafshin e shkruar, ku duhet marrë në konsideratë ndërhyrja e mundshme e kodifikuesve.

Desnickaja, në punimin *Disa mendime rreth problemeve linguistike të "Kanunit"*,[18] errësirën "orakullore" që bartin "formulat e qëndrueshme", e shpjegon me "rëndësinë rituale që kishin këto formula"[19] dhe kur shprehet për "provat origjinale", lë të kuptohet se ato janë krijuar nga vetë Gjeçovi, në shërbim të "stilit juridik", "të parat në gjuhën shqipe".[20]

Studimi i Desnickaja-s bart disa pohime të cilat flasin qartë për natyrën e ndërlikuar të këtij teksti: nga njëra anë nënkuptohet një kod "univok" kuptimor, kur flitet për "sistem semiotik me strukturë të vetme"- ku "mund të dallohen disa qendra semantike"[21] dhe nga ana tjetër nënkuptohet një kod "polisens", kur flitet për "zhanër letrar mjaft të rrallë"[22], ekuivok që gjendej më parë edhe në

---

[17] David Luka, Shprehje të Kanunit. Frazeologji, fjalë të urta etj., në *Pasuria gjuhësore e Kanunit të Lekë Dukagjinit*. Studime gjuhësore XIX, Fiorentia, Shkodër 2017, p. 173.

[18] Agnia V. Desnickaja, *Disa mendime rreth problemeve linguistike të "Kanunit"*, në Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave filologjike, VIII, Prishtinë 1978.

[19] Ivi, pp. 60-61: "Një vend të veçantë në tekstin e Gjeçovit zënë formula e qëndrueshme, të cilat në shumicën e tyre mund të jenë mjaft të vjetra. Ky tip i njësive gjuhësore dallohet me karakterin lakonik, madje në sa raste për së tepërmi lakonik. Duke i goditur situata tipike në thelbin e tyre, këto shprehje duken shpeshherë shumë të errëta, sepse kuptimi i i tyre del në shumë raste i pazgjeruar e i pashkoqitur në mënyrë logjike. Më duket se errësira orakullore e kuptimeve mund të përbënte një element të posaçëm në aureolin e rëndësisë rituale që kishin këto formula. Po jap disa shembuj të formulave që janë lidhur me rite të betimit: *Beja mêrr gjân e vet, Bé e s'ka përtej, Bejalan gjaqet e të tjera*."

[20] Ivi, p. 61: "Shtresën e dytë stilistike e përbëjnë pjesët e tekstit (nga ana kuantitative ato janë predominuese), në të cilat jepet interpretimi i formulave dhe paraqiten norma e procedura të së drejtës zakonore në formën e shtjelluar të paragrafëve të veçantë. Për të hartuar këto pjesë të tekstit, që janë me shumë rëndësi nga ana e përmbajtjes juridike të Kanunit, Gjeçovi u përpoq të krijonte prova origjinale të stilit juridik që ishin të parat në gjuhën shqipe. …në pjesë përkatëse të tekstit të Kanunit mbizotërojnë konstrukte sintakstike shumë të ndërlikuara e mjaft të rënda. Dallohet përdorimi i dendur i konstrukteve absolute me rasën emërore, të cilat shërbejnë për ta paraqitur kushtin e veprimit, ashtu edhe përdorimi i infiniteve të shumta të grumbulluara brenda një periudhe.".

[21] *Ibidem*: "[…] sistem semiotik me strukturë të vetme"- ku "mund të dallohen disa qendra semantike, rreth të cilave po grumbullohen fjalë të prejardhura, togfjalësha me karakter formulaik, ashtu edhe formula të gatshme, si të thuash, të rrumbullaksuara, të cilat përdoren për ta shprehur kuptimin e sitatave ligjore të veçanta, si edhe për ta sugjeruar mënyrën e sjelljes në situata të ndryshme të shoqërisë patriarkale fisnore, në një mënyrë shumë të prerë. Si elemente përbërëse të sistemit semiologjik të Kanunit na dalin jo vetëm terma të veçantë, por edhe njësi frazeologjike me karakter semiologjik.".

[22] Ivi, f. 59: "Prandaj nuk duhet konsideruar teksti, si një pasqyrim automatik i zakoneve e normave ligjore të popullit. Vepra e Gjeçovit i përket një zhanri letrar mjaft të rrallë, sidomos në letërsitë e kohëve moderne. Përveç rëndësisë së tij shkencore, historike e

veprën "Historia e letërsisë shqipe" të Schirò-it, i cili do ta klasifikojë atë si krijim artistik popullor ("La sapienza popolare"[23]).

Në vëllimin kushtuar Kosovës nga *Accademia reale d'Italia*, Schirò, për të dalluar atë që realisht është e popullit nga ajo që është prekur dhe amalgamuar nga mbledhësi, e pati klasifikuar lëndën gjuhësore të *Kanunit*, sipas stilit[24], duke dalluar "shprehjet proverbiale"/"espressioni proverbiali", "ligjet e shprehura në mënyrë të drejtpërdrejtë"/"legge espressa in forma diretta", "konstruktet sintaksore të së folmes së zakonshme, por gjithsesi popullore"/"periodare comune, ma pur sempre popolare", "periudhat e evoluara nga pikëpamja sintaksore dhe e koncepteve"/"periodo letterariamente, sintatticamente e di concetto evoluto", për të evidentuar në shtresën më antike "tendencën e spikatur për shprehje të figurshme"/ "spiccata tendenza alla espressione figurata in cui si riflettono i colori e i caratteri delle sue consuetudini e credenze."[25].

Funksioni i gjuhës së *Kanunit* është kulturor-social, pavarësisht shtresëzimeve të figurshme, falë një rrugëtimi përpunimi të gjatë: Sapir pohon se gjuhët e shkruara, pa pasur "pengesat" e gjuhëve të shkruara të popujve të kulturuar, kanë ruajtur mundësinë e transmetimit dhe për pasojë studimit të akteve gjuhësore, si pjesë të akteve të tjera të gjeografisë psikologjike të kulturës[26].

Ajo çka bie menjëherë në sy në lëndën gjuhësore të *Kanunit*, është fakti se konceptet kyç të tij, krijojnë një univocitet kuptimor, pavarësisht shtresëzimit të trashëgimisë së lashtë orale ku vlera etike përcillet me një gjuhë të figurshme.

---

juridike, ky tekst paraqet edhe mjaft probleme me një karakter historiko-letrar dhe linguistik".

[23] Për karakterin e figurshëm të shtresës së lashtë të kanunit, Schirò i propozon ta fusë *Kanunin* në të njëjtën kategori me krijimet gojore ("La sapienza popolare"). Ai shprehet se ka qenë i mrekulluar nga forca përqendruese e diturisë popullore (*Meditabondo*) shprehur në gjuhën e Kanunit, dhe propozon të futet te proza popullore, pikërisht për imazhet, format e qarta, me përkufizimet alegorike dhe me metaforat e kuptueshme veç prej atij që i njeh kodet zakonore. Cfr. Schirò, "Storia della letteratura albanese".
cfr. Giuseppe Schiró, Novellistica e sapienza popolare, in *Storia della letteratura albanese*, Nuova accademia, Milano 1959.

[24] Giuseppe Schirò, P. Gjeçov e la prosa del *Kanûn* di Lek Dukagjini, in *Le terre albanesi redente. I Kossovo*, Reale Accademia d'Italia, centro studi per l'Albania, Roma 1942, pp. 183-184.

[25] *Ibidem*: "[…] la spiccata tendenza alla espressione figurata in cui si riflettono i colori e i caratteri delle sue consuetudini e credenze".

[26] Edward Sapir, The Status of Linguistics es a Science, in Language, 5 (1929), tr. it. La posizione del linguaggio coe scienza, in *Linguaggio e relatività*, a cura di Marco Carassai ed Enrico Crucianelli, Castelvecchi, Roma 2017.

Gjuha e *Kanunit*, univoke në vetvete, në një vepër artistike si ajo e Kadaresë, "locus semantico del polisenso"[27], e realizon të vërtetën poetiko-artistike nga zhdërvillimi i gjuhës në stil.

Struktura e romanit paraqitet si "mbikalim kodesh", siç e quan Umberto Eco (në ndjekje të teorive të Hjemslev e Barthes) kur merr në analizë rastet se si një kod fillestar që mishëron një domethënie, hyn në marrëdhënie funksionale me një kod të dytë që mishëron një domethënie të dytë.

Rasti i rrëfimit kanunor në veprën e Kadaresë dhe përkthimit të saj, para se të analizohet për funksionin në veprën letrare, mund të vërtetojnë natyrën e tekstit burimor të *Kanunit*, heteronominë e tij semantike, apo varësinë e koncepteve nga të tjera kontekste që e sqarojnë dhe e saktësojnë vazhdimisht në formën e një zinxhiri për të mbërritur në rrafsh normativ, në një semantikë univoke, teknike (Della Volpe, "Çelësi semantik i poezisë")[28].

Kështu, secila prej konstrukteve formulaike apo njësive leksikore që bartet në fragmentin e marrë në analizë ("cjap i këmborës"; "gjakmarrës"; "dorëzohet mik"; "i prerë mik") i duhet nënshtruar interpretimit para se të përkthehet, në mënyrë që të mos rrezikohet funksioni i tyre në organicitetin artistik të veprës dhe të domethënies së saj polisense.

Për t'u ndalur në objektin-pretekst, në shprehjen "*cjap i këmborës*" objektivizimi i konceptit të nderit nëpërmjet metonimisë së *kumbonës* së dashit si shënjues i prirësit të tufës, përkatësisht kryefamiljarit (*metafora ovia*- e quan Della Volpe[29]), funksionon si një metaforë e kuptimësuar nga përdorimi.

Raporti kuptimor mes termave "cjap" dhe "këmborë", sugjeruar prej pranisë së këmborës në qafë, vjen prej idesë se cjapi/"ogiçi" që drejton tufën, bartës i këmborës, simbolizon "nderën" e vathit: "nye i katerdhetegjashtët, artikulli 153: *Ndera e vathit âsht në kumbonë*")/ "L'onore dell' ovile è rappresentato dalla campana" (përkth. i Dodaj-Fishtës).

Skirò-i, kur redaktoi botimin e *Kanunit*, e pa të nevojshme t'i shtojë një

---

[27] Galvano Della Volpe, La chiave tecnica della poesia, in *Critica del Gusto*, Feltrinelli, Milano 1966, pp. 59-161.

[28] *Ibidem.*

[29] Ivi, p. 86: "Anche le metafore ovvie si possono rendere necessarie giustificate ex-novo e rese necessarie dal contesto soltanto, che si sdoppia tacitamente in un nesso metaforico che solo da senso pieno alla rappresentazione con l'esprimere il senso generale come polisesno (non come univoco): come simbolo poetico insommacercare se il documento è insigne di discorsività polisensa: prasi di parafrasi critica: guardare nel letterale materiale i suoi equivalenti sempre approssimativi ma tali da permettere nel confronto la percezione del distacco di valore espressivo tra essi e la superiore formula poetica".

shënim artikullit "153" të përkthyer nga Fishta – Dodaj, (siç shihet nga kaligrafia në imazhin e bocave të *Kanunit*[30]) duke dashur të shpjegojë se fjala është për kafshën që drejton tufën, element që shënon terrenin e përbashkët ku bashkekzistojnë kafsha që drejton tufën me objektin - simbolin e nderit të tufës.



~~Articolo quarantesimosesto~~

IL ~~BECCO~~ capro OD IL MONTONE CHE PORTA LA CAMPANA

§ 153. - "L'onore dell'ovile è riposto nella campana". (2)

§ 154. - Se qualcuno ~~facesse preda del becco o del~~ rubba il capro o il montone, che porta la campana, per oltraggio o per astio, e ~~se sul punto~~ sul fatto non viene ucciso, dovrà pagare 500 piastre di multa e risarcire ~~doppiamente~~ il danno in ragione doppia.

(1) Codice Manu, (l. 8, Doveri dei giudici)

(2) vale a dire nell'animale guida del gregge che è appunto il capro o il montone.

Pikërisht, sepse është bartëse e këmborës, kafsha është e paprekshme dhe ka një çmim material në kanun: "*Po u muer pré, perdhûnë a prej ndo 'i marazi e faqe bariut skjapi a dashi i kumbonës, e po s'u vrán n'at hov, 500 grosh gjobë i mirren pretarit e gjaja dy per nji./ "*Se qualcuno per oltraggio o per astio rubba il capro o il montone che porta la campana, se non viene ucciso sul fatto, dovrà pagare 500 piastre di multa e risarcire il danno in ragione doppia", (*§154*).

Madje në rast gjobitjeje materiale, sekuestrimit të tufës i shpëton pikërisht "kumbona" pra kafsha që e bart: *Kumbona e ogiçit nuk mund, të mirret pashtrak, asht ndera e tufés*/ "Il capro od il montone che portano la campana, non possono pretendersi come multa; essi rappresentano l'onore e il prestigio del gregge", (§284).

Në kontekste të paragrafëve të tjerë të *Kanunit*, "kumbona", merr qartësisht vlerë kuptimore më abstrakte, simbolike, përderisa nuk lidhet ngushtësisht me kafshën (dashin apo cjapin). *Kanuni* toleron vjedhjen e kafshës, po kurrsesi atë të këmborës: "*Po u muer pré kumbona e ogiçit në mal a ne vath, kjo kà nderen sa tufa e mârrë e sa vathi pretari do të lajë 500 grosh giobë per nderë, edhè pse nuk muer kurrnji kâmbë berri./* (§798)- "*Togliere la campana dal collo*

[30] Volume sul Kanun: bozze, Archivio Storico dell'Accademia Nazionale dei Lincei, Fondo Accademici d'Italia, b. 5, fasc. 27.

del montone o del capro, significa disonorare tutto il gregge o l'ovile; l'agressore quindi dovrà pagare 500 piastre di multa per leso onore, anche se non ha preso neppure un capo di bestiame".

Kanuni madje e parashikon heqjen prej qafës së kafshës që e bart dhe vendosjen e saj në tra të banesës, nëse i zoti i tufës është i përfshirë në episode të *nderës shoqnore* për të riparuar dëme të kryera nga miku i tij: *Do të lajshë dâmet e bame prej mikut t'and tuj vû kumbonen e tufés s'atê në trà, a me të hjekun të kaut të hullis, a me të shitun të rendit të ujit*/ "Dovrai pagare tutti i danni fatti dal tuo ospite, anche se dovessi vuotare il tuo ovile, privarti del bove aggiogato o vendere l'acqua irrigata", ("§ 636).

Zinxhiri semantik, siç vërehet, i jep një univocitet (njëkahshmëri domethënieje) shprehjes "skjap i kumbonës".

Në strukturën artistike të veprës së Kadarësë, kjo shprehje merr natyrë intelektuale, për ta justifikuar veten në kontekstin e ri.

Zgjerimi (në rastin e përkthimit të parë italisht) i figurës së cjapit me epitetin "i madh" (që do të tingëllonte pak a shumë "o cjap me atë këmborë të madhe") e zhvendos vlerën semantike të objektit-cjap nga domethënia simbolike e pushtetit dhe ekuilbrit të të zotit të shtëpisë, objektivizuar në cjapin e këmborës, cjapin që prin kopenë, në një epitet me vlerë ornamentale. Pesha semantike e figurës devijon te mënyra se si është zbukuruar qafa e cjapit, duke e larguar pra atë nga tension -ideja e veprës, sendërtuar mbi çiftin 'nder' *vs*. 'turp'.

Në procesin e formësimit të polisensit të veprës, ky funksion i figurshëm (*traslato-veicolo*, siç e quan Richards[31]) dëmtohet për shkak të mungesës së raportit të brendshëm, organik me elementet e lëndës (*lettera-il tenore*) që sendërtojnë idenë e "ruajtësit të kodit", të nderit, "trarit" të shtëpisë.

Vepra e Kadresë vë në funksionim idenë e thyerjes në vepër, në tension të vazhdueshëm me idenë e pathyeshmërisë, bazuar në parimin moral të "nderit" në kanun, sipas të cilit, "prerja mik" është njëra anë e medaljes, në mënyrë plotësisht analoge me "prerjen në besë" dhe pasojave të saj në një shoqëri të ndërtuar mbi parimin moral të "nderës" (*Po i u pré kuej miku, kanûja i kà lânë dy udhë: a të fiket, a të koritet.*/ "Nei casi di lesa ospitalità, la legge fa questa condizione: o rovinarsi, o rimanere disonorato", *§*644).

Të bën përshtypje fakti se edhe në përkthimin drejtpërdrejt nga origjinali shqip i veprës së Kadaresë (2019), pa arsye, figura origjinale "cjap i këmborës" vjen në italisht me të njëjtën formë, "dal grosso campanaccio" ("Allora si rivolse

[31] Ivor Amsrong Richards, *The philosophy of Rethoric* (1936), tr. it. *Filosofia della retorica*, Milano, Feltrinelli 1967.

al caprone dal grosso campanaccio"[32]) duke përsëritur zgjedhjen e botimit të parë italiasht, të ardhur nga frëngjishtja.

Përkthyesi duhet të jetë pikë së pari kritik i mirë: dhe pikërisht tek aftësia e interpretimit të citimeve, shihet aftësia e kritikut për të dalluar ata tregues semantikë që janë bartës të koncepteve përmbajtjesore polisense: "*L'ufficio del critico letterario non è già di rinunciare a schemi unívoci di inquadramento del poetico, bensí di non astrarre dei contenuti o concetti dal contestuale organico e saper riconoscere invece dei contenuti o concetti nella loro precisa contestualità organica tramite quegli indici semantici indispensabili che sono le "citazioni": idest come contenuti formali polisensi – e come tali caratterizzarli poi in schemi o concetti unívoci adeguati di poetica e di stilistica concreta, sociologica.*"[33]

Kështu, për të mbetur në brendi të implikimeve tekstore që sjell interpretimi dhe përkthimi i fragmentit të mësipërm, ndalemi te mënyra se si është përkthyer situata e romanit të Kadaresë, përkatësisht nga frëngjishtja:

Avril brisé, 1982 (2003)[34]

"*Cette voix lui racontait l'histoire d'un voyageur qui passait seul un soir au pied d'un mont escarpé. Se sachant guetté pour* ***une reprise de sang,*** *il se gardait depuis longtemps du vengeur. Soudain sur cette grande route, à la nuit tombante, il fut pris d'un sombre pressentiment. Autour de lui, il n'y avait qu' une étendue déserte, aucune maison, aucune âme, dont il aurait pu invoquer la protection à titre d'hôte. Il aperçut seulement un troupeau de chèvres, mais abandonné pas son berger. Alors, pour se donner un peu de courage, ou peut-être pour ne pas mourir sans laisser de trace, par trois fois il appela le berger. Aucune voix ne lui répondit. Alors il appela le bouc à la grosse sonnaille:* "***O bouc à la grosse sonnaille****, s'il m'arrive un malheur, dis à ton maître qu' avaiet d'avoir franchi le col de cette colline,* ***je serai tué sous sa bessa****.*"

Aprile spezzato, 1993[35]

"*La voce raccontava la storia di un viandante che una sera procedeva solitario alle falde ripide di un monte. Sapeva di essere inseguito per* ***un riscatto di sangue,*** *e da molto tempo si teneva in guardia dal vendicatore. Improvvisamente, lungo quella grande strada, al calar della notte, fu colto da un oscuro presentimento. Tutt'intorno si apriva soltanto una distesa deserta: nessuna casa, nessun'anima a cui avrebbe potuto chiedere protezione a nome dell'ospitalità. Scorse tuttavia un gregge di capre, abbandonato dal pastore. Così per riprendere coraggio, o forse per non morire senza lasciare nessuna traccia di sé, fece appello tre volte al pastore. Nessuna voce gli rispose. Allora invocò il caprone dal grosso campanaccio:* "***O caprone dal grosso campanaccio****, se mi coglie una disgrazia, di'al tuo padrone che prima di aver valicato questo monte* ***sono stato ucciso sotto la sua besa***".

dhe nga origjinali shqip:

[32] Ismail Kadare, *Aprile spezzato*, […], cit., 2019, p. 83.
[33] Po aty, p. 85.
[34] Ismaïl Kadaré, *Avril brisé.* Traduit de l'albanais par Jusuf Vrioni, Fayard, Paris 1983, 78.
[35] Ismail Kadare, *Aprile spezzato*. […], cit., 1993, p. 63.

Prilli i thyer, 1978[36], 2003[37]

"Ai zë po i tregonte për një udhëtar që po kalonte i vetëm në muzg, në një rrëzë bjeshke. Udhëtari ***kishte për të dhënë një gjak*** *dhe prej kohësh ruhej nga gjakmarrësit. Dhe, befas, aty në udhën e madhe, në atë orë të muzgut atë e kapi një ankth e një parandjenjë e keqe. Përreth ishte shkretim i plotë, s'dukej as shtëpi, as frymë e gjallë njeriu, ku mund të futej ose të dorëzohej si mik. Ishte vetëm një kope (*tufë*) dhish, por edhe ajo pa bari. Dhe atëherë, për të trimëruar sadopak veten apo, ndoshta, për të mos mbaruar jetën pa një shenjë, njeriu* ***i thirri*** *tri herë bariut të tufës. Asnjë zë nuk iu përgjigj. Atëherë, ai* ***i thirri*** *cjapit të këmborës: "****O cjap i këmborës****, i thuaj tët (*tyt*) zot(*i*) se, po më gjeti gjë pa kaluar qafën e kodrës përtej, ta dijë se* ***i jam prerë mik****".*

***Aprile spezzato*, 2019[38]**

"*Le stava narrando di un viandante che, solitario, passava una sera ai piedi di un monte scosceso. Sapendo di essere* ***la vittima designata per un riscatto del sangue****, da tempo si teneva in guardia dal vendictore. Improvvisamente, su quella strada, al acalari della notte fu preso da un oscuro presentimento. Intorno a lui non c'era che una landa deserta: nessuna casa, nessun' anima cui chiedere protezione come ospite. Scorse solo un gregge di capre, ma non il pastore. Così, per farsi coraggio, o forse per non morire senza lascsiare traccia, lo chiamò per tre volte. Nessuno rispose. Allora* ***si rivolse*** *al caprone dal grosso campanaccio: "****O caprone dal grosso campanaccio****, di' al tuo padrone che, se mi capitasse qualcosa prima di aver scavalcato la collina, deve sapere che* ***mi sono consegnato ospite a lui".***

Versioni origjinal i *Kanunit* të '33 përkthehet nga Schirò:

"***Un sanguinario*** *passava lungo la costa di un monte ed era solo. Cammin facendo gli sopravvenne una grande paura che qualcuno non gli tendesse un agguato. Per farsi coraggio e asicurare se stesso, in quanto non voleva scomparire senza lasciare alcuna traccia di sé, appena vide un branco di capre che pascolavano per il monte, chiamò due, tre volte il capraio e poiché nessuno rispondeva, indirizzò la parola al capro che portava la campana, e gli disse: "O capro della campana, di' al tuo padrone che se mi capita qualcosa mentre attraverso la costa di quel colle, io mi considero come suo ospite". Dopo queste parola il sanguinario continuò il suo cammino, Aveva fatto un po' di strada che, prima di oltrepassare il colle, si udirono dei colpi di fucile. Egli cadeva a terra, morto.*

Dopo alcuni giorni, un altro pastore che si era trovato al monte con il proprio gregge e che aveva anche lui udito la raccomandazione del passante, informa del fatto il compagno. Udita la cosa, costui non proferì parola; portò il branco delle bestie all'ovile, si recò a casa, si armò per bene e partì per vendicare l'ospite. Appena l'uccisore dell'ospite gli capita sotto mano, lo uccide. Il caso fu portato in giudizio: il pastore consegnò il pegno e si rese garante che avrebbe pagato per tre omicidi se quel passante non lo avesse chiamato tre volte, e se, essendosi imbattuto nel gregge, non avesse detto al caprone con la campana che, accadendogli qualcosa per il colle, egli si sarebbe considerato come ospite del padrone del gregge. I giudici esaminarono il caso che si presentava molto sottile, ed infine emisero la sentenza che il pastore aveva vendicato l'ospite e che uccidendo l'assassino si era ripagato della violazione dell'ospitalità subìta. Così (l'omicidio e la vendetta) rientrano nei

[36] Ismail Kadare, Prilli i thyer (1978), në *Vepra letrare 10*, Tiranë, Naim Frashëri 1983, 13.

[37] Kemi vendosur në kllapa në korsiv ndryshime të variantit të '78-s në variantin e fundit të veprës së Kadaresë (2003, Onufri).

[38] Ismail Kadare, *Aprile spezzato*, 2019, cit.

casi della "ospitalità violata" e dell'"ospitalità vendicata".[39]

Situata fantastike e thirrjes së cjapit, në *Kanun* jepet me shprehjen "i lshoi zâ", pas përdorimit të foljes "i thirri", për thirjen drejtuar bariut, dallim që ruhet dhe në përkthimin italisht të situatës nga Schirò-i, që përdor përkatësisht "chiamò" për "thirri", drejtuar bariut dhe "indirizzò la parola" për "lshoi zâ" drejtuar *skjapit*.

Kadareja i ndërton të dyja situatat me një folje të vetme, "i thirri" ("*ai i thirri cjapit të këmborës"*), gjë që ruhet nga Vrioni në versionin frëngjisht "il appela" dhe interpretohet prej përkthyesit italian në format "fece appello" për situatën drejtuar bariut dhe "invocò il caprone" për cjapin (it. '93).

Versioni i fundit italisht (2019) përdor formën "chiamò" për bariun dhe "si rivolse" për cjapin, që nënkupton një kthim fizik me fytyrë nga objekti ("rivolgersi"- volgere la persona o il volto verso l'oggetto dell'attenzione"), dhe personalizim të kafshës.

Interpretimi kritik në bazë të versionit të fundit (2019) e dëmton "vërtedukshmërinë" (la verosimiglianza) e situatës e cila kërkon një abstragim nga situata narrative realiste.

Thirrja e bariut dhe fjalët që i drejtohen *skjapit* janë dy akte të ndryshme thëniesore. Ato ndajnë jetën nga vdekja: në rastin e dytë, përkujdesja e Gjogut për t'i dhënë një kumt kafshës që bart objektin simbol të nderit të bariut, nënkupton pamundësi për t'u mbrojtur më fizikisht dhe apelim të të zotit të shtëpisë për të mbrojtur nderin në jetën e tij pas vdekjes, apelim i të drejtës për të mos mbetur i turpëruar, gjakhumbur ("gjakhupë"/ "invendicabile").

Kazistika juridike (*Pleqt/*"i giudici" në rrëfimin kanunor), vetëm pse në nivel abstragimi, konsiderojnë si "normale" gjykimin e një rasti të ndërtuar mbi të folurit me kafshën. Në fakt, i zoti i tufës, mbasi mëson ngjarjen, nuk i mbetet zgjedhje tjetër veçse të niset "me pague mikun e vet", duke zbatuar ligjin e *Kanunit* që e kërkon mikun e "prém" si "mik i marrun" (&. 652).

Zgjedhja leksikore në gjuhën italiane e fragmentit në fjalë është ngushtësisht e lidhur me domethënien që shprehja "i jam pré mik" apo "mik premé", merr në zinxhirin semantik të artikujve të *Kanunit*. Në përkthimin e tyre nga Fishta – Dodaj gjendet në disa forma: "la violazione d'ospitalità" (§497); "l'offesa dell'ospitalità" (§ 952); "l'ospite tradito" (§922), apo edhe më qartë "vendicare l'altro" si në §652: *Me ndeshë n'udhë të madhe dy shokë, e si të bâjn do rrugë, e, kërset pushka dhe vritet njani sish, këtij tjetrit nuk i pritet mik.*

Në këtë rrafsh "semantik" duhet interpretuar domethënia e shprehjes *me*

[39] La protezione del capro che porta la campana, in Appendice, *Codice di Lek Dukagjini*…, 1941, cit., p. 294.

u pré mik/ "mi considero suo ospite" përkthyer nga Giuseppe Schirò: "*O capro della campana, di' al tuo padrone che se mi capita qualcosa mentre attraverso la costa di quel colle, io mi considero come suo ospite*".

Këtë rrafsh abstragues në përputhje me regjistrin juridik, nuk e përmban zgjedhja e versionit të Kadaresë drejtpërdrejt nga shqipja (2019), "*mi sono consegnato ospite a lui"* domethënia e të cilit ka të bëjë me çastin kur kalimtari "u beh mik"(§436) u "dorëzua mik", gjë që nënkupton kërkesë per mbrojtje fizike nga i zoti i shtëpisë. Është një çast që i paraprin çastit fatal, kur protagonisti e sheh veten tashmë të vdekur fizikisht dhe kryen përpjekjen e fundit për shpëtimin moral, të evokuar nga shprehja "i jam pré mik".

Përkthimi i kësaj shprehjeje në roman duhet të kushtëzohet nga një zgjedhje që *in absentia* të evokojë anën tjetër të medaljes, pasojat juridike të tradhtimit të parimit të mikpritjes, ndër më të rëndat për nga kostoja sociale (*kush vret mikun në besë/* "chi uccide l'ospite a tradimento", §1194).

Këtë interpretim, duket se ka parapëlqyer edhe Vrioni (për pasojë dhe teksti italisht i '93) i cili është më pranë domethënies së tekstit të Kadaresë, megjithëse më larg "letrës" së tij: "*je serai tué sous sa bessa*/"sono stato ucciso sotto la sua *besa*".

Evokimi i "besës" i jep një kuptim më organikisht të brendashkruar edhe fragmentit fillestar të kësaj historie, përshkruar në romanin e Kadaresë ku përmenden në të njëjtën fjali dy koncepte kyç të *Kanunit*, "me dhënë gjak" dhe "gjakmarrës"*: "Ai zë po i tregonte për një udhëtar që po kalonte i vetëm në muzg, në një rrëzë bjeshke. Udhëtari kishte për të dhënë një gjak dhe prej kohësh ruhej nga gjakmarrësit*", përkthyer besnikërisht në versionet frëngjisht e italisht ('93): ["Se sachant guetté pour une reprise de sang, il se gardait depuis longtemps du vengeur" (fr.); "Sapeva di essere inseguito per un riscatto di sangue, e da molto tempo si teneva in guardia dal vendicatore" (it., '93)] dhe interpretuar në mënyrë të zgjeruar në versionin e 2019 nga shqipja, me konceptin "vittima designata" ["Sapendo di essere la vittima designata per un riscatto del sangue, da tempo si teneva in guardia dal vendicatore." (it., 2019)].

Koncepti i atij që ka borxh gjak, dhënë në italisht me "la vittima designata per un riscatto del sangue" (it. 2019) që do të tingëllonte shqip si "viktima e paracaktuar e gjakmarrjes", plotësuar në fund të fjalisë me konceptin e "gjakmarrësit", italisht "vendicatore", e fusin lexuesin e huaj në fushën kuptimore të rrezikshme të viktimës për hakmarrje ndaj së cilës Fishta vetë u mundua ta shpëtojë *Kanunin,* duke i kushtuar një paragraf në parathënien e botimit 1933, kur fliste për mundësi që "gjaku" të interpretohej me konceptin italisht "vendetta".

Pra, gjakmarrja, thotë Fishta, nuk *"mun të quhet "uhá – marrme – vendetta", me anë të së cilës "pedantat e prezuntuozat duen me pru egersin e popullsis së maleve t'ona", pa u marrë parasysh "mndorja" rethana kur ndodhë, por zabtimi i një ligji që e quajnë të drejtë"*.[40]

Kjo situatë narrative në "Shtojcën" e *Kanunit*, ndryshe nga romani i Kadaresë, përmend veç njërën anë të medaljes, "gjaksin": "Nji gjakës ndolli tuj kalue brî njij malit kalli vetem. – Tuj bâ rrugë, xû me i a kputë giùjt friga, kah drote mos i ká dalë kush në pritë"./ "*Un sanguinario passava lungo la costa di un monte ed era solo. Cammin facendo gli sopravvenne una grande paura che qualcuno non gli tendesse un agguato*".

Në tekstin e *Kanunit*, ndërsa ekziston fjala *gjak-hupës*, mungon fjala *gjakmarrës* dhe zakonisht përdoret fjala *gjak-u* (*gjaku* 151/ La vendeta di sangue) dhe *gjakës*, që Schirò e përkthen italisht si Fishta-Dodaj, *sanguinario*.

Në logjikën juridike të *Kanunit*, borxhi i gjakut (i kërkuar nga gjakësi) nënkupton dhe anën tjetër të medaljes, marrjen e gjakut, si p.sh. "merr gjakun e vet / *ha vendicato il suo sangue* (§871); nuk mérr gjak por bjen në gjak"/ "*non vendica il sangue ma cade nella vendetta del sangue*", (§873).

Gjakmarrja e dhënë italisht nga Fishta-Dodaj si *vendetta di sangue*, nuk ka vlerën e fjalës *vendetta* italisht. Gjaku ka vlerë materiale, d.m.th. nuk lidhet me pretendimin për *hakmarrje* si reagim psikologjik: *Po vrau kush kend, gjaku lahet me "gjâ çdo gjâ",* si edhè *gioba e fajeve të randa faqe katundit a Flamurit, si për trathti, për mik të prém etjera*.// "Chi comette un omicidio paga il sangue con qualunque cosa in natura: con bestiame, terreno ed armi. Recentemente il sangue si paga con monete, e in tal caso si accetano anche armi." (§496).

Romani *Prilli i thyer* ndërtohet si përshkrim i rrugëtimit të Gjogut në shtëpinë e bajraktarit për të paguar 'gjakun'. Gjenia krijuese e Kadaresë, i ndërgjegjshëm për problematikat receptuese të një teksti të kodifikuar vonë e që, gjuhësisht i është nënshtruar një procesi gojor përsosjeje, në botimin e fundit të *Prillit*... (2003) ndërfut *ex novo* disa qartësime në lidhje me *Kanunin*, në një kontekst ku flitet për "keqkuptimet lidhur me *Kanunin*"[41].

Ideja se "kanuni", është "tjetër drejtësi"që nismëton nga "ligji i ri", nga

---

[40] Fishta, Parathâne, Kanuni, cit. 1933, p. XXXII.

[41] Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, përg. për bot. Bujar Hudhri, Tiranë, Onufri 2003, f. 81-82.: Atje në Tiranë ka keqkuptime lidhur me kanunin, - tha, me një zë kinse të përmbajtur, madje të lodhur. - Ti e di se keqkuptimi nis që me fjalën "kanun", që shumë njerëz, për shkak të tingëllimit e dinë orientale, domethënë turke, rrjedhimisht të prapambetur. Dhe, kur ua shpjegon se s'është veçse fjala e vjetër "canon" e te shqiptarët "kanu", për ta shndërruar më pas, nuk e di pse, në "kanun", zgurdullojnë sytë.

besa në thelb të kodit të lashtë, si dhe ideja se është aq i përparuar në krahasim me ligjet e makinës shtetërore, edhe sepse moderne"[42], rezulton po aq moderne sa dhe ndjeshmëria për të bërë dallimin mes kodifikimit (korpusit të përbledhur dhe kodifikuar) dhe lëndës burimore gojore mbi të cilën bazohet ose praktikisht justifikohet: kështu shprehjen "sipas kanunit" të botimit të parë të *Prillit*... ('78[43]), në versionin e fundit të romanit e artikulon dy mënyrësh: "sipas dokeve" (p. 23)[44], apo "siç dihej" (p. 38)[45] dhe kur flet për kodin, fjalën "kanun" e zëvendëson me fjalën më specifike "kod".

Këto problematika të receptimit të kanunit në një shoqëri të kulturës së shkruar e reflekton edhe historia e botimit italisht të tekstit që vërehen nga shqyrtimi i bocave të ruajtura pranë Istituto degli studi albanese, në *Accademia Reale d'Italia*, sot *Accademia dei Lincei*, të inventarizuara dhe komentuara në disa artikuj nga Donato Martuci[46].

Botimi integral i imazheve dhe teksteve të disa dokumenteve të ruajtura në këto fonde, do ta ndriçonte më mirë historinë e problematikave të trashëguara nga përkthimi i *Kanunit*.

---

[42] Dhe kjo është një histori e vjetër që nis qysh me Kostandinin, vëllain e vdekur, që u ngrit nga varri për të shpalosur një tjetër drejtësi. Me atë ligj të ri, besën, nismëton gjithçka.
- Po a s'pranohet sot që e drejta shtetërore është më e përparuar se ajo kanunore? - ndërhyri ajo me druajtje.
- Më e vonshme, do të thuash, dhe natyrisht më moderne. Por kjo s'do të thotë asgjë. Se, në të vërtetë, kush mund ta dijë në këtë botë se ç'është e përparuar e ç'është e vonuar? Nganjëherë, pikërisht ngaqë vonohesh, gdhihesh befas në një gjendje më të përparuar.
- O, Besian, më dukesh se po mahitesh me mua, - tha gruaja, duke e ngacmuar te qafa.
- Aspak, - u përgjigj ai. - Mendo një turmë njerëzish, ose brezash, ose shtetesh, që rendin pas një idhulli a ideje të marrë dhe ti, për një arsye ose një tjetër, mbetesh pas.
- Ti mendon se është e mundur ose e arsyeshme që ligjet e sotme të zëvendësohen nga ato të kryehershmet?
- Disa prej tyre, pse jo? Natyrisht që nuk është e lehtë. Megjithatë, edhe aq e pamundur s'është. Xhandarët e mbretit, për shembull, qëllon që ngjiten gjer këtu. Por ata mbërrijnë përherë tepër vonë. Me fjalë të tjera, shteti bën kinse nuk e sheh atë çka po ndodh mu në hundë të tij. Dhe shteti, të jesh i sigurt, s'është pa mend. Ka njerëz mendjefyell, por shtete marrokë s'ka. Shteti, pra, bën sikur nuk sheh atë çka ndodh, ngaqë e di se makina e tij gjyqësore do të thyhej që në ndeshjen e parë me kodin e lashtë.

[43] Ismail Kadare, Prilli i thyer (1978), në *Vepra letrare 10*, Tiranë, Naim Frashëri 1983.

[44] […] "fisheku i pajës", me të cilin, sipas dokeve, dhëndri kishte të drejtë të vriste nusen, në qoftë se ajo përpiqej të ikte prej tij. (f. 23).

[45] Ishte vrarë mu në kufi të trojeve të fshatit. Dhe, siç dihej, në qoftë se ti e përcolle mikun dhe miku u vra në sytë e tu, gjaku i tij bie mbi ty." (f. 38).

[46] Të përshkruara në detaj edhe nga Donato Martucci, Sua Eccellenza Giorgio Fishta, Accademico d'Italia, e l'edizione italiana del Kanun, in Palaver, vol. 4 n.s., Issue 2, 2015, pp. 231-264.; *id.* Le consuetudini giuridiche albanesi tra oralità e scrittura, in Palaver, n. 6 n.s., Issue 2, 2017, pp. 73-106.

Në radhë të parë vërehet nevoja e përgatitësve italianë për të sjellë versionin e *Kanunit* në një sistem pritjeje me traditë të gjatë shkrimi, të formësuar nga sisteme simbolike referenciale.

Duket se Fishta e ka pasur gjithnjë në vëmendje bindjen se zgjedhja do të duhej të respektonte plotësisht domethënien e titullit shqip: *Kanuni i Lekë Dukagjinit. (vepër postume) Permbledhë e kodifikue prej A. Shtefen Konst. Gjeçov, O.F.M.*] siç e tregon projekti dorëshkrim i fletës 173 të dosjes së Korrespondencës mes Akademikëve[47] ku parashikohet ky titull: [P. Stefano Cost. Gjeçov O.F.M.]/ *Canone di Leka Dukagjini* /ossia/ Codificazione del Diritto Consuetudinario/ in vigore sino al 1912 nelle Montagne d'Albania/ (*opera postuma*)/ Tradotta per cura del P. Giorgio Fishta O.F.M./ Accademico d'Italia./ Con prefazione del Prof. Patetta/ Accademico d'Italia.

Mungesa e njehsimit kuptimor të termit *Canone* me fjalën *Kanun* përdorur në shqip, vërtetohet edhe nga përpunimi i këtij versioni të parë në një tjetër titull, siç dëshmon fleta e panumëruar e dosjes që përmban bocat e *Kanunit*: P. Stefano Cost. Gjeçov O.F.M./ ***Codice/*** *di/ Leka Dukagjini/* ossia/ *Raccolta delle leggi Consuetudinarie/ delle Montagne d'Albania./* (opera [1933] Postuma)/ Traduzione italiana di/ P. Paolo Dodaj O.F.M./ Prefazione di … Patetta (?)/ .(?) ./ A cura di/ P. Giorgio Fishta O.F.M./ Accademico d'Italia.[48]

Fjala "codice" me siguri e orienton operacionin e përkthimit italisht më shumë kah korpusi juridik se sa te përmbledhja e dokeve zakonore ("doke"-përkthyer nga Dodaj-Fishta me termin "usi e costumi" (§19); "consuetudini (§ 266) që janë të lidhura me sjelljen, me "dukjen", sjelljen në kolektivitet (" ajo që pëlqehet, që duket e mirë"), gjë që përcakton dhe imazhin e njeriut në shoqëri, siç shpjegon Çabej fjalën shqipe "doke"[49] që përmendet nga Camaj në parathënien e versionit anglisht të *Kanunit*[50].

---

[47] "Corrispondenza con gli Accademici e sulle loro funzioni"., Pellati a Pateta, Archivio Storico dell'Accademia Nazionale dei Lincei, Fondo Accademia d'Italia, Tit XI, busta 12, fasc. 97.

[48] "Volume sul Kanun: bozze", Archivio Storico dell'Accademia Nazionale dei Lincei, Fondo Accademia d'Italia, ivi, b. 5, fasc. 27.

[49] Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes* III, Akademia e Shkencave te RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsise, Tiranë, 1987, p. 277: "doke", "zakon" […] është një emër foljor nga *duket* që i përgjigjet fjalës *dukë* f. t geg. veriperëndimore. […] Kuptimi që mori kjo fjalë për "zakon" është një zhvillim i rëndësishëm për drejtësinë populore shqiptare. këtu kemi një fjalë vendi me këtë përdorim, pranë sll. *zakon* e turq *kanun* e *adet*.".

[50] M. Camaj, *Foreword*, in *Kanuni i Lekë Dukagjinit / The Code of Lekë Dukagjini. Albanian Text Collected and Arranged by Shtjefën Gjeçovi*, edited by Leonard Fox, Gjolenkaj Publishing Company, New York 1989. cit edhe Martucci, *I Kanun delle mntagne albanesi. Fonti, fondamenti e mutazioni del diritto tradizionale albanese.*, Bari, Pagina soc.



Ndoshta pikërisht pikat kritike të kalimit të kodit gojor si tekst i shkruar në një sistem kulturor të trashëguar jo në mënyrë gojore, e kanë shtyrë Fishtën të përdorë termin "Codice" në versionin e dytë si dhe të heqë emrin e vet si përkthyes i tekstit të *Kanunit* në italisht në favor të emrit të Dodajt.

Titulli përfundimtar, "Codice di Leka Dukagjini *ossia Diritto consuetudinario delle montagne d'Albania*", i vendosur, siç duket pas vdekjes së Fishtës, nuk e përmban termin "raccolta", themelor për vlerën kuptimore të tekstit si përmbledhje normash e dokesh gojore kanunore, koncept qartësisht i rëndësishëm për Fishtën siç tregojnë dy bocat e sipërpërmendura me shkrimin e Fishtës. Intuita dhe kultura e Fishtës e ndan korpusin realisht rregullator praktik të jetës nga shkrim-kodifikimi i tij prej Gjeçovit. Fishta ishte i ndërgjegjshëm se bëhet fjalë për përmbledhjen e ligjeve kanunore të një zone shqipfolëse, zonës së *Malcìs* (që në italisht përkthehen me termin përgjithësues "montagne").



Zgjedhja përfundimtare e Schirò-it shkon drejt vullnetit për ta paraqitur si një korpus juridik, rezultat i shkrim-kodifikimit.

Schirò, siç pohon Villari (në recensionin nr. 3 të Revista d'Albania XX, fasc. 1, mars. 1942)[51] ka vënë këtë titull në respekt të vullnetit të Fishtës, pasi përkundrejt termit "Codice", ai do të kishte parapëlqyer termin "Canone" ose "Kanun".

Nga dokumentet arkivore të përshkruara nga Martucci nuk ndriçohet deri në fund reagimi i Fishtës për vendimin e akademikëve italianë, pak ditë para vdekjes së tij, për të vendosur edhe emrin e Schirò-it si përgatitës të veprës. Ajo që mbetet në dijeninë e lexuesit është se formalizimi i "revizionimit" të tekstit të Fishtës nga ana e Schirò-it ndodh në mënyrë jo shumë të qartë[52].

---

coop., Bari 2010, f. 16.

[51] Salvatore Villari, *Recensione alla traduzione "Dodaj-Fishta-Schirò" del Gjeçov*, in Rivista d'Albania, n. 3, pp. 67-72.

[52] Cfr. Donato Martucci, *Sua Eccellenza Giorgio Fishta, Accademico d'Italia, e l'edizione italiana del Kanun*, in Palaver, vol. 4 n.s., Issue 2, 2015, pp. 231-264.; *id. Le consuetudini*

Dihet se kodifikimin e *Kanunit*, Fishta e pati ndjekur qysh në krye të herës në botimet e pjesshme të Gjeçovit në *Hylli i Dritës*.

Me siguri, një studim i imët i bocave me shënimet e Schirò-it si dhe një krahasim i termave të këtij teksti në "Shtojcën" e përkthyer nga Schirò-i pas vdekjes së Fishtës, mund të na ndriçojnë natyrën e ndërhyrjeve të Schirò-it në versionin përfundimtar të veprës.

Në vështrim të parë duket se ndërhyrja e Schirò-it ishte redaksionale, përderisa zgjedhjet e tij, siç shihet edhe nga përkthimi i "Shtojcës" në pjesën teknike të termave, bëhen duke u bazuar gjerësisht në ndihmën e Fishtës: përveçse zgjedhjes teknike të termave sipas versionit Fishta –Dodaj, ndër letërkëmbime nënkuptohet qartë se sa themelore kanë qenë për Schirò-in takimet në *Via Merulana* me Fishtën.

Gjithashtu dosjet e letërkëmbimeve mes Dodajt, Schirò-it dhe Ercole ndriçojnë edhe ndihmën që Schirò-i mori jo vetëm nga Fishta, por dhe nga P. Dodaj për punimin e tij mbi gjuhën e *Kanunit* në vëllimin për Kosovën.

Pavarësisht se Fishta pranon vërejtjen e Pattetës për korrigjim të përkthimit italisht, tipari ngushtësisht dialektor i lëndës gjuhësore të *Kanunit*, e bënte të vështirë ndërhyrjen së brendshmi dhe interpretimin origjinal të gjuhës dhe kulturës së *Kanunit* nga ana e Schirò-it si përgatitës.

"Cura" apo "përgatitja", kurrsesi nuk mund të reduktohet në ndërhyrje redaktoriale, të shtimit të disa shënimeve, siç dëshmojnë disa botime në italisht, ku emra studiuesish universitarë, larg lëmive studimore të dialekteve gege, veriore dhe veri-lindore të shqipes i janë bashkëngjitur emrit të Fishtës, madje deri e kanë hequr krejt atë. [53]

Në mënyrë të sinqertë, karakterin e ndërlikuar të punës përkthimore të *Kanunit*, quajtur prej tij si një nga tekstet shqipe më të vështira ("Au total, le Kanun est bien un des textes albanais les plus difficiles comme l'a écrit ce grand

giuridiche albanesi tra oralità e scrittura, in Palaver, n. 6 n.s., Issue 2, 2017, pp. 73-106.

[53] Cfr. *Il kanun di Lek Dukagjini: le basi morali e giuridiche della società albanese*, traduzione di padre Paolo Dodaj, introduzione e cura di Patrizia Resta, Besa, Nardò 1996.
S. Capra, *Il Kanun di Lek Dukagjini. Le basi morali e giuridiche della società albanese*, introduzione e cura di Donato Martucci, traduzione di padre Paolo Dodaj, Besa, Nardò 2009. Në botimin e fundit Donato Martucci (a cura di), *Il Kanun di Lek Dukagjini. Le basi morali e giuridiche della società albanese*, Controluce, Nardò, gennaio 2019), përgatitësi Donato Martuci deklaron qartësisht që teksti i përgatitur prej tij është i njëjti i Akademisë mbretnore italiane 1941, me disa ndërhyrje në "gabimet e shtypit" dhe uniformim të shënimeve si dhe disa shtesa të arsyetimeve të Valentinit mbi disa përkthime që duken "të pamjaftueshme" (cfr. Nota al testo, pp. 31-32).

connaisseur qu'était Martin Camaj.")[54], e ka përmendur përkthyesi nga frëngjishtja Christian Gut, para se të falenderojë emra të njohur të gjuhësisë historike (Rexhep Ismajli, Ymer Jaka, Remzi Përnaska), për ndihmën që i kanë dhënë.[55]

Frontespici i botimit frëngjisht shënon emrin e Gut vetëm si përkthyes: "Le Kanun de Lekë Dukagjini. Traduit de l'albanais par Christian Gut. sur l'edition de Shtjefën Gjeçovi.".

Shprehja "skjap i kumbonës", objekt-pretekst i arsyetimit tonë traduktologjik dhe interpretues, vjen në frëngjisht me "bous sonnailler".

"Kumbona" është objektivizim i nderit jo për madhësinë, por për drejtimin e tufës nëpërmjet tingullit, gjë që nuk i ka shpëtuar studiuesit francez me formim filologjik, i cili me siguri ka pasur parasysh gjithçka që gjuhësia historike hipotizon për termin "kumbonë" (që Tagliavini e sheh me shumë gjasë të futur në shqip nga leksiku kishtar i dalmatishtes *canpuone*), emër që sipas Çabejt është ndikuar reciprokisht nga folja "kumboj".

Interpretimi i Renzi-t mbi shtratin e përbashkët shqiptaro-rumun do të gjente kështu lëndë per t'u vërtetuar në tekstin e Kanunit, burimin e të cilit Valentini e çon në kohën e konventuseve juridike të dalmacisë romake (*ai conventus iuridici della Dalmazia romana*)[56]

Një botimi të ri të *Kanunit* në gjuhën shqipe (e më pas ndoshta të riprovohet një botim italisht), pajisur me shënime të ndihmuara nga teknika kompjuterike e ekdotikës së tekstit, do të mund të realizonte si përfundim, përcjelljen e karakterit dinamik të një teksti që ka nevojë të klasifikohet sipas një grile logjike, të kushtëzuar nga mekanizmat mnemonikë të përdorimit gojor.

Kosova më duket vendi i duhur për ta shtruar këtë nevojë, jo vetëm për lidhjen e natyrshme me substancën e përmbajtjes gjuhësore dhe asaj shprehëse të *Kanunit*, por edhe sepse, falë punës së një biri të saj, Kostandin Gjeçovit (O.F.M.), kemi sot këtë korpus të papërsëritshëm.

---

[54] Christian Gut, Préface te Le Kanun de Lekë Dukagjini. Traduit de l'albanais par Christian Gut. sur l'edition de Shtjefën Gjeçovi, Dukagjini publishing, Pejë 2001, f. 10.

[55] Po aty.

[56] P. Giuseppe Valentini, *Conczione imperiale o repubblicana nel Kanun di Lek Duagjini*, in Rivista d'Albania, 1942, anno III-fasc. 1, p. 52: "Storicamente mi sembra che ciò si possa affermare: molte analogie esistenti fanno risaliree i primordi della costituzione tribale albanese ai conventus iuridici della Dalmazia romana e poi ai concili provinciali di cui vedi p.es. le leggi del Codice Teodosiano; e in tal caso è evidente che si riconosceva la superiore autorità.".

Mimoza PRIKU, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

ATENEU PADOVAN DHE ALBANOLOGJIA

Abstract. Padova përfaqëson një nyjë lidhëse mes Shqipërisë dhe Italisë që në kohë të hershme, por marrëdhëniet në fushë të kulturës u bënë intensive në gjysmën e parë të sh. XX. Në historinë e tij ky atene ka folur shqip duke u kthyer në vatër të rëndësishme të studimeve albanologjike. Në këtë punim do ta shohim në dy kahe rolin e traditës padovane në albanologji: për ndikimin që ka pasur Padova në përgatitjen e intiligjencies shqiptare dhe për traditën e studimeve albanologjike në këtë qendër.
Në aulat e këtij ateneu u formuan jo vetëm filologët e ardhshëm, por edhe mjaft intelektualë shqiptarë, si Gj. Gazulli, E. Koliqi, M. Pipa, Z. Zorba etj; shqiptarë të Kosovës, si I. Ajeti, M. Krasniqi etj. Po ky qytet nxori mendje që do të kontribonin për kulturën shqiptare, si albanologu Giuseppe Valentini.
Si një ndër lidhjet e para të Padovës me albanologjinë mund të përmendim botimin e prozës së parë e shkruar në gjuhën shqipe "Çeta e profetëve" (1685) e P. Bogdanit, e cila mori dritë fillimisht në këtë qytet. Universiteti i Padovës ka pasur një bërthamë albanologjike që zë fill me filologun italian Carlo Tagliavini dhe sidomos me themelimin e *Seminarit e filologjisë ballkanike (Seminario di filologia balcanica)* nga ky albanolog në vitin 1935. Ai do të ndihmohej nga Ernes Koliqi dhe një hap përpara do të bënte me një tjetër albanist, Giovan Battista Pellegrini-n.
Sot në Padova vazhdojnë të studiojnë mjaft shqiptarë. Cila është perspektiva albanologjike e saj? Që të nisë një përtëritje a është e domosdoshme që disa prej kontributeve albanologjike të prodhuara në këtë qendër të sillen edhe në gjuhën shqipe?

Linguistika dhe studimet mbi gjuhët kanë qenë të afta të kapërcejnë gjithherë kufij dhe nuk kanë njohur limite gjeografike. Falë këtij parimi edhe shqipja është bërë pjesë e qëmtimeve të mjaft filologëve e albanologëve, në veçanti atyre italianë. Lingusiti i njohur E. Banfi pohon se "*Un altro campo d'indagine privilegiato dagli studiosi italiani di cose balcaniche si riferisce al settore dell' albanologia*"[1] dhe në këtë kontekst Padova përfaqëson një nyjë të rëndësishme të ballkanologjisë dhe albanologjisë. Ky qytet ka pasur lidhje të hershme me kulturën shqiptare. Sidomos në gjysmën e parë të shek. XX u bë vatër e rëndësishme për përgatitjen e inteligjencies shqiptare.

Në aulat e këtij ateneu u formuan filologë të ardhshëm dhe intelektualë shqiptarë, si Gj. Gazulli, E. Koliqi, M. Pipa, Z. Zorba, e shqiptarë të Kosovës, si I. Ajeti, M. Krasniqi etj. Po ky qytet nxori mendje që më pas kontribuan për kulturën shqiptare, si ta zëmë albanologu i njohur Giuseppe Valentini (1900-1979).

---

[1] E. Banfi, *La linguistica balcanica in Italia: origini, evoluzione e linee teoriche*, në *Linguistica*, 1992, 32(2), f. 72.



Ndër lidhjet e para të Padovës me albanologjinë do të përmendim botimin e veprës *Cuneus Prophetarum* (1685) të Pjetër Bogdanit.[2] Bërthama albanologjike në Universitetin e Padovës zuri fill me filologun e eruditin Carlo Tagliavini, sidomos me themelimin e **Seminarit të filologjisë ballkanike** (Seminario di filologia balcanica) në vitin 1935, në hapje të të cilit ai mbajti *Kursin e gjuhës e letërsisë shqipe.* Pas përfudimit me sukses të studimeve, krah i djathtë i Tagliavinit u bë shkrimtari Ernest Koliqi. Vazhdimësia e veprimtarive u ruajt falë përkujdesjes së gjuhëtarit Giovan Battista Pellegrini, i cili eci në gjurmët e profesorit të tij.

Carlo Tagliavini është figurë qëndrore në albanologji, sidomos në gjysmën e parë të sh. XX. Me punën, përkushtimin e dashurinë e tij për shqipen, arriti të lërë gjurmë të pashlyeshme. Carlo Tagliavini ishte linguist, indoeuropianist, autoritet shkencor në Italì, në Europë e përtej saj. Ka lindur në Bolonjë në vitin 1903, por Padova përfaqëson një pikë domethënëse të karrirës së tij akademike e shkencore. Në Universitetin e Padovës ai punoi rreth 38 vjet dhe produkti i tij albanologjik është shumë i lidhur me këtë periudhë. U nda nga kjo jetë në vitin 1982 në moshën 79 vjeçare. Pellegrini profilin shkencor të filologut të njohur e ka përkufizuar kështu: "*...il prof. Carlo Tagliavini, una delle massime autorità dell'Ateneo Patavino, della linguistica italiana ed europea*".[3]

Si u lidh me shqipen Tagliavini? Poligloti bolonjez njihte shumë gjuhë të huaja dhe mjaft prej tyre i bëri objekt analizash kontrastive. Në mesin e tyre zuri vend shqipja, fillimisht si një prej gjuhëve për krahasim e më pas u konsiderua prej Tagliavinit si pikësynim më vete. Kjo punë e filologut italian vazhdon të vlerësohet nga e gjithë albanologjia, pasi "*Tagliavini me anë të studimeve të tij ballkanologjike krahasuese e transformoi në një domosdoshmëri shkencore përfshirjen e albanologjisë në kontekstin e ballkanologjisë krahasuese*."[4]

Studimi i gjuhëve e kulturave të rajonit ballkanik kishte zgjuar interesin e gjuhëtarëve pas Luftës së Parë Botërore. Sipas historianëve "*La nuova Europa*

---

[2] Albanica 18/I – Gaetano Petrotta, Popolo, lingua e letteratura albanese, a cura di M. Mandalà, A. C. Mirror, Palermo, 2003, f. 113.

[3] Giovan Battista Pellegrini, *Carlo Tagliavini* (Commemorazione tenuta il 19 febbraio 1983). Padova, Società cooperativa tipografica, 1984, p.51.

[4] E. Prifti, *Carlo Tagliavini dhe albanologjia*, ANASH, organ i Isntitutit Alb-Shkenca, nr. 2, 2006, f. 35, ANASH_02_2006_pdf.

che si delinea alla fine della Prima guerra mondiale è uno spazio culturale – linguistico composito, in cui le neo costituite nazioni dell'area dell' Europa centro-orientale e sudorientale si affacciano con la loro molteplicità di lingue, tradizioni e culture."[5] Brenda kësaj hapësire shqipja zgjoi interes studimor. Kështu për Calo Tagliavinin mendimi se shqipja do ta ndihmonte për të shpjeguar disa çështje të ballkanologjisë nisi ta ngacmonte pak e nga pak. Ishte vetëm 21 vjeç në vitin 1924 kur Tagliavini botoi në revistën *Dacoromania*[6] artikullin *Sulla questione della postpozicione dell'articolo*.[7] Ndërsa dy vitet e mëvonshme e vendosën filologun italian në mjedisin e pastër albanologjik.[8] Karrierën akademike e nisi gjatë viteve 1927-28 në Universitetin katolik të Nimegenit në Holandë, ku punoi si profesor i gjuhëve romane. Një vit më pas u transferua në Universitetin ELTE të Budapestit dhe u emërua titullar i katedrës së *Gjuhësisë neolatine*. Kjo periudhë e lidhi edhe më shumë Tagliavinin me gjuhët ballkanike.[9] Kudo që punoi Tagliavini la frytet e punës së tij.

Që kur Carlo Tagliavini ishte në Budapest shqipja filloi të hynte në fokusin e studimeve të tij dhe kërkoi që këtë fakt ta ndante me miqtë e tij gjuhëtarë. Në Biblioteca Estense Universitaria në Modena[10] gjenden disa letra e kartolina që Tagliavini ia kishte dërguar gjuhëtarit e kritikut letrar Giulio Bertoni (1878-1942) në lidhje me hulumtimet e tij për shqipen e Dalmacisë. Ai e vinte në dijeni Bertonin për botimin e një pjesë të rezultateve të këtyre kërkimeve me botimin e studimit *Penetrazione e adattamento delle voci italiane e croate nel dialetto albanese di Borgo Erizzo Zara* (Roma, Istituto per l'Europa Orientale, 1934 [Estr. da: *Studi albanesi*, 1934]).[11] Këtë lidhje të tij me shqipen dhe sprovat për një fiologji ballkanike Tagliavini i rrëfen vetë:

---

[5] Tommy Pizzolato, Tiziana D'Amico, Daniela Rizzi, *I Paesi dell'Europa orientale e sud-orientale Storia degli insegnamenti linguistico-culturali a Ca' Foscari* in *Le lingue occidentali nei 150 anni di storia di Ca' Foscari* (a cura di Anna Cardinaletti, Laura Cerasi e Patrizio Rigobon), Venezia Edizioni Ca' Foscari-Digital Publishing 2018, f. 226.

[6] *Buletinul Muzeului Limbei Române*, Cluj, România drejtuar nga Sextil Puşcariu.

[7] *Dacoromania*, Buletinul Muzeului limbei române, anul III, Cluj, 1924, f. 515-522.

[8] Boton artikullin *Gli studi albanesi nella Dacoromania*, në *Arhiv za Arbansku, Starinu Jezik I Etnologiju*, III, 1926, f.229-238.

[9] Në vitin 1927 themelon dhe drejton revistën *Studi rumeni* (1927-1933), e cila sipas filologut tonë do të kishte si objekt të saj të studimit jo vetëm rumanishten si gjuhë. Ai boton brenda kësaj reviste: C. Tagliavini, Rec., Kr. Sandfeld, *Balkanfilologien - En oversigt over dens resultater og problemer*, Köbenhavn, 1926, në *Studi rumeni*, III, 1928, f. 145-152; Rec., S. Mladenov, *Prinos kăm izčuvane na bălgarskoalbanskitě ezikvi otnošenija*, Sofija, 1927, I, në *Studi rumeni*, IV, 1929-30, f. 188-189.

[10] Bertoni, Carteggio, fasc. Tagliavini, Carlo

[11] https://manus.iccu.sbn.it/opac_SchedaScheda.php?ID=170308

"*Negli annni della mia giovinezza, qundo ero professore di linguistica romanza e di lingua e letteratura rumena alla Università di Budapest (1929-1935), dedicai un semestre di esercitazioni di seminario per gli specialisti di Rumeno alla fraseologia balcanica, partendo già citata monografia del Papahagi: la maggior parte degli allievi di quel corso erano Ungheresi di Transilvania e conoscevano, praticamente, molto bene il Rumeno, avendo fatto le scuole medie rumene, due conoscevano il Greco moderno, una stava studiando l'Albanese e una, oltre Serbocrorato, intendeva anche il Bulgaro....*"[12].

Tagliavini u njoh në botën shqiptare si linguisti i madh italian, profesori i shqipes, albanologu që ndihmoi edhe për të çelur rrugën e njësimit të shqipes e normësimit të saj me anë të manualeve, por njëkohësisht edhe si adhurues i kësaj gjuhe. Në kohën kur erdhi në Shqipëri për të marrë pjesë në Kuvendin e Parë të Studimeve Shqiptare në një prej të përkohshmeve shqiptare shkruante:

"Përveç ktij botimi periudhuer të komisjonit të gjuhës, Instituti do të botojë çdo vjet nji vëllim aktesh që përmbajnë kujtesat e këndueme nga antarët ose ato t' atyne që nuk bajnë pjesë n'Institut po të paraqituna nga nji antar. Ashta parapà mandej edhe botimi i veprave ma të mdha, që do të ndihmojnë për me u mërrijt qellimevet që ndjek Instituti dhe asht gjasa që nji nga problemet e para që do të mirren në bisedim do të jet pregatitja e nji gramatike të mirë shqipe dhe e nji fjalori të madh të gjuhës shqipe që të përmbledhi të gjitha visaret e ksaj gjuhe, që edhe pse nuk i ka traditat letrare të gjuhve të tjera, ka nji pasuni të çuditëshme shprehjesh." (Carlo Tagliavini, *Sot inaugurohet shkëlqimisht Kuvendi i parë i Studimeve Shqiptare*, gazeta *Tomori*, 9 prill, 1940, nr. 32, f. 1.).

Në vitin 1935 Tagliavini u emërua në universitetin e Cagliarit e më pas të Padovës (ku qëndroi deri në vitin 1973) dhe menjëherë themeloi *Seminarin e filologjisë ballkanike*. Në karrierën gati 40-vjeçare në këtë atene, ku formoi brezat e ardhshëm të gjuhëtarëve e albanologëve, pos studimeve mbi dialektet romane, iu përkushtua dhe problemeve të gjuhësisë ballkanike e albanologjisë. Padova ishte një qendër universitare që parapëlqehej nga studentë që vinin nga Shqipëria, prandaj dhe interesi për gjuhën shqipe atje ishte rritur.

Më 6 shkurt 1936 Carlo Tagliavini mbajti prolusionin e kursit zyrtar të Gjuhës dhe Letësisë shqipe në prani të Rektorit të Universitetit të Padovës Carlo Anti, trupës akademike e studentëve. Ngjarje e rëndësishme për shqipen, pasi ishte hera e parë në Fakultetin e Letërsisë së këtij ateneu të flitej për këtë gjuhë dhe historinë e saj. Ndër të tjera ai proklamoi:

"*Non sarà quindi inopportuno cominciare il corso di lingua e letteratura albanese che per la prima volta si tiene in questo Ateneo con un rapido sguardo alla lingua*

[12] C. Tagliavini, "Paralleli ungheresi a evoluzioni semantiche e a frasi idiomatiche ritenute caratteristiche delle lingue balcaniche", në *Miscellanea di studi dedikati a Emerico Várady*, Modena, 1966, f. 219-227. Ribotuar postum edhe në *Scritti minori*, Bologna, Pàtron, 1981, f. 686.

albanese, ai suoi elementi costitutivi e alla sua posizione nel seno della famiglia indoeuropea".[13]

Në këtë ngjarje morën pjesë emra të njohur të filologjisë italiane, si Matteo Bartoli, nga Universiteti i Torinos dhe i Studimeve Adriatike, albanologu A. Baldacci, glotologu B. A. Terracini etj. Në parashtrimet e tij Tagliavini deklaroi se "*gli indoeuropeisti continuano a trattare l'albanese come la cenerentola delle lingue indoeuropee*" (C. Tagliavini, *La lingua Albanese*, *Studi albanesi*, V-VI, 1935-1936, 5.). Në fjalën e tij solli trajtime me interes për karakterin indoeuropian të shqipes, pozicionin që ajo zë në familjen i.e., lashtësinë e saj. Për këtë ai thoshte:

> "*Per quanto non tutti questi punti reggano alla critica, pure, allo stato dei fatti odierno è d'uopo ritenere che non solo l'illirico rappresenti la base indoeuropea dell'albanese, ma una lingua illiro-trace, o, più probabilmente un dialetto tràce illirizzato. Così si spiegano anche le coincidenze sintattiche e fonetiche che si chiamano "balcaniche*" (*La lingua albanese*, f. 17).

Këto çështje ai do t'i trajtojë edhe në shkrime të tjera.[14]

Ky kurs u legjitimua edhe në *Gazetën zyrtare* (*Gazetta Ufficiale*) ku *Seminario di filologia balcanica* paraqitet si pjesë e Facoltà di lettere e filosofia.[15] Sigurisht, ai pati fazat e veta të zhvillimit. Pas disa kohësh në krah të Tagliavinit do të punojë një ish-student i tij, Ernest Koliqi, i cili më vonë punën me mësimin e shqipes do ta vazhdonte në Romë.

Cilat ishin fushat e kërkimit të Carlo Tagliavinit në albanologji? Megjithëse pas gjysmës së dytë të sh. 20 ai ishte më pak produkiv në studimet e drejtpërdrejta për shqipen, ai la gjurmë në mjaft fusha të albanologjisë, ndër të cilat mund të përmendim: historinë e gjuhës shqipe, leksikun dhe shtresimin e tij historik, dialektologjinë, etimologjinë, bibliografinë e më pak letërsinë shqipe dhe historinë e saj etj. Përmbledhtazi do të përpiqemi të analizojmë disa prej tyre.

Leksiku i shqipes ishte një fushë e pëlqyer e glotologut italian. Disa nga rezultatet e kësaj pune janë: shtresimi i leksikut të shqipes, identifikimi i elementeve latine dhe atyre indoeuropiane, duke prekur edhe shpjegime me karakter të mirfilltë etimologjik.[16] Këto punime të Tagliavinit, përveç vlerës së tyre

---

[13] C. Tagliavini, *La lingua Albanese*, në *Studi albanesi*, V-VI, 1935-1936, f. 7.

[14] *La lingua albanese* (Posizione e caratteristiche della lingua albanese nel seno dell'indoeuropeo. Elementi autoctoni e mutuati nel lessico albanese), në *Albania* I, a cura dell' istituto di Studi Adriatici, Venezia, 1939, f. 147-153; (në bashkëpunim me E. Koliqi) *Lingua e letteratura*, në *Abania*, Milano, 1940, f. 86-93 [volume della Guida d'Italia della Consociazione Turistica Italiana].

[15] *Gazetta Ufficiale*, Roma, mercoledi, 2 agosto 1939, numero 179, parte prima, Anno XVII, p. 3584; file:///C:/Users/User/Downloads/RG1939_08_02_179_P1%20(2).pdf.

[16] Përmendim: *Postille etimologiche albanesi*, (Arhiv za Ar); *Miscellanea etimologica balcanica. 1. Sui nomi della cutrettola in albanese, 2. alb.(ciam.) bobëlë "*lumaca*", 3. neoell.*

shkencore, sjellin dhe prurje të pasura bibliografike. Në truallin e studimeve mbi leksikun historik të shqipes arriti t'i rikthente shqipes mjaft fjalë nga fondi i vjetër i.e., të menduara më parë si fjalë të huazuara.[17]

Kontributi kryesor i kësaj fushe është volumi *La stratificazzione del lessico albanese. Elementi inoeuropei* (Pàtron, Bologna, 1945, [1965]). Botimi i tij erdhi krejt natyrshëm jo vetëm për faktin se Tagliavinit si ligjërues i shqipes i duhej një manual përmbledhës për këtë gjuhë, por edhe sepse ai kishte hyrë natyrshëm në këtë fushë me disa punime. Hulumtimet e tij prekën edhe leksikun e të folmeve shqipe jashtë territorevetë shtetit shqiptar.[18] Megjithëse ishte linguist i njohur ai shprehej me mjaft modesti për punën e tij:

> "*Il presente corso non si proponecerto di esaurire l'argomento che ha per oggetto, ma solo di dare una esemplificazione del metodo col quale la stratificazione del lessico albanese può essere investigata*."[19]

Edhe pse e papërfunduar, kjo punë e Tagliavinit shërbeu si metodë e studimit të leksikut të shqipes. Kontribut me vlerë për shqipen është edhe identifikimi i elementeve latine dhe përkimet e tyre me rumanishten e gjuhë të tjera ballkanike, të bëra objekt studimi jo vetëm në punimin "Gli elementi latini in albanese",[20] po edhe në punime të plota, si në monografinë "Le origini delle lingue neolatine" (1949). Në lidhje me këto elemente Tagliavini shkruan:

> "[...] *per quanto i più recenti studi di etimologia albanese abbiamo rivendicato al primitivo fondo indoeuropeo voci che sì credevano di provenienza latina e, ciò che più importa, suffissi di mozione e di derivazione, l'apporto dato dal Latino alla formazione del lessico albanese è pur sempre considerevolissimo. Dal punto di vista culturale, gli elementi latini del lessico albanese hanno grande importanza, perché*

---

*δελόγγον "*subito*". 4. alb. (gh.) kofen, kofna "*nassa*", 5. gh. mer. guverta "*Bettdecke*", 6. gh. stivue "*accatastare*", 7. alb. tsop(ë) "*pezzo*", Revue Internationales des Etudes Balkaniques*, I, 1934, f. 165-171; *Miscellanea etimilogica balcanica. 8. alb. dylmere "*cutrettola*", 9. alb. delentisë, delendrisë, Revue Internationale des Etudes Balkaniques*, II, 1936, f. 191-194; *Albanesische Etymologien*: *1. amë "*Flusebatt; Bodensatz der Flüssigkeiten*", 2. kal.-alb. apul "*weich, zart*", 3. barak "*schnellfüssig*", 4. batakshí, batakçi "*Gauner*", 5. batakçillek "*Gaunerei, Betrug*", 6. batoq "*Glockenklöppel*", 7. burak "*Torte*", 8. tsham. Mastrale "*Südwestwind*", 9. it.-alb. novë "*Neuigkeiten*", 10. rragatë "*zanken; Zank, streit*", 11. tscham. skanjo* "Stuhl", *Mélanges linguistiques offerts à M. Holger Pedersen*, København, 1937, f. 162-175.

[17] Shih: M. Priku, *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2011, f. 247.

[18] Penetrazione e adattamento delle voci italiane e croate nel dialetto albanese di Borgo Erizzo (Zara), në *Studi Albanesi*, III-IV, 1933-34, f. 214-242; Gli "Etnici" dei paesi albanesi d' Italia, në *Atti del (R.) Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti*, f. 1963-64, Tomo CXXII, 1964, f. 551-568 etj.

[19] C. Tagliavini, Premessa, La stratificazzione del lessico albanese. Elementi inoeuropei, Casa Edidrice Pàtron, Bologna, 1965.

[20] C. Tagliavini, Gli elementi latini in albanese, *Cultura Neolatina*, I, 1941, f. 90-93.

abbracciano varie sfere e parti essenziali del tesoro lessicale." (*Le origini delle lingue neolatine*, Pàtron editore, Bologna, 1982, f.189).

Meritë e Tagliavinit është studimi dhe analizimi i këtyre elementeve.

Sigurisht ndër arritjet e Tagliavinit është kritika që ky gjuhëtar i ka bërë fjalorit etimologjik të shqipes të Gustav Meyerit.[21] Megjithëse e çmonte mjaft kontributin në albanologji të G. Meyer-it[22], Tagliavini ka kritikuar disa qëndrime të këtij gjuhëtari për leksikun e shqipes. Ndër të tjera ai shkruan: *"Il dizionario etimologico del Meyer rapressentava, non solo il primo tentativo del genere, mà la più ampia raccolta lessicale albanese, basata su tutti i vocabolari e i testi dialettali esistenti",*[23] por nga studimet e bëra nga albanologu italian rezulton se nga 730 fjalët që Mayer-i i la pa shpjegim, *"pjesa më e madhe i përkasin fondit të vjetër i.e."*[24]. Nga punimet e fundit që prekin leksikun e shqipes përmendim *È autoctona la terminologia marinaresca e peschereccia albanesi* (*Bolletino dell' Atlante linguistico mediterraneo*, X-XII, 1968-70, f. 39-42).

Dialektologjia është fusha ku Tagliavini ka lënë gjurmë të çmueshme. Pos monografisë *L'Albanese di Dalmazia*[25] që cilësohet me prurje nga shtresimi i leksikut të kësaj së folmeje e sidomos me kërkime etimologjike, punim tjetër interesant e i vlerësuar nga albanologjia është *Le parlate albanese di tipo ghego orientale (Dardania e Macedonia nord-occidentale*),[26] ndërsa pjesa që i përkiste Çamërisë[27] doli vetëm këto vitet e fundit. Jo vetëm për tiparet dialektore të analizuara nga Tagliavini, por edhe parashtrimet me karakter historik, gjuhësor e folklorik u bënë mbështetje për idenë e autoktonisë së shqiptarëve në ato treva. Sipas studiuesit dhe ish-studentit të Tagliavinit, akademikut Idriz Ajeti:

> "*Mbi dëshminë e materialit të vjelë gjuhësor, folklorik e etnografik, prof Tagliavini na jepte një pasqyrë mbi tiparet dialektore të ligjërimeve më kryesore shqiptare në Jugosllavi; me atë rast ai prekte edhe veçoritë më kryesore të së folmes shqipe të Preshevës*."[28]

---

[21] G. Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg, 1891.

[22] C. Tagliavini, *Meyer Gustav*, *Enciclopedia Italiana di Scienze*, Lettere ed Arti, XXIII, f. 14.

[23] C. Tagliavini, *La stratificazzione del lessico albanese. Elementi inoeuropei*, Casa Editrice Pàtron, Bologna, 1965, f. 32.

[24] *La lingua albanese*, Prolusione al corso ufficale di Lingua e Letteratura albanese letta nella R. Università di Padova, botuar në *Studi Albanesi*, V-VI, 1935-1936, f. 19.

[25] C. Tagliavini, *L'albanese di Dalmazia: Contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara*, Firenze, Leo. S. Olschki, 1937.

[26] Në *Le terre albanesi recente. I. Cossovo, Roma*, Reale Accademia d'Italia, Centro studi per l'Albania, 1942, f. 1-82. Ribotuar në Scritti minori, Bologna, 1982.

[27] Albanistica 2, *Le terre albanesi redenti II. Ciameria* (A cura e con un saggio introduttivo di Donato Martucci), Comet Editor Press, Cosenza, 2012.

[28] I. Ajeti, "Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit", në *Studime për gjuhën shqipe*. Vepra të zgjedhura, Prishtinë, 2017, f. 362.

Një tjetër iniciativë mjaft e rëndësishme për shqipen ishin përpjekjet albanologjisë italiane për hartimin e një Atlasi dialektologjik të shqipes[29]. Në këtë nismë u bënë bashkë gjuhëtarët e njohur italianë, si Ugo Pellis, Clemente Merlo, Matteo Bartoli, C. Tagliavini dhe doktori i ri i filologjisë E. Çabej. Një pjesë e kësaj pune është pasqyruar në shkrimin e Tagliavinit *L'Atlante linguistico albanese*[30]. Ndërsa korrespondencat, takimet e diskutimet për këtë vepër madhore për shqipen gjenden në Archivio Storico dell'Accademia Nazionale dei Lincei (ASANL) dhe janë bërë të njohura edhe nga studiuesi Donato Martucci. Në shkrimin e tij për këtë nismë të madhe Tagliavini shkruan:

> *"Dova la collaborazione del Pellis al nostro Atlante si è rivelata poi particolarmente preziosa è stato nella revizione del questionario. Questo era stato preparato con grande competenza e coll' ausilio di tutte le opere etnografiche, folcloristiche ecc. sull' Albania dal dott. Çabej sul piano stabilito dal Comitato, ed era stato poi discusso quasi parola per parolarola frame e il dott. Çabej sia a Roma che a Padova e Bologna".*[31]

Carlo Tagliavini përfaqëson në albanologji edhe bibliografin e kujdesshëm, me njohje të thella në ballkanologji. Në metodologjinë e punës së Tagliavinit vihet re gjithmonë përdorimi i një biliografie të pasur, të përditësuar dhe të plotë për argumentin që ai trajton. Por, kur bibliografinë e ka si prioritet, albanologu e ballkanologu italian jo vetëm kërkon të jetë shterrues, por edhe arrin të realizojë një bibliografi të arsyetuar mirë. Kjo bilbiografi nisi "fillimisht në revisën *Rivista d'Albania* (1937-1939) si rubrikë më vete, punë e cila do të vazhdojë deri më 1942. Për t'u çmuar është bibliografia e botuar në revistën *Indogermaniches Jahrbuch*, rubrikë e mbajtur deri më 1941 nga një tjetër albanolog i njohur Norbert Jokli [...]. Shumë interesant është sidomos seksioni VII (*Albanese e linguistica balcanica*) i kësaj reviste.[32] Shënimet bibliografike, shpesh në trajtën e recensioneve e ndihmuan të popullarizojnë shqipen dhe kontributet rreth saj dhe ta ngrenë albanologjinë në standarde ndërkombëtare.

---

[29] Shih: Donato Martucci, *Il primo tentativo di compilazione di un Atlante Linguistico Albanese (1940-1944)* në *Res Albanicae*, anno I, n. 2, settembre 2012, f. 47-80.

[30] *L'Atlante linguistico albanese*, in J. Schrijnen, *Essai de bibliographie de géographie linguistique générale*, Nimègue 1933.

[31] C. Tagliavini, *Ugo Pellis e l' Atlante linguistico albanese*, *Ce fastu?*, XIX, nr. 4-5, Boletino della Società filologica friuliana, 1943, f. 174-175.

[32] M. Priku, *vep e cit*, f. 39.

Tagliavini la disa gjurmë edhe në letërsinë shqipe dhe atë arbëreshe[33]. Ai dëshmoi se njihte mirë letërsinë e vjetër e të re shqipe si dhe historinë e zhvillimit të saj[34]. Sipas këtij studiuesi

> "*Per trovare una leterattura albanese che abbia un valore estetico (a parte la leterattura popolare) dobbiamo arrivare ul secolo XIX con Kostandin Kristoforidhi (1827-1895), Naim Frashëri (1846-1900) e specialmente coi viventi Padre Gjergj Fishta (n. 1871), Vincens Prennushi (n. 1885), Ernest Koliqi (n. 1903) ecc., dobbiamo giungere cioè ai formatori della nuova letteratura albanese*".[35]

Ndihmesat e C. Tagliavinit në albanologji u bënë të njohura jo vetëm në rrethet albanologjike, por gjetën vend edhe në enciklopeditë ndërkombëtare. Në njërën prej tyre puna e këtij filologu përshkruhet kështu:

> "*Tagliavini showed special interest in historical and comparative linguistics; the diachronic perspective underlies his dialectological work on Ladin (1926, 1934, 1944) and Albanian (1937), and his onomastic studies (1957, 1981)*".[36]

Për kontributin në albanologji Tagliavinit iu akordua pas vdekjes nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë Urdhri "Naim Frashëri" i Klasit të Parë me motivacionin "*Për kontribut të shquar në studimet për historinë e gjuhës shqipe*". Sipas akad. I. Ajeti

> "*Tagliavini ishte punëtor i vyeshëm shkencor, çdo punim i tij shquhet me të dhëna të gjera, por edhe asosh të imëta, gjë që mundëson shqyrtim të sigurt të temës në tërësinë e saj dhe zgjidhje të çështjes në vështrim. Në albanistikë Tagliavini la gjurmë të shënueshme me vlerë të pakrahasueshme dhe të përhershme; një numër jo i vogël i eitmologjive të tij të trajtuara kanë gjetur zgjidhje, prandaj nuk ka nevojë t'u kthehemi, kjo vlen veçanërisht për venecianizmat e pranishme në gjuhën shqipe.*"[37]

Me shuarjen e tij humbën glotologjia italiane dhe albanistika. Eshtë meritë e Tagliavinit që shqipja u ngrit në ateneun padovan, krijoi një traditë të mirë të studimeve albanologjike e ballkanologjike. Tagliavini u dha studimeve mbi

---

[33] C. Tagliavini, *Un'opera sconosciuta della letteratura calabro albanese*, në *Rivista d'Albania*, I, fash. III, 1940, f. 268-278.

[34] C. Tagliavini, *Alcune considerazioni sulle origini e lo sviluppo della letteratura albanese*, *Rivista d'Albania* I, fash. I, 1940, f.71; *Qualques texts peu connus de l'Albanais de Grèce*, *Annuaire de l'Institut de philology et d'Histoire Orientales et Slaves* VI (1938), 289-302 [Mèlanges Émile Boisacq II].

[35] C. Tagliavini, *Alcune cosiderazioni sulle origini e lo sviluppo della letteratura albanese*, në *Rivista d'Albania* I, fash. I, 1940, f. 71-76; ribotuar në rev. *Bota e re*, Tiranë, 6 tetor, 1940, nr. 10, f. 3.

[36] Zëri *Tagliavini, Carlo (1903–1982)* shkruar nga P. Swiggers, Katholieke Universiteit Leuven, Belgium, në *Encyclopedia of Language and Linguistics*, 2nd ed., Keith Brown editor, Oxford, Elsevier, 2005, f. 476.

[37] I. Ajeti, *Vështrim i shkurtër i punës në studimet etimologjike të gjuhës shqipe*, në *Studime për gjuhën shqipe.* Vepra të zgjedhura, Prishtinë, 2017, 546-547.

shqipen një perspektivë të re dhe çeli rrugën për vazhdimësinë e kërkimeve albanologjike. Ai përfaqëson një gjuhëtar të gjithanshëm, ndërsa vepra e tij i ka bërë albanologët që t'i rikthehen vazhdimisht punës së këtij filologu italian. Tagliavini i drejtoi shpeshherë studentët e tij drejt argumenteve albanologjike[38] dhe siguroi një kontinuitet për albanologjinë në Universitetin e Padovës dhe këtu vlen të përmendet kontributi i një albanisti tjetër, Giovan Battista Pellegrini (1921-2007). G. B. Pellegrini përfaqëson filologun dhe profesorin në Universitetin e Pizës, Palermos e Padovës, Triestes, vazhduesin e denjë të punës së Tagliavinit në mjaft fusha, por sidomos në albanologji e ballkanologji. Ish-student i Tagliavinit në universitetin e Padovës, ai arriti pas disa vitesh eksperienca në universitete të ndryshme, të jetë krah Maestros në këtë atene. "*Në vitin 1958 do të japë mësim edhe në Universitetin e Triestes si i jashtëm dhe pastaj si profesor ordinar i "Historisë së gjuhës italiane*" dhe i Filologjisë romane për t'u vendosur përfundimisht nga viti 1964 në Padova, duke shërbyer pranë prof. Karlo Taliavinit. Në këtë universitet Xh. B. Pelegrini do të caktohet prof. ordinar i dytë pranë prof. Karlo Taliavinit. Në këtë periudhë do të zhvillojë lëndët "Histori krahasuese e gjuhëve klasike" dhe Gjuhësi latine. Mbasi la këto disiplina, zhvilloi Gjuhë dhe letërsi shqiptare (Me elemente të filologjisë ballkanike).[39]

Pas daljes në pension e largimit të Tagliavinit nga ky universitet, Pellegrini mbajti gjallë frymën albanologjike, u bë trashëgimtar i disa prej lëmive të lëvruara nga profesor Tagliavini. Pasi punoi në disa qendra universitare, ndër të cilat Palermo (1957-1958), Trieste (1954-1964), ai u kthye në Padova derisa doli në pension. Për këtë albanist gjuhëtari italian Alberto Zamboni shkruan: "affi ancando infine a Padova Carlo Tagliavini quale secondo ordinario di Glottologia: qui professando via via discipline 'minori' ma certo a lui congeniali come la stessa Storia comparata delle lingue classiche, la Linguistica ladina, infi ne la Lingua e letteratura albanese."[40] Poliglot si profesori i tij, Pellegrini fliste 10 gjuhë të huaja dhe i nxitur ndoshta dhe nga Tagliavini, shfaqi interes të veçantë për ballkanologjinë e shqipen, jo për gjuhët ekzotike. Sipas studiuesve,

> "*A differenza del suo maestro Tagliavini, Pellegrini non si spinse mai a indagare su lingue esotiche, però tutte quelle parlate attorno (e dentro) l'Italia rientravano nel raggio della sua curiosità*." (Danilo Gheno, 2008:103).

---

[38] E. Koliqi *Epica popolare albanese*, Tesi di laura in lingua e letteratura albanese, Relatore: Prof. Carlo Tagliavini, R. Università di Padova, Facoltà di Lettere e Filosofia, Anno Academico 1936-1937.

[39] T. Osmani, Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor 2, Shkodër, 2007, Shtëpia botuese Camaj-Pipa, f. 232.

[40] Alberto Zamboni, Ricordo di Giovan Battista Pellegrini, L'Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti, Venezia, 2008 f. 6.

Disa prej kontributeve të Pellegrinit në fushë të albanologjisë e ballkanologjisë janë: *Studi linguistici balcanico-danubiani* (1992), *Introduzione alla linguistica albanese* (1995); *Disa vëzhgime mbi elementin latin të shqipes*[41], *Concordanze balcaniche nell'uso dell'articolo determinativo, Studi rumeni e romanzi* (Omaggio a Florica Dimitrescu e Alexandru Niculescu, 1995, f. 201-218); *Avviamento alla linguistica albanese* (Rende-Cosenza, Centro Editoriale e Librario dell'Università della Calabria, 1998) etj.

> "*Në këndvështrimin dialektologjik nuk mbetën jashtë vëmendjes shkencore të Pellegrinit as të folmet shqipe jashtë arealit gjuhësor të vazhdueshëm ballkanik të shqipes. Kështu, ndër studimet gjuhësore mbi arbërishten bëjnë pjesë dhe tre punë të Pellegrinit, të titulluara Appunti sull' albanese d'Italia*[42]*, Il lessico dell' Arbëresh ed i turchismi*[43]*, dhe Una breve inchiesta arbëreshe di J. Baudouin de Courtenay*[44]*, ndërsa në artikullin Note linguistiche arvanitiche*[45] *trajtohen disa çështje gjuhësore të arvanitishtes.*"[46]

Pellegrini vazhdoi edhe traditën e mësimit të shqipes në Universitetin e Padovës, por edhe të përgaditjes së albanologëve të rinj ndër të cilët përmendim gjuhëtare tashmë të njohur Monica Genesin.

Në lidhje me kontributin e këtyre dy albanologëve E. Banfi shkruan:

> "*Nel settore albanologico, particolare menzione deve essere data ai lavori di C. Tagliavini e di G. B. Pellegrini, maestri insigni dell'ateneo patavino: in particolare vanno ricordati i loro saggi sulla stratificazione del lessico albanese, la cui straordinaria complessita prevede elementi greci (pre)classici, elementi latini (di epoche diverse), elementi greco-bizantini, slavi, turchi*".[47]

Kontributi i ateneut padovan e në veçanti i dy albanologëve Tagliaivni dhe Pellegrini, duhet vlerësuar dhe sot.[48] Me studimet që lanë për shqipen, punën e

---

[41] Botuar në rev. *Studime filologjike*, nr. 3, Tiranë, 1982, f. 85-102.

[42] Botuar në vitin 1994 në: Altimari, Francesco/ Savoia, Leonardo M. (a cura di): *I dialetti italo-albanesi. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe*, Roma: Bulzoni, [Biblioteca di Cultura, 488], f. 107-120.

[43] Botuar në vitin 1989 në: AA.VV.: *Le minoranze etniche e linguistiche*. Atti del 2° Congresso internazionale (Piana degli Albanesi, 7- 11 settembre 1988), Palermo: Renna, f. 327-362.

[44] Botuar në vitin 1980 në: *Romanistik in Geschichte und Gegenwart* I/2, f. 149-158.

[45] Botuar në vitin 1997 në: Ponto-baltica 7, f. 163-170.

[46] E. Prifti, *Giovan Battista Pellegrini*" (23 shkurt 1921 – 3 shkurt 2007), në *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2007, f. 171.

[47] Banfi, E. (1992). La linguistica balcanica in Italia: origini, evoluzione e linee teoriche. *Linguistica*, *32*(2), 65-73. https://doi.org/10.4312/linguistica.32.2.65-73, f. 72.

[48] Filologu i njohur arbëresh F. Altimari, duke bërë një panoramë historike të studimeve mbi arbërishten thekson se "Ndërmjet gjuhëtarëve bashkëkohorë të shkollës italiane që, në kuadrin e një drejtimi studimesh kryesisht në rrethin e gjuhëve orientale dhe për ballkanistikën, janë marrë edhe me arbërishten e Italisë, përveçse me shqipen e trevës ballkanike, në radhë të parë duhet të përmendim glotologun Giovan Battista Pellegrini, i cili në

palodhur për të krijuar një traditë në gjurmimet albanologjike, kanë zënë një vend nderi në albanologji.

Bibliografi

Ajeti, Idriz, *Studime për gjuhën shqipe*. Vepra të zgjedhura, Prishtinë, 2017.

Albanica 18/I – Gaetano Petrotta, Popolo, lingua e letteratura albanese, a cura di M. Mandalà, A. C. Mirror, Palermo, 2003.

Brown, Keith (ed.), *Encyclopedia of Language and Linguistics*, 2nd ed., Oxford: Elsevier, 2005.

Altimari, Francesco, Vëzhgime gjuhësore dhe letare arbëreshe, Shtëpia Botuese Konica, Prishtinë, 2002.

Banfi, Emanuele (1992), *La linguistica balcanica in Italia: origini, evoluzione e linee teoriche*, në *Linguistica*, *32*(2), 65-73. https://doi.org/10.4312/linguistica.32.2.65-73.

Gheno, Danilo, *Giovan Battista Pellegrini e l'Ungheria*, RSU. *Rivista di studi ungheresi*, VII, Sezione di linguistica 2008, p. 101-109.

Osmani, Tomor, *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor* 2, Shkodër, 2007, Shtëpia botuese "Camaj-Pipa".

Pellegrini, Giovan, Battista *Carlo Tagliavini* (Commemorazione tenuta il 19 febbraio 1983). Padova, Società cooperativa tipografica, 1984.

Pizzolato, Tommy; D'Amico, Tiziana; Rizzi, Daniela, *I Paesi dell'Europa orientale e sudorientale Storia degli insegnamenti linguistico-culturali a Ca' Foscari* in *Le lingue occidentali nei 150 anni di storia di Ca' Foscari*. (a cura di Anna Cardinaletti, Laura Cerasi e Patrizio Rigobon), Venezia Edizioni Ca' Foscari - Digital Publishing 2018, f. 225-260.

Prifti, Elton, *Carlo Tagliavini dhe albanologjia*, ANASH, organ i Isntitutit Alb-Shkenca, nr. 2, 2006, f. 35-38, ANASH_02_2006_pdf.

Prifti, E., *Giovan Biattista Pellegrini (23 shkurt 1921–3 shkurt 2007)*, në *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2007, f. 169-174.

Priku, Mimoza, *Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2011.

Tagliavini, C., *La lingua Albanese*, në *Studi albanesi*, V-VI, 1935-1936, f. 5-33.

Tagliavini, C., *Gli elementi latini in albanese*, në *Cultura Neolatina*, I, 1941, f. 90-93.

Tagliavini, C., *Ugo Pellis e l' Atlante linguistico albanese*, në *Ce fastu?*, nr. 4-5, XIX, Boletino della Società filologica friuliana, 1943, f. 174-175.

Tagliavini, C., *La stratificazzione del lessico albanese. Elementi inoeuropei*, Pàtron, Bologna, 1965.

Tagliavini, C., *Paralleli ungheresi a evoluzioni semantiche e a frasi idiomatiche ritenute caratteristiche delle lingue balcaniche*, në *Miscellanea di studi dedikati a Emerico Várady*, Modena, 1966, f. 219-227. Ribotuar postum edhe në *Scritti minori*, f. 683-694.

Tagliavini, Carlo, *Scritti minori*, Bologna: Patron, 1982.

Tagliavini, Carlo, *Le origini delle lingue neolatine*, Pàtron editore, Bologna, 1982, f.189

Zamboni, Alberto, *Ricordo di Giovan Battista Pellegrini*, L'Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti, Venezia, 2008.

---

këtë fushë vazhdoi traditën e lavdishme të Padovës, filluar nga mësuesi i tij, Calo Tagliavini", *Qasje historisë së dialektologjisë arbëreshe* në *Vëzhgime gjuhësore dhe letare arbëreshe*, Konica, Prishtinë, 2002, f. 115.

Nicola SCALDAFERRI, Università di Milano

ARKIVAT TINGULLORË NË ITALI DHE MATERIALET MBI FSHATRAT ARBËRESHE: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Abstract. L'intervento intende soffermarsi sui materiali provenienti dai paesi arbëreshë presenti negli archivi sonori in Italia, a iniziare dai due principali archivi che a lungo hanno costituito un passaggio imprescindibile per la conoscenza dei fenomeni musicali tradizionali del territorio italiano. Il primo è rappresentato dagli Archivi dell' Accademia Nazionale di Santa Cecilia (Roma), dove sono conservate la raccolta 20 di Ottavio Tiby a Piana degli Albanesi in Sicilia, e la raccolta 24 realizzata da Diego Carpitella ed Ernesto De Martino sulle comunità calabresi e lucane.
Il secondo è la Discoteca di Stato (Roma), dove vi sono i materiali della raccolta 35 LM, relativa agli anni 1967-1969, rilevati in numerosi centri su iniziativa dell'Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma la Sapienza, diretto all'epoca da Ernest Koliqi.
A questi due importanti archivi sono da aggiungere altre realtà che negli ultimi anni, grazie anche a specifici progetti che ne hanno consentito il recupero, sono stati resi accessibili all'attenzione degli studiosi, dal Fondo di Giuseppe Gangale ai materiali raccolti nel Fondo Roberto Leydi. Vi sono poi archivi di singoli ricercatori che testimoniano percorsi di ricerca individuali (come quello di papas Antonio Bellusci, o quello mio personale) e progetti di valorizzazione, come quello ospitato in www.archiviosonoro.org, che punta a realizzare una vetrina online capace di restituire i materiali ad una larga platea di fruitori.
Tutte queste realtà costituiscono un enorme patrimonio di notevole interesse, che sta portando a un significativo arricchimento delle conoscenze, nel quadro di una nuova consapevolezza dell'importanza ricoperta dai documenti sonori; questo non solo per lo studio delle specifiche pratiche musicali, ma per la comprensione della realtà linguistico-culturale arbëreshe nel suo insieme.

Etnomuzikologjia, qysh nga origjina e vet ishte një disiplinë e lidhur ngushtë me zhvillimin e teknologjive të regjistrimit të tingullit. Nëse duhet të zgjedhim një datë konvencionale për lindjen e kësaj disipline, kjo do të ishte ajo e vitit 1877, kur Thomas Edison patenton fonografin, aparat i cili mundëson regjistrimin e tingullit për herë të parë. Regjistrimi fikson një të dhënë tingullore, duke e izoluar nga konteksti dhe duke krijuar një objekt i cili mund të ridëgjohet, analizohet, transkiptohet dhe mbi të cilin mund të kemi një reflektim kritik. Me pak fjalë, ky proces është jashtëzakonisht i rëndësishëm për dokumentimin dhe studimin e muzikave që nuk mund të fiksohen nëpërmjet shkrimit, apo teknikave të tjera të ngjashme. Regjistrimet mund të konsiderohen edhe si prodhimet e fundit dhe më thelbësore të një etnomuzikologu. Teorive, analizave dhe

interpretimeve mund t'iu kalojë koha, kurse ngjarjet e regjistruara mund të ruhen, duke dokumentuar qoftë ekzistencën e realiteteve të caktuara tingullore që transformohen me kohë (ose shpesh zhduken krejtësisht), qoftë atë *modus operandi* që studiuesi ka përdorur.

Krijimi i arkivave, si vende për ruajtjen e njësive fizike dhe dokumenteve tingullore që i përmbajnë ato, përbën një moment thelbësor në studimin e materialeve të traditave orale, qoftë në nivel linguistik, ashtu edhe muzikor. Pikërisht, lindja e arkivave i dha mundësinë kësaj disipline që të përpunonte metodologjitë e përshtatshme për studimin e materialeve tingullore, duke vënë në punë teknika studimi të ndryshme dhe të pavarura krahasuar me ato të kërkimit në terren. Kjo duke filluar nga krijimi i Phonogramm-Archiv i Berlinit, në fillim të 1900-ës, arkiv që ruante rulat e fonografit, falë të cilave filloi të përvijohej dallimi mes momentit të kërkimit në terren dhe të ashtuquajturit studim "në tavolinë" i materialeve të regjistruara.

Në Itali, situata e kërkimit në terren dhe krijimi i arkivave tingullore, sidomos në nivelin institucional, u zhvillua me pak vonesë, krahasuar me vende të tjera të Europës. Më 1928, krijohet qendra kryesore italiane, *Discoteca di Stato* (Diskoteka e Shtetit), që në 2007 do t'i ndryshohet emri në *Istituto centrale per i beni sonori ed audiovisivi* (Instituti qendror për trashëgiminë tingullore dhe audiovizuale) (http://www.icbsa.it). Krijimi i këtij institucioni lidhet me koleksionin e muzikantit Rodolfo del Angelis, i cili kishte si qëllim të ruante në njësi fonografike zërat e personazheve të rëndësishëm. Gjithsesi, rolin më të rëndësishëm e luajti Gavino Gabriel, i cili bëri të mundur, qysh në vitet '30, që të përcaktoheshin qëllimet e qendrës, duke promovuar mbledhjen e këngëve dhe dialekteve të gjithë rajoneve të Italisë. Sidoqoftë, jemi akoma larg modeleve të mbledhjes në terren, gjë që do të fillojë më vonë, në kohën kur në Itali do të aplikohen metodologji më të përshtatshme për këtë nivel kërkimi.

Prania e materialeve që vijnë nga fshatrat arbëreshe në arkivin e Diskotekës së Shtetit daton në vitet '60 dhe lidhet me kërkime ku mbizotëron aspekti linguistik. Kemi parasysh mbledhjen n. 35 LM, në periudhën 1967-1969, e organizuar nga *l'Istituto di Studi Albanesi* (Instituti i Studimeve Shqiptare), në Universitetin e Romës dhe e drejtuar në atë kohë nga Ernest Koliqi. Për këtë kanë punuar e bashkëpunuar studiues të rëndësishëm ndër të cilët: Martin Camaj, Giuseppe Gradilone, Vincenzo Malaj, Elio Miracco, Alfio Moccia.

Duke parë vendet dhe datat, bëhet fjalë për një hulumtim me rreze të gjerë që preku thuajse të gjitha fshatrat arbëreshe, të shpërndara në rajone të ndryshme të Italisë jugore, me regjistrime të vetëm disa dokumenteve me interes në nivelin

gjuhësor. Në vijim, po paraqesim në rend alfabetik qendrat, qoftë bashki, qoftë komuna, që janë shkelur nga studiuesit gjatë këtij 3 vjeçari:

1967

Acquaformosa 24/08; Barile 27/08; Castroregio 4/12; Cavallerizzo 2/09; Cerzeto 30/08; Civita10/09; Eianina 17/08; Falconara Albanese 7/09 - 10/09; Farneta 4/12; Firmo 21/08; Frascineto 20/08; Ginestra 28/08; Greci 14/08; Lungro 21/08; Macchia Albanese 6/09; Marri 5/09; Maschito 27/08; Mongrassano 1/12; Plataci 4/12; S. Basile 25/08; S. Benedetto Ullano 3/09; S. Caterina Albanese 27/08; S. Costantino Albanese 25/08; S. Demetrio Corone 29/98; S. Giacomo di Cerzeto 29/08, S. Giorgio Albanese 7/10; S. Martino di Finita 28/08; S. Paolo Albanese 25/08; S. Sofia d'Epiro 27/08; Spezzano Albanese 4/12; Vaccarizzo Albanese 6/10.

1968

Pallagorio 9/08; S. Nicola dell'Alto 5/08; Carfizzi 7/08; Mercedusa 11/08; Andali 11/08; Zangarona 16/08; Caraffa 17/08; Vena di Maida 18/08; Gizzeria 20/08; S. Marzano di S. Giuseppe 25/08.

1969

Mezzojuso 15/03; S. Cristina Gela 18/03; Palazzo Adriano 23/03; Contessa Entellina 20/03 e 27/03; Piana degli Albanesi 16/03, 30/03; Ururi 17/08 e 18/08; Chieuti 19/08; Portocannone 20/08; Casalvecchio di Puglia 21/08, 22/08; Campomarino 25/08; Montecilfone 25/08; S. Sofia d'Epiro 13/09; S. Demetrio Corone 18/09; Macchia (Spezzano Piccolo) 18/9; S. Cosmo Albanese 19/09; San Giorgio Albanese 20/09; Vaccarizzo Albanese 21/09.

Në vitin 1948, krijohet në Romë, me nxitjen e Giorgio Nataletti-t, *Centro Nazionale Studi di Musica Popolare (CNSMP)*, Qendra Kombëtare e Studimit të Muzikës Popullore, si pjesë e Akademisë Kombëtare *Santa Cecilia* (Accademia Nazionale di Santa Cecilia), http://www.santacecilia.it. Më tej, kjo do të ndryshonte emërtim në Arkivat e Etnomuzikologjisë.

Si e tillë, ka pasur një rol thelbësor për përcaktimin e metodove dhe objektivave të etnomuzikologjisë italiane, duke sjellë ngahera një cilësi të lartë të regjistrimeve tingullore, kjo falë edhe bashkëpunimit me RAI-Radiotelevizione Italiana që ofronte strukturat teknike të nevojshme për atë kohë për të bërë regjistrime tingullore.

Edhe me arbëreshët janë zhvilluar ekspedita të rëndësishme të CNSMP-së. Ato janë bërë nga kërkuesit më të njohur italianë të atyre viteve: Ernesto De Martino e Diego Carpitella, në kuadër të një interesi të përgjithshëm që kishte në atë periudhë kundrejt formave të ndryshme të muzikës tradicionale, interes që do të çonte në lindjen e një etnomuzikologjie shkencore në Itali.

Kërkimet janë bërë nga Ottavio Tiby në 1952-1953 (Përmbledhja n. 20 në CNSMP) kushtuar traditës liturgjike të Piana degli Albanesi; ato të Diego Carpitella-s dhe Ernesto De Martino-s në prill të 1954-ës (Përmbledhja n. 22 në CNSMP) e lidhur me vende si Castroregio, Frascineto, Lungro, Macchia, S.

Demetrio Corone, Carfizzi, Pallagorio, S. Nicola dall' Alto në Calabria dhe San Costantino Albanese në Basilicata; ajo e Diego Carpitella-s e Alberto Mario Cirese-s në maj të 1954-ës (Përmbledhja n. 23 në CNSMP) në Ururi e Portocannone në Molise. Ndonëse kanë qenë rezultat i qendrimeve të shkurtra, nga këto ekspedita del në pah një panoramë e rëndësishme e praktikave muzikore. Regjistrimet që përmban përmbledhja n. 22 janë bërë, për shembull, brenda një javë, duke vizituar në total nëntë qendra, pra duke vepruar në mënyrë relativisht të shpejtë. Gjithsesi, regjistrime të tilla kanë një rëndësi thelbësore pasi datojnë në një periudhë kur praktika e këngëve tradicionale ka qenë shumë e gjallë. Megjithëse në atë kohë, ato nuk shoqëroheshin nga një vëmendje e specializuar në nivelin gjuhësor, regjistrimet në fjalë kanë mundësuar që ky lloj thellimi në planin gjuhësor të bëhet në një moment të dytë. Nga materialet e përmbledhjes no. 22 e kanë prejardhjen edhe regjistrimet mbi "shqiptarët e Calabria-s", të përfshira nga Alan Lomax në antologjinë e tij të famshme, me dy disqe LP kushtuar Italisë dhe publikuar në 1957 në bashkëpunim me Diego Carpitella-n.

Kujtojmë ndërkaq se Carpitella më vonë do të lidhej edhe me Institutin e Kulturës Popullore të atëhershëm, në Tiranë, bashkëpunim që solli realizimin e dy disqeve LP me materiale shqiptare, botuar në kolanën *I Suoni* (*Tingujt).*

Në Diskotekën e Shtetit dhe në Arkivin e Etnomuzikologjisë, të cilët janë dy arkivat kryesorë publikë, duhen shtuar edhe aktivitete të tjera të cilat kanë të bëjnë me inisiativa private nga kërkues e studiues të ndryshëm, të cilët lidhen me etapa të rëndësishme të kërkimeve të tyre individuale. Të tilla janë ai i papas Francesco Solano, ajo e papas Antonio Be-llusci, si dhe kërkimi im personal. Po aq i rëndësishëm është edhe Arkivi Tingullor i Fondit të Giuseppe T. Gangale-s, me dokumente tingullore të lidhura me zonën krotoneze dhe që tanimë është pjesë e një rimarrjeje në vëmendje pranë Universitetit të Calabria-s. Duhen përmendur gjithashtu materialet e përmbledhura në Fondin Roberto Leydi në Qendrën e Etnografisë dhe Dialektologjisë të Bellinzona-n, si dhe projekte vlerësimi që gjenden në www.archiviosonoro.org. Ky i fundit synon të realizojë një vitrinë online, për t'ua rikthyer këto materiale një auditori më të gjerë e më të shumtë në numër.

Sidoqoftë, mungon në gjithë këtë, një publikim në Internet, i cili t'i mund t'i bëjë të dëgjueshëm e të shikueshëm plotësisht të gjitha këto dokumente, ashtu si mungojnë lidhjet me qendra të tjera të huaja, duke filluar nga Arkivi i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në Tiranë, trashëgimtar i arkivit të Institutit të Kulturës Popullore, arkiv që sot ruan material të rëndësishëm

në lidhje me arbëreshët. Të gjitha këto realitete përbëjnë sidoqoftë një trashëgimi me vlera të çmuara, e cila është duke sjellë një pasurim të njohurive në kuadër të një ndërgjegjësimi të ri sa i takon rizbulimit të dokumenteve zanore. Kjo jo vetëm në nivel studimi të praktikave muzikore e gjuhësore specifike, por për të kuptuar realitetin kulturor arbëresh në tërësinë e vet.

Apendiks

Transkiptimi i teksteve të këngëve të CNSMP, Përmbledhja n. 22, regjistruar në S. Costantino Albanese më 23 prill 1954; regjistrim i Diego Carpitella-s dhe Ernesto De Martino-s. Sa i takon aspekteve muzikore, si dhe për të gjitha informacionet e tjera, shih: Scaldaferri 1994.

1. Ninulla
Nina nina biri im
kush t'i lan ato skutina
e t'i lan mëma ime
ti ka mëma nëk m'i dishe
ti ka mëma nëk m'i dishe
dishnje lar ba bukurusha
valle valle trekusalle
leu Krishti ndër Natalle
2. Këngë vaji
Oj mëma ime
ma ku të nistin e të qelltin sëmenat mëma ime o
ma çë kuraxh si km t' e bënj mëma ime
se mua më le vetem e s'kam njiri mëma ime o
E oj mëma ime
ma çë kuraxh bëre sëmenat t'dilnje ka shpia mëma ime o
ma ni ku kam të vete t'garramisem mëma ime o
se u s'kam njiri e kush m'rri rro rro mëma iime o
E oj mëma ime
ma çë kuraxh si kam t'ë bënj u për tikj mëma ime o
Ma ni-ë ike e së je ti më
e ku të m'marr malli im mëma ime o
ma ku i shtie sitë e të t'sho mëma ime o
ma ti ni sule e eja mos t'e t'vunxhonj pasjuna mëma ime o

3. Këngë dasme
Mirr uraten e sa'tëm
Puthi doren e t'it et

4. Këngë dasme
Hami buk e Skënderbek
çil ish të ngrënthit e tij
mish kaponj e lepurar
ju falima ju bular

5. Këngë dasme
Oj se ti mëm e mëma ime
çë kleva fëtesurith
e m'ndajte ka gjiri it
gjiri it e vatres sate

6. Vallja (valle e kënduar)
Oj oj mindullëz
si je ti t'kisha njëz
prajna do t'shkonja gaz
jo të shkonj jeten e zez
biu biu një narenx
mos u bij n'der t'ime
biu n'der bukurëz
si je ti t'kisha njëz

6. Vallja (valle e kënduar)
Korroxhina me shndet
kam u klën e s'kam u klën
kam u klën këtu dreq
sonde cë m'erdha vet
korroxhina me shndet
dot e thom se më i nget
im vllau dhëndrith
ime moter nusies

8. Këngë satirike
Rrukullisu si kupani
ec e eja nani nani
ec e eja via via
ec e bier ndër këmbt e mia
rrukullisu si narënxa
ec e bier ndër këmbt e mëms

9. Këngë satirike
E litmunore çë t'u dogj vandera
e zjarmi t'arrivoj njera te dera

s't'e shuajti shiu e nemenu bora
ti le finestren hapt e u erdh e hira
pirpara shtrati erdha e t'u vura
të ngava mollet e i kishe si bora
më ndotukeq e faregjë të bëra

10 Këngë karnevalesh
Zëmi na një pertikat
skëmandili ësht i glat
ësht i glat la bonazina
vemi ndër ato kandina
vem e bëmi shushavina

11. Këngë historike
Oj e bukura More
si të le u më ndëk t'pe
atje kam u zotin tat
atje kam u zonjen mëm
atje kam dhe t'ëm vlla

12. Serenatë me gajde (karramunxa)
E bonasera ju çë in e flëni
ni kini paqë ju ndë nëk na doni

Referencat

Biagiola Sandro (përg.) 1986. *Etnomusica.Catalogo della musica di tradizione orale nelle registrazioni dell'Archivio Etnico Linguistico-Musicale della Discoteca di Stato*. Roma: Discoteca di Stato.

Ferretti Rossana 1993. *Indice delle raccolte degli Archivi di Etnomusicologia*. EM. I: 157-190.

Garofalo Girolamo (përg.) 2002. *Musica e paraliturgia degli Albanesi di Sicilia* (Atti della giornata di studi a Mezzojuso, 28 Aprile 2002), Mezzojuso: Cooperativa Alessandro Scarlatti.

2006. *I canti bizantini degli arbëreshë di Sicilia. Le registrazioni di Ottavio Tiby (Piana degli Albanesi 1952-53) e l'odierna tradizione,* EM. II, 2: 11-65.

Gangale Giuseppe (përg.) 2005. *Voci e canti degli albanesi della Calabria Media (provincia di Crotone)*. Catalogazione a cura di G. Belluscio. Provincia di Crotone-Università della Calabria. 3 CD.

Lomax Alan and Diego Carpitella (përg.) 1957. *Northern and Central Italy and the Albanians of Calabria*, LP Columbia KL 5173. LP.

Ricci Antonello e Tucci Roberta (përg.) 2006. *Musica arbëreshe in Calabria. Le registrazioni di Diego Carpitella ed Ernesto de Martino (1954).* Roma: Squilibri. Con 2 CD.

Sassu Pietro 2013. *Dall'etnofonia all'etnomusicologia. Un secolo di studi sulla musica popolare italiana*. Archivio di Etnografia, 1-2/2011: 37-68.

Scaldaferri Nicola 1994. *Musica arbëreshe in Basilicata*. Lecce: Adriatica Editrice Salentina. Con audiocassetta.

Merita HYSA, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

KONTAKTET GJUHËSORE DHE SHFAQJET IDENTITARE NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE NË ITALI

Abstrakt. Studimet albanologjike në Itali përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme të studimeve shqiptare. Përmes identifikimit të veçorive kulturore, gjuhësore e letrare të arbërishtes, është hedhur dritë mbi ekzistencën e një bashkësie që diti ta ruajë identitetin e saj ndër shekuj.
Konturimi i qartë i identiteteve sociale përmes gjuhës dhe kulturës, përbën terrenin ideal për vëzhgimin e transformimeve sipërfaqësore ose të thella, të cilave iu është nënshtruar bashkësia arbëreshe.
Si rrjedhojë e faktorëve historikë e socialë, si dhe kontakteve të vazhdueshme gjuhësore e kulturore, në këto bashkësi vërejmë situatat tipike të gjuhëve në kontakt, si rrjedhojë përzierja e kodeve (code-mixing) shfaqet si një dukuri tejet e natyrshme.
Në këtë punim do të përpiqemi të bëjmë një parashtrim të përgjithshëm të veçorive gjuhësore të varieteteve arbëreshe, të paraqitura nga disa albanologë, pikërisht në dritën e kontakteve gjuhësore dhe reflekseve të tyre në nënsistemet e ndryshme gjuhësore.

Komunikimi ndërkulturor mes bashkësive gjuhësore që shtrihen brenda së njëjtës hapësirë gjeopolitike shërben si një formë ndërvepruese edhe për qasjet gjuhësore. Këto të fundit binarizohen në një dikotomi socio/kulturore nga njëra anë dhe identitare nga ana tjetër.

Konfigurimet gjuhësore që shfaqen në situatat e dy- dhe shumëgjuhësisë mund të vështrohen në aspekte të ndryshme:

Së pari, në bashkësitë multikulturore, çështja e identitetit kolektiv të një pakice gjuhësore përbën një nyje të rëndësishme të qasjeve sociolinguistike.

Së dyti, në vëzhgimin e identiteteve të veçanta, qoftë në përmasën e idiolekteve, qoftë edhe në atë të integrimit të tyre, si brenda grupit, ashtu edhe brenda bashkësisë shoqërore.

Identiteti i individëve përbëhet nga një tërësi karakteristikash që fiksojnë përkatësinë e tyre në një grup social[1]. Të tillë faktorë mund të jenë si të natyrës individuale (niveli i përftimit gjuhësor i të dy kodeve gjuhësore, aftësia ligjërimore, sjellja ndaj secilit kod etj, karakteristika të një folësi biling të pranishme në të njëjtin nivel, por me pasqyrime të ndryshme), ashtu të rendit social (dimensioni i grupit biling dhe homogjeniteti ose diversiteti i tij socio-kulturor kundrejt kulturës së komunitetit tjetër gjuhësor, toleranca apo purizmi në përdorimin gjuhësor etj.

[1] L. Savoia, *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë, 2015, f.280.

Studimet pohojnë se për të përcaktuar dukuritë e interferencës duhet të bëhet një qasje ndërdisiplinore (gjuhësore, psikolinguistike dhe sociolinguistike) dhe jo thjesht një analizë kontrastive a priori e karakteristikave strukturore e të dy sistemeve që janë në ndërlidhje. Kontakti ndërgjuhësor përfaqëson në thelb një kontakt kulturash.

Po cili është roli i gjuhës në konturimin e identiteteve sociale të grupeve shoqërore dhe individëve? Qasja nuk është edhe aq e thjeshtë sa duket, pasi raportet mes gjuhës së parë (L1), e cila parimisht duhet të përbëjë elementin bazë të përcaktimit të grupeve shoqërore dhe gjuhës së dytë (L2), që përcakton identitetin dhe impaktin social të këtyre grupeve në një shoqëri, variojnë nga rrethanat e jashtme, si: shkalla e përdorimit të L1 si kod i konsoliduar në familje dhe më gjerë, impakti me një bashkësi një ose shumëgjuhëshe, integrimi i plotë ose i pjeshëm i individëve etj. Në raste të tilla, gjuha shërben mirëfilli si mjet identiteti, por edhe si instrument veprimi social, si rrjedhojë vërehen edhe flukset e dukshme dhe të padukshme të integrimit gjuhësor në të gjitha rrafshet (fonetik, leksikor e gramatikor).

Përmasat identitare të gjuhës, shërbejnë si mjet lidhës për bashkësitë e vogla, gjë që dëshmohet më së miri në konservacionin shekullor të shqipes në hapësirën sociokulturore dhe gjuhësore italiane. Si rrjedhojë e faktorëve historikë e socialë, si dhe kontakteve të vazhdueshme gjuhësore e kulturore, në këto bashkësi vërejmë situatat tipike të gjuhëve në kontakt, si rrjedhojë përzierja e kodeve (code-mixing) shfaqet si një dukuri tejet e natyrshme.

Studimet albanologjike në Itali gjatë shkekullit të fundit, por jo vetëm, janë ndalur kryesisht në dy aspekte: *së pari*, në një vështrim të gjerë diakronik, i cili hedh dritë mbi evolucionin dhe karakteristikat origjinare të të folmeve arbëreshe ndër shekuj. Në këtë këndvështrim, situata e ndikimeve gjuhësore shoqërohet edhe me shtresëzimet kohore, të cilave iu është nënshtruar bashkësia shqiptare në Itali. Sipas F. Altimarit, shqyrtimi shterues i këtyre huazimeve paraqitet problematik, sepse është e vështirë të gjenden të dhëna diakronike dhe sinkronike të krahasueshme mbi mënyrat e ndryshme të përshtatjes së huazimeve nga italishtja dhe të folmet romane përreth viseve arbëreshe të Italisë së Jugut. Në fakt këto të fundit gjenden të shpërndara mes të folmesh romane johomogjene dhe tejet të fragmentarizuara.[2]

Së dyti, një vështrim me karakter të theksuar përshkrues, i cili sheh në

[2] F. Altimari, *Mbi huazimet nga italishtja dhe nga dialektet italo-romane në sistemin foljor të arbërishtes, në Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Prishtinë, 2014, f,170.

pikëpamje sinkronike gjendjen e këtyre të folmeve sot, përmes analizave të hollësishme që prekin të gjitha rrafshet, jo vetëm ato brendagjuhësore, por edhe vëzhgimet me karakter empirik sidomos në qasje pragmatike.

Kundrimet e hollësishme që u janë bërë të folmeve të veçanta arbëreshe (që nga Skiroi, La Piana, studimet sistematike të Guxetës, Banfit, Pisanit, Bonfantes, Camajt, Altimarit, Mandalàsë, Shkurtajt etj,) kanë hedhur dritë mbi një sërë veçorish që karakterizojnë këto të folme. Ajo që duam të theksojmë ka të bëjë pikërisht me faktin se tiparet gjuhësore nuk janë parë vetëm së brendshmi (sinkronikisht, apo diakronikisht), por edhe në përmasën e kontakteve gjuhësore shekullore, të cilat domosdo kanë lënë gjurmë në të gjitha rrafshet gjuhësore.

Metoda e studimit të dialekteve italo-shqiptare ka qenë një kapitull me vete ndër studimet albanologjike. Siç shprehet Camaj: "*U përjashtua a priori metoda krahasuese, ose diakronike tradicionale, duke parë se qëllimi ishte të përftonim përshkrime sinkronike të të folmeve të veçanta, nga të cilat do të nxirrnim ravijëzimet e strukturave të qarta dhe specifike gjuhësore*[3]".

Reflekset e drejtpërdrejta të kontakteve gjuhësore dhe kulturore shfaqen natyrshëm në të gjitha nënsistemet gjuhësore. Prania e dukurive të ngjashme apo të veçanta gjuhësore, në të gjitha të folmet arbëreshe, lidhet pa dyshim me impaktin sociokulturor që kanë pasur bashkësitë e vogla me dialektet romane nga njëra anë dhe italishten standard në anën tjetër, duke dëshmuar forma të larmishme diglotike. Prestigji kulturor i varietetit zotërues në këtë rast, ka markuar shfaqjen e elementeve hibride në këto të folme.

Domenet e ndryshme si shkolla, familja, peer-group, vendi i punës, si dhe situatat tipike në të cilat realizohen ngjarjet gjuhësore, së bashku me faktorë më të imët të rendit psikologjik, i lënë vendin një ndërkëmbimi mes gjuhëve ose varieteteve me status social dhe identitar të ndryshëm.

Është e vështirë, por jo e pamundur të shkëpusësh një gjuhë nga "*matrixi*" i saj kulturor. Parë në këtë këndvështrim, në situatën e kontaktit gjuhësor të këtyre kodeve, ne mund të veçojmë tipin e bilinguizmit social (ose kolektiv), pra atëherë kur një grup i tërë shoqëror (qoftë familje apo bashkësi) përdor dy kode gjuhësore në mënyrë të ndërsjellë[4], si dhe formave të ndryshme të diglosisë.

Në një kontekst të tillë, në mund të veçojmë dy dukuri simbiotike që janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, nga njëra anë huazimi dhe nga ana tjetër, në interlokutorë dhe situata komplekse komunikimi, vërejmë format e veçanta të

---

[3] M.Camaj, *La parlata Albanese di Grieci*, Leo S.Olschki Editore, Firenze, 1971, f.3.

[4] R.Titone, *Some Factors Underlying Second Language Learning*, ELT Journal, Volume XXVII, Issue 2, 1973, f. 110–120

hibridizimit gjuhësor, i cili materializohet në të gjitha nënsistemet gjuhësore, megjithëse në përmasa të ndryshme.

Ndërkëmbimet gjuhësore në këto kontekste prekin si grupet shoqërore (familjen, bashkësinë), ashtu edhe individët e veçantë, duke u shfaqur aktive në situata të ndryshme ligjërimore.

Sipas studiuesit F. Altimari, në komunitetet arbëreshe kanë ndërvepruar historikisht disa sisteme gjuhësore (arbërishtja, dialektet romane, italishtja letrare, greqishtja liturgjike), të cilat në periudha të ndryshme historiko-kulturore kanë mbajtur një peshë të ndryshme sociolinguistike, duke përcaktuar kësisoj krijimin e një sistemi të ndërlikuar huazimesh[5], si dhe me krijimin e formave hibride që cekin situatën e përzierjes së kodeve (code-mixing).[6]

Kur bëhet fjalë për kontakte gjuhësore, natyrshëm mund të pohohet se së pari ndikimet prekin rrafshin leksikor. Në fakt, studimet pohojnë që gjithçka mund të huazohet: elementet fonologike, kuptimet, rendi i fjalëve, ndajshtesat fjalëformuese dhe ato trajtëformuese. Megjithatë duhet ta pranojmë se njësitë leksikore janë ato që janë më të prirura drejt ndryshimeve, përkundrejt realiteteve fonike, apo ndërtimeve të brendshme gramatikore.

Studiuesi L. Savoia[7] pohon se këto forma "*gjuhësh të përziera*", të cilat përdoren në gjendje dygjuhësie e që karakterizohen nga një leksik i përzier dhe nga një morfosintaksë e veçantë, dallohen si nga ajo e gjuhës së origjinës, ashtu edhe nga gjuha e kontaktit të folësve.

Studiuesit ridimensionojnë pozicionin e të ashtuquajturit leksik kulturor, përkundrejt atij bazë. Elementet e huazuar që synojnë të mbushin një hendek leksikor në gjuhën marrëse, cilësohen si huazime kulturore. Ato shpesh ndërfuten së bashku me sendet apo dukuritë që emërtojnë, ndërsa elementet e huazuara që korrespondojnë afërsisht me elementet tashmë ekzistuese në gjuhën marrëse quhen huazime thelbësore.

Huazimet bazë shpesh fillojnë jetën e tyre si elemente të huaja në situatën e ndërrimit të kodeve, por gradualisht bëhen pjesë e gjuhës marrëse. Huazimet kulturore janë më të zakonshme se huazimet thelbësore.

Në qoftëse vërejmë natyrën e huazimeve gjuhësore[8], do të shohim se klasa e fjalëve të mëvetësishme (veçojmë këtu emrat, mbiemrat, ndajfoljet etj)

---

[5] F. Altimari, *Mbi huazimet nga italishtja dhe nga dialektet italo-romane në sistemin foljor të arbërishtes, në Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Prishtinë, 2014, f. 171.

[6] B. Baldi, L. Savoia, *Cultura e identità nella lingua Albanese*, Lingue e letterature d'Oriente e d'Occidente, n. 6, 2017, f. 53.

[7] L.Savoia, *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë 2015, f.280.

[8] Veçojmë këtu hulumtimet gjuhësore të bëra nga Camaj, Altimari, Savoia, Shkurtaj, Belluscio etj.

huazohen më lehtë se fjalët e pamëvetësishme (të cilësuara si klasa të mbyllura). Ky tipar përligjet me faktin që këta funktorë kryejnë funksione gramatikore dhe përbëjnë një inventar të mbyllur.

Kështu, Savoia pohon se: "*Leksiku bazë që shenjon objekte natyrale dhe module të tjera bazike (farefisni, ndarjen e kohës, numrat etj) është ai që përfshin numrin më të vogël të huazimeve. Në të kundërt, bashkësia e emrave që lidhen me artefaktet është veçanërisht e pasur me format hibride, pra me baza leksikore të gatshme për eptimin arbëresh ose roman në varësi të kontekstit*"[9].

Të folmet arbëreshe na shfaqen si një korpus sociolinguistik me interes të veçantë. Ndërthurja e natyrshme dhe shpesh e njëkohëshme e dukurive gjuhësore të huazimit, apo hibridizimit të trajtave leksiko/gramatikore, na përball qartazi me dukurinë e ndërrimit dhe përzierjes së kodeve, (code switching dhe code mixing). Prania e këtyre dukurive vërehet në trajtat ligjërimore, si në formën e ndërkëmbimeve gjuhësore, që kombinojnë elemente të italishtes regjionale dhe të dialekteve lokale romane, ashtu edhe në kalimin funksional nga dialekti arbëresh në italishten regjionale, duke inkorporuar një ose më shumë elementeve nga dialektet romane, në varësi të situatës së përdorimit. Në këtë mënyrë përftohen modele gjuhësore të përziera, si në format fonoleksikore, ashtu edhe në strukturat morfosintaksore.

Rindërtimi i bërthamave semantike dhe prania e formanteve të përziera gramatikore që i veshin ato, janë një element i veçantë i studimit të të folmeve arbëreshe që i ndeshim në vëzhgimet e Altimarit, Savoia-s, Turrano, Baldi-it, Camajt, Gambarara etj. Përshkrimi i dukurive me karakter kompleks gjuhësor është një veçori e këtyre studimeve, që ngërthejnë specifikimin e tipareve të veçanta të njësive dhe lidhjen e pandashme të tyre gjatë realizimit të formave identitare dhe të huazuara në varietetet e arbërishtes.

Tipat e variacionit gjuhësor që shfaqen në situatën e shumëgjuhësisë zbulojnë hap pas hapi mekanizmat e përzierjes së kodeve. Kështu, përdoruesit (në rastin tonë përdoruesit e arbërishtes në kontakt) mund të kalojnë nga njëri kod në tjetrin, duke prodhuar njësi gjuhësore në forma të përziera. Themi njësi gjuhësore, sepse të tilla ndërkëmbime prekin të gjitha njësitë e gjuhës, duke filluar nga sistemi tingullor dhe prozodia, e duke përfunduar tek ndërtimi i thënieve, procese këto që shfaqen natyrshëm te folësit bilingë.

Procesi i riorganizimit në nivele të ndryshme gjuhësore gjatë përzierjes së kodeve, ka një shtrirje të gjerë kohore dhe sociale. Kur flasim për ndikime

[9] L.Savoia, *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë 2015, f.280.

gjuhësore në të folmet arbëreshe, gjatë kohështrirjes së tyre ndër shekuj, studiuesit pohojnë që fillimisht ato vërehen në nivel leksikor dhe më ngadalë në nivel fonetik dhe gramatikor. Kjo sepse përmbajtja semantike huazohet më lehtë sesa forma fonetike.

Riorganizimi në kontekstet socio kulturore dhe mekanizmat e code mixing/ code switching përgjithësisht rregullohen nga faktorë psikologjikë, demografikë (mosha, gjinia etj), që lidhen me statusin dhe më në fund nga faktorë situacionalë, të regjistrave dhe, natyrisht, nga faktorë pragmatikë që dalin nga ndërtimi dhe nga interpretimi i kuptimit[10].

Identifikimi i tipareve arkaike të shqipes në të folmet arbëreshe, ka qenë një tjetër sfidë në studimet albanologjike në Itali. Analizat e hollësishme të të folmeve, duke nisur me sistemin fonetik dhe praninë e tingujve karakteristikë të shqipes, identifikimin e tipareve prozodike, riorganizimi i dukurive fonologjike, hedhin dritë mbi gjendjen e këtyre të folmeve gjatë kontaktit të gjatë me varietetet e italishtes.

Studimet mbi varietet arbëreshe paraqesin tipare të integruara në përftimin e njësive të reja leksikore, në kushtet e bilinguizmit aktiv. Sistemi tingullor mund të ndryshojë si rrjedhojë e huazimeve leksikore. Kjo ndodh zakonisht përmes huazimit të fjalëve që kanë në strukturën e tyre tinguj ose alofone të panjohura për varietetin arbëresh, ose mund të ndodhë edhe e kundërta, zotërimi i sistemit fonologjik bazë, të shërbejë si një susbstrat i sigurt për përvetësimin në pikëpamje nyjëtimore të të gjithë pasurisë fonemore të varieteteve me të cilat kanë qënë në kontakt të folmet arbëreshe. Në këto kontekste, kur cilësia e ndryshimit të segmenteve tingullore varion për shkak të ndikimit të substratit bazë, kjo më së shumti redukton numrin e tipareve dalluese në sistemin tingullor, gjë që ndikon në dallimet fonologjik mes njësive leksikore, si rrjedhojë preken edhe shqiptimi aktual, edhe sistemi themelor.

Specifikat e përdorimit të inventarit fonemor, variojnë në të folmet e arbërishtes dhe iu nënshtrohen shpesh herë skemave tonike dhe reduktimeve cilësore dhe sasiore, si në strukturat e brendshme të fjalëve, ashtu edhe në ato fundore. Një vëzhgim të tillë e gjejmë në studimin e J. Belluscio dhe Genesin:

> "*La riduzione/centralizzazione vocalica già rilevata per la lingua albanese standard e in numerosi studi dedicati alle parlate arbëreshe è l'esito delle strategie temporali proprie dell'albanese (lingua tendenzialmente ad isocronia accentuale) ma che nel caso di San Marzano si intreccia con la varietà romanza locale anch'essa a forte*

[10] B. Baldi, L. M. Savoia, *Perché barbari? Lingua, comunicazione e identità nella società globale*, Roma, 2006.

isocronia accentuale. Gli effetti prodotti da questo tipo di isocronia sono: '1. riduzione qualitativa/quantitativa in atonia con esiti [ə], accompagnata da soppressione di sillabe pretoniche, e 2. relativo aumento della velocità a discapito delle sillabe atone", për shembull: *ka vatur e bërë vizitë [ka̰ˈvatːɾ̥ ɛbːərˈviːst], kështu bëhen [kuʃtuˈbːətɛnɛ] etj.*[11]

Ndërkëmbimet në substrat, ndikojnë jo vetëm në sistemin tingullor, por edhe në rregullat e kombinimit të segmenteve në rrokje dhe në fjalë (rregullat fonotaktike), si psh.: shtimi i zanoreve epentetike në nyjat bashkëtingëllore, duke krijuar kështu njëfarë rregullimi të strukturës rrokjesore, me qëllim përshtatjen e formave paradigmatike.

Një tjetër aspekt i mekanzimave të hibridizimit në nivel fonologjik, është edhe prania e ndikimeve në tiparet mbisegmentore, si tonet, apo zhvendosja e skemave theksore, gjë që dëshmon qartazi për impaktin e dialekteve romane mbi format paradigmatike, duke u përshtatur me theksimin e natyrshëm paroksiton të italishtes.[12]

Statusi i formave hibride në përdorimet bilinge, lidhet në mënyrë simbiotike me procesin e ndërkëmbimit gjuhësor në situatën e përzierjes së kodeve. Pikërisht në këtë fazë mund të vërehen substratet e krijuara që prekin nivelin morfoleksikor, pra modele leksikore që integrojnë formante paradigmatike të kodit tjetër gjuhësor.

Modelet e përshtatjes morfologjike gjatë procesit të gjatë të kontakteve gjuhësore, janë të pranishme në të folmet arbëreshe në dy forma, si forma hibride dhe si huazime të plota. Situatat e përzierjes dhe ndërrimit të kodeve (code mixing dhe code switching) që vërejmë në të folmet arbëreshe lidhen si me gjedhet morfoleksikore, ashtu edhe me tipat e paradigmave eptimore. Sipas studiuesit Altimari, ky riorganizim leksikor dhe gramatikor që u detyrohet kontakteve ndërgjuhësore të arbërishtes në rrjedhë të shekujve, ka shkaktuar disa dukuri hibridizimi, sidomos në sistemin foljor, ku ndërthuren rrënjë morfologjike dhe ndajshtesa trajtëformuese me prejardhje të ndryshme gjuhësore. Krahas marrëdhënies mbizotëruese romano-arbëreshe, ku bazës leksikore romane u shtohen elemente morfologjike arbëreshe, hasen shpesh dhe forma hibride ku një baze leksikore arbëreshe i shtohen morfema trajtëformuese romane e greke, ose ku një bazë leksikore romane ndërthuret me prapashtesa greke e mbaresa arbëreshe[13].

---

[11] G. Belluscio, M.Genesin, *La varietà arbëreshe di San Marzano di San Giuseppe*, in collaborazione con Giovanni Belluscio, in: Idomeneo, 2015, n. 19, f.228.

[12] Po aty, f.229.

[13] F. Altimari, *Studia linguistica italo-albanica*, Prishtinë, 2014, f. 172.

Nga shembujt e vjelë në të folme të ndryshme arbëreshe, në trajtat paradigmatike, më tepër se huazime të plota, vërehen forma të hibridizimit gjuhësor. Ky tip trajtëformues i përzier, shfaq dy nivele të code switching, së pari, huazimin e natyrshëm të njësive leksikore, dhe së dyti, integrimin e modeleve paradigmatike të arbërishtes. Kjo është një dëshmi e qartë e ruajtjes së strukturave gramatikore, në shumë situata të ndërkëmbimeve gjuhësore.

Një model të tillë integrues, e gjejmë të studimi i F.Altimarit, i cili pohon se: "Ndryshe nga shqipja ballkanike, arbërishtja e Italisë përfshin në këtë klasë të fundit një mori huazimesh foljore nga italishtja me temë në bashkëtingëllore -ar e -ir, përkatësisht prej foljeve të rregullta italiane në -are e në -ire. Me fjalë të tjera, tema në bashkëtingëllore -ar e -ir përkon me trajtën e paskajores italiane pa zanoren fundore. Në këto raste bazës leksikore të huazuar drejtpërdrejt nga një paskajore romane u shtohen ndajshtesat trajtëformuese arbëreshe:

(1a) -are > -ar-si në mbitar-ënj nga 'invitare- v. I, e tashme, nj.'

(1b) -ere > -ir-si në gudhir-ënj nga 'godere- v. I, e tashme, nj.'

(1c) -ire > -ir-si në zvenir-ënj nga 'svenire- v. I, e tashme, nj."[14]

Këto formime janë rezultat i një mekanizmi të riorganizimit leksikor dhe morfologjik që ka vepruar në kushtet e shumëgjuhësisë ku ndodhen ngulimet arbëreshe të Kalabrisë. Dallimet që vihen re në proceset e huazimit dhe të rileksifikimit në të folmet arbëreshe pasqyrojnë qoftë varietete të ndryshme të kalabrishtes me të cilat arbërishtja ka rënë në kontakt, qoftë modalitete të ndryshme të kontaktit gjuhësor.[15]

Modeli i përzierjes së kodeve shfaqet si ndërthurje e dy gramatikave të koduara leksikalisht, në të cilat vërejmë projektimin e elementeve bërthamë nga leksikonet përkatëse. Elementet leksikore "*regjistrojnë*" kategoritë morfosintaksore të nevojshme për gjenerimin e fjalive. Veçanërisht variacioni mund të lidhet me mekanizma të caktuara gjatë procesit të përvetësimit gjuhësor.[16]

Elementet e variacionit gjuhësor shihen si një ndërthurje nivelesh, që prekin jo vetëm nivelin leskikor, si pasqyrim i drejtëpërdrejtë i integrimit gjuhësor, por edhe bashkëveprimin me modelet e realizimit fonologjik, që ndikojnë në krijimin e strukturave të reja gramatikore.

Kështu, variabilet gjuhësore që vërehen në të folmet arbëreshe, mund të kundrohen jo vetëm nën dritën e studimeve sociolinguistike, në të cilat shfaqen

[14] Po aty, f.172.
[15] Po aty.
[16] L. Savoia, *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë, 2015, f.13.

qartë modelet tipike gjuhësore që gjenerohen në situatat bilinge, por edhe përmes teorive moderne, që pasqyrojnë formimin e leksikonit, përmes gjenerimit të modeleve fjalëformuese, integrimin me mekanizmat tingullorë dhe prozodike, gjatë krijimit të skemave të larmishme të frazave.

Në qoftë se do t'u referoheshim modeleve gjenerativiste të organizimit të leksikonit në këto situata gjuhësore, mund të veçojmë procesin e kodimit të njësive leksikore, të cilat imponojnë në formim tipare të caktuara morfonologjike, për të gjeneruar format hibride që vërehen në situatat bilinge. Të tilla forma në këto të folme vërehen jo vetëm si përzierje fjalësh brenda fjalisë (të ashtuquajturat word mixing), por edhe si ristrukturim i brendshëm i fjalës.

Një vëzhgim të tillë e shohim në studimin e F.Altimarit, i cili vëren se në disa formime, bazës leksikore romane i bashkohet një ndajshtesë fjalëformuese me prejardhje greke, që ndiqet nga ndajshtesat trajtëformuese arbëreshe. Një rast i tillë është p.sh. huazimi foljor *ngolisënj* 'ngjis' nga it. 'incollare' < (n+tema kolë) *ngolë+is+ënj*, që në ndonjë të folme është zëvendësuar nga huazimi më i ri *ngolarënj* që haset aty-këtu krahas fjalës shqipe ngjitënj.[17] Po kështu, ai vëren se leksiku i varieteteve arbëreshe të shqyrtuara përfshin një grup bazash leksikore të përbashkëta me varietetin roman, të cilat kombinohen me morfologjinë fleksive arbëreshe; përveç kësaj shfaqen kushte të leksikalizimit specifik, të ndryshme nga ndërtimet standarde, që veçanërisht përkojnë me sintaksën e fjalisë së varur, të pjesores, të mbiemrit e të sintagmës emërore dhe të morfologjisë së foljes.[18]

Prania e formave hibride në këto të folme, si dhe riorganizimi në sistemin fonologjik, leksikor, si dhe në përftimin e strukturave morfosintaksore, fakton konvergjencën gjuhësore, si prirje e brendshme, por edhe si pasojë e shtresëzimit sociolinguistik të bashkësisë arbëreshe. Kundrimi i sistemeve gjuhësore që përfshihen sot në përshkrimet e situatave të ndërkëmbimit gjuhësor në këtë bashkësi, dëshmojnë për një përballje të dyfishtë, nga njëra anë binomi varietet arbëresh- varietet lokal i italishtes, i cili është duku u tkurrur[19], nga ana tjetër, përballja gjithnjë e më e fuqishme me italishten standard, si forma më masive e përdorimit të gjuhës, në media, shkollë e administratë. Dukuri të tilla, të kundruara në një shtrirje të gjatë kohore, dëshmojnë më së miri funksionimin e kësaj bashkësie në kushtet e një kontakti të gjatë gjuhësor dhe kulturor me varietetet romane.

---

[17] F. Altimari, *Studia linguistica*, f.181.
[18] Po aty, f.9.
[19] Shiko. F. Altimari, *Studia linguistica*, f.171.

Dialektika ligjërimore në të folmet arbëreshe, nuk është dominuar aq nga aspekti i prestigjit gjuhësor i varieteteve romane, sesa i është nënshtruar një ndryshimi gradual që ka ndodhur si pasojë e kontakteve gjuhësore.

Si përfundim mund të themi se studimet albanologjike në Itali përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme të studimeve shqiptare. Përmes identifikimit të veçorive kulturore, gjuhësore e letrare të arbërishtes, është hedhur dritë mbi ekzistencën e një bashkësie që diti ta ruajë identitetin e saj ndër shekuj.

Konturimi i qartë i identiteteve sociale përmes gjuhës dhe kulturës, përbën terrenin ideal për vëzhgimin e transformimeve sipërfaqësore ose të thella, të cilave iu është nënshtruar bashkësia arbëreshe.

Mirënjohje pa fund për kontributin e një plejade të ndritur studiuesish, që i dhanë dhe vijojnë t'i japin një imazh dinjitoz albanologjisë.

Bibliografia

Altimari, F., *Mbi huazimet nga italishtja dhe nga dialektet italo-romane në sistemin foljor të arbërishtes, në* Studia linguistic italo-albanese, *Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, Prishtinë, 2014.

Baker, M., *Gli atomi del linguaggio*, Milano, Hoepli, 2003.

Baldi, B., Savoia, L. M., *Cultura e identità nella lingua Albanese*, Lingue e letterature d'Oriente e d'Occidente, n. 6, 2017.

Baldi, B., Savoia, L. M., *Perché barbari?Lingua, comunicazione e identità nella società globale*, Roma, Bulzoni, 2006.

Baldi, B., Savoia, L. M., *La lingua e i parlanti.Uso del linguaggio e comunicazione*, Pisa, Pacini. 2008.

Banfi, E., *Linguistica balcanica*, Zanichelli, Bologna, 1985.

Camaj, M., *Albanian Grammar*, Harrassowitz, Wiesbaden, 1984.

Camaj, M., *Il bilinguismo nelle oasi linguistiche albanesi dell'Italia meridionale*, në Bilinguismo e diglossia in Italia, CNR-Centro di Studio per la Dialettologia Italiana, Pisa, Pacini: 5-13,1974.

Camaj, M., *La parlata Albanese di Greci in provincia di Avellino*, Firenze,Olshki, 1971.

Gerbino, G., *Dizionario arberesh - italiano della parlata arbereshe di Piana degli albanesi*, 2010.

Finocchiaro, G., *Variabili semantiche, grammaticali e fonologiche nel processo di produzione dei clitici accusativi*, në Quaderni del Laboratorio di Linguistica 3: 273-284, 2002.

Gambarara, D., *Parlare albanese nell'Italia unita*, në Zjarri, 27: 49-67, 1980.

Titone, R., *Some Factors Underlying Second Language Learning*, *ELT Journal*, Volume XXVII, Issue 2, 1973, f. 110–120.

Titone, R., Matras,Y., Bakker,P., *Mixed languages:re-examining the structural prototype*, Mouton de Gruyter, 2003, f.75-151.

Turano, G., *Dipendenze sintattiche in albanese*, Padova, Unipress, 1995.

Savoia, L. M., (ba. M. Rita MANZINI e Bendetta BALDI), Studime në gjuhësinë shqiptare, Prishtinë, 2015.

Evalda PACI, ASA Tiranë

RRETH DISA KONTRIBUTEVE TË VEÇANTA SHKENCORE MBI FIGURËN E GJERGJ KASTRIOTIT-SKËNDERBEUT NË TREVAT ITALOFONE

Abstrakt. Kontributet themelore që ndikuan në përforcimin e imazhit mbi një personalitet kompleks e të rëndësishëm për kohën në të cilën jetoi. Format e para të gjinive shkrimore e letrare që u përvijuan nën shtysën e përjetësimit të periudhës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ndikime në shkrimtarinë e përmbajtjen e veprave që u shkruan në formate biografike dhe analitike mbi figurën e heroit tonë kombëtar. Lëvrimi i gjinive shkrimore të caktuara në gjuhë kulture për kohën, latinishtja dhe italishtja. Rimarrja në një vështrim kritik e këtyre veprave dhe përpilimi i studimeve specifike shkencore historiografike dhe ndërdisiplinore mbi Gjergj Kastriotin dhe periudhën e tij. Kontributi i studiuesve italianë, por dhe rumunë, ndër të cilët veprat e shkruara në gjuhën italiane nga Francisc Pall, gjurmues i zellshëm i elementeve të historiografisë skënderbeiane dhe i biografisë së Marin Barletit, autorit humanist më në zë të letrave shqipe. Pikëpamje të studiuesve italianë mbi punimin monografik të F. Pall rreth Marin Barletit (Bukuresht, 1938) dhe karakterit humanist të veprës së këtij të fundit. Reflektimi i jehonës së bëmave të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në përpilime të mbështetura dhe në një dokumentacion të posaçëm arkivor, trajtesat specifike në lidhje me këtë të fundit dhe elemente të biografisë së Kastriotit. Kontribute *ad hoc* në të cilat trajtohet e analizohet periudha e Skënderbeut nga dokumente të natyrës arkivore që ruhen dhe në arkivat e Napolit. Vështrim kritik mbi disa artikuj të veçantë të botuar në të përkohshmet me profil shkencor në gjuhën italiane në dekadat e para të shekullit të kaluar (autorë, fusha studimi dhe sprovat përkatëse). Rimarrja e tyre në ditët e sotme nga dija e historiografisë dhe studiuesit e periudhës së Skënderbeut. Jehona e bëmave të Gjergj Kastriotit e konkretizuar në objekte kulti dhe vepra arti në vise të Gadishullit Italik dhe botime që pasurojnë traditën e hulumtimeve mbi këtë argument të veçantë.

Figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe historia e jetës dhe e bëmave të tij ka patur një impakt të veçantë në vetë arealin italofon duke qenë dhe shtysë për hartimin e veprave që për nga gjinia shkrimore dhe ndikimi që patën për shekuj të tërë vlen të renditen ndër realizimet më të mira e të vyera të frymëzuara nga personaliteti i heroit tonë kombëtar. Vetë tradita e studimeve mbi këtë figurë dhe periudhën kohore që pason largimin e tij nga jeta ka marrë në konsideratë një rend të caktuar përpilimesh dhe komponimesh që ndikuan qartë që të flitej gjatë dhe gjerësisht rreth Kastriotit dhe gjithë kontekstit historik që ndërthuret natyrshëm rreth tij. Një kronologji selektive dhe e përqendruar në një hierarki vlerash të autorëve që bënë objekt të veprave të tyre biografinë e heroit, elemente të qenësishme të rrugëtimit të tij jetësor, edukimin e posaçëm që ai

kishte marrë në oborre mbretërore larg vendlindjes, praninë dhe përfshirjen në ngjarje që lidhen dhe me fatin e popujve të afërt nga pikëpamja gjeografike, bëhet e domosdoshme sidomos kur flitet për të trajtuar më vete burime që pikësëpari e patën zanafillën në viset italike dhe në disa treva të këtij areali, duke qenë ky i fundit i destinuar dhe për arsye rrethanash të caktuara të bëhej strehë pritëse dhe formative për autorë që ndërkohë që përmbushnin një formim të natyrës specifike individuale, i kushtuan kësaj figure themelore në shumë pikëpamje vepra të një karakteri të veçantë gjinor.

Pushtimi otoman dhe më saktë fuqizimi i pandalshëm i një perandorie të madhe të asaj kohe ka ndikuar drejtpërdrejt në një sërë zhvillimesh në viset ballkanike, arbërore e më tej, në marrëdhëniet konkrete me shtete përtej Adriatikut, ndër të cilat Venediku ka qenë ndër më të ndërmendurat e më të përfshirat qoftë kur flitet për një historik migrimesh të popullsive shqiptare drejt brigjeve të sipërcituara, që patën shtysë arsye të natyrës jo vetëm ekonomike.

Të përpiluara në gjuhën latine, por dhe italiane, realizime kryesisht të Pesëqindës mbeten dhe sot e kësaj dite ekzemplarë që të trajtuara dhe në optikën e historianit të letërsisë së shkruar që ka objekt studimi pikërisht një periudhë të tillë historike, ofrojnë shtysa për trajtesa kryesisht ndërdisiplinore, duke qenë pa diskutim vetëdija dhe në këto rasa e konsiderimit me përparësinë e duhur të dimensionit historik dhe historiografik.

Gjergj Kastrioti, por dhe qëndresa kaq herë e ndërmendur ndaj përparimit të fuqive otomane përfshiu pa dyshim prelatë që ruanin të pashlyer një lidhje të fortë dhe të prekshme me viset arbërore, fakt që veçanërisht në rastin e Marin Barletit nënvizohet vazhdimisht nga studiuesit e kësaj periudhe dhe hulumtuesit e kontekstit që bëri të mundur ngjizjen e veprave në të cilat mund të gjurmohen përmasa të historiogafikes, por dhe letrarësisë dhe deskriptivizmit. Ndikimi që vepra e këtij të fundit pati qoftë mbi përpilime të mëvona ose të afërta në kohë, qoftë dhe në studime kritike që domosdoshmërisht do të merrnin në konsideratë *Historinë e jetës së Gjergj Kastriotit* të Barletit, është më se i qartë dhe ndër të tjera mbetet dëshmi e jetëgjatësisë së receptimit të një përpilimi me variantet përkatëse të ribotuara që me kalimin e kohës vetëm se vijoi të ishte burim referencial për këdo që i kushtohej studimit të një periudhe dhe të një personaliteti që e shënoi ndjeshëm kohën në të cilën jetoi. Vetë lidhjet e ndërmendura jo pak dhe kohët e fundit mes këtij autori dhe një rrethi të përbërë nga dijedashës dhe kultivues të librit në treva italofone të rëndësishme për kohën dëshmon që interesi për të nxjerrë në dritë të shtypit një vepër në të cilën do të trajtohej në mënyrë të artikuluar jeta e një heroi si Kastrioti, ishte i qartë dhe për më tepër i

plotësuar nga vetëdija që një përpilim i tillë i shërbente vetë kohës dhe ngjarjeve që përfshinin vende, vise dhe organizime tipike territoriale të saj. Një referim i qartë ndaj Barletit si historiograf do të mund të gjurmohet dhe i shtjelluar qartë në *Prefationën* me të cilën parashtron veprën e vet Jacques de Lavardin (botimet përkatëse më 1576; 1621) e një fakt i tillë rinënvizon jehonën e veprës së Barletit në vitet që pasojnë realizimin e saj.

I dha një shtysë të mëtejme konsiderimit të rrethanave të tilla dhe nënvizimi i të dhënave të caktuara biografike mbi këtë autor dhe formimin e tij personal, pjesë e të cilit natyrshëm do të ishin dhe tipografë dhe njohës të sprovuar të kulturës së librit, mbështetës të bibliofilisë si prirje e koncept, fakt që dëshmon rëndësinë që impakti i bëmave të këtij heroi do të vijonte të kishte në atë kohë dhe më vonë akoma.[1]

Dhe pse të bëra objekt vështrimesh kritike nga autorë që iu kthyen periudhës së Gjergj Kastriotit dhe përvijimit të personalitetit të tij të nisur nga premisa dhe arsye që kishin të bënin me interesa të përcaktuara studimore, veprat që u hartuan kryesisht në dekadat që pasuan vdekjen e heroit janë në vijimësi të marra në konsideratë të këtyre hulumtuesve, qoftë dhe për të shpënë më tej apo saktësuar rrethana a ngjarje që janë pjesë e pandarë e një mozaiku kompleks historik. Ato ngjajnë mes tyre dhe në pikëpamje të renditjes së elementeve tekstore që janë karakteristike për kohën në të cilën dhe panë dritën e shtypit, duke përfaqësuar kësisoj dhe të përmbajturit ndaj modelesh librore që pikërisht në atë kohë paraqiteshin të ngjashme dhe sa u përket elementeve të caktuara teknike, ikonografike dhe tipografike.

Vëmendja ndaj biografisë së heroit tonë është shprehur si në rasa të përpilimit të veprave të veçanta për nga natyra gjinore, ashtu dhe në materiale të natyrës arkivore që përbëjnë domosdoshmërisht një bazë burimore mbështetëse për studimet mbi Skënderbeun. E dëshmon një fakt të tillë një arsenal i pasur burimor i bërë objekt trajtimi që në gjysmën e parë të shekullit të kaluar nga studiuesi Francisc Pall, një ndër biografët më me emër të Marin Barletit dhe hulumtues në disa pikëpamje i veprës së këtij të fundit, që duke ushqyer interesa të qarta studimore dhe ndaj Katërqindës në veçanti, solli me një nga veprat e tij një këndvështrim kompleks mbi një periudhë që reflektohet si me trajtesa sintetike, si me materiale arkivore pa të cilat dhe vetë botimi në fjalë nuk do të

[1] Nadin L., *Marino Barlezio: appunti biografici. L'ambiente religioso padovano-vicentino tra Quattrocento e Cinquecento*, në *Shqipëria e rigjetur: zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shekullin XVI/L'Albania ritrovata: recuperi di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto*, Botime Onufri, Tiranë, 2012, f.98-129.

mund të receptohej qartë.[2]

Një punim i tillë ka në qendër të vëmendjes karrierën ushtarake të Kastriotit, pa lënë pas dore ecurinë e marrëdhënieve të shkëmbimit mes tij dhe Mbretërisë së Napolit, shtetin papnor të Romës si dhe dukatin e Milanos, me këtë të fundit veçanërisht në vitet 1451-1456, gjithnjë në optikën e luftës kundër Perandorisë otomane. Trajtesat e arsyetuara të Francisc Pall mbështeten nga një aparat kritik që bën të mundur jo vetëm të reflektohen burime të vjela prej këtij të fundit, por dhe konsiderata mbi një sërë studimesh që nuk shiheshin dhe nuk shihen as sot e kësaj dite nën të njëjtin këndvështrim nga gjurmuesit e së njëjtës periudhë. Në të vërtetë, është pikërisht një dokumentacion i kësaj natyre, i detajuar në shënimet e shumta që pasojnë një studim të tillë, i përbërë nga burime arkivore, por dhe botime të mbështetura mbi to që dëshmon që në interesin studimor të Francisc Pall ngjarjet që do t'i prinin realizimit të ndërmendur, por të parealizuar të një kryqëzate të organizuar kundër fuqisë otomane janë përherë një tërësi faktesh që hedhin dritë dhe mbi qëndrimin që mbahej ndaj prijësve të Ballkanit e më saktë dhe ndaj vetë Gjergj Kastriotit, që pa dyshim priste dhe një mbështetje konkrete në pikëpamje të vijimit përherë e më të vendosur të luftës kundër turqve. Në trajtesat e Pall dallohet mirëfilli vetëdija për një qëndrim të tillë duke qenë mjaft e qartë për të që dhe marrëdhëniet mes vetë shteteve a dukateve në Gadishullin Italik ndikonin dhe në ndërmarrjen e iniciativave konkrete për dërgimin e forcave ushtarake në viset e Ballkanit, bashkë me ndihma të domosdoshme në pikëpamje ekonomike. Një fakt i tillë vjen veçanërisht në vëmendje të studiuesve në periudhën e Papës Piu II, gjatë pontifikatit të të cilit ideja e një kryqëzate rrihej fuqimisht prej atij vetë dhe përkrahësve të tij.

Pall përzgjedh me mjaft vëmendje momente të veçanta nga jeta ushtarake e heroit tonë dhe vetë trajtimi që i kushtohet betejës së Beratit bashkë me cilësimet mbi fatin e pjesëmarrësve në të e rrjedhojat gjegjëse, dëshmon që kjo ngjarje jo fort fatlume mbetej ndër më shënueset në krejt karrierën e Kastriotit.[3] Dokumentacioni historik që sjell në vëmendje Francisc Pall në veprën e sipërcituar bashkë me një hyrje sa të thukët, aq dhe të qartë në pikëpamje të platformës që shprehet në të, përbën një arsenal burimesh në radhë të parë për historianët e periudhës, por dhe për këdo që shfaq interesa rreth natyrës së përpilimit të një

[2] Pall F., *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV(Documenti inediti con introduzione e note storico-critiche)*, Napoli, 1966.

[3] Pall F., *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV(Documenti inediti con introduzione e note storico-critiche)*, Napoli, 1966, f.153-157.

sërë tekstesh që duke ruajtur në thelb një natyrë të qartë kancelareske, përmbajnë të dhëna mbi emërtime, emra të përveçëm, më saktë, variante përveçimesh mbi vende dhe ngjarje. Zbërthimi i materialeve kancelareske dhe plotësimi përmbajtësor me shënime dhe referenca ndaj trajtesash gjegjëse zbulon dhe një aspekt të natyrës filologjike të punës së këtij studiuesi me një dokumentacion të pasur e që hedh dritë mbi një sërë çështjesh a faktesh, që mund të gjinden të trajtuara dhe në vepra më të plota që i përkasin së njëjtës periudhë, por që për arsye të natyrës gjinore dhe destinacionit më të përcaktuar përmbajnë dhe nota të një shkrimtarie që priret nga emfaza apo përshkrime të mbartura me subjektivitet.[4] Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe në këtë trajtesë tonën një recension apo vështrim të natyrës analitike e shkencore që Antonio Baldacci në vitin 1940 do t'i kushtojë kontributit të Francisc Pall ndaj veprës së Marin Barletit, duke renditur në një nga numrat e revistës *Dalmatica* (të këtij viti) jo pak konsiderata që jo vetëm shërbejnë për ta parë me një sy më objektiv Barletin si narrator, shkrimtar dhe autor, por dhe vetë arsyetimin apo artikulimin e veprës që rinënvizoi interesin e qartë studimor të hulumtuesit Pall ndaj humanistëve e më konkretisht ndaj një autori që për hir të së vërtetës nuk i përket vetëm traditës shqiptare të artit të të shkruarit. Rimarrja e optikës shumëdimensionale në të cilën Pall e shihte Barletin dhe shkrimtarinë e tij, ndikimeve të qarta të këtij të fundit nga autorë të klasicitetit latin, prirjeve për të celebruar një personazh si Kastrioti në dritën e ngjarjeve që e deshën të përfshirë këtë të fundit, ndihmon rikthimin ndaj një leximi të domosdoshëm nëse bëhet fjalë jo vetëm për të njohur më tej autorë që në kohën së cilës i përkisnin përshtatnin e lëmonin mënyra të shprehuri dhe artin e të shkruarit, por dhe një kontekst më të gjerë, që ushqeu e orientoi drejt përmbushjes botime që rezistuan gjatë dhe nuk iu dorëzuan harresës. Barleti duhet lexuar në mënyrë të diferencuar dhe sa i përket përafrimit që shfaq me kontekstin shqiptar në secilën prej veprave që mbajnë emrin e tij, ndërkohë që specifikat e secilës kanë të bëjnë dhe me receptimin e një ngjarjeje që ka shënuar shekullin në të cilin ka ndodhur *Rrethimi i Shkodrës*, si dhe me biografinë e një heroi që për nga bëmat dhe rrethanat historike që e patën

[4] Një vështrim më i plotë mbi pikëpamjet që ky studiues shpreh në lidhje me burimet në të cilat rimerret biografia e heroit tonë mund të konsultohet dhe në artikullin e botuar në vitin 1971(n.1) në RESEE(*Revue des études Sud-Est européennes*), pikërisht në atë me titull *Di nuovo sulle biografie skanderbegiane del XVI secolo*, pikërisht në një rubrikë kushtuar teksteve dhe dokumenteve në f.91-106 të numrit gjegjës të kësaj të përkohshmeje shkencore.

si protagonist mbetet po aq i veçantë dhe unik në kujtesën historike. Pall ka përpiluar ndërkohë një vështrim mjaft të kujdesuar si ndaj ribotimeve me ndryshime jo të pakëta në elemente të ndërtimit tekstor dhe risjelljes së parathënieve apo shënimeve të tjera që mund të gjinden në variantet e para të botimit të veprave të Barletit, por dhe të dhëna mbi vëllimet përkatëse në të cilat këto të fundit mund të përmbahen apo mund të gjurmohen. Një historik i mirëfilltë i kulturës së librit do të dalë në pah nëpërmjet analizave të imtësishme filologjike që ky i fundit ka realizuar gjithnjë nën optikën e gjurmimit të risjelljes së veprave të Barletit në disa gjuhë të Evropës, çka ridëshmon vëmendjen që ky dhe objekti i veprës së tij gëzonte ndër librarët e botuesit e kohës, sigurisht dhe historianët dhe kronikanët përkatës.[5]

Ndërmendja e origjinës familjare të Kastriotit tonë, trajtimi në pikëpamje të etimologjisë dhe i viseve që lidhen drejtpërdrejt me historinë familjare të tij, kontekstualizimi me hollësi i veprimtarisë së prelatëve që luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin apo orientimin e ngjarjeve me të cilat Skënderbeu rezulton ngushtësisht i lidhur, rimarrja e burimeve si Barleti, Frang Bardhi, Biemmi etj., në funksion të konsiderimit të një periudhe historike që në studimet tona ka për referim pikërisht këtë figurë me rëndësi, do të mund të gjurmohet në një vëllim që u shërben dhe sot e kësaj dite historianëve dhe filologëve, me titullin *Illyricum Sacrum*, që gjithashtu ka parë dritën e botimit në një kontekst tipik për librin dhe kulturën që ka të bëjë me të. Varianti i vitit 1817 i këtij vëllimi, botuar në Venezia nga Sebastiano Coleti, përmban të dhëna të shumta që ndërkohë dhe mund t'i gjejmë të ritrajtuara dhe mbi bazë burimesh të tjera nga studiues që bënë objekt të vëmendjes elemente të ngjashme të biografisë së këtij heroi. Ndërthurja e trajtesave në të cilat bëhet fjalë drejtpërdrejt për Kastriotin me të tjera të ngjashme, por në të cilat është e qartë që vetë komponimi i kreut lidhet me personalitete që në veprimtarinë e tyre i kushtuan vëmendje dhe marrëdhënieve mes prijësve shqiptarë në këtë periudhë, dëshmon rëndësinë e padiskutueshme që dhe për autorët e këtij vëllimi paraqiste figura e një fatosi që me qëndresën e vet në shumë raste të gjendur në pozicione të pafavorshme për nga numri i forcave dhe i mjeteve materiale që e mbështesnin, përbënte një mburojë të qartë për krishtërimin dhe vetë integritetin territorial të viseve evropiane.[6]

---

[5] I referohemi në veçanti kreut me titull *Edizioni, traduzioni e rimaneggiamenti*, në Pall F., *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucuresti, 1938, f.17-27.

[6] Shih ndër të tjera dhe kreun me titull *Episcopi Crojenses suffraganei Metropolis Dyrrhachiensis, po aty, botim i cituar*, 1817, f.411-433. Shih dhe paragrafin përkatës kushtuar një prej arqipeshkvijve të kishës së Durrësit, *po aty, botim i cituar*, f.372-273: *Paullus Archiepiscopus Dyrrhachiensis XXXI...*

Rimarrja e elementeve kryesisht biografike, por dhe historike që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me Kastriotin dhe kujtesën historike që lidhet me të do të mund të gjurmohet dhe në shënimet e Imzot Pooten (1863 e më tej),[7] si dhe në një nga krerët e veprës *Il presente e il passato di Bosnia, Erzegovina e Albania, terre della Dalmazia Romana,* shkruar nga Donato Fabianich, me titull *Fatti d'armi tra Scanderbeg e gli Ottomani,* Zarë, 1879.

Një qasje origjinale që merr parasysh ritrajtimin e kësaj figure në shekuj, por dhe reflektimin në disa disiplina të dijes mbetet ajo e studiueses Lucia Nadin, e cila konkludoi pak kohë më parë realizimin e një përmbledhjeje tematike që ka si bosht të vetën një rend të natyrës kronologjike duke pasur parasysh gradualizimin e jehonës së rolit të këtij heroi në një areal tejet të veçantë si ai i Veneto-Padovas, por dhe reflektimin në një sërë gjinish shkrimore dhe veprash arti, ndër të cilat dhe ato pamoret nuk mbeten pas. Një ndërthurje origjinale argumentesh dhe propozim i qartë për të lexuar dhe burime të tjera, që, përveç se të ndryshme nga natyra dhe prejardhja, riftojnë ta konsiderojmë Barletin dhe elementet teknike e specifike të ndërtimit tipografik të veprës së tij, karakterizon veprën me titull *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (nga historia te miti: shekujt XV-XVIII),* botim shqip i Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2018. Një rikthim i qartë dhe deciziv ndaj figurës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut përfaqësoi për të gjithë ne viti që shkoi dhe në këtë rasë përkujtimore jo pak u morën në shqyrtim raste të ribotimit e të rishfaqjes së veprës së Barletit në disa gjuhë të Evropës, jo vetëm në gjuhën latine, si dhe impakti i migrimeve drejt viseve italike si rrjedhojë e rëndimit të gjendjes së popullsive shqiptare nga presioni i pushtimit otoman. Janë të tilla dukuri migratore që janë reflektuar në anale dhe buletine të shkruara në gjuhën e kohës, në dokumente të natyrës së mirëfilltë arkivore e që përbëjnë alternativa të mundësisë për të lexuar më thellë e më qartë rreth një fenomeni që bëri të mundur të rithirrej në kauzë një marrëdhënie e gjatë shkëmbimesh mes dy popujsh, që koha do ta vinte sërish në provë.

Studimet e realizuara në trevat italofone, por dhe ato të shkruara në gjuhën italiane, siç rezulton një numër jo i pakët kontributesh të ndërmendura dhe

[7] Shih ndër të tjeradhe kreun me titull *Ecclesia Alexiensis sive Lissiensis*, f.91-93. Më konkretisht në faqet n. 91- 92 do të gjindet citimi i mëposhtëm: Post divisum Romanum Imperium Lissenses seu Alexienses Orientis Imperatoribus paruere, ac deinde eamdem ac aliae Epiri novae civitates fortunam experti multorum dominatum subierunt. Veneti an.1386 cum Dyrracchio Andegavensibus adempto Lissum quoque in suam potestatem redegerunt, quam an.1467 adhuc retinebant, cum heros celeberrimus Georgius Castriotus in ea urbe diem supremum obiit.

në këtë trajtesë tonën mbeten të një rëndësie të konsiderueshme nëse bëhet fjalë për një kategorizim sa i përket nënvizimit të vetive dhe cilësive komplekse me të cilat paraqitet në përgjithësi një personalitet si ai i Gjergj Kastriotit. Një pjesë e mirë e tyre ndjek Barletin në aspekte të konsiderimit të ngjarjeve dhe episodeve edhe kur nuk rezultojnë citime të drejtpërdrejta apo referime permanente dhe një fakt i tillë riprovon që ky i fundit në pikëpamje referencialiteti i ka qëndruar mirë kohës duke vijuar të gëzojë një lexueshmëri diskrete që në fund të fundit vetë përmbajtja dhe artikulimi i veprës së tij e bën të mundur një gjë të tillë. Ka mjaft trajtesa dhe kontribute në të cilat ndërkohë që ndiqet një ecuri e arsyetuar në lidhje me atë që quhet prej kohësh *histori e jetës dhe e bëmave të Gjergj Kastriotit*, nënvizimi i pamjes së jashtme që evokon ushtarakun e kalitur/sprovuar apo dhe i stratagemave në pikëpamje të zhvillimit të betejave dhe sulmeve në raste rrethimi, mbetet një prirje mbizotëruese dhe dëshmi e receptimit me pozitivitet të një figure të tillë burrërore. Prurje të konsiderueshme në pikëpamje artikujsh e kontributesh, por dhe reflektimesh mbi realizime të mëparshme ose të atyre viteve përfaqëson dhe e përkohshmja *Rivista d'Albania(1940-1941)*, në të cilën mund të gjurmohen shkrime shkencore, recensione dhe trajtesa kryesisht mbi botën shqiptare të vështruar në mënyrë komplekse e nga këndvështrimi i disa disiplinave, ndërkohë që pikërisht rikthimi i vëmendjes ndaj Kastriotit dhe periudhës së tij do të jetë objekt trajtimi nga studiues me emër që interesoheshin dhe për aspekte të studimit antropologjik e historik të botës shqiptare. Shkrime të F.Ercoles[8], G. M. Montit[9], Sofia Mascit, konfirmojnë rëndësinë që vijonte të kishte një periudhë e tillë historike, aq më tepër që në këtë të përkohshme botohen dhe recensione specifike mbi kontribute shkencore që kishin parë dritën e botimit pikërisht në ato vite. Vlerësime konkrete mbi punimin e mirënjohur të A.Gegajt *L'Albanie et l'invasion turque au xv-ème siècle*, Louvain, 1937, përqasjet në pikëpamje të konsiderimit të burimeve të marra parasysh me ato të autorëve të tjerë të afërt në kohë dhe ndjekës të linjave të përafërta studimore, konciziteti në analizën e elementeve përmbajtësore të

[8] Ercole F., *Skanderbeg e l'Italia*, në *Rivista d'Albania, fascicolo I,* 1940, f.10-17.

[9] Monti Gennaro Maria, *Rassegne (Storia)*, në *Rivista d'Albania, fascicolo II,* 1940, f.194-197. Shih në veçanti një pjesë të vlerësimit të këtij të fundit mbi kontributin e A.Gegajt, të cituar më sipër në tekst: Si tratta di un'opera di ampio respiro, che ha molti meriti e che sostituisce tutte le precedenti, anche perchè cerca, e riesce, a "correggere parecchi errori singoli e numerosi giudizi falsi o inesatti". È pur vero, però, che egli ci dà un'altra serie di altri errori, sia nei giudizi, come sui rapporti di Scanderbeg con il Magnanimo, sia nei dati di fatto, i quali furono rilevati in una minuta analisi dal Pall.(Une nouvelle histoire de S., në *Revue Historique du Sud-Est Europeen*, 10-12, 1937.)

kësaj vepre, por dhe të botimeve të tjera me të njëjtën tematikë na bën të vlerësojmë të tilla analiza që u ngjajnë recensioneve dhe ndërkohë paraqiten të thukëta në brendinë e tyre.

Këndvështrimet që jepen në të tilla refleksione mbi vepra të caktuara e që kanë koinciduar dhe në pikëpamje të afërsisë kohore të daljes në dritë të shtypit dëshmojnë dhe idetë e qarta mbi dallimet që vetë autorët e këtyre rubrikave i shprehnin në drejtim të thelbit a natyrës së këtyre punimeve: do të dallohet qartë në shënimet e tyre mes veprës me karakter shkencor, asaj me karakter divulgativ dhe veprës që dhe pse e shkruar me pretendime jo mirëfilli shkencore, shërbente për të krijuar ide mbi historinë e jetës së Skënderbeut. Në vëmendje të recensentëve të këtyre punimeve do të jenë përherë marrëdhëniet mes Gjergj Kastriotit dhe dukateve a mbretërive të Gadishullit Italik, gjithashtu Raguzës a ndonjë njësie tjetër shtetërore, ndërkohë që vërejtje të natyrës kritike nuk do të mungojnë ndaj pohimesh a gjykimesh të shprehura në botimet e marra në shqyrtim. Me gjithë vështrimin a qëndrimin e qartë kritik që lejon dhe të dallohen aspekte pozitive të ndërtimit të këtyre veprave, në këndvështrimin tonë punimet e A.Gegajt, F.Pall e të ndonjë autori tjetër mbeten më të realizuarat dhe në pikëpamje referencialiteti e integriteti përmbajtësor në ditët e sotme. Çështja e përqasjes mes autorëve që veçanërisht në këtë kohë, në dekadat e para të shekullit të kaluar, herë me punime të plota, por dhe me artikuj e shkrime shkencore i kushtuan hapësirë krijimtarie jetës dhe bëmave të Gjergj Kastriotit shtrohet dhe kur bëhet fjalë për të verifikuar burime të caktuara arkivore me materiale analoge të gjindshme në arkiva të tjera, gjithnjë nën perspektivën e saktësimit të elementeve të një historie që ndërkohë që e lidhim me vetë individin, ka të bëjë me një periudhë të veçantë e me një kontekst zhvillimesh po aq të veçantë.

Rimarrja e një historie bëmash kaq unike dhe të lidhur me një figurë të veçantë të kombit shqiptar si Gjergj Kastrioti përbën një fenomen që konkretizohet në realizime të një larmie gjinore komplekse pikërisht në arealin italofon, larmi që e parë kryesisht në një vështrim të natyrës diakronike ka pasuruar ndjeshëm burimet që kanë shërbyer përherë për leximin e rileximin e jetës së heroit tonë kombëtar në një optikë historike dhe letrare.

Bibliografi

Bardhi F., *Skënderbeu (Apologji), (përktheu nga latinishtja Stefan I.Prifti),* Tiranë, 1967.

Barleti M., *Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut, (përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga S. J. Prifti),* Tiranë, 1964.

Barleti M., *Historia e Skënderbeut* (nga lat. e hyrja nga S. Prifti), bot. II, Tiranë, 1967.

Barleti M., *Historia e Skënderbeut, (botim i tretë, përkthyer nga S.I.Prifti),* Tiranë, 1982.

Barleti M., *Historia e Skënderbeut,* bot. IV, shqipëroi S. Prifti, Infbotues, Tiranë, 2005.

Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës,* prej origjinalit latinisht nga H. Lacaj, Botimi II i plotësuar, Tiranë, 1967.

Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës (përktheu H.Lacaj); përgatiti për botim D.Hosaflook,* Botime

Onufri, Tiranë, 2012.
Ercole F., *Skanderbeg e l'Italia*, në *Rivista d'Albania, fascicolo I,* 1940.
Kamsi W., *Rrethimi i parë i Shkodrës(1474),* në *Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës*, n,7, 1968.
Marlekaj L., *Scanderbeg nelle tradizioni popolari albanesi*, Bari, 1969.
Nadin L., *Migrazioni e integrazione: il caso degli Albanesi a Venezia(1479-1552),* Bulzoni editore, Romë, 2008.
Nadin L., *Albania ritrovata.Recuperi di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto,* , Botime Onufri, Tiranë, 2012.
Nadin L., *Religiosi albanesi nelle terre della Serenissima tra Quattrocento e Cinquecento: uno scenario di incredibile ampiezza, tra storia di chiese e storie di arte,* në *Hylli i Dritës*, n. 3-4, 2013.
Nadin L., *Marino Barlezio tra Venezia, Padova, Vicenza. Paesaggi veneto-scutarini,* në *Shêjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.
Nadin L., *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga historia te miti: shekujt XV-XVIII),* përktheu e përgatiti: Dr. Evalda Paci, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2018.
Paci E., *Vepra e Marin Barletit, në një kontekst të historisë së letërsisë së shkruar shqipe,* në *Hylli i Dritës*, n.2, 2018.
Paci E., *Çështje të studimit të disa varianteve të botimit të veprave të Marin Barletit*, në *Shêjzat,* n.3-4, 2018.
Padiglione C., *Di Giorgio Castriota Scanderbech e de' suoi discendenti*, Napoli, 1879.
Pall F., *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucaresti, 1938.
Pall F., *I Rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV (Documenti inediti con introduzione e note storiche-critiche),* Estratto dall'Archivio Storico per le Province Napoletane, Terza serie, Vol.IV, Società Napoletana di storia patria, Napoli, 1966.
Pall F., *Di nuovo sulle biografie scanderbegiane del XVI secolo,* në *Revue des études sud-est européennes*, n.1, 1971.
Pipa A., *Umanisti italo-albanesi*, në *Albanica, Numër special*, 1992.
Plasari A., *Skënderbeu, një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare Gjergj Fishta, Tiranë, 2010.
Petrotta G., *Popolo, lingua e letteratura albanese (a cura di M.Mandalà),* Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
Scapolo E., *Venezia e Albania (saggio documentato delle relazioni Veneto-Albanesi nei secoli XIV-XV),* Fascicolo I, Venezia, 1908.
Sirdani M. O.F.M., *Skanderbegu mbas gojdhânash*, në *Zâni i Shna Ndout,* n.III, 1920.
Sirdani M. O.F.M., *Kerkime mbî vorrin e Skanderbegut,* në *Hylli i Dritës*, n.4, 1932.
Sirdani M.O.F.M., *Nji rival i Skanderbegut,* në *Hylli i Dritës*, n.7-8, 1932.
Sirdani M.O.F.M., *Në shka fajiset Skanderbegu,* në *Hylli i Dritës,* n.2, 1935; n.3, 1935; n.11, 1935; n.1, 1936; n.2, 1936; n.3, 1936.
Valentini Z. S.I., *Skandërbegu n'Europë t'atëhershme*, në *Shêjzat*, n.7-12, 1968.

Victor A. FRIEDMAN, Universitet Çikago/Universitet La Trob

ARBËRISHTJA E ITALISË, ERIK HAMPI DHE HISTORIA E GJUHËS SHQIPE, E ALBANISTIKËS DHE E LINGUISTIKËS

Dialektet e arbërishtes në Itali kanë një rëndësi shumë të madhe për historinë e gjuhës shqipe, dhe me këtë edhe për gjuhët indo-evropiane në përgjithësesi. Rëndësi kanë edhe për albanistikën në Amerikë dhe, me këtë, për linguistikën e përgjithshme. Dhe të gjitha këto lëndë janë njësuar në veprimet dhe aktivitetat e mentorit, kolegut dhe mikut tim të nderuar, Erik Hampit. Në këtë kumtesë do të dëftoj disa shembuj nga veprat si edhe nga aktivitetat e Erikut.

Po filloj me historinë e studimeve të Erikut, që janë të lidhura me historinë e linguistikës si edhe të albanistikës italiane në Amerikë. Eriku ishte doktorant te Joshua Whatmough (Xhoshua Watmo) në Universitetin Harvard 1948-1954. Në vitin 1954 e mbaroi doktoratën (Hamp 1954, 1993). Mirëpo, në vitin 1950 u bë instruktor për gjuhësinë indo-evropiane dhe eventualisht profesor në Universitin e Çikagos. Eriku ka studiuar filologji klasike - dmth. latinisht dhe greqishte të vjetër. Kur erdhi Eriku në Harvard, Whatmough ishte drejtor i Katedrës së filogjisë krahasuese, të cilën ai vetë (Watmo) e kishte organizuar në Harvard para shumë vjetësh. Para Whatmough nuk kishte pasur një katedër për studimet gjuhësore në Harvard, po vetëm kurse të ndryshme për gjuhët. Dhe mu në vitin 1951, para se të kishte mbaruar Eriku me doktoratën, Katedra e filogjisë krahasuese në Harvard u bë Katedër e linguistikës. Në Çikago një katedër e tillë kishte eksistuar që nga 1934, por modernizimi dhe riorganizimi i katedrës u bë në vitin 1962, me Erikun si një nga profesorët e Katedrës (siedhe kryetar 1966-1969). Kjo domethënë se mund të themi që Eriku ka marrë pjesë në modernizimin e lëndës së gjuhësisë pas Luftën së Dytë Botërore.

Dhe ky modernizim i lëndës së linguistikës në Harvard dhe në Çikago është i lidhur me arbërishten e Italisë. Xhoshua Watmo ishte eksperti më i madh i kohës së tij për gjuhët e lashta të Italisë, por me modernizimin e gjuhësisë interesi u përqendrua më tepër në teoritë ashtu si në gjuhët moderne. Dhe, si një gjuhë moderne në vendin e lashtë të Italisë, arbërishtja ishte tema e tezës së doktoratës së Erikut. Disertacioni i Erikut ka qenë vetëm për fonologjinë e të folmës arbërishte të fshatit Vakaric (italisht Vaccarizzo Albanese), por me këtë temë arbërishtja u bë pjesë e gjuhësisë moderne. Për kohën e atëhershme është

me interes të përmendim një diskutim midis Erikut dhe mentorit të tij. Në disertacionin e tij, Eriku ka përdorur termin "contoid" (kontoid) për tingujt bashkëtingullorë në përgjithsesi, d.m.th. zhurmët siedhe sonorantët me përdorime bashkëtingëllore. Prof. Whatmough e kundërshtoi neologjizmin, por Eriku e mbrojti sepse e gjeti në librin e Kenet Pajkut (Kenneth Pike) *Fonetikë*, që atëherë ishte relativisht i re (1943). Dmth. se Eriku ka përdorur metodologjinë më e moderne të asaj kohe për analizën e arbërishtes.

Në vitet '50, '60, '70, deri më 1988, Eriku hulumtonte gjuhën arbëreshe në çdo fshat e Italisë. S'ka fshat të Itali ku flitet arbërisht ku Eriku nuk ka mbledhur material. Edhe ka botuar mjaft artikuj për të folmet si edhe për etimologjinë, dhe veçanërisht një vepër kapitale për numërorët e shqipes si gjuhë indoevropiane (Hamp 1992). Në këtë artikull, Eriku botoi të dhënat nga 42 burime, 15 gegnisht dhe 27 toskërisht, nga të cila ai vetë kishte mbledhur 4 për gegnishten (Gusî, Tetovë, Tuz, dhe Shalë [të dhënat nga Shala i mblodhi nga një emigrant në Jugosllavi]) dhe ai vetë kishte mbledhur 16 për Toskërishten. Dhe nga të 27 burimet toske, 17 ishte arbërisht nga Italia. Dmth. se për rekonstruksionin e historisë së numërorëve në gjuhen shqipe 40% nga të dhënat janë nga Italia. Këto të dhëna kanë shumë vlerë për rindërtimin e situatës jo vetëm në shqipen e përbashket, por edhe në indo-evropianishten. Eriku gjithnjë insistoi që dialektet më të veçuara nga qendra kanë të dhëna shumë të vlefshme, të cilat nuk gjenden në ndonjë vend tjetër, dhe me këtë edhe shqipja për gjuhët indoevropiane si edhe arbërishtja për gjuhën shqipe kanë rëndësi të madhe. Për arbërishten Eriku ka shkruar se të dhënat janë shumë divergjente dhe me një rëndësi të madhe kulturrore (Hamp 1992:838).

Këtu mund të përmend një artikull tjetër, Hamp (2002), ku të dhënat nga arbërishtja kanë rëndësia më të madhe. Ky artikull grumbullon të dhënat për njëanësoret nga arbërishtja e Italisë dhe të Greqisë që Eriku vetë kishte mbledhur në terren për dyzet vjeç. Në këtë artikull, Eriku tregon begatinë e sistemit njëanësor të shqipes, rrugat nga një njëanësor indo-europian deri tre në sistemin fonologjik të shqipes së përgjithshme (dmth. para ndarjes gege/ toske) me sëpaku pesë variante. Dhe në këtë artikull, Eriku sugjeroi se sistemi i njëanësorevet së serbishtes ka një substrat lidhur me gjuhën shqipe.

Një gjë tjetër me rëndësi për rëndësi për arbërishten e Italisë për sa i përket albanologjisë moderne lidhet me politikën e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte e pamundshme për Erikun të shkonte në Shqipëri për të mbledhur materiale dialektologjike. Në kohët më të zeza të viteve '80, bile në kongreset ndërkombëtare, si ai i AIESEE-së në Beograd në vitin 1984, shqiptarët

nga Shqipëria nuk guxonin as të rrinin në sallë kur Eriku lexonte kumtesën. E mbaj mend shumë mirë sa ishte tronditur Eriku kur të gjithë shkencëtarët nga Shqiprëria paskëshin ikur në momentin kur ai kishte nisur ta lexonte kumtesën. Eriku mendonte se Brenda delegacionit kishte me siguri një anëtar që ishte i sigurimit. As rrethanat në Jugosllavi dhe në Greqi nuk ishin pa probleme. Por në Itali Eriku kishte mundësi të hulumtonte pa probleme edhe për të folmat më interesante.

Pa tjetër, pas çlirimit, Shqipëria e ka nderuar Erikun ashtu siç e meritonte, dhe, përveç agjentit të sigurimit, gjuhëtarët e Shqipërisë s'kishin asnjë faj. Por në kohën e ndërlikuar të luftës së ftohtë, veçanërisht në vitet '50, arbërishtja në Itali ishte feneri i gjuhës shqipe për perëndimin, dhe përveç kësaj, deri sot janë të folmet me shumë rëndësi për historinë e gjuhës shqipe, si ka treguar Erik Hampi.

Bibliografi

Hamp, Eric P. 1954. Vaccarizzo-Albanese Phonology: The Sound System of a Calabro-Albanian Dialect, PhD dissertation, Harvard University.

Hamp, Eric P. 1992. Albanian. *Indo-European Numerals*, ed. by Jadranka Gvozdanović, 835-921. Berlin: Mouton de Gruyter.

Hamp, Eric P. 1993. Il sistema fonologico della parlata di Varccarizzo Albanese (M. G. Belluscio, ed. & transl., with A. Bilotto). Cozenza: University of Calabria.

Hamp, Eric P. 2002. On Serbo-Croatian's Historic Laterals. *Of All the Slavs My Favorites: Studies in Honor of Howard I Aronson on the Occasion of his 66th Birthday,* ed. by Victor A. Friedman and D. Dyer, 243–50. Bloomington, IN: Slavica. 243-50.

Pike, Kenneth Lee. 1943. Phonetics, a critical analysis of phonetic theory and a technic for the practical description of sounds. Ann Arbor: University of Michigan.

VACCARIZZO ALBANESE
VAKARICI
(Comunita' di origine albanese)
30

Imri BADALLAJ, Prishtinë

MARTIN CAMAJ NË KËNDVËSHTRIMIN E STUDIMEVE ITALO-ARBËRESHE

Abstrakt. Martin Camaj në historinë e shkencës dhe të kulturës shqiptare njihet si një krijues i madh letrar, si pedagog universitar dhe si studiues i veçantë dhe fort i thellë i dialekteve italo-arbëreshe, duke i hulumtuar dhe duke i studiuar ato me një përshkrim e shpjegim sipas modelit funksionalist të shkollës strukturaliste.
Kjo mënyrë e studimit të dialekteve solli rezultate domethënëse dhe fort të rëndësishme, çfarë këtu më poshtë po i vënë në dukje disa nga titujt të studimeve të tij: *La parlata albanese di Greci (1971), Die albanische Mundart von Falconara Albanese (1977), La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese* (1983), bashkë me një përmbledhje tekstesh gojore arbëreshe: *Racconti popolari di Greci (Katundi) in provincia di Avellino e di Barile in provincia di Potenza (1972*), por duke vënë gisht më së tepërmi mbi të folmen e Greçit.
Gjithashtu, po i zëmë ngoje edhe disa nga studimet e veçanta të tij, si: *Zur albanischen Mundart von Barile in der Provinz Potenza (1971), Il bilinguismo nelle oasi linguistische albanesi dell'Italia meridionale (i974), Sprachreste der albanischen Mundart von Villa Badessa in der Provinz Pescara (1975), Per una tipologia dell'arbëresh (1982), Aspetti del plurilinguismo preso gli Arbëreshë d'America (1986) dhe (1989).* Më vonë, për të parën herë në studimet albanologjike, pas gramatikave të Jeronim de Radës u paraqit me gramatikën, të cilën e hartoi në dy variante: në gegërishte dhe në toskërishte, duke mos munguar edhe italo-arbërishtja, të titulluar: *Albanian Grammer (1984*).
Nga vetë titujt e studimeve të përmendur këtu më sipër, shihet qartë, se Martin Camaj është shembulli më i veçantë i studimeve italo-arbëreshe.

Martin Camaj si nxënës i Kolegjit Saverian të Shkodrës, qe i detyruar ta braktisë atdheun për të mos përjetuar të këqijat e regjimit komunist të karakterit stalinist. Në fillim gjeti mikpritje në Jugosllavi, duke i kryer studimet e larta në Beograd, por edhe në këtë shtet nuk e la të qetë UDB-ja jugosllave, për çfarë u detyrua të kalojë në Itali, ku pranë Universitetit të Romës zu vend dhe i thelloi dhe më tej studimet e tij, duke u emëruar edhe asistent i prof. Ernest Koliqit dhe kryeredaktor i *Shêjzave*, i cili pandërprerë insistoi, që Martini të merrej edhe me hulumtime shkencore rreth gjuhës së arbëreshëve, çfarë edhe në kuadrin e ndihmesave mbi studimin e të folmeve arbëreshe një meritë e veçantë i takon vetë Koliqit, këtij studiuesi, që shquhet edhe si krijues fort i madh në fushën e letërsisë, si: në poezi, në prozë e në dramaturgji.

Në saje të njohjes fort të mirë të të folmeve dhe të kulturës arbëreshe në përgjithësi, me kalimin e tij në Universitetin e München-it të Gjermanisë, Camaj

do t'i kushtonte pjesën kryesore të kërkimeve shkencore, pikërisht të gjuhës, të folklorit dhe të krijimeve letrare të arbëreshëve të Italisë. Dhe kështu, që nga fillimi i viteve '60 e deri në fund të viteve '80 ai dha një kontribut të veçantë në njohjen sistematike të të folmeve arbëreshe, me qëllim që të arrinte sa më saktë t'i përshkruante veçoritë më qenësore të trevave të ndryshme dialektore, para së gjithash të atyre më anësore e më të ekspozuara ndaj procesit të asimilimit nga italishtja.

Studimet e publikuara mbi të folmet italo-arbëreshe Camaj i shkroi në gjuhën italiane dhe në gjuhën gjermane me alfabetin fonetik internacional (IPA), ku përdori një metodologji fort të avancuar të gjuhësisë strukturaliste sipas modelit funksional të Claus Haebler-it, por duke qenë vazhdimisht në kontakt edhe me fonologun e njohur Zharko Mulaçiq (Žarko Muljačić), që në ato mote vepronte në Universitetin e Zagrebit dhe të Zarës, duke mos munguar edhe në disa universitete të Italisë, si në Romë, në Napoli, në Firencë, në Milano dhe që nga viti 1973 deri më 1988, si profesor ordinar ligjëroi romanistikë krahasimtare në *Freie Universität të Berlinit*, ku edhe u pensionua me titullin *profesor emiritus.* Gjatë këtyre 30 semestrave, sa qëndroi Mulaçiq në Gjermani, Camaj gjatë punës së tij shkencore qe në kontakte të vazhdueshme, i cili si strukturalist që ishte, nuk mungoi ndikimi i tij edhe tek Camaj, sidomos në studimet me karakter gjuhësor.

Kjo mënyrë e studimit të dialekteve solli rezultate domethënëse dhe fort të rëndësishme.

Po përmendim disa nga monografitë dhe studimet dialektore të Camajt: *La parlata albanese di Greci (1971), Die albanische Mundart von conara Albanese (1977), La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese* (1983), bashkë me një përmbledhje tekstesh gojore arbëreshe: *Racconti popolari di Greci (Katundi) in provincia di Avellino e di Barile in provincia di Potenza (1972*), por duke vënë gisht mbi të folmen e Greçit.

Gjithashtu, po i zëmë ngoje edhe disa nga studimet e veçanta të tij, si: *Zur albanischen Mundart von Barile in der Provinz Potenza (1971), Il bilinguismo nelle oasi linguistische albanesi dell'Italia meridionale (i974), Sprachreste der albanischen Mundart von Villa Badessa in der Provinz Pescara (1975), Per una tipologia dell'arbëresh (1982), Aspetti del plurilinguismo preso gli Arbëreshë d'America (1986) dhe (1989).* Më vonë, për të parën herë në studimet albanologjike, pas gramatikave të Jeronim de Radës u paraqit me gramatikën, të cilën e hartoi në dy variante: në gegërishte dhe në toskërishte, duke mos munguar edhe italo-arbërishtja, të titulluar: *Albanian Grammer (1984*).

Ideja e autorit në këtë *Gramatikë* ka qenë, që ky tekst t'u shërbejë shqiptarëve të ardhur në Amerikë nga troje të ndryshme, që gjithsesi edhe e folmja e tyre ishte me dallime jo të vogla.

Së dyti, ky tekst është edhe një model për gegërishten standarde, por me prirje afruese me toskërishten dhe italo-arbërishten.

Camaj ndonëse larg atdheut për shumë mote, ai i ndiqte të gjitha botimet shqiptare dhe duke parë ndryshimet, që po ndodhnin në evoluimin e gjuhës në këtë periudhë, shkroi këtë *Gramatikë,* që synonte kryesisht marrjen e disa elementeve më qenësore të gegërishtes, për t'i rreshtuar në standardin e shqipes së sotme. Për këtë, me të drejtë disa nga gjuhëtarët më në zë, mendojnë, se synimi i Camajt ishte i drejt dhe i qëlluar, ngase ai insistonte për disa trajta më të prekshme dhe me një valencë më të madhe gjuhësore, që përfshijnë një areal sa më të gjerë shqipfolësish.

Nga i gjithë opusi shkencor i Camajt mbi italo-arbërishten, në pika të shkurta po i vëmë në dukje disa të dhëna mbi veçoritë fonetike-fonologjike dhe gramatikore të shtruara në monografitë e tij, më parë po nisemi me studimin *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino. Firenze, 1971*.

Autori, në këtë studim me karakter dialektor për objekt studimi ka bërë regjistrimin dhe shpjegimin e të folmes arbëreshe të Greçit në gjendjen e fillimit të viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Në vizitën e parë, që e bëri Camaj në këtë katund në gusht të 1967 vuri re, se kishte të bëjë me një idiomë më dalluese nga ato të arbëreshëve të Kalabrisë, që në veshin e një shqiptari të ardhur nga Malësia e Madhe e Shqipërisë, i tingëlloi më ndryshe nga ato të folme, që më parë i kishte dëgjuar me vite të tëra ndër arbëreshët e të gjitha regjioneve të Italisë së Jugut. Ky ndryshim i vërejtur nga Camaj, gjithsesi ishte si pasojë, që grecezët jetuan për shumë vite të izoluar, jo vetëm nga italianët, por edhe nga vetë arbëreshët e regjioneve të tjera.

Gjatë hartimit të kësaj monografie, qëndroi me muaj të tërë midis folësve të Greçit.

Korpusi gjuhësor i kësaj monografie me durim të veçantë është nxjerrë nga përrallat, nga këngët nga tregimet e ndryshme, si dhe nga bisedat spontane të informatorëve të përzgjedhur sipas normave të hulumtimeve të kësaj natyre.

Në këtë monografi autori ka parashtruar një studim të plot mbi të folmen e Greçit, ku së pari bëhet fjalë mbi disa të dhëna rreth katundit Greçi dhe banorëve të kësaj enklave arbëreshe.

Vepra është e ndarë në katër krerë, duke filluar me fonetikë-fonologji,

morfologji, glosar dhe një korpus tekstesh të regjistruar nga informatorët kryesisht të moshuar dhe që përveç arbërishtes nuk njihnin, ose së paku nuk i flisnin në jetën e përditshme gjuhë të tjera. Materia dialektore është regjistruar, duke përdorur alfabetin fonetik internacional (IPA).

Kur e nis monografinë me shpjegimin e veçorive fonetike, së pari trajton sistemin konsonantik, pastaj vazhdon me sistemin vokalik, duke u pasuar me sistemin morfologjik, me tekstet dhe me glosarin.

Në sistemin fonetik, shihet qartë se Camaj tani më ishte i formuar gjuhësisht, që në punën e tij shkencore të fushës dialektore, aplikon një metodologji, që para tij e kishte përdor vetëm Claus Haebler në *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis (1965).*

Martini kishte kontakte të pandërprera me profesor Haebler-in, i cili edhe insistonte, që ky studiues i ri t'i përqafonte metodat më të reja për t'i studiuar të folmet italo-arbëreshe, sepse brenda tyre gjallonin tipare, që çonin drejt njohjes së shqipes së vjetër. Prandaj, me studimin e kësaj së folmeje, Camaj e filloi një frymë të re hulumtimi, çfarë për dialektologjinë shqiptare ishte një risi, sidomos për vetë mënyrën dhe udhën, që çonin në rezultate të qëndrueshme shkencore.

Në fillim të monografisë jepen disa të dhëna gjeografike, historike, demografike dhe kulturore për Greçin dhe banorët e tij, duke vazhduar me përshkrimin dhe shpjegimin e veçorive fonetike-fonologjike, morfologjike, dhe me disa tekste më karakteristike për këtë të folme. Edhe fjalori i vendosur në fund të këtij studimi monografik, sjell veçori dhe karakteristika, që për këtë të folme janë dëshmia më e mirë e vetë evoluimit të folmes, që Martin Camaj e bëri objekt studimi.

Kur merr dhe shpjegon autori veçoritë gjuhësore të kësaj së folmeje niset me shpjegimin e sistemit tingullor, duke prekur edhe disa dukuri fonetike, si theksin, sonorizimin, shtesat dhe rëniet e tingujve, kuantitetin vokalik, elizionin, apofoninë, metafoninë, asimilimin, dhe ndonjë dukuri tjetër, që për këtë të folme mund të jenë pasqyrë e qartë si një idiomë skajore e italo-arbërishtes.

Në sistemin tingullor ka regjistruar 29 fonema konsonantike dhe 6 vokale kardinale, duke munguar nyjëtimi /*y*/-së, por duke u realizuar me alternimin e saj në fonemën /*i*/. Mirëpo, në saje të realizimit të kuantitetit vokalik, që në këtë idiomë dialektore ka vlerë fonologjike, dalin 11 fonema vokalike: /i/, /i:/; /u/, /u:/; /e/, /e:/, /o/, /o:/; /ə/; /a/, /a:/.

Në sistemin konsonantik të kësaj së folme realizohen dy fonema, të cilat dalin jashtë sistemit fonetik të mbarë shqipes. Këtu është fjala për nyjëtimin e *sonantes frikative-uvulare/γ/*, që nëpër të folme të tjera nyjëtohet *ll: maγ < mall*

(it. mago), moγa < molla (la mela), ʃkaγa < shkalla (scala), baγt < ballt (la fronte), msaγa < msalla (il tavoglia), koγa < kolla (la tosse) etj.

Si sonante laterale autori i monografisë brenda kësaj së folmeje i ka gjetur të realizuara fonemat /l/ dhe lj/ʎ/. Pra, dy tipa të l-së dhe jo si në shumë të folme italo-arbëreshe dhe arvanite, që nëpër të folmet e tyre realizohen tre tipa*: l, ll dhe lj(ʎ), si p.sh.: biʎ(figlia), dieʎ(ragazzi), vaʎ(oglio), kueʎ(cavallo), ʎepur (lepre), gʎuri (ginocchio)* etj.

Njësitë gramatikore, sidomos ato morfologjike në këtë monografi shtrohen dhe shpjegohen në masën e duhur, duke filluar që nga emri me të gjitha kategoritë gramatikore, çfarë vë në dukje se disa emra që në shqipen standarde janë të gjinisë femërore, në këtë të folme dalin si emra mashkullorë: *fuRi, fofi, kəpurði,buzi, kafeu* e ndonjë tjetër.

Ndërsa asnjanësat ruhen si në fazat më të hershme të mbarë shqipes, ku edhe me këtë rast po i përmendim disa prej tyre. *ujət, vaʎt, kʎumft, trut, baγt, t'pirt* etj. Pra, emri ruan të tria gjinitë, ku më bindshëm vërtetohen edhe në tekstet të regjistruar nga informatorët, që kryesisht nuk kanë bërë lëvizje jashtë Greçit.

Sa i përket sistemit rasor, Camaj funksionalisht në këtë të folme dallon tri rasa: nominativin, akuzativin dhe margjinalen, çfarë do të thotë, se gjenitivin, dativin dhe ablativin i sheh në një segment rase. Ndërsa vokativi, sipas tij, nuk ndryshon nga nominativi. Pos tjerash ai shtron edhe një pasqyrë të të gjitha mbaresave emërore në numrin njëjës dhe në nurin shumës, në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar:

sing.	*m.*		*f.*		*n.*	
	pashq.	*shq.*	*pashq.*	*shq.*	*pashq.*	*shq.*
nom.	__	*-i -u*	__	*-a -ia*	__	*-t -it*
akuz.	__	*-in -un -n*	__	*-an -n*	__	*-t -it*
margj.	*–i -u*	*-it -ut -t*	*-a –ia*	*-s*	*-i -ua –ui*	*-uat -uit*

pl.	*m.*	*f.*
	pashq.	*shq.*
nom.	__	*-t -it*
akuz.	__	*-t -it*
margj.	*–ua -ui*	*-uat –uit*

Në strukturën e numërorëve është për t'u vënë në dukje rendi i shumëfishtë. Nga *e 20-ta, dizeta, trizeta, katërzeta*, por nga *1 deri 9 numërojnë me dhjetëshe, qindëshe dhe mijëshe*.

Numërori 3 ka gjini: *tre trima-tri kopiʎe, tre Ruʃ- tri trku:z* etj.

Kapitullin e mbiemrit Camaj e ka trajtuar mjaft gjerësisht. Kjo njësi

gramatikore hapet me përkufizimin përkatës dhe vazhdon me llojet e tyre, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në shkallët e mbiemërore.

Përemrat janë shtruar dhe shpjeguar, duke i parë të klasifikuar: në përemra vetorë, dëftorë, pronorë, lidhorë, pyetës dhe në të pakufishëm. Te përemrat vetorë veta parë e shumësit del me *na*, d.m.th. ruhet trajta e shqipes së vjetër, të cilën formë e hasim edhe në shumë të folme të tjera. Veta e parë njëjës del me *u* dhe jo me *unë*: //*di: u – di unë*//.

Në sintagmën e përemrit dëftor+emër, trajta e shquar varet nga përemri, çfarë do të thotë, se emri mbetet gjithmonë në trajtën e pashquar: *ki ka:ʎ - ky ka:l, kte ka:ʎ - këtë ka:l, ktia kaʎî – këtij kali* etj.

Nga përemrat e pakufishëm autori përmend këto forma: *ndoɲə* (ndonjë), *tietri* për gjininë mashkullore dhe *tietra* për gjininë femërore.

Përemrat pronorë në të folmen e Greçit kanë dy mënyra të lakimit: lakimin bashkë me një emër, ku përemri pronor përdoret si mbiemër dhe kur janë vetëm, lakohen si emra në trajtën e shquar. Edhe përemrat pyetës dhe lidhorë nuk janë lënë anash, të cilët konkretizohen me shembuj në kontekst.

Nga parafjalët autori i monografisë ka veçuar: *ka, nd, ndën, nden, ma, m, mbi* e ndonjë tjetër. P.sh.: //*u viɲ ka katundi // ish nd katund// nden ʃpi:s (poshtë shtëpisë) // m-na (nga na) //* etj.

Kapitulli ku bëhet fjalë mbi foljen dhe kategoritë gramatikore të saj përfshin numrin më të madh të faqeve të këtij studimi dialektor dhe pa dyshim shpjegimet rreth këtij segmenti gramatikor janë më të thelluara dhe fort të vëmendshme, ku për secilën kategori gramatikore të kësaj pjese të ligjëratës shtrohen shembuj, të cilët reflektojnë veprime a gjendje nga situatat ndër më të ndryshmet.

Problemin e klasifikimit të temave foljore dhe të zgjedhimit të tyre në të gjitha kohët e mënyrave, të cilat gjallojnë në këtë idiomë dialektore, autori është mbështetur në mbaresat foljore, në ndërrimet apozicionale të vokaleve dhe të konsonanteve si dhe në tipat e rrënjës foljore. Me ndërrimet e vokaleve shpjegon fenomenet e *apofonisë* dhe të *metafonisë*. Ndërsa me alternimin pozicional të konsonanteve janë vënë në dukje: *palatalizimi* dhe *asimilimi*, që si në kundërvëniet e njëjësit dhe të shumësit tek emrat edhe në sistemin foljor kanë funksion morfologjik.

Në të folmen e Greçit mënyrat e foljes janë pesë: *mënyra dëftore, mënyrës lidhore, mënyra dëshirore, mënyra kushtore* dhe *mënyra urdhërore*. Ndërsa si forma të pashtjelluara përmenden *participi* dhe *gerundi*. Nuk e di pse Camaj nuk e përmend fare edhe infinitivin, i cili mjaft sporadikisht, por gjallon

edhe në këtë idiomë dialektore, si edhe në shumë të folme të tjera italo-arbëreshe (shih*:* Imri Badallaj & Mario Massaro, në *Chieuti e la sua parlata arbëreshe, Apricena, 2011;* Francesco Altimari, në *Gjurmë të paskajoreve të shqipes në arbërishten e Italisë: Përqasje diakronike,* në *Çështje të studimeve diakronike të shqipes (ASHAK), Prishtinë, 2010;* Imri Badallaj, *La parlata albanese di Casalvecchio di Puglia, Prishtinë, 2017).*

Fjalorthi i kësaj së folme i vendosur në monografi nuk është gjithë-përfshirës, por autori me një kujdes fort të veçantë ka bërë një përzgjedhje të fjalësit, i cili pasqyron dendurinë e përdorimit të leksemave, që grecezët i përdorin gjatë komunikimit të tyre në të gjitha situatat, kur ata komunikojnë mes vete dhe me arbëreshët e katundeve dhe të regjioneve të tjera.

Monografia *La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino* përmbyllet me biblio-grafinë e konsultuar nga autori.

Monografia *Die albanische Mundart von Falcunara Albanese* pa dritën në Munchen më 1977, në të cilën në mënyrë fort të thukët shtron dhe interpreton shkencërisht të gjitha veçoritë e të folmes arbëreshe të katundit Falkunara. Me-njëherë pas disa të dhënave historike, gjeografike, dhe etnologjike përimtohet fonetika dhe fonologjia, sidomos gramatika gjerësisht dhe thellësisht përmban një analizë të gjithanshme, duke mos lënë pa i regjistruar dhe shpjeguar edhe ndikimet e italishtes mbi këtë idiomë dialektore. Sidomos bilinguizmi është parë te folësit e Falkunarës, si nj dukuri gjuhësore, e cila nuk mungon, pothuajse edhe në të folmet e tjera italo-arbëreshe.

Tekstet dhe fjalori, që janë vënë në këtë studim, pasqyrojnë vërtetësinë e studiuesit gjatë regjistrimit të materies gjuhësore me të gjitha nuancat e artikulimit fonetiko-fonologjik.

Monografinë e tretë Camaj e titulloi: *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia Potenza,* Rende 1993.

Ky studim dialektor ishte monografia e fundit, ku bëri përshkrimin e të folmes arbëreshe të katundit Shën Kostandin, i cili gjeografikisht zë vend në Provincën e Potencës, por për nga veçoritë gjuhësore kjo idiomë përafrohet me të folmet e tjera italo-arbëreshe të provincës së Kozencës.

E folmja e Shën Kostandinit u hulumtua nga Camaj me një distancë kohore prej tri dekadash, duke aplikuar metodën strukturaliste, metodë kjo, siç kishte vepruar edhe me monografitë e tjera po të kësaj sfere gjuhësore.

Në këtë vepër Camaj bëri përpjekje të veçanta, që libri të kuptohet sa më lehtësisht nga përdoruesit, e sidomos për ata arbëreshë, që dëshirojnë ta avancojnë të folmen e tyre arbëreshe

Libri përmban shpjegime të hollësishme të aparatit të teksteve me një transkriptim fonetik me alfabetin IPA.

Interpretimet krahasuese dhe zhvillimet historike të veçorive gjuhësore brenda kësaj së folme janë shtruar në mënyrë fort të hollësishme. Sidomos funksionet e kategorive gramatikore janë shtjelluar në gjerësi dhe thellësi, çfarë autori dhe ka konstatuar, se e folmja e Shën Kostandinit cilësohet si një idiomë dialektore, që në thelb ka karakter të fort konservativ.

Prandaj, Martin Camaj përveç krijimtarisë tepër të suksesshme letrare edhe në fushën e studimeve gjuhësore, me plot meritë zë një vend në majat e arritjeve të studimeve gjuhësore.

Bibliografia

Alfabetzzazione Arbëreshe, vëll. I, II, AIADI (a cura di), Lungro, Edizione Il Capitello, Torino

Altimari, F., *Studi linguistici arbëreshë, Quanderni di Zjarri,* vol. 12, San Demetrio Corone, 1988

Badallaj, I., *E folmja arbreshe e Kasallveqit,* Prishtinë, 2017

Badallaj, I., *Sistemi vokalik i të folmes së Kazallveqit,* Jeta Arbëreshe, 80, Eianina, 2016

Badallaj, I., *Distribucioni i fonemave konsonantike në arbërishten e Kasallveqit,* në JA, nr. 81.

Badallaj, I., *Disa dukuri fonetike në arbërishten e Kazallveqit,* në JA, 83, Eianina, 2017.

Badallaj, I., *Vrojtime gjuhësore, Prishtinë,* 2017.

Camaj, M., *La parlata albanese di Greci in Provinzia di Avellino,* Firenze, 1971

Camaj, M., *Die aalbanische Mundart fon Falkunara albanese,* München, 1977

Camaj, M., *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia di Potenza,* Rende, 1993

Camaj, M., *Racconti popolari di Greci (Katundi) in provincia di Avellino e di Barile (Barili) in provincia di Potenza a cura di Martin Camaj,* Tradizioni popolari degli albanesi d'Italia, vol.III, Roma, 1972

Çabej, E., *Italo-Albanische Studien,* Universität Wien (Doktorat), 1933

De Rosa, L., *Elementi di grammatica albanese, Varuante Arbëreshe del Molise,* Rur, 2005

Giordano, E., *Gramatikë Arbëreshe,* Manduria (Ta), 2005

Giordano, A., *Shënime mbi të folmet arbëreshe të Eianinës dhe të Frasnitës,* JA, nr.82, Eianina

Hamp, E., *La parlata di Vaccarizzo Albanese,* Roma, 1944

Ismajli, R., *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706),* Prishtinë, 1985

Lambertz, M., *Italo-albanische Dialektstudien,* in Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung (1923-1925).

Massaro, M. – Badallaj, I., *La parlata albanese di Chieuti,* Apricena, 2011.

Solano, F., *La parlata albanese di Firmo,* Quenderni di Zjarri, 4, S. Demetrio Corone, 1979.

Shkurtaj, Gj., Ligjërimet arbëreshe, Tiranë, 2006.

Topalli, K.. *Fonetikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 2007.

Topalli, K., *Gtramatikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 2012.

Remzi PËRNASKA, Tomorr PLANGARICA, Paris

LUIGJ-LYSJEN BONAPARTI – GJUHËTARI QË VËZHGOI, PËRQASI E DËSHMOI EDHE PËR GJUHËN SHQIPE DHE TË FOLMET E SAJ

Abstrakti : *Luigj Lysjen Bonaparti (1813-1891), gjuhëtar e dialektolog krahasues, është ndër ata dijetarë europianë të shekullit XIX që sollën informacione, dëshmi e interpretime me vlerë edhe për gjuhën shqipe e të folmet e saj. Me prurje shkencore sa jashtë fushës së gjuhësisë (në histori, etnologji, por edhe në kimi, mineralogji etj.) e po aq edhe në fushën e gjuhësisë (me shqyrtime e përkushtim të veçantë për baskishten, finlandishten, të folmet e gjuhës angleze dhe gjuhëve romane etj.), ai lë trashëgim në fondin e albanologjisë, si këngën e fundit të mjellmës, edhe shkrime që marrin në shqyrtim këtë gjuhë dhe veçanërisht të folmet arbëreshe. Nxjerrja në pah dhe diskutimi në lidhje me vlerat e këtij kontributi ndihmon për të plotësuar pamjen e ngrehinës së mendimit albanologjik; kjo përkujdesje është njëherazi edhe respekt për ato kontribute dhe përmasën e atij dijetari (autor i 216 vepërzave për kimi dhe gjuhësi, në frëngjisht, italisht dhe anglisht, midis të cilave një fjalorth i 70 gjuhëve - ndër to edhe shqipja - që është i dobishëm dhe sot).*

Ka personalitete që në fushën e kërkimit, falë aftësive e interesimeve ngulmuese të tyre, synojnë sektorë të shumtë e të ndryshëm të kërkimit shkencor, madje edhe të largët e pa lidhje të drejtpërdrejta me njëri-tjetrin. Vepra e tyre e shkruar dhe angazhimet e tyre për njohje e lëvrim në fusha të ndryshme përfton një lloj enciklopedie mbresëlënëse, që ngjall adhurim e respekt, por që, nga ana tjetër, të imponon mbajtjen e një lloj distance të domosdoshme për ta perceptuar atë në tërësinë e saj; ndikon gjithashtu kjo distancë për të mos pasqyruar sa duhet në gjerësi e thellësi pikërisht ato kontribute.

Rastis që këtij realiteti të gjerë shkencor, t'u shtohen edhe tregues e përmasa të tjera jashtëshkencore të rëndësishme, që lidhen me kontribute dhe angazhime të natyrës sociale, politike etj. Në këto raste, rrokja e plotë e vlerave të personalitetit përkatës shfaqet edhe më problematike, duke e bërë edhe më të detyrueshme pasqyrimin tërësor të profileve të tij, por edhe më të vështirë vetë pasqyrimin. I tillë shfaqet personaliteti i princit[1] Luigj Lysjen Bonaparti, pinjoll

[1] Ndodh hera-herës, gjithsesi jo shpesh, që personaliteteve që mbajnë tituj trashëgimie a ofiqe zyrtare, t'u krijojë përkatësi në fushën e shkencës edhe titulli që bashkëshoqëron emrin ; dhe jo vetëm për forcë zakoni, u mbetet ai emërtim edhe më tej ; dhe raste të tilla kemi edhe në fushën e albanistikës, ku titujt *princ, baron* a *konsull* mbeten pjesë e emërtimit të përmendjes së tyre. Ndodh kjo gjë edhe me Luigj Lysjen Bonapartin, i paraqitur qysh më 24 maj 1897 në gazetën "Shqipëria" të Bukureshtit me njoftimin: "Për shqiptarët ka shkruar edhe Princi Lucien Bonaparti, nip' i Napoleonit të math"; e në tetor të po atij viti:

i familjes Bonaparti, djali i vëllait të dytë të Napoleon Bonapartit.

Aureola e dijetarit, si qokë më domethënëse e personalitetit kompleks të L.L. Bonapartit

Të distancuar në kohë, pas njëqind e ca vjetësh pas vdekjes së L. L. Bonapartit (1891), emri i tij mbetet sërish i pranishëm në mjedisin shkencor shqiptar (por sigurisht edhe përtej këtij mjedisi) me aureolën e studiuesit, shkencëtarit, dijetarit e intelektualit të shquar të asaj kohe, edhe pse pjesë e personalitetit të tij janë edhe një sërë treguesish të tjerë të natyrës së hierarkisë sociale, politike, të prejardhjes, trashëgimisë etj. Mbizotërimi i vlerave *të* kërkimit shkencor dhe *për* kërkimin shkencor duket se i kalon në plan të dytë treguesit e tjerë: treguesit në lidhje me origjinën - është me origjinë italiane, korsikane, franceze a tjetër (në fakt, rastësisht ka lindur në Angli, në Thorngrowe (Worcestershire), më 4 janar 1813, ndërsa prindët e tij mbaheshin peng nga mbretëresha e Anglisë[2]; në raport me prejardhjen a trashëgiminë - nip i Napoleon Bonopartit, por i biri i një tjetër personaliteti që shkëlqeu veçanërisht në fushën e kulturës, Lysjen Bonapartit, i cili, po ashtu, me një jetë të vrullshme, me ulje-ngritje pasurore e administrative, la gjurmë në mjediset e kulturës me veprën e tij letrare, më shumë sesa me funksionet administrative e publike.[3]

Edhe për Luigjin gjurmët mbeten përtej origjinës, shkallës sociale a

"Shkronjëtorë që kanë shkruar për shqiptarët: Ndë Angliterë: Princi L. L. Bonaparte [nga fëmijë e Napoleonit të math]". Gjithsesi, nëse në kohën kur shkruan e botuan titulli bartte një lloj peshe a sugjestioni në raport me lexuesin, sot e kësaj dite janë kontributi në shkencë dhe vlera e studimeve ato çka u kanë dhënë jetëgjatësi emrit dhe personalitetit; është sidomos kjo e dhënë që u qëndron si aureolë që i bën të dallueshëm e që nxit respekt e adhurim të breznive.

[2] Shih për të dhëna më të hollësishme Artan&Remzi Përnaska, "Louis-Lucien Bonaparte, gjuhëtar dhe dialektolog krahasues (Me rastin e 120-vjetorit të vdekjes", në Hylli i Dritës, 3, 2011, ff. 93-113).

[3] Lysjen Bonaparti merrej me letërsi, shkroi disa vepra, ndër të cilat *La Tribu indienne, ou Eduard et Stellina*, roman, Paris, 1799, që u përkthye në anglisht e spanjisht; *Charlemagne ou l'Eglise sauvée*, poemë epike me 24 këngë, Paris, 1815, përkthyer në anglisht*; La Cyméïde ou la Corse sauvée*, Paris, 1819, poemë me 12 këngë; *Aux citoyens français membres des collèges électoraux*, Le Mans, 1834*; La vérité sur les Cent-Jours*, Paris, 1835; *Mémoires de Lucien Bonaparte, Prince de Canino, écrits par lui-même*, Paris, 1836; *Le 18 Brumaire*, Paris, 1845 (pas vdekjes). Ka treguar interes të veçantë për botën etruske, siç dëshmojnë një numër shkrimesh, si *Mémoire sur les vases étrusques*, Paris, 1836, etj. Kjo veprimtari kulturore e shkencore është, ndër të tjera, arsyeja që u bë anëtar i Akademisë Franceze në degën e gjuhës dhe të letërsisë franceze (1803).

ofiqeve zyrtare, megjithëse pati një jetë jo pak aktive si politikan[4] dhe meritoi një sërë titujsh nderi.[5]

Luigj Bonaparti mbetet personalitet në radhë të parë i shkencave natyrore, më tej atyre gjuhësore, madje me kontribute të spikatura në studimet baske e po ashtu me kontribute në fushën e albanistikës, sidomos për studimet e të folmeve arbëreshe.

Ai qe jo vetëm një kimist i talentuar (shpiku *valeriatanën e kinkinës*), por edhe gjuhëtar botërisht i njohur, specialist i gjuhëve finlandeze, baske dhe i dialekteve të anglishtes dhe gjuhëve romane. Ka pasë marrë pjesë në Mbledhjen e parë të shkencëtarëve italianë në Piza.

Është autor i 216 vepërzave për kimi dhe gjuhësi, në frëngjisht, italisht dhe anglisht, midis të cilëve një fjalorth të 70 gjuhëve (ndër të cilat edhe shqipja), që është i dobishëm edhe sot.[6]

Në fakt, këta dy dhjetëvjeçarët e fundit personaliteti dhe kontributet e Luigji Bonapartit kanë qenë jo pak herë në tavolinën e punës së studiuesve tanë, qoftë për t'u studiuar enkas e drejtpërdrejt, qoftë për të plotësuar pamjet dhe kontekstet e përftimit të dukurive të ndryshme, në të cilat vepra e Bonapartit sjell ndihmesa. Le të përmendim kalimthi studimet e konsideratat e shprehura për Bonapartin edhe nga Xhevat Lloshi[7], Shaban Sinani[8], David Hosaflook-u[9], si dhe botimin e bërë nga Bejtulla Destani në Londër[10]. Le të theksojmë nga ana

---

[4] L. L. Bonaparti qe deputet i Korsikës në Asamblenë Kombëtare të Francës (1848-1849); përfaqësues i popullit të departamentit të Senës (1849-1851); senator (1852); president i Këshillit të Përgjithshëm të Korsikës (1867-1870).

[5] I ishin akorduar këta tituj nderi : *Komandant i Madh i Legjionit të Nderit* (3 janar 1860); *Kryqi i Madh i Legjionit të Nderit në Francë* (1852); *Princ* dhe *Lartësi perandorake i Oborrit* (1852); Pension i veçantë prej mbretëreshës së Anglisë; *Doktor Nderi* për të drejtën civile nga Universiteti i Oksfordit.

[6] Për një përshkrim më të hollësishëm të të dhënave familjare e për shkollimin e hapat e parë në kërkimin shkencor të L.L. Bonapartit shih Artan&Remzi Përnaska, art. i cit.

[7] Xhevat Lloshi, Përkthime shqip nën kujdesin e Princit Bonaparti, në gazetën Shqiptarja.com, 19 qershor 2016.

[8] Shaban Sinani, Alfabetet si kufi: kur dhe si u shthurën qarqet, në *Studime, Revistë për studime filologjike*, 21, Prishtinë, 2014, faqe 163-192.

[9] David Hosaflook, Lëvizja Protestante ndër shqiptarët, 1816-1908, ISShP Shkup, 2019, f.185-189.

[10] Kemi parasysh botimin prej Bejtulla Destani (red.) Albanian Dialects – Price Louis-Lucien Bonaparte, London 2014, botuar nga The Centre for Albanian Studies; si dhe pasqyrimin e këtij botimi në median e shkruar në shqip, në Myzejen Myftari, *Dialektet e shqipes, në një studim të rrallë të Princit Lui Bonapart*, në *Gazeta 55*, 30. 07. 2014, e rimarrë në disa site në shqip.

tjetër ndjesën tonë që nuk kemi patur mundësi ta njohim në mënyrë më të plotë studimin e këtij personaliteti në institucionet kërkimore të studiuesve e filologëve arbëreshë në universitet në Itali, por gjithsesi të lajmuar e përmendur në studimet tona.[11]

Kontributet e Bonapartit si shfaqje e modelit humboldian në shqyrtime e botime

Në dijeninë tonë, studiuesit i janë qasur këtij personaliteti në kuadër të konteksteve të dukurive që kishin të fokusuara për studim, por pa shqyrtuar në tërësi kontributet e tij. Ndaj një vështrim më i plotësuar mbetet ende një synim i së ardhmes; madje ky synim më tërësor mund të harmonizojë dhe përftojë një ide më të saktë për natyrën e veprës së Bonapartit, duke marrë parasysh edhe studimet e tij për baskishten dhe gjuhë a të folme të tjera (studime të cilat ekzistojnë tashmë, por duhen shqyrtuar), për të krijuar një pamje më të plotë jo vetëm për lëndën e studimit, por edhe metodologjinë e përdorur prej tij.

Spikat veçantia e këtij gjuhëtari krahasues në dy plane:

Së pari, në kërkimet e tij vetjake gjuhësore, si filolog krahasues dhe dialektolog, kryesisht si baskolog, madje ndër baskologët më në zë të kohës. Ai renditet bashkë me Humboltin si baskologu më i shquar: hartoi e botoi një gramatikë të gjuhës baske; studimin "Le verbe basque selon huit dialectes de l'Euskara"; përkthimin në baskisht të "Cantique des cantiques" (Londër, 1863) etj.; hetoi, gjithashtu, të folmet e italishtes dhe të anglishtes (edhe pse jo në nivelin e baskishtes, megjithëse me të njëjtën metodologji). Si filolog krahasues, më qartë shfaqet me "Specimen lexici comparativi omnium linguarum europaearum. Opera et studio Ludovici Luciani Bonaparte, Florentiae, 1847", dhe me shkrime për leksikun e vreshtarisë, zvarranikëve etj. Përbën vlerë të veçantë kjo kahje e punës së tij, sepse fiksoi, fotografoi gjuhë, dialekte dhe të folme të

[11] Kemi parasysh referencat që jep Sh. Sinani në artikullin e cituar, për: Gëzim Gurga, "Il Vangelo di San Mateo ; variante inedita del manoscritto di Piana", edizione critica, tezë doktorate, Universitá degli Studi della Calabria, Cosenza 2006. Idem, "Aspetti linguistici del manoscritto dell'Anomino Epirota", në Atti del XXVIII Congrèsso Internazionale di Studi Albanesi, 16-19 Maggio 2002 (a cura di M. Mandalà), Universitá degli Studi di Palermo, Palermo 2003, pp. 281-289 ; gjithashtu Dorëshkrimi i pabotuar i Anonimit Epirot, në Studi in onore di Antonio Guzzetta (a cura di Francesca di Miceli e M. Mandalà), Universitá degli Studi di Palermo, Palermo 2002, pp. 203-217. Gjithashtu, Maria Tereza Borgia, Ungjilli i Shën Mateut, i përkthyer në arbërisht nga Giuseppe Camarda, botim kritik, tezë doktorate, Universitá degli Studi della Calabria, Cosenza, 2006.

ndryshme të Europës në fillim të shekullit XIX, duke lënë material për studime të mëtejshme për historinë e gjuhëve.

Së dyti, në përpjekjet e tij si përqokës, shqyrtues e botues i materialeve që dëshmonin në plan sinkronik gjendjen e të folmeve të gjuhëve të ndryshme (mes tyre edhe të folmeve të shqipes, kryesisht të arbërishtes, madje dëshmimin e tyre edhe përmes përdorimit në tekstet biblike të përkthyera enkas në ato variante gjuhësore)[12]; por edhe në ndjekjen me vëmendje e pasion të studimeve gjuhësore, duke lënë dëshmi të mrekullueshme që pasqyrojnë gjendjen e gjuhësisë krahasuese për gjuhët indoeuropiane deri në atë kohë.

Pati një shtypshkronjë të vetën, ku botoi një pjesë të librave të tij dhe përkthime, me një cilësi shumë të mirë të letrës e botimit, falë edhe dijeve të tij të thelluara si kimist; botoi dy katalogë librash gjuhësorë: "Catalogues des ouvrages de la linguistique européene", édité par Le Prince L.L. Bonaparte, Londër 1858; Deuxième catalogue des ouvrages destinés à faciliter l'étude comparative des langues européenes", 1862; po ashtu edhe "Remarques sur la classification des langues ouraliques", 1878 dhe "Parabola e farëhedhësit (mbjellësit) të Shën Matheut", në 72 gjuhë e dialekte europiane, midis të cilave edhe në gjuhën shqipe, 1857.

Natyra e kërkimeve të tij gjuhësore dhe e botimeve të tij ishte në përputhje me një kahje të suksesshme në fushën e gjuhësisë që ishte themeluar me Humboldin dhe po krijonte një paradigmë a model të suksesshëm në atë periudhë. Ngulmimi për njohjen, regjistrimin dhe publikimin e varianteve të ndryshme të të folmeve të një gjuhe ishte në përputhje me një model, me frymën dhe metodologjinë që po përhapej e dalëngadalë do të mbizotëronte prej prurjeve të Humboltit, i cili "pas zbulimit të gjuhës dhe kulturës baske (pas qëndrimit në Paris, 1797-1799), kishte përvijuar *parimet e përshkrimit gjuhësor modern*: studimi i gjuhëve në sinkroni, studimi deskriptiv dhe jo preskriptiv, rëndësinë e korpusit dhe të informatorëve, ashtu si dhe rëndësinë e kategorive gramatikore që përshkruajnë saktë dukuritë e mirëfillta në gjuhën e studiuar, çka e drejton që të hedhë tutje përligjien e kategorive të gramatikës latine për një gjuhë si baskishtja. Më vonë (1827-1829) ai tenton të rimendojë në tërësinë e saj gramatikën universale".[13]

---

[12] Xh. Lloshi jep të dhëna të vlefshme për këtë tregues të punës së tij dhe e kontekstualizon këtë kontribut në tërësinë e përpjekjeve që bëhen nga personalitete të ndryshme për përkthimet fetare. Shih më gjerë, Xh. Lloshi, art. i cit.

[13] H. Dilberman, W. von Humboldt et invention de la forme de la langue, në *Revue philosophique de la France et de l'étranger*, n° 2, 2006 (konsultuar *en ligne*, shtator 2019).

Me studimet e tij për gjuhën baske, finlandishten, italishten e anglishten, por edhe për të folmet e shqipes, kryesisht të arbërishtes, L.L. Bonaparti ishte pjesë përbërëse e kësaj paradigme shkencore që do të mundësonte më tej status tjetër të vetë mendimit gjuhësor. Nëse do t'i referohemi qëndrimit të Thomas Samuel Kuhn-it, është pikërisht përvijimi i këtyre paradigmave që mundësojnë më tej zhvillimet në kërkimin shkencor.[14] Me sa duket, L. L. Bonaparti i besonte asaj fryme, atij modeli, ndaj rreshtohet si kontribues në të, ishte pjesë e atij qëndrimi që parakuptonte ajo metodologji e re në shqyrtim.

Nëse do të vijojmë shpjegimin përmes Kuhn-it, sipas të cilit "perceptimi i shkencëtarëve ndryshon në ndjekje të revolucionit shkencor (duke shkuar përtej tezës bashelardiane, sipas së cilës "observimi varet prej teorisë që e udhëheq")[15], atëherë mund të pohojmë që shqyrtimet e Bonapartit edhe për shqipen përfaqësonin, në këtë pikëvështrim epistemologjik, një qëndrim të përpunuar dhe tërheqës për komunitetin e studiuesve (konsultimi i fondit të tij të dokumenteve në Çikago mund të sjellë të dhëna interesante e mund të vërtetojë pandehmat e kësaj natyre).

E gjejmë këtë prani të Bonapartit në paradigmën humboldiane në tërë veprën e tij; tejet të shprehur e konkrete edhe në punët e përkujdesjen për sigurimin e materialit për shqipen. Mjaft të kujtojmë disa tregues të pranishëm në shkrimet e tij për shqipen: regjistrimi i të dhënave gjuhësore, teksteve, thënieve e fjalëve drejtpërdrejt në terren, madje aktivizimi i njerëzve sa më të ditur që e kryejnë këtë mision dhe redaktimi, më tej, i materialeve prej redaktorëve kompetentë (le të kujtojmë që redaktimet e dy prej përkthimeve të "Mateut", për shembull, i bëri Dhimitër Kamarda, për *Gramatikën* e të cilit Bonaparti shprehet me një vlerësim të veçantë; apo le të sjellim në mendje faktin se në shkrimin

[14] Në "Strukturën e revolucioneve shkencore" (1962) Kuhn-i ngulmon në idenë që përftimi i një modeli, një paradigme në kërkim përftohet nga autoritetet shkencore në një fushë të caktuar; kjo paradigmë i rigrupon studiuesit për një kohë; por do të jetë zëvendësuar nga një tjetër në vazhdim të një revolucioni shkencor që do të ndryshojë thellësisht mënyrat e të shqyrtuarit. Duke u larguar prej idesë mbizotëruese në vitet 1950, që supozonte një evolucion të vazhdueshëm përmes akumulimit të dijes sipas metodës shkencore në sajë të zbulimeve individuale, për Kuhn-in "forma e re shkencore paraqet një koherencë të brendshme dhe nuk është çështje individuale, ajo është e lidhur me një grup të formuar prej mjeshtrish, bashkëkohës dhe ndjekës të tyre". Në "La structure des révolutions scientifique" ai thekson se një paradigmë/model lind prej një zbulmi shkencor të njohur universalisht, i cili për një kohë i parashtron komunitetit të studiuesve probleme, si dhe zgjidhje" (Kuhn, 1962 :11).

[15] Cituar nga Patrick Juignet, Les paradigmes scientifiques selon Th. Kuhn, në *Philosophie, science et société* [*en ligne*, 2015, konsultuar shtator 2019].

"Shqipja në viset e Otrantos", para se të kalojë në thelbin e shkrimit të vet, Bonaparti falenderon Imzot Rafael Rosin, Vikar i Madh i Kryepeshkopatës së Tarantos që e ndihmoi të sigurojë bashkëpunimin e famullitarëve për të dhënat e shqipes së folur atje – më 1889; le të kujtojmë po ashtu rëndësinë që u kushton të dhënave të gjeografisë dialektore, hartave dialektore, përshkrimit të historisë së bartësve, etj.[16]

Bibliofilia si nxitje për dëshmim të dijes dhe komunikim mes dijetarësh

Gjithsesi, një vlerë të veçantë përbën biblioteka e Bonapartit, vërtet një kujtesë e njerëzimit për gjuhët dhe dialektet që njiheshin deri atëherë (edhe pse e la të pakataloguar, çka u bë më tej nga Victor Collins-i e prej të cilit referohen më tej të dhënat; Collins-i botoi më 1894, në Londër, "Sprovë për një katalog të bibliotekës së të ndjerit Princ Louis-Lucien Bonaparte").

Falë përkushtimit të skajshëm të një bibliofili, falë miqësisë me gjuhëtarët më në zë të kohës, komunikimit të paprerë me antikuarët e librashitësit në vende të ndryshme, Luigj Bonaparti arriti të grumbullojë rreth 15 mijë libra (13657, sipas katalogimit të V. Collins-it) një kullë të vërtetë të babelit.[17] Kur Biblioteka Njuberi (Newberry Independent Research Library) në Çikago e bleu bibliotekën e Luigj Bonapartit (1901), disi me qesëndi gazeta "New York Times" shkroi: "Tani Europa duhet të vijë në Çikago për të studiuar gjuhët e saj dhe historinë e saj filologjike".[18]

Në përbërje të këtij visari shfaqet mbresëlënëse edhe pasuria e fondit albanologjik, me 91 zëra për gjuhën shqipe (nga faqja 710 -715, nga numri 13567-13657 i katalogut), pa llogaritur që në katalog hasen edhe libra të tjerë që kanë të bëjnë me shqipen, të cilëve u duhet t'u shtohen edhe, më së paku, tre ungjij dhe fabula e Farëhedhësit në shqip, që ai vetë e pat botuar në Londër. Shihet, pra, që vetëm pak libra të botuar deri në atë kohë për gjuhën shqipe mungojnë në bibliotekën e vet.[19]

Dëshmi të ndryshme lënë të kuptohet që biblioteka e tij ishte bërë mjedisi i përshtatshëm për konsultim e kërkim i shumë prej studiuesve të kohës. David Hosaflook-u vë në dukje: "Gjuhëtarët më të shquar e vizituan bibliotekën e tij

[16] Për më shumë të dhëna, shih Artan&Remzi Përnaska, art. i cit ; Xh. Lloshi, art. i cit.
[17] Xh. Lloshi flet për 18 mijë tituj të mbledhur nga Bonaparti në bibliotekën e tij; art. i cit.
[18] The Bonaparte Library That Goes to Chicago, New York Times, August 10, 1901. Cituar nga D. Hosaflook, vep. e cit. faqe 145.
[19] Për listën e plotë të veprave aty, shih Artan&Remzi Përnaska, art. i cituar.

për hulumtime. Bonaparti priti, për shembull, Persi Strangfordin (Viscount Persy Smythe Strangford), prej kohësh specialist në çështjet e Turqisë Europiane, Lindjes së Afërt dhe Shqipërisë. Strangford-i studioi librat e princit për shqipen, bullgarishten dhe vllahishten".[20] Po ky studiues, pohon se "Dhimitër Kamarda (filolog dhe redaktor i dy varianteve arbëreshe të "Mateut", botuar me shpenzimet e Bonapartit më 1868-1869 [...] kishte kaluar disa muaj në shtëpinë e Bonapartit në Londër, periudhë gjatë së cilës kishte studiuar koleksionin e botimeve të BFBS-së[21] (ndërkohë që në vitet 1868-1871 Bonaparti i dhuron bibliotekës së BFBS-së disa libra të veçantë, që ishin tri përkthime të "Ungjillit sipas Mateut", secili në një dialekt të veçantë të gjuhës shqipe".[22] Ndërsa Xh. Lloshi thekson: "Emrin e Kamardës (Bonaparti) ka gjasë ta ketë mësuar pas botimit të *Gramatologjisë* së tij më 1864 dhe të *Shtojcës* më 1866. Të dy këta libra gjenden në bibliotekën e Bonapartit, madje edhe një botim fare i vogël, tetë faqe i vitit 1869 "Alfabeti i përgjithshëm shqip-epirotisht". [...] Për variantin në të folmen e Shkodrës tregon, se është mbështetur te veprat e F. Ross-it, ndërsa përmirësimet i ka sjellë nëpërmjet diskutimeve të gjata me të dhe me redaktorin, Gaspër Krasniqi, si dhe duke u këshilluar me punimet e G. Jungg-ut, J. G. Hahn-it e sidomos të K. Kristoforidhit. [...] Duke i sintetizuar të dhënat nga disa anë më del se Kamarda do të ketë qenë në Londër për disa muaj në vitin 1868."[23]

Veçanti të prurjeve gjuhësore që vijnë përmes përkthimeve e studimeve të Bonapartit

Është ngulmuar jo pak tashmë në kontributin e dhënë nga Bonaparti në nxitjen e dëshmimit të veçantive dialektore të të folmeve përmes përkthimit të teksteve biblike në të folme të ndryshme të shqipes, një ndërmarrje me vlerë tejet inteligjente dhe me vlerë të shumëfishtë, sepse dëshmohej e përftohej një tekst që kishte gamë të gjerë përdorimi dhe vihej në proces komunikimi një tekst nga një fushë përdorimi që kishte receptues të shumtë, e për më tepër, një proces përdorimi po ashtu të gjerë. Përvojat e gjuhëve të tjera e kishin provuar efikasitetin e dobishmërinë e këtij procesi për zhvillimin e gjuhës. Gjithsesi, synimi i Bonapartit për përkthimin e copëzave të njohura nga tekstet biblike në të folme

[20] D. Hosaflook, vep. e cit., faqe 144.
[21] D. Hosaflook, vep. e cit., faqe 146.
[22] D. Hosaflook (faqe 144) i referohet fondit BFBS – AR 1869, Apendix 90; BFBS-AR 1871, Apendix 89.
[23] Xh. Lloshi sjell të dhëna më tej edhe për bashkëpunimin e komunikimin e Bonapartit me autoritetet e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja; shih më gjerë, art. i cit.

të ndryshme të shqipes, posaçërisht të arbërishtes, por edhe në të folme të gjuhëve të tjera, kishte synime të natyrës diturore, të *dëshmimit* të gjuhës dhe varianteve të saj në një etapë të caktuar, në një sferë përdorimi të caktuar, të kushtëzuar nga natyra kanonike në komunikim. Kjo prirje e tij rezonon në mënyrë të plotë me interesimet e tij diturore në fushën e gjuhësisë së krahasuar, ndaj *shqyrtimi në mënyrë tërësore* i trashëgimisë së tij në këtë fushë do të ishte qasje më objektive në lidhje me këtë personalitet. Për më tepër, që të dhënat me vlerë për historinë e gjuhës (edhe gjuhës shqipe) ndihmohen më së tepërmi nga prurjet e tij pikërisht përmes atyre dialektore.

Nëse do të shpreheshin përmes pohimit të A. Meillet-së, do të theksonin se "nuk ka histori të gjuhës pa një dialektologji dhe sidomos pa një gjeografi gjuhësore komplete dhe të mirëpërvijuar".[24]

Në materialet e botuara prej tij për shqipen, qoftë në formën e studimeve të drejtpërdrejta (*Albanian in Terra d'Otranto* (1885), dhe i plotësuar e saktësuar më 1891, *Shqipja, greqishtja e re, galo-italishtja, provensalishtja, dhe ilirishtja*[25] *ende në përdorim (në 1889) si ishuj gjuhësorë në krahinat napolitane dhe siciliane të Italisë*), qoftë në përkthimet e teksteve biblike (tri variantet e *Ungjillit sipas Mateut* dhe *Parabola e Farëhedhësit*), qoftë në listën e fjalëve të pranishme në *Vocabularium comparativium...*, (56 fjalët në latinisht, me bashkëpalësat edhe në shqip, por sidomos në listën prej 166 fjalësh, me disa tregues gramatikorë, në shkrimin *Shqipja, greqishtja e re, galo-italishtja...* (faqe 341) apo në variantet e shumta të *Lutjes ndaj Zotit* (14 variantet në të folme të ndryshme të arbërishtes, por edhe në toskërisht, në të folmen e Shqipërisë së Mesme e në shkodranisht) ose në rrëfenjën IX, të Ditës së Parë, të Dekameronit të Xhovani Bokaços) bien në sy disa tregues tejet domethënës, mes të cilëve mund të përmendim: përkujdesja për pasqyrimin e veçantive fonetike të të folmeve arbëreshe, duke u prirur të bëjë edhe inventarin e tingujve-fonema të tyre, për shembull, në rastin kur jep të dhënat për përshtatjen e ortografisë që sipas tij "synon përfaqësim sa të jetë e mundur dhe më të saktë të shqiptimit të dialektit të Piana dei Greci ndryshe në pionite"; përkujdesja për përzgjedhjen grafemore sa më të përshtatshme dhe shpjegimi i atyre përzgjedhjeve që synojnë të pasqyrojnë veçantitë që kanë të bëjnë me nyjëtimin e tingujve të të folmeve, madje duke i përqasur me nyjëtimin e tingujve-fonema të ngjashme a të përafërta të italishtes, frëngjishtes, anglishtes, greqishtes, madje edhe të holandishtes; përkujdesja për të dhënë shpjegime të thukëta në lidhje me natyrën e vendin e

[24] A. Meillet, Bull. de la Soc. De Ling. De Paris, t. XXX, 1929, p. 200.
[25] Me *ilirisht* duhen kuptuar gjuhët sllave të Adriatikut, kryesisht kroatishtja.

theksit në fjalët e thjeshta e të përbëra në të folmet arbëreshe, e prej këtej, edhe veçanti të zanoreve në lidhje me gjatësinë e hundorësinë; përkujdesja për lokalizimin e veçantive fonetike të së folmes në hapësira të caktuara gjeografike, madje edhe në lidhje me moshën e bartësve; e po ashtu, edhe mes formave, në krahasim me hershmërinë e shfaqjes së tyre; etj.

Vështrimi më tërësor e sistematik i kontributeve të L. L. Bonapartit në albanistikë do të duhet të rrokë, pra, jo thjesht kërkimin dhe nxitjen për botim (krahas gjuhëve të tjera) të teksteve biblike, por, më së tepërmi, edhe kontributet e tij përmes dëshmive të natyrës dialektore, përkujdesjen e tij për regjistrimin e botimin e të dhënave për të folme të ndryshme të arbërishtes, madje dëshmitë për veçantitë fonetike, morfologjike, leksikore e sintaksore për të folme të caktuara; e po ashtu, dëshmitë e natyrës së gjeografisë gjuhësore përmes studimit e disiplinimit të të dhënave nëpërmjet hartimit të hartave dialektore për pothuaj 55 ngulime arbëreshe ku shqipja flitej në gjysmën e dytë të shekullit XIX, madje të shoqëruara këto materiale edhe me një sërë të dhënash të tjera historike, etnologjike e antropologjike.

Kërkesa metodologjike e Bonapartit për të parë veçantitë nga njësitë minimale (dhe dhënia e një inventari të plotë tinguj-fonemash) e më tej fjalësh e deri fjalish e tekstesh, bëhet edhe më interesante si trashëgimi, sepse ai u përkujdes, madje e kishte në thelb të metodologjisë së tij të kërkimit, që të vështrojë variacionin ligjërimor nga një e folme në tjetrën; madje, kjo metodologji e çoi deri te dëshmimi e përqasja e gruptëfolmeve, te nëndialektet e deri te dy dialektet bazë të shqipes: toskërishtes dhe gegërishtes.

Vështrimi në mënyrë më tërësore dhe më sistemore i kontributeve të L. L. Bonapartit në momentin e tanishëm përmes konteksteve e teorizimeve epistemologjike të periudhës së tanishme na mundëson ta integrojmë më natyrshëm trashëgiminë e tij në dobi të albanistikës si një vlerë që ndihmoi në përvijimin e një modeli studimor në fushën e dialektologjisë së shqipes, një model i cili ka mundësuar më tej kuota të tjera më të larta në zhvillimin e mendimit gjuhësor. Përvijojnë një status të veçantë kontributet e tij, sepse, *në radhë të parë*, përmes kërkimeve, përshkrimeve e botimeve të Bonapartit kemi të pranishme të dhënat për shqipen, madje për të folme të ndryshme të saj në botime që kishin një gamë të gjerë lexueshmërie në mjediset e specialistëve e studiuesve të kohës në fushën e gjuhësisë, historisë, antropologjisë etj. (përvijohet ky status jo vetëm ngaqë Bonaparti ishte një personalietet i njohur dhe me komunikim intensiv me elitën intelektuale europiane të kohës së tij, por edhe sepse ai në disa raste këto të dhëna i jep krahas gjuhëve të tjera, interesi për të cilat ishte i madh; e po ashtu,

edhe sepse dy nga studimet e rëndësishme të tij për shqipen ai i ka botuar në një prej organeve në zë të kohës, siç ishte revista *Ndërveprimet e Shoqërisë Filologjike); së dyti,* lënda e të folmeve të shqipes kishte kaluar në shqyrtim në "laboratorin" e një studiuesi me emër, siç ishte Bonaparti, një studiues që rreshtohej krahas Humboltit në fushën e studimit të gjuhës baske (edhe shqipja shqyrtohej përmes së njëjtës metodologji të suksesshme, ndaj paraqitjet e tij për të folmet e arbërishtes kishin garancinë më të madhe për të qenë si dije të qëndrueshme për këtë gjuhë në tavolinat e punës së studiuesve europianë; e, nga ana tjetër, ajo lëndë, para se të kalonte në atë laborator, ishte mbledhur, formësuar e përpunuar nga njerës kompetentë, njohës të thellë e dijetarë, si Kamarda, Dorsa, Doçi, etj.); *së treti,* përmes kontributeve të Bonapartit dhe metodologjisë së tij të shqyrtimit, kemi të pranishme në albanistikë jo thjesht praninë e një gjuhëtari krahasues, por një gjuhëtar me veçanti të spikatur në këtë metodologji, me shqyrtime e krahasime jo të së tërës (gjuhës), por të të veçantave, varianteve a varieteteve të saj, siç janë të folmet; e për këtë arsye, një profil më shumë i modelit a paradigmës së studimit për kohën, që mundësoi më tej shqyrtime për nivele të tjera; *së katërti,* integrimi i të dhënave për shqipen në trajtesa e informacione krahas gjuhëve të tjera të Europës, e po ashtu edhe i studimeve për shqipen, krahas botimeve të tjera (madje prania e tyre për konsultim edhe në Amerikë, pas blerjes së koleksionit të librave e dokumenteve nga universiteti i Çikagos), u mundëson atyre dijeve të përvetësohen edhe në kontekste të tjera përtej europiane; *së pesti,* variantet dialektore të mesazheve biblike a të krijimtarisë popullore, por edhe më gjerë, siç ishte fragmenti nga Dekameroni, sjellin të dhëna të rëndësishme jo vetëm për shqyrtimin e njësive të sistemit parësor të shqipes, por edhe atë dytësor, për dukuritë e natyrës stilistike në sfera të ndryshme përdorimore të shqipes, në ligjërimin e folur e të shkruar, por edhe për stilin fetar, atë letrar e më gjerë.

Në mbyllje

Duke vlerësuar kontributet e L.L. Bonapartit në albanistikë, por edhe pasionin e tij si bibliofil, koleksionin e tij tejet të pasur që gjendet aktualisht në bibliotekën e Çikagos, nxitemi të pohojmë se homazhet për përkujtimin e tij në tubime shkencore (apo edhe botimet e studimeve të tij, tashmë) plotësojnë veçse pjesërisht detyrimin shkencor ndaj asaj trashëgimie.

Vëzhgimi dhe puna e drejtpërdrejtë për shqyrtimin e koleksionit të albanologjisë që Bonaparti ka lënë të grumbulluar, ndoshta nxjerrin në pah fakte e

të dhëna që fshehin a bartin ende të papritura që mund të zgjerojnë e thellojnë hapësirën e atyre kontributeve. Elementet e ndryshme paratekstore apo dokumente të caktuara që mund të jenë të pranishme në atë koleksion mund të jenë qoka të tjera përmes të cilave të zgjerojmë dijen për ato kontribute.

Në këtë periudhë të intensifikimit të komunikimit e lehtësirave të shqyrtimit të dokumentacionit, puna dhe zelli i Bonapartit (në kushtet e vështira për komunikim e shqyrtim të kohës) na e bëjnë të pamotivueshme vonesën tonë në gjetjen e shqyrtimin e pasurisë që ai ka lënë si pasojë e bibliofilisë nga ana e tij, e cila kishte rezonuar, madje i kishte zgjeruar hapësirat vetë personalitetit kompleks të tij si studiues e dijetar.

Vonesa e mëtejshmë në këtë rast është justifikim për të shkuarën, dhe jo për të tashmen.

Nëse e arrijmë apo i përafrohemi pasionit të Bonapartit për gjuhët e qytetërimet, madje edhe pasionit, kureshtisë e dashurisë edhe për shqipen, i mundësojmë vetes më tej, në kushtet e epokës sonë, shlyerjen e detyrimit intelektual ndaj së kaluarës, por mundësojmë, gjithashtu, plotësimin e përmasave të modelit që nxit e frymëzon për kërkimin shkencor ky personalitet.

L. L. Bonaparte dhe kontributet e tij e parakuptojnë dhe e meritojnë këtë përkujdesje dhe shqyrtim.

Aljula JUBANI, Tiranë

STUDIME TË FONETIKËS EKSPERIMENTALE MBI SHQIPEN NË UNICAL DHE KONTRIBUTI I PROF. JOHN TRUMPER

Abstrakt. Universiteti i Kalabrisë është një universitet relativisht i ri, i themeluar në vitin 1972, po me kontribut në zhvillimin e kërkimeve albanistike dhe albanologjike. Prania e komuniteteve arbëreshe dhe karriera akademike dhe profesorëve me origjinë arbëreshe ka qenë një shtysë mjaft e rëndësishme në këtë kuadër, ku themeluesi i kësaj "shkolle" Françesco Solano, thirri rreth vetes studiuesit më të përkushtuar e të talentuar, duke filluar me prof. Francesco Altimari-n, me emrin e të cilit fillon edhe numri i amzës i studentëve të regjistruar në degën e tij të studimeve. Prof. Altimari mbetet një autoritet akademik absolut në qarqet shkencore kudo në botë, duke qenë edhe ndër kontrubuesit më të rëndësishëm për çeljen e rrugëve të reja në kërkimet albanologjike për dekada të tëra.
Pas rreth një dhjetëvjeçari, prof. Giovanni Belluscio do të ishte i diplomuari i parë në fushën e fonetikës eksperimentale në UNICAL, me udhëheqës prof. John Trumper. Kështu, prof. Trumper zbuloi edhe nisjen e interesit të tij në kërkimet albanistike e në vitet e ardhshme, së bashku me të tjerë studentë të drejtuar prej tij, do të sillte një kontribut të madh në studimin e varianteve të ndryshme të shqipe, që nga të folmet arbëreshe, por edhe për variante të shqipes në Shqipëri e Kosovë. Kërkimet e tij shtrihen në fushën e fonetikës eksperimentale, të sociolinguistikës e të gjuhësisë historike.

Universiteti i Kalabrisë është një universitet relativisht i ri, i themeluar në vitin 1972, por me kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e kërkimeve albanistike dhe albanologjike. Prania e komuniteteve arbëreshe dhe karriera akademike e profesorëve me origjinë arbëreshe ka qenë një shtysë mjaft domethënëse në këtë kuadër, ku themeluesi i kësaj "shkolle", Francesco Solano, thirri rreth vetes studiuesit më të përkushtuar e të talentuar, duke filluar me prof. Francesco Altimari-n, me emrin e të cilit nis edhe numri i amzës i studentëve të regjistruar në degën e tij të dhe që është një autoritet akademik në qarqet shkencore kudo në botë, duke qenë edhe ndër kontribuesit më të rëndësishëm për çeljen e rrugëve të reja në kërkimet albanologjike për dekada të tëra. Jo rastësisht, me emrin e prof. Altimarit lidhet edhe programi i parë i një doktorature internacionale në Albanologji, me përfshirjen e Universitetit të Kalabrisë, të Palermos, Lecce-s, Tiranës, Prishtinës dhe Shkodrës.

Rreth një dhjetëvjeçar pas prof. Altimarit, Giovanni Belluscio do të ishte i diplomuari i parë në fushën e fonetikës eksperimentale në UNICAL, me udhëheqës prof. John Trumper. Siç tregon vetë prof. Trumper, ai filloi të interesohej për këtë gjuhë tek dëgjonte prof. Solanon të komunikonte me disa studentë

në një kod disi të panjohur për të. Kjo ishte pikërisht arbërishtja. Me drejtimin e temës së Belluscio-s, prof. Trumper zbuloi edhe nisjen e interesit të tij të drejtpërdrejtë në kërkimet albanistike në vitet që do të vinin. Së bashku me të tjerë studentë të drejtuar prej tij, do të sillte një kontribut të madh në studimin e varianteve të ndryshme të shqipes, që nga të folmet arbëreshe, por edhe për variante të shqipes në Shqipëri e Kosovë. Kërkimet e tij shtrihen në fushën e fonetikës eksperimentale, të sociolinguistikës, të fitonimisë dhe të gjuhësisë historike.

Në një artikull, së bashku me Maddalon, trajtojnë identitetin dhe kulturën, e, pas të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga studentë të UNICAL-it, shkruajnë: "Nel caso delle comunita italo-albanesi, uno dei problemi principali, nel passato e nel presente, è il mantenimento della loro identità culturale..., cosi come della loro lingua."

Si kujton G. M. Belluscio, tashmë ai vetë profesor e njëkohësisht vlerësues dhe mirënjohës ndaj punës së prof. Trumper: "John mi accolse ma non accetto il mio progetto di studio delle varianti di italiano usate dagli arbereshe; mi lancio invece, senza salvagente, nel mare magnum della fonetica sperimentale e mi costrinse a studiar di fisica e di acustica, di statistica, e poi i mostri sacri della fonetica e di quella sperimentale, salvo perdere le speranze per due anni: tre-quattro migliaia di frasi registrate, le (poche) analisi, finanziate da John ..."

Me krijimin e Laboratorit të Fonetikës, në Universitetin e Kalabrisë, nisin edhe këtu studimet eksperimentale për shqipen, të shtyra veçanërisht nga prania e të folmeve arbëreshe në këtë zonë. Duke filluar nga viti 1987, nisin botimet e para të kësaj natyre. Së pari, Trumper dhe Belluscio paraqesin rezultatet e analizës së kryer mbi të folmen e Frasnitës, Ungrës dhe Shën Vasilit[1]. Më 1989, Trumper dhe Romito[2], mbështetur edhe në rezultatet e studimit të mëparshëm të Trumper dhe Belluscio-s e duke shtuar edhe studimin e sistemit zanor të Acquaformozës dhe Spezzano Albanese-s, bëjnë një krahasim mes tyre dhe shkojnë më tej, duke i krahasuar me zanoret themelore. Ata ndalen edhe në çështjen e vlerës dalluese të kohëzgjatjes zanore. Në 1991, Belluscio sjell analizën e zanoreve të theksuara të shqipes[3], ku veç vlerave të dy formanteve të para

[1] Trumper, John, G. M. G. Belluscio (1987), *A First Acoustic- Perceptual Study of the Vowel System of Frasnita, Ungra and Shën Vasili*, Atti del Congresso Internazionale di Studi sulla Lingua, la Storia e la Cultura degli Albanesi d'Italia.

[2] Trumper John-Romito Luciano (1989), *Vocalismi arbëreshë a confronto: uno studio acustico comparativo*, Atti del XV Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 24- 28 novembre 1989)

[3] Belluscio G. M. G. (1991), *Le vocali toniche dello shqip*, Atti del 1^0 Seminario internazionale di studi studi albanesi, 7-8 giugno

gjejmë edhe ato të F_3, ndërtohen diagramet e ekzistencës së zanoreve dhe krahasohen rezultatet e analizës me ato të botuara nga Boriçi, Beci dhe Goga. E veçanta e këtij studimi qëndron jo vetëm në këtë. Këtu, për herë të parë, matja e vlerave të formanteve bëhet nëpërmjet analizatorit FFT Analyser, modeli ONO SOKKY, në Laboratorin e Fonetikës të UNICAL, që lejon përcaktimin më të saktë të vlerave frekuenciale.

Në këtë mënyrë, profesor Trumper investon në krijimin e një brezi të ri studiuesish. Së bashku, Trumper dhe Belluscio[4], në 1993, paraqesin në "Convegno Internazionale LABPHON 4", në Oxford një sërë të dhënash e diagramesh të ekzistencës së zanoreve, marrë nga tema e doktoratës së G. M. G. Belluscio, mbi të folmet e Farneta-s, Castroreggio-s, Pllatëniut, Çiftit, Ejaninës, Frasnitës, Shën Vasilit, Fermës, Ungrës, Acquaformoza-s, Spixanës dhe të shqipes standarde e të italishtes.

Në vitin 1996, Romito dhe Belluscio[5] paraqesin në Trento një punim bazuar në të dhënat elektro-palatografike të analizës së [l], [ɫ], (d), [ð], të realizuara në të folmen e Shën Vasilit dhe të Catanzaro-s, në këtë mënyrë, edhe analizat palatografike me metodat më moderne sjellin rezultate mbi shqipen. Ndërkohë, që deri më parë, sistemi bashkëtingëllor ishte analizuar kryesisht nga këndvështrimi fonologjik.

Për herë të parë, nga studiuesit e këtij laboratori, botohet një punim që ka si objekt studimin e izokronisë, duke trajtuar strategjitë kohore të shqipes standarde[6] dhe klasifikimin e shqipes në gjuhët me izokroni theksore, argument ky i paprekur më parë, por as më pas, për shumë vite, nga studiues të tjerë.

Një argument i ri trajtohet në 2002, nga Belluscio, në Torun. Për herë të parë, studiohen bashkëtingëlloret mbylltore të shqipes, duke analizuar një ele-

---

[4] Trumper, John, G. M. G. Belluscio (1993), *Multivalency of Mid-central Vowels: The Case of Albanian*, Convegno Internazionale LABPHON 4, Oxford, që më pas botohet me titullin *Polivalenza delle vocali medie centrali: il caso dell' albanese*, në Atti del XIX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 1993

* Turano G., Belluscio G., Il vocalismo tonico della parlata arbëreshe di San Nicola dell' Alto (CZ). 1993, Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria, n. 4, pp. 163177.

[5] Romito, L., Belluscio, G. M. G. (1996), *Studio elettropalatografico dell'opposizione fonematica /lɫ/, /dd/, /ɖɖ/ nel dialetto di Catanzaro e /l/, /ɫ/, /d/, /dh/ nella parlata albanese di San Basile*, Associazione Italiana di Acustica, XXIV Convegno Nazionale, Trento, 12- 14 giugno

[6] Belluscio G. M. G, Mendicino, A., Romito, L. (1997), *L'albanese standard: vocalismo e strategie temporali*, Quaderni del dipartimento di Linguistica, Università di Firenze 8

ment të rëndësishëm të tyre, VOT (voice onset time), kohën e fillimit të zëshmisë, pra, të atij segmenti kohor që fillon menjëherë pas shpërthimit dhe zgjat deri në rifillimin e dridhjeve të tejzave zanore, për nyjëtimin e zanores pasardhëse[7] dhe që është një tregues, në mjaft raste, edhe i frymëtimit bashkëtingëllor, por edhe që mund të shfrytëzohet për interpretime të mëtejshme në lidhje me prirjen për afrikatizim të mbylltoreve qiellzore.

Bashkëtingëlloret dridhëse të shqipes paraqesin një çështje më vete, të papasqaruar mirë ende, veçanërisht sa i takon /r/-së. Kjo kategori e bashkëtingëlloreve të shqipes merret në shqyrtim në punimin e Trumper dhe Tucci-t[8] (2002: 290), ku duke e analizuar në fjalët *kur, bor, bar,* të shqiptuara prej folësish nga Shqipëria dhe nga Kosova, vënë re se formantet e zanoreve paraardhëse, për shkak të ndikimit të *r*-së, që vjen pas, paraqesin një ulje të vlerave të tyre: për *a*-në e shkurtër F_1-shi ulet nga 70-120 Hz, F_2-shi ulet nga 200-400 Hz, fakte këto që i bëjnë autorët të mendojnë për një retroflekse aproksimante.

Gjithashtu, me këto studime zhvillohet edhe metodologjia e analizës së rezultateve përmes parametrave statistikorë, të cilët krijojnë hapësira për interpretim të treguesve të panjohur më parë në studimet shqiptare. Kjo metodologji pune strikte, por edhe e përpunuar sistematikisht në kohë i ka shërbyer gjetjes së njëpasnjëshme të të dhënave të panjohura paraprakisht.

Nga pikëpamja teknike, paraqiten në mënyrë të mirëpërcaktuar parametrat dhe rruga e identifikimit të tyre. Kështu, përcaktimi i "mid point" të segmentit, që duhet të ketë një gjatësi nga 20 ms- 80ms dhe që të përkojë sa më shumë me "steady state". Më tej, ky segment i nënshtrohet analizuesit FFT (Ono Sokki CF 930), me të cilin, me anë të analizës kepstrale identifikohen 3 formantet e para. Kjo metodë e analizës elektro-akustike ofron mundësi të një precizioni të jashtëzakonshëm në nxjerrjen e vlerave formantike. Sonografi jep mundësinë të observojmë dhe të masim në një shkallë frekuencash të zgjedhura, nëpërmjet një kursori, le formantet, që sigurojnë timbrin e zanoreve dhe të disa bashkëtingëlloreve të tingullta, si likuidet, hundoret dhe disa tipa të veçantë të dridhëseve aproksimante.

E gjithë kjo metodologji është shfrytëzuar në gjetjen e rezultateve të reja në studime dialektologjike edhe për variantet e shqipes. Një nga studimet më të plota dialektologjike të viteve të fundit është ai i realizuar nga Genesin dhe

---

[7] Belluscio, G. M. G. (2002), *Mbylltoret e shqipes. Cilësia e tyre fonetike, gjatësia dhe VOT-i,* Seminar kushtuar W. Cimochovski-t, Torun.

[8] Tucci, Maria- Trumper, John (2002), *Lateral and nasal co-articulation, R-colouring in English and North- East Italy Voce, canto, parlato,* Studi in onore di Franco Ferrero.

Belluscio, mbi të folmen e Thethit, ku ndër të tjera, autorët, që në fillim theksojnë se është "un dovuto omaggio a Martin Camaj, originario di questa Albania "periferica", e ai valori umani e spirituali che egli espresse nel corso della sua esistenza terrena". Nëpërmjet analizës fonetike, morfologjike dhe morfosintaksore të intervistave të transkriptuara është bërë i mundur krahasimi i karakteristikave gjuhësore të shfaqura me të dhënat e mbi këtë të folme, të publikuara në vitet '60-70 dhe që i referohen një konteksti politik, kulturor dhe social të ndryshëm i sotmi.

Nga kjo analizë, dalin të rezultate të reja mbi sistemin zanor:



Fig. 6. Thethi – *Diagramma di esistenza delle vocali toniche*

4.1. *Vocalismo*

Per il ghego nordoccidentale Gjinari 1989:109 e 299 dà tre serie di vocali: orali brevi, orali lunghe e nasali.

i y u i: y: u:

e o e: o:

a a:

ī ȳ ū

ē

ā

Questo dovrebbe essere dunque l'inventario dei fonemi vocalici di Thethi.

Për Vermoshin, Belluscio (2009) e kishte vënë tashmë në dukje "come siano discrepanti i dati forniti nell'Atlante dialettologico e quindi, in mancanza

di altre informazioni utili, bisogna prendere obbligatoriamente per buona la situazione riportata da Gjinari. Qualche dubbio resta però circa lo status fonemico di /ø:/ e di /æ:/, per questi due elementi non è chiaro se siano (allo)foni o fonemi."

Kështu, vërehet realizimi i një a-je hundore më të prapme e më të mbyllur se korresponduesja johundore. "Il vocalismo nasale del ghego occidentale presenta un sistema asimmetrico a causa della mancanza di /o)/. I vocoidi nasali presentano un forte accumulo di energia sonora prodotta dai risonatori delle cavità nasali, che vanno a posizionarsi in alcune zone del sonogramma evidenziando le cosiddette formanti nasali."

Ky argument gjen trajtim edhe nga Trumper J. , Tucci M., "Co-articulation and Phonetic Plots", ku tajtohen dukuritë e koartikulimit në kontekst bashkëtingëllor, sonorante, hundore, dridhëse. Në "Albanian: Northern Geg Nasal and Retroflex coarticulation versus Arbëresh (Tosk) reaction (Stability between adjacent segments)" trajtohet një analizë e aspekteve koartikuluese të shqipe në kontekste BZB, ku B është ose dridhëse, ose hundore. "Poste a confronto la varietà dialettale ghega di un informatore kosovaro, che presenta nel suo repertorio fonologico anche V nasalizzate (storicamente V+N, e oggi ridotte soltanto a V nasali omorganiche) con i risultati di precedenti analisi elettroacustiche sulle varietà arbëreshe (di tipo tosco) gli autori definiscono, nonostante il limitato corpus dei materiali analizzati, i valori delle prime tre formanti nasali (le cui medie in Hz – non indicate – risultano essere: FN1 545,42, FN2 1502,42, FN3 2536,14)."

Një kontribut me shumë interes është studimi i Belluscio-Mendicino-s mbi zanoret hundore dhe hundorësinë në gjuhën shqipe, që synon të shpjegojë evolucionin e zanoreve hundore. Duke konsideruar një kontekst hundor, prania e një bashkëtingëlloreje hundore pranë një zanoreje johundore mund të ndikojë duke e rritur me nga një njësi cilësinë akustike të zanores, derisa ta shndërrojë plotësisht në hundore. Belluscio: La nostra analisi ci porta a considerare la nasalizzazione senz'altro come un fenomeno panalbanese, la cui diffusione nel sistema è stata però selettiva non avendo interessato tutte le vocali contemporaneamente fin dal principio, ma avendo avuto il suo inizio a partire dalla vocale più bassa /a/ per poi procedere secondo fasi comuni a più sistemi linguistici individuate da Chen (1973b) e Ruhlen (1973, 1978).

Zhvillimi i këtyre studimeve dhe rezultatet e arritura krijojnë hapësirë për lëvrimin e fushave të studimore që kapërcejnë shkencën e gjuhësisë. Shfrytëzimi i të dhënave të fonetikës eksperimentale mund të na shërbejë për të

kontribuuar në kërkime të mëtejme në lëmin e logopedisë, por edhe të fonetikës ligjore.

Bibliografia

Belluscio G. M. G. (1991), *Le vocali toniche dello shqip*, Atti del 1^0 Seminario internazionale di studi studi albanesi, 7-8 giugno

Belluscio G. M. G, Mendicino, A., Romito, L. (1997), *L'albanese standard: vocalismo e strategie temporali*, Quaderni del dipartimento di Linguistica, Università di Firenze 8

Belluscio, G. M. G. (2002), *Mbylltoret e shqipes. Cilësia e tyre fonetike, gjatësia dhe VOT-i*, Seminar kushtuar W. Cimochovski-t, Torun

Belluscio, G. M. G.; A. Mendicino (2002), *Sulle vocali nasali e nasalizzate dell'albanese*, Lingue e Linguaggi 26

Romito, L., Belluscio, G.M.G. (1996), *Studio elettropalatografico dell'opposizione fonematica /l\/, /dd/, /ḍḍ/ nel dialetto di Catanzaro e /l/, /ł/, /d/, /dh/ nella parlata albanese di San Basile*, Associazione Italiana di Acustica, XXIV Convegno Nazionale, Trento, 12- 14 giugno

Trumper, John, G.M.G. Belluscio (1993), *Multivalency of Mid-central Vowels: The Case of Albanian*, Convegno Internazionale LABPHON 4, Oxford, që më pas botohet me titullin *Polivalenza delle vocali medie centrali: il caso dell'albanese,* në Atti del XIX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 1993

Turano G., Belluscio G., (1993) Il vocalismo tonico della parlata arbëreshe di San Nicola dell' Alto (CZ)., Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria, n. 4, pp. 163-177.

Trumper, John, G.M.G. Belluscio (1987), *A First Acoustic- Perceptual Study of the Vowel System of Frasnita, Ungra and Shën Vasili*, Atti del Congresso Internazionale di Studi sulla Lingua, la Storia e la Cultura degli Albanesi d'Italia.

Trumper John-Romito Luciano (1989), *Vocalismi arbëreshë a confronto: uno studio acustico comparativo*, Atti del XV Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 24-28 novembre 1989)

Tucci, Maria- Trumper, John (2002), *Lateral and nasal co-articulation, R-colouring in English and North- East Italy Voce, canto, parlato*, Studi in onore di Franco Ferrero

Bardh RUGOVA, Prishtinë

VENDI I THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE – KONTRIBUTI I STEFANO CANALISIT

Abstrakt. Për një kohë të gjatë ka pasur keqkuptime lidhur me theksin në gjuhën shqipe, duke e interpretuar si të lëvizshëm apo të ndryshueshëm nga rasti në rast. Studimet e Bevingtonit e më pas të Trommerit kanë dëshmuar për parashikueshmërinë e theksit në shqipen. Mbi ato dy studime, studiuesi italian Stefano Canalis ka ofruar një kontribut, duke u përpjekur të argumentojë se theksi i shqipes është i ndjeshëm ndaj kuantitetit dhe se vendi i theksit të shqipes mund të përcaktohet në bazë të trokut moraik brenda fjalës.

Në këtë kumtesë do të përpiqemi të bëjmë një lexim kritik të veprës së Canalisit kundruall kontributeve të autorëve të tjerë që janë marrë me çështjen e pozitës së theksit në gjuhën shqipe.

Ideologjia preskriptiviste ka bërë që disa probleme gjuhësore të shqipes të kenë shpjegime të gabuara, e që, të shndërruara në një formë miti e të marra si të mirëqena, kanë pasur ndikim edhe në shqipen kolokuiale dhe në dinamikat e përgjithshme të zhvillimit të shqipes:

- Shpjegimi i gabuar i kohëve të foljeve[1];
- Trajtimet e futurit dhe të kushtores[2];
- Diskutimi për rimarrjen e kundrinës[3]; dhe, përfundimisht,
- Çështja e vendit të theksit në gjuhën shqipe.

Një mit për theksin, i bartur disi si memë ndër breza, buron nga konceptime të mëhershme të Dodit (1968 [1963]) dhe përkufizuar më pas nga Dodi e Gjinari (1983), të cilët shpallin se vendi i theksit në shqipen nuk është i qëndrueshëm, lëviz nëpër rrokje, por se ka një prirje për të qenë në rrokjen e parafundit. Problemi kryesor i këtij shpjegimi është se nuk bën dallim mes mbaresave (shumica nga të cilat nuk marrin theks në shqipen) dhe prapashtesave (që marrin theks në shqipen) (shih Canalis 2007, Bozhoviq 2012).

Camaj (1984: 26) e pranon këtë shpallje dhe merr shembuj si *fshat – fshatár* si lëvizje të theksit, por shembuj *turí – turíj* e *nëpúnës – nëpúnësit* (sic) si moslëvizje të theksit - shembull tipik i barazimit të prapashtesave (fshat-ar) me

---

[1] Për elaborim të mëtejmë shih Ismajli 1980, 1985; Tahiri 2006, Rugova 2009, Rugova, Sejdiu-Rugova 2015.

[2] Për elaborim të mëtejmë shih Rugova, Sejdiu-Rugova 2015.

[3] Për elaborim të mëtejmë shih Bokshi 2004, 2014.

mbaresa (nëpunës-it). Camaj (1984: 8) thotë se vendi i theksit në fjalët e shqipes anon në rrokjen e parafundit të fjalës në trajtën e shquar (li'si, lu'lja, deve'ja v.j.), ndonëse trajtë kanonike është trajta e pashquar.

Në bazë të kësaj, kemi disa interpretime të ngjashme, duke nisur nga që më herët (Kacori 1979:195) te autorë të tjerë si Petrucci (1999:116), K. Topalli (1995) dhe, madje, shkarazi edhe Bokshi (2012) që e trajtojnë vendin e shqipes si të paqëndrueshëm, por me tendencë në rrokjen e parafundit.

Rusakov (2017: 572), po ashtu, shkarazi e shpall "relativisht të lirë" vendin e theksit në shqipen, por e vëren tendencën për të qenë kolumnal dhe pjesë e stemit të fjalës.

Në librin për mësimin e shqipes për të huaj, Shqip.al (2016: 9) tentimi për ta dëshmuar theksin si në rrokjen e parafundit është marrë, madje, me shembuj në trajtën jokanonike, por në trajtën e shquar: "Theksi i fjalës në gjuhën shqipe, nuk shënohet me shenja diakritike. Ai bie zakonisht në rrokjen e parafundit: vájza, kooperatíva, fári, bári, shqiptími, mënýrë etj. Megjithatë mund të bjerë edhe në rrokje të tjera…" (shih)

Përveç fjalës *mënýrë*, të gjitha të tjerat janë shënuar në trajtën e shquar.

Ky qëndrim, kur del edhe si i preskriptuar në libra mësimi, manifestohet edhe në disa shqiptime që mund t'i hasim në opinion: *Majkëll Xhe'kson, Xhoni Uo'ker, Kompjut'er* e kështu me radhë. Krahaso theksimin në fjalë të ngjashme fonetikisht si *mikrofo'n, pipe'r, habe'r*.

Në këtë punim do të diskutohet përpjekja e studiuesit italian Stefano Canalis për parashikueshmërinë e theksit në gjuhën shqipe, si pjesë e një shtrese studimesh lidhur me këtë problem që nga vitet '70, kur gjuhëtari amerikan Gary Loyd Bevington e ka dhënë përkufizimin e tij për vendin e theksit në shqipen.

Sa për parantezë, ndër studiues të tjerë në Itali lidhur me theksin, do të mund të përmendnim John Trumperin dhe Gianni Belluscion. Tre artikuj të Belluscios diskutojnë theksin me analizën fonetike. Dy artikujt e parë, sistemi zanor i San Nikola del Altos (Belluscio, Turano 1993) si dhe ai për zanoret e theksuara të shqipes (Belluscio 1993) e shtrojnë çështjen e theksit lidhur me faktin që atje u analizuan vetëm zanoret e theksuara; në artikullin e tretë (Belluscio et al 1997), theksi konsiderohet si parametër për të vlerësuar qendërzimin e zanoreve dhe/ose fshirjen e tyre në marrëdhënie me numrin e rrokjeve dhe me vendin e theksit në fjalët e përzgjedhura, pra, edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një studim të mirëfilltë akustik të zanoreve dhe me strategjitë kohore të gjuhës shqipe.

Sidoqoftë, miti i theksit të shqipes është shkundur nga Bevingtoni në

trajtimin e tij gjenerativist (për më shumë shih Rugova 2016).

Bevington ka dhënë skemën:

$$(1) \quad V \rightarrow [+\text{stress}] __ C_0 \left\langle \left\{ \begin{array}{c} e \\ a \\ o \\ ë(C) \\ as \\ ull \end{array} \right\} \right\rangle]_{\text{Stem}} \; \langle\text{-}V\rangle$$

Kjo sjell ndonjë paqartësi dhe/ose pasaktësi. Po e zëmë, prapashtesa *–as* nuk merr theks, por trajta *as* në fund të stemit po. Kemi *gjilán-as*, por *ananás*, kur nuk kemi prapashtesim. Në raste të tjera, kemi *heró*, por edhe *kállo*. Kemi, po ashtu, *pará* e *kalá* krahas *brénda* (kur *a*-ja është pjesë e stemit që dmth. se nuk përputhet me skemën e Bevingtonit). Pra, skema e tij nuk është e saktë krejtësisht, por ka vlerë se vëren që theksi i shqipes lidhet jo me fjalën, por me stemin.

Për pozitën fundore të theksit në stemin e fjalës është dakord Friedman (2004), i cili thotë se theksi i shqipes përgjithësisht bie në rrokjen e fundit të stemit, ndonëse "është i paparashikueshëm dhe distinktiv (dallues)".

Sawicka (1997:73) thotë se në shqipen theksi është në rrokjen e fundit të stemit, por shton se plot sufiksa e marrin theksin.

Hampi (1992: 904) duke theksuar se, historikisht, rumanishtja është latinishte me theks të shqipes, aludon, pak a shumë, për rrokjen e fundit të stemit (për rumanishten shih Ioana Chiţoran 2002).

Mirëpo, të shohim si është situata sipas Canalisit.

Duke e diskutuar kontributin e Bevingtonit, shkarazi e kemi prekur (Rugova 2016) edhe trajtimin e theksit të shqipes në këndvështrimin sipas teorisë së optimalitetit dhe të teorisë metrike, duke përmendur edhe Canalisin.

I pari që e ka rrahur theksin e shqipes nga këndvështrimi i teorisë së optimalitetit ka qenë Maynard (1997), ndjekur nga Trommer (2004, 2009, 2013). Edhe ky këndvështrim nuk bën shumë tutje nocioneve të Bevingtonit, duke sqaruar se mbaresat flektive të shqipes nuk janë të theksuara, përveç në rastet si *lúmë – luménj*, por ato janë rimorfologjizuar sipas analogjisë me mbaresën e shumësit *nj*.

Canalis, alumni i Universitetit të Padovas, tani në Universitetin Boazici në Turqi, ka kryer një analizë teorike të theksit të fjalës në shqipen sipas teorisë metrike të fonologjisë (Canalis 2007).

Ai, me pak fjalë, ndjek punën e autorëve që janë marrë me theksin e shqipes. Thotë se theksi i shqipes zbatohet në domenin e temës së fjalës (sikur edhe Bevingtoni 1974). Pranon, se theksi i shqipes ka orientim në të djathtë (sikur

edhe Maynardi 1997) dhe se varet nga pesha e rrokjes (sikur thotë edhe Maynard 2004, 2009, 2013).

Mirëpo, thekson, njëherësh, se pozita e theksit brenda fjalës në shqipen nuk duhet të kërkohet, thjesht, në nivelin e rrokjes, por më hollësishëm, në kuadër të morave dhe të këmbëve metrike të atyre rrokjeve.

Sipas tij, shqipja në morfonologjinë e saj është e ndjeshme ndaj sasisë metrike, apo kuantitetit të rrokjeve, pra nga numri i morave të tyre (pesha) dhe jo ndaj cilësisë së zanoreve në rrokje. Rrokjet mund të jenë të rënda, kur janë të gjata ose të mbyllura, apo kur përmbajnë ndonjë diftong, e prandaj përbëhen nga dy mora. Mund të jenë të lehta, kur janë të shkurtra dhe të hapura e prandaj përbëhen nga një morë metrike (shih Bozhoviq 2012:1480).

Sipas kësaj, Canalis përkufizon se rregulla e vendosjes së theksit të fjalës në shqipen do të nënkuptojë se te çdo fjalë e shqipes, theksi vendoset në morën e parë të këmbës së djathtë dymorëshe të temës së fjalës. Pra, sipas tij, të gjitha stemat e shqipes janë paroksitone sa i përket theksit, kështu që, sipas tij, kur stemi mbaron me një rrokje të lehtë, të shkurtër e të hapur, si *punë, borë, yndyrë, brenda*, e kështu me radhë, të dy rrokjet përbëjnë një këmbë trokaike dymorëshe, me theksin paroksiton[4]. Nëse tema mbaron me rrokje të rëndë a diftong, ajo rrokje vetë përbën një këmbë dymorëshe, e prandaj është e theksuar dhe kemi: *ve'nd, bilbi'l, shtëpi', njeri', bari', kala*'.

Në këtë kuadër, pak është me rëndësi nëse fjalë të tilla si punë do të transkriptohen /pu:n/ duke e llogaritur si njërrokëshe apo /punə/ si dyrrokëshe. Në të dy rastet përkufizimi i Canalisit do të merrej i saktë. Nëse stemi përfundon me rrokje të mbyllur, pra si njërrokëshe (shih /pu:n/), atëherë shembulli bartet në kategorinë me fjalë si *vend* apo *bilbil*. Mirëpo, kjo nuk është e rëndësishme në këtë moment.

Canalis (2007: 3), përgjithësisht, vëren se vendi i theksit në fjalët e shqipes nuk ndryshon kur ka mbaresa (me përjashtime: lu'më – lume'nj, dhëndër – dhëndu'rë); se orientimi është në të djathtë dhe se lëviz kur ka prapashtesa, por jo edhe parashtesa; se stemi është domen relevant i theksit në shqipen dhe se tema që mbaron me zanore jep theksin penultim, ndërsa ai me bashkëtingëllore jep theksin në elementin fundor (me përjashtimet -ull, -ur dhe ëC (C= bashkëtingëllore).

Si shembuj ofron fjalë të tilla si: *bre'nda, ci'li, pra'pa, ga'ti*, por ofron edhe shembujt e kundërt: *vëlla', shtëpi', tashmë'* (kur *ë*-ja e merr theksin), *aty', këtu'*.

[4] Ai fjalën *punë* e lexon si /punə/, me ç'rast ë-ja fundore është rrokje e lehtë, ndërsa u-ja është e rëndë dhe bashkë formojnë trok moraik.

Ai (Canalis 2007: 8), niset nga supozimi se theksi i shqipes është i ndjeshëm ndaj sasisë apo peshës së rrokjes, e sheh si trok, se këmbë kryesore është ajo që është në të djathtë dhe se rrokjet që shkojnë përtej stemit janë metrikisht jorelevante në shqipen. Mbi këtë e jep përkufizimin që e përmendëm më lart se në shqipen theksi bie në trokun e djathtë të stemit në morën e parafundit. Pra, jo në nivelin e rrokjes, por brenda rrokjes në nivelin e morës.

Kjo lidhet edhe me situatat kur ka tog zanoresh, në të cilin i theksuar është elementi i parë: ly'er, por edhe situatat si mendu'eshëm, kur rrokja e theksuar është e treta nga fundi, duke pasur morën daktilike U - - . Derisa te ue kemi theksimin e elementit të parë, pra trok, elementi –ëm tutje trajtohet si te shembujt e tjerë të tipit emër, vegël.

Canalis përpiqet të shpjegojë rastet ëC si p.sh. *ve'gël*, ku *ë*-në e sheh intrusive që s'është pjesë e stemit, sepse në paradigmë kemi *vegël – vegla*, për çka ofron krahasimin me *boshçallë'k*, ku *ë*-ja e merr theksin. Argumenton edhe rastet –ull, ur, duke kujtuar shembuj në shqipen kolokuiale si sheklli (shekull-shekulli), lepri (lepur – lepuri) që e vënë *u*-në si variant kombinatorik të *ë*-së me sonantet ll dhe r. Në të folme të shqipes (v.j.) ka edhe shembuj të tillë si *e bukër* (për *e bukur*) sidomor kur në vend të flapit /ɾ/ realizohet varianti /ɻ/ si aproksimant retrofleks. Te shembuj të tillë si *engjëll* (në të folme edhe *engjull*), Canalis (2007: 10) thotë se shpjegimi duhet kërkuar gjetiu e jo në fonotaktikë.

Canalis, njëherësh, thotë se në shqipen standarde nuk ka kundërvënie të gjatësisë – e cila është e pranishme te gegërishtja. Mbi këtë parim, mëton (Canalis 2007: 11) të shpjegojë edhe rastet si káfe (në gegërishten) – kafé (në toskërishten e në shqipen standarde). Poende, *ë*-në në shqipen standarde e sheh si fonemë, jo edhe si shenjues gramatikor (shumësi dy mekanikë) ose fonetik (kur tregon p.sh. se zanorja e fundit është e gjatë). Për këtë të fundit madje edhe jep shembujt *ly'em*, por *pi'më*, ku *ë*-ja del pas zanores së gjatë, kurse te togu *ye*, e theksuar është *y*-ja e jo *e*-ja, kështu që nuk ka *-ë* në fund të fjalës në drejtshkrimin e shqipes.

Natyrisht, problemi i turcizmave është pak më i komplikuar se kaq dhe lidhet jo me theksin oksiton dhe paroksiton, por me përshtatjen e huazimit (kaf/e-ja, sikur lul/e-ja, ku stemi është kaf-, apo si formë e plotë e turqishtes kafe-ja, ku stemi është kafe)[5].

[5] Ndonëse nuk janë përmendur nga Canalis, do të përmendnim edhe shembuj si *óperë* dhe *kámerë* që në drejtshkrimin e shqipes janë sanksionuar me theks në rrokjen e parë, por me *-ë* në fund të fjalës. Bëhet fjalë për huazime italiane, ngjashëm si te fjala *muzíkë*, ku theksi është përshtatur me të shqipes. Shembujt, *óperë* dhe *kámerë*, në të vërtetë janë shqiptime të shtresës snobistike që i ka përdorur ato fjalë (patjetër një shtresë që mëton

Vërejtje përmbyllëse:

Venerimet teorike të Canalisit, të mbështetura në teorinë metrike, e mbështesin qëndrimin për parashikueshmëri të theksit në shqipen, duke e vendosur në rrokjen e fundit të stemit, në morën e parafundit, që do të thotë se mund të paraqitet në prapashtesa, por jo në parashtesa dhe as në mbaresa. Për përjashtimet janë dhënë sqarime.

E ilustrojmë me shembujt: p**u'**në /pu:n/, pun**o'**j, punët**o'**r, punëtor**i';** dmth punët**o'**ri, punët**o'**rin, punët**o'**rëve, por punëtor**i'**a, punëtor**i'**në, punëtor**i'**ve (krahaso me përpun**o'**j – shqipja nuk e orienton theksin në të majtë).

Canalis nuk e diskuton çështjen e emrave femërorë. Fjalë të tilla si l**u'**le, nuk e kanë *e*-në si pjesë të stemit. Trajta e shquar është lulja. Ngjashëm është edhe me rastet si káfe – kafé dhe huazimet e tjera të turqishtes që janë shpjeguar gabimisht si theks oksiton dhe paroksiton (tenxh**é**re – tenxher**é**). Në raste të tilla nuk bëjmë fjalë për ndryshim theksi, por për trajtën që është pranuar si kanonike (tenxh**e**r-e/ja apo tenxher**e** – ja). Në të dy rastet është e theksuar rrokja e fundit e fjalës kanonike dhe kemi njësi dymorëshe.

Përjashtim përbëjnë, siç e shohim te ilustrimi sipas Bevingtonit, fjalë të tilla si: k**u**mbull, deç**a**nas (vetëm kur është prapashtesë – nuk vlen te ndërtimet e tjera p.sh. anan**a**s), lavd**i**shëm (por jast**ë**k), për të cilat Canalis ka ofruar shpjegime (i lavdishëm - e lavdishme – pra *ë*-ja është formë intrusive).

Mirëpo, konceptimet më precize të kundruara tutje sipas morave, jo thjesht rrokjeve, dhe interpretimet sipas teorisë së optimalitetit nga autorë/e të dy dekadave të fundit, si Canalis, tregojnë për theks të shqipes që bie në morën e parë të këmbës metrike, pra karakter troku jo në kuptimin e rrokjes, por të morave brenda së njëjtës rrokje të rëndë. Fjalë të tilla si *kalá*, *njerí* e kanë theksin në rrokje të rëndë që formon theks paroksiton moraik. Te fjalë si *kumbull* kemi rrokje të fundit të lehtë. Njëjtë është edhe te shqiptimi /pun̪ə/ - me ç'rast fjala ndahet në dy rrokje, e dyta nga të cilat është e lehtë, e hapur. Njëjtë është edhe te fjalët e tipit: trikó, palltó si dhe te parafjalët dhe pjesëzat e tipit: p**a**ra, k**u**ndër, mb**a**se, d**u**ke etj. Kjo do të

---

përkatësi më të lartë në hierarkinë kulturore) dhe, si të tilla, janë sanksionuar në drejtshkrimin e shqipes. Ndërkohë, *muzikë* ka përdorim më të gjerë, nga të gjitha shtrasat. Ka pasur propozime për ndryshim të kësaj nga Këshilli Ndërakademik.

thotë se rrokja në shqipen është e ndjeshme në sasinë metrike apo kuantitetin e rrokjes që nënkupton numrin e morave të tyre (pesha) e jo puro nga cilësia e zanores në rrokje. Pra, theksi i shqipes është i varur nga pesha e rrokjes dhe ka orientim në të djathtë.

Bibliografia:

Belluscio, G. (1993). Le vocali toniche dello shqip. Në: *Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria, 7, Serie Albanistica 1*, Rende: dell'Università della Calabria, pp. 23-42

Belluscio, G.; Turano, G. (1993). Il Vocalismo tonico della parlata arbëreshi di San Nicola dell' Alto (Cz). *QDLF 4*. Pp 163 - 177

Belluscio, G.; Mendicino A.; Romito L. (1997). L'albanese standard: vocalismo e strategie temporali. Në: *Quaderni del Dipartimento di linguistica dell'Università della Calabria*, 1997, Vol. 8, Rende: Università della Calabria, pp. 105- 116.

Bevington, G. L. (1974). *Albanian Phonology*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

Bokshi, B. (2004). *Për vetorët e shqipes*. Prishtinë: ASHAK

Bokshi, B. (2012). *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*. Prishtinë: ASHAK

Bokshi, B. (2014). *Varia*. Prishtinë: ASHAK

Bozhoviq, Gj. (2012). Theksi i fjalës në morfonologji të shqipes: teoria metrike dhe e optimalitetit. Në B. Rugova (red) *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 31/1*. Prishtinë, Universiteti i Prishtinës

Buchholz, O. and Fiedler, W. (1987), *Albanische Grammatik*, Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.

Camaj, M. (1984). *Albanian Grammar*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz.

Canalis, S. (2007). To What Extend is Albanian Stress Predictable. Në: A. Biseto, F. Barbieri (red.) *Procedings of the XXXIII Incontro di gramatika generativa* (fq 1 – 14). Bologna: University of Bologna

Chițoran, Ioana (2002), "A perception-production study of Romanian diphthongs and glide-vowel sequences". Në: *Journal of the International Phonetic Association*, 32 (2): 203–222

Chomsky, N., Halle, M. (1968). *The Sound Pattern of English*. New York: Harper & Row

Dodi, A. (1968 [1963]). *Fonetika e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Enti i teksteve…

Dodi, A.; Gjinari, J. (1983*). Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme letrare Shqipe,* Tiranë: Akademia e RPS të Shqipërisë

Friedman, V. A. (2004). *Studies on Albanian and Other Balkan Languages*. Pejë: Dukagjini

Hamp, E. (1992). Albanian. Në: Grozdenović J. (red.) *Indo-European Numerals*. Berlin, New York: Mouton de Gruyter

Ismajli, R. (1980) *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja

Ismajli, R. (1985) *Gjuha shqipe e "Kuvendit të Arbënit" (1706)*. Prishtinë: Rilindja

Kacorri, Th. (1979). *A Handbook of Albanian*. Sofia: Sofia University "Kliment Ohridski"

Kager, R. (2001). *Optimality Theory*. Beijing: Foreign Language Teaching and Research Press.

Maynard K. L. (1997). An Optimality analysis of Albanian word stress. Në: X. Li et al (red) *Papers from the 1997 Mid-America Linguistic Conference* (fq 94 – 100)

Newmark, L., Hubbard, P. And Prifti, P. (1982), *Standard Albanian: A Reference*

Grammar for Students, Stanford: Stanford University Press.

Petrucci, P. (1999). *Slavic Features in the History of Romanian*. Munich: Lincom Europa

Pipa, A. (1978). *Albanian Folk Verse: Structure and Genre*, München: Rudolf Trofenik.

Rugova, B. (2009). *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: KOHA

Rugova, B. (2016). Kontributi i Bevnington-it për fonologjinë e shqipes. Në: *Studimet albanistike në Amerikë*. Prishtinë: ASHAK

Rugova, B.; Sejdiu-Rugova, L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat

Rusakov, A. (2017). Albanian. Në: Kapović, M (red.) *The Indo-European Languages*. London, New York: Routledge

Tahiri, L. (2006). *Monologu, personazhi dhe autori*. Prishtinë: PEN Qendra

Topalli, K. (1995). *Theksi në gjuhën shqipe*. Tiranë: Shtëpia botuese enciklopedike

Trommer, J. (2004), *Albanian word stress*. Ms., së fundi kërkuar në www.unileipzig.de/~jtrommer/alb_stress.pdf. më 15 shtator 2015.

Trommer J. (2009), *Stress Uniformity in Albanian morphological argument for ciclycity*. Leipzig: University of Leipzig

Trommer J. (2013), Stress Uniformity in Albanian morphological argument for ciclycity. Në: *Linguistic Inquiry*, MIT Press.

Valbona SINANAJ, ASA, Tiranë

KONTRIBUTI I PAOLO DI GIOVINES PËR ALBANOLOGJINË

Abstrakt. Në Itali studimet për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët kanë qenë dhe vazhdojnë ende të jenë të gjera e të shumta, dhe lidhen me shumë aspekte të zhvillimeve shkencore në këtë vend. Studimet e shqipes në Itali kanë qenë të ndërlidhura prej kohësh me botën arbëreshe dhe me interesimet e saj për ta ruajtur gjuhën, por ato janë zhvilluar me një intensitet të shtuar dhe në qendra studimore italiane. Sot kemi një sërë universitetesh italiane ku zhvillohen studime për gjuhën dhe kulturën shqiptare (Roma, Cosenza, Palermo, Napoli, Firenze, Venezia, Lecce, etj.).
Ndër studiesit italianë që i janë kushtuar studimit të gjuhës shqipe është edhe gjuhëtari Paolo Di Giovine. Di Giovine me përkushtimin dhe mprehtësinë e një shkencëtari ka dhënë dhe vazhdon ende të jap kontributin e tij shkencor në departamentin e glotologjisë dhe të linguistikës, në Universitetin "La Sapienza" të Romës, të cilin e drejton tashmë prej vitesh, duke treguar gjithmonë interes dhe për albanologjinë. Ai ka studiuar gjuhën shqipe, dialektet dhe filologjinë shqiptare nën drejtimin e prof. Gradilones, filolog e testolog i njohur arbëresh. Formimin i tij si gjuhëtar e filolog e ka ndërthur edhe me disiplina të tjera gjuhësore si, gjuhësinë indoeuropiane, ballkanologjike e romanistike, dialektologjinë italiane, letërsinë arbëreshe, aspekte etimologjike, fonetike dhe fonologjike.

Në shek. XIX fillon të marrë jetë shkenca e albanologjisë, e cila me kalimin e kohës do të tërheqë edhe vëmendjen e studiuesve të huaj. Gjatë kësaj kohe interesimet për shqipen dhe për problemet e ndryshme gjuhësore të saj ishin objekt studimi kryesisht i gjuhëtarëve të huaj.

Në Itali studimet për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët kanë qenë dhe vazhdojnë ende të jenë të gjera e të shumta, dhe lidhen me shumë aspekte të zhvillimeve shkencore në këtë vend. Studiues të shumtë italianë kanë shprehur interesin që mund të kenë pasur për arbëreshët në Itali, por edhe për shqiptarët përtej Adriatikut, kështu që ato kanë shprehur interes të gjallë dhe për faza më të hershme të studimeve të popullatave fqinje në botën romane (ilirët, dardanët, mesapët, trakasit), apo edhe të tërësisë së botës ballkanike më vonë. Raportet e shqipes me latinishten, me italishten dhe romanitetin tjetër në Ballkan kanë qenë vazhdimisht në vëmendjen e studiuesve italianë. Studimet e shqipes në Itali janë zhvilluar me një intensitet të shtuar dhe në qendra studimore italiane. Sot kemi një sërë universitetesh italiane ku zhvillohen studime për gjuhën dhe kulturën shqiptare si, Roma, Cosenza, Palermo, Napoli, Firenze, Venezia, Lecce, etj.

In Italia, in genere, si è creata una buona tradizione di studi albanologici. Una tale tradizione, - thekson prof. Demiraj – *che risale a G. I. Ascoli, ha avuto degli illustri rappresentati, come C. Tagliavini, M. Bartoli, V. Pisani, G. Bonfante, G. B. Pellegrini ecc"*[1].

Studimet për gjuhën dhe historinë e shqipes kanë qenë gjithmonë në vëmendjen e mjaft studiuesve italianë, si G. B. Pelegrini, F. Altimari, M. Mandala, G. Gradilone I. K. Fortino, C. Tagliavini etj. Brezit më të ri të studiuesve të shqipes i përkasin studiuesit italianë, si E. Banfi, L. M. Savoia, A. Landi, G. Turano, P. di Giovine, E. Miracco, M. Genesin, G. Belluscio etj.

Në veprimtarinë e shumtë shkencore të Di Giovines një vend të rëndësishëm zënë edhe studimet e tij kushtuar albanologjisë. Di Giovine me përkushtimin dhe mprehtësinë e një shkencëtari ka dhënë dhe vazhdon ende të jap kontributin e tij shkencor në departamentin e glotologjisë, Facoltà di Lettere e Filosofia në Universitetin "La Sapienza" të Romës, të cilin e drejton tashmë prej vitesh, duke treguar gjithmonë interes dhe për albanologjinë. Ai ka studiuar gjuhën shqipe, dialektet dhe filologjinë shqiptare nën drejtimin e prof. Gradilones, filolog e testolog i njohur arbëresh. Formimin i tij si gjuhëtar e filolog e ka ndërthurur edhe me disiplina të tjera gjuhësore si, gjuhësinë indoeuropiane, ballkanologjike e romanistike, dialektologjinë italiane, letërsinë arbëreshe, aspekte etimologjike, fonetike dhe fonologjike.

Di Giovine është i mirënjohur në rrethet shkencore brenda dhe jashtë Italisë jo vetëm si shkencëtar, si studiues e hulumtues por edhe si drejtues; prej vitit 1948 është anëtar i Shoqatës Italiane të Glotologjisë (Società Italiana di Glottologia) dhe për periudhën 2008-2010 ka qenë edhe president i saj; prej 1988 anëtar i Shoqatës Glotologjike Milaneze (Sodalizio Glottologico Milanese), prej 2002 anëtar i Shoqërisë Filologjike (Philological Society), ka qenë pjesë edhe e Komisioneve Shkencore si "Linguistikë dhe letërsi" (Linguistica e letteratura); "Buletinit të Italianistikës" (Bolettino di Italinistica); është gjithashtu, këshillues në Fondacionin Shkencor Europian (Eoropean Science Foundation) etj.

Me një bagazh të tillë ndërdisiplinor dhe i pajisur me një pasion e përkushtim, pjesë e interesave të tij shkencore, Di Giovine ka botuar një numër të madh studimesh kushtuar gjuhësisë, por po përmendim vetëm disa nga studimet e tij për albanologjinë:

1. *Tracio, dacio ed albanese nella prospetiva genealogica*, në Accademia Nazionale dei Lincei, Serie VIII, vol. XXXIV, fasc. 7-12, Roma, luglio-dicembre 1979.

[1] Demiraj, Sh. *Sugli studi albanologici in Italia*, në "Zjarri", Nr. 35/36, 1991, f. 28.

2. *Il gruppo CT latino in albanese,* Roma, 1982
3. *Il lessico latino dell'albanese: problemi semantici,* në Actes du XVIII Congrès Ling. Et. Phil. Roma, Tübingen, 1983
4. *Il modello greco dell'albanese tarogzë,* në Studi e Saggi Linguistici, 24, 1984
5. *Su una presunta pecolarità fonetica dei prestiti greco antico in albanese,* në "Studi e Saggi Linguistici.", 28, 1988
6. *La lingua albanese tra mondo latino e mondo greco antico nella penisola balcanica,* në "Lingue e culture in contatto nel mondo antico e altomedievale", Atti dell'VIII Convegno Internazionale di Linguisti, Milano, 10-12 settembre 1992, a cura di R. B, Finazzi e P. Tornaghi, Brescia – Paideia
7. *Sull'edtio princeps de "La creazione del mondo sino al diluvio" di Niccolo Chetta,* E. Paratore, P. Di Giovine, L. Serianni, S. Zincone, I. C. Fortino, E. Miracco, Roma, 1993
8. *L'opera di Ernest Koliqi: considerazione linguistiche,* në "Miscellanea di Albanistica", Roma, 1997
9. *Un millenio di storia linguistica albanese: l'influsso lessicale della lingua italiana,* "L'Italia dialettale", 2008
10. *Gli italianizmi in albanese,* në "Gli italianismi nel mondo", (a cura di), L. Serianni vol. I, Torino, UTET, 2010

Elementi latin i gjuhës shqipe, përben një nga kapitujt më me rëndësi jo vetëm të historisë së gjuhës shqipe, por edhe për historinë e romanizmit në gjuhët fqinje me shqipen.

Vepra e parë që i kushtohet grupit *ct* latin në gjuhën shqipe është monografia e Di Giovines "Grupi *ct* i latinishtes në shqipe". Në këtë monografi autori e trajton problemin nga këndvështrimi i romanistikës, duke dhënë një ndihmesë edhe në fushën e historisë së marrëdhënieve të shqipes me latinishten ballkanike.

Kur flasim për konsonantizmin indoeuropian në gjuhën shqipe, kuptojmë atë sistem konsonantesh që gjuha jonë në thelb e ka trashëguar nga periudha e saj prehistorike, dhe e ka zhvilluar e ndryshuar gjatë shekujve në mënyrë të veçantë. Ky zhvillim e ndryshim bën pjesë në ato tipare karakteristike, që dallojnë shqipen nga gjuhët motra dhe i caktojnë kësaj atë vend më vete që ka në prehër të kësaj familjeje gjuhësore[2].

"Siç dihet[3] – thotë Çabej – çdo ndryshim fonetik ka kohën e tij, me një terminus a quo dhe një terminus ad quem apo post quem non". Edhe në shqipen ka ndryshime fonetike të lashta dhe të reja. Ndërkaq përcaktimi i tyre kronologjik, shtresëzimi i tyre kohor, nuk është gjithmonë i mundshëm, kryesisht për

[2] Çabej, E. vep. cit. f. 41.
[3] Çabej, E. *Studime për fonetikën historike të shqipes,* Tiranë, 1988, f. 86.

shkak të traditës së vonë letrare të gjuhës, sidomos për sa u përket atyre që janë kryer më parë, nga të cilat një pjesë arrin në lashtësinë e errët. Nëpërmjet krahasimeve të brendshme dhe rindërtimeve, nga njëra anë, dhe me ndihmën e marrëdhënieve gjuhësore fqinjësore, nga ana tjetër, është arritur të përcaktohen për disa procese fonetike zgjatja e përafërt kohore si dhe marrëdhëniet e ndërsjellta kohore. Një mjet të mirë ndihmës për këtë na japin para se të gjithash huazimet latine, fillimi dhe mbarimi i të cilave qoftë edhe me përafërsi është i përcaktueshëm historikisht. Me ndihmën e tyre dhe pjesërisht edhe të huazimeve nga greqishtja e vjetër mund të tregohet se çfarë i përket periudhës parahistorike dhe çfarë periudhës historike të gjuhës nga pikëpamja e fonetikës historike.

"Se ç'është dhe nuk është huazim latin në gjuhën shqipe kjo është detyrë e romanistit. Prandaj – vazhdon Çabej – atij i del një detyrë dyfishe, nga njëra anë të ndajë huazimet latine nga huazimet e tjera, dhe nga ana tjetër të veçojë në shqipen elementin huazim nga elementi trashëgim"[4].

Elementi latin, si për vjetërsinë si për përmasat e tij, si edhe për rëndësinë kulturore që ka, zë një vend kryesor ndër elementet me burim të huaj të shqipes. Në një vështrim kulturor vihet re se ndikimi latin shtrihet në shumicën e sferave të fushës leksikore të shqipes, jo vetëm të botës konkrete e të kulturës materiale, po sidomos edhe në ato të jetës mendore e sociale. N. Jokli ishte i pari që e vuri re ndikimin latin në shqipe edhe në lëmin e ligjeve popullore. Sikundër dihet, Jokli mbi dëshminë e disa elementeve leksikore e të disa toponimeve që në trajtën e tyre përkojnë me dalmatishten, është i prirur të gjejë praninë e një elementi etnik që fliste latinisht në disa anë jugore të Shqipërisë veriperëndimore në kohën antike.

"Shqipja – thotë Çabej – në trajtimin e elementit të huazuar prej latinishtes, si gjeografikisht, ashtu edhe gjuhësisht, zë një vend të ndërmjetëm midis rumanishtes dhe dalmatishtes".[5]

Reflekset e grupit *ct* në gjuhën shqipe merren në analizë në bashkëlidhje me njëri – tjetrin dhe kryesisht ndër huazimet latine, duke u përpjekur të gjenden edhe shkaqet e përfitimit të trefishtë apo të dyfishtë të tij.

Çabej vë re se "në shqipen guturali *k* në grupin *ct* mori tri rrugë zhvillimi, pa u ditur mirë kushtet: më një anë u ndërrua në spirantin labial *f*, më tjetrën anë më *j*, më tjetrën u thjeshtua në *t*; pra *ct* dha *ft*, *jt* e *t*".[6]

---

[4] Çabej, E. vep. cit. f. 267.
[5] Çabej, E. *Stydime gjuhësore IV*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 256.
[6] Çabej, E. *Elemente latine në gjuhën shqipe*, në Studime Gjuhësore IV, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 290.

Di Giovine pranon për shqipen vetëm dy reflekse të grupit latin *ct*, *ct* > *jt* dhe *ct* > *ft*, duke përjashtuar të tretin *ct* > *t*.[7]

Studiues si Majer-Lybke e Jokli e kanë parë refleksin *ct* > *jt*, përkatësisht *ct* > *ft* si fonetikisht të kushtëzuar, në kuptimin që rezultati *ft* i detyrohet një zanoreje të labializuar paraprijëse *o* ose *u*, p.sh. shq. *luftë* < lat. *lŭcta*, ndërsa rezultati *jt* është përtftuar pas një zanoreje të palabializuar, p.sh. shq. *drejt* < lat. *dīrēctu*. Në ballë të fjalës i vetmi rezultat ka qenë *ft*, p.sh. shq. *ftua* < lat. *cŏtōneum*. Jokli ka dalluar edhe një refleks të tretë, *ct* > *t*, në fjalë si shq. *(n)dërtoj* < lat. *directāre*.[8]

Problemi i reflekseve të grupit *kt* në shqipe vështirësohet nga përpjekja e disa gjuhëtarëve rumunë, të cilët japin shpjegime duke u mbështetur në hipotezën e pavërtetuar të një shtegtimi të shqiptarëve prej lindjes në perëndim në një kohë të hershme. Për shtresimet në lidhje me reflekset e grupit *ct* në gjuhën shqipe të paraqitura nga Puşcariu, Weigandi e Barićі, Çabej ka shkruar se "për këtë mendim nuk ekziston as hija e një argumentimi të vërtetë"[9].

Në përgjithësi duhet thënë se latinishtja është gjuha që ka lënë gjurmë më të thella në shqipen. Ndikimi i saj duhet parë si një përshkrim intensiv i leksikut, ku ka dhënë më shumë emra, folje e mbiemra, po nuk mungon edhe në fjalëformim me anë të disa sufikseve.

Elementi latin brenda romantizmit ballkanik qëndron gjuhësisht midis rumanishtes e dalmatishtes, si një element dhe kontinental dhe bregdetar, i cili i përket në përgjithësi latinishtes ballkanike, po që në mjaft raste paraqet konkordanza të veçanta me romanitetin perëndimor. Mbi dëshminë e disa indiceve fonetike huazimet latine të shqipes ruajnë disa tipare arkaike që jashtë shqipes mezi gjenden sot në ndonjë gjuhë romane. Kjo tregon se këto kanë hyrë shumë herët në Iliri, më herët se në Daci a në Gali a Spanjë. Edhe në leksikun latin të shqipes, sidomos në atë të sferës kishtare, gjenden disa elemente që përveç shqipes nuk i ruan ndonjë nga gjuhët romane. Në disa raste është e vështirë të ndahen huazimet latine të shqipes nga huazimet që kanë hyrë prej greqishtes së vjetër. Në disa të tjera është e vështirë dallimi midis elementit latin e italian, dhe elementit latin e rumun. Në disa të tjera është tepër e vështirë të veçohen

---

[7] Di Giovine, P. *Il gruppo 79.* Di Giovine e shpjegon: lat. *factūra* me shq. *fëftyrë : fëtyrë* me rënien e *f*-së në grupin *ft* si pasojë e një asimilimi.

[8] Vehbiu, A. *Paolo Di Giovine, Il gruppo ct latino in albanese*, në Studime Filologjike I, Tiranë, 1989, f. 217.

[9] Marrë nga Luka, D. *Për refleksin kt: jt në gjuhën shqipe*, në Studime gjuhësore V, Shkodër, 1999, f. 91.

elementet latin nga elementet autoktonë të shqipes[10].

Çabej thekson se "ndikimi latin ka zgjatur së paku shtatëqind vjet. Që brenda një periudhe kaq të gjatë, huazimet latine, që hynin vazhdimisht në gjuhë, nuk kanë pësuar të njëjtin trajtim, kjo është një gjë që do të pranohet a priori; dhe kjo aq më shumë kur kihen parasysh përzierjet etnike që janë kryer gjatë kësaj periudhe".[11]

Domi thekson se "latinizmat e shqipes dalin në trajta që u takojnë shtresave kohësisht të ndryshme, pasi ndikimi i saj në shqipe u ushtrua për një kohë relativisht të gjatë prej disa shekujsh".[12]

Si nga pikëpamja historike, por edhe nga ajo gjeografike, mbështetet teza se huazimet latine të shqipes kanë hyrë gjatë kontakteve të drejtpërdrejta të shqiptarëve me latinët, por edhe gjatë kontakteve të saj me latinishten e Dalmacisë, e më pas me latinishten danubiane. Duke u nisur nga premisa se bregdeti Adriatik dhe zonat pranë tij bëjnë pjesë në atdheun e lashtë ballkanik të shqiptarëve, Di Giovine me të drejtë thotë se "kontaktet midis shqipes dhe latinishtes së Dalmacisë janë më të hershme sesa kontaktet midis shqipes dhe latinishtes danubiane".[13]

Pozita gjeografike e Shqipërisë përbrenda trevës së kulturës greko-romake në kohën antike, prania e ngulimeve greke e romake në këto anë, marrja e huazimeve greke e latine afërsisht në të njëjtën periudhë dhe në rrethana kulturore të barabarta, refletimi i tyre në mënyrë të barabartë në gjuhën shqipe, e më në fund ekzistenca e huazimeve greke në latinishten dhe e huazimeve latine në greqishten, këto të gjitha bëjnë që për ndonjë fjalë nuk del në mënyrë të plotë se me ç'rrugë ka depërtuar në shqipen[14].

Megjithëse vepra shkencore "*Il gruppo ct latino in albanese"* e prof. Di Giovines, nuk e zgjidh problemin e reflekseve të grupit latin *ct*, në shqipe, shquhet për cilësinë e saj shkencore, për analizën e thellë objektive, pasi e studion çështjen e historisë së shqipes duke shfrytëzuar etimologjinë e saj, dhe duke i krahasuar me arritjet në lëmin e romanistikës dhe të ballkanalogjisë.

Në përmbyllje të kësaj paraqitjeje shumë të përmbledhur të kontributit të Di Giovines për albanologjinë, duhet të theksojmë se puna e tij e madhe pohon

---

[10] Çabej, E. *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Pishtinë, 1976, f. 55, 56.
[11] Çabej, E. vep. cit. f. 256.
[12] Domi, M. *Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe*, në Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij, Tiranë, 1988, f. 179.
[13] Vehbiu, A. vep.cit. f. 226.
[14] Çabej, E. vep. cit. f. 272.

padyshim seriozitetin e tij shkencor, si gjuhëtar, filolog dhe albanolog. Kontributi i tij për albanologjinë është i rëndësishëm pasi një pjesë të studimeve të tij ua kushton gjuhës shqipe, dialekteve, filologjisë, etimologjisë, letërsisë arbëreshe etj.

Bibliografi

Çabej, E. (1976). *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Pishtinë

Çabej, E. (1977). *Studime Gjuhësore IV*, Rilindja, Prishtinë

Domi, M. (1988). *Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe,* në "Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij", Tiranë

Demiraj, Sh. (1991). *Sugli studi albanologici in Italia,* në "Zjarri", Nr. 35/36

Di Giovine, P. (1982). *Il gruppo CT latino in albanese,* Roma

Di Giovine, P. *Tracio, Dacio ed Albanese nella prospettiva genealogica,* Accademia Nazionale del Licei, estratto dal fasc. 7-12 (luglio-dicembre), serie VIII, vol XXXIV, f. 397-412.

Di Giovine, P. *L'albanese una lingua lessicalmente romanizzata?* Leksion i mbajtur në "La Sapienzà" të Romës, më 10.02. 2005.

Luka, D. (1999). *Për refleksin kt:jt në gjuhën shqipe,* në "Studime gjuhësore" V, Shkodër, f. 91-102.

Topalli, K. (2002). *Mbylltoret e gjuhës shqipe,* Tiranë,

Topalli, K. *La fonetica storica e l'antichità della lingua albanese,* leksione të mbajtura në Universitetin "La Sapienzà" të Romës më 18.02.2008.

Shkurtaj, Gj. (2003). *Dialektologjia,* Tiranë

Vehbiu, A. (1989). *Paolo Di Giovine, "Il gruppo ct latino in albanese",* në Studime Filologjike I, Tiranë, f. 217-227.

Anila OMARI, ASA, Tiranë

LE IDEE DI DEMETRIO CAMARDA SULLA LINGUA LETTERARIA ALBANESE - UN APPROCCIO RISORGIMENTALE

Ormai si è confermato tramite diversi studi recenti[1] che al Risorgimento albanese un forte spunto è stato dato dalli intellettuali arbëreshë, proprio nel diciottesimo secolo, in cui la tradizione letteraria dell'area culturale del Nord cattolico albanese del '500-'600 si era ormai quasi spenta. Gli arbëreshë erano plasmati sin dagli inizi della loro migrazione in Italia e anche prima, nella terra degli antenati, di un forte senso identitario[2], come un tratto caratteristico dell' etnia albanese, messo in evidenza anche dal noto studioso delle nazioni Eric Hobsbawm.[3] Questa spiccata coscienza protonazionale si è sviluppata nella nuova patria anche dalle istituzioni religiose e culturali, libere di crescere, contrariamente a quello che succedeva nell'antica patria, e ravvivata nel '700 dalla creazione dei due Collegi italo-greco-albanesi di Calabria (1732) e di Sicilia (1734), dove si formò una élite intellettuale consapevolizzata delle sue origini e

---

[1] Cf. M. Mandalà, "L'opera di Nicolò Chetta e la cultura albanologica italo-albanese nel XVIII secolo", in: *Dialetti italoalbanesi e letteratura*, Palermo 1992; "Paolo Maria Parrino e le origini dell'*ideologia albanista*", in: *Aspetti della cultura bizantina ed albanese in Sicilia*, Palermo, 2005; "Vepra e pabotuar e At Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII", in: *Studime Filologjike* 1-2, Tiranë, 2006; "Ideologjia albaniste dhe Rilindja e parë: aktivitetet e arbëreshëve gjatë shekullit XVIII, in: *Një rilindje para "Rilindjes"*, Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës, Gjirokastër, 2014; quelli di F. Altimari, " Il ruolo degli intellettuali arbëreshë nella "Rilindja" albanese e nella storia culturale del Mezzogiorno", in: *Riflessioni sul Mezzogiorno*, Istituto Mezzogiorno Mediterraneo, Collana dell'Istituto Mezzogiorno-Mediterraneo Vol. 3, Cosenza, 2004; Gli Arbëreshë d'Italia per la rinascita dell'Albania tra XVIII e XIX secolo: parallelismi con altre diaspore di area italo-balcanica, *Studia Albanica*, Tirana, 2012; Napoli, vatër e rëndësishme e Rilindjes arbëreshe dhe shqiptare (shek. XVIII-XIX), in: *Një rilindje para "Rilindjes"*, Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës, Gjirokastër, 2014; Naples, an important center of the Arbëresh-Albanian Renaissance in 19th Century, *Studia Albanica*, nr. 2, Albanian Academy of Sciences, Tirana; e di B. Demiraj, "Giorgio Guzzetta e le origini della filologia arbëreshe", in: *Studi filologici arbëreshë*, Albanistica 5, Collana diretta da F. Altimari, Comet Editor Press, Cosenza, 2015.

[2] F. Altimari, Gli Arbëreshë d'Italia per la rinascita dell'Albania tra XVIII e XIX secolo: parallelismi con altre diaspore di area italo-balcanica, *Studia Albanica*, Tirana, 2012, p. 1.

[3] E. Hobsbawm, *Nationen und Nationalismus. Mythos und Realität seit 1780*, Campus Verlag, Frankfurt/New York, 2. Auflage 1992, p. 86.

preoccupata di mostrare l'antichità e la peculiarità della loro etnia, anche di fronte alla sua confusione e identificazione con quella greca, un opinione diffusa nell'Italia del tempo motivata dalla comune appartenenza religiosa. Nel secolo successivo, questa élite intellettuale, arricchita altresì delle idee del Risorgimento italiano, cercò di fare conoscere all'opinione europea la questione albanese, attraverso la viva attività editoriale nel campo della storia, cultura e lingua albanese.

La strada degli albanesi verso il Risorgimento nazionale del XIX secolo (ovvero la Rilindja albanese) è stata segnata da diversi momenti intensi storico-sociali di lotte per libertà, almeno dal secolo XV in quà, i quali sono stati accompagnati da un risveglio della coscienza etnico-nazionale, la quale tuttavia negli albanesi non fù mai spenta, anche in qualche periodo di affievolimento relativo, come fù il periodo prerisorgimentale del Settecento. In ognuna di queste fasi il risveglio del sentimento etnico è stato seguito e insieme guidato dall'idea della lingua albanese, dal mito della sua antichità e originalità e della sua scrittura come mezzo di sviluppo nazionale. La lingua è stata per gli albanesi il primo fattore identificatore e unificatore nazionale e questi periodi hanno segnato anche i passi più importanti nello sviluppo dell'albanese come lingua scritta. Gli inizi della scripta albanese con "La formula battesimale" coincidono con l'epoca gloriosa di Scanderbeg; i principi della letteratura filobiblica albanese sono prodotto dell'attività culturale-letteraria-politica del clero cattolico istruito dei secoli XVI-XVII, fattore importante precursore della Rilindja nazionale, intanto che la tradizione letteraria ortodossa dell'Albania Centrale potrebbe aver segnato l'inizio degli impegni per una lingua comune per tutti gli albanesi, anche se temporaneamente ammutolita sotto l'influsso culturale e politico della Patriarcana greca, consolidatasi alla fine del XVIII secolo.

Ognuno di questi periodi ha spianato e illuminato il percorso verso il Risorgimento nazionale del XIX secolo. Tuttavia, solo in questo secolo furono sviluppate e maturate pienamente le condizioni economico-sociali, storiche, politiche e culturali che hanno reso possibile la progettazione dell'ideologia di costruzione nazionale, un ideologia che metteva in primo piano i valori nazionali al di sopra dei particolarismi regionali e religiosi. In queste premesse nacque anche la questione di una lingua comune nazionale. In ragione del maggiore sviluppo economico e culturale del paese dove avevano trovato asilo da qualche centinaio di anni, queste condizioni maturarono alquanto prima negli albanesi d'Italia, dai quali sono usciti alcuni dei promotori della Rilindja nazionale albanese. Accanto ai trattati sull'identità storico-culturale e etnolinguistica degli

arbëreshë in quanto un etnia diversa dai greci, con i quali venivano spesso identificati a causa dello stesso rito religioso, tra gli studiosi arbëreshë è stata articolata presto anche l'idea di una lingua comune per tutti gli albanesi. Questa idea, all'inizio verosimilmente limitata nei circoli letterari arbëresh, pare che abbia messo radici già nel XVIII secolo negli arbëresh intellettuali, i quali con la cura della loro letteratura elevarono la lingua albanese non solo a livello di lingua poetica, con i testi di Nicola Brancati, Niccolò Figlia, Niccolò Chetta, ma anche di una lingua "ufficiale", con le lettere in albanese e latino di Monsignor Giuseppe Schirò dirette al Papa[4], oppure nei testi teologici e dottrinari composti da Niccolò Chetta[5]. Questi testi mostrano un albanese letterario sopradialettale, che include elementi del tosco, del ghego e del tosco arbëresh ed è purificato dalle influenze dialettali e italiane, con le caratteristiche di una koiné della comunicazione scritta.[6]

Questa tradizione culturale fù il suolo che ha nutrito gli attivisti arbëreshë della Rilindja nazionale del XIX secolo.

Demetrio Camarda è stato uno degli eminenti intellettuali arbëreshë, sacerdote, scrittore e linguista, il quale ha lasciato alcuni lavori di base nel campo della lingua e letteratura albanese. Influenzato da altri intellettuali arbëreshë di rilievo, suoi coevi, come Vincenzo Dorsa, Giuseppe Schirò, Girolamo de Rada e specialmente dalla illustre scrittrice e attivista Dora D'Istria, Camarda volse la sua attenzione verso la patria degli antenati sotto il dominio turco e adottò l'idea della sua indipendenza.[7] Un forte elemento che doveva servire alla unione albanese in funzione della causa finale era la lingua comune della letteratura albanese. La lingua albanese e la sua cura erano la preoccupazione principale degli attivisti della Rilindja come mezzo di presa di coscienza e di risveglio del sentimento nazionale degli albanesi. Camarda, a parte lo studio approfondito dell'albanese nel suo sistema linguistico e i tentativi di accertamento dell' origine del suo lessico nella sua opera fondamentale "Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese", giudicava necessaria una lingua letteraria comune per tutti gli albanesi e si impegnò in questo senso. Egli pensava che

---

[4] Vedi il lavoro di B. Demiraj, "Joseph Schirò në kulturën e shkrimit shqip të shekullit XVIII" in: *Studi filologici arbëreshë*, Comet Editor Press, Cosenza, 2015, f. 85-130.

[5] Vedi M. Mandalà, "Introduzione", in: P. Giorgio Guzzetta, *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa*, Palermo, 2007, f. 25.

[6] Ivi.

[7] Vedi anche A. Guzzetta, "Demetrio Camarda, uomo di fede, patriota, scrittore, linguista", in: *Demetrio Camarda e la linguistica albanese*, Atti del XI Convegno Internazionale di Studi Albanesi, Palermo, 20-22 Aprile 1983, Centro Internazionale di Studi Albanesi « Rosolino Petrotta », Facoltà di Lettere e Filosofia - Università di Palermo.

"una lingua nazionale comune colta ed illustre ‹che› è il primo e più necessario vincolo delle genti di una medesima stirpe".[8] Egli sviluppò la sua idea sulla lingua comune e sul modo in cui doveva crearsi questa lingua anche in polemica con il pensiero di De Rada sulla stessa questione.

Girolamo de Rada, combattente di prima fila nella causa del risorgimento della nazione albanese, si era appassionato dell'idea di una lingua letteraria comune a tutti gli albanesi. Alla base della sua idea risorgimentale egli aveva la creazione di una letteratura nazionale albanese[9], per rendere nota all'Europa l'anima e le virtù della nazione albanese, finora velata dall'oscurità della storia[10]. Questa letteratura, che aveva le origini nella poesia popolare, egli si sforzò di creare lui stesso, cercando di elaborare la sua lingua allo scopo di crearne una lingua letteraria. Come base dialettale di questa lingua comune, che egli usò anche nelle regole grammaticali della lingua albanese, egli scelse la parlata vernacolare delle colonie arbëreshë della Calabria dove era nato, essendo convinto che essa conservava in modo migliore le forme autentiche dell' albanese e si manteneva più puro delle influenze straniere. Il suo punto di vista sulla lingua letteraria degli albanesi appare chiaro nella sua corrispondenza con Demetrio Camarda negli anni 1865-1866, analizzata già in dettaglio da Androkli Kostallari[11].

Demetrio Camarda formula la sua critica dalla posizione del linguista e filologo istruito. Egli considera irragionevole ("delitto di leso buon senso") "il voler dare ad un‹o› [dialetto] particolare, di gente dispersa da secoli, ed esule dal patrio suolo, penetrata da ogni parte da straniere influenze, e volta per legge naturale a decadenza siccome ramo staccato dal tronco, volergli dare, dico, autorità superiore alla lingua stessa parlata nel proprio nativo paese dove essa

---

[8] D. Camarda, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Discorso preliminare, p. XI.

[9] "Nella mente di Girolamo De Rada sorse e s'indugiò con persistenza la grande idea di creare una letteratura nazionale albanese… Il popolo albanese non aveva letteratura, bisognava crearla, la lingua era rozza, bisognava correggerla; quest'interesse prevalse sopra ogni altro ed egli volle raggiungere la vittoria nel tentativo immane", cfr. Fr. Argondizza, "G. De Rada il Vaticinatore della libertà albanese", in *Rivista dei Balcani*, Roma, Anno I, nr. II, 30 luglio 1912, vedi G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Palermo, 2003, p. 235.

[10] "Non posso insieme non confessare la interna soddisfazione del potere presentare alfine alla culta Europa questo specchio della *natia virtù* della nazione mia, da essere conosciuta e pur comparata a quella che mai sia de' Neo-Elleni, riflessa in geniali lor produzioni letterarie", cfr. G. de Rada, *Antologia albanese*, Napoli, 1896, Prefazione, p. 4.

[11] A. Kostallari, "Rreth një pikëpamjeje të Jeronim de Radës për formimin e gjuhës letrare të kombit shqiptar", *Studime Filologjike*, nr. 3, 1981, p. 33-46.

vive vita rigogliosa e spontanea, qualunque siano le condizioni politiche della nazione".[12] De Rada da parte sua insiste nel suo progetto, messo in pratica ormai da decenni delle sua vita, e lo giustifica con il fatto che "le Colonie disseminate nelle provincie meridionali han già diverse provenienze" quindi non sono un dialetto particolare, ma "una lingua notata di vari dialetti" e inoltre con la sua persuasione che "le lingue stanno radicate nel vivo terreno delle anime nazionali; e che dove questi si serbino più schietti d'estranea lega, quella vi si mantenga più pura".[13] La lingua letteraria di De Rada ricevette critiche anche da altri intellettuali arbëreshë e fù giudicata come una varietà che mai sarebbe diventata la lingua comune degli albanesi.[14]

Demetrio Camarda pone la questione di una lingua comune per la nazione albanese in un modo più razionale e scientifico. Come criterio di accettazione di un elemento linguistico nella lingua letteraria comune egli considera il suo uso costante e generale.[15] Egli vede nelle creazioni popolari delle diverse parlate dell'albanese, come quelle delle raccolte di Hahn e dei testi di Reinhold, i primi passi per la costruzione di una lingua ben regolata e colta, con la prospettiva di diventare un giorno anche lingua letteraria.[16] L'importante per lui, è che in quelle creazioni si trovano gli elementi, la natura e le forme di una lingua albanese generale e comune a tutta la nazione albanese.[17] Per Camarda è chiaro che la lingua letteraria deve costruirsi su una specifica base dialettale, benchè quanto più larga e comprensibile per i due principali dialetti dell' albanese. Per quanto non fosse mai stato in Albania, egli è consapevole dell' esistenza di un area linguistica centrale dove s'incontrano e si mescolano i due dialetti albanesi, un area che va dal fiume Shkumbin al fiume Vjosa, la di cui parlata sarebbe la più idonea a diventare lingua comune.[18] Tuttavia, come

---

[12] D. Camarda, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, op. cit., p. 156.

[13] G. de Rada, *Grammatica della lingua albanese*, Firenze, 1870, p. 56 v.

[14] Citazione di Giuseppe Schirò in G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Palermo, 2003, p. 234.

[15] D. Camarda, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata*, Prato, 1866, p. 154.

[16] D. Camarda, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata*, p. IV.

[17] Idem, ibidem.

[18] "In guisa che se non può dirsi esattamente quello il linguaggio comune di tutta la nazione illiro-epirotica [si tratta della lingua della traduzione del Nuovo Testamento da V. Meksi su redazione di Gregorio di Argirocastro - A. O.], esso ne ha certo le più essenziali e genuine proprietà, ed è il più idoneo a divenir tale, si per le intrinseche prerogative, come per la posizione centrale dei paesi ove domina, in alcuni dei quali, e precisamente nel non breve tratto fra lo Shkumbi ed il Vojussa, odesi contemperato il tosko al ghego idioma (Hahn I, 218)", D.Camarda, ibidem, Discorso preliminare, f. V.

linguista egli sa che una lingua comune e generale non può esistere nella bocca del popolo, tendente a diramarsi in diversi dialetti, e, influenzato anche dal processo di formazione della lingua letteraria italiana, è dell'opinione che questa lingua comune dovrebbe essere il prodotto della coltura delle lettere, formato del fiore dei diversi idiomi locali, come sempre è accaduto in tutte le nazioni colte[19]. Secondo lui, il gran padre dell'illustre lingua d'Italia, Dante Alighieri, non preferiva un particolare dialetto ma si giovava di tutti, regolandosi sul modello della lingua latina per quanto il volgare lo permetteva. I singoli dialetti, egli riteneva, per quanto diversi che siano, sono patrimonio comune dell'intera nazione ed essa ha il diritto di proffittarne tutta quanta.[20] Pertanto, per la formazione della lingua comune albanese, era necessario ricercare i vari dialetti dell'albanese, nel modo in cui l'aveva fatto Reinhold sull'albanese della Grecia.[21] In questa richiesta troviamo per la prima volta espressa l'idea dello studio dei dialetti albanesi come premessa del progetto di una lingua comune letteraria, idea che sarà espressa più tardi solo nel 1952 dall'eminente linguista albanese Eqrem Çabej nell'ambito di una discussione sulla futura lingua comune della letteratura albanese.

Per rendere noto agli studiosi i modelli linguistici delle svariate aree dialettali dell'areale albanese Camarda compilò un antologia di testi scelti albanesi[22], che includeva dai pezzi in prosa della traduzione del Nuovo Testamento in dialetto tosco (1827), testi della parlata contemporanea scutarina (1845), fino ai testi folclorici in prosa e in versi in dialetti tosco, ghego centrale e sopratutto delle parlate arbëreshe di Italia e della Grecia, le quali considerava essere le più pure e immacolate dai turchismi.[23] Camarda s'impegnò anche in prima persona per la creazione di una lingua comune letteraria albanese, che provò di realizzare all'occasione della traduzione di uno studio di Dora D'Istria, pubblicato in francese nel 1866.[24] Nella Prefazione della pubblicazione albanese egli descrive

[19] "Fra tutte le colte nazioni invero questa lingua comune fu sempre il prodotto della coltura delle lettere, e non puo formarsi che del fiore per cosi dire dei diversi idiomi locali." Cfr. D. Camarda, *Appendice al saggio*, op. cit., Discorso preliminare, p. VIII.

[20] Ivi, p. XII.

[21] Ivi, p. X.

[22] *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, op. cit.

[23] Vedi p. 46-47, nota a.

[24] Dora D'Istria, "La nationalité albanaise d'après les chants populaires", in: Revue des deux mondes, Paris, 1866.

anche il metodo di formazione della lingua usata nella traduzione[25], che aveva già esposto nel discorso preliminare dell'Appendice di grammatologia comparata. Conformemente alla sua idea di un metodo eclettico per la creazione di una lingua comune, sopradialettale, valevole per tutti gli albanesi, egli lesse e studiò i vecchi testi albanesi e la loro lingua, nonchè tutto quanto era finora pubblicato in albanese[26], e fece uso della materia dialettale che gli pareva la migliore, la più nobile e pura albanese, in base al suo studio approfondito comparativo dell' albanese con le lingue sorelle (*Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864)[27]. Per i vocaboli astratti e dotti che non si potevano trovare in albanese, egli si servì della formazione di parole con la materia dell' albanese, nonchè del prestito linguistico, attingendo di più dal greco, secondo la sua idea della maggiore affinità dell'albanese con il greco, e scegliendo quei vocaboli che pensava avessero radice comune con l'albanese e che, quindi, non erano del tutto estranee. I turchismi cercò di eliminare del tutto dal suo linguaggio, come elementi della lingua di un popolo occupatore che non aveva legami di sangue e di etnia con gli albanesi. La lingua creata da Camarda meriterebbe uno studio specifico,[28] ma qui ci limiteremo in alcuni suoi tratti principali.

La base dialettale della sua lingua letteraria è comunque la variante siculo-albanese del tosco meridionale, emmendato sulla lingua del Nuovo Testamento in albanese pubblicato a Corfù nel 1827, anche quella una variante del tosco meridionale del lato occidentale (la costiera meridionale). Dalla lingua dei vecchi testi albanesi egli ricorse innanzitutto a Pietro Budi, come il più antico e

---

[25] Vedi Dora D'Istria, *Fylétia e Arbënore prej kanëkatë laoshima*, enkëthyeme në shkjipe përej D. Camarda, Në Livurnë, te typografia e P. Vannini e të Biritë, 1867, Prékallëzimë, p. III-X.

[26] D. Camarda, Prékallëzimë, f. X.

[27] "prashtu fjalatë e formatë gluhënishta që m'u-kanë fanarturë [dukur – A.O.], me gjithë spudhaksjen [studimin] t'eme, të mira e të bukura 'ndë çillindo dhialektë, a të folunë shqipë, unë ato i kamë dheksurë e përqaffurë [pranuar] tue unjitunë, e 'mbashkuenë të 'ndërishmetë dhialekte ënde proterimatë [të mirat] atune; posi janë ('mbë pjessë ndopakë) t' embashkuarë 'ndai Shqipëtarët' e së messëmes Arbënie; për të aratisurë [krijuar] e themeluarë ëmbë këtë mënyrë, në dashtë Inëzotë, një gluhë 'ndevonë mefëtetë [me të vërtetë] Shqipëtarkë të gjithakushme [të përgjithshme], e për të dalë 'ndë të shkruomit përej synoreshë [kufijsh] të Gegarismitë si edhe të Toskarismitë". Cfr. D. Camarda, Prékallëzimë, in: *Fylétia e Arbënore*, op. cit., p. V. Il testo di Camarda l'abbiamo trascritto nell'alfabeto odierno dell'albanese.

[28] Uno studio sulla lingua letteraria del Camarda è stato pubblicato anche da Gëzim Gurga: "Idiolekti "letrar" i Kamardës në dritën e veprës "Fyletia e Arbnore prej kanëkatë laoshima"", *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2011, pp. 112 - 124.

il migliore[29], dal quale prese il gruppo vocalico *-uo*: *të dystuome* (f. III), *të shkruomit, të pandrepuomi, të panumëruome* (f. V), *zakonuomë, mërguomë, e malljështuoshime, e huoja* (f. VI), *e kulluome* (f. VII), *e martuome* (f. XI) come anche l'usanza della spiegazione di un concetto con due o tre sinonimi o con una frase intera, per renderlo più chiaro.[30] Dal dialetto ghego prese il suffisso *-ni*: *foshnjëniën, vaizënia* (f. XV), *shokënia* (f. XX), i participi in *-m* e *-n* (con i loro derivati sostantivali e aggettivali): *'nkëthyemë* (p. III), *tue mennuemë* (p. V), *t'uidisme* (p. VI), *(fjalatë) ljipisme* (alb. moderno "fjalët e duhura" - le parole giuste) (p. VII), *(të kavshavet) ligjiruome, (dëshmi) i shkruomë, (frasë) të 'ndenëme* (alb. mod. "fjali të shtrirë, të zgjeruar" - frase estesa) (p. VIII), *e pamundme* (p. X), *e lamparmeja* "e ndritura - la illustre", *i namatismi* "i famshmi - famoso" (p. XI), *tue unjitunë e 'mbashkuenë, për të kallëzuenë, me u-bënë* (p. V), *(tue) ljëftuenë* (p. VI), *tue mataruenë* (p. IX), *me shpëtuenë* (p. XIII); lessemi del ghego settentrionale, come *vullnesë* (*vetëvullnesën* p. VI), *vdekë* (p. VI), *ndeerien* (p. XVII), *rezmë* "ndikim - influenza" (p. XIX), *kernallen* "oqeanin - l'oceano" (p. XVIII), *shëmëllëtyrë* (p. XXI), *andë* (p. XXI), *përçudë* (p. XVIII), *e konshime* (p. VII), *e 'nqielshme, e hyinushme* (p. VI), *me u madhënue* p. VI, *shpallunë* "botuar - pubblicare", *tue xanunë e gjegjunë* (p. XVII), *shëlboi* (p. XXI) ecc. Per quanto nell'epoca non si sapeva del "Messale" di Buzuku, Camarda usa una particolarita grafica simile a quella di Buzuku: l'aggiunta di un' *e* davanti ai gruppi consonantici *mb, nd*: *embi* (p. III), *embashkimatë* (p. VI), *embarë* (p. XVIII), *embretërishte* (p. XX), *endonjë, endjekunë, endritshmen* (p. III), *endevonë* (p. IV), *enderishe* "ndryshe" (p. VI) ecc.[31] Nondimeno dall' analisi filologica del testo sembra che questa protesi vocalica non abbia semplicemente valore grafico, ma anche fonetico. Nei casi dove questa vocale si elide nella pronuncia, essa si sostituisce con un apostrofo: *me-'ndishkue* (p. III), *e 'mbashkuenë, tue 'mbashkuenë* (p. V) (accanto a *t' embashkuarë,* ivi), *'mbë pjesë 'ndopakë* (p. V), *të tërë 'ndërishme fylie* (p. VI) (accanto: *me-bënë enderishe,* p. V). Queste grafie si incontrano anche nelle canzoni popolari ripro-

[29] Cfr. D. Camarda, Prékallëzimë, p. X, nota 1. In quel tempo l'opera di Gjon Buzuku non era ancora conosciouta.

[30] Prékallëzimë, p. VIII. Cfr. p. es.: *tue unjitunë, e 'mbashkuenë, do stisenë e aratisenë* (f. V), *epistimonikatë, a dietarëtë* (f. V), *embashkimatë a meartismetë fjalashë* (f. VI), *kamë përdorunë e zakonuomë* (f. VI), *të mos ish kthjellëtë e 'nçelë noima, e mennimi* (f. VIII), *grammatikësë të synkrisurës, a përgljasunës* "gramatikës së krahasuar" (f. IX), *nja të bukurë përrallë, a puarëzë* (f. XIII).

[31] Cfr. anche *kur i(sh) engjall* nella Pericope Evangelica.

dotte dalla raccolta di Hahn nella sua antologia "Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua Albanese": *Endë gjumë kurë bi' e flë/ vjen një çupëz e më 'ngrë/ Engreu, mike, të keqenë; Endë tyj e kanë sevdanë* (p. 26), ma in questi versi esse non comportano una sillaba a se stante oltre l'ottosillabo folclorico, e lo stesso Camarda nota che la *ë* nonvocalica spesso non si conta per il verso[32]. D'altra parte questa protesi vocalica non si trova nella raccolta originale di Hahn[33], quindi è una trascrizione fatta da Camarda, verosimilmente secondo una tradizione grafica più antica che dovrebbe aver riprodotto una pronuncia reale.

Una simile lingua letteraria creata sperimentalmente da elementi tanto disparati e senza l'appoggio di una base dialettale naturale non poteva avere successo come impresa individuale e non ha trovato accoglienza nelle élites intellettuali dell'epoca che coltivavano la lingua albanese. L'idea di una lingua letteraria creata dalla mescolanza di diversi dialetti regionali come lingua comune per tutti gli albanesi dominava agli inizi della Rilindja nazionale albanese e fù messa in pratica da alcuni attivisti della Rilindja come Sami Frashëri, Naim Frashëri e specialmente Jani Vreto[34]. La stessa idea è stata espressa da Faik Konica agli inizi della rivista Albania[35], il quale, più tardi, avvicinandosi alla realtà, ha cambiato le sue opinioni riguardo alla lingua letteraria comune degli albanesi[36]. Nonostante l'improbabilità della creazione volontaria di una lingua comune dalla mescolanza dialettale, gli sforzi collettivi estesi nei secoli dei precursori della Rilindja, degli stessi attivisti della Rilindja e di tutti gli scrittori posteriori che furono illuminati dall'idea di una lingua letteraria sopradialettale con la partecipazione dei due dialetti principali dell'albanese, hanno concorso alla formazione di una lingua letteraria elaborata ed arricchita di materiale linguistico dall'intero areale albanofono.

Nel valutare l'opera di Camarda, l'eminente glottologo italiano G. I. Ascoli sottolineava il vero motivo del libro, che era "ricomporre a unità letteraria

---

[32] *Appendice*, p. 24, nota.

[33] Cfr. gli stessi versi in J. G. von Hahn, *Albanesische Studien* II, Jena, 1854, p. 128 nr. 4, p. 129 nr. 7.

[34] Cfr. Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Universiteti i Prishtinës, 1970, pp. 63-66, 68-69v.

[35] "Për themelin e nja gjuhës letrarishtes shqip", Albania, nr. 1, 1897, p. 4-5: "Është dhe vërtet që, veç munt Elbasanishtes, as nja nënëgjuhë ka miaft qëruari për me u-lartuem në krye të tjerave. Andaj duhet të marim pakë nga të tëra nënëgjuhërat; dhe jo të marim si të bjerë, po mbas këtyre kanuneve…".

[36] Kristina Jorgaqi, studio introduttivo in: *Faik Konica, Mendime gjuhësie*, Ombra GVG, Tirana, 2006, p. 16 e segg.

le disgiunte membra del popolo albanese, della gente di Pirro, di Giorgio Castriota e di Marco Bozzari”[37].

Con la sua attenzione verso la lingua e i suoi sforzi per una lingua letteraria comune per tutti gli albanesi, nonchè la sua opera albanologica e i suoi intenti politici, Demetrio Camarda si lascia annoverare con pieno merito tra i precursori degli attivisti della Rilindja nazionale albanese.

[37] G. I. Ascoli, *Studi critici*, vol. II, 1877, vedi A. Guzzetta, “Demetrio Camarda, uomo di fede, patriota, scrittore, linguista”, art. cit. p. 15.

Giuseppina TURANO, Universiteti i Venecies

KONTRIBUTI I STUDIUESVE ITALIANË PËR MORFOSINTAKSËN E GJUHËS SHQIPE

Abstrakt. Kontributi i studiuesve italianë në fushën e sintaksës së shqipes nis nga fundi i shekullit XX në Universitetin e Firences me përshkrimet e Leonardo Savoias për sistemin fonologjik të disa të folmeve arbëreshe bazuar mbi modelin teorik të gramatikës gjenerativiste. Më vonë, i njëjti autor, botoi disa artikuj për morfosintaksën e frazave kauzative në disa dialekte arbëreshe në bashkëpunim me Luciana Brandi-n. Kurse, në bashkpunimet me studiuesen Rita Manzini, ka trajtuar çeshtje të lidhura me sintaksën e fjalive infinitive, të fjalive joaktive, me sintaksën e klitikëve, me sistemin rasor.

Giuseppina Turano është e para që në botimin e saj të vitit 1995 merret jo vetëm me morfosintaksën e të folmeve arbëreshe por edhe me atë të gjuhës shqipe standarde, duke analizuar fjalitë me foljen lidhore si dhe ato pyetëse. Në studimet e saj, është marrë më përshkrimin e fjalive kauzative, negative, lokative, ekzistenciale, infinitive, urdhërore, me klitikët, me strukturat emërore. Të gjitha janë trajtuar në këndvështrim gjenerativist.

1. Hyrje

Në këtë shkrim do të fokusohem në kontributin që disa studiues italianë i kanë dhënë gjuhës shqipe dhe të dy dialekteve të saj, gegërishtes dhe toskërishtes duke marrë parasysh kontributet shkencore që i përkasin sistemit morfosintaksor. Pra, përjashtohen studiuesit arbëreshë si dhe studimet të kryera në fushat e tjera (fonetika, leksikologja) të gjuhës.

Studimet e derisotme në fushën e morfosintaksës së shqipes janë akoma të pakta.

Në studimet italiane kustuar gjuhës shqipe mund të dallohen tri qasje kryesore:

1) Studimet që janë marrë me karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe;
2) Studimet që janë marrë me karakterin ballkanik të gjuhës shqipe;
3) Studimet në të cilat është përdorur modeli çomskian për përshkrimin morfosintaksor të gjuhës shqipe.

2. Shqipja si gjuhë indoeuropiane

Do të filloj me studiuesin Vittore Pisani (1899-1990), i cili në mesin e shekullit të kaluar botoi një vëllim me titullin *Saggi di Linguistica storica* 'Ese

mbi gjuhësinë historike' (1959). Ky vëllim përfshin kapitullin *L'albanais et les autres langues indo-européennes* 'Shqipja dhe gjuhët e tjera indoeuropiane', në të cilin autori vështron shqipen në përqasje me gjuhët e tjera indoeuropiane, për të vënë në dukje disa dukuri paralele të lashta midis tyre.

Para se të merret me dukuritë karakteristike të shqipes, autori bën një premisë në të cilën shpjegon se do të marrë në konsideratë vetëm elementet që i paraprijnë latinizimit, pra ai do të injorojë latinishten, elementet bizantine dhe neo-helenike si dhe elementet turke të shqipes. Dhe, për sa i takon elementeve sllave, autori do të konsiderojë vetëm ato më të vjetra, që datojnë para dyndjeve barbare. Specifikon më tej se, për sa i përket bashkëpërkimeve shqiptaro-rumune dhe shqiptaro-bullgare, do të marrë parasysh vetëm ato që datojnë nga periudha e substratit trak te rumanistes dhe të bullgarishtes.

Katër janë dukuritë që kanë rëndësi të veçantë për morfosintaksën edhe pse autori i trajton vetëm si dukuri morfologjike. Në fakt, në dukuritë që përmend Pisani, morfologja ndërthuret ngushtë me sintaksën.

E para është prapavendosja e nyjës së shquar, për të cilën autori shkruan se e gjejmë jo vetëm në shqipe, por edhe në bullgarishte dhe në rumanishte, hapësirë në të cilën dikur flitej trakishtja, dhe e gjejmë edhe në armenishte dhe në gjermanishte.

Veçorja e dytë është reduktimi i numrit të rasave në krahasim me tipin e lashtë i.e. (nga tetë në pesë). Lidhur me këtë veçori është përputhja e gjinores me dhanoren. Pisani saktëson se: 1) në të folmët toske, gjinorja merr formën e dhanores, siç ndodh në rumanishten, armenishten dhe iranishten; ndërsa në të folmet gege, gjinorja merr trajtën e rrjedhores, siç ndodh në greqishten dhe në balto-sllavishten. 2) Gegërishtja ruan dallimin e hershëm midid dhanores, gjinores dhe rrjedhores, pasi kjo e fundit merr mbaresën i.e. e lokativit. Përfundimi i autorit është se shqipja ka ngatërruar gjinoren, dhanoren dhe rrjedhoren.

Veçorja e tretë për të cilën bën fjalë është lakimi binar i shquar/i pashquar.

Veçorja e katërtë që merr në shqyrtim është nyja e përparme e gjinores dhe ajo e mbjemrave: jep si shembuj përkatësisht: *bir i mbretit* dhe *mal i lartë* për rasën emërore dhe *biri të mbretit* dhe *mali të lartë* për gjinoren. Me disa shembuj të tjerë, përmend përshtatjen e nyjës me emrin sipas gjinisë, numrit dhe rasës. Të njëjtën veçori e gjejmë në rumanishte dhe, jashtë gadishullit ballkanik, në iranishten, dmth. në gjuhën persiane dhe në dialektet e saj, ku mbiemri dhe gjinorja lidhen me emrin nëpërmjet nyjes *i*. Pra, kjo isoglosë bashkon shqipen me trakishten dhe me iranishten.

Në fund të kapitullit, autori thekson se këto tipare të përbashkëta e lidhin

gjuhën shqipe, nga njëra anë, me gjuhët gjermanike dhe me baltosllavishten, dhe nga ana tjetër, me trakishten (e përfaqësuar nga rumanshtja dhe nga bullgarishtja), me armenishten, me iranishten dhe me tokarishten.

Në vitet '90 të shekulli të kaluar, një studiues tjetër që ka trajtuar marrëdhëniet e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera indoeuropiane është Riccardo Ambrosini (1925-2008), i cili duke folur për truallin ku është formuar gjuha shqipe dhe për evolucionin e strukturës gramatikore të saj, dallon dukuritë që shqipja i ka trashëguar nga një fazë e hershme nga ato që janë zhvillime të reja, të përftuara gjatë evolucionit të saj historik. Edhe pse nuk është marrë posaçërisht me sintaksën, autori përmend disa veçori që, dashur pa dashur, hynë në fushën e morfosintaksës. Ambrosini (1981) përmend kundërvënien e kategorisë së caktuar dhe të kategorisë të pacaktuar që kujton dallimin midis lakimit të fortë dhe lakimit të dobët të mbiemrit në gjuhët gjermanike; përmend togfjalëshat e tipit *emër+deiptik+gjinore* dhe *emër+deiptik+mbjemër*, për të cilët jep shembujt *rrugë e fushës* dhe *burrë i mire;* përmend rimarrjen e kundrinës me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë, si në shembullin *Zefi e mori librin;* përmend përdorimin simultan të përemrave të theksuar dhe të patheksuar, si në shembujt *Dhimitri më thonte mue kështu* dhe *mue më quejnë Zef* (Ambrosini 1981).

Përveç këtyre, autori citon edhe procesin e formimit të zgjedhimit jovepror (vetvetor dhe pësor) për të cilin përdoren: a) mbaresa vetore të posaçme në kohën e tashme dhe në kohën e pakryerë (kjo është dukuri arkaike që afron shqipen me iranishten); b) forma analitike me pjesëzën *u* (më origjinë përemërore) për kohën e kryer e thjeshtë, për kohët e dëshirores, të habitores dhe të paskajores; c) forma perifrastike me foljen ndihmëse *jam*, për të gjitha kohët e së kryerës. Sipas Ambrosini-t, këto tri mënyra ndërtimi janë fenomene të periudhave të ndryshme: nga njëra anë, kanë hyrë në gjuhën shqipe falë vendndodhjes qendrore të saj në kuadrin e gjuhëve indoeuropiane, kurse nga ana tjetër, janë rezultat i një evolucioni të gjate historik, që gjuha shqipe ka pësuar në mënyrë të pavarur në truallin ballkanik.

Përfundimi i autorit është së konvergjencat e shqipes me gjuhët baltosllave lidhen me afërsinë dhe pozicionin gjeografik e këtyre gjuhëve, në kohët antike. Burimin e konvergjencës së shqipes me gjuhët ballot-sllave, autori e shpjegon me faktin se nga 2500 deri 2000 para Krishtit, gjuha shqipe flitej deri në Poloninë e sotme, kurse konvergjencat e shqipes me iranishten dhe armenishten datojnë nga periudha nga 2000 deri në 1500 para Krishtit dhe lidhen me migrimet në Rumaninë e sotme (Ambrosini 1981, 1996).

3. Shqipja si gjuhë ballkanike

Qasja e dytë në studimet italiane kushtuar gjuhës shqipe është ajo në të cilën trajtohet karakteri ballkanik i shqipes.

Dy studiues janë marrë me këtë aspekt: Emanuele Banfi në librin e tij *Linguistica balcanica* 'Gjuhësi ballkanike', botuar më 1985 dhe Giovan Battista Pellegrini (1921-2007) në librin *Avviamento alla linguistica Albanese* 'Hyrje në gjuhësinë shqipe', botuar më 1998.

Këta studiues janë marrë me shqipen si gjuhë e bashkësisë gjuhësore ballkanike, e cila përfshin dy gjuhë indoeuropiane më vete, greqishten e re dhe shqipen; disa gjuhë sllave si bullgarishten, kroatishten, maqedonishten, serbishten, sllovenishten; një gjiuhë romane: rumanishtja, dhe një gjuhë joindoeuropiane, turqishtja, edhe pse kjo nuk flitet në arealin ballkanik.

Në studimet e këtyre dy autorëve, dukuritë gjuhësore të shqipes janë vështruar në përqasje me dukuritë e ngjashme të këtyrë gjuhëve. Këto gjuhë të folura në arealin ballkanik, kanë, cila më shumë cila më pak, disa tipare të përbashkëta të cilat nuk gjenden në gjuhët me të cilat ato janë më të lidhura gjenetikisht; janë tipare që nuk rrjedhin nga një prejardhje të përbashkët, por nga fakti se këto gjuhë rrojnë krah për krah, pra janë tipare që janë zhvilluan në rrymë të kohës si rezultat i një ndërndikimi gjuhësor.

Tiparet kryesore të bashkësisë gjuhësore ballkanike të përmendura nga Banfi dhe Pellegrini janë ato që janë pranuar në mënyrë unanime nga të gjithë studiuesit.

Emanuele Banfi, duke ndjekur propozimin e Shaler-it (Schaller 1975), bënë dallimin midis ballkanizmave primarë, që karakterizojnë gjuhën bullgare, maqedonase, rumune dhe shqipe dhe ballkanizmat sekondarë, ata që gjënden në të paktën në dy gjuhë ballkanike me kusht që këto dy gjuhë të mos i përkasin të njëjtes familje gjuhësore.

Si ballkanizma primarë, në fushën e mosfosintaksës, Banfi jep:

1) Përputhjen e gjinores me dhanoren në bullgarishten, greqishten e re, maqedonishten, rumanishten dhe në shqipen. Shembujt e Autorit janë: *shtëpia e plakut* dhe *ja tha plakut*. Banfi saktëson se është trajta e dhanores që përdoret për gjinoren, dhe shton se me dhanoren/gjinoren përputhet edhe rrjedhorja, kurse emërorja përputhet me kallëzoren. Ky proces lidhet ngushtë me reduktimin e numrit të rasave, pra me thjeshtësimin e lakimit emëror.

2) Prapavendosjen e nyjës në bullgarishten, maqedonishten, rumanishten, shqipen. Shembujt që jep autori janë: *shok ~ shok-u*, *vajzë ~ vajz-a*. Ky fenomen është shumë i vjetër dhe, ndoshta, ka burimin në latinishten e Ballkanit.

3) Humbjen e paskajores në bullgarishten, greqishten, maqedonishten, shqipen. Në rumanishten, në serbo-kroatishten dhe në të folmet jugore të Shqipërisë, përdorimi i paskajores është i kufizuar, pra zhdukja nuk është e plotë. Paskajorja, në gjuhët ballkanike, mund të zëvendësohet me dy struktura të ndryshme: a) një fjali e varur qëllimore, me foljen lidhore, që paraprihet nga pjesëza *të;* b) një fjali e varur me foljen në mënyrën dëftore, që paraprihen nga lidhëzat *që/se*. Shembujt e autorit janë: *bëri që flë* dhe *mirë i ke bëre, që i ke prerë bishtin*.

4) Formimin e kohës së ardhme nëpërmjet një strukturë perifrastike të ndërtuar me foljen *dua* në bullgarishten, greqishten, maqedonishten, rumanishten, shqipen, dhe në disa dialekte të serbokroatishtes. Banfi jep si shembull: *do të punoj*. Përveç formës me *do*, shqipja njeh edhe formën me *kam*, që është tipike e gegërishtes: *kam me shkruaj*.

5) Reduplikacionin e objektit me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë, në bullgarishten, greqishten, maqedonishten, rumanishten, shqipen. Për këtë dukuri, Banfi nuk jep shembuj.

6) Përdorimin e lidhëzës *dhe* (nga lidhëza *ET* e latinishtes) përpara fjalive pohore që ndjekin një fjali mohore. Skema që jep autori është: fjali mohore + et + fjali pohore. Si shembull jep: *s'ndënjti shumë kohë, edhé na i vjen vdekija dhé plakut.*

7) Përdorimin e një strukture të tipit: Kallëzore + fjali substantive si e kishte latinishtja, dhe, për të cilën jep shembujt: *E dij mbreti, se ish djal tij* dhe *Gjeti të shoqënë që isht sëmurtur.* Kjo dukuri gjendet në bullgarishten, greqishten, rumanishten, shqipen.

Si ballkanizëm më të vogël, Banfi citon përdorimet më të shumta të parataksës në vend të fjalive të varura. Këtë dukuri e gjejmë në bullgarishten, greqishten, rumanishten, shqipen. Shembujt që sjellë autori janë: *Sh bim e rim?* dhe *Mund t i marr vetë zogut, edhé zogu most ë dëgjonjë.*

Si ballkanizëm sekondar, në fushën e morfosintaksës, Banfi përmend përdorimin e veçantë të parafjalës *me*, e cila kërkon një sintagmë emërore të shquar: *me shqiptarët, me hoxhën*. Kjo dukuri lidh gjuhën shqipe me rumanishten.

Edhe pse shembujt që sjell autori disa herë janë të diskutueshëm, libri i tij, edhe në ditët tona, mbetet një nga manualet më të mira të gjuhësisë ballkanike.

Giovan Battista Pellegrini shqipen e ka bërë objekt studimi në veprën e tij *Avviamento alla linguistica Albanese* (1998). Ky libër përfshin një kapitull

kushtuar raporteve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike. Këtu autori, duke folur për vendin e shqipes në kuadër të gjuhëve ballbanike, e klasifikon gjuhën shqipe si gjuhë ballkanike të shkallës së parë sepse ka një numër të madh bashkëpërkimesh me gjuhët e tjera të Ballkanit. Për përshkrimin e dukurive ballkanike, në më të shumtën e rasteve, ai i referohet Banfi-t dhe vetëm rallëherë shton informacion të ri. Për shembull, kur flet për prapavendosjen e nyjës shquese shton se ky fenomen gjendet edhe në gjuhët gjermanike dhe në armenishten dhe jep si shembuj disa fjalë të gjinisë mashkullore: *gur ~ guri*, *mik ~ miku*; të gjinisë femërore: *shtëpi ~ shtëpia*, *vajzë ~ vajza*; të gjinisë asnjanëse: *djathë ~ djathët*, *ujë ~ ujëtë*.

Kur flet për dufishimin e kundrinës me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë shton shembujt, që mungojnë në librin e Banfi-t: *e hapi kutinë*, *ia mori librin*.

Pellegrini e zgjeron inventarin e ballkanizmave duke përfshirë në listën një dukuri tjetër: përdorimin e trajtës së shquar me shumë kategori, për shembull, me emrat e përveçëm si: *Gjergji*, *Pali*, *Mara*, ashtu si edhe me emrat e vendeve: *Tirana*, *Shkodra*, *Vlora*. Këtë përdorim ai e sheh të ngjashëm me atë të greqishtes dhe te rumanishtes, kështu që arrin në përfundimin se edhe kjo dukuri mund të konsiderohet si ballkanizëm edhe pse për shqipen nuk është trajtuar kurrë si i tillë.

4. Shqipja sipas modelit çomskian

Qasja e tretë ndaj gjuhës shqipe është bërë kryesisht në fushën e sintaksës dhe të morfosintaksës. Për përshkrimin dhe analizën e dukurive sintaksore është ndjekur modeli teorik i gramatikës gjenerative-transformacionale, dmth. modeli i shkollës amerikane çomskiane, i zhvilluar qysh në vitet 50 (Chomsky 1957) e sidomos, për sa i përket gjuhës shqipe, pas viteve ’90 të shekullit XX.

Një nga studiueset italiane që, rreth viteve 1990, i është afruar gjuhës shqipe në kuadrin e modelit çomskian “Parime dhe Parametra” (Chomsky 1981, 1986) është Giuliana Giusti nga Universiteti i Venecies. Specialiste e sistemit emëror, objektivi i punës së saj ka qenë analiza e strukturës së sintagmave emërore në disa gjuhë ballkanike, si bullgarishtja, greqishtja, rumanishtja, shqipja, gjuha bosnjake (Giusti 1996, 1997). Për sa i takon shqipes, Giusti ka analizuar nyjën shquese që i prapavendoset emrit (*libr-i*). Teoria e ndjekur për strukturën emërore është ajo e Abney-t (1987), që propozon si kokë të sintagmës emërore elementin D (*Determiner*), sepse, sipas autorit, me anë të kategorisë D shprehet shquarsia e emrit. Pra, emri NP (*NounPhrase*) del si komplement i

determinantit:

(1) $[_{DP}$ D $[_{NP}$ N]]

Në skemën (1) është paraqitur struktura e një sintagme emërore e shquar: në pozicionin e kokës së sintagmës NP gjenerohet emri, ndërsa në pozicionin e kokës së sintagmës DP gjenerohet determinanti.

Në ato gjuhë ku determinanti trupëzohet me emrin, ky i fundit i nënshtrohet një rregulle sipas së cilës ai duhet të zhvendoset nga pozicioni bazë (N) ku gjenerohet për t'u ngjitur në pozicionin D ku është gjeneruar determinanti, në mënyrë që të bashkohet me të. Pra, emri lë pozicionin e tij fillestar dhe ngrihet në D, në të djathtë të determinantit.

(2) $[_{DP}$ libr-i $[_{NP}$ ~~libër~~]]

Kjo është analiza e ndjekur nga autoria.

Lidhur me këtë temë, Giusti (1996) ka analizuar edhe sintagmat ku emri shoqërohet nga një mbiemër, duke u përqendruar në dy struktura të ndryshme: ndërtimet emër + mbiemër si *gruaja e bukur,* dhe ndërtimet mbiemër + emër si *e bukura grua.*

Në rastin e parë, nyja shquese trupëzohet me emrin (*grua-j-**a**),* kurse mbiemri mbetet i pashquar (*e bukur*). Në rastin e dytë, nyja shquese trupëzohet me mbiemrin (*e bukur-**a***), kurse është emëri që mbetet i pashquar (*grua*). Për të shpjeguar këto alternime, Giusti propozon një sintagmë emërore që ka në përbërjen e saj një projeksion Fokus, dmth. një strukturë si më poshtë:

(3) $[_{DP}$ D $[_{FocP}$ $[_{Foc}$ N(+Art)] [.....t_i...]]]

Nyja shquese gjenerohet si morfem në pozicionin Foc (Fokus), brenda sintagmës emërore. Emri mund të lëvizë në pozicionin Foc, ku trupëzohet me nyjën: pra kemi struktura si *gruaja e bukur:*

(4) $[_{DP}$ D $[_{FocP}$ $[_{Foc}$ grua-j-(-a)] [~~grua~~ e bukur]]]

Por, edhe mbiemri mund të lëvizë në pozicionin Foc, ku mund të trupëzohet me nyjën. Në këtë rast kemi struktura si *e bukura grua*:

(5) $[_{DP}$ D $[_{FocP}$ e bukur $[_{Foc}$ (-a)] [grua ~~e bukur~~]]]

Një qasje tjetër ndaj nyjave e gjejmë në një punë të vitit 2012, në të cilën autoria analizon nyjen shquese të emrave dhe njyën e përparme të mbiemrave dhe të rasës gjinore.

Sipas autores, këto nuk janë tjetër veçse një tufë tiparesh sintaksore, si gjini, numër, rasë, shquarsi, funksioni i të cilëve është të realizojnë përshtatjen me një emër. Kështu, për shembull, në rastin e nyjës shquese, kjo shpreh shquarsinë e emrit; njya e mbiemrave shpreh përshtatjen e mbiemrit me emrin që modifikon; kurse njya e gjinores shpreh përshtatjën me emrin që paraprin. Sipas

autores, njyat shquese projetohen nga kategoria leksikore përkatëse (emri, mbiemri, emri në rasën gjinore), me anë të një operacioni sintaksor qe ajo e quan *Projektim*. Rregulla e Projektimit krijon aq kopje sa janë trajtat që njya bashkëndan me emrin.

Në fund, Giusti e Turano (2007) kanë analizuar strukturën e brendshme të sintagmave emërore partitive të tipit *një shishe verë* dhe *një tufë lulesh*. Nga ana sintaksore, paraqesin interes sepse, në këto struktura, emri i parë mund të paraprihet nga të gjitha elementet përcaktuese (6), por nuk mund të marrë një nyjë shquese (7):

(6) a. *një/kjo/ajo shishe verë*
b.*një/kjo/ajo tufë lulesh*

(7) a.**shishja verë*
b.**tufa lulesh*

Emri i dytë duhet të jetë në trajtën e pashquar sepse, po të jetë në trajtën e shquar, strukturat do të jenë jogramatikore:

(8)a.**(një) shishe verën*
b.**(një) tufë luleve*

Emri i dytë s'mund të paraprihet nga asnjë determinant:

(9) a.**(një) shishe një/këtë verë*
b.**(një) tufë disa/këtyre luleve*

Po t'i vërejmë me kujdes sintagmat *një shishe verë* dhe *një tufë lulesh*, do të vëmë re se, edhe pse kanë të njëjtën formë sipërfaqësore $NP_1 + NP_2$, ato kanë struktura të ndryshme pasi, në të parën, emri *verë* ka rasën kallëzore, ndërsa, në të dytën, emri *lulesh* ka rasën rrjedhore.

Përveç dallimit të rasës, sintagmat partitive kanë një dallim tjetër që lidhet me vendin e mbiemrave. Në ndërtimet me rasën rrjedhore, mbiemri mund të vendoset midis të dy emrave, si në (10a) ose në fund të strukturës partitive, si në

(10)a.*një tufë* ***e madhe*** *lulesh*
b.*një tufë lulesh* ***e madhe***

Kurse në strukturat me kallëzorën, mbiemri mund të vendoset vetëm në fund të sintagmës:

(11)a.*një shishe verë* ***e vogël***
b.**nje shishe* ***e vogël*** *verë*

Arsyeja pse mbiemri nuk mund të vendoset midis të dy emrave lidhet ngushtë me strukturën e brendshme të këtyre sintagmave. Në rastin e strukturës *një shishe verë*, të dy sintagmat formojnë një lloj emri të përbërë (CN = *Complex Noun*) dhe kjo nuk lejon të nxirret prej një përbërësi një pjesë e tij, pra NP_1 [*shishe*] nuk mund të shkëputet për t'u zhvendosur në pozicionin DP (koka e gjithë sintagmës), duke tejkaluar mbiemrin:

(12)*një [[$_{N1}$ shishe] X° [e vogël [[$_{CN}$ [$_{N1}$ ~~shishe~~] [$_{N2}$ verë]]]]

Përkundër, përbërësi CN [*shishe verë*] mund të lëviz si njësi duke kapërcyer mbiemrin:

(13) një [[$_{CN}$ shishe verë] X° [e vogël [$_{CN}$ [$_{N1}$ ~~shishe~~] [$_{N2}$ ~~verë~~]]]]

Ndërtimi me rrjedhorën paraqet një strukturë të ndrtshme: të dy emrat nuk formojnë nje *Complex Noun.* NP_2 *tufë* projekton një kokë funksionale Abl (*Ablative*) që i shënon rasën emrit *lulesh*. NP_1 lëviz në pozicionin e specifikuesit SpecAbl duke dhënë rendin linear NP_1 + NP_2:

(14) një [[$_{NP1}$ tufë] ABL [[$_{NP2}$ lulesh] [$_{NP1}$ ~~tufë~~]]

Duke qenë të dy emrat të pavarur nga njëri-tjetri, secili prej tyre mund të ketë mbiemër: kur mbiemri modifikon NP_2, projeksioni i tij i shtohet emrit *lulesh* (15a), kurse, kur mbiemri modifikon NP_1, i shtohet projeksionit të emrit *tufë* (15b).

(15) a. një [[$_{NP1}$ tufë] ABL [[$_{NP2}$ lulesh të freskëta] [$_{NP1}$ ~~tufë~~]]
b. një [[$_{NP1}$ tufë] X° [e madhe [$_{NP}$ ~~tufë~~] ABL [$_{NP2}$ lulesh] [$_{NP}$ ~~tufë~~]]

Qendri i dytë në Itali ku ka patur dhe vazhdon të ketë interesim për gjuhën shqipe, brenda kuadrit teorik gjenerativist, është Universiteti i Firences. Këtu, dy studiues, Leonardo Maria Savoia dhe Maria Rita Manzini, kanë trajtuar disa çeshtje në fushën e morfosintaksës.

Në punimet e para, duke përdorur si bazë empirike gegërishten e Shkodrës, të dy autorët janë marrë me pjesoren dhe me ndërtimet që e përmbajnë, dmth. format foljore pavetore ose të pashtjelluara (Manzini & Savoia 2003, 2007, 2012, 2015a). Autorët janë ndalur në përdorimin e pjesores si element përbërës i paskajores, ku paraprihet nga parafjala *me* (16a); i përcjellores, ku paraprihet nga introduktori *tu* (16b); i ndërtimeve privative ku pjesorja kombinohet me parafjalën *pa* (16c)[1]:

(16) a. *ka fillu me hãngër*
b. *jam tu ec*
c. *dola pa hãngër*

Autorët kanë marrë parasysh vendin e klitikëve brenda këtyre ndërtimeve, duke treguar se ata futen midis pjesores dhe parafjalëve *me, pa* ose pjesëzës *tu*:

(17) a. *kam ardh me* ***ta*** *dhãn*
b. *jam tu* ***e*** *la*

Kanë marrë parasysh vendin e elementit mohues *mas* që, në ndërtimet *me + pjesore*, i paraprin parafjalës *me* (18a), ndërsa në ndërtimet *tu + pjesore*, ndjek pjesëzën *tu* (18b)*:*

(18) a. *asht ma mir* ***mas*** *me e shkru*
b. *tu* ***mas*** *e bã*

[1] Shembujt janë marrë nga Manzini & Savoia (2015a).

Duke vijuar analizën e këtyre strukturave, autorët janë ndalur posaçërisht në ndërtimin e tipit *me + pjesore*, për të cilin kanë analizuar kontekstet ku shfaqet, sidomos kontekstet e varura në të cilat paskajorja përdoret në funksion modal (19a), shkakor (19b), aspektor (19c), pyetës (19ç), kushtor (19d), kallëzuesor (e), dmth. ato funksione sintaksore që në gjuhën shqipe standarde dhe në dialektet toske i kryen mënyra lidhore:

(19) a. *s munen me e bã*
b. *i ka vu me fiet fmit*
c. *kam fillu me hãngër*
ç. *nuk di ku me shku*
d: *bã me ardh, t pres*
e. *i kan thãn (çi) me ardh*

Kanë plotësuar përshkrimin duke marrë parasysh edhe kontekstet ku fjalia paskajore shfaqet si fjali e pavarur:

(20) *me ardh*!

dhe kontekstet ku paskajorja paraprihet nga introduktorë siç *çi, për* dhe *se*, si në shembujt:

(21) a. *kam ardh çi me e pa*
b. *kam ardh për me e pa*
c. *kam dal para se me shku*

Një dukuri sintaksore tjetër që autorët kanë analizuar është vendi i kryefjalës. Edhe pse forma e paskajores është e pashtjelluar, në gegërishten ajo mund të ketë një kryefjalë të shprehur. Kjo mund të shfaqet në dy pozicione: përpara paskajores, kur fjalia paraprihet nga një introduktor, si në shembullin (22a), ose në pozicionin pasfoljor, si në shembullin (22b):

(22) a. *du çi ti me e bã*
b. *doin (çi) me ardh ata*

Për sa i përket statusit kategorial të elementeve si *me, çi, se, për, tu,* Manzini e Savoia i kanë trajtuar si koka autonome, dhe kanë ndjekur propozimin se parafjalët *me* dhe *pa* leksikalizojnë një pozicion Determinanti në fushën e komplementuesit:

(23) [D *me/pa* [C [V *bã*]]]

Kurse introduktorët si *çi* dhe *se* janë operatorë me veti kuantifikuese brënda domeinit më të lartë të fushës C të fjalisë. Këto operatorë lidhin një ndryshore që i përgjigjet një fjalie:

(24) [OP *çi/se* [C_1 [D *me* [C [V *bã*]]]]]

Kur kryefjala ndodhet në të majtë të paskajores, si në shembullin (22a), ajo del si një element i topikalizuar, i leksikalizuar brënda domeinit më të lartë të fushës C:

(25) [OP *çi/se* [D *ti* [C_1 [D *me* [C [V *bã*]]]]]]

Edhe pjesëza *tu* konsiderohet si një operator, por për shkak të faktit se kjo i paraprin elementit mohues *mas* (18b), autorët e kanë trajtuar si operator në një pozicion të ulët të fushës C:

(26)[OP *tu* [C [V *bã*]]]

Në fund, elementi *për* është konsideruar nga autorët si parafjalë, pra si kokë e një ndërtimi parafjalor:

(27)[P *për* [D *me* [C [V *bã*]]]]

Edhe pse për infinitivin në gjuhën shqipe është shkruar shumë në fushën e albanologjisë dhe të ballkanologjisë, në studimet e Manzini-t e Savoia-s ndërtimet me paskajoren janë parë nën një këndvështrim të ndryshëm.

Me interes është edhe analiza që u bëjnë autorët fjalive me folje joveprore, për përshkrimin e të cilave kanë përdorur te folmet e Gjirokastrës dhe të Shkodrës (Manzini & Savoia 2008; Manzini, Roussou & Savoia 2016). Diateza joveprore karakterizohet nga një morfologji e veçantë, që përfshin tri mënyra të ndryshme realizimi: me anë të mbaresave të veçanta, që përdoren me kohën e tashme dhe të pakryerën (28); me pjesëzën *u*, që përdoret me foljet në kohën e kryerë të thjeshtë (29) dhe në të pakryerën në të folmen e Shkodrës (29c); me foljen ndihmëse *jam*, kur folja është në një kohë të përbërë (30)[2].

(28)a.*lahem*/*lahesha* (Gjirokastër)
b.*lahem* (Shkodër)
(29)a.*u laita* (Gjirokastër)
b.*u lava* (Shkodër)
c.*u lasha* (Shkodër)
(30)a.*ësht laitur* (Gjirokastër)
b.*asht la* (Shkodër)

Duke kaluar nga morfologja në sintaksën, autorët janë përqëndruar në formimet sintaksore të ndërtuara më morfologjinë joveprore, sepse kjo, në gjuhën shqipe, shërben për të shprehur më shumë se një vlerë. Diateza joveprore përdoret për të formuar:

a)fjali vetvetore, dmth. fjali në të cilat vepruesi e kryen dhe e pëson vetë veprimin:

(31)a.*zgjuhet* (Gjirokastër)
b.*u zgjoit* (Gjirokastër)
c.*ësht zgjuar* (Gjirokastër)

b) fjali mesore, fjali që nuk kanë veprues, dmth. se askush nuk e ka kontrollin e situatës së shprehur nga folja:

(32)a.*ati flëhet mir* (Gjirokastër)
b.*ati u fiet mir* (Gjirokastër)

[2] Shembujt janë marrë nga Manzini & Savoia (2008).

c. *atje asht fiet mir* (Shkodër)

c) fjali pësore, fjali në të cilat veprimi i kryer nga dikush kthehet mbi kryefjalën e fjalisë:

(33) a. *këto këmishë lahen nga ajo* (Gjirokastër)
b. *ata u zgjoitën nga të tierët* (Gjirokastër)
c. *këto këmishë jan laitur nga ajo* (Gjirokastër)

Pas këtij përshkrimi, autorët janë ndalur në strukturën sintaksore të këtyre fjalive, duke filluar nga ato që përmbajnë elementin *u*. Pjesëzën *u* e interpretojnë si një ndryshore që leksikalizon argumentin e brendshëm të foljes. Si ndryshore, duhet të jetë e lidhur prej një elementi referencial. Kur kjo ndryshore hyn në lidhje anaforike me elementin D të leksikalizuar nga fleksioni i foljes (dmth. me kryefjalën), kemi interpretimin refleksiv, si në shembullin (31b). Kur ndryshorja *u* nuk ka lidhje anaforike me kryefjalën por i referohet dikujt tjetër, kemi interpretimin pasiv, si në shembullin (33b). Kur *u* lidhet nga një operator i përgjithshëm, kemi interpretimin mesor, si në (32a).

Të njëjtën analizë autorët e përdorin për fjalitë joveprore të ndërtuara me foljen ndihmëse *jam*, që, sipas tyre, kanë një strukturë dyfrazore, sepse foljen *jam* e konsiderojnë si folje kryesore që merr si komplement një fjali pjesore. Pra, të dyja foljet, *jam* dhe pjesorja trajtohen si folje leksikore me strukturën e vet argumentuese. Edhe për ndërtimet *jam* + pjesore, autorët propozojnë idenë e një variabël (në këtë rast elementi D i pjesores) që lidhet ose nga elementi D i fjalisë kryesore, duke dhënë interpretimin vetvetor (31c), ose nga një operator i përgjithshëm, duke dhënë intërpretimin mesor (32c) ose pësor (33c).

Më në fund, në të njëjtën mënyrë mund të shpjegohen edhe ato ndërtime në të cilat morfologja joveprore shprehet më anë të mbaresave të veçanta. Sipas autorëve, edhe këtu kemi të bëjmë me një ndryshore, morfologjia fleksive e foljes, që lidhet nga një pozicion argumentues: kur lidhet nga argumenti i brendshëm kemi interpretim refleksiv (31a), kur lidhet nga një argument tjetër kemi intepretim mesor (32a) ose pësor (33a).

Sipas autorëve, avantazhi i kësaj analize është se tipa të ndryshëm fjalish (vetvetore, mesore dhe pësore) kanë strukturë sintaksore të njëjtë, pavarësisht nga morfologja me të cilën ndërtohen.

Një tjetër çeshtje që është bërë objekt analize në studimet e autorëve është struktura e sintagmave emërore, dhe, lidhur me këtë, sistemi rasor i emrave dhe i përëmrave. Edhe për trajtimin e kësaj dukurie, autorët përdorin gegërishten e Shkodrës (Manzini & Savoia 2007, 2010, 2011, 2014a, 2015b, Savoia & Manzini 2010).

Pas përshkrimit te formave emërore (dhe përemrore) sipas paradigmave

të shquarsisë dhe të pashquarsisë dhe të rasave të drejta dhe të zhdrejta, për të cilët të dy autorët japin shembuj që përfshjinë si emrat njëjes ashtu edhe ato shumës, ata marrin parasysh nocionin e rasës që nuk e interpretojnë si një veçanti të elementit emëror por si leksikalizim të disa vetive referenciale, si për shembull, D (Determinant), Q (kuantifikator), N (Emër). Rasa që identifikohet si emërore leksikalizon veti të tipit D; rasa që identifikohet si kallëzore leksikalizon veti të tipit N; rasat që identifikohen si gjinore, dhanore dhe rrjedhore leksikalizojnë veti të tipit Q. Sipas kesaj analize, rasa është një tipar që shpreh një lidhje relacionale, dmth. është një veçori që fikson treguesin e një argumenti të foljes: emërorja lidhet me subjektin e një predikati sepse fleksioni fundor i foljes korrispondon me një përemër brenda foljes me të cilin lidhet kategoria e determinantit. Rasa emërore është përkimi i një sintagme emërore me flektimin e foljes, është leksikalizimi i subjektit nëpërmjet vetive të shquarsisë.

Rasat e tjera kanë të bëjnë me konfigurimin e roleve tematike të caktuara nga folja. Kallëzorja leksikalizon një interpretim që lidhet me ngjarjen, pra përkon me argumentin e brendshëm të foljes.

Rasat dhanore, gjinore dhe rrjedhore identifikohen me kuantifikimin. Në mënyrë specifike, gjinorja lidh një argument me një grup në të cilin përfshihet. Dhanorja lidh një argument me një shpërndarës. Rasa rrjedhore lidhet me elemente leksikore që denotojnë grupe gjithëpërfshirëse. Pra, rasat e zhdrejta përkojnë me kontekste që shprehin bashkësi ose përfshirje.

Për sa i përket sintagmave përemrore, autorët vërejnë se në gjuhën standarde si në të gjitha dialektet e saj, përemrat e vetës së parë (34) dhe të dytë (35) nuk dallojnë rasën kallëzore nga rasa dhanore. Për shembull, në Shkodër:

(34) a. *më shikoin* ***mu*** (kallëzore)
b. *ma japin* ***mu*** (dhanore)

(35) a. *të shikoin* ***ty*** (kallëzore)
b. *ta japin* ***ty*** (dhanore)

Sipas autorëve, këto përemra marrin rasën dhanore edhe kur janë kundrina të drejta sepse ata i nënshtrohen DOM-it, "Dallimi i Objekteve të Markuara" (DOM= *Differential Object Marking*), dmth. janë kundrina të markuara diferencialisht.

Në domeinin e fjalive të nënrenditura, Manzini dhe Savoia (2018) janë marrë me statusin kategorial të komplementuesit *se*, introduktori i fjalive deklarative me folje në dëftore (36a), dhe të komplementuesit *që*, i cili i paraprin fjalive të nënrenditura me folje në lidhore (36b). Këtë shpërndarje e kanë ilustruar me shembuj nga e folmja e Gjirokastrës:

(36) a. *jam e sigurt* ***se*** *do të vijë*
b. *të thashë* ***çë*** *ta lanje*

Autorët kanë vënë në dukje se elementi *që* përkon me përemrin relativ (37b) si dhe me përemrin pyetës (37c):

(37) a. *të thashë* ***çë*** *ta lanje*
b. *ai ësht burri* ***çë*** *të thërret shpesh*
c. *çë mendon se* ***çë*** *bën ai?*

Ato, pra, arrjinë në përfundimin se fjalitë e nënrenditura janë gjithmonë fjali relative të lira. Komplementuesit nuk janë lidhëza por përemra me tiparin [+Relativ] dhe, si të tillë, ata shndërrojnë përmbajtjen e frazës në një fjali relative të lirë dhe kjo ndodh për shkak se fjalia (F) nuk mund të jetë komplement i një folje V (*Verb*), dmth. se mund të kemi struktura V + NP (folje + emër/ kundrinë) por jo V + F (folje + fjali). Pra, fjalia e nënrenditur duhet emërzuar që struktura të jetë V + $NP_{FRAZORE}$. Nënrenditja e një fjalie e shtjelluar përkon me një formë emërzimi. Ideja e autorëve është së nuk ka kategori C (komplementues) që i paraprin fjalive të nënrenditura të shtjelluara: *se* dhe *që* janë elemente me veti kuantifikuese, dmth. operatore: i pari lidh një ndryshore frazore, i dyti lidh një ndryshore individuale; vlera e ndryshores identifikohet me fjalinë e varur.

Një çeshtje tjetër që kanë trajtuar Manzini dhe Savoia (2014b) është ajo e nyjave që u paraprijnë mbiemrave (38a) dhe gjinores (38b)[3]:

(38) a. *erdhi diali i madh*
b. *libri i vëllait*

Këto nyja i kanë analizuar si lidhëza që i përkasin kategorisë së determinerëve. Janë koka D të pavarura, të cilat shprehin tiparet e rasës dhe te përshtatjes. Si koka D mbush argumentin e emrit N (Higginbotham 1985), ashtu njya e mbjemrit leksikalizon argumentin e kallëzuesit mbiemror. Sipas autorëve, këto elemente i ngjajnë klitikëve (argumente D që mbushin kallëzuesin foljor).

Për sa i përket njyës së gjinores, autorët saktesojnë se gjinorja është lidhja e një argumenti me një grup në të cilin përfshihet. Kjo lidhje përfaqësohet me simbolin (⊆), një operator divalent që denoton një relacion përfshirje midis emrave *vëllait* dhe *libri* në (38b). Njyja *i* mbush argumentin e emrit në gjinore. Autorët e trajtojnë si ndryshore që lidhet nga një operator D më i lartë: koka D e sintagmës emërore me të cilën bashkëndan veti referenciale.

Si nyjat e mësipërme, autorët kanë trajtuar edhe pjesëzën *të* të lidhores (Manzini dhe Savoia 2018). Sipas tyre, pjesëza e lidhores është një element D, një ndryshore që lidhet nga një operator D më i lartë që përkon me elementin që leksikalizon subjektin e foljes kryesore, dhe, nga ana e tjetër, lidh elementin D të foljes lidhore. Në këtë mënyrë, denotimi i foljes lidhore fiksohet nga elementi paraprirës që gjendet në fjalinë kryesore dhe kjo shkakton bashkëreferencën e

[3] Shembujt i kanë marrë nga e folmja e Gjirokastrës.

kryefjalës së nënrenditur me atë kryesore. Në strukturën e fjalisë, kjo pjesëzë leksikalizon një pozicion më i lartë se koka C:

(39)$[_{CP}$ D *të* $[_{CP}$ C $[_{IP}$ D_t $[_{IP}$ I..]]]]

Veprimtaria e autorëve është e gjerë dhe shqipja zë një vend qendror në studimet e tyre. Këto janë origjinale për metodologjinë shkencore, për trajtimin dhe për zgjidhjen që u japin problemeve të sintaksës. Manzini dhe Savoia janë ndër të paktit studiues që kanë zbatuar parimet e metodave gjenerative-transformacionale në sintaksën e gjuhës shqipe

Referime bibliografike

Abney, Steven (1987) "The English Noun Phrase in its Sentential Aspect", Ph.D. Diss, MIT.

Ambrosini, Riccardo (1981) "Elementi conservative ed innovative nella struttura dell'albanese" in A. Guzzetta (a cura di) *Etnia Albanese e minoranze linguistiche in Italia*, Palermo, 159-169.

Ambrosini, Riccardo (1996) "Su alcune caratteristiche storiche e tipologiche dell'albanese", in A. Guzzetta (a cura di) *Nuovi orientamenti della linguistica e della letteratura albanesi*, Palermo, 73-94.

Banfi, Emanuele (1985) *Linguistica balcanica*, Bologna: Zanichelli.

Chomsky, Noam (1957) *Syntactic Structures*, Berlino: de Gruyter.

Chomsky, Noam (1981) *Lectures on Government and Binding*, Dordrecht: Foris.

Chomsky, Noam (1986) *Knowledge of Language*, New York: Praeger.

Giusti, Giuliana (1996) "Is there a FocusP and a TopicP in the Noun Phrase Structure?", *University of Venice Working Papers in Linguistics* 6: 105-128.

Giusti, Giuliana (1997) "The categorial status of determiners", in L. Heageman (ed.) *The New Comparative Sintax*, London: Longman, 95-123.

Giusti, Giuliana (2012) "Enclitic and Proclitic Articles in Albanian", in G. Turano, R. Memushaj & F. Koleci (eds.) *Theoretical and Empirical Studies in Albanian Syntax*, Muenchen: Lincom, 55- 73.

Giusti, Giuliana & Giuseppina Turano (2007) "Case Assignment in the Pseudo-Partitives of Standard Albanian and Arbëresh. A Case for Micro-Variation", *Quaderni del Dipartimento di Linguistica - Università di Firenze* 17: 33-51.

Higginbotham, James (1985) "On semantics", *Linguistic Inquiry* 16: 547-621.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2003) "Morfo-sintaksa e pjesores dhe e paskajores në të folmen e Shkodrës, *Studime Filologjike*, 93-138.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2007) *A unification of morphology and syntax. Studies in Romance and Albanian dialects*, London: Routledge.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2008) "Non-active Voice in Albanian: Implications for the Theory of Movement", in Leonardo M. Savoia (ed.) *Studi sulle varietà arbëreshe*, Rende: Università della Calabria, 111-149.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2010) "Rasa dhe veti treguese: fleksioni emëror në të folmen gege të Shkodrës", *Identitete gjuhësore dhe kulturore – Studime shqiptare* 15: 13-29.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2011) "Reducing 'case' to denotational primitives", *Linguistic Variation* 11: 76-120.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2012) "Morphosyntax of the Participle and Infinitive in the Variety of Shkodër", in B. Rugova (ed.) *Studime për nder të Rexhep Ismajlit*, Prishtina: Koha, 651-677.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2014a) "Person splits in the case systems of Geg Albanian (Shkodër) and Arbëresh (Greci)", *Studi italiani di linguistica teorica e applicata*, vol. XL: 7-42.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2014b) "Linkers in Aromanian in Comparison to Albanian and Romanian, *Rivista di Grammatica Generativa* 36: 83-104.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2015a) "Morfo-sintaksa e pjesores dhe e paskajores në të folmen e Shkodrës, in L. M. Savoia, M. R. Manzini & Benedetta Baldi (eds.) *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë: ASHAK, 153-200.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2015b) "Ndarja e vetës në sistemet e rasës të gegërishtes (Shkodër) dhe arbërishtes (Greci)", in L. M. Savoia, M. R. Manzini & Benedetta Baldi (eds.) *Studime në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë: ASHAK, 153-200.

Manzini, M. Rita & Leonardo M. Savoia (2018) "Finite and non-finite complementation, particles and control in Aromanian, compared to other Romance varieties and Albanian", *Linguistic Variation* 18: 215-264.

Manzini, M. Rita, Anna Roussou & Leonardo M. Savoia (2016) "Middle-passive voice in Albanian and Greek", *Journal of Linguistics* 52: 111-150.

Manzini, M. Rita, Ludovico Franco & Leonardo M. Savoia (2019) "Suffixaufnahme, oblique case and Agree", in L. Franco, M. M. Moreno & M. Reeve (eds.) *Agreement, Case and Locality in the Nominal and Verbal domains*, Berlin: Language Science Press: 211-255.

Pellegrini, Giovan Battista (1998) *Avviamento alla linguistica Albanese*, Rende: CELUC.

Pisani, Vittore (1959) *Saggi di Linguistica Storica*, Torino: Rosenberg & Sellier.

Savoia, Leonardo M. & M. Rita Manzini (2010) "Sintagma nominale e caso a Shkodër", *Hylli i Dritës* 3: 111-122.

Schaller, Helmut W. (1975) *Die Balkansprachen: Eine Einführung in die Balkanphilologie*, Heidelberg: Winter.

Shkumbin MUNISHI (Prishtinë)

STUDIMET E EDA DERHEMIT PËR ARBËRISHTEN E PIANA DEGLI ALBANESI TË SICILISË

Abstrakt. Në këtë punim trajtohen pikëpamjet sociolinguistike të autores Eda Derhemi për arbërishten në Piana Degli Albanesi dhe gjendjen e saj. Më tej, nëpërmjet shtjellimit të pikëpamjeve të Derhemit, konstatohet se aktualisht arbërishtja e këtij lokaliteti mund të konsiderohet si gjuhë e rrezikuar nga zhdukja, e cila ka pësuar tkurrje dhe reduktim të formave, si dhe humbje të fushave e funksioneve të përdorimit. Në këtë kuadër, konstatohet se miratimi i disa ligjeve italiane për mbrojtjen dhe ruajtjen e gjuhëve minoritare, mund të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen dhe revitalizimin e arbërishtes. Këto dokumente ligjore duhet të shoqërohen patjetër edhe me veprimtari të tjera planifikuese, jo vetëm në kuptim të planifikimit të statusit të arbërishtes, por edhe në kuptim të planifikimit të funksioneve dhe të nxënies së saj në shkolla. Në fund, konstatohet se mësimi i arbërishtes do të duhej të shoqërohej edhe me përfshirjen e shqipes standarde në përmasa e funksione të ndryshme.
Fjalët kyçe: *arbërishte, rrezikshmëri e gjuhës, tkurrje, reduktim, revitalizim, planifikim i gjuhës (i funksioneve, i nxënies).*

HYRJE

Rrezikshmëria, tkurrja dhe vdekja e gjuhëve janë disa nga konceptet e rëndësishme sociolinguistike që ka zgjuar kërshërinë jo vetëm të studiuesve të ndryshëm, por edhe të institucioneve ndërkombëtare. Një gjuhë mund të konsiderohet e rrezikuar nëse fillon të reduktohet përdorimi i saj qoftë për shkak se folësit e saj vdesin, qoftë për shkak se folësit e saj e ndërrojnë atë gjuhë në përdorim me një gjuhë tjetër. Sidomos, në dekadën e fundit të shekullit XX dhe në dekadën e parë të mijëvjeçarit të ri, këto çështje u vunë në qendër të shqyrtimeve edhe si pjesë e diskutimeve mbi vlerat e respektimit të diversitetit kulturor dhe gjuhësor nëpër botë. Në këtë kuadër, ruajtja e gjuhëve të ndryshme nga zhdukja dhe mbrojtja e tyre janë bërë pjesë e aktiviteteve të ndryshme të institucioneve ndërkombëtare e shtetërore nëpër mbarë botën. Alarmi për rrezikshmërinë e gjuhëve është ngritur edhe nga organizatat e Kombeve të Bashkuara si UNESCO, e cila ka publikuar të ashtuquajturin *"UNESCO Atlas of the World's Languages in Danger"* (Atlasi i UNESCO-s i Gjuhëve të Rrezikuara të Botës) në të cilin bëhet një kategorizim i gjuhëve sipas nivelit të rrezikshmërisë. Edhe gjiganti i teknologjisë së informimit Google ka ndërmarrë një projekt të quajtur

"Endangered Languages Project" (Projekti i Gjuhëve të Rrezikuara) me qëllim të ruajtjes, por edhe regjistrimit të gjuhëve të botës, duke bërë kështu një katalogim të gjuhëve botërore.

Në këtë fryme janë miratuar deklarata e legjislacione të cilat bëjnë thirrje për ruajtjen e diversitetit gjuhësor, por edhe përcaktojnë dispozita lidhur me modalitetet që mund të ndiqen për ruajtjen, mbrojtjen, revitalizimin dhe kultivimin e gjuhëve të rrezikuara. Të tilla janë "Traktati Europian për Gjuhët Regjionale e Minoritare" e vitit 1992 dhe "Deklarata Universale e Barcelonës për të Drejtat e Gjuhëve" e vitit 1996, e cila synon mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, sidomos të atyre të rrezikuara. Të gjitha këto nisma kanë për qëllim që ta sensibilizojnë opinionin global lidhur me rëndësinë e ruajtjes së gjuhëve dhe respektimit të drejtave gjuhësore.

Aktualisht, gjuhët që konsiderohen të rrezikuara mund të gjenden në të katër anët e botës dhe bëjnë pjesë në shumë familje gjuhësore. Sa i përket gjendjes së varieteteve të shqipes në raport me rrezikshmërinë e tyre, mund të thuhet se shumica e varieteteve të shqipes që fliten në *continuumin* e tyre në Ballkan nuk mund të kategorizohen në grupin e gjuhëve të rrezikuara, pasi kanë përdorim të vazhdueshëm. Por, sa u përket varieteteve të shqipes që fliten në diasporën historike situata është më ndryshe. Varietetet arvanitase në Greqi në "Librin e kuq të UNESCO-s për gjuhët e rrezikuara" janë futur në kategorinë e "gjuhëve pothuajse të shuara", ndërsa varietetet e arbëreshëve të Italisë konsiderohen si gjuhë të rrezikuara. Se varietetet arvanitase janë në proces të shuarjes kemi të dhëna e raporte që nga vitet '70-'80 të shekullit XX nga Trudgill (1990), Hamp (2007) e Tsitsipis (1983, 1984).

Për dallim prej arvanitishtes, studimet shumëdimensionale për varietetet e arbërishtes së Italise nuk mungojnë, qoftë nga autorë shqiptarë e arbëreshë, qoftë nga ata të huaj. Megjithatë, në këtë punim do të trajtoj disa nga pikëpamjet kryesore sociolingustike të autores Eda Derhemi lidhur me gjendjen, rrezikshmërinë, statusin dhe dimensionet e tjera sociolinguistike të arbërishtes së Italisë.

Arbërishtja e Piana Degli Albanesi

Studiuesja Eda Derhemi është njëra ndër autoret kryesore, e cila është marrë me studimin e rrezikshmërisë së gjuhës arbërishte, kryesisht në Piana degli Albanesi në Sicili. Duke qenë se studimet e Eda Derhemit për gjendjen e arbërishtes janë studime rasti me shumë të dhëna, në vazhdim do të japim shumë nga këto të dhëna që na sjell autorja.

Nga vëzhgimet e Derhemit gjatë punës në terren në Itali midis qershorit

2001 dhe janarit 2002, del se më shumë se gjysma e këtyre komuniteteve kanë humbur gjuhën e tyre. Në shumicën e rasteve, veçoritë e dialekteve dhe kulturave të tyre shuhen të pambledhura si duhet. Ato komunitete që ende mbajnë të gjallë gjuhën e tyre kanë humbur një numër të madh folësish dhe përdorin arbërishten në situata dhe ambiente të kufizuara. Në disa vende gjuha është afër vdekjes së plotë. Një dukuri tjetër që e shoqëron humbjen e arbërishtes është një zhvendosja graduale drejt gjuhës mbizotëruese që është italishtja. Sipas Derhemit, edhe pse arbërishtja është gjuha e përdorur në komunikimin joformal të përditshëm dhe nuk është e stigmatizuar as nga folësit e saj, as nga joarbëreshët, ajo tregon veçori të qarta të tkurrjes gjuhësore. Një numër në rritje i boshllëqeve në sistemin gjuhësor të arbërishtes zvogëlojnë dobinë dhe shpeshtësinë e përdorimit të saj për komunikim, gjë që çon nga ana tjetër në tkurrje të mëtejshme. Nëse ky proces nuk ndalet, përdorimi i gjuhës do të vazhdojë të zvogëlohet, duke dobësuar pozicionin e arbërishtes në raport me gjuhën mbizotëruese italishten (Derhemi 2002:2).

Më tej, Derhemi thekson se Piana arbëreshe nuk e ka përparësinë e një tradite të shkruar, megjithëse ka pasur përpjekje sporadike, veçanërisht në përkthimin e teksteve fetare. Në studimet e shumta sociolinguistike në fushën e planifikimit të gjuhëve në mjaft raste theksohet rëndësia e pranisë së traditës letrare jo vetëm për standardizimin e gjuhës, por edhe për revitalizimin e saj (Downes 1984). Ajo pohon se njëra prej mënyrave për ta ndaluar procesin e tkurrjes dhe humbjes strukturore të arbërishtes është stabilizimi i një forme normative të gjuhës dhe mësimi i menjëhershëm i një forme të kodifikuar të gjuhës në shkollat në Piana. Për këtë qëllim, drejtuesit e komunitetit arbëresh në Piana degli albanesi dhe zyrtarë të tjerë duhet t'i shfrytëzojnë sa më mirë mundësitë që jep ligji italian i vitit 1999 për mbrojtjen e komuniteteve arbëreshe, i cili përshkruan disa veprime specifike dhe siguron fonde për ndryshimet e nevojshme.

Në përgjithësi, të dhënat për arbërishten e Pianës tregojnë se procesi i tkurrjes mund të përparojë drejt vdekjes eventuale, madje edhe në rastet kur gjuha ka ende një funksion të rëndësishëm në komunitet dhe folësit kanë pikëpamje pozitive për përdorimin dhe ekzistencën e saj. Analiza e rrezikimit të arbërishtes sugjeron jodrejtpërdrejt që komunitetet të cilat përpiqen ta kursejnë gjuhët dhe traditat e tyre duhet të rrisin vetëdijen se një gjuhë e një bashkësie pakicë mund të zhduket, paçka që kjo mund të ndodhë jo vetëm në rastet kur ekzistojnë grupe politike që luftojnë në mënyrë aktive dhe të qëllimshme ekzistencën e një gjuhe dhe kulture të caktuar. Derhemi vëren me të drejtë se gjuhët e pakicave gjithashtu mund të vdesin kur bashkësitë që përdorin këto gjuhë janë indiferente dhe

nuk kryejnë ndërhyrje institucionale efektive për t'i mbrojtur ato.

Në vëzhgimet e kryera, Derhemi ka vërejtur se karakteristika kryesore e arbërishtes sot është ekzistenca e përhapur e "gjysëm-folësve" ose folësve jo krejtësisht të aftë. Sidoqoftë, Piana është një nga fortesat e fundit të arbërishtes në këtë zonë, që tregon ende karakteristikat e saj origjinale përkundër tkurrjes gjuhësore. Ajo konstaton se ka komunitete të tjera arbëreshe rreth Pianës, si Palazzo Adriano, Santa Cristina dhe Contessa Entellina, të cilat janë të gjitha në një fazë më të përparuar të tkurrjes gjuhësore. Njerëzit e Pianës janë krenarë për gjuhën dhe kulturën e tyre, dhe ata ende e përdorin atë, megjithëse kompetenca e tyre gjuhësore dhe fushat funksionale të përdorimit të arbërishtes janë zvogëluar ndjeshëm. Në një anketë që kishte kryer Derhemi del se pjesa dërmues e të anketuarve janë krenarë që janë italianë me prejardhje arbëreshe. Duhet theksuar se nëse krahasojmë të dhënat që sjell Derhemi, me të dhënat që na sjell Trudgill (1990) për arvanitasit, për të cilët thotë se nuk shfaqin ndjenja të theksuara krenarie ndaj përkatësisë arvanitase dhe përpiqen qëllimshëm ta humbin gjuhen, vërehet qartë se arbëreshët e Sicilisë, por edhe të zonave të tjera në Itali shfaqin krenarinë e tyre lidhur me prejardhjen. Sipas Derhemit, është shumë e pazakontë për folësit e një gjuhe që po vdes të demonstrojnë këtë qëndrim ndaj gjuhës dhe përkatësisë etnike të tyre.

Megjithatë, meqenëse arbërishtja nuk është shkruar dhe nuk është mësuar kurrë sistematikisht në shkollë, italishtja e ka zëvendësuar atë në një gamë të gjerë fushash që kërkojnë një gjuhë më formale. Aktivitete të rëndësishme politike ose kulturore që zhvillohen përdorin ekskluzivisht italishten, pasi kjo e fundit është gjuhë me prestigj. Mungesa e përdorimit të gjerë të arbërishtes ka zvogëluar gradualisht forcën e saj shprehëse, kështu që tani ajo mund të plotësojë vetëm pjesërisht nevojat e bisedës së përditshme dhe kjo ka nxitur dukurinë e code switching-ut drejt italishtes.

Një tjetër konstatim me rëndësi që sjell autorja është se arbërishtja nuk ka qenë asnjëherë gjuhë zyrtare e mësimit, por ka ende fëmijë në klasat e hershme të shkollës fillore që ndjehen më përshtatshëm kur komunikimi në klasë është në arbërishte sesa në italishte. Një dekadë më parë, numri i fëmijëve që kishin një kompetencë më të lartë në arbërishte sesa në italisht kur kishin filluar shkollën. Në një anketë me 100 banorë të Pianës që ka kryer Derhemi, shtatëdhjetë e katër kanë thënë se ata kanë përdorur më lehtë arbërishten sesa italishten kur kanë filluar shkollën fillore. Por, vetëm njëzet janë deklaruar se përdorin arbërishten më rrjedhshëm se italishten në fund të shkollës së mesme. Kishte vetëm tre pjesëmarrës në shkollën fillore që ndiheshin se mund të komunikojnë

njësoj duke folur të dy gjuhët, dhe vetëm katër në fund të shkollës së mesme. Dallimi është se në shkollën fillore rreth 80 përqind ndjehen rehat me arbërishten, ndërsa në shkollën e mesme rreth 80 përqind ndjehen më komodë me italishten. Ky ndryshim dramatik ndodh në shkollë, gjatë viteve në të cilat folësit arbëreshë, ndërsa pasurojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në gjuhën italiane, nuk shtojnë asgjë në njohuritë e tyre për arbërishten.

Sa i përket sistemit gjuhësor të arbërishtes, Derhemi ka vërejtur se arbërishtja tregon shenja të qarta të tkurrjes gramatikore dhe leksikore. Megjithë rolin funksional të arbërishtes si mjet joformali komunikimit në Piana, një numër i madh i folësve, veçanërisht ata më të rinj, e flasin atë më pak rrjedhshëm sesa brezat e vjetër. Ndonëse ende përdoret në ambiente joformale, gjuha ngadalë po tkurret dhe po humbet shprehësinë e saj. Në këtë konstatim që sjell Derhemi, duhet shtuar se tkurrja gramatikore e leksikore është njëra nga karakteristikat kryesore të gjuhëve të rrezikuara. Dominimi i italishtes në të gjitha domenet formale favorizon përdorimin e saj në kundrejt arbërishtes. Një element tjetër që favorizon përdorimin e italishtes janë edhe mediat që janë pothuaj tërësisht në italishte

Ndryshe, lidhur me karakteristikat e tkurrjes së arbërishtes, duke e ndjekur modelin e Andersenit, i cili dallon tkurrjen disfunksionale prej tkurrjes kozmetike, Derhemi mendon se në rastin e arbërishtes kemi të bëjmë me tkurrje disfunksionale me një sërë tiparesh që janë të pranishme, siç janë: zvogëlimi i funksioneve, humbja e kompetencës gjuhësore dhe humbja e aftësisë informuese. Por, tipari i dytë, që është stigmatizimi i gjuhës, nuk është një karakteristike e këtij komuniteti. Sidoqoftë, ekziston një ndjenjë e pasigurisë për të komunikuar në arbërishte për shkak të gjendjes së saj të avancuar të rrezikimit. Por, nuk ka qëndrime negative ndaj arbërishtes, siç mund të jetë ngurrimi për ta përdorur gjuhën, turp në përdorimin e saj, stigmatizimi dhe refuzimin i përkatësisë etnike origjinale, ose xhelozia ndaj grupit mazhoritar (Derhemi 2006:31-32).

Më tej, sipas Derhemit, një problem tjerë kryesor i arbërishtes është se ajo është shkruar pak. Rëndësia e modelit të shkruar dhe një normë gjuhësore qëndron në faktin se format e shkruara krijojnë modele për folësit që janë në një gjendje të konfuzionit gjuhësor, i krijuar nga tkurrja dhe, njëkohësisht, mbrojnë njohuritë gjuhësore nga humbja e mëtejshme. Tani që gjuha ka arritur një nivel kritik rreziku, është e nevojshme një politikë gjuhësore e përshtatshme, e rregulluar dhe e koordinuar. Ajo thekson se në vitin 1998 është miratua një ligj rajonal (Nr. 26) për mbrojtjen e minoriteteve gjuhësore, por ai u ndryshua dhe u dobësua nga Komisari i Shtetit i cili mendoi se të drejta të caktuara duhet të mbesin

brenda kompetencave të shtetit dhe jo të rajonit. Ky legjislacion u modifikua më tej nga një projekt-ligj rajonal, por, megjithëse ishte një përmirësim, prapë konsiderohej të ishte një përgjigje shumë e dobët ndaj një kërkesave që janë të domosdoshme për ruajtjen e arbërishtes. Ajo që më në fund pati një ndikim të fuqishëm në përpjekjet e komunitetit për ringjalljen e gjuhës ishte një ligj kombëtar (Nr. 482) për mbrojtjen dhe promovimin e pakicave historike gjuhësore dhe kulturore shqiptare, i cili u miratua në dhjetor 1999, pasi ishte më i plotë dhe më radikal se ligji rajonal. Puna për zbatimin e këtij legjislacioni dhe shpërndarjen e tij në projekte praktike të pranueshme për financim të shtetit është ende në proces.

Nuk ka dyshim se shkaku kryesor i degjenerimit të fundit në sistemin gjuhësor të arbërishtes është mungesa afatgjatë e ndërhyrjes institucionale. Një arritje e komunitetit arbëresh në Piana është se legjislacioni tani lejon mësimin e shqipes dhe përdorimin e saj në procesin mësimor në shkollat fillore dhe të mesme, dhe trajnimin e mësuesve të nevojshëm.

Sa ik përket çështjes së mësimit të arbërishtes në shkolla, duhet theksuar se deri në vitin 1990, si pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për ta përhapur përdorimin e shqipes standarde, shqipja standard filloi të mësohej edhe në mesin e komunitetit arbëresh në Itali (shih p.sh. Altimari 1984). Por, pas vitit janë shtuar përpjekjet për përdorimin e arbërishtes si gjuhë të shkollave Piana. Në të vërtetë, aktualisht tek arbëreshet ka një debat lidhur me atë se cili kod do të duhej të mësohej në shkolla nga arbëreshet, a duhet të mësohet shqipja standarde apo arbërishtja. Derhemi vëren se edhe pas zbatimit të politikave të reja gjuhësore ende nuk ka ndonjë marrëveshje për kodin e zgjedhur. Sipas saj, një qasje më e mirë do të ishte kombinimi i dy pikëpamjeve kryesore të komisionit për zbatimin e legjislacionit. Një mënyrë për ta bërë këtë do të ishte përshtatja e shqipes standarde si gjuhë e shkruar, duke ruajtur versionin gojor të dialektit Piana dhe duke përgatitur kështu terrenin për kombinimin natyror të të dyjave. Pa një marrëveshje për një kod të zgjedhur, përpjekjet për të stabilizuar gjuhën nuk do të çojnë askund. Autoritetet në Piana që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duhet të jenë të vetëdijshme për rëndësinë e zgjedhjes së gjuhës që do të mësohet në shkolla.

Për ta pasur të qartë qëndrimin e Derhemit, në vijim po parafrazoj argumentet e saj duke u mbështetur në kushtet aktuale të arbërishtes në raport me shqiptarët, sipas së cilave arbërishtja është dëmtuar dukshëm nga tkurrja dhe ka nevojë për një formë normative për të ndihmuar komunitetin të krijojë një model të saktë në pothuajse çdo nivel gjuhësor. Më tej, arbërishtja është shumë

i kufizuar në funksionet e saj letrare dhe fushat e tjera gojore, dhe ka një sasi botimesh mjaft të kufizuara. Shqipja është një gjuhë e kultivuar në të gjitha format dhe ka botime në një shkallë të gjerë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Po ashtu, kostoja e përdorimit të një gjuhe që është e gjallë dhe e gatshme për përdorim është më e ulët se kostoja e rindërtimit të një gjuhe dhe pastaj përpjekja për ta vënë atë në dispozicion të një komuniteti të folësve. Së fundi, ajo nuk propozon zëvendësimin e arbërishtes me gjuhën shqipe, por ekzistencën e të dyjave paralelisht, me ç'rast arbërishtja do të përdorej më tepër në të folur, ndërsa shqipja në të shkruar Kontributi i shqipes, siç e shoh, do të konsistojë kryesisht në rindërtimin e strukturës gramatikore të arbërishtes, e cila ka një bazë shumë të ngjashme. Bashkëveprimi leksikor, ku dallimet midis dy gjuhëve janë më të mëdha, është sekondare dhe mund të vazhdojë shumë gradualisht. Qëllimi nuk është bashkimi i të dyve, por përkundrazi përdorimi i elementeve të shqipes për ta mbështetur rindërtimin e arbërishtes (Derhemi 2002).

Natyrisht, ajo ka parë edhe disa probleme që lidhen me ndryshimet midis dy gjuhëve dhe se është me rëndësi që këto ndryshime të kapërcehen në shqiptim dhe mbase me përdorimi i shqipes standarde vetëm në ligjërimin e shkruar, mund të gjenden mënyra për të krijuar një bashkëveprim natyror midis dy gjuhëve. Një tjetër problem që vëren autorja lidhet me paragjykimet sociolinguistike që janë shfaqur në Piana gjatë dekadës së fundit në lidhje me gjithçka që lidhet me Shqipërinë, dhe fluksi i vazhdueshëm i shqiptarëve që vijnë në Itali e forcon atë tendencë (Derhemi 2010).

Në trajtimin e këtyre koncepteve të Derhemit për arbërishten duhen parë disa aspekte. Së pari, çështja e rrezikimit të arbërishtes është një fakt i konstatuar dhe e vetmja gjë që mund të bëjnë folësit e saj dhe autoritetet italiane është që të ndërmarrin masa ta ngadalësojnë këtë proces. Natyrisht, një aktivitet i tillë nuk është aspak i lehtë kur merren parasysh gjetjet e Derhemit se arbërishtja tashmë ka pësuar tkurrje e reduktim të domeneve. Mosshkruarja e saj e mjaftueshme padyshim i ka kontribuar një situate të tillë dhe në planin konkret paraqet problem për revitalizimin e arbërishtes, sepse tradita letrare do të ishte një ndihmë e madhe në kuadër të përpjekjeve planifikuese.

Një tjetër dimension që prek Derhemi dhe që do të shkonte në drejtim të ringjalljes së arbërishtes është çështja e përcaktimit të statusit ligjor të saj dhe e promovimit eventual nëpërmjet ligjeve përkatëse, proces ky që ka filluar në Itali karshi arbërishtes. Ç'është e vërteta përcaktimi i politikave gjuhësore e i hapave adekuat në fushën e planifikimit gjuhësor nuk janë asnjëherë çështje të lehta, për shkak të ndjeshmërisë shoqërore. Planifikimi i statusit të gjuhëve është një

mjet i rëndësishëm në këtë drejtim dhe në rastin e shqipes, duke qenë se planifikimi i statusit të gjuhëve ka ndodhur nëpër etapa historike të ndryshme, shpeshherë kontradiktore, këto rrethana janë reflektuar në statusin e shqipes në hapësirat e ndryshme ku është përdorur ajo. Ecuria e statusit të shqipes më së miri mund të shihet te Kostallari (1984), Ismajli (1991) dhe Munishi (2010). Përpjekjet që përmend Derhemi që pozita e arbërishtes të përmirësohet nëpërmjet miratimit të legjislacionit italian që promovon përdorimin dhe mësimin e arbërishtes janë një rrugë e duhur në këtë drejtim, por duhet pasur parasysh se, siç thekson Mackey (1989), planifikimi i statusit të gjuhëve është i pamjaftueshëm në rast se nuk shoqërohet edhe me përcaktimin e funksioneve të tyre. Edhe për arbërishten është me rëndësi që të promvohet statusi i saj, por po aq e rëndësishme është të zgjerohen funksionet e saj në domene të ndryshme shoqërore. Për aq sa është me rëndësi planifikimi i statusit të arbërishtes, po aq është i rëndësishëm një dimension tjetër i planifikimit, atë që Cooper e quan planifikim i nxënies që nënkupton mësimin e gjuhës në shkolla (Cooper 1989). Në këtë aspekt pastaj bëhet e rëndësishme se cila formë gjuhësore do t'u mësohet nxënësve. Mendimi i Derhemit se në shkollat ku mësohet arbërishtja do të duhej arbërishtja të mbetej në përdorim në të folur, ndërkaq në shkrim do të duhej të mësohej shqipja standarde, më duket i paplotë, për shkak se mund të shfaqen probleme në përfaqësimin e formave gjuhësore në të folur dhe në të shkruar dhe anasjelltas. Mendoj se forma më adekuate do të ishte ajo që do te nënkuptonte se të dy kodet, edhe shqipja standarde, edhe arbërishtja, do të mësoheshin paralelisht duke e plotësuar njëri-tjetrin. Natyrisht, prioritet do të duhej t'i jepej arbërishtes në komunikim, por duke e plotësuar atë me shqipen standarde. Në këtë mënyrë do të ruhej arbërishtja si kod historik i shqipes dhe njëkohësisht folësit e arbërishtes do ta mësonin shqipen standarde.

Së fundi, sa i përket procesit të tkurrjes së arbërishtes, ky proces do të mund të ndalej vetëm nëpërmjet të një procesi që Fishman (1974) e quan "modernizim" i gjuhës dhe i cili do të ndikonte drejtpërdrejt në ngjalljen e arbërishtes.

Një pikënisje e mirë në përpjekjet për revitalizimin e arbërishtes qëndron në faktin se, për dallim nga rasti i arvanishtes që përmendëm sipër, në rastin e arbërishtes folësit e saj jo vetëm që nuk kanë paragjykime qe qëndrime negative ndaj kodit të tyre burimor, por në mjaft aspekte ndihen krenar për identitetin e tyre gjuhësore e etnik. Ky është një parakusht pozitiv, sepse mund të jetë motivues për mësimin dhe për përdorimin e arbërishtes nga folësit e saj në Itali.

Përfundime

Autorja Eda Derhemi në studimet e saj për arbërishten e Piana Degli Albanesi në Sicili na sjell një pasqyrë mjaft gjithëpërfshirëse për gjendjen dhe për përdorimin e këtij varieteti historik të shqipes. Ajo i ka vërejtur me të drejtë disa nga karakteristikat kryesore të këtij dialekti, siç janë: tkurrja e tij dhe prania e "gjysmë-folësve" të saj me aftësi krejtësisht të kufizuara të përdorimit të saj dhe mungesa e shkrimit dhe e mësimit të këtij varieteti në shkolla. Në bazë të këtyre parametrave, arbërishtja e Pianas me të drejtë mund të quhet gjuhë e rrezikuar, e cila jo vetëm që është duke humbur në mënyrë të vazhdueshme domenet e komunikimit, por po i humb njëkohësisht folësit e saj.

Në këtë situata, autorja konsideron se miratimi i direktivave ligjore në nivelin e BE-së dhe i ligjeve përkatëse në rrafshin shtetëror në Itali, mund të luajnë një rol me rëndësi për ringjalljen e arbërishtes dhe për ripërtëritjen e saj. Ky proces mund të forcohet vetëm nëpërmjet mësimit të arbërishtes në shkolla, por që ky aktivitet kërkon paraprakisht përzgjedhjen e varietetit, i cili do të mësohet. Në këtë kuptim, ajo mendon se qasja më e mirë do të ishte përdorimi i shqipes standarde në të shkruar dhe përdorimi i arbërishtes në të folur. Në këtë kuptim, konsideroj se një çështje është e padiskutueshme: si pikënisje duhet të shërbejë përdorimi i padiskutueshëm i alfabetit të shqipes së sotme edhe për shkrimin e formave gjuhësore të shqipes standarde, edhe për shkrimin e formave gjuhësore të arbërishtes. Në të folur, padyshim arbërishtja do të duhej të ishte kodi që do të përdorej, por qe nuk ka dyshim se do të duhej të shoqërohej edhe me përdorimin e vazhdueshëm edhe të shqipes standarde. Krejt kjo do të ndikonte jo vetëm në mësimin e arbërishtes, por njëkohësisht edhe në forcimin e kompetencës komunikuese të folësve të arbërishtes.

Krejt në fund, mund të konstatoj se krahas pikëpamjeve që ka Derhemi për zhvillimin e arbërishtes, revitalizimi i këtij varietei historik të shqipes mund të ndodh vetëm në kudër të një procesi të përgjithshëm të modernizimit të saj, sepse procesi i modernizimit, bashkë me përpjekjet për planifikimin e nxënies së arbërishtes, janë rrugët e vetme për ta ndalur tkurrjen dhe humbjen e domeneve të përdorimit.

Referencat:

Altimari, Françesko (1984). Vëzhgime mbi përdorimin dhe mësimin e gjuhës shqipe. Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letersisë. Tiranë. 1988.

Cooper, Robert L. (1989). Language Planning and Soial Change. Cambridge University Press. Cambridge. New York. Port Chester. Melbourne. Sydney.

Derhemi. Eda (2002). The Endangered Arbresh Language and the Importance of

Standardised Writing for its Survival: The Case of Piana degli Albanesi, Sicily. International Journal on Multicultural Societies, Vol. 4, No. 2. ISSN 1564-4901 © UNESCO.

Derhemi, Eda (2006). Features of dysfunctional attrition in the Arbresh of Piana degli Albanesi. International Journal of Sociology of Language 178 (2006). Walter de Gruyter. pp. 31–53

Derhemi, Eda (2010). New Albanian immigrants in the old Albanian diaspora: Piana degli Albanesi. Journal of Ethnic and Migration Studies. 29:6, 1015-1032, DOI: 10.1080/1369183032000171348

Downes, William (1984). Language and society. Fontata Paperbacs. London.

Fishman, Joshua A. (1974). Language Modernization and Planning in Comparison With Other Types of National Modernization and Planning. Advances in Language Planning. Edited by Joshua A. Fishman. Yeshiva University.New York. Mouton. The Hague. Paris.

Hamp, Eric P. (2007). Studime krahasuese për shqipen. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Ismajli, Rexhep (1991). Gjuhë dhe etni. Rilindja. Prishtinë.

Kostallari, Androkli (1984). Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë (referat). Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letersisë. Tiranë. 1988.

Mackey, William F. (1989). Determining the Status and Function of Languages in Multinational Societies. Status and Function of Languages and Language Varieties. Walter de Gruyter. Berlin – New York.

Munishi, Shkumbin (2010). Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë. Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Mal të Zi në krahasim me atë në përgjithësi (konferencë shkencore ndërkombëtare), Art Club, Ulqin, Mali i Zi.

Trudgill, Peter (1990). Kontakti gjuhësor në Greqi. Në Nuhiu, Vesel. Ndikimet ndërgjuhësore. Rilindja. Prishtinë.

Tsitsipis, Lukas D. (1983). Language shift among the Albanian speakers in Greece. Anthropological Linguistics 25, 288-308.

Tsitsipis, Lukas D. (1984). Functional restriction and grammatical reduction in Albanian language in Greece. Zeitschrift fũr Balkanologie 20, 122-131.

Rrezarta DRAÇINI, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

GEGËRISHTJA PËRMES STUDIMEVE TË LEONARDO M. SAVOIA

Abstrakt. Figura e prof. Leonardo M. Savoias është e lidhur ngushtë me Albanologjinë në Itali, jo vetëm se ka ndikuar në zhvillimin e Qendrave albanologjike atje, por edhe se një pjesë e punës së tij studimore lidhet me gjuhën shqipe.
Leonardo M. Savoia nuk u ndal përciptasi në fenomene të shqipes, po përkundrazi studimet e tij për disa dekada përfshijnë analizimin e shqipes në shumë aspekte, duke u ndalur në çështje që lidhen me kulturën dhe identitetin në gjuhën shqipe, me etimologjinë dhe gjuhën kombëtare, për të vazhduar me studimet e dialekteve të shqipes dhe trajtimet e problematikave që këto dialekte shpërfaqin.
Studimet që lidhen me gegërishten kanë një rëndësi të veçantë, pasi u bënë pjesë e pasurisë albanologjike në një kohë kur kishte boshllëk, pasi gegërishtja për rrethanat e krijuara në gjysmën II të sh. XX ishte lënë në hije.
Do të ndalemi pikërisht te studimet që prof. Savoia ka bërë mbi gegërishten, të cilat kanë një vlerë të shtuar edhe për faktin se janë në frymën e gjuhësisë bashkëkohore.

Paskajorja e gegërishtes është bërë pjesë e studimeve të Leonardo M. Savoias dhe M. Rita Manzinit, pasi, sipas autorëve, paraqet mjaft interes ndërtimi i saj (Savoia L. M.: 2015: 153). Vihet në dukje që në fillim fakti që:

1-në të folmet e shqipes mungon eptimi i specializuar i paskajores së tipit që hasim, p.sh. në gjuhët romane.

2-Të folmet e shqipes përdorin ose format e eptuara të foljes në lidhore ose ndërtimin që shqyrtohet në këtë punim të tipit *me ardhë*. Në këtë ndërtim introduktori parafjalor *mε* kombinohet me një alomorf të pjesores, *psh., me ardh.*

Konkretisht paskajorja nga autorët është studiuar:

1-për cilësitë e saj përndarëse,

2-për statusin kategorial të elementeve të saj përbërëse, pra *mε* dhe përbërësi (konstituenti) foljor.

Vihet në dukje se sjellja sintaksore e këtij ndërtimi varet nga cilësitë e tij strukturore dhe në fund të fundit nga cilësitë eptuese të elementit foljor.

Ndërsa analizojnë paskajoren e gegërishtes Savoja dhe Manzini ndalen në disa elemente të cilat përbëjnë dhe problematikat kyçe.

Konkretisht te:

- veçoritë e paskajores në të folmet e Shkodrës
- tiparet morfologjike të pjesores së pandryshueshme dhe të eptuar
- përndarja e ndërtimit me+pjesore
- analiza e të dhënave

Interes të veçantë paraqesin analizat e të dhënave të mbledhura me kujdes, pasi kjo analizë bëhet:

•në bazë të modelit të zhvilluar nga Manzini dhe Savoia vite më parë (1999-2004) për sistemet e përshtatjes në të folmet dialektore të italishtes dhe gjuhëve romane,

•në bazë të modelit të Rizit (1997) për strukturën e periferisë së majtë të fjalisë.

Analizën morfo-sintaksore të pjesores dhe të paskajores në të folmen e Shkodrës autorët e nisin me shqyrtimin e elementeve që mund të paraprijnë formën foljore të pandryshueshme: përveç elementit *mɛ*, janë edhe dy introduktorë të tjerë*, pa, tu (i)* 'duke' për përcjelloren.

dola pɒ hãŋər	*dola pa ngrënë*
shkova mɛ hãŋər	*shkova të ha*
jam tu e:ts	*jam duke ecur*

Theksohet se mohimi me pjesëzën *mas*, e cila paraprin *me* dhe ndjek *tu*, ndryshon prej mohimit të zakonshëm të fjalisë dëftore me pjesëzat *nuk* ose *s*, dhe përkon me elementin mohues të specializuar që shfaqet në urdhërore (Savoia:2015:155).

ɒʃt mɒ mir	*mas mɛ ʃkru*
është më mirë	*të mos e shkruash*

Savoia dhe Manzini, ndërsa trajtojnë sistemet e përshtatjes, eptimin e emrit dhe të foljes sipas tipareve emërore, argumentojnë se asnjëra nga kategoritë tradicionale të numrit, gjinisë, vetës e rasës, nuk jep në mënyrë të saktë realitetin empirik. Si shembull, ndalen te tipari i gjinisë, duke e specifikuar si problematik, pasi i përgjigjet një kategorie që ka rëndësi interpretuese në një nënbashkësi të vogël rastesh (ku në përgjithësi i referohet seksit mashkull apo femër), ndërsa në raste të tjera ky tipar nuk përcaktohet, duke kërkuar kështu një konceptualizim të ndryshëm (Savoia 2015: 167).

Sipas tyre, njësimi i analizës sintaksore të fjalisë dhe i sintagmës emërore me analizën morfologjike të elementeve leksikore mund të shpjegohet me eptimin e foljes së shtjelluar (Savoia 2015:169).

Savoia dhe Manzini citojnë teorinë e Çomskit, qasjen e tij tradicionale ndaj eptimit foljor në bazë të së cilës eptimi përbëhet nga një tërësi tiparesh të papërcaktuara të lidhura me foljen, vlera e të cilave përcaktohet nga tiparet përkatëse të kryefjalës së fjalisë.

Në analizën që bëhet nga Savoia dhe Manzini vihet në dukje fakti se njësimi i morfologjisë e i sintaksës i paraqitur këtu shpie përkundrazi në përfundimin se eptimi foljor ka brenda foljes të njëjtin status që ka kryefjala përemërore brenda fjalisë. Ndaj pranohet prej tyre që qoftë kryefjala përemërore, qoftë eptimi foljor kategorizohen si D(eterminat). Dallimi ndërmjet këtyre dy elementeve qëndron në faktin se eptimi foljor, p.sh.-*in* në shembullin *krehin*, ndodhet në një pozicion D në brendësi të fjalës, ku *kreh*- është baza leksikore V. Ndërsa në

strukturën e fjalisë tjetër *krehin ata* është folja e eptuar në tërësinë e saj që vendoset në F (V), ku ndiqet prej kryefjalës përemërore në D. (Savoia, 2015:169)

24

a. krehin

(P=Phrase/syntagma)

b. krehin



Përsa i takon foljes në (24) eptimi leksikalizon brenda foljes të njëjtat tipare që kryefjala leksikalizon brenda fjalisë; pra i njohin eptimit të njëjtën kategori D të kryefjalës.

Njësimin e nivelit morfologjik e sintaksor të analizës autorët e shtrijnë tek emri dhe sintagma emërore (ose mbiemri dhe sintagma mbiemërore). Struktura e brendshme e një emri ose mbiemri parashikon një bazë leksikore të treguar me N/A (mbiemri), të ndjekur nga një element eptues N, në (25 a) (Savoia 2015:170)

Ndërsa në brendësi të përbërësve emërorë dhe mbiemërorë, (25 *e kuqe*) eptimin e vënë në lidhje me kategorinë N (sipas Manzinit dhe Savoias, N përkon me argumentin e brendshëm, pra me argumentin e vetëm të emër/mbiemër).

Vihet në dukje se kategorizimi i ndryshëm pasqyron edhe tipare të brendshme të ndryshme të të dy tipave të elementeve, duke qenë se vetëm eptimi D ka cilësinë e vetës (folës, dëgjues), ndërsa vetëm eptimi N ka cilësinë e gjinisë (pra klasë emërore).

Nga ana e vet nyja që paraprin qoftë emrin, qoftë mbiemrin, sipas autorëve, mund të trajtohet, në caqet e analizës standarde të sintagmës emërore, si një element D, duke i dhënë shkas krijimit të strukturave *e kuqe*, (25b). Vihet në dukje se në tipin *e kuqja* përshtatja e nyjës me eptimin e emrit është e ngjashme me atë të gjuhëve romane të tipit *"e kuqja"*.

25

a.



b.



Struktura e pjesores së eptuar

Modelin morfosintaksor të shtjellur më sipër Savoja dhe Manzini e shtrijnë në pjesoret e të folmes gege, duke filluar nga format e përbëra morfologjikisht të pjesores së eptuar (Savoia L. M., 2015:171).

Fillimisht caktojnë natyrën e morfologjisë -*Vm* të klasës së foljeve në zanore, si -*um* në *mlu:m*, dhe të -*un* në foljet me bazë më bashkëtingëllore.

Ndërsa për elementin zanor -*u*, -*i*, -*a*, etj., specifikohet se ai shfaqet edhe pavarësisht nga prania e formativëve eptues në pjesoret e pandryshueshme të tipit *mlu*, *zi*, *la*, *pre* e etj.

Këtë element autorët pohojnë se mund ta lidhim me pozicionin N, si më poshtë, (26) sipas hipotezës që elementet eptuese të pjesores, si ata të emrave dhe ata të mbiemrave, i referohen pozicionit N.

26



Shënohet fakti që pjesorja e eptuar paraqet morfologjinë e përshtatjes së mbiemrave dhe të emrave. Në veçanti morfologjia e përshtatjes së pjesores përfshin formativët eptues, *ɛ*, *a* dhe nyjat parapjesore *i*, *ɛ* ,*t*, të cilave u përgjigjen hyrjet leksikore në (27) (Savoia L. M., 2015: 171).

Autorët sqarojnë se elementet *i*, *ɛ*, *a* lidhen me karakteristika tradicionalisht të quajtura të gjinisë, pra tipare të klasës emërore; këto i përgjigjen leksikalizimit të pozicionit N të emrit. Elementi *t* lidhet me shumësin dhe rasat e zhdrejta (dhanore dhe gjinore); ia njohim këtë element kategorisë kuantifikuese Q (Savoia L. M., 2015:172).

Vihet në dukje në punim që elementi proklitik ndryshon në varësi të rasës, në kuptimin që *i*, *ɛ*, *t* përfaqësojnë sistemin emëror, ndërsa në kontekstet në të cilat pjesorja përshtatet me një argument në kallëzore, si në (*e kam t'veʃun*), paraprihet në çdo rast nga *t*.

27
a. [N*i*]
b. [N*ɛ*]
c. [N*a*]
d. [Q*t*]

Formativët-*m e-un*, që karakterizojnë pjesoret e eptuara, mund të analizohen si leksikalizim i cilësive aspektore, më saktë perfektive, të fjalisë pjesore.

Në raste *ɛ mlume*, *t veʃuna*, elementet -*me* dhe -*n* mund të idendifikohen me kokën aspektore Asp si në 28 a. Baza foljore, ndonjëherë e zgjeruar me zanoren e temës si në *mlu*, në këtë rast është plotës i kokës T të përfaqësuar nga -*m/-n* dhe e futur si e tillë në pozicionin N në të majtë të -*m/-n*.

Eptimet *ɛ*, *a* (28) nga ana e tyre lidhen me një pozicion N brenda strukturës pjesore, në të djathtë të përbërësit (konstituentit) *mlum*, *ose veʃun*, të cilit i përcaktojnë argumentin e brendshëm.

Meqë klitiku parapjesor ndryshon në varësi të rasës së pjesores, autorët

pohojnë se mund të pranohet që vargu *ɛ, t* i emërores vendoset në pozicionin D të vargut klitik, që i caktohet argumentit EPP **(**extended projection principle) sipas Chomsky-t (1995), pra kryefjalës ose emërores tradicionale si në 28.a. Ndërsa për klitikun *t* i kallëzores mund të mendohet që ky element leksikalizon nga ana e vet argumentin e brendshëm Q si në 28.b (Savoia. L. M., 2015:173).

28.a



28. b



Sipas autorëve, analiza e brendshme e pjesoreve të pandryshueshme të tipit *mlu*, e paraqitur në (26), nënkupton që këto forma leksikalizojnë një element N, zanoren e temës. Në dallim nga sa ndodh me elemente N si *-a /-ɛ* në (28) zanorja e temës nuk ndyshon me ndryshimin e argumentit të pjesores. Elementet *-a /-ɛ* janë elemente përshtatëse në kuptimin tradicional të fjalës, në kuptimin që mbajnë parasysh klasën emërore dhe/ose numrin e argumentiti të pjesores (Savoia L. M., 2015: 173).

Nga ana tjetër, trajtimi i zanores së temës si një element N përkon me mundësinë që Manzini dhe Savoia quajnë përshtatje të pjesshme; pra eptimi N nuk leksikalizon referimin ndaj tipave të ndryshëm të klasave emërore dhe numrit, por thjesht ndaj argumentit N.

Vihet në dukje fakti që, ndërsa forma *mlu-* në (28a) përkon me pjesoren e pandryshueshme, zgjerimi -u i bazave bashkëtingëllore të tipit në (28b) specializohet si plotës i kokës aspektore -n (Savoia L. M., 2015: 173).

Nisur nga ky këndvështrim, sipas autorëve, nënkuptohet se formativi aspektor *-m/-n* merr si plotës jo bazën e thjeshtë foljore, por bazën që përfshin një formativ N, pra-*u.*

Pjesorja e pandryshuar e temave më bashkëtingëllore karakterizohet nga një bërthamë zanore e gjatë, p.sh. *ve:ʃ,* dhe dallohet kështu nga baza e thjeshtë foljore *veʃ* me bërthamë zanore të shkurtër. Analiza e pjesores së pandryshueshme *ve:ʃ* sugjerohet nga krahasimi me pjesoret e tipit *mlu* të analizuara në (26).

Autorët kanë analizuar zanoren e temës si një përbërës N të brendshëm të përbërësit foljor dhe kanë nënvizuar faktin se kjo analizë mund të shtrihet në pjesoren e tipit *ve:ʃ* duke e parë si një element leksikor të specializuar, që përfshin referimin e tipit N, ndërkohë që baza e thjeshte foljore *veʃ* nuk e ka këtë tipar

shenjues. (Savoia L. M., 2015: 174)

Me interes është dhe pohimi i faktit që ka edhe forma të pjesores së emërzuar, me eptim *-m,-(u)n*, që leksikalizojnë kundrinën e foljes kryesore. Sqarohet se pjesorja e emërzuar paraprihet nga pjesëza proklitike *s* e gjinores ose nga ajo *t* e kallëzores dhe përfshin eptimin *-it* të kundrinës së shquar si (*t shkrumit*). Formativi *-it* mund të analizohet si kombinimi i argumentit N i bazës pjesore *e shkrum-* edhe i elementit *t Q*. Theksohet se është përbërësi N që përcakton natyrën emërore të pjesores në tërësinë e saj. Ndërsa përsa u përket pjesëzave proklitike *t* të kallëzores dhe *s* të gjinores, autorët sugjerojnë që t futet në Q, në përputhje me interpretimin e pjesores si argument të brendshëm (29); dhe elementi *s* i gjinores mund të identifikohet si një element i tipit vendor *Loc*.

Savoia e Manzini nuk bëjnë vetëm një analizë morfo-sintaksore të brendshme të pjesores e të paskajores në të folmet e Shkodrës duke u ndalur në veçoritë e saj, por identifikojnë dhe të përbashkëtat që ato kanë me gjuhët e tjera. Ata shënojnë se dhe në gjuhët romane, p.sh., në *italisht,* gjinorja përkon me sintagmën parafjalore të paraprirë nga *di* ose nga klitiku *ne* që po ashtu mund të kenë vlerë vendore, si në *esco di lí, ne esco*, (dal që atje, dal prej).

29



Nga krahasimi i së folmes gege të Shkodrës me të dhënat nga e folmja toske, si ajo e Gjirokastrës, vihet në dukje se te kjo e fundit pjesorja/ paskajorja është gjithmonë e shoqëruar nga një eptim aspektor i specializuar, pra -Vr, që e analizojnë si kombinim të një zanoreje të temës N me kokën aspektore -r. Shënohet se, si në të folmen e Shkodrës, ashtu në të Gjirokastrës, ajo është një formë e pjesores pa eptim të bazës pjesore, e tipit (30a) që në përgjithësi shfaqet në kontekste perfektive me *kam* dhe *jam.*

Kjo formë me eptime të bazës pjesore dhe e përshtatur me një argument të fjalisë, është e kufizuar vetëm në kontekstet pësore; siç tregohet në (30b) eptimet e rëndësishme mund të analizohen njësoj si në të folmet gege.

30.a



30.b





Ndërsa analizojnë **format e pandryshueshme**, autorët vënë në dukje se në të folmet gege pjesoret e eptuara (*28 e mlume*), hoqërohen me një eptim pjesor të specializuar, edhe kontekstet në të cilat shfaqen ato janë kontekste pjesore, pra fjali këpujore dhe pjesore.

Pas tyre, përndarja e këtyre formave foljore të pandryshueshme në shkodranishte tregon që në kontekstet në të cilat ndjekin foljen ndihmëse ato kanë vlerë perfektive, pra kanë vlerë aspektore, ndërsa në kontekstet e paraprira nga *mɛ* leksikalizojnë tipare të modalitetit të papërcaktuar (Savoia L. M., 2015:176).

Savoia dhe Manzini shtjellojnë disa argumente: bazat zanore, bazat bashkëtingëllore, parametrizimin në lidhje me bazat bashkëtingëllore, fjalitë me *mɛ* dhe pjesore të pandryshuar, urdhëroren, elementin pjesor në ndërtimet me folje ndihmëse.

Specifikohet se qoftë cilësitë aspektore, qoftë ato modale të lidhura me bazat foljore me zanore të temës të shkodranishtes varen nga karakterizimi i kuantifikuar i referimit ndaj ngjarjes (eventit).

Përfundime

Në këtë punim vumë në dukje këndvështrimin e Savoia-s dhe Manzini-t mbi disa dukuri të pjesores dhe paskajores së gegërishtes, studime që i dhanë shqipes një qasje të re analize, pasi veçoritë e gegërishtes analizohen përtej saj: krahasohet jo vetëm me toskërishten si një dialekt tjetër i shqipes, por edhe me gjuhët e tjera. U ndalëm pikërisht te hulumtimet mbi gegërishten, sepse ato kanë një vlerë të shtuar edhe për faktin se janë në frymën e teorive më të fundit gjuhësore. Ky këndvështrim i ri në studimet mbi gegërishten merr një rëndësi të veçantë, pasi gegërishtja e harruar, jo vetëm që rikthehet si argument i rëndësishëm në punimet e studiuesve më me emër, por edhe trajtimi i tyre bëhet sipas prespektivës bashkëkohore gjuhësore.

Bibliografi

Chomsky. N., (2008). *Regole e rappresentazioni,* Milano.

Chomsky. N., (1995). *The Minimalist program*, The MIT Pres, Cambridge.

Chomsky. N., (2011). *Strukturat sintaksore*, Tiranë.

Demiraj. Sh., (1986). *Gramatika historike*, Tiranë.

Graffi. G., (2008). *Sintaksa. Strukturat e ligjërimit*, Tiranë.

Graffi. G., (2010). *Ç'është gramatika gjenerative*, Tiranë.

Manzini M.R., &Savoia L.M., (2010). *Rasa dhe veti treguese: emëror në të folmen gege të Shkodrës.* Identitete gjuhësore dhe kulturore, 13-29, Shkodër.

Memushaj.R., (2003) *Gjuhësia gjenerative*,Tiranë.

Savoia L. M., (2015). *Studime në gjuhësinë shqiptare*, AShK, Prishtinë.

Savoia L. M., Manzini M.R., (2012). *Case as Nominal Property: The Interaction of DOM and Discourse-linking in Shkodër Pronouns*. In: Rexhep Ismajli (Ed.). Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit - Albanian and Balkan Languages, 411-432, Prishtinë: AShAK-AShSh.

Savoia L. M., Manzini M.R., (2012). *Morphosyntax of the participle and infinitive in the variety of Shkodër*. In: Bardh Rugova(Ed.). Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rasin e 65-vjetorit të lindjes, 651-677, Prishtinë: Koha.

Savoia L. M., Manzini M.R., (2003). *Pjesorja dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës*, Studime Filologjike, 3-4: 93-138.

Genc LAFE, Lecce

MBI (RI)PËRCAKTIMIN E ITALIANIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt. Marrëdhëniet gjuhësore të shqipes me italishten (thuajse tërësisht në rrafshin leksikor), kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve që nga gjysma e dytë të shekullit XIX e deri më sot. Me këtë temë janë marrë përgjatë thuajse një shekulli e gjysmë një sërë gjuhëtarësh gjermanishtfolës, shqiptarë e italianë. Disa nga përfundimet e arritura në këtë lëmë kanë nevojë të rishqyrtohen për shkaqe të ndryshme: në periudhën e parë (që nga Miklosich-i e deri tek Jokl-i e vazhduesi i tij, Çabej) për përcaktimin e italianizmave ka mbizotëruar drejtimi neogramatikor, d.m.th. absolutizimi i përkimeve tingullore, ndërsa nuk është kryer një shqyrtim organik i zhvillimit historik-gjuhësor të të dyja gjuhëve e për rrjedhojë disa latinizma të vona të shqipes ose fjalë të tjera me burim jo nga italishtja janë vlerësuar si italianizma; ende nuk njiheshin ose nuk ishin studiuar sa duhet veprat madhore të shqipes së lashtë, shqyrtimi i leksikut të të cilave hedh dritë edhe mbi ndikimin e italishtes në periudhën përkatëse të shqipes; në vija të përgjithshme kjo vlen edhe për periudhën 1850-1920, duke qenë se botimi, në 20-30 vitet e fundit, i shumë burimeve leksikore dhe dokumentare të panjohura më parë, ka nxjerrë në pah një mori të dhënash që duhen hulumtuar, vlerësuar dhe pasqyruar në gjendjen e përgjithshme të studimeve mbi këtë temë.

1.Kuadri historik-gjuhësor i ndikimit të italishtes mbi gjuhën shqipe

Ndikimi i italishtes mbi gjuhën shqipe ka tërhequr vëmendjen e studiuesve thuajse që në hapat e parë të hulumtimeve mbi të[1]. Ky ndikim është kundruar përgjithësisht si vijim i ndikimit të latinishtes, duke nënkuptuar këtu një vazhdimësi thuajse të pandërprerë, siç shfaqet edhe në thënien e Çabejt se "*dallimi i italianizmave nga latinizmat është një nga çështjet themelore të historisë së gjuhës shqipe*"[2], e cila ka fituar pothuajse vlerën e një aksiome në gjuhësinë historike shqiptare.

Tipare të latinishtes së folur, ose vulgare, të ndryshme nga latinishtja klasike, letrare, fillojnë të dëshmohen në mbishkrime që në fillim të erës së re. Këto

---

[1] I pari që është marrë me huazimet e italishtes në gjuhën shqipe, edhe pse në kuadrin më të përgjithshëm të ndikimit të gjuhëve romane në shqipe, është Miklosich (*Albanische Forschungen II: Die romanischen Elemente im Albanesischen*, 1870). Në *Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache* (Meyer EW 1891) gjenden mjaft etimologji nga italishtja. Monografia e parë që trajton ndikimin leksikor të italishtes në gjuhën shqipe është ajo e R. Helbig-ut *Die italienischen Elemente im Albanesischen*, botuar më 1903. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore me këtë çështje janë marrë N. Jokl, G. Weigand etj.

[2] Çabej, Eqrem: *Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike (SF) 2, Tiranë 1974, (në vijim Çabej 1974), f. 28.

tipare shfaqen në shqiptim, morfosintaksë dhe leksik, duke na paraqitur një kuadër gjuhësor më të afërt me italishten e ardhshme, sesa me latinishten klasike. Ndikimi i latinishtes mbi parashqipen zë fill në shekullin II p.e.r. dhe vijon edhe pas rënies së Perandorisë Romake, si latinishte/ romanishte ballkanike, megjithëse me intensitet më të ulët. Sipas dëshmive historike varietetet e romanishtes ballkanike kanë vijuar të fliten pa ndërprerje në qytetet bregdetare të Adriatikut deri në Mesjetë[3] dhe kanë vijuar natyrisht të ndikonin edhe në gjuhën shqipe. Kjo gjuhë (romanishtja ballkanike) ndërkaq kishte pësuar shumë ndryshime, duke u afruar me të folmet e Italisë së Jugut, nga të cilat pas gjasash rrjedh të paktën një pjesë e latinitetit ballkanik[4]. Është e mundur pra të parakuptohet një vijimësi (*kontinuum*) gjuhësore ndërmjet idiomave romane të Italisë së Jugut dhe latinishtes ballkanike/romanishtes në brigjet lindore të Adriatikut.

Deri më sot në gjuhësinë historike shqiptare çështja e dallimit të latinishtes nga romanishtja ballkanike nuk është trajtuar, ose është përmendur shkarazi, pa u thelluar dhe pa i njohur asaj rëndësi parimore. Problemi i dallimit të romanizmave nga latinizmat është vënë re së pari nga H. Haarman[5]. Ngjashëm me Çabejn, por duke qartësuar më saktë objektin e shqyrtimit, ai formulon gjykimin se "*dallimi ndërmjet latinizmave dhe romanizmave vështirësohet së tepërmi nga disa faktorë pasigurie, të cilët e bëjnë atë një çështje parimore në hulumtimet gjuhësore të shqipes*"[6]. Ka ndikuar këtu dhe fakti që në sh.19-20,

---

[3] Jens Schmitt, Oliver *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München 2001, 125-127. Sipas K. Jireček-ut, *Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters (Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wiss. in Wien. Philosoph.-hist. Classe 48, 3. Wien 1901; 49,1 Wien 1903; 49,2 Wien 1904*), f. 44 dhe I 34-38 e vijim, cit. nga Schmitt, deri në shpërthimin e epidemisë së murtajës të vitit 1348 elementi roman mbizotëronte në popullsinë qytetare të Dalmacisë dhe bregdetit të Shqipërisë, ndërsa në qytetet bregdetare të Shqipërisë fliteshin romanishtja, vllahishtja, serbishtja, shqipja dhe greqishtja popullore, kurse në të shkruar përdoreshin latinishtja, dalmatishtja, e cila nga viti 1350 filloi të zëvendësohej shkallë-shkallë nga italishtja e folur (*vulgare*) e ndikuar nga venecianishtja, serbishtja e mesme dhe greqishtja.

[4] Një nga rrugët kryesore të depërtimit të latinishtes në brendësi të Ballkanit ka qenë pa dyshim *Via Egnatia*, e cila vijonte itinearin e *Via Appia*-s, që duke u nisur nga Roma përfundonte në Brindisi, pasi përshkonte pjesën jugore të Gadishullit Apenin. Khs. edhe Pellegrini, Giovan Battista: "…il principale serbatoio di voci latine per la Penisola balcanica, passate sull'altra sponda, è senza dubbio costituito dall'Italia meridionale…" (rezervuari kryesor i fjalëve latine për Gadishullin Ballkanik ka qenë pa dyshim Italia e Jugut), në *Ricerche linguistiche balcanico-danubiane*, Romë 1992, f. 113.

[5] Haarmann, H. *Die Problematik der Abgrenzung des lateinischen Elements vom romanischen im albanischen Wortschatz*, në *Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums, Insbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl*, Insbruck 1977, f. 313-319.

[6] Haarman 1977: 316.

kur zunë fill hulumtimet e para mbi ndikimin e latinishtes në gjuhën shqipe, me *latinishte* mbahej parasysh *latinishtja klasike*, si një idiomë homogjene me struktura të fiksuara dhe pa shmangie fonetike, gramatikore dhe leksikore, e pandryshueshme në përdorim dhe në hapësirë. Latinishtja e folur ishte ende pak e hulumtuar dhe mbishkrimet e zbuluara nga arkeologët ende nuk ishin studiuar. Këtu e kanë zanafillën edhe disa vlerësime të pasakta të romanizmave, të cilat janë vlerësuar si italianizma, në një kohë që për nga forma e tyre gjuhësore i takojnë një periudhe dukshëm më të lashtë se fillimi i ndikimit të italishtes mbi shqipen.

Si "*datëlindje*" e italishtes mbahet afërsisht fundi i mijëvjeçarit të parë. Rreth kësaj kohe (960–963) "*shfaqet për herë të parë në dritën e diellit gjuha e folur, e dalluar me vetëdije nga latinishtja*" në katër dokumente që njihen me emërtimin *I quattro placiti cassinesi*[7]. Fillimi i mijëvjeçarit të dytë vlen si *terminus post quem* teorik i zanafillës së ndikimit të italishtes mbi shqipen.

Këtu është vendi të rishikohet dhe saktësohet edhe pohimi i Çabejt, sipas të cilit "*është e vështirë të kryhet dallimi ndërmjet fazës së sprasme të latinishtes dhe fazës së parë të italishtes, sepse sikundër dihet caqet ndërmjet tyre nuk janë të prera*"[8]. Sipas të dhënave historike-gjuhësore italishtja, e kuptuar si tërësia e varieteteve romane të folura në Itali, fillon të ndikojë intensivisht mbi shqipen vetëm me mbërritjen e venedikasve në brigjet lindore të Adriatikut, rreth sh.13-14, ndërsa për periudhën paraardhëse duhet të postulojmë ndikimin e romanishtes ballkanike mbi gjuhën shqipe, në vijim të periudhës më të hershme të ndikimit latin. Pra, duke plotësuar Çabejn e duke iu rikthyer Haarmann-it[9], mund të themi që *caqet ndërmjet ndikimit të latinishtes e të romanishtes ballkanike nuk*

---

[7] Migliorini, B. *Storia della lingua italiana*, Firenze, f. 93-96. Bëhet fjalë për katër dëshmi mbi pronësinë e trojeve të tre manastireve që vareshin nga manastiri i njohur benediktin i Montecassino-s, të regjistruara me shkrim në *volgare* (në gjuhën e folur), në dallim nga gjuha e kancelarisë, e cila vijonte të ishte latinishtja. Tekstet janë si më poshtë:

1. Capua, mars 960: *Sao ko kelle terre, per kelle fini que ki contene, trenta anni le possette parte sancti Benedicti* (Di që këto toka, në këta kufij që përmenden këtu, i ka zotëruar për tridhjetë vjet pala e Shën Benediktit);

2. Sessa, mars 963: *Sao cco kelle terre, per kelle fini que tebe monstrai, Pergoladi foro, que ki kontene, et trenta anni le possette* (Di që këto toka, në këta kufij që ju tregova, kanë qenë të Pergoaldi-t, që përmendet këtu, dhe për tridhjetë vjet ai i ka zotëruar);

3. Teano, korrik 963: *Kella terra, per kelle fini que bobe mostrai, sancte Marie è, et trenta anni la posset parte sancte Marie* (Kjo tokë, në këta kufij që ju tregova, është e Shën Mërisë dhe për tridhjetë vjet e ka zotëruar pala e Shën Mërisë);

4. Teano, tetor 963: *Sao cco kelle terre, per kelle fini que tebe mostrai, trenta anni le possette parte sancte Marie* (Di që këto toka, në këta kufij që ju tregova, i ka zotëruar për tridhjetë vjet pala e Shën Mërisë).

[8] Çabej 1974: 29.

[9] Haarmann *loc.cit.*

janë të prera. Latinishtja/ romanishtja ballkanike vijoi të ndikonte mbi gjuhën shqipe, duke i dhënë asaj nga njëra anë romanizma, të cilët për nga forma janë më të ngjashëm me gjegjësit e tyre në italishte sesa në latinishten klasike dhe, nga ana tjetër, huazime nga gjuhë të tjera, të cilat latinishtja klasike nuk i ka, e për këtë arsye këto fjalë janë renditur mekanikisht ndër italianizmat e shqipes.

Në "*Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe*" Çabej konstaton se: "*në vijë të përgjithshme vihet re se elementi latin, për punë të moshës së madhe që ka, ka pësuar një ndryshim thuajse aq të madh në trajta sa edhe leksiku vendës i trashëguar dhe huazimet nga greqishtja e vjetër, me të cilat shpeshherë piqet në punë të vjetërsisë. Huazimet italiane përkundrazi nuk trajtohen shumë më ndryshe nga huazimet prej sllavishtes dhe greqishtes së re*"[10]. Por ky kriter i formuluar shumë saktësisht nuk është ndjekur me konsekuencë në çdo rast, siç do të shohim më poshtë.

Në gjuhësinë historike të shekujve XIX–XX për të dalluar latinizmat e vona nga italianizmat e hershme të gjuhës shqipe ka mbizotëruar thuajse gjithnjë kriteri formal fonetik. Ka munguar shpesh një analizë e thelluar e rrethanave jashtëgjuhësore të evolucionit dhe përdorimit të vetë fjalëve burim të italishtes. Kërkimi symbyllazi i përkimeve fonetike, sipas parimeve të *Gramatikanëve të Rinj* (*Junggrammatiker*), për të përcaktuar me siguri matematike se cilat fjalë kanë hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja e cilat nga latinishtja, ashtu siç bëhet për të rindërtuar fazat më të hershme të gjuhëve të vdekura, për të cilat nuk kemi dëshmi të shkruara e as dëshmi historike të periudhës kur janë folur këto gjuhë, ka sjellë përfundime që nuk i qëndrojnë një shqyrtimi të vëmendshëm e logjik, por shpërfaqin mospërputhje parimore, që do të shqyrtohen në vijim. Si shembull të parë e flagrant mund të përmendim përfshirjen e emrit *postier* ndër venecianizmat e shqipes për shkak të përputhjes fonetike me venecianishten *postièr*[11], të cituar tek Boerio[12], duke hamendësuar rrjedhimisht hyrjen në gjuhën shqipe të kësaj fjale në periudhën e ndikimit venecian, ndërmjet shekujve XIV–XV, në një kohë kur nocioni dhe funksioni i postierit nuk ekzistonin ende[13]. Më lart theksuam se si *terminus post quem* i ndikimit të latinishtes mbi gjuhën shqipe duhet konsideruar teorikisht viti 1000. Por ndikimi intensiv i italishtes

[10] Çabej 1974: 28.

[11] Jorgaqi, K. *Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në shqipen e sotme letrare*, Studime filologjike 1992/1, f. 62, e rimarrë në mënyrë jokritike nga Dashi, B. *Italianismi nella lingua albanese*, Romë 2013, f. 343.

[12] *Boerio, G., Dizionario del dialetto veneziano* (3 Ed. aument. e corret.), Venezia, 1867, s.v.

[13] Fjala *postier* është formim i brendshëm analogjik i shqipes, hyn në vargun e formimeve të ngjashme me këtë prapashtesë, khs. *banak: banakier, boks: boksier, financë: financier, karrocë: karrocier, kuzhinë: kuzhinier, magazinë: magazinier, portë: portier, vinç: vinçier* etj.

mbi gjuhën shqipe zë fill rreth tre shekuj më vonë, në shekullin XIII, me konsolidimin e kontrollit të Republikës së Venedikut mbi bregun lindor të Adriatikut dhe vendosjen atje të administratës venedikase dhe të rrjetit të tregtarëve venedikas[14]. Në këtë kohë ishte kryer ndarja dialektore e shqipes dhe ishin përmbyllur shumë nga proceset e fonetikës historike, të cilat hasen tek latinizmat e shqipes. Pra nëse si *terminus post quem* i ndikimit të italishtes merret viti 1000 (shfaqja e italishtes në dëshmitë e shkruara të kohës), praktikisht ky cak duhet shtyrë më vonë në kohë, në fillim të 1300-s.

Si rrjedhim huazimet veneciane, e më pas italiane, paraqiten në formë më të re dhe deri në shekullin XIX kanë përhapje të kufizuar dialektore (së këtejmi përjashtohen huazimet librore, që hasen në veprat e Buzukut, Bardhit, Bogdanit dhe Budit, të cilat nuk shfaqen më pas në shqipen e shkruar, ose që kanë rihyrë në të prej burimesh të tjera në periudhën ndërmjet shekujve XIX–XX kur gjuha shqipe fillon të përdoret gjerësisht në të shkruar).

2. Shqyrtim i rasteve të diskutueshme

Në hulumtimet mbi italianizmat e shqipes, duke u mbështetur në kriteret e shpjeguara më lart, janë përfshirë si italianizma disa fjalë, të cilat, nëse i nënshtrohen një analize të thelluar, shpërfaqin mospërputhje të dukshme parimore. Në analizë të fundit prejardhja e tyre prej italishtes shpesh nuk qëndron. Këto fjalë janë renditur ndër italianizmat e shqipes vetëm për arsye fonetike, më saktë për shkak të dogmatizimit të kriterit fonetik në shqyrtimin e tyre, duke shpërfillur në mënyrë disi të habitshme kriteret gjuhësore-historike, gjuhësore-gjeografike dhe kulturore, të cilat janë të domosdoshme për të gjykuar mbi proceset e interferencës gjuhësore dhe mbi huazimet leksikore që rrjedhin prej saj.

2.1. Romanizma/latinizma të vonë

Folja LËVROJ/LËROJ (geg. LAVROJ), e cila dëshmohet që më 1555, te Bu-

[14] Venedikasit shfaqen fillimisht në brigjet shqiptare që në fund të shek. XI, si aleatë të bizantinëve në mbrojtjen e Durrësit prej anzhuinëve. Kolonia venedikase e Durrësit gëzonte privilegje nga perandori i Bizantit. Pas Kryqëzatës së Katërt (1204) krijohet dukata venedikase e Durrësit 1205-1213. Më pas tregtarë venedikas u vendosën në Shqipëri gjatë shekujve XIII-XIV (familjet Contarini në Vlorë dhe Bonzi në Shkodër), duke blerë edhe toka. Më 1272-1281 Anzhuinët krijojnë Mbretërinë jetëshkurtër të Arbërisë (*Regnum Albaniae*) me Durrësin si kryeqendër. Më 1282 dëshmohet hapja e konsullatës venedikase në Durrës, më 1370 venedikasit fitojnë nga Balshajt privilegje tregtare në Ulqin. Krahas venedikasve në brigjet shqiptare në këtë kohë shfaqen shpesh edhe tregtarë nga Ancona, Ortona dhe Brindisi, të cilët nuk krijuan ngulime në bregdetin shqiptar. Në gjuhën shqipe në këtë periudhë nuk dëshmohen huazime nga të folme të tjera të Italisë, përveç venecianishtes.

zuku dhe shfaqet në mënyrë të qëndrueshme në të dyja grupet dialektore të shqipes, është kundruar herë si latinizëm dhe herë si italianizëm.

Miklosich-i sheh këtu një latinizëm nga *laborare*[15], po kështu edhe Weigand-i[16] e Tagliavini[17]. G. Meyer[18] anon nga një italianizëm (nga *lavorare*). Për Jokl-in[19] LËROJ vjen nga latinishtja e LËVROJ nga italishtja, për shkak të ruajtjes së grupit bashkëtingëllor *-vr-*; kështu edhe Topalli[20], ndërsa Çabej[21] pajtohet me Jokl-in vetëm për etimologjinë e *lëvroj*. Zhvillimi fonetik dhe përhapja dialektore lënë të hamendësohet që kjo folje ka hyrë në gjuhën shqipe në një periudhë të hershme, para ndarjes dialektore të shqipes, mjaft më herët se fillimi i mijëvjeçarit të dytë, e rrjedhimisht edhe nga viti 1300, i hamendësuar praktikisht si *terminus post quem* praktik për italianizmat. Këtë e përforcon edhe ekzistenca e mbiemrit *e lëvruame* (*ditë e lëvruame* 'ditë pune') në të folmen e Zagorisë, ku forma *e lëvruame* ruan kuptimin parak, të gjerë 'punoj', të latinishtes *laborare*, ndryshe nga *lavroj/ lëvroj*, ku kuptimi ngushtohet në 'punoj tokën'.

Nga pikëpamja fonetike duhet vënë në dukje se që në shekullin I e.r. një *-v-* ndërzanore ka kaluar në dybuzoren *-β-*, e cila më pas ka kaluar në fërkimoren *-v-*: në mbishkrimet latine dëshmohet një luhatje e theksuar ndërmjet *b*-së dhe *v*-së: *bibus - vivus, donabit - donavit, grabem -gravem*[22], pra në latinishten e folur folja *laborare* e lat. klasike ka kaluar që herët në *lavorare*, si në italishten e sotme dhe është krejt e mundur që ajo të ketë hyrë në (para)shqipe nga latinishtja e folur në këtë periudhë ose më vonë.

Prania e qëndrueshme e LAVROJ/LËVROJ/LËROJ në të gjitha të folmet e shqipes parakupton një kontakt gjuhësor intensiv e të hershëm, të ngjashëm me atë të latinishtes mbi (para)shqipen. Nga ana tjetër ekzistenca e LAVËR 'puna e bujkut në arë; aq sa lëron një pendë qe brenda një dite' (vetëm në gegërishte), duket se e ndërlikon edhe më tej tablonë. Çabej e lidh *lavër* me *lavar, lavare* 'kapistër' (e pranishme edhe në toskërishte duke e afruar me *var*) dhe hamendëson një prejardhje prejemërore *lavroj/lëvroj* nga *lavër*; megjithatë ai nuk shprehet me siguri për etimologjinë e *lavroj/lëvroj*, duke i lënë të hapura të dyja mundësitë dhe duke përfunduar se prejardhja romane është e gjasshme, por jo e

[15] Miklosich 1870 II: 34.
[16] Weigand 1914: 48.
[17] Tagliavini 1937, f. 175.
[18] Meyer 1891: 244.
[19] Jokl 1940: 31.
[20] Topalli 2017 s.v.
[21] Çabej SE V 2014: 231-232.
[22] Rohlfs, G., *Grammatica storica della lingua italiana e dei suoi dialetti*, Vëll. I, *Fonetica*, Torino 1966, f. 291.

sigurt. Ndërsa Topalli sheh tek *lavër* një formë prapavajtëse nga *lavroj*[23] duke mos pranuar përfundimin e Çabejt.

Duke mbajtur parasysh sa parashtruam më lart, jemi të mendimit se LAVROJ/LËVROJ/LËROJ është një latinizëm i vonë, duke u bashkuar me mendimin e Topallit për *lavër* si formim prapavajtës nga *lavroj*.

Emri MUR, i cilësuar herë si latinizëm e herë si italianizëm, bën pjesë në rastet e diskutueshme etimologjike. Kjo fjalë dëshmohet që tek Buzuku; Bardhi përkthen me *Muur* si lat. *mūrus* 'mur', ashtu edhe *paries* 'faqe muri'. Gjendet në të gjitha të folmet e shqipes, përveç atyre të gegërishtes lindore, ku në vend të tij shfaqet sllavizmi *zid*, vetëm në kuptimin 'mur', por jo edhe 'faqe muri' (ashtu si edhe në rumanishte, ku përkundrazi mungon forma vijuese e lat. *mūrus*).

Duke u mbështetur në kriterin fonetik *mur* është konsideruar si italianizëm[24] për shkak të ruajtjes së *u*-së (në latinizmat e shqipes *ū* zakonisht zëvendësohet nga *y*; khs. *gjymtyrë* > *iūnctūra*, *yndyrë* < *unctūra*). Miklosich[25] shikon këtu një lat. ndërsa Çabej luhatet ndërmjet lat. dhe it., gjithsesi në analizën e tij duket se mbizotëron kriteri fonetik e për këtë arsye e kundron fjalën *mur* më tepër si italianizëm[26]. Por në lidhje me këtë duhet përmendur se gjatësia e zanoreve në lat. kishte humbur në një periudhë të hershme[27] dhe si rrjedhojë *mur* mund t'i përkasë një shtrese më të vonë të latinizmave/romanizmave.

Gjithashtu, përhapja dialektore është një tregues lashtësie që shtrihet në kohë përpara fillimit të ndikimit të italishtes mbi gjuhën shqipe. Këtë e dëshmon edhe krahasimi me përhapjen e kufizuar të sllavizmit *zid* ndaj *mur*, si edhe zhvillimi kuptimor 'faqe muri', që nuk gjendet në këtë fjalë në gjuhët romane. Duke qenë se ndikimi gjuhësor i sllavishtes mbi shqipen zë fill më së shpejti pas rënies së Perandorisë Romake dhe rrjedhimisht pas dobësimit të ndikimit të latinishtes, është vështirë të mendohet se *mur* mund të ketë hyrë në shqipe si italianizëm teknik i fushës leksikore të shtëpisë pas vitit 1000, duke u përhapur thuajse në mbarë trevën e shqipes e duke nxjerrë eventualisht nga përdorimi sllavizmin *zid* ose cilëndo fjalë tjetër që shërbente për të shënjuar këtë koncept (në leksikun e trashëguar të shqipes nuk dëshmohet asnjë emërtim tjetër për konceptin MUR; emri i trashëguar *ledh* lidhet me një teknikë të ndryshme ndërtimi).

---

[23] Topalli 2017, s.v.

[24] Meyer 1891: 291; Helbig 1903: 58; Weigand 1914: 58; Topalli 2017 s.v.

[25] Miklosich 1870 II: 43.

[26] Çabej SE V 2014: 382.

[27] Sipas Rohlfsit (Rohlfs 1966: 5) që në fillim të erës së re kundërvënia e zanoreve të gjata dhe të shkurtra u zëvendësua nga ajo e zanoreve të hapura dhe të mbyllura dhe sistemi zanor i latinishtes së folur e humbi gjatësinë e zanoreve.

Tek *Karakteristikat*...[28] Çabej përmend dhe shembuj të tjerë, të cilët i kundron si italianizma, si: *furtunë, kapua/kapon, kënallë/ kërnallë, kudhër, magje, i qartë*. Nëse analizohen, këto fjalë, të cilat shfaqin tipare fonetike të lashta, ose rrethana gjuhësore historike të ndryshme dhe për këtë arsye duken të jenë më tepër latinizma të vonë/romanizma, ose romanizma të hyrë në shqipe nga gjuhët e tjera. Kështu *furtunë* 'stuhi detare', të cilën Çabej e konsideron si italianizëm[29], pas gjasash ka hyrë në shqipe nga gr. e re *φουρτούνα* (< it. *fortuna* 'fat')[30], ku dëshmohet së pari në këtë kuptim; khs. turq. *fırtına* me të njëjtin kuptim.

Për *kapua* (dëshmohet së pari te Bardhi: *kapue*) shumica e studiuesve[31] pajtohen mbi prejardhjen e kësaj fjale nga lat. Hapja *o* → *ua/ue* dhe prania e kësaj fjale në të dy dialektet është tregues i një periudhe mjaft të hershme të hyrjes së saj në shqipe. Ndërsa *kapon* mund të jetë huazim nga venec. *capon*, duke mbajtur parasysh përhapjen më të kufizuar të kësaj fjale në të folmet e shqipes.

Emrin *kënallë/kërnallë* Çabej e shpjegon si italianizëm, nga *canale*[32], për arsye se mungon rotacizmi i *-n*-së ndërzanore në toskërishte. Gjykojmë gjithsesi se vetëm kjo e dhënë nuk është e mjaftueshme. It. *canale* vjen nga lat. *canalis* "kanal, rrjedhë uji; shtrat lumi". Por *kënallë/kërnallë* në shqipe ka zhvilluar si kuptim të parë "ujë, pellg, masë uji"; Mitko citon një këngë popullore *në kërnallë të detit me luftua*[33] (në kuptimin "larg në det") dhe përkthen me *kërnall* termin OQEAN[34]. Më tej *kënallë/kërnallë* ka zhvilluar kuptimet "vend i shkretë; vend i thatë". Këto zhvillime kuptimore parakuptojnë një moshë relativisht të hershme të kësaj fjale në gjuhën shqipe, prandaj hyrja e saj në shqipe duhet të shtyhet pas në kohë, në periudhën përpara fillimit të ndikimit të italishtes (ndërsa mungesa e rotacizmit mund të jetë dhe tregues i një huazimi ndërdialektor, nga gegërishtja në toskërisht, ashtu si *shpinë*, fillimisht fjalë e geg., nga lat. *spina*)[35]. Për fjalën *kudhër*, e cila shfaq rotacizmin e *-n*-së ndërzanore në toskërishte, Çabej[36] pajtohet me shpjegimin e prejardhjes së kësaj fjale nga italishtja sipas

[28] Çabej 1974:28-30.
[29] Çabej 1974:28.
[30] Në italishte *fortuna* në kuptimin 'stuhi detare' është fjalë e ligjërimit letrar e dëshmuar më 1249 dhe vështirë të mendohet se ka hyrë në shqipe në rrugë gojore.
[31] Meyer 1891: 176; Mihăescu 1966:10; Haarmann 1972:47; Vătăşescu 1997:211, Orel 1998:170.
[32] Çabej 1974:29.
[33] Çabej SE V 2014: 87.
[34] Mitko, Th. *Fjalëtore gërqisht-shqip e shqip-gërqisht* (përgatitur nga Dh. Qirjazi), Korçë 2014, f. 290.
[35] Forma *shpirë*, me rot., që sot nuk përdoret, është fosilizuar në toponimin *Shpirag* < *shpirë agri* (për shkak të ngjashmërisë së kreshtës së malit të Shpiragut me shpinën e gomarit).
[36] Çabej 1974: 29.

Meyer-it[37], i cili e krahason atë me kalabrishten *ncudina*. Me sa duket Meyer-i është nisur nga forma e latinishtes klasike *incus, -dis*, duke mos njohur formën *incudine* të lat. së vonë, nga e cila rrjedh *incudine* në italisht dhe format e ngjashme në të folmet e saj, si edhe *kudhër* e shqipes, duke gjykuar edhe nga zhvillimi fonetik (rotacizmi) i kësaj fjale.

Magje[38] mbahet si huazim nga it. *madia*, me të njëjtin kuptim. Edhe këtu besojmë se kriteri fonetik ka qenë vendimtar për ta renditur këtë fjalë ndër italianizmat; por për mendimin tonë është shpërfillur kriteri gjuhësor-gjeografik. Përhapja e saj në të gjitha të folmet e shqipes, përfshirë të folmet arvanite, dëshmon për një periudhë mjaft të hershme të hyrjes së kësaj fjale në gjuhën shqipe, e cila nuk është karakteristikë e italianizmave (vlen të kujtojmë që të folmet arvanite janë shkëputur nga trungu kryesor i shqipes në periudhën e fillimit të ndikimit gjuhësor venecian). Pas të gjitha gjasave *magje* vjen nga lat. e folur *màgida*, e cila ka dhënë edhe it. *madia* përmes formës me metatezë **maida* (khs. sic. *maídda*)[39].

Edhe mbiemri *i qartë* (forma më e lashtë *qarë*, që dëshmohet tek Bogdani e Variboba), kundrohet nga Çabej[40] si huazim nga it. *chiaro* dhe jo si latinizëm. Çabej nuk e jep arsyen për këtë zgjedhje, por me sa duket është nisur nga forma fonetike (it. *chiaro* qëndron më afër formës së shqipes se lat. klasike *clarus*). Por përhapja e saj e gjerë në shqipe dëshmon një kohë të hershme të hyrjes së saj, ndërsa qenia e formës *chiar* në rumanishte[41] dëshmon për shndërrimin fonetik *kl* → *kj* që në latinishten/ romanishten ballkanike, dhe nga kjo formë e qiellzorizuar mbiemri *i qartë* ka të ngjarë të ketë hyrë në shqipe. Po ashtu edhe lat. klasike *clarus* nuk përjashtohet si burim, duke qenë se qiellzorizimi *kl* → *q* është një proces fonetik i brendshëm i shqipes *(khs. klanj > qaj, kluonj > quaj/quej*).

2.2. Gjermanizma të përcjella nga latinishtja e vonë

Miklosich[42] ka regjistruar lemën FANG 'fushë', duke e shpjeguar nga it. *fango*. Kjo fjalë shfaqet për herë të parë te Bardhi; në *Dictionarium latino-epiroticum* me FANGH përkthehet lat. *planities* 'fushë, rrafshinë'. Helbig[43] e miraton

---

[37] Meyer 1891: 209.
[38] Çabej 1974: 28.
[39] Devoto, G. *Dizionario etimologico. Avviamento all'etimologia italiana,* Firenze 1968, s.v. *madia* dhe https://www.etimo.it/?term=madia&find=Cerca, lexuar më 04.02.2020.
[40] Çabej 1974: 28.
[41] Vătăşescu 1997: 253.
[42] Miklosich 1870, II: 25.
[43] Helbig 1903: 118.

këtë etimologji, ndërsa Meyer[44] në këtë rast vë në dukje mospërputhjen semantike. Në fjalorin e *Bashkimit*[45] citohet forma e gegërishtes FÂNG: "terreno incolto e sterile" (tokë e papunuar dhe jopjellore). Në FGJSH 1954 shfaqet FANG dhe në FGJSSH 1980 FËNG 'bimë barishtore shumëvjeçare e kullotave, me kërcell të hollë dhe me fije të gjata e të ashpra si të tërshërës së egër, që dalin tufë nga rrënja; fëngishtë'. Çabej[46] jep dëshmi të pasura për kuptimet e ndryshme të FANG/FËNG:

Pukë, Spaç: 'fushore, bar, vend i ngritur me bar, emër bime'; gjithashtu në Pukë *fân* 'një lloj bari i egër që rritet deri në 40 cm';
Rekë: 'hi'.
Vlorë, Myzeqe Mallkastër: *Fëng*: 'bar i ashpër që del në fushë të papunuar';
Dukat: 'kodrinë e zhveshur buzë lumit me burime nëndhese në dimër'; 'ledh i ngritur e i mbuluar me bar i një hendeku, ku kalojnë fshatarët dimrit kur rruga është me baltë'; 'tokë buke e papunuar, bregore e veshur me bar të egër, djerr'; 'tokë e fortë e papunuar'; 'një lloj bari i egër';
fënk mali 'një lloj bari që e ka farën si tërshëra, po me gjemb'.

Kjo fjalë ka hyrë edhe në toponiminë e Shqipërisë së Veriut e të Jugut: *Fang* në Tropojë, Pukë, Lurë e Krujë e *Fânjet/Fâjet* në Postribë; në jug *Fëng* në pika të ndryshme të Labërisë[47].

Pas Çabejt në këtë kuadër semantik mbizotëron kuptimi 'baltë' dhe si rrjedhojë duhet të kemi të bëjmë me një huazim nga it. *fango*. I këtij mendimi është dhe Topalli[48].

Me *fang* lidhet edhe *fag* "bar i thatë e i shkurtër që bagëtia nuk e ha edhe aq tepër"[49]. Sipas Çabejt kemi të bëjmë me të njëjtën fjalë, të krijuar përmes çhundorëzimit të një forme *fâg*. *Fag* shfaqet edhe në toponomastikën e Shqipërisë së Veriut e të Mesme: *Fagu* fshat pranë Bujanit, në Tropojë dhe në Shëngjergj; në këtë të fundit po ashtu edhe *Mali i Fagut*, ndërmjet Erzenit dhe Shkumbinit). Kuptimi i vetëm i *fag* është 'barishte'.

Këtu është e nevojshme të thellohemi në shpjegimin e disa aspekteve historike, dialektore dhe semantike të burimit të hamendësuar *fango* dhe *fang/ fëng* të shqipes. Në italisht *fango*, e cila dëshmohet për herë të parë në të shkruar në shek. XIV, është huazim nga gotishtja *fani*. Nuk është një huazim që i takon vetëm truallit gjuhësor të italishtes (khs. edhe lombardishten *fanga*). Kjo fjalë shfaqet edhe në provencalishten *fanc*, *fanha*, fr. e vj. *faing*, fr. mod. *fagne*, në

[44] Meyer 1891: 99.
[45] *Fialuer i Rii i Scypés*, Shkodër; Ribotim *Fjalori i Bashkimit*, Prishtinë, 1978:105.
[46] Çabej SE IV, 1996:172-173.
[47] Çabej, *loc. cit*.
[48] Topalli 2017, s.v. FËNG/FANG.
[49] Çabej, *loc. cit*, 126; Topalli, *loc. cit*.

katalonishte *fang*, spanjisht *fango*. Përhapja e saj përkon me përhapjen territoriale të fiseve vizigote ndërmjet shekujve IV–VI e.r. Në këtë kontekst është me vend të përmendet se gotët u vendosën dhe qëndruan për rreth një shekull e gjysmë në trevat ballkanike, pasi shpërthyen *limes*-in e Perandorisë Romake në rrjedhën e poshtme të Danubit, gjatë Luftës Gotike në vitet 376–382 e.r.

Nëse fillimi i shekullit XIV duhet kundruar praktikisht si *terminus post quem* i hyrjes dhe përhapjes së italianizmave në gjuhën shqipe, është mjaft e vështirë të pajtohet kjo datë me zhvillimet fonetike dhe kuptimore dhe përhapjen e vetë fjalës në të folmet e ndryshme të shqipes, e cila duhet të jetë kryer përpara diferencimit të të dyja grupeve kryesore të dialekteve në gjuhën shqipe (*a*-së së theksuar hundore të gegërishtes i përgjigjet *ë*-ja e theksuar e toskërishtes), pra mjaft përpara vitit 1300. Fjala *fang/fëng* shfaq një zhvillim fonetik dhe kuptimor që është tipik për një shtresë më të lashtë të fjalëve të shqipes, ku hyjnë edhe latinizmat, dhe rrjedhimisht ka pak gjasa që kjo fjalë të vijë nga it. *fango*. Mbi këtë bazë është e mundshme të hidhet poshtë me siguri prejardhja nga italishtja. E mundshme është një prejardhje nga romanishtja ballkanike *fango*, siç provon edhe epenteza e *g*-së në *fango* < *fani*, e cila shpjegohet përmes ndërmjetësimit të latinishtes vulgare (khs. it. *vengo* / prov. *venc* < lat. *venio*). Nga latinishtja ballkanike kjo fjalë pas gjasash ka hyrë në (para)shqipe pas shekullit IV e.r. dhe me siguri përpara vitit 1000.

Po ashtu zhvillimi kuptimor, nga 'baltë' në 'bar i ashpër, barishte që rritet në toka me baltë; hi', nëpërmjet një forme *bar fangu/fëngu dhe më tej mbizotërimi i kuptimit 'bar i ashpër, i keq' në shumë të folme të shqipes, është i gjasshëm.

Ndërsa *fang* e *fànag* 'baltë, llucë' e të folmeve malazeze të Budvës dheKotorit, të përmendura nga Çabej në mbështetje të prejardhjes së *fang/fëng* nga it. *fango* (por që nuk shfaqin asnjë lloj zhvillimi semantik në krahasim me burimin e hamendësuar etimologjik *fango*) kanë hyrë në të folmet vendëse ose nga romanishtja ballkanike, ose nga venecianishtja.

I njëjti arsyetim mund të bëhet për SHKUMË. Pas Topallit kemi huazim nga it. (dial.) *scuma*[50]. Por kjo fjalë në italishte shfaqet si huazim gjermanik (nga frankishtja ose longobardishtja, si edhe në gjerm. e vj. të lartë *scūm*[51]). Ajo shfaqet në gjuhët romane perëndimore si në provencalisht, katalanisht, spanjishte portugalisht *escuma*, fr. e vj. *escume*, fr. mod. *écume*. Ky fakt dëshmon për një moshë relativisht të hershme të saj në latinishten e folur dhe gjasat janë që kjo

[50] Topalli 2017, s.v. *shkumë*.
[51] Devoto 1968, s.v. *schiuma* dhe https://www.etimo.it/?term=schiuma, lexuar më 24.01.2020.

fjalë të ketë hyrë në shqipe përmes latinishtes/ romanishtes ballkanike[52].

2.3.Një sllavizëm i konsideruar si venecianizëm

Për NETULL 'emri i një bime që përdoret për të bërë fshesa; *krahin.* fshesë', Çabej[53] miraton etimologjinë e Cordignano-s, i cili sheh në fjalën shqipe *netëll* (Dibër, Mat, Krujë) një venecianizëm nga **netola*, që rrjedhkësh nga venec. *netar*[54] 'pastroj'[55]. Duke qenë se **netola* nuk dëshmohet në venecianishte[56], ka pak gjasa që *netull* të jetë krijuar në shqipe nga *netar* e venecianishtes, duke u renditur në radhën e emrave me *-ull*.

Në rumanishte ekziston *mătură* dhe në arumanisht *metură* 'fshesë; emri i disa bimëve që përdoren për të bërë fshesa', të cilat i përgjigjen fonologjikisht shqipes *netull*[57]. Puşcăriu[58] sheh këtu një huazim nga sllavishtja *metla* në rumanishte dhe në shqipe, mendim ky i hedhur poshtë nga Çabej[59]. Vătăşescu[60] pajtohet me Brâncuş-in[61], i cili shprehet në të mirë të prejardhjes autoktone si për shqipen ashtu edhe për rumanishten, duke vënë në dukje përputhjen ndërmjet emrit të sendit dhe të bimës në të dyja gjuhët. Por përputhja e emrit të sendit dhe të bimës në shqipe dhe rumanishte nuk e përjashton prejardhjen nga sllavishtja për këto dy gjuhë, të cilat siç dihet kanë pësuar një ndikim intensiv nga gjuhët sllave të Ballkanit, ndërsa qenia e kësaj fjale në rumanishte e përjashton qartësisht ndikimin e venecianishtes (nuk dëshmohen venecianizma që të kenë hyrë në rumanishte nga shqipja). Prejardhja nga sll. e vj. ***метъла** (khs. bullg. maqed. skr. ***метла***[62]**,** rus. ***метлá*, 'fshesë' nga sll. e vj. ***метъла*, pra fjalë e**

[52] Khs edhe Orel 1998, s.v.

[53] Çabej SE VI 2002, f. 48.

[54] Te Çabej, *loc. cit*. shkruar *nettare*, sipas drejtshkrimit të italishtes.

[55] Cordignano, F. *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese (il nuovo Jungg), Parte Albanese-Italiana*. Milano 1934, f, 127.

[56] Në Boerio, G. *Dizionario del dialetto veneziano* (Terza Edizione aumentata e corretta), Venezia 1867, dëshmohet vetëm *netar* 'pastroj' dhe *neto* 'i pastër' (s.v.).

[57] Rotacizmi i *-l-* ndërzanore është dukuri e rregullt në fonetikën historike të rumanishtes, e ngjashme me rot. e *-n-* ndërzanore në tosk.; khs. çiftet e fjalëve të përbashkëta *mjegull = negură, avull = abur*.

[58] Puşcăriu, S. *Etymologisches Wörterbuch der rumänischen Sprache. I. Lateinisches Element.* Heidelberg 1905, f. 1053.

[59] Çabej, *loc. cit*.

[60] Vătăşescu 1997: 184.

[61] Brâncuş, G. *Vocabularul autohton al limbii române*, Bucureşti, 1983, f. 142.

[62] Këtë fjalë, në këtë formë tingullore dhe në kuptimin e lules së bimës nga e cila bëhet fshesa, e kemi dëgjuar nga vendësit në zonën maqedonishtfolëse të Pustecit, në Prespën e Madhe.

mbarë sllavishtes), mbetet zgjidhja më e gjasshme për shqipen dhe rumanishten, si nga ana fonetike, ashtu edhe nga ana e zhvillimit kuptimor: 'fshesë' → 'bimë që përdoret për të bërë fshesa'.

2.4. Lidhëza veçuese 'o'

Lidhëza veçuese *o* 'ose' sipas G. Meyer-it[63] rrjedh nga italishtja *o*. Kjo hipotezë pranohet nga Weigand[64] dhe Tagliavini[65], ndërsa Helbig[66] pranon etimologjinë e italishtes vetëm për *opor* (nga *oppure*). Çabej[67] pranon pa diskutim etimologjinë e propozuar nga Meyer dhe së fundi kështu bën edhe Topalli[68]. Lidhëza *o* shfaqet në të gjitha të folmet e shqipes dhe dëshmohet që tek Buzuku (1555).

Në këtë rast vlen të theksohet se huazimi, ose *transferimi* i një lidhëze, zakonisht ndodh kur një gjuhë e dytë ushtron një trysni të fortë mbi gjuhën e parë, ose kur gjuha e dytë përdoret intensivisht dhe për një kohë të gjatë në rrafshin e komunikimit[69]. Kështu ka ndodhur p.sh. me lidhëzën *ja*, sinonim i *o*, *ose*, *a*, e cila ka hyrë në shqipe nga turqishtja *ya*. Turqishtja ka qenë gjuha kryesore e komunikimit në Perandorinë e stërmadhe Osmane dhe ka ushtruar një ndikim intensiv përgjatë një periudhe pesëshekullore mbi gjuhën shqipe. Rrjedhojat gjuhësore të këtij ndikimi janë të krahasueshme me ndikimin e latinishtes e në disa aspekte ndoshta edhe më të thella. Në Perandorinë Osmane shumë individë apo grupe emigronin brenda saj, në kërkim të punës dhe të mundësive më të mira të jetesës. Gjuha që përdorej jashtë vendeve të prejardhjes ishte natyrisht turqishtja. Mërgimtarët ndikoheshin prej saj dhe e përhapnin këtë ndikim edhe kur ktheheshin në shtëpi. Pra ndikimi i turqishtes mbi shqipen (dhe mbi gjuhët e tjera ballkanike) është ushtruar jo vetëm në trevën ku flitej shqipja,

---

[63] Meyer 1891: 314.

[64] Weigand 1914: 64.

[65] Tagliavini, Carlo, *L'albanese di Dalmazia. Contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara*. Firenze 1937, f. 209. Tagliavini i referohet këtu së folmes së Borgo Erizzo-s, pranë Zarës, në Dalmaci.

[66] Helbig 1903: 44.

[67] Çabej, SE VI 2002: 111.

[68] Topalli 2017, s.v.

[69] Një tregues i kësaj trysnie është p.sh. përdorimi në shqipen e folur i ndajfoljes *già* të italishtes ende e paregjistruar nëpër leksikë dhe fjalorë). Ajo përdoret kryesisht nga njohës të italishtes për të plotësuar mungesën e referimit të menjëhershëm në kontekst, i cili i mungon barasvlerësit shqip *tashmë*. Në Internet kam hasur format e shkruara *xha* dhe *gia* (sic!). Një luhatje e tillë shihet si tregues i huazimeve të paintegruara.

por edhe përmes mërgimtarëve që ktheheshin. Në këto rrethana veprimi i procesit të huazimit gjuhësor edhe në një fushë leksikore mjaft të qëndrueshme si ajo e lidhëzave është i kuptueshëm dhe i përligjur. Por ndikimi i italishtes (dhe fillimisht i venecianishtes) nuk ka qenë assesi i kësaj natyre. Italishtja nuk ka qenë gjuhë kryesore e komunikimit, ose *lingua franca* për shqiptarët, përveçse në periudha kohore të kufizuara, venecianishtja në shek. XIV–XV në krahina të caktuara (Shkodër, Himarë, në këtë të fundit së bashku me greqishten) dhe italishtja veçanërisht në vitet 1920–1945. Veç kësaj duhet përmendur se lidhëza *o* përdoret shpesh në formën e përngjitur *ose* (khs. formën gjegjëse të gegërishtes *ase*), gjë që flet për një moshë të hershme të kësaj lidhëze në gjuhën shqipe. Për këto arsye mund të themi se prejardhja e saj nga italishtja nuk qëndron.

2.5. Latinishtja e mesme dhe ndikimi i saj në leksikun dituror të shqipes

H. Haarman (Haarman 1977: 320-321) tërheq vëmendjen mbi një kriter tjetër gjeografik-gjuhësor, të cilit deri më sot i është kushtuar pak vëmendje: krahasimit të latinizmave të shqipes me huazimet latine të gjuhëve periferike joromane: fjalë si *formë, libër, shkollë* fonetikisht mund të jenë si italianizma (ose venecianizma), si latinizma. Në përgjithësi këto fjalë janë kundruar si italianizma në shqipe, ka të ngjarë për arsye historike kulturore. Por fjalët përgjegjëse me prejardhje nga lat. gjenden edhe në gjuhë të tjera periferike joromane: lat. *fōrma* ka dhënë *ffurf* në uellsisht, *furf* në kornuellisht, *borma në* baskisht; lat. *librum* ka dhënë *lebhar* në irlandisht, *llyfr* në uells., *levar* në korn., *levr* në bret., *liburu* në bask.; *sc(h)ola* ka dhënë *ysgol* në uells., *scôl* në korn., *scol* në bret., *escola* në bask.. Në këtë kontekst bie në sy përkimi i baskishtes, e cila i ka huazuar të tria këto fjalë nga latinishtja, me shqipen, duke qenë se kontaktet kulturore dhe gjuhësore të baskishtes me latinishten shfaqin ngjashmëri me ato të shqipes. Është e mundur që këto fjalë të vijnë nga lat. e mesme[70], siç mendon dhe Çabej për fjalën *shkollë*[71]. Për këto arsye këto fjalë duhen kundruar më tepër si huazime nga latinishtja sesa nga italishtja në shqipe.

[70] Nën emërtimin *latinishte e mesme* ose *mesjetare*, përmblidhen varietetet e ndryshme të latinishtes që përdoreshin në Europë gjatë Mesjetës (pak a shumë nga shek. VI deri në shek. XV), si gjuhë kulture dhe gjuhë liturgjike e Kishës katolike, por edhe si gjuhë letrare, gjuhë e administratës dhe e së drejtës.

[71] Çabej 1974: 31. Çabej këtu mbetet i dyzuar midis lat. së mesme dhe venecianishtes, për shkak të reflektimit *s : sh*. Arsyet kulturore-historike (fjala *shkollë* në Mesjetë bënte pjesë në leksikun kishtar, ashtu si edhe *libër*), na shtyjnë të mendojmë se burimi më i mundshëm është lat. e mesme. Ndërsa reflektimi *s : sh* shfaqet edhe në italianizmat e shqipes (khs. *shpjegoj* nga *spiegare*).

3.Mbi italianizmat diturorë të hershëm e të rinj të shqipes

Huazimet diturore nga italishtja fillojnë të shfaqen në periudhën letrare të shqipes, që zë fill me *Mesharin* e Gjon Buzukut e vijojnë me autorët e tjerë të lashtë. Disa prej tyre do të rihyjnë në shqipe më vonë, në periudhën moderne të shqipes, "ndën trajtën, qi i përket karakterit të gjuhës" (shih më poshtë mbi rolin e *Komisisë Letrare të Shkodrës* në krijimin e leksikut dituror të shqipes), këtë radhë jo më si *italianizma*, por si *ndërkombëtarizma*. Një rast i tillë përfaqësohet nga koncepti OQEAN, i cili shfaqet fillimisht tek Bogdani në formën *oceano* (shqiptuar *oçeano*): "*detit, maa të shumëtë, i thonë oceano*". Ndryshe nga huazimet e tjera prej italishtes, e cila ishte gjuha e kulturës së Bogdanit, kjo fjalë shfaqet tërësisht e paintegruar në morfologjinë e shqipes, si një fjalë e huaj. Ky emër shfaqet vetëm një herë tek Bogdani dhe nuk del më te autorët pasardhës. Në *Dittionario italiano-albanese*[72] të Da Lecce-s it. *oceano* shpjegohet së pari në italishte si *mar grande* dhe shqipërohet *deti i maadh*. Mitko[73] e përkthen gr. *οκεανός* me *kërnallë*. Fjala *oqean*, në formën e sotme, sipas të dhënave që kemi në dispozicion, shfaqet në fillim të shekullit XX[74]. Si rrjedhim ndërmjet *oceano* (shqiptuar *oçeano*) të Bogdanit, e cila është një *hápax legómenon* në shqipen e shkruar, dhe *oqean* të sotëm nuk ka vijimësi historike; *oqean* nuk është vazhdimi i *oçeano*, siç pohohet në mënyrë të pasaktë në *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe*: "Huazim i ri nga it. *oceano* me burim prej gr. 'Ωκεανός..."[75].

Edhe përcaktimi i italianizmave diturorë që kanë hyrë në gjuhën shqipe që nga gjysma e dytë e sh. XIX paraqet disa probleme. Në *Vocabolario della lingua epirotica-italiana* (1875), të botuar në Alfabetin e Propagandës (Fide)[76], të françeskanit Francesco Rossi da Montalto Ligure, shfaqen, në mënyrë befasuese për kohën e botimit, disa fjalë diturore si: *estetik, etik, etimologìi, geodesìi,*

---

[72] Francesco Maria da Lecce, *Dittionario italiano-albanese* (1702), botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip përgatitur nga Gëzim Gurga, Shkodër 2009, f. 442.

[73] Mitko (Qirjazi 2014), *loc. cit*.

[74] Mann, St. E. *A Historical Albanian-English Dictionary* 1948: 334. Si referencë të parë jep Pekmezin, *Lehr- und Lesebuch des Albanesischen*, Wien und Leipzig 1912(?) dhe *Lese- und Übungsbuch der alb.* Sprache, Wien 1914 e më pas Leottin, *Dizionario Albanese-Italiano* 1937 s.v.

[75] Topalli 2017, s.v. *oqean*.

[76] Bëhet fjalë në thelb për drejtshkrimin e italishtes të përshtatur për gjuhën shqipe: *c* e *g* shqiptohen paraqiellzore, [ʧ] e [ʤ] (*ç* e *xh* të shqipes), ose grykore, [k] e [g], në varësi të fonemës vijuese, si në italisht; *gn* përdoret për fonemën [ɲ] (*nj* të shqipes), *z* shqiptohet gjithnjë [ts] (si *c* në shqip), dhe të plotësuar me pesë shenja të veçanta për të shprehur fonemat që nuk mund të shprehen me shkronjat latine.

geografìi, geologìi, geomanzìi, ideologìi, idrofobìi, idrografìi, kategorìi, kosmografìi, kosmologìi, kosmopolìt, pluràal etj. Këto fjalë janë përfshirë të gjitha, pa diskutim e në mënyrë jokritike, si italianizma në *Italianismi nella lingua albanese*[77]. Në Fjalorin e Rossi-t shfaqet madje si fjalë e shqipes edhe *geoponìk* 'bujk', nga it. *geoponico*, fjalë diturore me përdorim të rrallë në italishte, që nuk është hasur ndonjëherë në shqipe dhe nuk është përfshirë nga Dashi ndër italianizmat e shqipes.

Nga këndvështrimi historik-gjuhësor këtu bëhet fjalë për anakronizma, duke qenë se këto fjalë do të shfaqen dhe do të rrënjosen në shqipen e shkruar (jo të gjitha) vetëm pas vendimeve të *Komisisë Letrare të Shkodrës* (1916–1918). Për të sqaruar arsyen e shfaqjes së tyre tek *Vocabolario della lingua epirotica-italiana* i Rossi-t është i nevojshëm një shqyrtim i shpejtë i historisë së shqipes së shkruar. Tradita e shkrimit në gjuhën shqipe fillon me letërsinë katolike të Veriut, me Buzukun më 1555, dhe vijon përgjatë dy shekujve pasardhës. Gjatë shekullit XVIII ajo dobësohet deri sa fashitet tërësisht. Ndërmjet fundit të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX vërehen përpjekje individuale gjuhësore dhe letrare të intelektualëve shqiptarë, por vetëm pas *Lidhjes së Prizrenit* (1878-1881) merr hov dhe zhvillohet jeta kulturore kombëtare, hapen shkollat në gjuhën shqipe, lulëzon letërsia dhe zë fill përpunimi dhe pasurimi i gjuhës shqipe. Një pamje të besueshme të leksikut të shqipes në kapërcyell të shekujve XIX–XX na japin *Fjalori shqip-greqisht* i Kristoforidhit (1904) dhe *Fjalori i Shoqërisë "Bashkimi"* të Shkodrës (1908), vepra të domosdoshme për çdo lloj studimi dhe hulumtimi leksikologjik në lëmin e albanologjisë.

Nga sa përmendëm, bëhet e qartë se fjalët e cituara më lart nga *Fjalori* i Rossi-t nuk mund të kenë qenë në përdorim në gjuhën shqipe përpara vitit 1875. Është po ashtu e vërtetë se në gjysmën e dytë të sh. XIX në Shkodër, në kuadrin e *Kultusprotektoratit* austro-hungarez, u hapën shkollat e drejtuara nga françeskanët (e para u hap në Gjuhadol, më 1861) dhe jezuitët, në përgjithësi nënshtetas austro-hungarezë me kombësi italiane[78]. Megjithatë në procesin mësimor dhe në vetë tekstet e përdorura në Shkodër mbizotëronte italishtja (shqipja si lëndë shkollore do të hyjë në programet arsimore vetëm nga fundi i shekullit XIX, ndërsa tekstet në gjuhën shqipe do të shfaqen më vonë), dhe ka pak gjasa që këto fjalë të kenë qenë në përdorim në atë kohë, kur ende nuk kishte një prodhim

[77] Dashi 2013. Në Fjalësin (*Lemmario*) e këtij botimi këto fjalë janë sjellë në formën e sotme (*gjeografi, estetikë, gjeodezi, gjeologji, ideologji* etj.), duke u konsideruar rrjedhimisht si italianizma që janë shfaqur në gjuhën shqipe më së voni më 1875.

[78] Shih E. Deusch, *Das k.(u).k. Kultusprotektorat im albanischen Siedlungsgebiet in seinem kulturellen, politischen und wirtschaftlichen Umfeld*, Wien Köln Weimar, 2009.

letrar të qëndrueshëm në gjuhën shqipe. Vetë Rossi nuk na jep mundësi të kuptojmë më tepër në këtë pikë; nga faqja e parë e fjalorit mësojmë se "Fjalori u hartua duke u mbështetur në Fjalorët e Tanfani-t, Trinchèra-s e të tjerë"[79]. Në parathënie, ndërsa autori përshkruan vështirësitë që kishte hasur "... *pa mundur të gjeja libra përmes të cilëve të mundja të mësoja gjuhën*"[80], duke pohuar se "*në këtë Fjalor gjenden të gjitha fjalët e nevojshme për të folur dhe kuptuar gjuhën që përdorin sot shqiptarët*"[81], mungon çdo lloj informacioni për burime të mundshme leksikore që mund të ketë përdorur për të hartuar Fjalorin, përveç përmendjes së *Dittionario Italiano-Albanese* (*Fjalor Italisht-Shqip*) të Francesco Maria da Lecce-s (1702). Për më tepër, fjalët diturore të cituara më sipër në Fjalor shfaqen me një shpjegim të shkurtër në shqipe, siç bëhet në fjalorët e thjeshtë njëgjuhësh:

GEOGRAFÌI, 'die e dhéut' - *geografia*
ESTETÌK 't'gnoftunit e t'miirit' - *estetica*
ETÌK 'die e vessèvet' - *etica*
GEODESÌI 'die per me maat e me daa dheen' - *geodesia*
GEOLOGÌI 'die e dhéut' - *geologia*
IDEOLOGÌI 'die e mèndes'- *ideologia*
IDROFOBÌI 'turbim'- *idrofobia,*
IDROGRAFÌI 'die uit'- *idrografia*
KATEGORÌI 'rènd, riiesct'- *categoria*
KOSMOGRAFÌI 'die e dhéut' - *cosmografia*
KOSMOLOGÌI 'die e ligiavet dyrgnàâs' - *cosmologia*
KOSMOPOLÌT 'nier i scékullit' - *cosmopolita*
PLURÀAL 'sciùm' - *plurale, numero dei più*; 't'sciùm' — *pluralità, maggioranza, numero maggiore de' voti*

Nuk ndodh kështu me fjalë të gjuhës së folur ose me përdorim të shpeshtë, të cilat janë renditur në fjalor pa u shoqëruar me shpjegim në gjuhën shqipe, natyrisht për shkak se në rastin e tyre nuk ka vështirësi kuptimore. Fjalori i Rossi-t me siguri ka qarkulluar në mjediset e ngushta të shkollave dhe gjimnazeve françeskane dhe jezuite në Shkodër, por nuk ka njoftime e të dhëna mbi receptimin e tij nga publiku shqiptar dhe mbi përdorimin real të këtyre fjalëve në prodhimin letrar të shqipes së kohës. Këto fjalë, që për këtë arsye duhen përkufizuar si anakronizma, nuk shfaqen në fjalorët e Kristoforidhit (1904) e të *Bashkimit* (1908)[82], të përmendura më sipër, por as në *Etymologisches Wörter-*

[79] Në ballinë: "compilato sui vocabolari Tanfani, Trinchéra ed altri…"
[80] *Prefazione,* f. VII: "... senza poter trovare libri, onde apprenderne la lingua".
[81] *Prefazione,* f. VIII: "Avverto che in questo Vocabolario si contengono tutte le voci necessarie per parlare e intendere il linguaggio che si usa al presente dagli Albanesi".
[82] Në Fjalorin e *Bashkimit* shfaqet p.sh. *dheshkrojë,* formë e gegëzuar e neologjizmit

buch der albanesischen Sprache (1891) të Gustav Meyer-it e as në *Die Italienischen Elemente im Albanesischen* (1903) të Helbig-ut, të cilët e citojnë Rossi-n ndër burimet e tyre.

Termat diturorë me karakter të përgjithshëm që vijnë nga gjuhët klasike do të pranohen e do të zënë një vend të qëndrueshëm në përdorimin gjuhësor të shqipes vetëm pas vendimit të *Komisisë letrare të Shkodrës*, e cila u mblodh ndërmjet viteve 1916–1918 për të përcaktuar, ndër të tjera, edhe terminologjinë letrare, shkencore dhe administrative të gjuhës shqipe. Në shkurt 1917 *Komisia* vendosi që: "Termat e përgjithshëm të ditunís të rrjedhuna prej gjuhvet klasike e qi kanë marrë sot nji ngjyrë ndërkombtare, tue qenë të pranueshme në të gjitha gjuhët e Europës do të pëlqehen edhe në gjuhën shqipe ndën trajtën, qi i përket karakterit të gjuhës"[83]. Pas këtij vendimi në gjuhën shqipe hynë dhe zunë vend të qëndrueshëm në përdorim qindra fjalë e terma nga leksiku dituror me prejardhje klasike i gjuhëve europiane perëndimore, duke nxjerrë nga përdorimi edhe disa neologjizma të krijuara si kalke nga greqishtja, si *dheshkronjë* 'gjeografi' ose *gjithëmësimje* 'universitet'. Italishtja në këtë mes nuk përfaqëson gjuhën dhënëse, gjuhën që i ka përcjellë shqipes këto fjalë, por njërën nga gjuhët europiane të kulturës, gjuhën më të afërt gjeografikisht dhe fonetikisht me shqipen, e cila, së bashku me frëngjishten e më pak me gjermanishten, kanë ndikuar fort në formimin e shtresës leksikore diturore, duke i dhënë shkas formimit të fjalëve dhe termave diturorë, shkencorë, juridikë, administrativë etj., me prejardhje europiane në formën e sotme në gjuhën shqipe.

Përfshirja e fjalëve diturore të cituara më sipër në *Fjalorin* e Rossi-t duhet vlerësuar si një përpjekje për të mbushur zbrazëtinë thuajse tërësore që ekzistonte në lëmin e leksikut dituror me prejardhje klasike nga gjuhët perëndimore në shqipen e kohës, duke përshtatur për këtë qëllim fjalët përkatëse të italishtes në strukturën fonetike e morfologjike të shkodranishtes. Citimi i këtyre fjalëve në formën e sotme dhe përcaktimi i tyre si italianizma të dëshmuara në shqipe më së voni më 1875 (Dashi 2013) është metodologjikisht i gabuar dhe nuk i përgjigjet së vërtetës faktike.

Së fundi është e gabuar dhe e papranueshme, për arsyet e mësipërme, gjithnjë te Dashi 2013, përfshirja tek italianizmat e shqipes e një vargu të gjatë fjalësh diturore me burim nga gjuhët klasike ose që janë formime diturore të

dheshkronjë të krijuar nga S. Frashëri sipas modelit të gr. vj. *geographìa*; tek i njëjti fjalor nuk përmendet asnjë nga format e cituara më lart nga *Vocabolario della lingua epirotica-italiana* të Rossi-t.

[83] *Laimet e Komisis Letrare Shqipe në Shkodër, Numër 1, Kallënduer 1918, Vjet I*, f. 19.

gjuhëve europiane prej brumit të gjuhëve klasike, si p.sh. fjalët e formuara nga *demo-* (*demokraci* etj.), *drama-* (*dramaturgji, dramaturg* etj.), *alkool, alkoolizëm, antropofag, antropolog, antropologji, antropomorf, antroponimi, antroponimik, apogje, apologji, apendicit, arabist, arabizëm, arkeolog, arkeologji, arkeologjik, aritmetikë, asteroid, atmosferë, atom, autoktoni, diagonal, dialog, cilindër, dinamik, dinamizëm, dinozaur, ekonomi, ekonomik, elasticitet, elefant, elementar, empirizëm, enciklopedi, enciklopedik, energji, energjetik, enklitik, epik, episod, feudalizëm, filolog, filologji, filologjik, filozof, filozofi, filozofik, fonemë, fonetik, fonologji, fonologjik, formalizëm, globalizëm, idealizëm, imperializëm, klimë, klimatologji, komunizëm, oqean, oqeanografi, pitekantrop, satrap, socializëm, socialist* etj. ose terma specifikë të mjekësisë (*aerofagji, distrofi, distrofik, ekografi*) dhe madje edhe fjalë si *albanologji* e *albanologjik*[84]. Këto janë fjalë që vijnë nga leksiku dituror, me prejardhje klasike, i gjuhëve europiane, pra nga shumë burime, të pranuara në shqipe "ndën trajtën, qi i përket karakterit të gjuhës", ose, në rastin e *albanologji, albanologjik,* krijime diturore të shqipes. Aq më pak mund të konsiderohen italianizma fjalë me prejardhje orientale ose islamike, si *emir, kalif, kalifat, satrap*[85]. Ndërsa duhen konsideruar italianizma *fluoreshencë, fluoreshent, inkandeshent, lumineshencë, lumineshent* e të ngjashme me këto për arsye fonetike, për shkak të shqiptimit me *-sh-*, si në italishte, të grupit bashkëtingëllor të latinishtes *-sc-*.

3.1. Një italianizëm "i latinizuar" nga leksiku i automobilit

Si italianizma duhen konsideruar edhe fjalë që sipas formës së tyre tingullore në shqipe nuk do të konsideroheshin të tilla, por shfaqen të trajtësuara sipas latinishtes. Rasti më domethënës është ai i emrit *friksion*. Kjo fjalë, me përdorim mjaft të gjerë në veçanti pas viteve 1990, ka hyrë në gjuhën shqipe pas gjasave në gjysmën e parë të shekullit XX dhe ende nuk gjendet në fjalorët e shqipes[86]. Topalli e kundron si huazim latino-roman, duke përmendur (si burim)

---

[84] Për një kuadër të plotë shih *passim* te *Lemmario*, në Dashi 2013, ku përmenden disa qindra ndërkombëtarizma me prejardhje nga latinishtja dhe greqishtja e lashtë, të cilat për arsye vendi nuk mund të citohen të gjitha këtu, që konsiderohen *tout court* e pa asnjë diskutim si italianizma.

[85] Dashi 2013, *passim*.

[86] Mungon te Leotti 1937, në FGJSH 1954, në FGJSSH 1980, por çuditërisht edhe në FGJSH 2006. Gjendet te Leka-Simoni 1986 dhe te Leka-Simoni 2010 s.v. *frizione*, dhe te Leka-Simoni 2003 s.v, po ashtu edhe te Newmark 1998 s.v. Nuk është trajtuar te Lafe 2000 e te Dashi 2013.

lat. *frictio, -onis* dhe fr. *friction* "fërkim" nga folja lat. *fricare* "fërkoj"[87]. Kriteri fonetik ka qenë vendimtar në përjashtimin e italishtes për prejardhjen e saj, sepse gjykuar formalisht, një fonemë [ʦ] ndërzanore e italishtes (shkruar -z-) nuk jep asnjëherë *-ks-* në shqipe. Gjykuar thjesht nga forma fonetike, vetëm frëngjishtja *friction* do të vinte në vështrim si burim i mundshëm i shq. *friksion*. Por vlerësimi i kuadrit historik na çon në një përfundim tjetër. Frëngjishtja nuk ka ushtruar ndonjë ndikim të ndjeshëm në terminologjinë e automobilit dhe të motorëve në shqipe, ndërsa dihet qartësisht se kjo terminologji në gjuhën shqipe ka hyrë në pjesën më të madhe nga italishtja, përmes një procesi intensiv të ndikimit leksikor, i cili ka zënë fill që nga vitet e Luftës së Parë Botërore dhe ka vijuar deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Italianët ishin ndër të parët që sollën automobilat në Shqipëri dhe që filluan ndërtimin e rrugëve automobilistike. Së bashku me automobilin hyri edhe terminologjia përkatëse e këtij sektori teknologjik deri atëherë thuajse të panjohur në gjuhën shqipe. Ky proces shfaq ngjashmëri me vërshimin e termave nga anglishtja në të gjitha gjuhët e botës në sektorin terminologjik të kompjuterit dhe të financës, terma të cilat nuk përkthehen, por integrohen (ose përdoren të paintegruara) në gjuhët përkatëse. Fjala *friksion* si emërtim i një vegle të automobilit pa dyshim ka hyrë në shqipe nga italishtja *frizione*, nëpërmjet gjuhës së folur, dhe me sa duket është rimodeluar sipas trajtës klasike të latinishtes, pa përjashtuar në këtë proces ndikimin e fëngjishtes, në frymën e udhëzimeve të *Komisisë* (*...do të pëlqehen edhe në gjuhën shqipe ndën trajtën, qi i përket karakterit të gjuhës*), duke qenë një tregues i veprimit të planifikimit gjuhësor të shqipes edhe në këtë sektor, i cili nuk bën pjesë në leksikun dituror.

4. *Përfundime*

Siç u përmend më lart lidhur me periudhën e hershme të ndikimit të italishtes mbi leksikun e shqipes, mund të pohohet se ndërmjet latinizmave dhe italianizmave të mirëfilltë të shqipes dallohet një shtresë e ndërmjetme romanizmash, të cilët janë shfaqur në gjuhën shqipe përpara fillimit të ndikimit të italishtes/venecianishtes. Është e mundur të hamendësohet që në këtë rast kemi të bëjmë me fjalë që kanë hyrë në shqipe nga varietete të romanishtes së folur në bregun lindor të Adriatikut, ku sipas dëshmive historike këto vijuan të fliten pa ndërprerje edhe pas rënies së Perandorisë Romake, deri në shekullin XIV.

[87] Topalli 2017 s.v.

Në këtë kontekst pohimi i Çabejt[88], i cituar në fillim të këtij shkrimi, duhet saktësuar, duke dalluar latinizmat nga romanizmat ballkanikë që shfaqin tipare të ngjashme me varietetet e folura (*volgare*) në Gadishullin Apenin dhe duke i dalluar këto nga italianizmat e mirëfilltë, që shfaqen në shqipe pas vitit 1000, ose më saktë pas 1300-s. Përveç kësaj është e nevojshme të rishikohen të gjitha ato fjalë që janë përcaktuar në të shkuarën si italianizma të vjetër të shqipes, por prejardhja latine/romane e tyre nuk qëndron (si *netull*), ose që kanë hyrë në shqipe përmes latinishtes së vonë (*fang, shkumë*).

Në veprën e shumëpritur "Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe" të K. Topallit, të botuar më 2017, sipas gjykimit tonë mbivlerësohet roli i ndikimit leksikor të italishtes, duke u konsideruar si italianizma (për arsye formale, sipas trajtës fonetike) shumë fjalë kulture ose terma shkencorë që janë ndërkombëtarizma, të cilët kanë hyrë në shqipe nën ndikimin e përbashkët të gjuhëve kulturore europiane, jo vetëm të italishtes. Një shembull për këtë është termi *kation*, term i kimisë, nga gr. e vj. κατά "poshtë" + ἰόν "lëvizës", i krijuar në shekullin XIX nga kimisti anglez Michael Faraday. Sipas Topallit kemi të bëjmë me një "huazim të ri nga gjuhët romane: it. *catione*, fr. *cation*"[89]. Është e paqartë se për ç'arsye ky term duhet konsideruar si huazim i ri nga gjuhët romane. Kjo fjalë përdoret vetëm në fushën e kimisë dhe si çdo term specifik i shkencave të natyrës shfaqet në këtë formë fonetike në të gjitha gjuhët dhe ka depërtuar pas gjasave pas Luftës së Dytë Botërore në leksikun sektorial të fizikës dhe kimisë në gjuhën shqipe, mbi të cilin italishtja nuk ka ushtruar ndonjë ndikim specifik, si në rastin e terminologjisë mekanike (të automobilit dhe motorëve). Po ashtu nuk ka tregues fonetikë që të dëshmonin një prejardhje nga italishtja të saj, si në rastin e fjalëve *fosforeshencë, fosforeshent, lumineshencë, lumineshent* (shih më lart). Por italishtja mbivlerësohet edhe duke u konsideruar si burim për fjalë të rrënjosura që herët në shqipe e me përdorim të shpeshtë, siç është fjala *katund*[90], të cilën Topalli e sjell të prejardhur prej italishtes *cantone* 'rajon, krahinë' në pajtim me Miklosich-in[91], ndërsa të gjithë dijetarët e mëvonshëm e kanë hedhur poshtë këtë etimologji, e cila mund të duket tërheqëse nga ana fonetike, por nuk i qëndron shqyrtimit të rrethanave gjuhësore-historike dhe gjeografike. *Katund* është një fjalë e përhapur në mbarë shqipen, përfshirë edhe të folmet arvanite dhe arbëreshe, si edhe ka hyrë në disa gjuhë ballkanike, pra është fjalë e hershme

[88] Çabej 1974: 28.
[89] Topalli 2017, s.v.
[90] Topalli 2017, s.v.
[91] Miklosich AF II: 10.

në shqipe dhe si e tillë nuk mund të jetë italianizëm. Çabej e trajton gjerësisht këtë fjalë[92], duke hedhur poshtë prejardhjen nga italishtja, por edhe etimologjitë e propozuara nga të tjerë, e duke e lënë burimin e kësaj fjale të pazgjidhur.

Pas viteve 1990 zë fill një periudhë e re e ndikimit të italishtes mbi gjuhën shqipe, në veçanti në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX, kur italishtja, për shkak të veçantive historike-gjuhësore dhe kulturore të kohës, u bë për një periudhë të shkurtër gjuha e huaj kryesore në Shqipëri, për t'u zëvendësuar shpejt nga anglishtja në këtë rol. Kjo e ndërlikon edhe më tej kuadrin e italianizmave të shqipes, sepse shumica e anglicizmave që hyjnë si ndërkombëtarizma në gjuhët e botës kanë prejardhje nga latinishtja. Prandaj për të dalluar se ç'është italianizëm ose romanizëm e ç'është anglicizëm në shqipen e sotme është e nevojshme të njihet mirë historia e zhvillimit të leksikut të shqipes përgjatë shekullit XX.

Në mbyllje mund të thuhet se ndikimi gjuhësor i italishtes mbi shqipen mbetet një çështje komplekse dhe e hapur ndaj përfundimeve të reja, si ndaj punës së kryer në të shkuarën, ashtu edhe ndaj gjendjes së sotme të kërkimeve në këtë fushë. Mbetet po ashtu i vlefshëm konstatimi i Çabejt se "çështja se ç'është latine e ç'është italiane, një nga çështjet parimore të gjuhësisë shqiptare ... nga shumë pikëpamje do të shikohet ende si e pazgjidhur deri më sot. Në zgjidhjen e saj mund të ndihmonte vetëm një trajtim monografik i lëndës, ku përveç pikëpamjeve thjesht gjuhësore t'u jepej fjala edhe pikëpamjeve historike"[93]. Këtë thënie do ta plotësonim me kërkesën për të dalluar qartë italianizmat nga ndërkombëtarizmat me burim latin që kanë hyrë në gjuhën shqipe që nga fillimi i shekullit XX e deri më sot. (Ri)përcaktimi i italianizmave në gjuhën shqipe ngërthen edhe një varg problemesh të tjera, të cilat janë përmendur pjesërisht më lart, e që shpresojmë se do të jenë objekt i kërkimeve në këtë fushë për të ardhmen.

Burime leksikografike për gjuhën shqipe:

Bashkimi 1908: *Fialuer i Rii i Scypés, Perbâam Préi Shocniét t'Bashkimit*, Shkodër; Ribotim *Fjalori i Bashkimit*, Prishtinë, 1978.

Cordignano, 1934: F. Cordignano, *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese (il nuovo Jungg), Parte Albanese-Italiana*. Milano 1934.

Da Lecce 2009: Francesco Maria da Lecce, *Dittionario italiano-albanese* (1702), botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip përgatitur nga Gëzim Gurga, Shkodër 2009.

Dashi 2013: B. Dashi, *Italianismi nella lingua albanese*, Roma 2013.

Fgjsh 1954: *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954.

[92] Çabej SE V, 2014: 62-64.

[93] Çabej 1974: 29.

Fgjsh 2006: *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006.

Fgjssh 1980: *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.

Leka-Simoni 1986: F. Leka, Z. Simoni, *Fjalor italisht-shqip*, Tiranë 1986.

Leka-Simoni 2003: F. Leka, Z. Simoni, *Fjalor shqip-italisht*, Tiranë 2003

Leka-Simoni 2010: F. Leka, Z. Simoni, *Fjalor italisht-shqip i ndrequr e i përmirësuar*, Tiranë 2010.

Mann 1948: St. E. Mann, *An historical Albanian-English Dictionary*, London - New York - Toronto.

Meyer 1891: G. Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Straßburg 1891.

Miklosich 1870: F. Miklosich, *Albanische Forschungen II: Die romanischen Elemente im Albanesischen*, Wien, K. Akademie der Wissenschaften 1870.

Mitko 2014: TH. Mitko, *Fjalëtore gërqisht-shqip e shqip-gërqisht* (përgatitur nga Dh. Qirjazi), Korçë 2014.

Orel 2008: V. Orel, *Albanian Etymological dictionary*, Leiden - Boston - Köln, 2008.

Newmark 1998: Newmark, Leonard, *Oxford Albanian-English Dictionary* Oxford University Press, 1998

Rossi 1875: F. Rossi Da Montalto Ligure: *Vocabolario della lingua epirotica-italiana*, Roma, Tipografia poliglotta della s.c. di Propaganda Fide, 1875.

Topalli 2017: K. Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 2017.

Weigand 1914: G. Weigand, *Albanesisch-deutsches und deutsch-albanesisches Wörterbuch*. Leipzig 1914.

BURIME LEKSIKOGRAFIKE PËR ITALISHTEN:

Boerio 1867: G. Boerio, *Dizionario del dialetto veneziano* (Terza Edizione aumentata e corretta), Venezia,1867.

Devoto 1968: G. Devoto, *Dizionario etimologico. Avviamento all'etimologia italiana,* Firenze 1968.

HTPPS://WWW.ETIMO.IT (Leximi i fundit më 02.02.2020).

Zingarelli 2011: *Lo Zingarelli 2011. Vocabolario della lingua italiana di Nicola Zingarelli*, ristampa della dodicesima edizione, Zanichelli 2011.

BIBLIOGRAFI:

Brâncuş 1983: Brâncuş, Grigore, *Vocabularul autohton al limbii române*, Bucureşti 1983.

Çabej 1974: E. Çabej, *Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe*, Studime filologjike (SF) 2, 1974, Tiranë.

Çabej, SE 1976–2006: E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Vëll. I–VII, Tiranë. Në tekst citohet pas SE numri i vëllimit, viti i botimit dhe faqja.

Deusch 2009: E. Deusch, *Das k.(u).k. Kultusprotektorat im albanischen Siedlungsgebiet in seinem kulturellen, politischen und wirtschaftlichen Umfeld*, Wien Köln Weimar, 2009.

Haarman 1972: H. Haarman, *Der lateinsiche Lehnworschatz im Albanischen*, Hamburg 1972.

Haarman 1977: H. Haarman, *Die Problematik der Abgrenzung des lateinischen Elements vom romanischen im albanischen Wortschatz*, në *Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums, Insbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl*, Insbruck 1977, f. 313–319.

Helbig 1903: R. Helbig, *Die italienischen Elemente im Albanesischen, Inaugural-Dissertation,* Leipzig 1903.

Jokl 1927: N. Jokl, *Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen.* Fest. Salzburg

1927, 105–137.

Jokl 1940: N. Jokl, *Zur Erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmazien.* Arch. Rom. XXIV 1, 1940, 5–41.

Jorgaqi 1992: K. Jorgaqi, *Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në shqipen e sotme letrare*, Studime filologjike 1992/1, 55–66, Tiranë 1992.

Lafe 1998–1999: G. Lafe, *Der italienische Einfluß auf das Albanische. Erster Teil – Allgemeine Erörterungen*, in Ponto-Baltica 8–9, 1998–1999, 47–172, Milano 1999.

Lafe 2000: G. Lafe, *Der italienische Einfluß auf das Albanische. Zweiter Teil – Wörterbuch der Italianismen im Albanischen*, in Ponto-Baltica 10, 2000, 31–120, Milano 2000.

Lafe 2018: G. Lafe, *Nuovi spunti per la definizione degli italianismi nell'albanese*, në "Matteo Mandalà dhe albanologjia sot", Bot. Altimari, Gurga, Sinani, f. 259–272, Tiranë 2018.

Mihăescu 1966: H. Mihăescu, *Les éléments latins de la langue albanaise*, në RESEE IV (1966), f. 5–33, 323–353.

Migliorini 1978: B. Migliorini, Bruno, *Storia della lingua italiana*, Firenze 1978.

Osmani 2009: T. Osmani, *Komisia letrare shqipe në Shkodër (1916–1918)*, Shkodër 2009.

Pellegrini 1992: G.B. Pellegrini, *Ricerche linguistiche balcanico-danubiane*, Roma 1992.

Rohlfs 1966: G. Rohlfs, *Grammatica storica della lingua italiana e dei suoi dialetti*, Vol. I, Fonetica, Torino 1966.

Schmitt 2001: O. Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392–1479)*. München 2001.

Tagliavini 1937: C. Tagliavini, Carlo, *L'albanese di Dalmazia. Contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara*. Firenze 1937.

Vătăşescu 1997: C. Vătăşescu, *Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparaţie cu româna*, Institutul român de tracologie, Biblioteca Thracologica, Bucureşti 1997.

Vicario 1992–1993: F. Vicario, *L'influsso lessicale veneto nell'albanese,* Balkan-Archiv 17/18, 185–232, 1993.

Teuta ABRASHI, Prishtinë

RRETH DISA ÇËSHTJEVE TË DISKUTUESHME TË SINTAGMËS EMËRORE TË SHQIPES

Abstract. This article examines the Albanian noun phrase structure based on the minimalist model of Manzini & Savoia and Guisti. Both models explicate in depth the articles, as central elements of Arbëresh and Albanian noun phrase, however considering substantially and very different way how these articles project into syntax. While the former prefers the projection of lexical categories, excluding functional ones, the latter prefers the opposite, projection of functional categories only. Consequently, the first model assumes the presence of the semantic component at all articles without exclusion, while the second denies its presence at all of them without exception. Furthermore, such a (extreme) approach of one or the other model apparently is reflected in their presentation of syntactic phrase structure, which not occasionally is inconsistent with empirical data and therefore, with the respective Albanian noun phrase structure as well. The aim of this paper is to provide some additional remarks and explanations, which will eventually contribute to the mitigation of this discrepancy.

Kontributi i gjuhëtarëve italianë dhe arbëreshë për gjuhësinë shqipe dhe studimet albanologjike në përgjithësi ka qenë dhe është i konsiderueshëm dhe domethënës. Është botuar një numër i konsiderueshëm i studimeve gjuhësore të gjuhëtarëve italianë, qoftë në formë të artikujve nëpër revista të specializuara shkencore, qoftë të përmbledhura nëpër monografi. Ata analizojnë dukuri të ndryshme të gjuhës së arbëreshëve, por edhe të gjuhës letrare shqipe, duke përdor modelet aktuale gramatikore për të përshkruar këto dukuri të shqipes. Për t'u veçuar janë sidomos punimet e Giuseppina Turanos, të Leonardo Savoia-s, të Rita Manzini-t, të Giuliana Giusti-t etj. Pavarësisht se shumica dërmuese e këtyre punimeve janë të motivuara nga autorët e cekur si pjesë e një projekti, i cili synon hartimin e një modeli universal gramatikor për të gjitha gjuhët, pra jo apostafat për gjuhën shqipe - siç është p. sh. varianti i modifikuar i Programit Minimalist të Manzini-t dhe Savoia-s apo modeli i Giusti-t - këto studime mund të konsiderohen si ndihmesa të veçanta e shumë të vlefshme për gjuhësinë shqiptare. Këta autorë shpesh i marrin shqipen dhe dukuritë e saj si dëshmi empirike. Këtu po e veçoj Turano-n, e cila kështu vepron rregullisht. Falë këtyre punimeve, të cilat, përveç që ndihmojnë për të ndriçuar dukuri gjuhësore të shqipes, hapin njëkohësisht edhe debate të ndryshme, të cilat besoj kanë rol të dyfishtë pozitiv. Nga njëra anë, ato shërbejnë për të paraqitur këto dukuri nga

një pikëpamje e re dhe eventualisht për t'u dhënë një shpjegim më të avancuar. Nga ana tjetër, nëse ka të dhëna shtesë rreth këtyre dukurive, këto të fundit të shërbejnë eventualisht si mbështetëse për modelet e cekura gjuhësore. Në këtë frymë është paramenduar të jetë edhe kjo kumtesë, e cila do të rrahë disa çështje të diskutueshme në rrafshin emëror të shqipes, por edhe të analizojë disa propozime dhe vrojtime të gjuhëtarëve të përmendur. Do ta analizojmë strukturën e sintagmës emërore të shqipes bazuar në modelet minimaliste të Manzini & Savoia dhe Giusti. Lidhur me këtë, në fillim do të analizojmë çështje të përgjithshme rreth strukturës së sintagmës emërore dhe shtjellimin e mëhershëm të saj, përfshirë edhe disa diskutime rreth statusit morfo-sintaksor të disa nyjave të gjuhës shqipe. Në vazhdim do të paraqsim shkurtimisht modelin e ri (nga 2005) të Manzini & Savoia dhe analizimin e propozimeve të tyre, por pa lënë anash edhe diskutimin e propozimeve nga modeli i vjetër i bërë kryesisht nga Turano. Në pjesën e fundit, do të diskutojmë disa nga pikënisjet e modelit të Guisti-t.

Nyja definite dhe sintagma emërore

Po filloj me strukturën sintaksore të sintagmës emërore. Ngjashëm me Taraldsen (1990) për sintagmën emërore të gjuhës suedeze, Dobrovie-Sorin (1987) për sintagmën e gjuhës rumune, vepron dhe Turano (2003:168) për sintagmën emërore të gjuhës shqipe. Ajo supozon se nyja e shquar e shqipes nuk hyn në sintaksë në të njëjtin pozicion me emrin, por nyja hyn në pjesën e sipërme, kurse emri në pjesën e poshtme të drurit sintaksor. Emri i bashkohet nyjës nëpërmjet zhvendosjes, pikërisht aty ku është pozicionuar nyja.

(1)



Kështu në shembullin: *libr-i i mirë*, siç mund të vërehet në diagramin e parë të (1), emri *libër* realizohet në N°, kurse nyja shquese -i në D°. Struktura lineare e sintagmës realizohet kur emri zhvendoset në D°. Motivi i zhvendosjes së emrit në këtë pozitë, sipas Turano-s (2002: 176) bëhet për

shkak të natyrës së nyjës shquese të shqipes [+enclitic]. Kështu mendon edhe Kallulli në disertacionin e saj (1999: 131) dhe në një punim tjetër Kallulli (2005: 49), kur merr në konsideratë strukturën e sintagmës emërore të shqipes. Zhvendosjen si dukuri sintaksore, për të paraqitur strukturën e sintagmës së gjuhës shqipe e supozojnë edhe Koleci e Turano (2011: 66), si dhe Memushaj (2008:174) në librat e tyre për gramatikën gjenerative. Siç vërehet në diagramin e dytë, edhe mbiemri mund të zhvendoset për të marr tiparet semantike e gramatikore të nyjës shquese. Ai emërzohet dhe mund të marrë të gjitha funksionet sintaksore që zakonisht i realizon emri. Këtu po theksojmë se ka mendime të ndryshme rreth mënyrës se si dhe në cilën pozitë zhvendoset emri apo mbiemri. Disa mendojnë se emri zhvendoset si kokë dhe inkorporohet në D°, por disa konsiderojnë se zhvendoset si sintagmë te SPECIFIKATORI pranë nyjës. Sidoqoftë, për këtë diskutim tonin nuk është e rëndësishme se cila mënyrë është korrekte e cila jo. I rëndësishëm është supozimi i autorëve të përmendur se emri dhe nyja hyjnë në sintaksë në pozicione të ndryshme sintaksore dhe bashkëngjitja e tyre bëhet nëpërmjet zhvendosjes së emrit te nyja. Motivimi i kësaj zhvendosjeje sipas tyre bëhet për shkak të tiparit morfo-sintaksor [+enclitic]. Duhet pranuar se një konfiguracion i tillë i paraqitjes dhe i formimit të strukturës së sintagmës është një mënyrë elegante për të shpalosur eventualisht dukuritë sintaksore të sintagmës emërore. Madje, struktura e arritur në këtë mënyrë është shumë e përshtatshme (dhe e dëshirueshme) edhe për faktin se ajo nuk dallon fare nga struktura e sintagmave të gjuhëve në të cilat nyja shquese vendoset para emrit dhe është morfemë e izoluar, siç është rasti në gjuhën angleze (*the*), në gjuhë gjermane (*der*, *die*, *das*) apo në gjuhën italiane (*il*, *la*). Por, të dhënat empirike të gjuhës shqipe flasin diçka tjetër. Për të ilustruar këtë do të paraqesim disa dëshmi. Po fillojmë me dëshminë e parë duke analizuar sintagmën emërore si në vijim:

(2) *Leka i madh.*

Në këtë shembull emri i gjinisë mashkullore, nuk merr nyjë definite të gjinisë mashkullore *-i* apo *-u*, por merr nyjën definite të gjinisë femërore *-a*. Kështu ndodh shpesh me emrat e përvetësuar nga gjuhët e tjera, si p. sh. *axha i madh*, *daja i vogël*, *hoxha i urtë* etj. Se këta emra janë të gjinisë mashkullore vërehet më së miri kur mbiemri që i përcakton këta emra, emërzohet:

(3) *I madh-i Lekë, i vogël-i dajë, i urt-i hoxhë* etj.

Pavarësisht nga forma e nyjës femërore *–a* tek emrat *Lekë*, *dajë* apo *hoxhë*, kur mbiemri i paraprin emrit si në diagramin e dytë, ai merr nyjën

e formës mashkullore *-i*. Për hipotezën e zhvendosjes ky fakt paraqet një vështirësi të pakalueshme, sepse nëse nyja ka hyrë në sintaksë në mënyrë dhe pozicion të pavarur nga emri apo mbiemri, atëherë nuk mund të pritet që ajo ta ndryshojë formën në këtë pozicion varësisht nga fakti se a është zhvendosur emri apo mbiemri, ashtu që kur zhvendoset emri ajo të marrë formën e gjinisë femërore *-a*, kurse kur zhvendoset mbiemri të marrë formën e nyjës mashkullore *-i*. Nyja mund të ketë forma të ndryshme tek emri apo mbiemri vetëm nëse emri apo mbiemri realizohen në të njëjtin pozicion me nyjën gjegjësisht vetëm nëse emri apo mbiemri dalin nga leksikoni mental së bashku me nyjën. E kjo nënkupton se para se të hyjnë në sintaksë, rrafshi morfologjik duhet të bashkojë emrin apo mbiemrin me nyjën në format e tyre përkatëse për të hyrë në sintaksë. Se kështu është tregon edhe dëshmia me mbiemra të bashkërenditur si në vijim:

(4) a. *Vajz-a e mjerë dhe e gjorë.*
b. **E mjer-a dhe e gjorë vajzë.*
c. **E mjerë dhe e gjor-a vajzë.*
d. *E mjer-a dhe e gjor-a vajzë.*

Në shembullin (4a) emri *vajzë*, të cilit i është prapavendosur nyja femërore *–a*, përcaktohet nga dy mbiemra të bashkërenditur *mjerë* dhe *gjorë*. Nëse folësi vendos për t'i spikatur atributet e vajzës, atëherë nyja definite duhet t'u prapavendohet të dy përcaktorëve. Sikur kjo të mos ndodhte në rrafshin morfologjik (në nivel të fjalës), por në rrafshin sintaksor (pra, në nivel të sintagmës), atëherë në dispozicion do të ishte vetëm një nyjë definite. Si të tillë, asaj do t'i bashkëngjitej vetëm njëri nga mbiemrat ose si në (4b) apo si në (4c). Mirëpo, te të dy këto raste shprehja nuk do të ishte gramatikisht korrekte. Ajo është korrekte vetëm nëse të dy mbiemrave u bashkëngjitet nga një nyjë definite si në (4d). Pra, edhe (4) ngjashëm si (3) dëshmon se supozimi i zhvendosjes së emrit apo mbiemrit për të përfituar strukturën e sintagmës emërore të shqipes nuk mund të aplikohet si te gjuhët e tjera. E kjo ndodh, sepse nyja definite e gjuhës shqipes, për dallim nga nyja definite e anglishtes, e gjermanishtes apo italishtes, është një afiks dhe jo klitik. Jo pse ajo është e prapavendosur, por për shkak të natyrës dhe shkallës së gramatikalizimit të saj. Prapavendosja apo tipari [+enclitic] nuk nënkupton *per se* se nyja është afiks, p.sh. nyja e bullgarishtes dhe maqedonishtes, ani pse janë të prapavendosura, nuk janë afiks, por janë klitik.

(5) *a. Čanta-ta xubava i dobra Bullgarisht (Çant-**a** e bukur dhe e mirë)*
*b. Xubava-**ta** i nova čanta (E bukur-**a** dhe e mir-**a** çantë)*

(6) *a. Torba-**ta** ubava i dobra Maqedonisht (Çant-**a** e bukur dhe e mire)*

*b. Dobra-**ta** i ubava torba (E bukur-**a** dhe e mir-**a** çantë)*

Te këto dy gjuhë, nëse mbiemrat aplikojnë për referentin e njëjtë (*čanta* apo *torba*) mjafton që vetëm njëri nga mbiemrat të marrë nyjën definite, e këtë zakonisht e bën mbiemri i parë. Pra kemi një situatë të ngjashme me të gjuhëve angleze, gjermane e italiane:

(7) *a. Shkrimtar-**i** dhe gjuhëtar-**i** (Martin Camaj). Shqip*
*b. **The** writer and linguist (Martin Camaj). Anglisht*
*c. **Der** Schriftsteller und Linguist (Martin Camaj). Gjermanisht*
*d. **Lo** scrittore e linguista (Martin Camaj). Italisht*

Në (7) fjala është për të njëjtin person të quajtur Martin Camaj, pra për të njëjtin referent, i cili njëkohësisht është shkrimtar dhe gjuhëtar. Meqë nyja definite e mundëson referimin e emrit me një entitet jashtë kontekstit gjuhësor (në rastin tonë Martin Camaj), prania e saj tek emri që i referohet këtij entiteti shikuar nga rrafshi semantik (e pragmatik) është e nënkuptueshme. Meqë fjala është për një entitet të vetëm, qoftë ai njëkohësisht shkrimtar e gjuhëtar, semantikisht do të ishte e mjaftueshme prania e vetëm një nyje definite, si në shembujt në gjuhët angleze (7b), gjermane (7c) dhe italiane (7d), mirëpo në gjuhën shqipe (7a) janë të pranishme dy nyja. Kjo ndodh sepse, kur nyja është më e pavarur dhe ka komponentin semantik ende jo aq të zbehur (si në anglishte, gjermanishte e italishte), folësit mund ta shënojnë atë vetëm një herë, ngaqë fusha e veprimit apo skopusi i saj nuk kufizohet vetëm në gjymtyrën e parë. Mirëpo, nëse nyja definite është e integruar me emrin dhe ka komponentin semantik të zbehur (si në shqipe), atëherë fusha e veprimit të saj është e kufizuar dhe nuk mund ta përfshijë edhe gjymtyrën e dytë, prandaj lind nevoja që ajo t'i prapavendoset secilit emër apo mbiemër. Zbehja e komponentit semantik të nyjës definite të gjuhës shqipe është evidente. Prania e saj tek emrat e përveçëm dhe prania e trajtës gramatikore e shquar/jo e shquar te të gjithë emrat pa përjashtim, janë dëshmi të qarta të kësaj zbehje, e cila është pasojë e gramatikalizimit të theksuar të saj. Mirëpo, duhet thënë se gramatikalizimi i saj nuk ka arritur nivelin e gramatikalizimit të nyjës së mbiemrit, e cila është tërësisht e zhveshur nga komponenta semantike (dhe pragmatike) dhe shfaqet vetëm me mbiemrin, pjesë e pandashme e të cilit tashmë ajo është bërë. Në këtë kuptim nyja e mbiemrit paraqet shembull *par excellence* të një afiksi, sepse i plotëson të gjitha (nga gjithsejt gjashtë) kriteret e përpiluara nga Zwicky/Pullum (1983)

për të përcaktuar një element gramatikor si afiks apo klitik. Nyja definite e shqipes i plotëson pesë[1]. Për shkak të selektivitetit të saj relativisht të gjerë, sepse ajo nuk i bashkëngjitet vetëm emrit (si p. sh. nyja e suedishtes), por mbiemrit dhe elementëve të tjerë (si p. sh. përemrit), i ka shtyrë disa gjuhëtarë si Börjas (1998) të pohojnë se nyja e shqipes është klitik e jo afiks. Duhet cekur se çështja a është nyja definite e shqipes afiks apo klitik nuk është thjesht një çështje triviale, siç pretendojnë disa gjuhëtarë, të cilët në mënyrë lakonike thonë se është afiks apo klitik. Sidoqoftë, rreth kësaj çështjeje është interesant qëndrimi i Turano-s, e cila në Turano (2003:168) pohon se nyja definite e shqipes ka tipare klitiku (e jo afiksi), pa marrë parasysh faktin se një vit më herët Turano (2002: 210), në fusnotën 9, e ka parasysh punimin e Dimitrova-Vulchanova & Guisti (1998), të cilat dëshmojnë (ngjashëm si më sipër) se nyja definite e shqipes (dhe rumanishtes) është afiks e jo klitik. Po supozoj, se ky konstatim i saj (e rrjedhimisht) edhe aplikimi i zhvendosjes së emrit te nyja definite, për të shpalosur strukturën e sintagmës emërore të shqipes, janë bërë më shumë (si të themi) për të "kënaqur" modelin e atëhershëm të Manzini-t dhe Savoia-s, se sa i bazuar në të dhënat empirike. Ky model pas vitit 2005 (me të drejtë) ka pësuar një revidim.

Modeli i Manzini & Savoia

Modeli i ri e përjashton zhvendosjen e elementeve dhe kategorive abstrakte (të zbrazëta) në tërësi[2]. Sintaksa apo struktura e fjalisë apo e sintagmës emërore është e organizuar në tri domene (8) të ndryshme interpretuese (Manzini & Savoia 2007: 84-85).

(8)

[1] Lidhur me analizën e këtyre kritereve për nyjën shquese të shqipes shih Abrashi (2012).

[2] Përveç kësaj, modeli i përjashton gjithashtu tiparet e painterpretueshme dhe të pavlerësuara, si dhe verifikimin e tipareve të ashtuquajtura *phi* (Manzini & Savoia 2012:11). Fjala është për një model reprezentacional dhe jo derivacional, i cili nuk bën ndonjë dallim midis elementeve funksionalë dhe leksikorë. Rrjedhimisht, nuk pritet që këto dy lloje elementesh gjatë procesit të derivimit të futen në dy pika të ndryshme derivuese, të parat në strukturën sintaksore, kurse të dytat në strukturën morfologjike sikurse është rasti i modelit të morfologjisë distributive (*Distributed Morphology*). Ky model supozon se struktura në rrafshin morfologjik është tërësisht e unifikuar me sintaksën, duke treguar rend hierarkik identik (Manzini & Savoia 2012: 12). Është pra evidente se varianti i modelit minimalist i Manzini & Savoia bazohet në supozime shumë më të thjeshtuara se variantet e modeleve të tjera minimaliste.



Domeni më i ulët është i lidhur me predikatin e strukturës, pra me kategorinë leksikore V, N apo A, të cilin Manzini & Savoia (2007: 85) e shënojnë simbolikisht me L[3] (njësi leksikore).

(9) [C …[I …[L…

Në L pozicionohen argumentet (e brendshme) të fjalisë (kundrina etj.) ose argumentet përkatëse të sintagmës emërore (R)[4]. Domeni sipër L është domeni I apo domeni i fleksionit, të cilin Savoia (2015: 94) e shënon me F dhe pohon se ky domen: "zë pozicionin kryesor të projektimit të frazës apo të sintagmës emërore dhe elementi leksikor (folje apo emër/ mbiemër) leksikalizon veçoritë funksionale të frazës apo të sintagmës emërore". Ndërkaq domeni i sipërm i strukturës është domeni C, i cili është i lidhur me diskursin, modalitetin elementet ilokutore etj[5]. Në këtë mënyrë modeli u mundëson elementeve leksikorë të futen drejtpërdrejt në pozicionet e drurit sintaksor në të cilat shfaqen[6] ku marrin interpretime të ndryshme. Brenda domeneve insertuese në (9) elementet e futura predikativë (p. sh. folja në fjali dhe emri në sintagmën emërore) projektojnë një varg leksikalizimesh referente të veçorive të tyre funksionale (D, Q, P, Loc, N)[7]. Në

[3] Për të treguar se është një njësi leksikore, e cila mund të jetë një folje (V), emër (N) apo mbiemër (A). Se për cilin lloj është fjala, varet nga konteksti, sepse kjo s'mund të përcaktohet nga baza predikative e njësisë leksikore. P.sh. te sintagma *djali i madh*, *djali* shënon emrin kurse *i madh* shënon njësinë leksikore e cila tregon tiparin e gjymtyrës tjetër të sintagmës, e cila në gramatika zakonisht shënohet si mbiemër. Mirëpo te sintagma *i madhi djalë*, *i madhi* shënon një entitet emri i të cilit është *i madhi*, kurse gjymtyra *djalë* shënon një tipar, e cila mund të quhet mbiemër.

[4] Manzini (2018: 399) supozon se secili emër ngërthen në vete së paku një argument, roli tematik i të cilit shënohet me R. Ky rol tematik mund të realizohet apo (siç thuhet, në logjikë e gjuhësi gjenerative) të ngopet nëpërmjet të pranisë së nyjës shquese.

[5] Savoia (2015:95)

[6] Se cilët elementë, në cilin domen futen, shih Savoia (2015: 94-95)

[7] D-caktuesia, pa-caktuesia (shquarësia, jo-shquarësia), Q-kuantifikimi apo sasia (shumës/ njëjës), P-veta, Loc-tregues deiktik hapësinor gjegjësisht referenti i koordinatave hapësinore (këtu/atje), N-fleksioni i emrit. Deri te ky rend hierarkik, Manzini dhe Savoia vijnë duke analizuar klitikët (e kryefjalës dhe kundrinës) në dialektet italiane, me ç'rast vijnë

këtë mënyrë formohet një strukturë që madje është identike jo vetëm në rrafshin sintaksor (për fjalinë dhe sintagmën), por edhe në rrafshin morfologjik (pra, edhe për fjalën) si në (10) [8]:

(10) [D [Q [P [Loc [N [**C** [D [Q [P [Loc [N[**I** [D [Q [P [Loc [N[**L**

Kështu në (11) vërejmë se nyja e shquar italiane *la* dhe rrënja e emrit *machin-* kombinohen në nivel të sintagmës, kurse nyja definite shqipe (*-i* dhe *–a*) dhe emri *djal-* apo *vajz-* kombinohen në nivel të fjalës.

(11)



Për të treguar se si duket në këtë model dallimi strukturor i sintagmës emërore italiane e shqipe, po përdorim paraqitjen të Qefa (2014: 59), të cilën po e modifikojmë si në (12):

(12) **Niveli i sintagmës** **Niveli i fjalës**

[D R Q P Loc N[**C** [D R Q P Loc N [**I** [D R Q P Loc N [**L**

(1)	la	machin-	a
(2)		djal-	i
(3)		vajz-	a

Siç vërejmë, rrënja apo baza predikative te të dy gjuhët insertohet në I, e cila pastaj kombinohet (në L) në nivel të fjalës në gjuhën italiane me mbaresën e gjinisë *–a*, kurse në gjuhën shqipe me nyjën definite *–i* (mashkullore) apo *–a* (femërore). Mbaresa gjinore gjegjësisht nyja definite insertohen në N. Pra, N duhet kuptuar si një pozicion i cili karakterizon emrin. Ngjashëm siç veprohet me mbaresën e gjinisë në gjuhën italiane, në gjuhën shqipe mund të veprohet me mbaresat e shumësit si në (13):

(13)

---

në përfundim se klitikët si dhe mbaresat e foljes në fakt janë ekuivalentë me një sintagmë emërore, e cila projekton një varg hierarkik të kategorive gramatikore si më sipër.

[8] Sipas Manzini & Savoia (2007:16), kategoritë sintaksore në (10) të propozuara në mënyrë të pavarur nga shumë gjuhëtarë përkojnë me të njëjtat kategori morfologjike, andaj është i natyrshëm përvetësimi i strukturës identike të fjalisë e sintagmës nga njëra anë, me strukturën e fjalës, nga ana tjetër. Shih edhe (Manzini e Savoia 2011:237-238).



Sipas Manzini dhe Savoia një ndarje e tillë e morfemës së nyjës është e mundshme në bazë të të ashtuquajturit detyrim të renditjes universale (Universal Ordering Constraint) sipas të cilit kur janë të pranishme tiparet F1>F2 së pari verifikohet tipari F1 e pastaj tipari F2.

Pra, bazuar në (10), (11) dhe (12) në modelin e ri të Manzini e Savoia kemi një situatë të kundërt në krahasim me modelin e vjetër: konsiderimi i nyjës definite të shqipes si afiks (e jo klitik) është një konsiderim i mirëseardhur. Për shkak se gjuha shqipe ka edhe nyjën e përparme, te disa fjalë të ligjëratës (mbiemri, pronori etj.), në vazhdim po analizojmë se si është trajtuar ajo te Turano, Manzini e Savoia.

Nyja e përparme dhe sintagma emërore

Sipas Manzini & Savoia (2012: 246), por edhe Savoia (2015: 104), analizimi i sintagmave emërore me emrat e farefisnisë që dalin me nyjën e përparme, paraqesin një pikënisje shumë të rëndësishme të analizës së sintagmës emërore të shqipes, sepse ato paraqesin një strukturë më të ndërlikuar, në të cilën janë të pranishme të dy nyjat. Meqë këta emra janë të ndërlidhur me pronorin, atëherë në vijim po analizojmë disa veçori të vetës së pronorit dhe disa veçori morfo-sintaksore të pronorit në gjuhën shqipe. Po fillojmë me vetën.

Një tjetër tipar i emrit që lidhet me strukturën e sintagmës emërore është veta. Në strukturën e shpaluar të kësaj sintagme nga Turano dhe Manzini e Savoia (në modelin e vjetër dhe të ri), tipari i vetës leksikalizohet duke realizuar kështu një pozicion të veçantë në këtë strukturë, të shënuar si [P]. Tradicionalisht veta konsiderohet tipar semantik, pra i brendshëm i emrit, që buron drejtpërdrejt nga sistemi ynë kognitiv. Veta e parë shënon folësin, e dyta dëgjuesin, kurse e treta shënon të gjithë individët e tjerë, të cilët nuk janë interlokutorë. Në këtë kuptim emri (si jointerlokutor) zakonisht shënon vetën e tretë. Mirëpo, emri mund të shënojë edhe vetën e dytë siç është rasti me shprehjet vokative (dhe kuazi-vokative) të përcjella edhe me një formë e strukturë përkatëse në rrafshin fonetik9. Te struktura hierarkike në (10), [P është e rezervuar për vetën e parë dhe të dytë të pronorit, ngase forma e tij në gjuhën shqipe në

[9] Lidhur me tiparin e vetën shiko më gjërësisht në Abrashi (2014) dhe Abrashi (2017).

vetën e parë dhe të dytë, nga njëra anë, dallon nga forma e vetës së tretë, nga ana tjetër, qoftë në njëjës apo në shumës. Veta e tretë e pronorit sikurse veta e emrit, sipas Manzini & Savoia (2007:16 përkatësisht 30), shënohen në kategorinë [N, e cila e karakterizon njësinë leksikore emër10. Një ndarje e tillë e formave ndërmjet vetës së parë dhe të dytë, nga njëra anë, dhe vetës së tretë, nga ana tjetër, siç duket ka tendenca universale, ngaqë një dallim i tillë ekziston edhe ndërmjet klitikëve të vetës së parë e të dytë, nga njëra anë, dhe klitikëve të vetës së tretë në dialektet italiane.

Sidoqoftë, janë edhe së paku dy çështje të ndërlidhura ndërmjet tiparit të vetës dhe pronorit, të cilat kërkojnë një analizë dhe shpjegim shtesë. E para është çështja e kuptimit të tiparit të vetës te pronori. Pronori nuk shënon një individ por një relacion ndërmjet pronës dhe pronarit. Në këtë kuptim, edhe ai ka indeks, por ky indeks është vetëm një tregues se kujt i takon një send apo një entitet. Pra, indeksi nuk është referencial sikurse te vetori, por është një indeks relacional, sepse pronori për dallim nga vetori, nëse nuk emërzohet, nuk është i vetëmjaftueshëm. Rrjedhimisht tipari i vetës së vetorit dhe emrit, në njërën anë, nuk është identik me tiparin e vetës së pronorit, në anën tjetër. Le të analizojmë sintagmën në vijim për të ilustruar këtë situatë:

(14) *Libri im.*

Siç thamë, emri *libër* ka vetën e tretë, kurse përemri pronor *im* ka vetën e parë. Atëherë shtrohet pyetja: cila është veta e sintagmës emërore? Përgjigjja është veta e tretë, pra veta e emrit. Këtë mund ta shohim te folja në (12):

(15) *a. Libri im u lexua shumë. (Ai u lexua shumë.)*
*b. *Libri im lexova shumë. (*Unë lexova shumë)*

Por kjo nuk ndodh për shkak se veta e emrit dominon ndaj vetës së pronorit, por për arsye se veta e emrit shënon një individ kurse veta e pronorit shënon një relacion përkatësie, i cili lidhet pikërisht me emrin libër. Thënë ndryshe, tipari i vetës së emrit dhe tipari i vetës së pronorit janë të pozicionuar në rrafshe të ndryshme11, andaj edhe nuk ka situata të cilat mund të jenë "konfliktuoze".

E dyta (e cila rrjedh nga e para), për pronorin nuk mund të themi se është i caktuar (definite) apo i pacaktuar (indefinite) në kuptimin semantik, siç mund të thuhet p. sh. për një emër të përgjithshëm. Funksioni i pronorit është të jetë

[10] Manzini & Savoia nuk e përmendin faktin se emri mund të shënon edhe vetën e dytë.

[11] Janë ortogonale, nuk interferojnë në njëra tjetrën, gjegjësisht nuk kanë influencë ndaj njëra tjetrës, prandaj nuk ka nevojë të përshtaten.

treguesi i pronarit të një sendi apo entiteti, e jo shënimi i entitetit. Në këtë kuptim, prania apo mos prania e nyjës së përparme te pronori, siç ndodh rregullisht në gjuhën letrare, nuk mund të jetë për shkaqe semantike. Prania e nyjës së parme te pronori, p. sh. i vetës së tretë njëjës, nuk është, siç pretendojnë Turano (2003:188)[12] dhe Manzini e Savoia (2011:329)[13], për shkak se në këto veta pronori semantikisht është më i pacaktuar dhe kërkon nyjën e parme për t'u bërë më i caktuar, apo që pronorët p. sh. të vetës së parë dhe të dytë njëjës semantikisht janë më të caktuar, ngase tek emrat e farefisnisë këta pronorë mund t'i dalin emrit përpara, kurse ata të vetës së tretë jo. Rënia e nyjës së parme te këta pronorë supozohet se është bërë, siç pohon Topalli (1995: 362-363), për shkaqe fonetike. Renditja e tri zanoreve të njëjta njëra pas tjetrës në vetën e parë si në shembullin *libri i im* dhe renditja e tri zanoreve në veten e dytë (*libri i yt*) do të shkaktonte kakofoni në rasën emërore. Sipas Topallit, analogjia e emërores shkaktoi rënien e nyjës së parme te këta pronorë edhe në rasa të tjera, anipse rrethanat kakofonike nuk ishin të pranishme. Se kështu mund të jetë tregon edhe fakti se në zonat e veriut, ku ritmi i të folurit është më i ngadalshëm dhe rrethanat kakofonike nuk janë të theksuara, sipas Demiraj (1986: 499) pronorët e vetës së parë shfaqen rregullisht me nyja të përparme (*i em* / *i im, e eme/ e ime, i yne* / *e jone, i yt* / *e* jote~ *i (e)juaj*.). Kështu ndodh edhe në Kosovë, madje nyjat e parme folësit i përdorin edhe kur pronori emërzohet, p.sh. në vend se të thuhet *Vetura ime është e re. Kurse* ***jotja*** *e vjetër* në Kosovë thuhet *Vetura ime është e re. Kurse* ***e jotja*** *e vjetër*.[14]

Duke marrë parasysh se çka u tha për tiparin e vetës së pronorit mund të

[12] Why third person possessives … and first and second plural possessives … require the article, whereas first and second person singular … do not allow it? I would suggest that the obligatory presence of the possessive article in D is due to the indefiniteness of the possessive forms displaying the article itself. That is, the first and second possessive elements, which are characterised by the Person feature and which appear without article, are definite elements, whereas Q possessives only are inflectional elements which lack the Definiteness feature. This feature must be therefore lexicalised by a D° element in the possessive string. Then, 3 person possessives and 1 and 2 plural possessives lexicalise D through the insertion of the article. The idea that P possessives are definite elements is supported by the fact that in structures containing kinship nouns, P possessives can lexicalise the position D°, whereas Q possessives never do that.

[13] We may suggest that 1st and 2nd person possessives in Albanian are sufficient to lexicalize definiteness properties for the inflectional domain of the noun phrase otherwise lexicalized by the definite inflection– therefore excluding the latter.

[14] Deri te ky përfundim autorja e këtij punimi ka ardhur duke bërë testimin e një numri të folësve të kualifikuar (duke përfshirë edhe kolegët e fakultetit) në Universitetin e Prishtinës.

themi se prania e nyjës së parme te pronori në rrafshin sinkronik bëhet për nevoja gramatikore: për të lidhë pronorin me emrin përkatës. Kjo tezë mund të gjen mbështetje edhe te një veti tjetër e pronorit, e cila ishte dashur të kihet parasysh: kërkesa për një referencë të qartë të pronës. Kjo do të thotë se ai gjithnjë duhet të jetë pranë emrit që shënon pronën si p. sh. *djali im i madh*. Nëse ndërmjet emrit dhe pronorit futet mbiemri atëherë ai rregullisht emërzohet: *djali i madh* ***imi***. Emërzimi i pronorit bëhet edhe kur emri paraqitet në trajtën e pashquar: *një njeri* ***të tyrin***. Mirëpo, në rrafshin diakronik, siç duket, nyja e parme e pronorit ka luajtur rol edhe në rrafshin semantik. Dëshmi për këtë mund të jetë edhe fakti se kuptimi (i pronësisë) së saj është ende i pranishëm te disa ndërtime emërore. Kështu p. sh. sipas Gramatikës së Akademisë I (1995:124) te një numër i caktuar emrash që tregojnë lidhje farefisnore, nyjat *i, e, të* që u paravendohen këtyre emrave, përdoren paralelisht dhe kanë kuptim të ngjashëm me pronorët e paravendosur për dy vetat e para, por kërkojnë që emri pas tyre të vihet patjetër në trajtën e shquar, p.sh.: *i biri, e mbesa, të vëllezërit, të motrat* etj. (kr. me *im bir, jot mbesë* etj. të vetave të para). Në këto raste ata kanë kuptimin e pronorit për vetën e tretë (*biri i tij, mbesa e tij, vëllezërit e tij, motrat e saj* etj.). Sipas Manzini & Savoia (2012: 248) kombinimi i rrënjës leksikore (√) me fleksionin (N=*t*) dhe nyjën e përparme (D=*të*) rezulton me strukturën si në vijim:

(16)



tek e cila takohen nyja e përparme *të* dhe nyja definite –*t*. Manzini & Savoia (2012:271) dhe Savoia (2015:111) supozojnë se ndërmjet nyjës së parme (farefisnore) dhe rrënjës leksikore, në [Q mund të futet edhe një element sasior i numërueshëm (*katër*), si në vijim:

(17)



Në këtë mënyrë (sipas tyre) fitohet një strukturë e ngjashme me

strukturën e sintagmës emërore italiane, me ç ‘rast nyja e parme në D (*të*) në strukturë futet në domenin më të lartë C. Nga ana tjetër, mbiemri me nyjën e parme, ka gjithashtu një strukturë të ngjashme si nyja italiane (Manzini & Savoia 2012: 268) dhe Savoia (2015:128):

(18)



Sepse (Manzini & Savoia (2012:270)) elementet sasiore (kuantifikuese) *më* apo *shumë* dhe nyja e përparme e mbiemrit nuk e përjashtojnë praninë e njëra tjetrës, ata i paraprijnë nyjës së parme si në (19)

(19)*Është më/shumë i madh/e madhe.*

Mirëpo (sipas autorëve) elementet e mësipërme sasiore e përjashtojnë praninë e nyjës së parme te emrat e farefisnisë:

(20)*a. shumë motrave*
b. shumë i motrave*
c. të katër motrave

Rrjedhimisht, duke krahasuar (19) dhe (20a), mund të konkludohet se nyja e përparme e mbiemrit ka strukturë të njëjtë me nyjën italiane, por në pozicionin D futet në domenin më të ulët I:

(21)



Në (22) po paraqesim se si janë të vendosura nyjat e parme dhe nyja definite në sintagmën emërore të shqipes, krahasuar me nyjën definite të italishtes.

(22) **Niveli i sintagmës** **Niveli i fjalës**

[D R Q P Loc N[**C** [D R Q P Loc N [**I** [D R Q P Loc N [**L**

a.	la			machin-	a
b.				djal-	i
c.				vajz-	a
d.			e	vogl-	a
e.	i			bir-	i
f.	e			motr-	a
g.	të			motra-	t
h.	të	katër		motra-	t

Mirëpo, janë së paku tri çështje kërkojnë diskutim shtesë të analizës së mësipërme. E para, siç u tha edhe më herët, pronori është i lidhur shumë ngushtë me emrin dhe ai domosdo qëndron pranë tij. Kështu nuk është vetëm në rastin e përdorimit të pamarkuar të tij si p.sh. *djali im i madh/djali i madh imi*, siç u shpjegua më sipër, kjo vlen edhe në rastin e përdorimit të nyjës së përparme tek emrat e farefisnisë. Ndërmjet saj dhe emrit nuk mund të futet ndonjë element tjetër si p.sh.

(23) *a. të motrat*

b. të katër motrat

Përderisa në (23a) nyja e përparme ka kuptimin e pronorit të vetës së tretë *motrat e tij/e saj*, në (23b) nyja e përparme ka kuptimin e totalitetit, e cila ka funksionin e përfshirjes së të gjitha entiteve të numëruara (në rastin tonë katër motrave) në një ngjarje apo veprim të caktuar. Pavarësisht se kuptimi i kësaj nyje, siç pohon Agani (1975:8), është zbehur dhe asaj jo rrallë i shtohet pjesëza *që* për ta bërë kuptimin e totalitetit më të qëndrueshëm, kuptimi i saj për totalitetin në (23b) edhe pa këtë pjesëz është evident. Thënë ndryshe, në drurin sintaksor në (17) (të Manzini-t dhe Savoia-s) nuk është më e pranishme nyja e përparme *të* e emrave të farefisnisë, por nyja e përparme *të* e numërorit. Rrjedhimisht, nyja e emrave të farefisnisë nuk mund të futet në strukturë në domenin e sipërm C, por në domenin më të ulët I.

E dyta, për Manzini & Savoia (2012: 237) dhe Savoia (2015:123) fakti që nyja e përparme e mbiemrit është e pranishme edhe te lidhja me foljen këpujore:

(24)*Është e madhe*

dëshmon (sipas tyre) se nyja e mbiemrit nuk është pjesë e sintagmës emërore, por e sintagmës së mbiemrit, ndërtimi struktural i së cilës është dhënë si në vijim:

(25)



Kjo strukturë sipas Manzini & Savoia (2012: 269) dhe Savoia (2015: 128) është e ngjashme me strukturën e sintagmës italiane (*la machin-a*). Këtë tezë ata e konfirmojnë edhe në një punim të mëvonshëm (Franco & Manzini & Savoia (2015:281)), me ç'rast, duke u bazuar në autorë si Tomić (2006) dhe Campos (2008: 1009), nyjën e mbiemrit e konsiderojnë si klitik. Në këtë frymë ata[15] supozojnë se nyja e mbiemrit kontribuon edhe në operacionet semantike brenda sintagmës emërore[16]. Duke u bazuar te Higginbotham (1985), sintagma emërore *vajza e madhe*, sipas tyre, ka strukturë sintaksore e semantike si vijon:

(26) a. [[[Vajz-][-a]] [[e] [[madh][e]]]struktura sintaksore

b. [Vajz$_{\lambda y}$][a$_{\lambda y}$] ∩ [e$_{\lambda x}$] [madhe$_{\lambda x}$]struktura semantike

Shenja λy dhe λx shënojnë argumentet e detyrueshëm të emrit[17] dhe mbiemrit, kurse shenja "∩" simbolizon interseksionin apo prerjen (edhe *vajzë* edhe *e madhe* = *vajzë e madhe*). Sipas Manzini (2018: 400), emri dhe mbiemri kanë nga një argument të vetëm. Në këtë rast nyja e mbiemrit e$_{\lambda x}$ "siguron kënaqjen e argumentit të predikatit" (*e* provides a satisfaction of the argument slot of the predicate), ngjashëm sikurse nyja definite a$_{\lambda y}$ që kënaq rolin-R të emrit. Thënë ndryshe, nyja e mbiemrit në gjuhën shqipe (sipas tyre) kontribuon në rrafshin semantik ngjashëm sikurse nyja definite. Besoj se për shumë arsye një konstatim i tillë nuk qëndron. Pikësëpari, jo të gjithë mbiemrat në gjuhën shqipe janë të ndërtuar me nyja të përparme, andaj nuk është e qartë se si këta mbiemra hyjnë në relacion atributiv me ndonjë emër (si p. sh. *vajza besnike*) nëse realizimi i intersektimit me emrin bëhet nëpërmjet nyjës së përparme. Gjithashtu (siç u theksua edhe më herët) nyja e mbiemrit, në bazë të kritereve tashmë të dëshmuara, nuk mund të jetë klitik, por vetëm afiks. Se kjo nyjë është pjesë morfologjike (e jo sintaksore) e mbiemrit dëshmon edhe fakti se shfaqja e

[15] Shih Manzini (2018: 400), Manzin & Savoia (2012: 268-269), Franco & Manzini & Savoia (2015:310-312).

[16] In the body of this article we aim to show that linkers like the Iranian ezafe and Albanian pre-adjectival/genitival articles are endowed with interpretive properties (Franco & Manzini & Savoia 2015: 282).

[17] Roli-R I emrit, siç u shpjegua më herët.

kësaj nyje është e kushtëzuar në baza leksikore[18]. Nga ana tjetër, gramatikalizimi i kësaj nyje ka arritur stadin e fundit sipas kritereve të Greenberg (1978), andaj edhe zhveshja komplete nga komponenta semantike është e nënkuptueshme. Pra, të gjitha këto fakte flasin se kemi të bëjmë me një strukturë morfologjike gjegjësisht fjalëformuese, tek e cila nyja e mbiemrit është një prefix. Rrjedhimisht, ndërtimi i mbiemrit do të duhej të ishte në nivel të fjalës, ngjashëm si veprojnë Manzini dhe Savoia me nyjën definite për të cilën pohojnë se është një sufiks. Përndryshe, s'përputhja me parimin e gramatikalizimit do të ishte evidente. Andaj, supozimi se nyja e përparme futet në strukturë në domenin më të ulët se nyja definite italiane në domenin I do të duhej të rikonsiderohej ose ai mund të jetë i pranueshëm nëse do të ishte e mundshme që futja të bëhet në nivel të fjalës, e jo në nivel të sintagmës.

E treta ka të bëjë me nyjën e gjinores, e cila, sipas Manzini (2018: 401), është (sikurse nyja e mbiemrit) një klitik. Një supozim i tillë për nyjën e gjinores mund të jetë i pranueshëm nëse kihet parasysh fakti se kur dy përcaktorë në gjinore bashkërenditen atëherë nyja e përparme e gjinores shfaqet vetëm një herë si në shembullin në vijim:

(27) Zhurma **e** *kazmave* dhe *lopatave*

Pra, kemi një situatë të ngjashme me të nyjës definite në gjuhët angleze, gjermane dhe italiane, por edhe te nyja definite e gjuhëve bullgare dhe maqedonase, për të cilat konstatuam se këto nyja janë klitikë. Një supozim i tillë mbështetet edhe me faktin se, përderisa futja e ndonjë elementi leksikor ndërmjet mbiemrit dhe nyjës së përparme të tij është e pamundshme, futja e elementeve leksikore ndërmjet nyjës së gjinores dhe përcaktuesit (pra ngjashëm me futjen e një elementi leksikor ndërmjet nyjës definite dhe emrit në anglishte, gjermanishte e italishte) mund të bëhet rregullisht:

(28) Krahaso: Lotët **e nënës** së mjerë / Lotët **e** *të mjerës* **nënë**

Të gjitha këto fakte tregojnë se sintagma në gjinore dhe sintagma me mbiemër nuk mund të kenë strukturë identike, siç pretendon Manzini. Gjithashtu, për shkak se lejohet ndërkallja e elementeve të tjera leksikore ndërmjet nyjës dhe përcaktorit, futja e nyjës së gjinores duhet medoemos të bëhet në një pozicion më të lartë se nyja e mbiemrit, ndoshta duke i vendosur ato në domene të ndryshme. Mirëpo, vendosja në domene të ndryshme mund të paraqesë një problem të pakalueshëm sepse Franco & Manzini & Savoia (2015: 321) supo-

[18] Shih lidhur me këtë Buchholz/Fiedler (1987:316) dhe Himmelmann (1997: 169).

zojnë se funksioni i nyjës së gjinores në rrafshin semantik është identik me funksionin e nyjës së mbiemrit, pra të kënaqë argumentin e domosdoshëm të përcaktorit në gjinore. Nëse kësaj i shtohet edhe supozimi tjetër i tyre (f. 301) se nyja definite dhe nyja e përparme (e mbiemrit, gjinores dhe e farefisnisë) jo vetëm që kanë formë të njëjtë fonetike (PF), por kanë edhe përmbajtje të njëjtë, interpretimi i së cilës varet nga domeni në të cilin janë futur, atëherë futja e tyre në domene të ndryshme do të nënkuptonte edhe interpretime të ndryshme të tyre.

Nga sa u tha deri tash besoj se është e qartë që nyjat e shqipes: (i) mund të kenë formë fonetike të njëjtë dhe (përveç nyjës definite) Manzini e Savoia supozojnë që të gjitha duhet të futen në D të ndonjë domeni të drurit sintaksor, përfshirë edhe nyjën jodefinite *një*, por u pa se ato: (ii) nuk kanë status të njëjtë morfo-sintaksor: nyja e gjinores është klitik, kurse nyja e mbiemrit, nyja definite, e farefisnisë, e numërorit janë afikse, (iii) kryejnë funksione të ndryshme gramatikore (p. sh. nyja e gjinores dhe mbiemrit mund të klasifikohen si nyja tipike lidhëse (linkers) etj,) (iv) nuk kanë interpretim të njëjtë kuptimor: nyja e mbiemrit nuk shënon fare ndonjë kuptim, nyja definite shënon kuptimin e caktuesisë, nyja e gjinores dhe farefisnisë mund të thuhet (kushtimisht se që të dyja) shënojnë kuptimin e posesivitetit dhe nyja e numërorit shënon kuptimin e totalitetit. Sipas mendimit tim, trajtimi i nyjave, por edhe pronorëve në këtë model, do të duhej t'i nënshtrohej një qasjeje tjetër modifikuese. P.sh. është premtues konstatimi i Manzini e Savoia (2012: 251) se duke përdorur të ashtuquajturin *inkluzion zonal* (angl. *zonal inclusion*) të gjitha relacionet e posesivitetit do të mund të përmblidheshin në vetëm një, ku do të mund të përfshiheshin pronori, nyja e farefisnisë dhe nyja e gjinores. Duke pasur parasysh se sipas Franco & Manzini & Savoia (2015: 321) bartëse e raporteve relacionale brenda strukturës është kategoria Q (bazuar në *Generalized quantifier theory*), atëherë pronori dhe nyjat e përmendura mund të futen në strukturë nëpërmjet Q-së e jo D-së. Në këtë mënyrë gjithashtu do të ishte rrafshuar kategorizimi i pronorëve: në pronorë P dhe pronorë Q nga ana e Turanos (2002:186-188) në vetëm në pronorë Q, sepse u pa se rënia e nyjës së përparme te disa veta të pronorit është bërë më shumë për çështje gramatiko-fonetike se sa për çështje semantike. Mirëpo, në të dy rastet, të "dy llojet" e pronorëve shprehin po të njëjtin relacion.

Modeli i Giuisti-t

Përderisa modeli i Manzini dhe Savoia konsideron se të gjitha nyjat e shqipes kanë edhe komponentën semantike, disa më të theksuar e disa më të zbehur, Giusti (2012) dhe Giusti (2015), nga ana tjetër, konsideron

se nyjat e kanë të zhveshur komplet komponentin semantik dhe se tipari semantik caktues fare nuk ka të bëjë me nyjën definite. Sipas saj, nyjat janë të pranishme sepse kryejnë (vetëm) funksione të ndryshme gramatikore. Ajo supozon, duke u mbështetur në Cambell (1996), se tiparin semantik caktues tek emri (apo ndonjë gjymtyrë tjetër, si p. sh. mbiemri) e merr nga një operator i pozicionuar në specifikatorin e sintagmës determinuese:

(29)



Si dëshmi, ajo përmend disa konstruksione me nyjën definite, të cilat (mund të) shpien te përfundimi se nyja është kryekëput e pranishme për shkaqe gramatikore e jo për shkaqe semantike. Kështu ajo liston praninë e nyjës te: (i) shprehjet gjeneralizuese, (ii) emrat e përveçëm, (iii) shprehjet dëftor + emër + nyjë definite, por edhe (iv) daljen e emrit në funksione sintaksore pa praninë e ndonjë determinatori.

Nuk ka dyshim se nyja definite (dhe jo definite) në gjuhën shqipe i është nënshtruar procesit të gramatikalizimit dhe gjatë këtij procesi komponenta e saj semantike është zbehur, por njëkohësisht nga folësit (e lexuesit) është përvetësuar për të kryer edhe funksione të ndryshme gramatikore brenda sintagmës emërore dhe fjalisë, kështu që shpesh shfaqen paqartësi rreth arsyes së (mos)-pranisë së saj. Prania e saj (për shkak të dukurisë së analogjisë) tek emrat e përveçëm dhe prania e trajtës së shquar dhe të pashquar (pa përjashtim) te të gjithë emrat, padyshim janë dëshmi se nyja definite e shqipes ka arritur një stad të maturuar, por jo përfundimtar, të gramatikalizimit. Në vijim po i diskutojmë disa nga dukuritë e listuar nga Giusti, për t'u dhënë atyre (eventualisht) një shpjegim shtesë duke shpresuar se do të arrihet të pasqyrohet një situatë e cila nuk lë hapësirë për ekskluzivitet qoftë të njërit apo tjetrit rrafsh gjuhësor, pra as rrafshit sintaksor e as rrafshit semantik.

Shprehjet gjeneralizuese

Shprehjet gjeneralizuese janë shprehje të cilat kërkojnë nga të gjithë përbërësit e saj të plotësojnë disa kushte strikte, me ç'rast folësi do të jetë në gjendje të shpreh një mendim përgjithësues. Kështu p. sh. për të qenë në shembullin në vijim:

(30)Mac-ja mjaullin, apo Qen-i leh.

shprehje gjeneralizuese, kërkohet që emrat *mace* dhe *qen* të jenë të pajisura me nyjën definite dhe që folja *mjaullin* dhe *leh* të jenë në kohën e tashme. Nëse nyjën definite e zëvendësojmë me nyjën jodefinite *një*:

(31)Një mace mjaullin, apo Një qen leh

Shprehjet gramatikisht janë korrekte, mirëpo ato nuk tregojnë përfaqësuesin e një klase që *mjaullin* apo që *leh*, por një individ që i takon kësaj klase. Mirëpo, edhe kur përdoret nyja jodefinite shprehjet mund të jenë gjeneralizuese, por (kuptohet) në një kontekst tjetër gjuhësor:

(32)a. Macj-**a**/ **Një** mace mjaullin kur ajo kërkon diçka.

b. Qen-**i**/ **Një** qen leh kur është i shqetësuar

Mirëpo, shprehjet në (32) nuk kanë një interpretim gjeneralizues ngase trajta e shquar (dhe e pashquar), siç thuhet në Gramatikën e Akademisë (1995: 126), kanë një kuptim përgjithësues. Në këto shprehje kontribuon edhe folja, e sidomos me tiparin e saj temporal. Kështu p. sh. nëse në shembujt e mësipërm folja vendoset në kohën e pakryer:

(33)*a.* Mac-ja mjaullinte apo Qeni lehte

b. Macja/ Një mace mjaullinte kur ajo kërkonte diçka

c. Qeni/ një qen lehte kur ishte i shqetësuar

atëherë shprehjet gjeneralizuese shndërrohen në shprehje individualizuese. Pra, vërejmë se sapo kushtet "gjeneralizuese" të kthehen në kushte "normale", atëherë edhe nyjat definite dhe jodefinite kontribuojnë në inetrpretimet e tyre të zakonshme, individualizuese përkatësisht specifike.

Konstruksionet Dëftor + Emër i shquar

Lidhur me këtë konstruksion deri më tani kemi dy mendime:

(i)I Agallliut (1975) dhe Rrotës, sipas të cilëve dëftori në këtë konstruksion ka funksion anaforik, ngase komponenti deiktik i tij është i dobësuar, dhe

(ii)I Turanos dhe Rrokajt (2000), sipas të cilëve përdorimi i dëftorit është tipik për fjalitë topik-koment si p. sh.

(34) Ish kon ni burr e e kish pas ni çik. Gruja i kish pas dek e **ky burri**, *ish kon pas martu*.

me ç'rast *ky burri* është Topic, kurse *ish kon pas martu* është Koment. Besoj se këto dy mendime (i dhe ii), do të mund të shkrihen në një, ngase, siç thotë edhe Kallulli (1999:49), anaforiciteti është domeni i topikut. Por, këtu duhet theksuar se, nëse dëftori është në funksion anaforik (apo të Topikut) ai është i patheksuar.

Pra duhet marrë parasysh edhe formën fonetike të tij. Prandaj, analizimi i këtij konstruksioni do të duhej të bëhej ndaras për gjuhën e folur dhe atë të shkruar. Sidomos kjo është e rëndësishme nëse përdorimi i dëftorit nga folësi nuk bëhet në funksion anaforik, por në funksion të spikatjes, me ç'rast dëftori ose është në zonën fokale (pra në fokus) ose është në raport kontrasti me emrin e shquar.

Mirëpo, siç duket, dëftori mund të ketë edhe funksione dhe interpretime shtesë, të cilat mund të hasen në gjuhën e shkruar:

(I) Dëftori ka funksion të riaktivizojë referentin e diskursit. Këtu po marr shembullin nga *Gjakftohësia*[19] e Kadaresë: *Si shumë po vonohet* ***ky përkthyesi***, (f. 111).... me ç'rast *përkthyesi* është përmendur në tekst më herët (f. 110). Thënë ndryshe, ai ka qenë i pranishëm në diskurs, por nuk ka qenë aktiv. Duke përdorur dëftorin, autori dëshiron të jetë i sigurt se lexuesit ia ka riaktivizuar referentin e futur më herët në diskurs, pa lënë dilema se fjala është eventualisht për një referent të ri.

(II) Dëftori mund të ketë edhe interpretim mbiemëror. Sipas Lyons (1977:646) dëftori ka dy komponentë: deiktik dhe mbiemëror. Prandaj, prania e dëftorit bashkë me emrin e shquar mund të konsiderohet edhe si një lloj modifikimi (atribuimi) i emrit të shquar. Për të ilustruar këtë po marr gjithashtu një pasazh nga Gjakftohësia (f. 411): *Natën, në mes të fushës, në një stacion të humbur e të ftohtë, në tabelën e orarit të të cilit ka dy gabime ortografike, po rri e po pres një tren, që s' dihet a do të vijë, ose, më mire, që dihet se s'do të vijë. Marrëzi, vazhdonte të grindej me vete bashkëpunëtori shkencor. Aventurë e marrëzishme. Ah,* ***ky pasioni*** *për shkencën do të ma hajë kokën ndonjë dite, ose, që të jem më i saktë, ndonjë natë.*

Në këtë rast dëftori ***ky*** i referohet *aventurës së marrëzishme*, të cilën autori e përshkruan gjegjësisht e përkufizon në mënyrë ilustrative në tekstin paraprijës. Në këtë rast mund të thuhet se dëftori ***ky*** shoqërohet me mbiemrin *lloj* dhe si ekuivalencë mund të jetë fjalia në vijim: ***ky (lloj)*** *pasioni për shkencën...*

(III)Interpretim deiktik: *po ky plaku pse rri sikur i janë mbytur gjemitë*? (Gjakftohësia fq. 393). Me ç'rast dëftori ka tipar [+ Proximal]. Bëhet fjalë për një plak të ulur afër. Ky plaku këtu e jo ai plaku atje.

(IV)Interpretim ndajshtimor: Për këtë lloj interpretimi sugjeron edhe Lyons (1977: 652-653)[20]. Siç duket një interpretim i tillë është edhe në gjuhën

[19] Kadare, Ismail (1980): *Gjakftohësia-Novela*, Shtëpia botuese Naim Frashëri, Tiranë

[20] Although the demonstratives 'this' and 'that' are traditionally regarded as adjectival modifiers of a head noun in such phrases as 'this boy' and 'that boy', one might equally well think of them, from a semantic point of view, as pronouns combined with an appositional noun or nominal (f. 652). …we can interpret 'this boy': (i) as

shqipe ngase konstruksioni Dëftor + Emër i shquar ka strukturë ekzakt siç kërkohet në rast se ndajshtimi i ngjitet një përemri. Shembullin po e marr përsëri nga te Gjakftohësia dhe Novelat e Kadares (fq. 211): *O, po atëherë qenka tamam punë kufijsh, gjersa paska ardhur **ky gjeometri**, siç i thua ti.*

Besoj se te përdorimet e mësipërm të konstruksionit Dëftor+Emër i shquar është e qartë se fjala nuk është për një hiperkarakterizim ose një përdorim redudant në rrafshin semantik (siç pohon Giuisti) të dëftorit apo nyjës së shquar. Mbase kështu fitohet përshtypja nëse shikohet nga niveli i fjalisë pa e marr parasysh edhe kontekstin. Përveç kësaj duhet pas parasysh se nyja e shquar merr pjesë aktive edhe në paraqitjen e perspektivës së narratorit[21]. Këtë po e ilustrojmë me një fragment të shkruar në ballë të Gjakftohëisë (f. 6):

> *Silva e kaloi me shpejtësi shesh**in** e ministrive, megjithatë, kur mbërriti te hyr-**ja** e ministrisë së saj, ishte pak vonë. Pa e ngadalësuar ecjen, përshëndeti nëpunës-**in** e shërbimit, fytyra e të cilit mezi dallohej pas xham-**ët** të portinerisë dhe ashtu, gjysmë me vrap, nisi të ngjiste shkall-**ët**.*
>
> *Në korridor-**in** e katit të dytë desh u përplas me të njohur-**in** e saj të dikurshëm Viktor Hilën, të cilin s'e kishte takuar prej kohësh.*

Përderisa në tekstin e mësipërm fjala është për një shesh dhe hyrje të vetme të ministrisë, për një nëpunës (pas xhamit të vetëm të portinerisë) dhe shkallë e korridor të vetëm të katit të dytë, ku Silva desh u përplas me të njohurin e saj të dikurshëm, në tekstin në vijim, pas zëvendësimit të nyjës definite me nyjën jo definite, situata ndërron.

> *Silva e kaloi me shpejtësi **një** shesh e ministrive, megjithatë, kur mbërriti te **një** hyrje e ministrisë së saj, ishte pak vonë. Pa e ngadalësuar ecjen, përshëndeti **një** nëpunës e shërbimit, fytyra e të cilit mezi dallohej pas **një** xhamï të portinerisë dhe ashtu, gjysmë me vrap, nisi të ngjiste **disa** shkallë. Në **një** korridor **të** katit të dytë desh u përplas me **një** të njohur e saj të dikurshëm Viktor Hilën, të cilin s'e kishte takuar prej kohësh.*

Tani fjala është për njërin nga (shumë) sheshet e ministrive dhe njërën nga shumë hyrjet e ministrisë, në të cilën ajo përshëndet njërin nga nëpunësit prapa një (nga shumë) xhamat e portinerisë ...dhe kështu me radhë. Besoj se funksioni dhe kontributi i nyjës definite (dhe jo definite) është evident në nivel të tekstit dhe besoj se jep një pasqyrë shumë më reale për kontributin e saj edhe në rrafshe të tjera, përveç rrafshit sintaksor në nivel të fjalisë.

---

meaning "this (entity) - a boy" (f. 653)

[21] Shiko lidhur me këtë çështje Fludenik (1993:47), shiko gjthashtu po aty (fq. 438-445) Frame theory në lietarturë, ku shpjegohet përdorimi i nyjës definite në ballë të novelës, pa pas nevojë për një njoftim paraprak të njërit nga entitetet (si p. sh. sheshi i ministrisë, hyrja e ministrisë, shkallët etj.)

Emrat e zhveshur (angl. *Bare nouns*) në funksione sintaksore

Emrat e zhveshur kanë një përdorim në funksione të ndryshme sintaksore shumë më të kufizuar. Madje në suedishte, siç pohon Kalluli (2005: 18), duke u mbështet në Börjas, modifikimi i tyre nuk është i mundshëm tërësisht. Disi në mënyrë të ngjashme pohon edhe Turano (1998: 52), e cila në punimin e saj supozon, duke u mbështet te gjuhëtarja Hagit Borer, se emrat e zhveshur në anglishte dhe shqipe nuk mund të jenë antecedent të përemrit dhe sipas saj konstrukti:

(35)* Vera bleu makinë dhe ajo ishte e kuqe

Nuk është gramatikisht korrekt dhe e shënon sikurse ne me një asteriks (*). Nëse supozojmë se në këtë rast përdorimi predikativ dhe atributiv i mbiemrit prodhon kuptimin e njëjtë, pasi në (35) fjala është për një mbiemër i cili është një predikat individual-level[22] (shënon një tipar permanent), atëherë konstrukti në vijim:

(36)Vera bleu makinë të kuqe

është gramatikisht korrekt, por edhe sikur përdorimi predikativ dhe atributiv mos të prodhojnë kuptimin e njëjtë, shembulli i modifikuar i Turanos në vijim dëshmon se emri i zhveshur mund të jetë antecedent i përemrit anaforik gjegjësisht mbaresave anaforike të foljes:

(37)a. Vera bleu makinë dhe (më thanë se) ajo ishte e kuqe, apo

b.Vera bleu makinë dhe (siç duket) ajo është e kuqe.

Se predikatet mund ta modifikojnë njëra tjetrën e pohon edhe Kallulli (2005: 19), sipas së cilës modifikimi i emrit të zhveshur në gjuhën shqipe mund të bëhet nga një mbiemër, por vetëm parcialisht:

(38)a. Ana lexoi gazetë të vjetër.

b. *Ana lexoi të vjetër gazetë.

c. Ana lexoi të vjetr-ën gazetë.

Me parcialisht ajo mendon se ky modifikim mund të bëhet vetëm kur mbiemri i shkon emrit pas, por jo edhe kur i del përpara. Sepse, për ti dal përpara emrit, sipas saj, mbiemrit i duhet ti bashkohet nyjës definite në DP. Për Kallullin (2005:19-20) kjo është edhe një dëshmi se tipari, siç thotë ajo, [+enclitic] i nyjës definite të shqipes, e "motivon" mbiemrin për të lëvizur për t'iu bashkuar nyjës. Pavarësisht se më herët u dëshmua se lëvizja (e emrit dhe mbiemrit) në gjuhën shqipe duhet përjashtuar, megjithatë po themi se në lidhje me modifikim parcial Buchholz/ Fiedler (fq. 336)

[22] Lidhur me individual/stage – level predicates shiko Portner (2005)

mendojnë ndryshe. Ata thonë se modifikimi i emrave të zhveshur është i plotë:

> Das Substantiv erscheint im Nom ohne BZ. Es kann vor oder hinter dem Adj stehen *gjak i kuq / i kuq gjak* 'blutrot'. Diese Verwendung des Subst ist aus Vergleichskonstruktionen wie *i kuq si gjak* 'rot wie Blut' hervorgegangen. (Emri në emërore shfaqet pa BZ (pa nyje definite T.A). Ai mund të qëndron para dhe pas mbiemrit: *gjak i kuq / i kuq gjak*. Ky përdorim i emrit rrjedh nga konstruktet e ngjashme si *i kuq si gjak*. Përkthimi T. A.)

Sidoqoftë, për Kallulin (2005) modifikimi parcial është i rëndësishëm edhe për të treguar se emrat e zhveshur nuk mund të jenë antecedent i ndonjë përemri anaforik në diskurs, siç ndodh rregullisht gjatë rimarrjes së kundrinës së drejtë në gjuhën shqipe si në (39d):

(39)a. Nita e bleu fustanin.

b. Nita e bleu një fustan.

c. Nita bleu fustan.

d. *Nita e bleu fustan

Mirëpo, siç duket ky pohim për shqipen është diskutabil. Vocaj (2008: 155) vjen me një shembull, i cili ka për qëllim të dëshmoi të kundërtën:

(40)Kamionçin-a_i e Pjeros ka rimorkjo$_j$. Ajo$_{i/j}$ përdoret shpesh.

Siç tregojnë indeksat *i* dhe *j*, përemri *ajo* mund të ketë antecedent të dy emrat, si emrin e kryefjalës me nyjë definite *Kamionçina*, ashtu edhe emrin fare pa nyja të kundrinës *rimorkjo*.

Padyshim se duhet bërë hulumtime shtesë dhe eventualisht të gjinden edhe shembuj të tjerë të ngjashëm, sidomos të tillë te të cilët vetëm kundrina, e jo të tillë te të cilët ajo së bashku me kryefjalën janë njëkohësisht antecedent i përemrit anaforik. E kjo sidomos nëse kihet parasysh se situata rreth licencimit të pronorit është më e ndërlikuar. Licencimi është i diskutueshëm madje edhe nëse pranë emrit është e pranishme nyja jo definite. Thënë ndryshe, situata është e ngjashme si në (39b), tek e cila lecencimi zakonisht është i nënkuptueshëm. Lidhur me këtë po marr një shembull interesant nga von Heusinger (1997:127), i cili siç duket funksionon edhe në gjuhën shqipe. Në shembullin:

(41)a. Hans will *einen Fisch* fangen.

b. Hansi dëshiron të zërë një peshk.

do të duhej të ishte e mundshme që sintagma emërore me nyjë jo definite (*einen Fisch-një peshk*) të "kualifikohet" si antecedent i lidhjes anaforike me vetorin e vetës së tretë në kallëzore *ihn-atë*, si në vijim:

(42) a. *Er grillt ihn.

a'. * Ai e pjek atë.

b. Er möchte ihn dann grillen.

b'. Ai dëshiron ta pjekë atë.

Siç vërehet në (42b) dhe (42b'), lidhja anaforike e vetorit mundësohet vetëm nëse ai vendoset në një kontekst gjuhësor modal. Thënë ndryshe, mbase një send i quajtur peshk mund të identifikohet, por kjo nuk mjafton për ta etabluar tiparin e vetës, e cila ka nevojë për një kontekst modal për të paraqitur potencialin e saj anaforik në diskurs. Ky shembull na bën me dije se hulumtime të mëtutjeshme janë të nevojshme edhe për rrethana të ndryshme gjuhësore.

Siç e pamë edhe më lart (39c), kundrina e drejtë në gjuhën shqipe, është e pranishme edhe nëse emri që e shënon atë nuk përcillet me ndonjë përcaktor apo determinator. Kurse kryefjala, sipas Gramatikës së Akademisë, mund të paraqitet pa argument (pra, me emra të zhveshur) vetëm në kushte të caktuara, siç janë p. sh. fjalitë që kanë kallëzues të shprehur me foljet joveprore (*Mbahej **qetësi**.*), fjali mohore (*Në pyll as **shpend** nuk dëgjohej*). Për Buchholz/ Fiedler (1987:235) emri në gjuhën shqipe nuk mund të paraqitet pa nyja apo ndonjë mjet tjetër gjuhësor që e kualifikon atë për t'u bërë argument i kryefjalës (Wenn das Subst Subjekt des Satzes ist, kommt im Alb. der Ø-Artikel nicht in Frage). Mirëpo, kohët e fundit, ka zëra që flasin se edhe nën kushte të zakonshme emri si argument i kryefjalës mund të paraqitet pa u përcjellë nga nyja definite ose jo definite (një) apo ndonjë mjet tjetër, i cili do t'i kishte dhënë emrit tiparin semantiko-pragmatik të specificitetit. Kështu p. sh. Çeliku (2012:148):

(43)a. Një makinë ndaloi para universitetit.

b. Ca makina parkuan para hotelit.

(44)a. Makinë ndaloi para universitetit.

b. Makina parkuan para hotelit.

pohon se tipi i dytë (44) i shembujve del edhe me një rend tjetër:

(45)a. Para universitetit ndaloi maki"në.

b. Para hotelit parkuan maki"na.

Shenja e thonjëzave (") nënkupton theksimin e rrokjes. Sipas tij, ky është edhe rendi tipik i thënies (e përbërë nga çifti *Temë-Remë*), në ndërtimet neutrale të së cilës rema vendoset zakonisht pas temës. Çeliku pohon më tutje se (43) dhe (44) janë konstrukte gramatikore sepse: "në (43) përbërësit kokë paraprihen nga caktuesorët e domosdoshëm **një** dhe **ca**, që janë nyjat joshquese të emrave e që tregojnë ekzemplarin a ekzemplarët e një klase sendesh homogjene; theksi logjik bie mbi kallëzuesin, që përben

remën e thënies, ndërkaq kryefjala është tema e thënies. Në (44) përbërësit kokë nuk paraprihen nga caktuesorët e pashquarsisë **një**, **ca**; mungesa e këtyre është e detyruar; theksi logjik i fjalisë bie mbi kryefjalën **makinë** (njëjës.), **makina** (shumës), ku nënvizohet lloji (makinë dhe jo karrocë); në (44) kryefjala është rema".

Kujtoj se konkludimi i Çelikut për disa arsye mund të jetë problematik: e para, e gjithë esenca e ndarjes së fjalisë në temë-remë bazohet në kontekst, sepse struktura informative e fjalisë varet nga të dhënat përtej fjalisë. Pra nga informata e dhënë qoftë në fjalinë e mëparshme, apo në një kontekst qoftë ai edhe minimal (si p.sh. pyetje-përgjigje). Nëse (siç pohon vetë Çeliku), në (44) nënvizohet lloji (*makinë* dhe *jo karrocë*, apo *autobus*) atëherë del se konstrukti (44) është ose formë eliptike e thënies: *Makinë e jo karrocë u ndal para universitetit*, ose është përgjigje në pyetjen: *A u ndal (para universitetit) makinë apo karrocë*? Me ç'rast kryefjala *makinë* e humb statusin e remës sepse ajo tashmë është e pranishme te pyetja. E dyta, konstrukti (44) i izoluar, pa qenë pjesë e kontekstit si më sipër, për shumicën e shqipfolësve nuk është i pranueshëm[23], sepse i paraqitur në këtë mënyrë ky konstrukt nuk është lehtë të pranohet si gramatikor. Mirëpo, duhet pranuar se kur të dalin me një rend tjetër, i cili sipas Çelikut, është edhe rendi tipik i thënies:

(46)a. Para universitetit ndaloi makinë.

b. Para hotelit parkuan makina.

shembujt janë disi më të pranueshëm. Mbase kjo ndodh për shkak se shembujt në (46) kanë edhe një interpretimi tjetër:

(47)a. Para universitetit (ai) ndaloi makinë.

b. Para hotelit (ata) parkuan makina.

Te interpretimi i parë, fjala është për një ngjarje tek e cila një individ ndalon para universitetit një makinë, apo para hotelit disa individë parkojnë makina. Në këtë rast, emrat pa nyjë definite apo ndonjë determinant, janë (për dallim nga interpretimi i dytë) në funksion të kundrinës së drejtë, e jo të kryefjalës. Tek interpretimi i dytë, kryefjala (ai /ata) mund të jetë e nënkuptueshme nga mbaresat vetore (ai ndaloi / ata parkuan), e meqë në gjuhën shqipe, siç u tha më herët, kundrina e drejtë mund të paraqitet pa argument, atëherë kjo mund të jetë eventualisht arsyeja pse pranueshmëria e tyre është më e madhe.

[23] Hulumtimi në Google, më 6 Gusht 2019, ora 09:00 ka dhënë 433 preferenca për "një makinë ndaloi" dhe asnjë preferencë për "makinë ndaloi" (pa nyjën një).

Mirëpo, siç duket, Çeliku i ka kapur pikërisht këta shembuj në njëjës dhe shumës për t'i dëshmuar lexuesit se edhe kryefjala mund të jetë remë. Por mjerisht, kur bëhet fjalë për strukturën informative të fjalisë argumentimet mbesin të mangëta nëse shembujt nxirren të izoluara nga konteksti. Një shembull të ngjashëm të tillë ka edhe Kallulli (1999:36) në disertacionin e saj, të cilin e përsërit në punimin Kallulli (2005:8):

(48) GJARPËR kafshoi Anë-ën.

Germat e mëdha tregojnë se emri është i theksuar dhe se konstrukti, siç thotë ajo, është i varur në tërësi nga diskursi. Mirëpo, për dallim nga Çeliku, për Kallullin GJARPËR nuk mund të jetë kryefjalë apo TOPIC, pra një send për të cilin bëhet fjalë apo predikohet në fjali. Para se të vazhdoj po bëjë një digresion: termat TOPIC/FOCUS që përdor Kallulli dhe THEME-RHEME që përdor Çeliku kanë ngjashmëri, por nuk janë identikë. Për dallim nga këta të fundit, TOPIC/FOCUS si pikënisje merr pikëpamjen e dëgjuesit. TOPIC është ajo pjesë e thënies për të cilën folësi supozon se ajo tashmë është e njohur për dëgjuesin. Prandaj, si shembulli i Çelikut ashtu edhe shembulli i Kallullit kanë nevojë për informata shtesë, sepse, nëse shfaqen të izoluar (sikur të kishin pikur nga qielli (*out of the blue*)), siç thotë edhe vetë Kallulli, ata nuk mund të pranohen si konstrukte gramatikore korrekte. Mirëpo, Kallulli shkon edhe një hap më tutje, sepse edhe sikur informata shtesë të jetë e pranishme, GJARPËR nuk mund të jetë kryefjalë e fjalisë sepse GJARPËR është predikat apo shënues i tipareve, e jo shënues i një sendi apo individi. Është pra një NP e cila nuk është e kualifikuar për të marrë një funksion sintaksor të tillë. Kësaj sintagme i mungon projeksioni DP, pra projeksioni i sintagmës determinative, e cila shndërrohet nga NP kur kësaj i bashkohet nyja definite, apo ndonjë determinant tjetër, siç është nyja jodefinite *një*, apo dëftori (k*y/ai gjarpër kafshoi Anën.*). Sipas Kallullit shembujt e tillë edhe kur të janë të pranueshëm për dëgjuesin, duhet marrë si fjali te të cilat kryefjala mungon, ngjashëm sikurse ajo mungon dhe nënkuptohet nga mbaresat vetore të foljes. Sidoqoftë, për analizën tonë është me rëndësi se në gjuhën shqipe emrat në njëjës nuk mund të kryejnë funksionin e kryefjalës pa praninë e një determinanti si p. sh. nyja definite.

Të shikojmë tani emrat e zhveshur në shumës si në shembullin e Çelikut (*Makina parkuan para hotelit.*). Siç duket situata në shumës, për dallim nga njëjësi, është pak më ndryshe, sepse numrin e emrit në shumës nuk e shënon vetëm nyja definite, por, siç dëshmojnë shembujt në vijim,

edhe emri:

(49)bregu – brigjet

(50)hekurpunues – hekurpunues**a**

Sipas Vocaj (2008:156), që të dy shënuesit e numrit kontribuojnë në semantikën e sintagmës nominale:

(i)shënimi i numrit shumës te nyja lejon atomizimin e bashkësisë së sendeve, pra tregon se bashkësia është e përbërë nga individët apo sendet që shënon emri tek i cili është aplikuar shumësi, si p. sh. *lapsi – lapsat*. Ndërkaq,

(ii)shënimi i numrit tek emri tregon se anëtarët e bashkësisë së sendeve janë grumbuj të përbërë nga sende, si p. sh. *laps – lapsa*. Por, këta grumbuj nuk duhet ngatërruar me emrat kolektivë si p. sh. *orkestra, bordi, partia* etj. të cilët shënojnë grupet e individëve. Në këtë rast fjala është për një grumbull individësh gjegjësisht sendesh të cilët formojnë një tërësi të pandashme, kështu në shembullin në vijim:

(51)Nxënës të klasave të para kënduan një këngë.

nuk mund të interpretohet sikur secili nxënës të këndon një këngë të veçantë, siç do të ishte rasti kur nyja definite apo një determinant do të ishin të pranishëm:

(52)Nxënës-it/Ca nxënës të klasave të para kënduan një këngë.

por mund të interpretohet si: *nxënës të klasave të para këndojnë një këngë* **të vetme**.

Po kthehemi tani te shembulli i mëhershëm i Çelikut: *Makina parkuan para hotelit*. Në një kontekst të caktuar, pra kur disa makina në të njëjtën kohë parkojnë para hotelit, konstrukti gramatikisht mund të jetë korrekt, sepse emri në shumës *makina* referon një grumbull makinash. Besoj edhe shembujt e tjerë që paraqet Çeliku (f. 139) si:

(53)Në mbledhje të Akademisë së Shkencave merrnin pjesë mjeshtër ndërtimi, teknikë, arkitektë, arkeologë, historianë, gjuhëtarë, mësues e punonjës të kulturës popullore.

(54)Kalonin asaj udhe fshatarë, kallajxhi, kovaçë, barinj.

mund të shpjegohen në të njëjtën mënyrë, pra të gjithë emrat e pashquar (*mjeshtër ndërtimi, teknikë, arkitektë, arkeologë, historianë, gjuhëtarë, mësues e punonjës së kulturës popullore*) dhe (*fshatarë, kallajxhi, kovaçë, barinj*) referojnë si një grumbull. Pra, edhe te shumësi i emrave të zhveshur pak a shumë është një situatë e ngjashme si te njëjësi, rrjedhimisht përdorimi i emrit pa ndonjë determinant apo përcaktor në gjuhën shqipe është i

kufizuar.

Përveç këtyre rasteve Guisti përmend edhe konstruksionet me parafjalë dhe vokativë te të cilët emri shfaqet pa nyja. Ky punim nuk do të shtjellojë këto dy raste, ani pse çështja e konstruksioneve vokative mund eventualisht të shpjegohet edhe me faktin se në këtë rast emri ka tiparin e vetës së dytë e jo tiparin (e zakonshëm) të vetës së tretë. Sidoqoftë, synimi i këtij punimi nuk është dëshmimi detyrimisht i pranisë së komponentit semantik të nyjës në çdo përdorim të saj. Përndryshe, edhe Guisti e ka shumë vështirë të shpjegojë se pse nyja definite në maqedonishte e bullgarishte nuk është tregues i rasave, nëse ajo është e pranishme kryekëput për të kryer funksione gramatikore.

Përfundim

Kontributi i gjuhëtarëve italianë për gjuhën shqipe në shumë pikëpamje është i pamohueshëm. Është botuar një numër i konsiderueshëm i studimeve gjuhësore në formë të artikujve dhe monografive. Aty analizohen dukuri të ndryshme të gjuhës arbëreshe, por edhe të gjuhës letrare shqipe, duke përdorur modelet aktuale gramatikore. Në këtë punim është analizuar qasja e modeleve të Manzini dhe Savoia, nga njëra anë, dhe modeli i Guistit, nga ana tjetër, por duke u përqendruar kryekëput në domenin e sintagmës emërore. Të dy modelet kanë një qasje të detajuar kundrejt nyjave të gjuhës arbëreshe dhe shqipe, si elemente qendrore të sintagmës emërore, por që dallojnë esencialisht se si këto nyja projektohen në sintaksë. Përderisa njëri model (Manzini e Savoia) favorizon projektimin vetëm të kategorive leksikore duke përjashtuar ato funksionale, modeli tjetër (Guisti) preferon të kundërtën, projektimin vetëm të kategorive funksionale duke përjashtuar ato leksikore. Rrjedhimisht, modeli i parë supozon praninë e komponentit semantik te të gjitha nyjat pa përjashtim, kurse i dyti e mohon praninë e saj te të gjitha nyjat pa përjashtim. Padyshim se qasja e tillë (e skajshme) e njërit apo tjetrit model ndaj nyjave reflektohet edhe në pasqyrimin e tyre të strukturës së sintagmës emërore, e cila e ndërtuar në supozime të tilla, jo rrallë është në shpërputhje me të dhënat empirike, e rrjedhimisht, edhe me strukturën e pritur të sintagmës emërore shqipe. Synimi i këtij punimi është që të japë disa vërejtje dhe shpjegime shtesë, të cilat do të kontribuojnë në zbutjen eventuale të kësaj shpërputhjeje.

Literatura

Abrashi, Teuta (2012): Nyja e prapavendosur në gjuhët e Ballkanit – ngjashmëri dhe dallime morfosintaksore / *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Albanian and Balkan Languages*. ASHAK, Prishtinë/ fq.235-266

Abrashi, Teuta (2014): Lidhja kryefjalë-kallëzues: përshtatje, drejtim apo të dyja, *Studime 21*, 325-340

Abrashi, Teuta (2016): Das Nähe-Distanz Modell und die Informationsstruktur im Deutschen, Në: Jülich, Petrović Marina & Vujćić Nikola: *Nähe und Distanz in Sprache, Literatur und Kultur-Beiträge zur 8. Jahrestagung des Südosteuropäischen Germanistenverbandes* (Kragujevac, 11. – 15. November 2015), 37-54

Abrashi, Teuta (2017): Zur syntaktischen Eigenheiten des Merkmals Person im Deutschen, *Germanica Wratislaviensia Nr. 142*, 105-118

Abrashi, Teuta (2018): Ndajshtimi i paveçuar dhe disa çështje në rrafshin sintaksor e semantik / *Albanistische Forschungen in deutschsprachprachigen Ländern*, ASHAK, Prishtinë, fq. 383-430

Agalliu, Fatmir (1975): Ndërtimi Dëftor + Emër i Shquar në gjuhën shqipe, SF 1

Börjas, Kersti (1998): Feature *Distribution in Swedish Noun Phrase*, Blackwell, Oxford

Buchholz, Oda und Wilfried Fiedler (1987: 216): *Albanische Grammatik*, Verlag Enzyklopedie, Leipzig

Campbell, R. (1996) "Specificity Operators in SpecDP" *Studia Linguistica* 2:161-188.

Campos, Héctor (2008): Some notes on adjectival articles in Albanian. *Lingua* 119(7), 1009–1034

Demiraj, Shaban (1986): *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Tiranë

Dimitrova-Vulchanova, M. & G. Giusti (1998) "Fragments of Balkan Nominal Structure", in A. Alexiadou & C. Wilder (eds.) *Possessors, Predicates and Movement in the Determiner Phrase*, Benjamins, Amsterdam 333-360.

Dobrovie-Sorin, C. 1987 "A propos de la structure du groupe nominal en Roumain", *Rivista di Grammatica Generativa* 12: 123-152.

Fludenik, Monica (1993) : *The fictions of language and the languages of fiction*, Routledge, London

Franco, Ludovico & Manzini, Rita M. & Leonardo, Savoia M. (2015) : Linkers and Agreement, *The Linguistic Review*, 32 (2) :277-332

Fromkin, V. et al. (2000): *Linguistic Theory*. Oxford/ Massachusetts: Blackwell

Giusti, G.(2012): Enclitic and proclitic articles in Albanian , *Theoretical and Empirical Studies in Albanian Syntax - Studime teorike dhe empirike nè fushèn e sintaksès sè shqipes*, Monaco di Baviera, LINCOM EUROPA, vol. LSIEL 39, pp. 55-73

Giusti, G (2015): *Nominal Syntax at the interfaces. A comparative study of languages with articles* , Newcastle upon Tyne, Cambridge Scholars Publishing

Gramatika e Akadamisë (1995) : *Gramatika e Gjuhës Shqipe I dhe II*, Tiranë

Greenberg, Joseph (1978): How does a language acquire gender markers?. Në J. Greenberg et. al. (eds.): *Universals of Human Languages, vol 3. Word Structure*, 47-82. Stanford: Stanford University Presss.

Hcusingcr, K. (1997): *Salienz und Referenz. Der Epsilonoperator in der Semantik der Nominalphrase und 'anaphorischcr Pronomen*. Studia Grammatica 43. Berlin.

Higginbotham, James (1985): On semantics. *Linguistic Inquiry*, 16(4): 547–621.

Himmelmann, Nikolaus (1997): *Deiktion, Artikel, Nominalphrase. Zur Emergenz syntaktischer Struktur*. Tübingen: Niemeyer

Koleci, Flora & Giuseppina Turano (2011): *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*,

Universiteti i Tiranës, 2000.

Kallulli, Dalina (1999) *The comparative syntax of Albanian: on the contribution of syntactic types to propositional interpretation*., Durham theses, Durham University. Available at Durham E-Theses Online: http://etheses.dur.ac.uk/1466/

Kallulli, Dalina (2005): On existential bare plural subjects: they don't exist!, *Belgian Journal of Linguistics 19*, 29-57

Lyons, John (1977): *Semantics 2*, Cambridge University Press, London

Manzini, Rita. M (2018): Possessive pronouns as oblique DPs: linkers and affix stacking, *Jezikoslovlje 19.3*, 393-425

Manzini & Savoia (2007): *Unification of Morphology and Syntax-Investigations into Italian, Romance, and Albanian dialects*, Routledge, Abingdon

Manzini & Savoia (2011): *Grammatical categories : variation in romance languages*, Cambridge University Press, Cambridge

Memushaj, Rami (2008): *Gjuhësia gjenerative-botimi i dytë i përmirësuar*, Shtëpia botuese e Librit Universitar, Tiranë

Portner, Paul H. (2005): *What is Meaning*, Blackwell, Oxford, UK

Qefa, Sonila (2014): *Elements of Albanian Grammar-A Minimalist Determiner Phrase Structure*, Temë dizertacioni, Università Ca' Foscari Venezia, (18.02.2020; 15:22. http://dspace.unive.it/bitstream/handle/10579/4529/825357-108806.pdf?sequence=2)

Savoia, Leonardo M.et.al (2015): *Studime në Gjuhësinë Shqiptare*, ASHAK, Prishtinë

Taraldsen, T. 1990 "D-projections and N-projections in Norwegian", in M. Nespor e J. Mascarò (eds.) *Grammar in Progress*, Foris, Dordrecht 419-431.

Tomić, Olga Miseska (2006): *Balkan Sprachbund Morpho-syntactic Features*. Dordrecht: Springer.

Topalli, Kolec (1995): *Theksi në gjuhën shqipe*, Shtëpia Boyuese Enciklopedike, Tiranë

Turano, Giuseppina (1998): (A)TELICITY AND CASE IN ALBANIAN, Università di Firenze 9 (1998/99): 49-56

Turano, G & Rrokaj, Sh. (2000): A proposito del sintagma nominale in albanese-Il caso di un dimostrativo seguito da un DP definito-*Lingua e Stile* 35/1, 95-128

Turano, G. (2001), "Albanian noun phrase domain."Quaderno del Dipartimento di Linguistica –Serie Albanistica 3, Università di Cosenza.

Turano, G. (2002), "On modifiers proceeded by the article in Albanian DPs" –University of VeniceWorking Papers in Linguistics Vol.12, pp.169-215, edited by Laura Brugè

Turano, Giuseppina (2003): Similarities and differences between standard Albanian and Arbëresh numerals. A case of micro-parametric variation, *University of Venice Working Papers in Linguistics*, Vol. 13, 155-177

Vocaj, Etleva (2008): Bare plurals in Albanian, in: Tadić, Marko & Mila Dimitrova-Vulchanova, Svetla Koeva: *Proceedings The Sixth International Conference Formal Approaches to South Slavic and Balkan Languages*, 25-28 September 2008, Dubrovnik, 153-158

Zwicky, Arnold & Geoffrey Pullum (1983): *Clitization vs. Inflection: English n't*. Language 59: 502-513

Ardian NDRECA, Romë

REVISTA "SHÊJZAT" VOTËR E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË ITALI (1957-1978)

Abstrakt. Ky kontribut mëton të paraqesë në diakroni organizimin e studimeve albanologjike në Itali në periudhën e mbas Luftës II Botnore nepërmjet punës së Ernest Koliqit, themelues i së përkohshmes *Shêjzat*, dhe bashkëpunëtorëve të tij ma të afërt. Prania e studiuesve si Matteo Sciambra, Alessandro Serra, Rosolino Petrotta, Giuseppe Valentini Giuseppe Gradilone, Angela Cirrincione, Francesco Solano, Giuseppe Ferrari dhe e shumë të tjerëve ban që revista e Koliqit të kthehet ndër vite në nji tribunë të studimeve albanologjike në Itali. Përposë autorëve të njohur në lamin e albanologjisë revista vazhdimisht i dha hapsinën e duhun edhe studiuesve të rinj që lauroheshin nën drejtimin e profesorave në zâ si G. Valentini, J. Marlekaj, K. Gurakuqi, A. Guzzetta etj.
Fjalëkyçe**:** *Shêjzat*, Ernest Koliqi, albanologji, *Le Pleiadi*.

Revista *Shêjzat* trajtohet si vijimi shpirtnor i së përkohshmes *Shkëndija* e cila pati fatin me me u botue në harkun kohor 1940-1943 e drejtueme prej Ernest Koliqi me drejtor Selahydin Toton. Ne te ashtuquejtinin Akt-besimi, themeluesi Ernest Koliqi theksonte tri pikat themelore të programit të kësaj së përkohshme:

1) gërmim i vijueshëm në shpirtin shqiptar të pa-rmuem;
2) Lartësim të instinkteve ma të shëndosha të kombit;
3) Përpjekje gjuhësore në mënyrë qi zhvillimet e idevet të reja t'u japin hov të ri e virtyt të fuqishem shprehjeje fjalvet te gjuhes s'one se vjeter.[1]

Shkendija e Koliqit mblodhi rreth vetes disa penda te njohuna italiane, kuptohet jo të studjues të albanologjisë, madje jo pak prej tyne improvizatorë të gjanave shqiptare, mbasi ishin intelektualë që thjesht gjindeshin ne Shqipni për shkak të Luftës. Ndër ta përmendim: Nicola Lorusso Attoma, Gianni Botta, Enrico Grassi, Paolo Veronese, Rosolino Petrotta, Gaetano Bazzoli.

Me përfundimin e Luftës së Dytë botnore dhe me gjendjen e re te krijueme, Ernest Koliqi i ndodhun në Romë tashma si emigrant politik dhe njikohsisht si profesor pranë Universitetit te Romes La Sapienza, i dha jete nji reviste te re qe e quejti *Shêjzat - Le Pleiadi*.

Jemi në vitin 1957 dhe përposë vështirësinave ekonomike të kuptueshme intelektualët antikomunista në mërgim ndienin nevojën e krijimit dhe të pasjes së nji tribune shkencore ku të shpalosnin idetë dhe kërkimet e tyne shkencore.

---

[1] E. Koliqi, *Akt-Besimi*, në *Shkëndija*, n. 1, 1940, f. 7.

Jemi në gushtin e vitit 1957 kur revista nxjerr numrin e parë me pronar Ernest Koliqin, drejtor përgjegjës Matilde Mancinelli dhe kryeredaktor Martin Camajn.

"Na, botuesit e kësaj së përkoheshmje, - shkruente Ernest Koliqi - duem të jemi pranë, në vijën ma të parë luftarake, me armën e kulturës. Na dëshirojmë me anën e orvatjes s'onë të përvujtë por plot synime ndërtuese, t'a përdorim këtë armë për të sjellun nji skjarim në shesh të bisedimeve ku rrahen problemet gjallnore te shqiptarizmit. Duem qe te japim kontributin tone ne lamije te kultures, vetem neper rreze te se ciles çashtja shqiptare mund te zgjidhet lumnisht. (…) Kjo e perkohshme don te jete tryeze e lire kuvendi burrnuer, te mbajtun mbrenda caqeve t'urtis e te njerzis".[2]

Në fakt në mërgim do të dilte edhe ndonji organ tjetër që do të promovonte shkencat albanologjike, e kemi fjalën për të përkohshmen *Shpirti shqiptar* të Namik Ressulit por edhe për organin e Komitetit Shqipnija e Lirë. Kufizimi i daljes së tyne në kohë dhe përmbajtja e kufizueme prej rrethanave do t'i kthenin në meteorite që u shuen shumë shpejt.

Ky kontribut mëton të paraqesë në diakroni organizimin e studimeve albanologjike në Itali në periudhën e mbas Luftës II Botnore nepërmjet punës së Ernest Koliqit, themelues i së përkohshmes *Shêjzat*, dhe bashkëpunëtorëve të tij ma të afërt. Nuk duhet të harrojmë se ndaj Ernest Koliqit nji pjesë e mërgatës politike do të ushqente po aq urrejtje sa edhe ndaj regjimit të komunist të Enver Hoxhës. Disa sish, për shembull Arshi Pipa, do t'i rrinin larg Koliqit për shkak të pjesmarrjes së tij në qeverinë fashiste, të tjerë si Abaz Ermenji, bashkëpuntor i deklaruem i nazistave, do të kishte shumë pak arsye me vjellë vner kundër intelektualit shkodranë. Nëse Dhimitër Shuteriqi në përmbledhjet e tija historike që botonte në Tiranë do ta kishte nji farë justifikimi me errësue figurën e Koliqit, të gjithë ata që ndodheshin në botën e lirë dhe e prozhmonin ose thjesht shpifnin ndaj tij, nuk kishin asnji rrethanë lehtësuese, përposë frustrimit dhe të qenit dështakë.

Mungesa e shumë pendave të randësishme të arealit shqipfolës u ekuilibrue prej Koliqit nga pjesmarrja në nismën e *Shêjzat* e nji plejade autorësh arbëreshë, të vjetër dhe të rinj. Prania e studiuesve si Matteo Sciambra, Alessandro Serra, Rosolino Petrotta, Giuseppe Valentini Giuseppe Gradilone, Angela Cirrincione, Francesco Solano, Giuseppe Ferrari dhe e shumë të tjerëve ban që revista e Koliqit të kthehet ndër vite në nji tribunë të studimeve albanologjike në Itali. Përposë autorëve të njohur në lamin e albanologjisë revista vazhdimisht

[2] E. Koliqi, *Mbas udhehjekjes së Shêjzave*, në *Shêjzat*, n. 1, 1957, f. 2.

i dha hapsinën e duhun edhe studiuesve të rinj që lauroheshin nën drejtimin e profesorave në zâ si G. Valentini, J. Marlekaj, K. Gurakuqi, A. Guzzetta etj.

Në fakt prania e studiuesve italianë në shtyllat e *Shêjzave* mund të shihet në disa kandvështrime. Së pari kemi italianë dhe arbëreshë. Gjejmë studiues të vjetër dhe të rinj e në fund kemi edhe rishtarë që sapo kanë krye studimet dhe paraqesin në shtyllat e *Shejzave* frytin e punës së tyne të parë. Shumë prej tyne do ta mbyllin me aq, disa të tjerë - kajherë duhet me thanë edhe mjerisht - vijojnë me kambëngulë pa u ndalë. Gjithsesi mes tyne ka talente dhe qarkullojnë idena origjinale e me vlerë. Ndoshta nji studim i thelluem do të kishte vlerën e nji censusi kritik të tezave të albanologjisë që janë diskutue në ato dekada në Palermo, Bari, Romë! Nga nji kopje të atyne tezave e pat koleksionue Át Jakë Marlekaj e sot ndodhen në bibliotekën françeskane në Shkodër.

Botimi në shtyllat e *Shêjzave* asokohe përbante nji problem për nji pjesë të studiuesve arbëreshe që rrekeshin me pasë marrëdhanje normale me Tiranën zyrtare, nji pjesë e tyne gjeti nji lloj ekuilibri, me disa prej tyne Koliqi hyni në polemikë mbasi e konsideronte tradhti ndaj idealeve kombtare faktin që disa intelektualë e shkrimtarë arbëreshe ishin ba zadhanës të regjimit të Enver Hoxhës. Në nji farë mënyrë edhe marrëdhanjet me studiuesit kosovarë që jetonin në Jugosllavinë e Josip Broz Titos ishin problematike mbasi Koliqi trajtohej prej Beogradit si ish ministër fashist që kishte ndikue në Kosovë gjatë Luftës, madje në momentet e ashpërsimit të terrorit kundër shqiptarëve edhe qarkullimi i revistës *Shêjzat* në Mal të Zi e në Kosmet nuk ishte gjithnji i lirë.

Emnave të studiuesve italianë dhe arbëreshë të njohun si Zef Valentini, Zef Schirò, Alessandro Serra i bashkohen ata të brezit të mavonshëm si: Matteo Sciambra, Giuseppe Ferrari, Francesco Solano, Emanuele Giordano, Emilio Tavolaro, Domenico Bellizzi, Vincenzo Selvaggi, Ignazio Parrino, Giuseppe Gradilone etj.

Në dhjetëvjetorin e *Shêjzave*, tue folë për ndihmesen e bashkëpuntorëve të tij, Koliqi vëren: "Tubimi i tyne mbi nji platformë miqsore spjegon rrafshin e shënueshem kulturuer të së përkohëshmes dhe fuqín depërtuese t'idéve qi i a frymzojnë shkrimet. Intelektualët gjithkund në botë bashkohen me vishtirsí, sepse sejcili prej tyne ushqen mendime të veta edhe thellon e zgjânon ditunín në degën e vet me mënyra e prirje të veçanta. (…) Nji ndikimi intelektualvet të bashkuem do t'u jepte ndoshta nji rrjedhje tjetër, mâ të pështatun për të mirën e përgjithshme dhe mâ në përgjasí me frymën e kohnave".[3]

Ajo çka më duket ma e randësishme asht prania në shtyllat e *Shêjzave* e

[3] E. Koliqi, *Miqsija e bâni këtë mrekullí*, në *Shejzat*, nn. 1-4, ff. 2-3.

të sapolauruemve që paraqisnin zakonisht përmbledhjet e kapitujve ma të randësishëm të tezave të tyne, të diskutueme në katedrat ku jepnin mësim: Ernest Koliqi, Zef Valentini, Jak Marlekaj, Karl Gurakuqi etj.

Ndër ta vlen me u përmendë:

Angela Cirrincione me kontributet: *La poesia di Jacova-Merturi* (1957), *La desinenza -sh nella declinazione albanese* (1958), me nji studim për lojnat popullore shqiptare e siciliane (1958), me studimin: *L'albanese nell'indoeuropeo* (1962).

Gilda Occhionero me kontributin *Kokrra krype arbneshe* (1959). Occhionero do të laurohet në 1963 në Universitetin e Romës me "Raccolta di favole fiabe racconti preghiere proverbi indovinelli espressioni augurali e imprecatorie".

Jozefina Giampietro me kontributin *Fjalë të urta arbëreshe* (1959), ajo asht edhe bashkëautore e vëllimit: "Novellistica italo-albanese" (Firenze 1970).

Rosa Proietti: me nji studim për Sami Frashërin (1960).

Rosa Meoli, e cila laurohet në vitin 1960 në Universitin e Romës me disertacionin me titull: "Scanderbeg nella letteratura albanese". Në vitin 1961 boton tek *Shêjzat* kontributin: "Due poeti italiani che cantano le gesta di Scanderbeg: Margherita Sarrocchi - Baldassare Scaramelli". I rikthehet argumentit të M. Sarrocchi edhe në vitin 1969, kur boton tek *Shêjzat* nji kapitull të tezës së saj të mbrojtun pranë Istituto di Studi Albanesi della Università di Roma. Vlen të përmendet se Meoli cilësohet prej E. Koliqit si "diligente alunna".

Maria Quadraccia, boton "Bardha de Temal" (1962), kapitull i tezes që ka diskutue në vitin 1959 pranë Universitetit të Romës.

Maria Mustillo, boton *Gli albanesi* (1963) – që siç shënohet te *Shêjzat*: "*tratto dalla sua penetrante e nitida tesi di laurea "L'Albania e gli albanesi nell'opera del Degrand*". Po atë vit boton tek *Shejzat*: "Usi e costumi Albanesi" (1963).

Alba Capo, e cila laurohet ne 1963 në Universitetin e Romës me disertacionin: "Contributi degli italo-albanesi al Risorgimento d'Italia" (shih: *Shêjzat*, 1963, n. 5-8).

Çuditë fakti se 90% e autorëve të tjerë të rinj që vijnë prej botës arbëreshe në ato vite, puna shkencore e të cilëve promovohet në nji farë mënyre tek *Shêjzat*, janë studentesha të sapolaurueme. Ndër to përmendim edhe emnat e Maria Primiani, Emilia Giglio, Giovanni Cava, Maria Pia Castelli, Angela Minicucci, Adele Salerno Ficarra, Michelina Cinquemani, Maria Teresa Spitali, Marisa Gabriella S. Caracciolo, Maria Luisa Azzinari etj. Shumica e tyne vinte prej

bankave të Institutit të Koliqit, i cili i drejtuem me urti e kompetencë prej tij ruejti deri në fundin e jetës së shkrimtarit shkodranë frymën konviviale të bashkëpunimit me të gjithë studiuesit vullnetmirë të lamijes së albanologjisë, letërsisë, ballkanologjisë, tue u mundue me ndërveprue edhe me studiues të emigracionit të Lindjes komuniste. I duhet dijtë për nderë punës organizative të Koliqit krijimi i bibliotekës së pasun të atij Instituti dhe tërheqja drejt tij e studentave dhe fondeve për organizimin e kuvendeve dhe botimin e shumë vëllimeve me studimeve dhe veprave tjera letrare. Me vdekjen e Koliqit Instituti nuk pati pasues të nivelit të duhun dhe çdo gja degradoi gradualisht deri në kthimin e tij në nji mësimdhanje të thjeshtë, tue rrezikue madje për nji kohë deri edhe mbylljen.

Ernest Koliqi vuejti gjatë viteve të mërgimit për lexues, për pasues, e tue përjashtue Martin Camajn e ndonji tjetër nuk pati as bashkëpuntorë për kryemjen e detyrëve ma elementare që duhet të bajnë nji drejtues i nji të përkohshmes si *Shêjzat*. Mjafton me kujtue se qortuesi i shtypajve të *Shêjzave* dhe i nji morie veprash tjera që u botuen tek tipografi i mirënjohtun Ugo Detti në Romë, ishte kunati farmacist i Koliqit, Petro Vuçani.

Sot kemi ardhë në nji kohë kur Koliqit nuk i shërbejnë as admiruesit dhe as lavduesit, atij i duhen lexues dhe studjues të censhëm që ta përimtojnë veprën e tij letrare, studimore, përkthimet mjeshtërore, tue nxjerrë në pah vlerat e tija si në aspektin e stilit ashtu edhe në atë të përmbajtjes. Këtu nji vend me randësi zen edhe ndërmarrja e tij ma ambicioze kulturore, botimi i revistës *Shêjzat*.

Shêjzat janë ringjallë tashma prej vitit 2016 (www.shejzat.com) dhe e konsiderojnë veprën e Koliqit si pikënisje e nji rrugëtimi të ri në kushtet e sotme ku ndodhen shkencat shpirtore shqiptare. Ashtu si Koliqi dikur, *Shêjzat* sot përpiqen me inkurajue të rinjtë, me mbajtë larg megallomanët dhe kallpët, me nderue traditën por me shikue përpara drejt horizonteve të përbashkëta kultorore të popujve të tjerë europianë.

Rusana BEJLERI, Universiteti i Sofjes “Sh. Kl. Ohridski”

VENDI I ANTOLOGJISË NË STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI

Abstrakt. Në këtë kumtesë do të merren në shqyrtim përdorimi i formës së antologjisë lidhur me letërsinë shqipe në Itali dhe me letërsinë arbërshe në përgjithësi. Në bibliografinë e studimeve arbëreshe (Ferraro, 2011) fjala “antologji/ antologia” ndeshet 12 herë në 229 faqe dhe gjysma prej tyre janë libra të mirëfilltë. Kjo më shtyu t’i gjej dhe t’i rilexoj këto antologji - katër në bibliotekë dhe të tjera në internet, për t’i parë dhe diskutuar si libra burimorë mbi lëndën e përzgjedhur.

Në bibliografinë më të përhapur të studimeve arbëreshe (Ferraro, 2011) fjala ‘antologji’ ndeshet 12 herë në 229 faqe dhe gjysma e tyre janë libra të mirëfilltë. Kjo më shtyu t’i gjej dhe t’i rilexoj këto antologji, të cilët pas kërkimeve rezultuan shumë më tepër si numër dhe llojshmëri lidhur me letërsinë shqipe në Itali dhe me letërsinë arbërshe në përgjithësi. Përkufizimi i antologjisë është i thjeshtë dhe nuk përbën fushë diskutimi teorik në gjuhë dhe në burime të ndryshme dhe për këtë arsye do ta parashtrojmë vetëm si pikënisje: “përmbledhje pjesësh të zgjedhura nga autorë të ndryshëm” (FESh). Semat që përshkojnë më mirë këtë lloj botimesh janë ‘i pashteruar’ dhe ‘selektiv’. Megjithatë është për t’u mahnitur sa të ndërgjegjshëm janë shkencëtarët që kanë shfrytëzuar emrin dhe mbiemrin përkatës për vepra objektivisht madhore në një segment edhe më të ngushtë sesa vetë tema e konferencës (Mandalà 2005-12; Altimari et al 2009; Guida C&G 2009) me modesti intelektuale dhe përkulje para thellësisë së dijes që kanë zbuluar dhe prekur me sy dhe mendje.

Jeronim de Rada është i pari që ka përdorur formën e antologjisë në botimin e tij të vitit 1896 në Napoli me titull *Antologji shqipe e përkthyer besnikërisht në gjuhën italiane ose Antologia Albanese tradotta fedelmente in italiano. Tekstet janë paralele dygjuhëshe dhe janë të përziera si tematikë,* ku përfshihen sipas renditjes përralla popullore si p.sh. *Vashëza e dhia*, *Përralëza e tridicinit (vëllait të tretë)*; një tregim historik për Gjakoven në vitin 1880 nga *Flamuri i Arbërit*; *Vita immortale* nga temat fetare dhe politike. Vijojnë disa letërkëmbime, ndër të cilat me Thimi Mitkon, Spiro Dinen në Egjipt, me nënën; pastaj një pjesë e shkurtër për Shkollën e gjimnazit të vitit 1872; vijojnë vjersha nga Demetrio Bellucci, Antonio Argontizza, Bernardo Bilota – *Dhimbja e njeriut*; pas kësaj kënget epike – *Konstandini i vogël* dhe disa këngë të tjera nga koha e pushtimit turk, që janë botuar së pari te *Flamuri*; Jul Variboba, botimi i

vitit 1762 i Romës, me fusnotë të hollësishme gjysmë faqe për jetën e tij; përkthim i *Ferrit* të Dantes në gjuhën arbëreshe nga Luigi Lorecchio. Në seksionin dramaturgjik gjejmë një pjesë nga vet De Rada dhe një dramë nga Fra Antonio Santori, skena V e shoqëruar prapë me fusnotë gjysmë faqe për Santorin. Shënoj me vëmendjen të dyja fusnotat e hollësishme, sepse kjo faktikisht, por edhe si ndikim mbi lexuesin, dëshmon rëndësinë që u kushton autorëve në fjalë De Rada dhe me vëmendjen e tij bën një dallim psikologjik për audiencën. Dihet se kjo antologji për vetë autorin ishte pjesë e pandarë e Gramatikës së shqipes (1894), sikurse praktikohet shpesh, dhe është e pritshme që shpjegimi i gramatikës së një gjuhe të ilustrohet me tekste të gjinive të ndryshme. Siç mund të gjykohet, pjesët e larmishme të përfshira në antologji janë në pajtim me kohën dhe objektivat didaktike sinkronike. Megjithatë për lexuesin e sotëm kjo vepër mbart edhe informacion tjetër diaktronik - sesi janë paraqitur në zanafillë nga De Rada fenomene globale që u zhvilluan, u shpalosën dhe madje u venitën ndërkohë. Kam parasysh një fragment të kapitullit të dytë, i cili titullohet italisht *Il socialismo* kurse është i përkthyer 'besnikërisht' si *E përbashkëmia e gjees të spivet*. Hamendësimet dhe humori politik dhe ekonomik në këtë drejtim janë më se kurioze, sepse i përkasin periudhës kur territoret shqipfolëse ishin akoma nën një pushtet feudal dhe mënyra e të menduarit të De Radës krijon analogji me tekstet parapritëse të Zhyl Vernit në perceptim.

Antologjia e parë moderne është hartuar nga Ernest Koliqi dhe e botuar në Milan në vitin 1963. Titulli i saj në shqip është "Antologjia e lirikës shqiptare". Botimi është plotësisht në italisht, 318 faqe gjithsej. Hyrja e përgatitur nga hartuesi kap 40 faqe me shpjegime të shkurtra mbi historinë e zhvillimit letrar në trojet shqiptare nga shekulli XVI e këtej ku përmenden autorët e vjetër, bejtexhinjtë, autorët arbëresh, rilindësit Frashëri, Çajupi dhe autorët e Pavarësisë – Mjeda, Fishta dhe Migjeni, sikurse në fund edhe Kosovën. Bie në sy se hartuesi nuk ka bërë grupime të veçanta tematike, të cilët jemi mësuar t'i shohim në variantet bashkëkohore të antologjive, por ka ndjekur më dukshëm kronologjinë e thjeshtë. Nga autorët e Shqipërisë shihen emrat e Bernadin Palajt apo Ethem Haxhiademit, të cilët tani duken sikur gjithmonë kanë qenë aty, por në atë periudhë ishin tabu në vendlindje. Në fillim të viteve '60 ishte herret të priteshin emrat e poetëve të Kosovës, që akoma nuk ishin shfaqur mirë dhe u bënë pjesë e pandashme të antologjive të mëvonshme, por është me interes se një fragment i është kushtuar zhvillimit kulturor të krahinës së atëhershme. Nga kjo antologji edhe një lexues specialist mund të mësojë gjëra të reja, p.sh. të ndeshet me emrin e Ganimete Nurës, emri i vetëm që përmendet për autorët e Kosovës. Koliqi e

përshkruan me admirim si "një zë që thyen heshtjen", kurse sot Google thotë në mënyrë lakonike vetëm se është parashutistja e parë. Vlen të përmendet se Ernest Koliqi u kushton vëmendje koncepteve kryesore në këngët popullore shqiptare duke i shpjeguar nga pikëpamja etnolinguistike, nuk harron as instrumentet muzikore - lahutën dhe çiftelinë, të cilat i përshkruan fizikisht. Në versionin që mund të shkarkohet online teksti arrin deri në f. 58 dhe përfshin 7 këngë popullore të jugut dhe veriut, poezi të Jul Varibobës, Jeronim de Rada, Skiroi Plak, Naim Frashëri, Xhusepe Skiroi, Çajupi, Mjeda, Fishta, Asdreni. Në formën e librit kjo antologji mbetet një burim shumë konciz që gjendet në 6 biblioteka europiane të Italisë, Zvicrës dhe Gjermanisë.

Antologjitë bashkëkohore pas viteve 1990 janë më të larmishme. Ato kanë si objektiv njohjen e ndërsjellë të degëve të ndryshme të familjes divergjente shqipfolëse. Ndikimi i dytë është nxitja e studimeve të mëtejshme të materialit të mbledhur dhe të popullarizuar me anë të antologjisë. Merita të çmuara zotëron përmbledhja e vitit 1990 me të cilën u njoha vetë menjëherë pas botimit kur isha akoma studente: *Poezia e sotme arbëreshe. Nga fillimi i shekullit XX*, hartuar nga Rexhep Ismajli, 322 faqe dhe 22 autorë. Shumica e autorëve janë paraqitur me 10 e më shumë poezi. Parathënia në 30 faqe është informative dhe analitike, e përshtatur me saktësi logjike për llojin e përmbledhjes dhe adresatët e saj. Duke e rikujtuar për këtë kumtesë, e konceptova në thellësi rolin e veçantë të parathënies për këtë gjini botuese. Kur bëhet përzgjedhje më shumë se çdo herë tjetër duhet të jepet orientim për lëminë, për kriteret dhe për kufizimet objektive, sepse antologjia nënkupton një auditor më pak të specializuar ose me më pak akses sesa hartuesi në segmentin konkret. Në këtë rast vështirësitë dhe limitet janë shpjeguar thjeshtë – nga një autor ka pasur në dorë disa vëllime, nga të tjerë - vetëm vjersha të shkëputura nëpër revista. Është nxjerrë në pah kriteri informativ, regjistrues, si referencë për hulumtime të mëtejshme. R. Ismajli ka përdorur stilin e tij implicit, argumentues dhe të angazhuar shpirtërisht për të krijuar dhe transferuar një lidhje emocionuese me poetët arbëresh. Për këtë shërben edhe fakti se antologjia është shqipëruar në shqipen e sotme dhe kjo e bën letërsinë arbëreshe më të arritshme jo vetëm për bashkatdhetarët e tjerë, por edhe për lexuesin e huaj.

Antologjitë në mijëvjeçarin e ri reflektojnë mundësitë e zgjeruara nga njëra anë për projekte, nga ana tjetër për shikueshmëri në internet. Hartuesit më aktivë në fushën e antologjisë besoj pa dyshim janë Francesco Altimari dhe Anton Nikë Berisha, të cilët në bashkëpunim të dy ose më të tjerë ndër të cilët Vincenco Belmonte si përkthyes i kanë dhënë jetë disa antologjive të letërsisë

arbëreshe, të cilat në Itali janë botuar në variant dygjuhësh, kurse simotrat e tyre në Shqipëri ose Kosovë - vetëm në shqip.

Një shembull i njohjes anasjelltas është projekti në Lecce "Fisnikëria e shqiponjave" i realizuar nga N. Jorgaqi me parathënie të Sh. Sinanit me titullin *Antologia della letteratura albanese* , 2007. Në këtë libër me 478 faqe janë prezantuar kryesisht autorë të Shqipërisë pas viteve '60 - me 2-4 vjersha secili poet dhe me fragmente të shkurtra proze. Libri shoqërohet me fotografi dhe piktura që ilustrojnë artet pamore. Përkthimi i veprave në italisht u përket përkthyesve të ndryshëm dhe na bind se në këtë drejtim letërsia shqipe ka një rrugëdalje-autostradë të cilësisë së mirë dhe me shumë korsi.

Antologjia mesa dëshmojnë projektet online ofron mundësi mësimore për nxënësit dhe të rinjtë në Itali në kuadrin e konkurseve për krijimtari në gjuhën arbëreshe, të organizuara nga shoqata "Vatra Arbëreshe" de Chierri në Piemonte të Torinos. Aktivitete të tilla lejojnë edhe prezantime të denja në italisht të kulturës arbëreshe brenda përbrenda vendit ku lulëzon. Si projekte të dobishme mund të vlerësojmë edhe dy përmbledhjet e titulluara 'antologji' të Antonio Beluscit me tekste folklorike-etnografike, në të cilët lexuesi mund të njihet me të folurën arbëreshe, frazeologjinë dhe me përshkrimin e zakoneve në veshje, në të ngrënë, në martesa e vaje, termat e bujqësisë dhe të blegtorisë, si dhe me disa dorëshkrime arbëreshe të shek. XIX. E folura arbëreshe është e transkriptuar dhe e përkthyer në italisht. Këta libra njihen në bullgarisht nga projekti i përkthimit studentor për shkak të interesit që ofrojnë materialet e përmbledhura dhe për shkak të mundësisë së ndërmjetësimit të teksteve në prozë nga italishtja.

Përfundim: Antologjia mbetet një opsion i pëlqyer dhe/ose i përshtatshëm komunikimi me letërsinë arbëreshe për shqiptarët dhe italianët, shpesh edhe midis arbëreshëve të rajoneve të ndryshme brenda Italisë.

Bibliografi:

1896: Giloramo de Rada. *Antologia Albanese*. Napoli
1963: Ernesto Koliqi. *Antologia della lirica albanese*. Milano
1990: *Poezia e sotme arbëreshe*. Rexhep Ismajli. Prishtinë
1998: *Antologji e poezisë gojore arbëreshe. Antologia della poesia orale* arbëreshe. Transkriptimin F. Altimari. Përkthimin V. Belmonte Rubbettino, Soveria Mannelli, Catanzaro.
1999: *Antologji e poezisë gojore arbëreshe. Vetëm tekstet në arbërisht.* Prishtinë
1999: *Antologji e poezisë bashkëkohore arbëreshe*. Anton Nikë Berisha. Përkthimi dhe rishikimi i poezive në italisht Vincenco Belmonte, Universiteti i Kalabrisë.
2002: *Antologji e poezisë bashkëkohore të arbëreshëve të Italisë* Anton Nikë Berisha
2003: Antologji arbëreshe. Prozë dhe poezi gojore. Antonio Belusci.
2004: *Il Milosao di Gerolamo De Rada. Antologia*. Gennarro de Cicco.
2005: *Antologjia e konkursit për poezi në gjuhën arbëreshe*. Cucci Vincenco, Tomasso Campera. Torino.

2005: Mandalla, Mateo. *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia*. I-III (2005- 2007-2012)

2009: Altimari Francesco, Anton Nikë Berisha, Fiorella De Rosa, Vinçenc Belmonte. *Antologia della letteratura degli Albanesi di Calabria***.** Botimi i Universitetit të Kalabrisë .

2009: *Antologia degli autori frascineti. Caterina Adduci-Giulia Adduci.*

2011: Ferraro, Enrike. Bibliografia Arberesca - letteraria, linguistica, folklorica, storica, etnografica e artistica

Majlinda BREGASI, Universiteti i Prishtinës

NJË VEND PËR ANGELA CIRRINICONE-N NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE

Abstrakt. Angela Cirrincione është një emër pak i njohur sot në studimet albanologjike, edhe pse që nga viti 1957, kur për temë disertacioni mbrojti "Një vështrim mbi manualin e gjuhës shqipe të Auguste Dozon"e deri në fund të karrierës nuk hoqi dorë nga studimet mbi gjuhën dhe letërsinë shqipe. Tani që kemi në dorë arkivin e saj, mund të flasim më me kompetencë për kontributin e saj për shqipen. Në gjuhësi trajtoi çështje komplekse gramatikore, u morr me sintaksën e autorëve të vjetër, me semiotikë e semantikë, dialektologji etj.
Ndër punimet letrare përmendim veprën "Opere" vëllimi i parë, vepra më e plotë e Bernardin Palajt e botuar deri më tani, që përfshin 1180 vargje të përkthyera në italisht, La poesia di Jakova Merturi, I personaggi del romanzo "Shija e bukës së mbrûme" etj.

A është Angela Cirrincione albanologia e parë italiane?

Kontributi i grave albanologe të shekullit të kaluar shpesh mbetet i panjohur apo i pavlerësuar drejt në studimet e albanologjisë, edhe pse ka qenë një numër sosh të cilat kanë sjellë kontribute me vlerë[1]. Nga materiali që kemi në dorë, Angela Cirrincione (28.08. 1926, Palermo) na rezulton të jetë studiuesja e parë italiane që në qendër të punës së saj pati albanologjinë, para saj Cristina Genitle Mandalà ka kontribuar në përmbledhjen e folklorit[2]. Në punimin e parë të saj *La poesia di Jakova-Merturi (1957)*[3], Cirrincione bën një analizë kontrastive mes poezisë së Mërturit dhe poezisë europiane, konceptet e tij i krahason me ato të poetëve të Rilindjes italiane, te stili i tij gjen herë Leopardin, herë Polizano-n, për të analizuar pastaj imazhet e tij, ku gjen gjithë koloritin e pikturave të Botticelli-t. Që në këtë studim Cirrincione dëshmohet si studiuese e thellë dhe e apasionuar. Përmendim që në fillim që në studimet e saj ajo na e sjell gjithmonë tekstin në dy gjuhë, shqip dhe italisht të përkthyer nga vetë ajo.

Fusha e studimeve të Cirrinciones është e gjerë, duke nisur nga studimet letrare, folklori, te gramatika historike, edhe pse ajo mbetet kryesisht gjuhëtare në formimin e saj. Përmendim studimet *Sull'uso della negativa albanese "mos"*

---

[1] Uhlisch Gerda, Desnickaja, Agnija, Oda Buchholz ect.
[2] Petrotta, G., 2003, f. 72
[3] **1957**, Shejzât, Nr. 2-3, f. 65-69,

(1958), *Forme difficili e irregolari di alcune parti del discorso della lingua albanese* (1960), *Gjuha shqipe* (1961), *Sui Verbi albanesi* (1968) etj. Si njohëse e mirë e gjuhës së autorëve të vjetër, në 1968, boton *Sintassi Albanese degli antichi scrittori*, një studim komparativist i veçantë (Çapaliku, 2003, Bregasi, 2005). Përmendin faktin se Cirrincione prej vitit 1959 ka punuar në Katedrën e Filologjisë Gjermane, në universitetin e Palermos, dhe ka botuar librin studimor "Wulfila-La Bibbia gotica" të shoqëruar me fjalor komparativist (1970) dhe "Antologia di testi gotici con relativo dizionario comparativo", të cilin e ka lënë në dorëshkrim.

Çirrincione e filloi karierën akademike me shqipen, në 1952 u emërua Asistente vullnetare në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Palermos, pasi kishte diplomuar me temën "Uno sguardo al 'Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise' di Auguste Dozon", të udhëhequr nga Gaetano Petrotta. Cirrincione diskuton aty argumente të punës së Dozon-it, si Dozon e l'origine della parola "Shqip", ku e hedh poshtë tezën e tij, ashtu sikurse edhe të Šufflay-t,[4] Haxhit[5] etj duke e mbështetur në një numër të gjerë referencash. Për të dhënë hipotezën e saj të prejardhjes së emrit shqiptar, Cirrincione i referohet direkt letërsisë shqipe, autorëve si Budi te "Dottrina Cristiana",[6] "Shqip të mundënj me rrëfyem – ndonji kankë të re", Bogdani te "Cuneus Prophetarum" dhe këngës "Zani i Kasnecavet për të përfunduar: Si dhe kur u përdor ky emër si emërtim i kombit nuk e dimë. Mund të hedhim ndonjë hipotezë, duke u bazuar te rrethanat historike, se mund të ketë qenë një element patriotizmi nga ndonjë prift katolik për të mbajtur lidhur shqiptarët me njëri-tjetri, ata që kishin përkrahur besimin islam dhe ata që nuk donin të braktisnin besimin e të parëve […] Kjo fjalë u shpërnda nëpërmjet këngëve. […] Nuk ka asnjë dyshim se fjala përbëhet nga rrënja *shqip* dhe prapashtesa *tar* sikurse në kompozitat e tjera të këtij lloji që nga fillesat e letërsisë shqipe deri më sot.[7]

Cirrincione e mbështet arsyetimin e saj edhe në faktin se te Gustav Meyer dhe Kristoforidhi e gjejmë foljen 'shqipoj' me kuptimin 'kuptoj' nga latinishtja 'excipio'. Pra fjala *shqip* sipas saj duhet të ketë ardhur në këtë mënyrë direkt nga latinishtja gjatë pushtimit romak, ashtu sikurse e tregon edhe struktura e saj.

Dy kapitujt e tjerë trajtojnë tregimet dhe këngët popullore, ku ajo përveç

[4] Uno sguardo al 'Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise' di Auguste Dozon, f. 15.
[5] Po aty, f. 8.
[6] Po aty, f. 18.
[7] Vep. e cituar, f. 19.

diskutimit të gjerë teorik tregon edhe mangësitë e punës së Dozon-it, problemeve në përkthim, veçmas te këngët, ku ajo thotë se është bërë një përkthim "ad sensum". Cirrincione na jep përkthime origjinale të tri përrallave[8], të disa këngëve popullore[9] dhe të disa fjalëve të urta duke iu referuar direkt tekstit shqip.

"moj e mira që shkon me gjâ Tu, mia bella, che vai col gregge,
Lak më lak të njof më zâ" Ti conosco dalla voce

Cirrincione nuk hyn në analizën e pjesës së gramatikës së Dozon-it, pasi nuk i duket që e ka mjaftueshëm kompetencën shkencore për ta bërë atë.

1.Minoranze Linguistiche per l'Area Albanese di Sicilia

Fusha e studimeve të Cirrinciones është e gjerë, sikurse e thamë më sipër, për nivelin e tyre shkencor, po sjellim një pjesë nga letra që Tullio de Mauro i dërgon në 1972, ku në emër të Società di Linguistica Italiana i kërkon bashkëpunim për një studim mbi minorancën gjuhësore arbëreshe në Sicili:



SOCIETÀ DI LINGUISTICA ITALIANA
PALAZZO ANTICI MATTEI
VIA MICHELANGELO CAETANI, 32
00186 ROMA

Tel. 651.613

rigoroso accertamento scientifico dei fatti.
I rapporti così raccolti dal Servizio Studi verranno riuniti in un apposito dossier, firmati dai singoli autori e preceduti dall'indicazione del coordinatore (nel caso che questo sia diverso dall'autore dei rapporti) e da un suo eventuale rapporto di insieme. Questo materiale sarà posto a disposizione dei parlamentari interessati.
Nella lettera di invito, il Servizio Studi Le sarà preciso per quanto riguarda il compenso dei singoli collaboratori che Lei vorrà indicare (Le sarei grato se volesse darmi un cenno in proposito già in un'eventuale risposta a questa mia) e Suo, sia come nutrice che come collaboratrice.
Confido vivamente nella Sua accettazione. Sa meglio di me che il campo delle alloglossie è minato da mistificazioni di tutti i tipi, ed anche una sintesi informativa esige tutto l'impegno critico e documentario di cui Lei ci ha dato tante prove preziose.
Cordialissimi saluti dal Suo

Tullio de Mauro

Tullio De Mauro
Viale di Porta Tiburtina, 32
00100 Roma
Tel.4953835

P.S. Anzitutto per Sua informazione, ma anche nella speranza di metter subito a frutto la Sua preziosa collaborazione, Le allego la bozza di un appunto sulla nozione di 'minoranza linguistica' cui il Servizio Studi della Camera intende attenersi in queste indagini, e la bozza di una "traccia" di argomenti che per ogni Comune si vorrebbero trattati nei "rapporti" Suoi o dei collaboratori da Lei indicati. Le sarei vivamente grato se, nel rispondermi, si potesse già far pervenire osservazioni sull'una e sull'altra bozza, in modo che mi sia possibile proporre al Servizio Studi di tenerne conto.

P.P.S. Per Einaudi (o altri) Le scriverò a parte: dovremmo parlarne bene. La pago per ora, per questa lettera, di rispondermi (spero positivamente!) con la massima riservatezza. Non vorrei che qualcuno di là Le creasse difficoltà: ci terrei a che Lei, e non altri, facciano questo lavoro. Suo

Tullio

[8] Po aty, f. 35, 42, 47
[9] Po aty, f. 58, 69, 71, 73, 77, 80, 92

mitizime të të gjitha llojeve, ndaj qoftë edhe një sintezë informuese kërkon përkushtim kritik dhe të dokumentuar, gjë për të cilën ju na keni dhënë gjithë ato prova të çmuara. (arkivi i Cirrinicione-s)

Cirrincione e përfundon vetë projektin *Minoranze Linguistiche per l'Area Albanese di Sicilia,* në 1973**,** një studim 60 faqësh me informacion të ngjeshur e të dokumentuar me një bibliografi dhe një numër të konside-rueshëm informatorësh. Ajo fillon prej historikut të ardhjes së arbëreshëve për secilin vendbanim (ato historike dhe ato aktuale), zakoneve, dhënies së një pasqyre të shkrimtarëve për secilin katund deri te analiza gjuhësore të cilën shpesh e ilustron me transkripte dialogjesh dhe përrallash nga informatorë të ndryshëm. Theksojmë se në 1958 Cirrincione kishte botuar "Cenni storici sull' origine delle colonie albanesi di Sicila"[10] të cilën e pasuron me kërkime në terren. Informatorët e Cirrinciones janë kryesisht gra ku ajo me mprehtësi vëren më qartë huazimet nga italishtja qendron në një raport gjinor 15% : 40% për gratë.

Kemi të bëjmë këtu me dukurinë që në sociolinguistikë njihet si 'pasiguri gjuhësore' të studiuar nga Labov (1972) të cilën te emigrantët shqiptarë në Itali (Bregasi, Savoia, 2019) e kemi vërejtur në formën e përzgjedhjes së gjuhës së komunikimit (mes shqipes e italishtes), ku përqindja e grave që përzgjedhin italishten është më e madhe se ajo e burrave, gjë që rrjedh nga vlerësimi i italishtes si gjuhë prestigji nga ana e tyre.

Ndryshimi i shpeshtë stilistik i varianteve që tregohet nga klasa e ulët dhe e mesme, hiperndjeshmëria ndaj karakteristikave stigmatizuese të cilat ato vetë i përdorin dhe perceptimi i pakuruar i të folurit të tyre, gjithçka na sjell në shkallën e pasigurisë gjuhësore… pasiguria e madhe gjuhësore e këtyre folësve shpije te ndryshimet e shpeshta të normave të tyre në kontektet formale, madje edhe në moshën e mesme, ato kërkojë të përdorin në gjuhë bartësit e prestigjit… Kjo i bën gratë e klasës së mesme dhe të ulët që të zgjedhin 'hiperkorrektizmin' në përdorimin e varianteve të prestigjit. Labov (1972:132, 134)

Cirrincione del në përfundimin se përqindja e huazimeve te arbëreshët e Sicilisë varet nga mosha e informatorit dhe nga tema e bisedës, ndërkohë që vazhdon me një vlerësim përgjithësues të tipit: "Nuk ka asnjë ndikim nga klasa sociokulturore, pasi […] gjuha ka qenë dhe ende është folur nga të gjithë në familje, e trashëguar nga prindi. Pra ashtu sikurse flet një profesor arbëresh, një avokat, një prift, ashtu flet edhe një fshatar, një artizan, një grua shtëpiake. Për më tepër, në një dialog mbi jetën e përditshme hasim më shumë huazime, sesa

[10] Cirrincione, A., Cenni storici sull'origine delle colonie albanesi di Silicia, Centro Internazionale di Studi Albanesi di Palermo, 1958

në një përrallë sikurse E bukura fatë, te të rinjtë kemi 10% elemente leksikore të huazuara, ndërsa te gruaja 80 vjeçare, vetëm 1%. (Cirrincione, 1973: 60).

Vetë konfirmimi i fundit i Cirrincione-s tregon se nuk mund të kemi njëtrajtshmëri të gjuhës te folësit jo vetëm nga aspekti i moshës, por as nga aspekti social e kulturor, gjinor etj. Puna e saj ka dhe disa mangësi të tjera, si marrja e fjalës *mbrënda* (me kuptimin brenda në shtëpi) si kalk gjuhësor në të folmen e Santa Cristina Gela-s, ndërkohë që kjo fjalë përdoret me të njëjtin kuptim dhe në toskërishte.

2."Opere" Volume I - Poesie, vepra e Bernardin Palajt

Nga veprat më të spikatura të albanologes kam përzgjedhur botimin në italishte të *Opere* Volume I - Poesie, vepra e Bernardin Palajt, që përfshin 1180 vargje të përkthyera në italisht. Është një autopublikim nga autorja[11]. Nga intervista me të nipin Bumbola Pietro, i cili na ka dhuruar gjithë arkivin e Cirrinciones, mësuam se për financimin e botimit të veprës së Palajt, i ati i Cirrinciones shiti tokë.

Në shënimin që hap veprën Çirrinçone njofton se ky vëllim do të pasohet nga një vëllim i dytë, gjë që nuk u realizua. Gjithashtu ajo thekson vështirësitë e shumta që ka pasur gjatë përkthimit për shkak të imagjinatës së fortë shqipe, "aq të pasur dhe unike" saqë shpesh i është dashur të sakrifikonte natyrshmërinë e italishtes për t'i mbetur besnike vargjeve të mrekullueshme të Palajt.

Në hyrje Cirrincione ndërton një biografi të plotë të Palajt, më herët Koliqi kishte shkruar një biografi në "Kuq e zi – Epopeja e Flamurit" (Albanie Libre, n. 68)[12], pastaj përpiqet ta vendosë figurën e Palajt në kuadrin të letërsisë shqipe. Ndihet, thotë ajo, mungesa e një historie të plotë dhe objektive të letërsisë shqipe, që do të sintetizonte afinitetin kreativ të popullit dhe interpretuesve të tij[13]. Cirrincione citon si veprat më të plota të asaj kohe "Storia della letteratura albanese" të Schirò, Milano 1959, *Popolo, lingua e letteratura albanese* të Papas Gaetano Petrotta, 1931. Opera e Rrotës e 1925 *Letratyra shqype* ka mangësi analizën estetike, shkruan ajo, ndërsa dy vëllimet *Historia e Letërsisë Shqipe*, Tiranë 1959, shkruan se kanë injoruar figurat e mëdha si Fishta, Palaj,

[11] Opere, Bernardin Palaj, 1969, Cirrincione. Përfundoi shtypjen më 30 shtator 1969 nga Tipografia Dario Detti – Via Girolamo Savonarola, 1 – 00195 Roma.
[12] Po aty, 7
[13] Po aty, 10

Shantoja, Harapi, Koliqi etj[14]. Pastaj vazhdon me një pasqyrë të plotë të studimeve dhe shkollave letrare shqipe deri në atë periudhë.

Cirrincione analizon tri aspektet themelore të krijimtarisë së tij: Palajn poet, prozator dhe folklorist. Po ndalemi te Palaj poet pasi këtu kemi një vlerësim autentik të Cirrinciones, ndërsa në dy pjesët e tjera ndihet ndikimi i madh i Koliqit, madje te pjesa e folklorit Cirrincione sjell në italishte shkrimin e plotë *Nji rapsod i Alpevet Shqiptare - Frati i Kangve* nga Gazeta Shqiptare, Bari 1937 të Koliqit.

Si poet me origjinalitet të theksuar, Cirrincione e krahason Palajn me Carduccin. Përveç se letrar plot jetë, shkruan ajo, Palaj ishte edhe një muzikant i talentuar me një zë të mrekullueshëm. "*Këto talente ai i përktheu në vargje që shpesh tingëllojnë si nota muzikore. Nuk mund të thuhet nëse talenti i tij si lirik shfaqet më superior se ai epik, sepse krijimet e tij janë një alternim e gërshetim i të dy motiveve, të dy të realizuar mrekullueshëm. Por mjaft e fortë është tendenca epike, tipar i përbashkët i gjithë popullsisë së Shqipërisë së Veriut*"[15].

Në krahasimin që i bën Palajt me Gjeçovin e Fishtën, Cirrincione shkruan: Po çfarë ka Palaj nga malësori klasik, sikurse është Gjeçovi, dhe çfarë ka nga prototipi i poezisë popullore dhe refleksive, siç është Fishta? Sipas krahasimit horacian-senekian që qëndron në bazë të poetikës së Petrarkës, edhe Palaj si bletët ka thithur pjalmin e mjaft luleve, por mjalti që ka prodhuar i ka ruajtur të gjitha aromat e atyre luleve dhe gjëja e re që ka sjellë është një prodhim origjinal e unik i veti.[16]

Elegjinë *Kah nata e vetme* kushtuar Fishtës Cirrincione e vlerëson si një elegji universale. Kushdo që ka ndier dhimbjen nga humbja e një njeriu të dashur, të pazëvendësueshëm, gjen në këtë poemth shprehjen më të qartë, më të plotë, më të thellë të dhimbjes. Gjen në këto vargje si të skalitur zbrazëtinë që lë mbrapa ndarja, humnerën që lë në shpirt e në shtëpi, qetësinë që ndihet në çdo gjë që ka nostalgji për të[17]. Për cilësinë e përkthimit në italishte të veprës së Palajt u mbetet studiuesëve të japin vlerësimin e tyre.

3.Immaginificazione idiomatica albanese

Imagjinata e fortë idiomatike e shqipes, botuar në pesë numra të *Shêjzave*, është një fjalor idiomatik i përbërë nga 282 zëra. Shpjegimet përfshijnë një korpus prej 1133 njësish frazeologjike, struktura të përafërta me to ose me

[14] Po aty, f. 9-10
[15] Vep e cituar, f.12
[16] Po aty, f. 12
[17] Po aty, f.13

prirje drejt tyre, sintagma me një gjymtyrë të figurshme dhe përdorime praktike të fjalëve por gjithnjë me ngyrim të figurshëm.

Secili shpjegim i zërave shquhet nga ekspresiviteti i stilit të Cirrinciones, pasioni që e karakterizon kur ndeshet me shprehjet e veçanta të shqipes, të cilat shpesh mundohet t'i shpjegojë duke dhënë shprehje ekuivalente nga italishtja, dialektet apo nga latinishtja. Korpusi bazohet te vepra e Fishtës, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Jakova Merturi etj. Fjalori nuk është shoqërohet nga ndonjë shënim i autores kështu që nuk dihet nëse ka shfrytëzuar edhe fjalorë të tjerë të këtij lloji apo është bazuar vetëm në literaturën shqipe që ka disponuar, pra mbetet për t'u hulumtuar. Ajo çfarë i jep një rëndësi të veçantë këtij fjalori është nxjerrja në dritë e shumë fjalëve të vjetra e shprehjeve idiomatike të formuara me to.

Në rastin e zërit ferrë, në shprehjen 'i bâhet ferra Brahim" kemi edhe një shpjegim të tillë të Cirrinciones "*kështu ma shpjegoi me gojë profesor Gurakuqi*" kur jep historikun e shprehjes.

Duke i kërkuar disa prej zërave të Cirrinciones te fjalori etimologjik i Topallit, shihet dallimi që vjen nga plotnia e shpjegimeve dhe shprehjeve të dhëna në kontekst. Të dyja veprat janë bërë për dy qëllime të ndryshme, por krahasimi na shërben për të parë ekpresivitetin e stilit të Cirrinciones.

Cirrincione: *agzot*-i, pluhur baruti: "*por gjith synin flakë e agzot*" (Fishta). Krahasimi shpreh imazhin e syrit të ndezur zjarr si reflektim i një gjendjeje nervozizmi dhe një ngarkese emocionale gati për të shpërthyer. Përdorimi i fjalës *agzot* si dhe flakë me ngjyrim ndajfoljor i jep forcën e duhur krahasimit. Ndërsa te Topalli kemi këtë shpjegim: "*barut i imët, që vihet në bubëzën e armëve me strall*", fig. "*shkëndijë, zjarr*"; Fishta: *Sy n'agzot, zêmren barot* (LM). Fjalë e vjetruar, meqënëse nuk përdoren më armë të tilla.

Fjalën *nur* Topalli e jep kështu: "*Shprehja e fytyrës, hijeshi*". Fjalë e mbarë gjuhës. Huazim nga turq. *nur* "dritë, shkëlqim" me burim prej arabishtes. Ndërsa Cirrincione na jep një kuptim tjetër: *nur*-i, hi, fjalë me origjinë turke, që përdoret në fjalinë *me bâ nuri*. Bëj hi, e shndëroj në hi. "*Asht si qytet prej ânmikut banum nuri*" (Jakova Merturi).

Te Cirrincione gjejmë gjithashtu fjalë të cilat nuk përfshihen te fjalori i Topallit si: *lmajë-a***,** acro: me e lânë punën lmajë, t'i lësh gjërat varur.

*Kakujë- a***,** veshika: morri i huej t'a çon kakujë. Gjëja e tjetrit të krijon shqetësime.

4."Sintassi Albanese degli antichi scrittori"

Sintaksa shqipe e autorëve të vjetër është vepra më e rëndësishme e

Cirrinciones në fushën e gramatikës historike, ku ajo jo vetëm tregohet njohëse e mirëfilltë e shqipes së vjetër, por shfaq edhe gjithë dijen e saj si filologe për një analizë të mprehtë të teksteve. Kemi të bëjmë me një sintaksë komparative të gjuhës së autorëve të vjetër, ku përveç krahasimit të njësive sintaksore të tyre Cirrinicone bën krahasimet edhe me njësitë paralele latine, greke e gote. Për shembull në shpjegimin e kohës së ardhme të shqipes me ndërtim perifrastik: e tashme e dëftores së foljes *me pasë + infinitivi i foljes, Ëndima eme **ka me m'ardhunë** prej s'ime Zot* (Buzuku), e krahason me strukturën latine amare-habeo, ***amabo*** (do të dua) dhe atë gote ***taujan haba*** (do të veproj)[18]. Janë këtu mjaft interesante edhe përdorimet e veçanta gjuhësore që Cirrincione nuk i lë pa i vënë në pah, si për shembull kur kemi përdorimin e lidhores me kuptimin e së ardhmes: *Hinje se ëndë bark t'at **të zihete** e ti **të lenjësh** një bir …(Buzuku),* që dëshmojnë për një njohje të mirëfilltë të shqipes së vjetër.

Në këtë sintaksë Çirrinçone kalon nga analiza sintaksore në atë morfologjike. Konceptet teorike janë dhënë të shoqëruara nga shembuj konkretë:

*E përap*ë renegoi Pjetri (Buzuku)
Pietri prá e mohói përsëri (Kristoforidhi)[19]

Kjo sintaksë ka vetëm 115 faqe, ku informacioni është i ngjeshur dhe veçanërisht i përqendruar te dhënia e përkufizimeve (jo gjithherë) dhe te shembujt konkretë, gjë që bën që kjo sintaksë të ketë edhe një karakter praktik që ndoshta mund të ketë qenë edhe qëllimi i saj. Sintaksa është e ndarë në dy pjesë, në pjesën e parë jepen elementet themelore të fjalisë së thjeshtë, por një vend i veçantë i kushtohet nyjes dhe rasave, pjesa e dytë, e cila fillon me foljen dhe format nominale të saj, i kushtohet tërësisht periudhës.

Në analizën që i bën fjalisë është përqendruar te dy gjymtyrët kryesore (subjekti dhe predikati) dhe nga gjymtyrët e dyta ka trajtuar përcaktorin dhe ndajshtimin. Gjymtyrët e tjera janë lënë jashtë një trajtimi të posaçëm, edhe pse do të përmenden në momente të ndryshme të shtjellimit sintaksor që bën autorja.

Kur është përballë çështjeve që përbëjnë edhe tipare të veçanta të shqipes, si çështja e papavendosjes së nyjës për shembull, Çirrinçone jep shpjegime më të hollësishme duke kaluar në rrafshin komparativist.

5.Epistolari

Fakti tjetër ku do ndalesha është epistolari i saj me figura të rëndësishme të albanologjisë në Itali si Koliqi, Gurakuqi, Marlekaj etj nga ku mësojmë fakte

[18] *Sintassi Albanese degli antichi autori*, Cirrincione,1968, fq. 63
[19] Vep e cituar, f. 16

interesante jo vetëm mbi jetën e lidhjen e fortë mes tyre, por gjejmë edhe ndonjë punë të pabotuar, një dorëshkrim pa emër autori e mbi të gjitha një Angela tejet të dëshpëruar, e cila ndihej e përjashtuar si nga katedrat e shqipes në Itali, ashtu edhe nga ato të filologjisë. Nuk kam më asnjë motiv, shkruan ajo në 1997. Shkrimin e saj të fundit të botuar e gjejmë te Shejzât, pas vdekjes së Koliqit, 'Skutari, piange con me' (Shkodra qan me mua), një elegji e shkruar me dhimbje të madhe për mikun, punën kolosale të të cilit Shqipëria e izoluar nën diktaturë nuk e njihte. Për epistolarin dhe dorëshkrimet e gjetura në arkiv do të përgatisim një punim tjetër.

Bibliografia

Bregasi, Majlinda, 2005, Kontributi i Angela Cirrincione-s, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, Universiteti i Prishtinës.

Bregasi, Majlinda., Savoia, Leonardo., 2018, Gjuha shqipe dhe identiteti i emigrantëve shqiptarë në Itali, Shejzât 3- 4,

Cirrincione, Angela, në Shejzât: *La poesia di Jakova-Merturi [1]*. I/1957, Nr. 2-3, ff. 65-69.

***La desinenza* –sh *nella declinazione albanese.* – II/1958, Nr. 5-6, ff. 171-173.**

- *Addentellati fra i giuochi popolari albanesi e quelli siciliani* [*Qiri mbi qiri/*Il cero sul cero – *Na ket babgjysh/*Ecco questo nonno]. – II/1958, Nr. 9-10, ff. 314-317.
- *Addentellati fra i giuochi popolari albanesi e quelli siciliani.* II/1958, Nr. 11-12, ff. 398-405.
- *"Gjuha shqipe".* – V/1961, Nr. 11-12, ff. 472-476.
- *L'Albanese nell'indoeuropeo.* – VI/1962, Nr. 9-10, ff. 313-317.
- *I personaggi del romanzo "Shija e bukës së mbrûme".* 1963, n.5 - 6 -7- 8
- *Immaginificazione idiomatica albanese* [Abe-ja – Bollë-a]. VIII/1964, Nr. 3-4, ff. 107-110.
- *Immaginificazione idiomatica albanese* [Borë-a – Dhí-ja]. IX/1965, Nr. 1-2, ff. 21-26.
- *Immaginificazione idiomatica albanese* [erë-a – hije-ja]. IX/1965, Nr. 5-6, ff. 170-177.
- *Immaginificazione idiomatica albanese* [hjekë (me) kurriz-i]. X/1966, Nr. 5-6, ff. 169-172.
- *Immaginificazione idiomatica albanese* [lá (me) – zhár-i]. XI/1967, Nr. 9-12, ff. 356-377.
- *Sui verbi albanesi* [Coniugazione mista – Verbi irregolari o con apofonia]. XII/1968, Nr. 7-12, ff. 321-330.
- *P. Giuseppe Valentini nella figura di "Maestro".* XIV/1970, Nr. 10-12, ff. 386-390 me fot.
- **"Vajtim" a Ernest Koliqi – *Scutari, piange con me!* [XIX/1978], nr. Përkujtimor, ff. 52-54.

-1958, Sull'uso della negativa albanese "mos", estratto da "Ricerche linguistiche" Bolletino dell'Istituto di Glottologia dell'Università di Roma, IV.

- *1960, Forme difficili e irregolari di alcune parti del discorso della lingua albanese,* Centro Iternazionale di Studi Albanesi, Tip. Boccone del Povero, Palermo.
- *1968, Sintassi albanese degli antichi scrittori,* Tip. D. Detti, Roma.
- 1968, Bernardin Palaj – Opere – Volume I Poesie, Tip. D. Detti, Roma.

Çapaliku, Alfred, 2003, Alfabeti i munguar, Shkodër.

Petrotta, Gaetano, 2003, Popolo, Lingua e Letteratura Albanese, Studi di storia e letteratura albanese, Palermo.

Labov W. 1972a, *Language in the Inner City*, University of Pennsylvania Press, Philadelphia.
Labov W. 1972b, *Sociolinguistic patterns*, University of Pennsylvania Press, Philadelphia.
Topalli, Kolec, 2017, Fjalor Etimologjik i Gjuhës Shqipe, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Berton SULEJMANI, Universiteti i Tetovës

FRANCESCO ALTIMARI PËR HABITOREN

Abstrakt. *Në këtë punim do të trajtojmë kontributin e Prof. F. Altimarit për gjuhën shqipe në përgjithësi e në veçanti për mënyrën habitore të saj. Habitorja nuk gjendet në asnjë të folme arbëreshe të Italisë, sepse në shekullin XV si duket ende ishte në rrugën e formimit dhe e kryera e "supozimit", në rrethin e sistemit foljor të arbërishtes do të përfaqësonte "bërthamën" e parë të kësaj mënyre të foljes. Pikërisht për këtë arsye, punimi ynë kap edhe vëzhgimet e tij për të kryerën e "supozimit" të arbërishtes për të cilën dukuri një kontribut të theksuar, madje të parë, e jep edhe studiuesi Valter Breu (Walter Breu), i cili ka theksuar ngjyrimin modal dhe pikërisht "supozues" që ka fituar e kryera, përfaqësuar nga ndërtimi analitik kam + pjesore, në disa të folme arbëreshe. Një dukuri të tillë Breu e ka vendosur në rrethin e një zhvillimi "të brendshëm" të arbërishtes së Italisë, që do të jetë ndihmuar nga kontakti gjuhësor me të folmet romane italo-jugore, por në disa nga to mungon fare e kryera, e cila është zëvendësuar nga aoristi (e kryera e thjeshtë). Duke qenë se para Breut s'kemi asnjë studim, që do të shpjegonte gjendjen dhe përhapjen e kësaj dukurie në arbërishte, Profesor Altimari bëri një hulumtim për disa vite në Kalabri, Bazilikatë dhe Sicili, përkatësisht në të pesëdhjetë të folmet arbëreshe ende të gjalla, duke përdorur përmbledhjet e botuara me material gjuhësor, studimet me 'karakter më të veçantë dialektologjik të cilat i përmbledh në një hartë nga e cila shihet dukuria e përhapjes të së kryerës "së supozimit".*
Fjalë kyçe: mënyra habitore, e kryera e "supozimit", të folmet arbëreshe, shqipja, arbërishtja, bullgarishtja e maqedonishtja.

Prej kohësh kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve trajtat e habitores së foljeve, për shprehësinë e lartë dhe ngjyrimin stilistik që i përçojnë fjalisë. Gjatë viteve '70, E. Lafe[1], duke i bërë jehonë një këshille të K. Cipos, shkruante se "për më tepër duhet kërkuar se trajtat e habitores të përdoren më dendur prej shkrimtarëve, publicistëve e përkthyesve, sepse i japin ligjërimit gjallëri dhe hijeshi, një të veshur e frymë shqipe[2]. Ndër ata studiues të njohur, vendas e të huaj, që janë marrë me studimin e foljeve të gjuhës shqipe në përgjithësi, veçanërisht në aspektin sinkronik, pa dyshim që vendin qendror e zë prof. Selman Riza me veprën "*Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*", hartuar që në vitet '60, por botuar së pari më 1994 dhe është përfshirë në vëllimin e dytë të veprave të tij, të botuar në Prishtinë më 1997.

Është e kuptueshme se habitorja është më e pëlqyeshme dhe më e përdorshme në gjuhën e letërsisë artistike dhe sidomos në prozën artistike, sepse

---

[1] Emil Lafe, *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*, SF 2, 1975, f. 146.
[2] Kostaq Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 143.

kjo e fundit mbështetet në ligjërimin në trajtë dialogu, monologu etj. Sidomos letërsia për fëmijë është mjaft e ndjeshme ndaj trajtave të habitores së foljeve që shprehin më fort befasi, çudi për një veprim të papritur. Veçanërisht përrallat, ku fjalitë e shkurtra nxitëse a pyetëse janë aq të shpeshta. Kjo është e natyrshme dhe në pajtim të plotë dhe me një karakteristikë të rëndësishme të fëmijëve, komunikimin emocionues, shprehjen e ndjenjave pa atë stërhollim, që ndodh më vonë te të rriturit. Në vitet '80 M. Ymeri[3] shkruan se edhe poezia, e cila i pohon idetë e bindjeve nëpërmjet përjetimeve e arsyetimeve, po i përfshin trajtat e habitores si mjete të frytshme stilistike.

Gjuhë shqipe ka një sistem shumë kompleks foljor. Ky sistem i shqipes është shumë i pasur në forma dhe mjaft i dallueshëm. Ai përmban forma *sintetike* si dhe struktura *analitike* e *gjysmanalitike*. Profesor M. Domi[4] shkruan se mjaft forma janë pasojë e përngjitjes së shprehjeve *perifrastike*. Elementet morfologjike të vjetra këtu janë ruajtur më mirë se sa në sistemin emëror dhe pikërisht për këtë arsye lidhjet me sistemin foljor indoevropian kapen më me lehtësi.

Shqipja njeh gjashtë mënyra të shtjelluara: *dëftoren, lidhoren, urdhëroren, kushtoren, habitoren* dhe *dëshiroren* dhe tri kategori formash të pashtjelluara: *pjesoren, paskajoren* dhe *përcjelloren*.

Habitorja është një ndërtim i veçantë foljor i shqipes, i cili si i tillë nuk haset në gjuhët tjera indoevropiane. Koha e tashme dhe koha e pakryer e saj janë formuar me përngjitje nga një formë analitike e përbërë nga pjesorja e shkurtuar e foljes që zgjedhohet dhe format vetore të së tashmes, gjegjësisht të së pakryerës të foljes ndihmëse *kam*, me fjalë të tjera, për nga formimi ajo është një e kryer e përmbysur: *lidhkam* < *lidhë* + *kam*: *lidhke, lidhka* etj.

Veç studiuesve të njohur, vendës e të huaj, si: E. Çabej, I. Ajeti, S. Riza, Sh. Demiraj, B. Bokshi, K. Topalli, N. Jokl, A. Desnickaja, W. Fidler, V. Fridman etj., në këtë mes, një vend të rëndësishëm zë edhe kontributi i Françesko Altimarit për të kryerën e "supozimit", përkatësisht studimi i tij me titull "*Vëzhgime për të kryerën e "supozimit" të arbërishtes dhe për formimin e habitores të shqipes*[5]*"*.

Profesor F. Altimari në artikullin e tij për të kryerën e "supozimit" të arbërishtes, tezën e dytë[6] për krijimin e habitores nën ndikimin e turqishtes në

[3] Mariana Ymeri, *Çështje të stilit dhe të normës në trajtat e habitores*, GJJ 1, 1988, f. 14.

[4] Mahir Domi, *Shqipja dhe struktura e saj gramatikore*, SF 3-4, 2001, f. 13.

[5] Francesco Altimari, *Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, ASHAK (botime të veçanta), libri 51, Prishtinë, 2014, f. 11 – 25.

[6] Për origjinën e habitores janë shfaqur tri teza kryesore. Mbështetësit e tezës së parë mendojnë habitoren zhvillim të brendshëm të gjuhës shqipe, por ndahen në qëndrimet e tyre për burimin nga i cili janë krijuar format e habitores. Këtë tezë e mbështetin: N. Jokli, Sh.

strukturën gramatikore të shqipes dhe gjuhëve sllave të Ballkanit, e kundërshton dhe mban qëndrimin e Fidlerit[7] e që ky i fundit është i mendimit se habitorja është krijuar si pasojë e ndikimit të ndërsjellë në gjuhët e Ballkanit (gjuha shqipe në njërën, bullgarishtja e maqedonishtja në tjetrën anë).

Në Kongresin ndërkombëtar të studimeve shqipe të zhvilluar në Mannheim, në qershor të vitit 1987, për këtë dukuri, pra për dukurinë e "supozimit", çuditërisht e panjohur deri në atë kohë nga studiuesit që janë marrë me arbërishten, u interesua në mënyrë të thelluar dhe dha kontribut Walter Breu. Ai ka theksuar ngjyrimin modal dhe pikërisht "supozues" që ka fituar e kryera, përfaqësuar nga ndërtimi analitik *kam* + pjesore, në disa të folme arbëreshe. Një dukuri të tillë Breu e ka vendosur në rrethin e një zhvillimi "të brendshëm" të arbërishtes së Italisë, që do të jetë ndihmuar nga kontakti gjuhësor me të folmet romane italo-jugore, në disa nga të cilat mungon fare e kryera, e cila është zëvendësuar nga aoristi (e kryera e thjeshtë).

Kjo gjë, pra mungesa e një studimi të tillë, Altimarin do ta nxit që të bëjë një hulumtim të thellë shkencor dhe të shpjegojë gjendjen dhe përhapjen e kësaj dukurie në arbërishte. Paraprakisht, këtë punë e nisi me një vështrim në të pesëdhjetë të folmet arbëreshe ende të gjalla, duke përdorur përmbledhjet e botuara me material gjuhësor, studimet me 'karakter më të veçantë dialektologjik si dhe rezultatet e disa kërkimeve "në terren", që i bëri për disa vite në Kalabri, Bazilikatë dhe Sicili. Ai vërejti se habitorja nuk paraqitet në të folmet e arbëreshëve në Itali dhe Çamëri, por në 37 të folme arbëreshe të përhapura në Italinë jugore, me përjashtim të Sicilisë ku shfaqet një dukuri që mund të ndërlidhet me habitoren e shqipes. Në këto të folme, forma analitike dhe ajo sintetike e së shkuarës nuk janë në kundërvënie kohore, por modale dhe përdoren për të treguar një veprim "të sigurt" e të "pasigurt" që ka ndodhur në të shkuarën. Forma analitike, duke u mbështetur në autorin po i referohem si "e kryera e supozimit", mund të përdoret vetëm në vetën e tretë për të shprehur një informatë të pasigurt (khs. shembujt nga punimi i Altimarit[8]): *ai shkruajti* (në

Demiraj, I. Ajeti, K. Topalli, B. Bokshi. Teza e dytë është ajo e krijimit të habitores nën ndikimin e turqishtes në strukturën gramatikore të shqipes dhe sllavishtes së Ballkanit. Këtë tezë e mbështesin: V. Fridman, Conev, Golab, B. Koneski. Fidler dhe Çabej mendojnë se procesi i formimit ka përfunduar rreth viti 1600, ndërsa Ajeti, Bokshi, Demiraj e Topalli kanë qëndrim tjetër: se habitorja është krijuar në periudhën parashkrimore të shqipes. Prania e habitores në tekstet e autorëve të vjetër veriorë mbështet këtë tezë.

[7] Blertë Ismajli, *Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja*, Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK, Prishtinë, 2012, f. 745.

[8] Francesco Altimari, *Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe evropian*, AShAK, Prishtinë, 2014, f. 12.

shqipen letrare *ai shkroi)* "ai shkroi" ~ "ai ka shkruar", ndërsa *ai ka shkruar* ka kuptimin "ai ndoshta ka shkruar".

Ndërtimi analitik *ai ka shkruajtur* i përkthyeshëm me shprehjen "*ai ndoshta ka shkruar, ai do të ketë shkruar*", përkon me atë që De Rada tashmë në gramatikën e tij të shqipes të vitit 1870 (e para gramatikë e shtypur për arbërishten) për herë të parë kishte përcaktuar si "e shkuar dyshimore". Këtë ndërtim sintaksor, Altimari e sheh si formë të konservuar në të folmet arbëreshe me prejardhje ballkanike e cila pasqyron një fazë të ndërmjetme në procesin e krijimit të habitores në gjuhën shqipe. duke e mbështetur tezën e Fiedler-it, shpreh idenë se kjo formë është krijuar si pasojë e ndikimit të ndërsjellë ndërmjet gjuhëve ballkanike në kalimin e përbashkët nga një e kryer e vjetër (kam+pjesore në gjuhën shqipe, pjesore –l+jam në gjuhët sllave) në një mënyrë të re. Kundërshton tezën e ndikimit të gjuhës turke sepse ngulimet osmane në gjysmën e shek. XV, kur filloi krijimi i bashkësive të para arbëreshe, ishin të paqëndrueshme dhe s'mund të kenë ndikuar shumë dhe sepse periudha e shkurtër kohore e sundimit osman e pamundëson ndikimin e thellë në gjuhën shqipe deri në sistemin sintaksor duke pasur parasysh se turqishtja ishte në pozicionin e superstratit. Në anën tjetër, të folmet arbëreshe janë më tepër ishuj gjuhësorë të shkëputur territorialisht nga njëri-tjetri. Prandaj e kryera e supozimit nuk mund të konsiderohet zhvillim autonom nën ndikim të ndërsjellë të të folmeve në njëra-tjetrën.

Në fund, nga konteksti më i përgjithshëm i vrojtimeve të shprehura në këtë punim, mund të nxjerrim përmbledhtas këto përfundime:

a) e kryera e "supozimit" duhet quajtur një arkaizëm, një element i ruajtjes së sistemit foljor të shqipes së shekujve XV-XVI, e sjellë me vete nga arbëreshët e Italisë dhe jo një element risie, një zhvillim modal "i brendshëm", gjoja i ndihmuar ky edhe nga ajo që, në dialektet romane jugore, me të cilat të folmet arbëreshe kanë qenë në kontakt për pothuaj gjysmë mijëvjeçari, një kohë e tillë ndeshet rrallë;

b) e kryera e "supozimit" e arbërishtes së Italisë, bashkë me të shkuarën e supozimit, gjurmë të së cilës gjenden edhe në shqipen e Shqipërisë përveç se në sistemin foljor të gjuhëve sllave jugore, do të përfaqësonte një izogramatizëm ballkanik, zhvilluar mbi bazën e së kryerës së vjetër analitike brenda sistemit të gjuhëve ballkanike në një zonë kontakti të ndërsjellë shqipo-sllav dhe jo nga ndikimi i turqishtes;

c) e kryera e "supozimit", që gjendet në arbërishte, po edhe në disa dialekte gege të qyteteve të Shqipërisë Qendrore, për këtë arsye do të përbënte

pikën e nisjes të atij procesi që ka sjellë, ca kohë pas emigrimit të arbëreshëve në Itali, formimin në shqipen e përbashkët të mënyrës habitore.

Në fund, Profesor Altimari pohon se habitorja nuk gjendet në asnjë nga 50 të folmet arbëreshe të Italisë, sepse në shekullin XV ka të ngjarë që kjo mënyrë e re ishte ende në rrugën e formimit dhe kështu e kryera e "supozimit", në rrethin e sistemit foljor të arbërishtes do të përfaqësonte "bërthamën" e parë të kësaj mënyre të foljes, që u formua pastaj në shqipen e përbashkët përmes gramatikalizimit të ndërtimit analitik të së kryerës të përmbysur dhe zgjerimit të funksionit të papërcaktueshmërisë që është i rrënjosur në këtë kohë foljore.

Literatura e shfrytëzuar:

Lafe, Emil: *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*, SF 2, Tiranë, 1975.

Ajeti, Idriz: *Historia e gjuhës shqipe*, ASHAK, Prishtinë, 1998.

Altimari, Francesco: *Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*, ASHAK (botime të veçanta), libri 51, Prishtinë, 2014.

Cipo, Kostaq: *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.

Demiraj, Shaban: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002.

Domi, Mahir: *Shqipja dhe struktura e saj gramatikore*, SF 3-4, Tiranë, 2001.

Ismajli, Blertë: *Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja*, Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK, f. 473 – 483, Prishtinë, 2012.

Ismajli, Rexhep, Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik, ASHAK, Prishtinë, 2015.

Riza, Selman: *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Vepra 2, ASHAK, Prishtinë, 1997.

Rugova, Bardh: Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë, ASHAK, Prishtinë, 2019.

Ymeri, Mariana: *Çështje të stilit dhe të normës në trajtat e habitores*, GJJ 1, Tiranë, 1988.

Лаброска, Веселинка: *Начини на изразување на адмиративот во западното македонско наречје*, Меѓународен македонистички собир: реферати од научниот собир одржан 29-31 август 2008 г. во Охрид.

Фридман, Виктор: *Дијалектна основа, варијација и кодификација на балканските литературни јазици: албански, бугарски, македонски, ромски*, XVII научна дискусија: Охрид, 13-15 август 1990 година.

Emilia CONFORTI, Università della Calabria

IL CONTRIBUTO DI SANTORI PER LA LINGUA ALBANESE

Ogni volta che affiora, in un modo o nell'altro, la questione della lingua, ci si trova di fronte ad alcuni interrogativi: la formazione della classe dirigente, la necessità di stabilire rapporti personalizzati e sicuri nella società e riorganizzare l'egemonia culturale.

(Antonio Gramsci: 1950)

Abstrakt. Qëllimi i këtij studimi është abaliza e organizimit të çështjes së gjuhës shqipe në Itali që në shekullin e kaluar u ndje veçanërisht nga figurat kryesore të skenës kulturore dhe letrare arbëreshe dhe vazhdoi edhe sot nga shkrimtarë, gazetarë , gjuhëtarë dhe historianë të letërsisë. Puna e gjuhës është e vështirë për shkak të leksikut që gjuha e ka të disponueshëm.
Me Santorin gjuha merr ngjyrat në të cilat lexuesi mund ta gjejë gjuhën e tij, veçanërisht në leksikun që ka një pasuri të jashtëzakonshme dhe përqafon një numër më të madh variantesh sociale.

1. Introduzione

Lo scopo di questo studio è quello di analizzare il tentativo dell'organizzazione della questione della lingua albanese in Italia che, nel XIX secolo, fu particolarmente sentito da personaggi di spicco del panorama culturale e letterario italo-albanese. Da qui l'indagine su uno degli esponenti che più hanno contribuito all'affermarsi dell'uso scritto della lingua italo-albanese, Francesco Antonio Santori[1].

Gli scrittori di minoranza linguistica storica albanese hanno dovuto fare i conti non solo con la mancanza di una lingua unitaria delle comunità albanofone in Italia, ma anche con l'assenza di una variabilità diafasica e diamesica,

[1] F. A. Santori nacque a Santa Caterina Albanese nel 1819 e morì a Cerzeto nel 1894. Fu considerato una delle più importanti personalità arbëreshe. Egli venne avviato agli studi dal parroco del suo paese d'origine e successivamente entrò nel convento francescano di San Marco Argentano. Più tardi fu costretto ad abbandonare la vita monastica per dedicarsi al sacerdozio nel suo paese natio dove viveva di lezioni private e di vendita di filatoi di sua invenzione. All'età di 57 anni venne nominato parroco di San giacomo di Cerzeto dove riesce ad ottenere dal sindaco un appezzamento di terreno da coltivare per il proprio sostentamento. Molto sensibili agli eventi nazionali del tempo scrisse di brigantaggio, di repressione del governo unitario, di movimento patriottico calabrese oltre che di narrativa, dramma, lirica. Conosce il movimento culturale italo-albanese e il suo iniziatore De Rada e da qui inizia a scrivere in arbëresh.

dal momento che le varie parlate erano cristallizzate sul registro familiare. La necessità è stata dunque dover forgiare uno strumento espressivo adatto alle proprie esigenze linguistico-letterarie.

La questione linguistica, com'è noto, è sempre in fase di rinnovamento per riuscire a trovare e diffondere una lingua dal forte valore identitario e che sul piano sociale rappresenti un efficace strumento comunicativo. Certo, che la questione della lingua non potrà mai risolversi in modo assoluto: la lingua usuale, infatti, ingloba termini da sempre in uso e comprensibili a tutta la comunità di riferimento mentre la lingua scritta e la sua struttura grammaticale e lessicale utilizza strutture specifiche, letterarie e tecniche cariche di significati nuovi e neologismi che certamente affascinano i lettori.

2. La lingua arbëreshe scritta

Il processo storico di formazione della lingua arbëreshe in forma scritta presenta aspetti complessi e peculiari, che ne fanno un caso particolarmente ricco per le riflessioni sui rapporti tra realtà sociale, dimensione politica, tradizioni culturali e funzioni della lingua.

Nel XIX secolo, Santori ha sentito l'esigenza di rendere un registro letterario che non avesse confini locali e si determinasse come lingua "colta". Naturalmente la scelta di questa lingua scritta era esclusivamente una scelta letteraria, in quanto solo una piccola parte della popolazione sarebbe stata in grado di leggerla, nonostante ciò sarebbe riuscita a collocarsi come lingua di cultura anche in assenza di una specifica entità politica di riferimento, essendo minoranza in stato straniero.

La lingua degli arbëreshë è stata essenzialmente una lingua orale, fatta di racconti popolari e lingua del focolare. Già prima di Santori, altri scrittori quali Matranga, che fu l'autore della prima opera scritta, Variboba, Serembe e De Rada utilizzarono le varie parlate albanesi locali nelle loro opere, aprirono la strada al costituirsi della lingua scritta.

Con Santori la lingua scritta assume le coloriture in cui il lettore si può ritrovare, per ciò che riguarda il lessico, egli presenta un vocabolario straordinariamente ricco che abbraccia la popolazione legata alla lingua orale e la popolazione colta, utilizza una lingua mista di grecismi, latinismi, italianismi, neologismi e più di una varietà linguistica albanese d'Italia[2]. In Santori, dunque,

[2] Santori frequentò diverse comunità alfanofone: San Benedetto Ullano, San Martino

vediamo riassunto tutto il patrimonio linguistico della sua epoca.

L'arbëresh era un registro familiare tramandato oralmente e per questo conservatore rispetto alla lingua albanese d'oltremare, infatti ne manteneva le caratteristiche fonetiche, grammaticali, sintattiche e lessicali, con le quali non era in grado di esprimere un qualsivoglia concetto. Il processo linguistico-letterario successivo servì appunto per espandere le risorse linguistico-espressive della lingua arbëreshe.

Ad ogni modo, la cosiddetta "questione della lingua", nelle comunità albanesi d'Italia, come nella lingua italiana, è sempre stata una questione relativa alla lingua letteraria. Il Santori, nel manoscritto B_2 del saggio *Su articolo etnografico,* scrive: "Voglio lusingarmi che non saranno per sembrare strani questi miei sforzi, tendenti a dar vita letteraria ad una lingua abbastanza classica, almeno per la sua antichità e per le grandi memorie che le si accoppiano, e per le gravi peripezie che gravano le genti, da cui ella, attraverso delle anfratte guerresche, del tempo delle transmigrazioni, è conservata tutt'ora viva/ fresca, vergine e adorna di specifiche e belle forme. Sol dunque per voglia di non abbandonare al totale deperimento, senza monumento di rimembranza, questo fatto Etnografico, che pur potrebbe in tal modo riuscire proficuo, mi sono occupato ad ordinare questi cenni Grammaticali, traendoli dal fondo della lingua parlata". Il suo estenuante impegno è stato quello di rendere la situazione linguistica il più possibile omogenea, per sua stessa affermazione e come evidenziato anche nel lavoro di Altimari (1982)[3].

Molti studiosi prestarono il loro impegno alla lingua italo-albanese per far si che diffondendo la lingua potesse rifiorire la cultura italo-albanese così da farla entrare nella letteratura e nella linguistica italiana, albanese e non solo. Tuttavia ancora oggi, dopo tantissimi anni dalle prime manifestazioni, l'arbëresh, in forma scritta, rimane una questione di nicchia, soltanto i cultori della materia, gli studiosi e pochi giovani studenti tramite corsi scolastici extracurriculari, attivati con la legge di tutela delle minoranze linguistiche storiche, sono in grado di farne uso scritto e letto.

---

di Finita, Cerzeto, Cavallerizzo, San Giacomo, Acquaformosa, Santa Sofia d'Epiro, Civita e Frascineto.

[3] F. Altimari, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua albanese e i suoi alfabeti*, Quaderni di Zjarri, Cosenza, 1982, p. 8: "In questa introduzione sono ampiamente esposte le idee del nostro autore sulla lingua universale, tema quest' ultimo largamente dibattuto in quel tempo dai circoli intellettuali e recepito dal Santori, che, nel condividerlo si preoccupava di conciliarlo con i suoi sforzi, apparentemente contraddittori, tesi a dare dignità letteraria e scientifica alla lingua albanese".

3. Santori e la lingua albanese

La lingua che Santori utilizza, è una lingua semplice impiegata già prima di lui da altri intellettuali da cui è stato influenzato (in primis da De Rada).

Santori, di origine italo albanese, si formò in un istituto sacerdotale di rito latino, scrisse opere appartenenti a diversi generi in lingua italiana e arbëreshe, fu infatti autore di drammi, poesie, romanzi, saggi di meccanica, matematica e politica. La condizione bilingue del Santori si manifesta in alcune opere, come ad esempio ne "Il Prigioniero politico", opera in lingua italiana ed endecasillabi sciolti che presenta intermezzi di canzoni in albanese, o anche nella Sofia Cominiate, romanzo storico, di cui si conoscono tre libri ciascuno composto da dieci capitoli, i luoghi descritti sono comunità albanesi del cosentino e paesi calabresi, il romanzo è scritto in italiano e in arbëresh.

In quanto alla lingua italo-albanese, scrisse Solano (1975) nel saggio sul teatro, "Santori aveva la convinzione che, come ogni altra lingua, anche l'albanese potesse esprimere adeguatamente qualsiasi concetto o sentimentto umano e che non esistono generi o tecniche letterarie più adatti ad una lingua che ad un'altra"; si pensa, continua Solano, che "egli volesse dare una sua risposta - con i fatti - alla polemica allora in corso tra gli intellettuali arbëreshë sull'indole della lingua albanese e sulle sue limitazioni". La lingua usata nei suoi lavori è molto agile, ricca e scorrevole, ha acquisito l'autorità della lingua colta.

Dagli scritti di Santori emerge che il fondo unificatore della lingua scritta è l'italiano, le contaminazioni della lingua sono avvantaggiate dal fatto che le minoranze linguistiche storiche albanesi si trovano in territorio italiano, ciò non toglie che le innovazioni provengono anche dalla conoscenza e dalla formazione linguistico-culturale dell'autore, in cui le numerose varianti geolinguistiche arricchiscono la sua produzione linguistica e letteraria.

Egli usa le abituali strutture del parlato a cui affianca però soluzioni colte e ricercate attingendo appunto al linguaggio scientifico; si serve di verbi onomatopeici, modulazioni corrispondenti; così la lingua scritta diventa ampia e profonda fino a essere considerata colta. Solano (1979) scrive "Giunse così alla convinzione che ogni parola ogni pronuncia riscontrata e vivente in comunità albanesi, nella madrepatria o fuori di essa, era patrimonio della lingua comune e degno di essere adoperato nelle opere letterarie. Così egli accettò, nelle sue opere, varianti fonetiche e morfologiche dalle comunità e dagli scrittori a lui noti, ma le adoperò con una giusta misura del modo e del luogo e non in maniera casuale. La sua lingua è sì una lingua "composita" per la combinazione di elementi di diversa provenienza. Perciò la lingua in Santori fu lessicalmente così

ricca come in nessun altro scrittore suo contemporaneo".

Santori fu artefice di un proprio alfabeto che presenta e descrive in alcune sue opere, raccogliendo il maggior numero di dati linguistici di varia provenienza al fine di stilare un sistema grafico coerente. Il continuo lavorio sull' alfabeto è espressione dell'esigenza di superare la precarietà e la varietà dei segni grafici delle colonie albanesi che sono rappresentati da una grafia variabile.

L'impegno culturale del Santori è di sostenere la pari dignità scientifica e letteraria della lingua albanese con le altre lingue europee di antica e consolidata tradizione culturale.

Per l'uso della lingua arbëreshe nell'opera di Santori, Solano si espresse col dire che "Base del suo dire, non v'è dubbio, furono la parlata di S. Caterina e quelle di Cerzeto e S. Giacomo; ma ben presto il Santori ebbe occasione di visitare, in veste di predicatore, e di sostare presso molte altre comunità albanesi della Calabria. Conobbe anche, e molto belle, quanto si scriveva in albanese dai suoi contemporanei, e studiò; con particolare amore le opere del De Rada che fu considerato sempre suo maestro e ispiratore. Lo afferma espressamente nella lettera a Stamile[4]. Studiò poi con uguale amore e interesse anche opere di scrittori d'Albania. Di uno di essi, il Bogdani, ne fa espressa menzione nel "Krështeu i shëjtëruor", riportandone un brano per dimostrare che la lingua degli arbëreshë non è diversa da quella che si parla in Albania." L'intenzione potrebbe essere quella di sottolineare l'appartenenza dell'arbëresh alla lingua albanese.

Santori nel suo scritto premette al brano del Bogdani dal "Cuneus Prophetarum" del 1685 la seguente affermazione: "U kalla këtu, këtë Ligjëratë të atij, te bënë të xënë, ata çë thomse nëng e dinë. se janë të tjera livre albëreshë; e ndonjë fjalë çë vjen të i duket e ré, pse nëng e adhetur ndë Katundet çë gjënden ndë Litalljen, mos të mbanjin se u e nxora ka kryeja ime, pse e mora tek ai; tas çë njoha se gjyha nëng ndryshën keq, e si flitet nani këtu, flitej atje 300 vjet prapa"[5].

4. Conclusioni

[4] La lettera è contenuta nell'opera di Santori "Il Prigioniero politico. Libero e reduce per la Costituzione del 1848"

[5] Io ho posto qui questo Discorso di lui (Bogdani), per far conoscere a coloro che forse non lo sanno, che vi sono anche altri libri in albanese, e qualche parola che loro potrà sembrare nuova, perché non in uso nelle Comunità che trovansi in Italia, non pensino che io l'abbia inventata, poiché invece la presi da lui (Bogdani), quand'ebbi constatato che la lingua non differisce molto, e come si parla oggigiorno qui, si parlava là 300 anni addietro.

La lingua albanese di tradizione orale divenne "adulta" per affrontare argomentazioni dotte e specifiche, infatti le nuove strutture linguistiche non entrarono nell'uso quotidiano.

Santori insieme agli altri autori italiani di lingua minoritaria albanese si rese ben conto del ritardo della letteratura nel far fronte alle mutate esigenze della cultura e nel rispondere alle nuove condizioni della società e diede il suo contributo, optando per una lingua che fosse in grado di comprendere le lingue parlate in Italia (nelle varie comunità albanofone che frequentò), quella albanese in Albania (attraverso gli scambi culturali con i suoi contemporanei) e le lingue acquisite durante i suoi studi quali greco e latino.

La pratica linguistica di Santori testimonia una trasformazione importante, nel senso di evoluzione e maturazione della situazione linguistica albanese in quanto l'autore usa espressamente diversi dialetti che conosce creando commistioni e mettendoli a contatto tra loro.

Bibliografia

F. Altimari, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua albanese e i suoi dialetti*. Quaderni di Zjarri 7, Cosenza, 1982.

P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, Padova, 1685.

V. Dorsa, *Sugli Albanesi, Ricerche e Pensieri*, Napoli, 1847, p. 134.

A. Gramsci, Letteratura e vita nazionale.
http://www.intratext.com/ IXT/ITA3066/_PA.HTM, 1950.

F. A. Santori, *Il prigioniero politico e reduce e libero per la Costituzione del 1848*, tipografia Trani, Napoli, 1848.

F. A. Santori, , Primo Discorso della IV Scala su Bogdani *Cuneus Prophetarum*

F. A. Santori, Sofia Cominiate, manoscritto presso il Fondo De Rada della Biblioteca Civica di Cosenza.

F. Solano, F. A. *Santori tra lingua e dialetto*, Quaderni di Zjarri 5, Cosenza, 1979

Begzad BALIU, Universiteti i Prishtinës

VLERËSIME TË PROFESOR JUP KASTRATIT PËR ALBANOLOGJINË E MJEDISIT ARBËRESH TË ITALISË

Abstrakt: Objekt i këtij studimi do të jenë konceptet, vlerësimet e diskutimet e profesor Jup Kastratit për zhvillimin e albanologjisë brenda proviniencës, "gjuhës", "lëvizjes kulturore", dhe "mjedisit arbëresh të Italisë" sikur i shquan ai në veprat e tij.
Përtej një përcaktimi kulturor, historik e gjuhësor të vendit të albanologjisë në gjuhën italiane, janë me shumë interes diskutimet e Profesor Jup Kastratit mbi ndikimet e mundshme të këtyre arritjeve në albanologjinë e proviniencës gjuhësore gjermane e më tej. Në këtë rrjedhë nuk është vështirë të shihet dhe të vlerësohet me interes edhe zhvillimi dhe ndikimi i kësaj shkolle si metodë dhe si dije në përbërësit gjuhësorë, letrarë e kulturorë në përgjithësi, të albanologjisë së periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare në Shqipëri dhe në kolonitë e tjera të diasporës shqiptare të kohës. Hulumtimi mbështetet në studimet e botuara kryesisht në fushë të historisë: *studime, vepra, komunikime, imazhe, vlerësime, dokumente, dorëshkrime* së albanologjisë nga ky studiues dhe në vëllimet e lëna në dorëshkrim.
Fjalët kyçe: *Jup Kastrati, letërsia arbëreshe, De Rada, vepra, studime, editime*

Hyrje

Janë shumë rrethana që e arsyetojnë interesimin tonë për t'u marrë me studimet arbëreshe të Profesor Jup Kastratit, në një konferencë si kjo që i kushtohet *Kontributit të studiuesve shkodranë për arbëreshët e Italisë*. Vepra e tij është e gjerë në shumë anë të saj: si materie (disa mija faqe studimi, dokumente, letërkëmbim, fotografi etj.); si fusha studimi (gjuhësi, albanologji, letërsi, folklor, histori, pedagogji, publicistikë etj.); si lëndë (e botuar, në dorëshkrim, e përkthyer, e transliteruar, e përshtatur) etj. Ngado që të merren studimet e tij, ato paraqesin një mal të madh materialesh, problemesh e trajtimesh.

Në një hyrje për *Studimet arbëreshe të Profesor Jup Kastratit*, sinteza e thelluar shumëdimensionale as që mund të mendohet, por njëkohësisht ajo mund të paraqitet e plotë përmes një pasqyre të dendur dhe të plotë për lidhjet e Jup Kastratit me arbëreshët dhe me kontributet e tyre historike, gjuhësore, etnokulturore dhe letrare në përgjithësi. Sikur mund të shihet prej arkivit të tij, prej botimeve të tij dhe aktiviteteve të tij kulturore, arsimore dhe shkencore, ato janë të natyrës historike, kulturore, profesionale, personale dhe madje intime.

Sot, po të shikohet vepra shkencore dhe intelektuale e Jup Kastratit në linja sado të ngushta, studimet arbëreshe dhe deradiane gjithsesi do të nxjerrin krye,

pavarësisht prej veprave të mëdha që ka dhënë në fushë të albanologjisë, të gramatologjisë, të letërsisë dhe të bibliografisë. Për disa dekada me radhë nuk është zhvilluar asnjë manifestim, sado i vogël apo i madh qoftë, në të cilin të mos ketë qenë edhe Profesor Jup Kastrati. Për disa dekada me radhë, zor të gjendet një redaksi e botimit të letërsisë arbëreshe e sidomos veprës letrare dhe shkencore të Jeronim de Radës, në të cilën Jup Kastrati nuk e ka pasur vendin më të rëndësishëm, madje jo vetëm në Shkodër e Tiranë, por edhe më gjerë ndër arbëreshët e Italisë. Sot është vështirë të gjendet një fushë hulumtimi, botimi a studimi në fushë të studimeve arbëreshe, e cila nuk lidhet me emrin, me interesimin dhe më në fund me kontributin e Jup Kastratit.

Është e kuptueshme prandaj, pse edhe në këtë rast, kur këtu ne paraqesim një *hyrje* në *studimet arbëreshe* në përgjithësi dhe *studimet deradiane* në veçanti, e shohim të arsyeshme të paraqesim edhe një pasqyrë sado të përgjithësuar të veprës së botuar, veprës së hulumtuar, arkivit dhe veprës në dorëshkrim të Profesor Kastratit.

Jup Kastrati ka shkruar shumë artikuj dhe studime monografike të karakterit shkencor, por në serinë e veprave të tij dhe sigurisht edhe në serinë e vëllimeve të botuara deri më tash vepra *Studime arbëreshe* mbetet një nga krye-veprat e tij, por edhe kryevepra më e plotë e studimeve arbëreshe.

Pse mund të thuhet kështu?

Hulumtimet, studimet dhe sintezat e Jup Kastratit për arbëreshët e Italisë nisin që në dekadën e parë të kërkimeve shkencore dhe kulmojnë me sintezat e mëdha me emrin e shkrimtarit më të madh të kolonisë shqiptare në Itali, Jeronim de Rada[1]. Prej këtij viti, për pesëdhjetë vjet me radhë nuk do të kalojë pothuajse asnjë vit e të mos botojë e ribotojë me dhjetëra artikuj brenda një viti, në të cilët dijetarët arbëreshë, veç e veç dhe historia, gjuha, letërsia, kultura, arsimi etj., si tërësi ose si sintezë nuk bëhen objekt kërkimi, studimi e vlerësimi[2], për të lënë edhe një mal dorëshkrimesh të pakrahasueshme në studimet e deritashme albanologjike.

Jeta dhe vepra e personaliteteve arbëreshe, vepra e tyre etnohistorike dhe

---

[1] Shih Begzad Baliu, *Vepra bibliografike e Profesor Jup Kastratit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.

[2] Veprat me temë arbëreshët e Italisë: *Autobiografia e De Radës*, Tiranë, 1999; *Këngë të Milosaut*, Tiranë, 1956; J. de Rada, *Publicistika, Letërkëmbimi. Autobiografia*, Tiranë, 1987; *Skanderbeku i pafanë*, Tiranë, 1987; *Jeronim de Rada (Jeta dhe veprat).* Botim i ripunuar i vitit 1962. Monografi, Tiranë, 1979; *Studime për De Radën*, "Era", Prishtinë, 2003, New York, 2003 etj.

sidomos gjuhësore dhe letrare, konceptet e tyre për identitetin dhe veçoritë materiale, shpirtërore e sidomos gjuhësore etj., për më shumë se një gjysmë shekulli kanë qenë objekt studimi e referimi në shumë institucione kulturore, arsimore dhe shkencore, të themeluara nga arbëreshët në Itali.

Kjo është arsyeja pse edhe veprat në të cilat është trajtuar kultura, tradita dhe historia gjuhësore e letrare e autorëve në radhët e arbëreshëve ka qenë e përmasave të ndryshme: traktati *Histori e albanologjisë*[3], monografia *Histori e gjuhësisë shqiptare. Pjesa e parë (1497 - 1944), Gramatologjia e gjuhës shqipe*[4], *Dhimitër Kamarda*), studimet *Mbi rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* dhe dr. *Mikel Markianoi dhe ndihmesa e tij në folklorin arbëresh*, *Arbëreshët për ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore të popullit tonë*[5], studime të thelluara shkencore e paraqitje fejtonistike në shtypin ditor, botime me karakter shkollor dhe botime me karakter shkencor, përkthime nga gjuhët në të cilat kanë shkruar shkencëtarët dhe letrarët arbëreshë gjatë disa shekujve të veprimtarisë së tyre në Itali etj.

Jeronim de Rada dhe fillimet shkencore të Jup Kastratit

Nëse shënime për versionet dhe variantet e botimit të monografisë për Faik Konicën, si dhe botimin e veprës së tij, kemi pasur rastin t'i lexojmë për shkak se monografia e tij për Konicën u botua atëherë kur Konica ishte një prej personaliteteve shumë të theksuara në jetën politike, shkencore dhe kulturore, shënime personale të tij rreth përpjekjeve për botimin e veprave të plota a të zgjedhura për Jeronim de Radën nuk i kemi gjetur, në mënyrë të veçantë, as nuk ia kemi dhënë rastin t'i tregojë në intervista ekskluzive ku ai do të sillte informacione më shteruese sesa shumë studiues në veprat e tyre shkencore. Sigurisht për shkak se veprën e plotë të Jeronim de Radës nuk arriti ta botonte të plotë, ashtu sikur e kishte planifikuar as në fillim të viteve '50, as diku në fillim të viteve '90, Jup Kastrati nuk ka shkruar apo sjell përvojën e tij në mbledhjen, studimin, përkthimin, botimin dhe sintetizimin e veprës së Jeronim de Radës.

Mirëpo nëse i qasemi Arkivit të Jup Kastratit nuk të mbetet gjë mangët, pavarësisht nëse ke të bësh me ndërtimin e personalitetit të tij, apo me zhvillimet

---

[3] Shih traktatin Histori e albanologjisë I, dhe dy vëllimet në dorëshkrim: *Historia e albanologjisë (1497-1997).*

[4] *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944),* Rilindja, Prishtinë, 1980.

[5] Në studimet albanologjike të gjysmës së dytë të shekullit XX, në dy nga konferencat më të mëdha shkencore të kësaj kohe, Jup Kastrati përfaqëson mendimin historik, gjuhësor dhe kulturor të arbëreshëve të Italisë.

albanologjike të kohës kur jetoi ai. Prej arkivit privat të tij do të mund të kuptojmë se historia e interesimit të Jup Kastratit për arbëreshët e Italisë është e lidhur me emrin e Jeronim de Radës, prandaj është e kuptueshme pse jetën dhe veprën e tij do ta trajtojë shumë herë dhe do ta trajtojë në shumë vepra të tij, madje të botuara e të plotësuara. Pavarësisht nga botimi i parë i një monografie për jetën dhe veprat e Jeronim de Radës në vitin 1962 dhe botimit të dytë të plotësuar të vitit 1979, autori e ka përgatitur një dorëshkrim tjetër, i cili në shumë pika plotëson jetën e tij, trajton në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme veprën e tij diturake, historike, gjuhësore, letrare, arsimore, publicistike etj., ndërsa duke iu referuar parathënies së librit, kuptojmë se autori njëkohësisht punon edhe një vepër për studimet gati njëshekullore deradiane 1903-1993. Po të vlerësohet vetëm kontributi i madh i punës së Jup Kastratit në mbledhjen dhe botimin e veprës së De Radës, do të mund të shihet se vetëm në studimin e jetës dhe veprës së tij, ai ka ngritur një trilogji, të cilën deri më sot nuk e kemi bërë për asnjërin prej shkrimtarëve tanë.

Dorëshkrimi *Studime për De Radën* për herë të parë trajton në mënyrë shteruese jetën, *Autobiologjinë* (autobiografinë) e tij, pikëpamjet kulturore, filozofike dhe sidomos politike, pa pengesat ekstrashkencore që i dilnin dikur, kontributin e tij për gjuhën shqipe: tezën pellazgjike të prejardhjes së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, te artikujt, *Hyjni pellazge* (1840), *Identiteti i pellazgëve me shqiptarët* (1846), *Lashtësia e kombit shqiptar dhe afri e tij me helenët dhe latinët* (1864), *Pellazgët dhe helenët* (1885), *Konferenca mbi lashtësinë e gjuhës shqipe* (1893), *Pellazgo-shqiptarët* (1897), *Tiparet e gjuhës shqipe dhe përmendoret e saj në periudhën parahistorike* (1899), e cila njëkohësisht është edhe tezë kryesore e rilindjes kombëtare shqiptare në përgjithësi. Në këtë vepër autori ka trajtuar edhe disa probleme të toponimisë, një fushë gjuhësore e lëvruar kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit XX, por me të cilën, sikur ka vënë re Jup Kastrati, sado me koncepte të paragjykuara, është marrë edhe De Rada te studimet *Toponimia historike shqiptare*, *Toponime për Lezhën në revistën* Fjamuri i Arbërit *(1885)* etj.

Ashtu sikur edhe rilindësit më të shquar jo vetëm të popullit shqiptar, por edhe të popujve të tjerë të Ballkanit, edhe De Rada do të merret me dy çështje themelore të gjuhës dhe të kulturës së popullit shqiptar: me alfabetin e gjuhës shqipe (*Çështje të alfabetit të gjuhës shqipe)* dhe me përpjekjet për ta shkruar gramatikën e gjuhës shqipe (*Gramatikë e gjuhës shqipe,* 1870 dhe *Fonetikë dhe gramatikë e gjuhës shqipe,* 1894) me vlerat historike dhe gjuhësore të të cilave Jup Kastrati është marrë madje jo vetëm këtu. Përtej saj, Kastrati do t'i qaset

studimit të një vepre jo aq të njohur dhe jo aq të popullarizuar përgjithësisht edhe sot në studimet albanologjike (*Fjalori i Rapsodive,* 1884).

Duke këmbëngulur që të japë një pasqyrë sa më të gjerë dhe më të thellë, si të zhvillimeve gjuhësore ndër arbëreshët e Italisë, të lidhura me veprën e De Radës, ashtu edhe me kontributin vetjak të tij, profesor Kastrati do të shkruajë për ngjarje me rëndësi historike, për gjuhën dhe kulturën shqiptare ndër arbëreshët e Italisë (*Kongresi në Koriljano-Kalabro,* 1895; *Kongresi në Lungro* 1897), ashtu edhe për artikuj që De Rada i shkruante në raste nga më të ndryshmet (*Dinjiteti i gjuhës shqipe,* 1861; *Shqipëria përballë Evropës,* 1880, *Shënime gjuhësore* (1883-1884); *Tri fjalë shqipe,* 1884; *Vërejtje gjuhësore,* 1885; *Gjurmë të vendbanimeve tona të lashta që rrojnë endè,* 1887; *Mësime për gjuhën shqipe,* 1891), të cilët jo gjithnjë kufizohen brenda problemeve të ngushta linguistike. Kjo është arsyeja pse një prej studimeve të tij do ta përfundojë me këtë vlerësim: "De Rada ishte i pushtuar nga ideja fisnike që ta ringjallte Atdheun e të parëve dhe kështu, nën shtytjen atdhetare, shkencën e ktheu në një fushë beteje, ku ai luftoi me zjarr, siç bën edhe rilindës të tjerë. Këtë ai e realizoi pothuajse në çdo vepër të tij. Edhe në mes të lajthitjeve, vepra e tij gjuhësore do të mbetet në historinë e albanologjisë si një përpjekje fisnike e një shqiptari të madh, i cili, megjithë mungesën e përgatitjes filologjike dhe linguistike, megjithë mungesën e akribisë shkencore, megjithë mungesën e anës materiale, megjithë vuajtjet e mëdha shpirtërore dhe kushtet e disfavorshme, arriti ta zgjojë kureshtjen e botës shkencore të dijetarëve të kohës. Veprat e tij historiko-filologjike hyjnë në fondin e artë të traditës së shekullit XIX. Ato bëjnë pjesë në korpusin '*Trashëgimi ynë kulturor – Monumente të gjuhës shqipe', në historinë e mendimit shkencor gjuhësor shqiptar*"[6].

"*De Rada ka qenë jo vetëm mbledhës i këngëve popullore, por edhe studiues i hollë i tyre. Ky kontribut i vyer i tij në historinë e folkloristikës shqiptare nuk është vënë në dukje*"[7]. Kështu e mbyll kapitullin e studimit të tij për kontributin e De Radës dhënë folklorit shqiptar. Nëse ndihmesa e tij në këtë fushë deri më tash është parë kryesisht duke u nisur prej pasurisë etnografike dhe folklorike që sjellin veprat e tij letrare, studimi i Jup Kastratit niset nga artikujt programatikë të De Radës (*Rapsodi të një poeme shqiptare, 1*861; *Rapsodi kombëtare,* 1883; *Hyjnizime etnografike,* 1886), vlera e të cilëve këtu kuptohet edhe prej ekstrakteve të shpeshta, me të cilët pasurohet kapitulli për këtë temë.

---

[6] Shih dorëshkrimin: 301.
[7] Po aty: 348.

Rilindja kombëtare shqiptare ka pasur shumë personalitete letrare e shkencore të cilët kanë qenë të përkushtuar ndaj arsimit kombëtar, por nuk besoj të kemi rilindës, i cili ka punuar me kaq përkushtim për organizimin jo thjeshtë të një *mësonjëtoreje* shqipe për çuna a vasha, por për një shkollë kombëtare me të gjitha nivelet e nxënies së gjuhës dhe dijes. Është e kuptueshme prandaj pse Profesor Jup Kastrati një kapitull më vete ia kushton ndihmesës së De Radës për shkollën shqipe, për t'u ndalur pastaj në mënyrë të veçantë në aktivitetet konkrete të organizimit të shkollës shqipe nga De Rada dhe bashkëkohësit e tij (*Themelimi i Katedrës së gjuhës shqipe*, 1849; *Kolegji arbëresh i Shën Adrianit*, 1861; *Manifesti i gjimnazit "Garopoli"*, 1868; *Kolegji arbëresh dhe ministrat e Italisë*, 1876, *Kolegji arbëresh*, 1884; *Kolegji arbëresh në Shën Adrian*, 1886; *Kolegji i Shën Adrianit*, 1887; *Rivendosja e Katedrës së Shqipes, 1889*), por edhe për ndonjë projekt të karakterit pedagogjik, sikur është ai: *Kolegji arbëresh i Shën Adrianit, a do të jetë Seminar Korsini apo Gjimnaz-licé italo-grek, me ndonjë degë universitare kishtare?*, 1891 dhe manifesti *Katedra e shqipes në Shën Mitër Korone*, 1892. E kësaj natyre është edhe *Antologji shqipe*, 1896, dhe Proluzioni: *Ligjëratë për periudhën e vitit të ri shkollor*,1902, me të cilat Jup Kastrati merret njëherë në mënyrë të veçantë me secilën, pastaj me sintezën e tyre në përmbyllje.

Ashtu sikur edhe me veprat më të mëdha dhe më të vogla të gjuhësisë edhe me veprat letrare artistike të Jeronim de Radës, Jup Kastrati do të merret në shumë aspekte. Ndryshe nga gjendje e gjertashme e studimit të veprës së tij letrare, ku studiuesit e periudhave të ndryshme kanë hulumtuar, trajtuar dhe bërë sinteza kryesisht vetëm për veprat letrare të shkruara në gjuhën shqipe, apo edhe të përkthyera a transliteruara, në veprën e tij *Studime për De Radën* autori është marrë me veprat e shkruara në gjuhën shqipe, me veprat letrare të shkruara në gjuhën italiane dhe me veprat e shkruara në gjuhën shqipe e italiane paralelisht. Duke u marrë me veprat letrare më të hershme (*Odiseu*, 1832, 1847; *Krutani i mërguar*, 1832 - 1833, 1841; *Disa poezi dhe proza ritmike*, 1834 - 1840), apo më të vona, më të vogla apo më të mëdha (*Këngë të Milosaut*, 1836, 1847, 1873; *Serafina Topia*, 1839, 1943); *Një pasqyrë shtegtimi njerëzor*, 1897), të botuara në një variant apo në më shumë variante (*Skënderbeu i pafat*,1872 - 1884), ai njëkohësisht është marrë edhe me ngritjen cilësore letrare e artistike të veprës letrare të De Radës, me kulturën letrare dhe gjuhësore të tij, me konceptet moderne të kohës në letërsi, me vlerësimet e kohës për poezinë e tij etj. Duke u marrë me pikëpamjet letrare të De Radës, Jup Kastrati njëkohësisht do të merret më gjerësisht se deri më tash dhe mbase për herë të parë në mënyrë të plotë edhe

me pikëpamjet estetike të De Radës (*Parime të estetikës*, 1861) etj.

Për ta plotësuar botën diturake të Jeronim de Radës, Jup Kastrati në veprën e tij dorëshkrim *Studime për De Radën* ka hulumtuar dhe i ka bërë objekt trajtimi edhe dy gazeta të De Radës *Fjamuri i Arbërit* (1883-1887) dhe *Shqiptari i Italisë* (1848). Si gazeta e parë ashtu edhe e dyta dallohen për veçoritë e tyre historike, politike, kulturore dhe shkencore. *Fjamuri i Arbërit*, ka shkruar Profesor Jup Kastrati, "është revista e parë letrare, kulturore, artistike, folkloristike, etnografike dhe publicistike në gjuhën shqipe. Organi luajti një rol të madh në fushën e politikës shqiptare, të lëvizjes sonë politike dhe asaj mendore"[8]. Me këto fletore De Rada i ka vënë vulë lëvizjes së përgjithshme të Rilindjes Kombëtare jo vetëm ndër shqiptarët e Italisë, por edhe në lëvizjen e saj përgjithësisht. Aty janë botuar pjesë nga veprat letrare të De Radës dhe të shkrimtarëve të tjerë të kohës. Artikuj publicistikë, kulturorë e politikë të ardhur nga e gjithë bota shqiptare, prandaj është e kuptueshme pse vlerësimet shembullore për gazetat e De Radës vijnë jo vetëm nga shtypi shqiptar i kohës në Shqipëri, në kolonitë shqiptare të Rumanisë, Stambollit e Egjiptit, por edhe nga shtypi i huaj i kohës.

Vepra *Studime për De Radën* e Kastratit mbyllet me kapitullin që u kushtohet *veprave autobiografike të De Radës* (*Një autograf*, 1885; *Autobiografi*, I, II, III, IV, (1898-1899); *Testamenti politik*, 1902). Ndonëse për autorin ato ishin vepra të njohura, prej më shumë se tri dekadash, veprat autobiografike të De Radës nuk ishte e mundur as të botoheshin të plota, as të bëheshin objekt trajtimi në të gjitha aspektet e mundshme. "*Autori ynë ishte, asokohe, 89 vjeç. Mbas pesë muajsh, më 28 shkurt 1903, ai u nda prej nesh, duke na lënë dhiatën e vet, në të cilën ishte sintetizuar gjithë veprimtaria e tij atdhetare, politike, letrare, gjuhësore, folklorike, publicistike, historike në shërbim të çështjes shqiptare, të gjuhës amtare, të kulturës kombëtare, të çlirimit të mëmëdheut të vet të dashur e të shtrenjtë*"[9].

Ashtu sikur veprat e tjera, madje edhe studimet, edhe dorëshkrimi *Studime për De Radën* mbyllet me *Bibliografinë e veprave të De Radës, konsultuar, shqyrtuar e përdorur nga autori në monografi*, e cila zgjeron interesimet e studiuesve për kërkime të reja në fushë të studimeve arbëreshe në përgjithësi dhe në fushë të studimeve deradiane në veçanti.

Në kërkim të sintezave të mëdha

Një vend të veçantë dhe të përhershme për arbëreshët e Italisë paraqesin

[8] Shih dorëshkrimin: 462.
[9] Shih dorëshkrimin: 544.

kërkimet e tij sistematike dhe sistematizuese në vëllimet bibliografike[10]. Veprat dhe studimet e tij tashti janë bërë literaturë e përhershme referimi edhe në meset shkencore të institucioneve arsimore, kërkimore e kulturore të arbëreshëve të Italisë.

Profesor Jup Kastrati në dhjetëvjetëshin e fundit të jetës së tij qe bërë anëtar i shumë institucioneve kulturore të arbëreshëve të Italisë. Ka lexuar kumtesa në sesione shkencore, në mbrëmje përkujtimore (jubilare), konferenca albanologjike, kongrese gjuhësore, kuvende studimore dhe ka bërë gjurmime bibliotekare për tekstet e vjetra shqipe në Romë, Napoli, Torino, Firence, Salerno, Leçe, Kalabri etj.

Ai ishte anëtar shumë aktiv i veprimtarive të veçanta dhe të përhershme kulturore e shkencore, i organeve kulturore e shkencore që botohen atje, duke dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për ruajtjen e trashëgimisë etnokulturore e gjuhësore, zhvillimin e saj dhe çuarjen përpara të kulturës bashkëkohore të arbëreshëve të Italisë. Ishte anëtar i redaksisë së revistës *Lidhja* (L'Unione), Kozencë (1991 - 1992) etj. Punimet shkencore të Jup Kastratit janë përfshirë në përmbledhje dhe në vëllime studimesh, të botuara nga Universiteti i Napolit, Universiteti i Kalabrisë, Universiteti i Salernos etj.

Profesor Jup Kastrati në arkivin e tij ka sistemuar një letërkëmbim shumë të pasur me arbëreshët, madje me studiuesit italianë të kulturës shqiptare në përgjithësi dhe të kulturës arbëreshe në veçanti, sikur janë: Giuseppe Ferrari, Giuseppe Schiro Juniori, Carmel Candreva, Francesco Salono, Carmine de Padova, Antonio Bellusci, Giuseppe Gradilone, Francesco Altimari, Italo Costante Fortino, Giovanni Battista Pellegrini, Giuseppe Retelli, Mario Bolognesi, Andrea Bellucci, Vincenzo Belmonte, Ernesto Tocci, Giuseppe Camillo De Rada, Francesco De Belsi, Emanuel Giordano, Agosto Mauro, Michele Rizzo, Addolorata Landi[11] etj.

Ndonëse i penguar për shkaqe jashtëshkencore dhe pa mundësi për të botuar në mënyrë të rregullt në organet shkencore dhe kulturore të arbëreshëve të Italisë, Jup Kastrati ka botuar disa dhjetëra artikuj shkencorë dhe kulturorë ndër revista e periodikë që dalin në Itali nga shoqata dhe institucione shkencore, të cilat merren me studimet arbëreshe, si dhe në institucione arsimore, kulturore e shkencore të studimeve albanologjike në Shqipëri e jashtë saj. Në Shqipëri ai ka

[10] *Bibliografi albanistike I* (Veprat e plota), nën përkujdesjen e Begzad Baliut. Era, Prishtinë, 2001. N

[11] Shih arkivin personal të Profesor Jup Kastratit në Shkodër.

botuar dhe ribotuar disa vepra shkencore, të cilat i janë publickuar edhe në Kosovë, për t'u bërë ndër veprat më të referuara ndër studiuesit e kësaj ane.

Dhe jo vetëm kaq. Hulumtimet e tij kurrë nuk kanë pushuar ndër arkiva të Ballkanit, Evropës dhe veçanërisht ndër arkivat e arbëreshëve të Italisë, ndërsa pena e tij kurrë nuk ka pushuar së shkruari studime të ndryshme dhe së bëri sinteza nga më të mëdhatë për autorët, veprat dhe rezultatet shkencore të tyre. Ai ka një varg veprash studimore në dorëshkrim, që në të vërtetë paraqesin të arriturat më të mëdha në fushë të studimeve arbëreshe në përgjithësi dhe në fushë të studimeve deradiane në veçanti, duke filluar me vëllimet:

Veprat historiko - filologjike dhe publicistike të Jeronim de Radës[12]. Shkodër. 1999, 1 850 f. të daktilografuara, në tre versione: italisht, në të folmen e arbëreshëve (transkriptim) dhe në përshtatjen e gjuhës së sotme shqipe.

Jeronim de Rada, Skanderbeku i pafan, në tri versione: italisht, arbërisht (transkriptim), përshtatje në gjuhën e sotme. Vepra hapet me një studim introduktiv problemor dhe me aparat shkencor, Shkodër, 1999, 1 240 f. të daktilografuara.

Për të përfunduar me korpusin e madh shkencor, që përtej studimeve historike, gjuhësore, letrare, kulturore e publicistike, paraqet veprën jetësore të Jup Kastratit për qytetërimin arbëresh[13].

Kontributi i tij në studimet arbëreshe përfshinë vepra monografike për autorë, personalitete të mëdha historike, shkencore dhe kulturore si: Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Nikollë Keta, Vinçenc Dorsa, Vinçenc Librandi, Nilo Borxha, Gaetano Petrota, Marko la Piana, Françesko Solano (1914 - 1999) etj., pjesa më e madhe e të cilave ende nuk janë botuar. Vetëm monografia e tij për De Radën ka dy versione të botuara e të ribotuara dhe dy vëllime në dorëshkrim, të cilat përbëjnë tërësinë e kontributeve të tij për jetën dhe veprën e këtij krye-rilindësi shqiptar jo vetëm në koloninë arbëreshe të Italisë, por edhe për rilindjen shqiptare në përgjithësi. Ndonëse në dorëshkrim, dhe të përfshira brenda vëllimit *Studime arbëreshe*, edhe studimet për këta autorë paraqesin monografi më vete, si për hulumtimin dhe studimin e plotë të veprës së tyre ashtu edhe për vëllimin në të cilin janë trajtuar, nga 120-450 faqe dorëshkrimi për autorë.

---

[12] Sipas një njoftimi të *Këshillit shkencor të ILPSh-së, për vitin 1977*, botuar në *Kronikën e Shkodrës*, veprën *Veprat historike dhe filologjike të Jeronim de Radës*, Jup Kastrati e kishte të përfunduar që në vitin 1977. Jeta shkencore në Shkodër (korrik 1978-qershor 1979), BSH, Shkodër: 185-186.

[13] *Studime arbëreshe*. Monografi. 1.725 faqe dorëshkrim. Përmbajtja botohet për herë të parë: Redakt.: Diana J. Kastrati-Mr. Begzad Baliu. Recensues: Prof. dr. Tomorr Osmani, Prof. dr. Artan Haxhi. Rekomanduar për botim: Universiteti I Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Duke hapur *Parathënien*[14] e shkurtër për një vëllim kaq të madh studimesh, madje të pazakonshme në përvojën e studimeve kastratiane, autori kujtonte se fjala është për një vëllim me studimet më të mira të shkruara nga viti 1956 deri në vitin 2000. Në të vërtetë ato përfshijnë studime të fushave të ndryshme, të cilat fillojnë me gjuhën, letërsinë, kulturën, historinë, folklorin, etnografinë etj., disa prej të cilave tashmë janë lexuar në konferenca shkencore, janë botuar në vëllime shkencore, në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

E shikuar nga një kënd tjetër, nga këndi i fushave të studimit, *Studimet arbëreshe* të Jup Kastratit trajtojnë tema:

- nga historia: reflektime dhe angazhime mbi Lidhjen e Prizrenit, Kongresin e Berlinit, çështjen e pavarësisë së Shqipërisë etj.;
- nga historia e kulturës dhe letërsia: letërsi e vjetër, letërsi e rilindjes dhe përkimet e saj me letërsinë evropiane, letërsia e gjysmës së parë të shekullit XX dhe letërsia bashkëkohore;
- nga folklori dhe etnologjia: autorë dhe vepra, si Markianoi, De Rada, Antonio Belushi, Folklora arbëreshe dhe trashëgimia e saj etj.;
- nga gjuhësia dhe shkollat e fushat e studimit të saj (filologji-linguistikë-albanologji): historia e albanologjisë, filologjisë dhe linguistikës, dialektologjisë, gramatologjisë, sintaksologjisë, leksikologjisë e leksikografisë, morfologjisë, fonetikës dhe fonologjisë, ortografisë, transliterimit e transkriptimit, përkthimit e kulturës së leximit, kritikës gjuhësore, polemikës e letërkëmbimit;
- nga bibliografia e autorëve dhe për autorët: bibliografia e gjuhësisë, letërsisë, folklorit dhe publicistikës. Bibliografi të veçanta madje ka përgatitur për Gjergj Guxetën, për Pal M. Parrinon, për Nikollë Ketën, për Engjëll Mashin, për Gjon Skiroin, për Vinçens Dorsën, për Dhimitër Kamardën, për Niko Borxhan, për Gaetano Petrotan, për Mark la Pianen, për Mateo Shambren; për Françesk Solanon, për Nilo Katalanon, për Francesko Maria da Leçen etj.

Ka trajtuar në këtë vepër me një skrupulozitet të shumanshëm çështje të historisë së arbëreshëve të Italisë, rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878 - 1881), historinë e vendosjes dhe të jetesës së arbëreshëve në Leçe (shek. XV - XVII), historinë e themelimit dhe të punës së Seminarit Arbëresh të Palermos (1734) dhe Kolegjit Arbëresh të Shën Adrianit (1736), vijimësi e të cilëve në jetën nacionale, arsimore, kultu-rore e shkencore janë edhe dy kongrese gjuhësore për gjuhën arbërore ndër arbëreshët e Italisë (1895, 1897). Brenda një kaptine të veçantë autori trajton çështje të etnografisë së arbëreshëve të Italisë. Fjala është për kontributin e arbëreshëve të Italisë për ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar. Me po kaq përkushtim dhe thellësi autori hulumton dhe trajton çështje të folklorit të arbëreshëve të Italisë. Brenda këtij problemi hyjnë studi-met që trajtojnë fondin e përbashkët të poezisë popullore arbëreshe dhe të ciklit të këngëve legjendare

[14] Shkodër, më 15 shtator 2001.

të kreshnikëve, folkloristikën arbëreshe të shekullit XVIII dhe të gjysmës së parë të shekullit XIX, si dhe ndihmesën e dr. Mikele Markianoit dhënë folklorit arbëresh.

Nëse trajtimi i historisë, etnografisë dhe folklorit të arbëreshëve të Italisë nga Jup Kastrati ka qenë pjesë e përkushtimit të tij për *Studimet arbëreshe* trajtimi i *çështjeve të gjuhësisë shqiptare ndër arbëreshët e Italisë në shekullin XVII* ka edhe shumë arsye të tjera. Historia e albanologjisë ka qenë dhe mbetet një prej fushave në të cilën është angazhuar shumë Jup Kastrati, ndërsa gjuha e arbëreshëve të Italisë ishte dhe është një prej vlerave të mëdha gjuhësore, kulturore dhe shkencore, pa studimin e së cilës nuk mund të arrihen rezultate të rëndësishme shkencore në fushë të albanologjisë. Në këtë fushë ai me përkushtim ka trajtuar periudha, autorë dhe vepra të rëndësishme shkencore si: Nilo Katalano (1637 - 1694), Lëvizja mendore gjuhësore në mjedisin arbëresh të Italisë në shekullin XVIII, Gjergj Guxeta (1682 - 1756), Pal M. Parrino (1710 - 1765), Nikollë Keta (1741 - 1803).

Përtej një interesimi të Jup Kastratit për gjuhën e arbëreshëve të Italisë, si lëndë për studime krahasuese në fushë të dialektologjisë, leksikografisë e gramatologjisë etj., përkushtimi i tij do të lidhet me gjuhësinë si dije nacionale, e cila si askund ndër shqiptarët, tek arbëreshët e Italisë sillte përvojën e shkollës evropiane të kohës. Fjala është për studimet dhe studiuesit e arbëreshëve të Italisë të shekullit XIX: Engjëll Mashi (1758-1821), Mikel Skutari (1762-1830), Zef Krispi (1781-1859), Xhusepe Angelo Noçiti (1831-1899), dr. Gjon Skiroi (1835), Jeronim de Rada (1814-1903), Dhimitër Kamarda (1822 - 1882), Vinçenc Dorsa (1823-1859), Vinçenc Librandi (1897); po edhe për dijetarë e gjuhëtarë arbëreshë të shekullit XX, disa prej të cilëve edhe sot vazhdojnë të hulumtojnë, trajtojnë dhe çojnë përpara përvojën shekullore të shkollës së arbëreshëve të Italisë në fushë të gjuhësisë: Nilo Borxha (1870-1942), Gaetano Petrotta (1882-1952), Marko la Piana (1883-1958), Mateo Shambra (1914-1967), Françesko Solano (1914-1999), Anton Belushi (1934-); Emanuil Jordani (1963).

Prej veprave gjuhësore kryesisht të karakterit filologjik e etnografik të brezit të parë dhe të dytë dhe prej veprave gjuhësore kryesisht të karakterit gjuhësor e linguistik të brezit që sot vazhdon të merret me studimet albanologjike ndër arbëreshët e Italisë, Jup Kastrati jo vetëm e ka plotësuar veprën e tij me rezultate të reja, por në gjuhësinë shqiptare ka sjellë rezultate të reja, të cilat gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, përgjithësisht ia kemi atribuuar gjuhësisë dhe studiuesve austro-gjermanë. Kur një ditë të jetë botuar vepra e plotë e Jup Kastratit, përkatësisht sintezat e tij për historinë e albanologjisë ndër arbëreshët e Italisë, në

mjaft pika mendimi për shkollat, konceptet shkencore, domenet dhe nocionet e studimit të albanologjisë, si dhe tezat, sikur është ajo e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe, do të ndryshojë në interes të dijes shqiptare.

Njohësit e jetës dhe veprës së Jup Kastratit e dinë se si formim arsimor ai ishte dialektolog, prandaj është e kuptueshme pse përkushtimi i tij për dialektologjinë në përgjithësi dhe për të folmen veriore në veçanti, ishte plotësuar edhe me të dhënat për të folmet e arbëreshëve të Italisë, strukturën gramatikore të saj, disa veçanti morfologjike, gjendjen e sotme të shkrimit të saj etj.

Nëse me probleme të historisë, etnografisë e etnologjisë, folklorit e traditës përgjithësisht kulturore të arbëreshëve të Italisë Jup Kastrati merrej për ta plotësuar korpusin e tij të madh të studimeve arbëreshe, me gjuhësinë dhe me letërsinë ai merrej për të ngritur dy nga majat më të larta të studimeve të tij: *Historinë e letërsisë shqiptare* dhe *Historinë e albanologjisë*. Në një rreth më të ngushtë do të mund të shikohej edhe interesimi i tij për letërsinë e arbëreshëve të Italisë. Nëse interesimi i tij në *Studimet arbëreshe* lidhet sa me historinë, dijen si kulturë, gjuhën, folklorin, etnografinë etj., për të plotësuar sa njërën periudhë sa tjetrën dhe sa njërin autor sa tjetrin, interesimi i tij për letërsinë është i lidhur para së gjithash me përkushtimin dhe dimensionet e shumanshme të tij për Jeronim de Radën (Jeronim de Rada. *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, 2001), për jetën e tij, (*Jeronim de Rada* (monografi). Përmbyllje, 1962; *Autobiografia e De Radës*. Parathënie, 2001), për veprën artistike dhe letrare të tij (*Këngë të Milosaut*. Parathënie, 1956); për veprën diturake të tij (*Rassegna di Studi Albanesi*. Recension, 1964); për publicistikën e tij *Fjamuri i Abërit*, Parathënie, 1967) etj. I prirë për të parë nga shumë drejtime të kaluarën dhe të sotmen e arbëreshëve të Italisë, Jup Kastrati më në fund do të shkruajë edhe oponenca (*Poezia e De Radës*: oponencë për Klara Kodrën (1981), përshtypje udhëtimi, reportazhe etj.

Pra, vepra e tij madhore, nga më të mëdhatë deri më tash në studimet arbëreshe këtej deti, kap një fushë të gjerë studimore, si: çështje të historisë së arbëreshëve të Italisë, çështje të etnografisë së arbëreshëve të Italisë, çështje të folklorit të arbëreshëve të Italisë, çështje të gjuhësisë dhe të gjuhës së arbëreshëve të Italisë, çështje të letërsisë së arbëreshëve të Italisë dhe çështje të publicistikës së arbëreshëve të Italisë.

Dhimitër Kamarda një nismë e pakurorëzuar e sintezave të mëdha shkencore

Nga fundi i jetë së tij, më 18 nëntor 2000, Profesor Jup Kastrati më shkruante nga Shkodra: “Monografinë ‘Dhimitër Kamarda 1821-1882 (jeta, veprat,

idetë, roli i tij në lëvizjen mendore shqiptare të viteve 1864-1882, rëndësia dhe vendi i tij tejet e madhe në gjuhësinë shqiptare dhe në kulturën kombëtare, veprimtaria albanologjike e kohës)', e kam projektuar për ta përfshirë në vëllimin e dytë të traktatit 'Historia e albanologjisë', që përmban periudhën shkencore të studimit të gjuhës shqipe, që nga Franz Bopp (Berlin, maj 1854) e deri vdekjen e Norbert Joklit (Vjenë, maj 1939). Deri më sot (18 nëntor 2000) kam shkruar 300 (treqind) faqe të daktilografuara. Kaq vend do t'i jap Kamardes në këtë monografi. Por unë do ta vazhdoj punën për viganin e gjuhësisë shqiptare ndër arbëreshët e Italisë. Pasi të përfundoj së botuari vëllimin e katërt të veprës në fjalë (që përmban vetëm aparatin shkencor), unë do ta vazhdoj punën për hartimin e monografisë shteruese: "Dhimitër Kamarda (1821-1882)[15]".

Pak vite më parë ndërkaq kishte përfunduar serinë e sintezave të gjëra për të gjithë gjuhëtarët më të rëndësishëm arbëreshë, si kapituj të veçantë të "Historisë së albanologjisë", por që zinin vend të merituar me studime përgjithësuese në projektin jetësor "Studimeve arbëreshe", dhe përtej tyre mund të botoheshin edhe si monografi më vete. Në mesin e tyre ai shquante studimin e tij për Nikollë Ketën, nga dorëshkrimi i të cilit nuk kishte botuar madje as edhe një fragment. Po këtu mund të shquheshin edhe monografitë për albanologë të shquar arbëreshë, sikur janë Pal Parrini e të tjerë. Dorëshkrim i pabotuar. Varianti i zgjeruar. Nga 140 faqe që ka teksti, janë botuar vetëm 20 faqe në: *Gjuhësia shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XIX ndër arbëreshët e Italisë*, me shkruante mjeshtri im. Me këtë mënyrë dhe me këtë elan të pafundmë pune, bibliografia e botimeve shkencore të Jup Kastratit për kulturën kombëtare shqiptare të arbëreshëve të Italisë, vetëm për një periudhë 45-vjeçare (1953 - 2002), kap 236 zëra, si edhe shënimeve bibliografike për të.

Në vend të përfundimit: vlerësimet e Çabejt, Justin Rrotës dhe të botës arbëreshe

Në Arkivin e letërkëmbimit të pasur të tij me gjithë albanologët e kohës në Shqipëri dhe në botë, gjejmë edhe një dosje posaçërisht të vëllimshme, në të cilën është ruajtur letërkëmbimi me mikun e tij të jetës, Profesor Eqrem Çabejn. Të sistemuara me kujdes sipas kohës së dërgimit, në të cilën ka jo vetëm letra përshëndetëse e kartolina urimesh për ndërrim motesh, po edhe diskutime, përshkrime, fragmente studimesh në dorëshkrim etj. Që në letrën e trembëdhjetë gjejmë të bashkangjitur me një letër që ka karakter personal edhe një dorëshkrim

[15] Profesor Jup Kastrati, letër nga Shkodra, më 18 nëntor 2000: 5

të Profesor Eqrem Çabejt, që në të vërtetë është recension/ rekomandim për një dorëshkrim për botimin e veprave të zgjedhura të Jeronim de Radës[16]. Fjala është për veprat 1. *Këngët e Milosaut,* 2. *Një pasqyrë e jetës njerëzore (Serafina Topia),* 3. *Skanderbekku i pa-faan,* 4. *Poezi shqipe,* 5. *Odiseu,* 6. *Rapsodi shqiptare dhe* 7. *Gramatika shqipe e Zef de Radës,* një pjesë e të cilave ishin të plotë, disa fragmentare dhe disa të tjera vetëm analiza.

Në dorëshkrimin e Çabejt, pas pjesës përshkruese për veprat e de Radës, të planifikuara nga Jup Kastrati për botim, janë dhënë gjerësisht edhe gjykimet e përgjithshme, vërejtjet e veçanta me karakter parimor, vërejtjet rreth transkriptimit, vërejtjet për konsonantat, për përkthimin (parafrazën) e *Milosaut*, si dhe shënime rreth vërejtjeve (komenteve) të veprës *Milosaut*.

Këtë recension Çabej e fillon:

> "M'u dhanë nga Instituti i Shkencavet për shqyrtim këto vepra të De Radës përgatitur për botim nga ana e Prof. J. Kastratit, thuhet në fillim të recensionit të Profesor Eqrem Çabejt, për të vazhduar më tej[17]:
>
> 1. *Këngët e Milosaut,* botim i parë: a) Parathënie; b) Shënime mbi alfabetin e De Radës; c) Teksti origjinal (transkribimi); d) Përshtatje në gjuhën e sotme me bazë dialektin toskërisht; e) Shënime e komentime (vetëm I-XVI këngë); f) Botimi i dytë. Vetëm transkribimi bashkë me përkthimin italisht prej vetë poetit. 2. *Një pasqyrë e jetës njerëzore (Serafina Topia):* a) analiza e veprës (shkon vetëm gjer në f. 14); b) Teksti origjinal (transkribimi); c) Përshtatje në të folmen e sotme; d) Shënime gjuhësore (3 ½ faqe). 3. *Skanderbekku i pa-faan,* vol. V, libri IV, historia IV: a) Teksti origjinal (transkribimi); b) Përshtatje në të folmen e sotme; c) Shënime gjuhësore. 4. *Poezi shqipe,* 5 histori: Teksti origjinal. Vetëm transkribimi bashkë me përkthimin italisht të De Radës vetë. 5. *Odiseu, (3 faqe).* 6. *Rapsodi shqiptare.* Jepet një "analizë e veprës" që s'është tjetër veçse përkthimi i së dy parathënieve italisht. 7. *Gramatika shqipe e Zef de Radës.* Analiza e veprës, dmth. një përmbledhje e përmbajtjes së kësaj. Gjykimi i përgjithshëm. Si shqyrtuam këtë punë nga krei e gjer në fund, në përfundim të analizës që i bëmë kemi arritë në këtë gjykim të përgjithshëm: Nuk është zbatuar sa duhet një metodë rigoroze filologjike kombinuar me kriterin literar, metodë që na duket e domosdoshme në punime të këtij lloji. Në mënyrë të veçantë do të kërkohej një zotërim më i plotë i dialekteve arbëreshe të Kalabrisë. Veçse do thënë se të dyja këto janë punë të vështira, aq më shumë kur nuk kemi një studim rreth dialekteve të asaj treve.
>
> Këto të meta kundërpeshohen me anën tjetër nga një vullnet i mirë, një dashuri për temën, nga përpjekja për ta zotëruar lëndën dhe nga një kujdes i madh që tregohet në këtë punë.
>
> Në këtë mënyrë është kryer një punë pozitive, që meriton të çmohet. Një meritë e

[16] Eqrem Çabej, ***Veprat e G. De Rades***. Transkribuar, kthyer në gjuhën e sotme të Shqipërisë e pjesërisht komentuar prej Jup Kastratit, Tiranë, më 12 prill 1953, 17 faqe të daktilografuara dhe të plotësuara në ndonjë rast me dorë.

[17] Në studimin tonë vërejtjet e përgjithshme po i jap në mënyrë integrale brenda tekstit (ndërhyrjet me laps në fusnotë), ndërsa vazhdimin e tekstit, për vërejtjet e veçanta gjuhësore, po në formë integrale do t'i jap në shtojcë.

veçantë është gatitja e këtyre teksteve për një rreth më të gjerë lexuesish, sidomos për shkolla.
Vërejtje të veçanta me karakter parimor
a) Për sa i përket përkthimit në shqipen tonë, ky që të dalë sa më mirë duhet të arrijë këto cilësi: të jetë poetik që të ruajë kështu frymën e poetit, po me anë tjetër të ruajë edhe ritmin e veçantë të poezisë së De Radës, me anë tjetër të kuptohet prej publikut të Shqipërisë, për të cilin destinohet gjithë kjo punë. Të jetë pra përkthimi dhe i kuptueshëm dhe i hijshëm, pa humbur nga bukuria poetike e origjinalit.
b) Sa kohë që përkthimi është bërë në toskërishten e sotme, të ruhen karakteristikat e këtij dialekti: si në fonetikë, si në ritëm, si dhe në fjalor.
c) Dihet se de Rada ka një fjalor të vetin, fjalë të cilat na duket se s'kanë nevojë për shpjegim; përkundrazi ndonjë fjalë është rrezik të mos kuptohet, me gjithë se kemi përkthimin, p.sh. *kallëzoret* te Milosau. Po ajo që bie në sy këtu është sidomos fakti që shënimet gjuhësore janë përsëritur, shpesh dhe më së një herë, shpjegimet e fjalëve të vështira. Kështu p.sh. shpjegimi i fjalëve *gjellë, ruan, nëng, kopilje, ljinar, gardhi, garé, kurmi, i galjthër, u pruar.* Për t'i evituar këto përsëritje të mërzitshme thom se do menduar se mos nuk është më mirë të mblidhen këto fjalë në një glosar të vogël, i cili do të shërbente kështu për të gjitha rasat kur ndeshin në këto fjalë. E në shënime të shtjelloheshin të tjera sende.
d) Posaçërisht për *Milosaon* botuesi ka gatitur një botim të bazuar në edicionin e parë. Në edicionin e dytë De Rada sikundër dihet, ka shtuar disa këngë të reja. Prandaj si Gualtieri si Resuli i kanë pasur parasysh që të dya botimet. Le të shihet a mos nuk është mirë të shtohen në këtë botimin shqip edhe këto këngët e edicionit të dytë, të paktën si shtesë në fund.
dhe) Për mënyrën e Transkribimit sh. më poshtë. Këtu vetëm do të shënojmë se trajtesat e gabuara në tekstin e De Radës është më mirë të mos riprodhohen në këtë formën e gabuar si bie fj. *botta* për *bora* te kënga e I-e Milosaut, *Shugjeza,* për *shëngjeta* të XVII, po të vihet në tekst trajta e drejtë dhe gabimi të shënohet në shënimet.
e) Nga vërejtjet që kemi bërë rreth Milosaut dhe Serafina Topisë mund të shihet se si mendojmë ne për përkthimin e për shënimet edhe për sa iu përket veprave së tjera të De Radës. Kështu po ato vërejtje themi se mund të hyjnë në punë dhe për këto vepra".

E sollëm këtë fakt për arsye se del për herë të parë një dëshmi e Profesor Eqrem Çabejt për angazhimin e Profesor Jup Kastratit për ta botuar veprën e Jeronim de Radës, të cilën nuk arriti ta botonte për të gjallë të tij, si dhe për të sjellë këtu dy aspekte të përpjekjeve të Jup Kastratit në fushë të veprimtarisë botuese: përpjekjen për botimin e veprës së tij dhe më parë se botimin e veprës së plotë të tij, botimin e plotë të trashëgimisë së albanologjisë në përgjithësi dhe trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të arbëreshëve në veçanti.

Në këtë kohë botohet vetëm vëllimi *Këngët e Milosaut*[18], ndërsa vepra më e plotë e Jeronim de Radës botohet vetëm në vitin 1987[19].

[18] Jeronim de Rada, *Poezi shqipe të shekullit XV. Këngë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës.* Transliteruar, përshtatur në gjuhën e sotme e komentuar, Tiranë, 1956, 204 f.
[19] Jeronim de Rada, *Vepra letrare.* Tre vëllime: Vol. I, 407 f.; vol. II, 403 f. Vol. III, 400 f.

Dhe meqenëse për të gjallë të tij nuk arriti ta botonte as veprën shkencore të tij as atë pjesë të trashëgimisë letrare kombëtare, për të cilën kishte punuar një jetë të tij, sot mund të thuhet se e para si dhe e dyta sot janë testament i përbashkët i atij monumenti që i ka lënë këtij brezi.

Arsyeja për ta sjellë pjesën hyrëse të recensionit të Profesor Çabejt ka të bëjë edhe me një diskutim që është bërë vitet e fundit lidhur me botimin e letërsisë arbëreshe në Tiranë dhe në Prishtinë, që as në përmasën e studimit kritik as në kontekst të kërkimeve, nuk solli ndonjë kontribut të ri në studimet arbëreshe. Përkundrazi, vlerësimi i plotë për kontributin e Jup Kastratit në mbledhjen, botimin, sistemimin dhe studimin e trashëgimisë materiale dhe shpirtërore arbëreshe, nënkupton njohjen dhe botimin e disa dhjetëra recensioneve, studimeve dhe vlerësimeve të bashkëkohësve të tij, të botuara në shtypin ditor dhe atë shkencor apo të lëna në dorëshkrim.

Studime, recensione në dorëshkrim e të botuara janë shkruar për të gjitha botimet, përfshirë ato që Kastrati i kishte në dorëshkrim, si dhe për studime të veçanta kushtuar personaliteteve apo temave të veçanta arbëreshe: *Këngët e Milosaos* (1956), monografinë e parë: *Jeronim de Rada - jeta dhe vepra* (1962), *Skënderbeu i pafan* (...); *Autobiografinë (1973/2003)* dhe në mënyrë të veçantë për monografinë *Jeronim de Rada - jeta dhe vepra* (1979). Për veprat *Studime për De Radën* (2003) dhe *Studime arbëreshe* vlerësimet dhe recensionnet janë botuar disa vjet para se veprat të dalin nga shtypi.

Prej recensioneve për botimet e këtyre veprave dhe sidomos prej recensioneve në dorëshkrim për diskutimin e tyre në redaksitë e botimeve dhe institucioneve shkencore e arsimore, në të vërtetë, lexuesi do ta kuptojë kohën e përgatitjes së tyre për botim.

Sikur mund të shihet, vërejtjet e Profesor Eqrem Çabejt nuk kanë të bëjnë me të gjitha këngët. Prej tekstit të tij në dorëshkrim nuk është vështirë të shihet se leximi ishte shumë i kujdesshëm dhe vërejtjet dilnin nga një lexim i tekstologut që më parë sesa të merrej me leximin e dorëshkrimit të përgatitur nga Jup Kastrati, kishte njohur gjerësisht të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe më parë se ta bënte objekt vlerësimi dorëshkrimin e Jup Kastratit, kishte bërë objekt kritike edhe tekste të tjera letrare e gjuhësore të letërsisë së arbëreshëve të Italisë[20] dhe madje kishte përgatitur edhe një dorëshkrim për këtë letërsi. Vë-

Gjithsejtë: 1.210 f. Shtëpia Botuese Naim Frashëri. Tiranë, 1987.

[20] Shih Eqrem Çabej, *Tekste italoshqiptare*, Hylli i dritës, Shkodër, prill 1935; sipas *Studime gjuhësore*, IV. Rilindja. Redaksia e botimeve. Prishtinë, 1977, 7-13.

rejtje të kësaj natyre nuk bëhen fare në këngët: IV, V, VI, VII, XI, XXVI. Brenda vërejtjeve të karakterit perifrazues hyjnë edhe ato të përgjithshme që Çabej i shënonte me shprehjet apo sintagmat*: "e errët", "nuk është dhënë mirë", "nuk shkojnë fort mirë", "Gualtier e ka...", "kjo shprehje nuk shkon tek ne", "trajta e parë është gegërisht"* etj. Pra, ndonëse gjen ndonjë vërejtje të natyrës gjuhësore apo estetike, nuk shënon propozimin e tij në të gjitha rastet.

Duam të theksojmë këtu se pjesa më e madhe e vërejtjeve të Eqrem Çabejt kanë të bëjnë me anën dialektore të fjalëve, kuptimin e disa fjalëve dhe sidomos trajtat dialektore gege apo toske në të cilat duhet të mbështetej Jup Kastrati në perifrazimin e tyre.

Në këtë kontekst këtu po i sjellim edhe vlerësimet e disa studiuesve të therë, disa prej të cilave botohen nga dorëshkrimi dhe botohen për herë të parë.

Do të fillojmë me një gjykim e vlerësim shumë pozitiv për Jup Kastratin, nga nipi i Jeronim de Radës: Giuseppe Camillo De Rada, në një letër të dërguar më 20 dhjetor 1962, për të vazhduar me më të madhin filolog të kohës së tij dhe nga më të veçantit të shekullit XX, Pater Justin Rrota, i cili në një *Letër urimi për Milosaon* e De Radës, më 2. 5. 1957, në Shkodër i shkruante:

> "*Fort i dashuni Jup,*
> ....Por pika kryesore, për mue po thom, âshtë me t'u falë nderës, për ato dy librat e çmueshëm që më ke dërgue falë. E ma së parit, për botimin e bukur të *Milosut*. (...) Shumë kemi këndue dikur përmbi këtê poet edhe përmbi këtê pemë, Milosau por jitte për ne gjithnji nji prodhim letrar i panjohtun. E njihshim vetëm nëpër pritmin e atyne shkrimtarëvet të letratyrës shqipe, të cilët e kishin këndue si atë mënyrën kritike t'autorit, ma atë alfabet e djalekt teper larg nga këta tanët. E marrshim vesh ndonjë send, por ma fort nuk mbrrijshim t'ia grabisim poetit çka donte me thanë. Merita jote pra, ma e parë âsht kjo, pse na e ke prû në Shqipni, *"alla portata di tutti"* këtë poemë, për ne Shqiptarët këndej Adriatikut, të thuesh krejt të panjohtuem. (...) Sa për zhvillimin e introdukcionet të këtij poemi, jam i sigurtë se ia ke qëllue mirë. (...) Të lumtë!
> (...) Fjalë tekstuale, që ti i thue për "Milosanë" e De Radës, i cili, hiq gjuhën e Arbëreshëvet, dhe diçka fluturimet poetike t'auktorit, mue, si nuk âshtë vështirë t'a kuptojsh, nuk mund t'ishte aqë i tërhjekshëm!
> *Patër Justini*"

Disa vite më vonë (1960), studiuesi i njohur i lagjes së arbëreshëve Giuseppe Gradilione, në studimin e tij "Canti di *Milosao* di Gradilione de Rada", veprën e De Radës përgatitur nga Jup Kastrati e diskutonte katër herë:

- herën e parë, duke njoftuar për botimin e versionit të dytë të De Radës "Këngë të Milosaut", Tiranë, 1956;
- herën e dyti, shkruante

> "Il Kastrati nella sua recente edizione del "Milosao" conserva sia le doppie vocali che le doppio cononanti e l'accento acuto, con evidente svantaggio per una esatta lettura dell' opera" (108);

- herën e tretë, duke veçuar dukuritë fonetike të transliterimit të veprës,

"Qui il Kastrati dimostra di non avare inteso il fenomeno fonetico e qindi i correspondenti segni grafici del De Rada per cui, ce parer suo, gh =gh e g=g; come conseguenca egli interpreta erroneamente come velare tende k il gc (gk), usato invece del De Rada nella prima edizione (sostituito nella sekonda e senza da gch) con valore di velare media g (che chiama guturale rafforzata in "Fiàmuri Arbërit" per distinguerla appunto da quella derivata dalla li)" (110);

dhe herën e katërt, duke veçuar çështjet që kanë të bëjnë me alfabetin:

"Fino a questo puno si é parlato generalmento dell'alfabeto della prima adezione, il quale però subisce nelle successive dei mutamenti, per cui si avvicina di più all'alfabeto di Manastiri. Il Kastrati li ha trascurati, tenendo presonte soltante qullo della prima edizione" (112).

Botimit të veprës së De Radës "Këngët e Milosaos", i ka bërë jehonë edhe bardi i kulturës arbëreshe Francesco Solano. Në studimin e tij "Osservazioni sulle pallate italo-albanesi", veç të tjerash, theksonte:

"... e nell'ugualmenti recente edizione del *Milosao*, curata da J. Kastrati a Tirana, si è incursi nell'errore di riprodurre in trascrizione le doppie usate dal De Rada affermando che un appunto fatto spesso a questi dai vicini italiani è proprio quelle di non pronunciare le doppie dell'italiano, e di profesori delle nostre scuole medie ne sanno qualche cosa, dovendo correggere le composizioni dei loro alunni italo-albanesi"[21].

Le të jenë këto dëshmi të botuara dhe të lëna në dorëshkrim të veprës së Jup Kastratit dhe të vlerësimeve për veprën e tij, vetëm një prej arsyeve pse sot, pas më shumë se gjashtë dekadave, vepra dhe kontributi i Profesor Jup Kastratit do të duhej të vlerësohen dhe të respektohen si një përmendore e veçantë e këndej detit për arbëreshët e Italisë, madje jo vetëm për ta.

[21] Cfr. L'edizione del *Milosao*, curata da J. Kastrati, Tirana 1956, p. 112.

Meliza KRASNIQI, Prishtinë

ROMA E MUSINE KOKALARIT

Abstrakt. Musine Kokalari është shkrimtarja e parë shqiptare dhe e vetmja deri në vitin 1960 që botoi libër. Ajo shkroi tri tekste letrare në Shqipëri dhe tri të tjera të natyrës joletrare në Itali, konkretisht në Romë. E gjithë vepra letrare e saj është rrugëtim që sprovon format: tregime të shkurtëra, tregime të lidhura dhe roman. Ndërsa tekste të tjera joletrare përcillen me shenja autobiografike, antropologjike dhe mendime kritike. U nënvizuan dy plane të shkrimtarisë së Musinesë: një që lidhet me Shqipërinë apo këtu dhe një me Italinë pra me atje. Kërkimi ynë ka për objekt studimi pikërisht rrëfimet e Musinesë për Romën ku tekste themelore janë: Jeta ime universitare dhe Nënua Plakë në Romë.

Këto dy vepra njohin dhe mbitheksojnë rrëfimin antropologjik e autobiografik. *Jeta ime universitare* është rrëfim personal e udhëtim shpirtëror i një studenteje shqiptare që përpiqet ta shohë Italinë si të huaj, ndërkaq Shqipërinë me syrin e një italianeje ku vë në lojë rrëfimin antropologjik mes habisë, refuzimit dhe ironisë (Geraci, 2017, pp. 11-59). Ndërsa, te *Nënua plakë në Romë,* Musineja i ikën rrëfimit autobiografik e rinor, teksa rritet kulturalisht, dhe teksti i përgjigjet një rrëfimi - dëshmimi intepretativ e refleksiv (Asllani, 2018, pp. 61-81) duke kryqëzuar diskursin letrar e antropologjik.

Me anë të analizës tekstuale shpalosim thurjen e këtyre dy veprave duke identifikuar praninë sistematike të përshkrimeve etnografike, vëzhgimin e mprehtë të situatave dhe të skenave të jetës së përditshme romane. Udhëtimi i *nënos plakë* në Romë dhe *Jeta universitare* në Romë të Kokalarit janë refleksione dhe përjetime që ngjajnë në pikën e një ligjërimi të gjallë e të shkallëzuar antropologjik.

Për Musine Kokalarin është shkruar, sidomos këto dy vitet e fundit mjaft, ajo është vështruar në planin kontekstual e në dimensione të ndryshme: qoftë familjar, intelektual, social, kulturor e politik. Gjithashtu është vërejtur se lexuesi dhe kritika ka qëndrime të anshme ndaj figurës së Musinesës, pasiv ndaj verës e aktiv ndaj jetës. Ne jemi munduar që të provojmë argumentin se Musineja përveç që ishte intelektuale e diplomuar në Romë, me origjinë nga një familje aristokrate, e dashur dhe e respektuar nga intelektualët dhe personalitetet e kohës, e dënuar dhe e persekutuar për shkak të politikës, ka qenë e para shkrimtare grua shqiptare dhe e vetmja deri në vitet 1960 që botoi libër. Pra Musine Kokalari ishte shkrimtare e cila shkroi tri tekste letrar në Shqipëri përkatësisht katër nëse *Si lindi partia social-demokrate* mund të quhet i tillë (një sprovë historiko – politike – autobiografike me përsiatje origjinale) dhe tri të tjera të natyrës joletrare në Itali, përkatësisht në Romë. E gjithë vepra letrare e saj është rrugëtim që sprovon format: tregime të shkurtra (*Siç më thotë nënua plakë*), tregime të lidhura (*Rreth vatrës*) dhe roman *(...sa u tunt jeta*). Ndërsa tekste të tjera joletrare

përcillen me shenja autobiografike antropologjike (*Jeta ime universitare*), fiksionale etnografike-/antropologjike (*Nënua plakë në Romë*) dhe mendime kritike (tema e diplomës për *Naim Frashëri*).

U nënvizuan dy plane të shkrimtarisë së Musinesë: një që lidhet me Shqipërinë pra Gjirokastrën dhe një me Italinë apo me Romën. Kërkimi ynë ka për objekt studimi pikërisht rrëfimet e Musinesë për Romën ku tekste themelore janë: *Jeta ime universitare* dhe *Nënua Plakë në Romë*.

Një shprehje e njohur thotë: "Të gjitha rrugët të çojnë në Romë". Kjo lidhet kryesisht me pushtetin që romakët kishin dikur dhe me faktin se Roma shërbente si urë ndërlidhëse midis vendeve tjera të pushtuara prej tyre. Musineja e kishte zgjedhur pikërisht Romën si vend për të studiuar, jo vetëm se në Shqipëri ky nivel i studimit mungonte por edhe për arsyen se Roma ka trashëgiminë historike, kulturore dhe arkitektonike ndër më të pasurat në botë. Prandaj ajo në një moment do të shkruaj "*Roma, ëndrra ime. Sa gjëra kisha mësuar rreth këtij qyteti...*". Rruga jetësore e çonë edhe Musinen në Romë. Dhe Roma, merr një shije tjetër kur guidë bëhet një shkrimtare. Një shëtitje romane e përjetojmë me Musine Kokalarin përmes kujtimeve të shkruara në autobiografinë *Jeta ime universitare* dhe tregimet *Nënua plakë në Romë.*

Interesimi dhe prirja e vazhdueshme etnologjike e Kokalarit për përshkrime të bukura, të sakta, e të gjalla të elementeve etnografike e zakonore dhe folklorike është i hershëm dhe bën që rrëfimet e saja të ndërthurin artistiken me antropologjinë dhe të japin vepra që në të njejtën kohë shkaktojnë kënaqësi leximi, edhe si vepra që na japin informacione interesante për Gjirokastrën, Romën dhe mënyrën e jetesës në këto dy vende.

Këto dy vepra njohin dhe mbitheksojnë rrëfimin antropologjik e autobiografik. *Jeta ime universitare* është rrëfim personal e udhëtim shpirtëror i një studenteje shqiptare që përpiqet ta shohë Italinë si të huaj, ndërkaq Shqipërinë me syrin e një italianeje ku vë në lojë rrëfimin antropologjik mes habisë, refuzimit dhe ironisë[1]. Ndërsa, te *Nënua plakë në Romë,* Musineja i ikën rrëfimit autobiografik e rinor, teksa rritet kulturalisht, dhe teksti i përgjigjet një rrëfimi - dëshmimi intepretativ e refleksiv[2] (thotë Persida Asllani, 2018, pp. 61-81) duke kryqëzuar diskursin letrar e antropologjik.

---

[1] Mauro Geraci, *Musine Kokalari dhe fuqia e ëmbël e poezisë: letërsia, autobiografia dhe antropologjia,* Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Tiranë, 2018, f. 15–30.

[2] Persida Asllani, "Nënua plakë në Romë"- aventura romane e zemrës shqiptare, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Tiranë, 2018, f. 61 – 81.

Roma e Musine Kokalarit vëzhgohet dy fish dhe paralelisht, si dëshmi e përvojës jetësore në tekstin autobiografik si antropologji e Romës së viteve ’40 dhe si antropologji letrare me tekstin fiksional.

Të dy tekstet janë shkruar në kohë të përafërt dhe kishin fatin pothuajse të njejtë, ato gjithashtu përplotësojnë njëri-tjetrin si dy faqe të një jetë por të rrëfyera në mënyrën e tyre, si dëshmi e letërsi të ndërtuara nga zëra të ndryshëm, si ego e alterego apo Musineja dhe Nënua plakë.

Në kronologji do të shpalosim thurjen e këtyre dy veprave duke identifikuar mënyrën e shkrimit të tyre. Udhëtimi i *nënos plakë* në Romë dhe *Jeta universitare* në Romë të Kokalarit janë refleksione dhe përjetime që ngjajnë në pikën e një diskursi të gjallë e të shkallëzuar antropologjik.

Nënua plakë në Romë

Në vitin 1940, më saktë nga 2 qershori deri më 21 gusht, Musine Kokalari do t’i botojë rrëfimet *Nënua plakë në Romë*[3] në formën serike në gazetë, pothuaj si vazhdim i tregimeve të veprës *Siç më thotë nënua plakë*. Mirëpo, këto tekste e kanë një histori të shkrimit prapa, jo vetëm pse janë të shkruara në modelin e strukturave të tregimeve të *Siç më thotë nënua plak*ë, por përtej kësaj. Rrëfimet *Nënua plakë në Romë* janë shkruar sipas kërkesës, janë shkruar me detyrim, andaj na lejohet t’i analizojmë në këtë vijë. Intepretimi i parë lidhet me letrën e datës 2 prill 1940, kur Nikola Lorusso Attoma e ngarkon Musine Kokalarin me detyrë të bashkëpunojë me gazetën *Tomori* për të shkruar rubrikën *Nënua plakë në Romë*. Teksti i letrës origjinale është ky:

Alla Signorina
Musine Kokalari
Roma

A seguito del colloquio da Voi avuto a Roma con l'Eccellenza Parini, VI confermo l'incarcio da Egli datovi di scrivere i nuovi capitoli del libro "i racconti della nonna", con riferimento a Roma e alla vita degli studenti albanesi in Italia.
I Nuovi capitoli del Vostro libro saranno riprodatti a puntate dal Giornale "Tomori" e compensati a parte dall'amministrazione del Giornale stesso.
Resto in attesa di un cenno di riscontro.
Cordiali Saluti[4]

[3] Musine Kokalari, *Nënua plakë në Romë*, BKSH, Tiranë, 2017.

[4] Për zonjushën, Musine Kokalari, Romë. Si rezultat i bisedës që keni pasur në Romë me Shkëlqesë Parini, ju konfirmoj detyrën që ua dha për të shkruar kapitujt e rinj të librit *Rrëfimet e gjyshes*, duke iu referuar Romës dhe jetës së studentëve shqiptarë në Itali. Kapitujt e rinj të librit tuaj do të ribotohen në episode në Gazetën *Tomori* dhe do të kompensohen veçmas nga administrata e Gazetës. Në pritje të përgjigjes suaj.

Veç kësaj korrespondence, ekzistojnë edhe dorëshkrime të Musinesë ku vërehen qartë intervenimet e autores në tregime. Së pari, letra e Lorusos dëshmon se tekstet e *Nënua plakë në Romë* fillimisht janë porositur dhe pastaj janë shkruar e rrëfyer nga autorja. Kjo korrespondencë, dorëshkrimi e daktilografimi që i paraprijnë tekstit letrar të Kokalarit, në studimet kritike të viteve ’70 hyjnë në atë që quhet *avant-texte*. Këtë fenomen e studion kritika gjenetike, e cila i shqyrton mundësitë interpretuese të *avant-tekstit* dhe përshkruhet si *mbledhje e shënimeve të shkrimtarit, skicave, drafteve, dorëshkrimeve, daktilografive, provave dhe korrespondencës*[5].

Termi *kritikë gjenetike (critique génétique)* u formulua nga Louis Hay në vitin 1979 me titullin: *Ese të kritikës gjenetike*. Kritika gjenetike përqendrohet në dimensionin e shkrimit dhe veprën letrare e konsideron proces e jo produkt. Objekti i kritikës gjenetike është shkrimi dhe procesi, pra ajo përqendrohet në *inventio/ shpikje*. Gjenetika, si poetikë e procesit, përveç që përcakton ndryshimet eventuale të shkrimit ajo lidhet edhe me metodën e autorit. Dihet që veprat e botuara kanë një histori shkrimi, si dorëshkrime, drafte, versione, variante, ndërhyrje, heqje, shtime etj. Në letërsinë botërore veprat e Xhejms Xhojsit, Marsel Prustit dhe Tomas Manit janë modele klasike të ndërhyrjeve autoriale, ndërsa në letërsinë shqipe shembulli më i mirë i këtij fenomeni janë veprat e Kadaresë.

Kur bëhet fjalë për rrëfimet e *Nënos plakë në Romë* kujtojmë se ato po aq sa janë të rëndësishme si tekste letrare janë mjaft domethënëse edhe si pjesë e një projekti të kërkuar. Avant – teksti, letra dhe dy variantet e rrëfimit, apo fazat paratekstore të veprës japin një pamje dhe një konceptim të çmueshëm për të depërtuar në interpretim. Pra, si duket mbarëvajtja e punës dhe relacioni kronologjik i procesit të shkrimit të Kokalarit.

Nënua plakë në Romë, sipas shënimeve që i posedojmë prej ditarit *Jeta ime universitare*, është shkruar gjatë vitit të tretë të studimeve në Romë e shtyrë nga kërkesa e Komisarit Italian në Shqipëri z. Parini. Siç e kemi lexuar, letra projekton strukturën elementare të rrëfimeve të Musinesë, sepse aty shënjohet tema dhe forma: “kapitujt e rinj të librit *Rrëfimet e gjyshes*, duke iu referuar Romës dhe jetës së studentëve shqiptarë në Itali” dhe të cilët do të ribotohen në episode në Gazetën *Tomori*. Andaj Kokalari e strukturon tekstin mbi këtë princip të kodit tematik që përmbante nëntë fashikuj të tregimeve të përmbyllura. Referencë herë e bën letrën herë tregimet e *Siç më thotë nënua plakë*, imitohet vepra jo jeta. Prandaj autorja, duke e ditur se nuk përgjasonte por imitonte, ajo

[5] Paola Italia, Giulia Raboni, *Che cos e la filologia d'autore*, Carocci, Rome, 2010.

padyshim ishte edhe e vetëdijshme për shtirje. Këtu empirikisht përmbyset konteksti, i cili shndërrohet në pseudo kontekst letrar. Edhe tregimet e *Siç më thotë nënua plakë* edhe *Nënua plakë në Romë* artikulojnë të njëjtin subjekt, me të njëjtin diskurs në të njëjtën mënyrë. Ato i ngjajnë aq shumë njëra-tjetrës në planin e rrëfimit dhe të formës sa behën rend ciklik ngjarjesh të nënos në Gjirokastër dhe në Romë. Nëse krahasojmë tregimin e parë të përmbledhjes së vitit 1939 dhe pjesën e tretë të tekstit të botuar nën titullin *Ditën e parë…* vërejmë se rrjeti i figurave të krahasimit, sistemi i ideve, *në kohën tonë dhe në kohën tuaj* apo *gratë Gjirokastrite dhe gratë romane*, si dhe esenca e diskursit kanë të njëjtin model shkrimi:

> *Pse më dridhen ashtu, ç'janë ato roba që më bëjnë pas trupit, sikur do t'u çahen veshur. Ç'janë ato nisëla, ata të kuqë e të bardhë që më vënë, po për nusëri ç'do të lënë. Janë të udhës këto, ku është parë kështu! Pa u martuar flasin me burra, më dalin krah më krah, sa i sheh gjithë bota. Jo, jo kjo është e tepërtë. Ne, na zinte babai, as na pjete fare dhe nuk e shihnim gjer sa martoneshim… Të thom, u-bëra kaqë, nuk e di se si është të thënit e emrit të burrit. U – bëra me gjashtë fëmilë, nuk thaçë di fjalë radha me të ndjerin: na, ama, mere, jepe, atë, këtë, këto qenë fjalët t'ona.*
> Siç më thotë nënua plakë[6]

> *Ajo q'i binte qemanes qe në shkallë të Haxhës-të Gjuzos, bërë krolle, qe kallaisur gjer në vesh. S'kish kënë të kuq e të bardhë në Pazar. Si lakudreq më qe bërë…*
> *- Uh, I thaçë, vajzë ësht akoma. E ç'pret, kur do martinet? Ësht nënole, i ka vjeçët ndënë lëkurë. Pastaj pse më është nisur ashtu, e kujt i tregonet...*
> *Mendova, moj këto duan burrat t'onë, që me zi na flasin di fjalë radha. E na dridhemi pa le t'na mbajnë pallton...*
> III. Ditën e parë...[7]

Pavarësisht risive dhe të gjitha gjërave të bukura që sheh dhe provon gjyshja në Romë, karakteri i saj përshkruhet si në përmbledhjen e mëhershme mbi nënon plakë të Gjirokastrës dhe kjo sugjeron se shkrimet janë strukturuar sipas parimeve të shkuara. Përveç funksionit strukturor edhe roli tematik, *brezi i grave të reja dhe brezi grave të vjetra* ripërpunohet tashmë në fillin tematik si *gratë e huaja dhe gratë tona*. Dallimi i vetëm qëndron në atë se përmbledhja *Siç më thotë nënua plakë* e shkruar në diskursin satirik e kritik, ku secila shenjë ka funksionin e vet, autorja e kërkon formën me durim. Këto tregime të shkruara gjatë vitit 1938, do të qëndrojnë në formë të shënimeve e të dorëshkrimeve për një vit dhe vetëm pas vjeshtës së vitit 1939 ajo i boton si libër. Ndërsa tekstet e *Nënos plakë në Romë* të kërkuara në prill të vitit 1940 dhe të kushtëzuara si për kah tema ashtu edhe për nga struktura, botohen në seri vetëm dy muaj më pas. Nëse për librin e parë kishte shkruar edhe poeti Lasgush Poradeci, duke i çmuar

---

[6] Musine Kokalari, *Siç më thotë nënua plakë,* BKSH, Tiranë, 2017.
[7] Musine Kokalari, *Nënua plakë në Romë,* BKSH, Tiranë, 2017.

publikisht shkrimet e Kokalarit, tregimet e shkruara në seri nuk kishin bërë të njëjtin efekt. Aleksandër Xhuvani në letërkëmbimin e atyre javëve thotë:

> *Mirë i ke shkruar përshtypjet e nënos plakë në "Tomorri'n". Më kanë pëlqye (sado që ndokujt jo), e sidomos ajo e III-ta në "Tomorri", 9 korrik.*

Megjithëse tregimet e *Tomorrit* ishin shkruar me një frymë, detyrimi nga ana e Komisarit Italian, si zotim i një marrëveshjeje reflekton në strukturën e shkrimit, i cili skematizohet. Skema hetohet në metodën narrative, e cila tani diktohet nga redaksia e gazetës, sepse pjesët e novelës së serializuar kushtëzohen edhe strukturalisht dhe dalin identike. Formati i *Tomorri-t* domosdo do të kërkonte një numër të caktuar fjalësh apo zakonisht një numër të caktuar faqesh dhe intriga do të duhej të ishte mjaft e shtrirë për të siguruar zhvillimin e plotë të një ngjarje, situate a ndodhie. Çdo tregim javor duhej të ishte interesant dhe i përmbyllur, por duke lënë kufijtë të hapur. Secili rrëfim planifikohej paraprakisht, si ndërtim i jashtëm dhe i brendshëm. Andaj duke i hetuar në këtë pikë, shihet qartë se seria e tregimeve *Nënua plakë në Romë* është dëshmi e një projekti të porositur, një tekst që ka mision dhe përballet në thelb fuqishëm me tregimet e njohura të *Siç më thotë nënua plakë*. Por, procesi i statusit të veprës duhet analizuar edhe më tej, në rrafshin kronologjik të dorëshkrimeve të gjetura. Dy tekstet në dorëshkrim dhe shkrimi i botuar shpalojnë shtigjet e ndjekura dhe rrugët e mbyllura. I japim në vazhdim një pjesë të avant – teksteve dhe tekstin e botuar, megjithëse nuk kanë ndonjë datë do t'i radhisim në formën se si janë shkruar, njëri me shkrim, tjetri i daktilografuar dhe në fund japim tekstin e botuar në gazetën *Tomorri*:





NENUA PLAKE NE ROME.

I. Ne shtepi.

Nenua plake verdhe-dille nga sursti, me kembe dere dreqnja e ere nga udha si mos o Zot, Nërë kaperceu prakun e porte. Erdhi ne avlimi po fundi i frexhes i varesh nga nje ane, nje kuti e mbante ne dore dhe jemeniu i kokes i kish shkare. Pur pa njerzit e shtepisë q'e [illegible] u leshit. Ulë kutin ne shesh dhe iu hodhi duarte. Puth njerin e pusit tjetren.

-"ueh zoj korba..." tha " ju pace dhe nje here! Ueh moj Gjuzo (mori frime)..nuk di me vishen site nga gazi, me hidhë zere si gule. (vuri doren me gjoks)." Pastaj i veshtroi nje nga nje, po nuk i pa te gjitha. "Po nuse Shuqurit ku eshte? Katixheja? Pse s'kane dale te me presim? Pa me thoni si jeni" dhe bente ere me jeneni ne njeren dore dhe me tjetren hapte jakan e antërise. Po zenden e kishte ne vat. Donte te dinte eco gje.."Pa me thoni si jeni? Gjithe mire? Po vogjelit si kane gene? kane bere gje te liga"

NENUA PLAKE NE ROME

I. NE SHTEPI

Ulë... moj korba, mpë... mpë... si mëtej. Ulë... moj Gjuzo... nuk di, me vishen site nga gazi, me hidhë zërin... Po dorën ne gjoks). Po ku kishë nuse Shuqurit. Katixheja, pse s'kanë dalë te me presim? Si jeni, gjithë mirë, me shëndet, të vogjëlit q'bëjnë, a kanë bërë të ligë? Ulë gjuzi mirë, shuriti mënua po e ja hëtu (vënë të vogël). Po si ju bërë burrë. Ashtu do... po më thuaj si bëroni gjë mërin more jetë. Moj fëmi' shtë e ka bërë kësë djalë. Po Shuqurëshës po më duket e prishur nga kurrsti, si mos të kapen mos i ndu ato gjëra në dunë... më si fati e mi. Po bëtë na duket dhë mënja e vogël. Kishë bërë? Lëmë të ëë puth, mos mo ia durën ne e kam if po lard.

— Po urdhëro brënda moj kumbakë — i thotë nuse Shuqurit, pse si u bëmbë. Dal. Si u mar nga krahu, ne si vëgjë dërt shkëlitur se ja e kapur nga mëna. Xëmë bjërt shëshëlat (*) bëlu.

— Oh, ia ti ulpënë bëtë mësëndër në dëndërnua — thotë nënua. I vështrin nje nga nje të gjitha, që nga koka gjer në bërë. I prenë kafënë... nje nga vënë i bëdhë pëll'on krahënë. Allu nëjë m'i vëgël in fat me pëjë dhë i kërkënë shëpën e ëë djëmëve. Mësuar e fjëmi i rënë në kënë pëpëra.

Të gjithë mirë ju gëngj. — u thotë prapë nënës. Shuqurës e pëqë na shëshës e polisë, dënë me pëll me jandin e ndës. Oh kurbë... me dukënë mënë nukë do të vëjë prapë... ëë moj shëtë, moj shëtë, m'a-dukë mërë si ti.

Nuk ju thënë, kënë të falë e pë përfëjë nga ajë vëlë me Mëmë. Më gënë e me gënë mar i nëjë. E lëqë mënë, po i mënë shë ëë me lë kar me pëmëll e ju a mënë, se mës mënë pak, njëës dënë.

Po ju g'më thënë, g'kënë mënë? Gjuzi si e ka djëlë e kanë e lëqë të kë gënë? Si e kanë vajë tek Xëmëti, kuk e di se g'kënë bërë, se e prishë djalë. Po ëë me shëë moj nënë, mës më si dënë (*) me kënë. Po pse s'flë? Moj bëllëgënë. Si nënë me ë flënë, e ngritë ënë e sjënë, gjërë i shëndët, i vënë ëë vëndë. Hapë e mësë i gjëë, q'i bënë ënë më ënë dhë bërë i ju thënë kar ënë?

— Të gjithë mirë jemi, ë mërë dërë (*) — u pëgëgë Ëëëëë, mënë e dënë. Mës ë bënë mënë mënë. Tënë vënë ë ë bënë, nje mënë me gënë ë ngënë ë ë mëëëë kënë, t'u rëëëë (*) ënë ë bënë. Mënë gë na ënë, se na dënë ë shëëë shë. S'ka bënë shënë ju po ë mënë. Dhë ë vëgëë bënë e dënë me kënë vënë, po le Allu gë, gë ë mëëë e gënë ë kënë dënë ë kënë mënë mënë dënë.

— E mënë kënë e jënë moj nënë (*) e jënë. Ëëëë,ënë e vëgël gë kënë. Ëëëë mënë gë kënë gë s'u bënë shënë jënë, se g'kënëënë mënë mënë gë ënë? Ëëëë jënë ëëëë gë s'kënë gë, e kënë i dënë mënë.

— Oh, ëë moj shëëëë, bënë moj mënë, ënë ë mënë ë jënë. Mënë dënë e gënë, shënë se mënë kënë bënë kënë jënë. Po, po e vëgë mënë mënë shënë, do ë kënë mënë gë kënë mënë. Bënë mënë gë bënë ënë jënë. Ëëëë mënë mënë, kënë jënë, ë kënë gë bënë. Ëëëë mënë mënë, ë kënë jënë, ë kënë mënë.

Avant-tekstin e *Nënua plakë në Romë* e përbëjnë dy shkrime, një dorë-shkrim dhe një i daktilografuar. E vërejmë se te dorëshkrimi në paragrafin e parë ka tri ndërhyrje, janë hequr e zëvendësuar fjali të ndryshme, por edhe u është ndërruar vendi. Ndërsa paragrafi i parë i tekstit të daktilografuar është krejtësisht

tjetër. Por, plani i idesë është i përqendruar, figurat dhe diskursi janë po ato. Amplifikimet dhe rimarrjet nga ana e autores shënojnë referencialitetin e plotë të dorëshkrimeve me rrëfimin e dhënë. Këto dorëshkrime, avant-tekste, pa pasur nevojë të përshkruhen e analizohen tutje artikulojnë dëshminë e subjektit autorial. Skica bëhet tregim, mandej tregimit i shtohen edhe disa paragrafë dhe botohet në gazetë. Njohja e avant-tekstit si empiri e hapur shënon luhatjet e Kokalarit, e cila duke i ruajtur ato, tregon se komunikonte me procesin e krijimit si esencë.

Por, si duket vepra tani që është botuar e plotë? Struktura e saj është e ndarë në nëntë pjesë: *Në shtëpi, Udhës, Ditën e parë, Ç'i zuri siri, Nënua në Thjatro, S'marr vesh fare, Nënua në shkollë të madhe, Nënua u duk prapë* dhe *Nënua do Gjirokastrën*. Udhëtimi i nënos që kap njëzet ditë në Itali, Romë, ka dy topose *këtu* dhe *atje*, *Gjirokastra* dhe *Roma*. Nënua plakë kishte vizituar mbesën në Romë dhe aventura e saj konsiston në rrëfimet plot humor, satirë dhe kritikë. Rrëfimi homodiegjetik i vënë në gojën e nënos plakë, e bën diskursin e tregimeve edhe më pikant kur ajo dëshmon për përvojën e saj personale në anije, në kafene, në teatër e në fakultet. Si një hetuese e mprehtë, ajo sheh dhe dallon shenjat urbane dhe teknologjike të cilat i krahason me prapambetjet e vendit të vet, Gjirokastrës. Megjithatë këto kontraste të forta qoftë edhe në sjelljen e njerëzve dhe qytetërimit modern, ajo prapëseprapë anon kah e vetja, kjo vërehet dhe lidhet simbolikisht dhe me titullin e kapitullit të fundit *Nënua do Gjirokastrën*.

Rrëfimi spontan e plot humor i Nënos plakë për Romën për të rrëfyer Gjirokastrën dhe e kundërta është objekti i tregimeve, që, edhe pse shkruara në bazë të një kërkese të hapur në formë serike në gazetë, gëzojnë një vend të veçantë në krijimtarinë e Musinesë si proza mjaft interesante.

Jeta ime universitare

Para se të kthehej në Shqipëri, në vitin e fundit të studimeve, Musine Kokalari do të shkruajë libër mbi jetën e saj universitare të kaluar në Romë nga viti 1938 në 1941 të titulluar *Jeta ime universitare*. Por, cili është statusi i këtyre shkrimeve për jetën? Nëse nisemi nga titulli dhe e lexojmë ndarjen e brendshme të librit e shohim se shënimet e *Jeta ime universitare* janë të strukturuara në katër, respektivisht pesë pjesë: *Parafjalë, Viti i parë, Viti i dytë, Viti i tret* dhe *Viti i fundit*. Rrëfimi për jetën e kaluar katërvjeçare në Itali është jetëshkrim që na shpie te zhanri autobiografik, apo nënllojet e tij. Autobiografia përkufizohet si zhanër narrativ, ku narratori rrëfen historinë e jetës së vet në formë të kujti-

meve e që është e lidhur ngushtë me memuaret, kujtimet, ditarin dhe biografinë[8]. Por, ajo që e dallon atë nga këto është se në memuare jeta personale nuk është në qendër të rrëfimit, ditari jo domosdoshmërisht karakterizohet nga prapakthimi, ndërsa me rastin e biografisë, autori dhe narratori nuk janë i njëjti person, kurse kujtimet janë nënlloj që ngërthen të gjitha më sipër dhe e përbashkëta e gjithë këtyre është se nuk janë zhanre letrare. Te *Jeta ime universitare* Kokalari rrëfen storjen e vet, duke pasur në qendër vetveten, në formë retrospektive dhe del se këto shënime kanë statusin e kujtimeve personale si subzhanër autobiografik.

Kujtimet e Kokalarit kërkojnë modelin e shkrimit subjektiv sepse këto janë përshtypjet e saj të shkruara aposteriori, motivi është objektiv, sepse u drejtohet lexuesve si dëshmi, ndërsa në qendër të tekstit është *jeta* përgjatë katër vjetëve më të rëndësishme të autores. Libri ishte shkruar në italisht dhe ishte menduar të botohej atëherë, por nuk e pa dritën e botimit deri pas vdekjes së autores. Në pjesën *Parafjalë*, të cilin do ta japim të plotë, që bëhet çelës për leximin e kujtimeve në fjalë, Kokalari shkruan:

> *Në qershorin e vitit 1937 kreva në Tiranë shkollën e mesme dhe nisa ta mendoj fort për muaj të tërë për një aspiratë të madhe, të re për ne vajzat shqiptare: Universitetin. Deri tani, mjaft herë kisha dëgjuar për jetën universitare si për një jetë të thjeshtë, të këndshme dhe plotë ëndrra.*
> *Mungesa në vendin tonë e këtij niveli studimesh na shtynte ne vajzave shqiptare ta kërkonim jashtë, e natyrisht në Itali, mundësinë për t'i përmbushur ambiciet tona.*
> *Tani jam duke e mbaruar këtë kurs, kësisoj vendosa të shkruaj përshtypjet e mia, para se të iki nga Italia.*
> *Ky libër është një dëshmi vetjake e përvojës sime jetësore e akoma më shumë e mendimit tim. Është një prozë e natyrshme e jetës së përditshme.*
> *Idetë e shprehura në këtë libër nuk janë të reja, i kanë menduar tashmë edhe të tjerët, por ato janë bërë pjesë e qenies sime.*
> *Nuk jam erudite, ndaj vëzhgimet e mia mund të mos duken të thella. Kam lexuar shumë, gjithçka që më ka rënë në dorë, metoda ime e shkollës së mesme ishte e gabuar dhe aty e kanë burimin vështirësitë me të cilat jam përballur gjatë universitetit.*
> *Nuk kanë për të munguar kritikat për librin tim, veçanërisht lidhur me italishten, që është gjuhë e bukur dhe shumë e pasur, por që unë nuk e njoh në mënyrë të përsosur: pavarësisht kësaj dua të përpiqem t'i shpreh mendimet e mia*[9].

Në këtë *parafjalë* Kokalari shënjon natyrën dhe objektin e asaj që do të rrëfehet. Në fillim hap çështjen që lidhet me përcaktimin e autores për të vazhduar shkollimin si përmbushje e ambicieve të saj, duke na informuar njëkohësisht se në vendin e saj mungonte ky nivel i lartë studimi. Kjo zbulon dëshirën

---

[8] Roy Pascal, *Design and Truth in Autobiography*, Cambridge: Harvard University Press, USA, 1960.

[9] Musine Kokalari, *Jeta ime universitare*, Geer, Tiranë, 2009, f. 335.

e subjektit rrëfyes që na shpie te individualiteti i saj, por gjithashtu provon evidentimin e informacionit. Vërtet deri në vitin 1957 nuk u themelua universiteti shqiptar si institucion. Kokalari zgjedh të shkruajë *përshtypjet* si *dëshmi* dhe në këtë plan ato i quan *proza të natyrshme të jetës së përditshme.* Duke e lexuar kështu, hapet rruga jo vetëm për të hetuar informacionin e dhënë, evidencat e përshtypjet, por kjo nënkupton edhe pozicionim më të përgjithshëm, sepse kur autorja shkruan për jetën e saj universitare ajo flet për jetën universitare të një të huaje në Itali. Ky libër do të zbulojë nivelin e njohjes së gjuhës italiane të saj, thotë ajo, duke i shprehur mendimet dhe përjetimet me një gjuhë të thjeshtë elementare ajo frikësohet se do të kritikohet dhe se gjuha do t'i ngjajë thjeshtësisë se jetës së autores. *Parafjala* bëhet shenjë që identifikon modelin e shkrimit informues, argumentues dhe përshkrues nga njëra anë dhe ekspresiv, emocional dhe shpjegues në anën tjetër. Kjo e lidh tekstin me empiri e sentiment.

Autorja i shmanget ndërtimit klasik të rrëfimit, këto kujtime i shkruan mbi bazën e strukturës së temporalitetit, kohëshmërisë, që nis me hyrje, duke vazhduar me vitin e parë deri te viti i fundit i studimeve, duke përzgjedhur episode të rëndësishme jetësore.

Viti i parë: Meqë teksti është i shkruar në formë të koncentruar temporale, duke nisur nga viti i parë i studimeve, autorja kujton ditën e nisjes, 15 janarin e vitit 1938. Ajo shkruan haptazi dhe arbitrarisht e me emocion: *Roma, ëndrra ime!* Musineja e realizon ëndrrën e saj, por edhe të qindra vajzave të tjera, jo vetëm shqiptare, të studiojë në Itali. Pjesa e parë e *Jeta ime universitare* është rrëfim për ëndrrën dhe ambicien që përbashkon përjetimin dhe përshtypjen, të cilat i rrëfen në rend. Ky sistem shënjon ndodhitë, situatat, detajet e veçantitë. Këto njësi minimale të diskursit autobiografik e biografik, Roland Barti i kupton si biografema[10], *...kur jeta e shkrimtarit reduktohet në disa detaje, shije, ndryshime....* Meqenëse Barti flet për biografinë, është me e natyrshme, nëse këtë term do ta zëvendësojmë me një tjetër që i përshtatet autobiografisë e të cilin do ta quajmë autobiografemë. Autobiografemat që përbëjnë konstruktin e kësaj pjese janë: njohja e Romës, mosnjohja e gjuhës dhe kthimi për pushime në shtëpi. Kokalari ishte informuar për Romën paraprakisht dhe kësisoj e kishte ndërtuar si ide përmes leximeve. Pas ardhjes ajo do të thurë përjetimin e Romës përmes shëtitjeve, duke na endur nëpër rrugët e njohura dhe të panjohura nëpër të cilat ec me orë të tëra pa u lodhur. Duke u ndier më e gjallë në ëndërr sesa në zhgjëndërr, duke ndier momente zbrazëtie e pakënaqësie, ajo këtë dhimbje

[10] Roland Barthes, *Sade, Fourier, Loyola,* University of California Press, USA, 1989, f. 9.

emocionale të padurueshme e kthen në vizita të vazhdueshme të pallateve, muzeve, bazilikave, monumenteve, kishave, shesheve, shtatoreve etj. Në planin diskursiv themi se këtu preket diskursi informues me atë përshkrues, por të lëkundur nga emocioni. Rrëfimi për vitin e parë të studimeve ka për esencë në radhë të parë refleksionet e autores për Romën, të cilat dalin si kronikë historike e një kulture të vendit. Musineja frikën dhe mërzinë e sheh edhe në mosnjohjen e gjuhës, meqenëse ajo zotëronte vetëm nocione të natyrës shkollore që e shtyn atë të mos komunikojë pothuajse fare. Tutje rrëfimi përqendrohet te kthimi në shtëpi ku për herë të parë vë re rrugët, shtëpitë, banorët dhe padashur zhvillohet një tip krahasimi i *këtu* dhe *atje*. Shenjë kjo se nëpër këtë proces vëzhgimi social e kulturor, autorja shkruan përvojën jetësore të vitit të parë më shumë si dëshmi sesa përshtypje subjektive:

> *Pak më tutje lartësohen tri kolonat e tempullit të Kastorit: një kujtim i kohëve të para të Republikës, kur beteja e vitit 494 para Krishtit shkatërroi çdo shpresë të rikthimit të Tarkuinit. Pastaj syri bie mbi një hapësirë të gjerë drejtkëndore: bazilika Xhulia. Aty afër është tempulli i Saturnit*[11].

Diskursi informues dhe përshkrues e ndërton kryesisht pjesën e parë të rrëfimit i cili kërkon të lexohet si përjetim pasi që lidhet ngushtë me subjektivitetin e rrëfyeses në planin autodiegjetik, e mbizotëron emocionin dhe bëhet shënjues që jepet në funksion klasik të dhënies së vendeve.

Viti i dytë kap saktësisht një vit të plotë, nis në fund të tetorit të 1938, me kthimin e Musinesë në Itali, dhe përfundon me 20 tetor 1939 po ashtu me një kthim tjetër në Romë. Ecuria e rrëfimit të kujtimeve nis me përshkrimin e peizazheve natyrore si skena metaforike të gjendjes së brendshme të autores. Autobiografema e parë ka të bëjë me ndryshimin e natyrës shpirtërore te Musinesë. Nëse në vitin e parë të studimit, mosnjohja ishte frikë dhe emocionalisht kjo përkthehej e shërohej me vizita e ecejake të shumta, tani situata do të ndryshojë ndjeshëm. Psikologjia e saj krijon një zhgënjim për Romën me të cilën tanimë ishte familjarizuar mjaft dhe kërkon një ikje në vende të reja; ajo shkon të vizitojë Napolin. Forma e rrëfimit relativizohet, nga narracioni autodiegjetik realiteti tani ndërron shkallë dhe rrëfehet në shumës në pozicionin heterodiegjetik:

> *Nuk ndalojmë gjatë, nisemi në Pompei. Mbërrijmë dhe atje gjejmë njerëz të tjerë. Duket sikur kemi ardhur të gjithë bashkë dhe ja ku jemi te Porta, ku shohim shtatoren e Minervës dhe ndonjë hap më tutje hyrjes dyqanet e hapësirshme të dikurshme, që janë kthyer në muze*[12].

Këtu thyhet besueshmëria e paktit autobiografik, i cili i formuluar nga

---

[11] Musine Kokalari, *Jeta ime universitare*, Geer, Tiranë, 2009, f. 344.
[12] Po aty, f. 362.

Philippe Lejeune, kërkon që në rastin e shkrimit të autobiografisë, autori të hyjë në një pakt ose kontratë me lexuesin, duke premtuar që të japë të dhëna të hollësishme të jetës së tij/saj dhe asgjë tjetër pos asaj jete[13]. Ky kusht, tejet i rëndësishëm, midis autorit dhe lexuesit, presupozon, veç tjerash, që autori, narratori dhe protagonisti duhet të jenë plotësisht identik. Narratori në pjesën e dytë të *Jeta ime universitare* nuk flet më në veten e parë dhe vetëm për veten, por në shumës dhe për të tjerët. Ndodh që ky identifikim me të tjerët, me shoqet e saj, është krijuar për të zgjeruar përjetimin e shkurtër të ikjes nga melankolia që e kishte kapluar Musinenë. Autobiografema që lidhet më gjendjen e trishtë të autores, të ditëve të kaluara pa kuptim dhe qëllim, e që artikulohet në mënyrë filozofike mbi kuptimin e jetës, do të shndërrohet në një autobiografemë të re. Kokalari tregon me dhembshuri lidhur me sëmundjen e kunatit të vëllait, të cilin do ta vizitojë për çdo ditë në spital. Shenjat e indiferencës ndaj Romës dhe mërzisë së shëtitjeve tani zëvendësohen me vuajtje e sëmundje. Gjendja shpirtërore e vrarë tani sëmuret vërtet, ambienti i hapësirës ngushtohet në dhoma spitalore, ndërsa fytyrat e lumtura dhe të shkujdesura të italianëve tani marrin pamjen e njerëzve të pakënaqur dhe me buzëqeshje të dobët e sy gjysmë të mbyllur. Teksti i pjesës së dytë lidhet me autobiografemat e vuajtjes shpirtërore, e diskursi emocional vihet nën shenjën e sentimentit personal. Ndjeshmëria, lufta me ndërgjegjen, revolta me vdekjen nga njëra anë dhe situata politike në Shqipëri midis trupave ushtarake do ta rëndojnë psikologjinë e Kokalarit, e cila vitin e dytë do ta përfundojë si përjetim të lodhshëm.

Viti i tretë dhe viti i fundit apo pjesa e tretë dhe e katërt e tekstit të kujtimeve autobiografike të Musinesës lidhet me tri autobiografema të mëdha: sëmundja, dashuria, diplomimi. Pas shtrimit të nipit, Hektorit, në spital, rrëfimi sërish do të shtjellohet si dëshmi e një vëzhgimi të shquar të mjedisit spitalor, sjelljes e gjesteve të të sëmurëve e mjekëve.

> *Pata në këtë mënyrë rastin të njihja mjekët. E çuditshme, qysh në fillim nuk kisha arritur t'i takoja. Gjithnjë shumë të zënë, të pakapshëm, gjithnjë kishin punë për të bërë. Të gjithë të çonin sa te njeri, sa te tjetri.*
> *Pasi e kuptova mënyrën e sjelljes së mjekëve, arrita më në fund të flas me një prej tyre*[14].

Në faqe të tëra dëshmia personale e Musinesë, që sërish gjendet në spital, e krijon një formë të ndërliksur diskursi informues e sentimental. Saga për rrëfimin e këndit të të sëmurëve lëkundet midis boshtit të varianteve diskursive. Në spital, përveç dramës së brendshme shpirtërore të autores rrëfehet për nipin

---

[13] Philippe Lejeune, *On Autobiography*, University of Minnesota Press, USA, 1989.
[14] Musine Kokalari, *Jeta ime universitare*, Geer, Tiranë, 2009, f. 384 – 385.

me anë të skenave e portreteve rrëqethëse ku ndihet britma e njeriut në humnerën e dhimbjes. Në këtë ambient nuk ka se si të mos përshkruhen mjekët, infermieret, prindërit e shqetësuar që presin me ankth vdekjen, fatalitetin e shpërfytyruar në këtë kënd të harruar të botës. Artikulimi i këtyre kujtimeve i përshkruar thjesht dhe me kujdes, duke dhënë tablonë e përgjithshme, i ndërton personat në vija të trasha, duke mos i karakterizuar apo emëruar, ata i përmend vetëm me iniciale.

Paralelisht me këtë përjetim, por në një nivel krejtësisht emocional, tematizohet rrëfimi për dashurinë. Historia e dashurisë midis Musinesë dhe një italiani të dhënë me inicialet P. T. është autobiografema më e rëndësishme, sepse ky përjetim do ta ndryshojë thellësisht Kokalarin si individ. Rrëfimi për dashurinë si kujtim personal krijon identitetin e narratores autobiografike, duke bërë që të intensifikojë pjekurinë e saj shpirtërore. Në vorbullën e çështjeve që kishin të bënin me provimet, diplomimin dhe kujdesin për nipin, ajo përjeton dashurinë, mashtrimin, pabesinë e sidomos zhgënjimin. Musineja e krijon lidhjen shoqërore me djalin italian mbi bazën e pasioneve të përbashkëta, mirëpo dashuria e saj ndërtohet me skepticizëm dhe dyshim. Në letërkëmbimin e shpeshtë midis saj dhe të dashurit lexojmë:

> *Jam në Tripoli dhe nesër nisemi për në frontin egjiptian. Por duhet të kesh besim tek e ardhmja. Jam i ri dhe do të kthehem. Nuk më shkruan kurrë një fjalë të ngrohtë dhe nuk më thua kurrë se më do. Me t'u kthyer në postë, do të çoj lajme*[15].

Përshkrimi dhe paraqitja e ngjarjes lidhur me dashurinë midis Kokalarit dhe P. T.-së jepet në mënyrë kronologjike, me anë të letrave, takimeve e më vonë thashethemeve të iniciuara nga e ëma e P. T.-së. Situatat, mendimet, dilemat, ndjenjat dhe përvuajtja e Musinesë, e cila jo vetëm që zhgënjehet me të dashurin, me familjarët e tij, por e distancon edhe nga shoqet, rrëfehet me një shtresë të diskursit ironik dhe eksplikohet me komente, gjykime dhe dekurajim jo vetëm për dashurinë, por dhe për njerëzit në përgjithësi. Jeta e Musinesë merr kuptim vetëm në vetmi dhe shprehet si mërzi.

Me pak tekst e me fjalë të kursyera, autorja mbërrin të na jap autobiografemën e fundit, përfundimin e universitetit. Ambientin e atmosferën e realizmit të ëndrrës e ilustron shpejt e shpejt dhe pastaj kalon në një shpërthim ku ajo i drejtohet vetes: *Erdhi koha për t'u nisur drejt vendit tënd, drejt mjedisit tënd të vjetër, drejt një të ardhmeje përvijimesh të paqarta....* Këtu theksohet kthimi, por nënkuptohet e ardhmja e pasigurt, në formë urdhërore dhe me një dozë shqetësimi e ndjeshmërie.

---

[15] Po aty, f. 397.

Kujtimet e *Jeta ime universitare* të shkruara si autobiografi, ka për objekt atë që shënjon titulli *jetën universitare*. I tërë libri përcillet me një diskurs në variante, herë informues e argumentues, e herë emocional e më ekspresiv. Ngjarja jetike e katër viteve të kaluara në Romën e bukur zbërthehen nëpërmes njohjes, dashurisë, vuajtjeve, mërzisë, fatkeqësive të ndryshme e pikëllimit. Musineja përveç kronikës së historisë së vet universitare jep dëshmi për dy vende, Italinë dhe Shqipërinë, përgjatë viteve 1938 – 1941. Ajo i shkruan biografi vetvetes me një rrëfim personal dhe intim, të hapur e konkret. *Jeta ime universitare* manifeston botën e brendshme të Kokalarit, është një autobiografi intelektuale me mjaft përshkrime, përjetime dhe plot emocion, të cilat në fund të fundit mund të quhen edhe kujtime letrare meqenëse janë shkruar nga një shkrimtare.

Këto dy tekste të Kokalarit janë shkruar në Romë, për Romën e viteve ’40. Ajo kishte përbashkuar hapësirën përmes këndvështrimit të saj origjinal, si dëshmi e kritikë, të rrëfyera si humor e si histori. Rrëfimi i nënos plakë për Romën moderne si letërsi nga njëra anë dhe rrëfimi i Musinesë për Romën e ëndërruar përtej kronikës universitare janë një lloj sinteze e modeleve të rrëfimeve entografike.

Nënua plakë në Romë dhe Jeta ime universitare përmbajnë vlera të rëndësishme të një letërsie dhe autobiografie të mirëfilltë etnografike për Romën. Një antorpologji bashkëkohore që sjell informacione për Romën dhe mënyrën e jetesës së Romës si studente e si viztiore në vitet ’40, dallimet Shqipëri – Itali që realizohen mjeshtërisht përmes zërit të nënos e ndërgjegjes së Musinesë.

Agron Y. GASHI, Prishtinë

DE RADA SIPAS ARSHI PIPËS

Abstrakt. De Rada, autori i madh arbëresh, jetoi, krijoi dhe vdiq në Maki të Italisë. Arshi Pipa poet, kritik dhe filozof, studioi dhe shkroi në pjesë të veprës së tij, po ashtu në Itali. Vepra e të parit u bë objekt studimi i të dytit te *Trilogia Albanica* II, *Hieronymus De Rada* (1978), të cilën do ta shqyrtojmë, meqë konsiderohet si njëra ndër studimet më gjithëpërfshirëse jo vetëm për De Radën, por edhe për letërsinë dhe gjuhën e arbëreshëve të Italisë në përgjithësi.
Vështrimi ynë, ashtu si studimi i Pipës, strukturohet në mes letërsisë dhe linguistikës; nis me interpretimin e dorëshkrimeve të De Radës, zgjerohet në gjuhën, metrikën e shqiptimin stilistik e deri te poetika e romantizmit shqiptar, duke zbërthyer fenomene letrare dhe ekstraletrare të letërsisë së arbëreshëve të Italisë. Motiv për të analizuar këtë monografi është fakti se ajo ofron të dhëna të studiuesve arbëreshë për veprën e De Radës, si nga pikëpamja letrare, ashtu edhe nga filologjikja. Aty analizohen shkrimet dhe dorëshkrimet e hershme italisht, gjuha, prozodia, ideologjia, stili dhe çështje të tjera nga linguistika (leksiku, morfologjia, sintaksa), estetika e politika.

1. Hyrje

De Rada, autori i madh arbëresh, jetoi, krijoi dhe vdiq në Maki të Italisë. Arshi Pipa, poet, kritik dhe filozof, studioi dhe shkroi një pjesë të veprës së tij, po në Itali. Vepra e të parit u bë objekt studimi i të dytit te *Trilogia Albanica* II, *Hieronymus De Rada* (1978), e cila konsiderohet si njëra ndër studimet më gjithëpërfshirëse, jo vetëm për De Radën, por edhe për letërsinë, gjuhën e arbëreshëve të Italisë, në përgjithësi.

Studimi i Pipës strukturohet në mes letërsisë dhe linguistikës; nis me interpretimin e dorëshkrimeve të De Radës, zgjerohet në gjuhën, metrikën e shqiptimin stilistik e deri te poetika e romantizmit shqiptar, duke zbërthyer fenomene letrare dhe ekstraletrare, jo vetëm të veprës së De Radës, por edhe të letërsisë shqipe të arbëreshëve të Italisë. Aty analizohen shkrimet dhe dorëshkrimet e hershme në italisht, si: gjuha, prozodia, ideologjia, stili dhe çështje të tjera nga linguistika (leksiku, morfologjia, sintaksa), estetika e politika.[1]

2. Leximi e kërkimi

Historia e leximit nis në rini, ajo e kërkimit dhe e interpretimit në pjekuri.

---

[1] Arshi Pipa: *Jeronim De Rada*, Trilogjia Albanika II, Princi, Tiranë, 2013

Tashmë Pipa ishte dëshmuar mirë në studime e metoda kërkimesh, nga interpretimi filozofik, krahasues, kërkimi i autorit, interpretimi sociolinguistik e perspektiva sociale, deri te kritika e analiza filologjike e tekstit.

Albansk Samling Ellbansk Semlling është Instituti i Linguistikës në Kopenhagë, ku u mblodhën dorëshkrimet e De Radës, për të cilat linguisti i njohur Luis Hjemeslev, ftoi studiuesit shqiptarë që t'i studiojnë, meqë ndiqte traditën e Holger Pedersenit. Arshi Pipa, tashmë autor i sprovuar në jetë dhe letërsi, profesor në universitetin e Minesotës, iu vu kërkimit. Fillimisht autori jep një pasqyrë të të dhënave në këtë institut, pastaj të gjendjes së dorëshkrimeve nëpër biblioteka italiane e deri te përplasja e tezave me Xhyzepe Ferrarin, sipas të cilit, në një dorëshkrim të gjetur në Kalabri, kishte autor Mikel Belushin, i vdekur më 1707.

Po sipas Ferrarit, koleksioni i këngëve "të Belushit" paraqet "tufën më të vjetër të këngëve popullore italo-shqiptare duke i paraprirë, madje edhe *Kodeksit të Kieutit (Chieuti Codex)*.

Ajo që krijoi dilema edhe te Arshi Pipa është fakti se ky koleksion kishte mjaft të përbashkëta me *Milosaon*, hiç më pak se njëmbëdhjetë këngë. Prandaj çështje që shtrohej në këtë arenë diskutimesh ishte pikëpyetja se, *a mos De Rada i kishte përvetësuar këto këngë popullore dhe i kishte paraqitur si të vetat? Teza e Ferrarit le të kuptohet se kemi të bëjmë me plagjiator*,[2] thotë Pipa. Në mes këtyre hipotezave, dilemave të (pa)natyrshme, Pipa konstaton se De Rada ishte marrë në mbrojtje nga Françesko Solona, apologji kjo e botuar ne revistën *Shêjzat*, përmes së cilës hodhi poshtë hipotezën e Ferrarit. Nga kjo doli teza se këngët popullore arbëreshe me titullin italisht *Collezione di poesie albanesi*, që i atribuoheshin Mikel Belushit, ishin të mbledhura nga De Rada i ri, me motivimin e Rafaele Valentinit.[3]

Duke rendur pas dorëshkrimeve të *Milosaos*, një variant në *Albansk Samling*, në Kopenhagë, (1979), rezulton të ketë jo vetëm tri variante, por pesë deri në gjashtë variante të shkruara të *Milosaos*. Pipa zbulon fragmente të *Proto-Milasaos*, të cilat i botoi në shtypin e kohës, (*Përpjekja jonë*, 1972), pastaj edhe në një revistë franceze (1973) me titull *Gjeneza e Milosaut.*

Pra, pjesa e parë është një udhëpërshkrim kontekstual i një kërkimi gjenetik të dorëshkrimit të *Milosoas* dhe fragmenteve të saj.

Po në vitet '70, kur u botua kjo monografi, studimet letrare janë pasuruar me një qasje të re, me kritikën gjenetike, e cila propozohet për të ripërtërirë

[2] Arshi Pipa: *Jeronim De Rada*, Trilogjia Albanika II, Princi, Tiranë, 2013, f. 21.
[3] Arshi Pipa: Idem.

njohuritë e teksteve në dritën e dorëshkrimeve të tyre, duke zhvendosur çështjen kritike nga struktura drejt procesit, nga vepra drejt gjenezës së saj.[4]

Nuk themi se intenca autoriale ishte të provohej në një qasje të re, pra në kritikën gjenetike, por kjo ishte e domosdoshme që të arrinte rezultatet, meqë autori donte t'i shpaloste dorëshkrimet dhe t'i interpretonte në dritën e botimit.

Kritika gjenetike gjen hapësirë më shumë te pjesa e parë e monografisë, sidomos te *Zanafilla e Milosaos*, në të cilën autori i përshkruan faktet, e që bien ndesh me pretendimet e Xhuzepe Ferrarit, i cili shtroi dilemën e autorësisë së dorëshkrimit. Sikur kjo të mos i mjaftonte, Pipa përherë rikontekstualizon referenca nga *Autobiologjia I* dhe, meqë në dorë ka *Milosaon*, analizoi fletë të shkëputura, fragmente nga *Strofat e Milosaos*, skica të papërpunuara, deri te varianti i plotë. Po ashtu, gjatë këtij kërkimi vuri në pah kodet e saj: moralitetin shqiptar dhe simbolizmin erotik, një analizë kjo kontekstuale (e botimit) dhe tekstuale (e kuptimit) dhe e përfaqësimit figurativ e autorial.

Pra, kërkimin e tij e shtron edhe si kalim nga rrafshi i përvojës reale të autorit, pra nga autobiologemat e tij, te rrafshi fiksional, të cilin Pipa e cilëson si letërsi e stilit *Ëeltcshmerz*,[5] por gjithnjë me *aromën e idileve klasike* si jehonë e Virgjilit dhe Teokritit, t*ë lidhur fort për folklorin italo- shqiptar*.[6]

Përderisa subtemat evidentohet të përafërta me ato të Homerit (klasikët), për Pipën, motivet bëhen të ngjashme me ato të Leopardit, sidomos të Petrarkës. Këtë të fundit, De Rada *e kishte studiuar me ngulm në kolegj në mënyrë që të formonte një stil të vetin*,[7] atë që De Rada e quante *rrëfim lirik të dyfishtë*.[8]

---

[4] Almuth Gresillon: *Kritika gjenetike, origjina, metodat, teoritë, hapësira, kufijtë*, Institut des Textes et Manuscrits Modernes, VEREDAS 8 (Porto Alegre, 2007) 31-45, botuar në revistën letrare *Jeta e re*, nr.1, 2018, f.193.

[5] *Weltschmerz* (nga gjermanishtja, fjalë për fjalë - dhimbje po edhe lodhje botërore. E shqiptuar si *vɛltʃmɛ̞ʁts* është term i krijuar nga autori gjerman Jean Paul. Në kuptimin e tij origjinal në Deutsches Wörterbuch nga Vëllezërit Grimm, ky term tregon një trishtim të thellë në lidhje me papërshtatshmërinë ose papërsosmërinë e botës. Ky lloj vështrimi, botës ishte i përhapur në mesin e disa autorëve romantikë dhe dekadentë, si: Lord Byron, Oscar Wilde, William Blake, Marquis de Sade, Charles Baudelaire, Giacomo Leopardi, Paul Verlaine, François-René de Chateaubriand, Alfred de Musset, Mikhail Lermontov, Nikolaus Lenau, dhe Heinrich Heine.

[6] Pipa: *Trilogjia Albanika II, Jeronim De Rada*, f.25

[7] Pipa: f. 29, referncë nga Autobiologjia I

[8] Në një letër të shkruar Kamardës më 10 korrik 1855, e cila u botua te *Shejzat* (1964) De Rada shkruan: *Kisha marrë porosi për të mbledhur këngë popullore shqiptare për një përmbledhje(…) Ndjeva kënaqësi të madhe prej disa syresh dhe ua kam mësuar të rinjve fshatarë. Në fund u rreka edhe vetë të krijoj disa, simbas modelit të tyre. Përpjekja ime nuk doli pa sukses, me qenë se gratë në dritaret e shtëpive rrinin e dëgjonin çdo vjershë të re, që këndohej rrugëve në mbrëmje. Mora zemër nga kjo, dhe sajova rrëfimin tim lirik*

Rrëfimi lirik i dyfishtë, sipas Pipës, ka dy interpretime:

- Poema përthekon brenda vetes përvojat reale jetësore dhe përvojat imagjinare, dhe

- Kjo frazë duhet të ketë lidhje me një variant të ndryshëm me variantin e parë. Sidoqoftë, kjo ilustrohet edhe me shembullin e *Proto-Milosaos* dhe *Proto-Serafinës*.

Arshi Pipa provon të jetë shterues në kërkimet për gjenezën e poemës së rinisë, të cilën e gjen në fragmente edhe t*ë Odisesë,* si libri i parë i shkruar nga Da Rada, por që ishte i botuar pas *Miloasos*.

Nga kërkimi gjenetik, Pipa zgjerohet në kërkimin intertekstual, të cilën metodë hulumtimi e kishte përvetësuar edhe te studimi krahasues *Dante dhe Montale*. Prandaj, analiza tekstuale, fragment për fragment, bën që Pipa të konstatojë se De Rada i *bashkon reminishencat e ndryshme letrare, klasike dhe neoklasike*.[9]

Në këtë mënyrë, Pipa heton motivet danteske të shprehura me gjuhën e Foskolos, ngadalë fokusohet në një interpretim përqasës (krahasues), ku vë në pah idetë asketike, shpalon strukturën e strukturimin e tekstin, identifikon shenjat kompozicionale - dramatike (preludet), sidomos kur flet për *Ode albanese* të cilës i bën interpretim tematik, po ashtu edhe kjo me reminishenca nga letërsia e përbotshme në krye me Homerin, pastaj me Arioston etj.

Nga ky interpretim vijmë në përfundim se periudha fillestare e krijimtarisë së De Radës, ishte *bijë e klasikëve italianë dhe grekë*. Pastaj më vonë u desh një pasion për këngët popullore arbëreshe dhe një dashuri reale, që t'i kthehet amzës së vet poetike.

Pipa është i mendimit se amza e poezisë së De Radës është *Përmbledhja e poezisë shqiptare*, këngë dasmash korale të kënduara në ceremoniale, e që më vonë hapin rrugën e teksteve autoriale të de Radës. Megjithatë, mbledhja e teksteve dhe imitimi i tyre *ishte i njëjti proces***.**

Pra, kush merr nga tradita, edhe i jep traditës. Këtë e provoi de Rada. Këtë e argumentoi Arshi Pipa.

3. Një pikëpyetje e madhe dhe një përplasje e vogël

të dyfishtë, në të cilin hodha shumë ëmbëlsi e trishtim, port ë vërtetën mbi të gjitha, sepse në pjesën më të madhe pasqyrova të bëmat e mia, diçka që nuk e mbaj mend ta kem ndeshur ndonjëherë në gjithë ç'kam lexuar. (Cit. Pipa, Ibid, f.31

[9] Pipa: Idem, f. 29

Pipa, përveç strukturën, përmbajtjen, analizon edhe karakteret e veprave në gjenezë, duke evidentuar lëvizjen e tyre nga vepra në vepër. Kësisoj, Pipa identifikon dy karaktere personazhesh: konstantë dhe pasionantë.

Këto karaktere modifikohen, ndryshojnë gjatë *endjes së tyre*, megjithatë disa janë të qëndrueshme, sepse kapërcejnë sensualitetin, përballë karaktereve pasionante që janë karaktere të paqëndrueshme. Sidoqoftë, Pipa vjen në konkluzion se personazhet, edhe pse kalojnë nga një vepër në tjetrën- evoluojnë, madje sipas tij krijojnë *triadën mashkullore*, si: Bosdari, Radhovani dhe Milosao. Ky i fundit është konstant dhe pasionant, lëkundet para dikotomisë: moralitet-pasionalitet, konvencion dhe pasion.

Në këtë kontekst, autori analizon edhe titullin e librit duke e cilësuar emrin e personazhit si *emër të çuditshëm*.[10] Sipas qasjes diakronike, mbi burime të dokumentuara, emra familjesh të mëdha, në Shkodrën e shekullit 15, *emri Milosao, nuk figuron gjëkundi*, gjë që Pipën e hamendëson se nga e gjeti De Rada këtë emër, siç e cilësoi ai, *të çuditshëm*, që, sipas tij, *nuk është shqiptar, italian, as grek*? Këtë dilemë e shtron edhe për emra karakteresh të tjera, si: *Miloshini*, *Radovani* dhe *biri i Fuhës*, që burojnë nga këngët popullore arbëreshe.[11]

Ai konstaton se këta emra janë sllavë! Për këtë i referohet edhe studimit të Franc Miklosich-it, i cili etimologjinë e emrave Radovan dhe Miloshin e nxjerr nga emrat serbë, por që mund të jenë edhe polakë e çekë, meqë sipas tij, emra të tillë gjendeshin në Shkodrën e Mesjetës.

Argumenti ndërtohet mbi prapashtesimin -ov-an dhe rrënjën "radu" (i zellshëm). Sidomos, Miloshin është i sigurt se është emër serb, edhe pse po në të njëjtën frazë e pranon një emër dhe mbiemër shqiptar, Pjetër Shini, si një prej heronjve të këngëve popullore arbëreshe (*Rapsodie III 26*).

Këtë e arsyeton edhe me shpjegimin e Shuflait, i cili kishte pranuar *një simbiozë të qenies shqiptare me atë serbe* gjatë periudhës së Mesjetës, sidomos në Shqipërinë e Veriut.

Madje, këtu shkon edhe më larg, duke iu referuar edhe emrit Scutari (Skadar serb dhe Shkodër shqip), duke e lidhur më sundimin e princërve dhe të aristokratëve, para se të ngrihej Principata e Balshajve dhe mbas shpërbërjes së mbretërisë së Stefan Dushanit, me vdekjen e tij, më 1335.

Mirë, çfarë të themi për arkigjenezën e emrit të vjetër *Scodra*, të cilën më vonë, Mjeda e vë titull krahas tingëllimave të tij? Një pikëpyetje e madhe. Megjithëse kjo justifikohet edhe me argumentin tjetër të E. Hampit, sidomos

[10] Arshi Pipa: Idem, f.53
[11] Idem

me shpërnguljen e shqiptarëve pas vdekjes së Skënderbeut, në Italinë e Jugut.[12]

Hipotezat e Pipës, jo pak janë kundërshtuar. Njëri prej tyre që e vë në pikëpyetje, përderisa merret me topo-onomastikën e letrare deradiane, është Matteo Mandalà, i cili, edhe pse e vlerëson lart këtë monografi të Pipës, përderisa i merr në shqyrtim këto hipoteza, ai nuk pajtohet me to me arsyetimin se për këto çështje kemi të bëjmë me:

1. Kufizimet e anakronizmit metodologjik të Arshi Pipës, me anë të të cilit ai u rrek të gjente burimet e frymëzimit deradian në disa studime të botuara gjatë gjysmës së dytë të shek XIX.

2. Mandala, më poshtë menjëherë e konstaton të njëjtën gjë që e thotë Pipa për De Radën, kur flitet për autoreferencën e De Radës, që De Rada "*Imitoi në formë e përmbajtje këngët popullore arbëreshe*".[13]

3. Pipa, pra lëshohet në kontekstet historike nga Mesjeta e këndej, madje me referenca të sakta, gjithnjë historike, për përhapjen e disa sllavizmave në Ballkan, mbi prejardhjen e disa emrave të personazheve të De Radës, për të ngritur hipotezën e tij, pothuajse të panatyrshme, edhe pse kishte shumë argumente historike, por pranonte sensin letrar e kulturor se: "*De Rada nuk e ka shpikur emrin në rangun e alter egos së vet. Dhe, meqë ky emër nuk del në traditat dhe folklorin arbëresh, burimi mund të jetë i natyrës letrare*". Deri këtu i relativizon të gjitha argumentet e shtruara me saktësi, por më poshtë sikur i përmbys ato me konstatimin se "*Ka të ngjarë se poeti të ketë njohur ndonjë sllav në Napoli, i cili i ka shpjeguar kuptimin e emrit. Sidoqoftë, atë emër ashtu e ka zgjedhur*", përfundon Pipa.

4. Matteo Mandala hedh poshtë këtë hipotezë me argumentimin biografik se emri Miloshini i përket periudhës para se De Rada të shkonte në Napoli. Këto dy variante të emrave i sheh në marrëdhënie interesante ndërtekstore në mes të dy *poemave binjake*, të Proto-*Milosaoas dhe të Proto-Serafinës* në një moment delikat të përpunimit të tyre. Në këtë mënyrë, Mandala shtron hipotezën se De Rada zëvendësoi emrin Miloshini me Millosau, duke e *konsakruar* këtë të fundit në botimin e shtypur.[14]

5. Mandala, duke pasur përballë një strategji onomastike, Milo Shinin e nxjerr nga epika popullore arbëreshe, duke rendur pas ngjyresave semantike të artikuluara edhe te autorë të tjerë arbëreshë, edhe pse hedh poshtë pohimin e Arshi Pipës, pas të cilit emri Milo përdoret rëndom në ngulimet arbëreshe, e që

[12] Idem, f.55
[13] Matteo Mandalà: *Jeronim De Rada, Portret artisti në rini*, Naimi, Tiranë, 2018, f. 31.
[14] Matteo Mandalà: Idem, f.33.

Mandalà thotë se "*në fakt kurrë nuk ka ekzistuar si emër "real" dhe këtë e arsyeton me mendimin që kemi të bëjmë me "një dukuri klasike intertekstuale*".

Kjo ilustrohet me faktin se Skiroi e huazoi nga Milosau deradian "emrin folës" të personazhit të vet, që e gjejmë te *Milo e Hajdhiee*. Fundja, kjo ka një mbështetje letrare, e cila është e pranueshme edhe për ne.

Nisur nga interpretimi filologjik diakronik i Pipës, te interpretimi hermenueutik, e në rastin konkret që merr për bazë tiparet letrare dhe semantikën e tyre, po ashtu marrë parasysh analizën filologjike sinkronike të Altimarit, konstatohet se *De Rada u ndikua fort deri te zgjedhja e emrit të përveçëm, i cili nga Miloshin u shndërrua në Millosau.* Megjithatë, ne mendojmë se me mbështetjen në etimologjinë, konktekstualitetin historik, të dhënat onomastike dhe toponomastike të bazuara në referenca të autorëve të zgjedhur, nuk pajtohemi që metoda e Pipës ishte *anakronike*, por ka një logjikë interpretuese, e cila mbetet çështje e hapur deri te një argumentim më i fortë.

4. Romantizmi – dy faqe të të njëjtës medalje

Pipa bën një përmbledhje diakronike të lëvizjeve kulturore e kombëtare në periudha të ndryshme për ta shenjuar romantizmin kalabro-shqiptar. Evidenton autorët, profilizon dhe vlerëson përkushtimin e tyre, duke e tipizuar folklorin arbëresh për të cilin thotë se *është tipik aristokratik*, por me cilësime si *teokratik me një frymë kryqëzate e ksenofobie*. Kjo për faktin se amza e kësaj letërsia, pra, këngët popullore, fillimisht mblidheshin prej priftërinjve. Tutje, nga këtu trajton edhe dukuritë që i shkojnë për shtati tërë romantizmin kalabro-shqiptar prej nga rrjedhin edhe karakteristikat e gjithë kësaj epoke në letërsinë shqipe, si: kthimi në kohë e hapësirë, mbështetjen në këngët popullore etj.

Kështu, duke pasur në fokus veprën e De Radës dhe romantizmin kalabro- arbëresh, Pipa mirëfilli përcakton raportet në mes të kësaj epoke a shkolle dhe letërsisë orale, duke pohuar se romantizmi kalabro-shqiptar mori në mbrojtje folklorin, për dallim nga letërsia klasike, e cila e refuzoi atë. Tash, koncepti letërsi klasike për Pipën, përderisa flet për letërsinë arbëreshe, nuk është qartë i definuar. Megjithatë, Pipa, duke qenë një erudit i llojit të vet, bën krahasime edhe me letërsinë evropiane, nga rryma e parë romantike gjermane *Sturm und Drang* (*Stuhi dhe vrull*), duke i përshkruar me kujdes konceptet teorike të teorikëve të kësaj periudhe: Herder, Shlegel, Shiler, qoftë si ide, qoftë si teoretizime për të konkluduar se e përbashkëta e romantizmit shqiptar dhe evropian

është se *romantizmi dhe nacionalizmi ishin dy faqe të së njëjtës medalje*.[15]

Pikëvështrimi i tillë bëhet duke pasur për bazë variantet e *Milosaos*, po edhe *Rapsoditë*, njëkohësisht edhe ndikimin nga leximet që i kishte bërë Madame de Staël-in, Bajronit dhe Foskolos, pastaj në përkthime për t'i ngjarë romantizmit perëndimor: Werther dhe René, Çajlld Harold dhe Jocopo Ortis për të hetuar më pas elementet e autorëve grekë, por jo në veprën *Milosao*, të cilën e cilëson si vepër tërësisht romantike, me shenja klasiciste, sidomos kur këtë e kundron nga një koncept natyralist, parim ky edhe i klasicizmit evropian.

Sipas Pipës, *Milosao* është poemë kalabro-shqiptare e religjionit bizantin ortodoks, në të cilën jo pak përshkruhen ritualët e ditës së kremte.[16] Megjithatë e pranon se aty ka edhe himne pagane, sidomos kah fundi i saj, kur personazhi i jep lamtumirën Shkodrës,

5. Gjuhë dhe prozodi

Kapitull më vete është gjuha dhe prozodia, në të cilin Pipa trajton çështje të alfabetit, tiparet fonetike, metrikën arbëreshe, vargun tradicional e deri te leksiku, morfologjia dhe sintaksa.

A është prozodia ajo që i përmbledh të gjitha këto që u përfolën këtu?

Dihet, *prozodia* është koncept amerikan, e që brenda vetes përfshin variacione të lartësisë (denduria e dridhjeve), të intensitetit (amplituda e dridhjeve) dhe të gjatësisë (koha).[17]

Ndërsa, si term evropian është *prozodema*. Meqë jemi te termat gjuhësorë, prozodia përfshin elemente, si: theksi, ritmi, toni dhe intonacioni.18 Kështu, brenda funksionit të gjuhës dhe prozodisë, Pipa shqyrton çështje të gjuhës e të alfabetit të shekujve 16 e 17, me fokus variacionet e shqipes në fillim të shekullit 19 si konstantë e traditës gjuhësore dhe evoluimit të saj nga autori në autor, nga vepra në vepër. Të gjitha këto ai i quan si një lloj *sinkretizimi kulmor* të De Radës, të cilin e vlerëson në gjuhën dhe metrikën e tij.

Sipas Pipës, në variantin e shqiptarëve të Kalabrisë, ka shumë huazime nga greqishtja, madje me tipare arkaike, të cilat e bëjnë më të vështirë leximin e tekstit të De Radës. Tutje, ai konstaton se metrika te poemat e

[15] Arshi Pipa: Idem, f. 62.
[16] Arshi Pipa: Idem, f. 80.
[17] Bardh Rugova: *Leksikon i termave të fonetikës dhe fonologjisë*, ASHAK, Prishtinë, 2019.
[18] Rugova: Idem, f.150

De Radës është tipike e poezisë gojore të shqiptarëve të Italisë, njëkohësisht evidenton edhe elemente të italianizuara, por me alfabet të ndryshëm nga alfabeti latin që është përdorur në Shqipëri gjatë kësaj periudhe. Pipa, para se t'i analizojë veçantitë e alfabetit të De Radës, siç e thamë më lart, lëshohet në diakroni, duke parë gjuhën e De Radës si vijimësi të shekullit 16-17: nis me Buzukun, vazhdon me Budin, Bardhin e Bogdanin, për të ardhur në përfundim se, autori i tij, përdor alfabet latin, por me elemente greke.[19] Konkretisht, për të përfunduar se alfabeti i De Radës paraqet një aspekt të veçantë në varësi të disa konstanteve:

a) Mbizotërim i lëndës fonetike latine
b) Një element i greqishtes i përbërë prej një numri shkronjash greke
c) Dyfishim zanoresh dhe bashkëtingëlloresh.

Kësisoj, Pipa analizon zanoret e dyfishta, digramet dhe fonemat latine e greke, duke i krahasuar ato edhe me autorë të tjerë arbëreshë. De Rada provonte të arsyetonte tingujt e gjuhës greke me harmoninë e gjuhës epirotike (shqipe).[20]

Analizë të veçantë iu bën edhe shenjave diakritike të vendosura te zanoret e mesme e të gjata (të mesme: déra, mŏra, ndërsa të gjata-zanoret e dyfishta: *gliee, aat*, dhe bashkëtingëlloret dyshe, si: *botta, voessa*, duke i qëmtuar me kujdes ndryshimet fonetike që pësojnë nga variantet e *Milosaos*, te variantet e *Serafinës*, njëkohshëm duke interpretuar ato në kontekst të ri të fjalës dhe risemantizim të vargut.

Prej këndej, ai e ka të shtruar më mirë rrugën për t'u marrë me prozodinë e De Radës, konkretisht me metrikën e vargut të tij, të cilën në thelb e sheh njëlloj si metriken arbëreshe në konselacion me metrikën shqiptare në përgjithësi, të cilën deri në momentin që po merrej vetë me të, e cilësonte si një fushë të virgjër, arsye kjo që metrika e De Radës i ka zënë ngushtë ata që janë munduar ta shpjegojnë atë.

Megjithatë, ai i referohet studimit të Markianoit, sipas të cilit e la në përgjysmë dhe u nda i zhgënjyer me arsyetimin se vargu i De Radës, tetërrokësh në pjesën me të madhe, por i përzier me shtatë, gjashtë, e madje me pesërrokësh, ndjek modelin (...) e vargut të Rapsodie. Është e kotë të kërkohet ndonjë rregull në këtë lloj vargu me gjithë ato lloje variante që ka, e që është i ndryshëm nga vargu barasvlerës italian, me përkime fort të rralla me të.[21]

---

[19] Arshi Pipa, Idem, f.92
[20] Arshi Pipa, Idem, f.93
[21] Idem, citat i shkëputur nga *Albania e l'opera di F. de Rada* (Trani, 1902), f. 186.

Kritiku ynë, është i bindur se ky vlerësim i cili shpie te përkufizimi i vargut të De Radës, si varg heterometrik, lë pa përgjigje pikërisht pyetjen që ai shtron, d.m.th. se si mundet që isometria dhe heterometria të bashkekzistojnë![22]

Ai merr në shqyrtim mendimet e studiuesve arbëreshë, madje duke i vlerësuar qoftë si identifikime të sakta për të hapur rrugë studimeve mbi metrikën arbëreshe, qoftë si gabime të zakonshme kur vargu arbëresh analizohet sipas standardeve që nuk janë të shqipes, të italishtes, ose të greqishtes së sotme. Së këndejmi, Pipa analizon numrin e rrokjeve, të theksave, llojin e metrit (nga shtatë deri në njëmbëdhjetërrokësh).

Kështu, struktura metrike e De Radës, del të jetë variant i përkryer i metrikës popullore arbëreshe. Ajo është e provuar dhe e pasqyruar edhe në tabela statistikore, me matje të sakta të rrokjeve dhe llojeve të theksit, të ritmit, nga vepra në vepër.

Pas prozodisë, Pipa analizon veprën e De Radës dhe në planin leksikor, morfologjik e sintaksor. Ai evidenton saktë leksikun e përdorur të De Radës, siç ndodh te Milosao, sa fjalë përdor? Cilat janë të huazuara prej greqishtes së sotme dhe italishtes kalabreze? Po ashtu edhe huazimet nga latinishtja, greqishtja e lashte dhe sllavishtja. Në këtë hulli evidenton neologjizmat, fjalët që janë të përbashkëta me toskërishten dhe arbërishten, po edhe fjalë që vetëm në variantin e gegërishtes përdoren (hjeshëm-i hijshëm, mixore-mizore etj.).

Tutje, analizon numrin e fjalëve të thjeshta dhe të përbëra, formimin e fjalëve të prejardhura për të konstatuar se veprat e mëvonshme të De Radës kanë leksik më të pasur.

Ndërsa, në pikëpamjen morfologjike analizon vetëm Milosaon, meqë morfologjia e veprave të tjera ka pak ndryshime nga ajo. Pipa analizon kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit dhe të përemrit dhe specifikat e tyre nëpër rasa, po ashtu foljet dhe zgjedhimin e tyre.

Trajtat sintaksore, fjalitë e varura, pas Pipës, te De Rada dalin me origjinë prej teksteve orale. Në to dominojnë fjalitë e varura (të shumtën kohore) asindetike. Ndërsa fjalitë bashkërenditëse në të shumtën zëvendësojnë fjalitë e varura.

Përfundimisht, siç e thotë edhe më vonë, nga analiza që i bëri metrikës dhe sintaksës së De Radës, rezulton se shumë këngë kanë një mënyrë të shprehuri e të stolisuri e të stërholluar, përfshirë edhe mjete të tilla si vazhdimi i fjalisë nga njëri varg te tjetri dhe shkëputja sintaksore, të cilat nuk hasen në metrikën e poezisë popullore.

[22] Idem, f. 107.

6. Ideologjia dhe stili

Në pjesën e tretë *Ideologjia dhe stili* Pipa merr në shqyrtim veprat mbas botimit të parë të *Milosaos*. Pas kësaj periudhe është ideologjia ajo që ndikon drejtpërdrejt edhe në stilin e tij, ku *radikali bëhet i moderuar, më pas konservator dhe, në fund, reaksionar, ndërkohë që besimtari i vakët*, siç thuhet, shndërrohet në vëzhgues, pastaj në fanatik dhe përfundon në asket.

Të gjitha këto lëkundje të karakterit të autorit, Pipa i justifikoi me zhvillimet historike, personale e familjare, pra që lidhen me jetëshkrimin e tij. Në çdo etapë jetësore, sipas Pipës, De Radës i shpërfaqen edhe modele të ndryshme stilshmërie. Tashmë metoda e kërkimit të Pipës është tjetër, merret me rrethanat jetësore, me autobiolegemat të cilat shndërrohen në ideologema, të vërtetuara nga vetë autori në *Autobiologjinë* e tij. Të shtatë etapat apo të shtatë moshat e njeriut (De Radës), ashtu siç i kishte ndarë edhe Shekspiri, Arshi Pipa i lexon dhe i interpreton sipas një rendi kronologjik, si: Fëmijëria, një tragjedi, një krizë religjioze dhe botimi i variantit të parë të *Milosaoas*, deri te pleqëria e thellë, kur De Rada rreket t'i ripunojë veprat e tij, madje të merren edhe punime filologjike (broshura).

Këtu *Autobiologjia* bëhet referencë kryesore e ideologjisë së autorit, por dhe bazë për vlerësime për stilin e gjenezën e veprave. Madje, duke e parë letërsinë si autobiografike, poezinë të lidhur dhe me ideologjinë politike të autorit.

Pipa është i mendimit se nga e gjithë përmbajtja e *Autobiologjisë,* titulli që do t'i shkonte më së shumti për shtati këtij autokonfesioni do të ishte *Letërsia dhe revolucioni*. Në këtë mënyrë, autobiologjia bëhet autoideografi e deri te një apologji e vetvetes përballë paradokseve të kohës; kujtojmë këtu kryengritja e dështuar të qershorit të vitit 1837 etj.

Në këtë kontekst, De Rada largohet nga besimi, idetë religjioze, hapet në nënteskt, herë në mënyrë implicite, herë mbi besëtytni, herë fatazamgori makabre, siç ndodh te ajo që Pipa e quan metamorfozë e Serafinës, e cila ndeshet rreptë me censurën kishtare. Bazuar në këto shenja tekstuale e kontekstuale, *Serafina* cilësohet si një poemë gotike-lirizmi e tmerresh të mbinatyrshme, por herë-herë edhe me një strukturim epik-dramatik më shenja lirike.

Në përgjithësi, duke analizuar narracionin e poemave të De Radës, Pipa vë në pah ideologjinë politike dhe nga zhgënjimi prej saj, ideologjinë nacionale, qoftë përmes veprimeve të personazheve, qoftë përmes pretendimeve autoriale. Kështu, duke pasur parasysh raportet e letërsisë romantike arbëreshe, të de Radës, Pipa shkon edhe më tutje në tipizimin e *Serafinës A* si një mozaik romantik

kalabrez me demonizëm bajronian dhe folklor shqiptar me petk gotik.

Në tekstet shpjeguese me bazë shkrimin autoreferencial të De Radës, shihet ndikimi i tij nga Shekspiri, sidomos në stil, për ç'gjë shkruante edhe vetë De Rada: *Forca e Shekspirit në punë të stilit kurrë nuk më ka dalë nga mendja* (*Autobiologjia*). Gjithashtu, Pipa përbrenda strukturës së poemës së De Radës identifikon edhe elemente të teatrit klasik grek, strofën dhe antistrofën, si në këngët korale klasike. Madje, kritiku ynë ngrit hipotezën që "ndërkëmbimi" i këngëve korale mund të jetë frymëzim nga *Antigona* e Sofokliut.

Megjithatë, *Serafina B*, sipas tij është një formë ë e trajtimit politik. Rivaliteti në dashuri përzihet me konflikt klasor ashtu siç ndodh te *Milosao*. Po ashtu, religjioziteti nuk mund te shmanget lehtë, kur De Rada shkruan në frymën ortodokse, madje edhe kur flet për Shqipërinë, ka për bazë formulimin: *Shqipëria dhe Shën Mëria*.

Kështu, autori ynë analizon De Radën sipas një skeme: fryma nacionale, erotike dhe religjioze.

E para është intencë e kthimit në epokën e artë, përmes së cilës integron erotizmin me shenja autoktone, ndërsa e fundit si një letërsi qëllimore që të dominojë një tip i aristokracisë, si më i lashtë, si më i plotë, ide të cilën ua kishte rrënjosur kleri grigjës së vet, gjithnjë në raport me lashtësinë e kombit shqiptar. Edhe pse kishte një izolim socioekonmik, De Rada, nga këtu nuk del *autor i mjerë*, ashtu siç jemi mësuar ta portretizojmë një kohë të gjatë, por një kavalier në dashuri, një aristokrat në jetë, racional në besim. Kur ideologjia politike i fanitet e idealet i zvetënohet, shpërthen ideja për artin dhe estetikën.

Literatura

Arshi Pipa: *Jeronim De Rada*, Trilogjia Albanica II, Princi, Tiranë, 2013

Bardh Rugova: *Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë*, ASHAK, Prishtinë, 2019-10-19

Matteo Mandalâ: *Jeronim De Rada, Portret artisti në rini*, Naimi, Tiranë, 2018.

Uran Kalakulla*: Arshi Pipa- Njeriu dhe vepra*, Plejad, Tiranë, 2010

Almuth Gresillon: *Kritika gjenetike, origjina, metodat, teoritë, hapësira, kufijtë*, Institut des Textes et Manuscrits Modernes, VEREDAS 8 (Porto Alegre, 2007) 31-45, botuar në revistën letrare *Jeta e re*, nr.1, Prishtinë, 2018.

Abdulla REXHEPI, Prishtinë

VEPRA E NAIM FRASHËRIT NË PERSPEKTIVËN ITALIANE

Abstrakt. Në këtë shkrim synohet të prezantohen dhe analizohen interpretimet në italisht të disa studiuesve shqiptarë dhe analizat e depërtimet e një studiuese italiane në poezinë e Naim Frashërit. Shkrimi ka për objekt analize punimin e doktoratës të Musine Kokalarit, shkrimet e Ernest Koliqit të botuara në italisht, dhe disa shkrime të Jolanda Kodrës (Iolanda Guazzoni), një italiane që shkruante shqip dhe botonte në revistat shqiptare. Do të bëhet përpjekje të vihen në pah dimensionet e veprës së Naimit që iu kanë paraqitur audiencës italiane nga Kokalari dhe Koliqi, si dhe arketipat, konceptet e topikat e poezisë naimiane që ia tërhoqën vëmendjen Kodrës, të cilat mtoi t'i interpretonte në shkrimet e saj në shqip.
Fjalë kyçe: N. Frashëri, studime italiane, M. Kokalari, E. Koliqi, J. Kodra.

Hyrje

Vepra e Naimit që kishte rezultuar nga një gërshetim epistemash orientale e oksidentale, nga fillimet e shekullit XX qe bërë objekt i studimeve dhe interpretimeve të studiuesve e letrarëve të ndryshëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë. "*Teksti është tapiceri e citateve që rezulton nga mijëra burime të kulturës*",[1] shkruan Roland Barti, andaj njohja e këtyre burimeve kulturore përbërëse të tekstit, mund të konstruktojë një lexim e kuptim të ndryshëm nga leximet e tjera të pafamiljarizuara me këto kultura. Gjithashtu, në anën tjetër, hermeneutistët si Hans G. Gadamer, vënë theksin te kuptimi si kontratë midis dy subjekteve, pra subjektit të tekstit dhe subjektit të lexuesit. Për Gadamerin, përveç subjektivitetit të tekstit, ekziston dhe subjektiviteti i lexuesit, dhe si rezultat i një dialogu dhe marrëveshjeje midis tyre mund të kemi kuptimin e shënuar të tekstit. Prandaj, Gadamer-i duke e vënë theksin në epitetin kontraktues të kuptimit, në të vërtetë, potencon faktin se kuptimi është i prodhueshëm, në njërën anë, dhe i praktikueshëm, në anën tjetër.

> "*Procesi i kuptimit të tjetrit, nuk është riprodhim i prodhimit tënd, por prodhimi i së vërtetës bazuar në dialogun midis "meje" dhe "teje". Kuptimi varet nga pozicionimi dhe integrimi i individit, dhe lind si rezultat i përgjigjes që i jepet pyetjes së tij*".[2]

Kështu, kulturat me ontologji e epsitemologji të caktuar strukturojnë dhe subjektet e veçanta të tyre, si rezultat i të cilëve, për një fenomen a tekst shënojnë

---

[1] Roland Barthes (1975). *The Pleasure of the Text*, p. 13.
[2] Jean Grondin (2002). *Gadamer's Basic Understanding of Understanding*, p. 67.

leximet e kuptimet e posaçme të tyre. Nisur nga ky pretendim, studimi dhe familjarizimi me kulturën e tjetrit nga një lexues, në subjektivitetin e tij zënë vend dhe epistemat e asaj kulture, dhe kështu, ndërtohen kuptime të ndryshme, nga ato që mund t'i ketë pasur ai para se të njihej me atë kulturë.

Ambienti intelektual e akademik italian, përveç vlerave dhe karakteristikave autoktone, shumë herët njihet edhe me studimet e tij në fushën e orientalistikës, si dhe me përkthimet nga letërsitë orientale. Për atë dhe studimi dhe formimi intelektual nëpër këto ambiente, siç është rasti i Musine Kokalarit, Ernest Koliqit dhe Jolanda Kodrës, do të duhej të linte gjurmë edhe në leximet e interpretimet e tyre, në këtë rast të veprës së Naim Frashërit. Prandaj, duhet parë mënyrën se si vepra e Naimit është lexuar e kuptuar nga një studiuese italiane si Jolanda Kodra (1910-1963), si dhe, nga dy studiuesë shqiptarë, Musine Kokalari (1917-1983) dhe Ernest Koliqi (1903-1975), të cilët, qenë shkolluar e formuar në ambiente kulturore italiane.

Studimet Orientale në Itali shënjojnë ndërkomunkime të lashta kulturore midis Italisë e botës islame. Veçanërisht përmendet Universiteti i Padovës, në të cilin, në shekujt e humanizmit italian, ishte formuar një rrymë filozofike e quajtur "*Shkolla Aeverroiste*", e frymëzyar nga idetë dhe mendimet filozofike të filozofit mysliman Averrosit (Ibn Rushd), lëvizje që pastaj qe shpërndarë nëpër tërë kontinentin evropian. Në këtë vend gjithashtu vërehen studime shumë serioze në lidhje me kulturën perse në përgjithësi, dhe për letërsinë perse në veçanti. Ndër këta studime mund të përmenden "*Storia della poesia persiana*" e autorit Italo Pizzi, "*Inizi di lirica aschetica e mistica persiana*", e autorit Giuseppe Messina dhe Biblica et Orientalia e Cristianesimo, dhe shumë të tjerë. Vepra e studime të tilla sigurisht që kishin krijuar mundësi për të kuptuar më mirë kulturën dhe letërsinë persiane. Sigurisht se ata që do të merreshin me veprën dhe poezinë e Naim Frashërit në Itali, do t'u referoheshin veprave të sipërpërmendura, sigurisht pa përjashtuar dhe veprat e tjera.

Studime të thella mbi kulturën perse, sidomos filozofinë dhe mistikën perse, kishin munguar në mjediset intelektuale shqiptare, prandaj, fryma mistike e filozofike e poezive të Naimit nuk është lexuar e kuptuar sa duhej.

Musine Kokalari

Një studiuese shqiptare që objekt të studimit të saj pati jetën e veprën e Naimit ishte Musine Kokalari. Gjatë viteve që kishte studiuar në Romë, ajo kishte kryer studimet në fushën e letërsisë dhe në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Romës kishte mbrojtur temën me titull: *Naim Frashëri (1846-*

1900), e përkthyer më vonë në shqip nga Elinda Kokalari. Punimi i Kokalarit përbëhet nga tri pjesë. Në pjesën e parë ka shkruar për jetën e Naimit, saktësisht për kushtet historike, mjedisin ku ka jetuar dhe shkurtimisht një biografi të poetit. Në pjesën e dytë, me titullin "*Mendimi*", Musineja jep të dhëna elementare për historinë dhe doktrinën e bektashinjve dhe për botën shpirtërore të Naimit. Ndërsa në pjesën e tretë flet për veprat e Naimit, të cilat mton t'i klasifikojë në vepra fetare, shkollore, vepra me karakter politik, vepra me karakter sentimental dhe vepra me karakter të përzier. Edhe pse në fillim, Kokalari e ka kapur mirë idenë bosht të veprës së Naimit, pra Zotin, por gjatë njësisë "*Bota shpirtërore e Naim Frashërit*", mjaftohet që botën ezoterike të Naimit ta paraqesë me disa fjalë tepër të shkurtra, dhe menjëherë e ndjen nevojën të vërë në pah idetë e tij kombëtare e kombëtariste. Musineja, gjithashtu, pohon se

> "*aspekti që të imponohet i pari e që padyshim përbën thelbin e botës shpirtërore të poetit, është ai fetar. Prej andej, zënë fill të gjitha aspektet e tjera ideologjike të Naimit: ai politik, ai sentimental, ai shkollor, etj. Është, pikërisht, aspekti fetar, ai që ia përshkon doktrinarnisht të gjithë veprën, duke i dhënë një gjurmë të pangatërrueshme në krahasim me çdo letrar tjetër bashkëkohor apo modern*".[3]

Punimi i Musinesë nuk shquhet për ndonjë analizë të thellë letrare, por ka karakter më shumë paraqitës dhe përshkrues.

Ernest Koliqi

Një studiues tjetër shqiptar që kishte jetuar e vepruar në Itali ishte Ernest Koliqi, i cili në një ligjëratë në Institutin për Orientin, në vitin 1953, audiencës italiane i kishte folur për "*Ndikimet orientale në letërsinë shqipe*", ligjëratë të cilën e kishte botuar në vëllimin *Saggi di litteratura albanese*, Romë, 1972, që më pas u përkhye nga Dhurata Shehri dhe u botua nga Botimet IDK, Tiranë. Koliqi një pjesë të konsiderueshme të kësaj ligjërate ia kushton Naim Frashërit, duke vënë në pah elementet orientale të veprës së Naimit. Koliqi, edhe pse në fillim deklarohet me shumë modesti si jokompetent për studimet orientale për të folur për një temë të tillë, të dhënat, kundrimet dhe konstatimet e tij dëshmojnë se ai, ashtu si në fushat e tjera, edhe në këtë temë ka sjellë prurje dhe qëndrime të reja dhe të pathëna nga para- dhe pasardhësit e tij. Koliqi vëren se ndikimi i kulturës dhe letërsisë orientale te shqiptarët nuk depërtoi nëpërmjet turqve dhe Turqisë, por ishte Naim Frashëri ai që solli te shqiptarët këtë kulturë:

> "*Sipas meje, një gjurmë shpirtërore që në disa autorë ka marrë formën e një prerjeje të re letrare për të thyer mburojën e sensit të tepruar të realitetit, peng i të cilit mbetet*

[3] Musine Kokalari (2009). *Vepra* (Vëllimi i parë), f. 280.

shpirti i shqiptarit, si dhe përpjekja për t'u ngritur në nivelin e soditjes së të bukurës, vazhdon të jetë e fuqishme. Por ky nuk është një trashëgim i drejtpërdrejt nga Turqia. Ky ndikim i kulturës orientale ka hyrë në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet shpirtit të madh të Naim Frashërit, që është vënë në grykëderdhje të katër shekuj e gjysmë sundimi osman, gati për t'i sintetizuar e shndërruar në një valë dobie të paparashikueshme. Nëpërmjet vargjeve të Naimit, orienti i mistikëve u shfaqet brezave të rinj me kupat e tij të çmuara mbushur plot e përplot poezi gjithë frymëzim që nëse nuk mund ta shuajë të paktën mund ta zbusë etjen që djeg shpirtin".[4]

Pasi përmend karakterin kombëtar e rilindës të veprës së Naimit, Koliqi audiencës italiane synon t'ia paraqesë thelbin e poezisë së poetit shqiptar. Prandaj, derisa flet për formimin intelektual, mistik e letrar të Naimit, Koliqi vëren se ai kishte lexuar e studiuar thellësisht filozofët persianë. Vetë veprat e Naimit provojnë se ai i ka lexuar e njohur mirë poetët, mistikët e filozofët persianë, duke filluar nga kryeepi iranian *Shahnameja* e Fridevsit deri te poeti Saib Tabrizi, poet i papëlqyer dhe shumë pak i njohur në Iran, e për të cilin Naimi kishte një respekt të veçantë. Koliqi gjithashtu pohon faktin se Naimi konceptin e tij panteistik për Zotin e kishte huazuar nga mistikët persianë, edhe pse nuk përmend asnjë nga ta. Koliqi pohon se

"*tek Naimi, panteizmi nuk është as estetik e as poetik, por mistik, pra fërgëllon prej besimit dhe paraqet një lidhje të vërtetë me universin, me Zotin, pjesë e të cilit ai ndjehej*".[5]

Por duhet vënë në pah se në teologjinë apo filozofinë së cilës i përkiste Naimi, pra bektashiane, mistika, estetika, mistika e poezia nuk qenë të ndara prej njëra tjetrës. Të gjitha këto qenë pjesë apo manifestim i Qenies së Lartë. Për filozofin mysliman, e bukura është fron ku shpërfaqet drita hyjnore dhe manifestohet e vërteta e Qenies, pra kur shfaqet e vërteta domethënë është shfaqur e bukura. Sipas këtij mendimi, të gjithë qenësorët janë të bukur dhe kështu bukuria ka status qenësor dhe realizim objektiv e s'ka të bëjë me shqisat perceptuese të subjektit. Por sipas tij, individi duhet të ketë arritur një nivelë të lartë intelektual dhe spiritual. Meqë estetika në këtë botëkuptim është ontologjike, atëherë zbulesa apo epifania ka kuptim përmbajtësor.

Ernest Koliqi vë në dukje edhe ndërmarrjen për t'i gërshetuar idetë mistike me ato kombëtare te Naimi dhe shkruan:

"*Që sot e tutje dy janë motivet që ndërthuren duke u përzierë me njëri-tjetrin: ai i bashkimit me Zotin në një martesë mistike dhe ai i rilindjes së atdheut në shenjën e vëllazërimit të të gjithë shqiptarëve*".[6]

---

[4] Ernest Koliqi, *Ese të letërsisë shqipe*, f. 177.
[5] Ibid, f. 180.
[6] Ibid, 183.

Dhe këtu, Koliqi prek një nuancë tepër elegante, kur e krahason ndarjen e kallamit nga kallamishtja, poezi e Rumiut dhe më pas e Naimit, me ndarjen e poetit nga kallamishtja Frashër, i cili njësoj si Fyelli gjëmon për ndarjen e tij dhe ndjen mall për rrënjët e origjinën e tij.

Koliqi gjithashtu ka hasur një koncept mjaft interesant, atë të ringjalljes apo të pavdeksisë së shpirtit, të esencës apo kuptimit.

> "*Sipas poetit (Naimit, a.r.), asgjë nuk shkatërrohet e zhduket në këtë botë, gjithçka rilind. Gjithçka ndryshon e asgjë nuk vdes*".[7]

Kurse koncepti i ndryshimit ose përsëritjes si një botëkuptim kyç i filozofisë mistike shënon diçka më shumë se përsëritje. Për shembull, sipas Ibn Arabiut, nuk kemi përsëritje, sepse, bota, botëkuptimi ose domethënia është imanencë hyjnore e shpërfaqur në çdo çast.[8] Sipas mistikëve myslimanë, krijimi nuk është një punë e kryer në të shkuarën, por krijimi është një lëvizje e përsëritshme dhe e pafund, prandaj, qenia/ ekzistenca në çdo çast shpërfaqet në një formë/ shenjë të re. Naimi, njësoj si filozofët e mistikët lindorë, është i mendimit se Krijuesi/ Zoti është një esencë e përhershme dhe e pakohshme, e cila në çdo moment shpërfaqet në forma, kuptime dhe shenja të panumërta. Ndërsa i krijuari, kuptimi dhe shenja janë forma, kuiditete të ndryshueshme, të tjetërsueshme dhe si të tilla gjithnjë të zëvendsueshme. Në këtë det të Qenies, qenësorët, pra krijesat, format, kuptimet në çdo moment tjetërsohen në forma të reja dhe, siç thotë Ibn Arabiu, krijohen ose lindin rishtazi.[9]

Bazuar në këto depërtime mistike, edhe Naimi thekson se krijesat, ndër to edhe njerëzit, ndryshjnë dhe rilindin, po asnjëherë në mënyrë të njëjtë.

qeshë diell, ishnja hënë,
u bëshë uj' e val' e rë,
yll e zok e dash kam qënë
pa edhe njeri shumë herë.[10]

Pra, Naimi pohon se në ndonjë epokë tjetër, ai ka qenë diell e hënë, ujë, valë dhe re, yll, zog e dash, por disa herë ka qenë dhe njeri. Në këto vargje ai thotë se si shpirt që është, nëpër kohë është transformuar e shpërfaqur në ndërtime të ndryshme. E njëjta qasje vërehet edhe në vargjet e më poshtme:

pa jam bërë shumë herë
zjar e uj' e balt' e erë.

---

[7] Ibid, 185.
[8] Ibn Arabi (2006), *Fususu'l Hikem*, f. 118
[9] Ebu'l-Ala Afifi (2000), *Fususu'l Hikem Okumalari Için Anahtar*, f. 50.
[10] Naim Frashëri, *Vepra* 1, f. 194.

jam një shkëndijë pej qielli
dhe një drudhëzë pej dielli.
bënem qëngj e kec i pirë,
lul' e bar e gjeth i mbirë.[11]

Njësoj vepron edhe Jacques Derrida kur pohon se teksti nuk mund të lexohet dy herë, sepse, gjithmonë leximi i dytë i tij në fakt është lexim i ri. Por në qoftë se Naimi dhe mistikët e tjerë këtë rilindje apo ndryshim e përdorin për të gjithë universin, Derrida fokusohet vetëm në tekstin e domethënien e tij.

Sipas Koliqit, nëpërmjet krijimtarisë së Naimit, Orienti ka lënë gjurmë të thella në kulturën e mendësinë shqiptare. Ai shkruan:

> "*Poezia e Naimit fashiti atë lloj konceptimi tepër realist të jetës, ëmbëlsoi nevojën për konkretësi dhe dobësoi deri diku lidhjen me ca vlera praktike e konkrete që përbëjnë bazën e shpirtit shqiptar. Naimi u mësoi shqiptarëve ëmbëlsinë e arratisë ëndërrimtare në krahët e forcave misterioze mirëbërëse, ngushëllimin e shpresës nën një Qenie të pafundme që është e pranishme në ujin që rrjedh, në fluturimin e dallëndyshes, në të artën e diellit, në syrin e bareshës. Ai u mësoi besimin tek vëllami i të njëjtit gjak, te fërgëllimi i të fshehtave shëndritëse që rrahin në ngrohtësinë e shtrëngimit të një dore që shqiptari jep shqiptarit, te kështilla e vëllazërimit universal të cilën Zoti e ka shkruar me shkronja të arta në fund të ndërgjegjës së çdo njeriu. Ndonëse nuk duket kështu, rinia e sotme është e etur për Absoluten*".[12]

Jolanda Kodra

Jolanda Kodra ishte një italiane e lindur me emrin Iolanda Guazzoni në vitin 1910, në Romë, dhe është mbesa e Enrico Guazzoni, skenarist dhe regjisor filmi italian. Ajo ishte martuar me Malo Kodrën, me origjinë nga Gjirokastra, i cili kishte qenë student në Romë. Nga shqipja në italisht Jolanda Kodra përktheu veprat e shkrimtarëve shqiptarë, si Ndre Mjeda, Migjeni, Petro Marko dhe Sterjo Spasse. Ajo gjithashtu ishte bashkëpunëtore e ngushtë e revistës "*Njeriu*" - Revistë e përmuejshme Shpirtnore Kulturore, e cila u botua në periudhën Korrik 1942 - Shtator 1944 në Tiranë. Midis shumë shkrimeve, Kodra në numrat 3, 4, 7 dhe 8 të kësaj reviste ka botuar një shkrim me titull "*Mejtime filozofike-fetare të Naim Frashërit*".

Ajo që bi në sy gjithandej këtij shkrimi të Jolanda Kodrës është krahasimi që i bën Naimit me poetë të njohur italianë, si Horaci e Virgjili. Kodra gjithashtu prek edhe një koncept interesant mbi ndërveprimin mistik midis poetit dhe lexuesit dhe shkruan:

---

[11] Naim Frashëri, *Vepra* 2, f. 10-11.
[12] Ernest Koliqi (2008), Ibid, f. 187.

"*Por duke u shpërndarë ajo lë pas vehtes një gjurmë mirësije vepëruëse, frymën e freskët të një atmosfere më të kulluar, kështu që lidhja pothuaj se mystike që lind në mes të shpirtit të Poetit dhe të shpirtit t'atij që lexon, nuk prishet pa pritur, por qëndron, gati si një erë e këndëshme, në kujtimin e përmallimeve që Ay ka zgjuar*".[13]

Por Kodra, për dallim prej secilit studiues tjetër të mendimit dhe poezisë së Naimit, ka arritur të kundrojë njërin nga konceptet themelore, për të mos thënë konceptin thelbësor të filozofisë së Naimit, pra konceptin *Mirësi*.

"*Poeti i sigurtë për këtë brëndësi hyjnore, ecën pa u shmangur kurkund në rrugën që të shpie drejt Faktorit kryesor të të gjitha sendeve: në rrugën e Mirësisë*".[14]

Pra, Kodra e ka hetuar me shumë mbrehtësi njërin nga qëllimet thelbësore të mistikëve, por edhe të Naimit, që është Mirësia, e cila bart një kuptim më të gjerë e më të thellë nga ç′e kuptojmë ne (një fjali me kuptimet e mirësisë nga fjalori i gjuhës shqipe). Sipas Kodrës,

"*Mirësi, do me thënë virtyt që përmbleth gjithëçka duhet të jetë dëshirë e shpirtit njerëzor; drejtësi (por me kuptim edhe të ndjenjës së mëshirës), e vërtetë, bukuri, e sidomos dashuri*".[15]

"*Mirësija është e vetmja mbrojtje që e ruan njerinë nga plagët shpirtërore e me të cilën do të ketë mundësi t'ia harrijë fitores më të vështirë: atë mbi vetë-vehte. Fitore që do t'i çelij dyert për të gëzuar ëndjet e pa-mbaruara të jetës së amshuar*".[16]

Në mendimin paramodern, veçanërisht në botën myslimane, e bukura diskutohej brenda kornizave të Qenies, e cila ishte e bukur dhe trajtimi i të bukurës do të thotë trajtim i Qenies dhe qenësorit. Mosekzistenca e koncepteve si art apo estetikë në kuptimin modern të tyre, nuk do të thotë se në dijet klasike te myslimanët nuk pati përsiatje dhe diskutime mbi të bukurën. Por nëse duam të fokusohemi në mendimet e filozofëve dhe mistikëve myslimanë mbi të bukurën, atëherë duhet të lexojmë dhe analizojmë fjalët kyçe të këtij diskursi, siç janë: *husn* (e cila ka kuptimin bukuri, hijeshi, mirësi dhe virtyt), *texhel'li* (epifani, zbulesë, shpërhapje, dritë hyjnore) dhe *ashk* (dashuri). Ligjërimet e filozofëve myslimanë rreth të bukurës sillen rreth këtyre tri fjalëve.

Nisur nga konstatimi i Gadamerit, vërejmë se subjekti tekstual i Naimit në dialog me subjekte të formuara në ambiente intelektuale italiane si Kokalari, Koliqi dhe Kodra, ka prodhuar kuptime dhe depërtime të thella filozofike dhe spirituale. Këto domethënie të shënuara nga autorët e sipërpërmendur nuk mund të vërehen nëpër studimet e kundrimet e poezisë së Naimit nga studiuesit

[13] Jolanda Kodra (1943). *Mejtime filozofike-fetare të Naim Frashërit*, nr. 4. f. 3.
[14] Ibid, f. 5.
[15] Ibid, nr. 7. f. 6.
[16] Ibid. nr. 8. f. 3.

shqiptarë të kohës në Shqipëri e Kosovë. Autorët vënë theksin tek idetë fetare, apo frymëzimet e Naimit me koncepte mistike e teologjike bektashiane, si përpjekje e tij për zbuluar dimensione të reja të imagjinatës kreative. Ata, veçanërisht Koliqi e Kodra, kanë arritur të definojnë konceptet e arketipat kryesore të poezisë dhe filozofisë së Naimit, siç janë Rilindja apo Ringjallja, si dhe Mirësia. Kështu, leximet dhe hermeneutika e tyre mund të hapin shtigje dhe dimensione të reja në studimet e veprës së Naimit, të cilat u heshtën në studimet naimiane gjatë sundimit komunist. Gjithashtu mund të thuhet se studiuesit shqiptarë para komunizmit Naimin e vështronin më objektivisht dhe vinin në pah të gjitha dimensionet e tij intelektuale, qoftë ato lindore, apo perëndimore. Por më pas Naimi u lexua, u interpretua dhe u konstruktua sipas ideologjieve dominuese të kohës, siç ishin etnocentrizmi dhe marksizmi-leninizmi. Etnocentrizmi si ideologji kombëtare në studimet letrare, krijimtarinë artistike të autorëve shqiptarë e paraqet esencialisht dhe ekskluzivisht shqiptare, të pandikuar dhe të shkëputur nga ndërveprimet me kulturat e tjera. Kurse në studimet e orientuara marksiste-leniniste, të identifikuara si studime të realizmit socialist, në luftën e klasave "*autori*" duhej të rreshtohej në anën e klasës së sunduar, pra të pozicionohej në anën e kundërt me klasën sunduese. Si i tillë, "*autori*", në këtë rast Naimi, dekontekstualizohej e zhvishej nga dimensioni artistik e pikëpamjet e tij estetike e shpirtërore, dhe kështu reduktohej në "*intelektual organik*" (Gramsci) të popullit. Veprimtaria komplekse e tij kufizohej vetëm në një dimension, si poet i popullit, ndërkaq dimensionet e tjera kundroheshin si "*të huaja*", "*besime të kota*" e "*patetike*". Këto studime e heshtnin ose e minimizonin skajshmërisht praninë e kulturës orientale-islame në veprën e tij. Madje, Naimi paraqitej vetëm si një mësues, atdhetar, e nuk përmendej fare se ai ishte edhe mistik e teolog bektashian.

Literatura

Ebu'l-Ala Afifi (2000), *Fususu'l Hikem Okumalari Için Anahtar*, Përkth. Ekrem Demirli, Istanbul: Iz yayinlari.

Ernest Koliqi (pa vit botimi), *Ese të letërsisë shqipe*, Tiranë: IDK.

Naim Frashëri (1986). *Vepra* 1-2, Përgatiti për botim: Rexhep Qosja, Prishtinë:Rilindja.

Ibn Arabi (2006), *Fususu'l Hikem*, Përktheu dhe komentoi: Ekrem Demirli, Istanbul: *Kabalci Yayinlari*. Jean Grondin, "Gadamer's Basic Understanding of Understanding," in *the Cambridge Companion to Gadamer*, ed. Robert J. Dostal (Cambridge: Cambridge University Press, 2002).

Jolanda Kodra (1943). *Mejtime filozofike-fetare të Naim Frashërit*, **Njeriu -** Revistë e përmuejshme Shpirtnore Kulturore, Tiranë: Drita hyjnore.

Musine Kokalari (2009). *Vepra* (Vëllimi i parë), Tiranë: Geer.

Roland Barthes (1975). *The Pleasure of the Text*. Translated by Richard Miller, New York: Hill and Wang.

Shpëtim ELEZI, Prishtinë

STUDIUESIT ITALIANË PËR SHQIPEN DHE SHQIPTARËT NË *FJALORIN ENCIKLOPEDIK TË KOSOVËS*

Abstrakt. Ky punim merret me fjalësin e albanistëve italianë të përfshirë në *Fjalorin enciklopedik të Kosovës* (2018), që është vepra e parë leksikografike e kësaj natyre e botuar në Kosovë nga AShAK-u. Në *Fjalor*, në mesin e rreth 6000 zërave të fushave të ndryshme, evidentohen 30 studiues italianë të gjuhës shqipe, të cilët trajtohen në këtë punim sipas një kronologjie nga fillimi i shekullit XVIII e deri më sot dhe sipas fushave të studimit gjuhësor. Sa i përket përfaqësimit të tyre, në krahasim me zërat e *Fjalorit enciklopedik të Kosovës*, punimi vështron edhe zërat e albanistëve italianë në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (2009). Punimi nxjerr se studimet albanistike në Itali lidhur me arbërishten dhe me shqipen përgjatë këtyre tre shekujve të zhvillimit të tyre kanë dhënë rezultate shkencore në të gjitha fushat e kërkimit gjuhësor, si në fonetikë e fonologji, gramatikë, leksikologji, gjuhësi tekstore, filologji tekstore me përpunim elektronik, në sinkroni e diakroni, nga këndvështrimi struktural, funksional e gjenerativ. Përveç studimeve tradicionale në fushë të historisë së shqipes, të filologjisë e të dialektologjisë dhe në fushë të hartimit të fjalorëve të shqipes dhe hartimit të gramatikave për arsye metodike, këto studime së fundmi kanë dhënë rezultate edhe në fusha të tilla si sociolinguistikë, kontakte të gjuhëve, etnolinguistikë, fonetikë eksperimentale, gjuhësi e zbatuar, planifikim dhe politika gjuhësore etj.
Fjalët çelësa: Fjalori enciklopedik i Kosovës, Fjalori enciklopedik shqiptar, albanistikë, albanistë italianë.

Hyrje

Punimi vështron përmbledhtas studimet albanistike në Itali të përfaqësuara përmes zërash të përveçëm në *Fjalorin Enciklopedik të Kosovës* (FEK), botim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (2018), e cila është vepra e parë leksikografike e këtij lloji e botuar në Kosovë. Në mesin e 6 mijë zërave të fushave të ndryshme të shkencës, të artit, të kulturës e të dijeve të përgjithshme, në këtë *Fjalor* në tërësi përfshihen si zëra të veçantë 46 emra italianë, shumë prej tyre arbëreshë, studiues të fushave të ndryshme, klerikë, misionarë dhe albanologë. 30 prej tyre janë albanistë që janë marrë me studimin e gjuhës shqipe. Në mesin e 10 zërave të tjerë janë historianët Paolo Giovio (1483-1552), Daniel Farlati (1690-1773), Agostino Pertusi (1918-1979) dhe Egidio Ivetic (1965-), gjeografi dhe botanisti Antonio Baldacci (1867-1950), teologu Daniel Farlati (1690-1773), klerikët Daniel Duranti (1633-1713) dhe

Darioucciarelli (1827-1878), mjeku Luciano Motroni (1905-1989), poeti arbëresh Domenico Bellizi (1918-1989), i njohur më shumë si Vorea Ujko dhe Francesco Bider (1961-1999), dëshmor i luftës së fundit në Kosovë. Kontributi i tyre lidhur me shqiptarët shtrihet përgjatë shekujve XV-XXI. Në *Fjalor* janë të përfshirë edhe pesë shkrimtarët më të rëndësishëm të përfaqësimit të letërsisë arbëreshe, të fazave të ndryshme letrare të saj, si Lekë Matrënga (rreth 1567-1619) dhe Jul Variboba (1724 ose 1725-1788) nga letërsia shqipe e shekujve XVI-XVIII dhe Jeronim de Rada (1814-1903), Françesk Anton Santori (1819-1894), Gavril Dara i Riu (1826-1885) dhe Zef Serembe (1844-1901) nga letërsia e romantizmit arbëresh. Duke qenë se punimi ka për objekt trajtimi albanistët italianë të përfshirë në këtë *Fjalor*, në vijim do të vihet në pah kontributi i tyre për gjuhën shqipe dhe shqiptarët, ashtu siç prezantohet në formë zërash të veçantë në FEK. Gjithashtu, për sa i përket shkallës së përfaqësimit të tyre, punimi krahason zërat e albanistëve italianë të përfshirë në *Fjalorin enciklopedik të Kosovës* (2018) me zërat që prezantohen në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (2009), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë punim paraqitja e studimeve albanistike në Itali vendoset sipas një kronologjie dhe sipas fushave të studimit gjuhësor.

Sa i përket albanistikës, interesimi i studiuesve italianë për shqipen dhe për shqiptarët dëshmohet si mjaft i hershëm. Shfaqet për herë të parë në fillim të shekullit XVIII dhe me intensitet më të madh vazhdon edhe në shekullin XIX dhe sidomos përgjatë shekujve XX-XXI, periudhë gjatë së cilës vihet re një shtim i studimeve edhe në aspektin sasior e në aspekt të larmisë së fushave të studimit, por edhe në aspekt cilësor sa i përket prurjes së rezultateve shkencore. Kështu, që nga fillimi i shekullit XVIII, kur kemi gramatikat e para të shqipes: dorëshkrimi i Grotaferratës (1710) dhe gramatika e Da Leçes (1716), studimet albanistike në Itali kanë krijuar tashmë një traditë mbi 300-vjeçare. Për një çast, duke lënë mënjanë *Fjalorin* e Bardhit (1635), tek i cili gjenden shënimet e para leksikografike gjuhësore dhe duke marrë për bazë këto dy gramatika të para të shqipes, mund të thuhet se pikërisht në Itali fillojnë mirëfilli studimet albanistike në përgjithësi. Kjo gjë nuk është e rastit, pasi lidhet para së gjithash me komunitetin arbëresh atje, me emra të përveçëm studiuesish me interesim për fusha të ndryshme studimi të gjuhës shqipe, të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm lidhur me hapjen e departamenteve për mësimin e shqipes. Në Itali kemi edhe departamentin e parë të mësimdhënies së shqipes në Institutin Oriental të Napolit (1900), i cili konsiderohet si departamenti më i vjetër, i ideuar nga De Rada, por ku fillimisht ka mbajtur mësim Zef Serembe e më pas

edhe Zef Skiroi (Giuseppe Schirò, 1865-1927), i cili më vonë kreu edhe funksionin e drejtorit të departamentit. Kurse më pas shqipja nisi të mësohet edhe në qendra të tjera të Italisë si në Palermo (1932), Padovë (1936), Kozencë, Romë, Firence, Venecia etj., krahas qendrave të tjera nëpër botë si në Beograd (1921), Shën Peterburg (1957), Paris, Mynih, Torunj, Sofje, Edrene, Ohajo, Indiana, Arizona etj. (shih FEK 2018: 38, zëri *Albanistika*, B. Rugova). Prandaj, për vetë peshën dhe rëndësinë shkencore që ka veprimtaria shkencore e studiuesve italianë të shqipes e shtrirë përgjatë kësaj periudhe treshekullore, përfshirja e tyre në *Fjalorin Enciklopedik të Kosovës* është krejt e pritshme dhe e natyrshme, sepse pa këto studime dhe pa këta emra studiuesish albanistika në përgjithësi nuk do të dukej e plotë, prandaj edhe *Fjalori* nuk do të ishte i tillë.

Studimet albanistike në shekullin XVIII

Në shekullin XVIII kemi studimet e para të mirëfillta për gjuhën shqipe jo vetëm në Itali, por edhe në vende të tjera të Evropës. Ndërsa studiuesit evropianë si Lajbnic (1705-1715) e Tunman (1774) hapin shtigjet e para të studimit në fushë të historisë së shqipes, në Itali kemi studimet e para në fushë të gramatikës dhe të leksikografisë. Filozofi gjerman Gottfried Wilhem Leibnitz ka shprehur disa mendime rreth diakronisë së gjuhës shqipe. Ai mbahet si i pari studiues që në fushë të historisë së gjuhës shqipe nxiti debatin për prejardhjen ilire të shqipes dhe për vendin dhe raportet e saj me gjuhët e familjes IE . Me shënimet e tij të viteve 1705-1715 ai mbështet tezën e origjinës ilire, pasi për të është e qartë se relikte të ilirishtes ruhen veçanërisht në shqipen, konstatonte mëvetësinë e shqipes nga gjuhët sllave apo nga greqishtja dhe gjente afri të shqipes me latinishten dhe me keltishten. Po ashtu edhe gjuhëtari suedez Johann Erich Thunman (1746-1778) argumentoi teorinë ilire të prejardhjes së shqiptarëve në veprën "Kërkime për historinë e popujve të Europës Lindore" (1774).

Lidhur me studimet albanistike të shekullit XVIII në Itali, në *Fjalorin Enciklopedik të Kosovës* (2018) paraqiten të dy autorët italianë të përmendur më lart, Didacus da Dezio (Da Desio, shek. XVIII) dhe Francesco Maria da Lecce (?-1718), të cilët shquhen me kontributet e tyre për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët. Sipas asaj që cilësohej në dokumentacionin e Propagandës Fide: "e ka gati për shtyp një gramatikë të kësaj gjuhe (të shqipes – shënim imi), Da Dezio konsiderohet si autor i Gramatikës së vogël shqipe, e njohur si dorëshkrimi i Grotaferratës (1710) që ruhet bashkë me fjalorin në Dorëshkrimin e

Manastirit Grotaferrata. Ky dorëshkrim me faksimilet dhe transkriptimin, interpretimet dhe historinë tjetër të librit dhe diskutimin për autorin e mundshëm të tij është botuar te "Rilindja" më 1982 në Prishtinë nga R. Ismajli. Da Dezio ishte mësuesi i parë i gjuhës shqipe në Romë në Kolegjin e Shën Pietro Montorios nga 20 prill 1711 deri më 1722 dhe paraprakisht edhe misionar në Mat (Macedonia) nga 1702-1710. Kurse albanologu italian Françesko Maria da Leçe njihet për gramatikën më të hershme të botuar të shqipes me titull "Vërejtje gramatikore mbi gjuhën shqipe dhe drejtshkrimin e saj" (Osservazioni grammaticali nella lingua albanese), botuar në Romë më 1716, si dhe për një fjalor italisht-shqip me titull "Dittionario italiano-albanese", "që besohet të jetë hartuar rreth vitit 1702" (Vehbiu 2013). Ky fjalor i tij, që deri vonë mendohej i humbur, u zbulua më 1995 nga Mateo Mandalà (1958-) dhe u botua më 2009 nga G. Gurga në Shkodër.

Studimet albanistike në shekullin XIX dhe në gjysmën e parë të shekullit XX

Në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX albanistika ka qenë më shumë e orientuar nga historia e gjuhës shqipe, duke qenë objekt studimi i autorëve europianë si Franc Bop (Franz Bopp, 1791-1867), Georg fon Han (Johan von Georg Hahn, 1811-1869), Franc Mikloshiç (Franc Miklošič,1813-1891), Gustav Majer (Gustav Meyer, 1850-1900), Holger Pedersen (1867-1953), Norbert Jokl (1877-1942) e të tjerë, me të cilët përplotësohen e konsolidohen më tej studimet shkencore në fushë të albanistikës. Në këtë fushë në mesin e albanistëve italianë njihet kontributi i rëndësishëm për kohën i Dhimitër Kamardës (Demetrio Camarda, 1821-1882), i cili në vitin 1864 botoi veprën e tij kryesore "Sprovë e gramatologjisë krahasuese mbi gjuhën shqipe" (Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese), që është vepra e parë shkencore e një studiuesi shqiptar që i trajton faktet e gjuhës shqipe në planin historik-krahasues. Në këtë vepër Kamarda mbronte teorinë, të papranuar nga shkenca gjuhësore më vonë, se shqipja afrohet me "çiftin pellazgjik", domethënë me latinishten e me greqishten, por më fort me greqishten. Megjithatë, vepra ka një lëndë mjaft të pasur e mjaft të përpiktë nga gjuha shqipe dhe vëzhgime me interes për gramatikën dhe për etimologjinë e shqipes e greqishtes (shih FESh 2008, zëri: *Kamarda*, J. Kastrati). Ai u mor edhe me alfabetin e shqipes, më 1869 botoi broshurën "Alfabeti i përgjithshëm shqip-epirot" (Alfabetto generale albano-apirotiko), me çështje të gjuhës letrare (standarde) shqipe dhe me probleme të morfosintaksës së shqipes.

Nga albanistë italianë, studimet për çështje të diakronisë së shqipes dëshmohen edhe në gjysmën e parë të shekullit XX. Kështu, në fushë të fonetikës historike-krahasuese në vitin 1924 e kemi punimin e Gaetano Petrotës (Gaetano Petrotta, 1882-1952), me titull "Sprovë e fonetikës krahasimtare të gjuhës shqipe", i cili çështje të historisë së gjuhës shqipe, të alfabetit e të studimeve albanologjike në përgjithësi i trajton edhe në veprën e tij kryesore "Populli, gjuha dhe letërsia shqipe" (1931). Në fushë të fonetikës historike-krahasuese kemi edhe studimin krahasues të vitit 1937 për sistemin e zanoreve në shqipen dhe në latinishten të Marko la Pianës (Marco la Piana, 1883-1958), i cili ka publikuar më pas edhe një studim tjetër për bashkëtingëlloret likuide dhe ato hundore të shqipes (1952). Nga studimet e La Pianës, një fjalor etimologjik i shqipes dhe një gramatikë historike e shqipes, që kujtoheshin të zhdukura, është raportuar se gjenden në bibliotekën e seminarit arbëresh në Horën e Arbëreshëve. Më pas, me probleme të historisë së shqipes u mor edhe indoeuropianisti Vittore Pisani, i cili e vështroi shqipen në kuadër të gjuhëve indoeuropiane në "Shqipja dhe gjuhët e tjera indoeuropiane" (1950) dhe argumentoi mbi burimin e shqipes në "Origjina e gjuhës shqipe" (1964) dhe "Mbi gjenezën e shqipes" (1972). Çështje të historisë së shqipes u trajtuan edhe nga romanisti e ballkanologu italian Carlo Tagliavini (1903-1982), i cili në fushë të etimologjisë konsiderohet si vijues i studimeve albanistike të Meyerit (1891), Pedersenit (1894, 1895) dhe Joklit (1911), me punimin e tij "Shtresëzimi i leksikut të shqipes. Elementet indoevropiane" (1965) me të cilin dha ndihmesë për studimet etimologjike në rrafsh të shqipes, duke vënë në dukje përfundimet e arritura në periudhën pas botimit të "Fjalorit etimologjik" (1891) të G. Majerit.

Këto studime në fushë të historisë së shqipes dhe në fusha të tjera të studimeve gjuhësore (gramatikë, leksikologji e leksikografi, dialektologji, botime filologjike etj.) janë intensifikuar e janë zgjeruar sidomos në periudhën e Rilindjes Kombëtare, gjatë së cilës ka pasur interesim të shtuar për shqipen si te vetë arbëreshët në Itali, ashtu edhe ndër shqiptarët këndej Adriatikut, pasi krahas botimeve të Naum Veqilharxhit ("Evetari", 1845) dhe gramatikave normative të Kristoforidhit e të Sami Frashërit, në mesin e rilindësve shqiptarë, të asaj kohe janë edhe gramatikat e Zef de Radës, Dhimitër Kamardës, Françesko Rosit (1866), në mesin e arbëreshëve të Italisë. (shih FEK 2018: 37, zëri: *Albanistika*, B. Rugova). Kjo traditë e botimit të gramatikave të shqipes nga albanistë italianë vijon edhe në gjysmën e parë të shekullit XX si nga Angelo Leotti (1884-1963), i cili botoi dy gramatika të rëndësishme për kohën: njërën për dialektin toskë (1915) dhe tjetrën për dialektin gegë (1916). E kësaj kohe është edhe një

gramatikë shqipe e së folmes së Horës së Arbëreshëve e lënë në dorëshkrim më 1938 nga Gaetano Petrota (Gaetano Petrotta, 1882-1952). Një gramatikë mbi dialektin gegë të gjuhës shqipe të vitit 1931 e kemi edhe nga Fulvio Cordignano (1887-1952), i cili në këtë kohë ka dhënë një ndihmesë edhe në fushë të leksikografisë, duke hartuar dy fjalorë: Fjalor shqip-italisht dhe italisht-shqip (1934) dhe Fjalor italisht-shqip dhe shqip-italisht (1938). Në fakt, tradita e hartimit të fjalorëve dygjuhësh italisht-shqip dhe anasjelltas lidhet me emrin e Francesco Rossi (1814-1888), i cili kah mesi i shekullit XIX rimerr fjalorin e Da Leçes dhe më 1866 e boton me titullin "Fjalor italisht-epirotisht" me 11 mijë fjalë të shqipes. Por një fjalor më të madh shqip-italisht me rreth 30 mijë zëra e me 2500 proverba e idioma e kemi nga Anxhelo Leoti më 1937. Gaetano Petrota la dorëshkrim një fjalor frazeologjik të arbëreshëve të Sicilisë (1942), kurse nga Marko la Piana kemi një studim për prefiksin la- në gjuhën shqipe (1957).

Në fillim të shekullit XX, me studime dialektologjike ndër albanistë italianë shfaqet Michele Marchianò (1860-1921), i cili në veprën "Kolonitë arbëreshe të Italisë dhe letërsia e tyre" (Le colonie albanesi d'Italia e la loro letteratura), Romë, 1913, vë në dukje se "dialektet e Kalabrisë, të Pulias e të Sicilisë janë një pasqyrë gati besnike e të folurit të Toskërisë", por gjithashtu shënon se "në traditat e shkruara" flitet edhe për koloni arbëreshe të ardhura nga vise të tjera të Shqipërisë së sipërme. Kurse gjuhëtari italian Mateo Bartoli (Matteo Bartoli, 1873-1946), vepra kryesore e të cilit është për dalmatishten (1906), në studimet e shqipes ka luajtur rol në fushë të dialektologjisë, pasi si themelues i rrymës së gjuhësisë hapësinore ishte i pari që artikuloi idenë për hartimin e një atlasi dialektologjik të shqipes, për të cilin shkruante në "Buletinin e atlasit gjuhësor italian" (Bolletino dell' Atlante linguistico italiano, 1933). Lidhur me këtë, më 1940, u formua një komitet ekzekutiv që përbëhej nga K. Merlo, M. Bartoli dhe K. Taljavini. Në fillim ai mendonte që mbledhjen e materialit t'ua besonte N. Resulit e G. Skiroit, por, më 1943, u vendos që këtë punë ta kryente E. Çabej. Projekti nuk u realizua për shkak të ndryshimeve politike në Shqipëri gjatë e pas Luftës së Dytë Botërore, por ai u mor parasysh kur u hartua "Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe". Edhe Karlo Taljavini njihet në këtë fushë me veprën "Shqipja e Dalmacisë" (L'albanese di Dalmazia, Firencë 1937) me të cilën dha ndihmesë për njohjen e së folmes shqipe të Borgo Ericos (Arbneshit) të Zarës dhe me monografinë dialektologjike "Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore (Dardania dhe Maqedonia Veriperëndimore)" (La parlate albanesi di tipo Ghego oriantale (Dardania e Macedonia nord orientale), Romë, 1942, në të cilën dha disa tipare të përgjithshme të të folmeve të Kosovës dhe të

Maqedonisë. Kurse nga Marko la Piana kemi një studim për dialektet arbëreshe (1949).

Në fushë të filologjisë për ribotimin e teksteve dhe botimin kritik të tyre në fillim të shekullit XX ndër albanistë italianë shquhen Gaetano Petrota, Nilo Borxha e Marko la Piana. Petrota botoi analiza filologjike të teksteve të vjetra të shqipes dhe një studim mbi një katekizëm shqip redaktuar nga M. Markiano, si dhe analizoi disa pjesë të Mesharit (1555) të Buzukut, pasi më parë i kishte botuar me P. Skiroin. U mor edhe me jetën dhe veprën e Bogdanit. Veçohet sidomos puna e filologut dhe bibliofilit Nilo Borxha (Nilo Borgia, 1870-1942), i cili u mor me gjurmime tekstesh e dokumentesh për gjuhën shqipe e për historinë e shqiptarëve dhe botoi me fotokopje e komente dokumentin më të vjetër të toskërishtes, të shkruar çamërisht me shkronja greke "Perikopeja e Ungjillit" (Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV, da un manoscritto greco della Biblioteca Ambrosiana), të zbuluar në Grotaferratë të Italisë (1930), me transkriptim e komentim të tij për këtë tekst të shekujve XV a XVI. Ai argumentoi nevojën e studimit të thelluar filologjik të autorëve të vjetër si burim për pasurimin e shqipes letrare dhe për mënjanimin e fjalëve të huaja. Një kumtim gojor i tij dhënë E. Çabejt se në Arkivin e Vatikanit gjendet një dokument shqip më i vjetër se ato që njihen, ende nuk është vërtetuar. Kurse Marko la Piana ka publikuar një kopje të veprës së Lekë Matrëngës në Romë (1912). Në këtë mes mund të futet edhe Xhuzepe Tomas Gangale (Thomas Giuseppe Gangale, 1898-1978), themelues dhe drejtor i një qendre gjuhësore greqisht-shqip (Crotone), i cili njihet për fondin Gangale me dorëshkrime e botime arbëreshe në Bibliotekën Mbretërore të Danimarkës.

Studimet albanistike nga gjysma e dytë e shekullit XX e deri më sot

Në gjysmën e dytë të shekullit XX e këtej studimet më shumë orientohen nga strukturat e shqipes, në sinkroni e në diakroni. Në këtë kohë ka studime më intensive dhe më sistematike të shqipes në mesin e albanistëve italianë, gjë që shkon në përputhje me zhvillimet e përgjithshme të gjuhësisë shqiptare në Shqipëri, Kosovë e gjetkë. Në këtë kuadër u botuan disa gramatika, kryesisht për nevoja didaktike, por edhe studime të veçanta për strukturat morfosintaksore, si nga Françesko Solano (1972), Emanuil Jordani (2005), Anxhela Çirinçone (1968), Leonardo Savoia, Xhusepina Turano (2004, 2011, 2012) e të tjerë.

Puna kërkimore e albanistëve italianë është konkretizuar me disa botime edhe në fusha të tjera të gjuhësisë, si:

a) në leksikologji e në leksikografi, kryesisht në punë të hartimit të fjalorëve dygjuhësh shqip-italisht dhe arbërisht-italisht dhe fjalorëve të të folmeve arbëreshe e fjalorëve terminologjikë të gjuhësisë, veçohen studimet e Emanuil Jordanit (2005), të Françesko Altimarit, të Xhovani Belushos (2011) etj.

b) për çështje të fonetikës dhe të fonologjisë shquhen studimet albanistëve, si Xhovan Batista Pelegrini (Giovan Battista Pellegrini, 1921-2007), Leonardo Savoia, Paolo di Xhovine (Paolo Di Giovine, 1957-), Xhovani Belusho (Giovanni Belluscio, 1961-) etj.

c)në studime dialektore lidhur me aspekte të ndryshme gjuhësore të të folmeve arbëreshe dhe me probleme të tjera të dialektologjisë shqiptare në përgjithësi, kemi studime nga Francesco Solano (1914-1999), Emanuele Giordano (1920-2015), Xhovan Batista Pelegrini, Antonino Guxeta (1978, 1983, 1986), Italo Fortino (2008), Leonardo Savoia (2003, 2008, 2012), Françesko Altimari (1986, 1994), Xhovani Belusho, Xhusepina Turano (2001) etj.

d) në fushë të studimeve historike të shqipes, të fonetikës e të gramatikës historike dhe në lidhje me fjalorin, çështje të burimit dhe huazimet, të para veçan dhe në kuadër të indoevropianistikës e të ballkanistikës, veçohen studimet e albanistëve italianë, si Xhovan Batista Pelegrini, Antonino Guxeta (1922-2017), Karlo de Simone (1932-), Emanuele Banfi (1985, 1987, 1991, 2003), Matteo Mandalà, Paolo di Xhovine (1979, 1982, 1992, 1996, 2007, 2008), Monika Xhenezin (1994, 1995, 1998, 2007) etj.

e) në fushë të filologjisë e të botimit kritik të teksteve të vjetra dhe të analizës së tyre filologjike lidhur me konkordancat elektronike shquhen me kontributet e tyre albanistë, si Mateo Shambra (1964), Italo Fortino (1984), Françesko Altimari (1995, 1998, 2005), Mateo Mandalà (1995, 1998, 2001, 2007, 2013), Xhovani Belusho, Xhusepina Turano (1961-) etj.

Në dekadat e fundit është shtuar edhe kuadri i studimeve gjuhësore edhe me disiplina të reja për sfera të ndryshme të shqipes në këndvështrime të ndryshme strukturale dhe funksionale të studimit dhe në fusha të ndryshme të gjuhësisë, si:

a) në fushë të sociolinguistikës e të etnolinguistikës, më fort në lidhje me arbërishten, por edhe me arvanitishten e me shqipen në përgjithësi, kemi studime nga Matteo Sciambra (1914-1967), Angela Cirrincione (1926-2008), Emanuele Banfi (1946-), Leonardo Savoia (1948-) etj.

b) në fushë të gjuhësisë së zbatuar shquhen sidomos studimet nga Emanuele Banfi, Leonardo Savoia, Xhovani Belusho etj.

c) me probleme të politikave gjuhësore, të minoriteteve gjuhësore, të

kontakteve gjuhësore janë marrë albanistë, si Leonardo Savoia, Francesco Altimari (1955-), Xhusepina Turano etj.

Në këto dy dekadat e fundit kemi studime të shqipes dhe nga këndvështrimi gjenerativ, sidomos nga Leonardo Savoia e Xhusepina Turano.

Në studimet albanistike në Itali kemi edhe një varg revistash e konferencash shkencore për çështje të caktuara të albanistikës në qendra të ndryshme të mësimit e të studimit të shqipes në Itali, kurse me kohën filluan edhe pjesëmarrjet e albanistëve italianë në organizimet shkencore në Shqipëri e Kosovë, sidomos vihet re pjesëmarrja e tyre e përvitshme nga 1974 e këtej në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë, i cili ka qenë një dritare e hapur për studimet e shqipes ndër të huaj në përgjithësi.

Në vitet e fundit disa prej albanistëve italianë janë zgjedhur anëtarë nderi e anëtarë të jashtëm të dy akademive shqiptare, të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Françesko Altimari, Mateo Mandalá). Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës në kuadër të serisë së botimeve albanistike ka filluar edhe me botime të veçanta të studiuesve italianë, si "Studime gjuhësore italo-shqiptare" të Françesko Altimarit (2014) dhe "Studime në gjuhësinë shqiptare" të studiuesit Leonardo Savoia (2015).

Albanistët italianë në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (2009)

Fjalori enciklopedik shqiptar (FESh) i vitit 2009 është vepra e dytë e këtij lloji që është botuar në gjuhën shqipe nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e cila ka vijuar rrugën e çelur nga botimi i parë i vitit 1985. Ky botim i vitit 2009 është variant i rishikuar dhe i plotësuar jo vetëm për nga ana sasiore, por edhe për nga përmbajtja e zërave dhe nga mënyra e trajtimit të tyre. Në këtë vepër, mes fushave të tjera, një vend të rëndësishëm e zënë zërat e fushës së albanologjisë në përgjithësi dhe të albanistikës në veçanti, përmes të cilëve pasqyrohen të arriturat shkencore të albanologjisë e të albanistikës. Nga 7200 zërat e tërësishëm që përmban *Fjalori*, përfshihet edhe një numër i albanistëve italianë e arbëreshë, gjithsej 23, të cilët në kuadër të veprimtarisë së tyre shkencore në vazhdimësi kanë bërë objekt trajtimi gjuhën shqipe.

Krahasuar me *Fjalorin enciklopedik të Kosovës* (2018), *Fjalori enciklopedik shqiptar* (2009) përfshin si zëra të veçantë edhe 9 studiues italianë që në një formë a tjetër janë marrë me probleme rreth shqipes dhe shqiptarëve. Në mesin e tyre është Bernard Bilota (1843-1918), i cili pos si poet e folklorist arbëresh, ka kontributet e tij edhe si gjuhëtar, pasi ka qenë ndër nismëtarët e dy

kongreseve gjuhësore arbëreshe (Koriljano Kalabro, 1895; Ungër, 1897) dhe ka botuar italisht e ka lënë në dorëshkrim disa vepra studimore me karakter gjuhësor, kryesisht mbi arbërishten. Në këtë mes hyn edhe arbëreshi Vincenzo Dorsa (1823-1885), i cili sjell dhëna gjuhësore për arbërishten e për shqipen (1847) dhe u mor edhe me etimologji (1862). Edhe Giuseppe Ferrari (1913-1990), pos të tjerash, ka kontribuar në fushë të studimit të gjuhës shqipe, si filolog (1963) dhe gramatikan (1971), duke qenë dhe delegat në Kongresin e Drejtshkrimit (1972). Si filolog njihet dhe Giuseppe Gradilone (1925-), i cili pos kontributit të tij kryesor në fushë të studimit të letërsisë shqipe, ka lëvruar edhe fushën e analizës filologjike dhe të kritikës së tekstit, me një varg botimesh kritike nga krijimtaria e autorëve arbëreshë (1997). Në mesin e zërave të albanistëve zë vend në FESh edhe Dhimitër Kamarda për kontributin e të cilit si albanist u fol më lart. Kurse Zef Krispi (Giuseppe Crispi, 1781-1859) u mor me origjinën e shqiptarëve e të gjuhës shqipe (1831) dhe është i pari që shkroi mbi "Mesharin" e Buzukut, prej të cilit botoi një fragment, sipas letrës së Gjon Kazazit, që ia jep lajmin e zbulimit të tij, më 1740, Gjergj Guxetës (Giorgio Guzzetta). Si filolog njihet edhe Pal Skiroi (Paolo Schirò, 1866-1941), pasi ai e rizbuloi "Mesharin" në vitin 1910 dhe për tridhjetë vjet u mor me studimin e tij dhe me përgatitjen e botimit filologjik të librit, duke botuar disa pjesë të kësaj pune në bashkëpunim me G. Petrotën. Është autor i një gramatike të shqipes dhe ka lënë në dorëshkrim kthimin e fjalorit latinisht-shqip të F. Bardhit në shqip-latinisht. Edhe Lluka Perrone (1920-1984), pos si studiues i folklorit, njihet edhe si leksikograf, pasi ka botuar një fjalor të pasur të së folmes së Ejaninës në "Dialektologjia shqiptare" VI (1990) dhe VII (2005). Po ashtu edhe albanologu Zef Valentini (1900-1975) njihet edhe si albanist, pasi përpos studimeve të shumta në fusha të ndryshme, si histori, letërsi e folkloristikë, botoi edhe studime gjuhësore.

Përveç këtyre 9 albanistëve që u prezantuan më lart, sipas të dhënave nga zërat e prezantuar në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (2009), në FESh janë të përfshirë edhe 14 zëra studiuesish italianë të shqipes, si: Antonino Guxeta, Anxhelo Leoti, Françesko Altimari, Françesko Solano, Gaetano Petrota, Italo Fortino, Karlo Taljavini, Marko la Piana, Matteo Mandalà, Mateo Shambra, Mikele Markiano, Nilo Borxha, Zef Skiroi dhe Xhovan Batista Pelegrini, për kontributin e të cilëve u fol më lart sipas të dhënave të zërave të paraqitur në *Fjalorin enciklopedik të Kosovës* (2018). Por, nga ana tjetër, në FESh nuk kanë zënë vend 16 albanistët që pasqyrohen si zëra të veçantë në FEK, si Anxhela Çirinçone, Da Dezio, Emanuele Banfi, Emanuil Jordani, Françesko Maria da

Leçe, Françesko Rosi, Fulvio Kordinjano, Karlo de Simone, Leonardo Savoia, Mateo Bartoli, Monika Xhenezin, Paolo di Xhovine, Vitore Pizani, Xhovani Belusho, Xhusepina Turano dhe Xhuzepe Gangale.

Përfundime

Studimet albanistike në Itali, nga ajo që prezantohet në *Fjalorin Enciklopedik të Kosovës* (2018), si dhe në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (2009), kanë një traditë treshekullore nga fillimi i shekullit XVIII dhe janë zhvilluar pandërprerë përgjatë kësaj kohe deri më sot, qoftë përmes emrave të përveçëm të albanistëve italianë, qoftë në kuadër të katedrave të gjuhës shqipe në formë projektesh shkencore. Në fakt, vetë albanistika e mirëfilltë shkencore ka nisur në Itali, e cila në rrjedhë të kohës e ka përplotësuar veten dhe studimet gjuhësore shqiptare në përgjithësi.

Rezultatet e tyre shkencore janë në të gjitha fushat e kërkimit gjuhësor, si në fonetikë e fonologji, gramatikë, leksikologji, gjuhësi tekstore, në sinkroni e diakroni, lidhur me arbërishten dhe me shqipen nga këndvështrimi struktural, funksional e gjenerativ. Përveç studimeve historike e dialektologjike, që kanë një traditë më të gjatë që nga fillimi, në dekadat e fundit kemi rezultate shkencore edhe në disiplina gjuhësore, si sociolinguistikë, kontakte të gjuhëve, etnolinguistikë, gjuhësi teksti, filologji tekstore me përpunim elektronik, fonetikë eksperimentale, gjuhësi e zbatuar, politika gjuhësore etj.

Nga aspekti sasior, si numër studiuesish italianë e arbëreshë që janë marrë me shqipen e me shqiptarët, 30 zëra në FEK dhe 23 në FESh, në tërësi 39 zëra të veçantë nxjerrë nga të dy fjalorët enciklopedikë shqiptarë, kuptohet se studimet albanistike të zhvilluara në Itali zënë një vend të rëndësishëm në studimet për gjuhën shqipen dhe për shqiptarët. Kështu këto studime dhe këta emra të përveçëm albanistësh italianë zënë një vend të veçantë në kuadër të albanistikës shqiptare dhe rrjedhimisht edhe në *Fjalorin enciklopedik shqiptar* (2009) dhe në *Fjalorin Enciklopedik të Kosovës* (2018).

Bibliografia

Altimari, F. (1982). Un saggio inedito di Francesco Antonio Santori sulla lingua albanese e i suoi alfabeti (An unpublished essay of Francesco Antonio Santori on the Albanian language and its alphabets), *Quaderni di Zjarri* Vol. 7, San Demetrio Corone: Zjarri, 1982.

Altimari, F. (2002). Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe (Arbereshe linguistic and literary observations), Prishtina: Shpresa & Faik Konica, 2002.

Altimari, F. (2014). Studime gjuhësore italo-shqiptare. Prishtinë: AShAK.

Altimari, F. (2017). Canti di Milosao. Edizione critica delle tre versioni a stampa (1836, 1847, 1873) e della IV versione manoscritta (1896)/a cura di Francesco Altimari-Opera Omnia di Girolamo De Rada, vol. II, Soveria Mannelli: Rubbettino Editore.

AShAK (2018). Fjalori Enciklopedik i Kosovës. Prishtinë: AShAK.

AShSh (2009). Fjalori enciklopedik shqiptar. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Banfi, E. (1972). Aree latinizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica (area della via Egnazia), in "Rendiconti dell'Istituto Lombardo - Accademia di Scienze e Lettere - Classe di Lettere", 106 (1972), pp. 185-243.

Banfi, E. (1985). Linguistica balcanica. Zanichelli, Bologna.

Banfi, E. (1986). Cristianizzazione nei Balcani e formazione della lega linguistica balcanica, in Zeitschrift für Balkanologie, 23 (1986), pp. 1-11.

Banfi, E. (1991). Storia linguistica del Sud-Est europeo. Crisi della Romània balcanica tra alto e basso medioevo. Franco Angeli, Milano.

Bartoli, M. (1933). Bolletino dell'Atlante linguistico italiano. Udine.

Belluscio, G. – Rrokaj, Sh. (2011). Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë: shqip-italisht-frëngjisht-anglisht. Tiranë.

Belluscio, G. (1993). Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo Albanese. Rende: Univ. di Studi della Calabria.

Belluscio, G. (2010). ALBANIAN. The Albanian Language in education in Italy.

Borgia, N. (1930). Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV, da un manoscritto greco della Biblioteca Ambrosiana. Grottaferrata, Scuola Tipographica Italo-Orientale.

Camarda, D. (1864). Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese. Livorno.

Camarda, D. (1866). Appendice al saggio di grammatologia comparata della lingua albanese. Prato.

Cirrincione, A. (1968). Sintasi Albanese degli antichi scritori. Roma.

Cordignano, F. (1931). Lingua albanese (dialetto ghego): Grammatica, saggi di letteratura, fraseologia e poverbi. Milano.

Cordignano, F. (1934). Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese. Milano.

Cordignano, F. (1938). Dizionario italiano-albanese.

Crispi, G. (1831). Memoria Sulla Lingua Albanese. Shih: Kessinger Publishing (10 Sept. 2010).

Da Lecce, F. M. (1716). Osservazioni grammaticali nella lingua albanese. Romë.

Da Lecce, F. M. (rreth 1702). Dittionario italiano-albanese. ("Fjalor italisht-shqip"). Shih G. Gurga, botim kritik, 2009, Shkodër.

De Simone, C. (1986). Gli illiri del Sud. Tentativo di una definicione. Iliria 1.

Di Giovine, P. (1979). Tracio, dacio ed albanese nella prospettiva genealogica. Accademia Nazionale dei Lincei. Roma.

Di Giovine, P. (1982). Il gruppo ct latino in albanese.

Di Giovine, P. (1988). Su una presunta peculiarità fonetica dei prestiti greco antichi in albanese. Studi e saggi linguistici, Pisa.

Di Giovine, P. (1993). La lingua albanese tra mondo latino e mondo greco antico nella penisola balcanica. ku?

Di Giovine, P. (2007). Dal dukát all'investitór: nove secoli di italiano in Albania. ku?

Di Giovine, P. (2008). Un millennio di storia linguistica albanese: l'influsso lessicale della lingua italiana. L'Italia dialettale, Pisa.

Di Giovine, P. (2012). L'albanese: una lingua (lessicalmente) romanizzata? ku?

Di Giovine, P. (2013). Toponomastica albanese nei Balcani antichi. ku?

Di Giovine, P. (2017). Riflessi linguistici della figura femminile nella cultura albanese. La vexata quaestio della sorella-madre (alb. motër 'sorella') / Giovine, Di. - Stampa. - (2017), pp. 219-232.

Di Giovine, P. (2019). La città di Roma e la lingua albanese: un rapporto secolare / Giovine, Di. - (2019), pp. 87-94.

Dorsa, V. (1847). Sugli albanesi, riserche e pensieri. Napoli.

Dorsa, V. (1862). Studi etimologici della lingua albanese. Kozencë.

Ferrari, G. (1963). Canti albanesi, raccolta di Michele Bellusci del '600. Bari. Shih: F. Solano, "Belluscio o De Rada? (Osservazioni su un manoscritto di canti albanesi)", Roma, 1966, në:

http://www.fondazioneuniversitariasolano.it/wp-content/uploads/2018/06/BELLUSCI-O-DE-RADA.pdf.

Ferrari, G. (1971). Grammatica albanese, Parte I, Fonetica, Morfologia. Rende.

Fortino, I. C. (1984). Prolegomeni: Giulio Varibobba, La vita di Maria, Cosenza.

Gangale, G. T. (1979). Fragmenta ethnologica arberesca medio-Calabra. Rubbettino.

Genesin, M. (1994). Il sintagma preposizionale ën +ablativo nel Mëshari del piú antico scrittore albanese: Gjon Buzuku. Con particolare riguardo alle espressioni locali nelle lingue balcaniche. Balkan-Arhiv N.F. 19/20, Hamburg, Buske Verlag, 1994/5, pp. 351-77.

Genesin, M. (1999). Il Cuneus Prophetarum di Pjetër Bogdani: un commento storico-culturale alla luce della prima scala, in: Studi in onore di Luigi Marlekaj, a cura di M. Mandalá, Universitá degli Studi di Bari, Adriatica Editrice, Bari, 1999; pp. 191-204.

Genesin, M. (2012). The Albanian Plural Ending -(ë)na/ra: Distribution and Function, in: Sovremennaja Albanistika: dostiženija i perspektivy. Sbornik Statej. Rossijskaja Akademija Nauk. Institut Lingvističeskih Issledovanij. Nestor-Istorija. Sankt-Peterburg. 2012, pp. 126-137.

Genesin, M. (2019). Una classe verbale speciale nel ghego antico del Meshari. Alcune osservazioni tra diacronia e sincronia. In: Aspetti e momenti dell'albanologia contemporanea.

Giordano, E. (1963). Dizionario degli Albanesi d'Italia. ("Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë"). Bari.

Giordano, E. (2000). Alfabetizzazione Arbëreshe. Torino.

Giordano, E. (2000). Dizionario Arbëresh-Italiano. Castrovillari.

Giordano, E. (2005). Gramatikë arbëreshe. Manduria.

Gradilone, G. (1997). Studi di litteratura albanese contemporanea. Roma.

Guzzeta, A. (1968). Tracce della lingua albanese nel secolo XV nella documentazione veneta dell'epoca. Palermo.

Guzzeta, A. (1973). Tracce della lingua albanese del secolo XV nella documentazione veneta dell'epoca. Palermo.

Guzzeta, A. (1978). La parlata di Piana degli Albanesi, Parte I – Fonologia. Palermo.

Guzzeta, A. (1983). Descrizione fonematica della parlata arbëreshe di Contessa Entellina in Sicilia. Palermo.

Guzzeta, A. (1986). Per una descrizione funzionale della morfologia del sostantivo nella parlata arbreshe di Contessa Entellina. Palermo.

Guzzeta, A. (1988). Il ruolo della scuola per la difesa dell'etnia arbëreshe. Palermo.

Guzzeta, A. (1988). L'etnia albanese in Italia. Palermo.

Guzzeta, A. (1989). I rapporti Arbëresho-Shqiptarë attraverso i secoli. Palermo.
La Piana, M. (1912). The Albanian Catechism of Lekë Matrënga, 1592, from a Vatican Manuscript. Grottaferrata.

Ismajli, R. (1982), Gramatika e parë e gjuhës shqipe, botim kritik, Rilindja, Prishtinë.

La Piana, M. (1939). Prolegomeni allo studio della linguistica albanese. Introduction to the Study of Albanian Linguistics. Palermo.

La Piana, M. (1949). Studi linguistici albanesi: i dialetti siculo-albanesi (Albanian Linguistic Studies: The Albanian Dialects of Sicily). Palermo.

Leotti, A. (1915). Grammatica Elementare della Lingua Albanese. Dialetto Tosco. Heidelberg.

Leotti, A. (1916). L'Albanese parlato. Cenni grammaticali; vocabolario albanese-italiano-italiano-albanese – dialetto ghego. Milano.

Leotti, A. (1937). Dizionario albanese-italiano. Roma.

Mandalà, M. (2005). Gjurmimet leksikografike në mjedisin arbëresh të Sicilisë. In Akademia e Shkencave e Shqipërisë (a cura di), Leksikografia shqipe. Trashëgimi dhe perspektivë (pp. 82-103). Tirana : Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Mandalà, M. (2007). Kënga e sprasëme e Balës (Il Canto ultimo di Bala)di Gabriele Dara junior, Edizione critica. Palazzo Adriano: Grafiche Geraci.

Mandalà, M. (2013). Lekë Matranga: njeriu, koha, vepra. Mbi botimin kritik të varianteve dorëshkrim e të shtypur të veprës "E mbsuame e krështerë" (1592). Tiranë: Ombra GVG.

Mandalà, M. (2013). Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe. Tiranë.
Marchianò, M. (1913). Le colonie albanesi d'Italia e la loro letteratura. Romë.
Pellegrini, G. B. (1977). Introduzione allo studio della lingua albanese. Padova.
Pellegrini, G. B. (1992). Ricerche linguistiche balcanico-danubiane. Roma.
Pellegrini, G. B. (1995). Avviamento alla linguistica albanese. Palermo.
Petrotta, G. (1932). Popolo, Lingua e Letteratura albanese. Palermo.
Pisani, V. (1950). L'albanais et les autres langues indoeuropéennes. Bruxelles.
Pisani, V. (1964). Les origines de la langue albanaise. SA 1964/1.
Pisani, V. (1972). Sulla genesi dell'albanese. Akten Innsbruck.
Rossi, F. (1866). Vocabolario italiano-epirotico. Roma: Stamperia della S.C de Propaganda Fide.
Savoia, L. (1994). I dialetti italo-albanesi: studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe. Roma.
Savoia, L. (2015). Studime në gjuhësinë shqiptare. Prishtinë: AShAK.
Savoia, L. M. – Manzini, M. R. (2007). A unification of morphology and syntax: investigations into romance and Albanian dialects. London; New York: Routledge.
Savoia, L. M. – Manzini, M. R. (2018). The morphosyntax of Albanian and Aromanian varieties: case, agreement, complementation. Berlin; Boston: Walter de Gruyter.
Schirò, G. (1904). L'Albania e la questione Balcanica. Napoli.
Sciambra, M. (1964). La "Dottrina Cristiana" albanese di Luca Matranga. Vaticano: Biblioteca Apostolica Vaticana.
Sciambra, M. (1964). Stato attuale della parlata albanese di Contessa Entellina (Sicilia), in Orbis, voi. XIII, n.2. 1964 .
Sciambra, M. (1966). Evoluzione del linguaggio e del pensiero di Giuseppe Schirò dalla I alla II edizione del "Te dheu i huaj", in Giuseppe Schirò nel I centenario della nascita, Atti del IV Convegno Internazionale di Studi Albanesi, Annuario accademico 1965-66, Palermo.
Solano, F. (1972). Manuale di lingua albanese: elementi di morfologia e sintassi esercizi-cenni sui dialetti. Corigliano Calabro.
Tagliavini, C. (1937). L'albanese di Dalmazia: contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo, presso Zara. Introduzione, testi con traduzione interlineare, lessico etimologico. Firenze.
Tagliavini, C. (1942). La parlate albanesi di tipo Ghego orientale. Dardania e Macedonia nord orientale. Roma.
Tagliavini, C. (1965). La stratificazione del lessico Albanese. Elementi indoeuropei. Bologna.
Turano, G. – Koleci, F. (2011). *Hyrje në gramatikën gjenerative*. Tiranë: SHBLU.
Turano, G. – Memushaj, R. – Koleci, F. (2012). Theoretical and empirical studies in albanian syntax, Studime Teorike dhe empirike në fushën e sintaksës së shqipes (Albanian) Paperback.
Vehbiu, A. (2013). Shqipi i Da Lecce-s. (16 janar 2013). Në: https://peizazhe.com/2013/01/16/shqipi-i-da-leçe-s/ (Qasja e fundit më 21.10.2019).

Antonino GUZZETTA

CENNI SULLA STORIA DELLA CATTEDRA DI LINGUA E LETTERATURA ALBANESE PRESSO L'UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI PALERMO[1]

L'insegnamento di "lingua albanese e letteratura albanese" nell'ateneo palermitano va inserito storicamente nel più ampio quadro della fortuna accademica che la disciplina ha avuto in Italia. La presenza di una popolazione albanofona numerosa, sensibile ai problemi della sua identità etnico-linguistica e particolarmente attiva nel promuovere iniziative culturali tese a difendere le sue caratteristiche di comunità alloglotta, ha richiamato l'attenzione degli studiosi italiani, gli stessi che hanno dato il maggiore impulso alla istituzione delle cattedre in discipline albanologiche presso i centri universitari di Napoli, Palermo, Roma, Bari, Cosenza. Tale presenza ha concorso, direi naturalmente, alla formazione scientifica di un cospicuo numero di studiosi italo-albanesi, gli stessi che nel tempo si sono susseguiti nella direzione di tali cattedre[2], assicurando loro continuità operativa sia sul piano didattico - si ricordi che in Italia la lingua albanese si insegna ufficialmente soltanto nelle Università - sia su quello più proprio della ricerca scientifica dell'albanologia italiana, che non a caso costituisce il più qualificato punto di riferimento dei diversi paesi europei nei quali la lingua albanese viene studiata ed insegnata.

L'istituzione della Cattedra di lingua e letteratura albanese presso l'ateneo palermitano è in gran parte dovuta alla figura del papas Gaetano Petrotta (Piana degli Albanesi, 1882-1952). Laureatosi a Palermo nel 1913 con una tesi di argomento albanologico dal titolo *Fonetica comparata della lingua albanese*,

---

[1] Me propozim të prof. dr. Matteo Mandalàsë po rimarrim këtë shënim të përmbledhur për historinë e Katedrës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Palermo nga njëri prej profesorëve të saj të shquar Antonino Guzzetta, i cili nuk rron më. Redaksia.

[2] Per alcuni anni, dopo il secondo conflitto mondiale, le cattedre di Roma, Napoli, Bari sono state dirette o da studiosi di origini albanesi, quali Ernesto Koliqi, Namik Ressuli, Giacomo Marlekaj, Karl Gurakuqi, oppure da studiosi italiani che avevano a lungo vissuto in Albania, come Giuseppe Valentini, del quale diremo più oltre. La più antica cattedra di lingua e letteratura albanese fu istituita nel 1900 presso l'istituto Orientale dell'Università di Napoli ed affidata al poeta Giuseppe Schirò (1865-1927), arbëresh di Piana degli Albanesi. Attualmente i docenti delle cattedre di lingua e letteratura albanese di Roma, Napoli, Palermo e Cosenza sono studiosi italo-albanesi.

in seguito alla pubblicazione del ponderoso *volume Popolo, lingua e letteratura albanese* (Palermo, 1932), il Petrotta fu incaricato nel 1932 di tenere un Corso di cultura albanese nell'Università di Palermo per gli anni accademici 1931-33. Nell'anno accademico 1933-34 gli fu conferito l'incarico di Lingua e letteratura albanese, rinnovato annualmente sino al 1944, dopo che, nel 1940, aveva conseguito la libera docenza in questa disciplina.

Durante la seconda guerra mondiale, su sollecitazione del Petrotta, il Governo Alleato riconobbe l'alta funzione scientifica dell'albanese. Sulla base di tale provvedimento, che fu successivamente convalidato dal Governo Italiano con un decreto legge del 7 maggio 1948, il Ministero della Pubblica Istruzione, in seguito al nuovo stato giuridico della cattedra di Albanese e alla richiesta inoltrata dalla Facoltà di Lettere dell'Ateneo di Palermo, bandi nel 1950 il pubblico concorso che si effettuò nel novembre dello stesso anno con la proclamazione di Gaetano Petrotta a titolare della Cattedra di lingua e letteratura albanese. Due anni dopo, con legge regionale n. 235 del 1952, il Parlamento della Regione Siciliana approvò l'istituzione di "un posto di Professore di ruolo di lingua albanese presso l'Università di Palermo". In quella circostanza il legislatore, sottolineando che il provvedimento mirava anche alla valorizzazione della "colonia albanese in Sicilia" - che aveva esercitato una "sua incidenza nella lingua, nella cultura, nel costume, nella storia e nella tradizione sociale-religiosa dell'isola" -, auspicava che "le nobili tradizioni del popolo albanese [fossero] studiate con animo aperto e [formassero] in Palermo il centro di interessi da parte degli studiosi e cultori". Questo riconoscimento ufficiale da parte del Parlamento Regionale trovava una immediata rispondenza scientifica e accademica, documentata da quanto è avvenuto a Palermo in questi ultimi quattro decenni, a partire dalla organizzazione del I *Convegno di studi albanesi* (Palermo-Piana degli Albanesi, 24-26 ottobre 1948) che si svolse sotto gli auspici del Governo regionale siciliano e che fu significativamente inaugurato da illustri studiosi dell'Università di Palermo, in particolare da Bruno Lavagnini (presidente del Comitato del Convegno), da Antonino Di Stefano, da Giuseppe Cocchiara, fra i promotori e principali sostenitori dell' iniziativa.

La Cattedra di lingua e letteratura albanese deve al prof. Petrotta non solo la sua istituzione giuridica e la sua prima e valida organizzazione della didattica dell'albanese, ma anche l'impostazione rigorosamente scientifica della ricerca albanologica. Se si tiene in debita considerazione il fatto che l'insegnamento della lingua e della letteratura albanesi, in Italia come in Europa c nella stessa Albania, si trovava in una fase ancora pionieristica, limitata alle lodevoli ma

isolate iniziative di illustri studiosi, quali Carlo Tagliavini e Matteo Bartoli, assume ulteriore rilevanza lo sforzo profuso dal Petrotta con la sua attività didattica. È sufficiente uno sguardo ai corsi da lui svolti per comprendere a quali indirizzi si rivolgeva il suo insegnamento universitario, da un lato, occupavano un posto di rilievo gli argomenti linguistici che miravano a descrivere "la grammatica albanese con particolare riferimento ai due dialetti, ghego e tosco, e le loro principali differenze fonetiche e morfologiche"; dall'altro, emergevano i suoi interessi critico-letterari ed in particolare gli approfondimenti delle opere dei maggiori autori albanesi (Naim Frashëri e Giorgio Fishta) e italo-albanesi (Girolamo De Rada e Giuseppe Schirò). Per rendere più agevoli ed efficaci questi corsi, il Petrotta lavorò assiduamente alla preparazione di diverse antologie che raccoglievano, riassumendoli in quadri concettuali assai chiari e rigorosi, i principali risultati cui erano approdati gli studi linguistici e quelli letterari. È utile ricordare che egli lasciò inediti i suoi studi comparati sulla lingua e dialetti albanesi, la sua indagine sul lessico e lo schema grammaticale della parlata di Piana degli Albanesi, mentre riuscì a pubblicare alcune importanti antologie letterarie collaborando alla stesura della monumentale opera *Shkrimtarët Shqiptarë* e alla compilazione della grande antologia *Bota Shqyptare*, entrambe apparse a Tirana.

Dal punto di vista della ricerca, non possiamo non menzionare, oltre al citato volume *Popolo, lingua e letteratura albanese* - l'opera certamente più importante, gli altri principali studi del Petrotta, quali il saggio *Il più antico testo di lingua albanese: D. G. Buzuku* (estratto dalla *Rivista indo-greco-italica*, f. I e II, 1932), l'opera *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese* (Palermo, 1950) e le voci *Italo-albanesi, Italo-bizantino e Italo-greci* che Egli curò per la *Enciclopedia Cattolica* (vol. VII, Città del Vaticano, 1951).

Il Petrotta lasciò nel 1952 la Cattedra di lingua e letteratura albanese per raggiunti limiti di età, ma non per questo trascurò di interessarsi del futuro di questa importante istituzione scientifica. Fu infatti dietro suo personale interessamento che la Facoltà di Lettere e Filosofia chiamò alla successione il prof. Giuseppe Valentini (1900-1979), le cui qualità di studioso il Petrotta aveva avuto modo di apprezzare durante le sue lunghe permanenze in Albania. Valentini visse per quasi cinque lustri nella missione gesuita di Scutari, dove diresse il prestigioso Collegio Saveriano, autentica fucina di intellettuali e studiosi. A Scutari ebbe occasione non solo di imparare e poi di parlare perfettamente l'albanese nella sua varietà dialettale ghega, ma nel tempo divenne uno dei principali studiosi della storia, della lingua, della cultura, delle istituzioni sociali

e giuridiche dell'Albania. I suoi studi, in ispecie quelli dedicati alle istituzioni giuridiche, costituiscono ancora oggi il più avanzato studio raggiunto in questo settore della ricerca albanologica.

Il Valentini, pur assicurando piena continuità alla impostazione didattica e scientifica che il Petrotta impresse alla Cattedra di lingua e letteratura albanese di Palermo, apportò preziose e proficue innovazioni, prima fra tutte quella relativa alla creazione di organismi che affiancarono la cattedra e che, nello stesso tempo, consentirono un più agile ed efficace collegamento con il retroterra culturale rappresentato dalle colonie albanofone d'Italia. Coadiuvato dal fratello del suo predecessore, il deputato regionale Rosolino Petrotta, il Valentini mise mano ad un'opera di potenziamento delle strutture universitarie, a quei tempi ancora del tutto inadeguate, che permise da un lato di elevare l'istituto di Lingua e Letteratura albanese al rango di centro propulsore dell'attività didattico-scientifica e dall'altro di proporlo all'attenzione degli studiosi, soprattutto palermitani, quali i sullodati proff. Cocchiara, Di Stefano, Lavagnini, che già da tempo sostenevano con entusiasmo e determinazione le iniziative promosse dalla Cattedra di lingua e letteratura albanese. In questo periodo di fervore Rosolino Petrotta e Giuseppe Valentini istituirono il "Centro Internazionale di Studi Albanesi", la cui fondazione era stata auspicata dal I Convegno di Studi Albanesi ed il cui ruolo sarebbe divenuto insostituibile negli anni a venire sia per i puntuali congressi scientifici che organizzò sia per aver stimolato la promozione culturale nelle comunità albanesi di Sicilia.

Per documentare l'attività di ricerca e di studio del prof. Valentini si richiederebbe uno spazio più ampio, giacché tali e tanti furono i suoi interessi e numerose le sue pubblicazioni. Ci limitiamo a segnalare, fra i suoi più cospicui e principali studi, *La declinazione determinata e indeterminata in albanese* (in Ricerche linguistiche dell'Università di Roma, 1952 e 1954), *Sviluppi onomastico-toponomastici tribali delle comunità albanesi in Sicilia* (in Bollettino del Centro di studi filologici e linguistici siciliani, III, Palermo, 1955), *Polifonia e contrappunto dei dialetti albanesi* (in Communications et rapports du Ier Congrés International de Dialectologie géneral, Louvain, 1964), *La famiglia nel diritto tradizionale albanese*, *Il diritto delle comunità nella tradizione giuridica albanese. Generalità*, parte I (Firenze, 1956), nonché i 25 volumi della serie *Acta Albaniae Veneta* che raccolgono i documenti relativi all'Albania dell'epoca di Skanderbeg tratti dagli Archivi della Repubblica di Venezia.

Seguendo le orme del Petrotta, il Valentini insegnò la grammatica albanese descrivendo la sua evoluzione storica e le sue articolazioni dialettali, ivi

comprese quelle delle colonie albanesi d'Italia. Per offrire agli studenti una migliore e più chiara rappresentazione di tali complessi aspetti della lingua albanese, soleva commentare e tradurre i classici della letteratura albanese, dalle opere in ghego del Fishta, che egli conosceva perfettamente, di Bernardino Palaj, di Ndre Mjeda, a quelle in tosco di Frashëri, De Rada, Schirò. Forte della sua ampia e sicura padronanza di tutti gli aspetti scientifici e culturali dell' albanologia e sostenuto dalla generale ammirazione di colleghi e studenti, il Valentini fu relatore di oltre 50 tesi di laurea, ognuna delle quali costituisce una prova della straordinaria versatilità scientifica e della più varia ricerca pluridisciplinare che caratterizzarono il periodo della sua direzione della Cattedra di lingua e letteratura albanese di Palermo.

La carriera universitaria del prof. Valentini iniziò, come si è accennato, nel 1952, quando gli fu conferito lo straordinariato di lingua e letteratura albanese, che nel 1955 divenne ordinariato. Quasi contemporaneamente ricevette per alcuni anni l'incarico di Filologia Bizantina e, per altri anni, l'incarico di Letteratura Cristiana Antica. Nel 1970 andò fuori ruolo, nel 1975 in pensione.

Dal 1976 ad oggi la Cattedra di lingua e letteratura albanese è stata diretta da chi scrive. In questi due decenni, pur essendo stata assicurata continuità didattica e scientifica alla impostazione data dal Petrotta e dal Valentini, sulla base delle radicali innovazioni intervenute nel frattempo, si è proceduto verso un ulteriore allargamento degli ambiti della ricerca, ad una più rigorosa organizzazione della didattica, alla creazione di una più vasta rete di collegamenti e di scambi culturali con altri centri universitari italiani e stranieri.

In considerazione del fatto che l'insegnamento della lingua e della letteratura albanese - in particolare a partire dalla seconda metà degli anni '70 – aveva ricevuto un impulso notevole, soprattutto grazie alla attività degli importanti istituti di ricerca sorti in Albania, anche gli studi albanologici in Italia ed in Europa si caratterizzarono ulteriormente mediante l'elaborazione e l'attuazione di progetti interdisciplinari. A tali obiettivi contributi la Cattedra di lingua e letteratura albanese di Palermo, in ciò inserendosi nel solco della tradizione che la distingueva, attraverso un'attività che abbracciava diversi settori della ricerca albanologica, e precisamente:

1) quello dialettologico (indagini e descrizioni delle parlate albanesi di Sicilia, costituzione di un archivio sonoro, partecipazione alla stesura dell'Atlante dialettale delle parlate italo-albanesi);

2) quello socio-linguistico (indagini sulle comunità albanofone interessate al cosiddetto fenomeno "della diaspora nella diaspora");

3) quello storico-sociale (ricerche archivistiche sulla storia degli insediamenti siculo-albanesi);

4) quello letterario (analisi critica dei maggiori autori della letteratura italoalbanese);

5) quello linguistico-letterario (trattamento informatico dei testi letterari finalizzato alla stesura di un dizionario storico della lingua letteraria italoalbanese);

6) filologico (studio, trascrizione e traslitterazioni dei testi in lingua albanese delle comunità arbëreshe);

7)socio-antropologico (indagini sincroniche e diacroniche sulle strutture sociali e e antropologiche che caratterizzano le comunità albanesi di Sicilia).

Ognuno di questi settori ha richiesto specifiche competenze che potevano essere assicurate soltanto dagli esperti che già da tempo si curavano di tali problematiche e che, pertanto, occorreva coinvolgere nella realizzazione dei suddetti progetti. Da questa preliminare esigenza è nata l'intensa attività che ha registrato, nel volgere di un ventennio:

a) l'organizzazione di 20 Congressi Internazionali di Studi Albanesi, puntualmente seguiti dalla pubblicazione dei volumi dei relativi Atti, unanimemente considerati come primarie fonti per chi intenda occuparsi di albanologia;

b) la istituzione di dottorati di ricerca in Albanologia, che hanno proficuamente e validamente favorito la specializzazione nella ricerca linguistica e letteraria di giovani ricercatori, quasi tutti italo-albanesi;

c) la costante e intensa attività di scambio di esperienze e di conoscenze con altri centri di ricerca esistenti in altre Università italiane (Padova, Pisa, Firenze, Cosenza, Bari) ed europee (Monaco di Baviera, Innsbruck, Costanza), oltre che con i centri di ricerca d'Albania, precisamente con l'istituto di Linguistica dell'Accademia delle Scienze e con la Facoltà di Storia e Filologia dell'Università di Tirana e, nonostante le note difficoltà politiche, con l'Accademia delle Scienze e della Arti della Kosova.

Da questa attività sono scaturiti risultati assai importanti e significativi, anche grazie al potenziamento delle strutture di cui già disponeva la Cattedra di lingua e letteratura albanese di Palermo, in particolare l'arricchimento della Biblioteca, il cui fondo di dotazione non è solo cospicuo, ma anche prezioso; all'acquisizione di mezzi e supporti informatici; alla pubblicazione di un "Quaderno dell'istituto di lingua e letteratura" albanese dal titolo *Albanica*, del quale

sono già apparsi 10 numeri.

Nel frattempo sono stati particolarmente curati i rapporti con le Amministrazioni comunali e con gli enti culturali delle comunità albanesi di Sicilia, comprese quelle non più albanofone, con le quali la Cattedra ha instaurato proficui rapporti di collaborazione, giungendo in molti casi alla realizzazione di iniziative culturali ed editoriali di grande importanza scientifica. Ci limitiamo qui a menzionare come esempio, l'edizione critica, curata dal mio allievo Matteo Mandalà, del manoscritto *Il codice chieutino* che documenta la parlata albanese della comunità albanofona di Mezzojuso – parlata ormai scomparsa da oltre due secoli e che è stata pubblicata grazie al sostegno, non solo finanziario del Comune di Mezzojuso, che in tal modo ha voluto partecipare alla valorizzazione della propria identità storico-culturale. Di grande signifycato sono stati i corsi di lingua albanese promossi e realizzati nei vari comuni siculo-albanesi, al fine di scongiurare la minaccia della perdita della competenza linguistica degli albanofoni.

Un punto di forza strategico della politica accademica e scientifica è stato costituito dal forte e adamantino sodalizio con la cattedra di Lingua e Letteratura Albanese dell'Università della Calabria diretta dal fraterno amico prof. Francesco Solano, con la quale sono stati elaborati importanti progetti di collaborazione e di mutuo scambio culturale. Insistendo sulle due regioni dell'Italia meridionale più densamente abitate dagli albanofoni della immigrazione storica, le due Cattedre hanno rivolto uno sguardo costante alla realtà delle nostre comunità, mostrando nei loro riguardi un costante e incisivo interesse, vuoi di natura scientifica vuoi di concreto sostegno alle politiche di tutela promosse dalle istituzioni locali (Comuni, Scuole, Chiesa locale). Di grande interesse per il futuro sono i grandi progetti che mirano al recupero e alla documentazione linguistica, alla creazione di importanti e inalienabili monumenti alla memoria storico-culturale, alla reinterpretazione dei miti e dei simboli che corredano la preziosa eredità antropologica delle comunità albanesi d'Italia. L'impegno delle due cattedre costituisce un valido modello per il futuro della ricerca scientifica e, dati i risultati finora raggiunti e, soprattutto, date la costanza e la qualità che garantiscono i nostri allievi, mi sorride l'idea di intravedere un futuro molto più sereno per l'albanologia.

Lumnije JUSUFI (Berlin)

GELEHRTE ZWISCHEN WISSENSCHAFT UND POLITIK. AM BEISIEL VON ERNEST(O) KOLIQI (1903-1975)

0. Einleitung

Ernest Koliqi oder Ernesto Koliqi gilt heute als einer der wichtigsten Vertreter der albanischen Literatur der Diaspora und Begründer der Auslands-Albanologie. Mit seinem Doppelnamen, Ernest auf Albanisch und Ernesto auf Italienisch, steht er auch für eine kultur-sprachlichen Bivalenz der Diaspora, die als solche in den nationalen Ansprüchen nicht betrachtet wird. Ernest Koliqi steht aber auch als bestes Beispiel für die Verflechtung zwischen Wissenschaft und Politik, wie auch seine gesamte Generation des jungen albanischen Staates in der ersten Hälfte des 20. Jahrhunderts. So eine Verflechtung hat kürzlich Kurt Gostenschnigg in Bezug auf die österreichisch-ungarische Albanologie erforscht.[1] Andere ähnliche Untersuchungen gibt es nicht.

Der Artikel baut auf folgende Forschungsfragen auf: Wie kommen Wissenschaftler auf politische Rollen und Funktionen? Was sind ihre Ziele? Und wie geht die Gesellschaft und die nachfolgenden Generationen mit solchen Rollen um? Solche Fragen sind zunächst eng mit der Biographie der ansprechenden Person, mit ihrem wissenschaftlichen Werdegang und den Scherpunkten ihrer wissenschaftlichen Tätigkeit verbunden.

Die Schwierigkeit einer möglichst detaillierten und authentischen Darstellung der Person Koliqi drückt am besten das folgende Zitat von Peter Bartl aus:

> Die Verschiedenartigkeit seiner Tätigkeitsgebiete und die vielfachen, teils freiwilligen, teils erzwungenen Ortsveränderungen machen es schwierig, Koliqis Biographie en detaille zu verfolgen. Sein Lebenslauf ist charakteristisch für die Intelligenzschicht des 1912 entstandenen albanischen Staates: Die wechselnden politischen Verhältnisse in Albanien und die Unmöglichkeit, im Heimatland eine höhere Ausbildung zu erhalten, zwangen zu längeren, manchmal ständigen Auslandsaufenthalten, zumeist in Österreich, Italien oder Frankreich. Zu einer Entfremdung gegenüber dem eigenen Volk führten dieses jedoch nicht, Koliqi ist ein bezeichnendes Beispiel dafür.[2]

---

[1] Gostenschnigg, Kurt (2017): W*issenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*. Berlin.

[2] Bartl, Peter: *Ernest Koliqi zum 70. Geburtstag.* In: *Südost-Forschungen* 32. S. 321-322. München 1973. S. 321.

Hinzu kommt noch Schwierigkeit der Zielsetzung dieses Artikels, nämlich die Hinzuziehung der politischen Tätigkeit Koliqis als Bildungsminister und Leiter des Instituts für Albanische Studien in Albanien zu Zeiten der italienischen Besatzung. Die Schwierigkeit dieser Darstellung ist mit drei Punkten verbunden:

1. Der wissenschaftliche Koliqi ist vom politischen Koliqi nicht zu trennen.
2. Koliqi bekleidete den Posten eines Ministers unter dem faschistischen Italien.
3. Dieser "faschistische" Fleck war für die Erforschung seiner Person und seines Schaffens lange wichtiger gewesen ist als seine wissenschaftliche und literarische Tätigkeit.

Die Basis dieses Artikels bilden zwei kurze Artikel von P. Bartl und P. T. Vuçani sowie eine ganze Nummer von *Shêjzat (Le Pleiadi)*, die Koliqi gewidmet wurde, sowie einige Artikel von Koliqi selbst. Weiterhin wird versucht, Koliqi in den politischen Ereignissen Albaniens zu suchen.

1. Koliqi im Chaos des posttürkischen Albaniens

Koliqi wurde am 20. Mai 1903 in Shkodra (Shiroka) geboren. Da er 1910 die zweite Klasse im *Collegio S. Francesco Saverio* in Shkodra besuchte, darf angenommen werden, dass er 1908, mit fünf Jahren eingeschult worden ist. Schon in seiner Kindheit zeichnete er sich im Lesen und Schreiben aus.

Im Frühjahr 1911 kam es in Albanien zu lokalen Empörungen gegen die Zentralpolitik der jungtürkischen Regierung. In Shkodra war die Situation besonders kritisch. Die Empörungen steigerten sich in Shkodra zum Aufstand auf, inszeniert zum größten Teil von Katholiken. Es kam zu blutigen Auseinandersetzungen die bis August andauerten. Die Aufständischen waren dabei erfolgreich, und im August desselben Jahres kam es zur Einigung zwischen den Aufständischen und der Regierung.[3] Aufgrund dieser Unruhen von 1911 wurde der junge Ernesto zusammen mit seinem Bruder Dom Mikeli von seiner Familie zum *Collegio Arici* in Brescia in Italien geschickt.[4] Die Balkankriege und der Erste Weltkrieg zwangen ihn lange in Italien zu bleiben. In der Zeit perfektionierte er sein Italienisch, das später seine zweite Muttersprache werden sollte, vergaß aber seine erste Muttersprache fast gänzlich.[5] Im Jahre 1918 gründete er zusammen mit anderen Studenten die Zeitschrift *Noi Giovani*, in der seine ersten Gedichte in italienischer Sprache zu finden sind, d. h. im Alter von 15 Jahren.

---

[3] Bartl, Peter: Albanien. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart. Regensburg 1995. S. 124ff.

[4] Koliqi, Ernest: Dy shkollat letrare shkodrane. E Etënvet jezuitë dhe e Etënvet françeskanë. In: Shêjzat (Le Pleiadi). Nr. 17/9-12. Romë 1973.

[5] Ebd., S. 374.

Am 9. November 1921 erkannte die Botschafterkonferenz in Paris Albanien als unabhängigen Staat mit den Grenzen von 1913 an, mit einigen kleinen Veränderungen. Die Innenpolitik aber war verworren wie nie zu vor. Seit dem Kongress von Lushnja (28. Januar 1920) hatten acht Regierungen ihr Glück versucht, in Albanien Ordnung bzw. Macht herzustellen. Trotz dem Durcheinander ließen sich dabei zwei Monopole erkennen:

> 1. Die Großgrundbesitzer des Süd- und Zentralalbaniens sowie die nordalbanischen Stämme, welche die Wiederherstellung der alten Privilegien anstrebten und 2. bürgerliche und protobürgerliche Gruppen aus den Städten und der Diaspora, die für die Änderung der sozioökonomischen Verhältnisse kämpften.[6]

In diesem Chaos (1921) kehrte Koliqi aus seinem langen italienischen Aufenthalt nach Albanien zurück, wo er sich der albanischen Sprache erneut widmete. Dem Journalismus und der Dichtung blieb er aber treu, unter der Obhut von Luigj Bumçi[7], der ihn mit einigen Aktivisten für die albanische Kultur im Shkodra-Kreis bekannt machte, wie Kolë Thaçi (1886-1941), Kolë Kamsi (1886-1960), Lazër Shantoja (1892-1945) und Karl Gurakuqi (1895-1971). In diesem chaotischen Zustand hatte Albanien einen frischen geistigen Wind nötig. Als einer in Italien, d. h. im Westen, ausgebildeter junger Mann, sah sich Koliqi verpflichtet und geeignet, etwas in die Richtung zu unternehmen. 1923 gründete er mit P. Anton Harapi (1888-1946) und Nush Topalli die Zeitschrift *Ora e maleve* ('Der Geist der Berge'), ein Organ der oppositionellen Katholischen Demokratischen Partei in Shkodra.[8] Durch die in dieser Zeitschrift gesammelten schriftstellerischen Erfahrungen und unter dem Einfluss der zeitgenössischen Schriftsteller, wie Gjergj Fishta (1871-1940), Luigj Gurakuqi (1879-1925), Mid'hat Frashëri (1880-1949) und Fan Noli (1882-1965), zu denen er Kontakt hatte, hielt sich nun der junge Koliqi für reif, ein größeres und selbstständiges Werk zu versuchen. 1924 veröffentlichte er in Tirana sein Erstling, die dramatische Dichtung "Kushtrimi i Skanderbeut" ('Skanderbegs Kriegsruf').

2. Koliqi und das Zogu-Regime

In Folge einer vorgeschlagenen Agrarreform eskalierte die Situation im Juli 1924 so sehr, dass die Opposition das Parlament verließ und zusammen mit

---

[6] Habibi, Anila: *Das autoritäre Regime Ahmed Zogus und die Gesellschaft Albaniens 1925-1939*. In: Oberländer, Erwin (Hrsg.): *Autoritäre Regime in Ostmittel- und Südosteuropa 1919-1944*. Paderborn 2001. S. 351f.

[7] Luigj Bumçi (1872-1945) war Vorsitzender der albanischen Delegation bei der Friedenskonferenz von 1919 in Paris.

[8] Elsie, Robert: *Histori e letërsisë shqiptare*. Pejë 2001. S. 329.

Offizieren und Bauern von Vlora nach Tirana marschierte. Zentren der "Revolution" waren Shkodra im Norden und Vlora im Süden. Die Regierung und die Großgrundbesitzer verließen das Land. Die "Revolutionäre" bildeten eine "bürgerlich-liberale" Regierung, waren aber dennoch nicht in der Lage für Ruhe und Ordnung zu sorgen. Höchstwahrscheinlich war die Gruppe, welcher Koliqi angehörte, auf der Seite der Revolutionären, da die Zeitschrift *Ora e Maleve* mit Ahmet Zogus (1895-1961) Machtübernahme im Dezember 1924 eingestellt wurde[9] und Koliqi, wie viele andere albanische Intellektuelle und die "Revolutionäre", sah sich gezwungen, das Land zu verlassen. Er ging nach Jugoslawien. Drei Jahre verbrachte er dort, zunächst in Montenegro, später in Tuzla. Auch hier, wie in Italien, machte er sich mit der Sprache und Lebensweise des Landes vertraut. 1929 ging er in die albanische Kolonie Zadar und veröffentlichte dort die Novelle *Hija e maleve* ('Der Schatten der Berge'), welche ihn zum Schöpfer der albanischen Novelle machte.

Am 7. März 1925 gelang es Zogu eine neue Verfassung zu verkünden. Zogu erkannte Italien als "Schutzmacht" an. Durch den Tirana-Pakt vom November 1926 wurde Albanien de facto zum italienischen Protektorat. Dies passte Zogu nicht ganz, blieb ihm aber nichts anderes übrig, denn ohne Italien wäre er dem Posten schneller los als er ihn bekam. Nachdem sich Zogu 1928 zum König der Albaner proklamierte, nahm er sich die Schaffung von neuen staatlichen Institutionen vor, für die es Vorbilder mehr als genug gab, aber keine gut ausgebildeten Arbeitskräfte, die diese an Albanien anpassen konnten. Man hielt eine Transformation für nötig, man wollte die Vergangenheit ruhen lassen, sich vom Osten nach Westen wenden und sich Europa nähern. Aus diesem Grund versuchte Zogu die exilierten "Revolutionäre" durch verschiedene Amnestien nach Albanien zu holen. Viele kehrten auch zurück und darunter auch Koliqi im Jahre 1930. In den drei Jahren Heimataufenthalt arbeitete er als Lehrer für albanische Literatur in Vlora und Shkodra. Durch seine Schulausbildung im Jesuitenkolleg und in Italien bedingt, gab er sich die Aufgabe eines kulturellen Vermittlers zwischen Albanien und Italien. Sein im Jahre 1932 veröffentlichtes

[9] Als ihre Nachfolgerin verstand sich die im Jahre 1928 in Wien herausgegebene Zeitung *Ora e Shqipnisë* unter der Leitung von Dom Lazar Shantoja. Sie charakterisierte sich als politisches Blatt gegen das Regime von Zogu. (Vgl. Körner, Christine: *Der Beitrag der Exilblätter "Ora e Shqipnisë" und "Bashkimi Kombëtar" zur Verbreitung des Gedankens der nationalen Einheit*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978. S. 188).

Werk *Poetët e mëdhenj t'Italis* (‚Die großen Dichter Italiens')[10] ließ die italienischen klassischen Autoren albanisch sprechen und machte sie dadurch für den Albanischleser zugänglich. 1933 kam sein Gedichtband *Gjurmat e stinve* ('Die Spuren der Jahreszeiten') heraus.

An der Wende von den 1920-ern zu den 1930-ern lebte die Kultur in Albanien wieder auf. Die im Ausland ausgebildeten Albaner, die sich als "die Jungen" oder "Neoalbaner" nannten, wurden eingesetzt. Die Zeitschrift *Illyria*, die von Avni Rrustemi gegründet worden war, verstand sich als *das* Organ der Jungen. Darin war auch Koliqi tätig. Eine neue Unterteilung der Gesellschaft zwischen "den Jungen" und "den Alten" war die Folge. Der Gegensatz wurde immer größer und die Situation immer spannender, bis König Zogu am 21. Oktober 1935 das "Kabinett der Nationalen Jugend" ernannte.

Der Preis aber für die Rückkehr der "Revolutionären" war der Verzicht auf die eigenen politischen Ziele und die Abfindung mit dem neuen Regime. Man passte sich entweder an, oder man wurde für immer mundtot gemacht, oder man floh wieder. Zogu wollte seinen Posten immer mehr monopolisieren, darunter auch das Schulwesen. Sein Ziel war eine Eindämmung des ausländischen (vor allem des italienischen und griechischen) Einflusses. In diesem Zuge wurden 1933 alle Privatschulen geschlossen, die italienischen und die der Religionsgemeinschaften miteinbezogen.11 Genau in diesem Jahr verließ Koliqi Albanien. Wahrscheinlich wurde ihm der Freiraum immer kleiner und der Kreis der Jungen immer radikaler.

Er schrieb sich an der Universität von Padova ein. 1936 wurde er dort Lektor für albanische Sprache. Ein Jahr später schloss er seine akademischen Studien mit dem Thema *L'Epica popolare albanese* ab. Auch hier fiel seine Rolle als Kulturvermittler auf; den Italienischlesern bot er auch ein Stück albanische Kultur an. Die Arbeit fand große Aufmerksamkeit bei den deutschen Albanologen Norbert Jokl (1877-1942) und Maximilian Lambertz (1882-1963). In die andere Richtung arbeitet er weiterhin. 1936 wurde der zweite Band von *Poetët e mëdhenj t'Italis* ('Die großen Dichter Italiens')[12] veröffentlicht. Herausgeber war der italienische Albanologe Carlo Tagliavini (1903-1983), mit einer Kritik vom albanischen Schriftsteller dieser Zeit Ndre Mjeda (1866-1937). Koliqi hat auch an einem dritten Band gearbeitet, konnte ihn aber aus unterschiedlichen Gründen

[10] Dieser Band umfasst die Zeit von Dante bis Tasso.
[11] Bartl, Peter: *Albanien*. S. 215.
[12] Dieser Band umfasst die Zeit von Parini bis Manzoni.

nicht veröffentlichen. Teile davon sind in den verschiedenen Zeitschriften erschienen. Nach diesen hervorragenden Studien ist es nicht verwunderlich, dass er im Oktober 1937[13] nach Rom als Lektor für albanische Sprache berufen wird, um ein Jahr später dort den neu gegründeten Lehrstuhl für albanische Sprache und Literatur zu erhalten.

Trotz der "diplomatischen" Bemühungen Zogus geriet Albanien wieder in Unruhen. Das Zogu-Regime scheiterte somit zunächst im Inland und mit der Errichtung des italienischen Protektorats setzte Italien ihm das endgültige Ende. Am 7. April 1939 besetzte Italien Albanien, nachdem Zogu einen Beistandspakt abgelehnt hatte. Zogu verließ daraufhin das Land, zusammen mit seiner Familie und einem Teil seiner Minister. Nach wenigen Wochen war Albanien Italien ganz eingegliedert. Koliqi, als sehr guter Kenner beider Kulturen, erfüllte die besten Voraussetzungen, den Stand der Kultur voranzutreiben. Dies erkannte auch die Politik, und ernannte Koliqi 1939 zum Unterrichtsminister Albaniens. Dieser Posten sollte nicht der Höhepunkt seiner Karriere sein. Im Gegenteil, Koliqi nahm dies zum Anlass, sein Wissen in einem neuen Gebiet einzusetzen, in dem des Unterrichtens, ein Gebiet, der im albanischen Siedlungsraum großen Nachholbedarf hatte. Es fehlte an Unterrichtsmaterial und –personal, ein Vorhaben, das für einen einzigen Menschen unmöglich zu bewältigen war. Koliqi gründete eine Arbeitsgruppe von ausgewählten Forschern und Schriftstellern jener Zeit, und leitete sie nach bestem Wissen und Gewissen. Als Ergebnis dieser Zeit zeigte sich eine Vielfalt von Aktivitäten. Unter der Initiative von Koliqi wurde 1940 in Tirana ein Kongress für albanische Studien organisiert, der Vorläufer von *Instituti i Studimevet Shqiptare* ('Institut für albanische Studien'). Die Reihe *Studime e tekste* ('Studien und Texte') hatte ihren Ursprung bei diesem Institut. 1941 wurde in Tirana die zweibändige Anthologie Shkrimtarët shqiptar ('Die Albanischen Schriftsteller') veröffentlicht. Die Folklorensammlung Visarët e kombit ('Die Schätze der Nation'), von denen bis dahin nur drei Bände erschienen waren, erreichte unter der Leitung von Koliqi eine Erweiterung von 14 Bänden; ein Werk, das bis heute nicht überholt worden ist.

Am 6. April 1941 griff Deutschland Jugoslawien und Griechenland an. Nach wenigen Tagen kapitulierten beide. Am 20. April wurden die eroberten Gebiete in Besatzungszonen eingeteilt. Der größte Teil Kosovos, Westmakedonien und der albanisch besiedelte Teil Montenegros kamen an Italien, Rest-

[13] Koliqi, Ernest: *Migjeni dhe unë*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 15/7-9. Romë 1971. S. 83, Anmerkung (2).

makedonien und Teile von Kosovo an Bulgarien und Nordkosovo an Deutschland. Am 12. August 1941 vereinigte Italien alle albanisch besiedelten Gebiete. Nach dieser Vereinigung folgten einige Schulreformen, besonders im ehemals jugoslavischen Teil, in denen vorher keine albanische Schule gab und über 90% der Bevölkerung Analphabeten waren. In den Jahren 1941/42 wurden ca. 200 Lehrkräfte für die Grundschulen in Kosovo bereitgestellt. Am 12. Dezember 1941 wurde das erste albanische Gymnasium (Oberstufe) in Prishtina eröffnet, dann folgten viele Grundschulen nicht nur in Kosovo, sondern auch in Ulqin, Tetovo und Dibra, Mittelschulen in Prizren, Gjakova, Peja, eine landwirtschaftliche Berufsschule in Tetova, eine Berufsschule für Teppichweben in Prishtina und ein Internat für ca. 200 Studenten mit staatlichem Stipendium ebenfalls in Prishtina. Vielen Studenten aus Kosova wurden Stipendien für ein Auslandstudium in Italien und Österreich ermöglicht. Material, Personal und Geld wurden vom Unterrichtsministerium Albaniens übernommen.[14]

Sein größtes Verdienst in dieser Zeit ist die Bemühung um die Rettung des schon erwähnten Albanologen Norbert Jokl, den er im Dezember 1937[15] in Wien persönlich antraf. Jokl sollte wegen seiner jüdischen Herkunft nach Polen deportiert werden. Er wurde vom Ministerpräsidenten Shefqet Vërlaci[16] auf Forderung von Koliqi zum "Organisator der albanischen staatlichen Archive und Bibliotheken"[17] ernannt, um somit der Deportation zu entkommen. Der Versuch scheiterte. Jokl kam mit dem Deportationszug, der aus einer Brücke stürzte, um.[18]

1942 heiratete er die Lehrerin Vangjelja Vuçani, mit der er zwei Kinder, Marco und Elisabetta, bekam. Im selben Jahr verließ er das Unterrichtsministerium und wurde zum Leiter des Instituts für Albanische Studien in Tirana ernannt. Diesen Posten bekleidete er bis 1943. In der Zeit arbeitete er mit den bedeutendsten Persönlichkeiten der albanischen Forschung zusammen, wie Asdreni, Lasgush Poradeci, Aleksandër Xhuvani u. a.

3. Koliqi und die albanische Nachkriegsdiaspora

---

[14] Krasniqi, Rexhep: *Ernest Koliqi dhe zhvillimi letrar në Kosovë*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

[15] Koliqi, Ernest: *Tue bisedue me Prof. Joklin*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 16/1-4. Romë 1972. S. 87.

[16] Vorsitzender des albanischen Ministerrates.

[17] Koliqi, Ernest: *Tue bisedue me Prof. Joklin*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 16/1-4. Romë 1972. S. 87.

[18] Ebd.

Bereits im Jahre 1943 zeigten sich für Italien viele Schwierigkeiten in Albanien, bedingt durch den wachsenden Partisanenkampf und den militärischen Niederlagen Italiens. Mit dem Sturz Mussolinis am 8. September 1943 kapitulierte Italien vor den Alliierten. Danach wurde Albanien von Deutschland besetzt. Mit dem Ankommen der deutschen Truppen in Albanien, ging Koliqi wieder nach Rom zurück, wo er wieder den früheren Posten als Professor für albanische Sprache und Literatur in Rom übernahm.

Mit der Räumung Shkodras am 29. November 1944 verließen die letzten Verbände der Wehrmacht Albanien. Schon ein Tag vorher waren die kommunistischen Truppen symbolisch in die bereits am 17. November eroberte Hauptstadt Tirana eingezogen. Somit kam Albanien endgültig in die Hand der kommunistischen Sieger.[19]

Koliqi traf das Schicksal aller antikommunistischen Intellektuellen. Er sollte nie mehr ein Fuß in seine Heimat setzen. Trotz alledem hörte er nicht auf für und über sein Land zu arbeiten. Es folgten zahlreiche wissenschaftliche Artikel und Veröffentlichungen, darunter: *Kangjelet e Rilindjes* ('Lieder der Wiedergeburt') (1959), *Rapsodi e rapsodie delle Alpi Albanesi* (1961), *Antologia della lirica albanese* (1963), die Monographie *Albania* (1965) und *Saggi di literatura albanese* (1972). Weiterhin übersetzte er Teile aus der albanischen Literatur, hauptsächlich der nordalbanischen ins Italienische. Der Belletristik bliebt er weiterhin treu, wobei er in zahlreiche Prosa und Poesien sein Heimweh zum Ausdruck brachte und dem Westen ein Überblick über das Leben in den Bergen Nordalbaniens verschaffte.

Es darf nicht unerwähnt bleiben, dass er als Wissenschaftler, Professor und Liebhaber der albanischen Kultur zu tragender Säule der albanischen Diaspora wurde. Mit der Gründung 1957 der Zeitschrift *Shêjzat (Le Pleiadi)* und 1965 der Reihe *Studi Albanesi* schaffte er den Versammlungsort aller Ideen und Bemühungen aller Albanologen außerhalb des Balkans, ungeachtet auf welchem Gebiet. Oder um es auf die metaphorische Art der Überschrift der Zeitschrift auszudrücken, schaffte er *Shêjzat (Le Pleiadi)*, die Sternenversammlung des Siebengestirns. Einer seiner Schüler, Freund und engster Mitarbeiter war der wichtigste Vertreter der albanischen Exilliteratur der Nachkriegszeit und Begründer der Albanologie in München, Martin Camaj, bei dessen literarischem Schaffen Spuren des Stils von Koliqi zu finden sind.[20]

Schließlich leistete Koliqi wesentlichen Beitrag in der Bewahrung und

---

[19] Bartl, Peter: *Albanien*. S. 239.

[20] Xhyra-Entorf, Jonida: *Soziokulturelle Aspekte bei Martin Camajs Prosawortschatz*. Wiesbaden 2006.

Erforschung der italoalbanischen Kultur, die bis dahin von der albanischen Forschung schwer vernachlässigt worden war. Er bildete in Rom italoalbanische Studenten aus, die nach ihrem Abschluss zurück in ihre Dörfer kehrten, um dort für ihre Kultur tätig zu sein, sei es in Schulen, Kulturvereinen oder Zeitschriften.[21]

4. Folgen seiner politischen Tätigkeit

4.1. Zur Lebezeiten von Koliqi

Am 15. Januar 1975 starb Koliqi in seiner Wohnung in Rom. Drei Tage später wurde er in Rom beigesetzt. Zu seiner letzten Ruhestätte begleiteten ihn Freunde, Kollegen, große Persönlichkeiten und einfache Menschen aus der ganzen Welt.

> Der Vater und beispielloser Bruder, Freund und Meister der vielen von uns und eine der Säulen der albanischen Literatur wurde weit weg von der Heimat bestattet. Dieser Gedanke lastete noch schwerer als jemals zu vor im Kopf und im Herzen der Vorhandenen genau in dem Moment, als der Leichnam von Ernest Koliqi sich der Öffnung des Grabes näherte.[22]

Das Heimweh, das die Hinterbliebenen erst jetzt spürten, muss Koliqi jahrelang mit sich herumgetragen haben, ausgedrückt in vielen literarischen Werken von ihm. Dies kann am besten durch die Sprache von ihm selbst dargestellt werden, beispielsweise im nachfolgenden Gedicht:

***Shko ti* ... Geh du ...**

Mbasi qi stina rrshet tatpjetë	Da die Jahreszeit hinabgleitet
e fort un tutem se atdheun n'këtë jetë	und ich fürchte mich sehr, dass ich die
me sýt adhruesa,	[Heimat in diesem Leben
qi pajadá	mit den bewundernden Augen, die das Feuer
i a çmuene hirin,	ihnen die Asche bewundert,
s'kam për ta pá	nie sehen werde
shko ti, lum bija, n'at Shkodrën t'ime	geh du, meine Tochter, zu dieser Shkodra von mir
kúr n'terr do t'sosem	wo ich in der Dunkelheit enden werde
me trup e andrrime:	mit Leib und Träume:
atjè si t'gjindesh, sýt e mij n'ball	sobald du dich dort befindest, meine Augen im Kopf
t'andin do t'hapen:	in deinen aufgehen werden:
n'tý kam m'u ngjáll	in dir werde ich wiederbelebt werden.
Për mue ti Shkodrën	Für mich meine Shkodra,

[21] Fortino, Italo C.: *Ernest Koliqi dhe Arbëreshët e Italisë.* In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

[22] "Ati dhe vëllai i pa shoq, miku dhe mjeshtri i shumëvet prej nesh dhe nji ndër shtyllat e letërsisë shqipe po vorrosej larg Atdheut. Ky mendim peshoi ma rande se kurr në krye dhe në zemrat e të pranishëmvet shí në atë moment kur kufoma e Ernest Koloqit u ul te gryka e vorrit." (Camaj, Martin: *Vorrimi i prof. Ernest Koliqit*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978. S. 317).

për mue sodite;	für mich betrachte;
mallin,	die Sehnsucht,
e sjellun dhe n'vorr,	mitgebracht im Grab,
shafite.	mildere.
Shkodra me shpija ndrŷ n'avllija	Shkodra mit Häusern, eingeschlossen in Hofmauern,
t'qetat oborre plot land' shatorre,	die ruhigen Höfe voller Gegenstände und Laubdächer,
kumbulla e manda, pjergulla e tanda	Pflaumen und Maulbeeren, Weinlaube und Laubhütten,
sodit me at afshin qi kishe un gjáll	-betrachte mit dieser Leidenschaft, die ich lebend hatte
me mall t'im n'zemër,	mit meiner Sehnsucht im Herzen,
me sý	mit den Augen
t'mij	meinen
n'báll.[23]	auf der Stirn.[24]

Zwar verbüßte Koliqi nicht die physische Strafe, wie seine zeitgenössischen Kollegen nicht nur in Albanien, aber seine war auch nicht milder, wenn nicht härter.

4.2. Nach dem Tod von Koliqi

Auch nach seinem Tod sollte er zum Hassobjekt des kommunistischen Albaniens werden. Das Land, für das er sein ganzes Leben lang gearbeitet hatte, lehnte ihn ab und beschimpfte ihn in den übelsten Ausdrucksweisen. Die Geschichte der albanischen Literatur[25] verweigerte Koliqi nicht nur seine wohlverdiente Anerkennung als Schöpfer der albanischen Novelle, sondern beleidigte ihn mit den härtesten Worten:

> […] *eine Gruppe von Profaschisten und Faschisten mit dem Verräter Ernest Koliqi an der Spitze.*[26] *[…] einige klerikale Autoren des Nordens und Bourgeoisen der zeitgenössischen Literatur, die das Bergleben idealisierten oder illustrierten* (*Fishta, Koliqi usw.*)[27]

Die Literaturgeschichte Prishtinas von 1989 gab die von Tirana ohne Veränderungen heraus und leider auch die Meinung über Koliqi, in der Stadt, die Koliqi die erste Oberstufe zu verdanken hat. Aber zum Glück erlebte Koliqi es nicht mehr.

Nach der Wende in Albanien hat sich Koliqis Bild zum positiven

---

[23] Koliqi, Ernest: *Bijës s'ime*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 17/1-4. Romë 1973. S. 259.

[24] Die Übersetzung stammt von der Autorin.

[25] Shuteriqi, Dhimitër S. u. a.: Historia e letërsisë shqiptare. Që nga fillimet deri te lufta antifashiste nacionalçlirimtare. Tiranë 1983. Die Literaturgeschichte Tiranas von 1959 kam bis zu der Epoche der Nationalbewegung. Die Zeit Koliqis konnte noch verschont davonkommen. Die Literaturgeschichte Prishtinas von 1975 ist ein Abdruck der letzteren.

[26] "[...] një grup profashistësh e fashistësh me tradhtarin Ernest Koliqin ne krye;" Ebd., S. 460.

[27] "[...] disa autorë klerikalë të Veriut dhe borgjezë të letërsisë së kohës, të cilët e idealizonin ose e lustronin jetën e malësisë (Fishta, Koliqi etj.) [...]" Ebd., S. 554.

gewandt, aber richtige wissenschaftliche Auseinandersetzungen gibt es leider nicht und die wenigen bewegen sich im Rahmen seiner literarischen Tätigkeit. Über den Diplomaten und Politiker Koliqi gibt es fast gar nichts. Der Grund ist hauptsächlich an fehlenden Quellen über ihn als Person und seiner politischen Wirkung, aber auch die Erforschung dieser Zeit in der alabnischen Historiographie. Die Folgen der von den Kommunisten beeinflussten Historiographie wirkt immer noch nach. In einem Artikel über den Verlust von Koliqi schreibt Camaj über das letzte Problem wie folgt:

> Aber von der anderen Seite wegen Mangel an Dokumentation habe ich Angst, dass die Rolle Koliqis als Sprecher der albanischen Kultur und Seelenaussteuer unter den Fremden, vor allem in den letzten dreißig Jahren, zum größten Teil im Schatten der Zeit geraten wird.[28]

5. Eine zusammenfassende Betrachtung

Ein Wissenschaftler muss sich über die Konsequenzen, die eine politische Tätigkeit mit sich bringt, von Anfang an im Klaren sein. Entweder man nimmt in Kauf, mit der politischen Gruppe, in der man tätig wird, u. U. unterzugehen, oder man lässt es ganz sein, beide schwierige oder schicksalhafte Schritte. All dies war Koliqi bewusst, wie er später in einem Artikel schreibt:

> Wer sich mit Politik beschäftigt, muss mit den Folgen, die aus dieser Tätigkeit hervorgehen, rechnen, d. h. (viele) Beschimpfungen und (wenige) Lobpreisungen erwarten, oft übertrieben, seien es die ersten oder die zweiten. [...] Als solcher, für einen Albaner, der sich mit Politik beschäftigt, ist die beste Haltung, weder die Lobpreisungen noch die Beschimpfungen zu berücksichtigen und wie die ersten so die zweiten durch das Sieb des Gewissens durchgehen zu lassen, ohne das Gerede der anderen zu beachten. [...] Ich kenne mich nicht als politischen Menschen, der sich mit Literatur beschäftigt, sondern als Literat, den besondere Umstände in den Tanz der Politik brachten. Deshalb verteidige ich mich als Literat. Was über mich als politischer Mensch geredet wird, macht mich weder heiß noch kalt: ich habe mich an das Refrain gewöhnt.[29]

---

[28] "*Por nga ana tjetër për mungesë dokumentacioni kam frigë se do të bjerë në pjesën ma të madhe nën hijen e kohës roli i Koliqit si zadhanës i kulturës dhe pajës shpirtnore shqiptare ndër të huej, sidomos në këto tridhet vjett e fundit.*" (Camaj, M.: *Nji humbje e randë.* In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978. S. 8).

[29] "Kush merret me politikë duhet të llogarisi pasojat qi rrjedhin nga nji veprimtarí e tillë, d.m.th. do të presi të sháme (shum) e làvde (pak), shpesh të teprueme në daç të parat në daç të dytat.[...] Kështu tue qêne, mâ i miri qindrim për nji Shqiptar qi merret me politikë âshte mos me i përfillë tepër as làvdet as të shámet dhe me i përshkue si të parat ashtu të dytat në sitën e ndërgjegjes së vet, pa i vû veshin fjalëve te hallkut. A nuk thotë goja e popullit: fjalët e hallkut dhe birat e gradhit nuk mbllen kurr? [...] E njehi veten jo njerí

Trotz alledem übernahm Koliqi diese politische Aufgabe, um für sein Land wirkungsvoller zu arbeiten, obwohl er wusste, dass die Politik im Albanien jener Zeit ein schwierigeres Unterfangen und die Linie zwischen Held und Verräter stark verschwommen war. In seiner Biographie, auch in diesem Artikel, liest sich seine politische Tätigkeit wie ein roter Faden seiner beruflichen Tätigkeit. Er widmete sich wie eh und je seiner Heimat, seiner Kultur und seiner Sprache. Seine Kollegen, Freunde und Weggefährten sahen das auch so. Das kommunistische Albanien reduzierte ihn darauf und verurteilte ihn deshalb aufs Schärfste. Das postkommunistische Albanien hat Koliqi im Zuge der gesamten Diaspora rehabilitiert und verschweigt diesen Teil seiner Karriere gänzlich. Eine andere Diskussion kann es sich auch angesichts der unfairen Behandlung des Nordens im Kommunismus nicht leisten.

Kein Mensch ist unpolitisch, würde man zu seiner Verteidigung sagen, aber auch dass der Zweck nicht alle Mittel heiligt, ist hier auch angebracht. Doch das ist eine Frage der Perspektive. Koliqi wird heute als Schriftsteller wahrgenommen und damit ist der Wunsch von Martin Camaj in Erfüllung gegangen.

Zitierte Literatur

Elsie, Robert: *Histori e letërsisë shqiptare*. Pejë 2001.

Bartl, Peter: *Albanien. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart*. Regensburg 1995.

Bartl, Peter: *Ernest Koliqi zum 70. Geburtstag*. In: *Südost-Forschungen* 32. S. 321-322. München 1973.

Begeja, Halim: *Kultura dhe politika e Koliqit*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

Berisha, Anton Nikë: *Ernest Koliqi. Poet e prozator*. Rende 1995.

Camaj, Martin: *Vorrimi i prof. Ernest Koliqit*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

Fortino, Italo C.: *Ernest Koliqi dhe Arbëreshët e Italisë*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

Gostenschnigg, Kurt (2017): *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*. Berlin.

Guzzetta, Antonio: *Ernesto Koloqi. Un poeta sociale*. Milano 1968.

Hoxha, Fatbardha: *Rreth kontributit të Ernest Koliqit si studiues i letërsisë*. In: *Studime shqiptare 3: Ernest Koliqi 1903-1075*. Shkodër 1995.

Jacomoni di San Savino, Francesco: *La politica dell'Italia in Albania nelle testimonianze del Luogotenente del Re*. Bologna 1965.

---

politike qi merret me letërsí, por letrar qi rrethâna të veçanta e hodhen në valle të politikës. Prandej mprohem si letrar. Shka flitet për mue si njerí politike nuk më bân as të nxehtë as të ftohtë: jam vaditë me at avaz." (Koliqi, Ernest: Migjeni dhe unë. In: Shêjzat (*Le Pleiadi*). Nr. 15/7-9. Romë 1971. S. 82).

Karamitri, Eli: *Koliqi dhe arsimi shqiptar*. In: *Studime Shqiptare* 3: Ernest Koliqi 1903-1975. Shkodër 1995.

Koliqi, Ernest: *Migjeni dhe unë*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 15/7-9. Romë 1971.

Koliqi, Ernest: *Tue bisedue me Prof. Joklin*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 16/1-4. Romë 1972.

Koliqi, Ernest: *Shqipja n'Universitetin e Padovës*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 17/1-4. Romë 1973.

Koliqi, Ernest: *Dy shkollat letrare shkodrane. E Etënvet jezuitë dhe e Etënvet françeskanë*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*). Nr. 17/9-12. Romë 1973.

Körner, Christine: *Der Beitrag der Exilblätter "Ora e Shqipnisë" und "Bashkimi Kombëtar" zur Verbreitung des Gedankens der nationalen Einheit*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

Krasniqi, Rexhep: *Ernest Koliqi dhe zhvillimi letrar në Kosovë*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

Schmitt-Neke, Michael: *Entstehung und Ausbau der Königsdiktatur in Albanien (1912-1937)*. München 1987.

Shuteriqi, Dhimitër S. u.a.: *Historia e letërsisë shqiptare. Që nga fillimet deri te lufta antifashiste nacionalçlirimtare*. Tiranë 1959/1983, Prishtinë 1975/1989.

Vuçani, Petro T.: *Jeta dhe veprat e Koliqit*. In: *Shêjzat* (*Le Pleiadi*): Numër Përkujtimuer kushtue Prof. Ernest Koliqit. Romë 1978.

Xhyra-Entorf, Jonida: *Soziokulturelle Aspekte bei Martin Camajs Prosawortschatz*. Wiesbaden 2006.

Zamboni, Giovanni: *Mussolinis Expansionspolitik auf dem Balkan. Italiens Albanienpolitik vom I. bis zum II. Tiranapakt im Rahmen des italienisch-jugoslawischen Interessenkonflikts und der italienischen "imperialen" Bestrebungen in Südosteuropa*. Hamburg 1970.

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACCADEMIA DELLE SCIENZE E DELLE ARTI DELLA KOSOVA

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
Section of Linguistics and Literature
Sezione di linguistica e letteratura

Konferencë shkencore ndërkombëtare
International scholarly conference
Conferenza scientifica internazionale

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI

ALBANISTIC STUDIES IN ITALY

GLI STUDI ALBANISTICI IN ITALIA

Programi / Program / Programma

Prishtina

22-23 tetor/ October/ ottobre 2019

22. 10.
9:00
Mehmet Kraja, Kryetar i ASHAK/ President of KASA/ Presidente dell'ASAK - Përshëndetje
Rexhep Ismajli, Francesco Altimari - Fjala e hapjes
9:30
I
Seancën e drejtojnë: **Rexhep Ismajli, Emanuele Banfi, Francesco Altimari**

- **Emanuele Banfi**: Vittore Pisani e la posizione della lingua albanese tra le lingue indoeuropee
- **Seit Mansaku**: Problemi i origjinës së gjuhës shqipe në shkrimet

albanologjike të Vittore Pisanit
- **Rexhep Ismajli**: Studiues italianë për prejardhjen e gjuhës shqipe – G. Bonfante
- **Floresha Dado**: Prometeizimi në letërsinë shqipe sipas autorit italian Mauro Geraci ("Prometeo in Albania")
- **Francesco Altimari**: Ballkanizma dhe italo-romanizma në ndërtimet foljore aspektuale të arbërishtes së Italisë
- **Leonardo Mario Savoia & Benedetta Baldi**: Clitic Orders in Imperative: Proclisis, enclisis and mesoclisis in Gheg, Tosk and Arbëresh
- **John Trumper**: The Role of Albanoid Groups (Albanian and Italo-Albanian) in Language Transmission (Italy and Calabria as an exemplum)

Pushim për kafe/ Coffe break/ Caffé
12:00
II
Seancën e drejtojnë: **Floresha Dado, Sabri Hamiti, Matteo Mandala**
- **Sabri Hamiti**: Ernest Koliqi: "Shêjzat" e letërsisë shqipe
- **Matteo Mandalà**: Studimet albanologjike në Universitetin e Palermos. Një këndvështrim tipologjik
- **Shaban Sinani:** Kadare në studimet italiane
- **Kujtim Shala**: Latiniteti ynë
- **Dhurata Shehri**: "Storia della letteratura albanese" apo "Histrori e letërsisë shqyptare"
- **Persida Asllani, Brunilda Dashi**: Studimet kritike për letërsinë shqipe të studiuesit italo-arbëresh Giuseppe Gradilone
- **Bashkim Kuçuku:** Impakti i një vepre historiografike në historitë e letërsisë shqipe dhe në tekste të tjera - Gaetano Petrotta *Popolo, lingua e letteratura albanese*

14:00 Pushimi i drekës/ Lunch/ Pranzo
16:00
III
Seancën e drejtojnë: **Seit Mansaku, Leonardo Mario Savoia, Shaban Sinani**
- **Osman Gashi**: Letërsia shqipe në fokusin e kritikës së Antonino Guzettas
- **Gëzim Gurga**: Francesco Solano për studimet arbëreshe gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX
- **Blerina Suta**: Botimi italisht i Kanunit përgatitur nga Dodaj, Fishta, Schiró (1941): disa konsiderata
- **Maria Luisa Pignoli**: Mbi projektin e Fjalorit të madh digjital të arbërishtes
- **Anton Berishaj**: Kontributi i Matteo Mandalasë për studimin e teksteve të vjetra arbëreshe
- **Mark Marku**: Ndihmesat e Zef Valentinit për studimet albanistike
- **Mimoza Priku**: Ateneu padovan dhe albanologjia
- **Nicola Scaldaferri**: I materiali arbëreshë negli archivi sonori in Italia
- **Edmond Çali:** Botimet e katedrës së shqipes në Universitetin L'Orientale të Napolit (1999 – 2016)

- **Sara Manali**: Negoziare l'obbedienza: l'integrazione tre cattolicismo e ortodossia nel' esperienza degli Italoalbanesi durante il papato di Benedetto XIV (sec. XVIII)
- **Merita Hysa**: Kontaktet gjuhësore dhe shfaqjet identitare në studimet albanologjikë në Itali
- **Evalda Paci**: Rreth disa kontributeve të veçanta shkencore mbi figurën e Gjergj Kastriotit-Skenderbeut në trevat italofone

23. 10.
9:00
I
Seancën e drejtojnë: **Victor Friedman, Persida Asllani, Teuta Abrashi**

- **Victor Friedman**: Studimet e Eric P. Hampit për arbërishten e Italisë
- **Imri Badallaj**: Martin Camaj në këndvështrimin e studimeve italo-arbëreshe
- **Remzi Përnaska, Tomor Plangarica**: Luigj Lysjën Bonaparti – gjuhëtari që vëzhgoi, përqasi dhe dëshmoi edhe për gjuhën shqipe dhe të folmet e saj
- **Aljula Jubani**: Studime të fonetikës eksperimentale mbi shqipen në UNICAL dhe kontributi i prof. John Trumperit
- **Bardh Rugova**: Parashikueshmëria e theksit në gjuhën shqipe – kontributi i Stefano Canalisit
- **Valbona Sinanaj**: Kontributi i Paolo Di Giovones për albanologjinë
- **Anila Omari**: Pikëpamjet e Dhimitër Kamardës për gjuhën letrare shqipe
- **Flora Koleci**: Rreth disa çështjeve morfosintaksore të trajtuara në veprën *Saggio di grammatologia compatrata della lingua albanese* të D. Camardës

Pushim për kafe/ Coffe break/ Caffé
11: 30
II
Seancën e drejtojnë: **Aljula Jubani, Imri Badallaj, Anton Berishaj**

- **Giuseppina Turano**: Kontributi i studiuesve italianë për sintaksën e gjuhës shqipe
- **Teuta Abrashi**: Rreth disa çshtjeve të diskutueshme të sintagmës emërore të shqipes
- **Shkumbin Munishi**: Studimet e Eda Derhemit për rrezikimin e arbërishtes në Itali
- **Rrezarta Draçini**: Gegërishtja përmes studimeve të L. M. Savoias
- **Genc Lafe**: Mbi disa çështje të përcaktimit të italianizmave në gjuhën shqipe
- **Maria Luisa Pignoli**: Arbëresh Plant Names: An Excample of Lexicon Through Motivation
- **Ardian Ndreca**: Revista "Shêjzat" votër e studimeve albanologjike në Itali (1957-1978)
- **Haki Hysenaj**: Kontributi i Koliqit për njësimin e gjuhës shqipe

14:00
Pushimi i drekës/ Lunch/ Pranzo
16:00
III
Seancën e drejtojnë: **Giuseppina Turano, Rusana Beyleri, Osman Gashi**

- **Rusana Bejleri**: Vendi i antologjisë në studimet albanistike në Itali

- **Majlinda Bregasi**: Një vend për Angela Cirrincionen në studimet albanistike
- **Doris Kyriazis**: Kohë dhe hapësirë për të menduar ndryshe – "Urat e Arbërit 2015" dhe "Arbërit e Jonit 2016" në optikën e albanistikës italiane
- **Berton Sulejmani**: Francesco Altimari për habitoren
- **Emilia Conforti**: Roli i Santorit në gjuhën shqipe
- **Atdhe Hykolli**: Revistat arbëreshe dhe identiteti
- **Begzad Baliu**: Vlerësime të Profesor Jup Kastratit për albanologjinë e proviniencës gjuhësore italiane
- **Meliza Krasniqi**: Roma e Musine Kokallarit
- **Agron Gashi**: De Rada sipas Arshi Pipës
- **Abdullah Rexhepi**: Vepra e Naim Frashërit në perspektivën italiane
- **Shpëtim Elezi**: Studiuesit italianë për shqipen dhe shqiptarët në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës

NGA KONFERENCA/ FROM THE CONFERENCE/ DALLA CONFERENZA

Përshëndetja e Komferemcës nga Kryetari i ASHAK-ut, akademik Mehmet kraja

Një minutë heshtje – nderim për Wilfried Fiedler-in

Nderim për Wilfried Fiedler-in

Persida Asllani

STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI
ALBANISTIC STUDIES IN ITALY
GLI STUDI ALBANISTICI IN ITALIA

Konferencë shkencore ndërkombëtare/ International Scholarly Conference
Conferenza scientifica internazionale

Prishtina 2019, 22-23 Tetor, October, Ottobre

Përgatiti: Akademik Rexhep Ismajli

2020

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:
ASHAK

Madhësia: 35.50 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

811.18(062)
821.18(062)
008(=18:450)(062)

Studimet albanistike në Itali : konferencë shkencore ndërkombëtare, Prishtina 2019, 22-23 tetor = Albanistic studies in Italy : international scholarly conference = gli studi albanistici in Italia : conferenza scientifica internazionale / përgatiti për botim Rexhep Ismajli. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2020. - 568 f. 24 cm.

Titulli paralel në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane

1.Ismajli, Rexhep

ISBN 978-9951-26-020-6

ISBN 978-9951-26-020-6